REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI " FAN S . NOLI"
"FAKULTET I I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË
KORÇË

"FAN S. NOLI NË 130 - VJETORIN E LINDJES" 1882-2012

KONFERENCA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE

(Përmbledhja e materialeve të konferencës kushtuar Fan S. Nolit në 130 - vjetorin e lindjes)

Korçë, 2012

“FAN S. NOLI NË 130 - VJETORIN E LINDJES” 1882-2012

KONFERENCA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE

(Përmbledhja e materialeve të konferencës kushtuar Fan S. Nolit në 130 - vjetorin e lindjes)

BOTIM I FAKULTETIT TË EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË

Miratuar për botim me vendim të Këshillit të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë

Redaksia e botimit:

Prof. dr. ALI JASHARI

Msc. HYSNIE HYSKA

Përgatitja kompjuterike:

EDIOLA NASE

BENISA KOKONOZI

ISBN: 978-9928-146-05-2

Botime “FEF”, SCRIPTA MANENT, 3

Korçë, 2012

promo print Publishing House

Shtëpia Botuese: Promo Print Sh.p.k.

PROGRAMI I KONFERENCËS SHKENCORE NDËRKOMBËTARE

"FAN S. NOLI NË 130-VJETORIN E LINDJES"

SEANCA PLENARE
Hapja e konferencës, prof. dr. ALI JASHARI, dekan i Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë

- **Fjalët përshëndetëse:**
  - **Prof. as. dr. GJERGJI MERO, rektor i Universitetit të Korçës "Fan S. Noli"**
  - **akad. JORGO BULO, Akademia e Shkencave të Shqipërisë**
- **Referate:**

1. Prof.dr.NASHO JORGAQI: Kontributi i Nolit në marrëdhëniet shqiptaro-amerikane.

2. Akad.FLORESHA DADO: Fan Noli në sfidat e një Historie të re të Letërsisë Shqiptare.

3. Imzot JOHAN PELUSHI: Fan Noli dhe Kisha Shqiptare.

Kumtesa
Seksioni I: VEPRA LETRARE E FAN NOLIT

1.DHURATA SHEHRI: Pushteti i diskursit, diskursi i pushtetit në të folurit publik të Nolit.

2. ELVIRA LUMI: Fan Noli- poet politik apo i "dilemave të rastit'?"

3. ERIS RUSI: Madhështia dhe limitet e dramës "Izraelitë dhe filistinë"- Sipari i një vepre të hapur.

4. ESMERALDA HIDRI: Individualizmi i statusit dramatik i veprës "Izraelitë dhe Filistinë" *(Në kërkim të një metodologjie analizuese).*

5. KASTRIOT GJIKA: Çështje të receptimit historik të poezisë së Nolit.

6. VJOLLCA OSJA: Energjia simbolike në poezitë biblike të Fan Nolit.

7. ILIR SHYTA: Nol-Samsoni, letraro- biblik.

8. KLODIANA KULLOLLI: Mjeshtëria e vargut nolian.

9. MIRLINDA KRIFCA-BEQIRI: Çështja e varianteve dhe versioneve në poezinë e Fan Nolit.

10. NUHI VINCA: Për një botim kritik të një poezie të "Albumit" të Nolit.

11. SKËNDER KARRIQI: Rasti prometeik i poezisë së Fan. S. Nolit

12. YLLKA KËNAÇI, LAURETA DHOSKA: Fan Noli si përçues i frymës perëndimore në letërsinë shqipe.

Seksioni II: VEPRA LETRARE E FAN NOLIT

1. ADEM JAKLLARI, MARINA PRIFTI: Shenja dhe kode mitike në poezinë e F. S. Nolit.
2. AGRON XHAGOLLI: Folklori në vëmendjen e Fan S. Nolit.
3. AJLIDA SELIMI: Fan S. Noli dhe Historia e Letërsisë.
4. ALBANË MEHMETAJ: Drama e Fan Nolit.
5. BRUNA NURA: Noli përmes simbolikave biblike.
6. GLADIOLA DURMISHI (ELEZI): Simbolika dhe muzikaliteti në poezinë e Fan S. Nolit.
7. JONELA SPAHO: Roli i satirës dhe humorit në poezinë e Nolit, në funksion të artikulimit ideor.
8. JOSIF PAPAGJONI:"Izraelitë e filistinë" – kumti biblik dhe "loja" me kohën (ose që tejkalon kohën).
9. KRISTAQ JORGO: Kuantemnanca në poezinë dhe shqipërimet e F.S.Nolit.
10. MERITA GJOKUTAJ-SHEHU: Muzikaliteti në poezinë e Nolit.
11. NELI NAÇO: Disa arritje poetike në poezinë "Marshi i Barabajt".
12. NIAZI XHAFERAJ: Vështrim rreth figurave stilistike dhe elementeve të vjershërimit në poezinë e Nolit.
13. RAHIM OMBASHI: Duke ridëgjuar letrën e fundit.
14. XHULIANA LIÇI: Mbi një tipologji interpretimesh të ideve në dramën "Izraelitë dhe filistinë".
15. YMER ÇIRAKU: Një letër e Krist Malokit dhe Autobiografia e Nolit.
16. ZEJNEPE ALILI (REXHEPI): Simbolika poetike e Nolit si "frymë e kohës" apo tendencë më se moderne.

Seksioni III: ÇËSHTJE GJUHËSORE NË VEPRËN E FAN NOLIT

1. ABDULLA BALLHYSA, MIRELA SHELLA: Khajamin persishtes - Rubaitë shqipes.

2. AJTENE QAMILI: Orientalizmat në poezinë e Fan S. Nolit.
3. ALBANA NDOJA: Mbi mundësinë e një qasjeje drejt korpusit nolian me anë të figuracionit strukturor gjuhësor. Specifika stilistike të disa formave foljore karakteristike.
4. ELONA BIBA: Kohezioni në tekstin letrar të F. Nolit.

5. GIOVANNI BELLUSCIO; FLORA KOLECI: Risitë leksiko-gramatikore në përkthimet e Fan Nolit nga anglishtja (Hamleti, Makbethi, Othello, Jul Cezari).
6. ISMET OSMANI: Gjuha shqipe në shkrimet dhe përkthimet e Nolit**.**
7. SASHENKA KAMBERI, ALMIRA SADIKAJ: Rreth antonimisë dhe sinonimisë stilistikore në krijimtarinë poetike të F.S. Nolit.
8. SPIRIDHULLA POÇI: Dukuri morfologjike në krijimtarinë e Fan Nolit.
9. ALI JASHARI: Burimet e lëndës idiomatike në veprën e Fan Nolit.
10. ASLLAN HAMITI: Vlera ekspresive-impresive e tingujve në poezitë "Anës lumenjve" dhe "Rent, or Marathonomak" të Fan Nolit.
11. BESA SHINGJERGJI: Miti biblik dhe historizimi i tij.
12. LINDITA XHANARI: Vlera semantiko-stilistikore e huazimeve turko-orientale në veprën e Nolit.
13. LIRI SEITLLARI: Rreth shprehësisë leksikore në poezinë e Nolit.
14. MATILDA PARLLAKU (ÇOLLAKU): Veçori sintaksore në gjuhën e Nolit parlamentar.
15. MIMOZA ZEKAJ: Rreth pasurisë së leksikut politik e shoqëror në publicistikën e Fan Nolit.
16. NATASHA POROÇANI (SHUTERIQI): Noli në disa aspekte të pragmalinguistikës: përdorimi i teksteve të Nolit në mësimdhënien e gjuhës dhe letërsisë shqipe në shkollën e mesme.
17. SHKËLQIM MILLAKU: Kompozitat, roli dhe funksioni në përkthimet e Nolit.

Seksioni IV: ÇËSHTJE TË PËRKTHIMIT DHE PUBLICISTIKËS NË VEPRËN E FAN NOLIT

1. ARISTOTEL SPIRO: Fan S. Noli dhe shqipërimi si antinomi terminologjike.
2. ALDA CICKO (JASHARI): Një shqyrtim përqasës i "My native land" i Valter Skotit në përkthimin e Nolit.
3. ARJAN KALLÇO: Noli më shumë se përkthyes, është shqipërues i zoti.
4. ARTA XHIKA: Noli në optikën kritike të Koliqit.
5. EDLIRA ÇERKEZI, GLADIOLA DURMISHI, EVIS CELO: Mesazhet e Nolit në publicistikën shqiptare dhe aspiratat atdhetare.
6. FATMIR SULEJMANI : Raportet e Fan S. Nolit me Faik Konicën.
7. HEKTOR ÇIFTJA: Fan Noli dhe Arshi Pipa: dy kontekste dhe një tekst.
8. KLEDI SHEGANI: Mesazhet e publicistikës së Nolit, realitete përmes historisë.
9. DION TUSHI: Kontributi i Nolit në traditën e hershme të përkthimeve fetare nëpërmjet teksteve liturgjikë te përkthyer prej tij.
10. GËZIM RREDHI: Mendimi kritiko –letrar i Fan Nolit në lidhje me artin klasik botëror.

11. HAMIT XHAFERI: Vështrim mbi studimin e Nasho Jorgaqit "Udhëtim me Fan Nolin".

12. MELI SHOPI, DENIS HIMCI: Fan S. Noli si përkthyes e shqipërues dorëmbarë (Mbështetur kryesisht në përkthimin e romanit "Don Kishoti" të M. Servantesit**).**

13. MIMOZA SHQEFNI: Mesazhet e publicistikës së Nolit për realitetin dhe historinë shqiptare.

14. NEIM ZHURI: Noli: përkthyesi dhe kritiku.

15. VASILIKA POJANI, HILDA LUBONJA, ERIOLA BONJA: Poema "Skënderbeu" e Longfellout përmes shqipërimit të Fan S. Nolit.

16. VEHBI BEXHETI: Noli dhe Shekspiri.

17. VJOLLCA RRAPAJ, MIRELA SARAÇI: Një dokument i ri oratorik i Fan S. Nolit (Deklarata në Lidhjen e Kombeve, 2 tetor, Gjenevë, 1921)

Seksioni V: ÇËSHTJE TË HISTORISË DHE POLITIKËS NË VEPRËN E FAN NOLIT

1. ADELINA NEXHIPI: Gjashtë muajt e qeverisjes së Nolit (arritjet dhe dështimet e Nolit si kryeministër).

2. ALBA KREKA: Figura e Nolit në studimet historike komuniste dhe bashkëkohore.

3. BASHKIM JAHOLLARI, PAVLLO CICKO: Fan Noli dhe lidhjet e tij me Korçën.

4. BLERIM BALLA: Fan Noli dhe Revolucioni i Qershorit 1924.

5. DRITAN PALNIKAJ: Fjalimi i Fan S. Nolit në Lidhjen e Kombeve në 10 shtator 1924 si shprehje e pikëpamjeve të tij për politikën ndërkombëtare.

6. ERINDA PAPA, BENITA STAVRE, PAVLLO CICKO: Përpjekjet e Fan Nolit në planin ndërkombëtar për të zgjidhur ngërçet e politikës shqiptare.

7. ESTELA HOXHA: Veprimtaria e Fan S. Nolit në Lidhjen e Kombeve në vitet 1920-1921.

8. ETLEVA BRESHANI (NITA): Qasje dhe interpretime për figurën e Fan S. Nolit dhe "Revolucionin e Qershorit" në tekstet shkollore para dhe pas viteve '90.

9. FEHMI XHEMO, JONELA SPAHO: Fan S. Noli, deputet i krahinës së Devollit.

10. ERMELINDA KASHAHU, EDLIRA DHIMA: Laureati dhe intektuali shqiptar që ndikoi figurën e humanistit.

11. ETLEVA GOXHAJ: Dritëhijet e një politikani: Noli në Lidhjen e Kombeve gusht –tetor 1924.

12. FADIL GRAJÇEVCI: Fan Noli dhe Marin Barleti.

13. IRENA NIKAJ: Napoleoni, shekulli i Dritave dhe Noli-një jehonë noliane në kohë të tjera.

14. ORJON AGO: Veprimtaria politike e Fan S. Nolit në vitet 1923-1924 sipas shtypit të qytetit të Korçës.

15. RUDINA MITA, LIRA GJEVORI, HYSEN KORDHA: Alternativa e opozitës demokratike për zgjidhjen e krizës politike në Shqipëri në fillim të vitit 1924.

16. SHKËLZEN RAÇA: Veprimtaria e Fan Nolit në pavarësimin e kishës ortodokse shqiptare.

17. SHYQYRI HYSI: Homazh i Asamblesë Kushtetuese dhe fjala e Nolit për Udro Uilsonin, shkurt 1924.

18. VALBONA KALO (SHËNGJERGJI): Kritika funksionale e Nolit, në kontekstin social-politik të viteve 1926-1930.

19. ZEQIR KADRIU: Fisnikërimi e edukimi i Nolit në Ibrik Tepe.

20. EDLIRA DHIMA, ERMELINDA KASHAHU: Noli-një figurë poliedrike

21. MAZLLUM BARALIU: Eruditizmi i Fan S. Nolit, rrjedhojë e kushteve dhe rrethanave të kohës apo e gjenialitetit poliedrik të personalitetit të tij.

22. BEGZAD BALIU: Noli dhe shekulli i Pavarësisë.

SEANCA PLENARE

Prof. dr. ALI JASHARI
Dekan i Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë

FJALA E HAPJES NË KONFERENCËN SHKENCORE NDËRKOMBËTARE "FAN S. NOLI NË 130- VJETORIN E LINDJES"

Të nderuar pjesëmarrës!
Ju përshëndes të gjithëve dhe në emër të stafit akademik dhe të studentëve të Fakultetit të Edukimit dhe të Filologjisë, ju uroj mirëseardhjen në Universitetin e Korçës, që mban me nder emrin e Nolit tonë të madh, qysh nga 25 maji i vitit 1994, një emër që e kërkuan gjithë intelektualët dhe anëtarët e shoqërisë "Fan Noli", siç shkruante në shtypin e asaj kohe z. Kristaq Kotonika, një nga profesorët dhe drejtuesit e këtij institucioni.
Kjo konferencë me karakter shkencor e jubilar ka disa veçanësi, për nga vlerat që sjell, për momentin që po mbahet, por, mbi të gjitha, për faktin se ajo rrok një sërë problemesh që lidhen me studimin e veprës dhe të veprimtarisë së gjithanshme të Fan Nolit, si dhe për dëshirën e madhe të 115 profesorëve dhe studiuesve nga 14 universitete dhe institucione shkencore brenda dhe jashtë vendit, të cilat po i paraqes më poshtë:
Universiteti i Durrësit "Aleksandër Moisiu"
Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
Universiteti i Gjirokastrës "E. Çabej"
Instituti Albanologjik i Prishtinës
Universiteti i Kalabrisë, Itali
Universiteti i Prishtinës, Kosovë
Universiteti i Prizrenit, Kosovë
Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë
Universiteti i Shkupit "Shën Kirili e Metodi", Maqedoni
Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, Maqedoni
Universiteti Shtetëror i Tetovës, Maqedoni
Universiteti i Tiranës
Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali"

Dua të përshëndes pjesëmarrjen e veçantë në këtë konferencë të prof. dr. Nasho Jorgaqi, një nga studiuesit më të shquar të veprës së Nolit, akad. Floresha Dado, akad. Jorgo Bulo, Imzot Joan Pelushit.

Më në fund, do të përmend përkushtimin e studentëve të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë për shfaqjen artistike që kanë përgatitur me këtë rast, si dhe punonjësit e mediave që do ta përcjellin këtë veprimtari.

Duke e hapur këtë konferencë shkencore ndërkombëtare kushtuar 130-vjetorit të lindjes së Fan Nolit, uroj punime të mbara dhe sa më shumë "bereqet" shkencor edhe në veprimtari të tjera.

Faleminderit!

Prof. as. dr. GJERGJI MERO
Rektor i Universitetit «Fan S. Noli »

FJALA PËRSHËNDETËSE NË KONFERENCËN SHKENCORE NDËRKOMBËTARE "FAN S. NOLI NË 130- VJETORIN E LINDJES"

I nderuar prefekt i Qarkut të Korçës z. Andrea Mano
I nderuar Kryetar i Këshillit të Qarkut të Korçës z. Landi Gushi
I nderuar hirësi e tij, imzot Johani
Të nderuar akademikë, pedagogë e studentë, miq e të ftuar nga Shqipëria, Kosova, Tetova e nga trojet e tjera shqipfolëse
Të nderuar pjesëmarrës

Është kënaqësi për mua, që në emër të stafit akademik dhe studentëve të Universitetit tonë t'ju përshëndes dhe falenderoj për praninë tuaj në këtë konferencë shkencore ndërkombëtare që Universiteti ynë planifikoi të organizojë në kuadrin e veprimtarive të shumta e të larmishme mbarëkombëtare që po organizohen dhe do të organizohen gjatë këtij viti jubilar me rastin e 100- vjetorit të pavarësisë, kësaj ngjarje të shënuar për kombin shqiptar.

Konferenca që Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë në Universitetin tonë po zhvillon sot, i kushtohet një prej figurave më të mëdha të kombit tonë, poetit, përkthyesit e historianit, dijetarit, artistit, studiuesit, eruditit, sociologut, politikanit e filozofit, burrit të shtetit Fan Stilian Nolit. E ndjejmë si detyrim, por është dhe në nderin e Universitetit tonë, të këtij Institucioni Akademik Universitar që mban me nder emrin e personalitetit të madh e të shquar të historisë e kulturës kombëtare, Fan S. Nolit, që të vlerësojë dhe nderojë këtë burrë të mençur e patriot në 130- vjetorin e lindjes së tij.

Qëllimi i kësaj konference që ne po mbajmë sot, është që të nxjerrim edhe më shumë në dritë punën dhe veprën e Fan Nolit dhe patriotëve e dijetarëve shqiptarë në përgjithësi dhe atyre korçarë në veçanti, për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare nëpërmjet veprave dhe historisë që ata shkruan duke mos u tërhequr asnjëherë nga përpjekjet dhe lufta e tyre e pamposhtur për liri, dije dhe kulturë.

Fan S. Noli ishte një burrë shteti, poet, përkthyes e historian shqiptar, përfaqësues i shquar i letërsisë demokratike që u zhvillua në Shqipëri fill pas Rilindjes. Ai dha një kontribut të çmuar për Shqipërinë dhe thesarin e kulturës kombëtare shqiptare.

Veprimtaria krijuese e Nolit nis me publicistikën dhe oratorinë të cilat shprehin qartë pikëpamjet e tij thellësisht demokratike dhe janë si një kronikë e jetës politike e shoqërore shqiptare. Karakteristikat kryesore të tyre janë mendimi i qartë dhe i mprehtë, qëndrimi i drejtë dhe i prerë dhe reagimi i menjëhershëm ndaj ngjarjeve më të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare. Larminë dhe rëndësinë e veprimtarisë së Nolit e shtojnë mjaft edhe studimet e tij për Skënderbeun, heroin tonë kombëtar, për

figurën e madhe të Bethovenit "Bethoveni dhe Revolucioni Francez" etj. "Historia e Skënderbeut" është vepra së cilës Noli iu rikthye disa herë.

Shkrimet kritike të Nolit pohojnë jo vetëm gjykimin e thellë dhe kulturën e gjerë të tij, por edhe sepse pikëpamjet e tij mbi letërsinë janë nga më përparimtaret. Në to ndihet menjëherë mjeshtëria e Nolit për të shprehur qartë e thjeshtë çështje të ndërlikuara e të diskutueshme të letërsisë botërore. Gjatë analizave që u bën veprave të Shekspirit, Servantesit, Ibsenit, Omar Khajamit etj. , Noli solli gjithnjë, përballë veprës letrare, përvojën jetësore dhe ligjet e shoqërisë.

Noli si përkthyes i krijoi vetes një vend nderi në letrat shqiptare. Këtë ai nuk e arriti vetëm pasi ishte njohës i mirë i disa gjuhëve si greqishtja, latinishtja, frëngjishtja, spanjishtja, anglishtja, gjermanishtja, turqishtja etj, por sepse krahas talentit për të mësuar gjuhët e huaja, Noli njihte mirë thesarin e gjuhës amtare e gjithashtu njihte thellë kulturën botërore dhe atë kombëtare, kishte aftësi të tilla gjykimi dhe shije aq të hollë sa mundi të zgjedhë e të përkthejë vepra të shquara të shkrimtarëve të mëdhenj botërorë, që jo vetëm e pasuronin kulturën tonë kombëtare por edhe u bënin direkt jehonë shumë problemeve aktuale të realitetit shqiptar.

Universiteti “Fan S. Noli ”, si qendra më e madhe arsimore dhe shkencore e rajonit të Korçës, e ka për nder dhe detyrë që të jetë nismëtar i kësaj konference shkencore ndërkombëtare, në bashkëpunim me institucione brenda dhe jashtë vendit, sepse duke përkujtuar Nolin në 130-vjetorin e lindjes, në 100- vjetorin e Pavarësisë, në këtë vit me ngjarje historike për kombin tonë, ne evidentojmë dhe evokojmë vlerat e larta atdhetare e patriotike të veprimtarëve të shquar shqiptarë, që luftuan pa u kursyer për çështjen kombëtare.

Universiteti ynë, si tempulli më i lartë i dijes në rajonin e Korçës, duke u mbështetur në këto vlera të pamohushme që na kanë lënë brezat, do të dijë t’i ngrejë edhe më lart ato, nëpërmjet ngritjes dhe lartësimit të emrit të tij, të emrit të Nolit të madh me arritjen e niveleve më të larta mësimore e shkencore duke u përballur më denjësisht me sfidat e kohës dhe kërkesat që shtrohen sot para arsimit të lartë shqiptar për plotësimin e standardeve që kërkon Ligji i Arsimit të Lartë, Procesi i Bolonjës ku ne jemi të përfshirë tërësisht dhe intensivisht.

Të nderuar pjesmarrës në këtë konferencë!
Duke çmuar dhe vlerësuar praninë e autoriteteve vendore dhe akademike, angazhimin dhe vlerësimin që i kanë bërë kësaj konference mjaft akademikë, studiues dhe pedagogë, brenda dhe jashtë vendit duke u paraqitur në të me referime e kumtesa, dua t’ju falenderoj dhe i uroj në emër të stafit akademik të Universitetit suksese dhe punime të mbara kësaj Konference.

Ju faleminderit!

Akademik JORGO BULO

FJALA PËRSHËNDETËSE NË KONFERENCËN SHKENCORE NDËRKOMBËTARE "FAN S. NOLI NË 130- VJETORIN E LINDJES"

I nderuar Zoti Rektor,
Të nderuar autoritete vendore dhe fetare,
Të dashur kolegë dhe studentë,

Kam nderin që në emër të Akademisë së Shkencave të përshëndes dhe t'i uroj punë të mbarë Konferencës suaj shkencore kushtuar 130-vjetorit të lindjes së Fan Nolit.

Kjo konferencë, në serinë e shumë veprimtarive të tjera shkencore që ka organizuar Universiteti juaj, është një dëshmi e rritjes së këtij universiteti si një vatër e dijes dhe e kërkimit shkencor. Niveli shkencor që premton programi i Konferencës dhe pjesëmarrja në të e specialistëve të njohur të fushave ku ka shkëlqyer mendja universale e Fan Nolit, është një garanci e suksesit të Konferencës.

Universiteti i Korçës ka fatin të mbajë një emër të madh, emrin e Fan Nolit. Burrë shteti, poet, përkthyes, publicist dhe dramaturg, historian, kritik letrar dhe muzikolog, erudit poliglot, themelues i Kishës Autoqefale Shqiptare, Fan Noli është gjeniu i kulturës shqiptare të shekullit XX, jeta e të cilit u shtri në dy shekuj dhe tri epoka historike. Një rrugëtim i gjatë tetëdhjetetrevjeçar, nga djepi ku e përkundi Gjyshe Sumba, në shtratin e prehjes së amshuar ku e përcolli nga larg atdheu i tij, nga një ngulim i humbur shqiptarësh në Ibrik Tepe, në kontinentin e ri, nga shkolla fillore greke e fshatit, ku e çoi të futur në thes Nënë Maria, në Harvard, nga përdorues vetëm i zhargonit shqip të katundit, në mjeshtër të shqipes të kultivuar dhe njohës të nja dhjetë a më shumë gjuhëve të tjera, nga sufler teatri, në foltoren e Lidhjes së Kombeve në Gjenevë, nga Kryeministër i Shqipërisë në një azilant të ndjekur nga ankthi për bukën e gojës, nga përkthyes në greqisht i një libri programor të Sami Frashërit për të shkuarën dhe të ardhmen e Shqipërisë, në shqipërues të kryeveprave të letërsisë botërore, nga i dënuar me vdekje prej monarkisë, në të pavdekshëm, kjo është jeta e Fan Nolit.

Ju e përkujtoni sot Fan Nolin në 130-vjetorin e lindjes, në këtë vit të 100-vjetorit të Pavarësisë, jo për një koincidencë të rastit, por sepse Fan Noli është një nga protagonistët dhe arkitektët e mëdhenj të pavarësimit të kombit, të ndërtimit të kulturës kombëtare, një shtetar i madh dhe diplomati që i siguroi shtetit shqiptar njohjen ndërkombëtare në Lidhjen e Kombeve.

Kalorës i dy utopive të mëdha dhe vuajtës prej tyre, me peshën e rëndë të Kryqit të Krishtërimit dhe të stërhalleve të vendit të vet, Noli njeri, artist e politikan, i kapërthyer midis kundërthëniesh e dilemash tragjike, i përballoi ato me filozofinë biblike të përkohësisë së fitimit të çastit dhe të përjetësisë së shembullit moral. Ai

është një Jezu "që do të shpëtojë llauzin e vet nga fajet e tij" dhe jo veten e vet nga vuajtja e sakrifica, deri te sakrifica sublime e idealistit të përkushtuar.

Heroi i idealizuar i një revolucioni të dështuar dhe i përfolur nga ithtarët për shkaqet e këtij dështimi, ose nga kundërshtarët për pasojat e atij revolucioni prej të cilit bejlurçina nuk e mori dot më veten, Noli mbeti besnik i bindjeve dhe moralit të tij; ai parapëlqeu të mbetej tërë jetën vuajtës, Moisi përjetësisht i djegur nga malli për "tokën e premtuar", duke neveritur jetën e qetë të paguar me çmimin e humbjes së dinjitetit; me fjalë të tjera parapëlqeu, siç shkruan vetë, "më mirë i vdekur në syrgjyn e në rrogoz, se i gjallë e i katandisur në Qoshen e Bejlerëve".

I rrethuar për së gjalli prej judësh mercenarë e derbederë dhe i ndjekur për së vdekuri sot e kësaj dite prej hakmarrjes së hienave politike, Noli mbetet simbol i liberatorit që sfidon konjukturat e çdo kohe. Kjo sepse Noli njeri, artist e shkencëtar, u angazhua në betejat mendore, shoqërore e politike si idealist atdhetar e demokrat, pa ambicie karriere politike personale. Prandaj ai nuk la kufoma në fushën e këtyre betejave, por la mësime historike e morale. Fan Noli jetoi një jetë dhe la një vepër mesazhi dhe morali i të cilave i kalon kufijtë e kohës së tij. Kumti aktual dhe i përjetshëm i jetës dhe i veprës së tij është morali i *kurajës dhe i dinjitetit,* që aq shumë u duhet shqiptarëve sot.

Duke ju falënderuar për ftesën dhe duke përshëndetur organizimin dhe synimin e këtij tubimi shkencor për të hedhur dritë në veprën e këtij krijuesi gjenial e të papërsëritshëm në kulturën shqiptare, edhe njëherë i uroj Konferencës suaj punë të mbarë.

Prof. NASHO JORGAQI

ROLI I FAN NOLIT NË MARRËDHËNIET SHQIPTARO-AMERIKANE

Marrëdhëniet diplomatike shqiptaro-amerikane kanë prehistorinë dhe historinë e tyre, në të cilat një rol parësor padyshim ka luajtur Fan Noli. Në këtë rol e kanë zanafillën përpjekjet e shqiptarëve të Amerikës për të hedhur që herët urën e njohjes dhe bashkëpunimit të ndërsjelltë mes vendit të tyre të vogël dhe njërës prej fuqive më të mëdha të botës. Në qoftë se pranojmë se Federata "Vatra" në vitet 1915-1920 u bë si të thuash një qeveri e shqiptarëve në mërgim, atëherë nuk mund të lemë në harresë tërë atë veprimtari të dendur e të frytshme që ajo zhvilloi për t'u hapur rrugën marrëdhënieve diplomatike të mëvonshme. Puna e përkushtuar e Nolit në udhëheqje të saj i shërbeu jo vetëm afrimitetit dhe konsolidimit të pozitës së komunitetit shqiptar në SHBA, por dhe rolit aktiv që ajo duhet të luante në një akt historik të pritur, siç ishte vendosja e marrëdhënieve diplomatike midis dy vendeve. Në këtë drejtim Noli bëri një punë të madhe, gati të pazëvendësueshme, nga një anë, për njohjen dhe propagandimin e Shqipërisë dhe të vlerave të saj etno-historike para opinionit amerikan dhe, nga ana tjetër, për legjitimitetin e të drejtave të popullit të tij në qarqet zyrtare amerikane. Prapa kësaj prehistorie qëndron një veprimtari e gjithanshme me synime të qarta politike e me një strategji patriotike, me vështirësi të jashtëzakonshme, po të marrim parasysh terrenin e një vendi të madh multinacional dhe në një kohë kur, siç thotë F. Konica, "fati i Shqipërisë ishte në balancë".

Përpjekjet e "Vatrës" me në krye F. Nolin për të mbjellë farën e bashkëpunimit e kanë fillesën menjëherë pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Në 1913 ishte puna e Nolit me shokë që siguroi mbështetjen e një personaliteti si Ç. Krane, i cili do të ndikonte në Konferencën e Ambasadorëve të Londrës me anë të E. Greit për një zgjidhje të drejtë të çështjes shqiptare. Më pas, më 21 gusht 1915, ishte Noli ai që hodhi hapin e parë zyrtar, duke i drejtuar Sekretarit të Departamentit të Shtetit R. Lansing një telegram, me anën e të cilit denonconte traktatin e fshehtë të Londrës dhe kërkonte nga Presidenti Uillson "të parandalonte ndarjen e Shqipërisë nga Fuqitë e Mëdha". Brenda një kohe të shkurtër u arrit që të krijohet Komiteti i miqve të Shqipërisë me figura të njohura filoshqiptare, si Ç. Krane, S. Uilliams, R. Uds, T. Erikson etj. Puna e këtij komiteti bëri që t'i çelet rruga vargut të kontributeve që ata do të jepnin për mbrojtjen e interesave të Shqipërisë, nga të cilat mund të përmendim hapjen e konsullatës së parë shqiptare në SHBA.

Në vitet 1917-1918, që mbahen mend dhe si kohë e artë e "Vatrës", Noli, si kryetar i saj, zhvilloi një veprimtari të dendur politike, me peshë disa herë vendimtare. Krahas një takimi zyrtar në Departamentin e Shtetit, ai arrin të bisedojë personalisht me ish-presidentin e SHBA-së, T. Ruzvelt dhe të marrë prej tij mesazhin se "Shqiptarët i dua dhe i admiroj se janë një racë e vjetër dhe trima dhe se independenca e Shqipërisë duhet restauruar dhe garantuar nga fuqitë aleate. " Pas një viti, më 4 korrik 1918, Noli, duke përfituar nga pjesëmarrja si delegat në Kongresin e Kombeve

të Shtypura në Uashington, takohet dhe bisedon me Presidentin e atëhershëm të SHBA Uillsonin. Kanë mbetur të skalitura në kujtesën shqiptaro-amerikane fjalët gjeneroze të burrështetit idealist që i shqiptoi ai Nolit: "Unë do të kem vetëm një zë në Konferencën e Paqes në Versajë dhe këtë zë do ta përdor në interes të Shqipërisë. " Në këto fjalë historike zë fill ai qëndrim dashamirës i politikës amerikane ndaj Shqipërisë dhe jo më kot mendimi i ri historiografik shqiptar e cilëson atë si gur themeli të politikës së SHBA-së ndaj vendit tonë. Akti i parë i këtij miku të madh të shqiptarëve është denoncimi i traktatit famëkeq të Londrës, për t'u pasuar me përkrahjen që i dha Shqipërisë në Konferencën e Paqes të Versajës.

Aksionet politike e kulturore që Noli ndërmori në vitet 1917-1918 janë të gjithanshme dhe nga më të ndryshmet, të papraktikuara deri atëherë në atë shkallë nga qarqet shqiptare për të njohur e propaganduar kauzën e atdheut të tyre në Amerikë. Kanë hyrë në analet e historisë së bashkësisë shqiptare konferencat e tij përpara auditorëve amerikane, duke filluar nga Universiteti i Harvardit, nëpër klube e shoqata, e deri nëpër kisha të sekteve të ndryshme. Janë këto mbledhje që bëhen shkas që të shtohen radhët e shoqatës "Miqt' e Pavarësisë së Shqipërisë" me dhjetëra anëtarë të rinj. Noli shkon e flet dhe në Kemp Deivis para ushtarëve amerikanë me origjinë shqiptare që stërviteshin për luftë. "Shqipëria, - u drejtohet ai bashkëkombësve të tij, - i është borxhli Amerikës. Borxhin do ta shlyejmë vetëm duke luftuar në front për fitoren. Është një shans për t'ia shpërblyer".

Shtypi amerikan u bë tribunë dhe mjet i efektshëm i Nolit për të ndriçuar të vërtetën mbi Shqipërinë dhe shqiptarët. Janë me dhjetëra artikujt që ai boton në gazetat e njohura, si "Nju Jork Herald", "Nju Jork Taims" apo "Boston Herald", "Boston Glob" etj. Por për Nolin dhe shokët e tij nuk mjafton vetëm kjo. Nga shtatori i 1918, ai fillon botimin dygjuhësh të revistës "The Adriatic Review" me qëllim që, siç del nga kryeartikulli i parë, "të bëjë të njohur çështjen tonë para amerikanëve, për miliona njerëz" dhe të tërheqë në këtë kauzë bashkëpunimin e intelektualëve amerikanë. Në faqet e kësaj reviste, Noli realizon një nga dëshirat e tij krijuese, duke përkthyer në shqip faqe nga më të bukurat të poezisë amerikane. Përkthen jo vetëm vjersha të E. Poes, po edhe poemën: Skënderbeu" të Longfellout, që zgjon krenarinë e shqiptarëve.

Me rimëkëmbjen e shtetit shqiptar në vitet '20 është përsëri F. Noli, i dërguar i "Vatrës", ai që kryeson delegacionin shqiptar dhe falë aftësisë dhe meritave të tij Shqipëria pranohet në Lidhjen e Kombeve. Hyrja e saj në këtë forum të lartë ndërkombëtar krijoi premisat dhe bazën ligjore për njohjen zyrtare të Shqipërisë, në fillim nga Fuqitë e Mëdha europiane dhe pastaj nga SHBA-ja. Dhe është një koincidencë fatlume që përsëri do t'i takojë nderi Nolit që, duke qenë Ministër i Jashtëm i Shqipërisë, të nënshkruajë në janar të vitit 1922, tamam nëntëdhjetë vjet më parë, notën zyrtare të qeverisë shqiptare që kërkon vendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis dy vendeve.

Në ngjarjet që erdhën më vonë, ku Noli u bë i njohur si një nga protagonistët e tyre, mund të përmendim dy momente që lidhen me marrëdhëniet shqiptaro-amerikane. Në shkurt të vitit 1924 vdiq, siç dihet, presidenti i Amerikës Uillsoni dhe me këtë rast Noli mbajti para Parlamentit shqiptar një fjalim panegjirik, nga më të

fuqishmit e oratorisë së tij. Ai e quan Uillsonin "amerikani i madh, idealist bujar, diell i vegjëlisë, mbrojtës i Shqipërisë" dhe kjo i jep shkas të shpallë të vërtetën e pakundërshtueshme se Amerika u bë për shqiptarët fushë pune, se një e katërta e Shqipërisë së Jugut ushqeheshin me kurbetin e Amerikës, po dhe shkollë, ku mësuan të respektojnë ligjet, disiplinën, vlerën e organizimit, detyrat ndaj atdheut. Ishte mirënjohje ndaj këtij vendi bujar, por dhe nderimi i thellë për gjithçka sa kish bërë presidenti Uillson për Shqipërinë që, me propozimin e Vatrës, qeveria e kryesuar prej Nolit, më 21 gusht 1924, i dha portit të Shëngjinit emrin e tij.

Koha e qeverisjes së Nolit pas Revolucionit të Qershorit, nga sa dëshmojnë dokumentet, nuk u pa me sy të keq nga shteti amerikan, sidomos në fillimet e veta, por më vonë, kur erdhi puna për ta njohur zyrtarisht, nuk e hodhi këtë hap. Kjo ndodhi si për shkak të ndikimit negativ të Anglisë dhe të politikës izolacioniste që ndiqte SHBA-ja asaj kohe, ashtu dhe për radikalizmin e pikëpamjeve dhe qëndrimeve të vetë Nolit. Pra, ishin, siç pohon historiani A. Puto, më shumë shkaqe politike se sa juridike. Megjithatë, Noli do t'i qëndrojë besnik atdheut të tij të dytë dhe gjithë sa ndodhën në jetën e tij të trazuar deri në fillim të viteve '30 nuk do ta lëkundin pozitën e shqiptaro-amerikanit të madh.

Pas largimit disavjeçar nga jeta politike, Noli u shfaq rishtazi në vitet e Luftës së Dytë Botërore dhe përsëri në krye të "Vatrës" për të mbrojtur interesat e Shqipërisë në arenën e politikës amerikane. Në këto vite ai mban lidhje ose bashkëpunon me Departamentin e Shtetit, me Zyrën Informative të Luftës (OWI – Office of War Information), me Zyrën e Shërbimeve Strategjike (OSS – Office of Strategic Services), me radion "Zëri i Amerikës" etj. Gjithë përkushtimi i Nolit në rrethanat e luftës botërore e të rreziqeve të mëdha ishte të siguronte njohjen e ekzistencës politike të Shqipërisë, pavarësinë dhe integritetin e saj të pasluftës.

Duke jetuar në një nga metropolet e mëdha të politikës botërore, ai do të qëndronte gjithnjë syçelët dhe do të ndërmerrte me guxim e vendosmëri aksione të ndryshme politike. Që në mesin e vitit 1942 i dërgon qeverisë amerikane një memorandum për të njohur rezistencën antifashiste të popullit shqiptar, siç përshëndet e falënderon nga fundi i këtij viti deklaratën e Sekretarit të Departamentit të Shtetit C. Hull për një Shqipëri të pavarur pas fitores mbi fashizmin. Nga ana tjetër, Noli, gjatë viteve të luftës, ndjek taktikën e bashkimit të shqiptarëve të Amerikës nën flamurin e interesave kombëtare dhe ndërmerr hapa konkrete duke mbështetur idenë e krijimit të një qeverie shqiptare në mërgim, qoftë dhe nën drejtimin e Zogut. Liberalin vizionar demokrat nuk e pengoi republikanizmi i tij që të përkrahte monarkun Zog, për deri sa në këtë kohë luhej fati i Shqipërisë. Kjo ishte çështja kryesore në raportet e tij me Departamentin e Shtetit dhe organizmat e tjera qeveritare dhe joqeveritare në vitet 1941-1945. Noli u përpoq që të njihet nga SHBA-ja një qeveri shqiptare në mërgim, por qeveria amerikane deri në fund nuk e miratoi, sepse ajo i njihte e i çmonte forcat e vërteta që luftonin brenda në Shqipëri. Gjithsesi një gjë e tillë nuk e zmbrapsi udhëheqësin e shqiptarëve të Amerikës që ta mbante ngritur problemin shqiptar në qarqet zyrtare të vendit. Kjo do të zgjasë deri në qershor të viti 1944, kur Noli do të vihet në dijeni realisht nga Departamenti i Shtetit për gjendjen në Shqipëri. Pas kësaj ai do të ndahet përfundimisht nga Zogu dhe do të unifikojë qëndrimin e tij me

politikën zyrtare të SHBA. Në nëntor 1944 Noli i drejton një telegram Presidentit Ruzvelt, me anë të të cilit i kërkon angazhimin e shtetit amerikan për pranimin e Shqipërisë në OKB. "Presidenti Ruzvelt, - do t'i përgjigjej Nolit sekretari i tij Uilliam Hasset, - është prekur shumë nga mesazhi juaj dhe është posaçërisht mirënjohës për dëshirat tuaja fisnike. "

Në vitet e para të pasluftës, Noli u vu në ballë të përpjekjeve për rivendosjen dhe normalizimin e marrëdhënieve diplomatike midis dy vendeve tona. Në këtë kohë u shfaqën probleme të ndërlikuara dhe mjaft delikate, zgjidhja e drejtë e të cilave lypte dhe urtësinë, përvojën dhe diplomacinë e Nolit. Aq e vërtetë është kjo sa Noli u gjend mes dy zjarreve: të kushteve të Departamentit të Shtetit dhe qëndrimit të ngurtë të qeverisë së Tiranës. Ishte fjala që njohja dhe normalizimi i marrëdhënieve diplomatike nga SHBA-ja të mos kondicionohej nga vendimi i Kongresit të Përmetit, sipas të cilit nuk njiheshin traktatet dhe marrëveshjet e qeverive të mëparshme. Noli që në fillim, duke e vështruar më larg e më thellë problemin, u kërkon qeveritarëve të Tiranës që "të pranohen menjëherë traktatet në fjalë" dhe për këtë sjell si shembull rastin e Jugosllavisë, që ka bërë të njëjtën gjë. Siç del nga korrespondenca me Enver Hoxhën dhe nga ditari i bashkëpunëtorit të tij Q. Panariti, Noli në këtë kohë ka zhvilluar takime të shumta dhe të vështira zyrtare të të gjitha rangjeve në Uashington dhe në Nju Jork. Ndërkaq, problemi ndërlikohet e rëndohet jo vetëm për shkak të kushteve që vënë palët e ndërsjella, por dhe nga përndjekja që pëson misioni amerikan në Shqipëri. Mendja realiste dhe përvoja politike e Nolit këshillonin tolerancë e modesti ndaj këmbënguljes së paarsyeshme dhe ideologjizimit të çështjes nga Tirana zyrtare.

Në verë të vitit 1946, kur në SHBA shkoi një delegacion i kryesuar nga Tuk Jakova, Noli e shoqëroi atë deri në Departamentin e Shtetit, e mbështeti dhe e ndihmoi pa rezerva. Por për fat të keq delegacioni nuk diti të përfitojë nga ndihma e tij e kualifikuar. Noli mbeti shumë i pakënaqur nga misioni i dështuar i delegacionit, aq sa përjetoi një dramë të vërtetë shpirtërore. "U lodha, - shkruante në një letër dërguar Enver Hoxhës, - duke ju përsëritur që duhet t'i pranoni traktatet në parim pa kondita, se fundi i fundit kjo është çështje formale pa rëndësi praktike. " Ishte e qartë se nga abrogimi i këtyre traktateve do t'i hapej rruga jo vetëm rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike, po dhe pranimit të Shqipërisë në OKB, ndihmave të UNRRAS, të Kryqit të Kuq amerikan etj. Por fjala e tij nuk u dëgjua. Historia tregoi si ai kishte të drejtë dhe këshillat e tij qenë plotësisht me vend.

Ndërkaq, në këtë kohë doli në rend të ditës rreziku i pretendimeve greke për aneksimin e Korçës dhe Gjirokastrës. Kësaj here problemi i këtyre rivendikimeve absurde nuk kish vetëm përkrahjen e Anglisë qysh gjatë luftës, por dhe të disa qarqeve të caktuara në SHBA. Në shkurt 1946 senatorët Claud Peper, Sallonstall e Uells paraqitën në Komisionin e punëve të jashtme të Senatit Amerikan një rezolutë në mbështetje të pretendimeve greke. Noli, që e kishte merakun më të madh ruajtjen e integritetit tokësor të Shqipërisë, do të ngrinte "Vatrën" në këmbë dhe do të ndërmerrte veprime energjike. Jo vetëm shkoi në Uashington dhe bisedoi me senatorin Peper, i cili bëhej interpret i interesave të lobit grek të Floridës e të shoqërisë epirotase AHEPA, por ndërhyri deri në Departamentin e Shtetit dhe sensibilizoi e qartësoi opinionin amerikan për legjitimitetin e të drejtave të shqiptarëve mbi tokat e tyre. Në

këtë kuadër, Noli boton në gazetën "Nju Jork Herald Tribun" artikullin e gjatë "Shqipëria nga viti 1939", ku do ta shpaloste dhe kësaj here besimin e thellë që kish te Amerika si vend i demokracisë, te autoriteti i saj i palëkundur si një fuqi e madhe, por dhe për faktin se ajo nuk kish interesa politike si Anglia (të cilën Noli e quante imperialiste) dhe çmonte komunitetin shqiptar si një urë miqësie mes dy vendeve. Falë këtyre përpjekjeve u bë e mundur të shmanget rreziku. Qeveria amerikane nuk e miratoi dhe s'kish si ta miratonte një dokument që binte në kundërshtim me interesat e popullit shqiptar.

Për herë të fundit, në marrëdhëniet zyrtare shqiptaro-amerikane, Noli shfaqet në shkurt të vitit 1955, kur Presidenti i atëhershëm i SHBA, D. Ajzenhauer, desh të ndihmojë popullin shqiptar me anë të Lidhjes së Shoqatave të Kryqit të Kuq, duke dërguar nja sasi gruri. Kjo ishte, siç shkruante presidenti Ajzenhauer në telegramin e tij, "një shprehje e miqësisë së vjetër që ekziston mes popullit të SHBA dhe popullit shqiptar. " Qeveria shqiptare jo vetëm e refuzoi në mënyrë kategorike, por bëri dhe një zhurmë të madhe propagandistike. Noli pati kurajën të ngrihet në mbrojtje të gjestit fisnik të qeverisë amerikane. Në telegramin dërguar kryeministrit shqiptar Mehmet Shehu ai, duke shprehur keqardhjen e thellë për refuzimin e qeverisë shqiptare që u bën ndihmave të qeverisë amerikane, pohon se "kjo dhuratë ka kuptimin e plotë të një gjesti të vullnetit të mirë, si një dëshirë serioze për të përmirësuar marrëdhëniet midis SHBA dhe Shqipërisë dhe si një hap jo pak i rëndësishëm drejt vendosjes së paqes në Ballkan. " Ai i kërkon që të pranohet oferta amerikane, sepse "hedhja poshtë do të përdoret nga armiqtë e Shqipërisë. " Noli dhe kësaj here do të tregohet kurajoz e vizionar, por, ç'është më e rëndësishme, mbrojtës i palëkundur e konsekuent i miqësisë mes dy vendeve tona.

S'ka dyshim se Noli është figura qendrore e bashkësisë shqiptare të Amerikës, shtylla e saj. Duke qenë i tillë, ai është njohur dhe çmuar jo vetëm nga qarqet intelektuale e klerikale, por dhe nga ato zyrtare, si përfaqësuesi më i shquar i shqiptaro-amerikanëve. Prandaj nuk duhet të na habisë fakti që në qershor 1964, me rastin e 400 vjetorit të lindjes së Shekspirit, ai u ftua në Shtëpinë e Bardhë, mes shekspirologëve më të shquar, nga Presidenti L. Xhonson. Në ceremoninë presidenciale, Noli shqiptoi si klerik një lutje fetare "për këtë vend të madh. . . që po e udhëheq njerëzimin drejt një të ardhme më të mirë dhe paqes universale, drejtësisë, lirisë dhe demokracisë", por Noli përkthyes i Shekspirit evokoi me këtë rast dhe kujtimet e veta për dramaturgun gjenial.

Kjo ishte hera e parë dhe e fundit që Fan Noli ngjiste shkallët e Shtëpisë së Bardhë, por nuk ishte hera e parë që ai takonte presidentë të SHBA. Ai ishte takuar ose kish pasur lidhje me T. Ruzveltin, U. Uillsonin, F. Ruzveltin, H. Trumanin, D. Ajzenhauerin e Xh. Kenedin. Një fakt i tillë, me domethënie sa historike aq edhe emocionale, është tregues i rrugës nëpër të cilën kanë ecur marrëdhëniet shqiptare amerikane, ku Fan Noli ka luajtur një rol parësor.

Akademik FLORESHA DADO

FAN NOLI NË SFIDAT E NJË HISTORIE TË RE TË LETËRSISË

Gjithnjë, në raste përvjetorësh të rëndësishëm të autorëve të shquar, studiuesit synojnë të sjellin qasje të reja, për të plotësuar ato vlera që nuk janë vënë në dukje deri më sot. Jam e bindur se kjo konferencë shkencore do të krijojë një bazë të re për interpretimin e F. Nolit, në sfondin e problemit themelor të shkencës së sotme shqiptare: hartimit të një historie të re të letërsisë. Në diskutimet e shpeshta të këtyre dy dhjetvjeçarëve të fundit theksi është vënë kryesisht mbi domosdoshmërinë e futjes në këtë histori të mjaft autorëve, të përjashtuar për shkaqe jashtëletrare, si dhe çlirimin e saj nga autorë të konsideruar thjesht për vlerat ideore. Por problemi i vërtetë i hartimit të *Historisë së Letërsisë Shqiptare* nuk mbaron këtu. Madje aspekti më i rëndësishëm dhe më i vështirë është: mënyra e trajtimit të letërsisë, ndërtimi i një marrëdhënieje të drejtë midis ligjërimit artistik, në kuptimin e gjerë, dhe metaligjërimit shkencor; ndërtimi i raportit të drejtë midis vlerave si *kategori estetike* dhe si *kategori historike***.**

Noli i përket grupit të autorëve të pamohuar, por, nëse pati 'privilegjin' të përfshihej në Historinë e letërsisë a mund të themi se interpretimi i krijimtarisë së tij, në gjithë historitë e letërsisë, që janë hartuar deri më sot, është i tillë që e vendos plotësisht në sistemin letrar, në kuptimin më të saktë të këtij sistemi? Domethënë, a është parë krijimtaria e tij si ngjarje estetike përballë sfondit të mëparshëm dhe bashkëkohor të letërsisë, si kulm, apo jo dhe e tillë, e një periudhe letrare, drejtimi, stili letrar etj. ? A kemi tek ky autor një vazhdimësi të formave letrare, apo një fenomen individual në procesin e zhvillimit historik të letërsisë? Kjo do të thotë se mënyra e trajtimit të Nolit, lidhet me një varg aspektesh teorike, të diskutueshme për hartimin e Historisë së Letërsisë.

Në botimin themelor të *Historisë së Letërsisë Shqiptare*, nga fillimet deri në vitet '39, kapitulli për Nolin është konceptuar sipas një strukture, që ishte e qëndrueshme për gjithë autorët e tjerë. Interpretimi i të gjithë llojeve të veprimtarisë së tij krijuese (poezia, drama, publicistika) qëndron më shumë në parimin e zbulimit të marrëdhënieve shkak-pasojë, dhe pak depërton në strukturat e brendshme artistike të tyre. Vetë ndarja e çështjeve: *Arti dhe Gjuha*, janë dëshmia më e dukshme e një trajtimi përgjithësisht formal, që gjuhën e sheh si një aspekt të pjesshëm të ligjërimit artistik, që formëson gjithë veprën artistike.

Përvoja studimore e trashëguar, por edhe trajtime të ditëve të sotme kanë nxjerrë problemin që *Historia e letërsisë* duhet të përcaktojë më saktë fushën e studimit dhe kriteret që e kufizojnë atë. Vështrimi i veprës së Nolit si ilustrim i momenteve të caktuara të historisë apo qasja ndonjëherë sot, sipas konceptit të esesë, në të vërtetë cënojnë kuptimin e krijimtarisë si evolucion *artistiko-historik*. Midis këtyre dy aspekteve, në të vërtetë ka një marrëdhënie antagoniste, e cila e afron krijimtarinë e Nolit me historinë, por njëkohësisht edhe e largon prej saj. Krijimtaria e

Nolit përfaqëson një fenomen simultan, domethënë nga njëra anë reflekton një realitet të caktuar, nga ana tjetër nuk është thjesht pasqyrim i këtij realiteti, sepse nuk është thjesht 'produkt i historisë', por 'produkt historik', çka nënkupton se në Historinë e Letërsisë ajo duhet të zerë vend si një ndër dukuritë e strukturës së zhvillimit letrar dhe të përvojës estetike. A ishte poezia e tij një modifikim i letërsisë së deriatëhershme, një përpunim gjinor, i llojit, që çoi në krijimin e dukurive të reja artistike? Mënyra e trajtimit të Nolit, në sfondin e një historie të letërsisë, nxjerr disa çeshtje. Midis tyre:

1- A do të qëndrohet në interpretimet e veprës në vetvete apo do rikonceptohen vlerësimet në kontekstin e autorit dhe periudhës? Domethënë, sa do synohet të interpretohet nëse poezia e tij, e parë në planin bashkëkohor, ka në substratin e brendshëm edhe manifestimet e zhvillimit historik? Cilat janë marrëdhëniet e padukshme me fenomene letrare, që në kohë dhe hapësirë të ndryshme, ripërsëriten? (drejtim estetik, veçori gjinore ose të llojit, etj.). Në plan më konkret kjo do të thotë: si dhe në ç'përmasa do shkrihet analiza estetike mbi strukturat letrare të Nolit në raport me vështrimin e dukurisë letrare në plan historik?

2- Dihet se studimi në plan diakronik, që është qasja themelore në historinë e zhvillimit të letërsisë sonë, ka në themel interpretimin e veprës së autorit si një moment historik, jo thjesht si dukuri kronologjike, por për të nxjerrë në pah një kategori të re historike, sa e perceptueshme ka qenë ajo në momentin e shfaqjes, sa e modifikoi perspektivën e zhvillimit të letërsisë shqiptare. Për të realizuar këtë synim, qasja diakronike mund të ngrijë në një moment të caktuar (në çastin kur bën analizën e brendshme të poezive, dramës së Nolit), për të zbuluar marrëdhënien e poetit me letërsinë e bashkëkohësve të tij. Historiani, në këtë mënyrë, do të mund të thellohej në strukturën artistike të veprave të poetit në një moment të caktuar të zhvillimit historik. Pra vështrimi diakronik synon të zbulojë specifikën dhe peshën e sistemit poetik nolian në zinxhirin e sistemit artistik të letërsisë shqiptare.

Por, nga ana tjetër, dimensioni i përfshirjes së krijimtarisë së Nolit në historinë e letërsisë, nënkupton interpretimin jo thjesht dhe vetëm si dukuri historike, por si fenomen *estetik* që ndryshoi rrjedhën *historike* të letërsisë sonë, në konceptimin e figurës, apo në shtrirjen e përmasave metaforike të saj, në brendinë e ndërtimit të strukturës alegorike etj. Kjo do të thotë se pozicioni i historianit të letërsisë në ndërthurje me qasjen sinkronike të kritikut letrar bëhet thelbësor, dhe absolutisht i domosdoshëm. Kjo sepse interpretimi i veprës së Nolit, si *pjesë e historisë së letërsisë*, nuk mund të konceptohet thjesht dhe vetëm as si histori personaliteti, as si histori veprash të veçuara nga rrjedha e brendshme e zhvillimit të letërsisë sonë, por mbi të gjitha si strukturë e realizuar, si histori formash stilistikore.

Pra dy aspektet e një historie letërsie: i gjenezës dhe i qëndrimit në specifikën e sistemit letrar, do të përbënin boshtet themelore të studimit të autorit tonë. Njohja e saktë e kuptimit teorik të kësaj marrëdhënieje hap rrugën për të vendosur raporte të drejta midis tekstit dhe kontekstit, për ta vendosur këtë autor në proceset e zhvillimit të letërsisë: a) *të kohës* kur u shkrua dhe b) të gjithë *procesit historiko-letrar*. Për ta interpretuar jo thjesht dhe vetëm a) në *kushtëzimet historiko-kulturore*, por edhe b) sipas *principeve të sistemi letrar*.

Sensi historik i kritikut dhe *sensi kritik i historianit*, të kombinuar në studimin historiko-letrar, do të krijonin qasjen më shkencore ndaj krijimtarisë së Nolit. Nëse prishet kjo marrëdhënie, historia e letërsisë del jashtë thelbit të vet dhe autori është përjashtuar prej saj. Dhe ndodh ky fenomen: një autor si Noli, *është* në Historinë e letërsisë, por edhe *nuk është*. Kështu do të ishte për të gjithë autorët e trajtuar, apo dhe për ata që duhet të përfshihen në Historinë e letërsisë shqiptare.

3- Duke folur për riinterpretimin e krijimtarisë së Nolit në sfondin e rishkrimit të *Historisë së letërsisë*, mund të themi se problem tjetër i rëndësishëm metodologjik ka të bëjë me pyetjen: cili do të ishte objekti i historianit të letërsisë: poezitë e Nolit si përjetohen sot, apo në kohën kur u botuan? Ndonëse përgjigjia duket si e thjeshtë, zbatimi është më i ndërlikuar. Kjo sepse dihet që teoritë bashkëkohore kanë plotësuar mënyrat e qasjes ndaj letërsisë në krahasim me ato që njiheshin dy dhjetëvjeçarë më parë. Marrëdhënia e gjenezës së poezive, me vlerësimin e historianit të sotëm hap një varg problemesh të interpretimit dhe sidomos të ruajtjes së raportit të drejtë midis pritjes së kohës së krijimit dhe pritjes së kohës së sotme të interpretimit. Nga ana tjetër në vartësi të kritereve të konceptimit të Historisë së letërsisë, (gjinor, sipas drejtimeve letrare apo sipas individualiteteve), do të dilnin probleme të ndryshme në mënyrën e trajtimit të krijimtarisë së Nolit, në përzgjedhjen e disa veprave, apo përfshirjen e të gjithave. Në qasje teorike del problemi i marrëdhënies midis *autonomisë semantike të tekstit* dhe vlerësimit të tij sipas *kontekstit, rrethanave të reja të interpretuesit*. Teza e Gadamer sipas së cilës "çdo epokë duhet ta kuptojë një tekst të transmetuar në mënyrën e vet" nxjerr pikëpyetje në marrëdhënien e realitetit historik të periudhës së krijimit dhe realitetit të kuptimit të këtyre vlerave sot, kur kemi një distancë historike.

A ka ndryshuar sistemi i vlerave në krijimtarinë e Nolit? Kjo pyetje mund të bëhej për gjithë shkrimtarët e traditës. Estetika e krijimit të veprave në çerekun e parë të shekullit XX dhe estetika e kohës së sotme të interpretimit shprehin, realisht, një marrëdhënie të komplikuar, çka i krijon historianit të letërsisë vështirësi jo të lehta. Ne e dimë se për të njejtin autor janë dhënë vlerësime jo të njëjta në historitë e letërsisë, të shkruara nga autorë të ndryshëm.

Në zgjidhjen e këtij ngërçi të vlerësimit historiani i letërsisë e ka të domosdoshme të shtrijë vështrimin në thellësi të eksperiencës letrare dhe të synojë një zbulim të ri midis kohës së krijimit dhe momentit të interpretimit. Kjo jep mundësi të përcaktojë, nga njera anë, në ç'masë poezia e Nolit është pranuar në kohën e vet, nga ana tjetër, sa kjo krijimtari, në momentin e perceptimit dhe interpretimit të sotëm, arrin të hedhë dritë në trashëgiminë letrare të së shkuarës, të momentit kur u botua. Kjo qasje, ky synim, ky proces kërkimi bën që krijimtaria e poetit të mos vlerësohet si një risi absolute, në një hapësirë boshe, por që sjell diçka nga tradita dhe gjallëron në një plan të ri interpretimin e sotëm të historianit të letërsisë. Nga ana tjetër, hedh dritë mbi individualitetin e papërsëritshëm ose jo të këtij autori. Ndonëse vepra e Nolit përfaqëson një vlerë të qëndrueshme, historiani do të duhej të përcaktojë *historicitetin e standardit të vlerave* të autorit. Pra synimi është: çdo tendencë e re në krijimtarinë e Nolit a mund të shihet si evolucion i vetë sistemit letrar shqiptar?

Në këtë qasje ka shumë rëndësi *ruajtja e ekuilibrit* midis shijes individuale të studiuesit që lexon veprën e Nolit, letërsinë e traditës dhe historianit të letërsisë, i cili

ka kritere të tjera vlerësimi. I pari e përjeton veprën në mënyrën e tij, kurse i dyti e interpreton sipas parimeve estetike, që dallojnë letërsinë si lloj arti nga format e tjera të krijimtarisë, gjithashtu që ka të qartë edhe specifikën e hartimit të një historie të letërsisë, e cila ka kërkesa, parime dhe synime të caktuara.

4- Historiografia letrare dhe historiciteti i saj janë dy koncepte që, ndonëse lidhen ngushtë me njeri-tjetrin, janë thelbësisht të dallueshëm në specifikat e brendshme të tyre. Kjo na orienton për të zhvilluar praktikisht idenë se bazat për rikonceptimin e mënyrës se si mund të trajtohet një figurë si F. Noli, por edhe gjithë autorët e përfshirë apo të mohuar, në një histori të re të letërsisë shqiptare, lidhen me *zgjerimin e kuptimit të interpretimit letrar*, për të mos mbetur vetëm në nivelin e studimit biografik e psikologjik, në huazimin e nocioneve nga fusha të tjera si historia shoqërore, historia e ideve, vëzhgimeve sipërfaqësore në fushën e stilit gjuhësor, por për të zbuluar se në ç'përmasë historia e letërsisë është ndryshueshmëri letrare, dhe ç'përfaqëson vepra e Nolit në këtë proces *historiko-estetik.*

Ka shumë momente që poezia e Nolit është interpretuar si segment i historisë politike e kulturore të kohës, pa u thelluar në nivelet e poetikës së brendshme të veprës së tij. Prandaj themi se aspekti themelor metodologjik i ritrajtimit të Nolit në historinë e letërsisë ka të bëjë pikërisht me përqendrimin e vëmendjes në faktin se letërsia shqiptare, e cilësdo periudhë, do të duhet të trajtohet si shfaqje e një sistemi specifik, çka do të bëjë që parimi historiko-letrar të mos fokusohej vetëm në interpretimin e faktorëve ndikues, jashtëletrarë, por të thellohet tek natyra e brendshme e letërsisë.

Koncepti formalist i evolucionit letrar, që ka në themel ndryshimin e sistemit letrar dhe parimeve të ndërtimit të këtij sistemi, jashtë ekstremitetit mohues të rolit të faktorëve të jashtëm, ka padyshim një thelb të qëndrueshëm dhe një rol të padiskutueshëm në thellimin e vëmendjes në aspekte që specifikojnë veprat letrare të dallueshme nga format e tjera të krijimtarisë. Kështu, pikëpamja e formalistëve se poetika e periudhave të veçanta karakterizohet nga një dominante në sistemin letrar, orienton që vepra e Nolit të lidhet me dominanten artistike të periudhës historike, viteve '30, së cilës i përket. Nëse letërsia shqiptare është një sistem që është transformuar në kohë, kriter i vlerësimit të shkrimtarit do të ishte edhe hetimi i dukurisë së ndryshueshmërisë që solli poezia e tij në këtë transformim të formave letrare. Sa ekziston realisht ky tipar në veprën e tij, apo sa nuk është? Cili është raporti me format paraardhëse? Kjo do të thotë se kur rikonceptojmë historinë e letërsisë sonë, në këtë studim duhet proceduar *historikisht*, por jo sipas renditjes dhe numërimit të veprave. Çdo praktikë letrare evoluon; krijimtaria e Nolit mund të shihet vetëm në këtë pikëvështrim, për të hetuar ç'pozicion ka marrë ajo në raport me traditën paraprake. Qasja metodologjike, e kuptuar sipas pikëpamjes se çdo evolucion i formave letrare mbart brenda vetes ndryshime të formave artistike që reflektojnë lëvizjet në jetën shpirtërore të shoqërisë, është shumë e rëndësishme për konceptin e ri që duhet të jetë në themel të hartimit të një historie të letërsisë. Metodologjia e ndërtimit të saj, sigurisht nuk ka të bëjë thjesht dhe vetëm me krijimtarinë e Nolit, po të gjithë shkrimtarëve dhe proceseve letrare që karakterizuan zhvillimin e letërsisë sonë, nga fillimet deri në ditët e sotme.

Teksti i *Historisë së letërsisë shqiptare* nuk mund të jetë një histori e historisë, por historia e zhvillimeve të brendshme të gjinive, poetikave, strukturave letrare, që përvijojnë individualitete, siç është Fan Noli. Kjo nuk do të thotë se vlerat dhe specifikat artistike të Nolit duhen parë më vete, por në kohë dhe hapësirë.

5- Siç e thashë që në fillim, rishkrimi i Historisë së letërsisë sonë nuk është thjesht përfshirje e autorëve të munguar, por zgjerimi i konceptit për letërsinë dhe njohja e specifikës komplekse të interpretimit të saj, për të realizuar vlerësimin e plotë të çdo autori në sfondin historiko-estetik dhe në veçoritë e sistemit letrar. Duke u ndalur vetëm në një pjesë të problematikës, që parashtron studimi i një autori të shquar, si Fan Noli, në raport me sfidat e rikonceptimit të historisë së letërsisë, është e qartë se të njëjtat probleme qëndrojnë edhe në interpretimet e autorëve të munguar apo dhe të përfshirë në tekstet e mëparshme.

Problematikat e ndryshme dhe të shumta që do parashtrohen në këtë Konferencë të gjerë, rreth figurës komplekse të Nolit, padyshim do jenë zgjerim, thellim në këto dy boshte themelore, të cilat përcaktojnë suksesin e trajtimit të çdo autori në një korpus gjigand, siç duhet të jetë Historia e letërsisë shqiptare.

Mitropoliti i Korçës
Imzot **JOAN PELUSHI**

PESHKOP THEOFAN NOLI-
NJË JETË NË SHËRBIM TË KISHËS

Nuk ka asnjë dyshim që figura e cila dominoi historinë e Kishës Orthodhokse shqiptare pothuajse gjatë gjithë shekullit XX ishte Peshkop Theofan Noli. Aktiviteti i tij kishtar dhe patriotik, letrar dhe politik dihet tashmë pothuajse nga të gjithë. Po ashtu edhe jeta e tij dhe peripecitë e dorëzimit të tij si prift dhe si peshkop. Për këtë arsye do të doja të ndalesha, jo vetëm në kontributin e tij të jashtëzakonshëm në pavarësinë e kishës dhe në pajisjen e saj me librat e domosdoshëm liturgjikë, pa të cilët nuk mund të kryhej shërbesa e kishës, por më tepër në raportin e tij me besimin, me kishën dhe me fenë. "Megjithë faktin që Fan Noli ishte një personalitet shumë i njohur – shkruan At Liolini – mendimet e tij të brendëshme dhe emocionet e tij mbeten edhe sot e kësaj dite një enigmë." Mendoj se At Liolini shprehet kështu ngaqë ai është i vetëdijshëm se në përgjithësi, jo vetëm Noli, por pjesa më e madhe e personaliteteve më të shquara shqiptare mbeten një enigmë, përsa i përket mendimeve, ndjenjave dhe emocioneve të tyre të brendshme. Kjo edhe si rezultat se sociologjikisht, kultura dhe mentaliteti shqiptar, jo vetëm atëherë por madje edhe sot, nuk inkurajon shprehjen në mënyrë të lirshme të këtyre ndijimeve të brendshme. Kështu, ndërsa i njohim shumë mirë veprimtaritë e tyre të jashtme, ana shpirtërore e tyre mbetet pothuajse e mbyllur. Dhe duke mos e njohur mirë jetën e tyre të brendshme lihet gjithmonë hapësirë për spekulime të ndryshme, ndonjëherë edhe për shpifje monstruoze. Megjithatë aktivitetet e tyre të jashtme mund të nxjerrin sado pak në dritë diçka nga bota e tyre shpirtërore dhe emocionale.

Fan Noli u përfshi në jetën kishtare që në fëmijërinë e tij, sepse në ambientin ku ai lindi dhe u rrit Kisha ishte institucioni qëndror fetar dhe kulturor. Për të kuptuar Nolin dhe besimin e tij ne duhet ta shohim atë në kuadrin e kohës kur ai ka jetuar, sepse si të gjithë ai ishte produkt i kohës së tij dhe i influencuar nga ideologjitë e kohës: dhe po ashtu si të gjithë njerëzit e mëdhenj ai ngrihet mbi kohën e tij. Fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX, që korrespondon me formimin kulturor dhe intelektual të Nolit, u karakterizua nga dominimi i filozofive dhe ideologjive nihiliste dhe revolucionare, të cilat shpresonin dhe predikonin të ndërtonin një botë të re, të ndërtuar mbi vlera të reja dhe që u kundërviheshin vlerave tradicionale, duke i parë ato si pengim për lirinë e njeriut. Pa dyshim kritika kundër padrejtësive dhe shtypjes shekullore ishte e drejtë, ndonëse zgjidhjet që ato afronin shpesh rezultuan

katastrofike. Noli si intelektual dhe si kërkues nuk mund të mos influencohej prej tyre. Por fara e besimit e mbjellë në shpirtin e tij qysh nga vogëlia kurrë nuk do të thahej, madje edhe në vitet ku dukej se ai ishte shkëputur krejtësisht nga feja dhe jeta kishtare. Besimi i vërtetë dhe i sinqertë nuk është statik, por dinamik. Ai është një udhëtim, një kërkim për të përmbushur veten, një udhëtim ku ka rënie dhe ngritje, dyshime dhe sigurira. Prandaj edhe Noli ishte një figurë e ndërlikuar sepse ishte kërkues. Ai nuk mund të kënaqej pa gjetur përgjigjet që mund ta paqësonin shpirtin e tij të trazuar. Mbas një rrugëtimi të gjatë shpirtëror ai do të deklaronte në shumë takime se libri që i jepte më shumë kënaqësi dhe paqe ishte Ungjilli. Ky libër nuk mund të japë paqe nëse atje nuk shikon dhe nuk gjen atje përmbushjen tënde. Një tjetër njeri i madh dhe me një jetë të thellë shpirtërore, Dostojevski, deklaroi të njëjtën gjë mbas rrugëtimit të tij të gjatë. Edhe ai u rrit si fëmijë me besimin, pastaj nën influencën e ideologjive të kohës u bashkua me grupe revolucionare dhe mbas shumë peripecive ai rizbuloi përsëri besimin, por në një dimension akoma më të thellë.

Prandaj një njeri nuk mund të gjykohet vetëm nga një periudhë e jetës së tij, por nga e gjithë jeta e tij dhe sidomos nga fundi i saj, që është gjithmonë përmbledhja e asaj që ka qenë ai njeri. Ka ndodhur shpesh që Noli është gjykuar vetëm nga një pjesë e jetës, ose vetëm nga disa thënie të tij në periudha të caktuara. Por përfundimet e nxjerra vetëm nga disa pjesëza nga thëniet ose nga letrat e tij nuk mund të japin të gjithë personalitetin kompleks të Nolit. Pa dyshim jeta e Nolit, dhe jo vetëm e tij, por edhe e shumë njerëzve të tjerë të mëdhenj, është veshur me mite, të cilat e vështirësojnë zbulimin e njeriut të vërtetë, sepse shpesh fshehin ose nuk përmendin të metat dhe gabimet. Të metat dhe gabimet nuk e zvogëlojnë një njeri kur ai ngihet sipër tyre. Miku dhe biografi i tij i parë gazetari, Qerim Panariti do ta karakterizonte Nolin njeri me këto fjalë: "Një person kompleks që gëzonte të gjitha të metat e njeriut, plus të metat e tij si individ". Dhe kjo është e vërtetë, ai nuk ishte kurrsesi njeri pa të meta, por këto të meta nuk ishin ato që do përcaktonin karakterin dhe qëllimin e jetës së tij, sepse ai u ngrit gjithmonë mbi ato, duke treguar se idealet e tij: përkushtimi ndaj Kishës, humanizmi, atdhedashuria dhe besimi i dhanë gjithmonë forcën për të kapërcyer kufizimet njerëzore.

Duke e gjykuar vetëm nga pozicioni kanonik i kishës dhe të shkëputur nga koha kur ai ka jetuar, pa dyshim që në jetën e tij mund të shihen gabime. Por ja si shkruan për të Ernest Koliqi: *"Gabimet ase në datsh të thuesh fajet që Fan Noli ka mujt me ba, nuk ja zbresin vlerën tri veprave të pashoqe që ai kreu: Autoqefalinë e Kishës, fletoren "Dielli" dhe futjen e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve. Kush jeton si i ndodhi atij ma se tetëdhet vjet dhe në një periudhë historike ma të stuhishmet qi njofti njerzimi, lehtaz bahet objek kritikash sepse një jetë kaq e gjatë rrethohet me fazat e ndryshme të saj, me dritat e me hije të cilat ndoshta shkaktohen nga rrethinat, nëpër të cilat u përshkue, ma se një vullnet i prem dhe i paravendosun m' u sjell ashtu si u suell. Si të*

gjithë njerzit me një vlerë të veçantë edhe Fan Noli nderohet e përçmohet me ngulmim qi shpesh herë arrin në parosizëm ndër lëvduesa e prozhmuesa të tij."

Kur u dorëzua dhjakon dhe prift në vitin 1908, ndonëse shumë të njohur të tij u befasuan , ai iu përkushtua tërësisht organizimit të shqiptarëve orthodhoksë dhe themelimit të një kishe shqiptare. Ai u akuzua nga armiqtë e tij se ishte bërë prift për të siguruar jetesën, ndërsa shumë miq dhe dashamirës e kanë shpjeguar se u bë vetëm për arsye atdhedashurie dhe për hir të çështjes kombëtare. Si në çdo vendim të rëndësishëm arsyet janë të shumta, ashtu si një lumë i madh nuk formohet vetëm nga një burim, por besoj se arsyeja dominuese ishte lidhja e tij shpirtërore me kishën. Pa dyshim të qenurit klerik i siguroi atij mënyrën e jetësës dhe po ashtu i dha pozicionin e duhur për të mbrojtur dhe për të promovuar kauzën e kishës orthodhokse dhe atë shqiptare, por këto nuk ishin arsyet kryesore për këtë vendim kaq të rëndësishëm të jetës së tij. Në pesëdhjetëvjetorin e themelimit të Kishës ai deklaroi se "Jam marrë me histori, letërsi dhe muzikë me raste, por feja ka qenë puna e jetës sime, sepse e fillova karrierën time si njeri i kishës në 1909 dhe jam akoma njeri i kishës mbas 50 vjetësh." Në një tjetër dokument që ruhet në arkivin e Kryepeshkopatës shqiptare ne Amerikë ai pohonte se : "E gjithë veprimtaria ime, dashuria ime e parë është kisha…" Më duket më se i drejtë konkluzioni i njërit prej studjuesve më të njohur të Nolit Pr. Nasho Jorgaqi, i cili shkruan se kauza të cilën ai e mbante të shenjtë, ishte feja dhe se feja do të mbetej deri në fund vokacioni i tij kryesor.

Kur Shqipëria fitoi pavarësinë kishte ardhur tashmë koha që edhe kisha orthodhokse në Shqipëri të ishte autoqefale, ashtu siç kishte ndodhur edhe në shtetet e tjera të pavarura të Ballkanit. Kështu para historisë e drejta për një kishë të pavarur në Shqipëri është e pakontestueshme. Ndonëse kriteret e dhënies së autoqefalisë, për të gjitha kishat orthodhokse, janë të debatueshme edhe sot nga kanonistët, përsëri ishte formuar një traditë që një shtet i pavarur të kishte një kishë të pavarur. Duhet ditur se Kishë Autoqefale do të thotë pikërisht pavarësia e saj në çështjet e organizimit, sepse Kanonet dhe doktrina janë të njëjta për të gjitha kishat. Pa dyshim autoqefalia nuk arrihet vetëm me një dekret, por me ngritjen e një hierarkie kishtare, me përgatitjen e kuadrove të duhura për të drejtuar kishën dhe me pajisjen e saj me klerikë dhe teologë për të plotësuar tërësisht nevojat për shërbesat kishtare. Realizimi i autoqefalisë së Kishës në Shqipëri ishte një vepër që përfshiu jo vetëm klerikët dhe besimtarët, por gjithashtu edhe diplomatë, politikanë dhe qeveritarë të asaj kohe dhe kontributi i tyre nuk duhet nënvlerësuar. Sepse akti i dhënies së autoqefalisë nuk është vetëm një akt kishtar, ai është gjithashtu një akt juridik, kanonik dhe si në të gjitha rastet e tjera të mëparshme të autoqefalive, elementi politik dhe diplomatik ka luajtur një rol të shumë të madh.

Arritja e autoqefalisë kaloi nëpër një rrugë të gjatë dhe plot peripeci. Kontributi i peshkop Theofan Nolit në këtë arritje është madhor dhe i pakrahasueshëm. Me

themelimin e kishës shqiptare në Amerikë, me gazetën *Dielli* dhe organizatën *Vatra*, Fan Noli arriti të ndërgjegjësonte dhe të kombëtarizonte kishën orthodhokse shqiptare. Influenca e diasporës orthodhokse në Amerikë ishte jashtëzakonisht e madhe në Shqipëri. Ata nëpërmjet kontakteve, letrave dhe artikujve të ndryshëm mbanin të gjallë aspiratën, si për një vend të pavarur ashtu edhe për një kishë të pavarur orthodhokse, si të gjithë simotrat e saj në Ballkan. Frymëzuesi dhe organizuesi i gjithë kësaj fushate ishte Fan Noli. Ndonëse ai nuk ishte aktor kryesor në bisedimet ndërmjet kishës dhe shtetit shqiptar me Patriarkanën e Stambollit, gjatë kohës së negociatave për njohjen e autoqefalisë së kishës orthodhokse në Shqipëri, përsëri mund të themi me bindje se pa veprën e Nolit në ndërgjegjësimin e orthodhoksëve shqiptarë dhe pa kontributin e tij të pallogaritshëm në organizimin e tyre kishtar në SHBA, zor se mund të arrihej autoqefalia. Kështu që me të drejtë ai është quajtur nga shumë si ati i autoqefalisë së kishës orthodhokse shqiptare.

II

Imzot Theofan Noli, nuk ishte vetëm "protagonisti kryesor i kombëtarizimit dhe i pavarësisë së Kishës sonë Orthodhokse",[1] por ai ishte gjithashtu edhe një përkthyes i talentuar dhe një njohës i shkëlqyer i gjuhës shqipe dhe i shumë gjuhëve të tjera. Ai ka përkthyer në shqip librat më të domosdoshëm liturgjikë, duke sjellë një kontribut të madh në lëmin e përkthimeve dhe në konsolidimin e terminologjisë fetare, duke plotësuar kështu nevojat për besimtarët orthodhoksë. Imzot Th. Noli boton në 1908 në Boston *Shërbesa e Javës së Madhe,* dhe në 1909 *Librë e Shërbesave të Shenjta të Kishës Orthodhokse;* në 1911 *Librin e të Kremteve të Mëdha të Kishës Orthodhokse;* në 1913 përkthen dhe boton *Triodin e Vogël* dhe në 1914 *Lutjesoren* dhe *Pesëdhjetoren e Vogël.* Në parathënien e *Librë e Shërbesave të Shenjta të Kishës Orthodhokse;* ai jep edhe arsyet që e kanë shtyrë të filloj këtë punë: *"Po u fal shqiptarëve orthodhoksë këtë librë, e cila është e dyta dhe pandeh që përdorja e sajë do t'i sjellë një shërbim vendit tonë. I kam dhënë zotim kombit tim t'u jap vëllezërve të mi bashkëfetarë librat më të nevojshëm për të praktikuar faljen e tyre në gjuhën kombëtare, dhe zotimin tim do ta mbaroj ndofta brenda në pak kohë, në qoftë se shqiptarët janë gati të më ndihin, sikundër më ndihnë me të shtypurit e këtyre dy librave. Me të kthyer të kësaj libre u përpoqa të mos largohem nga teksti greqisht dhe besoj që u dhashë shqiptarëve një kthim ekzakt të lutjeve të kishës orthodhokse. Natyrisht nuk mund të mbetesha i kënaqur nga kthimet e vjetra të atdhetarit të shkëlqyer Z. K. Kristoforidhi, dhe u përpoqa ti ndreq ato që hynë në këtë libër pas*

[1] Dh. Beduli, *Gjuha Shqipe në Kishë*, f. 15.

përparimit që ka bërë gjuha shqipe që nga koha e tij, pa mohuar që puna e tij qe një ndihmë dhe themeli për mua."

Si del edhe nga citimi i mësipërm Imzot Noli ishte i ndërgjegjshëm për nevojat e Kishës në lëmin e përkthimeve dhe sidomos për nevojën e përdorimit të gjuhës bashkëkohore të kuptueshme nga populli. Përkthimet e teksteve liturgjike janë shumë të vështira edhe për gjuhë me terminologji të konsoliduar në shekuj. Për arsye që dihen në gjuhën tonë mungonte një gjuhë e lëvruar kishtare dhe një terminologji teologjike, duke e bërë kështu përkthimin në shqip akoma edhe më të vështirë. Për më tepër, në përkthimin e teksteve liturgjike nuk mjafton vetëm njohja e mirë dhe e thellë e gjuhës, por duhet edhe një njohje e mirë e doktrinës dhe e Tipikosë së shërbesave fetare. Gjithashtu, kërkohet një njohje e muzikës kishtare që teksti ti përshtatet melodisë. Në këtë të fundit duhet ruajtur raporti ndërmjet tekstit origjinal, që të ruhet besnikëria e tekstit dhe përshtatjes për muzikën. Imzot Theofan Noli ishte njeriu i duhur për këtë punë. Ai ishte pajisur nga Perëndia me një karakter kurajoz për të pasur guximin për të shkelur në udhë të panjohura dhe për të hapur shtigje të reja; një njohës i mirë i jetës kishtare, familjar me liturgjinë e kishës dhe me greqishten biblike, të praktikuar prej tij prej shume kohësh si psalt. Ai ishte një ekspert i mirë i muzikës kishtare dhe i apasionuar me të. Shpirti i tij poetik dhe talenti për të artikuluar frazat do ti jepnin përkthimeve të tij një fuqi dhe bukuri.

Përkthimet e tij u motivuan nga kërkesa e ngutëshme për tekste liturgjike, sepse në kohën që ai u dorëzua prift këto tekste në gjuhën shqipe mungonin pothuajse tërësisht. Kështu që para tij ishte një detyrë e vështirë dhe urgjente, ngaqë një nga kushtet që kishte vënë peshkop rus Platoni, ishte që meshimi të kryhej sipas librave liturgjikë të Kishës Orthodhokse, gjë për të cilën Fan Noli ishte zotuar. Ashtu siç shprehet edhe ai vetë synimi i tij ishte që në një kohë sa më të shkurtër ti jepte kishës dhe orthodhoksëve shqiptarë tekstet më të nevojshme të shërbesave kishtare, sidomos ato të mistereve dhe shërbesave të të kremteve. Vështirësitë ishin të jashtëzakonshme sa do të kishin zmbrapsur çdo njeri tjetër, por jo Fan Nolin. Ndonëse pa studimet e duhura teologjike dhe në mungesë të një trashëgimie të përkthimeve liturgjike në shqip ai filloi veprën madhore të përkthimit, sepse kohën e kishte me ngut. Të përkthyera shpejt dhe në mungesë të një terminologjie teologjike në ato mund të vërehen disa gabime. Parë nga sot ato mund të duken gabime të rënda dogmatike, si p.sh. termi *hipostasis* u përkthye *substancë* – literalisht ky është kuptimi, por si një term dogmatik përkthehet *person* ose thjesht *hipostazë*. Mendoj se këto gabime nuk erdhën vetëm nga mosnjohja teologjike e termave, por më tepër nga mungesa e një terminologjie të konsoliduar. E theksoj mangësinë e një terminologjie të konsoliduar, ngaqë mungesa e saj paraqet një vështirësi të jashtëzakonshme në çdo përkthim, dhe sidomos në përkthimet teologjiko-liturgjike. Në botimet e mëvonshme, do të ishte vetë Noli që i korigjoi ato. Por ndonëse përkthimet e tij të para u shkruan *in tempore belli* -

në kohë lufte – përsëri ato të mahnisin me gjuhën e pastër shqipe, me frazat e rrjedhshme dhe me neologjizmat e goditura. Të bëra në një kohë rekord, nga një njeri i vetëm dhe në mungesë të një tradite të gjuhës kishtare, ato flasin vetë për madhështinë dhe talentin e jashtëzakonshëm të përkthyesit.

Ndonëse tek Imzot Noli vërehet që shpesh balanca anon nga përshtatja në muzikë në dëm të besnikërisë së tekstit, përsëri përkthimet e tij dallohen nga stili poetik, aq i nevojshëm për të transmetuar spiritualitetin e shërbesave liturgjike të Kishës Orthodhokse, dhe nga fuqia e fjalës. Në këtë drejtim, shkrimi i tij ka më poezi, forcë dhe muzikalitet në krahasim me përkthimet e mëvonshme, që ndonëse janë më besnik ndaj tekstit origjinal, e kanë humbur pak forcën poetike biblike. Për të dalluar aftësitë e jashtëzakonshme përkthyese të Nolit do të mjaftontë të shihet vetëm përkthimi i *Himnit Akathist*, një nga mrekullitë poetike fetare, i cili konsiderohet si një himnet liturgjikë më të vështirë për tu përkthyer, aq sa një përkthyes i madh e ka quajtur të papërkthyeshëm. Fan Noli ka bërë një përkthim të lirë dhe shpesh nuk i ka qëndruar besnik origjinalit, por përsëri ai mbetet një nga përkthimet më të bukura poetike të tij. Fuqia e fjalës dhe ritmi himnologjik i japin këtij përkthimi një bukuri dhe emocion të jashtëzakonshëm që rrallë shihet edhe në përkthimet e gjuhëve të tjera. Kushdo që e lexon apo e dëgjon kur këndohet gjatë të Premteve të Kreshmës së Madhe do të kuptojë se përkthyesi kishte jo vetëm një talent poetik, por edhe një shpirt që ishte formuar nga një religjiozitet i thellë dhe nga një përkushtim tërësor ndaj kishës. Thënia e vetë Nolit se vepra e tij më e madhe në fushën e letrave ishte përkthimi i Kremtores, tregojnë një njeri me bindje dhe përjetim të thellë fetar.

Imzot Theofan Noli përktheu libra të shumtë liturgjikë, ndër to mund të përmendim *Uratoren*, *Triodin* dhe sidomos *Kremtoren*. Madje pjesa më e madhe e përkthimeve të tij, gati tre të katërtat, janë në lëmin e liturgjisë kishtare. Ai, së bashku me Kostandin Kristoforidhin, janë pionierët e parë të themelimit të gjuhës kishtare dhe të një terminologjie kishtare shqipe. Fjalët e gjetura prej tyre, në përkthimin e disa termave shumë të vështirë biblikë, teologjikë dhe liturgjikë, akoma edhe sot ato nuk e kanë humbur aktualitetin dhe janë akoma në përdorim, duke mos gjetur dot fjalë të tjera më të sakta dhe më të goditura në shqip. Përkthimet e tyre mbeten akoma edhe sot themeli dhe baza për përkthimet e sotme dhe të së ardhmes.

Ai e ruajti kontaktin me zhvillimet e kishës në Shqipëri gjatë gjithë jetës së tij. Gëzohej për çdo përparim dhe hidhërohej për vështirësitë. Ndiqte sidomos me interesim të veçantë ecurinë e përkthimeve dhe botimeve kishtare. Ndonëse kishte dhënë kontributin më të madh në fushën e përkthimeve fetare, ai përsëri ishte mendjehapur dhe i gatshëm të ndryshonte dhe korigjonte përkthimet e tij dhe të nxiste të tjerët për të vazhduar punën në korigjimin e teksteve liturgjike. Në korespondencën e tij me teologë dhe gjuhëtarë shihet interesimi i madh i tij, në të gjitha aspektet, për gjendjen e Kishës Orthodhokse në Shqipëri. Për kontributin e madh që dha në

ndërgjegjësimin, kombëtarëzimin dhe pavarësinë e kishës, si edhe për kontributin e tij të pashoq në përkthimet fetare dhe në pasurimin e gjuhës fetare shqipe, Mitropolit Theofan Noli, mbetet një figurë e dashur në kishë dhe padyshim përkthyesi më i madh në Kishën Orthodhokse dhe ne do e kujtojmë atë gjithmonë me dashuri e mirënjohje.

SEKSIONI I: VEPRA LETRARE E FAN NOLIT

Prof. as. dr. DHURATA SHEHRI

PUSHTETI I DISKURSIT, DISKURSI I PUSHTETIT NË TË FOLURIT PUBLIK TË NOLIT

Nëse ka një shprehje që të gjithë nxënësit shqiptarë që kanë kryer gjimnazin para viteve ’90 e lidhin pazgjidhshmërisht me Fan Nolin është natyrisht shprehja: “Fan Noli është një figurë poliedrike”. Thelbi i kësaj kumtese të shkurtër është një farë dekonstruksioni paradoksal i kësaj shprehje duke u rrekur që përmes ngushtimit të objektit vetëm tek të folurit publik të përcaktojmë dominancën e tekstit publik të Nolit e pak më larg se kaq dominancën e funksionit të tekstit publik të Nolit.

Të folurit publik të Nolit, ligjërimi që ai prodhoi, por më shumë diskursi publik e politik (në kuptimin e lidhjes së publikes me politikën si polis) lidhet ngushtë me dukurinë e “retorizimit të kulturës” e cila ka të bëjë me kalimin nga një model vertikal dhe hierarkik, me origjinë aristoteliane tek një model horizontal dhe përfshirës që parashikon hibridizimin e dijes. Retorika, ndonëse e konceptuar sipas modelit të parë të organizimit kulturor, në periudhën e modernitetit, për shkak të përdorimit epistemologjik parapëlqen modelin e dytë. Në këtë pikëpamje, oratoria e Nolit, me gjithë teknikat e ndërtimit të saj, duke parapëlqyer modelin e dytë, horizontal e përfshirës, bëhet një nga bartëset dhe shenjat e “komunikimit publik modern”. Ndërkohë, diakronia dhe konteksti i komunikimit publik e më ngushtësisht politik shqiptar që kur ka ekzistuar, aq sa ka ekzistuar ka dominancë të modelit të parë hierarkik.

Ndërsa tekstualiteti është një “proces prodhimi dhe depozitimi i të shenjuarve, koncepti i diskursit, me lidhjen e tij të fortë me rrethanat konkrete të thënies, është përdorur për të përshkruar mënyrën si fiksohen kuptimet bashkë me riprodhimin dhe qarkullimin në formë përfaqësimi. Diskursi nga ky këndvështrim është procesi shoqëror i krijimit dhe i riprodhimit të kuptimit që ndodh brenda formacioneve shoqërore, institucionale e historike”[2] Fan Noli është aktor e autor i diskursit politik. Ai tenton të fiksojë duke krijuar, të ndërtojë histori duke folur për bashkëkohësinë, të ndërtojë njëherësh edhe përfaqësimin edhe të përfaqësuarin.

Diskursi politik nuk është apo është vetëm pjesërisht, një diskurs përfaqësues, mimetik ndaj botës së fakteve: prandaj nuk mund të përshkruhet vetëm si një bashkësi thëniesh në marrëdhënie konjitivo-referenciale me realitetin, pasi, përkundrazi, ky i fundit, realiteti pëson procese narrativizimi, e për pasojë të manipulimit diskursiv[3]. Ky interpretim vë në dukje faktin që shumë nga të vepruarit politik është të vepruarit

[2] Ugo Volli, Manuale di semiotica, Roma-Bari, Laterza, 2000, f.. 308

[3] Paola Desideri, “La comunicazione politica: dinamiche linguistiche e processi discorsivi”, in Stefano Gensini, Fare comunicazione, f. 68

gjuhësor dhe kjo krijon një afri mes fushës së të bërës – hapësirës politike – dhe fushës diskurseve. Kjo afri është e tillë që mund të "hetohet gjithmonë një rrënjë narrative e pushtetit. Për të vendosur legjitimitetin, pushteti ka nevojë të tregohet (rrëfehet), qoftë sipas një modaliteti natyral (për shembull përmes historisë së zanafillës së vet apo përmes gazetarisë), qoftë në mënyrë artificiale (miti i themelimit, epika e heronjve)[4]. Diskursi politik që hyn në njërën prej këtyre dy formave të narracionit natyral është mbi të gjitha një diskurs i kuptuar si ngjarje, si fakt thelbësisht pragmatik, si akt ligjërimor që e përmban në mënyrë të pashmangshme përbërësin ngjarjesor. Diskursi politk është gjuhë e përdorur në një situatë konkrete për të mbërritur qëllime, është strukturë e njëkohësisht proces.

Noli është nga ata oratorë e politikanë (ndoshta për edhe për shkak të profesionit të tij pak më të hershëm – mesharisë) që e ka vetëdijen për pushtetin e fjalës në kuptimin e marrëdhënies me të ndodhurën dhe me veprimin e ardhshëm. Ai e kupton pushtetin e diskursit politik si veprim politik.

Ndoshta për këtë arsye politikani Fan Noli nuk ka asnjë ngut të krijojë legjitimimin e pushtetit real në vjeshtën e largët të 1924, por shijon pushtetin e fjalës në fjalimet e Lidhjes së Kombeve. Tashmë pushteti i fjalës që i ka krijuar atij vetë, krijuesit në kuptimin e demiurgut iluzionin e pushtetit, që realisht do t'i zgjasë vetëm pak, para se të nisë të vajtojë poetikisht e politikisht anës lumenjve ndërsa ka ngecur në kurthin që i ngriti ligjërimi i vet politik tashmë i shndërruar në narrativë e histori që tenton hierarkinë.

Se ç'e shempnë derbederët,
Mercenarët dhe bejlerët,
Se ç'e shtypnë jabanxhinjtë,
Se ç'e shtrythnë fajdexhinjtë,
Se ç'e pren' e se ç'e vranë,
Ç'e shkretuan anembanë,
Nënë thundrën e përdhunës
Anës Vjosës, anës Bunës.

Ai është i vetëdijshëm për pushtetin e fjalës publike (që shndërrohet në fjalë të pushtetit), ndërsa na ngre ne kurthin e një teksti jodiskursiv. Naiviteti ynë është i dyfishtë, i mohojmë diskursivitetin politik ligjërimit të tij publik, ndërsa vetë Noli kalon përtej, për shkak të kurthit që i ngre vetë ligjërimi. Ky fiksin është bërë pjesë e ligjërimit të tij poetik të shndërruar në diskurs, madje në diskurs politik.

Të marrim dy shembuj të përdorimit diskursiv dhe të fiksimit të kuptimit në dy nga fjalimet politike të Nolit: Është fjala për dy përdorime antonimike në nivel ligjërimor, por sinonimike në nivel diskursiv të konceptit deputet apo Parlament:

Ja si e përkufizon kontekstualisht konceptin deputet në vitin 1921 kur është pjesë e Parlamentit shqiptar dhe në opozitë:

[4] Ugo Volli, Manuale di semiotica, Roma-Bari, Laterza, 2000, f. 280

Për deputetët e Drinit – Fjalim i mbajtur në Parlamentin shqiptar në qershor 1921 me cilësinë e kryetarit të partisë popullore që ishte në opozitë:

Duke marrë në sy se pjesa më e madhe e ndenjësve të Dibrës nuk mori pjesë në votim nga shkaku i okupatës serbe dhe një pjesë u ndaluan me bajonetë prej guvernës, të 10 deputetët e Drinit përfaqësojnë vetëm 15 000 shpirt nga të 120 000 ndjenjës që ka prefektura e Drinit … Populli I tërë Shqipërisë prêt me gojë hapur një përgjigje nga ne. A do t'i përgjigjemi që pëlqejmë zgjedhje të bëra me bajonetë dhe me zar pas qefit të ministerëve tanë? [5]

Ndërsa në fjalimin në Asamblenë e Lidhjes së Kombeve, më 10 shtator 1924 shfaqet një konceptim i përkundërt në nivel ligjërimi, pasi niveli përformativ i diskursit i kërkon këtë konceptim "negativ" të termit parlament: ai është përfaqësues i një qeverie kryengritëse, që nuk ka Parlament dhe ka nevojë për të hyrë në bisedime për një hua në Lidhjen e Kombeve:

Po a e dini ju ç'është parlamenti? Pa dyshim e dini po do të keni një ide më të qartë kur t'ju them se ç'mendoj për të. E pra, parlamenti është një sallë ku mblidhen politikanë pa shpirt për të bërë prova operate në trupin e gjallë të racës së tyre, një sallë plot me gazra helmuese…"[6]

Vënia e theksit mbi vlerën konative të fjalës e vë në pah më shumë ndryshimin e nocionit të tekstit me atë të diskursit që "shtrohet specifikisht si përdorim (proces) i kontekstualizuar dhe i qëllimshëm i gjuhës që realizohet përmes ndërveprimit dhe nuk e lë mënjanë përbërësin performativ. [7]

Noli në fakt arriti ta bënte diskurs oratorinë e tij politike, por komponenti performativ i diskursit të tij politik dështoi. Ne jemi mësuar ta gjykojmë oratorinë e tij si diskurs performativ duke bërë sikur harrojmë kurthin e tij. Noli flet për deputetë e Parlament, por edhe ne si ai bëjmë sikur harrojmë se ai ishte një Kryeministër që qeverisi pa Parlament e pa zgjedhje.

Dy janë karakteristikat thelbësore të diskursit politik: qëllimi alokutiv (të bësh të besojë) dhe qëllimi perlokutiv (të bësh të bëjë). Në diskursin politik, akti i të bindurit (të bësh të besojë) gjithmonë finalizohet me aktin e të bërit. Ligjërimi i Nolit mbetet vetëm në njërën nga karakteristikat e diskursit politik – tek të bërit të besosh

Diskursi politik ka valenca pragmatike që manifestohen në përmasën e tyre performative përmes funksionit konativ të shprehur gramatikisht me foljet në urdhërore apo me përemrat e vetës së dytë.

Mjafton të kujtojmë vargjet e "Anës lumenjve" (jo rastësisht poezia më popullore e Nolit):

[5] Fan Noli, Vepra 5, f. 115

[6] Fan Noli, Vepra 5, f. 215

[7] Francesca Santulli, Le parole del potere, il potere delle parole, f. 13

Ngrehuni dhe bjeruni
Korini dhe shtypini
Katundar' e punëtorë
Që nga Shkodra (a Moska) gjer në Vlorë

Në fakt, kurthi i ligjërimit politik që shndërrohet në diskurs politik tek Noli (pra bëhet performativ) sundon edhe poezinë e tij. Përtej arsyeve politike me të cilat u lexua poezia e Nolit (propagandistike, qëndrimit pro Bolshevik të Nolit etj), ligjërimi poetik i "Albumit" duhet parë si vazhdim i diskursit të tij politik. – lakmus të këtij diskursi janë: përdorimi i vetës së dytë, i urdhërores, i dëshirores etj. , - tregues gramatikorë tipikë për ligjërimin e diskursin politik**.** Noli mbetet një poet që flet e shkruan si politikan – në fakt edhe figurat "akustike' të poezisë së tij e "tradhtojnë" këtë qëllimshmëri.

Gjithsesi, edhe për Nolin vlen shprehja e famshme e Marray Edelman-it se publiku përjeton gjithsesi ligjërimin mbi ngjarjet politike më shumë se vetë

ngjarjet[8]. Edhe në rastin e përvojës sonë me Nolin si "figurë politike e poetike", ligjërimi politik është realiteti politik.

[8] Murray Edelman, . *Costruire lo spettacolo politico*, Torino, Nuova Eri, 1992, f. 98

Dr. ELVIRA LUMI

FAN NOLI POET POLITIK APO I "DILEMAVE TE RASTIT"?

Në poezitë e Nolit duhet parë 'revolucionari'[9] siç e quan ai veten, apo poeti i 'dilemave dhe rrethanave të rastit'[10]?

Nëse do t'i referohemi kritikës sonë, pjesa më e madhe e tyre duke perfshirë si kritikën tradicionaliste por edhe një pjesë e kritikës së sotme e përcakton Nolin si 'poet esencialisht politik' (Kuteli, Koliqi, Fatos Arapi, Nasho Jorgaqi, Robert Elsie, Iskra Thoma, Rexhep Qosja, Arshi Pipa) ndërsa të tjerë e përcaktojnë Nolin si poet 'të dilemave dhe rrethanave të rastit' (Kujtim Shala, Sabri Hamiti, Mensur Raifi), duke e përjashtuar përcaktimin e parë si 'tepër i sforcuar'.

Do të ishte një titull më i qartë nëse do të pranonim: 'Politika dhe poezia e Fan Nolit' duke respektuar mendimet e dy grupimeve të kritikës, por bashkëjetesa e dy mendimeve të ndryshme në një analizë studimore si titull nuk do të na lejonte të ballafaqonim mendimet e kundërta dhe të hidhnim si tezë se cili mendim është më i drejtë dhe më i saktë dhe cili është qëndrimi ynë në rastin në fjalë.

Poezi tendecioze, e angazhimit, revolucionare, polemikë direkte, poezi retorike, agjitative, satirike deri dhe me prirje të majta janë disa tipare të poezisë politike që e dallojnë atë nga llojet dhe poezitë e zakonshme. Por dhe Homeri, Shekspiri, Dante ishin poetë politikë sepse veprat e tyre i bënin jehonë aktivitetit human në një kontekst historik, ku prirja politike shfaqet si angazhim i shkrimtarit në një kohë të trazuar të shoqërisë.

Në poetikë është e diskutueshme poezia politike, dhe lidhet me idenë a duhet të jetë politike apo jo një poezi, ku më shumë sillen argumente rreth kësaj ideje dhe rrallë kritikët merren me ekzaminime detajesh poetike. Po çfarë lloj poezish politike janë dhe çfarë tiparesh kanë? Poezitë politike nuk do të shkonin larg nëse poetët nuk do të shkruanin poezi të tilla me frymë politike. Ne jemi duke folur për poezi që lidhen me qëndrimin ndaj klasave, partive apor revolucionit. Disa kritikë mendojnë se çështjet politike nuk janë subjekt i përshtatshëm për poezi artistike. Mos ndoshta dhe dashuria, feja dhe natyra nuk janë të përshtatshme për poezinë? Diskursi politik duke iu referuar ideve dhe strukturës poetike lidhet me retorikën, me fjalorin greko-romak me filozofinë, psikologjinë, etikën dhe estetikën që gjen shprehje edhe në poezi politike. Shembujt më të mirë të poezisë politike janë kur poeti përfshihet me pasion në lëvizjet historike të kohës dhe zë një vend të caktuar në kohën kur jeton dhe krijon.

Nisur nga poezia dhe rrethanat historike[11], Noli na paraqitet një lider politik, udhëheqës fetar dhe gjeni i republikës së letrave. Përcaktimi si poet politik nuk na

[9] Shuteriqi. Dh, "Marin Beçikemi dhe shkrime të tjera", Naim Frashëri, Tiranë, 1987.
[10] Shala. Kujtim, "Vepra e vetmisë", Dukagjini, Prishtinë, 2005.
[11] Demiraj. Sh, "Fan Noli dhe gjuha e tij", Studime Filologjike 1, Naim Frashëri, Tiranë, 1982

duket ‘i sforcuar’ por natyral dhe dialektik[12] sepse lidhet me vendin që zë Noli në historinë politike të shtetit shqiptar, bindjet dhe idetë e tij mbi revolucionin dhe pasojat e përshtypjet që la ky revolucion në poezitë dhe në studimet e veta. Çabej pohon për Nolin se “nuk është e rastit por një poet ku përpjekjet për liri sociale e politike dhe konfliktet e brendshme shpirtërore janë ndërthurur në një mënyrë si moskund në literaturën botërore” që ai përkthen[13].

Ku mbaron politika fillon poezia për Nolin, sepse ai nga njëra anë raporton për politikanë si Ahmet Zogu, veten, Luigj Gurakuqi, Bajram Curri, Esad Toptani, Tomsoni etj. , dhe nga ana tjetër ai shkruan poezi mbi ta dhe përkthen prozë që janë kryevepra të letërsisë botërore por që lidhen me kontekstin politik dhe social të kohës. Kur poeti bëhet Kryeministër atëhere ai është poet i shqetësuar sa edhe një Kryeministër bëhet poet. Do të na duhet t’i referohemi Aristotelit në veprën “Etika” se ‘angazhimi politik është shkalla më e lartë e emancipimit të njeriut’[14]. Noli ishte një misionar politik që e angazhoi veten në Revolucionin e Qershorit ’24, dështimi tragjik i të cilit e frymëzoi pas katër vjetësh të shkruante 11 vjersha kushtuar vetëm kësaj ngjarje. Idesë së revolucionit, por tashmë atij francez, do t’i kthehet dhe në moshë të thyer me studimin “Bethoveni dhe revolucioni francez” (New York 1947). Rimarrja e idesë së revolucionit pas 27 vjetësh, na dëshmon për një poet që i mbeti besnik vizionit politik të domosdoshmërisë së ndryshimit demokratik dhe në rrugë revolucionare. Noli është poet i një kauze siç është revolucioni, çmimin dhe natyrën e të cilit e shprehu në poezitë e veta. Ai mbajti qëndrim politik ndaj klasave duke shprehur vizionin se pushteti lidhej me ‘katundarë e punëtorë’ pse jo dhe me një hero si ‘kuqo, Marathonmak’.

Çështja e Nolit është dhe një temë dilemë ku dilemat e tij mund të shqyrtohet me metodën psikologjike[15]. Fakti që i vetmi vëllim poetik ‘Album’ (1948) ku përfshihen dhe poezitë politike (pranoj t’i quaj kështu) apo dhe 26 vjersha origjinale të shkruara në një periudhe kohore prej 60 vjetësh (më lejon të pranoj pjesërisht dhe mendimin e dytë) ku Noli ishte dhe poet i ‘dilemave’ por jo thjesht të rastit dhe të rrethanave, por i një poeti gjeni që dilemat e jetës i pasqyron si dilema poetike utopike dhe universal (Jorgo Bulo)[16]. Rexhep Qosja do të pranojë se aksiologjia e tij politike dhe shoqërore është metafizike… një vision universal, oh çfarë iluzioni, Noli ka folur në emër të njerëzimit. [17]Edhe po t’i referohemi ‘konteksit’ apo ‘rrethanës personale’ poezia e tij bëhet konkrete, e hapur dhe kur është simbolike, alegorike apo një ‘alegori mitike’ sepse ajo paraqitet si poezi e një poeti të angazhuar që sakrifikoi gjithçka për jetën publike dhe civile dhe për ligjin parlamentar si ide progresiste. Poezia e tij është jo aq drama vetjake sesa ajo e kombit dhe e popullit të vet. Edhe kur flasim për dramë personale ajo më teper është një dramë politike sepse lidhet me thyerjen e

[12] Thoma Iskra, “Individualitete dhe vepra letrare”, “8 nëntori”, Tiranë, 1988.
[13] Cabej. E, ‘Fan Noli ynë’, Revista Nëntori, 4. 1965. Tiranë.
[14] Aristotelis, Hysni Bregu, “Etika”, Fllad, Tiranë 2001.
[15] Raifi. M, “Fan Noli dhe Migjeni”, Rilindja, Prishtinë, 1979.
[16] Bulo. Jorgo, “Magjia dhe magjistarët e fjalës”, Dituria, Tiranë, 1998.
[17] Qosja. R, “Panteoni i rralluar”, Naim Frashëri, 1988.

Revolucionit Demokratik dhe me kundërrevolucionin. Noli ishte udhëheqësi i këtij revolucioni dhe mësimet e tij i mishëroi në poezi[18]. Poeti u edukua me tiparet e viganit liberator, heroit dhe liderit të masave, tipare këto që lidhen me historinë e jetës dhe të edukimit të tij që nga familja, revolucioni dhe deri me shugurimin e tij si prift apo edukimi në shkollën e Harvardit. Noli është një poet i guximshëm, që botoi në organe politike të kohës. Eshtë poet i mosbindjes (deputet i opozites demokratike radikale në parlament) i cili synon të shpjegojë si 'poet gjykatës' veprimin e tij nga Perëndia tek njeriu dhe më gjerë nga njeriu tek revolucioni.

Përkthimi në greqisht i manifestit të Sami Frashërit "Shqipëria çka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet" qysh herët na bën të mendojmë se Noli ishte i prirur drejt veprave politike. Kultura e tij e gjerë e leximit zbulohet në fjalimin që mbajti në Gjeneve me rastin e pranimit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve të Bashkuara. Në një koment më 23 korrik 1924, Guardian Manchester e përshkruan Fan Nolin si një njeri "i cili do të kishte qenë i shquar në çdo vend. Një diplomat i përkryer, një ekspert në politikën ndërkombëtare, një debatues i zoti, që nga fillimi ai bëri një përshtypje të thellë në Gjenevë... Ai është një njeri me kulturë të gjerë që ka lexuar çdo gjë me vlerë në anglisht dhe frëngjisht ".

Po të shohim veprën poetike të Nolit ajo është 'tipikisht' krijimtaria e një poeti 'patriot revolucionar' që 'nis të aktivizohet në çastet e mbarimit të Rilindjes… dhe që e përgatitën për lëvizjen politike kulturore shqiptare" pohon Dhimitër Shuteriqi[19]

Ndërsa Kujtim Shala kundërshton: "Poezia politike kërkon te manifestohet përtej ç'është tipike në tekstin letrar e për komunikimin letrar. Duke qenë e lidhur me doktrinën e duke e afishuar atë, ajo do që të ndërhyjë në jetën sociale, në dimensionin politik te saj. Tekstet e tilla reduktojnë figurën përballë idesë e perballë ideologjisë. Identifikimi i poezisë së Nolit si politike me duket teper i sforcuar. Ai shkroi poezi të dilemës pa pretenduar sistematik idesh".

Mendojmë se nuk është e rëndësishme të pretendosh një 'sistematik idesh' por t'i bësh jehonë idesë së revolucionit në poezi si një mjet ndryshimi progresist është thelbi i një poeti politik. Iskra Thoma pohon se Noli sheh vetëm nevojën për luftë, e cila mund të kurorzohet me sukses vetëm prej udhëheqësit dhe në këtë rast i referohet poezisë së Nolit: "Te ura te ura/vraponi, o burra, me armë e me topa/ me kordh e me shpata. "[20] Po kjo studiuese thekson se tek Noli i rëndësishëm është ndikimi i ideve revolucionare dhe i referohet Nasho Jorgaqit kur pohon se Noli do të rishohë disa koncepte të botëkuptimit të tij, si pikëpamja mbi rolin e masave në histori, nevojën e përdorimit të dhunës revolucionare, karakterin klasor të shoqërisë etj.

Noli na del një poet në kapërcyell[21], nga romantizmi i Rilindjes Kombëtare ku spikat patrioti idealist dhe utopik, në poet surealist i dilemave politike, dilema që

[18] Akademia e Shkencave, 'Noli Vepra 5', "8 Nëntori", Tiranë, 1988.

[19] Shuteriqi. Dh, "Marin Beçikemi dhe shkrime të tjera", Naim Frashëri, Tiranë, 1987.

[20] Thoma Iskra, "Individualitete dhe vepra letrare", "8 nëntori", Tiranë, 1988.

[21] Demiraj. Sh, "Fan Noli dhe gjuha e tij", Studime Filologjike 1, Naim Frashëri, Tiranë, 1982.

shprehin qëndrimin kompleks të poetit dhe liderit kryengritës me forcat politike kundërshtare të kryesuara nga Ahmet Zogu.

Ernest Koliqi e vë Nolin në një radhë me De Radën, Naim Frashërin dhe Gjergj Fishtën me pasuni e thellësi ndjesish, me një prirje të vetvetishme për shprehje të mprehta e të preme. Një poezi romantike me tipare politike është "Hymni i flamurit" ku poeti i referohet atdheut, të shkuarës historike, evokon kultin e Skënderbeut, i referohet idesë së bashkimit dhe paqes fetare si një përlindje për atdheun. Poeti shkruan: "Përpjetë prije Shqipërinë/Përlintja shpirtin dhe fuqinë/Diell për vllanë, yrnek për fqinë/Për botën ëndërr e qiell i ri! [22]" Po në këtë poezi poeti shpreh bindjen se është ky "flamur i madh për vegjëli" një ide demokratike që me sa duket lidhet me programin e Konare-s, kryetar i të cilit Noli u zgjodh.

Idetë e Nolit janë shpërfaqur jo vetëm në poezitë, por dhe në përkthimet dhe introduktat e tij. 'Mendimi letrar i Nolit pohon Nasho Jorgaqi, do të tingëllojë i fuqishëm me një rezonancë përtej kufijve të artit… Tek introdukta për Jul Çezarin, Noli do të merret kaq shumë me këtë introduktë, me praktikën e luftës politike dhe me mësimet që dalin prej saj, sa kjo hyrje për një vepër letrare duket më tepër si një traktat politik mbi thelbin dhe luftën kundër tiranisë[23].

Po Nasho Jorgaqi shkruan se poezitë e Nolit 'përcjellin dhe sot e gjithë ditën idealet e revolucionit demokratik, mësimet e nxjerra nga fitorja dhe disfatat e tij, aspiratat njerëzore për progres, të vërtetën e përjetshme se i vogli mund viganin. S'ka dyshim se poezia më e mirë e Nolit është pjellë autentike e revolucionit demokratik shqiptar[24]".

Edhe Arshi Pipa e përcakton Nolin si poet politik, dyfish apostull. Ai shkruan: 'Si të gjithë të mëdhenjtë tanë, edhe Noli i kalon caqet e letrarit të thjeshtë, tue u shkri në një personalitet politik-fetar ma të gjanë'[25]. Formula e Nolit qe gjithmonë "Arti për edukatë". [26] Po ky studiues kur i referohet vjershave si 'Moisiu në mal' dhe "Shën Pjetri në Mangall'pohon 'edhe pse janë vjersha me tituj e me simbole biblike, përkah brendia janë satirike-politike dhe kanë të bëjnë me ngjarjet politike të qershorit dhe të dhjetorit të vjetit 1924". [27]

Ndërsa Kujtim Shala pohon se: Poezitë e tij në dukje, të një kodi biblik, s'janë postekste qe i referohen kontekstit personal te artikuluesit. Ato artikulojnë dilemën personale se a duhet të rrjedhë bindja nga forca e argumentit, apo nga argumenti i forcës. Kritika jonë ka parë këtu poezinë politike referenciale ndaj ngjarjeve të vitit 1924. Vetë këto ngjarje kanë qenë të dhunshme. Të tërën Noli e personalizon në poezi, duke mbetur te konteksti personal; kujto figurën e Moisiut ose te Krishtit si figura që i atribuohen autorit.

[22]Akademia e Shkencave: "Noli Vepra 1", "Album"; "Hymni i Flamurit", "8 Nentori", Tiranë, 1987.

[23] Akademia e Shkencave, 'Noli Vepra 5', "8nëntori", Tiranë, 1988.

[24] Jorgaqi N, "Estetika e fjalës shqipe", Onufri, Tiranë, 1996.

[25] Kulla. N, "Mendimi kritik letrar shqiptar", Plejad, Tiranë, 2004.

[26] Pipa. A, "Bariu i popullit", Kritika-Nr 4, Qershor 1944.

[27] Peshkëpia. N, "Fan Noli si poet dhe si përkthyes", Revista "Drita", 1 Maj 1994.

Jemi dakort me Shalën kur pohon se poezia e Nolit 'artikulon dilemën personale se a duhet të rrjedhë bindja nga forca e argumentit, apo argumenti i forcës', por mbetet pak konfuz kur një herë pohon se 's'janë postekste që i referohen kontekstit personal… 'dhe po vetë pranon se është poezi "e mbetur te konteksti personal".

Në këtë rast do të na duhet t'i referohemi elegjive për Luigj Gurakuqin dhe Bajram Currin, në të cilat poeti Noli njërin do ta quajë 'vëlla' dhe tjetrin 'baba'[28], janë poezi që u bëjnë jehonë bashkëluftëtarëve të tij dhe ku spikasin dhe elementë të kontekstit personal. Poeti e karakterizon B. Currin si tribun të vegjëlisë, dhe Gurakuqin si vigan liberator.

Koço Bihiku në artikullin e tij mbi "Fan Nolin dhe kulturën shqiptare" do të pohojë se 'Pikëpamjet e Nolit mbi kulturën mund të kuptohen thellë vetëm në qoftë se shihen në lidhje të ngushtë me pikëpamjet e tij politike e shoqërore dhe me këtë rast i referohet Nolit i cili shkruante: "... Kryeplaga, është feudalizma. Prej kësaj mahisen të gjitha sëmundjet…se janë pjesë e sistemit të saj. Çkule feudalizmën dhe si me magji të gjitha të tjerat çkulen…"

Poezia e Nolit 'nuk mund të mos përshkohet nga fryma demokratike dhe si e tillë duhet të ishte antipod i kulturës feudale'. Edhe në lidhje me klasat Noli mbetet një antifeudal dhe përçues i botës perëndimore.

Kujtim Shala e quan poezinë e Nolit si poezi te rrethanave. Mendojmë se ardhja e Nolit në Shqipëri më 1913 apo vizita e tij në Bashkimin Sovjetik, pjesëmarrja në Revolucionin e Qershorit të '24, apo fjalimi i tij në Lidhjen e Kombeve janë rrethana historike që do të ndikojnë në bindjet politike të Nolit, por do të ndikojnë dhe në intuitën e tij poetike jo thjesht si poezi e rrethanave të rastit por më tepër një poezi e rrethanave historike dhe revolucionare[29]. Njohja e të parit vend socialist me anë të vizitës në Bashkimin Sovjetik (1927), pjesëmarrja në Kongresin Ndërkombëtar Antifashist në Berlin, (1929) përkrah shkrimtarit komunist frëng Hanri Barbys, ndërsa militonte në Komitetin Çlirimtar Nacional qenë disa faktorë që ndikuan të shkruajë poezi politike, ku nga njëra anë mbrojti revolucionin demokratik, nga ana tjetër stigmatizoi Zogun dhe klasën e tij.

Eshtë mendimi politik idealist, i një vizionari utopik liberal që lufton për një shtet demokratik qeverimi deri dhe një aludim i një poeti me prirje të majta. Poezitë më të arrira politike Noli i krijoi gjatë viteve 1926-1930, në mërgim, nëpër Europë, i dënuar me vdekje në mungesë nga ana e regjimit zogist. Poezitë e mërgimit apo shtegtimit "Anës lumenjve" dhe "Rend or Marathonomak" janë dëshmi e ideve revolucionare. Poeti shpërthen në thirrje revolucionare kur pohon "Ngrehuni dhe bjeruni/Korrini dhe shtypini/katundar e puntorë/që nga Shkodra gjer në Vlorë/, ndërsa te Marthonomaku do të shprehet me patos retorik dhe politik: Se i vogli shtyp viganin/dhe i shtypuri tiranin/ veç e tok;/Tok, or Marathonomak.

Duke u nisur dhe nga poezitë me kod biblik mendojmë se të gjitha poezitë e Nolit zbulojnë një utopi ku poeti gjen një lehtësim nga jeta publike. Poeti tërhiqet nga sfera sociale dhe hyn në një ambient mitik, por politika në poezitë e tij është unike në atë që

[28] Arapi. F, "Fjalë për poezinë", Naim Frashëri, Tiranë, 1987.

[29] Akadameia e Shkencave të Shqipërisë, "Noli", Vep. 5, 8 Nëntori, Tiranë, 1988.

i mungojnë cilësitë pastorale apo cilësitë e një bote thjesht romantike, poeti gjendet i vetmuar në një kohë të trazuar dhe kontradikta është ajo midis angazhimit publik dhe izolimit personal.

Për Genet kontradiktat janë në qendër të politikës. Në rastin e Nolit politika paraqet luftën e brendshme të poetit për t'u angazhuar apo dilemën për të qëndruar larg nga bota? Në poezinë 'Kirenari" apo "Shën Pjetri në mangall" Noli denoncon pikërisht ata bashkudhëtarë të përkohshëm të lëvizjes demokratike, që dikur i përqafuan idetë e revolucionit, por që më vonë u larguan nga kjo lëvizje dhe i mohuan idealet e saj. Noli është një zë politik, që mban një pozicion në politikë, që kërkon të flasë me publikun dhe të zhytet në dilemat e tij universale. Në poezitë e Nolit ka opozita dhe kontrase të figurave, që shfaqen për të sfiduar dy anët e një qëndrimi, tek 'Moisiu në mal' shkruan: "Këtej ka dimrin, andej pranverën, /Kërkon parajsën, vdes në Skëterrën, / Ajme sa vrer, sa keq e sa zor, /Liberator".

Politika i dikton poetit një reflektim poetik dhe personal që e bën poezinë më të ndjeshme, emocionuese dhe që shfaqet si një raport i idesë me mendimin ku fiton emocioni. Ka një marrëdhënie mes politikes, siç është revolucioni, dhe estetikës, mes politikës dhe artit. Noli bën portretet poetike të shumë figurave politike. Armikun e vet politik e quajti Baraba dhe Sulltan, ndërsa veten e përqasi figurativisht me Krishtin si kryeprofet, njeri-perëndi, hero të masave. Në këtë rast Noli na del një poet narciz që e mbivlerëson veten dhe e veçon nga të tjerët. Do t'i referoheshim Tomas Manit i cili pohon se në kohën tonë fati i njeriut paraqet kuptimin e vet në qëndrimin politik. Noli shprehu revoltën e vet ndaj forcave zogiste dhe klasës feudale, dhe besoi në kuptimin e 'njeriut-perëndi'. Noli udhëheqës të kujton 'mbinjeriun' niçean që është kthyer në Mesi.

Kujtim Shala pohon se poezia e Nolit është e rastit, referenciale e okazionale, e lidhur me situata konkrete, si "Tomsoni dhe kuçedra", "Syrgjynvdekur", "Shpellë e Dragobisë". Për nga kriteri i kategorialitetit, kjo poezi njeh himnin, odën, elegjinë. Ndërkaq po iu referuam statusit të tekstit njohim poezinë e diskursit satirik, si "Kënga e Salep Sulltanit… "

Nga sa thamë më sipër nuk mendojmë se poezia e Nolit është e rastit, ajo është poezi e diskursit politik që pasqyroi reflektimet e poetit mbi kohën e revolucionit. Noli do të marrë material poetik nga historia, nga bibla dhe nga antikiteti dhe kjo nuk është e rastit. Nga historia do të marrë heronjtë, prej bilbës do të nxjerrë shëmbëlltyrat simbolike dhe prej antikitetit do të marrë figura për t'i derdhur në poezi.

Elegjia dhe satira janë dy llojet e poezisë që poeti lëvron më shumë. Tek elegjitë na shfaqet drama dhe tragjedia e dështimit të revolucionit, por dhe humbja e bashkëluftëtarëve më të mirë si Gurakuqi, Bajram Curri etj. , ndërsa satirat janë vazhdim i replikave politike që me improvizimet poetike në ish-parlamentin shqiptar në prag të revolucionit e deri tek satirat me kod biblik si "Marshi i Barabajt" apo 'Kënga e Salep Sulltanit", 'Sulltani dhe kabineti' dhe 'Vdekja e Sulltanit" që janë fejtone politike.

Ernest Koliqi do të shkruajë se në vjershat e pavdekshme të Fan Nolit shfaqen përpjekjet për ideal, ai naltsoi me një hov lyrik flatër-vervitës burrnin, veti qensore e jetsore kryekkrejet e fisit arbnuer. "…Nëno moj, mbaj zi për vllan, / Me tre plumba na

i ran…/ …Se të deshte kur s' të deshnin, / Se të qante kur të qeshnin / Se të veshte kur të çveshnin. / Nëno moj të ra dëshmor…/. . Ky vigan liberator". E ato për Bajram Currin? "…O Bajram bajrak i gjallë, /…Katakomb i Dragobis[30]

Vehbi Bala pohon se poezia politike realiste e Nolit karakterizohet nga njëra anë prej një intonacioni liriko-epik, dhe nga ana tjetër, prej një patosi qytetar dhe satirik tejet goditës.

Ne mendojmë se poezia e Nolit është surrealiste sesa realiste, sepse në to gërshetohet imagjinata e lirë duke prodhuar një proces krijues të lirë e kontroll të vetëdijshëm, ku buron shpirti i poetit idealist dhe utopik me prirjet e tij demokratike dhe progresiste. Poezia e tij është e pasur me figura; metafora, antiteza, simbole, alegori, është poezi që i referohet ndjenjave, por dhe argumentimit intelektual se sa ankesës retorike.

Përfundim: Poezia e Nolit është një poezi politike e dilemave universale, poezi surealiste dhe utopike, është një poezi që i drejtohet një auditori të gjerë publik, jo thjesht të shprehë ndonjë program apo fjalim, por të prekë mendjet dhe zemrat e publikut me anë të figurave. Është një poezi e fakteve dhe e konflikteve të brendshme, pse jo dhe një oratori publike. Poezi që rrjedh me vetëdije ose imiton poezinë popullore. Poezi që komunikon me forcën e saj retorike, poezi e fjalës gati në ekstazë. Poezi e humorit dhe e satirës. Poezi e dokumentuar, por dhe e tipit deklaratë poetike. Poezia e Nolit ka përmbajtje progresive, sepse shfaq vizionin e një bote demokratike.

[30] Koliqi E, "Emzot Theofan S. Noli", Revista 'Shejzat', 3-4/1965

Msc. ERIS RUSI

MADHËSHTIA DHE LIMITET E DRAMËS "IZRAELITË DHE FILISTINË" - SIPARI I NJË VEPRE TË HAPUR

Hyrje

Arti i teatrit është një nga shprehjet më të plota të natyrës së njeriut. Çdo kulturë e madhe dëshmon një traditë të gjerë teatrore dhe nxit përvijimin artistik të saj me vepra të mbrujtura në kohë: shkëlqejnë shembujt e Teatrit të Rusisë, të Francës, të Anglisë.

Drama ka qenë më pak e shtjelluar se gjinitë e tjera letrare në Shqipëri, ndaj përherë krijimet dramaturgjike, nga ai rreth i ngushtë autorësh shqiptarë, hapin vend për analizë dhe reflektim. "Izraelitë dhe filistinë" është drama e vetme e botuar nga Noli. Publiku dhe lexuesi shqiptar të cilit iu drejtua, qe tërësisht i ri, i pamësuar, gati indiferent. E shkruar në fillesat e Nolit artist, vetë autori kohë pas publikimit i hodhi kësaj vepre veladonin e pikëpyetjes dhe pak nga tisi misterioz i kohës. Është një dramë, nga të parat dhe të vlerësuarat e gjuhës shqipe, por mbeti më shumë një enigmë. "*Prandaj po ua hedh vëllezërve si një enigmë. Të shohim kush do ta zgjidhë*.[31]"

E vërteta është që mendja e një shkrimtari fsheh në labirintet e saj një fluks rrugëtimesh misterioze, që iu kundërvihen shpjegimeve të ditës dhe kritikave të muzgut. "Izraelitë dhe filistinë" është e hershme në kohë, si mosha dhe nxitjet e Nolit, ku nis të ndihet kozmopoliti qytet-shëtitës dhe djaloshi modest, nga një komb i vogël, me dëshirën për t'u bërë i madh.

1. 2 "Heretiku" dramatik

Studiuesi N. Jorgaqi prezanton ngjizjen e dëshirës së Nolit me teatrin, duke dhënë dëshminë fillestare të djaloshit që i afrohej skenës: "*Gjimnazisti pranoi menjëherë dhe atë ditë braktisi shkollën, për t'iu mësuar tekstin aktoreve analfabete*[32]. " Noli u njoh dhe u lidh me trupat teatrore shëtitëse, me pamjen e aktorëve, me skenarin e pjesëve, rolin e regjisorit dhe kumtin e përmbajtjeve. Për më shumë, ai përjetoi me raste vështirësitë praktike të profesionit skenik: *"Dy javë të tëra trupa mbeti rrugëve deri sa gjetën një anije me vela, një karakatinë që transportonte eshtra, dhe u futën fshehurazi. "*[33]

Konteksti ku u pranua, nuk qe vetëm jehona madhore e dialogëve drithërues, por edhe frika e aktorëve. Ëndrra idilike shndërrohej shpesh në "vetëm" një skenë të mbushur ca më tepër se zakonisht. Ndonjëherë e gjitha i ngjante rutinës së zgjimit të ngadaltë nga përtejbota. Noli i ri shkëmbeu me dëshirë punën e mundimshme të momentit, me rolin e kopistit pranë dramaturgut Kamburogllu. Por në thelb, ajo çka

[31] Sabri Hamiti, *"Letërsia moderne shqiptare"*, f. 114.

[32] Nasho Jorgaqi, *"Jeta e Fan. S. Nolit"*, Ombra Gvg, Tiranë 2005, f. 81.

[33] Po aty, f. 104

njohu dhe përjetoi, u pështjellua në një përditshmëri mbijetese, ku rrallë e pak lartësoheshin papritmas kështjella e artit, mundshëm dëgjoheshin kumbimet e duartrokitjes, e me dihatje përvijohej uni artistik. Nga jashtë, ngjante sikur Noli do të shndërrohej herët a vonë në një "heretik" dramatik. Teatri ku bënte pjesë, qe disi larg teatrit të '900-ës që i bënte luftë tekstit, e hiqte atë nga skena apo më mirë, e përdorte sipas qejfit të vet.

Ndërsa shumë protagonistë të kulturës teatrore të kohës hoqën dorë shprehimisht nga roli qendror i tekstit, ndonjëherë e eliminuan tërësisht, e manipuluan, e reduktuan në shërbim të rolit në skenë, trupat teatrore ku bënte pjesë Noli ishin të vogla dhe praktike. S'kishin pse të dëshmonin risinë e kohës kur iu duhej të mbushin sallat sot në një vend, nesër në tjetrin. Kjo e bëri Nolin të reflektonte. Hoqi dorë nga pjesëmarrja në turne. U shkëput nga shoqëritë teatrore: "*I kaloj ditët duke ngrënë hurma dhe duke filozofuar për kotësinë e botës"*[34]**,** sikundër i shkruante një shokut të tij. Por ndërkohë, e ka thënë të tijën. I ndjeu duartrokitjet dhe u gdhi në mëngjesin skenik. Tashmë e pat krijuar një dramë. "Izraelitë dhe filistinë".

1. 3 Ndërmjet dy shekujve

Analiza e Nolit si autor drame, duhet të nisë nga raporti i ngushtë i tij me artin dramatik, me botën skenike dhe me dramaturgët e mirëfilltë botërorë. "Izraelitë dhe Filistinë" u shkrua nga Noli në moshën 20 -vjeçare, kur ishte në Athinë dhe e botoi më 1907 në Boston. Procesi i krijimit dhe botimit të saj na lejon të shohim Nolin si një autor të dyzuar, ndërmjet një shekulli që vdes dhe tjetrit që porsa ka filluar. Noli nuk dukej në këtë kohë i ndërgjegjësuar plotësisht me panoramën artistike të kohës. Ambientet letrare e për pasojë bota teatrore në Evropë ishte në pështjellim të madh. Dolën dhe u krijuan avangardat e kohës që hynë në çdo fushë të artit, duke rrëzuar me dhunë të padyshimtë kanonet estetike dhe shprehëse të së shkuarës.

Fare pak u pa një ndikim i tillë në dramën e Nolit, por ajo çka e bëri të veçantë dhe tunduese këtë vepër, qëndroi pikërisht te rrugëtimi që bëri dorëshkrimi nga Athina ku u shkrua në moshën 20 -vjeçare deri në Boston ku pa dritën e botimit. Ndaj, nëse në vepër nuk shohim të reflektohen luhatjet e ndjenjave avangardiste evropiane, procesi i udhëtimit të veprës lejon të ndriçohet natyra kërkuese e autorit i cili dëshiroi të gjente tempin e duhur dhe bindjet e forta për të ndërhyrë dhe redaktuar veprën me frymën dhe nevojat e kohës.

Ishte e dukshme tek autori i ri dëshira për të dalë në skenë. Përballja dramatike në art s'qe gjë tjetër veçse pasqyrim i asaj çka do të ofronte më vonë jeta reale e Nolit. Kështu krijimi i dramës mund të përkthehet edhe si mbivendosje e skenës mbi jetën konkrete. Pra vepra s'është gjë tjetër veçse një laborator i vogël, ku luajnë e gjallojnë ide. Noli studioi në teorinë dramatike, atë që do të luante vetë në jetë, ndaj drama u bë për të një zgjatim kuptimplotë i jetës reale.

[34] Nasho Jorgaqi, *"Jeta e Fan. S. Nolit"*, Ombra Gvg, Tiranë 2005, f. 113

1. 4 Sfondi biblik dhe heroi kundërthënës

Historia e Samsonit merret nga "Libri i Gjykatësve". Samsoni (në gjuhën hebraike Shimshon që do të thotë "diell i vogël") ishte një gjykatës biblik i përshkruar në "Librin e Gjykatësve". Nuk përjashtohet që në origjinë, mund të bëhej fjalë për një figurë mitike gjysmë hyjnore, meqenëse emri i tij lidhet me Diellin. Kjo tezë, shumë e përhapur në shekullin XIX, sot gjen konsensuse më të pakta akademike sesa në të shkuarën.

Libri mbulon një hapësirë historike dyqindvjeçare, afërsisht nga 1200 deri në 1030 p. K (data zyrtare e fillimit të monarkisë në Izrael) dhe është periudha kur pasi janë lënë pas krahësh ngjarjet e lavdishme të fitimit të Tokës së Premtuar, Izraeli gjendet i rrethuar nga armiq të huaj dhe të brendshëm të çdo lloji. Rabi Jokanan, rabini i madh hebre i shekullit të parë, e komentonte kështu emrin e tij: "*Zoti është dielli dhe mburoja. Ashtu siç Zoti mbron botën, njëlloj dhe Samsoni mbronte popullin e Izraelit"*[35]. Lindja e Samsonit i ngjan nga afër asaj të Izakut, të Samuelit, Të Gjonit dhe të vetë Jezusit. Në të gjitha rastet, një engjëll i paralajmëron lindjen prindërve. Pasi fëmija lind, ai i dedikohet Zotit. Ja përse bëhet "nazireas", duhet t'iu nënshtrohet disa privimeve në jetë, të mos pijë alkool dhe sidomos të mos presë flokët. Samsoni duhet të jetë nazireas përgjithmonë, pasi koha ku jeton është dramatike, me Filistinët që dominojnë dhe shtypin popullin hebre.

Po Samsoni a është vërtet një hero? Në Testamentin e vjetër një hero nuk është i tillë kur ka një forcë të madhe, por kur arrin të fitojë sidomos vetveten, iu reziston instinkteve dhe heq dorë nga diçka që dëshiron. Rabinët e vjetër shpreheshin *që "Torahu i bën më të dobët ata që e studiojnë"* duke nënkuptuar forca fizike është e kotë për atë që ka forcën e fjalës.

Samsoni vdes në mes të tre mijë armiqve, por vdes i vetëm. Është vërtet i fortë, por përse është gjithmonë i vetëm, pa miq, pa shoqëri armësh? Përse nuk mbledh një ushtri që ta çojë tek fitorja? Sikundër komenton Eli Viesel (Elie Wiesel): "*Samsoni është vërtet një personazh kundërthënës. Është një luftëtar, e për më tepër i pamposhtur, por forca e tij fizike vjen gjithmonë nga shpirti i Zotit. Është një hebre, por shumicën e kohës e shohim në territorin e Filistinëve. I është përkushtuar Zotit por shkon përherë në gjueti të femrave pagane. "*[36]

Krishtërimi trashëgoi nga tradita hebraike imazhin e Samsonit që në territoret latine pësoi një lloj transformimi, duke u krahasuar për aspektet më "muskulore" me atë të Herkulit dhe për ato shpirtërore (përkushtimi ndaj së Përjetshmes, sakrifica finale) me atë të Krishtit. Për këtë arsye Samsoni u përdor në ikonografinë paleokristiane si simbol i Krishtit.

Për shekuj figura e Samsonit mbeti një arketip i figurës së heroit duke përfaqësuar efektet e asgjësimit të prodhuar mbi heroin nga tërheqja femërore – asgjësim nga i cili ai arrin të shkundet vetëm kur paguan si çmim sakrificën ekstreme të vetes.

[35] Libri i Gjenezës, 28.

[36] Elie Ëiessel, *"I maestri della Bibbia, del Talmud e del Chassidismo"*, Garzanti Editore,

Në këtë formë, Samsoni është heroi më i përshtatshëm për dramën e Nolit. Heroi, i detyruar të jetojë kundërvënien e idealeve frymëzuese me realitetin pasionant, lejon që subjekti biblik të harmonizohet natyrshëm me brendi filozofike, shoqërore dhe morale.

Antitezat e Samsonit duke njohur më vonë dhe predispozitën e veçantë të Nolit për këtë figurë retorike, i japin skenave kolor tragjik, lartësojnë veprimet dhe gjestet e mundësojnë bashkëjetesën e situatave të kundërta mes tyre.

Kundërvëniet ndërmjet rolit përfaqësues dhe mendimeve në kundërshtim me të, shfaqen që në fillim të veprës edhe te personazhe dramatike si figura e rabinit. Ky personazh, në fjalët e para hapëse të dramës, ndërpriten nga turma dhe akuzohet: *"Blasfemon, në mos i ke besë fuqisë së Perëndisë. "*[37]

Rabini i veshur me petkun e Perëndisë, predikon pashpresën. Fjalët e tij quhen mëkate dhe zëri i kthjellët i ngjan përqeshjes së hidhur: "*Të vërtetën lipset ta japim me hapë Gënjeshtreje"*, ose *" Njerëzit do ta pandehin të vërtetën si gënjeshtër dhe atje është goditja"*[38]

Kundërthëniet e heroit jo vetëm tronditin shpirtin e tij, por nxisin ankth dhe frikë sa zgjidhja më e mirë është të jetosh në padituri: "*Në vafshim pas zemrës, prishemi. Në vafshim pas shpirtit dëbierim udhën e qëllimit të rrojtjes. "* [39]

2. 1 Udhëtimi i heroit

Jozef Kampbell në veprën e tij "Heroi me njëmijë fytyra" i kushton rëndësi të veçantë mitit të heroit. "*Të gjithë mitet e heronjve janë pak a shumë e njëjta histori me futjen e variacioneve dhe të gjitha rrëfimet ndjekin modelet e mitologjisë, ku udhëtimi i heroit përfaqëson pikën e nisjes. Elementët e udhëtimit janë përfaqësime simbolike të elementëve universalë të jetës dhe këto simbole mund të ndryshojnë për t'iu përshtatur rrëfimit ose vlerave të shoqërive të ndryshme. "*[40]

Modeli i udhëtimit të heroit paraqitet në çdo kulturë dhe në çdo kohë. Bëhet fjalë për një model me nuanca të thella dramatike dhe që e shohim të restauruar në veprën 'Izraelitë dhe Filistinë", ku Samsoni përshtatet në gjithë etapat e rrugëtimit të heroit biblik në tre aktet e dramës. Ai është një hero që paraqet dobësi, nuk i mposht dot asnjëherë plotësisht demonët e tij deri në pikën sa rrezikon të mundet dhe vetësakrifikohet. Në këtë rast sakrifica dhe vdekja e heroit hyn në paradigmën e ndëshkimit pasi ka abuzuar me fuqinë e tij aq sa ka kapërcyer çdo limit.

Fazat e udhëtimit të heroit:

Bota e zakonshme

Samsoni në fillim të dramës përshkruhet në ambientin e tij natyral, për të krijuar një kontrast me botën ku do të shkojë. Ngjarjet zhvillohen në Jerusalem dhe pamja e parë hapet në Sinagogën e Judëve. Hierarkia fetare dhe të pranishmit janë nga i njëjti komb

[37] F. S. Noli, "*Vepra 1"*, f. 133
[38] Po aty, f. 136
[39] Po aty, f. 143
[40] Joseph Campbell, *"The hero ëith a thousand faces"*, Bollingen series, nr. 17.

dhe besim si Samsoni. Kryerabini paraqet që në fillim misionin e të përzgjedhurit: *"Popull i Dheut të shenjtë të Izraelit, sot në këtë konferencë iu thirra të gjithëve që t'i jepni bashkë me mua uratën këtij njeriu që mori përsipër të sjellë më udhë të drejtë botën e dëbiertur të Filistinëve"*[41]

Samsonit i prezantohet një mision i vështirë për t'u kryer. Kjo do ta largojë nga bota e zakonshme për ta shtyrë drejt një bote tjetër të re dhe të panjohur. Noli ngre në këtë pikë disa pyetje dramaturgjike: " *Pra po si ju tani mund të bindni një njeri të lumtur dhe pasur që gëzon gjithë gëzimet e jetës, se nuk rron pas së vërtetës? (f. 132) ; Një popull i tërë i jep uratën, priftërinjtë e gjithë Izraelit e përcjellin me bekime, po atëherë kush mund të dyshojë? (f. 133); "Si? Të lëçitim të vërtetën me shpata dhe me pahir? (f. 13). "*

Përvoja dhe eksperienca ngre pikëpyetje nga ku Samsoni duhet të mësojë dhe të reagojë. Por Samsoni është një personazh i epërm shpirtërisht, i pastër dhe kerubin i së mirës dhe të vërtetës. Ngjason në tipare dhe në mendim me engjëjt e dëlirët të qiellit e jo me profetët e rrahur të tokës. Fjala e tij është predikim, argumentet që tregon janë psalme që ngjasojnë së tepërmi në formë dhe në përmbajtje me mesazhin e krishterë të Qengjit të Perëndisë. Në tempullin e besimit dhe para popullit të tij, Samsoni ngjan i pagëzuar me fjalën e shenjtë. Është uji i kthjellët, pa nisur zbritjen nga burimi i vet. E pikërisht zbritja dhe kalimi në tokat e huaja të filistinëve, do njollosë dhe korruptojë shpirtin e tij: *"Dua ta përhap mbi gjithë botën dhe asnjë fuqi nuk mund të më qëndrojë. Dua t'i mësoj Filistinët të këqyrin perëndinë brenda në natyrë dhe Përjetësinë në dashuri. Por këto nuk përhapen me zjarr e me hekur, por vetëm kur njeriu është i lirë t'i marrë vesh, apo jo? (f. 138). "*

Ndërmarrja e misionit

Samsoni reflekton dilemën morale të popullit të tij. Mëdyshjet dhe luhatjet se cila është rruga më e mirë për të përçuar të vërtetën dhe dritën e Zotit tek filistinët, orientojnë luftën e brendshme të tij para nisjes. Dëshirat dhe nevojat universale që në fillim ndeshen me paragjykimin kritik të një rrugë që është provuar nga të tjerë predikues. Samsoni duhet të ecë aty ku kanë dështuar më parë. I ngjizur me pasionin e fjalës, ndryshe nga heronj të tjerë, ai nuk pranon të ketë shoqërues dhe ndihmës. As figurën e një mentori praktik e të mençur, por "*vetëm dashurinë e Rahilës dhe zjarrin e të vërtetës së hyjëshme (f. 142).* "

Duket sikur Samsoni ndien që në fillim fundin e tij tragjik. Parandjenja e tij s'e lejon të marrë udhëtarë të tjerë në pelegrinazhin që do të nisë. Kjo zgjedhje e vetmisë, me arrogancën e moshës dhe bindjen e verbër, i ngjan një defekti tragjik që më vonë do ta vendosë në baraspeshë me fatin e vet dhe në fund do ta çojë në shkatërrim. Samsoni mëson të njohë dhe pret aventurën e madhe, kalimin e vështirë drejt diçkaje të rrezikshme dhe të panjohur. Është gati të niset dhe mes veti thotë: "Bota më heq! "

[41] F. S. Noli, "*Vepra 1"*, f. 131

Bota e jashtëzakonshme

Akti i dytë hapet me praninë e Samsonit në tokën e filistinëve. Gjendet i rrethuar nga armiq që komplotojnë kundër tij: *"Po ti moj Dalile, shiko ta vësh të flerë sot në pëlqi tënd dhe të na thërraç ta lidhim dhe ta vrasim (f. 145)"*

Kërcënimi që i avitet Samsonit nuk është fizik. Forca e tij e jashtëzakonshme i jep ndjesinë të ndeshet dhe të triumfojë mbi situatat. Fatkeqësisht, përballja ku del i humbur është beteja e errët midis dritëhijeve të zemrës. Aty ku pasioni zgjohet dhe errëson gjykimin, Samsoni tenton të shpëtojë dhe evokon kumtin e tij fetar, zërin e së vërtetës. Por sa keq që askush, as zemra e tij, s'ka forcë ose largohet ta dëgjojë. Për atë tani janë vetëm puthjet dhe ledhatimet e Dalilës.

I mjaftojnë të heqë dorë për pak, mbase do çohet më vonë e të të përmbushë atë për të cilën është nisur. E Dalila e ka zërin aq të ëmbël, trupin aq të bukur e puthjet aq të zjarrta, sa kur flet zëri i saj çliron pasion erotik: *"Eja Samson. Pra mendohu se sa gjë e bukur është të duash të ndreqësh botën dhe të flesh mbi gjunjët e së dashurës. (f. 147). "*

Beteja e Samsonit shndërrohet nga përballje në skenë të hapur me armiqtë e Së vërtetës, në një krizë emocionale ku i duhet të dorëzohet pashmangshëm krahëve të Dalilës. Ngjan sikur fuqia e tij nuk qëndron më te flokët (aq sa këtë sekret e shpërdoron duke e treguar pa më të voglën rezistencë), por te thelbi i tij si njeri; te pasionet dhe zjarri që i djeg zemrën, jo shpirtin.

Bota e jashtëzakonshme, e huaj, ku ndodhet, është toka e pasioneve; jo Vendi i Premtuar i Perëndisë por shtrati i ngrohtë e joshës i Dalilës. Samsoni zvogëlohet, mblidhet e mpaket në një njeri të zakonshëm, që përditëson adhurimin e tij ndaj femrës përkrah. Në këtë fazë, Noli na ofron një hero tokësor, me lirizmin e pasioneve dhe dobësitë njerëzore që projektojnë keqardhje të natyrshme për fatin e tij tragjik.

Rënia

Ky është një motiv që do ta shoqërojë fatalisht Nolin në jetën e tij. Më siguri nuk e kishte të qartë gjatë krijimit të veprës se fati do ta vendoste disa herë përballë zgjedhjeve të vështira, ku pas lartësimit në tokën e triumfit, do të rrëzohej dhe do t'i duhej t'ia niste me vështirësi, por pa tërheqje, nga e para. Rrëzimi i Samsonit, humbja e forcës dhe verbimi i tij, mbart në vetvete elemente epike, duke u afruar çuditshëm me peripecitë e Uliksit në tokën e Polifemit. Në këtë rast Dalila është njeriu dinak, që me mjeshtëri dhe zgjuarsi arrin të nxjerrë sekretin e forcës së Samsonit dhe ta përdorë atë për të ndihmuar njerëzit e saj. Samsoni, shndërrohet nga një hero i popullit të tij, në një vigan të verbuar, që kobshëm afron fatin e tij me atë të Polifemit.

Gjiganti i frikshëm i "Odiseas" së Homerit, i turbulluar edhe ai nga avujt e verës dhe sofra tokësore e kënaqësisë, bir i Posedonit e për këtë prepotent për fatin e madhërishëm që s'ia ndryshonte dot kush, e lë veten të mashtrohet dhe shpërbehet për mendjelehtësinë e tij, me verbimin e kobshëm.

Sikundër tek eposi homerian, filistinët, këta paganë që notojnë mes luksit të kënaqësive dhe epshit të mishit, verbojnë Samsonin duke skuqur një hekur për t'i nxjerrë sytë.

Nga shumë studiues 'Izraelitë dhe Filistinë" është quajtur një dramë idesh e mesazhesh dhe vërtet janë të rralla ilustrimet e forcës, preken përciptazi demonstrimet e frikshme të shpërthimit së Samsonit. Për të plotësuar diçka nga figura e heroit biblik, mund të jetë me vlerë interpretimi aspak ortodoks i studiuesit Vogels, i cili provokon duke e quajtur atë një dështim total. *"Ky Tarzan biblik,* - thotë Vogels, - *i la pas dore detyrimet e besimit të vet. Akoma më keq, ngjan sikur s'mësoi gjë nga eksperiencat e tij të këqija. E Ofendoi Zotin, bëri të vuajnë prindërit e tij, përdori gra të ndryshme për të kënaqur pasionet e veta. Vrau me mijëra filistinë, por pa arritur dot një paqe afatgjatë. Çfarë jetë e harxhuar kot dhe sa vdekje e pakuptimtë. Samsoni s'është një hero, por një i çmendur. "*[42]

Kuptohet që ky provokim agresiv nuk duket në veprën e Nolit. Por gjithsesi autori na jep profilin e një njeriu që dështon dhe mposhtet në idetë e tij. Humbja e shikimit dhe e forcës është kastrimi i virilitetit të heroit. Çuditërisht fatkeqësia e bën Samsonin të rifitojë pak e nga pak pulsin e mendimeve që e frymëzuan para nisjen në misionin e tij. Por ndërkohë, i dobët fizikisht e vetëm me idetë që nisin t'i qartësohen në mendje, nuk është më i mjaftueshëm për Dalilën: "*Unë të donja sa ishe trim dhe kishe duar të forta të më shtrëngonje në qafë dhe të vrisje filistinët, tani ç'të bëj me ty? (f. 155)"*

Samsoni i provoi të gjitha mënyrat të bënte për vete Dalilën e cila simbolizon dhe popullin e saj filistin. I tregoi Të vërtetën, fjalët i renditi si kumt i madhërishëm e kur ato s'mjaftuan, e përqafoi, e puthi dhe ngrohu trup e zemër me të. Të gjitha nuk mundën që ajo të ndryshonte. Asgjë nuk e bindi të ndërronte mendim.

Nga studimet e bëra mbi dramën "Izraelitë dhe Filistinë", me të drejtë është konsideruar që drama *"mund të shprehë idetë e kundërta për jetën e dy popujve, ku sado e fuqishme të jetë një kulturë, ajo nuk duhet t'i mbivihet një kulture tjetër me qëllimin që ta asimilojë atë, e bashkë me të dhe popullin e saj* (S. Hamiti). Nëse thellohemi në këtë pikë, shohim se është e vështirë të kryhet një imponim i tillë. Fati i Samsonit dhe Dalilës, dy njerëz që personifikojnë dy botë të kundërta, e sugjeron këtë bindje si përfundim.

Rikthimi

Akti i tretë i ngjason ringjalljes së heroit të verbuar. Tek ai ka zënë vend arsyeja dhe ndjenjat e shpirtit janë filtruar në kanalet e shpresës dhe besimit në Zot. Pafuqia dhe dobësia e përftuar, ndihmojnë në pastrimin e Qenies dhe e bëjnë Samsonin t'i afrohet Qiellit dhe dritës së përtejme. Ai fiton një personalitet të ri, i sheh gjërat si janë dhe pëson një lloj *katarsis* që e ndihmon të gjejë gradualisht forcën e humbur. I larë në rrezet e kësaj drite të re, Samsoni gjen forcë të lutet e me këtë të kthehet si ishte më parë. Por forca fizike që i vjen, nuk shoqërohet me dritën e syve, e në verbërinë e tij, zëri Samsonit është i thellë, tragjik. E tija i ngjan një hakmarrjeje të kobshme. E nuk kemi triumfalizëm, më tepër na duket të shohim fatalizmin e një jete që s'u çua në fund ashtu si duhej. Atë që s'bëri fjala do ta bëjë humbja e saj. Vdekja e armiqve, njëherë e përgjithmonë: *"Unë do të rri këtu të vdes bashkë me ta. Do të vritem sepse*

[42] Valter Vogels, *I falliti della Bibbia,* San Paolo 2008

më s'mund të të dashuroj, por do t'i vras edhe këta që ma vodhë dashurinë tënde. Do të vritemi të gjithë. (f. 165)"

Në këtë pikë, drama merr sensin e mbylljes dhe të përmbushjes. Rrëfimi kthehet në gjendjen fillestare. Lexuesi ka kohë të kujtojë se si ka filluar çdo gjë për heroin, është në gjendje të bëjë një krahasim dhe të shohë sa larg ose sa shumë ka ndryshuar ai. Fundi i pashmangshëm është sakrifikimi final i vetes. Është mbarimi i udhëtimit, rënia e siparit që i lë më të ndërgjegjshëm, pjesëmarrës të së gjithës e të transformuar, lexuesit e dramës. Rrethi kështu mbyllet.

Përfundime

Jo të gjithë autorët e teatrit shqiptar mund të quhen me titull të plotë "dramaturgë". Pirandelo sugjeron *dikotominë ndërmjet "atij që bën art dhe atij që bën artefic" e cila sigurisht nuk synon të dobësojë veprën e artizanit të mirë, por e dallon nga artisti krijues i formave të reja, dramaturgu*[43].

Duke qenë e kufizuar krijimtaria dramatike e Nolit, është e arsyeshme të mos bëhet një vlerësim i mirëfilltë pirandelian i modelit dhe dramës së tij. Një analizë e ngurtë e këtij lloji, padyshim do ta largonte Nolin nga dramaturgu apo artisti krijues të formave të reja.

Oskar Shlemer e cilëson historinë e teatrit si transformim të figurës njerëzore. Vetë jeta e Nolit mund të cilësohet një transformim dramatik i njeriut që lufton e ndeshet me jetën, deri në tone tragjike. Bie e lartësohet disa herë, kumbon jehonën kozmopolite me tiparet e trazuara të mendimtarit patriot shqiptar.

"*Drama*, -shkruan Mauris Blanshot (Maurice Blanchot), - *i jep zë, tek njeriu, të pathënës, të pashprehurës, jonjerëzores, asaj që është pa të vërtetë, pa drejtësi, pa të drejtë, aty ku njeriu nuk arrin të njohë vetveten"*. [44]

Janë pikërisht këto cilësi të dramës që e tërheqin instinktivisht Nolin në krijimin e "Izraelitë dhe filistinë". Vlerat e dramës dhe arritjet e saj qëndrojnë te fryma dhe idetë që paraqet Noli jo vetëm te personazhi qendror, por edhe të figura të tjera të dramës. Ideja e misionit për të përçuar të vërtetën, lartëson misionarin dhe hap para lexuesit jo vetëm rrugën e lodhshme që duhet bërë, por edhe humnerat ku trupi dhe shpirti rrezikojnë të varet.

Arti dhe mjeshtëria e Nolit qëndron në maturimin e një subjekti biblik, me idetë dhe mesazhet e kohës, duke i dhënë deri diku një heroi të Testamentit të Vjetër, frymën kristiane dhe frymëzimin humanist.

Drama është e strukturuar në akte që funksionojnë të ndërlidhura artistikisht dhe kanë harmoni skenike. Një nga limitet e dramës qëndron pikërisht te mungesa e vënies në skenë nën mbikëqyrjen e vetë autorit. Kjo mund t'i jepte më tepër lëvizshmëri dhe formë personazhe, e mund të çonte në rishikimin, përpunimin dhe qartësimin e mëtejshëm të kumtit dhe ideve.

Është një limit ky i pranueshëm në kohën kur Noli vendosi të shkëputet nga teatrot shëtitës dhe atmosfera kaotike e zhurmës së skenës. Ndaj dhe e quan "skelet dramë"

[43] Giorgio Squarotti Barberi, *"Saggi critici su Luigi Pirandello",* Saggistica Bonaccorso.

[44] Maurice Blanchot, *"Lo spazio letterario"*, Einaudi Editore.

veprën e tij. E di që i mungon dhe është ende e paplotësuar diçka, ndoshta tek roli qendror i Samsonit tragjik.

Por këtë, vetë Noli do të përpiqet ta korrigjojë më vonë, kur interpreton në jetën reale e mes filistinëve bashkëkohës, heroin modern të kombit të tij.

Msc. ESMERALDA HIDRI

INDIVIDUALIZMI I STATUSIT DRAMATIK I VEPRËS "IZRAELITË DHE FILISTINË"

(Në kërkim të një metodologjie analizuese)

Drama e vetme e Nolit e shkruar në gjuhën shqipe "Izraelitë dhe Filistinë", e konsideruar si drama e parë e ideve në letërsinë shqipe[45], vazhdon të intrigojë në çdo përpjekje entuziaste për t`iu afruar asaj. Nisur nga kjo joshje e veçantë që ajo gjeneron dhe për t`i shpëtuar tundimit për t`u përsiatur në thellësitë e saj të sugjeruara ose jo, jam përpjekur të ndërtoj në hulumtimin e saj një metodologji të paracaktuar që parashikon tre plane, atë filologjik – dramaturgjik dhe simbolik, të cilat vijnë të shkrira mes tyre në kërkim të elementeve ndërtues të poetikës së kësaj drame.

E ndërtuar si një arketip i vështirë për t`u klasifikuar, ndonëse e thjeshtë në paraqitjen e saj skenike të vetëm tre akteve, ajo në të vërtetë nuk mund të lidhet me një model të përgjithshëm drame. Vetë Noli e quajti *skelet dramë*, apo *foshnjë-dramë*, duke qenë i vetëdijshëm për formën e saj të paplotë e duke propozuar si enigmë jo vetëm idetë, por dhe formën e saj. Ndaj do të jenë sugjestionimet biblike, të njëjtat që i shërbyen Nolit si ndërtuese të dramës së tij e të vetmet baza të vërtetueshme, ato që do të përdoren si një çelës i parë interpretues i tërësisë së saj. Shohim sesi simbolika e parashtesës biblike të Zanafillës e dërgon Nolin-krijues në një tjetër dimension profetizimi, në një kontekst që tashmë i referohet aktualitetit historik. Nisur nga koncepti teorik analizues, që i sheh rrëfenjat biblike si sygjeruese në planin e refleksionit filozofik, të lidhjes së momentit dramaturgjik njerëzor me atë njohës, parë kjo sidomos në profilin e teologjisë kristiane, që dhe na intereson, do të nisemi nga raporti shumë i ngushtë mes dramaturgjisë dhe liturgjisë, për të kaluar tek ai specifik i kësaj drame me kohën që e lindi dhe shoqërisë së cilës iu drejtua.

Duke analizuar përmbajtjen e dramës në raport me makinën simbolike që e drejton atë, rrëfimi biblik i Samsonit, parë nga Noli si një dilemë ideologjike e lejimit ose jo i ndryshimit me dhunë, do të shërbejë si një lloj pasqyre e shoqërisë njerëzore të pakohë, por edhe asaj shqiptare dhe realitetit historik të fqinjësive ballkanike të kohës së shkrimit nolian. Sikurse studiuesja Ewa Miodonska Brookus nënvizon, roli i shkrimeve dramaturgjike në kohë të caktuara e historikisht të angazhuara, ka qenë i lidhur fuqishëm me ngjyrimet nacionaliste. Që këtu gjurmët e dukshme të personalizimit nolian të rrëfenjës biblike, që erdhi në gjuhën shqipe në formatin dramaturgjik pikërisht në kohën e manifestimeve serioze të ndërgjegjes kombëtare, sidomos në popujt e Ballkanit.

[45] Shiko Sabri Hamiti, Poetika shqipe, SHTEPIA BOTUESE 55, fq. 172

Edhe studiuesi ynë i mirënjohur, Rexhep Qosja, ndërsa e cilëson Nolin si një prej shëmbëlltyrave më interesante të letërsisë, kulturës e historisë shqiptare[46], përcakton kohën e shkrimit të kësaj drame nga Noli, si momenti i ndërgjegjësimit të tij për prioritetin e aktivitetit praktik, politik e shoqëror përballë veprave artistike. Ndoshta kjo është një nga arsyet që e pengoi Nolin të vazhdonte të eksperimentonte në gjininë e dramës, përtej dëshirës dhe talentit të tij dramatik. Kur Heidegger i dha vetëdijes domethënie historike, ai ia humbi njeriut pozicionin si figurë qëndrore dhe dominuese. E përmendim këtë pasi fenomenologjia hermeneutike, themeluar prej tij do të bëhej e para që do të shprehte aspirata interpretuese për shkrimet e shenjta e më pas për interpretimin tekstual në përgjithësi, duke më ndihmuar në njohjen e këtij teksti të veçantë, sjellë nga Noli jo thjesht si shprehës i subjektivizmit individual, pasi edhe në këtë rast subjekti është thjesht mjeti shprehës i së vërtetës. Pikërisht kjo do të jetë pika e njohjes nga e cila duhet të nisë hulumtimi i poetikës së kësaj vepre pasi koncepti dramaturgjik që e sheh teatrin si një vend ku mundësia metaforike e tekstit mund t`i japë jetë një përballjeje dhe debati idesh që në realitet do të ishin censuruar, gjen vend sidomos në këtë dramë të Nolit[47].

Janë personazhet kryesore, përmes të cilëve mishërohen bërthamat problemore të tragjedisë, nga ku do të përpiqemi të sendërtojmë idenë-dilemë që autori ndërton në të. Noli e kishte kuptuar se në ndërtimin e vërtetë të tyre një rol shumë të madh do të kishte dhe lexuesi, të cilit do t`i duhej t`i rindërtonte këto figura, t`i plotësonte apo qartësonte imazhin e tyre, duke i rikontekstualizuar në kohën, vendin e sipas mënyrës së tyre, gjithmonë duke respektuar faktin që vetë autori vendosi të mos i prekë më për të ruajtur ndoshta kështu naivitetin e perceptimit të tyre fillestar. Që në përzgjedhjen e temës, pra të parabolës së Samsonit, Noli dëshmoi frymën romantike që ende dominonte në frymëzimet letrare shqiptare. Dihet se edhe përgjatë romantizmit shkrimet e shenjta shërbyen si një model stilistikor ku përmes vizionit politik të popullit të Izraelit transmetoheshin ide dhe mendime me frymë nacionaliste. Kështu ngjarjet biblike prezantohen në këto rimarrje si një rreth i mbyllur ku e shkuara dhe e tashmja përzihen sikurse kulturat dhe qytetërimet që ajo lidh. Në momentin që zgjodhi Samsonin si protagonistin e tij, Noli do t`i jepte atij një jetë të re, përtej paratekstit biblik nga ku e mori, por dhe dimensionit skenik ku do ta prezantonte.

Samsoni[48], heroi me forcë të mbinatyrshme, dhënë nga Zoti, padyshim më i veçanti i gjykatësve të librit të shenjtë, vjen në përfytyrimin nolian të aktit i parë, i lartësuar në vetëzgjedhjen e misionit të tij si i vetëm dhe i pashoqëruar nga forca e dhuna: "*Tani ndjenj me vete fuqi sa të pushtoj gjithë dhenë*! "[49]. Ndërsa asgjë nuk thuhet nga autori

[46] Shiko R. Qosja, *Panteoni i rralluar*, "Naim Frashëri", Tiranë, 1988, fq. 165

[47] Për më gjërë rreth këtij koncepti shiko Tanda N. , Il teatro di idee di Vincenzo Monti, in AA. VV. , Atti di Convegno di studi, Ravenna, Longo, 1982, fq. 40 – Po aty autori shkruan "*Ngjarjet e medha mitike e historike me traditën e tyre simbolike, përdoren për të shprehur pasionet dhe idetë e momentit dhe të kohës.* "

[48] Sansoni: hebraisht Shimshon, *diell i vogël*, përshkruhen në Librin e gjykatësve, kapitulli 13-16. Ai ishte NAZIRE, i kushtuar Zotit që në barkun e nënës dhe libri i shenjtë thotë se ai shërbeu si gjykatës biblik për 20 vjet.

[49] Fan Noli, *Izraelitë dhe Filistinë*, **West Print**, Tiranë, 2011, fq. 21

rreth jetës së tij të mëparshme, figura e tij përshfaqet e paqtë dhe e vendosur, mbështetur nga dy gratë e jetës së tij, nëna dhe Rahila, figurë e shtuar kjo e fundit nga autori, ndofta për t`i shërbyer idesë së pastërtisë fillestare të Samsonit. Krejt ndryshe nga gjykatësi sivëlla[50], Samsoni nolian nuk beson se njohja e perëndisë mund të bëhet me zjarr dhe me hekur, *po vetëm kur njeriu është i lirë...* Në vend të rrëfimeve biblike që e paraqesin ndërsa ai shqyen një luan vetëm me forcën e duarve, apo të atyre që shfaqin zemërimin e tij të pamasë ndërsa masakron filistenjtë për martesën me një tjetër burrë e më pas dhe djegien e gruas së parë filistine të cilën ai dashuroi, Noli preferon ta shfaqë atë së pari në një sinagogë, rrethuar nga rabinë dhe njerëz që e adhurojnë. Ai flet pas një dialogu të gjatë që nuk e përfshin, madje nuk supozon as se ai mund të jetë aty, dhe në këtë shfaqje të parë të Samsonit, Noli derdh gjithë talentin e oratorisë së tij që aq mirë do ta njohë mjedisi kulturor dhe ai politik pak vite më pas. "*Vetëm nëse ka gjuhë ka botë*! "[51] Bota që ndërton Samsoni është e magjishme, pasi e vërteta në të nuk ka fuqi imponuese, por ka kurajë të përhapet përmes lirisë.

Në të njëjtën kohë ndërsa ndërton miratimin e Samsonit nga të gjithë, parë si *i madhuar* në përdorimin nolian, një tjetër figurë fiton terren në po atë akt. Siç thotë dhe KERTESZ, *heroi i tragjedisë është njeriu që lartësohet e rrëzohet*. [52] Dalila është maja nga e cila Samsoni do të marrë rrokullimën. Prania e saj duket sikur orienton drejt një konceptimi të ngjashëm me melodramën e shekullit të XVIII. Personalizimi i kësaj figure të veçantë femërore, që do të përfaqësojë paradigmën konkrete të personazhit negativ në vepër, do ta bëjë Dalilën e këndvështrimit nolian, një figurë aktive, ndryshe nga sa shfaqet në bibël. Ajo jo vetëm luan me sensualitetin e saj, por edhe flet, ndërton strategji argumentuese, duke u shfaqur njerëzore më shumë se djallëzore. Pasioni i saj për Samsonin e shtyn ta robërojë atë, nxitja atdhetare e bën të realizojë tradhtinë. Për ta afruar atë me variantin burimor biblik, Noli ia zhduk asaj dyshimin dhe vrasjen e ndërgjegjes nga sjellja e pamëshirshme ndaj personit që adhuronte. Gjymtimi i Samsonit dhe lehtësia e largimit të saj, riabiliton përkohësisht ngjyrimin e pamoralshmërisë së figurës së saj, duke vërtetuar kështu trajtimin e kujdesshëm dhe shqetësues nga ana e krijuesit. Duket se Nolin 21-vjeçar Dalila e ka intriguar me paplotshmërinë e figurës së saj biblike, dhe aty ku parateksti hesht, Noli ndërton e plotëson sipas vizionit të tij rinor[53]. Në fakt përtej vetë simbolikës së Dalilës dhe asaj që ajo përfaqëson, Samsoni nolian e shpëton gruan që i humbi fuqinë, por dhe që i mësoi forcën e diversitetit, duke e legjitimuar këtë të fundit si një prani, përtej

[50] Shofetim, gjykatës, term që në hebraisht do të thotë edhe guvernator. Ishin drejtues ushtarak ose civil, të thirrur nga Zoti në raste të veçanta për të shpëtuar fiset izraelite nga kërcënimet e popujve fqinj. Samsoni përfshihet tek gjykatësit e lartë dhe dhuna përmes forcës së tij të mbinatyrshme, ishte shenja e tij dalluese.

[51] Heidegger sheh tek gjuha një mekanizëm qëndror që mundëson ekzistencën.

[52] Imre KERTÉSZ, *Diario della galera*, Milano, **Bompiani**, 2009, fq. 9

[53] Vetë emri i Dalilës, tradhëtare, duket se është më tepër një epitet sesa vetë emri i saj. Në tekstin biblik nuk thuhet asgjë rreth saj dhe llojit të lidhjes që ajo pati me Samsonin, që këtu interpretimet që e quajtën atë si prostitutë apo grua të pamoralshme. Po ashtu nuk thuhet nëse ishte filistinase, ndaj mund të ishte shumë mirë dhe izraelite, gjë që tek Noli shmanget duke e quajtur filistine që në fillim.

moralitetit apo drejtësisë. Prifti i ardhshëm, që adhuronte shëmbëlltyrat njerëzore, ka ditur të kapërcejë steriotipin e përdalë femëror të Zanafillës, duke nisur që këtu ndërtimin e një ideje të madhe të pjekurisë së tij, atë të lirisë së mendimit, të cilën aq shumë ia adhuronte Kajamit. [54]

Duke lëvizur imazhet skenike në tre pamje të ndryshme, përmes të cilave spostimi gjeografik nga një tempull në tjetrin, dëshmon kalimin e kohës si unitet ndërtues i tragjedisë, Noli i jep dhe një pamje historike hapësirës ku zhvillohet ngjarja. Sa më larg popullit të tij, aq më i pafuqishëm bëhet Samsoni. Tashmë ai nuk është vetëm një lajmëtar i një ideje, është bërë më njerëzor, drithërues në dramën e tij ekzistenciale. Plani njerëzor në të cilin e vendos protagonistin biblik Noli në aktin e dytë dhe të tretë të dramës, është ai që na ndihmon të hedhim një sy dhe në klasifikimin e saj si zhanër.

Ndërsa struktura metrike dhe shpërndarja e dialogjeve e monologjeve, mbesin të ngjashme me ato të përdorura në melodrama, është karakterizimi i personazheve dhe fundi aspak i lumtur i heroit, ajo që e largon përfundimisht veprën nga përcaktimet melodramatike. Një tjetër veçori e dukshme e veprës, parë dhe interpretuar si prani në planin sipërfaqësor të analizës, konkretisht parateksti biblik, mund ta vendosë nxitimthi "Izraelitë dhe Filistinë" nën etiketën e *tragjedisë kristiane.* Historia martirizuese e Samsonit që ka frymëzuar Nolin, bën pjesë në gamën e gjerë të historive të shenjtorëve e martirëve në mjaft tekste dramaturgjike sidomos të shekullit XVII e më pas në të XIX-in, që konfigurohen nën këtë difinicion e në mënyrë më të përgjithshme dhe paradoksale në dukje, cilësohen *si tragjedi me fund të lumtur*. Sqarojmë, së pari, se anomalia e një përkufizimi të tillë vjen pikërisht nga heronjtë tipikë të tragjedive kristiane, martirë a shenjtorë, besimi i të cilëve dhe bekimi hyjnor ndërtojnë ngushëllimin kristian në rregullin hyjnor të botës. [55] Por nëse na duhet të flasim rreth karakterit të heroit tragjik, pasi vetëm ai mund të na ndihmojë t`i afrohemi një definicioni të kësaj vepre, na duhet të nënvizojmë që në fillim mendimin aristotelian rreth tij. Kujtojmë se sipas Aristotelit paraqitja e dënimit të një të keqi nuk do ta kishte kënaqur spektatorin, pasi nuk do të kishte gjeneruar as mëshirë dhe as tmerr, duke neutralizuar kështu katarsisin. Për të njëjtin motiv do të përjashtohen nga ky efekt i tragjedisë edhe heronjtë tragjik me karakter të përsosur "*përmes të cilëve synohet të rizgjohet admirimi i spektatorit, e kjo sidomos për heroin perfekt të botës kristiane, shenjtorët e martirët.* "[56]

Që këtu, vështrimi ynë në paraqitjen e këtyre karaktereve në tragjedinë e Nolit, vërteton, së pari, zbutjen e vazhdueshme të dinamikave konfliktuale biblike, që shkon në orientimin e protagonistëve biblikë drejt personalizimit e individualizimit. Për

[54] F. Noli në "*Ligjërime, introdukte*", fq. 102 shkruan në kritikën për Khajamin: "*Liria e mejtimit i është bërë një fe, për të cilën lëfton si çdo fanatik i çdo feje dhe për të cilën është gati të pinjë kupën e helmit si Sokrati a të shkonjë në kryq si krishti.* "

[55] Në traktatin *Della ragion poetica* e 1708, Gian Vincenso Gravina shkruan se *personazhi letrar kristian, ndryshe nga ai antik, mund të jetë i përsosur, të kalojë "dobësitë njerëzore" falë frymëzimit hyjnor*. Po ky autor në 1715 në veprën *Della tragedia* shkon përtej duke thënë se *besimi dhe bekimi hyjnor ndërtojnë ngushëllimin që i mungonte veprës antike dhe vizionit të tyre fatalist dhe të palumtur të gjendjes njerëzore*.

[56] MATTIODA E. , *Teorie della tragedia nel Settecento*, Modena, **Mucchi**, 1994, fq. 150

Nolin rrëfimi i ngjarjes mbetet e rëndësishme, por jo me të njejtën peshë sa kanë për të ndjenjat dhe larmia e përjetimeve të saj në personazhet e ndryshëm, duke e kapërcyer vazhdimisht në momentet dramatike ngjarjen e duke u fokusuar tek protagonistët dhe ambiguiteti i tyre i vazhdueshëm, që duket se i shërbejnë shumë më tepër ideshmërisë së krijuesit sesa vizionit profetik biblik. Pretendimet tiranike biblike rreth të vërtetës, që përjashtojnë çdo lloj mendimi tjetër duke pretenduar madje se është e vetmja e vërtetë, këtu janë zbehur gjer në atë masë sa filistinët quhen shokë dhe Dalila e mrekullueshme në vërtetësinë e saj të pandryshueshme. Në këtë mënyrë zgjedhjet autoriale e largojnë dramën "Izraelitë e Filistinë" përfundimisht nga klasifikimi si *tragjedi kristiane*, pasi në vend që të ndërtojë admirimin dhe imitimin e virtyteve të heroit, që sipas kritikës aristoteliane do të neutralizonte përfundimisht katarsin, në të vërtetë, fundi i Samsonit nolian, një njeri që shkon përtej karakterizimit si i keq, por dhe shumë larg heroit tragjik me karakter të përsosur të botës kristiane, ndërton në mënyrë të përsosur efektin e katarsit, duke u bërë kështu pjesë e tërheqjes së veçantë që kjo dramë ka. Duke preferuar katarsin në vend të admirimit përmes reduktimit të veprimit të shenjtë në favor të normave aristotelike, Noli realizon në vështrimin e përgjithshëm, atë që Cornej përmbushi në Francën e shekullit XVII. Kështu drama e Nolit afrohet me poetikën e re të Corneit, duke kapërcyer fundin e lumtur melodramatik dhe duke e lidhur përfundimisht mësimin moral të virtytit jo më me admirimin, por me katarsin.

Lavdia e Samsonit në disfatën e tij, mbetet një lavdi individuale, shumë larg hyjnores. I verbër dhe i dërrmuar, ai përmbush misionin e tij që tashmë është shumë larg bindjes. Veprimi përfundimtar i tij, që duhet të ishte dhe ai shenjtëruesi e që në të njëjtën kohë duhej ta rikthente Samsonin tek besimi i tij, pasi e pamë të humbte shpesh koordinatat në sytë tanë përgjatë ndryshimit të tij të vazhdueshëm si krijesë njerëzore, duke pritur kështu që drita hyjnore të manifestohej fuqishëm në këtë veprim të fundit të protagonistit, në fakt vjen kontrastues dhe i ndryshëm. Duke i konsideruar filistinët shokë e duke e lënë Dalilën të mbyllë aktin përfundimtar me këngën e saj, Samsoni, përmbushës i fatit të tij por dhe viktimë e tij, kapërcen përfundimisht sivëllain e tij biblik, për t`u bërë njësh më rishkruesin e ngjarjes së tij.

Ky përfundim duket se shkon më pranë përcaktimit që studiuesi S. Hamiti i bën kësaj vepre të Nolit, të cilën e sheh si *një rindërtim të tragjedisë klasike me temë antike biblike*. [57] Bie në sy në të forma klasike e tragjedisë antike, por ndërtimi i personazheve duket se lëviz nga poli i "*tipit*" që ishte mënyra e rafigurimit të personazhit në antikitet, tek ai i "*individit*" që i takon figurave biblike, të cilët vijnë si personazhe më komplekse krahasuar me ato antikë dhe kanë një shfaqje të tyren më të thellë e më individuale. [58]

[57] S. Hamiti, vep e cit. fq. 196

[58] Shiko AUERBACH, Mimesis, I, 20-21 " *Personazhët biblikë janë subjekte të një zhvillimi të vazhdueshëm, shumë më të rëndë të jetës së tyre…Ato janë vazhdimsht nën dorën e rëndë të Zotit, që jo vetëm i ka krijuar dhe zgjedhur, por që vazhdimisht i kalit, i përkul, i ndërton, dhe pa shkatërruar esencën, nxjerr prej tyre forma që më parë nuk ishin aq të parashikueshme…*"

Qëndresa biblike e Samsonit shndërrohet kështu në dilemën noliane rreth përparimit njerëzor dhe dëshirës për mosasimilim të kulturave të ndryshme. Vdekja e heroit mbetet një katastrofë e një katarsis në të njëjtën kohë. Ndonëse një vepër e papërmbushur, protagonisti i saj arrin të projektohet me të gjitha kriteret e të qenit personazh universal. [59] Përgjigjet hipotetike në një formë dramaturgjike të paplotësuar, do t`i japin kësaj drame një dimension shumëkohshmërie dhe aftësinë për t`u rikontekstualizuar në shoqëri specifike. Në dialogun mes së shkuarës dhe së tashmes, ajo arrin të shtrojë gjithmonë pyetjet e duhura duke mos i ezauruar asnjëherë domethëniet e saj. Në të njëjtën mënyrë përzierja kulturore nëpër të cilat kaloi Noli, duke ndërtuar përmes tyre një përkatësi kombëtare të vetëdijshme e të përgjegjëshme, do ngulisin në këtë vepër letrare të mrekullueshme në brishtësinë e saj, gjurmë të theksuara autenticiteti përmes dëshirës reformuese të vetvetes dhe të tjerëve.

[59] R. Alter, *I piaceri della lettura*. "Il testo liberato", **Leonardo**, Milano 1990. *Ndërsa kundërshton vizionin formalistik të personazhit, Alter ripërcakton vlerën universale të protagonistit si figura që vazhdojnë të na intrigojnë pasi ripropozojnë dilema universale dhe na ndriçojnë jetën.*

Doc. KASTRIOT GJIKA

ÇËSHTJE TË RECEPTIMIT HISTORIK TË POEZISË SË NOLIT

Problematika e kësaj kumtese i referohet një çështje që ka të bëjë me pranimin/refuzimin a gjysmë refuzimin e veprës poetike të Nolit, me mënyrën sesi në rrjedhën e historisë së letërsisë shqipe është receptuar kjo pjesë e rëndësishme e krijimtarisë së tij letrare në tërësi. Nëse dorëzimi i tij si prift dhe nisma e aksioni i tij për mëvetësimin e kishës ortodokse shqiptare rezultuan të ishin edhe problematike, edhe ndonjëherë të kontestuara, të keqkuptuara a të mbuluara me mjegullën e zilisë e me zellin "alla shqiptar" të kundërshtisë, gjithaq problematik, në mos edhe më shumë, rezulton të jetë pranimi i tij si poet në tryezën edhe ashtu jo shumë të pasur të poezisë shqipe.

Çfarë e ka ushqyer e mbajtur gjallë këtë lloj "nihilizmi" në pranimin e njohjen e Nolit si poet (sidomos në periudhën para mesit të viteve '40 të shekullit të kaluar) është një mungesë e një botimi tërësor të veprës së tij poetike. Po ashtu, mendojmë se kësaj i ka kontribuar jo pak edhe njëfarë tërheqje e mosbesimi i Nolit vetë në aftësitë e tij si poet, si edhe, siç është vënë re, njëfarë "anomalie" në rrugëtimin e tij si poet e autor poezish origjinale, në kuadrin tërësor të veprimit të tij letrar e kulturor dhe jo vetëm.

Për çfarë konkretisht e kemi fjalën? Nëse poezia e parë origjinale e Nolit, "Fryn moj erë", datohet në 23 janar 1907 (ca ditë pasi ishte bërë 25 vjeç) dhe e fundit poezi origjinale në dorëshkrim, "Vdekja e Sulltanit" daton më 1 shkurt 1964, vetëm pak kohë para vdekjes së tij; në mes këtyre dy datave kemi një periudhë të gjatë kohore në të cilën Noli ndërmori dy herë "vrrulle" krijimesh poetike. Së pari, në vitet '20 të shekullit të kaluar (kur ai ishte 40-vjeçar) dhe së dyti, në vitet 50 – 60, kur Noli ishte në pleqëri të thellë.

Që Noli nuk kishte ndonjë vlerësim të lartë për poezinë e tij, na e pohon vetë, teksa i rrëfen një auditori të rinjsh në vitin 1958: "*Sa për vjershat e mia, unë nuk kujdesesha shumë për to. Mendoja se nuk vlenin fare. Zakonisht i botoja nëpër gazeta, derisa i harrova krejt. Në fakt, i humba 2 a 3 prej tyre… Por një shoku im, një admirues, Mitrush Kuteli, i mblodhi të gjitha poezitë e mia dhe i botoi në një libër. Ai i bëri një analizë shumë të bukur disave prej tyre dhe pastaj, kur i lexova, mendova se ato vlenin për t'u botuar. Miku im kishte botuar disa prej tyre, pothuaj gjysmën, sepse ai nuk i kish kopjet e plota të gjithë poezive të mia*"[60]. Megjithatë, ka studiues, siç është Nasho Jorgaqi, që e vënë disi në dyshim këtë pohim e dëshmi modestie të Nolit, duke u

[60] JORGAQI Nasho – *"Mbi procesin e punës krijuese e studimore të Fan Nolit"* 1982-1986, botuar në *"Profile dhe probleme letrare (studime, gjurmime, ese)"*- DUDAJ, 2008

bazuar në faktin se janë bërë tashmë të njohura planet që ai vetë kishte bërë për botimin e poezive të tij[61].

Dhe në të vërtetë "kumbara" i tij në poezi, pra njeriu që e ka "shuguruar" si poet Nolin, ia ka përmbledhur e botuar poezitë e tij (jo të gjitha) në një vëllim poetik, për lexuesin e Shqipërisë, ishte Mitrush Kuteli. Gjejmë rastin sërish t'i shprehim një përnderim të thellë këtij "miku" të madh e të përkushtuar të letërsisë shqiptare, pa kontributin e gjithanshëm të të cilit ndryshe do të kishte qenë pamja historike e poezisë sonë, veçanërisht me promovimin që i bëri ai poezisë së Lazgush Poradecit dhe asaj të Fan Nolit.

Që Fan Noli nuk ishte i njohur si poet përpara botimit të përmbledhjes "Mall e brengë" prej Mitrush Kutelit, më 1943-shin, na e dëshmon mënyra e paraqitjes së profilit të tij si krijues në dy vepra të rëndësishme historiografike të viteve '20 e '30. Së pari, është vepra "Literatura shqype – për shkolla të mesme" e Justin Rrotës, Shkodër 1925. Autori në të i referohet veprimtarisë së Nolit si përkthyes, vlerëson si veprën e tij më të mirë "Historinë e Skënderbeut", Boston, 1921. Ndërsa si shembull të një teksti krijues të Nolit merr nga oratoria e tij ligjëratën në Kishën e Shën Gjergjit më 28 nëntor 1915. [62]

Në veprën e Gaetano Petrottës "Populli, gjuha e letërsia shqipe", Palermo 1932, Theofan Nolit i kushtohen 5 faqe tekst. I përmenden si kontribute letrare: 1- shqipërimet fetare për nevoja të kishës ortodokse, 2 – botimi i dramës "Izraelitë e Filistinë" (1907), 3 – përkthimet letrare ("Otello", "Jul Cezari", "Hamleti", "Kasollja"), 4 – përkthimi në vargje i "Skanderbegut" të Longfellout. Si vepër "më të vlertë" të Nolit, nga çdo pikëpamje, Petrotta konsideron veprën e Nolit "Jeta e Skanderbegut" (1921), të cilën e njeh nga përkthimi italisht prej Francesko Argondizës (Romë 1924). Çka është interesante në këtë paraqitje, citohet një kritikë e Konicës e bërë në "Dielli" në 27 prill 1926, në të cilën qortohet Noli në lidhje me fjalët e reja që ka futur në gjuhën shqipe, "*jo vetëm pa nevojë, por me kritere gjuhësore që nuk i përgjigjen aspak natyrës së vetë gjuhës (shqipe)*". [63]

Duket se Fan Noli kishte edhe të tjera shtysa për të bërë një paraqitje të poezive të tij. Na e dëshmon këtët fakt një letër e Ali Kelmendit drejtuar Nolit më 27 korrik 1938, në të cilën i shkruan: "*Imzot, në Berlin më ke pas thanë se të gjitha kangët e jueja (vjershat) do t'i botojshit në një volum, mirëpo këto, megjithëqë jam interesue, nuk i kam pa. Si duket, hallet e jetës nuk të kanë lanë me i botue. Edhe këto s'asht për t'i lanë në nji anë, pse jemi shumë fukara në literaturë*"[64]. Pra një lexues e njohës i poezive të tij, siç ishte A. Kelmendi, ia vë fajin "halleve të jetës" për vonesën e botimit

[61] BIHIKU Koço – "Planet e Nolit për botimin e veprave të veta poetike" – Studime Filologjike Nr. 1, 1972

[62] RROTA Justin – "Letratyra shqipe" – për shkolla të mesme – Shtypshkronja Françeskane, Shkodër 1925, - ribotuar 2006

[63] PETROTTA Gaetano – "Populli, Gjuha dhe Letërsia shqiptare" – Palermo, 1932- ribotuar "Almera"- Tiranë

[64] JORGAQI Nasho – ""Nga letërkëmbimi i Ali Kelmendit me Fan S. Nolin"-1981, botuar në "Poetika e dokumentit – studime, artikuj, ese" – Naim Frashëri, Tiranë, 1987

të një përmbledhjeje me poezi të Fan Nolit. Nuk mendonte njësoj Dhimitër Shuteriqi, i cili në vitin 1956 do ta shpjegonte kështu faktin pse Noli i hyri disi vonë rrugës së poezisë: "*Noli i ri …, bën pjesë në njerëzit që nuk i kënaq më poezia e kohës dhe që kërkojnë një letërsi më artistike. Nga ana tjetë, kur këta vetë provojnë të shkruajnë, mbeten ndonjëherë po aq të pakënaqur nga vepra e tyre, të cilën u qëllon që edhe ta marrin nëpër këmbë, siç bëri Noli vetë me dramën e tij "Izraelitë e Filistinë"*[65]. Po sipas këtij studiuesi, në ato rrethana Noli e ushtroi penën e tij si artist përmes përkthimit, duke rritur kështu besimin në forcat e veta krijuese përmes punës titanike të përkthimit, për të cilat, rreth një dekadë më pas, Dh. Shuteriqi nuk do t'i kursente lëvdatat: "*Përkthimet e tij…, shpesh më shumë se përkthime janë krijime e me shumë se krijime, kulme të fjalës poetike shqiptare"*[66]. Vërjemë në këtë përcaktim të njëjtin entusiazëm e frymë lavdëruese që e kishte shfaqur Mitrush Kuteli në analizën e tij të famshme me rastin e botimit të përmbledhjes "Mall e brengë" me poezi origjinale e përkthime të Nolit. Në këtë paraqitje kritike të poezisë Nolit dhe të atij vetë me një profil më të qartësuar prej poeti, Kuteli vazhdimisht këmbëngul te koncepti i tij se Noli ka qenë gjithmonë poet, madje poet i një "*inspiracioni të ri*". Ndërkaq, me shumë intuitë, por edhe kompetencë, ai e përcakton poezinë e Nolit si një poezi *"politiko-patriotike"*, të llojeve e nëndarjeve që ai i grupon në satirike, elegjiake, simbolike e apllogjetike-retorike. Sipas Kutelit, poezia e Nolit është "*një poezi personale*", me burimin në ngjarjet politike që "*i pat rrojtur e vojtur ai vetë*" pas qershorit 1924. Çka na duket e gjetur është kjo fjali që e hasim në në këtë analizë: "*Fan Noli bëhet poet, pa i thënë vetes poet*". Është një çudi më vete sesi Kuteli ia del të depërtojë mu në thelbin e poezisë së Nolt kur kërkon ta hetojë e ta përkufizojë atë së brendshmi. E bën këtë gjë me dashuri e mirënjohje, por edhe me kompetencë e profesionalizëm. E quan Nolin një poet "*jo kontemplativ, pasiv, pritës – po buçitës, sulmonjës, dërmonjës*"[67]. I ka mbetur kohërave edhe përcaktimi se "*vargu i tij nuk është vizual, por auditiv*". E sa për fjalorin poetik të Nolit, referencat janë sa të karakterit historik, aq edhe patriotik: "*Një shtrëngatë fjalësh shqipëtare ose të shqiptarizuara kjo e Nolit, ku buçet ashpërsija teftane, krutane dhe vlonjate, këto kulme heroike të racës shqipëtare*"[68].

Pa kaluar as një vit nga botimi i këtij libri me poezi të Nolit e nga përcjellja kritike që M. Kuteli i bëri atij botimi, një tjetër "yll në ngjitje" i kritikës dhe i letrave shqipe, Arshi Pipa, merr të shkruajë një kritikë të gjatë e të ngulur: "Shënime kritike mbi librin Fan S. Noli "Mall e brengë", me një vështrim kritik prej Mitrush Kutelit", të cilin e boton në revistën "Kritika", nr 1, mars, 1944. Në këtë vështrim kritik, duket që në krye të herës njëfarë mosbesimi në cilësinë e Nolit si poet, teksa ngulmohet në vështirësinë që, sipas A. Pipës, kishte hasur M. Kuteli për t'i bërë bashkë (me mjaft

[65] SHUTERIQI Dhimitër – "Gjurmime letrare" – Naim Frashëri, Tiranë, 1974
[66] SHUTERIQI Dhimitër – Po aty

[67] KUTELI Mitrush – "Poeti Fan Noli – vështrim panoramik" botuar në "Fan S. NOLI - Mall e brengë – vjersha", Tiranë 1943
[68] KUTELI Mitrush – Po aty

mundim) nja një duzinë vjershash origjinale e përkthimesh të Nolit. Më tej, në vështrimin e vet, A. Pipa e sheh figurën e Fan Nolit në përqasje me atë të Gj. Fishtës, duke i cilësuar si "*dy pole të gjenialitetit shqiptar*", por edhe si dy figura "*antitetike*". Na duket me mjaft vend përcaktimi që kritiku i ri i bënte, nga njera anë Gj. Fishtës, si "*konservator, tradicional, shqiptar, malsuer fanatik qind për qind*", nga ana tjetër F. Nolit si "*shqiptar evropian, revolucionar*". Arshi Pipa e sheh Fan Nolin si një personalitet të dyzuar mes Lindjes e Perëndimit, me një shtysë instiktive drejt botës lindore, por i pajisur me një arsye të qartë që e shtynte drejt Perëndimit, atij "*ma të largtit, ma modernit: Amerikës*". Më përmbledhtaz, Noli sipas Pipës ishte ma tepër "*centrifugal*", çka shenjon fort edhe veprën e tij, pasi edhe në poezi ai ishte "*nji shtegtar, nji dilektant, por gjenial*".

Më tej në këtë vështrim kritik, Arshi Pipa mbron e argumenton mendimin se kompleksiteti e gjenialiteti i Nolit nuk mungojnë, por ato janë të një lloji të vecantë, "*një lloj gjenialiteti asimilues, riprodhues*". Në mbështetje të këtij arsyetimi, A. Pipa analizon edhe përkthimet e Nolit, më të mirat prej të cilave ai cilëson pikërisht ato që janë më pak besnike ndaj origjinalit. Asnjë përkthyes i zakonshëm nuk mund të realizojë atë "*transfigurim*" që ka bërë Noli poet, nënvizon Pipa. Për të mbërritur në një përfundim paksa drastik: "*Poet pa vepra, poet në potencë, qe çka asht Noli!* ".

I vonët ishte prezantimi i Nolit si poet edhe në Kosovë, me përmbledhjen poetike "Sulm e lotë" (nuk e kemi zbuluar pse është përdorur ky titull i një vepre poetike të Kutelit), shtypur nga "Enti për Botimin e Teksteve" të R. S. Serbisë – Reparti në Prishtinë- 1963, me një parathënie prej Hilmi Aganit. Ribotuar më pas nga "Rilindja", Prishtinë, më 1964. Njohja e propagandimi i veprës së Nolit në Kosovë kulmon me botimin në vitin 1968 të veprës së plotë të Fan Nolit nga "Rilindja" e Prishtinës. Kurse në Tiranë kjo ndodhi në vitin 1988 e u kurorëzua me botimin e Veprës 6 të vëllimeve të veprave të plota të Nolit në vitin 1996.

Pas viteve 1944-1945, falë faktit se Noli nuk hyri në listën e zezë të shkrimtarëve të anatemuar e të përjashtuar nga regjimet politike të vendosura në të dyja anët e kufirit pas Luftës, kemi një afirmim të tij si poet, një vëmendje të shtuar e të orientuar posaçërisht nga poezia e Nolit. Kështu, më konkretisht, nga viti 1944 deri në vitin 1974 u shkruan e u botuan rreth 80 artikuj, studime, parathënie, komente etj. , për krijimtarinë dhe profilin e Nolit si krijues, nga të cilat plot 34 iu kushtuan tërësisht poezisë së tij. Pa përfshirë këtu monografinë e Vehbi Balës "Jeta e Fan S. Nolit" – portret, monografi, Tiranë, 1972; tekstet e historive të letërsisë shqiptare të botuara në Tiranë e në Prishtinë e pa përmendur pastaj studimet tërësore të prof. Nasho Jorgaqit, pa asnjë diskutim biografit e studiuesit më referencial të jetës e të veprës së Nolit.

VJOLLCA OSJA

ENERGJIA SIMBOLIKE NË POEZITË BIBLIKE TË FAN NOLIT

Në një intervistë që Mallarme-ja i jep Jules Huret, në lidhje me zhvillimet letrare në Francë, ndër të tjera ai pohon, se: *Të emërtojmë një objekt, do të thotë të cungojmë tri të katërtat e haresë së poezisë që duhet të dilte nga zbulimi i dalëngadalshëm; ndërsa, nga ana tjetër, ta sugjerosh objektin është gjë e ëndërrt.... një objekt e shfaqim pak nga pak në mënyrë që të tregojmë një gjendje shpirtërore ose, anasjelltas, zgjedhim një objekt dhe çlirojmë prej tij një gjendje shpirtërore, duke shfrytëzuar një sërë deshifrimesh.* [69]

Një gjykim i tillë, që vjen nga një zë i rëndësishëm i simbolizmit francez të fundshek. XIX (një ngjarje e madhe kjo për letërsinë moderne në përgjithësi[70]), mendojmë se na jep dorë, në formë sugjeruese, për të shkuar sa më afër konceptimit të natyrës së simbolit. Kështu, sipas sugjerimit të mësipërm, natyra e gjuhës së simbolit duhet parë e lidhur ngushtë me projeksionin e efekteve që ai shpërndan dhe jo me kërkimin e ngulmët të domethënies së plotë e të vetme të një referenti konkret, pasi siç na bën me dije edhe U. Eko, në këto raste, mesazhi referencial, përkundër atij estetik që do të kërkonte simboli, *priret që ta reduktojë sa të jetë e mundur dykuptimësinë dhe të zhdukë çdo tension informativ në mënyrë që të mos kërkojë ndihmën vetjake (individuale) të marrësit*[71], pra të *mos varet nga veçantitë e lexuesit individual.*

Duke e konsideruar simbolin, apo *aksionin simbolik*, si pjesë të rëndësishme të repertorit stilistik të Nolit, qasja jonë do të ketë për objekt një pjesë të poezive (me motive biblike) që e kanë për mjet shprehje këtë figurë. Argumenti do të shtrihet duke marrë parasysh mekanizmin e ndërtimit të "mendimit simbolik", nëpërmjet kondensimit të frazës poetike[72].

Por, në këtë rast, problemi që mund të ngrihet, dhe jo vetëm këtu te Noli, por gjithandej në letërsi e në veçanti në letërsinë shqipe, mbetet të jetë ai i fshehjes së simbolit nën "tunikën e leshtë" të alegorisë apo përdorimi i kësaj të dytës si përfaqësuese e simbolit dhe përgjegjëse e domethënies së tekstit. (Kujtojmë që për një aradhë studiuesish poezia e Nolit është parë nën këtë dritë dhe për ndonjë prej tyre

---

[69] "*Mbi zhvillimet letrare*"- bisedë e Mallarmé-së me Jules Huret, te lib. Stéphan Mallarmé, *Poezi*, Tiranë 2004, fq 84

[70] Sipas U. Ekos kjo është periudha që radikalizon shikimin mbi simboliken, pasi, tashmë, kemi hyrë në një gjithësi laike, ku simboli nuk duhet të zbulojë dhe të fshehë absoluten e besimeve, por absoluten e poezisë. Si manifest të kësaj periudhe letrare ai pranon poezinë "Les correspandances" (Përkimet) të Baudelaire-it. U. Eko, *Për letërsinë*, Dituria, Tiranë, 2007, fq. 147

[71] U, Eko, *Struktura e papranishme*, Pejë, 1996, fq. 89

[72] Sipas Todorovit, Goethe insistonte në karakterin lakonik dhe kondensues të simbolit, *Theories of simbol*, Tzetan Todorov, Cornell up, Ny, 1984, fq. 204

karakteri simbolik i poezive është parë si e metë e autorit[73].) Pra, në një pozicionim të tillë, ku alegoria (që mund të deshifrohej me një tendosje të thjeshtë të mendjes, pasi është kuptimi i referueshëm) dhe simboli (të cilit, sipas retoristëve modernë nuk i gjendet një formulë racionale për ta shpjeguar) shtrihen njëherazi brenda tekstit, na mbetet të gjykojmë në bazë të vlerës që ka gjuha e tekstit si e referueshme apo e shumëkuptimtë.

1. Kështu në bazë të marrëdhënies që ka ndërtuar apo që vendos Noli, me referencat biblike[74], leximi i poezive që kanë këtë motiv, sigurisht nisur edhe nga ekzigjencat dhe veçanësitë e formimit të lexuesit, i nënshtrohet dy niveleve:

Niveli i parë - ai alegorik - është i kuptueshëm në perspektivën e leximit referencial (kërkimi i mesazhit referencial).) D. m. th. tentohet të identifikohet përvoja e autorit (referenti konkret - jeta personale dhe publike e Nolit) me përvojën e njohur të shenjës biblike. Në këtë rast përvoja e shenjës biblike aktualizohet, duke mbartur brenda vetës edhe tipare të subjektit që pretendohet të identifikohet pas saj. Kështu është interpretuar, përgjithësisht, në nivelin alegorik, marrëdhënia e Nolit me Moisiun, Krishtin, Shën Pjetrin, Kirenarin etj. , tek poezitë respektive. Ne mendojmë se kjo marrëdhënie e kërkimit të një mesazhi të vetëm, të referueshëm, e tkurr energjinë e tekstit, duke e çuar në një drejtim leximin e tij. Nevoja për t'i lexuar këto poezi si pjesë të "biografisë politike" të autorit, apo për të ilustruar me secilën prej tyre situata e gjendje konkrete të Nolit e thjeshtëzon natyrën e tekstit. Ndërkohë që sipas studiuesit A. Kapurani, natyra e marrëdhënieve të Nolit me shenjën biblike është më thellë, ajo është e natyrës semiotike[75]. Aty shenja biblike është *defamiljarizuar* duke iu nënshtruar *pluralizmit tekstual të pacak*.

Niveli i dytë - ai simbolik - është i kuptueshëm në perspektivën e leximit tekstual: d. m. th. ne tentojmë të zbërthejmë shenjat e kondensuara biblike brenda tekstit në bazë të efekteve që ato prodhojnë këtu dhe tani. Në këtë rast *simboli nuk priret të zbulojë dhe të fshehë absoluten e besimeve* nga të cilat është nisur shenja, *por absoluten e poezisë*[76]. Ndaj, në këtë nivel alegoria është e tejkaluar që në momentin kur tentojmë të ndërtojmë vija shenjore leximi dhe të priremi ta interpretojmë tekstin në bazë të efekteve që ato prodhojnë në momentin e leximit.

Kështu, p. sh, e gjithë poezia "*Kryqëzimi"*, nëpërmjet kondensimit të frazës poetike rrit potencialin e evokimit të imazheve dhe zvogëlon identifikimin e tekstit në një ide

[73] "ku mbizotëron alegoria biblike, poezia merr një karakter simbolik dhe intelektual që e largon disi nga fryma popullore, . . . kufizon poetin të shprehet gjithmonë drejtpërdrejtë dhe qartë, e vështirëson ndonjëherë komunikimin" Dh. Shuteriqi, etj, *Historia e letërsisë shqipe*, 1983, fq. 517

[75] Ajo (fjala poetike e Nolit –shën. im V. O) *realizon kushtin themelor të pluralizmit tekstual të pacak. Fjala e Nolit bëhet tekst modern.* Anastas Kapurani, *Migjeni-ose parathënia e dyzuar*, Onufri, 2010, fq. 105

[76] U. Eko, *Për letërsinë*, Dituria, Tiranë, 2007, fq. 147

të vetme. Prania e sintagmave të referueshme biblike: *Krishtin kryqëson*, *tri Mari*, nuk e shter të ashtuquajturën *mjegull semantike* që shpërndan teksti. Përkundrazi, simbolika më e lartë e *krishterimit*, kryqi -kryqëzimi, mund të merret jo për të ndërtuar analogji me një realitet konkret, por për të evokuar ritualin e aktit, për të dhënë dimensionin e tragjikes, për të dhënë lartësimin moral, për të dhënë si të virtytshëm përvujtninë, për të dhënë kotësinë e sakrificës, për të dhënë... , për të dhënë,... Pra, në këtë rast simboli është një ftesë për një lexim subjektiv, ndërsa referenca mbetet të shërbejë si pikë (sa përafrimi aq edhe përlargimi) nga ku mund të ngrihen ose jo marrëdhëniet tona interpretative me tekstin. Njohja apo mosnjohja e jetës së Nolit nuk përbën kushtin e interpretimit të tekstit. Dhe nëse flasim me gjuhën e Rifaterre-s, *poezia nuk priret t'i drejtohet (referohet) një realiteti, por priret të vendosë një sistem koherent domethënie*.

Në të mirë të leximit simbolik mund të vijnë edhe disa veçori të anës formale që ka poezia, siç janë përdorimi i simbolit tingëllor: në tekst ndihet dominanca e tingujve goditës grykorë *k/g*: *Po troket çekani/Po kërcet mejdani. /Dor'e këmb' i çpon/Krishtin kryqëzon...* / *Çdo peronë plagë/përvëlon si flagë/ Çurka gjak buron/ Fryhet dhe pikon*) dhe përdorimi i simbolikës ritmike (6-rrokësh i shpejtë me këmbë të alternueshme).

E njëjta procede ndërton edhe simbolikën te poezia "*Kirenari"* apo te "*Moisiu"*. Te "*Kirenari"* teksti evokon një sërë idesh dhe i mbledh ato së bashku në një formë të veçantë të fjalëve që sigurojnë një vlerë simbolike. Vetë figura biblike e Kirenarit[77] është e papërcaktuar qartë për rolin që ka luajtur në historinë e kryqëzimit të Krishtit.

Ndërkohë, që në tekst, që në strofën e parë, zëri lirik kondenson dy prej strukturave simbolike që mund të evokonte kjo figurë:

Ç'deshe ti, mor, në Kalvar,
O qyqar, o Kirenar!
1. Del me poçen për sehir,
2. Ndrit në Kryqin si martir

Ndërkohë që vetë poezia ofron, në mënyrë dikotomike këto perspektiva leximi:

1. Përzierja e rastësishme në histori
2. Sublimimi i aktit nëpërmjet përfshirjes.

[77] Figurë biblike e papërcaktuar qartë për rolin që pati në historinë e kryqëzimit të Krishtit. Sipas tre prej Ungjijve (përveç atij të Gjonit, i cili nuk e përmend këtë figurë) Simoni i Cyrene-s ishte i detyruar nga romakët të mbante kryqin e Krishtit, ndërsa Krishti shkonte drejt Kalvarit. Ndërkohë studiuesit e ndarë në dy grupe e kanë analizuar këtë pasazh, se:

1. zgjedhja e Simonit të Cyrene-s për të mbajtë kryqin qe bërë për shkak të simpatisë që kishte për Jesusin, dhe
2. grupi tjetër e mohon këtë fakt, duke pohuar se teksti vetë nuk thotë asgjë, se Simoni nuk kishte zgjedhje tjetër dhe se nuk ka baza që ta lidhë detyrimin për mbajtjen e kryqit me simpatinë për Jesusin, T. A. Bryant, compiler. *Today's Dictionary of the Bible*. Minneapolis: Bethany House, 1982. Page 580.

Triologjia e Marsheve (*Marshi i Krishtit, Marshi i Kryqëzimit, Marshi i Barabbajt)* ndërlidhet me një rreth simbolik. *Marshi i Krishtit* dhe *Marshi i Barabbajt* ofrojnë të njëjtën arkitekturë ndërtimi (aq sa e dyta mund të shihet si projeksion, nga pikëpamja e strukturës ritmiko-rimike e sintaktike të vargjeve dhe strofave, i së parës), por ndajnë një veshje leksiko-semantike të ndryshme në varësi të simbolikës. Simbolikisht e dyta konoton vlera negative përkundrejt së parës. Të dy variantet së bashku marrin vlerë simbolike dhe në këtë marrëdhënie ato formojnë rrethin simbolik.

Gjysma e këtij rrethi (që korrespondon me poezinë e parë) evokon, ndër të tjera, ndjesinë e madhërimit nëpërmjet njëjtësimit emocional të figurës së Mesisë me frymën simbolike që konotojnë poetikisht fjalët *lule, dafin', brohoritni, trumbeta, zurna* etj. , ndërsa gjysma tjetër e rrethit (që korrespondon me poezinë e dytë) evokon ndjesinë e poshtërimit e pështirosjes nëpërmjet njëjtësimit emocional të figurës së Barabbajt me frymën simbolike që konotojnë fjalët *hithr', shtog, gumëzhit, zinxhir, kamçik* etj.

Këto dy poezi në ndërtimin e tyre i referohen arkesemes[78] simbolike.

Nga **Marshi i Krishtit***:*

Hosanna o çlironjës, Mesi, hosanna!
Shtroni udhën me lule, dafin'e hurma,
Brohoritni trumbeta, timpane, zurna,
Thirr e zbras, o gurmas: Hosanna, hosanna!
... .
Përmi Dhe, përmbi fron, përmbi Qjell u bekofsh,
Përmi djall dhe tiran, përmi Ferr mbretërofsh
Me pean dhe temjan, dhe këmban' u- këndofsh,
Drit'e gas, rrofsh e qofsh: Hosanna, hosanna!

Nga ***Marshi i Barabbajt****:*

Allalla, o rezil e katil, allalla!
shtroni udhën me hithr' e me shtog turfanda
Gumëzhit, o zinxhir e kamçik, baterma
Lehni, laro, kaba: Hosanna Barabba!
... .
Në budrum, nëpër llom' e kufom' u-mallkofsh,
Në skëterrën, katran e tiran, u harbofsh,
Me tam-tam e allarm' e me nëm u-shurdhofsh,
Në zëndan mbretërofsh: Hosanna, Barabba!

Poezia e tretë "*Marshi i Kryqëzimit"* lidhet me të parën, "*Marshi i Krishtit*", nëpërmjet strategjisë ironike. I gjithë teksti sugjeron një lloj kodi të ri për ta ndërlidhur figurën e Mesisë me atë që evokon poezia e parë. Gjuha sugjeruese e simbolit, në këtë rast bëhet pjesë e rëndësishme e *thurjes ironike* të tekstit. Simbolikisht, struktura e vargjeve të kësaj poezie është ndërtuar në bazë të dy gjysmë njësive kundërvënëse që

[78] Termi archeseme është formuar për analogji me archiphoneme-n e Trubetzkoy-it për të shënuar njësitë kuptimore që përfshijnë të gjithë elementet e përbashkëta në një kundërvënie leksiko-semantike, J. Lotman, *The structure of artistic text*, University of Michigan, (Michigan Slavic Contributions 7.) USA, 1977, fq. 146.

prodhojnë energjinë ironike. Për ilustrim, nga *Marshi i Kryqëzimit*: *Do të vrasim, Jesu, se të kemi Baba, /Do të varrim, Mesi, se të kemi Usta,*

Kryqësoji këta, se na vothnë fort pak, / Kryqësoje këtë se s'na vodhi aspak,

Brenda kësaj përmase simbolike mund të lexohen edhe poezisë *Moisiu në mal* apo *Shën Pjetri mbi mangall.* Sepse te Noli duhet të lexohet dhe vlerësohet *letrarja.* Këtë bën edhe Koliqi, kur në njërin prej numrave të revistës së tij, pohon:

Ajo qi lëshon rreze ma tepër dhe do të lajë mbresë të përjetshme në breznitë e përtardhuna t'ona ashtu si ndikoi edhe ato të sotmet, besoj se asht puna e tij letrare, e cila lyp nji parashtrumje të hollësishme", ... "*Ai pajisej me nji frymëzim të fuqishëm, shije letrare të sigurtë me pasuni e thellësi ndiesish*[79]

[79] E. Koliqi, *Emzot Theofan S. Noli*, "Shejzat", IX, nr. 3-4, Romë, 1965, fq. 79

Msc. ILIR SHYTA

NOLI-SAMSONI LETRARO-BIBLIK

Pa mëdyshje të gjithë njerëzit janë skematikë. Jeta e tyre s'është gjë tjetër veçse luftë me skemën. Kjo luftë mund të kurorëzohet me sukses a fitore, por edhe me nënshtrim. Rishmazi këtij kriteri duhen klasifikuar shkrimtarët. Duke qenë pa përjashtim që të gjithë skematikë ata ndahen në dy kategori: në shkrimtarë që i ribëjnë skemat dhe në shkrimtarë që u nënshtrohen skemave. Fan Noli që bën pjesë në të parët, duhet thënë se në "Israelitë e filistinë"e merr subjektin nga Bibla (Dhiata e Vjetër) dhe rikrijon atë ashtu si përdoret një gur i vjetër në një mur të ri, nga mjeshtri ndërtues. Kultura e fituar pas përfundimit të të lexuarit biblik ndalon në "Dhiata e vjetër", Libri i Gjyqtarëve, Kapitulli 10, ku ekzaktësisht thuhet: "*Në fillim pa lindur Samsoni ishin Israelitët që mëkatonin kundër Zotit. Ata adhuronin perëndi të huaja Baallin dhe Astarten si dhe perënditë e sirianëve dhe fenikasve, moavasëve të amonasve dhe filistinëve. Ata i kishin kthyer shpinën Zotit, nuk e nderonin më. Atëherë ai u zemërua me israelitët dhe i dorëzoi te filistinët dhe amonasit"*. Konkretisht, ajo që dimë është se Noli e merr subjektin e veprës së tij nga "Bibla" dhe e rikrijon. Pikërisht këtu qëndron dhe thyerja që i bën atij. Në dramën "Israelitë e filistinë", ata që mëkatojnë nuk janë izraelitët, por filistinët. Janë këta dhe vetëm këta që i kthejnë krahët Zotit dhe adhurojnë Baallin dhe Molohun. Janë po këta që heroin e Izraelit e gjykojnë dhe e tallin po në këtë tempull. Noli enkas i vendos filistinët armiq të Zotit (pra, bën thyerje nga versioni biblik), ndërsa do të saktësoja se shembjen e tempullit në fund të dramës nga Samsoni e jep njëherazi edhe si hakmarrje, një dëshirë nga vetë Zoti për të gjithë ata që nuk respektojnë fuqinë dhe ligjet e tij, që bëjnë mëkate e vepra të qoftëlargut.

Në "Bibël" fjala shpirt nënkupton edhe personin dhe kjo s'duhet të na befasojë në të mësuarin se shpirtrat mund dhe do të vdesin. Shkrimet e Shenjta thonë: "*Shpirti i cili bën mëkat vetë do të vdesë"* dhe në dramë Samsoni sqaron: "*Le të vdesë shpirti im me filistenjtë"*. Kjo thyerje në subjektin e dramës bëhet me qëllim adhurimi. Kushdo që nuk i bindet dëshirës së Zotit, vetëm shkatërrimi e pret, skëterra. Perëndia i urren fetë e rrejshme. Ndaj për të vlerësuar dhe gjykuar mbi skenën e aktit të fundit, duhet të shtojmë që veç dhunës që përdor Samsoni, kemi edhe dhunën që përdor vetë Zoti për ata që rastësisht me dashje e harrojnë ekzistencën e tij.

Në kuadër të këndvështrimit kontekstual të veprës, Noli(Samson) tashmë e ka nisur misionin. Kjo dëshmohet nga formimi dhe suksesi që ai ka në përhapjen e së vërtetës. Samsonin "tij" e ndihmon edhe fuqia hyjnore që mbart në vetvete si bir perëndie. Një mënyrë kjo për të ndëshkuar gjithë armiqtë e pabindur. Fuqisë së tij, kundërshtarët nuk i bëjnë dot ballë. Ja si e rrëfen Bibla të fshehtën e fuqisë së Samsonit: "*Djali që do të lindë, do t'i shugurohet Zotit që nga lindja e tij. Flokët e tij nuk duhen qethur. Me to do të fillojë çlirimi i izraelitëve nga shtypja e filistinëve"*. Ja e si e gjejmë në dramë: "*Gjatë gjithë jetës sime nuk i kam qethur asnjëherë flokët. Kjo e fshehtë i tmerron filistinët"*. Padyshim për çdo kundërshtar Samsoni mbetej egërshan i pathyeshëm. Më

tej në subjekt përfshihet vetë mbreti i filistinëve, i cili i qahet Dalilës: "*S'na lë më rehat ky njeri, po erdhi të bëjë fatzezë një botë të tërë me të vërtetat që lëçit. Prandaj u munduam ta zinim me ndonjë lak, pra një ditë ju hodhëm sipër papandehur, po s'bëmë gjëkafshë, ka aq fuqi ky njeri që i vrau të tërë"*. Ky rrëfim saktësohet edhe në Bibël: "*Ai luftoi me filistinët dhe gjeti një kockë të nofullës së poshtme të gomarit, e kapi dhe me të vrau 1000 filistinë. Pastaj e hodhi tutje kockën. (Sot vendi quhet Ramat-Lahi, Kodra e Nofullës)"*. Samsoni është i pathyeshëm. Në pathyeshmërinë e tij futet si krisje Dalila. Loja e saj zhvillohet me ritëm lajkatar. Kur vetmëvete Samsoni vë në fuksion arsyen kupton se dashuria përndritëse e tij për Dalilën është rezultat i dobësisë së zemrës. Më tej bën katarsis me Dalilën. Duke u pastruar shpirtërisht ajo do të jetë e denjë si e dashura e tij. Në pritje të një përgjigje të saktë rreth meditimit, nëse ka të drejtë zemra apo shpirti dhe nëse duhet të jetë njeriu skllav i pasioneve a zot i tyre, ne na ndihmon përfundimi i dramës, po aq sa fati i Nolit. *"Njeriu duhet të jetë Zot i pasioneve... , po ju pandehtë se qëllimi i rrojtjes është të ecim me katër këmbë përmbi dhet si bagëtia"*. Autori dramaturg pohon se vetëm duke qenë zot i zemrës dhe i qejfeve njeriu mund të sakrifikohet për idealin final të lumturisë. Kështu Noli e trajton fatin e Samsonit në një profil që e shqetësoi gjithherë unin e tij: Ç'qëndrim duhet të mbajë udhëheqësi në jetë? Ç'rrugë duhet të zgjedhë ai për të realizuar misionin e tij atëdheas? A duhet të jepet ai pas qejfeve dhe ta braktisë misionin e tij apo ta çojë gjer në fund? Përgjigjen e saktë të tri pyetjeve e jep vetë jeta e mëtejshme e Fan Nolit. Ç'po ndodhte me Nolin ndërkaq? Mos e priste vallë fati i Samsonit?

Dihej që Noli ishte misionar i një feje të re "Perëndisë së re", Shqipërisë, në një popull që nuk e njihte më, që e kishte harruar tanimë vetë Shqipërinë. Përpjekjet e Nolit vijnë si rezultat i përpjekjeve të gjithhershme të rilindësve. Kujtoj këtu thënien e Pashko Vasës: "*Feja e shqyptarit është shqyptaria"*. Noli, shndërrohet kështu në kambanë që bie për rizgjim. Del në plan të parë tani vetëm çështja e kombit. Ndonëse shqiptarët e kishin harruar Shqipërinë e asaj kohe, Noli përpiqet për të. Eshtë koha kur ai e ëndërronte veten në rolin e një udhëheqësi (vështruar të gjitha këto deri në kohën kur ai e botoi këtë dramë, dukë lënë jashtë ngjarjet e qershorit '24).

Kthehemi në dramë. Samsoni bie pre e Dalilës së bukur. Epshi e mund misionin, kur futet me botën në lidhje, kontakt. Ai humbet. (Samsonit i dalin fjalët e Rabinit) *"... po pse moj Perëndi të na trashëgoç ment që ta kuptojmë të vërtetën dhe të mundohemi? "* Fjalëve të mësipërme unë do t'u shtoja foljen "pendohemi" dhe më sinqerisht do të tingëllonte kjo shprehje kështu: "*... po pse moj Perëndi të na trashëgosh mend që ta kuptojmë të vërtetën dhe të pendohemi? "*. Ndërkaq kështu do të ishte fjalia më e drejtpërdrejtë në peshën dhe misionin që ajo do të përmbushte dhe përmbushë në fatin Nol-Samson. Përsa i përket formës që duhet të zgjedhë njeriu gjatë fillimit të misionit, do të më dukej tepër e kuptimtë thirrja e hapur që Noli u drejton shqiptarëve: "*... të ngrihemi ta bëjmë Shqipërinë"* dhe për ta bërë atë duhet mund, djersë, vullnet dhe këmbëngulje. Detyra është e vështirë dhe kërkon sakrifica. Për këtë çështje, lypset që njeriu të privohet nga lumturia, qejfet e jetës (Shih jetën e Nolit, deri në botimin e dramës) kur ai djalosh mund t'i shmangej rrugës së udhëheqësit (që e ëndërronte) e t'u jepej kënaqësive të saj.

Noli zbulon, zbërthen dhe gjykon vetveten. Endrra për ta parë veten në rolin e udhëheqësit do ta ndjekë gjithherë. Udhëheqësi në mendjen e tij krijohet si "njeri shembull" në të gjitha drejtimet. *"Populli kurrë s'ka pyetur nga e shpien... u vra dashi dhe humbi edhe populli udhën. Dolli një tjatër udhëheqës dhe thërret: "O burrani këtej, kthen këtej. Andej! Kthen andej...*

... kryen nuk e zgjidh populli, por ai zgjidht vetë përmbi popullin, lindet krye që në djep... Duket ay që mund të bëhet krye... ". Ky ishte mendimi i Nolit në atë kohë për "kreun" dhe popullin, mes të cilit ndërkaq e pozicionone veten, udhëheqës për këtë vend. Ndoshta janë vitet e një veprimtarie të gjerë dhe formimi nga gjimnazi i Edrenesë, rezultat i rrugës që ai do të ndiqte në jetë. Noli u përpoq t'i shërbente vendit, popullit. Kjo ishte për të një përgjegjësi e madhe që kërkonte një angazhim të gjithhershëm shpirtëror e fizik. Udhëheqësi i tij nuk shihej i shkëputur nga masat. "Kreu" i një populli nuk ka interesa të veçanta, por të përgjithshme e duhet të bashkojë fatin e tij me fatin e popullit. Për Nolin "Kreu" s'ka fëmijë, grua dhe pasuri. Fëmija i tij është gjithë populli (cilësi që i shohim te figura e Nolit, e që ai do t'i zbatojë gjatë gjithë jetës). Ndërkaq pas botimit të dramës dhe më pas Noli kurrë s'u martua, nuk pati fëmijë dhe e çoi tërë jetën larg në mërgim. Gjithmonë duke ëndërruar udhëheqësin që do të zgjonte kombin, Noli u privua nga kënaqësitë djaloshare, nga "Dalilat e bukura " që e prisnin udhëve të misionit të tij të shenjtë. Noli gjatë gjithë kohës sakrifikoi, bile edhe kur u bë kryeministri më i kulturuar europian në vendin më të prapambetur në vitin 1924, simbol datësor që në vështrimin kontekstual të kësaj drame nuk luan asfarë roli, por që në zhvillimin politik të ditëve tona duhet pasur zili. Në Shqipëri mbretëron konfuzioni i pesë anarkive, do të thonte Noli, për të përforcuar këtë portret mjeran, në fjalimin e mbajtur në Parlamentin shqiptar, në vitin 1924.

"... kolltukofagët, krimba të verdhe me kokë të zezë, që rriten me plagët e infektuara të Shqipërisë në lëngim, këpushë që mund t'i coptosh, por jo ti ç'qitësh, që kafshojnë e thëthijnë vazhdimisht. Që t'i ç'qitësh këta tanët nga kolltuku duhet t'u preç jo vetëm duart e kokën, por edhe këmbët e trupin... ". Në këtë dramë shtrohet edhe çështja nëse izraelitët do ta përhapnin fenë e tyre ndër filistinë mes dhunës a bindjes, pra mes luftës apo fjalës? Ndoshta një rrugë kjo që diskutohej më parë për zgjidhje nga rilindësit dhe që Noli me kapacitetin e vet atdhedashës parapëlqeu të parën. Ndoshta në një udhëkryq të tillë si Noli, mbase ka patur edhe plot të rinj shqiptarë që predikonin rrugë të ndryshme? Kësaj kohe, një përvojë e madhe qenë rilindësit, veçanërisht Samiu me "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet" kur thotë: "... *për liri shqiptarët duhet të kenë pushkën plot"*. Ndërkohë për fatin e djalërisë shqiptare, nuk dimë të thuhet ndonjë gjë rreth rrugëve që ata shtronin për çlirim kombëtar. Te Noli tani kemi një mendim të patjetërsueshëm, i cili kundërshton tezat që janë hedhur rreth mendimit të papjekur djaloshar të tij. Gjatimet rreth këtij problemi do të qenë të kota, sepse qëndrimi i Nolit kish në vetvete një ëndërr finale "Të bëhej kreu i Shqipërisë".

Në këtë tragjedi Samsoni kërkon ta realizojë misionin përmes predikimit të fjalës, bindjes pa përdorur dhunën, armët. Noli, sigurisht na e la ta zbërthejmë këtë zhvillim, ne lexonjësve nëpër kohë. Në momentin kur ai e shkroi dramën, enigma e mësipërme kishte rëndësi të dorës së parë. Ndërsa lexon pjesën, kupton se mendimi djaloshar

gjithmonë lëkundet. Nuk di nga të anojë. Bindja apo dhuna do të triumfojnë? Nëse ndiqet (predikimi i fjalës) sipas Rabinit do të dështonim përsëri, por nëse fjalën e shoqërojmë bashkë me fuqinë (gjithmonë sipas Rabinit të mençur) misioni do të kryhej me sukses deri në fund të mundshmërisë së tij. Pra Samsoni që i kundërvihet urtësisë së mendimit (Rabinit) fluturon drejt qiellit të stuhishëm pa u menduar mirë. *"... dua të mësoj filistinët të kqyrin Perëndinë brenda në Natyrë dhe Përjetësinë në Dashuri. Po këto nuk përhapen me zjarr dhe hekur, por vetëm kur njeriu është i lirë t'i marrë vesh... "* Janë të rëndësishme këto radhë për të kuptuar mendimin e djalërisë së Nolit, por edhe për të mësuar pse Rabini dhe mendimi i tij nuk çmohen fillimisht. Oratoria flet gjithmonë mbi bazën e përvojës. *"Ashtu flet djalëria, dhe unë kur isha i ri e nisa të marr vesh botën, u thosha shokëve të mi. Neve të gjithë e dimë të Vërtetën dhe do t'ia mësojmë botës. Na vinte çudi si asnjë para nesh se bëri këtë... , për provë pas dy-tre vjeç as e kujtonim më se çi kishin zotuar botës, se hymë dhe ne atje, dhe deshim ndrequr neve më përpara. Do kuvendojmë mirë Samson, pas dy-tre vjeç... "* Nga këto fjalë profetike, fill në fjalinë: "*Do kuvendojmë mirë Samson, pas dy-tre vjeç... "*, del si vështrim aty pari edhe kortezia, nëse duhet t'i bindet nxënësi mësuesit apo thënë ndryshe hovi rinor, djaloshar a mos duhet të dëgjojë përvojën që lind nga urtia, përvojën e shekujve? Dihet nga historia, nga shembujt e saj që përdorimi i dhunës është rruga që sjell fitore, por ka raste të tjera që të tërheqin edhe në rrugë të mesme, ndoshta pa fitore. Pikërisht një rrugë e tillë në dramë është bindja. *"Eshtë forca e ligjit, ajo që rregullon dhunën në bashkëjetesë me drejtësinë"*. Thënë shqip, vetëm kështu ujdiset e drejta, me dhunë. Domethënë ruan interesin e më të fortëve.

Ndërkaq të vështruara të gjitha këto në një aspekt të përbashkët tregojnë urti. Fytyra e Judës, rikthehet në këtë tragjedi, si maskë nga "Dhiata e Re", të cilën Noli e njihte mjaft mirë. Dyzimi i fytyrave pret vetëm një shenjë nga Dalila që tinëzarisht rri zgjuar brenda planeve të saj. Pas bukurisë, ajo fsheh helm të ngjyrosur me shije paralajmërimi. Dhunshëm filistinët, shfytyrojnë bukurinë fizike të Samsonit, deri në poshtërim e tallje. Njerëzimi gjithmonë është i gatuar për pabesi. Një e vërtetë historike kjo, refren për kohët e shkuara e të reja.

Në qoftë se të parët (izraelitët) s'e përdorën dhunën që në fillim, janë filistinët të cilët ushtrojnë dhunë më pas. Të kuptosh gabimin është një veprim më i reflektueshëm se sa ta vuash pa e kuptuar deri në brejtje të ndërgjegjes. Mllefi, urrejtja, përbuzja... , nuk përsëriten asnjëherë, "Kurrë më".

Samsoni gaboi. Për gjërat e dhimbshme në jetë nuk flitet dy herë. Zërin e zemrës të Samsonit djaloshar e sfidon mendja e shëndoshë e urtësisë (Plaku Rabin). Kjo është një tjetër e vërtetë faktike. Shprehja *"I riu si veriu"* mposhtet për të fituar koherencë brenda të njëjtit lloj meditimi. I riu duhet të dëgjojë gjithmonë mendimin e urtësisë që ka përvojë madhore në jetë. Fitoren ta garanton vetëm gryka e pushkës dhe drejtësia e shënjestrës së saj. Noli kur e shkroi këtë dramë ish fare i ri dhe kishte mendimin personal të përdorimit të dhunës, si mjetin më efikas që i jep dinjitetin kombit shqiptar. Brenda këtij slogani nuk shpjegohet vetëm zezona e '24-s, kur ai ishte Kryeministër, por edhe ditët e revolucionit të tij, kur nuk përdori asfarë dhune për kundërshtarët e betuar. Mos duhej që Krishti të kishte në dorë edhe kamxhikun? Apo më mirë kështu, largim nga pushteti pa terror?

Noli e dinte fare mirë që vetëm përdorimi i dhunës do e çonte misionin e tij deri në fund. Pse nuk e përdori atëherë? Samsoni më tej pendohet që nuk përdori dhunë që në krye të misionit të tij mbi filistinët. Mos vallë Noli u pendua ndonjëherë? Kjo përgjigje vjen nga introdukta e Makbethit: "*Ai që nis qeverimin me gjakderdhje dhe terrorizëm është i shtërnguar fatalisht të vazhdojë ashtu si nisi, s'kthehet dot prapa më, hyn thellë e më thellë sa vete, dhe është i detyruar të mbytet në pellgun e gjakut që ka krijuar ai vetë"*. Eshtë ky paragraf i shkruar nga vetë Noli, që jep përgjigjen e dilemës së tij në vitin '24. Ndoshta kjo është një përgjigje më e pjekur, që plotëson kuadrin e rinisë së tij, kur nuk diti t'i japë të drejtë: Forcës apo Fjalës sikundër në tragjedinë e tij "Israelitë e filistinë". Samsoni i tij dështoi dhe tashmë kjo dihet botërisht. Qëllimi i dështimit është rruga që ai zgjodhi. Zëri i përvojës kujton që e vërteta të besohet, kërkon dhe përdorimin e dhunës gjithherë. Këtë e vërteton edhe historia. Mos vallë për të arritur në këtë përfundim Noli duhej të mendohej gjatazi? Janë vite të një tollovie të madhe, kur ai kërkon të skicojë rrugët, të cilat dëshiron t'i imitojë sukseshëm. Fan Noli kërkonte në gjithfarë kushti t'i shërbente pupullit, vendit të vet. Një përgjegjësi e madhe kjo, që kërkonte angazhim të gjithanshëm shpirtëror e fizik. Me një fjalë, që në moshën 20-vjeçare kuptoi që e vërteta nuk përhapet pa forcë, pa mbështetjen e gjerë të miletit. Gjithmonë sipas Nolit, robve u duhet një udhëheqës i lindur si "Samsoni që Perëndia i fali fuqi trupi dhe shpirti". Udhëheqësi nolian duhej të ishte largpamës dhe jo rrezeshkurtër. Të mbështetej në mendimin e përvojës. *"Unë më s'shëkonj, dëgjonj të qeshurën e tyre që më qeth zemrën, dhe i jap të drejtë Rabinit me gjithë shpirt; Ah! se sa të drejtë kish. Lipsej të vinja me ushtëri israelitësh dhe ta diqnja, ta dërmoja gjithë këtë Botë të kalbur e të gënjeshtërme"*.

Samsoni e kuptoi "lojën e jetës" kur doli vetë pjesërisht jashtë saj. Flokët i rriten, fuqia i rivjen, mendjen e ka esëll, por i mungon drita e syrit. Zien nga një hakmarrje e tmerrshme. Pësimi i tij mbetet një mësim për izraelitët që gjithmonë t'i falen zërit të mençurisë kombëtare, përvojës, eksperiencës. Përmes fantazmës së vdekjes dhe gërmadhave të tempullit të Baallit, Samsoni ndihet i qetë, sepse përdori në një farë mënyre dhunën që ia impononte zëri i largët i urtësisë atdhedashëse, Izraeli. Asnjëherë nxënësi s'duhet të dalë para mësuesit. Madje edhe kur nxënësi ia kalon këtij të fundit, përsëri nuk duhet të nxitohet. Abazi me shokë, Samsoni... , që u përpoqën të çonin misionin e tyre deri në fund, dështuan. Shkaku mbeti një dhe i vetëm. Rruga që ata zgjodhën, ishte e gabuar. Me fjalë të tjera gjithë këta prijës ndërruan fytyrë, nga izraelitë u kthyen në filistinë, viktima të cilët do t'i afroja me fatin e Sokratit, që feçkën e derrit (filistinët) ia vunë izraelitëve dhe fytyrën e vetes këta të fundit ia ngjitën kokës së derrit pendimtar (rasti konkret izraelitëve). Kështu parakalon njeriu në histori. Mësim ky që Noli na e shpjegoi në moshën 20- vjeçare. Njeriu poshtërohet deri sa bëhet derr dhe vetveten (Sokratin) e dëbon të fyer, duke i veshur lëkurën e kafshës. Aktualisht kjo mbetet një nyje e përvijëzuar labirintheve universale të ekzistencës. Aty zbulojmë që Samsoni mëshironte për Nolin (në vetvete) dy deviza. Saktësoj, si bir i Perëndisë së Krishterë ai jep shpirtin e tij bashkë me filistinët, kur shemb tempullin e Baallit dhe Molohut. Samsoni i flijon të gjithë duke i lidhur përgjithmonë në besimin e njëjtë fetar, njëherazi për t'u falur mëkatet e bëra, ndërsa si izraelit përdor dhunën që e dëshiruan aq shumë të parët e tij, mjet që ia motivonte zëri

i urtësisë së atdheut. Vdekja e Samsonit në gërmadhat e tempullit filistin, për të çuar në vend detyrën e tij si hero i Israelit, mbart mes veti nëntekste fetare dhe krenarie brenda formatit që të lejon atdheu i gjithkujt. Ai vret filistinët dhe vdes bashkë me ta, vetëflijohet për t'u hapur dyert e qiellit të krishterë, përfundimisht jo parajsën. Me një akt të vetëm, Samsoni hero me natyrë të dyfishtë, ju përshtat të dyja anëve të natyrës së vet dhe përmbushi të dyja kërkesat e saj. Ushtron dhunën që i kërkon judaizmi dhe bën vetëflijimin që i kërkon krishtërimi. Kjo dramë dhe sinteza e saj mbeten për atë kohë, përvojë e mallkim i fjetur, si vetë mosha e brishtë që Noli ka dhe shndërrohen në siguri për kohën tonë. Gjejmë te kjo vepër një mrekulli e bukuri që herë venitet, shuhet e përndizet prapë për të mos u shuar kurrë a kaluar në plogështi shpirtërore, gjejmë dhimbjen jetësore, gjeografinë e personazheve që rrezatojnë respekt dhe urtësi përvoje. Ekzistojnë dy mendime për të ndrequr gjithmonë botën. Së pari, marrëzia për t'i vënë zjarrin dhe së dyti, mençuria për ta ribërë a ndrequr atë. Don Kishoti dhe Hamleti mbetën udhëkryqesh të saj. Nëse një herë të vetme, mendimeve të mësipërme u shton dhe forcën patjetër që mund të arrish diku...

Në gjithë këtë kapërcyell dimrash, Noli-Samsoni endet mes nocioneve: vdekje dhe pavdeksi. Me siguri, do të thoja, jo për emocion zakoni, që ai prehet mes së dytës. Pavdekësia ndihet në tërë kapacitetin vital të tij, edhe kur ndonjëherë ti e pandeh të vdekur. Këtij mendimi i peshon në kujtesë edhe gjykimi mendjeesëll i Eqrem Çabejt, kur e cilëson si një Ante të pavdekshëm, si njeri që e harron se ka vdekur, e që ndoshta e ke afër dhe larg si në ëndërr. Padyshim kur ke përpara figura si Noli (vdekja si ligj natyre) harrohet. Kjo e vërtetë duhet besuar edhe me sy hapur, sepse mishëron arketipin e tokës mëmë. *"Më tepër është shkrimtar i plisit të dheut se sa i qiellit"*. Eshtë toka mëmë që i dha fuqi dhe e mikloi Nolin njëzetvjeçar edhe kur shkroi "Israelitë e filistinë", edhe kur u bë Kryeministër, edhe kur mërgoi në anë të dherit, drejt "tokës së premtuar", në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pavdekësia për Samsonin, është pavdeksi edhe për vetë Nolin. *"E dua, e dashuroj moj Rahilë, këtë tokë me gjithë fuqinë që humba, me gjithë mërrinë dhe mërzitjen time, me gjithë mundimet. Pra me gëzim do t'i këmbeja sytë e shpirtit tim me ata që më doqnë, por vetëm ta shikonja dhe për herën e fundit këtë tokë kaq të mirë"*. Noli shfaqet i lidhur me qiellin dhe dheun e të parëve, që janë forca, qëndrueshmëria, pathyeshmëria e ekzistencës. Noli është një Ante i lashtë që merr fuqi prej mëmës tokë e rritet si një lis i moçëm (Samon i fortë), me rrënjë jo te vdekja, por te pavdekësia. Gjithsesi jeta vazhdon... Vdekja është veç prehja e udhëtarit... !

Msc. KLODIANA KULLOLLI

MJESHTËRIA E VARGUT NOLIAN

Fan Noli poet që vinte nga Rilindja, u bë përcaktues në periudhën midis dy luftërave, përgjithësisht me frymëzimin e ri, tonet e forta të pandjera në lirikën shqipe të kohës, veçanërisht me lirikën politike, si një nga llojet më të palëvruara nga poetët pararendës e bashkëkohës të tij.

"Fan S. Noli i shfaqet botës shqiptare edhe si poet, poet i vërtetë i një inspiracioni të ri. Ay krijoj poezinë dinamike, të metaforave të forta, të rrepta (...) Vjersha e Fan S. Nolit është esencialisht vjershë politike-patriotike". [80]

Edhe pse në numër relativisht e pakët, poezia e Nolit, me brendinë e fuqishme e me veçori në aspektin e motiveve po ashtu dhe të figuracionit do të lërë shenja të patjetërsueshme e madje origjinale në poezinë lirike të 1914-1944.

Poezia e Nolit, e fuqishme në tonalitete, paraqitet para lexuesve poezi e fortë, shpërthyese, mbartëse e idealeve të larta humane, e ndërtuar mbi figura e simbole historike, fetare, në raporte ndërtekstualiteti me fragmente të shkëputura nga bibla etj.

Origjinaliteti shfaqet edhe në aspektin formal ku spikat vargu ekspresiv me muzikalitetin e pahasur më parë në poezinë shqipe. Poezia dëshmon nga njëra anë fuqinë e frymëzimit dhe nga ana tjetër punën e madhe për formësimin e saj.

Noli është rast i veçantë në lirikën shqipe të periudhës midis dy luftërave, e përgjithësisht në gjithë traditën e lirikës sonë. Vargu sjell ritëm dhe ton të ri. Ajo që filloi me Asdrenin, përkujdesja për aspektin tingullor, muzikalitetin e vargut, kthehet te Noli në parim kryesor, parim drejtues i krijimit poetik.

Kuteli do ta evidentojë muzikalitetin e vargut të Nolit që në krye të herës. *"Vargu i tij nuk është vizual, po auditiv. I drejtohet, pra, veshit, jo syrit."* [81]

Studimi i Kutelit do të vazhdohet më tej prej Rexhep Qoses, i cili, në kuadrin e një kohe të re thellohet në hetimin e veçorive të poezisë së Nolit.

Në ndikimin e kritikës strukturaliste e formaliste, që vendosin formën në qendër të studimeve, Qosja sjell një këndvështrim të poezisë noliane nisur prej këtyre pozitave, me ide, argumente e teza të bazuara në hulumtimin e vargut të Nolit.

Muzikalitetin dhe përdorimin e simboleve Qosja e ka cilësuar si veçanti kryesore të poezisë noliane në sfondin e poezisë shqipe të kohës.

---

[80] Mitrush Kuteli, *Poeti F. S. Noli, Vështrim panoramik*, në "Kuteli, Shënime letrare", GrandPrind 2007, fq. 45: Botuar për herë të parë në librin "*Fan S. Noli, Mall e brengë" (Me një vështrim kritik prej Mitrush Kutelit*), Tiranë, 1943.

[81] Mitrush Kuteli, po aty, fq. 60.

"Vjershat e Nolit, me gjithë përgjithësimin simbolik që përmbajnë, do të ishin artistikisht të zbehta, sikur të mos ishin aq muzikore sa janë. Mungesën e shprehjes metaforike ai e ka zëvendësuar me ato dridhjet ritmike dhe muzikore çfarë nuk ka përjetuar poezia shqipe para, as pas tij. "[82]

Poezia e Nolit, me tipar qartësisht të evidentueshëm prej lexuesit muzikalitetin, lidhet me simbolizmin nëpërmjet këtij tipari.

Duke e kuptuar thelbin e poezisë, si arti i fjalës, poetët e periudhës së midis dy luftërave do ta latojnë fjalën shqipe si kurrë më parë. Kujdes tregohet jo vetëm për vargun si njësi e plotë e poezisë, por shtrihet në të gjitha elementet përbërëse formale: vargu, sintagma, togfjalëshi, fjala, rrokja, tingulli si njësi ndërvepruese që mbartin mundësi të pafundëta shprehësie.

Puna me fjalën është veçori e drejtimit simbolist, që, siç e kemi përmendur edhe më sipër pati një ndikim të dukshëm në disa prej poetëve më madhorë të kësaj periudhe.

Në ndërtimin e këtij muzikaliteti gjuha luan rolin kryesor. Përdorimi i figurave tingullore, (asonanca, aliteracioni, asidenti, polisidenti, anafora, përsëritjet), pasuria e fjalorit, kërkimi e përdorimi i fjalëve ekspresive, përdorimi i barbarizmave për arsye stilistikore, rima në fund të vargjeve, ndërtimi i ritmit të brendshëm janë pikërisht elemente të poezisë së Nolit që dëshmojnë punën e tij me gjuhën, vlerën që i jep fjalës dhe vargut, rrokjes dhe tingullit, si mbartëset kryesore të vlerave poetike.

Mbartësja e konotacioneve mund të jetë qoftë një njësi gjuhësore me përmasë më të madhe se fjala (pjesë fjalie, fjali, tekst), qoftë edhe një njësi gjuhësore më e vogël se fjala. [83]

Tek Noli janë të shumta vargjet ku dominojnë zanoret (të gjitha zanoret përdoren prej tij, duke qenë secila prej tyre dominante në vargje e poezi të ndryshme) si edhe bashkëtingëlloret (veçanërisht bashkëtingëlloret ç, m, n, s, r, sh, gj). Një analizë të detajuar e me shembuj ilustrues ka realizuar Qosja në studimin e vet.

Në vargun e Nolit luhet me tingujt, me vlerat që përftohohen prej tyre, ndaj dhe figurat mbizotëruese janë ato tingullore. Por nuk mungojnë edhe figura të kuptimit.

Një figurë tjetër e përdorur në mënyrë të veçantë nga Noli është edhe simboli. Shfrytëzon simblole të njohura në poezinë botërore si edhe ato biblike, duke bërë kapërcimin nga shqetësimet personale në përgjithësime artistike.

I nxitur prej ngjarjeve e figurave konkrete Noli do të përdor këtë figurë si mjet mbartës të përjetimit subjektiv. Në këtë mënyrë poezia e Nolit e dëshmon intencionin, veçse si intencion poetik. Simbolet noliane bëhën bartëse të motiveve universale, mënyrë kjo për t'i shpëtuar një leximi thjesht autobiografik të poezisë së tij.

"Noli është shembulli më i njohur në letërsinë shqipe për të parë cilat janë vlerat e mungesat e poezisë qëllimore; sa mund të ndërtohet fuqishëm e sa jo poezia që mbështetet kryesisht në ide". [84]

---

[82] Rexhep Qosja, *Fan Noli*, në "Panteoni i rralluar", Tiranë 1988, f. 203.

[83] Nicolas Laurent, *Initiation á la stylistique*, Hachete Superieur, Paris 2001, fq. 20.

[84] Sabri Hamiti, *Letërsia moderne shqiptare*, Tiranë, Alb-ass, 2001, fq. 70.

Noli, ashtu si Çajupi, do të evokojë në lirikën e tij figura e simbole biblike, fjali e mendime të tëra, por duke mos pasur asnjë lidhje të brendshme me to, përveçse si lëndë nga e cila gjenerojnë kuptime, vokacione artistike.

Vlera e poezisë së Nolit qëndron pikërisht në aftësinë për t'i folur lexuesve të ndryshëm, të niveleve e kohëve të ndryshme, në një shumësi leximesh e interpretimesh, ku nënteksti ndërtohet mbi dy kuptime: kuptimin e veçantë (më i sipërfaqshëm, më i lehtë për t'u receptuar), por që e mbart kuptimin e përgjithshëm që duhet zbërthyer nëpërmjet dekodimit të simboleve. Është simboli që i siguron vargut të Nolit kapërcimin nga ngjarjet konkrete në përcjelljen e mesazheve përgjithësuese.

Në drejtim të vargjeve të përdorura Noli spikat jo vetëm për përdorim të llojeve të ndryshme, të traditës sonë (popullore e të lëvruar) dhe asaj europiane, por edhe në kombinimet e përzierjet e tyre. Mbizotëron përdorimi i 8, 10 e 12- rrokëshit.

Noli e përdor dendur 8-rrokëshin e ndarë në dy hemistikë me theksa ritmikë të palëvizshëm me ritmin karakteristik ngjitës të gjithë poezisë noliane (*Syrgjyn vdekur*, *Shpell' e dragobisë*, etj), po ashtu edhe vargun 12-rrokësh, marrë prej poezisë popullore, mjaft i përdorur në lirikën tonë.

Në poezinë e Nolit gjejmë përdorime mjeshtërore të vargjeve të tjera, kombinimeve të tyre, që dëshmojnë vlerën e punës krijuese të Nolit në aspektin e kujdesit ndaj vargut, ndërtimit harmonik të tij.

Vargu katërrrokësh ka një përdorim të rrallë e zakonisht të përzier me vargje të tjera te Noli:

... po kur dimër del behari,
s'ka si zjarri! (Noli, "Shën Pjetri në mangall")

Noli e ka përdorur vargun 5-rrokësh (varg i taditës) duke e kombinuar me vargun 6-rrokësh në poezinë "*Kryqësimi*". 7-rrokëshi del i kombinuar me tetërrokëshin në vjershën "*Kirenari*".

Një varg i njohur pak në letërsinë tonë por me përdorim tepër mjeshtëror në periudhën midis dy luftërave është 9-rrokëshi. Me këtë varg Noli ka shkruar një nga krijimet më të mira të kësaj etape, poezinë "*Hymni i flamurit*". I drejtohet edhe vargut 11-rrokësh.

Një varg që është përdorur për herë të parë në poezinë shqipe pikërisht nga Noli, është 13-rrokëshi, marrë prej poezisë angleze. Noli procedon si në poezinë angleze, e ndërton vargun me anapestë duke shtënë në përdorim fjalë oksitone. Skema ritmike themelore e tij është 3, 6, 9, 12.

Tradhëtor, ti na nxive, na le pa atdhe,
ti na çthure, na çkule, na çduke çdo fe! (Marshi i Barabait)

Edhe poezitë "*Marshi i Krishtit*", "*Marshi i kryqëzimit*", "*Krishti me kamçikun*" janë ndërtuar me 13-rrokësh.

Poezia noliane shfaqet e pasur edhe ne përdorimin e strofave e të rimave. Noli përdor forma të ndryshme strofore, duke u nisur që nga strofat katërshe (strofa safike, është mbizotëruese), e deri në ato 8, apo më shumë vargëshe, në kombinime të ndryshme midis tyre. Katrena e Nolit del me strukturën e rimave të njëjtë si te Mjeda (AABb), por me vargje më të shkurtër: tre tetërrokësha + një katërrokësh: P. sh.

Fryn e çfryn veriu,
Njeriu mërdhiu i ziu
Dhe sangalli i afrohet,
që të ngrohet. (*Shën Pjetri në mangall*)

Fan Noli e ka përdorur mjeshtërisht këtë strofë edhe në poezinë "*Moisiu në mal*" por të ndërtuar me varg tetërrokësh dhe pesërrokësh.

Te Noli gjejmë të përdorur rimën me bisht (si te Asdreni):

Fryn e çfryn veriu,
njeriu mërdhin i ziu
dhe mangallit i afrohet
që të ngrohet. (Shën Pjetri në mangall)

Rima e brendshme është dukuri që merr përmasa të reja në periudhën e Pavarësisë. Noli e përdor dendur rimën e brendshme në vargjet e tij.

Dallkaukët, kopukët e turmat pa tru,
zemër-krund-e-gërdhu: Hosana, Baraba! (Marshi i Barabait)

Po ashtu gjejmë tek ai edhe ndërthurjen e rimës në fund me rimën në mes të vargjeve:

Bëj gajret, mor Kirenar,
Drejt përpjetë në Kalvar! (Kirenari)
Po troket çekani
Po kërset mejdani (Kryqësimi)

Vargu i Nolit është gjithmonë ritmik e i rimuar, me kumbim të pandierë në lirikën shqipe të kohës.

Këto janë disa nga tiparet e vargut nolian. Poetika e tij bëhet përfaqësuese e modernitetit të periudhës së Letërsisë së Pavarësisë e gjithashtu e klasifikohet kah rrjedhat e zhvillimit të poezisë europiane.

Simbolizmi, si një drejtim modern që u konsolidua në Europë, shfaqet në poezinë shqipe të periudhës së midis dy Luftërave, duke u kthyer në urën kryesore lidhëse midis poezisë shqipe dhe asaj europiane. Në këtë kontekst roli i Nolit dhe i disa poetëve të tjerë të periudhës në qasjet ndaj prirjeve moderne e në zvogëlimin e hendekut të krijuar mes letërsisë shqipe dhe asaj europiane, është vendimtar.

Nën ndikimin e simbolizmit e sheh Qosja muzikalitetin e vargjeve të Nolit dhe përdorimin prej tij të simboleve. *"Intonimi muzikor i vargjeve të tij flet qartë sesa shumë ishte nën ndikimin e simbolistëve. Kjo vërehet edhe në futjen e ideve të tij politike brenda kornizës së simboleve të biblës. Prej këtyre dy fakteve mund të shihet, gjithashtu, sesa bukur e ka ditur ai kahun e zhvillimit të poezisë bashkëkohore dhe sesa i ri është treguar me ndjeshmërinë e vet poetike".* [85]

Por si dëshmohet ky ndikim në poezinë e Nolit?

Le të ndalemi tek muzikaliteti, veçoria kryesore e vargut nolian.

A është muzikaliteti i vargut nolian ndikim i drejtëpërdrejtë i simbolizmit, apo është më shumë prirje e brendshme e poetit?

[85] Rexhep Qosja, *Panteoni i rralluar*, art. i cit. , fq. 211.

A e dëshmon poezia ndikimin nga ndonjë poet europian?

A vjen si ndikim i asaj fryme të re që filloi të shfaqet në poezinë shqipe që me vargjet e Asdrenit?

Kujtojmë këtu se muzikaliteti tipik i vargut nolian nuk duket në dy poezitë e tij të para, por vetëm në poezitë e mëvonshme.

Sa ka ndikuar njohja për muzikën, jeta fetare e politike, me ngjarjet që përjetoi poeti?

Lirika shqipe e periudhës së midis dy luftërave shfaqet me risi që e ndërlidhin me poetika të ndryshme europiane. Më së shumti këto shfaqje të modernitetit lidhen me aspektin formal. Kjo prirje shfaqet në poezinë e Asdrenit, në vëllimin "Psallme Murgu", e bëhet mbizotëruese në poetë të tjerë të kësaj periudhe.

Muzikaliteti është i dukshëm në disa poezi të Asdrenit, veçse vargu nolian duket se në ndërtimin e tij nuk ka lidhje të dukshme me vargun e Asdrenit. Tonet dhe dridhjet e vargut nolian shfaqen origjinale sa vështirë të evidentohet burim apo model të cilin autori e ka shfrytëzuar, apo është ndikuar. Muzikaliteti i vargut nolian ka pamje krejt të ndryshme prej gjithë poetëve të tjerë të periudhës dhe të mëvonshëm, në poezinë e të cilëve dëshmohet prania e këtij tipari. Ndryshe prej Asdrenit, prej Lasgushit e ndonjë tjetri, vargu i Nolit nuk është i butë, lirik, por buçitës. Karakteri kushtrues i vargjeve shkon në të njëjtën linjë me llojin, përmbajtjen dhe idetë e poezive.

"Fan S. Noli sjell në letrat e shqipes një stil individual, të tijnë, një vibracion energjik, një verb violent me shprehje metaforike të forta, që rrokullisen njëra pas tjetrës. " [86]

Ky stil i veçantë qëndron në harmoninë mes përmbajtjes dhe formës. Edhe tipari kryesor, muzikaliteti, ashtu si edhe simbolet me domethëniet e tyre, por edhe tiparet e tjera të formës në vargun e Nolit (rima, ritmi, toni, strukturat sintaksore etj.) qëndrojnë si përzgjedhje në përshtatje me përmbajtjen e poezive.

Sa ndikues mund të ketë qënë përkthimi i vargjeve të autorëve anglezë në këtë drejtim?

Përsëritja, në nivele të ndryshme (tinguj, fjalë, shprehje) është mjet nëpërmjet të cilit ndërtohet atmosfera e vargut. Në këtë pikë vargu i Nolit ka pika takimi me vargun e E. A. Poe, ku mjeshtërisht ndërtohet atmosfera e dhimbjes me anë të përsëritjeve. Kjo mund të interpretohet edhe si ndikim prej njohjes dhe përkthimit që i ka bërë Noli vargjeve të Poe-së.

Prirjen kah muzikaliteti Qosja nuk e sheh të rastit, duke patur parasysh një trashëgimi prej të atit, pjesëmarrjen e Nolit fëmijë në korin e kishës e dashurinë për muzikën, dëshmuar deri në fund të jetës.

Hetimi në gjithë fazat e jetës dhe krijimtarisë së Nolit në fusha të ndryshme dëshmon jo thjesht një prirje të rastit ndaj muzikës. Ka disa premisa që janë domethënëse në këtë aspekt. Noli trashëgon prej të atit, psallt në kishë, dashurinë për muzikën kishtare. Ndoqi një gjimnaz që i dha një formim muzikor. Ishte drejtues i korit të kishës dhe organizonte ceremonitë kishtare.

[86] Mitrush Kuteli, *art. i cituar*, fq. 61.

Poezia e Nolit e dëshmon aftësinë kompozuese më parë se të shfaqet në muzikë.

Kompozimet e tij muzikore, edhe pse më të mëvonshme se krijimtaria poetike (që mund ta quajmë pa frikë kompozim fjalësor), vetëm e përforcojnë më tej prirjen ndaj muzikës.

Por nuk ishte thjesht një prirje, një dashuri ndaj muzikës. Monografia "Bethoveni dhe Revolucioni francez", studim serioz në fushën e muzikës, dhe kompozimet muzikore janë tregues i formimit kulturor ndaj muzikës.

Ky receptim i muzikës në tërë etapat e jetës shndërrohet në muzikë e fjalës. Pra, nuk është e rastit fakti që i dha poezisë karakterin muzikor, auditiv. Kjo nuk përjashton preferencat dhe ndikimet e poetëve të huaj që krijonin në këtë terren.

Janë këto hipotezat që kërkojnë hulumtim të thellë në poezinë noliane.

Poezia e Nolit e shtron këtë si detyrë për studiuesit dhe kritikët edhe sot pas kaq dekadash.

Por Noli nuk bëhet i dallueshëm vetëm me muzikalitetin dhe tiparet e tjera të vargut të tij, por edhe në nivel të temave e motiveve. Ai shkëputet prej frymës romantike e neoklasiciste që vazhdonte të ndihej në poetë të brezit të tij.

"Duke qenë në çdo gjë origjinal në një mënyrë të posaçme, nuk është çudi pse Noli nuk ka lënë trashëgimtarë të llojit të vet as në krijimtarinë poetike e, gati, as në aktivitetin politik". [87]

[87] Rexhep Qosja, *Fan Noli*, në "Panteoni i rralluar", Tiranë 1988, f. 170.

MIRLINDA KRIFCA-BEQIRI

ÇËSHTJA E VERSIONEVE DHE VARIANTEVE NË POEZINË E FAN NOLIT

Shumë çështje që kanë të bëjnë me versionet e veprës letrare mbesin të hapura, meqë akoma nuk ekziston një teori e plotë e versioneve. Ekzistojnë studime të shumta që, kryesisht, u referohen versioneve të veprave të caktuara.

Studimet që merren me laboratorin krijues të shkrimtarëve të mëdhenj na njoftojnë se ata kanë investuar mjaft në veprat e tyre. Është e njohur letra e Turgenjevit, e shkruar kur ai ishte shtrirë në tavolinën kirurgjike: "*I kërkoja fjalët, prore i kërkoja fjalët, me të cilat saktësisht dhe më së miri do ta përshkruaja përshtypjen që zgjonte në mua bisturia kirurgjike, e cila, duke më prerë lëkurën, futej thellë në trupin tim"* (Eshtrefi, 1990: 108).

Shkrimtarët e mëdhenj, veçmas poetët, kanë qenë kërkues të pasionuar të fjalës, meqë fjala paraqet brumin me të cilin e ngrejnë kullën e vet poetike. Pra, shkrimtarët e mëdhenj kanë qenë njerëz që më me pasion do t`i korrigjonin veprat e tyre të përparme se sa të shkruanin vepra të reja. Endja pas fjalëve e ka shtyrë stilistin e madh G. Flober që në hartimin e një romani të investojë një punë 5-6 vjeçare edhe përkundër faktit se ka punuar më se 10 orë në ditë. Mopasani disa prej novelave të tij i ka përpunuar 8 e më shumë herë. L. N. Tolstoi për 6 vjet ka shkruar 6 variante të veprës së tij "*Ringjallja"*.

Poetët e mëdhenj kanë investuar shumë punë dhe mund në gjetjen e fjalës sa më të përshtatshme që do t`i përgjigjej kontekstit të dhënë. *"Disa poetë të rëndësishëm as pas disa javëve dhe muajve nuk mund ta mbaronin poezinë e tyre. Kështu Shilerin dhe Hygonë, dëshira për përkryerje i ka shtyrë që disa herë t`u kthehen veprave të tyre. Akoma më bindës është rasti i Hajnes. Ai, si një nga poetët më muzikalë dhe më të mëdhenj gjermanë, poezisë së tij "Lorelaj" i është kthyer dhe e ka korrigjuar më tepër se pesëdhjetë herë dhe vetëm atëherë e ka botuar"* (Ble~i}, 1988: 38-41).

Biografitë e shkrimtarëve të mëdhenj na njoftojnë se veprat e tyre nuk janë fryt i inspirimit momental, por janë rezultat i një pune dhe investimi të madh. Vepra e suksesshme letrare është sinonim i punës së pakompromis. Në lidhje me këtë, edhe mendimi i *U. Eko: "Nuk më kujtohet se për cilën prej vjershave të veta Lamartini shkroi se i kishte lindur vetvetiu, një natë stuhie në pyll. Kur vdiq, u gjetën dorëshkrimet me ndreqjet e variantet, dhe u zbulua se ajo ishte ndoshta vjersha më "e punuar" e gjithë letërsisë franceze"* (Eko, 1996: 456).

Vepra poetike paraqet mundësi për të operuar me impulset e gjuhës poetike. Autori investon në përsosjen e veprës së tij. Ndryshimet që i përjeton një vepër gjatë përkryerjes së saj janë dëshmi se autori zhvillon dialog me të, përkatësisht se ka qëndrim kritik ndaj kreacionit të tij. Vepra letrare, si e tillë, është e hapur dhe gjithmonë ofron mundësi për korrigjime, ndryshime, plotësime.

Versionet apo variantet e veprës letrare na njoftojnë me metamorfozat që i përjeton një vepër e caktuar deri në formën e saj definitive, përkatësisht deri në botimin e saj, edhe pse, edhe pas botimit të veprës, autori mund t`i kthehet sërish asaj dhe të bëjë intervenime të caktuara.

Të gjithë autorët, natyrisht, nuk kanë pasur qëndrim të njëjtë ndaj kësaj çështjeje. Përderisa pjesa më e madhe e autorëve të mëdhenj përcaktohen për rrugën e korrigjimeve, disa autorë mendojnë se autori nuk duhet të humbasë kohë duke i korrigjuar veprat e vjetra, por me veprat e reja duhet t`i shmangë dobësitë e veprave paraprake. Ata janë të bindur se, në të vërtetë, një autor vazhdimisht shkruan një vepër të vetme, përkatësisht se çdo vepër e tij, në një mënyrë apo në një tjetër, është version i veprave paraprake.

Motivet që e nxisin autorin t`u kthehet veprave të tij mund të jenë nga më të ndryshmet. Sido që të jetë, vetë përpunimi i veprës artistike paraqet akt kritik, përkatësisht kthim kritik të autorit ndaj të gjitha strukturave të veprës së tij. Duke u përcaktuar për korrigjime, autori në një mënyrë i kundërshton (mohon) veprat paraprake, përkatësisht i pranon mangësitë, të metat e tyre.

Është e njohur se edhe në mesin e autorëve ka të tillë që e kanë zgjedhur rrugën e korrigjimeve të veprave të tyre. Derisa disa kënaqen me korrigjime fare të vogla, të cilat shpeshherë nuk e prekin strukturën semantike të veprës, përkatësisht kanë të bëjnë me fonostrukturën e saj, të tjerët janë të disponuar për korrigjime më të mëdha. Nuk mungojnë edhe rastet, kur autorët, të pakënaqur me veprat e tyre paraprake, i mohojnë plotësisht ato, duke i konsideruar vepra të dështuara.

Varësisht nëse korrigjimet në një vepër janë më të vogla apo më të mëdha, mund të flasim për *rikonstruim* ose për *korrigjim.* Rikonstruimi vjen në shprehje, kur bëhet fjalë për përmirësime të imëta të veprës që, zakonisht, janë ndryshime të natyrës stilistike ose leksikore.

Varësisht nga koha kur bëhen intervenimet, mund të flasim për *përpunim* (të veprës së pabotuar) ose për *ripunim* (të veprës së botuar). Me dallim nga ripunimi, që paraqet dukuri më të rrallë, përpunimi është karakteristikë e çdo vepre.

Versione mund të quhen përkthimet e një vepre nga një gjuhë në një gjuhë tjetër, përkatësisht përshtatjet e veprës prej një mjedisi në një tjetër ose prej një kohe në një tjetër; transformimet e një vepre prej një gjinie në një gjini tjetër letrare, p. sh. prej poezisë në prozë ose anasjellas; si dhe prej një arti në një art tjetër, p. sh. prej romanit në film etj.

Atje ku kemi *mimesis* kemi edhe *version.* Marrë në përgjithësi, çdo lloj përshkrimi ose rikrijimi mimetik i realitetit paraqet një version të atij realiteti (Popovi}, 1975: 22).

Versione quhen edhe botimet e shkurtuara ose të zgjatura të një vepre të caktuar letrare. Fundja, edhe mënyrat e ndryshme të të lexuarit, të të komentuarit dhe të të kuptuarit të po të njëjtës vepër nga ana e lexuesve, paraqesin një lloj versioni të një vepre të caktuar.

Që të kemi versione, duhet të kemi edhe dallime mes dy veprave. Afërsia tepër e madhe, si edhe ndryshueshmëria tepër e madhe, nuk është karakteristikë e versioneve. Gjatë hartimit të versionit të ri të një vepre bëhet fjalë për transferim të

caktuar të vlerave strukturore të krijimit të përparshëm që sërish ristrukturohet. Versioni më shpesh bëhet për qëllime kreative.

Nocioni *version* nuk ka përkufizim të qartë. Shpesh, bashkë me të, përdoren edhe nocionet *redaktim, variant, revizion.* Kështu, p. sh. , në terminologjinë profesionale ruse preferohet nocioni *redaktim* që, si i tillë, përfshin ndryshime më të mëdha të veprës letrare, përderisa nga ana tjetër në Evropë më tepër përdoret nocioni *variant.*

Pavarësisht se versioni dhe varianti shënojnë një dukuri të njëjtë, varianti, megjithatë, është rast i veçantë i versionit. Përderisa versioni ka të bëjë me një krijim të plotë dhe të pavarur poetik, varianti i referohet një njësie parciale dhe relativisht të varur të veprës në fjalë. Në të vërtetë, nuk është lehtë të përcaktohet kufiri mes tyre. Varianti është sinonim i versionit, por përfshin njësi më të vogla të strukturës. Ai më tepër i referohet rrafshit morfologjik të veprës.

Versionet e një vepre të caktuar mund të jenë a) *autoriale, b) bashkëautoriale dhe c) joautoriale (të përshtatura, të censuruara, të redaktuara).*

Në raste më të shpeshta, versionet janë rezultat e endjes së autorit për përkryerje. Në të vërtetë, çdo vepër e re e një autori paraqet version të veprës ose veprave paraprake me të cilat zhvillon dialog. Versioni i një vepre mund t`i referohet përpunimit të elementeve të ndryshme të saj, siç janë subjekti, tematika, kompozicioni. Ekzistojnë forma të ndryshme të versionit, si *versioni i punës (përpunimi), ripunimi, përkthimi, përshtatja.*

Metamorfozat e poezisë noliane

Në dallim nga poetët e Rilindjes Kombëtare, vepra letrare e të cilëve, kryesisht, ishte në shërbim të vetëdijësimit kombëtar, poetët e periudhës pasardhëse, përkatësisht asaj mes dy luftërave botërore, krijuan vepra letrare që, në radhë të parë, janë në shërbim të nevojave të tyre artistike, prandaj është e natyrshme të pritet që t`i kushtojnë kujdes më të madh vargut, përkatësisht të investojnë më shumë në përkryerjen e veprave të tyre. Ata nuk e kuptojnë veprën letrare si mjet për realizimin e këtij ose atij qëllimi, por, në radhë të parë, si vepër letrare, e pastaj edhe si vepër që mund të jetë e angazhuar ose jo.

Synimi për t`iu afruar idealit poetik, përkatësisht dëshira për krijimin e një vepre të përkryer, do t`i motivojë ata t`i latojnë vargjet, duke bërë korrigjime dhe intervenime të ndryshme, qofshin ato korrigjime në ritmostrukturë, siç ndodh në numrin më të madh të rasteve, ose ndryshime në semantostrukturë. Ata qenë të prirë nga ideja se një poet i mirë nuk duhet të shpejtojë në botimin e veprave të veta, por se duhet që veprën ta lërë të flejë për një periudhë të caktuar, që t`i rikthehet sërish më vonë, dhe atë disa herë, meqë vetëm në këtë mënyrë mund të japë tërë potencialin e vet poetik në krijimin e një vepre sa më të realizuar.

Poezia e Nolit dëshmon përpjekjen e poetit për krijimin e një vepre të përkryer ose të një *"arti magjik"*, siç shprehet poeti i madh lirik nga Pogradeci. Andaj, opusi poetik i Nolit është fare i vogël, por i veçantë. Kjo dëshmon se ai ka investuar më shumë në komponentin vertikal sesa në atë horizontal, i bindur se kusht themelor që një poet të mbetet e pavdekshëm nuk është sasia, por cilësia e veprës së tij. Ai, sikur pranon mendimin e Lasgushit të madh, i cili shprehet: "*Poezia duhet të jetë cilësi jo*

shumësi. Mos ki frikë se ke shkrojtur gjatë jetës tënde vetëm dhjetë poezi. Frikë të kesh po të kesh shkrojtur njëqind poezi. Poezi s`do të thotë shumë vëllime. Poezi do të thotë: një vëllim! Një vëllim me poezi shumë të mira. Kaq" (Kolevica, 1992: 84-85)

Pjesa më e madhe e varianteve të poezive të Nolit, janë rezultat i përpjekjes së tij për krijimin e një poezie melodike, të një poezie, përbërja fonike e së cilës do të zgjojë asociacion në problemin që është objekt trajtimi, përkatësisht në ambientin ose disponimin për të cilin bëhet fjalë.

Shembulli i Nolit dëshmon se ai ka mbajtuar llogari për muzikalitetin e krijimeve të tij. Poezitë e tij fashinojnë, pos tjerash, edhe me muzikalitetin e tyre.

Si njohës i mirë i kryeveprave të letërsisë botërore, ai ishte i njoftuar me të vërtetën se krijimet më të realizuara të poetëve të mëdhenj kanë kaluar në më tepër variante, derisa kanë arritur në formën e tyre përfundimtare. Noli kishte përvojë edhe nga puna e tij përkthyese, përkatësisht nga shqipërimi i një numri të madh të kryeveprave të letërsisë botërore. Duke folur për veprimtarinë e tij përkthyese, ai thotë: "*Asnjëherë s`i pëlqeva këto dhe gjithmonë hezitoja t`i botoja. Gjithmonë sërish i shikoja dhe i korrigjoja"* (Jorgaqi, 1987: 64)

Numri më i madh i përmirësimeve me të cilat shoqërohen variantet e shumta të poezive të Nolit janë korrigjime që kanë të bëjnë me ritmostrukturën e vargut.

Vargu i Nolit është varg që zgjon efekte akustike, së këtejmi tërë ajo rimë dhe ritëm, imazhe dhe fjalë, shpesh edhe të ashpra dhe barbarizma që janë në shërbim të përshkrimit sa më të përshtatshëm të asaj që është objekt i krijimit poetik. Në këtë kontekts do të mund t`i përmendnim poezitë e tij *"Mojsiu në mal", "Marshi i Krishtit", "Marshi i Barabbajt", "Marshi i kryqëzimit", "Moisiu në mal", "Kryqëzimi",* etj.

Ndryshimet që shoqërojnë poezitë e Nolit janë të lidhura me fenomenin e *premutacionit*, përkatësisht me ndërrimin e vendeve të fjalëve, e më rrallë edhe të vargjeve në poezi.

Kështu, p. sh. , vargu i parë i poezisë së Nolit *"Mojsiu në mal"* në variantin në dorëshkrim figuron:

"Përpjetë ngjitet malit të shkretë",

përderisa në variantin e botuar vjen te ndërrimi i vendeve të dy fjalëve të para:

"Ngjitet përpjetë Malit të shkretë... "

Te Noli kemi edhe shembuj, kur nuk i ndërrojnë vendet fjalët në një varg, por vargjet mes veti. Kështu, katër vargjet e para të strofës së tretë të poezisë *"Anës lumenjve"*, në variantin në dorëshkrim, janë të radhitura në këtë mënyrë:

"Nënë thundrën e përdhunës,
Anës Vjosës, anës Bunës!
Se ç`e pren e se ç`e vranë,
Ç`e shkretuan anembanë... ",

përderisa në variantin përfindimtar e hasim këtë rend të vargjeve:

"*Se ç`e pren e se ç`e vranë,*
Ç`e shkretuan anembanë,
Nënë thundrën e përdhunës
Anës Vjosës, anës Bunës! . . . "

Shpesh, gjatë përpunimit të një poezie, përkatësisht të varianteve të saj, vjen te ndryshimi i ndonjë fjale. Në raste më të shpeshta, bëhet fjalë për fjalë që zëvendësohet me ndonjë fjalë tjetër me përmbajtje të ngjashme ose me sinonimin e saj. Në raste të tilla, intervenimi i bërë nuk e ndryshon kuptimin semantik të poezisë.

Noli investoi jashtëzakonisht shumë në gjetjen e fjalëve përkatëse. Për të dëshmuar këtë, do të shërbehemi me këtë deklaratë të tij: "*Tani të vijmë n`elegjinë e Gurakuqit. Vargu i fundmë i strofës së katërt është: "Ti s`i dhe as varr për horr". Fjala "hor" (jo "korr'), të cilën e dini pa dyshim, është e poshtër nga kuptimi e nga tingëllimi dhe t`ju them të vërtetën, kam hezituar mjaft para se t`i lëshoj një vend në vjershën, po është ekspresive dhe e fortë nga egërsia; pastaj vehet në kundërshti e dhëna e "Lirisë dhe kurorës" prej këtij dhe refuzimi i një varri që Arnautllëku i fal çdo hori"*. Në këtë mënyrë vargu *"Ti s'i dhe as varr për horr"* e fitoi të drejtën e ekzistencës në këngë, për shkak se kjo fjalë është më ekspresive. Por Noli, megjithatë, mendon se me këtë varg Gurakuqi, të cilit i kushtohet elegjia, nuk është i karakterizuar si duhet. Prandaj, më tej, në letër vazhdon: "*Më poshtë ju jap ca variante që i kam hedhur në shportë: 1) Ti s`i dhe as vënt për vorr; 2) Ti s`i dhe as varr në fror; 3) Ti s`i dhe as varr mizor; 4) Ti m`i dhe një varr mizor...*

Do t`ish punë e gjatë t`ju shpjegoja pse preferova vargun që u dërgua për botim. Dhe sa për vargjet nr. 1, 2, 3 s`më vjen shumë keq (nënv R.. I. ) që i eliminova, po për vargun nr. 4 ka një posibilitet që të riabilitohet dhe të figurojë më një ribotim të elegjisë: E merrni vesh lehtë pse: E para, fjala mizor tingëllon më mirë në vesh se sa horr; e dyta në të tre vargjet, të hedhura në shportë, si edhe n`atë që u adaptua, thema është refuzimi i varrit n`atdhe, i cili reflektohet me një mënyrë më tragjike në strofën e fundme me fjalët "syrgjyn vdekur" kur në vargun nr. 4 thema është për "varrin mizor", që i dha Arnautllëku si çpërblim të shërbimeve... " (Idrizi, 1987: 12).

Te ndryshimi i fjalës vjen edhe në vargun e fundit të strofës së fundit të poezisë *"Rent, or Marathonomak"*, përkatësisht në vargun "*Tok, or Marathonomak! ",* që në variantin në dorëshkrim del*: "Çift, Marathonomak"*.

Ndryshim të fjalës hasim edhe në poezinë me më tepër korrigjime të Nolit, përkatësisht në poezinë *"Mojsiu në mal"*, poezi në të cilën autori ndryshon nga një fjalë në të gjitha vargjet e strofës së parë, përveçse në vargun e parë, ku vjen në shprehje dukuria e premutacionit. Kështu që, përveç variantit përfundimtar, që shprehet:

"Ngjitet përpjetë malit të shkretë
Kry - Profeti trimi me fletë,
Të bisedojë me Perëndinë
Për Palestinë... "

e kemi të njohur edhe variantin e dorëshkrimit, që shprehet:

"Përpjetë ngjitet malit të shkretë
Liberatori trimi me fletë
Te fjaloset me Perëndinë
Për vegjëlinë... "

Siç vërehet, në vargun e dytë leksema *"liberator"* është zëvendësuar me *"Krye-profet"*. Në vargun e tretë folja *"të fjaloset"* zëvendësohet me foljen *"të bisedo-*

jë”, kurse në vargun e katërt emri *”vegjëlinë”* zëvendësohet me emrin *“Palestinë”*. Sa u takon ndryshimeve që paraqiten në vargun e dytë dhe të katërt, nuk është e vështirë të vërehet se ato janë rrjedhojë e bindjes së autorit se emrat *Profet dhe Palestinë* janë më të përshtatshëm, meqë në strofën e dhënë bëhet fjalë për bisedën e zhvilluar me Zotin, prandaj është më e logjikshme dhe më e arsyeshme të pritet që kjo bisedë të zhvillohet nga një profet, e jo nga një liberator. Në fjalën *liberator* autori kthehet në vargun e fundit, me qëllim që të na përkujtojë në situatën e dytë jashtëtekstuale, përkatësisht në realitetin shqiptar si kontekst që e motivoi poezinë.

Në lidhje me korrigjimin e bërë në vargun e katërt mund të themi se autorit i është dukur më e logjikshme të shërbehet me toponimin *Palestinë* sesa me emrin *vegjëlinë*, meqë në këtë mënyrë poezia më shumë do të lidhet me paratekstin biblik dhe njëkohësisht nuk do t`i mvishet preteksti klasor, siç qe rasti me variantin e parë.

Mjaft korrigjime fjalësh përjeton edhe poezia *“Krishti me kamxhik”*. Fjala *“Akropol”* nga vargu i parë është zëvendësuar me fjalën *”kështjellë”;* fjala *“kusar”* nga vargu i dytë është zëvendësuar me fjalën *“saraf”*; fjala *”pretendojnë* nga vargu *“Dhe pastaj pretendojnë kështu Izraelin ta mbrojnë dhe shpëtojnë”* është larguar tërësisht; fjala *“të mjerët”* nga vargu i tretë i strofës së dytë zëvendësohet me emrin *“vegjëlinë”*. Në vargun e katërt të strofës së pestë ndryshojnë dy fjalë, përkatësisht vargu

“Dhe nga krimbat që hanin atdheun e shpëtoi”

në variantin përfundimtar del:

“Dhe nga larot gjakpirës atdheun e shpëtoi”.

Shpesh, por jo gjithmonë, në poezitë e Nolit fjala zëvendësohet me fjalë të ngjashme, përkatësisht me fjalë që ka konstantë të afërt përmbajtësore, por përbërje të ndryshme fonetike, së këtejmi edhe efekte të ndryshme fonostilistike.

Te Noli ndodh që versionet e ndryshme të të njëjtës poezi të dallohen në raport me numrin e strofave ose vargjeve. Në raste të tilla korrigjimi i një poezie shpie në ndryshimin e gjatësisë së saj. Në numër më të shpeshtë të rasteve versioni i ri është më i shkurtër se i vjetri, meqë përkryerja e një poezie, përveç tjerash, domethënë edhe gjejtje e një shprehjeje më koncize, përkatësisht ekonomizim në fjalë. Pra, në numrin më të madh të rasteve në versionet përfundimtare vjen në shprehje procedeu i *ekstrapolacionit*, përkatësisht procedeu i largimit të pjesëve të caktuara nga struktura e krijimit poetik. Por, nuk mungon edhe procedeja e kundërt, përkatësisht procedeja e *interpelacionit*. Kështu, poezia *”Himni i flamurit”* e Nolit, e botuar në përmbledhjen *“Album”*, dallon dukshëm nga versioni paraprak, botuar në përmbledhjen *“Mall e brengë”*, ku ka pasur tri strofa, kurse versioni përfundimtar ka gjashtë strofa. (Gega, 1968: 186)

Edhe përkundër faktit se Noli pothuajse asnjë poezi nuk e la në variantin e saj të parë, megjithatë prej varianteve të tij në dorëshkrim, para së gjithash prej atyre që janë të njohura, vërejmë se autori më tepër intervenon në poezitë *“Mojsiu në mal”, Krishti me kamxhik”, “Sugjyn - vdekur”, “Marshi i Krishtit”, “Marshi i Barabbajt”, “Anës lumenjve”*.

Poezitë e Nolit, përveç korrigjimeve të përmendura, pësojnë edhe korrigjime të titujve, si elemente të peritekstit (sipas Zh. Zhenet). Noli, si gjithë poetët e mëdhenj ka investuar në gjetjen e titujve sa më të përshtatshëm për krijimet e tij poetike, i bindur se titulli, si element me të cilin vendoset kontakti i parë mes veprës dhe marrësit, duhet të jetë sa më i përshtatshëm, titull që do të përkojë me karakterin e poezisë.

Në të shumtën e rasteve titujt e poezive pësojnë ndryshime para botimit të tyre nëpër revista të ndryshme, domethënë në dorëshkrim, edhe përkundër faktit se nuk përjashtohen edhe rastet, kur titujt janë ndryshuar gjatë botimit të tyre në përmbledhje të caktuara.

Noli është përpjekur të gjejë tituj që do t`u përgjigjen krijimeve së tij poetike. Në numrin më të madh të rasteve poezitë e tij lidhen me emrat e heronjve që janë objekt i trajtimit artistik. Sot, kur i kemi të njohura planet e Nolit për botimin e poezive të tij, pavarësisht se një numër i tyre mbeti i parealizuar, megjithatë jemi në gjendje të vërejmë se autori shumë krijimeve të tij poetike ua ndryshoi titullin e imagjinuar ose të parashikuar në planet e projektit të tij poetik. Duke pasur parasysh faktin se opusi letrar i Nolit është mjaft i ngushtë, është e natyrshme të pritet që ndryshimet e titujve të jenë më të rralla, edhe përkundër faktit se, megjithatë, ekzistojnë. Këtu ndikon edhe fakti se titujt e Nolit, siç përmendëm, paraqesin emrat e personazheve poetike, prandaj edhe mundësia për ndryshime është më e vogël, përkatësisht më e kufizuar.

Poezia *"Anës lumenjve"* në versionin e vet të parë është e njohur me titullin *"Anës lumenjve të Babilonisë"*, që domethënë se në variantin e ri Noli e shkurton titullin paraprak. Poezia *"Kirenari"*, botuar në revistën "*Bota e Re"* (Tiranë, 1945, shtator, nr. 3, f. 46), mban titullin *"Kënga e Kirenarit"*(Noli, 1945: 46-47). Poezia *"Jepni për nënën"* është e njohur edhe me titullin *"Mbretëreshë pa kurorë"*. Poezia *"Bismillah tredhjetë seneja"* në dorëshkrim është titulluar *"Kënga e Dervish beut"*. Poezia *"Kënga e Salep- Sulltanit"* në variantin e vet të parë është e njohur me titullin *"Kënga e monarkisë"*, etj.

Opusi letrar i Nolit karakterizohet me një numër të madh të korrigjimeve. Arsyet që e kanë shtyrë atë që t`u kthehen krijimeve të tij të përparme dhe të intervenojë, janë nga më të ndryshmet. Ndonjëherë versionet e një vepre janë rezultat i nevojës për arritjen e homogjenizimit në kuadër të makrotekstit që, si i tillë, është i përbërë prej më tepër teksteve, përkatësisht mikroteksteve, që mund të jenë krijuar në mënyrë ta pavarur prej njëri-tjetrit dhe në një distancë kohore jo të shkurtër, siç ndodh kjo në raste më të shpeshta me përmbledhjet poetike. Në raste të tilla bëhet fjalë për ndryshime që i bëhen tekstit për shkak të nevojës për lidhjen e tij me tekstet e tjera, së bashku me të cilat do të formojë një cikël poetik ose një përmbledhje. Kuptohet, një dukuri e tillë respektohet, në radhë të parë, nga ana e autorëve që mbajnë llogari për anën kompozicionale të veprës së tyre ose për opusin poetik në përgjithësi. Domethënë, ndryshimet e tilla me qëllim homogjenizimin janë karakteristike për vepra që kanë një strukturë të fortë organizative.

Duke pasur parasysh se Noli ka mbajtur llogari për integrimin e mikroteksteve në makrotekst, është e natyrshme të pritet që edhe në këtë fazë të mbledhjes së poezive në tërësi integrale të bëj korrigjime të caktuara, që ndonjëherë mund të mos jenë në dobi të mikrotekstit, por që, gjithsesi, janë në dobi të përmbledhjes, përkatësisht të makro-

tekstit. Korrigjimet e tilla, kuptohet, janë rezultat i fazës së përgatitjes së veprës ose të tekstit në tërësi dhe janë të natyrës *"integrale"*.

Nuk është e rrallë edhe dukuria që një poezi të paraqitet në më tepër se dy variante dhe në raste të tilla është e natyrshme të pritet që ndryshimet, veçmas kur korrigjimet nga varianti i parë deri te i fundit janë më të mëdha, të mos bëhen menjëherë, por gradualisht. Studimi i tyre na mundëson që të njihemi me kohën në të cilën janë bërë korrigjimet e tilla, përkatësisht me historinë e metamorfozave që i përjeton vepra deri në gjetjen e formës së saj më të përshtatshme.

Në shumë variante vërehet se korrigjimet janë aq të vogla, sa nuk është e lehtë që të konstatohet se cili variant paraqet formën më të përkryer të poezisë.

Sido që të jetë, pavarësisht se a përcaktohet për intervenime më të mëdha ose më të vogla, pavarësisht se a bëhet fjalë për intervenime që i referohen semantostrukturës apo fonostrukturës së veprës, me rëndësi është se autori që është objekt i këtij punimi përcaktohen për shkrim nëpërmjet të varianteve, gjë që flet për seriozitetin me të cilin e kupton dhe i qaset punës së tij krijuese.

Dr. NUHI VINCA

PËR NJË BOTIM KRITIK TË NJË POEZIE TË "ALBUMIT" TË NOLIT

Në mars u bënë shtatëdhjetë e pesë vjet nga vrasja e Luigj Gurakuqit dhe gati po kaq vjet jetë po i bën edhe poezia "*Syrgjyn vdekur"* të cilën Noli ia kushtoi bashkëluftëtarit, shokut të pendës e të jetës Luigj Gurakuqit dhe e botoi në "*Liria Kombëtare"* në Gjenevë.

Poezia "*Syrgjyn vdekur"* që nga botimi i parë në "*Lirinë Kombëtare"* të Gjenevës e gjer më sot është ribotuar shumë herë, ashtu siç ngjet me të gjitha poezitë e Fan Nolit. Poezia "*Syrgjyn vdekur"* sa herë që është botuar e ribotuar gjithmonë është dhënë ashtu si e pat shkruar Fan Noli, pos vetëm një vargu që në kontekst të poezisë është kështu:

Se të deshte kur s'të deshnin
Se të qante kur të qeshnin
Se të vishte kur të çveshnin…

Vargu i parë i kësaj strofe haset edhe ndryshe. Konkretisht në veprën "*Mall e brengë"*
të Fan Nolit, botuar në Tiranë më 1943 me një vështrim kritik të Mitrush Kutelit, në faqen 36 është rradhitur poezia "*Syrgjyn vdekur"* e ndërkaq vargu për të cilin e kemi fjalën është botuar kështu: *Se të deshte dhe s'të deshnin…*

Po në këtë përmbledhje në parathënien e Mitrush Kutelit gjejmë këtë citat:

Nga kontraste morale e veprimit, midis tij dhe atyre që e lëftonin dhe që e vranë ngrihet lart fytyra serafike e Luigjit. Ja edhe vargu: Se të deshte kur s'të deshnin se të qante kur të qeshnin, Se të veshte kur të çveshnin etj… Pra, si shihet, në të njëjtën vepër vargu në fjalë paraqitet në dy variante: me fjalëzën (lidhëzen) *DHE e me fjalëzën KUR.*

Në veprën "*Sulm e lot"* Beograd 1963, në faqen 42 po ashtu figuron vargu me lidhëzën *dhe* d. m. th. *(Se të deshte dhe s'të deshnin)* ndërsa në librin "*Ndër bashkëkohësit",* Prishtinë, Rilindja, 1968 në fq. 181 është botuar në variantin tjetër *Se të deshte dhe s'të deshnin.*

Në veprën "*Fan Noli",* botim i Universitetit Shtetëror të Tiranës më 1972 në fq. 13 e gjejmë po këtë varg: *Se të deshte dhe s'të deshnin…*

Në të përditshmen "*Rilindja"* të datës 6. III. 1985 në fq. 14, në rubrikën *Enciklopedia e vogël,* duke iu përgjigjur pyetjes, ku është botuar herën e pare elegjia "*Syrgjyn vdekur"* e Nolit, citohen po ashtu tri vargjet e strofës që kemi në shqyrtim, duke dalë vargu në fjalë me fjalëzën *kur* (Pra: Se të deshte kur s'të deshnin…) Po në

këtë rubrikë të "*Rilindjes"* referohet se botimi i parë i kësaj poezie qe në "*Liria Kombëtare"* dhe se botimi i parë i kësaj poezie del me fjalëzën *kur.*

Duke mos dashur të referojmë edhe burime të tjera se si paraqitet ribotimi i kësaj strofe, përkatësisht se si robotohet vargu për të cilin e kemi fjalën (sepse ka edhe shumë e shumë raste ribotimesh të tjera), do të sjellim përfundimin që është mjaft eksplicit se në poezinë "*Syrgjyn vdekur"* të Fan Nolit një varg i kësaj poezie vazhdimisht po na paraqitet në dy variante. Duke lënë anash tani metodën statistikore se ku e sa herë e si është ribotuar poezia e Nolit, le të ndalemi e ta përimtojmë vargun që na paraqitet në dy variante dhe të pyesim edhe një herë publikisht a thua Noli e shkroi këtë varg: (SE TË DESHTE DHE S'TË DESHNIN)

pra me fjalët *dhe* apo *kur*?

Le t'i qasemi këtij vargu tani në aspektin semantik dhe aspektin strukturor. Si në shumë poezi të tjera, Noli, për strukturim të vargut e merr kontrastin, antitezën; kështu e gjithë strofa katërshe, me varg tetërrokësh e discipline të fortë metrike e poetike ka për figurë bazë kontrastin, sidomos në vargun *Se të qante kur të qeshnin* / *Se të vishte kur të çveshnin.* Duke menduar për vargun e kësaj strofe, vargun dyvariantësh, na imponohet pyetja: cili transponim artistik apo cila poetikë del më e fuqishme: ajo kur dy njësitë semantike lidhen me fjalëzën *dhe* apo ato që lidhen me fjalën *kur?*

Po si u bë që ky varg i paraqitur në dy variante u botua e ribotua sa qe gjallë Noli e pas Nolit e kurrë me sa dime nuk u reagua?

A mos Nolit, me aq akribi shkencore e krijuese t'i ketë shpëtuar ndonjë lajthitje?

A mos vallë në procesin teknik të botimit të parë u bë *dhe* fjalëza *kur* apo thënë më mirë e bënë ashtu, ata që panë ndonjë epërsi estetike te fjala e dytë? Ose si u bë pra që Noli sa qe gjallë nuk e tha asnjë fjalë për këtë ndryshim, për këtë variant. (Edhe pse variante nuk kanë poezitë e nënshkruara apo letërsia e kultivuar, si i thonë, ja që "*Syrgjyn vdekur"* na u paraqit me vite e decenie me një varg të saj dy variantësh. Dhe që të dyja variantet janë të bukura, por ajo që në strukturë të saj e ka mishëruar fjalëzën *kur* gjithsesi e rrit sugjestivitetin, e shquan edhe për një nuancë kuptimore më shumë kontrastin dhe shton intensitetin dhe tenstionin poetik.

Kështu ndërlidhemi me çështjen e botimeve kritike duke sjellë argumente të disa studiuesve tonë si Nasho Jorgaqi, Alfred Uçi etj. Por përveç studiuesve tanë, përmendim edhe studiues të huaj si V. Kajzer, O. Delorko, të cilët nuk e fshehin aludimin e tyre për t'i hyrë punës së ndreqjes së atyre gabimeve që janë bërë nëpër botime të ndryshme. V. Kajzer tekstualisht thotë: " Duhet të armatosemi me mosbesim ndaj të gjitha botimeve që shohin dritën pas kalimit të afatit të garantimit dhe mbrojtjes të së drejtës së autorit. Shpëtimin, si duket, duhet kërkuar duke iu kthyer botimit të parë, që është botimi më i dashur i autorit. Por nuk mundet secili ta lexojë tekstin autentik të ndonjë vepre. Mjafton të lexojmë ndonjë botim të ri që na e sjell tekstin autentik. Një botim i tillë quhet botim kritik " *(V. Kajzer, Jezicko umetnicko delo, SKZ, Beograd, 1973, fq. 26) (Vepra gjyhësore artistike.)*

Ka ardhur koha, pra, që edhe ne të kemi botime kritike, t'i përmirësojmë gabimet e botimeve tona, duke shkuar kështu dy hapa para, pa harruar një hap kthimi pas për të parë frytet tona me sy kritik.

Msc. SKËNDER KARRIQI

RASTI PROMETEIK NË POEZINË E FAN. S. NOLIT

Një dukuri pak apo aspak e studiuar në letërsinë shqipe është prometeizmi, një tipar që e karakterizon atë që nga fillimet filobiblike e deri sot.

Krijimtaria si flijim, dhimbja si burim frymëzimi dhe kulti i ardhmërisë, janë tri hapësirat tematike ku gjen shprehje përmbajtësore kjo dukuri, ndërkohë që shenjohet edhe me trajta gati të standardizuara, të konsoliduara më parë në poetikën romantike evropiane dhe në këtë kontekst kulturor, të reflektuara edhe në letërsinë shqipe.

Rasti i porzisë së Fan Nolit është i veçantë, si shprehje e kushtëzimit rastësor (okazional) të saj. Më shumë se për çdo autor, në poezinë e Nolit (dhe jo vetëm në poezi), vërehet prania e elementit autobiografik në kuptimin e rastit, rrethanës, që e lind dhe e motivon poezinë e tij (dhe jo vetëm atë). Në këtë kuptim poetika e tij është e lidhur me imazhin e heroit prometeian në raporte ndriçimi, nxitjeje dhe kushtrimi me masat: rebel, i dëbuar politik, i vetmuar në brigje lumenjsh me dhimbjen e tij: një herë ëndërrimtar i pashpresë dhe një herë endërrimtar me besë e shpresë.

Poetika noliane pra është poetika retorike që hedh dritë dhe i jep vëzhgueshmëri përjetueshmërisë prometeike të heroit lirik (politik), përndryshe autorit. Është pikërisht ky aspekt i kësaj poetike që kushtëzon vetën e parë të shprehjes dhe kontekstin e nëntekstin rastësor (okazional), si veçori të një letërsie të këtillë, që dukshëm ka të bëjë me angazhimin dhe protagonizmin social-politik të Nolit, të këtij Krisht-Prometeu, që vjen si i tillë, sidomos nëpërmjet ciklit poetik me motive biblike.

* * *

Në kuptimin e një letërsie rastësore (okazionale), ajo e Nolit mund të mos shkruhej fare, ose në përputhje me rrethana të tjera, s'do të ishte kështu siç e kemi sot. Që u shkrua si e tillë, ajo qe produkt i rastit si rrethanë politike dhe si rrethanë kulturore. Rrethana politike përcaktoi raportin prometeik të heroit (autorit) me masat. Rrethana kulturore, si horizont pritës dhe si pjesë e identitetit kulturor të heroit (përndryshe autorit), përcaktoi mënyrën letrare të motivimit, zgjedhjen e motiveve dhe përshtatjen e figurave (personazheve) referenciale në masën e shtatit të vet autorit. Po, ndodh edhe kështu: me tekstilin kulturor të kohërave, të dizenjuar me fragmente suksesive ngjarjesh ku spikasin heronj simbolikë, autori të presë robën e vet, kostumin e vet, me të cilin ai do të hyjë i veshur në historinë politike dhe kulturore të një vendi. Kjo mund të ndodhë me heroin që, përveçse protagonist politik, është dhe protagonist letraro-kulturor. Ky është rasti edhe i Fan Nolit, i cili pozon në muzeumun politik dhe kulturor shqiptar veshur me kostumin prometeik.

Në fakt të krijohet përshtypja e një mospërputhjeje në lidhje me çka artikuluam më lart. Duket sikur faktet letrare flasin kundër nesh: Fan Noli, përkthyesi i madh shqiptar në gjuhën shqipe përktheu vetëm 34 vargje nga tragjedia *Prometeu i*

*mbërthyer*e Eskilit. Ndërsa heroin mitik Prometeun, e përmend vetëm një herë, në ciklin strofik *Tallja përpara kryqit,* në rastin e Ariosit[88], kur ky i drejtohet Krishtit në kryq me fjalët: *Do të të them që s'ke qenë përveç se njeri/ Se kjo vojtje s'ka hije për një perëndi. /Këtë prallë pagane ia fal Shën Thanasit, / Më kujton shum a pak Pometen' e Kafkasit. /*[89]

Në koment të këtyre dy rasteve do të thoshim se, gjithsesi, ata kanë domethënien e tyre të interpretueshme në lidhje me rastin prometeik të poezisë së Nolit.

Rasti i parë, ai i përkthimit të vetëm 34 vargjeve nga "*Prometeu i mbërthyer"*, është një përzgjedhje jo rastësore, as një punë e filluar (për përkthimin e tragjedisë) dhe e lënë në fillim të fillimit. Përkundrazi, përkthimi këtyre vargjeve është bërë *sipas rastit* të ndjeshmërisë dhe përjetueshmërisë prometeike të autorit të përkthimit, në raport me *rastin* autobiografik të tij. Në shënimet redaktoriale të *Veprës 1* të Nolit, (botimi i Akademisë), shkruhet se ky përkthim është botuar për herë të parë në vitin 1948, në *Albumi 1*[90]. Në këtë vit, në një distancë kohore prej 24 vjetësh, (duke marrë si referencë kulmore të aktivitetit të tij Revolucionin e Qershorit, që në kuptimin e rastit, rrethanës, do të kushtëzonte krijimtarinë poetike, por edhe përkthimet), Noli zgjodhi pikërisht këto 34 vargje të tragjedisë eskiliane si pasqyrë për të parë profilin e vet prometeik. Kjo është mundësia e heroit të iluminuar. Si i tillë, nëpër faqet e kulturës botërore ai do të haset edhe me profilin e vet heroik, me të ngjashmin e vet, ku do të gjejë sigurinë e statusit dhe të ekzistencës. Dhe akti i tij ekzistencial është t'u tregojë njerëzve për të cilët u sakrifikua, arketipin e vetë literal, ndaj e përzgjedh atë, e ndriçon, ashtu siç bëri Noli me përkthimin e *Promete*-ut të Eskilit, duke e sjellë atë në shqip vetëm në një fragment të pjesës prologjike, dhe pikërisht në ligjëratën urdhërore të *Përdhunës* (Në variante të tjera është përkthyer *Pushteti*), ndaj Hefestit, ku ndër të tjera portretizohet Prometeu në këndvështrimin olimpik, si mëkatar njeridashës, dhe ligjëratën e Hefestit, ku portretizohet Prometeu në këndvështrimin humanist, njeridashës. Me sa duket, kështu e përjetonte profilin e vet historik Noli, me këtë pamje të dyzuar prometeike, parë në këndvështrime jo thjesht të ndryshme, por të përkundërta politiko-shoqërore. Kjo përjetueshmëri si e tillë shenjohet pikërisht me kuptimin e përkundërt (antonimik) të aktit të njeridashjes: njeridashjes si helm në ligjëratën e Përdhunës (*Dhe heq dorë nga helm' i njeridashjes*)[91]dhe njeridashjes si akt human në ligjëratën e Hefestit (*Këto t'i solli vepr' e njeridashjes*)[92]. Kundërvënia kuptimore (njridashja) *helm* dhe (njeridashja) *vepër*humane nuk ka të bëjë me fjalën, por me këndvështrimin e përkundërt, i cili përshtatet lehtësisht me kontekstin politiko-shoqëror, si rast, si rrethanë, që motivon autorin përkthyes (përshtatës). Në këtë kuptim dhe përkthimi I Nolit, *helm' i njeridashjes*, përkundër *vepr' e njeridashjes*, ka funksion ndriçues në lidhje me profilin humanist, njeridashës, pra prometeik të Nolit.

---

[88]…ose Ari, prift i Aleksandrisë (s'i dihet data e lindjes-vdiq më 336. es). Ishte themelues i sektit të arianizmit, i cili mohonte doktrinën e krishterë mbi thelbin e njëjtë të trinisë, por edhe karakterin hyjnor të Krishtit.

[89]*Tallja përpara kryqit.*. F. S. Noli, Vepra 1, botim i Akademisë së Shencave, 1988, fq102

[90]F. S Noli. , Vepër e cituar, fq365

[91]F. S Noli, *Prometeu i mbërthyer.* Fragment përkthyer nga Eskili. Vepër e cituar, fq 245

[92]Po aty

Rasri i dytë kur përmendet Prometeu, ai i të tallurit të Ariosit përpara kryqit, është një rast i distancuar i Nolit nga mendimet e priftit themelues të arianizmit, jo për arsye doktrinare fetare, por thjesht për arsye teknike të realizimit të marrëdhënies së rrëfyesit me personazhin, marrëdhënie që në këtë rast është bërë sipas teknikës së komentit psikologjik, në zbatim të së cilës autori në rolin e rrëfyesit, heq dorë nga zotërimi dhe përdorimi i informacionit në favor të *pushtetit të vet*. Përkundrazi, sipas kësaj teknike që në traditën e poetikës romanore e hasim tek Dostojevski, personazhet, në mënyrë të pavarur nga rrëfyesi, zotërojnë informacion aq sa, ose më shumë se autori duke qenë të pavarur nga ai dhe duke mundësuar kështu dukurinë e *polifonisë së zërave*. Veçoria e Nolit ka të bëjë me faktin se ai mbështetet jo mbi dijen tërësore të personazheve, por mbi këndvështimin e tyre, që në këtë rast shërben edhe si material portretizues për të na dhënë një polifoni zërsh si polifoni tipash. Ky do të ishte këndvështrimi formalist i trajtimit të problemit.

Në këndvështrimin përmbajtësor, tallja e Ariosit përpara kryqit na çon në shekujt paraprirës të Mesjetës, kur ndaj Prometeut si figurë mitologjike (pagane), do të ushtrohet një presion i madh ideologjiko-fetar për ta eklipsuar, me qëllim që t'i hapej rrugë në bashkësinë e simboleve referencialë Jezu Krishtit, heroit të ri mesianak. Paralel me këtë model kundëvënieje, po gjatë Mesjetës e në vazhdim, gjatë Rilindjes Evropiane, do të shihen edhe përpjekje për ta integruar figurën e Prometeut në kristianizëm. Gjatë periudhës romantike prirja për t'i pajtuar këto dy figura (Jezuin me Prometeun) do të jetë më e fuqishme, veçse do të rezultojë jo me integrimin e Prometeut në kristianizëm, por në të kundërt, me integrimin e Jezu Krishtit në titanizëm, në familjen ku bënin pjesë Tantali, Atlanti, Titiosi, Satanai, Sizifi, Orfeu dhe Prometeu[93].

Përbashkimi në këtë mënyre i këtyre figurave i njëson dhe i bën ato të këmbyeshme në përdorimin simbolik për të shprehur qëndrimin dhe energjinë titanike të heroit lirik (përndryshe autorit), në argumentim të statusit, duke e projektuar veten në masën e këtyre heronjve titanë, e lidhur kjo edhe me rastin autobiografik. Kështu imazhit kristian të Jezuit romantizmi evropian do t'ishtojë edhe profilin e rrebelit, e mëtej jo vetëm sakrifikues por edhe reflektues ndaj mosmirënjohjes dhe moskuptimit njerëzor, ndaj distancës tragjike ndërmjet heroit (në rastin tonë Prometeut), dhe njerëzimit (masave).

Me sa duket, për Nolin, njohësin dhe lexuesin e rregullt të letërsisë europiane, dhe jo vetëm europiane, shkrirje të tilla kulturore, që sjellin profile të reja të heronjve simbolikë, jo vetëm ishin të njohura, por edhe i vinin përshtat komunikimit artistiko-letrar të tij me lexuesin, të cilin ai e ka parasysh edhe si lexues politik, që, si i tillë, do dhe duhet të sqarohet për rastin politik (për disa, rast aventurier revolucionar), të tij (Nolit). Pikërisht duke qenë në argumentim dhe komunikim të statusit dhe rastit të tij, Noli konceptoi më herët një Moisi-Promete e më pas një Krisht-Promete, e thënë edhe njëherë, në masën e shtatit të vet historik.

[93]Raymond Trousson. *Le thème de Promèthèe dans literature europèenne*. Librarie DROZ. Genève 2001.

Ndjeshmërinë prometeike të Nolit, në pikëpamje përmbajtësore, si dhimbje e rëndë për vdekjen e njeriut, (përkatësisht vajzës së re), me të cilin (të cilën) poetin nuk e lidh asgjë intime, e vëmë re para se ai të trajtonte motivet biblike, që në një poezi të hershme të tij, të titulluar *Fry moj erë,* botuar në gazetën *Kombi*, 25 janar 1907[94].

Përveç të tjerash, në këtë poezi, ndjeshmëria prometeike, përkatësisht dhimbja për njeriun, do të sendërtohet në pikëpamje të formës si marrëdhënie në një distancë perspektive majëmali e poetit me objektin poetik të rrëfyer, përkatësisht tragjedinë e vajzës, sikurse vihet re në vargjet:

- Nga na vjen, moj erë e rreptë? / .../-Vinj drejt nga malet e Shqipërisë/.../Syri m'u err nga ato që pashë. / Atje tek losnja në fush' të Korçës, / ... /një qivur pashë me nj' çup' të virgjër, / ma vrau shpirtin ay filis. / Tokat pushonin, prift nukë dukej. / E pakënduar na u varros: / Mihnë dëborën, i bënë varrë, /.... /. [95]

Distanca perspektive ***mal***(*malet e Shqipërisë*) - ***fushë***(*nëfush' të Korçës*), është hapësira informative e heroit lirik të sublimuar në majëmalin (vend) dominues për së larti e për së gjeri. Ky këndvështrim perspektiv i hapësirës informative pa dyshim që është i lidhur me karakterin panoramik e deri telegrafik të vargjeve të cituara, ku mendojmë se fjalët kyçe janë: *malet* (e Shqipërisë), *fush*' (e Korçës), (prift) *nuk dukej*.

Arketipin e kësaj distance perspektive majëmali të poetit me objektin poetik, Elise Radix e gjen tek miti i Prometeut dhe më pas e argumenton të reflektuar në poezinë romantike evropiane tek *Meditime poetike* të Lamartine-it, *Moisiu* të Alfred dë Vigny, *Oberman* të Senoncour, *Shpella e Islandës* dhe *Punëtorët e detit*, të Hugo-it etj[96].

* * *

Cikli i motiveve biblike në vëllimin *Album* të Nolit (1948), hapet me poezinë "*Mojsiu në mal"*. Ndërkohë që në *Vepra1* të Nolit, (botim i Akademisë), ne njihemi me një variant tjetër dhe kemi mundësi të konstatojmë diferencat ndërmjet variantit të botuar dhe atij të korrigjuar, në librin "*Mall e brengë"*, të përgatitur për botim dhe të shoqëruar nga *Një vështrim kritik* mbi 7 poezi dhe disa shqipërime të Nolit (poezi, fragmente tragjedish, rubai), nga Mitrush Kuteli, ne njihemi me një variant tjetër të poezisë "*Mojsiu në mal"*, i cili përbëhet prej 5 strofave të para *mot á mot* të variantit të botuar në "*Album 1"*. [97]

Pikërisht këtë variant 5-strofësh analizon Kuteli në *Vështrimin kritk*, të përmbledhjes së cituar më sipër, duke e zgjeruar analizën edhe në planin komparativ, përkundrejt poemës së Alfred de Vigny-së, me titull *Moisiu*. Ndër të tjera, për këtë poezi Kuteli në krahasim e sipër, thotë se ajo *ka sulm heroik*[98], përkundrejt poems së Vigny-së, që *ka ondulacione lirike*[99]. Me sa duket, këtë *sulm heroik,* kritiku e argumenton me *fazën*

[94] F. S Noli. Vepër e cituar, fq 61
[95] Nga poezia e cituar më lart (Fry moj erë)
[96] Elise Radix. *L'homme-Promèthèe vainqueur au XIXe siècle. L'Hartman 2006. , Paris*
[97] *Mall e brengë*. Tiranë, 1943, fq 43.
[98] Vepër e cituar. *Një vështrim kritik*
[99] Po aty

heroikeoptimiste[100]të Moisiut, të cilën e sheh vetëm në dy vargjet e para të strofës së parë, (*Ngjitet përpjetë Malit të shkretë/ Krye-Profiti trim me fletë/*), që për këtë arsye edhe i veçon në *Vështrimin…* e tij. Në fakt ideja e sulmit heroik mund të shihet në një plan më të gjerë, si veçori përmbajtësore e gjithë poezisë. Ajo (ideja a sulmit), do të tingëllonte e pambështetur pa kundrinën (poetike), dhe si e tillë në rastin konkrejt është *Perëndia,* sikurse mund të shihet në strofën e plotë: *Ngjitet përpjetë Malit të shkretë/ Krye-Profiti trim me fletë, /Të bisedojë me Perëndinë/ Për Palestinë/.* Pra ideja e sulmit heroik zgjerohet dhe me imazhin e përballjes (prometeike) të heroit me Perëndinë, imazh ky i mbështetur fuqishëm dhe nga strofa e pestë e variantit referues të Kutelit, si dhe nga 4 strofat që mungojnë në këtë variant[101]. Madje në argumentim të idesë së përballjes (prometeike), duhet të përmendet edhe fakti që në dorëshkrim, në strofën e parë është *Liberatori trim me fletë*, në vend të *Krye-Profiti trim me fletë*. Emri *Liberator* është në përputhje me idenë e përballjes (prometeike), por autori, me sa duket, e përdor atë në fund të poezisë duke zëvendësuar në dorëshkrim: *…/Ajme, sa vrer, sa keq e sa zor, / Moisi! /,* me*…/Ajme, sa vrer, sa keq e sa zor, / Liberator!* / për të dhënë idenë e një rritjeje të shkallëzuar të Moisiut, gati deri në shndërrim, nga një figure biblike pasive, në një figurë social-politike aktive, plotësisht në masën e modeleve prometeike europiane në kërkim të lirisë, njeri prej të cilëve është *Moisiu*i Vigny-së. Kjo dinamikë rritëse e heroit kushtëzohet padyshim edhe nga rasti autobiografik i autorit

Kuteli bën fjalë vetëm për fazën heroike optimiste të heroit, aksioni i së cilës (fazës) është: *Ngjitet përpjetë Malit të shketë/ Krye-profiti trim me fletë, /.* Por ç'u bë me heroin? Mos vallë ai u deheroizua në mënyrë qesharake? ! Pas tronditjes dhe kërkesës *formale* të mëshirës, vjen faza heroike tragjike e heroit, e sendërtuar artistikisht në vargjet: "*Pse kaq gjatë Zot m'arratise? / Pse më përplase, më përpëlise? / Pse shpresën dyzet vjet m, a yshqeve/ dhe sot m'a preve? "/... "NemDhen' e Lirë! Zot ku ma ke? "/.../*[102]. Këto vargje, që vijnë pas vargut: *…/ I lyp mëshirë. /* të futur formalisht në thonjëza, duket sikur janë vargjet me të cilat kërkohet mëshirë, por në fakt, nga ana kuptimore janë shumë larg kësaj ideje. Në të kundërt, ato janë vargje që bartin idenë e përballjes me fjalë, përballje kjo që arrin deri në nivelin e kërkesës së llogarisë në emër të palestinezëve, për vuajtjet e tyre. Këto tone përballjeje vijnë pas artikulimit të dënimit hyjnor, përmasat fatale dhe tragjike të të cilit i kupton dhe i ndien në mënyrë përfaqësuese vetëm Moisiu, falë pozicionit të tij dominant sublimues në majëmalin e Nebos, nga ku së largu dhe së larti, (me anë të distances perspektive), *…/ Sëlargu Zoti ia pasqyron, / Dhe e shikon. /*[103]atdheun e mohuar. Kjo është faza heroike tragjike e Moisiut që kulmon me përballjen prometeike përkundër Zotit dhe vijon me dhimbjen për shkak të dënimit të humanëve, vuajtjes për ta se s'donon lirinë (*Se liris'doni*). Rasti i poetizuar prometeik i Moisiut është rasti i Nolit, të cilit për çka bëri në lidhje me emancipimin politiko-shoqëror të shqiptarëve në vitet '20-të, iu

[100]Po aty

[101]Shih *Album* (1948) në *Vepra 1,* Botim i Akademisë, 1988, fq72.

[102]Vargu i fundit nuk është në variantinreferues të Kutelit

[103]Varianti ibotuar në*Album 1* (1948) *Vepra 1*. Botim i Akademisë (cituar)

mohua atdheu. Gjithashtu ky është rasti prometeik i Nolit të dënuar, sepse nuk u kuptua nga njerëzit (masat) projekti i tij i lirisë.

Në lidhje me përmasën prometeike, sendërtuar në përballjen e heroit (Moisiut), poezia e Nolit është e krahasueshme paraelel me poemën *Moisiu* të Vigny-së ku Elise Radix ve re të njëjtën gjë tek heroi: përballjen me Zotin, por me qëllim për të kërkuar përgjigjen pyetjeve me rëndësi ekzistenciale për njerëzimin. Këtë paralele prometeike ndërmjet dy krijimeve poetike s'kishte si ta vinte re dhe ta artikulonte Kuteli, i cili në vitin 1943 i referohet një varianti të reduktuar pikërisht në ato strofa që e mbartin më së shumti idenë prometeike.

Rasti prometeik në poezinë e Nolit vjen edhe në modelet e tri poezive të tjera me motive biblike. Është fjala për "*Marshi i Krishtit"*, "*Krishti me kamçikun"* dhe "*Marshi i kryqëzimit"*. [104] Siç e kemi thënë gjetkë në këtë kumtesë, Noli e njihte lidhjen e ngjashmërisë ndërmjet figurës së Prometeut dhe Jezu Krishtit dhe me siguri që ai ka njohur edhe veprën e romantikëve e cila e integron këtë të fundit (Jezu Krishtin), në titanizëm duke e bërë të këmbyeshëm me figurat e tjera rebele, sidomos me Prometeun. (Të dy i lidh akti vetëflijimit për njerëzit). Në këto rrethana, me sa duket për të komunikuar me simbole të njohura prej lexuesit, siç ishte Jezu Krishti, përkundër Prometeut të panjohur, por ndoshta edhe për të ruajtur staturën e njeriut të Kishës, institucionit që distancimin prej Prometeut e kishte doktrinal, Noli shkroi *Marshi i Krishtit,* e cila në vetvete është modeli i poezisë ku heroi (në rastin tonë heroi biblik, Jezu Krishti), rindërtohet sipas profilit prometeik të heroit lirik, përndryshe autorit, duke vijuar kështu poezinë (okazoniale), sipas rastit, kuptuar ky si rrethanë. Ky rindërtim i imazhit të Jezu Krishtit vihet re që në titull, e më tej konsiston në ngushtimin e përmasave globale të qëllimit të veprës mesianake duke i përshtatur termat me imazhin e ri të heroit. Kështu titulli *Marshi i Krishtit* reflekton rindërtimin e imazhit biblik të Jezu Krishtit, përkundër temperamentit të qetë dhe pacifik të tij në bibël, si të vrrullshëm përgjatë gjithë poezisë, që do të thotë se rindërtimi bëhet sipas ritmit të brendshëm të heroit lirik, Nolit, ritëm me të cilin ai deshi të ndryshonte (revolucionarisht) Shqipërinë e viteve 20-të. Qëllimi mesianak i Krishtit të Nolit është: *Kryetrim që lëfton, triumfon për atdhe*[105], pra siç shihet, i ngushtë përkundër qëllimit global të Krishtit biblik, dimension ky i fituar me përhapjen e përbotshme të Kristianizmit duke tejkaluar dimensionin lokal të Krishtit si i dërguar për popullin e Izraelit. Në përputhje me qëllimin e Krishtit të tij prometeik që e ndien brenda vetes të lidhur dhe me rastin autobiografik, Noli përshtat terma të tillë si: *çlironjës, kryetrim, lëfton, triumfon, Njeri- Perëndi*, (përkundër *Mesi* që ka të njëjtin kuptim, por e thënë kështu, e mban imazhin e Krishtit branda kornizës fetare dhe kjo nuk i shërben rindërtimit), *kryemjek, kryeshenjt, kryefe*, që janë pikërisht të tilla që rindërtojnë imazhin e ri prometeik të Krishtit.

Poezia *Krishti me kamçikun*[106]është e modelit *spekulativ* me lëndën biblike. Në qoftë se në poezinë e parë (*Marshi i Krishtit*), vinim re modelin e rindërtimit të imazhit të

[104] F. S. Noli. Vepër e cituar

[105] *Marshi i Krishtit.* Vepër e cituar, fq 74

[106] *Krishti me kamçikun*. Vepër e cituar, fq 75.

heroit, në poezinë e dytë vëmë re zgjerimin *spekulativ*, në përmasat e Atdheut (për qëllime të krijimit dhe komunikimit artistik), të vendveprimit të heroit (biblik), ndërkohë që burimi (biblik) përcakton si vend veprimi faltoren. Në vargun e parë të strofës së parë atdheu dhe tempulli, formalisht vihen në marrëdhënie varësie përcaktuese *(tempulli i fesë- kështjella e Atdheut*)[107], ndërsa në vargun e katërt të strofës së pestë[108], aksioni i Krishtit *çlironjës* ka vendveprimi dhe kundrinë (poetike) Atdheun *të çliruar* nga imazhi *i ngushtë* i tempullit. Një imazhi të tillë i ka paraprirë dhe shkallëzimi zbritës i dy nocioneve të vëna formalisht në lidhje varësie përcaktuese (*kështellë…-tempull…)*. Rasti prometeik në këtë poezi ka të bëjë me fatin tragjik të idealistit që mendon drejt, se lirinë e sjell *drita e mendjes dhe jo druri*. Në idealizmin e vet tragjik, Noli e ve heroin në raport me Shën Pjetrin, (ndaj të cilit heroi është mosbesues), *dhe larove, sarafëve, trathtarve* (*dinakë e kusarë*), ndaj të cilëve heroi biblik është i mundur tragjikisht, i huaj me idealin e vet të dritës që sjell lirinë në kuptimin e gjerë metafizik të fjalës.

Ndërsa poezia *Marshi i Kryqësimit, [109]* është e modelit të ironisë tragjike, ku rasti prometeik konsiston (për ironi tragjike), në aktin e dënimit të heroit nga njerëzit, pikërisht për të mirat që ai (heroi) u kishte bërë atyre (Krishti *i çliron, i forcon, i shëron, i ndriçon, i do, urren tiraninë, vetmohohet për ta, u ndreq shtrembërinë, nuk punon për sherr, nuk punon për gjakmarrje, punonpër vëllazërim, nuk rren, beson në zgjimin e mendjes dhe jo në përdorimin e armës*). Pë këto të mira Krishti-Promete ishte i huaj dhe tragjikisht i moskuptuar për njerëzit të cilëve u shërbeu. Në këtë kuptim kjo poezi (dhe jo vetëm kjo) të kujton ndiesinë prometeike të pamundësisë, me të cilën De Rada do të shenjojë vetveten: *Tani për tani unë eci në* ***via exulius****. [110] Përpjekjet për ta bërë të njohur Shqipërinë duke e lidhur me Italinë, i shoh të më shkërmoqen nëpër duar…****Pamundësia është mbështjella që i hengri zemrën Prometeut, por nuk më ka përkulur.*** [111] Kjo pamundësi është edhe rasti prometeik i Nolit, që e percepton tragjikisht si të tillë fatin e vet revolucionar.

Studimi tërësor i rastit prometeik në poezinë e Nolit do të trajtohej plotësisht me identifikimin e kësaj dukurie në poezi të tjera të autorit si: *Himni i Flamurit, Syrgjyn-vdekur, Shpell' e Dragobisë, Rent, or Maratonimak! , Anëslumenjve*. Madje në këtë drejtim mund të arrihet deri në studimin e përkthimeve *sipas rastit* të shumë kryeveprave të letërsisë botërore, të përkthyera nga Noli.

Jo vetëm gjerësia e lëndës, e cila shkon përtej limiteve të një kumtese, por edhe mënyra e konceptimit dhe argumentimit të rastit prometeik në poezinë e Nolit(për sa u tha në këtë kumtesë) e lënë të hapur shtegun për të argumentuar në këtë mënyrë edhe më tej poetikën e energjisë noliane, si një shenjë e personalitetit të poetit dhe më gjerë, si një shenjë që e karakterizon mbarë poezinë shqipe.

---

[107] */Në kështjellë t'atdheut, në tempull të fesë/* Vepër e cituar dhe poezi e cituar fq 75.

[108] Po aty…

[109] Po aty… fq 81.

[110] Rrugë pa krye. Lat

[111] E. Koliqi. Ese letrare, botim i IDK. Citohet De Rada nga *Carteggio, De Rada- De Gubernatis*

YLLKA KËNAÇI, LAURETA DHOSKA

FAN S. NOLI SI PËRÇUES I FRYMËS PERËNDIMORE NË LETËRSINË SHQIPE

Për të evidentuar në mënyrë sa më të plotë rëndësinë e përkthimeve të F. Nolit, për kohën kur ato iu servirën lexuesit shqiptar, por edhe më tej, çka përbën objektin e kësaj kumtese, e shoh të arsyeshme të cek së pari çështjen e përkthimit dhe rolit të tij në procesin letrar. Në përkufzimet e përgjithshme përkthimi është konceptuar si mjet esencial komunikimi me një vepër të huaj, mjet që e bën te mundur takimin e letërsive e kulturave kombëtare me njëra-tjetrën e rrjedhimisht edhe qarkullimin e vlerave të letërsisë së përbotshme. Diskutimet lidhur me përkthimin përqëndrohen në shkallën e përfshirjes së tij në sistemin e pritjes. Yves Chervel në tekstin "Letërsia e krahasuar" ngre si problem faktin se të përkthesh, të botosh një përkthim, nuk do të thotë të kryesh vetëm një veprim gjuhësor, do të thotë, gjithashtu, të marrësh një vendim që vënë diskutim një ekuilibër kulturor dhe shoqëror. [112]Kështu duke u gjendur përballë kërkesës për ta bërë tekstin tërësisht të komunikueshëm e të pranueshëm nga sistemi i pritjes, përkthyesit i duhet të përekthejë, veç të tjerash, edhe kontekstin social e kulturor nga i cili buron vepra, por hera-herës edhë botëvështrimin e krijuesit të saj, në mënyrë që ky tekst të zërë vend si pjesë e traditës letrare e kulturore në vendin pritës. Kështu një tekst letrar, nëpërmjet përkthimit, komunikimit me një masë shumë më të madhe lexuesish, nuk mbetet më brenda kufijve të një letërsie kombëtare, por bëhet pasuri kulturore e mbarë njerëzimit, e asaj që Gëte do ta emërtonte "letërsi e përbotshme".

Në këtë mënyrë vepra e përkthyer shërben si një faktor i rëndësishëm në zhvillimin e procesit letrar, pasi bën të mundur pasurimin e përvojës letrare edhe evoluimin e vlerave artistike. Siç do të shpreheshin formalistët rusë, ndryshimet në letërsi nuk varen më shumë nga rrethanat personale e psikologjike të një autori, por nga format paraekzistuese të letërsisë. Pra, një vepër letrare lidhet me letërsinë në përgjithësi dhe autori (krijuesi)është një ekspert në punën e tij. [113]

Të përkthyerit mund të shihet edhe si një privilegj ndaj tekstit që bëhet pjesë e këtij procesi, pasi do të thotë se më parë ai i është nënshtruar përzgjedhjes në radhën e veprave më të arrira e të vlerësuara, gjithashtu kjo vepër do të servirë risi në sistemin e vlerave ku do të vendoset do t'i vijë në ndihmë zhvillimit të kulturave të tjera.

Lidhur me ndikimin e përkthimeve në letërsinë shqipe, mund të flasim për një traditë të nisur nga K. Kristoforidhi dhe të themeluar prej Fan Nolit. Atëherë le të shohim se çfarë ndihmese i dha F. Noli kulturës dhe letërsisë shqiptare? Si ndikuan përkthimet e tij në zhvillimin e procesit letrar?

---

[112] Yves Chervel, *Letërsia e krahasuar*, Albin, Tiranë, 2002, faqe 25

[113] Anne Jeferson, David Robby, *Teoritë letrare moderne*, Albas, Tiranë, 2006, faqe 53

Lidhur me fushën e përkthimit dhe mendimit kritik Fan Stilian Noli ka meritë të shumëfishtë ndaj lexuesit shqiptar pasi është ndër të parët personalitete të kulturës sonë që bëri të mundur njohjen me kryeveprat e letërsisë botërore. Lista e veprave që përktheu e që i projektoi për të përkthyer përmban tituj të cilët shënuan kulminacione e kthesa të mëdha në historinë e letërsisë botërore siç janë: "Jul Qesari", dramat "Armiku i popullit"e "Zonja Ingra e Ostrotit"të Henrik Ibsenit, romani "Don Kishoti i Mançës", të gjitha vepra, të cilat Noli i rekomandon "në mes të njëzet a tridhjetë kryeveprave, te cilat nuk duhet të vdesë njeriu para se ti këndoje"[114]. Noli i solli këto perla të letërsisë botërore në një çast vendimtar për letërsinë shqiptare. Është koha, kur letërsia jonë po kapërcente fazën e "fëmijnisë"së saj dhe po hynte në një faze të re zhvillimi ku tentohet të forcohet kultura letrare e shkrimit. Karakteristikë e kësaj shkolle (nëse do të përdornim termin që përdor S. Hamiti duke e quajtur Shkolla kritike) është braktisja e tendencave himnizuese e glorifikuese për të kaluar në modelin kritik ku spikatin temat sociale që vijnë duke u bërë gjithmonë e më kritike. Kontakti me vepra të tilla që mbartin ide të mëdha e problematika universale, jo vetëm mbush një zbrazëti të madhe në përvojën letrare të deriatëhershme, por i jep liri zhvillimi dhe ushqen me vlera të reja letrarët shqiptarë.

Në këtë pikë Noli ndjek rrugën e Rilindësve shqiptarë të cilët mishëruan në veprat e tyre idetë iluministe e humaniste, veçse prurjet e tyre kishin karakterin oriental, ndërsa përkthimet e Nolit mbartnin frymën perëndimore. Vet Noli deklaron se frymëzimet i kishte te Rilindësit shqiptarë, ndërsa mësues të mëdhënj kishte autorët që përkthente. Edhe fuqinë kritike të interpretimit të letërsisë e shfaq në fillim duke ballafaquar kriteret e veta letrare me kryeveprat e përkthyera. [115]

Epoka e humanizmit dhe e Renesansës së cilës iu referua Noli është padyshim një nga periudhat më të frytshme të kulturës dhe të letërsisë botërore nëtërë historinë e saj. Në periudhën kohore për afro dy shekuj sa zgjati ajo, popujt e Evropës përjetuan një zhvillim të hovshëm kulturor një rilindje të vërtetë shpirtërore. Historiani frëng Zhyl Michele i cili njihet edhe si kumbar i Renesansës e ka quajtur humanizmin dhe renesansën "epokë te zhvillimit të njeriut". [116]

I mbrujtur me një formim intelektual e kulturor të admirueshëm, i gjendur në një situatë të trazuar politike e përballë një realiteti me shumë probleme që vinin si pasojë e prapambetjes shekullore, Noli u vetëdijësua se rruga e zhvillimit dhe e ndriçimit shpirtëror do të ishte e vështirë dhe do të kërkonte shumë punë intelektuale. Duke u gjendur në udhën midis predikuesit dhe vepruesit (prijës shpirtëror dhe prijës politik) dhe duke pasur një formim kulturor kundërthënës Noli e pa Shqipërinë me syrin e idealistit dhe u përpoq ta ndryshojë me veprimet e realistit. Me sa duket Nolin e shqetëson po aq sa varfëria botëkuptimore edhe varfëria kulturore e jetës shqiptare. I ndodhur në këto kushte dhe në një fazë historike kur letërsia ishte një art me funksion shoqëror, më tepër sesa me funksion estetik, Noli si shkrimtar militant i përdor shqipërimet dhe zgjedhjet e veta artistike për të frymëzuar tek lexuesi ide

[114] F. S. Noli, *Vepra 5*, faqe 24
[115] S. Hamiti, *Letërsia modern shqipe*, Prishtinë, faqe33
[116] A. Vinca, *Panteoni i ideve letrare,* Camaj-Pipa, Shkodër, faqe 106

emancipuese. E kush do t'i nevojitej më tepër se sa Shekspiri e Servantesi lexuesit shqiptar në një periudhë të tillë kur ishte nën ndikimin e rendit feudal dhe mungesës së utopisë.

Për këtë arsye përkthimet e Nolit janë më tepër shqipërime brenda të cilave ka edhe përshtatje të cilat kohët e fundit kanë shkaktuar edhe polemika dhe kërkesën për t'i ripërkthyer këto vepra. Por ajo që paraqiti më tepër rëndësi është fakti se Noli i serviri lexuesit shqiptar nëpërmjet këtyre kryeveprave modelin e artit të madh. Në këtë mënyrë ai kultivon shije estetike, prirje artistike, ushqen procesin krijues me modele shkrimi të cilat mendimi kritik botëror i ka vlerësuar si më të përsosurat artistikisht. Romani i Servantesit "Don Kishoti i Mançës"ishte konsideruar nga kritika botërore e deriatëhershme si një ndër prozat më të realizuara dhe që ofronte shumë lexime e interpretime. Pavarësisht ndërhyrjeve që bën, pasi Noli është i prirur për përkthime-rikrijime, thelbi filozofik dhe kumtimi i mesazheve të veprës mbetet i paprekur. Tek e fundit paralelet e konteksteve sociale ai i gjen në problematikën që këto vepra mbarin, në luftën kundër pushtetit tiranik, në luftën kundër rendit feudal, në afirmimin e personalitetit të njeriut, çështje që preokuponin edhe realitetin shqiptar. Filozofia e "donkishotizmit" dhe "hamletizmi" gjenin shprehje më mirë se kudo në epokën e trazuar në të cilën jetoi e krijoi Noli.

Noli si përkthyes e ka vendosur veten në marrëdhënie me dy skaje: në njërën anë kultura pritëse, me zbrazëtitë në jetën intelektuale e artistike dhe me tranzicionin e vlerave kulturore, dhe në anën tjetër vepra e madhe e komplekse e klasikëve që kërkonte profesionalizëm e përkushtim për t'u "rilindur" në gjuhën e një kulture tjetër. Dhe duket se në këtë ndeshje kërkesash, i ndihmuar edhe nga formimi i tij i gjerë intelektual, njohja e shumë gjuhëve të huaja, njohja e thellë e veprës së klasikëve si Servantesi, Shekspiri, Edgar Alan Poe, Henrik Ibsen, Hajne, Tolstoi, filozofisë pozitiviste të Ipolit Tenit etj. , Noli e ka gjetur një rrugë "të mesme të artë". Pavarësisht, përshtatjeve, ndërhyrjeve që bën për ta bërë tekstin të induktuar në sistemin e pritjes, por edhe për të nxjerrë përfundime me vlerë për aktualitetin politik e social të kohës, Noli nuk ia tjetërson thelbin universal, nuk e prek kumtin filozofik së këtyre veprave.

Merita më e madhe e Nolit, qëndron aq sa në krijimin e një teksti letrar të aftë për t'i rezistuar kohës e për t'u lexuar me emocion deri sot, aq edhe në pasurimin e gjuhës letrare shqipe. Ai i solli Shekspirin, Ibsenin, Servantesin etj, përmes një ligjërimi të qartë, të fuqishëm, të bukur dhe ekspresiv. Nasho Jorgaqi në "Jeta e F. S. Nolit" shprehet se " në penën e Fan Nolit gjuha shqipe dëshmoi aftësitë dhe pasuritë e saj, vlerat estetike dhe semantike. [117]

Që një vepër me nivel të lartë artistik siç është ajo e Shekspirit dhe Servantesit, të vijë denjësisht e përkthyer, duhet që gjuha e letërsisë pjesë e së cilës do të bëhet më tej, të ketë arritur një shkallë të tillë kultivimi e "rritjeje" që të jetë e aftë ta "rilindë" pa ia humbur vlerat kësaj vepre. Edhe pse pa praninë e një tradite të pasur përkthimesh tek e cila të mbështetej, Noli arriti t'ia sjellë tragjeditë e Shekspirit dhe prozën e Servantesit me një potencë të jashtzakonshme shprehjeje. Kështu, romani "Don

[117] N. Jorgaqi, *Jeta e F. S. Nolit*, Tiranë, Ombra CVG, 2005, f. 66

Kishoti i Mançës", i vjen lexuesit me një narracion që nuk ishte arritur deri atëherë nga asnjë shkrimtar tjetër shqiptar, ndonse shqipes nuk i kishin munguar vepra cilësore në prozë si ajo e Çajupit("Klubi i Selanikut") deri tek romani satirik i Faik Konicës, "Doktor Gjirpëra zbulon rrënjët e Mamurrasit. [118]

Tek përkthimet e Nolit, e sidomos tek ky roman duket se u përzgjodh thuajse tërë pasuria e madhe e gjuhës shqipe, e derdhur me aq mjeshtëri në gojën e Don Kishotit e Sanço Pançës që i shëmbëllen gjithmonë një fshatari të zgjuar shqiptar.

Rrëfimi i Nolit gërshetuar me dialogun e natyrshëm dhe mbi të gjitha frazeologjia e mbështetur në fjalorin e pasur të shqipes, shërbyen si shembull për të gjithë prozatorët shqiptarë që shkruan pas botimit të kësaj kryevepre në gjuhën shqipe.

2. Introduktat si sprova të para të mendimit kritik shqiptar.

Në themelimin e konsolidimin e kritikës letrare shqiptare si disiplinë shkencore Fan Noli vendoset në radhën e themeluesve e nismëtarëve krahas Faik Konicës e te tjerëve. Ecuria dhe afirmimi i Nolit si kritik letrar shfaqet kryesisht me introduktat e tij, të cilat përbëjnë një ngjarje të rëndësishme që i kapërcen kufijtë e letërsisë. [119]Si pjesë të pashkëputura të veprave të përkthyera qëndrojnë edhe introduktat të cilat janë sprovat e para të mendimit kritik për këto vepra. Rëndësia e tyre qëndron në tre faktorë.

1. Ato sjellin pjesërisht mendimin teorik botëror letrar mbi këto vepra.
2. Bën të mundur komunikimin e lexuesit me tekstin letrar.
3. Krahas Konicës, Noli nëpërmjet introduktave dhe studimeve të tjera si "Shekspiri në rrezik"hedh gurin e themelit në mendimin kritik letrar dhe estetik shqiptar.

Duke qenë i vetëdijshëm se një tekst i përkthyer është gjithmonë më pak i njohshëm sesa një tekst i dalë prej letërsisë kombëtare, Noli merr përsipër t'i prijë lexuesit në botën e ndërlikuar të letërsisë botërore duke dhënë interpretimet e nevojshme mbi përkthimet e veta. Ndihmesa e jashtëzakonshme e tij ndaj lexuesit shqiptar konsiston krijimin e kushteve të tilla për pranimin dhe receptimin e veprës. Nëse në skemën e komunikimit letrar kritiku vendoset mes lexuesit dhe veprës, Noli ka ditur ta zërë mirë këtë vend, duke bërë që vepra ta kryejë më së miri funksionin e vet frymëzyes, emancipues dhe mbi të gjitha estetik.

Noli shkroi gjithsej 8 introdukta, të parën introduktën për "Otellon" (1916), më tej introduktat e për "Jul Qezarin", "Hamletin", "Makbethin", deri tek introdukta e fundit për "Don Kishotin"(1952). Ato janë vështrime panoramike lidhur me veprat përkatëse dhe vendin kryesor në to e zë Shekspiri, vepra e të cilit, me kompleksitetin e vet përfaqësonte në letërsi një botë të tërë për nga problemet shoqërore, psikologjike e filozofike që përmbante. Mendimi shekspirian do ta frymëzonte dhe inspironte Nolin gjatë gjithë rrugës së vet si përkthyes, studiues e krijues.

[118]S. Këlliçi, *Don Kishoti i P. Zhejit, pasurim i mëtejshëm i gjuhës shqipe*, ëëë. gazetametropol. com

[119] Vepra 5, f. 12

Që prej introduktës së pare del qartë kredoja e shëndoshë estetike, metoda analitike, për t'u marrë me përparësi me brendinë edhe funksionin shoqëror të veprës. [120] Mendimi kritik i tij nis me artikullin "Shekspiri në rrezik" (1906), vazhdon me introduktat e përkthimeve dhe arrin kulmin me veprën madhore "Bethoveni dhe revolucioni francez"(1947) dhe përmbyllet me shkrimet e fundit për Shekspirin më 1964. Edhe në këtë pikë Noli operon në fusha të pashkelura më parë në historinë e kritikës. Mendimi kritik i tij në pjesën më të madhe lidhet me veprat e letërsisë së huaj.

Pavarësisht se si artist dhe studiues i angazhuar ai jep më tepër refleksione mbi funksionin social dhe ideologjik të veprës sesa për funksionin artistik të saj, përsëri ndihmesa e tij mbetet e pazëvendësueshme për njohjen që ofron ndaj këtyre traditave letrare, por edhe filozofike e humaniste.

I ndikuar edhe prej filozofisë pozitiviste të Ipolit Tenit që sundoi mendimin teorik letrar në pjesën e dytë të shek XIX, Noli bën një qasje sociologjike ndaj veprës dhe bëhet kështu interpretues i përmbajtjes së saj. Për Ipolit Tenin Noli shfaq vlerësim tek introdukta e "Armikut të popullit", kur e cilëson atë së bashku me Leon Tolstoin dhe Henrik Ibsenin si kryeintelektualët revolucionarë të shek XIX, kurse I. Tenin si kritik letrar jo vetëm e përmend, por mbështetet tek ai në vitet e fundit të jetës kur thotë se për të kuptuar faktorët që përftojnë krijimin e artit i duhet drejtuar teorisë së tij. [121]Për këtë arsye dhe për mënyrën e trajtimit që i bëri Noli vepra ve letrare, kritikën e tij mund ta quajmë kritikë letrare sociologjike.

Si përfundim mund të themi se Noli, me kontributin e vlefshëm që dha në letërsinë shqipe në fushën e krijimit, studimit dhe përkthimit meriton të quhet mësues dhe prijës i të gjithë asaj plejade shkrimtarësh që do të vijojnë më tej rrugën e krijimtarisë letrare në letërsinë shqiptare.

[120] Vepra 5, faqe 12

[121] Vepra 5, faqe 54

SEKSIONI II: VEPRA LETRARE E FAN NOLIT

Prof. as. dr. ADEM JAKLLARI
Msc. MARINA PRIFTI

SHENJA DHE KODE MITIKE TE POEZIA E NOLIT

Do ta fillojmë këtë punim me një shprehje nga studiuesi francez Roland Barthes: ”Libri është një botë. Kritiku përpara librit ndesh të njëjtat kushte të të folurit, që i ndesh shkrimtari përpara botës”[122]. Ndodhemi përpara një bote, përpara një strukture gjigande e komplekse, siç është krijimtaria letrare e Nolit. Jo pa qëllim jemi fokusuar te shenjat dhe kodet mitike që përshkojnë këtë krijimtari dhe tek mënyra se si këto kode materializohen në tekstin letrar duke hapur kuptime të reja. Tipologjikisht poezitë më të spikatura që mishërojnë lidhjet e shumëfishta të tekstit poetik me mitin janë “Anës lumenjve” dhe “Moisiu në mal”.

Punimi ka për qëllim të kapë strukturat më të thella të tekstit, duke u nisur nga niveli i thënies te niveli i opozicionit binar ose kuadratit semiotik. Sipas Greimas te “Dizzionario”, kuadrati semiotik është struktura elementare e shenjimit, i cili shenjon opozicionin logjik që ndodhet në qendër të progresionit narrativ, semantik, tematik ose përmbajtjes simbolike. [123] Sistemi i vlerave rreth të cilit ndërtohet korpusi mitik pohohet dhe mohohet në mënyrë alternative duke krijuar sintaksën narrative të mitit. S1+S2 ose S1 + S2 është sipas Greimas e zakonshme në tekstet mitike poetike dhe të shenjta. Po të vërejmë poezitë “Anës lumenjve” dhe “Mojsiu në mal” opozicioni binar i termave dhe vlerave kalon nga strukturat sipërfaqësore të tekstit tek ato më të thellat, në strukuturat opozicionale të pohim-mohimit, duke rindërtuar mbi këtë dualitet, një pikëtakim të ri, historik dhe ahistorik, ku mitit ekzistencial i mbivihet miti i ri. Levi-Strauss te libri i tij”Naked man”, në volumin e fundit të “Mythologiques”, në kapitullin “Operatorë binarë”, iu referohet kështu uniteteteve themeltare të mitit: “Të gjitha mitemat, të çfarëdolloj natyre qofshin, duhet në një vështrim të përgjithshëm ta imitojnë vetveten drejt operacioneve binare, përderisa të tilla operacione janë një tipar i brendshëm i mënyrës së krijuar nga natyra për ta bërë të mundur funksionimin e gjuhës dhe mendimit”[124]. Sipas Strauss, miti është gjuhë dhe strukturë. Duke patur parasysh ndarjen Saussyriane të *language* dhe *parole*, Strauss e lidh mitin me një referent të tretë, i cili përmban cilësitë e *language* (referent i një kohe të kthyeshme) dhe *parole* (referent i një kohe të pakthyeshme). “Vlera operacionale e mitit, modeli

[122] “Aventura semiologjike”, fq 233, Prishtinë 1987
[123] Semiotika e tekstit, Tiranë 2005, fq 53
[124] L. -Strauss, claude, 1955”The structural study of myth” journal of American folklore 68: 428-444

specifik i përshkruar është i pakohë, ai shpjegon të tashmen, të kaluarën dhe të ardhmen. [125] Te poezia "Anës lumenjve" opozicioni fillestar është ai hapësinor, hapësirë e jashtme-hapësirë e brendshme, qendër-joqendër, vatër-jovatër, së dyti është opozicioni diegjetik i përjashtuar- i përfshirë, i mundur- fitues, i arratisur-prezent.

Poezia "Mojsiu në mal" krijon katër shkallë rivlerësimi të opozicionit fillestar zot-jo zot:

1. Shkalla 1 (ose miti1), Jezusi biri i zotit-i dënuari i njerëzve
2. Shkalla 2(miti 2), Mojsiu profeti i shumëpritur – i refuzuar nga zoti dhe njerëzit.
3. Shkalla 3(miti 3), Noli liberatori i shenjtë – i shkurorëzuar nga njerëzit.
4. Shkalla 4 (miti 4), e mira- e keqja

Ky mit është ahistorik dhe në krahasim me tre mitet e tjerë është substrat filozofik dhe strukturë mbajtëse. Strauss flet për simbolin në gjendjen e tij të pastër si simboli zero ose shenja e cila mund të shkarkohet dhe ringarkohet semantikisht gjatë tekstit duke mbetur përsëri pjesë e sistemit real themelor të vlerave opozicionale të mitit. Në dy poezitë e lartpërmendura simboli zero është pozicionimi jetësor i pashmangshëm dhe i pakontrollueshëm. Hegeli thotë se shpirti fillimisht nuk është i lirë vetëm si mundësi, ai bëhet në realitet i lirë në atë masë që ai merr pjesë tek natyra për të vepruar atje në mënyrë afektive, pra realiste. Kështu shpirti shprehet nëpërmjet një veprimi që asgjëson dhe kapërcen të fundmen, për të bërë me të, të pafundmen. "Duhet kapërcyer e fundmja nëpërmjet mohimit të natyrës së jashtme të saj. Kemi të bëjmë me një rrugë të ngjashme me atë të së famshmes: vdis dhe bëhu! "[126] në këtë mënyrë natyra, nëpërmjet mohimit rikthehet tek brendësia e shpirtit. Noli si qytetar dhe intelektual aktivisht i organizuar dhe i implikuar në strukturat sociale dhe politike të kohës, pasqyron në gjithë jetën e tij, luftën titanike të shpirtit për të realizuar idealet e shenjta të barazisë, lirisë ose "TË MIRËN HYJNORE" në kuadratin mohues të një realiteti kundërshtar dhe mospranues. Ky fakt ekzistencial shërben si motor shtytës për dy poezitë ku kodet dhe shenjat mitike ristrukturohen në bazë të strukturave themeltare të mitit, siç janë opozicioni binar, qendra e botës ose Axis Mundi, koha e përjetshme dhe hapësira mitike.

Të dyja poezitë ndërtohen mbi imazhin-simbol. Te "Anës lumenjve" kemi imazhe të ngarkuara emocionalisht të cilat përdoren si shenjues të nivelit të tretë (mbi nivelin e parë gjuhësor dhe të dytin kulturor-historik, ngrihet niveli i tretë emocional-simbolik). Imazhi zbrazet nga kuptimi fillestar dhe rimerr një kuptim të ri, atë të shenjuesit mitik. Kodi i organizimit të imazheve-shenjues është opozicioni binar deri në kapërcimin e kontradiktës nëprmjet krijimit të mitit të ri të imperativit kategorik të Kantit, i cili është kërkesa e kulluar e ligjit moral. Ai bëhet i pranishëm sa herë që një njeri thotë"Une duhet ta bëj, sepse ashtu duhet". [127] Denotacioni përfaqësues i një imazhi vizual, është ajo çfarë lexuesit e çdo lloj kulture dhe kohe do e njihnin si formën përfaqësuese të informacionit. Konotacioni i imazhit, lidhet në ktë rast me shkallën e dytë të shënjimit. Mbi shënjuesit i palarë, i paparë, i pangrënë, i panxënë, konotacioni i

[125] Strauss "The structural study of myth", fq 56
[126] Habia filozofike, fq 85
[127] Habia filozofike, fq 159

imazhit aktivizon kodin e ri semantik, atë të mungesës. Gjithçka gjendet në mungesë, në mosqenie, në zhdukje. Është zhdukur një botë ekzistente (ku e lamë e ku na mbeti) dhe është krijuar një botë tjetër e kundërt me të parën ku gjithçka ekziston është në gjendjen e mospasjes ose në gjendjen e kundërt të krijimit.

Poezia "Anës lumenjve", ndërtohet përmes strukturës opozicionale binare si mit i Gjenezës me kaosin dhe rregullin, errësirën dhe dritën, mosqenien dhe qenien. Gjithçka natyralizohet në funksion të ideologjisë përmbajtëse të poezisë, gjendja jepet si realitet natyror, si dukuri e motit, furtunë, dimër, verë etj. , dhe si pasojë e pashmangshme e ndryshimit gjeografik shembet-ngrihet, anës-pranë dhe ndryshimit jetësor mplaket-rinohet, vajtoj-brohoras

Te "Mojsiu në mal" opozicioni hapësirë e jashtme-hapësirë e brendshme kthehet në opozicionin hapësirë e shenjtë – hapësirë profane, opozicioni diegjetik i pranuar-i papranuar nga shoqëria është present, ndërsa opozicioni vatër- jovatër shkrihet në opozicionin e shenjtë – profane. Hapësira e shenjtë ne poezi shënohet në një ekzagon struktural, sipas skemës :



duke lënë përsëri një lumë të vendosë kufijtë e botës, siç vihen lumenjtë në rolin përcaktues të hapësirës te "Anës lumenjve". Tre qytetet e sipërme përfaqësojnë etapat fillestare të jetës së Jezusit, lindjen, rritjen;tre vendndodhjet e poshtme gjeografike jane respektivisht mal, pllajë e shkretë (Bethsaida) dhe kodër (Golgotha), ku aktualizohet vlera modale e opozicionit fuqi hyjnore-shfuqizim. Në Bethsaida, Jezusi ushqen nëpërmjet mbrekullisë një turmë të tërë me pesë bukë dhe dy peshq. Mali i Sionit ishte mali ku Mojsiu mori 10 urdhëresat dhe u ngrit në rangun e zotit dhe Golgothaja është përfundimi tragjik i opozicionit fuqizim-shfuqizim. Gjjithë poezia reflekton kontradiktën mes hyjnores, të shenjtës dhe jo hyjnores, profanes, të ultës, skllavërisë, mungesës dhe dështimit. Janë tre heronj, tre herë të kurorëzuar dhe tre herë të shfuqizuar, Jezusi si bir i Zotit, Moisiu si Profet dhe Noli si liberator. Qendra e botës MALI I SHENJTË, shërben si shtylla mbi të cilin ngrihet miti i ri ose miti zero, e mira në luftë me të keqen.

Sipas Ricoer te " The symbolism of evil", natyra e së keqes është e trashëguar brenda natyrës jo- perfekte njerëzore. Te "Fallible man", Ricoer thotë se ky disproporcion epitomizohet nga diferenca mes "bios"ose jetës së përcaktuar

kronotopeike dhe "logos", përdorimit të arsyes për të kapur universalen. Ky disproporcion shfaqet në çdo aspekt të ekzistencës humane. "Njerëzimi është përpjekur të aktualizojë paaftësinë e tij për të kuptuar ekzistencën e së keqes, duke përdorur gjuhën e cila tërheq mbi vete simbolet e mëdha dhe mitet të cilat flasin për origjinën dhe fundin. Kjo gjuhë përmban më shumë se një kuptim të vetëm dhe mund të lexohet në më shumë se një mënyrë. [128]

Levi Strauss te "The raw and the cooked" thotë, "Studimi i mitit vendos një problem metodologjik për faktin se ai nuk i përmbahet principit kartezian të ndarjes në aq pjesë sa ç'është e nevojshme. Nuk ka një fund të verifikueshëm ose terminal në anlaizën mitike, asnjë unitet sekret i cili mund të kapet në fund të "dekompozicionit". Termat e dublikojnë vetveten në pafundësi. Kur mendojmë se i kemi shmpleksur nga njëra-tjetra dhe mund t'i mbajmë të veçuara ato bashkohen përsëri nën veprimin e afiniteteve të padukshme. Si pasojë uniteti i mitit është vetëm tendencial dhe projektues, ai nuk reflekton kurrë një gjendje ose moment të mitit…mund të thuhet se shkenca e studimit të mitit është anaklastike, duke e marrë termin në gjerësinë e tij të plotë, që do të thotë se është një shkencë që studion rrezen fillestare të kuptimit si edhe ato të përthyerat prej saj duke shkuar pas në origjinë, pa pasur një fokus tjetër virtual. Duke dashur të imitojë lëvizjen spontane të mendimit mitologjik, përpjekja ime duhet t'i nënshtrohet kërkesave të këtij mendimi dhe të respektojë ritmin e tij. Kështu, ky libër, është një mit në vetvete dhe në mënyrën e tij"[129]

Sipas Barthes vepra është e përjetshme, jo pse iu imponon një kuptim të vetëm njerëzve të ndryshëm, po për shkak se iu sugjeron kuptime të ndryshme njeriut të njëjtë, i cili e flet gjithnjë të njëjtën gjuhë simbolike nëpër kohë të ndryshme. Gjuha simbolike, së cilës i përkasin veprat letrare, për nga struktura është gjuhë shumës, kodi i së cilës është bërë ashtu që çdo vepër e prodhuar nga ky kod të ketë kuptime të shumëfishta. [130]

Nga rrafshi paradigmatik në atë sintagmatik, simboli ngrihet vertikalisht lart në shumëfishim kuptimor semantik dhe strukturë organizuese komplekse që i bën të dyja poezitë polivalente dhe shumë dimensionale.

Duke huazuar fjalët e fundit të Strauss-it ky pumin, është një përpjekje për të dekoduar mënyrat dhe llojet e ndryshme me të cilat aktualizohen shenjat dhe kodet e fshehura të strukturave arketipale më të thella mitike të poezisë.

Përfundime

-Noli poet la trashëgim një cikël poetik në të cilin simboli dhe shenja mitike shërben si metatekst. Meritë e tij si krijuese qëndron në aftësinë për të përdorur instrumentet moderne të transfigurimit, të cilat nënkuptojnë relativizimin e semantikës religjioze me synimin e fortë autorial për konotim social dhe politik.

-Kjo mënyrë e prosedesë, e përzgjedhur prej tij, krijon distancën e nevojshme të poezisë së tij nga ligjërimi politik dhe nga strukturat e tipit propangandistiko-publicistik, fuqizon shtresën simbolike dhe i jep krijimtarisë së tij një recipient të

[128] Ricoer "The symbolism of evil", New-York: Harper and Row, 1967(1960)

[129] hytra. humanities. uu. edu/derrida/sign-playhtlm

[130] Aventura semiologjike, fq 223

gjithkohshëm. Mendimi ynë është se përzgjedhja e kësaj paradigme nuk e ka bazën te ndroja e Nolit për t'u ballafaquar hapur me antagonistët e vet, gjë të cilën ai e bëri me publicistikën sa herë ia deshi puna, por te vetëdija e tij estetike për të sendërtuar një poezi sa më universale.

-Përdorimi mjeshtëror i shenjave dhe kodeve mitike i kanë dhënë kësaj tipologjie të poezisë Noliane polisemi dhe disa herë ambiguitet, regjistër të gjerë ritmik dhe fonologji, duke krijuar në poezinë shqipe një nga rastet më origjinale të simbolizmit natinomik dhe fonologjik.

Prof. dr. AGRON XHAGOLLI

FOLKLORI NË VËMENDJE TË FAN S. NOLIT

Rilindësit shqiptarë përgjithësisht i kanë çmuar së tepërmi rolin dhe rëndësinë e folklorit, funksionet e tij, duke i vënë në shumë raste në shërbim të qëllimeve patriotike. Duke u përfshirë në këtë lëvizje të rëndësishme kombëtare, edhe Fan S. Noli kur bën fjalë për kulturën tonë, ndër të tjera, shprehet: "*Rilindja shqiptare, doemos, ishte një lëvizje politike dhe kulturore. Qëllimi ynë ishte të shpejtonim themelimin e një shteti të pavarur shqiptar dhe të çonim më tej kulturën dhe letërsinë shqiptare"*[131]. Në këtë vazhdë Noli nuk i ka lënë pa shprehur interesimet e veta për folklorin, si një nga përbërësit e rëndësishëm të kulturës shqiptare. Për më tepër, për të mbështetur idetë e veta, në shumë raste ai i është drejtuar konkretisht krijimtarisë folklorike shqiptare.

Fan S. Noli, një emër me shumë peshë në fusha të ndryshme të dijeve shqiptare, por jo vetëm, është bërë objekt trajtesash nga më të ndryshmet, ndonëse deri më sot nuk kemi trajtesa rreth vëmendjes dhe konsideratave të tij në krijimtarinë folklorike. Nisur nga një vështrim i përgjithshëm i trashëgimisë së tij të pasur, bindesh se edhe krijimtaria folklorike shqiptare njihej prej tij dhe ajo përfaqësonte dhe shprehte për të interesa të caktuara. Pikërisht, për të vënë në dukje këto aspekte të interesimeve të Nolit rreth folklorit, që në të vërtetë janë dhe vlerësime e konsiderime të tij për folklorin, do të bëjmë fjalë në këtë kumtim. Konkretisht do të ndalemi në konceptimin e Nolit dhe shfrytëzimin prej tij të krijimtarisë folklorike në raste të ndryshme; për përcjelljen e dëshmive të natyrës historike përmes krijimtarisë folklorike; së fundi, do të trajtohet praktikimi i fjalëve të urta nga Noli.

Fillimisht do të ndalemi te konceptimi dhe shfrytëzimi i krijimtarisë folklorike nga Noli si një nga elementet përbërëse të identitetit kombëtar. Gjithnjë në atë vazhdë të pararendësve të tij rilindës, që gjithnjë e vlerësuan drejt rolin dhe rëndësinë e folklorit në zgjimin e ndërgjegjes kombëtare, edhe Noli në raste të ndryshme është shprehur me shumë respekt dhe e ka vlerësuar krijimtarinë folklorike shqiptare, duke e konsideruar atë si një nga pasuritë e paçmuara të popullit shqiptar. Këtë vlerësim e gjejmë në raste të ndryshme. Ndër të tjera, kur Noli bën fjalë për marrëdhëniet shqiptaro-greke, sipas disa parashtresave që i njëjtësojnë këta dy popuj, i mbështet mendimet e veta rreth raporteve shqiptaro-greke pikërisht te kënga popullore. Kështu, në artikullin "Ali Pasha dhe Thermopylet", botuar në tre numra të gazetës "Kombi" me tituj të ndryshëm, në muajt shkurt-mars të vitit 1907, përpiqet të kundërshtojë mendimin e një shqiptari nga Moreja, zotit Konstantopulos, i cili, sipas Nolit, përpiqej *"të rrëfejë që raca e shqiptarëve është një me racën e grekëve dhe përandaj duhet të*

[131] "Fan S. Noli. Vepra" 5, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1987, f. 283.

bashkohemi dhe të luftojmë kundër bullgarëve"[132]. Për të kundërshtuar këtë pohim, Noli përdor argumente të ndryshme. Krahas atyre nga fusha e gjuhësisë dhe e historisë, ai sjell në vëmendje të lexuesve edhe dëshmi nga traditat dhe zakonet shqiptare. Ndër të tjera, duke dashur të mbrojë tezën e vet, Noli shprehet: "*Provën e kemi përpara syve. Shqiptarët e Moresë nuk bëjnë krushqi me grekët, të cilët i quajnë shkleh domethënë sllavë. Kjo gjë është mjaft të na rrëfejë sa armiqësi e vjetër është jona me të grekëve dhe sa e ruajmë gjaknë tonë ne shqiptarët që të mos turbullojmë me gjak të huaj"*[133].

Por jo vetëm kaq. Noli, gjithnjë në mbështetje të tezës së vet, sjell në ndihmë shqyrtimin e zakoneve, veshjeve dhe këngëve popullore. Më konkretisht ai shprehet: "*Zakonet e grekëve të Moresë si dhe të veshurat dhe këngët që shëmbëllejnë i kanë marrë prej shqiptarëve, dhe ja se ku kemi përpara zakonet, këngët dhe të veshurat e nisiotëve grekër të cilët janë më të kulluarit gjak grek që ndryshojnë fare"*[134].

Të gjitha sa thamë besojmë se pasqyrojnë dhe shprehin krahas vlerësimit, edhe rëndësinë që u kushtonte Noli në përgjithësi trashëgimisë kulturore dhe në veçanti krijimtarisë folklorike shqiptare, në funksione të përcaktimit të identitetit kombëtar shqiptar. Kur është fjala për grindjet dhe armiqësitë midis grekomanëve dhe shqiptarëve në Korçë, që sipas Nolit po shtoheshin për dita (bëhet fjalë për vitin 1909), për ndarjet midis tyre, për ta bërë edhe më të pranishme, më të besueshme situatën, sjell në një shkrim të vetin edhe një pasazh, që flet qartë për këtë ndarje edhe përsa i përket qarkullimit të krijimeve folklorike: "*Shumë gjëra për të qeshur ngjajnë nga kjo armiqësi. Një mik na tregonte se më çdo dasmë a pagëzim, a vdekje a urim për emër, domosdo do të ngjante një zihje…. Kështu pra një që bën dasmë a ziafet në Korçë duhet të ketë këtë gjë përpara. Duhet t'i verë në një sofrë të veçantë grekomanët dhe në një tjatër shqiptarët. Sazet me këngë shqip nga kjo anë dhe saze me këngë palikarishte nga tjatra"*[135].

Midis shkrimeve të ndryshme të Nolit gjejmë edhe ndonjë të tillë ku dalin të qarta edhe disa konstatime të tij për krijimtarinë folklorike. Sipas Nolit kombësia nuk luan gjithnjë rol në krijimin dhe praktikimin e krijimeve folklorike. Këtë pikëpamje të drejtë ai përpiqet ta mbrojë duke u shprehur mjaft qartë. Për mendimin e Nolit, nuk ka rëndësi kombësia, që një individi të caktuar t'i kushtohen dhe për të të praktikohen krijime folklorike nga një komb tjetër. Konkretisht ai e ka fjalën për Skënderbeun dhe Ali pashë Tepelenën, për të cilët ka krijime folklorike edhe në popullin grek. Por sipas Nolit kjo nuk provon *"vëllazërinë dhe njësinë kombëtare të shqiptarëve dhe të grekëve"*[136]. Dhe sjell analizën e vet rreth pranisë së këngëve për këto dy figura të

[132] "Fan S. Noli. Vepra" 2, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1987, f. 136.

[133] Po aty, f. 140.

[134] Po aty.

[135] Po aty, f. 194.

[136] Po aty.

popullit shqiptar edhe në popullin grek. Ndër të tjera ai pohon: "*Për këngët që lëvdojnë Skënderbenë s'duhen shumë fjalë, se do të ishte shumë prapa nga bota populli grek, pot ë mos i rrëfente mirënjohjen e tij me këngë për atë trim që lëftoi 40 vjet pothua për tërë krishtërimnë e Evropës kundër turqve"*[137]. Në të njëjtën mënyrë ai arsyeton edhe për praninë e këngëve popullore për Ali pashë Tepelenën në popullin grek. *"Si të mos e këndojnë grekët pastaj Ali pashë Tepelenën nga i cili, jo vetëm s'panë asnjë të ligë, po dhe lirinë që kanë marrë ia kanë detyrë atij? Dhe jo vetëm këngë, po dhe një statujë duhet t'i ngrinin përpara pallatit në Athinë"*[138], shprehet me bindje Noli. Ai është i ndërgjegjshëm se *"Një popull trim lëvdon nër këngët e tij heroike, jo vetëm trimat prej gjakut të tij, po prej çfarëdo gjaku të huaj dhe armiku qoftë"*[139].

Pas këtij pranimi, Noli gjen rastin që të dëshmojë se populli shqiptar është nga ata që ka krijuar me mijëra këngë ku lëvdohen tërë trimat armiq, me të cilët luftoi. *"Do të gjejmë këngë panegjirike për tërë trimat, qofshin grekër, qofshin malazes, qofshin rusër a arabë. Nër këto këngë kalorsishte, të cilat rrallë munt t'i gjejë njeriu në gojat e popujve të tjerë, vajtohen trimat shqiptarë të cilët u vranë dyke lëftuar armiqtë, po lëvdohen e ngrihen gjer në qiell trimat armiq, të cilët qenë të zotë t'i mposhtin djemat e lëvduar të Shqipërisë"*[140].

Duket qartë se përmes këngës popullore Noli dëshironte jo vetëm t'iu kundërvihej mendimeve që nuk përputheshin me të vërtetat e dëshmuara, por dhe të ngrinte lart, të çmonte së tepërmi cilësitë dhe karakteristikat e popullit shqiptar. Kjo do të përbënte dhe një veçori Noliane në të përcjellurit dhe vlerësimin në një mënyrë elegante të trashëgimisë folklorike shqiptare.

Por duhet thënë se Noli krijimtarinë folklorike e ka shqyrtuar dhe për ta vlerësuar atë si një "dokument" që vërteton faktet historike. Më së qarti e gjejmë këtë në një nga bisedat e tij lidhur me ekzistencën te shqiptarët të ndjenjës së patriotizmit. Ai, duke iu kundërvënë të gjithë atyre që shprehen se shqiptarët s'kanë pasur patriotizëm, për të vërtetuar të kundërtën, merr në konsideratë vëllimin e Thimi Mitkos, "Bleta shqiptare", botuar më 1878, duke shkëputur prej tij për të analizuar këngën kushtuar Rrapo Hekalit. Duke iu drejtuar të pranishmëve, Noli thotë: "*Vjersha popullore që do t'ju deklamoj tani është krijuar më 1850, kur u bë kryengritja e Labërisë në kohën e Tanzimatit. Turqia desh të impononte Tanzimatin një kanun të përgjithshëm për gjithë viset e Turqisë. Kjo do të thoshte që ca të drejta të pakta vetqeverimi që kishin shqiptarët, do t'i merrte Turqia dhe kështu vendi do të robërohej fare. Dhe populli u ngrit"*[141]. Pikërisht kryetrimave të kësaj lëvizjeje, Rrapo Hekalit, Hodo Nivicës dhe Gjolekës, u bën jehonë kënga që Noli e merr në konsideratë. Në vazhdim, pasi ka dhënë vargjet e njohura tashmë të kësaj kënge popullore, Noli shprehet: "*Ato tri radhët e fundme (e ka fjalën konkretisht për këto vargje: Pse, lufton a derëzi? / As për*

[137] Po aty.
[138] Po aty f. 141.
[139] Po aty.
[140] Po aty.
[141] "Fan S. Noli. Vepra" 5, vepër e cituar, f. 277.

mua, as për ti/ Po për gjithë Shqipëri) tregojnë se qëllimi i kësaj kryengritjeje ishte për tërë Shqipërinë"[142]. Dhe në vazhdim të analizave dhe sjelljes së shembujve konkretë Noli arrin në përfundimin *"që nuk e shpikëm patriotizmën shqiptare, e gjetëm"*[143]. Kjo ishte mënyra me të cilën Noli analizonte dhe shpaloste tiparet dhe virtytet e shqiptarëve, të pasqyruara nga kënga popullore shqiptare.

Interesimet e Nolit për folklorin i shohim edhe më qartazi në shfrytëzimin që u ka bërë fjalëve të urta. Në mjaft artikuj publicistikë të tij ai praktikon edhe një numër fjalësh të urta, në shërbim të përforcimit të mendimeve të trajtuara prej tij. Dihet se krijime të këtij lloji folklorik praktikohen në jetën e përditshme duke kryer *"me shkathtësi rolin e argumentit, të parabolës, të pohimit apo të mohimit tepër shprehës, duke i dhënë gjallëri, forcë, mençuri e kolorit bisedës apo ligjërimit"*[144]. Por që t'i përdorësh fjalët e urta me vend, paraprakisht është e nevojshme që t'i njohësh ato. Pastaj, brenda natyrës polisemantike që ato kanë, duhen përzgjedhur më të përshtatshmet për problemin apo situatën që bëhet fjalë.

Pikërisht këtë gjë e realizon me shumë mjeshtëri F. Noli. Tri janë format e praktikimit të fjalëve të urta nga Noli. E para, ai i përfshin ato në trup të shkrimeve të tij, si një mënyrë më koncize dhe përgjithësuese e të shprehurit; e dyta, ai i sjell fjalët e urta në fund të artikujve të tij, në mbyllje të shkrimeve të caktuara, duke luajtur rolin e argumentit të padiskutueshëm. Së treti, ka edhe ndonjë rast që ai fjalën e urtë e sjell në formën e një titulli apo nëntitulli të artikullit të vet. Në të tria rastet ai është mjaft i suksesshëm në përzgjedhje dhe i përdor fjalët e urta me shumë vend, në funksionin e tyre të mirëfilltë.

Noli përgjithësisht i ka përfshirë fjalët e urta në trup të shkrimeve të tij. Me rëndësi për t'u theksuar është fakti se në këto raste fjalët e urta e sjellin në mënyrë të përgjithësuar përvojën popullore në shërbim të ideve të Nolit në një mënyrë shumë bindëse dhe pa ekuivoke. Kjo përbën meritën e Nolit që duket se e njeh pasurinë proverbore të popullit shqiptar, por jo vetëm, nga njëra anë, dhe di të përzgjedhë ato që e realizojnë më së miri funksionin me të cilin ai i ka përfshirë në shkrimet e veta, nga ana tjetër.

Tematika e fjalëve të urta të përdorura nga Noli në trup të shkrimeve të veta është e natyrave të ndryshme. Ndër të tjera, gjejmë fjalë të urta ku bëhet fjalë edhe për ndonjë karakteristikë të popullit shqiptar. Pasi e zbërthen gjerë e gjatë konceptin e tij rreth popullit shqiptar, duke u shprehur, ndër të tjera, se ky popull *"duke kapërcyer armiqësinë dhe ndryshimnë e gjakut, e nderon armiknë e tij, po të jetë trim. Kurrë nuk e mposht veten e tij aq sa të shanjë trimnë e huaj ose ta turpëronjë"*[145], menjëherë, në

[142] Po aty, f. 278.

[143] Po aty, f. 279.

[144] J. Panajoti, A. Xhagolli, Hyrje, "Fjalë të urta të popullit shqiptar", Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë 1983, f. 8.

[145] "Fan S. Noli. Vepra" 2, vepër e cituar, f. 141.

vazhdim, sjell fjalën e urtë: "*Vraje trimnë, po mos e shaj", thotë gojë e popullit tonë"*[146].

Meqënëse konteksti në të cilin përdoret fjala e urtë është përcaktuesi i kuptimit të saj, paraqitja e secilës duhet sjellë pikërisht në tërësinë e kontekstit, për të shprehur tematikën. Në këtë aspekt del në pah edhe mjeshtëria e Nolit në praktikimin e fjalëve të urta. E njohur në shkrimet e tij është ironia ndaj kundërshtarëve politikë. Me këtë sens janë dhe mjaft fjalë të urta, të përzgjedhura prej tij. Le të sjellim këtu vetëm ndonjë shembull konkret të fjalëve të urta në kontekstin që janë praktikuar gjë që shpreh më së miri edhe mjeshtërinë e Nolit: "*Po agai i "Diellit" s'ka frikë se bëhet qesharak. Se nuk është e mundur të bëhet më qesharak se ç'është. I mbyturi s'ka frikë nga të lagurit"*[147]. Në një rast tjetër Noli i kundërvihet një prifti kundërshtar që donte t'i jepte mend. Ja se si ai i kundërpërgjigjet; *"Mënt më duheshin sa pa u gënjyer dhe sa pa bërë një prift si ky që më këndon këtë urim mi kokë, se tani, sikundër thotë fjala popullore, "ardhë mentë, po shkuan dhëntë"*[148].

Në një rast, kur bën fjalë për raportet midis shteteve të madha e të vogla, Noli e sjell fjalën e urtë, *"Pishku i math e ha të voglin"*[149], duke iu kundërvënë kuptimit të drejtpërdrejtë të saj. Në këtë rast Noli i kundërvihet Lumo Skëndos, duke thënë ndër të tjera: "*Në këtë letër ky zotëni na rrëfen ligjën e natyrës pas së cilës pishku i math ha të voglin"*[150].

Kur i përdor fjalët e urta në fund të shkrimeve të veta, i sjell të shoqëruara në disa raste edhe me shprehje të kësaj natyre: *sikundër thotë fjala popullore*; *thotë gojë e popullit* etj. Për ta konkretizuar, po sjellim ndonjë rast nga përdorimet e fjalëve të urta nga Noli në fund të shkrimeve të veta. Midis të tjerash veçojmë: "*Pishku i math ha të voglin"*[151]; *"Ruaju nga qeni"*[152]; *"Me profka të zbrazëta nuk mbyllen plagët"*[153] etj.

Siç e përmendëm dhe më lart, në raste të caktuara Noli e përdor fjalën e urtë edhe si nëntitull të ndonjë prej shkrimeve të veta. Kështu p. sh. , te shkrimi i botuar në vitin 1932, si nëntitull ka gjetur me mjaft saktësi, në kontekstin e praktikuar, fjalën e urtë: "*Shtëpia digjet kokona krihet"*[154].

Duhet sjellë në vëmendje edhe fakti se në ndonjë rast Noli, është në pozicionin e "krijuesit" të këtyre fjalëve: duke shfrytëzuar përvojën e fjalëve të urta shqiptare, realizon ndonjë thënie që duket sikur ke të bësh me ndonjë fjalë të urtë popullore. Fjala vjen, në thënien e përdorur nga Noli, lidhur me një realitet faktik në Turqi, kur u ndërrua Ministri i Punëve të Brendshme, ndryshim që nuk solli asgjë të re, si në titull të shkrimit, edhe në fund të tij ai shprehet: "*Iku Taalati dhe ardhi Halili"*[155], sipas

[146] Po aty.
[147] "Fan S. Noli. Vepra" 3, f. 252.
[148] Po aty, f. 110.
[149] Po aty, f. 199.
[150] Po aty, f. 199.
[151] "Fan S. Noli. Vepra" 2, vepër e cituar, f. 199.
[152] Po aty, f. 320.
[153] Po aty f. 352.
[154] Po aty, vëll. 3, f. 370.
[155] Po aty, vëllimi i dytë, f. 377, 378.

fjalës së urtë popullore, *"Një hyn e një del një Spiro, një Vangjel"*. Kjo tregon jo vetëm njohjen e fjalëve të urta të shqiptarëve nga Noli, por dhe shfrytëzimin prej tij të përvojës krijuese të këtij lloji folklorik.

Gjithnjë, lidhur me fjalët e urta, duhet thënë se është karakteristik fakti që përdorimi i tyre nga Noli zakonisht kryhet mbi një bazë njohjeje të praktikimit të fjalëve të urta në popull, duke respektuar natyrën dhe frymën popullore që ato kanë brenda një konteksti të qartë e të përcaktuar mirë. Për shembull, duke bërë fjalë për një nga kundërshtarët e tij Noli konkretisht në kontekstin e të gjithë shkrimit të tij e përcjell këtë suazë duke përfshirë brenda saj edhe fjalën e urtë përkatëse: "*Po agai i "Diellit" s'ka frikë se bëhet qesharak. Se nuk është e mundur të bëhet më qesharak se ç'është. I mbyturi s'ka frikë nga të lagurit"*[156]. Ka edhe mjaft raste të kësaj natyre, kur Noli e sjell drejtpërdrejt fjalën e urtë në tërësinë e kontekstit të praktikimit: *"Inglezët thanë që të gjithave munt t'u gjendet ilaçi urtë e butë sipas proverbit "urët e butë e plot tigani"*[157].

Krahas sa thamë, Noli ka dhe përdorime të zgjeruara të fjalëve të urta, të cilat i vendos në kontekstin që i duhet për ligjëratën e tij. Kështu p. sh. , fjalën e urtë "Ç'i duhen qenit brekët", Noli e përfshin në mendimin e vet duke i shtuar një pjesëz ndërlidhëse. Konkretisht ai e sjell mendimin e vet në këtë mënyrë: *"Protektoratën dhe kapitalin e paskan marrë bejlerët, po kulturën jo. Se ç'i duhen qenit brekët"*[158]? Edhe në raste të tjera Noli vepron në këtë mënyrë, duke mos e sjellë fjalën e urtë drejtpërsëdrejti si në popull, por duke ia përshtatur kontekstit të praktikimit të tij. Dhe ja si e përdor në një rast tjetër: "*Inglizët u zotuan të hyjnë si nërmjetarë për një zgjidhje të nderçime dhe të drejtë për të gjitha palët që edhe mishi të piqet edhe helli të mos digjet"*[159]. Edhe kur i drejtohet Faik Konicës (dihen përgjithësisht replikat e Nolit me të), jo pa ironi therrëse, Noli shpërfaqet duke e përdorur fjalën e urtë në strukturën e tij të të shprehurit: "*Kështu, o Faik bej, kështu. Pra, mos i bjer samarit po gomarit"*[160]. Krahas ka dhe ndonjë rast kur Noli nuk e jep të plotë fjalën e urtë. Konkretisht ai sjell këtë formë: *"Nesër pastaj, puna mbaron sipas proverbit të shëmtuar që nis me fjalët: "kapërceva lumën"*[161]?

Duhet thënë se në disa raste Noli, si erudit që ishte, përdor dhe fjalë të urta të popujve të tjerë, duke sjellë krahas edhe kuptimin në shqip. Ai përdor ndonjë proverb në latinisht, të tipit: "Asinus asinum fricat" (Gomari fërkon gomarin)[162]; në frengjisht: "*Tel maitre, tel valet" (Ay usta atë çirak do)*[163]; nga greqishtja: "*Ekso kuklla, mesa panullka" (Jashtë i bukur si kukëll, brenda i tmerruar si murtajë)*[164]; nuk i referohet gojës së popullit shqiptar, por sjell një proverb në frengjisht *"La raison du plus fort est*

[156] Po aty, vëllimi i tretë, f. 252.
[157] Po aty, f. 272.
[158] Po aty, f. 179.
[159] Po aty, f. 271-272.
[160] Po aty, f. 174.
[161] Po aty, f. 274.
[162] Po aty, f. 173
[163] Po aty, f. 174.
[164] Po aty, f. 135.

toujours la meilleure" domethënë arësyeja e më të fortit është gjithnjë më e mira"[165]. Në ndonjë rast tjetër sjell së pari proverbin në latinisht dhe pastaj fjalën e urtë në shqip: "*Cave canem! Ruaju nga qeni! "*[166]. Por ka dhe prurje të ndonjë proverbi në shqip, pasi më përpara e ka shprehur mendimin me ndonjë fjalë të urtë në frengjisht. Gjatë një kundërvënie ndaj F. Konicës fillimisht Noli i përgjigjet atij frengjisht: "*Qui s'excuse s'accuse"*[167]. Pasi e shqipëron (*ay që çfajësohet, kallëzon vetveten*), e vazhdon polemikën në këtë mënyrë: "Po do t'i përgjigjemi edhe shqip, se shqipja ka një proverb më të lezetçim, që zbatohet në kurrizin e beut: "*Kur e ke ujkun përpara, mos kërko gjyrmat"*[168].

Përgjithësisht lidhur me praktikimin nga Noli të fjalëve të urta duhet thënë se ai me shkrimet e veta, siç e kemi përmendur paksa edhe më lart, krahas të tjerash, mund të shërbejë edhe si një model në shfrytëzimin e tyre. Ai nuk qëndron thjesht rob i tyre, por e shfrytëzon thelbin e secilës fjalë të urtë, përmes një pozicionimi të veçantë, për të theksuar apo nxjerrë në pah idetë e tij. Kështu p. sh. , është e njohur fjala e urtë: "*Populli nuk ha kashtë"*. Noli e merr dhe e zgjeron duke u shprehur, ndër të tjera, se: "*Populli shqiptar nuk ha kashtë"*[169]. Në këtë mënyrë ai fjalën e urtë e përdor ashtu si i vjen atij më mirë të shprehë një mendim të caktuar, brenda një kumtimi.

Nga sa thamë deri tani, besojmë se Fan S. Noli në shkrimet e tij ka sjellë dhe shprehur një interesim jo të pakët për folklorin shqiptar, në aspekte të caktuara, duke treguar se sa më afër popullit të jesh, aq më të kuptueshme dhe shprehëse bëhen mendimet. Në asnjë rast Noli nuk shprehet nacionalist i paarsyeshëm, që vendos kombin e tij mbi gjithçka, por gjithnjë ka pasur shqetësim moscënimin e tij duke luftuar me cilindo që i ka rënë në qafë… Ndaj mund të themi me plot gojën se Noli mbetet një nga modelet më të mira të vlerësimit dhe të funksionimit të krijimtarisë popullore, gjithnjë në shërbim të nxjerrjes në pah të vlerave, natyrës, tipareve dhe cilësive të popullit të vet.

[165] Po aty.
[166] Po aty f. 320.
[167] Po aty, f. 319.
[168] Po aty.
[169] Po aty, f. 181.

AJLIDA SELIMI

NOLI DHE HISTORIA E LETËRSISË

Për të gjithë studiuesit e letërsisë, veçanërisht për zhvillimin e kësaj problematike, këto vitet e fundit, kam parasysh mendimet dhe analizat e studiuesve Floresha Dado[170] dhe Sabri Hamiti[171], ku janë bërë të dukshme problemet më të cilat ndeshet Historia e letërsisë shqipe, por, megjithatë, është rasti që, në kuadër të kësaj konference për figurën dhe kontributin e Nolit, të bëhet një rishikim dhe vlerësim për raportin që është krijuar midis veprës letrare të Nolit dhe Historisë së letërsisë shqipe.

Ndoshta, një pikëfillesë për t'u përballur me problemet që ka historiografia e letërsisë shqipe është, ndër të tjera, edhe rishikimi i përfaqësimit dhe peshës që ka çdo autor në një vepër të tillë. Për të bërë këtë, duhet parë në rend diakronik dhe sinkronik se si është përfaqësuar dhe ka ardhur Noli në vite dhe periudha historiko-letrare të ndryshme.

Për të bërë këtë qasje janë marrë në konsideratë tre modele të historisë së letërsisë shqipe si: *Historia e letërsisë shqiptare, që nga fillimet deri te Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare* (1983), *History of Albanian Literature* (1995) dhe *Letërsia moderne shqipe* (2009). Në fakt, jo rastësisht janë marrë në shqyrtim këto tre modele, pasi, në rend kronologjik dhe përmbajtësor, i përkasin periudhave kohore të ndryshme për nga këndvështrimi sesi është parë letërsia në vetvete.

E para, pra *Historia e letërsisë shqiptare, që nga fillimet deri te Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare*, e vitit 1983, i takon të jetë e periudhës komuniste dhe është punuar kryesisht nga studiuesit dhe akademikët më me ndikim të periudhës, e që, në mënyrë të kujdesshme, janë munduar të mos dalin jashtë ideologjisë së kohës. Ky vëllim u mor në konsideratë, nga e gjithë shumësia e botimeve për historinë e letërsisë shqipe para viteve '90 për dy arsye: e para, është vepra më e plotë që është hartuar për historinë e letërsisë shqipe që, për arsye të ditura nga studiuesit e letërsisë, me gjithë problematikën që përmbledh, vazhdon të mbetet literatura bazë ose guidë për t'u përdorur nga studentët e më gjerë. E dyta, duke qenë e botuar në vitin 1983, të vjen e besuar se figura letrare e Nolit duhet të jetë e parë mirë dhe e vlerësuar në gjithë komponentët e saj.

Në të vërtetë, kjo vepër, edhe pse e pranuar në vite, përbën një "tragjedi kombëtare", sepse është e mbrujtur me një interpretim primitiv stalinist të socializmit, duke i parë pesë shekuj të shkrimit nga këndvështrimi i luftës së klasave. Ajo i fut, pothuaj me forcë, të gjithë autorët, madje edhe ata të shekujve të mëparshëm, në kategoritë e cekëta të atyre politikisht progresistë dhe politikisht reaksionarë.

---

[170] Floresha Dado, *Probleme të rishkrimit të historisë së letërsisë shqiptare*, Në Studime Albanologjike, Viti XIII, Tiranë 2008, f. 165.

[171] Sabri Hamiti, *Histori e Letërsi*, Në Studime Albanologjike, Viti XIII, Tiranë 2008, f. 173.

Historia e letërsisë e vitit 1983 është e përshkuar tej e mbanë nga një ideologji po aq e dëmshme, ku shkrimi artistik në shqip interpretohet, nga fillimi deri në fund, si një akt patriotizmi. Ndërkohë që kjo, për disa raste, mund të qëndrojë, dhe vërtet ka pasur lidhje të forta, midis rritjes së letërsisë shqipe dhe lëvizjes kombëtare. Mendohej se letërsia e nivelit të mirë duhej të ishte letërsi patriotike, dhe se çdo gjë tjetër ishte e tepërt dhe e panevojshme.

Dhe kjo është fryma ose cektësia me të cilën shikohet një figurë shumëpërmasore si Noli, pra citoj:

"Letërsia, që u zhvillua ndër ne në vitet '20 të këtij shekulli, pati te Noli përfaqësuesin më të shquar. Poezia e tij, e përshkruar nga fryma demokratike luftarake, antifeudale dhe antiimperialiste, u bëri jehonë përpjekjeve të masave të popullit për drejtësi shoqërore dhe për një jetë më të mirë. Noli dha një ndihmesë të jashtëzakonshme në zhvillimin dhe pasurimin e kulturës kombëtare, si poet, publicist, orator, kritik letrar, shqipërues i letërsisë botërore, historian, kompozitor, historian i muzikës, lëronjës i gjuhës letrare, etj. "[172]

Pra, në këtë vepër është shumë e vështirë të kërkosh mbi kritere shkencore të historiografisë letrare, ku vjen më e pleksur se kund tjetër raporti i historisë me letërsinë, në të cilën historia, ajo ideologjike komuniste, përthyhet mbi atë letrare.

Për sa i përket rastit të vitit 1995 nga Robert Elsie, është një model i paramenduar për lexuesin jashtë vendit, që rrjedhimisht i duhet edhe një kornizë hyrëse, për t'u njohur më në brendësi për shqiptarët dhe letërsinë e tyre. Edhe këtu ndeshemi me një parim *historicist*[173] të theksuar, ku mbizotëron qasja e mbështetur në histori për të arritur tek Noli.

Më shumë se sa me vlerat letrare artistike të Nolit, duket sikur Elsie ka marrë përsipër të përshkruajë periudhën historike-kulturore në të cilën ai është pjesë e tij, duke u përqendruar veçanërisht në dhënien me hollësi të detajeve që e përbëjnë atë. Siç e thotë edhe vetë, ai bën një *"overview"*[174], të asaj që në fakt duhet të ishte një motor kërkimi për vlerat artistiko-letrare të Nolit, e që rezulton një histori e momentit historik në të cilin Noli ishte protagonist. Pra, edhe këtu parimi historicist i hartimit të historisë së letërsisë bëhet qenësor.

Në të vërtetë, vepra *Letërsia moderne shqipe*, e botuar si tekst më vete në vitin 2009, është nga të vetmet që i shmanget dukshëm modele të historisë të hartuara më herët, duke u përpjekur të bazohet në kritere më shumë letrare, sesa parimeve historiciste. Që në titull, edhe pse është një histori letërsie, duket kanalizimi që merr letërsia, pra moderne, për t'u përqendruar më së shumti tek vlerat artistiko-letrare. Të vjen e prekshme që S. Hamiti bën një kapërcim të madh, teksa edhe kur vjen momenti që

[172] Botim i Akademisë së Shkencave, *Historia e letërsisë Shqiptare, që nga fillimet deri te lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare*, Tiranë 1983, f. 483.

[173] Floresha Dado, *Sfida Teorike të Historiografisë letrare*, Botimet "Bota Shqiptare", Tiranë 2009, f. 31.

[174] Robert Elsie, *History of Albanian Literature*, Neë York 1995, f. 343.

duhet të cekë jetën e Nolit, e lidh atë me veprën letrare. Gjithashtu, edhe në vijim, është i dukshëm përqendrimi që ka teksti i letërsisë për të përcjellë vlerat e Nolit, por ato thellësisht letrare dhe çfarë vendi zë Noli në Letërsinë shqipe të asaj periudhe kohore (fillimi i shek. XX - deri në vitet ’40), por edhe më shumë, në të gjithë letërsinë shqipe që nga fillimet e saj. Pra, ku qëndron veçanësia e Nolit si shkrimtar në raport me të tjerët, çfarë e dallon, çfarë solli në letërsinë shqipe, cilat janë vlerat artistike të përçuara prej tij e të tjera kritereve të lidhura ngushtësisht me letërsinë duhet të jenë pjesë themelore, përveç kritereve të hartimit të historiografisë letrare, që duhet të shërbejnë për hartimin e një Historie të letërsisë shqipe.

ALBANË MEHMETAJ

DRAMA E FAN NOLIT

1. Drama e Nolit

Fan S. Noli e shkroi dramën e tij të parë dhe të vetme që kemi nga ai, *Israilitë e Filistinë*, në vitin 1902, në Athinë. E botoi më 1907, në Boston, kur në historinë e letërsisë shqipe kishte fare pak drama. Pra, u botua pesë vjet pasi ishte shkruar, meqë autori mendonte ta përpunonte, gjë të cilën nuk e bëri. Veprën ai e quante "foshnjë-dramë" e "sqelet-dramë" dhe e linte të hapur, si një enigmë për shqiptarët, për ta zgjidhura në intepretimin e tekstit.

Drama e Fan S. Nolit është hipertekst i rrëfimit biblik për izraelitët dhe filistinët. Noli ishte rritur me kulturën e religjionit dhe që në fëmijëri e kishte hero Krishtin. Kështu që temat e *Biblës* e kanë ndjekur atë gjithmonë, në të gjitha zhanret. Dramën në fjalë Noli e ka shkruar në moshën 20-vjeçare, si vepër të parë të tijën, me të cilën ka përçuar ide dhe pikëpamje biblike, të përkthyera si pikëpamje politike dhe humane. Ide të ngjashme ka zhvilluar edhe në poezinë e tij. Në njëfarë mënyre, duke pasur parasysh ambicien e autorit dhe veprimtarinë e tij të mëvonshme, vepra i është kushtuar edhe aktualitetit në të cilën ka jetuar ai. Por, rëndësia e kësaj drame qëndron në enigmën që shtron autori vetë dhe në idetë e veprës. Drama e Fan Nolit është një vepër e ideve dhe personazhi i saj, Samsoni, është bartës i një ideje që duhet t'u thuhet të tjerëve.

"Israilitë e Filistinë" idetë e autorit e universalizojnë dhe e bëjnë dramë të situatave, në të cilat mbrohen identitetet përballë të vërtetave të tjetrit. Në të vërtetë, krahas dilemës që lë autori, ne e konsiderojmë si vepër të kryer, meqë mesazhi përcillet dhe merret i plotë. Për këtë shkak, ne do ta analizojmë strukturën e kësaj drame, si dhe do t'i interpretojmë idetë themelore, për të fituar një pamje të kësaj vepre.

2. Hipoteksti biblik

Fan S. Noli "*Israelitë e Filistinë"* e shkroi duke e marrë temën nga *Bibla*, rrëfimin mbi Samsonin. Rrëfimi ndodhet në *Librin e gjyqtarëve*, ka për titull emrin e heroit, Samsonit, dhe përbëhet nga këta nëntituj: "Lajmi i lindjes së Samsonit", "Shfaqja e dytë e engjëllit", "Martesa e Samsonit", "Gjëegjëza e Samsonit", "Samsoni i djeg të korrat e filistenjve", "Nofulla e gomarit", "Ngjarja me derën e Gazës", "Samsoni tradhtohet prej Dalilës", "Hakmarrja dhe vdekja e Samsonit". Për ta parë sa më saktë burimin bazik të Nolit, po e parafrazojmë rrëfimin biblik, që është fabula bazë e dramës së autorit tonë.

Në këtë rrëfim populli izraelit është dënuar nga Zoti që të rrijë nën robërinë filistine për dyzet vjet. Shkaku, siç shkruhet, është për një të keqe që kanë bërë të parët,

izraelitët. Konkretisht njoftohemi për një luftë dhe urrejtje ndërmjet dy popujve. Ngjarja ndryshon. Gruas së Manuehut prej Sarasë, fisit të Danit, i dëftohet engjëlli i Zotit:

"*Ja, pra, je barkshuar, e pa fëmije. Por do të ngjizësh e do të lindësh një djalë. Pra, kujdes, mos pi verë as pije dehëse dhe mos ha asgjë të papastër, sepse do të ngjizësh e do të lindësh një djalë. Kryet e tij të mos e prekë brisku rrues: sepse fëmija qysh në kraharorin e nënës do të jetë i kushtuar Hyjit-nazaré-dhe ai do të filloj ta shpëtoi Izraelin prej dorës së filistenjve*" (1 - 309 - *Bibla*).

Lind pra Samsoni, i bekuar nga Zoti, me fuqi mbinjerëzore, për t'i pushtuar filistinët. Samsoni fillimisht kërkon të martohet me një grua filistine. E vendos Zoti këtë rrugë nëpërmjet të të dërguarit të tij, për të kërkuar shkas ngatërrese, me filistinët. Rruga për te vasha e zgjedhur filistine është e mbushur më shumë rreziqe. Samsoni i tejkalon të gjitha, me fuqinë që ka, duke e marrë gruan e dëshiruar. Në festën e dasmës, të pranishmëve, filistinëve, Samsoni ua hedh një gjëegjëzë:

"*Po ju tregoi një gjëegjëzë dhe, nëse ma zbërtheni brenda shtatë ditëve të gostisë do t'ju jap tridhjetë zhguna dhe tridhjetë petka ndërrimi; po në qoftë se nuk do të mund ta shtjelloni, atëherë do të me jipni ju tridhjetë zhguna e po aq petka ndërrimi. Ata iu përgjigjën: tregoje gjëegjëzën ta dëgjojmë. E ai u tha:*

Prej atij që ha, doli ç'hahet

Prej të fortit doli ëmbëlsira. (2 - 310 - *Bibla*)

Gruas se Samsonit i bëjnë presion bashkëvendësit e vet, që ta marrë përgjigjen nga i shoqi, e t'ua tregojë këtyre. Pas shumë përpjekjeve të gruas, Samsoni ia zbërthen gjëegjëzën asaj e ajo filistinëve dhe ata përgjigjën:

"*Ç'është më e ëmbël se mjalti*

ç'është më i fortë se luani? "

Do të thotë, Samsoni tradhtohet nga gruaja. Ai e kupton, por mban premtimin që e ka bërë dhe kthehet te shtëpia. Pas një kohe, shkon ta shohë gruan, të cilën babai i saj e kishte martuar me një tjetër. Samsoni hidhërohet, hakmerret, duke ua djegur filistinëve të gjitha të mbjellat. Filistinët kur e marrin vesh arsyen e djegies, vrasin babën dhe gruan e Samsonit. "Atyre Samsoni u çoi fjalë: "*Pasi bëtë ashtu, unë nuk do të pushoj derisa t'ju hakmerrem. I vrau e i copëtoi e bëri kërdi në ta dhe mandej shkoi të jetojë në shpellën e qetës Etam. "* (3 - 311- *Bibla*) Filistinët, pas shumë përpjekjesh, e zënë Samsonin, por ai pushtohet nga shpirti i Zotit dhe gjithherë shpëton. Ai është gjykatës i izraelitëve për njëzet vjet. Samsoni kalon nëpër shumë kurthe të filistinëve, nëpër shumë sprova, por gjithmonë del fitimtar. Ai është i dërguari i Zotit, ka përkrahjen e tij. I dërguari, i përkrahuri i Zotit, në *Bibël* gjithmonë mposht çdo të keqe. Rrëfimi merr kahe tjetër kur Samsoni dashurohet njëmend me një grua filistine, Dalilën. Por, përsëri armiqtë e tij, filistinët, lusin Dalilën që ta zbulojë fuqinë e Samsonit, duke i premtuar një mijë e njëqind monedha argjendi nga secili. Dalila joshet nga pasuria, pranon detyrën dhe, pas shumë përpjekjesh, e zbulon të fshehtën e fuqisë së Samsonit. Fuqia ndodhet në flokët e tij. Ajo kryen detyrën e vet, duke ua treguar këtë zbulim bashkëvendësve të saj.

"*Kur pa Dalila se ia kishte hapur krejtësisht zemrën e tij, çoi t'i thërisnin krerët e filistinëve e u tha; Ejani vetëm edhe kësaj here, se tani ma ka zbuluar krejt zemrën e*

vet. Ata erdhën e me vete i morën paratë, që ia kishin premtuar. Ajo e vuri në gjumë mbi gjunjët e vët, thiri një rrustar dhe ia rroi shtatë bishtalecat e tij e zuri ta vërë në lojë: sepse forca u largua menjëherë prej tij! Kur i doli gjumi tha vet me vete: Do t'ia dal si i bëra më parë e do të çlirohem, sepse nuk e dinte që Zoti ishte larguar prej tij. E kapën filistenjtë, ia nxoren sytë dhe e çuan në Gazë. E lidhen me dy palë hekura të bronzta dhe e ndryen në burg. Aty sillte gurin e mullirit" (313 - *Bibla*)

Samsoni u burgos nga filistinët, u verbua dhe u përqesh. Kur filluan t'i rriten flokët dhe po shkonte t'i zbaviste filistinët, iu lut Zotit që t'ia kthente edhe njëherë fuqinë, e t'u hakmerrej atyre: "*O zot, Hyj, të bjerë ndërmend për mua! Ma kthe vetëm edhe kësaj forcën e mëparshme o Hyj, që t'u hakmerrem filistenjëve njëherë për dy sytë e mi!* (4 - 313, *Bibla*) Kështu, Samsoni rimerr forcën vetëm sa për të rrënuar tempullin filistin, duke vrarë veten dhe rreth tre mijë burra e gra që kishin ardhur për ta parë atë të robëruar: "*I kapi dy shtyllat e mesme, mbi të cilat mbështetej shtëpia, njërës i vuri dorën e djathtë, tjtrës së majtën, e tha: Le të mbarojë jeta ime me filistenj!* (5 - 313 - *Bibla*)

Parafrazuam kështu rrëfimin biblik, temën e të cilit autori ynë e rimerr në dramën e tij. Shihet se rrëfimi u ndërtua mbi pikëpamjet e dy kulturave të ndryshme, që kishin dy besime të ndryshme, izraelitëve, që besonin në Zotin e vërtetë, monoteizmin, dhe filistinëve, që njihnin politeizmin. Samsoni është i dërguari i Zotit, i cili ngjizet në gruan e përzgjedhur nga vetë Hyji. Samsoni është hero izraelit, me fuqi mbinjerëzore dhe lufton për ta shpëtuar popullin, që është nën sundimin dyzetvjeçar të filistinëve dhe për ta ngulitur ndër ta besimin në Zotin e vërtetë. Por, ai mashtrohet nga Dalila filistine, duke zbuluar fuqinë, të fshehtën e Zotit. Prandaj, Zoti e dënon me vdekje, të cilën Samsoni e dëshiron ta ketë bashkë me filistinët. Mesazhi biblik: Parimisht populli izraelit është i dënuar për një të keqe që ka bërë, pastaj i dërguari i Zotit nuk i bindet plotësisht atij, tradhton besimin e tij, dhe natyrisht që do të dënohet dhe rrëfimi do të përfundojë tragjikisht.

Tani do ta shohim se si e ndërton këtë temë Noli në dramën e tij.

3. Hiperteksti i Nolit

Drama e Nolit *Israilitë dhe Filistinë* përbëhet nga tri akte, të cilat ndahen në skena, pamje. Ngjarja në aktin e parë zhvillohet në Jerusalem, në të dytin dytin në shtëpi të Daliles, ndërsa në të tretin në Gaz, në tempullin e Baallit. Personazhet e dramës janë: Krye-Rabib'i i Judenjëvet, Rabini-i, Samsoni-i, Sarra, e jëma, Rahil, e fejuara, Dalia, grua Filistine, Kryeprift'i i Filistinëve, Mbret'i i tyre, Një mëmë Judenje me një djalë, Judenjët dhe Filistinët. Komunikimin ndërmjet tyre autori e realizon kryesisht në dialogë dhe me përshkrime të veprimeve dhe të lokacioneve në të cilat veprojnë ata. Dialogu ndërmjet tyre bëhet pa ndërhyrje autoriale, kështu që ngjarja duket shumë reale, duket sikur po ndodh tani. Gjithashtu edhe ambienti ku zhvillohet ngjarja përshkohet me konkretizime. Natyrisht që drama duhet ta ketë konfliktin, gjë që Noli e konkretizon që në aktin e parë, pas një përshkrimi të shkurtër.

Në pjesën e parë ngjarja zhvillohet në Sinagogën e Judenjëve, ku parësia është mbledhur që t'ia japë bekimin Samsonit, i cili merr detyrën që t'i kthyer në rrugë të

drejtë filistinët. Rrugën e Samsonit e kishin provuar shumë bashkëvendës të tij, para tij, por pa sukses. Samsoni, si i shenjtëruar nga Zoti me fuqi dhe mendje, merr përsipër të kryejë një mision, të përhapë të vërtetën. Në këtë akt zhvillohet një bisedë rreth këtij misioni të nisur nga personazhi kryesor, Samsoni, ku shprehen bindje të ndryshme e mospajtime. Personazhi që nuk pajtohet është Rabini. Ai idesë së Samsonit, pra të vërtetës së fjalës, i kundërvihet me idenë se filistinët duhet të vetëdijesohen me anë të forcës. Tridhjetë vjet më parë vetë Rabini kishte marrë të njëjtën detyrë, por ishte mundur nga bota filistine, nga paratë dhe femrat e bukura. Kështu që ai mendon që e vërteta duhet të aplikohet me njerëzit e vërtetë dhe nuk beson që duhet të shqyrtohet me filistinët. Ai mendon se Samsoni nuk duhet të shkojë vetëm më të vërtetën, me idenë e së mirës, por të shkojë më të edhe populli me shpatë në dorë. Sipas tij, nuk mund të ketë bindje pa forcën e detyrimit. Samsoni nuk pajtohet me Rabinin. Qëndrimi i tij thuhet kështu: "*Dua t'a përhap mi gjithë Botën dhe asnjë fuqi nuk munt të më qëndrojë. Dua t'i mësoj Filistinët të kqyrin Perëndinë brënda në Ntyrë dhe Përjetësinë në Dashuri"* (6 - Fan Noli - 199) Samsoni merr pëlqimin e së ëmës dhe të dashurës, Rahiles, dhe niset për te filistinët.

Në aktin e dytë Samsoni gjendet në botën filistine, në shtëpi të Daliles. Mbreti filistin e lut Dalilën e bukur që ta mashtrojë Samsonin, ta pushtojë, që ta shpëtojnë popullin nga ai. Të vërtetën e Samsonit mbreti filistin e quan "marrëzirat e besës së tij". Mbreti lut Dalilën që ta kryejë këtë detyrë, duke thënë që as një fuqi njerëzore nuk mund ta luftojë Samsonin. Lut Dalilën që ta shpëtojë atdheun. Dalila pranon detyrën dhe motivohet më shumë kur beson që, pasi ta pushtojnë Samsonin, do ta marrë burrë për vete.

Samsoni pushtohet vetëm nga dashuria e Dalilës. Kur bie në gjirin e dashurisë së saj, harron misionin, harron dashurinë e parë, Rahilen, dhe i zbulon të dashurës sekretin e fuqisë që e ka në flokët e gjatë. I dehur nga vera, i dehur nga bukuria dhe dashuria e Dalilës, Samsoni bie në duart e filistinëve. Ata e qethin, ia humbin fuqinë, e lidhin dhe e verbojnë. Vetëm pasi Dalila e refuzon si të dashur, Samsonit i kujtohet Rahilja dhe kur e verbojnë dhe e përqeshin, i kujtohet Rabini.

Akti i tretë zhvillohet në tempullin e Baallit e Malohut, dy perëndive filistinë të pasurisë e të dashurisë. Aty janë të mbledhur filistinët, burra, gra, mbreti, priftërinjtë, të gëzuar nga fatkeqësia e Samsonit. Skena është e mbushur me këngë, valle e verëra. Fillimisht shfaqet mbreti: "*Ejani, Filistinët e mi, gëzohuni dhe dëfreni, armiku një më i madh gjendet nër duart t'ona i verbër, i pa fuqishëm, këtë ditë le t'a kemi si të kremte që të na hikë frika e Perëndisë së Israilit. Molohu-u triumfon. "* (7 - 222, Noli) Filistinët të bashkuar dhe të gëzuar mallkojnë Samsonin, që donte t'ua mësonte të vërtetën e huaj për ta. Ata i besojnë Perëndive të tyre dhe vetëm ato ua bëjnë jetën të lumtur. Akti i tretë pothuajse deri në fund ndërtohet mbi gëzimin e filistinëve, duke e parë të humbur Samsonin. Gjersa në aktin e parë parësia izraelite është mbledhur t'i japë bekimin Samsonit, në aktin e tretë parësia filistine mblidhet që t'i japë mallkimin. Skena pasurohet nga biseda të ndryshme të mbretit, priftërinjve, kryepriftit. Fokusohet edhe Samsoni i lidhur dhe i penduar, duke i dhënë të drejtë Rabinit: "*Ah! Se sa të drejtë kish. Lipsej të vinja me ushtëri Israilitësh dhe t'a diqnja, t'adërmonja gjithë këtë*

Botë të kalbur e të gënjeshtërme. Ah, me sa gëzim do t'a bënja tani, të më vinte dorësh". (8 - 227, Noli)

Samsonit nis t'i kthehet fuqia, kur fillojnë t'i rriten flokët. Thërret Rahilen e Dalilën të largohen nga tempulli dhe vdes bashkë me filistinët, duke e rrënuar tempullin me forcën e rigjetur. Duke e parë veten se është bërë si ata, Samsoni vdes bashkë më filistinët, duke i ftuar të vdesin së bashku, qafë për qafe.

Nga vështrimi që i bëmë fabulës së rrëfimit origjinal biblik dhe dramës së Nolit, shohim se në përgjithësi autori ka ndjekur ndodhinë biblike. Por, pa dyshim, teksti i Nolit, përveç pikëtakimeve, ka edhe diferenca, të cilat edhe do t'i shqyrtojmë. Fillimisht po themi se në rrëfimin biblik Rabini nuk ekziston, është figurë plotësisht e krijuar nga Noli, me të cilin universalizon një ide më të madhe. Pra, në rrëfimin biblik nuk e kemi fare polemikën ndërmjet dy izraelitëve.

Për krahasim po portretizojmë heroin kryesor të të dy teksteve, Samsonin, dhe shkakun e konfliktit. Në tekstin biblik Samsoni hyn në librin e gjyqtarëve. *"Gjyqëtarët këtu kanë kuptimin e personave që janë udhëheqës të pajisur me pushtetet ushtarak e civil. Këta kanë edhe një veçori: janë njerëz posaçërisht të ngritur prej Zotit për të shpëtuar një fis a shumë fise të popullit të Izraelit, kur ky bjen nën pushtimin e popujve idhujtarë fqinjë. Janë pra çlirimtarë, heronj, të kohës ndërmjet jozuehut dhe formimit të monarkisë izraelite. "* (9 - 290, *Bibla*) Në kapitullin e Samsonit teksti fillon duke u theksuar që Zoti i lë izraelitët në duart të filistinëve, për një të keqe që kanë bërë. Samsoni këtu vjen si gjyqtar, i zgjedhuri i Zotit, për t'i kthyer filistinët kah Zoti. Edhe në dramën e Nolit shënohen dy popujt që përfaqësojnë dy kultura të ndryshme, që njëra do ta imponojë atë të veten. Edhe këtu Samsoni është i zgjedhuri i Zotit e i Nolit, për të treguar rrugën e kthimit nga Zoti. Te teksti i parë Zoti paralajmëron lindjen e Samsonit, paralajmëron fuqinë e tij, shkurtimisht paralajmëron që është i dërguari i tij. Këtu përshkruhet lindja, rritja dhe rrugëtimi i tij që nga fillimi. Samsoni në rrëfim biblik i ka të dy prindërit. Te teksti i Nolit Samsoni shfaqet i rritur dhe i vetëdijshëm, bashkë me të ëmën dhe të fejuarën, duke marrë uratën për një mision. Për dallim Samsoni biblik është figurë më e vrazhdë, njeri më fuqi të panatyrshme, që ecën pothuajse pavetëdijshëm, vetëm nën ndikimin e Hyjit. Ai i ndëshkon shumë filistinët sa edhe vetë izraelitët provojnë ta lidhin dhe t'ua dorëzojnë filistinëve. Përshkruhet si njeri i tregimeve epike, kur vetëm forca kryen punë. Samsoni i Nolit duket qartë figurë më e ndërtuar, për nga fuqia dhe mendja, duke e kultivuar idenë e së mirës, idenë e një "të vërtete" që duhet t'ua imponojë të tjerëve.

Në rrëfimin bazë, ngatërresa me filistinët fillon kur Samsoni martohet me një filistine, ngreh një gjëegjëzë për filistinët, që zbulohet nga mashtrimi i së shoqes. Samsoni hidhërohet, djeg të korrat e tyre dhe në fund hakmerret duke i vrarë shumë nga ata. Në dramën e Nolit misioni fillon në mënyrë shumë më paqësore, me zgjedhjen e rrugës së bindjes me anë të fjalës. Ai shkon në tempujt e tyre me mënyrën më njerëzore, duke u bërë të ditur kërkesën e tij. Mirëpo, edhe pse në tekstin biblik, ky vendim duket më luftarake, kjo është zgjedhje e Zotit. Për më shumë po e ilustrojmë këtë pjesë: "*Por Samsoni iu përgjigj t'et: Ma merr atë, se ajo më pëlqen. Prindërit e tij nuk e dinin se kjo gjë bëhëj prej Zotit, i cili kërkonte shkas ngatërrese me filistnej"* (10 - 310, *Bibla*) Nga ky përshkrim shohim edhe një dallim tjetër, nga drama e Nolit,

që Samsoni biblik martohet me një filistine, para se ta njohë Dalilën. Samsoni biblik mashtrohet dyfish, tradhtohet nga dy gra filistine. E para i kërkon zbërthimin e gjëegjëzës, e dyta burimin e forcës. Në këtë kontekst edhe heroi i Nolit ndryshon, sepse është i fejuar me Rahilen. Mirëpo Samsonit biblik gruaja e parë i vdes, ia mbysin. Samsonit të dramës gruaja e parë i gjendet pranë gjer në çastin e fundit të jetës.

Gjatë analizës së tekstit biblik ndeshëm edhe dy fenomene të tjera, që i përgjigjen tregimeve epike, krahas dramës së Nolit. Është historia e gjëegjëzës dhe e nofullës së gomarit. Këto dy histori motivojnë ngjarjen edhe më shumë në *Bibël*. Samsonit biblik, kur futet në botën filistine, i del para zogu i luanit, të cilin e mposht. Por, pas disa ditëve, kur kalon afër luanit të vrarë, sheh skemën e bletës në trupin e luanit dhe fashollin me mjaltë, të cilën e hanë rrugës. Këtu e ka burimin edhe parashtrimi i gjëegjëzës së tij, të cilën e kemi parafrazuar më lart. Gjëegjëza bëhet këtu edhe mollë sherri i konflikteve të mëtutjeshme: gruaja e parë e mashtron dhe më pas babai i saj e marton atë me një filistin, Samsoni djeg të gjitha të korrat e filistinëve, gruan ia mbysin, dhe në fund heroi bën kërdinë mbi ta. Samsoni letrar nuk i ka këto telashe. Sa i përket nofullës së gomarit, në dramën e Nolit përmendet njëherë:

"Dalile

Hardhë me nj'cop'heresh! As nuk i mora vesh. Po ç'të ha malli tani, i vrave të gjithë?

Samson

Po! me një nofull gomari." (11 - 217, Noli)

Ky është teksti biblik që bën të kuptojmë që "nofulla e gomarit" përdoret si simbolikë e forcës, konkretisht si mjet i forcës së Samsonit:

"Me nofull gomari

Mogilë i bëra!

Me fuqi gomari

Vrava një mijë burra!" (12 - 311, *Bibla*)

Pasi po kërkojmë diferencat e dy teksteve që po shqyrtojmë, duhet të përmendim edhe dallimin në përshkrimin e takimit të Samsonit me Dalilën. Derisa në rrëfimin biblik Samsoni takohet rastësisht me Dalilën, në dramën e Nolit heroi niset drejt në shtëpi të saj, i dehur nga zëri i saj ende pa u nisur për mision. *"(Dëgjon këngën më çudi e me mall, zëmra me mëntë i luftojnë brenda) Bota me heq!"* (12 - 205, Noli) Janë këtë fjalët dhe ndjenjat e Samsonit, para se të nisej në rrugën e së vërtetës. Me gjithë ngjashmëritë, dallon në disa nuanca edhe shkaku i mashtrimeve të Samsona-ve, dallon metoda që përdorin gratë, dallon qëllimi i Dalila-ve. I pari tregon sekretin, pasi lodhet nga presioni dhe ngacmimi i së dashurës, ndërsa i dyti tregon duke qenë i dehur nga pija. Janë këto dy arsyet anësore, sepse që të dy janë të dehur nga dashuria. Dallime ka edhe në procesin e të treguarit të sekretit, i pari mashtron disa herë të dashurën, derisa sekretin i dyti ia tregon rrëshqitazi.

Ndërsa, sa u përket grave, e para mashtron për para argjendi, ndërsa e dyta mashtron duke besuar se Samsoni do të bëhej i saj dhe si përkushtim atdheut. Për më tepër, nga leximi i të dy teksteve, mund të themi se dashuria e Dalilës biblike dhe në përgjithësi e të dy protagonistëve, është e varfër krahas Dalilës dhe Samsonit nolian.

Dy Samsona-t përfundojnë të tradhtuar, verbohen dhe u humbet fuqia. Edhe mënyra se si vdesin është e ngjashme. Rimarrin fuqinë pasi u rriten flokët dhe shembin tempullin. Për dallim që i pari thërret Hyjin për t'i mbytur filistinët, pasi shpirti i tij pushtohet nga Zoti. Që të dy duan të vdesin së bashku me filistinët, pasi që konsiderojnë se janë bërë si ata. Samsoni i dramës diferencohet në këtë aspekt pasi thërret dy dashuritë, Rahilen dhe Dalilën, që të ikin nga tempulli, që të shpëtojnë. Samsoni biblik nuk e thërret Dalilën, ndërsa Rahilja as nuk ekziston në atë rrëfim. Rreth shkakut të vdekjes së tyre, mund të themi se edhe drama, edhe rrëfimi biblik mund të konkretizohen më mirë me *Librin e gjyqtarëve*:

"Libri i mësonte izraelitët se ndëshkimi është rrjedhim i pasbesnikërosë, kurse ngadhënjimi mbi armikun fryt i pendimit e i kthimit te Zoti." (13 - 290, *Bibla*)

Në këtë këndvështrim, pra të përfundimit, është e rëndësishme të përmendet edhe mënyra e sjelljes së Dalilave, gjatë përfundimit tragjik të të dashurve të tyre. Derisa ajo biblike nuk përmendet fare pas gjykimit të Samsonit, ajo noliane nuk e do më Samsonin, pasi ai humb fuqinë.

Siç shihet nga ky konkretizim i shkurtër, gjatë vënies përballë të situatave, figurave qendrore, atmosferës, lokacionit, motiveve të të dy teksteve, biblik dhe nolian, mund të themi se drama e autorit tonë dallon në shumë aspekte tekstore, duke filluar që nga struktura e deri te protagonisti kryesor, sa arrijmë që të njëjtin personazh, Samsonin, t'i quajmë Samsona-t. Njëherësh mund të themi se drama e Nolit edhe e pasuron mitin për Samsonit. Natyrisht që drama lëndën e ka marrë nga mitologjia biblike.

4. Samsoni dhe Dalila

Akti i dytë i dramës së Nolit ndërtohet pothuajse i tëri nga një histori dashurie midis dy heronjve të dramës, Samsonit dhe Dalilës. Në këtë akt gjejmë pjesën më të bukur të dramës, gjejmë dialogët më origjinalë, me plot pasion e dashuri, gjejmë shenjat më të forta autoriale. Rrjedha e veprimit këtu merr përmasa shumë emocionale, sidomos kur kemi përpara një trim me forcë të panatyrshme, i patrembur para askujt dhe i përkulur vetëm para dashurisë. Gjithë këtë emocion, gjithë këta dialogë dashurie i fuqizon bukuria e Dalilës. Por, pjesën finale të këtij emocioni e ndërton sinqeriteti i dashurisë së Samsonit dhe pamundësia për ta mposhtur atë para një detyre që ka.

Megjithëse e tërë drama është e shtruar si dilemë, ky akt përbën një dilemë në vete, a e do Dalila Samsonin, apo po e zbaton marrëveshjen që bën me mbretin? Shikuar në këndvështrimin se çfarë strategjie përdor Dalila, në çfarë mënyre mashtron ajo, teksti të shtyn të mendosh se është një mashtruese, por Dalila e dashuron Samsonin. Kujtojmë dialogun që ajo bën me mbretin:

"Dalila

Unë të kërkonj gjëkafshë përveç Samson-në, ju zotohem t'i bënj ç'të më thoni, po do mos e vrisni, do t'm'a ipni mua të lidhur, gjer sa t'a bind unë të më marrë për grua dhe të rrpnj si Filistin këtu bashkë me ne." (14 - 208, Noli)

Kjo tregon që Dalila e dashuron Samsonin, e do për vete, në vendin e saj. Vetëdijshëm ose pavetëdijshëm edhe Dalila i shërben atdheut të vet, edhe ajo kryen një mision, duke e vë në kurth një njeri që për mbretin e vet: "*S'na le më rehat ky*

njeri, po ardhi të bënjë fat-zezë një botë të tërë me të Vërtetat që lëçit" (15 - 207, Noli)

Dalila, në dramë, pasqyron vajzën e bukur, vajzën e cila dhe me këngën dhe bukurinë, hiri i së cilës rrënon një ide, rrënon një misionar, dhe ndoshta ndërron një histori të tërë. Nga ana tjetër, Dalila del edhe si një grua e bukur, që dashuron një trim mbi trima. Është naive kur mendon që Samsonin do t'ia dorëzojnë ta mbajë për vete. Mëdyshja e dilemës se a dashuron Dalila shfaqet përsëri në dialogut që ka në fund me Samsonin:

"Dalila

Unë të doja sa ishe trim dhe kishe duar të forta të më shtrëngonje më qafë dhe t vrisje Filistinë, tashi ç'të bënj? Pas pak ore, do jesh i verbër dhe mua munt të më gëzonet vetëm ay që i ka të shëndosha syt'e trupit. (ikën)" (15 - 220, Noli)

Përgjithësisht mund të themi se ky dialog provon edhe njëherë se Dalila është një *grua*. Nuk ka të bëjë me dilemën e parashtruar. Dalila dashuron trimin dhe nuk e dashuron humbësin, që do të thotë se edhe dashurinë e ka naive, pasi që dashuria nuk njeh kritere të tilla, nuk njeh veti të tilla e për më tepër nuk njeh fuqi.

Ndryshe nga Dalila është Samsoni. Ai dashurohet që në çastin e parë me Dalilën, dashurohet në këngën e saj, e dashuron edhe kur merr vesh për tradhtinë e saj:

"Dalilkë! Ku je? s'dëgjon se ç'duan të më bëjën? për ty i pësoj të gjitha këto! Po prapë të dua. Prapë të kam mall me gjithë sobësinë t'ime. " (16 - 220, Noli)

E do edhe në fundin e jetës, duke kërkuar që ajo të shpëtojë:

"Të dua, se këtu në Botë e gjeta prapë fuqinë t'ime dhe munt të vras dhe tani si më parë, dhe kur vras të dua dhe me do! Eja të të puth, pa hikë shpjet që këtejza. Pra kur djell'i nderkës ndriton dhenë, kujto se Samson-i të puthi një herë dhe humbi gjithë fuqin'e tij. Dalile, moj Dalile. " (17 - 223, Noli)

Dashurinë si një ndjenjë shpirtërore, të pastër, hyjnore, e provon më së miri Samsoni. Ndjesia për dashurinë ndaj Dalilës, ia prish idenë e së vërtetës: "*Ah! Moj Dalilkë! Përpara teje ndjenj të më mpaket fuqia pandeh se dëbier udhën"*. Me gjithë lidhjen që ka me Zotin: "*Perëndia na dha shpirtin si udhë-heqës së rrojtjes së Vërtetë, dhe zëmrën si rufjan të së gënjeshtërme. Në vafshim pas zemrës, prishemi, në vafshmi pas shpirtit dëbierim udhën e qëllimit së rrojtjes. Cili ka të drejtë? . . . .* Me gjithë misionin që ka përpara dhe të dashurën hija e së cilës e ndjek: "*Sepse ndërmjet nesh është hij"e Rahilesë, ajo do të më shpierë nër qiejt, dhe ti në dhe të vulpteçin. Sepse përpara syve kam koret e priftërinjvet t'atdheut që më thonë: përpara! përpara! (ngrihet ikën).* Samsoni bie në prehrin e ëmbël të Dalilës, pushtohet nga dashuria e saj.

5. Israilitë e Filistinë

Thelbi që krijon konfliktin tragjik në dramën e Nolit është ndeshja e dy kulturave të ndryshme, është përpjekja e izraelitëve për t'i detyruar filistinët të ndërrojnë besimin e tyre politeist, në atë monoteist. Do të thotë, dramatizohet përplasja e këtyre dy kulturave të ndryshme, ku njëra do ta imponojë veten, besimin e vet,

etikën e vet, të vërtetën e vet. Prandaj, edhe dramën e Nolit e quajmë dramë të ideve. Bartës i idesë është Samsoni, si figura themelore e veprës.

Tematika e dramës është marrë nga mitologjia biblike, por të cilën Noli e ka ngritur mbi çështje të brendshme shqiptare. Ndodh kështu pasi që rrëfimi në tekstin biblik përfundon shumë qartë: Samsoni nuk ndjek siç duhet rrugën e Zotit dhe në fund ndëshkohet nga ai, si edhe çdo rrëfim tjetër biblik. Te Noli drama merr përmasa të tjera. Teksti i tij arrin një kuptim të ri ideor. Tejkalon domethënien biblike, duke e realizuar në një jetë njerëzore. Samsoni i Nolit është personazh i subjektivuar. Që në moshën 20-vjeçare, Noli ka përcjellë situatën e vendit, duke e bërë që me këtë dramë të ngrejë çështjen se si duhet thënë e vërteta: me fjalën e Zotit, Samsoni/Noli, apo me forcë, Rabini si njeri në moshë e me përvojë. Në dramë fiton mundësia e dytë, pra është forca ajo që mund ta imponojë të vërtetën. Normalisht, kjo mundësi është përdorur nga Noli vetëm si tezë, si enigmë, sepse ai ka provuar në dramën e tij mundësinë e parë, ka përdorur "fjalën e së vërtetës". Qëllimi i tij ishte kërkesa për theksimin e idesë.

Noli dramën e ka parashtruar si enigmë, duke e lënë me mundësi të ndryshme interpretimi nga vetë lexuesit. Prandaj, dramën mund ta shtrojmë edhe në një çështje tjetër. Samsoni duhet të simbolizojë një ide, që duhet t'u imponojë edhe të tjerëve. Ai është i zgjedhuri i Zotit, prandaj edhe nuk duhet të mposhtet nga asnjë e ligë. Ai është misionari, por, në kundërshtim me këtë rregull, ai mundet nga dashuria. Mundet nga bukuria e vashës, mundet nga vera, mundet nga jeta njerëzore. Dashuria këtu del si esenë e jetës. Samsoni nuk mundet nga asnjë forcë, është me fuqi të panatyrshme njerëzore e mendore, por mundet nga dashuria. Dashuria është forca më e madhe, që tejkalon çdo kufi.

Për më tepër, drama në vete implikon çështje që kanë interes edhe sot. Do të thotë janë këto dy tema përherë aktuale: diskutimi se si duhet imponohet e vërteta, forca, apo fjala e paqes, dhe mbi të gjitha dashuria si e vërtetë e të vërtetave.

BRUNA NURA

NOLI PËRMES SIMBOLIKAVE BIBLIKE

Noli parë përmes simboleve biblike është një lamie e punuar dendur. Në këtë punim gjakimi është të zbulohet zëri i unit poetik. Thënë kjo, ideja e parë që vjen është një panoramë simbolesh, të rifunksionalizuara në kontekstin e mesazhit. Duke qëndruar në skemën

Kodi

Dhënësi Mesazhi Marrësi

Konteksti

Le të përqëndrohemi tek kodi dhe mesazhi dhe gjakimi per dekodifikim. Me formim kristian, ortodoks, Noli nuk mund t'i shpëtonte ndikimeve biblike. Kjo vërehet në sa vijon në një gamë relativisht të gjerë të simboleve me tharm biblik, të cilat janë edhe me elemente te theksuara autobiografike. Poezitë e marra në shqyrtim do të jenë: Moisiu në Mal; Marshi i Krishtit; Krishti me Kamçikun; Shën Pjetri në Mangall; Marshi i Barabbajt; Marshi i Kryqësimit; Kirenari dhe Kryqesimi. Elemetet biblike në këto poezi janë: Moisiu, Perëndia, Palestina, Jehovaj, krye – profet, Zot, Nazaret, Betlehem, lum' i Jordanit, Jerusalemi, Mal i Sionës, Bethsaidaja, Golgothaja, bir i Davidit, njeri – Perëndi, Jesu, Mesi, Shën Pjetri, Barabbaj, stërnip i Kainit, Kryqësim, Kryq, Mari. Në vështrim të parë statistikor vërehet fakti se ka një mesatare prej rreth tri elementesh për poezi. Pyetjet që shtrohen: Kush është Krishti? Kush është Moisiu? Ç'është kamçiku, ? Kush është Shën Pjetri? Kush është Barabbaj? ç'është kryqi dhe kryqësimi? Kush është Kirenari? Për të mbërritur këtu na nevojitet një analizë, e cila këtu do të ketë vetëm fillimin dhe nuk pretendon të jetë shteruese. Noli krijon kështu një lloj bible poetike, por nuk është larg as një ditari politik, Krishti dhe Moisiu mund të jetë paraprakisht uni poetik, e uni poetik të jetë vetë Noli, sipas edhe një nga hipotezat e shtruara nga Remo Ceserani ne veprën "Il testo poetico". Shën Pjetri, miqtë që tradhtuan, Barabbaj tradhtari i idealit kombëtar. Në këto poezi Krishti është ai që vendoset në disa raporte; me Kryqin, me Shën Pjetrin, Kirenarin, Barabbajn, me Moisiun, me kamçikun. Dallohen dy lamie, raportet e sipërpërmendura janë a) brenda të njejtës poezi, por edhe b) në poezi te ndryshme.

Raportet brenda të njëjtës poezi: Krishti me Kamçikun, Krishti me kryqin, Krishti me kryqësimin, Krishti me Shën Pjetrin

Raportet në poezi të ndryshme: Krishti me Moisiun, Krishti me Shen Pjetrin, Krishti me Barabbajn, Krishti me Kirenarin.

Sigurisht raportet brenda të njëjtës poezi janë edhe ato më të dendurat dhe me intensitet më të lartë veprimi. Kjo e fundit kthehet edhe në një element dallues të poetikës së Nolit. "Peshkopi – Poet", sipas një emërtimi të Kutelit; vërejme rendin e fjalëve në togfjalësh, jo poeti - peshkop, por e anasjellta, dallohet për poezi të veprimit, poezia e tij nuk është poezi meditimi dhe kjo është vepruese. Në ndihmë të

kësaj hipoteze duke qendruar në një vështrim statistikor, mjafton te vërehet edhe një detaj, fakti që në tetë poezi, në tri prej tyre është fjala ‘’Marsh’’ që në titull.

Për t’u kthyer tek raportet, duhet të bëjmë një pasyrim të tipareve të simboleve të veçuara nga poezitë e marra në shqyrtim.

Simbol/ karakteristika	**KRISHTI**	**MOISIU**	**KRYQ**	**KIRENAR**
	ÇLIRONJËS KRYETRIM SHPËTIMTAR KRYEMJEK KRYESHENJT KRYEFE BIR I DAVIDIT I MIRI BARI NJERI-PERËNDI I ËMBËL MESI BABA USTA JO JETE JO MARTESË JO PARA PERUNJ PASURINË ÇLIRON VARFERINË LËNGATËN SHËRON NDRIÇON VERBËRINË KURRË S’RREN DO VEGJËLINË TIRANIN URREN NUK SHFRYTSON JO LUFTE JO VLLA-VRASJE	KRYE – PROFET TRIM ME FLETË BISEDON ME PERËNDINË SHPIRT KËPUTUR LOT NË SY ZEMËR TË NGRIRË LYP MËSHIRË LIBERATOR	VRASJE VARJE MARTIRIZIM KRYQESON NGULEN SHTISEN TALLEN QESËNDISEN	QYQAR RENT U GJËNJEVE PËRMBYSESH KAMÇIKOSESH RRIHESH NGRIHESH ÇDEHESH ZGJOHESH

Simbol/ karakteristika	KRYQËSIM	KAMÇIK	BARABBAJ	SHËN PJETËR
	MBI KRISHTIN DO TË VRASIM DO TE VARIM DEMIN	KËRBAÇ NDREQ KURRIZIN SHËMPNË ÇLIRONJËSIN, FENE E ATDHENË	RREZIL KATIK TRADHËTOR STËRNIP I KAINIT NA DHE: VARFË RI POSHTËRSI ROBËRI KUKUTH LUBI NA THER NA GRIN NA BË N FLI I ÇGRRYER I ZHYER ZEMË R KRUND GËRDHU	I GËZUAR SE PERDOR DHUNË NDRQ KURRIZIN I ZIU MBËRDHIN NGRIN HIDHUR LESH LËSHUAR DUAR LIDHUR FAQE NXIRË

Kështu krijohen raporte pozitive dhe negative.
Raport pozitiv dhe plotësues krijon Krishti me Moisiun.
Raport të përkundërt krijon me Shën Pjetrin, Barabbajn, Kirenarin, Kamçikun.
Ka edhe një lloj raporti me të cilin Krishti ndëshkohet; kryqi dhe kryqëzimi.
Ne biblën e Nolit secili zë flet dhe vepron. Me Moisiun duket thuaj se dyzohet nga i dyti, duket sikur flasim për trajta të ndryshme të të njëjtës figurë. Moisiu është krye-profet, me lot në sy, me zemër të ngrirë etj.

Me kamçikun, brenda të njëjtës poezi krijohet përballja. Kamçiku ka rekomandimin e një miku dhe qëndron i gatshëm përballë. Por parimi biblik ; "të keqes përgjigju me të mire", del edhe nje herë qartë nga qëndrimi i Krishtit, që nuk pranon ta perdorë kamçikun edhe me kostot e prezantuara nga miku i tij.

Me Shën Pjetrin e shohim të evoluojë. E shohim si këshilltar, tek "Krishti me kamçikun" dhe më tej e shohim si raport të huajëzuar tek "Shën Pjetri në mangall" mutacionin që pëson miku dhe se si ndëshkohet mbas çdo të vërtete të mohuar.

Në këto kushte, dhe bazuar në fakte historike mund t'ia lejojmë vetes përfundimin; simbol- uni poetik – poeti / personazh historik. Ky përfundim paraprak çon në përfundimin vijues se poezitë me simbolikë biblike janë edhe ato me elemente më të dendura autobiografike. Duke shkuar kështu në krah të mendimit të Sabri Hamiti, i cili këtë grupim e sheh si poezitë autobiografike.

Dr. GLADIOLA ELEZI (DURMISHI)

SIMBOLIKA DHE MUZIKALITETI NË POEZINË E FAN S. NOLIT

Fan S. Noli ka luajtur rol të rëndësishëm në letërsinë kombëtare. Poezitë më të mira janë frymëzuar prej simpatisë, me pikëllime dhe shpresa politike. Simboli dhe muzikaliteti janë mjete të rëndësishme estetike në poezinë e Nolit. Simboli është mjet stilistik i rëndësishëm sepse me anë të tij krijuesi është në gjendje të shprehë të veçantën, frymëzimin real. Me domethënien e tij të gjerë mund të përfshijë edhe të përgjithshmen. Simboli ndeshet shpeshtësisht në veprën poetike të Nolit. Kjo figurë e kuptimit të fjalës sendërtohet duke trajtuar ngjarje konkrete. Në këtë mënyrë të artikulimit e realizimit të vargut të poezisë së vet, autori ka arritur ta bëjë poezinë interesante për ata që duan të njohin realitetin e Shqipërisë mes dy luftërave botërore, kurse me universalizmin e kuptimit të simbolit, ai ka arritur ta bëjë interesante dhe për ata që kërkojnë kuptim dhe ndjenja të përhershme në të. Kështu kuptohet dhe kështu i kanë kuptuar studiuesit, poezitë e tij.

Noli s'ka kërkuar frymëzimin në raftet e bibliotekave dhe sirtarët e arkivave historikë, si disa prej poetëve tanë, në kohën kur ai ka shkruar poezitë e tij më të mira simbolike. Ai nuk është frymëzuar prej ideve dhe sistemeve filozofike si: Lukreci kur ka shkruar "*Epin mbi natyrën*", Dante kur ka shkruar "*Komedinë Hyjnore*", Gëte kur ka shkruar "*Faustin*", por prej ngjarjeve shoqërore dhe politike në të cilat ka qenë dhe vetë një prej aktorëve kryesorë. Për këtë shkak, doemos i është dashur të fusë veten nëpër vargje.

Muzikaliteti të bie në sy në vargjet e Nolit. Muzikaliteti është në shërbim të përmbajtjes dhe kuptimit të poezisë pasi muzika e vargut e ka bërë imanencë të saj. Muzikaliteti dhe simbolet janë mjete artistike të dukshme dhe të spikatura nga lexuesi i kohës, dhe janë krijuar me mjeshtëri e kujdesin më të madh të autorit. Në këtë artikull shkencor do të studiohen simbolet dhe muzikaliteti i vargut, në veprën poetike "*Album*" me poezi të Nolit. Nën petkun realist politik të poezisë, Noli ka fshehur ide që vazhdimisht i përsërit historia. Lexuesi që i njeh ngjarjet, të cilat e kanë frymëzuar, do të kuptojë vjershat e tij edhe ashtu siç janë lexuar deri sot, ndërsa lexuesi që nuk di asgjë për këto ngjarje, do të përjetojë thellësisht, ndjenjat e shprehura në to. Një kuptim të tillë të përgjithshëm disave prej poezive të veta, Noli ka arritur t'ua japë me anën e simboleve të ndryshme. Numri më i madh janë simbole të letërsisë fetare hebraike dhe të krishterë. [175]

Noli nuk është frymëzuar prej simboleve, siç u ka ndodhur disa prej poetëve të sotëm, por prej ngjarjeve konkrete, të cilat kanë shprehur përmes tyre. Në poezinë e tij simbolet bëhen bartëse të përjetimit subjektiv dhe të reagimit ndaj këtyre ngjarjeve, por nuk ngelin vetëm në një nivel të tillë. Ato kanë fuqinë e përgjithësimit. Me anën e këtyre simboleve, Noli i ka shpëtuar banalizmit, që mund të sjellë trajtimi i temave

[175] *Poezi shqiptare*, SF, Tiranë, 1992, f. 25-30

politike në poezi. Prej librave të shenjtë Noli ka marrë jo vetëm simbolet, po edhe fjali dhe mendime të tjera, të cilat në poezinë e tij janë shndërruar në vargje simbolike si në poezitë: "*Marshi i Kryqëzimit", "Marshi i Barbajt", "Krishti me kamxhikun", "Moisiu në mal"*. Si tekste, gati në tërësi, janë të marra prej *"Pesë librave të Moisiut"* dhe "*Dhiatës së Re*", por të lidhura me aluzione konkrete politike, janë bërë kuptimisht origjinale. Noli ka marrë simbole dhe prej shumë poetëve të tjerë botërorë, si: (Dante, Milton, Bodler, Novalis, Alfred de Vinji) etj. Megjithatë, ka arritur, t'i shpëtojë iluzionit të kuptimit thjesht, jetëshkrimor të poezisë së tij.

Në të vërtetë, vetë motivet e tij janë universale. Kështu, Motivi i poezisë "*Marshi i Krishtit*", është apoteoza e lidhjes së prijësit me popullin; motivi i poezisë "*Marshi i Kryqëzimit*", është dështimi i kryengritjes, që nuk e zbaton dhunën historike në raste të tilla, është vetë historia njerëzore, duke futur ndër to edhe vetë Nolin; motivi i poezisë "*Kryqëzimi*", është mjerimi dhe qesëndija, që mund të pësojë prijësi, i cili ka dështuar; motivi i poezisë "*Moisiu në mal*", është pikëllimi, vetmia dhe mjerimi në të cilin ndodhet prijësi i braktisur, kurse motivi i poezisë "*Rend, or Marathonomak*", është shpresa e ngadhënjimi i shumicës mbi pakicën dhe vështirësitë nëpër të cilat kalojnë përpjekjet për ngadhënjimin e fitores.

1. Simbolet më të fuqishme në poezinë e Nolit

Duke sjellë me vete një pjesë të domethënies simbolike të "*Biblës*", poezitë e Nolit janë plotësuar dhe me domethënien konkrete të monumentit historik[176]. Noli sikur është nisur prej parimit shekspirian se, nuk është me rëndësi tema, që prezantohet sa mënyra e trajtimit të saj dhe kuptimi që del prej saj. Në këtë mënyrë, "parafrazat" e Nolit kanë dalë të rëndësishme si për mënyrën e trajtimit, ashtu edhe për sugjerimin që ato krijojnë. Duke ndjekur në pikëpamje të strukturës së vargjeve procedimin simbolik të poezisë, Nolit i ka dalë *Krishti*, simbol i shëmbëlltyrës së tij personale dhe i rolit që ka luajtur në historinë tonë të re, por ç'është me rëndësi për poetin, është simboli i çlirimtarit, që sakrifikohet në emër të shumicës. Fytyra tjetër biblike, *Barabaj*, i cili ka dalë simbol i mbretit, Ahmet Zog, por edhe simbol i oligarkut, i tiranit, i shtypësisë së të sunduarëve. *Shën Pjetri* ka dalë simbol i bashkpunëtorëve, që herë e kanë braktisur e herë i janë kthyer, por edhe simbol i tradhtareve, dhe i projekteve politike, që kthehen andej nga fryn era. Ndërsa shëmbëlltyra e *Kirenarit*, i ka dalë simbol i atyre që s'kanë ditur nga t'ia mbajnë në momentet historike, por edhe simbol i njerëzve, të cilët, për shkak se nuk kanë parime të krijuara morale dhe ideologjike, gjenden në anën e së keqes, pikërisht pse nuk e përfaqësojnë përgjegjësinë kolektive. Mund të thuhet, gjithashtu, se shëmbëlltyrën e *Bajram Currit*, Noli e ka ngritur në nivel simbolik të heroizmit kombëtar, dhe pak kush sot, mund ta kujtojë ndryshe emrin e tij. Simboli si mjet poetik është i rëndësishëm, pikërisht, se me anën e tij simbolizuese, autori është në gjendje të shprehë të veçantën, frymëzimin real, dhe me domethënien e tij të gjerë të përfshijë e të paracaktojë brenda vargut edhe të përgjithshmen.

2. Ndërtimi i simboleve dhe funksioni i tyre estetik

[176] Wellek R, Warren A; "*Teoria e Letërsisë*". Onufri, f. 191-219. Tiranë, 2009.

Simbolet janë mjete artistike me të cilat poetët flasin në mënyrë indirekte. Përmes tyre ata i vihen rrotull idesë, mendimit, krijojnë lidhje të reja dhe sugjerojnë kuptime më të gjera. Mjeshtëria e Fan Nolit si poet, mund të vërehet edhe në racionalizimin me të cilin i ka shfrytëzuar e ndërtuar simbolet. Vjershat e tij janë të qarta aq sa mund të jetë e nevojshme qartësia në poezi, po si poezi të simboleve edhe sugjestive aq sa një sugjestion i tillë nuk e përjashton qartësinë e tyre. Me këto veçori të vetat, poezitë e Nolit bëjnë të shtrohet një çështje teorike aq kundërshtimore për një palë studiuesish, që janë dogmatikë përkrah bindjeve dhe aq të pohuara për një palë tjetër, që fenomenet letrare nuk përpiqen t'i futin brenda kanunesh utilitariste. A mund të ketë poezi të fuqishme, që mund të jetojë dhe përtej momentit të vet në qoftë se nuk i kap thellësitë dhe domethëniet, që ndikojnë në kontekstet e veta historike? A mund të ketë poezi të madhe, në qoftë se nuk ngrihet deri tek një domethënie simbolike? Natyrisht, që përgjigjia është e kuptueshme.

Fan Noli me vjershat më të mira e ka zgjidhur këtë çështje në mënyrë mohuese. Noli si poet i frymëzimit politik e ka shkruar pjesën më të madhe të vjershave me qëllim që të çlirohej shpirtërisht dhe të zhgjakosej për dhembjet që i kanë sjellë. Poezitë e tij simbolike, përpos faktit që të sjellin kënaqësi estetike, të sjellin edhe një kuptim të posaçëm që, natyrisht, e shton këtë përjetim estetik. Kjo është e mundur sepse Noli ka depërtuar thellë në cipën e vlimeve të përkohshme politike. Ai ka pasur fuqi të reagojë ndaj tyre me ndjenja të fuqishme, të përhershme dhe sepse ka arritur t'u japë një shprehje të përsosur këtyre ndjenjave dhe mendimeve të veta. Noli nuk ka mbetur poet i një momenti politik, por i ndjenjave dhe idealeve universale që, pos të tjerash, i përsëritin dhe momentet çfarë ka qenë ai i tragjedisë së tij intime, dhe i tragjedisë së popullit tonë të pavarur më 1924. Poezitë e Nolit kanë gjithmonë të trajtuar një copëz jete nga atdheu. Në pjesën më të madhe, poezitë përshkruajnë fatin historik të shoqërisë dhe fatin e tij intim në vitet 1924.

Poezitë më të arrira dhe ato më simboliket janë frymëzuar prej ngjarjeve të këtij viti. Ato kanë të bëjnë, kryesisht, me mërzitë dhe simpatitë, me pikëllimet dhe shpresat politike. Poezitë shpesh marrin formën e meditimit, ku autori shqyrton kontributin si prijës i Revolucionit të Qershorit, 1924. Për më tepër, ka poezi, që janë përdorur dhe për t'iu përgjigjur kundërshtarëve politikë. I mbushur nga ndjenja të urrejtjes, nervozizmit të kundërshtarëve politikë, në poezi ka shprehje satirike, fshikulluese, goditëse, më dukshëm se te ndonjë poet tjetër në letërsinë tonë, si figura e *"Sulltan Salepit"* etj. Kundërshtarët "më të rëndësishëm" Noli i ka mallkuar dhe futur në dhe, ndërsa kundërshtarët më "të vegjël" i ka bërë rrezil, duke u kujdesur që, pas kolonës së përbindëshave të vërë lotët e tyre. Përpos monumentit të shëmtuar që i ka ngritur tiranit shqiptar, Noli ka vënë gargujt e oportunistëve të tij. Në qoftë se në një numër vjershash ka ironizuar dhe ka satirizuar Ahmet Zogun me ministrat dhe me përkrahësit e tij të ndryshëm, në një numër tjetër vjershash, Noli ka glorifikuar rolin e vet dhe të bashkëpunëtorëve të vet. Përmendore të bukura u ka ngritur ai, shokëve të luftës dhe të ideologjisë, Luigj Gurakuqit dhe Bajram Currit, të cilët i ka vënë në piedestalin e luftëtarëve, që demonstruan shpirt sakrifice për lirinë, demokracinë dhe pavarësinë e popullit shqiptar. Prej poezisë së kritikës dhe të mallkimit, ai i është kthyer poezisë së

adhurimit dhe të glorifikimit. Kundërshtarët e vet Noli i ka quajtur robërues shpirtërorë të popullit, kurse veten dhe shokët e vet i ka quajtur çlirues të tij:

P. sh. : *Mesi, hosanna! / Shtoni udhën me lule, dafin' e hurma, / Brohoritni trumbeta, timpane, zurna. / Thirr e zbras, o gurmas: Hosanna.*

(*"*Marshi i Krishterë*"* [177] *Album*)

Në poezinë e tij ka furtunë, pra, ndjenjat, botëkuptimet, mëritë dhe simpatitë e veta, i kanë bërë poezitë mrekullisht e plotësisht jetëshkrimore. "*Albumin*", ai edhe vetë e ka trajtuar si një përmbledhje që "përmban një koleksion vjershash origjinale dhe parafraza të ndryshme", prej të cilave pjesa më e madhe janë dramë a pak simbole. Lexuesi i poezive të Nolit qoftë dhe ai, të cilin e preokupon jetëshkrimi intelektual pasi në to përplasen dy parime kontradiktore jetësore, morale, dy programe politike dhe, më në fund, dy ideologji të ndryshme. Ky fakt përmbushet sepse poeti ia imponon lexuesit, kuptimin universal të vjershave të veta. Duke e shpënë më tutje karakterin përgjithësues dhe simbolik të poezisë së tij, mund të pohoet se në të ka gjetur shprehjen dhe parimi i njohur i luftës së të mirës me të keqen, i dritës me errësirën, i progresit me regresin.

3. Ndërtimi dhe funksioni muzikor i vargut të Nolit

Çdo lexuesi të poezisë së Nolit i bie menjëherë në sy muzikaliteti i saj, prandaj të gjithë ata që kanë shkruar për të e kanë vënë në dukje këtë fakt edhe pse shumica nuk e ka provuar nëpër analiza konkrete. Kur ka bërë përmbledhjen e poezive të Nolit, Mitrush Kuteli ka theksuar në parathënie, muzikalitetin si një prej karakteristikave themelore të vargut të tij. Kuteli ka vënë në dukje se "*Vargu i tij nuk është vizual apo auditiv. I drejtohet, veshit, jo syrit*"[178]. Noli nuk është kujdesur shumë që vargu i tij të jetë aq metaforik. Përkundër poetëve botërorë të kohës së tij, që i kanë kërkuar aq shumë metaforat, ai është kënaqur të marrë të gatshme simbolet biblike, si dhe shumë poetë të Rilindjes Evropiane, dhe t'ia nënshtrojë vargun, logjikës së vet krijuese.

Poezitë e Nolit, megjithë përgjithësimet simbolike, që përmbajnë do të ishin artistikisht të zbehta, sikur të mos ishin aq muzikore sa janë. Mungesën e shprehësisë metaforike, ai e ka zvëndësuar me dridhjet ritmike dhe muzikore, çfarë nuk ka përjetuar poezia shqipe para, as pas tij. Prirja e Nolit që të mbështesë fuqinë e vargut të vet mbi muzikalitetin e tyre nuk është rastësi. Ai është marrë me muzikë që i vogël duke u aktivizuar në korin këngëtar të kishës së qytezës, më pas kur u rrit, u pushtua prej asaj dashurie përgjithmonë. Më vonë ka diplomuar muzikën, është marrë me kompozicione muzikore dhe studimin e muzikës.

Muzika në veprën letrare është pjesë e marrëdhënieve të letërsisë me artet e tjera. Marrëdhëniet e muzikës me letërsinë në terrenin tonë gjuhësor e letrar i kanalizojmë në dy drejtime. Drejtimi i parë i shikon ato në folklorin gojor shqiptar, ndërsa i dyti në letërsi, duke filluar që nga letërsia e vjetër, e Rilindjes, në vijim në veprën e krijuesve të shquar të fillimit të shek XX e deri në letërsinë e ditëve tona, përafërsisht, katër shekuj. Disa nga dukuritë që shoqërojnë këto marrëdhënie, si p. sh. : "muzika"

---

[177] Fan Noli, "*Album*", Reklama, Tiranë, 2010, f. 12.

[178] M. Kuteli, "*Poeti Fan S. Noli" "*Albani". Rilindja, Prishtinë, 1999, f. 25.

(muzikaliteti) që "prodhohet" nga përdorimi i materialit gjuhësor e letrar, nuk janë të reja për letërsinë shqipe. Me kohë kanë qenë vërejtur nga kritika jonë letrare "…muzika e ritmit të Fishtës dhe ngjyrimet e ligjëratës së tij"[179]; "ngjyra e muzikës (në veprat e Mjedës). ku tingujt e ndryshëm marrin rolin e instrumenteve kryesore në një orkestër"[180]; "... kulti simbolik i muzikës (në vjershat e Nolit) dhe struktura muzikore e vargut"[181]; "... tingëllimi si polifoni zërash i kryeveprave artistike"[182]; "... organizimi akustik i vargjeve (në krijimtarinë e Ali Asllanit) dhe ekspresiviteti i jashtëzakonshëm eufonik"[183]; "…aktivizimi melodik dhe muzikor (në poezinë e Lasgush Poradecit) i interpunkcionit"[184]; "…vlera akustike (e veprës së Skiroit)"[185] etj. Muzika provon se kur vendoset në realitete të tjera mbart qindra forma të ndryshme të shfaqjes e po ashtu edhe misterin e përjetshëm të muzikogonisë.

Një situatë më e drejtpërdrejtë e marrëdhënieve të muzikës me letërsinë konstatohet në historinë e muzikës shqiptare, e konkretisht në një pjesë të saj, që lidhet me zhvillimin e këngës patriotike në vitet e Rilindjes. Shkrimtarë, si: Asdreni, M. Grameno, Th. Mitko, V. Pasha etj.. çuditërisht muzikojnë vetë poezitë e tyre, ndërkohë, që edhe një pjesë e madhe e muzikës vokale të krijuar në këtë kohë, u vu në shërbim të drejtpërdrejtë të përhapjes së gjuhës dhe letërsisë shqipe.

Veprat e artit duke qenë produkte të mendjes dhe shpirtit njerëzor, veç të tjerash kanë padyshim edhe një lidhje të veçantë të të dhënave natyrore të njeriut me to. Arkitektura, skulptura dhe artet vizive, meqë janë të drejtpërdrejta në funksion të syrit njerëzor, paraqiten në përgjithësi si projektime të strukturës në hapësirë; ndërkohë që letërsia dhe muzika strukturohen në një formë më të dukshme për veshin sesa për çfarëdo organi tjetër duke u quajtur ".. arte të të dëgjuemit"[186] Meqënëse jemi në vlerësimin dhe lidhjet që muzika shfaq në lidhje me organin dëgjimor, mendoj se këtu zë vend më së miri shprehja e Kadaresë "Veshi, ndonëse u duk se shumë herë u rrëzua, mbeti prapë i fuqishëm. Atij i përket gjithmonë dhe gati tërësisht muzika, çka është kolosale". [187]

Në vargun e Nolit muzika është vënë në funksion të përmbajtjes dhe të kuptimit të poezisë, pasi muzikën e vargut e ka bërë imanencë të saj. Noli ka zgjedhur të mos luajë me tinguj, me fjalë, po të konkretizojë, të shtojë më tepër ndjenja, përjetime personale. Në vargjet e Nolit me anë të muzikalitetit i nxitet atmosferë lexuesit, por kjo mund të interpretohet edhe në një rrafsh tjetër, atë të ironisë, satirës, e cila në situata kritike, brenda urrejtjes së shpirtit të trazuar, arrin deri në sarkazëm. Në poezinë e Nolit nuk ka elemente formale. Mjetet estetike të përdorura në poezi, si

[179] F. Konica. "Vepra", Tiranë, 1993, f. 487.
[180] R. Qosja. "*Panteoni i rralluar*", Tiranë, 1988, f. 163.
[181] Po aty, f. 189, 211.
[182] A. Uçi. Estetika 2, Tiranë, 1989, f. 167.
[183] R. Qosja. "Antologji e Lirikës Shqipe", Hyrje, Prishtinë, 1970, f. 28.
[184] Po aty, f. 30.
[185] A. Xhiku. "Shënime përcjellëse për Skiroin dhe Veprën", Idili "*Mili dhe Hajdhia*", Tiranë, 1994, f. 31.
[186] A. Xhuvani, "*Antologji e mendimit estetik shqiptar*" Tiranë, 1979, f. 352.
[187] I. Kadare, "*Legjenda e Legjendave*", Dukagjini-Pejë, 1996, f. 49.

rima, ritmi, ngjyra e tingujve, përsëritjet janë elemente, që e bëjnë vargun më specifik e muzikor.

Ekzistojnë në veprën poetike "Album" të Nolit, poezi, që janë ndërtuar në bazë të përsëritjeve të tingujve ku tingujt mund të jenë zanorë ose bashktingëllorë. Kështu pra, asonanca dhe aliteracioni kanë krijuar elemente dhe ngjyra të posaçme muzikore të vargjeve ku nëpërmjet tyre, autori krijon përfytyrime dhe ndjenja, që dëshiron t'ia sugjerojë dhe t'ia përcjellë lexuesit. Ngjyrat e melodisë ndryshojnë nga një poezi në tjetrën. Pra, në njëfarë mënyre, krijohet një mozaik ngjyrash, që jepen te lexuesi me anë të tingujve të ndryshëm. Si poet me një sublimitet të posaçëm, i ka ndjerë nuancat e tingujve. Noli i ka përsëritur nëpër vargje kur e ku një zanore si dhe kur e ku një bashktingëllore, por këto i ka motivuar semantikisht dhe nuk janë zgjedhje të pavetëdijëshme nga autori. Një shembull tipik i përsëritjes së zanoreve është poezia "Himni i Flamurit".

P. sh. : /**a**: *O Flamur gjak, o Flamur shkabë. / **e**: Me grusht prej rrufeje, që ngrin e që tret/ **ë**: Që të pren' e që të vranë. / **i**: O bir i Davidit, i miri bari. / **u**: Dallkaugt, kopukët e turmat pa tru. **o**: Po më kot i këshillove. / **y**: Gryka si gjyryk të çfyrn* etj.

("Himni i Flamurit" *Album*)

Por kemi dhe poezi të cilat janë të theksuara në frekuenca të shpeshta. Brenda vargut bashkëtingëlloret, si:

ç: *Ti na çthure, na çkule, na çduke çdo fe. / **m**: Me armë, me topa, me kordh' e me shpata. /**n**: Se urën e ruan, se urën e mpron. /**r**: Si gjarpër zvariniset, i sillet përqark. /**s**: Se s'ka dashuri as jet' as martes' as para. / **sh**: Shkab' e shkëmb me proz' e fjalë. / **z**: Me zjarr e zi u ndeze, u nxive/ gj: Gjel me gjëmb' e këng' armike* etj.

Noli, gjithashtu, ka zgjedhur metoda të tjera artistike për të krijuar muzikalitetin e vargut e përsëritjen jo vetëm të një tingulli, por të dy e më shumë tingujve në të njëjtin varg, si:

a, ë, m: *Me tam-tam e alarm e me nëmë u shurdhofsha*. / **u, ë, m**: *Në bodrum, nëpër llomë e kufomë u mallkofsha*! / **a, r, s**: *Arratisur, syrgjynosur, / rraskapitur dhe katosur* etj.

Në poezitë e Nolit ka raste kur tërë muzikën e një poezie e përcaktojnë dy ose më shumë tinguj, siç është poezia "Marshi i Kryqëzimit" ku përsëriten më shpesh tingujt zanorë dhe bashtingëllorë *a, s, r*. [188] Duke përdorur tinguj të tillë autori krijon imazhe tek Jezusi dhe sugjeron fenomenet e natyrës. Përsëritjet e tingujve me frekuenca të shpeshta, Noli i përdor në poezi për të imituar fenomenet e natyrës. Një rast i tillë është vjersha " *Rend, or Marathonomak*".

P. sh. : " *Vapa mbyt e pluhri nxin/ Ferra çjerr e guri ngrin/ Afsha gjoksin përvëlon/ Syrin avulli verbon;/ Ur' e prush, / Furr', or Marathonomak!* etj.

Nëpërmjet përsëritjes së tingujve *u* dhe *r*, krijohet ideja ose imazhi onomatopik i vapës, i izolimit, i mbytjes. Përdorimi i tingullit "r*"* nga Noli bëhet në një mënyrë të

[188] R. Sokoli, "*Për krijmtarinë muzikore të Nolit si kompozitor e muzikolog*", në Nëntori, 1974/4, f. 95-104.

përsosur ku gërshetohen dy elemente, që bashkëjetojnë në mënyrë harmonike me njëri- tjetrin, muzika e vargut nga një anë dhe idetë e lëvizjes e të shpejtësisë nga ana tjetër. Përdorimi i tingullit "r" nuk është rastësor. Këtë proces tingullor përdorimor e pohon dhe fakti, që ky tingull shoqërohet me asindetin. Një poezi e tillë, është "*Kirenari*", ku autori ka përdorur shpesh këtë tingull për arsye se është përdorur dy herë në titull, por edhe se nëpërmjet tij ka sendërtuar idetë e veta në poezi.

P. sh. : *Ç' vete shtrembër në Kalvar/ O qyqar, o Kirenar! / Se ç' përmbysesh, kamçikohesh. / Rihesh, ngrihesh, çdehesh, zgjohesh.*

Me përsëritjen e tingujve *r* dhe *sh*, të krijohet ideja e shushurimës, e rrokullisjes, që këto i japin një koloristikë muzikore stogës, ndërsa asindeti nxit shpejtësinë e ritmit, rrokullimës. Nëpërmjet saj arrihet të përfocohet ideja e poetit ku ai e simbolizon veten me fytyrën biblike të *Kirenarit*. Në këtë mënyrë arrihet të përputhet forma me përmbajtjen. Në këtë vjershë Noli ka lënë dhe një hapësirë për të shprehur përvojën e vet historike mbi Revolucionin e Qershorit ku shpreh se shumë njerëz nuk e kishin mbështetur, nuk e kishin kuptuar sepse, sipas tij, ishin pa parime morale dhe guxim qytetar. Ka raste kur tingulli dhe asindeti janë bashkë në vargje dhe në to ai fuqizon ose apoteozon p. sh. :

Kryetrim, që lufton, triumfon për atdhe/ Shpëtimtar, kryemjek, kryeshenjtë, kryefe...
("Marshi i Krishtit" *Album*)
Ose mallkon:

Varfëri, poshtërsi, robëri ti na dhe/ Derberdyer, ujk e derr: Hossana, Barabba?
("Marshi i Barabajt" *Album*)

Kjo është një poezi sa intime ku autori shpreh një lumë ndjenjash personale, por arrin të përdorë dhe mjete të efektshme estetike për të shpeshtuar ritmin. Gjithashtu, ka dendësuar shprehjen, me anën e asindetit si dhe ka shprehur në mënyrë jo të drejtëpërdrejtë edhe përfytyrime vizuale. Në poezinë "*Rend o Marathonomak*", Noli ia ka dedikuar këtë rrugëtim ushtarit grek, i cili vrapon për të lajmëruar për fitoren e përgjakur kundër persianëve. Në këto dy vargje të saj shprehet:

Nëna, motra, nusja dalin, / ngrehin krahët të të ndalin,
("Rend or Marathonmak" *Album*)

Autori nëpëmjet asindetit shpreh se me ç'shpejtësi i dalin përpara Marathonomakut nëna, motra, nusja dhe krijojnë një gardh që ta ndalin. Në këtë moment asindeti kryen dy funksione:

a) tregon shpeshtësinë,
b)b) pamjen vizuale të pengesës.

Nëpërmjet fjalëve *nënë, motër, nuse* të krijohet përfytyrimi vizual, depërtues, kjo do të thotë se autori ka ditur t'i drejtohet edhe syrit. Ka poezi në të cilat, ai ka përdorur ngadalësimin e përfytyrimimeve vizuale dhe bashkë me këtë, ka përshtatur edhe

mjetin me të cilin mund ta realizonte pra, polisindetin, që arrin të zbusë hovet ritmike, p. sh. :

Jesu Krishti s'dëgjoi, dhe s'e mori vesh mikun, / Dhe s'u unj përsëri që ta merrte kamçikun: , / Dhe e kapën kamçikun sarafët për fenë, / Dhe e shpunë çlironjësin, fen'e atdhenë.

Përdorimi i lidhëzës, autori e përdor për dy funksione:

a)përqëndron më tepër vëmendjen e lexuesit rreth situatës që tregon, duke stivuar lidhëzën

b) tregon stivimin e të këqijave pas thënies së tij nga pushteti.

Përdorimi i polisindetit tregon ndikimin e stilit biblik mbi stilin fanolian. Në këtë mënyrë mund të bëhen paralelizmat e shpeshta sintaksore-ritmike apo vetëm sintaksore nëpër vargjet e Nolit. Jo vetëm nëpërmjet asindetit dhe polisindetit autori mund të arrijë efekte të caktuara, por edhe me anë të ritmit dhe të rimës së vet. Rima, si kufij ritmik, është njëkohësisht dhe kufiri logjik i vargut. Rima në vargje nuk krijon vetëm muzikën, por thekson dhe mendimet e tij, që do të shprehë te lexuesi. Një shembull i tillë është poezia "*Anës lumenjve*"

Anës detit i palarë, / anës dritës i paparë. / Pranë sofrës i pangrënë, /pranë dijes i panxënë.

Këto vargje janë të realizura sipas parimit të paralelizmit sintaktiko-ritmik dhe janë vendosur në pozitën e rimës. Fjalët: *i palarë, i paparë, i pangrënë dhe i panxënë,* shprehin ngarkesën emocionale për të theksuar pozitën e mjeruar arsimore, sociale dhe shëndetësore të popullit, për të theksuar tri pikat nevralgjike të realitetit shqiptar: arsimin, shëndetësinë, buqësinë. Në poezinë e Nolit rimat bëhen edhe në mes të tyre, si p. sh. : në poezitë "Kirenari", "Kryqëzimi" etj.

Po troket çekani, / Po kërcet mejdani.

Duke përsëritur tingullin *r* dhe *s*, Noli ka krijuar atmosferën e shpeshtisë sesi e gozhduan *Krishtin*. Duke përdorur njësitë morfologjike, sugjeron shpejtësinë se si përtollisen tri Maritë duke parë gozhdimin e *Krishtit*. Kjo shfaqet brenda gjithë poezisë. Noli ka sjellë ritmin në pajtim me ndjenjën dhe idenë e tij. Poezinë "*Krishti me kamzhik*" ku shprehet pendesa e prijësit, Noli e ka shkruar në trembëdhjetërrokësh; në poezinë " *Marshi i Krishtit* ", flet se sa të vështirë e ka prijësi ta realizojë idealin. Këtë poezi e shkruan në dymbëdhjetërrokësh. Noli e shpejton ritmin e vargjeve të parafundit të çdo strofe, duke e zvogëluar më tepër numrin e rrokjeve, që t'i japë hov e nxitim ndjenjës dhe idesë së vet. Në poezinë "Anës lumenjve", në të cilën tetërrokëshi, gjithë derisa i afrohemi kulmit të ndjenjës dhe idesë së shkrimtarit, kur kalon në shtatërrokëshin, e zgjeron vizionin, vargu bëhet tetërrokësh, si shtatërrokëshi i mësipërm:

Ngrehuni dhe bjeruni, / Korini dhe shtypini,
Katundarë e punëtorë, / Që nga Shkodra gjer në Vlorë!
("Anës lumenjve" *Album*)

Shqetësimi i autorit ka gjetur shprehinë adekuate edhe në stilin e poetit Fan S. Noli. Strukturës së vargut Noli i ka nënshtruar pos të tjerash si ngjyrime politike, edhe leksikun. Në poezi ka përdorur shumë barbarizma: në turqisht, arabisht, persisht dhe gjuhëve neolatine. Fjalët e huaja Noli ka ditur se ku duhet të përdoren e ku jo. Në poezitë "*Himni i Flamurit*" dhe "*Jepni për nënën*" nuk ka përdorur fjalë të huaja. Ndërsa, në poezitë " *Kënga e Salep Sulltanit*", "*Kirenari*", "*Marshi i Barabajt*" i ka përdorur shumë, ku me anë të leksikut ka dashur ta konkretizojë më mirë dhe më qartë atmosferën. Kur ka shkruar për realitetin shqiptar, kur ka ironizuar politikanët ka përdorur turqizma dhe arabizma, për të pasqyruar mentalitetin dhe stilin jetësor të prapambetur dhe për të demaskuar pushtetin e tyre. Nëpërmjet këtyre mjeteve artistike trëhiqet vëmendja e lexuesit dhe realizohet nëpërmjet shprehjeve të mendimeve të autorit me anë të simbolikës së poezisë. Në qoftë se simbolet janë "udhëheqëse" të meditimit e forcës tipizuese të vargut poetik të Nolit, muzikaliteti krijon hapësirë për të tërhequr vëmendjen e lexuesit, duke zbutur tonalitetin e duke ëmbëlsuar ashpërsinë e forcës së vargut. Fan Noli është poet që ka dhënë kontribut të rëndësishëm në letërsinë simbolike dhe do të ruhet gjatë në kujtesën e lexuesit.

Duhet thënë se Noli bën pjesë në atë panteon figurash poetike që sa më larg janë vitet e dekadat, aq më shumë lartësohet figura e tij. Jo thjesht për vlerat si krijues i veçantë i vlerave në letërsi, por si figurë poliedrike, e cila u kthye për shumë njerëz ikonë dhe simbol frymëzimi. Simbolikat e tij artistike shërbejnë si modele studimi për kritikën letrare. Padyshim, Fan Noli do të mbetet një prej krijuesve më të rëndësishëm të letërsisë shqiptare në dekadat e para të shekullit XX, për tërësinë e vlerave të krijmtarisë së tij. Shpirtin e tij luftarak në poezi, revolta dhe thirrja e hapur kundër shtresave, vlerësimi dhe lartësimi i figurave patriotike e atdhetare, si dhe mesazhet e fuqishme, që ai sjell në tërësinë e krijmtarisë së tij, e bëjnë Fan Nolin vlerë të pazëvendësueshme në poezinë shqiptare. Ndoshta do të duhen dekada të tëra që letërsisë shqipe t'i vijë një krijues si Fan Noli.

Përfundime

1. Me trajtimin e ngjarjeve konkrete në poezi ku përcillen me anë të simboleve të ndryshme Noli arrin ta bëjë poezinë interesante për ata që duan të njohin realitetin e Shqipërisë mes dy luftërave botërore, kurse në universalizimin e kuptimit të simbolit, ka arritur ta bëjë interesante edhe për ata që kërkojnë kuptime dhe ndjenja të përhershme në të.

2. Simboli si mjet poetik i rëndësishëm ku krijuesi është në gjendje të shprehë të veçantën, frymëzimin real dhe domethënien e gjerë arrin me forcën përgjithësuese të përfshijë edhe të përgjithshmen brenda vargut.

3. Nëpërmjet simboleve transferohen mesazhe nga tejkohësia në bashkëkohësi.

4. Muzikaliteti në vargjet e Nolit është vënë në shërbim të mirërmbajtjes dhe të kuptimit të poezisë.

5. Ritmi, rima, ngjyrat e tingujve, përsëritjet janë si kufij ritmikë, njëkohësisht, dhe kufij logjikë në poezinë e Nolit.

6. Shkrimtari i zhvillon mendimet dhe ndjenjat e veta në planin objektiv. Lirika, siç është e ditur, është forma e zhvillimit të këtyre mendimeve dhe ndjenjave në planin subjektiv. Ajo i ka tërhequr vazhdimisht e gjatë gjithë kohës lexuesit.

7. Ka shumë poetë botërorë, që janë të famshëm si poetë politikë, partiakë dhe kanë humbur famën kur zhvillimi i ngjarjeve shoqërore ka tejkaluar simpatitë e tyre politike. Noli nuk i takon këtij grupi poetësh për shkak se askush prej nesh nuk mund të thotë se vlera e poezisë së tij qëndron vetëm në afrinë, që kanë idetë e tij me kohën dhe realitetin. Poezitë e tij simbolike, krahas kënaqësisë estetike të sjellin edhe një kuptim të posaçëm, që natyrisht e shton këtë përjetim estetik.

Dr. JONELA SPAHO

ROLI I SATIRËS DHE HUMORIT NË POEZINË E NOLIT, NË FUNKSION TË ARTIKULIMIT TË IDESË

Poezia noliane është një univers më vete, krejt original dhe unik, në gjithë korpusin e zhvillimit të kësaj gjinie, sidomos për periudhën 1912-39. Arsyet që e bëjnë tejet origjianle dhe universale këtë poezi janë të shumta: universaliteti i motiveve, referencat biblike, përgjithësimi i situatave historike, që përsëriten në vorbullën e zhvillimit historik të shoqërisë njerëzore, vargu i përpunuar deri në virtuozitet, fjalori poetik, muzikaliteti etj. Por, ajo që është e kudogjendshme, pothuaj, në të gjitha poezitë e Nolit, në variacione dhe gradacione të ndryshme, që diktohet qoftë prej motivit të trajtuar, personazhit, statusit emocional, patosit etj. , është satira e mprehtë, sarkazma dhe grotesku i papërsëritshëm nolian, edhe ky krejt unik në poezinë shqipe, në poezitë politiko - shoqërore dhe autobiografike dhe humori i hollë, i këndshëm dhe i strukturuar, kaq organikisht, përmes vargut te 5 poezitë liriko - intime të Nolit.

Të gëzosh statusin e një poeti të fuqishëm satirik është një mision, është shenjë dalluese e një emancipimi letrar, kulturor dhe shoqëror, është dhe një këndvështrim ndryshe për të vënë gishtin mbi plagë. *"Natyrisht, qëndrimet që shprehte poezia satirike e gjysmës së parë të shekullit XX, ishin të ndryshme nga njëri autor tek tjetri"*[189]. Noli shkroi poezi të fuqishme, ku me një satirë të mprehtë shprehu vrrullin e zemërimit të tij të skajshëm për ato që ndodhën në Shqipërinë e vitit 1924. Jo vetëm simbolika dhe personazhet biblike, alegoria e figurave, orientalilizmat, efektet e forta të tingujve, do të mjaftonin për të shprehur identitetin se tij shpirtëror dhe të vërtetën e një ngjarjeje historike, protagonist i së cilës ishte vetë ai. Ai inicioi, veproi, pa, ndjeu, vuajti dhe u dëshpërua deri në ato përmasa dhe ato nivele, saqë vetëm fuqia e një vargu të pavdekshëm, si ai që krjoi do t'i demonstronte ato përjetime. Dhe atij njeriu të shquar për erudicionin e tij dhe humorin e rrallë, do t'i vinin më mirë në ndihmë mjetet shprehëse të satirës, sartkazmës dhe goteskut, për të shprehur në gjithë prizmet ato që përjetonte ideatori, udhëheqësi, i munduri, i tradhtuari, i arratisuri, i anatemuari, i kryqëzuari, sepse *"pa një urrejtje të fortë satira nuk arrin shkëlqimin e duhur"*[190].

Kategorizimi i satirës dhe humorit varion në studime të ndryshme. Sipas një pikëpamjeje të ndonjë studiuesi të huaj, satira shpreh vetëm dukuri të jetës politike, ndërsa humori ka si objekt cilësi e anë që lidhen me sjelljet dhe normat morale[191]. Natyrisht që ka shembuj të shumtë, si nga letërsia jonë dhe nga ajo e huaj, që tregojnë së satira drejtohet dhe kundër veseve morale të shoqërisë, por në rastin e Nolit kjo është e vërtetë. Vjershat politiko-shoqërore të tij e japin, shpesh idenë nëpërmjet

[189] Ali Xhiku, *Letërisa shqipe si polifoni*, Tiranë, 2004.

[190] Jakup Mato, P*aradokset e satirës dhe humorit*, Tiranë, 2000. f. 34.

[191] Po aty, f. 54.

satirës, sarkazmës dhe groteskut, ndërsa poezitë intime ku bëhet tallja e vesit të plakut që kërkon të kthejë rininë, bëhet përmes humorit. Natyrisht që qëndrimi satirik i Nolit në poezitë e tij përcaktohet nga natyra dhe përmbajtja e motivit që trajton, si dhe nga këndvështrimi i tij për të artikuluar artistikisht idenë. Më saktë Nolit do t'i shkonte përcaktimi i B. Kroçes për satirën: "*Me satirë kuptohet një shqetësim moral, që ndonëse e sheh me sy vesin për ta luftuar dhe për ta paraqitur shëmtimin e tij, nuk e humbet nga syri shkakun e indinjatës që qëndron në një dashuri të zhgënjyer për fisnikërinë, pastërtinë dhe ndershmërinë"*[192]. Ndërsa humori ka natyrë tjetër, kur karakterizon personazhe që nuk janë vetë shkaktarët e dobësive dhe të metave të tyre, por ato që e kanë burimin në rrethanat, kushtet shoqërore e në mjedisin ku gjenden dhe veprojnë[193] dhe kjo vlen përsëri për Nolin kur flasim për 5 poezitë me temë liriko - intime. Por edhe këtu larmia e humorit shtrihet midis dy skajeve, midis humorit të lehtë, të ngjashëm me shakanë dhe humorit përmes lotëve dhe atij që afron shkallë – shkallë, deri në kufirin e satirës.

Satira e Nolit ndihet e fuqishme që në poezitë e para të shkruara në vitin 1914: "*Kënga e Dervish begut"* dhe *"Tomsoni dhe kuçedra",* të cilat janë shkruar ende pa ndodhur Revolucioni i Qershorit, por që lidhen me një moment jo më pak kritik të historisë kombëtare. Stigmatizimi që i bën këtu Turqisë, me stilema groteske që sa vijnë dhe intensifikohen, shprehin qartë urrejtjen, por dhe rrezikun që i kanosej Shqipërisë nga një rikthim i frikshëm i asaj që sapo ishte zhdukur. Stilemat groteske: kuçedër, gjarpër, lubi e Dovletit, me pexhorativitetin e tyre bëjnë stigmatizimin e asaj pjese të shqiptarëve që akoma kërkonin të kthenin kohën prapa, ndërkohë që Evropa dërgonte gjeneral Tomsonin të luftonte për të mirën e shqiptarëve. Satira e mprehtë e fillimit të poezisë, kalon në një sarkazmë therrëse kur ai antemon dhe mallkon ata që kërkonin të ndalnin rrugën e zhvillimit të kombit: "*Thomsonin e ngratë, që ju vetë e vratë, / që pas nuk i ratë, po vetëm e latë, / Kur shkonte kaluar të vdesë për ne, / për ju të mallkuar, që s'doni Atdhe"*[194]. E njëjta situatë dhe i njëjti shqetësim, por me tone qesëndisëse, që shkojnë drejt sarkazmës therrëse jepet dhe te vjersha *"Kanga e Dervish begut"*, satira e së cilës realizohet përmes kontradiktës mes idhtarëve të "Baba Dovleti" dhe Ismail Qemalit që kërkon të ndërtojë një shtet sipas modeleve europiane*: "Sot vatani don nji kral, / Don një kral oxhak kaurri, / se me turk na piu qivuri"*[195]. Fjalët kaurr dhe turk, janë përdorur enkas nga Noli për të satirizuar situatën. Vargu i parë thekson akoma më shumë talljen dhe stigmatizimin e Nolit kundrejt atyre që kërkojnë të kthejnë kohën prapa: "*Bismila, tridhjet seneja, / Topat krisën porsi rrufeja, / Na u bë mbretni Shqypneja"*[196]. Vitin 1914, Noli e ka konvertuar me vitin 1230 allaturka, për t'u tallur dhe për të ironizuar, si dhe për të goditur dukurinë regresive që shfaqej te një pjesë e shqiptarëve që rronin ende me nostalgjinë e Dovletit dhe që për Nolin qe një stërkëmbësh që i vihej zhvillimit perëndimor të vendit. Në këtë poezi dhe

[192] Benedeto Kroçe, *Poezia antike dhe modern*, Tiranë, 1998, f. 98.
[193] Jakup Mato, *Paradokset e satirës dhe humorit*, Tiranë, 2000, f. 103.
[194] Fan Noli, *Vepra 1*, Tiranë, 1988, f. 69.
[195] Po aty, f. 63.
[196] Po aty

rimimi i fjalëve: *seneja - Shqypneja, Dovleti – Muhameti, dini – kuran qerimi*, theksojnë mesazhin e gjithë vjershës. Kënga është shkruar si imitim i këngëve epike historike të veriut duke përdorur, kështu, mjetin komik të parodizimit të këngëve popullore, që lartësonin trimërinë e heronjve, ndërsa në këtë rast Noli imiton këtë model për të qesëndisur e satirizuar figurën e Dervish begut, të cilit fanatizmi fetar i ka errur sytë aq shumë, sa dhe fenë e identifikon me kombin: "*Dervish Begu, trim si Zana, / Djal si aj s'ka puthun nana"*[197]. Kjo vjershë është një sintezë e një realiteti të hidhur, të përshfaqur në format e tij më të errëta, kur momentet kyçe të historisë sonë kërkonin një tjetër vizion, qëndrim dhe këndvështrim prej shqiptarëve.

Tjetër dimension merr satira, ironia, sarkazma dhe grotesku te poezitë me motive biblike. Këtu satira shfrytëzohet në të gjitha dimensionet e saj për të dhënë jo vetëm shkulmet e zemërimit, urrejtjes që shpërthente, indinjatës dhe revoltës, por edhe të dhembjes. Siç është shprehur nga kritika, qasja që bën autori me përvojën personale te "*Moisiu në mal"*, është më afër se poezitë e tjera, sepse këtu artikulohet dhembja vetjake e individit deri në shkallën e tragjizmit, përpara krijuesit. Në këtë atmosferë tragjike, ku gjithçka të duket sikur lëngon, lexuesi sikur përjeton mundimin dhe lodhjen e Moisiut plak, tek ngjitet malit për të biseduar me perëndinë. Në strofën e parafundit, autori i largohet tonit elegjiak dhe gjen rast të qesëndisë, por fare hollë, jo aq me antitezat, por vetëm me vargunt e fundit të shkurtër: *O Moisi!* . Ndihet pra, një lloj qesëndisje e hollë e Nolit, ndoshta me vetveten, për misionin e pambaruar që i mori, më kot, kaq mund e lot dhe kur bëhet bilanci…: " *Sheh gaznë e pritmë për djalërinë, / Dhe shkretëtirën për pleqërinë, / Atje sa bukur, këtu sa zi, / O Moisi*[198]*"*. Jo rrallë Noli përdor rimimet e dy fjalëve për të theksuar idenë: *zi - Moisi, zor – liberator,* të cilat përmbajnë në vetvete gjithë shprehësinë kuptimore të vjershës.

Një nga mjetet e përdorura rëndom prej Nolit në poezitë politiko - shoqërore, që stigmatizojnë ngjarjet e 1924, është paradoksi dhe kontrastet nga më të çuditshmet. Paradoksi përdoret si mjet efikas i satirës në poezinë *"Krishti me kamçik ", "Marshi i kryqëzimit"*. Paradoksi është përdorur nga Noli si pikëndërprerje e komikes nga tragjikja: "*Kush fitonte më tepër ai ish usta, / dhe kush nuk plaçkiste ishte krejt budalla", "Tregëtojnë e gënjejnë, rrëmbejnë e sfrutojnë, / thonë ashtu Izraelin e mbrojnë e shpëtojnë* ". Paradoksi dhe alogjizmi përdoren këtu për të pikturuar me ngjyrat më të errëta kobin që sipas Nolit po i bëhej atdheut: tempullit të shenjtë, ndërsa brenda kësaj logjike të paradoksit shkojnë dhe fjalët e shën Pjetrit: *"Me kërbaç e me shpatë mi ne mbretëro, / Dhe me forcë e pahir na çliro, na shpëto", "Përkëdhelu kurrizin dhe do të besojnë, / Vraji shtypi dhe shtrydhi dhe do të adhurojnë*". Absurditetin e gjithë situatës, pezmin, dhembjen dhe dilemën Noli ka përzgjedhur që ta japë nëpërmjet idesë së përmbysur. Edhe këtu, rimimi i fjalëve përforcon idenë dhe satirën: *"Truri - druri, fenë - atdhenë, usta – budalla,* etj.

Në dimensione dhe artikulime më të fuqishme përshfaqet situata te *"Marshi i kryqëzimit*", ku çdo varg dhe gjithë kuptimi i strofës zbërthehet përmes paradoksit dhe alogjizmit. Në gjashtë strofat e para poeti përshkallëzon dukshëm përmes paradoksit

[197] Po aty

[198] Po aty, f. 73.

figurën e shpëtimtarit, për të arritur në strofën e fundit, ku sarkazma therrëse, më shumë se një anatemim i të tjerëve është një anatemim dhe stigmatizim i vetvetes: "*Vrajeni kryengritësin e shenjtëruar, / Si katil të mallkuar, atë ka kërkuar, / Se kujtoi se pa armë na ka për të zgjuar"*[199].

Në dy vjershat e tjera të cilit biblik "Shën Pjetri mbi mangall" dhe "Kirenari", autori ka përdorur mjetin satirik komik të karrikaturizmit. *"Zmadhimi ose shtrembërimi i disa cilësive të njerëzve, ose i trajtave të dukurive, me qëllim që të zbulohet komizmi, lidhet, sidomos, me mjetin artistik të karrikaturizmit"*[200]. Tek e para Noli satirizon figurën e renegatit, shokut, bashkëpunëtorit, mikut që e braktisi dhe tek e dyta të njeriut pa bosht, që gjendet rastësisht në rrugën e mundimshme të sakrifikimit dhe që nuk ka takat ta përballojë. Shën Pjetrit mblidhet kruspull mbi mangall duke djegur pjesë të trupit, ca nga ca (dorën, mjekrën dhe në fund gjuhën), të cilat në mënyrë satirike i përgjigjen shkallëve të mohimit të tij. Për të shprehur mërinë e tij Noli ndërton portretin karrikaturor, tragjikomik të njeriut që mblidhet kruspull mbi mangall kur jashtë *fryn e çfryn veriu*. Sarkazma arrin kulmin në vargjet: "*S'ka e s'ka si heroizma, / Edhe si idealizma, / Por kur dimër del behari, / S'ka si zjarri"*[201]. Këndezi që sipa profecisë i kujton Shën Pjetrit fajin, jepet me një gjetje të bukur ironike: *bandill këndezi.*

Ndërsa te Kirenari karrikaturizmi është bërë nëpërmjet groteskut që e përforcojnë fjalët: *qyqar dhe, pijanik*. Dy vargjet e strofës së parë japin fundin dhe fillimin e kësaj figure groteske nëpërmjet kontrastit: *"Del me poçe për sehir, / Ndrit me Kryqin si martir"*.

Noli është cilësuar prej kritikës dhe si mjeshtër i detajit në poezi. Nëpërmjet detajit, ai do të ndërtojë gjithë vjershën satirike *"Kënga e Salep - Sulltanit"*. Noli me një ose dy detaje sinjifikative i vendos anëtarët e kabinetit qeveritar në një rend satirik, që jo rallë shkon deri në grotesk: *Koço Kota mjek hanxhari* (sepse nuk kishte mundur t'i përfundonte studimet për mjekësi), *Fyt i Floqit po pëllet* (himni që K. Floqi shkroi për Zogun), *Një mexhelis të madh na çeli, / Pandeli Jano Vangjeli* (mexhlis është parlameni në turqisht, njeri që kthen të vjetrën në bashkëkohësi), *Sarahoshi Iljaz Vrioni, / dehet siç e do zakoni*, etj. Me sa duket, bëhet fjalë për parlamentin dhe kabinetin qeveritar që u vendos pas Revolucionit të Qershorit. Sipas shënimit, kjo vjershë është shkruar në Vjenë, në vitin 1928, kur mëria zemërimi dhe dhembja e Nolit ishte ende e freskët. Për të shpallur vokacionin e tij poetik ai ngre një vjershë, fund e krye satiriko - groteske, duke vënë shenjën e barazimit midis sulltanit të Turqisë dhe Ahmet Zogut që u bë sulltan, jo vetëm nga besmikët e tij, por dhe nga "mileti". Sarkazma këtu nuk kursen dhe një pjesë të popullit: "*Seç u rehatos mileti, / Se Sulltanin prap e gjeti, / Se që kur e humbi, s'fjeti"*[202]. Përcaktimi salep - sulltan është tejet grotesk (salepi - pije orientale).

[199] Po aty,
[200] Jakup Mato, *Paradokset e satirës dhe humorit*, Tiranë, 2000.
[201] Po aty, f. 78.
[202] Po aty, f. 87.

Një mjet tjetër që përdor Noli për të realizuar satirën dhe humorin është edhe monologu vetëdemaskues si te vjersha e gjatë *"Sulltani dhe kabineti"*. Duke ndjekur modelin e Çajupit tek vjersha "Sulltani", edhe Noli në këtë poezi përdor vetëdemaskimin e sunduesit, por dhe injorancën dhe korrupsionin e gjithë stafit të tij: "*Jam Ali Qopeku i Parë, / Qen si unë s'kini pare"*. I gjithë prezantimi i kabinetit të tij është bërë nëpërmjet paradoksit dhe alogjizmit: "*Ti Halim, që s'di këndim, / je vezir për arësim", "Celo hudhër tarator, / Ty të bëra ambasador", "Ty hajdut të bëj policë, / Vidh pa frikë e me shumicë", "O Kalam, kaurr bekri, / Ty të bëra Bash Myfti"* etj. Për poezitë "*Sulltani dhe kabineti"* dhe *"Vdekja e sulltanit"*, Noli duket se ka përdorur stilin e rëndomtë të bejteve popullore. *"Sigurisht nuk duhet menduar se Noli e ka ulur nivelin e origjinalitetit krijues poetik, ashtu kot së koti, por me ndërgjegjje duhet të ketë zgjedhur modelin e bejteve dhe groteskun perqeshës, sepse personat realë që i përqesh nuk janë personalitete të shquara historike…. prandaj në frymën e bejteve popullore Noli i trajton si palaço horra, karagjozë, grykës, hora etj. Ata, sipas poetit meritojnë epitete groteske që zbërthejnë thelbin e tyre qesharak dhe të poshtër*". [203] Kjo është vjersha më e gjatë satirike kushtuar figurës së monarkut absolut, e vendosur në një mjedis oriental ku sundon ligji dhe metoda tipike anadollake, etja për para dhe barbarizmi në pushtet. Këto ai i jep përmes monologut vetëdemaskues të figurës groteske të një sundimtari obskurantist dhe të zvetënuar shpirtërisht. Studiuesit janë të mendimit se kjo është, në një farë kuptimi, anatema e fundit e poetit 79- vjeçar kundër kryekundërshtarit të tij, është një pasqyrë e vdekjes civile të këtij sulltani shqiptar në planin historik. Ka dhe aludime se Noli mund ta ketë shkruar këtë poezi për të anatemuar e satirizuar regjimin komunist në Shqipëri, por vetë Noli e ka kundërshtuar këtë: "*Kur shkrova vjershën ofenduese s'kisha ndërmend regjimin komunist në Shqipëri, por shpreha ndjenjën time kundër çdo regjimi diktatorial që kufizon lirinë e mendimit"*. [204]

Pas tre vjetësh Noli do të botonte dhe poezinë e fundit satirike *"Vdekja e sulltanit"*, me rastin e vdekjes se Zogut, me 1961. Sipas studiuesit Nasho Jorgaqi, Noli në këtë vjershë ndryshe nga të tjerat, figurën e sulltanit nuk e trajton në rafshin e satirës politike. Pra ai nuk e kap këtu këtë figurë në rrafshin politik, sepse tashmë ai ka vdekur, por e kap në rrafshin etiko-moral. Vdekja e sulltanit nuk sjell ndonjë ndryshim të madh me përjashtim të ndërrimit të haremit*: "Mbreti vdiq, vjen mbreti i ri, / Me trumbet e brohori, / jashtë del haremi i vjetër, / Brenda hyn haremi tjetër"*[205]. Ideja e Nolit në këtë poezi është se me vdekjen e një sulltani, despoti, uzurpatori, nuk vjen ndonjë ndryshim kolosal, sepse sapo vdes njëri sulltan vjen tjetri, i cili nuk ndryshon format e qeverisjes për prosperitetin dhe zhvillimin e shoqërisë njerëzore, por ndryshon vetëm format e komoditetetit dhe egoizmit të vet. Dhe me këtë vjershë të fundit për Zogun ai përcillte mesazhin filozofik, atë që historia i kishte dhënë njerëzimit, se fati i popujve nuk ndryshon me ndërrimin e pushteteve depotike: "*Se sulltani kurrë s'vdes, / prandaj po thërres, / Pashallarë dhe bejlerë, / Rrofshi qofshi*

[203] Alfred Uçi, *Estetika e groteskut*, Tiranë, 2001.
[204] Gazeta *Dielli*, Boston ", 1961.
[205] Fan Noli, *Vepra 1,* Tiranë, 1987.

kurdoherë ”[206]. Për të ngritur gjithë padinë në rrafshin etiko – moral, Nolit, me sa duket, i ka mjaftuar vetëm detaji i haremit, duke dashur, kështu, të japë nëpërmjet satirës idenë jo vetëm të një degjenerimi individual, por dhe shoqëror.

Në të gjitha poezitë e tij satiriko – politike, për të rritur përshkallëzimin e mjeteve shprehëse të satirës dhe humorit, Noli ka përdorur dukshëm orintalizmat. *“Elementi me të cilin Noli tregohet mjeshtër i vërtetë i krijimit të figurave groteske dhe të konceptimit poetik grotesk të dukurive jetësore janë orientalizmat*”[207]. Orientalizmat në vjershat: “*Kënga e Dervish begut”, ”Sulltani dhe kabineti”, ”Kënga e Salep Sulltanit”, “Vdekja e Sulltanit*”, shkojnë bukur me strukturën dhe ambientin e poezisë. Disa prej tyre janë: *din, dovlet, bismilah, elamdurllah, ikstarfullah, imam, padishahu, selamet, namuz, zullum, bodrum, rezil, bashqatip, tertip, sersem, sazdrazem, nefer, serasqer, bekri, bashmyfti, domuz, usull, nbash, binbash, dinkardash, akçibash, dinkarashmastraf, sesapçi, taksildari, nargjile, ferman, xheneti, shamatë, temena, sevda, hadëm, hanëmsevap, meze, qebap, çomlek, kavurma, kapama, imambajalldi, jani, bakllava, dondura, muhalebi, revani, syltiaç, pekmez, hoshaf,* etj, kryejnë funksionin e ngjyrimit të fortë satiriko - grotesk. Rimimi i fjalëve, sidomos te *“Sulltani dhe kabineti*”, bëhet, pikërisht, nëpërmjet orientalizmave, të cilat plotësojnë imazhin dhe vizionin, jo vetëm nolian, por dhe të lexuesit të thjeshtë mbi këto fenomene dhe mbi këto personazhe. Noli, nga ana tjetër, është kujdesur që të shfrytëzojë edhe efektin tingullor të këtyre fjalëve, për të krijuar edhe përmes përsëritjes së tingujve efekte që shkojnë drejt një plotësimi të situatës dhe kuadrit të poezisë. Në këtë rast gjetja që ka bërë Noli është mëse funksionale*: ”Bëjmë dollma me japrak, / bëjmë kos e kaçamak, / bëjmë mish e pastërma, / kavurma dhe kapama”*[208]. Ai ka dashur, që të krijojë nëpërmjet këtyre fjalëve të kulinarisë turke mbingopjen, neverinë dhe rëndojësinë.

Noli nuk i kursen orientalizmat edhe në poezitë e ciklit biblik, sidomos te *“Marshi i Barabajt*”. Megjithëse poezia ndërtohet si parodizëm i psalmeve biblike, Noli kombinon në të dhe orientalizamt për të sjellë thelbin grotesk të Barabajt: *allah, rezil, katil, turfanda, batërma, derbebder, kukuth, lubi, bodrum, dallkauk, kopuk* etj. Këtu, zjarrmia e zemërimit dhe mërisë gjeti vokacionin poetik nëpërmjet orientalizmave. Nuk ndodh ky fenomen te *“Marshi i kryqëzimit”*, ku me përjashtim të orientalizmit *usta* nuk është përdorur tjetër orientalizëm, sepse nuk i përshtatet aspak portretit të çlironjësit, të identifikuar me vetë autorin. Pardoksi qëndron edhe midis dy poezive: te e para refreni është panegjirizmi me kuptim të përmbysur, që e përmbys vetë përmbajtja e strofës*”Hosana Baraba”*, ndërsa te *“Marshi i kryqëzimit”* refreni në fund të çdo strofe është *“Kryqëzoje, Pilat, në Kalvar Golgotha”.* ,

Një mjet tjetër i përdorur dendur në poezitë e Nolit, por që merr një efekt të veçantë stilistik brenda kontekstit, është dhe epiteti i thjeshtë. Noli ka ditur ta vërë çdo përcaktim në vendin e vet, në funksion të plotësimit të idesë qendrore për të realizuar një ideomatikë të qëndrueshme dhe një satirë fshikulluese. Epiteti *faqenxirë*, që

[206] Po aty, f. 118.
[207] Alfred Uçi “*Estetika e groteskut*”, Tiranë 2000, f.
[208] Fan Noli, *Vepra 1,* f. 107.

përdor në fund të poezisë *"Shën Pjetri mbi mangall"*, shenjëzon përfundimisht portretin e renegatit, ndërsa të *"Kirenari"*, karrikaturizmin e personazhit e plotëson epiteti *qyqa*r dhe *pijanik*. Te *"Marshi i Barabajt*, epiteti është mjeti kryesor i procedimit dhe ndërtimit organik të strukturës së poezisë, epitet që realizohet kryesisht përmes orientalizmave, fjalëve shqipe dhe kompozitave: *rezil, katil, laro, tradhtor, i çgryer, i zhyer, turpendotkundërmonjës, zemërkrundegërdhu* etj. Për të stigmatizuar turmën e dalldisur dhe galerinë groteske të njerëzve të poshtër, ai përdor epitetet: *të mjerët, të humburit, të marrët, të shurdhërit, hipokrit, kusar, budalla etj,* ndërsa hirearkinë e pushtetarëve të kabinetit të sulltanit i qesëndis me epitetet *sulltan –llokum, sulltan salep, sarahosh, kaurr bekri, qafir, martalloz, hadëm etj*.

Duke folur për satirën dhe humorin e poezive të Nolit nuk mund të lëmë jashtë vëmendjes edhe 5 vjershat lirike intime dhe humoristike: "*Plak topall dhe ashik", "Sofokliu", "Saga e Sermajesë", "Lidhje e paçkëputur" dhe "Çepelitja"*. Studiuesit janë të mendimit se këto poezi janë shkruar në formën e poezisë popullore, por vërehet në to dhe ndikimi i theksuar i rubaive të Omar Khajamit. Tre poezitë e fundit Noli i shkroi në moshën mbi 80 - vjeçare, në kulmin e dhembjeve që i shkaktonte sëmundja e tmerrshme dhe mesa duket ai shkroi këto poezi për të sfiduar atë. Ishte i çuditshëm vitaliteti i këtij njeriu që gjente forca për të qeshur, sepse ai, në fakt, është cilësuar si njeriu i paradokseve të mëdha, jo vetëm në art por edhe në jetë. *"Noli nuk mplakej (sipas Konicës) sepse dinte të qeshte dhe në pleqëri. Këtë veti të shpirtit të tij ai e shfaqi në disa vjersha të humorit të çiltër, me një ngjyrim të tragjicitetit, kur këndon mallet njerëzore, mallin e dashurisë, kur ndeshet me kalueshmërinë e kohës. Ka këtu humor e përqeshje të vetvetes. Ishte Noli i moshuar kur foli teorikisht për artin e poezisë e thirri: "Ata që shkruajnë nuk duhet t'i fshehin mëkatet. Ashtu qoftë! "*[209]

Te këto poezi elementi zotërues nuk është satira, por humori, një humor i hollë, i gjetur dhe i këndshëm, i cili buron nga kontradikta mes dëshirave, mallit për djalërinë e humbur, dashurisë për vajzën e re të një plaku dhe pamundësisë së tij për të kapur dashurinë, siç ndodh në vjershat: "*Plak topall dhe ashik", "Sofokliu", "Lidhje e paçkëputur", "Cepelitja"*. Ndërsa te "*Saga e Sermajesë"*, humori shkaktohet nga kontradikta midis dëshirës për të patur vajzën dhe pamundësisë për shkak të varfërisë. Pothuaj, në të gjithë këtë cikël ndodh që humori i hollë dhe qesëndisës të marrë shpesh trajtat e një dhembjeje që në brendësi i shndërrojnë këtë poezi në elegji të pashprehura. Në këto poezi, Noli përdor si mjet të krijimit të komizmit vetëpërqeshjen. Kjo ndihet sidomos te *"Plak topall dhe ashik"*, një kryevepër në llojin e vet. *"Motivi shfaqet në vjershërinë tonë gojore që vë në bisht të lahutës burin e moshuar, i cili rend pas vashës së re. Ndërtimi i strofës, kadenca trokaike, që mbyllet me një jamb, i jep vjershës harmoninë imituese të rendjes dhe ndalesës"*[210]

Humori i kësaj poezie shpaloset qartë që në vargun e parë: "*Dale moj se kam një fjalë, / Se më rrjedhin djersët vale"*, ku fjala *dale moj*, një fjalë e rëndomtë e ligjërimit të përditshëm është ngritur në art në gojën e plakut dhe të krijon idenë e thirrjes së dëshpëruar, jo ndaj vajzës por ndaj rinisë së larguar shpejt, të cilës ai akoma nuk ia ka

[209] Sabri Hamiti, *Letërsia moderne shqiptare*, Tiranë, 2000, f. 71

[210] Fan Noli, *Vepra 1, Parathënie, Vehbi Bala*, f. 43.

nxjerrë mallin dhe këtë e vërteton fjala *valë*, në kuptimin e zjarrmisë dhe afshit dashuror për jetën. Humori i kësaj poezie përshkallëzohet deri në strofën e fundit, në një gradacion rritës, që jepet mes veprimit simboliko - humoristik, për të përfunduar me të njëjtën strofë si në fillim dhe në fund, por ku ndodh vetëm një ndryshim: fjala *djalë* është zëvendësuar me fjalën *çalë*, për të dhënë idenë e një rinie të përfunduar, të çalë, e cila ende i jep një shpresë të vagullt. Epiteti *topall* dhe *ashik* realizojnë gjithë gamën humoristike dhe kuptimore të poezisë, që në thelb, të dyja pranë e pranë janë në kundërthënie. Ndërsa tek *"Sofokliu*", ai përdor një detaj humoristik, duke kundërshtuar filozofin e madh, për të artikuluar idenë e epikurianizmit dhe hedonizmit që të fton kah gëzimit të jetës, në çdo moshë dhe ky është detaji i goditur i Ferid Asllanit, për të cilin: "*Amerika, Evropa u çudit, / Nuse desh kur vdiq"*[211]. Edhe te vjersha *"Lidhje e paçkëputur"* ideja artikulohet përmes një shkallëzimi ngjitës të veprimit humoristik. Këtu, portreti i vajzës, në kundërthënie me ndjenjën që ndez, jepet në planin grotesk duke operuar me epitetin: *shejtane, shafrane, kurbatkë, katarroshe.* Komizmi i vjershës që synon të japë mesazhin realizohet dhe përmes antitezave dhe kontrastit, mjetit më të parapëlqyer të Nolit: "*Unë hesht, ti po bërtet, / unë fle, ti po gërrhet"* dhe nga rrafshi i veprimit antitezat kalojnë në rrafshin shpirtëror: "*Unë prush ti dëborë, / unë dërrasë ti këmborë, / unë hi e ti vullkane, / unë mi e ti kapllane*"[212]. Përsëritja e shpeshtë e tingullit ***r,*** këtu nuk ka efektin që ka përsëritja e këtij tingulli tek poezitë politiko – shoqërore, ku sjell shkulmin, tmerrin zhurrmën, por tingulli ***r*** dëshmon këtu unitetin e të kundërtave, në një bashkjetesë të përjetshme e të pandarrë: "*tok pra mbetemi sa të tretemi"*.

Në rrafshin e krijimi të një humori të dhimbshëm, Noli ka operuar te vjershat *"Cepelitja"* dhe *"Saga e Semajesë"*, duke shfrytëzuar situatën e kundërt të poezive *"Plak topall dhe ashik"* dhe *"Sofokliu"*. Në këtë rast është vajza që e ngacmon dhe i bie në qafë plakut, dhe kjo nuk ndodh në realitet, por në ëndërr. *"Një nga format e situatës komike realizohet kur personazhet e kundërta ndërrojnë rolet e veta dhe veprojnë e flasin në kundërshtim me natyrën dhe fizionominë e tyre"*[213]. Përmbysja e situatës, sulmi, këmbëngulja e vajzës dhe tërheqja e plakut, fjalët që shkëmbejnë ndërsa ajo digjet nga pasioni dhe plaku luan rolin e indiferentit, janë shprehur përmes një fryme popullore dhe leksiku oriental, që e bëjnë poezinë tërheqëse dhe gazmore. Orientalizmat: *hajat, usull, kabull, kusur, aman, kapllazane, jallane, qerpaze, paraqende*", forcojnë më shumë komizmin dhe nuk kanë ndonjë rol të dukshëm në artikulimin e idesë. Ndërsa strofa e fundit: "*Kur më puthi u trullosa, / dhe teslim u katranosa, / dhe kështu or, u mbërtheva, / Po për zotin s'u gënjeva"*, duket sikur kërkon të luajë me lexuesin duke e vënë në dilemë për mesazhin e poezisë. Jeta jetohet dhe në ëndërr dhe kur shpirti është zgjuar dhe jeta është zgjuar. Kjo është një dëshmi e shpirtit të Nolit që dëshirën dhe mallin për jetën nuk e kishte tretur ende. Poezia realizohet përmes rimash foljore që përcjellin idenë e një veprimi që zhvillohet më

[211] Po aty, f. 98.
[212] Po aty, f. 113.
[213] Jakup Mato, *Paradokset e satirë dhe të humorit*, Tiranë 2000, f. 226.

shpejtësi përmes kundërthëniesh, deri tek finalizimi i idesë që dashuria jetohet në shpirt.

Tek *"Saga e Sermajesë"* Noli shfrytëzon tonet e forta ironike dhe sarkastike që të japë idenë e një aventure donkishoteske: një mesele në vargje siç e quan ai për të argëtuar lexuesin shqiptaro - amerikan. Duket sikur gjithë komizmi dhe humori i poezisë është vetëm argëtues, për të vënë buzën në gaz. Në këtë vjershë të gjatë, plot orientalizma të këndshme, veç parantezës që bën për të stigmatizuar Hitlerin(Hito katili) dhe Musolinin që kishin sulmuar Stalinin, nuk ka ndonjë satirë të fortë. Agresionin e Hitlerit dhe Musolinit, Noli e përdor si paralelizëm paradoksal dhe qesharak për të të treguar tmerrin e një aventure të tillë: "*Kur u nismë u tunt dynjaja, / Dhe u err, u nxi havaja"*. Një paradigmë kjo dhe për dashurinë që ai e quan *dashuria - lebetia*, që më shumë sjell shqetësim se gëzim: "*Se të kap sevdaja, / Dhe të mbyt belaja"*[214]. Në moshë të thyer, Noli i kundërthenieve shikonte dhe anën tjetër të medaljes; dashurinë si brengë. *"Shakatë më të mira janë ato që bëhen padashur e pa ditur, kur ai që na gostit me këto e ka mbushur kokën e na shtron përpara mjeteve serioze"*[215] - thotë ai.

Noli nuk shkroi vëllime me vjersha satirike si Fishta as poema satirike si Çajupi, Ali Asllani etj, por poezia e vëllimit "Album" në një pjesë të konsiderueshme të saj është një shkollë më vete përsa i përket satirës, groteskut dhe humorit të poezisë shqiptare, sidomos asaj të periudhës në fjalë. Vetëm një njeri që mund të ndiente, të dinte, të kuptonte dhe të asimlilonte kaq mirë absurditetin e rrethanave dhe ngjarjeve, mund të arrinte të zbrazte kaq fuqishëm, arrtistikisht, zjarrminë e brendshme të urrejtjes përvëluese. Prandaj satira sarkazma ironia dhe grotesku i kësaj poezie janë krejt unike në letërsinë shqipe dhe që të evidentohen plotësisht kanë nevojë për studime të mëtejshme.

[214] Fan Noli, *Vepra 1,* f. 112.

[215] Fan Noli *Vepra 3,* Tiranë, 1987, f. 204.

Prof. dr. JOSIF PAPAGJONI

"IZRAELITË E FILISTINË" – KUMTI BIBLIK DHE "LOJA" ME KOHËN

Penat e talentuara, thuhet, vetëshprehen qysh në ag, porsa mugullon rinia. S'është fjala më shumë tek sqima stilistike, lodrimet e mendjes apo përsosja e fjalës. Këto vijnë e piqen ca më vonë. Fjala është për ato bulbe, ftillëzuar në kryeherë, por që dalin e ridalin më vonë, shpesh në formë ciklesh, në krijimtarinë e mëpasme kur ajo vërshon lirisht. Kështu thotë së paku edhe Kadareja tek "Ftesë në studio" për krijimtarinë e vet. Por këtë mund ta themi edhe për Fan Nolin dhe dramën tij ***Izraelitë e filistinë***. Ai e shkroi atë në rininë e hershme, në Greqi, Athinë, dhe e botoi më 1907. S'ishte sprova e tij e parë në dramaturgji, por e dyta. Noli kishte punuar për dy vjet si sufler pranë një teatri ambulant, çka nxiti tek ai pasionin për teatrin. Shi asohere shkroi në greqisht dramën *Zgjimi*, që u luajt nga trupa shëtitëse, por që për fat të keq nuk ka mbërritur dot në ditët tona. Fill më pas, diku nga viti 1902, aty tek të njëzetat, konceptoi edhe dramën *Izraelitë e filistinë.* Dyshues ndaj vetes dhe veprës, s'e quajti dramë por "sqelet drame".

Po ç'bëhej me Shqipërinë dhe shqiptarët në vitin 1902? Shumëçka dhe asgjë. Le ta quajmë këtë fillimshekulli, në dukje një përgjumje, një "dum Babën", slogan i klithur fort pas dhjetë-njëmbëdhjetë vjetësh nga haxhiqamilistët, porse në fakt, ashtu si lëngjet e pranverës mbushin sythat e i bëjnë gati të plasin në gjelbërim, ashtu dhe kjo "heshtje" pas shtypjes së kryengritjeve shqiptare të Lidhjes së Prizrenit 1878-1881, s'ishte veçse "heshtja" e llavës vullkanike nën koren e tokës teksa bëhej gati ta flakte tej zhguallin e rëndë, inert dhe armiqësor të sundimit otoman. Ishte pikërisht kjo koha kur në shpirtin e Nolit të ri, ende pa rason e priftit mbi shpinë, vetonte imazhi i një vetëmohimi ala Samson për të drejtën dhe të vërtetën, nënkupto Lirinë. Ishte pikërisht kjo koha, kur rioshi Fan Noli mendonte mbi vullnetin kantinan si shprehja e frymës së Perëndisë që vetëshprehej te njeriu i madhërishëm, fisnik, vetëmohus, njeri i cili mund të shkonte drejt qëllimit dhe amshimit i dritësuar veçse nga parimet e religjionit. Dhe prandaj çdo akt i vullnetshëm që sjell harmoninë dhe përsosmërinë, që vendos të drejtën mbi të padrejtën me triumfin e së mirës ndaj së ligës, s'është veçse pjesë e vullnetit hyjnor në sendërtimin konkret, të njeriut a popullit konkret, në situatën konkrete. Dhe prandaj, në formën e një asociacioni tejet transparent, mendja e rishtarit të lirisë kanonike e shpirtërore rrugëtonte drejt lirisë së kombit të tij duke i ofruar zgjidhjen e sanksionuar prej rilindësve shqiptarë: me pushkë dhe me penë. Ndryshe thënë, kryengritje dhe diturim. Një ide e pnellshme për kohën kur drama u ngjiz, po aq e pllenshme edhe për kohë të tjera, para apo pas saj.

E këqyrur në trungun ku buthtojnë idetë bazike të veprës, midis tyre spikat ideja e triumfit të së vërtetës, si triumf i urtësisë dhe arsyes, si triumf i drejtësisë. Nëpërmjet subjektit të shkëputur nga Dhiata e Vjetër, posaçërisht nga miti i Samsonit dhe lufta e izraelitëve me filistinët, Noli ka dhënë te kjo dramë gjasa të mjaftueshme dhe kuptime lehtësisht të rrokshme, falë edhe përditësimit që pëson domethënia e ardhur nga

shkrimi i shenjtë me aplikimin e alegorisë. A ka në konceptimin e figurës së Samsonit diçka nga mbinjeriu niçean, nga vullneti i jashtëzakonshëm që rikrijon ose e zëvendëson Perëndinë, një farë Zarathustre që e sheh turmën jo nga brenda tempullit si Samsoni filistinët, por nga maja e malit, domethënë nga sipërania e arsyes dhe vullnetit si dallim dhe refuzim ndaj mediokritetit, rëndomtësisë, të ulëtës? Besoj se jo. Së paku në brendi. Përkitje me paradigmën niçeane mund të gjenden, por asnjëherë s'duhet harruar se Noli asaj kohe ishte një rishtar i thekur i doktrinës së krishterë. Samsonit i ishin atribuuar vërtetë fuqi hyjnore, të jashtëzakonshme, mbinjerëzore, pikërisht tek flokët dhe mjekra e tij; vërtet ai e rropos një tempull ngritur mbi idhujtarinë, gënjeshtrën dhe të padrejtën; vërtet ai shemb për të rindërtuar, shkatërron një rend të vjetër bazuar mbi anarkinë për të rikostruktuar një rend të ri bazuar mbi kozmogoninë, por, në fund të fundit, Samsoni s'është fillikat, as përjashtimisht vetvetja. Ai është vazhdues i vullnetit të Hyut, i dërguari i një populli dhe fuqie te një popull dhe fuqi tjetër. Pra, një përfaqësues dhe delegat, më shkurt fare mesazh i një qytetërimi të shenjtëruar ndaj një tjetër qytetërimi, tashmë të shajnuar dhe të djaboluar. Në mesoren e këtyre dy botëve: izraelitëve të lidhur në besë me Hyun dhe filistinëve të pabesë ndaj tij, sakaq i dashuruar nga Rakela, por i tunduar prej Dalilës, ai ftohet në fisin e filistinëve si bujtës dhe i adhuruari i princeshës idhull bukurie dhe ambicieje, mashtrohet prej saj, dehet, lidhet me litarë dhe i priten mjekra dhe flokët gjatë gjumit apo jermit, duke ia hequr përkohësisht fuqinë që i pat dhënë Hyu. I tradhtuar, i tallur, i lidhur, i burgosur, ai ndërmend të vërtetën e shprehur prej Rabinit se filistinët besonin në ar, në dashuri, në qejfe dhe që të besonin edhe tek e vërteta, duhej edhe fuqia. Prandaj të vemi të gjithë me shpata, këmbëngulte prifti izraelit. Sakaq Samsoni ndien se flokët dhe mjekra po i rriten, dhe bashkë me të i vjen edhe fuqia. Për t'i ndëshkuar filistinët si besëlëshuar ndaj Hyut dhe së Drejtës Hyjnore, ai e shemb tempullin ku e kishin burgosur dhe tok me vdekjen e tij nën rrënoja, bën të vdesin edhe gjithë filistinët, duke e rivendosur të drejtën e mohuar të Hyut.

Pyetja e shtruar është: me bindje apo me forcë vendoset e drejta te popujt e shajnuar që aplikojnë politeizmin? Është një alternativë e kahershme sa edhe e gjithhershme se si mund të zgjidhen konfliktet. Të dyja rrugët janë të drejta sa dhe të padrejta, të mundshme dhe të pamundshme. Ato sjellin pasoja me ploja gjaku, mohime të skajshme, robërime, shkatërrime, urrejtje, konflikte pa fund. Pse? Sepse janë pjesë e atributeve njerëzore, e natyrës së papërsosur të qenies, rrjedhimisht paaftësi e "arsyes" së kufizuar kur kjo nuk e njeh dhe nuk mëton të ngrihet në nivelin e arsyes hyjnore. Ndonëse Samsoni është thirrur si përmbarues i fuqisë dhe pathyeshmërisë njerëzore, bartës i së drejtës hyjnore, i idesë dhe energjisë trashendentale, gjithsesi ai s'del dot nga caqet e veta prej njeriu që tundohet nga pasioni ndaj Dalilës, që mashtrohet ose vetëmashtrohet nga shkëlqimi i rremë, luksi dhe argëtimi. Dhe tashmë si i mëkatnuar, pra i ndotur, jo i pastër dhe i virgjër si fillesë bazike hyjnore, bëhet nga i pavdekshëm i vdekshëm. Pozita tragjike e Samsonit shprehet në aktin vetëflijues të tij jo thjesht për triumfin e izraelitëve, por për triumfin e të drejtës dhe arsyes absolute, duke e mbyllur ciklin ekzistencial të trifishtë: i pavdekshëm në fillim, i vdekshëm në fund si njeri, sërish i pavdekshëm si shembull, ide dhe frymëzim. Pra, bashkimi i tij me frymën dhe fuqinë eskatologjike është rimishërimi i mesazhit dhe arsyes hyjnore, që ne e

komentuam më sipër si pjesë të mendimit nolian. Në dimensionin filozofik të këtij mendimi, afërmendsh që drama e tejkalon cakun e ngushtë të një kohe: ideja e saj bëhet universale. Por e qasur me një realitet historik konkret mes shqiptarësh në rizgjim kombëtar, drama ngulitet pikërisht tek situata politike e shoqërore e fillimshekullit XX. Dhe ajo s'mund të dilte jashtë programit politik dhe arsyes së rilindësve tanë për mënyrën se si mund e duhej themeluar kombi dhe shteti kombëtar i shqiptarëve. Duhej besuar ende tek "çallma turke" me gjithë rrengjet, pabesitë, konvertimet, plojat, bjerrjen dhe zvetënimin që kishte sjellë apo duhej rrëmbyer shpata e të drejtës historike, e të drejtës kombëtare, e së drejtës së përkatësisë europiane perëndimore, edhe në u dashtë që në tempullin e ri të vihej si vetëflijim qafa, pra dhe gjaku i pritshëm i bijve të shqipes të blatohej e përhirohej nga Hyu si epifania e fundme pas kalvarit 500- vjeçar të modelit Lindor. Qysh 20 vjeç, rioshi Fan Noli e kishte zgjedhur udhën e tij. Madje mund të thuash se edhe jeta e tij i ngjan nga pak Samsonit vullnetmadh, vetëflijimit të tij në tempullin e shajnuar për pak më shumë dritë Perëndimi. Kështu, duke dhënë përpjekjen e izraelitëve për të detyruar filistinët politeistë që të përqafojnë besimin te një Zot i vetëm dhe unik (monoteizmi), drama shtronte pyetjen: me forcë apo me bindje duhej hapur udha e të vërtetës? Fundi i saj jep edhe përgjigjen, se e vërteta duhet rrokur njëherit në të dyja dimensionet: bindjes dhe forcës.

Ndërkaq, autori operon në mënyrë të çlirët me koncepte dhe ide universale që prekin ekzistencën njerëzore, ontologjinë e saj, si për shembull kuptimin e të drejtës si rend, rregull dhe kozmos kundër së padrejtës si kaos, anarki, zvetënim; mënyra e njohjes të së vërtetës dhe e vendosjes të së drejtës duke i kthyer ato në arsyen absolute të Zotit dhe delegimin e pushtetit të tij në tokë; aktin e sakrificës për të vërtetën, dikotomitë gjithëkohore të së mirës dhe të ligës, të besnikërisë dhe tradhtisë, të dashurisë dhe pabesisë, të reales dhe fantastikes, të së njëmendtës dhe iluzionit etj. Nga personazhet e skalitur në dramë janë Samsoni, Rabini, Dalila, Rakela. Këto të fundit, dy të dashuruara pas Samsonit, shprehin edhe dy kundërtitë njerëzore femërore në mënyrën se si e kuptojnë dashurinë dhe devocionin ndaj të dashurit. Rakela është arketipi i gruas besnike, të sinqertë e të përkushtuar, me besimin në Zot, prandaj dhe me nënshtrimin ndaj vullnetit hyjnor, fatit dhe të dashurit. Dalila, përkundrazi, si e kundërta e Rakelës, është arketipi i gruas tunduese, epshore, mëkatnore, që nuk ofron as sinqeritet, as përkushtim dhe as besnikëri, përkundrazi bëhet lehtësisht e instrumentalizuar duke mbetur deri në fund një frymëzim satanik. Madje edhe pas shembjes së tempullit ajo nuk vdes si gjithë të tjerët, por shpëton. Dhe me këtë ide befasuese e tejet racionale, Noli do të na thotë se e keqja, sado që ndëshkohet, mbetet diku rrotull nesh, mbijeton e shpëton, ashtu si Djalli i zhytur nën tokë nga këmba e Zotit por që bishti i pat mbetur sipër për të trazuar sërish njerëzit, për t'i ftuar sërish në mëkate, pabesi e shajni. Dhe atëbotë fundi bëhet pafundësi ose fillim, për njeh fillim e fund tjetër, çka në vetvete shenjon antinominë e përjetshme të së mirës dhe të keqes, hyjnores dhe djallëzores. Në këtë rrafsh Noli, me dashje apo pa dashje, ka mbërritur në konceptin ontologjik të vetë qenies si dhe njerëzimit si të tillë, çka nënkupton sakaq dialektikën e përmbysjeve, riciklimet progresive dhe vetëmjaftueshmërinë e dy poleve të kundërt.

Sado që drama e vetme e tij, F. S. Noli bëhet megjithatë pararendës i modeleve të reja e moderne në dramaturgjinë shqipe, selitës dhe risemantizues i rrëfenjave biblike (që funksionalizohen si rrjedhë e subjektit dhe premisë e konfliktit dramatik), ku fiton shprehësi po aq edhe një gjuhë filozofike e me patos romantik. Falë krijimit të qasjeve midis mitit religjioz dhe realitetit të prekshëm social të kohës, autori shkon më tutje se domethënia simbolike e tyre, në rrafshet e një realiteti tashmë të universalizuar.

I vetëdijshëm për kriteret që lipseshin ndaj një krijimi dramaturgjik të mirëfilltë, Noli ishte i bindur se drama *Izraelitë e filistinë* kishte nevojë të mbushej, të pasurohej e të përpunohej me tej. Marrë nga pikëpamja e ngjeshjes së veprimit dramatik që vërehet, drama mbetet një nga vlerat e rralla cilësore të trashëgimisë sonë dramaturgjike për kohën kur u shkrua (1902), filluar nga struktura kompozicionale e saj, paçka se jo deri në fund koherente; më pas nga mënyra e thurjes së ngjarjeve, nga gjuha lakonike dhe e figurshme, nga kontrastet e forta, nga personazhet me mbarsje sa mitologjike po aq filozofike, deri te mesazhet që rrokin e alternojnë si anën historike, ashtu edhe atë aktuale.

Dr. KRISTAQ JORGO

KUANTEMNANCA NË POEZINË DHE SHQIPËRIMET E F. S. NOLIT

Kjo kumtesë synon të marrë në shqyrtim dukurinë e kuantemnancës në krijimtarinë poetike të F. S. Nolit (poezi origjinale dhe shqipërime).

1. Kuantemnanca përfaqëson njërin ndër konceptet kryesore të një ngrehine teorike në ndërtim e sipër, të pagëzuar prej nesh 'teori e kuantifikimit harmonik të tekstit'. Meqenëse një pjesë e ndihmesave tona në këtë lëmi të kumtuara në aktivitete shkencore, janë ende të pabotuara[216], po parashtrojmë në krye të herës, fare shkurtimisht disa prej parimeve/vëzhgime themelore:

1. 1. Teksti poetik (letrar) – i përkufizuar prej nesh 'tekst i kuantifikuar dhe/apo i kuantifikueshëm harmonikisht'-është një sistem vetorganizues; parimi themelor i morfologjisë së krijimit të tij - i rendit kuantitativo-kualitativ, i shprehshëm përmes një logaritmi të tipit rekursiv (parimi i pikëprerjes së artë)/dhe ose përmes plotpjesëtueshmërisë.

1. 2. Një matricë e tillë maksimalisht elementare, e cila 'synon' t'i administrojë të gjitha nivelet e tekstit është, ndër të tjera, përgjegjëse dhe shpjeguese e paradoksit themelor estetik në lëmë të poezisë (dhe të letërsisë përgjithësisht): si arrihet që e bukura – kryecilësia e 'prodhimit shpirtëror *më kompleks* të shpirtit njerëzor', tekstit poetik (J. Lotman) ashtu si çdo vepre arti përgjithësisht – të zbulohet në mënyrë *të përnjëhershme e të pandërmjetshme*.

---

[216] Kristaq Jorgo, *Mbi kuantifikimin harmonik në poezi. Pyetje për një paraskicë të një filologjie të tretë*, në: AA. NN. , Studime filologjike shqiptare, . Konferencë shkencore, 21-22 nëntor 2007, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës – Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Prishtinë, 2008, f. 309-314; Kristaq Jorgo, *Koha në lirikë. Mbi funksionin themelor të kohës në ligjërimin letrar*, në: AA. NN. , Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, gusht 2007, Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Filologjisë dhe Universiteti i Tiranës – Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Prishtinë, 2007, f. 197-202;Kristaq Jorgo, *Për një analizë kuantematike të tekstit poetik (At Gjergj Fishta, Nji lule vjeshtet)*, në "Studime albanologjike", II, Letërsi, Universiteti i Tiranës – Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, viti XIII, 2008/2, f. 77-82;Kristaq Jorgo, *Drejt një teorie të kuantifikimit harmonik të tekstit*. Kumtesë mbajtur në Konferencën e Shkencave Albanologjike të Takimit III Vjetor Ndërkombëtar të Institutit Alb-Shkenca, Tiranë, 1-3 shtator 2008. Kristaq Jorgo, *Koncepti i kuantemnancës në teorinë e kluantifikimit harmonik*, Kumtesë mbajtur në Konferencën e Shkencave Albanologjike të Takimit IV Vjetor Ndërkombëtar të Institutit Alb-Shkenca, Prishtinë, 2-4 shtator 2009; Kristaq Jorgo, *Kuantifikimi klasematik në poezi*, Kumtesë mbajtur në Konferencën e Shkencave Albanologjike të Takimit V Vjetor Ndërkombëtar të Institutit Alb-Shkenca, Tiranë, 1-4 shtator 2010.

1. 3. Ligji i kuantifikimit harmonik, i njëmendësueshëm në trajta praktikisht të panumërta, shfaqet në thelbin e vet i njëjtë në krijime të ndryshme të secilit autor, të autorëve të ndryshëm të së njëjtës gjuhë, në tekste poetike të periudhave e letërsive/gjuhëve të ndryshme.

1. 4. Në zhvillim të kësaj hipoteze formulohen (riformulohen) nga ne konceptet e kuantemës, të bashkësive kuantematike, të simetrisë dinamike të tekstit, të kuantifikimit ndjenjësor, dy- a më shumëfonemor, rrokjesor, ritmik, kompozicional, klasematik, sintaksor dhe shembullzohen këto përmes analizës kuantematike të një vargu tekstesh.

1. 5. Kuantema është një njësi e ligjërimit poetik (rrjedhës ligjërimore), identiteti i së cilës është intuitivisht i njohshëm, por e cila në procesin e analizës kuantematike të tekstit mbetet të përcaktohet.

1. 6. Kuantemën mund ta përkufizojmë si njësinë bazë e organizimit estetik të tekstit.

1. 7. Kuantemat e një bashkësie shenjohen nga një tipar i përbashkët a element ndërlidhës, i cili nga pikëvështrimi i kuantifikimit ka aftësinë të rrafshojë tiparet e tyre dalluese për hir të tiparit të tyre lidhës. Ky tipar duke qenë i njëjtë, i përbashkët, realizon përnjësimin e bashkësisë kuantematike.

1. 8. Parimi i përgjithshëm i kuantifikimit harmonik të tekstit mund të formulohej shkurtimisht kështu: Në tekstin poetik (A) mund të hetohen një shumësi bashkësish kuantematike binare (B vs. C) të niveleve të ndryshëm. **Raportet numerike të së tërës A me bashkësinë kuantematike B dhe të kësaj me bashkësinë e vogël kuantematike C priren t‘i afrohen koeficientit të prerjes së artë (përafërsisht 1. 618) ose të jenë madhësi të plotpjesëtueshme me më të voglën prej tyre a më një nënfish të të triave.**

1. 9. Kuantemnanca - një term yni përmbledhës për të gjitha figurat e përsëritjes [aliteracioni, asonanca, homeoteleuti, rima, homofonitë e ndryshme, përsëritja e plotë apo e pjesshme e fjalëve a sintagmave (anafora, anadiploza, epifora, përsëritja e vargjeve etj.)] – është sipas nesh një fenomen bazal, gjenerues dhe mbarështrues i të gjitha këtyre formave të përsëritjes në tekstin poetik. Ky koncept (kuantemnanca) shenjon rrokjet apo njësitë dy-a-mëshumëfonemore që përsëriten të paktën dy herë në vijë të rrjedhës së ligjërimit.

2. Për qartësim e konkretizim të konceptit të kuantemnancës marrim në analizë strofën e parë të pozisë së F. S. Nolit *Himni i Flamurit*:

2. 1. Kuantema/kuantemnanca rrokje

O Flamur gjak, **o flamur** shka**bë**,
O vënd **e** vatr' **o** nën' **e** ba**bë**,
La**gur me** lot, dje**gur me fla**gë,
Flamur i kuq, **flamur i** zi. [217]

Në këtë strofë të poezisë *Himni i Flamurit* kuantemat-rrokje (të nxira): **o, fla, mur, bë, e, gur, me, i** përsëriten së paku dy herë**.** Të tjerat vetëm një herë**.**

2. 2. Kuantema/kuantemnanca dyfonemore

O **Flamur** gjak, o **flamur** shk**abë**,
O v**ën**d e vatr' o n**ën**' e b**abë**,
Lagur me lot, dje**gur me flag**ë,
Flamur i kuq, **flamur** i zi.

Po këtu, kuantemat dyfonemore (çifte fonemash të njëpasnjëshme): **fl, la, am, mu, ur, ab, bë, ag, gu, ën etj.** përsëriten së paku dy herë**.** Çifte të tjera fonemash të njëpasnjëshme si **gja, ak, shk, ka, nd, va, at, tr, në, ba, lp, ot, dj etj.** dalin në tekst vetëm një herë.

Njësitë (kuantemat) rrokje apo dy- a më shumëfonemore që përsëriten i emërtojmë, në analogji ky term me termat 'asonancë', 'konsonancë' etj. , **kuantemnanca,**

2. 3. Bashkësitë e kuantemave / kuantemnancave

Formohen kështu në kuadër të tekstit tri bashkësi:

A. bashkësia e përgjithshme e kuantemave (rrokje, fonema);
B. bashkësia e kuantemave që nuk përsëriten;
C. bashkësia e kuantemave që përsëriten (kuantemnancat)

2. 4. "Ligji" i kuantemnancës

Sipas pikëpamjes sonë, në tekstet poetike të nivelit të lartë raporti i bashkësisë së përgjithshme të njësive/kuantemave (A) me bashkësinë e njësive/kuantemave që përsëriten (kuantemnacat) (B) dhe i këtyre me bashkësinë e kuantemave që nuk përsëriten (C) nuk është i çfarëdoshëm, por ka prirjen t'i nënshtrohet një rregullsie pak a shumë universale, e cila herë shfaqet në trajtat **e plotpjestueshmërisë** dhe herë në atë **të koeficientit të prerjes së artë (1. 618).**

2. 5. Raporti i bashkësive kuantematike

[217] Fan S. Noli, *Vepra 1*. Zgjedhur e përgatitur nga prof. Nasho Jorgaqi, Botimet "Dudaj", f. 37.

O Flamur gjak, **o flamur** shka**bë**,
O vënd **e** vatr' **o** nën' **e** ba**bë**,
La**gur me** lot, dje**gur me fla**gë,
Flamur i kuq, **flamur i** zi.

A. Bashkësia e përgjithshme e kuantemave 36
B. Bashkësia e kuantemnancave 23
C. Bashkësia e kuantemave (rrokjeve) që nuk përsëriten 13

Siç mund të vërehet lehtësisht, nuk ka as plotpjestueshmëri dhe as koeficient të prerjes së artë në raportin e bashkësive A, B e C. Duhet të mbajmë parasysh – në këtë përfundim kemi arritur - se **"ligji" i kuantemnancës nuk priret, si rregull, "të veprojë" në fragmente të tekstit, por në kuadër të tekstit si një i tërë.**

3.

Siç këmbëngulin me të drejtë kritikët e sprovave në fushë të raporteve të tekstit poetik/letrar me matematikën dhe siç është e vetëkuptueshme, thelbësor për verifikimin e vlershmërisë a jo të (hipo)tezave kuantifikuese, si kjo në themel të 'teorisë' sonë të kuantifikimit harmonik të tekstit, është zgjerimi sa të jetë e mundur më shumë i korpusit të teksteve që i nënshtrohen analizës.

Këtë jemi përpjekur të bëjmë me krijimtarinë poetike noliane. Ia kemi nënshtruar analizës kuantematike në nivelin e kuantemnancës një pjese të mirë të korpusit të teksteve poetike origjinale të F. S. Nolit. Përfundimet e analizës konfirmojnë për numrin më të madh të teksteve hipotezën tonë

Sjellim këtu si shembuj analizën kuantematike në nivelin e kuantemnacës të dy poezive: *Hymni i Flamurit* dhe *Kryqësimi*

3. 1. Fan S. NOLI, *Hymni i Flamurit*[218] (analizë e kuantemnacës)

3. 1. 1. Kuantemnanca rrokjesore

O Flamur gjak, **o flamur shkabë**,
O vënd **e** vatr' **o** nën' **e** ba**bë**,
Lagur me lot, dje**gur me fla**gë,
Flamur i kuq, **flamur i *zi***.

Fortesë shkëmbi tmerr tira**ni**,
S'të trëmp **Romani**, as **Ve**nec**jani**,

[218] Fan S. Noli, *Vepra 1*, 37-38.

As Sërp Dusha**ni**, **as** Turk Sull**tani**,
Flamur i math **për** Vegjë**li**.

Flamur që **lint** Shën Kos**ta**ndinin,
Pajton Islamn' **e** Krish**tërimin**,
Çpall **mi**dis fe***ve*** **vlla**zë**rimin**,
Flamur bujar **për** Njerë**zi**.

Me Skënderben' **u**-**la**vdë***ro*****ve**
Dhe në furtun' **i** funt**mi u**-sho**ve**,
Me Malon pra**pë** lart vra**pove**,
Yll **i pa**vdekur **për Liri**.

Sa shpesh **pa**staj **për**-**dhe u**-shtri**ve**
Me zjarr **e zi u**-ndeze **u**-nxi**ve**,
Po çdo **mi**zor **me** shpat' **e** gri**ve**,
O fushë-**kuq**, **o shkabë**-**zi**.

Përpje**të** pri-**e** Shqi**përinë**,
Përlintj'a shpirtin **dhe fu**qi**në**,
Diell **për vllanë**, yrnek **për** fqi**në**
Për botën ëndr' **e** qjell **i ri**.

Raporti i bashkësive kuantematike

A. bashkësia e përgjithshme e kuantemave (rrokje): 214
B. bashkësia e kuantemave që përsëriten (kuantemnancat): 132
C. bashkësia e kuantemave që nuk përsëriten: 82
214 : 132: 82

A/B (214/132) = 1. 621; B/C (132/82) = 1. 609

3. 1. 2. Kuantemnanca dyfonemore

O Flamur **gjak**, **o** flamur shkabë,
O vënd **e** vatr' **o** nën' **e** babë,
Lagur me lot, **d**jegur me fla**gë**,
Flamur **i** kuq, flamur **i** zi.

Fort**e**së shkëm**bi** tme**rr** tirani,
S'të trëm**p** Romani, as Vene**c**jani,
As Sërp **D**ushani, as Turk **Sull**tani,
Flamur **i** ma**th** për Ve**gjë**li.

Flamur **që** lint Shën **Ko**standinin,
Paj**t**on Islam**n**' **e K**rishtërimin,
Çpa**ll** midis **fe**ve vlla**z**ërimin,
Flamur **bu**jar për **Nj**erëzi.

Me **S**këndër**b**en' **u**-lavdërove
Dhe në furtun' **i** funtmi u-**sh**ove,
Me Malon prapë lart **v**rapove**,**
Yll i pavdekur për Liri.

Sa shp**esh** pastaj për-dhe **u**-shtrive
Me **z**ja**rr** **e** zi **u**-nde**ze** **u**-**nx**ive,
Po **çdo** mi**z**or me shpat' **e g**rive,
O fushë-kuq, **o** shkabë-zi.

Përpjetë pri-e **Sh**qipërinë,
Përlintj'a shpirtin dhe fuqinë,
Diell për vllanë, **yr**nek për **f**qinë
Për **b**otën ënd**r**' **e** **q**jell **i** ri.

Raporti i bashkësive kuantematike

A. bashkësia e përgjithshme e kuantemave (fonema): 528
B. bashkësia e kuantemave dyfonemore që përsëriten (kuantemnancat): 440
C. bashkësia e kuantemave që nuk përsëriten: 88

528 / 88 = 6 440 / 88 = 5
6 / 5 / 1

3. 2. Fan S. NOLI, Fan S. NOLI, *Kryqësimi*[219] (analizë e kuantemnacës)

3. 2. 1. Kuantemnanca rrokjesore

Po troket çe**kani**
Po kërcet mejda**ni**,
Dor' **e** këmb' i çpon,
Krishtin **kry**qëson.

Me tërbim go**ditin**
Me gjëmim **e** ngji**tin**
Tur**ma** ulë**rin**
Nëna blegë**rin**.

[219] Fan S. Noli, *Vepra 1*, 61.

Çdo pero**në** pla**gë**
Përvëlon **si** fla**gë**
Çur**ka** gjak buron
Fryhet **e** pikon.

Kryqet ngulen, shti**sen**,
Tallen, **qe**sën**disen**;
Sipër Kryqe tre,
Tri **Ma**ri **për**-dhe.

96 / 59 / 37 = (afërsisht) 1. 618

3. 2. 2. Kuantemnanca dyfonemore

Po trok**et** ç**e**k**ani**
Po kërc**et me**j**d**a**ni**,
Dor’ e **këm**b’ i ç**pon**,
Krish**tin kryq**ës**on**.

Me t**ër**b**im** go**ditin**
Me gj**ëmim** e ngj**itin**
T**urma ulërin**
Nëna b**legërin**.

Ç**do** pe**ronë** p**lagë**
Përvël**on si** f**lagë**
Ç**urka** gjak b**uron**
F**ry**h**et** e pik**on**.

Kryqet ng**ulen**, sh**tisen**,
Tall**en**, qes**ëndisen**;
Sipër Kryqe tre,
Tri Mari për-dhe.

220 165 55 220/55=4 165/55=3 4 / 3 / 1

4. Kuptohet se shtrëngesat e shumta që ‘imponon’ teksti origjinal do të duhet t’i bënin, në mos të pamundura, tepër të rralla shfaqjet e kuantifimimit harmonik në përkthimet. Fakti që ky parim zbulohet (i plotë a i përafërt) në një numër jo të vogël shqipërimesh të F. S. Nolit ashtu si dhe të përkthyesve të tjerë të shquar nga gjuhë të huaja në shqip (nga një varg gjuhësh në gjuhë të tjera po ashtu), dëshmon se, sipas

pikëpamjes sonë, kemi të bëjmë me një parim vërtet fundamental të organizimit të tekstit poetik.

Sjellim një varg shembujsh:

Omar Khajam, *Rubairat*

4. 1. Rubaji 26[220]

Si mjer' ay që **Dashuri** s'ka ndje**rë**
Dhe zemra **s'i** ka ndritur në prënve**rë**:
Pa Ver' e **Dashuri** çdo dit' e shkuar
Prej meje s'nëmërohet asnjëhe**rë**.

Kuantemnanca rrokje 11
1/4 e bashkësisë së përgjithshme 44

Si m**jer**' ay që **Dashuri** s'**ka ndjerë**
Dhe z**ëm**ra **s'i ka ndritur në** p**rën**v**erë**:
Pa **Ver**' e **Dashuri** çdo d**it**' e shkuar
Pr**ej** m**eje** s'**nëm**ëro**he**t asnjë**herë**.

Numri i përgjithshëm i kuantemave **103**; kuantemnanca dyfonemore **64**; fonema që nuk formojnë kuantema dyfonemore që përsëriten **39**

103 / 65 / 38 = 1, 618

4. 2. Rubaji 72[221]

Sa kohë po vazhdon kjo Jet' **e** ngra**të**
Për qafe **ka**p-e Qiparisn' **e** gja**të**.
Se nesër **Mëmë-Dhe**u do t'të **kapë**
Dhe po**sa të** pushtoj s'të lëshon pra**pë**.

Kuantemnanca rrokje 11
1/4 e bashkësisë së përgjithshme 44

Sa kohë po vazh**don** kjo Jet' e ng**ratë**
Për qafe **kap**-e Qiparisn' e gj**atë**.

[220] Fan S. Noli, *Vepra 1*, f. 64
[221] Po *aty*, f. 273

Se nes**ër Mëmë-Dhe**u **do t'të kapë**
Dhe po**sa të** pushtoj s'**të** lësh**on** p**rapë**.

Numri i përgjithshëm i kuantemave **101**; kuantemnanca dyfonemore **49**; fonema që nuk formojnë kuantema dyfonemore që përsëriten **52**

4. 2. Rubaji 29[222]

E prisnja! Si rru**feja më** trondi**ti**!
E Dashura **më** shkoj, **më** neveri**ti**:
S'e çmo**ja** kur **e** kisha... Ah, ç'm'a **priti**!
Në **Fe**rrin nga Parajsa **më** vërvi**ti**.
Kuantemnanca rrokje 17
44 / 27 / 17 afërsisht 1. 618

E **pri**snja! Si rru**feja më** trondi**ti**!
E Dash**ura më** shk**oj**, **më** neve**riti**:
S'e çm**oja** k**ur** e kisha... Ah, ç'm'a **priti**!
Në **Fe**rrin nga Pa**ra**jsa **më** vërv**iti**.

Numri i përgjithshëm i kuantemave 99; kuantemnanca dyfonemore 44; fonema që nuk formojnë kuantema dyfonemore që përsëriten 55. Nënfishi i plotë it ë tria bëshkësive: 11

4. 3. Më poshtë japim rezultatin e analizës së më shumë se 30 rubajive. Mund të vërejmë se shfaqet qartazi prirja e përgjithshme e kuantifimimit harmonik në nivelin e kuantemnancës.

R1 44/12, 99/43; R2 44/15, 105/60/15; R7 44/10, 106 64 (k65. 5); R11 44/14, 101/ 41 (20); R18 44/15, 98/28 (p14); R22 44/22, 113 / 49 (7); R26 44/11, 103 / 65 (64 d); R29 44/17, 99/44 (p11); R40 44/8, 98/50; R42 44/16, 105/43 (p21); R46 44/20, 108/54; R50 44/7, 100/33; R59 44/14, 108/48 (p12); R62 44/17, 97/48; R71 44/11, 90/22; R72 44/11, 101/49; R81, 44/12, 99/55; R85 44/22, 112/70 (k69); R88 44/10, 106/64 (k65. 5); R92 44/16, 98/44 (p11); R118 44/20, 95/ 48 (k47. 5); R123 44/22, 90/50; R125 44/25, 100/63 (k62); R131 44/15, 97/42 (p14); R218 44/17 103/51; R223 44/19, 92/32; R236 44/8, 106/40 (k41); R267 44/16, 91/35; R324 44/9, 101/39; R325 44/11, 100/43 (p11); R326 44/11, 106/41[223]

[222] Fan S. Noli, *Vepra 1*, f. 164.
[223] Po *aty*, f. 259-324

4. 4. M. De Cervantes, *Don Kishoti*[224]

Këtu dergjet Don Kisho**ti**:
Ish i fort' e **ish i zoti**,
Bo**tën** pra**pa** desh **t'a** kthen**te**
Dhe **me** ush**tën t'a** mbërthen**te**.

Këtu brënda fle Dylqi**nja**:
Se ç'këndon**te si më**lli**nja**!
Ish e kol**me**, rumbulla**ke**,
Faqe-kuqe, **pupu**la**ke**.

Këtu dergjet Sanço Pan**ça**:
Si ay s'ka **parë** Man**ça**!
E kish barkun sa një kosh,
E kish kokën **fare** bosh.

Këtu dergjet Ro**si**nan**ti**:
Ishte më interesanti
Nga çdo **ka**lë **që ku**llo**ti**
Barin që ka bë**rë Zoti**.

128 / 80 / 48 (afërsisht) 1, 618

4. 5. H. Longfellow, *Skënderbeu*[225] (strofa I)
Lëfton luftën dhe fiton
Mbreti Ladisllav gjëmon,
Djek si Ferr, si vdekje pret
Ditën e Rushajevet,
Dhe nga fush' e kuqe gjak
Ikën, rent përpara tij
E Muratit ushtëri
Që shpëtoj e s'ra në lak.
139 / 86 / 53 afërsisht 1. 616

Si përfundim mund të nënvizojmë se rikonfirmimi i hipotezës sonë të kuantifikimit harmonik të tekstit në nivelin e kuantemnancës përmes analizës së një numri poezish origjinale të Nolit dhe shqipërimesh të tij (rubai etj.):

[224] Po *aty*, f. 95-96
[225] Po *aty*, f. f. 74

1. njëherësh nga këto dy tipa tekstesh dhe

2. nga një korpus relativisht i madhsish, ofron:

së pari, një varg provash më shumë për vlefshmërinë e përgjithshme të saj (hipotezës),

së dyti, ‘objektivizon’ vlerësimet mbi mjeshtërinë krijuese të Nolit,

së treti, na jep në dorë instrumente të reja (tek të cilat ne nuk u ndalëm posaçërisht) për analizën e një vargu aspektesh të kësaj mjeshtërie dhe të krijimtarisë (së tij) poetike në përgjithësi.

Prof. as. dr. MERITA GJOKUTAJ-SHEHU

MUZIKALITETI NË POEZINË E NOLIT

Noli, i lindur në një kënd tek kryqëzohen kultura e Lindjes dhe kultura e Perëndimit, paraprijës i letërsisë së angazhuar sociale të viteve ’30, i dhuruar me një inteligjencë të rrallë dhe, pothuaj, fenomenale, ka futur në letërsinë shqipe një kujdes shumë të madh ndaj krijimtarisë poetike dhe një kulturë shumë të gjerë letrare, vetëm e vetëm që t’i farkojë shqiptarët sipas vizionit të tij moral, politik dhe shoqëror.

Midis të tjerash, si poet, ai e ka ndihmuar shumë zhvillimin dhe përsosjen e mëtejshme të fjalës sonë artistike. Poezitë e tij kanë shërbyer si shembull se me ç’përgjegjësi duhet të krijojë një shkrimtar, se sa e kujdesur dhe e përsosur duhet të jetë shprehja poetike për të qenë shprehje artistike.

Poezitë e Nolit janë të pakta, por, siç shprehet prof. Rexhep Qosja *“ Mungesën e sasisë Noli e ka zbutur me cilësinë... Ai ka punuar tejet pak, por ka punuar tejet bukur. ”*[226]Ajo që të bën përshtypje, në radhë të parë, te poezia e Nolit, është muzikaliteti i saj, harmonia e përsosur me të cilën tingëllon gjuha shqipe në këto vargje.

Kuteli është ndër të parët që ka theksuar muzikalitetin si një prej karakteristikave themelore të vargut të tij duke cituar*“Vargu i Nolit nuk është vizual, po auditiv. I drejtohet, pra, veshit, jo syrit”*[227]Kurse profesor R. Qosja ka theksuar se *“Vargjet e Nolit, me gjithë përgjithësimin simbolik që përmbajnë, do të ishin artistikisht të zbehta, sikur të mos ishin aq muzikore sa janë. Mungesën e shprehjes metaforike ai e ka zëvendësuar me ato dridhje ritmike dhe muzikore çfarë nuk ka përjetuar poezia shqipe para e pas tij. ”*[228]

Kur flasim për këtë problem, është e domosdoshme të theksojmë faktin se muzikën Noli e ka vënë në shërbim të përmbajtjes dhe të kuptimit të poezisë. Vargun ia nënshtron logjikës së tij krijuese. Tendenca e tij nuk ka qenë që të luajë me fjalët, tingujt, me mjetet poetike, përkundrazi, të gjitha këto i ka zgjedhur që të konkretizojë dhe të shtojë sa më tepër ndjenjën, përfytyrimin, idenë, por dhe përjetimin e vet psikologjik.

Ky muzikalitet i ka shërbyer për t’i sugjeruar popullit të vet atmosferën, për t’i shtuar kësaj atmosfere kuptimin ironik e satirik, pra, te ky artist elementi formal i vargjeve ka dalë prej përmbajtjes së krijimeve.

Në vargjet e tij ka një arkitekturë të përkryer, që shpesh të jep përshtypjen se çdo fjalë është kthyer në një notë muzikore. Muzikaliteti i vargjeve të Nolit krijohet nga

[226]R. Qosja. Vendi i Nolit në letërsinë shqiptare dhe nëkulturën shqiptare. Shkrimtarë dhe periudha. Tiranë, 2005. F. 310.
[227]Mitrush Kuteli, Poeti Fan S. Noli, parathënie e Album, Rilindja, Prishtinë, 1968, f. 25.
[228]Rexhep Qosja, Tingujt dhe muzika e vargut. Shkrimtarë dhe periudha. Tiranë, 2005. F. 286.

pasuria e mjeteve që janë përdorur për instrumentimin e tyre. Ky instrumentim është bërë në mënyrë intuitive, kryesisht, nën ndikimin e melodisë popullore, e për këtë arsye komunikon natyrshëm.

Prof. Çabej, argumentimin e rolit dhënës të letërsisë gojore në raport me letërsinë e shkruar, qoftë në kuadrin nacional, qoftë në atë ballkanik, e lidh me një varg faktorësh të jetës së popujve e, në mënyrë të veçantë, me disa cilësi të letërsisë gojore, e cila, duke qenë më e vjetër dhe me një traditë më të madhe ekzistimi dhe transmetimi, ka pasur ndikim më të dukshëm në letërsinë e shkruar.

Ai thotë: "*Është një influencë e madhe e poezisë popullore mbi shkrimtarin. Kjo shpiegohet me lidhjen e ngushtë që ka poezia popullore me jetën shpirtërore të këtyre popujve. Poezia popullore është ndër këta e gjallë e produktive, prandaj komponentja e këngës popullore është kudo e dukshme. Kjo influencë shprehet në lëndë, në formën e përbrendshme, në ritëm, metrikë si dhe në veçantira.*

Nuk ekziston këtu një poezi me të vërtetë krijuese, e cila të mos bazohet shpirtërisht te populli. Jo se s'ka poetë që të kenë ecur në rravat e artit të huaj, dhe, pa pasur asnjë lidhje organike, të kenë mbetur formë e zbrazët. Por përgjithësisht këtu poetët kanë dalë prej tokës së natyrshme të poezisë popullore. "[229]

Është kjo arsyeja pse themi me bindje se, njohja e instrumentimit të vargut dhe njohja e kësaj teknike nga ana e poetëve është një udhëkalim i domosdoshëm, është shkollë e madhe që kërkon punë e dashuri të vazhdueshme.

Duke qenë të vetëdijshëm për rolin që ka poezia në veçanti në këtë periudhë, themi se Nolit iu desh të kapërcente vështirësi e pengesa të ndryshme, jo vetëm të sferës së brendisë, por edhe të formës. Organizimi artistik i fjalës poetike është një punë shumë e rëndësishme, që ka të bëjë jo vetëm me mjeshtërinë por, para së gjithash, me konceptimin ideo-artistik të vetë krijimtarisë poetike. Kjo kuptohet qartë po të kemi parasysh të vërtetën se forma e përmbajtja e një vepre arti nuk mund të konceptohen jashtë lidhjeve dialektike midis tyre.

Muzikor e specifik vargun e tij e bëjnë:

1.

Ritmi. Për nga struktura ritmike, vargu i Nolit është mjaft i bazuar mbi vargun popullor. Ato shquajnë para së gjithash për një ritëm të përkryer, që përputhet në harmoni të plotë me brendinë, me ndjenjat dhe mendimet e shfaqura. Pavarësisht se si është arritur kjo melodi ritmike (me anë të larmisë së theksave ritmikë, me anë të rimave, përsëritjeve etj.), në vargjet e Nolit, shqipja kumbon, shpalos tërë vlerat e saj shprehëse dhe artistike, shpërthen me tërë fuqinë e pasurinë e saj. I njëjti varg, ta zëmë tetërrokëshi, di të marrë kadenca ritmike të ndryshme, herë ngjitëse e herë zbritëse, herë me ashpërsi, herë me butësi, herë me kumbime epike dhe herë me brishtësi lirike. Në tërë këto ndikon, në radhë të parë, brendia, por organizimi metrik i vargut krijon, pikërisht, atë ritëm të përshtatshëm për rastet e ndryshme.

Cilët bij të tradhëtuan
Dhe të doqnë dhe të shuan... [230]

---

[229] Çabej, E. *Për gjenezën e literaturës shqipe*. Studime gjuhësore, V. Prishtinë, 1975. fq. 133.
[230] Jepni për nënën.

Vendi dridhej, ai mbeti
Se s'tronditej nga tërrmeti... [231]

T'u-tha gryka, po s'të pihet,
T'u-mpi këmba, po s'të rrihet...

Çakërdisur, batërdisur,
Përpëlitur dhe zalisur... [232]

Dale, moj, se kam një fjalë,
Se më rrjedhin djersët valë
Dale, moj, se s'jam më djalë... [233].

Ritmi i poezisë së Nolit nuk është përherë një standard, por ka një liri të plotë në organizimin e tij. Që këndej vijmë në një karakteristikë tjetër, në teknikën e theksimit ritmik të vargjeve, pikërisht, te liria e theksimit. Një nga mënyrat me anë të së cilës vargjet e tij largohen nga uniformiteti, monotonia dhe fitojnë një larmi dhe pasuri të rrallë ritmesh, është që vargjet nga njësi të mbyllura, të ngurtësuara sipas një rregulle fikse, kthehen e bëhen njësi të gjalla artistike, të shkathta, të manovrueshme, burime të pashtershme ritmesh me kombinimet e pafund të theksave ritmikë.

Noli edhe kur bazohet plotësisht në strukturat rrokjesore dhe ritmike të vargut popullor, ashtu edhe kur bazohet në përvojat rrokjesore dhe ritmike të letërsive të huaja, përpiqet ta bëjë ritmin bartës përkatës të emocionit, të disponimit dhe të mendimit të tij. Funksioni i ritmit dhe kuptimi i vargut qëndrojnë në raporte dialektike; kuptimi i vargut kushtëzon rrjedhën e ritmit, kurse ritmi me cilësinë e strukturës së tij ndikon në qartësinë dhe në efektin e kuptimit të vargut.

2. Rima. Te Noli, kufiri ritmik është njëkohësisht edhe kufi logjik i vargut. Përveç faktit që krijon muzikën, rima në vargjet e tij, thekson dendur edhe mendimin që shpreh. Vërejmë rimën fundore:

Kryqet ngulen, shtisen
Tallen, qesëndisen;
Sipër Kryqe tre
Tri Mari për-dhe... [234]

Sa kërkon e sa të duhen?
Burrat nga detyra s'druhen! [235]

---

[231] Shpell'e Dragobisë.
[232] Anës lumenjve.
[233] Plak, topall, dhe ashik.
[234] Kryqëzimi
[235] Jepni për nënën.

por dhe rimën e mesit të vargut në dallim nga gjithë autorët e tjerë të letërsisë shqipe.

Bëj gajret, mor Kirenar
Drejt përpjetë në Kalvar... . [236]
Fryn' e çfryn veriu,
Ngrin, mërdhin i ziu... [237]

3. Ngjyra e tingujve (ndien nuancat e tingujve). Një nga elementet e qenësishme të organizimit të vargjeve të Nolit është përdorimi me mjeshtëri i një sistemi të tërë përsëritjesh. Përsërit të njëjtën zanore ose bashkëtingëllore, me asonancë dhe aliteracion, krijon një ngjyrë të veçantë muzikore në varësi të ndjenjës.
Gryka si gjyrik të shfryn; Ti na çthure, na çkule, na zhduke çdo fe; Kryetrim, që lëfton, triumfon për atdhe, / Shpëtimtar, kryemjek, kryeshenjt, kryefe... ;

Në procesin e krijimit, Noli, synoi me ndërgjegje edhe mjete të shprehjes poetike, që i shkojnë më për shtat përhapjes së letërsisë në rrugë gojore. Midis këtyre mjeteve lakmoi veçanërisht figurat e diksionit, perceptimi i të cilave nënkupton gojën dhe veshin, folësin dhe dëgjuesin. Ndër figurat e diksionit ka zgjedhur ato më të përdorurat në folklor, me të cilat veshi i masave popullore qe mësuar prej fëminisë, madje, synoi të tilla si aliteracioni, anafora etj. , të cilat e bënin vargun e shkruar më melodioz e, rrjedhimisht, më të përshtatshëm për t'u mbajtur mend e për t'u transmetuar gojarisht, pasi, siç shprehet Noli, në veprën "*Autobiografi"***,** asokohe *"shqiptarët nuk dinin të lexonin shqip"*. [238]

Përsëriten tinguj, përsëriten fjalë, përsëriten vargje të tëra. E gjithë kjo nuk kryhet vetëm për punën e harmonisë, melodisë, ritmit, por, para së gjithash, për të vënë në dukje një mendim, një ndjenjë, një aspekt a një figurë të rëndësishme. Gjithçka, edhe këtu, është në shërbim të idesë. Por sidoqoftë, përsëritja me të gjithë larminë e saj, është një tipar karakteristik qenësor në instrumentalizimin e vargut të Nolit.

Përsëritja paraqitet në forma të ndryshme, disa prej të cilave duket lehtë që e kanë burimin nga muzika, por, tashmë, ato kanë fituar një mëvetësi e pavarësi të plotë, sa që janë bërë karakteristika, bashkë me mjetet e tjera të instrumentimit të poezisë së Nolit. Më e përdorur është, përsëritja e thjeshtë brenda të njëjtit varg, që, sipas rastit, mund të marrë nuancë të gëzuar apo të trishtuar.
Ky ilaç e ky kushtrim/Më bën djal' e më bën trim... ;Pres një shenj' e pres një dritë... ;Qaj, moj erë, moj er' e shkretë qaj…;Pranë vatrës, pranë punës... . ;Rent, or rent, rent e u thuaj...

Mbizotëron gjithashtu anafora: *Po troket, po kërcet; Me tërbim, me gjëmim; Se të deshte, se të qante, se të veshte; Na i vranë, na i thanë; Kur tufani, kur tirani; Atje nisi, atje mbaroi; Se u ç'thurr ordi e huaj, se betejën e fituam; Anës detit, anës dritës; Pranë sofrës, pranë dijes; Se ç'e shtypnë, se ç'e shtrydhnë etj, etj.*

[236] Kirenari
[237] Shën Pjetri në mangall.
[238] R. Qosja, Shkrimtarë dhe periudha, fq. 234, Tiranë, 2005.

Asonanca dhe konsonanca së bashku, sipas rastit, herë me asindetin e herë me polisindetin, dendëson shprehjen dhe rrit muzikalitetin:

Se ç'përmbysesh, kamçikohesh,
Rrihesh, ngrihesh, çdehesh, zgjohesh;

Varfëri, poshtërsi, robëri ti na dhe
Derbeder, ujk e derr: Hosana, Baraba...

Jezu Krishti s'dëgjohej, dhe s'e mori vesh mikun,
Dhe s'u- unj përsëri që ta merrte kamçikun... .

3. Për t'i dhënë muzikalitetin vargut dhe për të përforcuar ndjenjën e mendimin Noli shpeshherë përdor tingullin e thirrores ***-o-*** qoftë në fillim, në mes a në fund të vargut. Kjo është karakteristikë që paraqitet në këngët popullore, nga e cila mendojmë se është marrë edhe prej Nolit:

O flamur gjak, o flamur shkabë, /O vend e vatr'o nën' e babë... . ;O fushë-kuq, o shkabë-zi... . ;Thirr e zbraz, o gurmas: Hosana, hosana... ;O i bir i Davidit, i Miri Bari... ;O i fort'o i urt' o i ëmbël Jesu.. ;O qyqar, o Kirenar...

4. Strukturës muzikore të vargut Noli i ka nënshtruar, veç të gjitha elementeve të tjera poetike, edhe leksikun. Duke kërkuar fjalët më ekspresive në poezi dhe duke njohur gjuhët e huaja, nuk ka mundur t'i rezistojë dëshirës së vet të madhe që ta bëjë sa më muzikor dhe sa më ekspresiv vargun me përdorimin e barbarizmave, si psh: *mexhlis, kësmet, ferman, xhumhuriet, milet, ylefe, kallaballëk, uzur, vergji, sajdis, syrgjyn, turfanda, derbeder, buxhaku, allçaku, lanet, din, dovlet, etj.*

Në mbyllje theksojmë se Noli ka dashur ta tërheqë lexuesin e dëgjuesin e vet, veç të tjerave edhe me larminë e strukturave metrike dhe ritmike të vargut të tij, duke e ndihmuar shumë zhvillimin dhe përsosjen e mëtejshme të fjalës sonë artistike. Ai e pasuroi sistemin e vargëzimit shqip me ritme e kombinime të reja, duke vënë përherë e më tepër, më mirë e më bukur në bazë të saj vargëzimin popullor, ritmin dhe muzikalitetin e poezisë popullore.

Poezia e tij është poezi gjithnjë moderne për faktin se është e çelur për kah kuptimit dhe e përsosur për kah strukturës formale.

NELI NAÇO

DISA ARRITJE POETIKE NË POEZINË "MARSHI I BARABBAJT"

Poezia e Nolit "*Marshi i Barabajt"* është një nga poezitë më të rëndësishme të tekstit nolian. Për nga mënyra e realizimit poetik, poezia është e përafërt me dy poezi të tjera të ngjashme me të edhe vetë në konceptin e Nolit, përderisa emërtimi i tyre është bërë mbi të njëjtin koncept dhe këto janë "*Marshi i Krishtit*" dhe "*Marshi i Kryqëzimit*". Ato janë poezi "me një strukturim të ngjashëm ritmik dhe figurativ". [239]

Në dy nga tekstet kritike më të rëndësishme të poezisë "Marshi i Barabbajt" është quajtur poezi satirike. Kështu Mitrush Kuteli shprehet: "Midis dy elegjive motra që kujtuam më sipër edhe dy vjershave të një torture psikike *Shën Pjetri mbi mangall* edhe *Moisiu në mal*", me të cilat do të merremi më poshtë, qëndron vjersha satirike *Marshi i Barabbajt*. "[240]

Por gjithashtu edhe Sabri Hamiti në veprën "Letërsia Moderne" bën një vlerësim të ngjashëm: "Vjersha satirike janë: *Marshi i Barabajt*, *Kënga e Salep Sulltanit*, *Vdekja e sulltanit*... "[241]

Në të dyja rastet poezia është pranëvendosur me poezi të cilat qëndrojnë larg saj dhe janë më afër me gjykimin teorik për poezinë satirike. Nëse poezitë "*Kënga e Salep Sulltanit"* dhe "*Vdekja e sulltanit"* janë më afër me atë që përkufizohet si satirike poezia Marshi i Barabbajt e kalon këtë kufi. Në përkufizimin që jep M. H. Abrams për satirën në "Fjalorin e termave letrarë" thuhet: "Satira mund të përshkruhet si arti letrar i zvogëlimit apo uljes të një subjekti duke e bërë atë qesharak dhe duke evokuar përkundrejt tij qëndrimet e zbavitjes, përbuzjes, neveritjes, ose indinjatës. Ajo dallohet nga komikja që evokon të qeshurën kryesisht si një përfundim në vetvete, ndërsa satira përtall; që do të thotë përdor të qeshurën si një armë, dhe kundër një shenje që ekziston jashtë veprës letrare. "[242]

Poezia "*Marshi i Barabbajt"* për nga emocionaliteti që bart, zemërimi i skajshëm, vendosja e qartë e zërave artikulues në pozicion kundërshtar, duket se e ka kaluar kufirin e një poezie thjesht satirike, ajo përdor shumë nga elementet e satirës përbuzjen, neveritjen, indinjatën, por është zhvendosur pak më tej dhe ka shkelur me sa duket në domenin e tragjikes. *Marshi i Barabbajt* e ka tipar "dominant" tragjiken krahasuar me satiriken po të përdornim një term të përdorur nga Jakobsoni. Poezia është botuar në gazetën "Liria Kombëtare" më 28 nëntor 1928 dhe mban shënimin e autorit: "*Marshi i Barabbajt* është hequr nga Tragjedia e Kryqit, një vepër poetike që

[239] Sabri Hamiti, "Letërsia Moderne" në Vepra Letrare 8, Prishtinë 2002, faqe 361.
[240] Fan S. Noli, "Mall e Brengë", Tiranë 1943, faqe 13.
[241] Sabri Hamiti, "Letërsia Moderne" në Vepra Letrare 8, Prishtinë 2002, faqe 361.
[242] M. H. Abrams, "A glossary of literary terms" ninth edition, Ëadsëorth Cengage Learning 2009, faqe 320.

trajton pësimet e Krishtit. ”[243] Poeti pohon se poezia është nxjerrë nga një cikël i cili emërtohet prej vetë atij Tragjedia e Kryqit. Po ky emërtim ruhet në dorëshkrimet që poeti ka lënë dhe njëkohësisht ku ka bërë përpjekjet për sistemimin e veprës së vet në cikle. [244]

Emërtimi “Tragjedia e kryqit” dëshmon se poezitë e Nolit në vetëdijen e tij poetike bartin më së shumti elementin e tragjedisë dhe tragjikes, por një tragjedi që nuk është pasqyruar vetëm si e tillë. Noli padyshim i ka mbushur me satirë, humor dhe ironi një pjesë të mirë të poezive të tij, por këto veçori stilistike që janë të pranishme në poezinë e Nolit kanë përgjithësimin e tij “Tragjedia e kryqit” për faktin se Noli nuk harron elementin më mbresëlënës dhe më të fuqishëm që gjeneron krijimin e poezisë tek ky poet: Idenë që ndërton dhe strukturon mendimin poetik të tij, ndërsa qëndrimet stilistikore në ndërtimin e poezisë së vet janë nga më të larmishmet.

Dinamika e tragjikes në poezinë *Marshi i Barabbajt* rritet nga një veçori tjetër unike që ka poezia krahasuar madje edhe me dy simotrat e saj *Marshi i Krishtit* dhe *Marshi i Kryqëzimit* që nuk e kanë këtë veçori. Marshi në tërësinë e vet është një poezi e artikuluar njëzëshëm nga një shumësi zërash të shkrirë, është pra monofonike.

Unikë shprehen zërat në poezinë *Marshi i Krishtit* që adhurojnë Krishtin. Marshi është unik dhe mbart të pangatërruar idetë e lavdërimit, adhurimit, lartësimit, bekimit të kryefigurës biblike.

O i bir’ i Davidit, i miri bari,
Ti na prin dhe na rrit në luadh e vërri
Ti na ruan, dhe na mpron, dhe për ne bëhesh fli,
O Njeri – Perëndi: Hosanna, hosanna!

Njëzëri artikulohet edhe teksti poetik i *Marshit të Kryqësimit*. Zërat e shkrirë përsëri në një kërkojnë kryqëzimin. Për *Marshin e Kryqësimit* Sabri Hamiti shprehet “Në vështrimin e ndërtimit të figurës e të idesë të përmbysur me anë të ironisë, vjersha më e përsosur e këtij cikli është *Marshi i Kryqësimit*. E tëra e ndërtuar në një diskurs të sforcuar mohues të vlerave të Krishtit, vjersha ngre kultin e këtyre vlerave duke ngritur kundërshtimin human. ”[245]

Vrajeni se përunj dhe përmbys pasurinë,
Pasuron, dhe çliron, dhe forcon varfërinë,
Se lëngatën shëron, se ndriçon verbërinë:
Kryqësoje, Pilat, në Kalvar, Golgotha!

Poezia *Marshi i Barabbajt* krahasuar me dy të parat është një poezi e ndërtuar mbi dy njësi zërash të shkrirë. Ndonëse artikuluesi mund të jetë i njëjtë ose i ndryshëm kundërvënia e zërave që shprehen në poezi ekziston dhe poezia marsh kthehet nga një

[243] Fan S. Noli, “Vepra 1”, Tiranë 1987, faqe 333.
[244] Po aty, faqe 337.
[245] Sabri Hamiti, “Letërsia Moderne” në Vepra Letrare 8, Prishtinë 2002, faqe 364.

shumicë zërash monofonikë, në një bifoni ku rezultat është përplasja dhe përplasja mbart një tragjikë të fuqishme. Në vëllimin "Mall e Brengë" Kuteli do ta vlerësojë dy herë me epitetin apokaliptike fuqinë e përplasjes. Ai shprehet së pari: "Hyn në këtë vjershë një atmosferë apokaliptike dhe një invenktivitet epitetesh zhurmonjëse të një ashpërsie të pashoq në letrat e shqipes"[246] dhe më poshtë "një rrëke e rreptë që zbret tatëpjetë me zhurmë shurdhonjëse, një artileri e rëndë fjalësh dhe shprehjesh, një fërtymë mallkimesh apokaliptike – ky është Marshi i Barabbajt"[247]

Në poezinë *Marshi i Barabbajt* nuk kemi një pikëpamje apo një sistem të përfunduar vlerësimi të figurës, por kemi dy të tillë. I pari që zhvlerëson dhe ul figurën e tradhtarit, e jep në dimensionin e vet kriminal, e mallkon me fuqi maksimale, padit ndjekësit e tij si po aq të kriminalizuar dhe i dyti që e vlerëson dhe lavdëron pikërisht këtë figurë.

Sipas sistemit të parë gjykues të vlerave të Barabbajt ai është tradhtori dhe krimineli i arsyetuar si i tillë, sipas sistemit të dytë të gjykimit ai lavdërohet verbërisht, pa përmendur vlera as virtyte. Fjalët përmbyllëse të zërave të dytë në fundin e secilës katrenë janë sinonimi i fatkeqësisë që pllakos, çdo arsyetimi, indinjimi dhe mallkimi të zërave të parë, i përngjitet e njëjta shprehje si përgjigje dhe njëkohësisht si fatkeqësi Hosana Barabba! Po ta themi ndryshe në poezitë e tjera ka një ndërgjegje artikuluese në poezi, tek *Marshi i Barabbajt* ka dy ndërgjegje të tilla të krijuara fondamentalisht ndryshe dhe që artikulojnë fondametalisht ndryshe. Të parët janë të mbështetur tek ideja e arsyes dhe e ndjenjës që rrjedh prej arsyetimit. Të dytët tek ideja e forcës, e mosarsyetimit dhe e dhunës që vulos çdo veprim.

Nuk ka rëndësi për ne, apo nuk ndikon fort në zhvillimin e poezisë bifonike zëri që artikulon konkretisht poezinë. Në katrenën e parë duket se është i njëjti zë krijues për gjithë poezinë, dhe ka të ngjarë që të jetë kështu edhe për strofat në vijim, por sidoqoftë jehona e ndërgjegjes së dytë artikuluese, asaj që lavdëron Barabba-n është ekzistente, e fuqishme brenda ndërgjegjes së parë artikuluese, dhe nëse ndërgjegjja e parë shpreh rrugën e mundimit me zë më të ulët, e dyta shpreh mosarsyen me një zë shumë më të fuqishëm se e para.

Allalla, o rezil e katik, allalla,
Shtroni udhën me hithr' e me shtog turfanda,
Gumëzhit, o zinxhir e kaçik, batërma,
Lehni, laro, kaba: Hosanna, Barabba!

Edhe vetë në vargun e fundit të kësaj katrene fjalët paraprirëse (Lehni, laro, kaba:) parathonë një intensitet më të madh force për refrenin Hosanna, Barabba!

Unifikimi i zërave në poezitë e sipërpërmendra "*Marshi i Krishtit*" dhe "*Marshi i Kryqëzimit*", unifikon ideologjinë, unifikon edhe qëndrimin e stilin e autorit. Përplasja

[246] Fan S. Noli, "Mall e Brengë", Tiranë 1943, faqe 13.
[247] Fan S. Noli, "Mall e Brengë", Tiranë 1943, faqe 13.

e zërave në poezinë *Marshi i Barabbajt* shpie në përplasje ideologjish, rrjedhimisht në përzierje e kompleksitet më të madh të gjuhës poetike.

Përplasja e zërave kundërshtues, e dy koreve me zëra të shkrirë në një që i kundërvihen njëri – tjetrit mund ta çojë receptorin e poezisë deri tek ideja e lashtë e korit të tragjedisë antike.

"Vuajtja është një moment shumë i gjatë" thoshte Oscar Wilde. Përsëritja e katrenës së parë edhe si mbyllëse e poezisë të çon tek ideja e zgjatjes së vuajtjes dhe e mos zgjidhjes së situatës së krijuar çka e ripërsërit emocionin dhe rrit tragjicitetin e poezisë.

Përdorimi i mjeteve gjuhësore stilistike, aliteracioneve, epitetet zhurmonjëse, përdorimi i fjalëve arabisht, turqisht dhe persisht të përdorura nga Noli në këtë poezi janë çështje të njohura dhe të trajtuara edhe herë të tjera.

Si përfundim them se nga pikëpamja e përplasjes së zërave poezia "Marshi i Barabbajt" është një poezi unike në letrat shqipe, ajo është unike edhe brenda grupimit të poezive me ndërtim të ngjashëm që ka krijuar Noli. Kompleksiteti i ndërtimit dhe përdorimi i zërave të shkrirë në një bifoni them se e tejkalon kufirin e të qenit vetëm një poezi që duhet të klasifikohet vetëm si satirike, por ka shkuar deri në zonën e tragjikes.

NIAZI XHAFERAJ

VËSHTRIM RRETH FIGURAVE STILISTIKE DHE ELEMENTEVE TË VJERSHËRIMIT NË POEZINË E NOLIT

Gjenialiteti i Nolit ka shkëlqyer edhe në poezi. Poezia e tij është përmbledhur në vëllimin e njohur "*Album*", që u botua në vitin 1948. Titulli i këtij libri është një metaforë që tregon përmbajtjen e këtyre poezive, si album kronikash poetike me përjetime nga ngjarjet e ndryshme historike. Në poezitë e këtij vëllimi Noli shpreh larminë e emocioneve dhe përfytyrimeve nëpërmjet figurave stilistike, që e bëjnë më bindës ligjërimin e tij poetik. Mjetet shprehëse më të parapëlqyera janë aliteracioni, epiteti, metafora, antiteza, alegoria, simboli, shkallëzimi, përsëritjet sintaksore etj. Këto mjete shprehëse janë shpalosur me forcë të madhe emocionale në dy poezitë e tij më të bukura "*Anës lumenjve*" dhe "*Rent, or Maratonomak!* ". Te "*Anës lumenjve*" jepet imazhi i një gjendjeje shpirtërore të dërrmuar për fatet e atdheut dhe besimi për të parë një dritë shprese. Tridhjetë e katër vargje flasin për gjendjen e mjeruar të Shqipërisë e të poetit dhe njëzet e gjashtë vargje të tjera flasin për shpresën e poetit për ndryshimin e kësaj gjendjeje. Dramat e popullit ishin edhe dramat e Nolit të mërguar. Megjithëse në dhé të huaj, ai kish me vete botën shqiptare, njerëzit e saj, vegjëlinë në radhë të parë. Figura kryesore që e përshkon nga fillimi deri në fund këtë poezi është shkallëzimi. Renditja e fjalëve a sinonimeve stilistike që e shprehin mendimin ose shqetësimin shkallë-shkallë, herë në ngjitje e herë në zbritje, ndihet pothuajse në çdo strofë, ku shprehet dhimbja për gjendjen e vajtueshme dhe urrejtja për shkaktarët.

Fjalët "*arratisur", "syrgjynosur", "raskapitur", "katosur", "pa fund"* e "*pa shpresë*" si enumeracione që shkallëzohen në rënie, japin mesazhin e një frymëmarrjeje të mekur dhe të një pulsi të pafuqishëm. Edhe përsëritjet e fjalëve "*pa*" dhe "*anës"* në vargun e tretë e të katërt shërbejnë për të dhënë gradualisht rëndimin e gjendjes shpirtërore të poetit. Fjalët e togfjalëshat "*e shembën", "e shtypën", "e shtrydhën", "e prenë", "e vranë", "e shkretuan anembanë"* përshkruajnë me një shkallëzim zbritës gjendjen e Shqipërisë. Paralel me këtë gjendje përshkruhet edhe gjendja psikologjike e poetit, e cila jepet shkallë-shkallë nëpërmjet sinonimeve stilistike: *çirrem, digjem i vrerosur, sakatosur, çarmatosur, as i gjallë, as i varrosur*. Edhe sinonimet e shprehura me pjesoret me funksion mbiemri *çakërdisur, batërdisur, përpëlitur* e *zalisur* luajnë rolin e përforcimit emocional të ligjërimit poetik. Në strofën e dytë dallojmë qartë antitezat e fuqishme emocionale të Nolit, të cilat së bashku me anaforat "*anës*", "*pranë*", me përsëritjen artistike "*ku*" dhe me bashkimet e fjalëve shqipe me ato turke në aliteracionet "*vaj-vatani e mjer-mileti*" përligjin motivimin artistik të Nolit duke vënë në veprim disa përftesa njëherësh.

Shkalla e lartë e përngjashmimit tingullor që krijon paronomazinë te vargjet:

"*Seç u tera, seç u mplaka,*

Seç u çora, seç mpaka"

ndihmon në orkestrimin poetik të Nolit, i cili e përfytyron imazhin artistik edhe si kompozitor. Shkallëzimi zbritës kthehet dalëngadalë në shkallëzim rritës. Gjendja e tij shpirtërore kalon nga vajtimi pa fund e pa shpresë te ëndërrimi pa fund e pa shpresë dhe në fund te brohoritja me besë e shpresë. Aliteracioni te fjalët "*Brohorit me besë e shpresë"* e bën poezinë më burrërore. Zëri që vjen nga lumi shkallë-shkallë po bëhet më i fuqishëm, ai do të zgjojë jo vetëm poetin, heroin lirik të kësaj poezie, por edhe "*miletin*", mbarë popullin që po përgatitet për të korrur e shtypur shkaktarët e kësaj gjendjeje. Sinonimet stilistike të ndërtuara me foljet në mënyrën urdhërore *ngrehuni, bjer**u**ni, korr**i**ni, shtyp**i**ni* shprehin me gradacion natyrën kushtruese të poezisë. Sinonimet e tjera stilistike "*ilaç-kushtrim*", "*djalë-trim", "forcë-shpresë"* janë në kontrast me sinonimet e strofës së parë. *Paralelizmi figurativ* që përdor Noli midis lumenjve që fryhen e skuqen dhe përgatitjes së miletit për t'u hakmarrë shërben për të na e paraqitur sa më qartë forcën e kësaj revolte popullore. Poezia ndërtohet me vargje tetërrokëshe, me strofa katërvargëshe e tetëvargëshe dhe me theksa ritmikë në rrokjen e tretë dhe të shtatë. Gjithë figuracioni i përdorur në këtë poezi si dhe elementet e vjershërimit janë në funksion të idesë së Nolit për të bindur lexuesit me forcën dhe bukurinë e vargut.

Poezitë e Nolit kanë në brendinë e tyre një ngjarje. E tillë është edhe poezia më e parapëlqyer e tij "Rent, or Maratonomak! ". Në këtë poezi realizmi shkrihet me një romantizëm shumë optimist. Edhe *asindeti*, si figurë e sintaksës poetike, përdoret si një zgjedhje stilistike që krijon përshtypje. Ashtu si Maratonomaku që vrapon për të shpurë sa më shpejt lajmin e gëzuar të fitores, ashtu siç dalin njëra pas tjetrës nëna, motra dhe nusja, po ashtu edhe vargu pa lidhëza ecën me ritëm të shpejtë e të vrullshëm.

Një figurë tjetër e sintaksës poetike që përdoret si burim shprehësie është *përsëritja*. Folja "*rent*" përdoret shtatë herë në këtë poezi për të theksuar ngulmimin dhe dëshirën për të çuar sa më shpejt lajmin e fitores. Në përputhje me tonin stilistik të poezisë, përdoren edhe sinonime stilistike të fjalës "r*ent*", si: "*shpejt*", "*turru tej*", "*tutje*", "*mbahu*", "*haj dhe pak*", të cilat dallohen për shkallën e intensitetit dhe paraqitjen e idesë me gradacion. Te poezia "*Rent, or Maratonomak! "*, përsëri është fjala "*maratonomak*" e titullit, që përbën dominanten fonetike dhe që ka përftuar deri edhe jehona fonetike si: *me tokmak, -or Maratonomak; lark or lark-or Maratonomak, haj dhe pak or Maratonomak.* [248] Edhe Rexhep Qosja e ka vlerësuar muzikalitetin e vargjeve të Nolit. Ai ka theksuar: "Intonimi muzikor i vargjeve të tij flet qartë sesa shumë ishte nën ndikimin e simbolistëve. "[249] Në këtë poezi përdoret tetërrokëshi trokaik me theksa kryesisht në rrokjet 1, 3, 5, 7, që i japin tekstit kumbimin e duhur, tonalitete të larta. Një vend të veçantë në krijimtarinë poetike të Nolit zënë edhe elegjitë "*Syrgjyn –vdekur*" dhe "*Shpell'e Dragobisë*". Apostrofat, metonimitë, simbolet, aliteracionet e asonancat, rimat e përputhura dhe epitetet janë tregues i mjeshtërisë artistike të Nolit në artin e portretizimit. Elegjia për Luigj Gurakuqin është

[248] Xhevat Lloshi, *Mjeshtëria e simbolizmit tingullor*, në: "Historia e letërsisë shqipe. Materialet e Konferencës Shkencore", Prishtinë, 2010, f. 169-198..

[249] Rexhep Qosja, *Panteoni i rralluar*, Tiranë, 1998, f. 211.

lirike dhe e ëmbël, kurse elegjia për Bajram Currin është epike, himnizuese e luftarake. Me epitetet "*gojëmjaltë*", "*zemërhekur*", "*shpirt të bardhë*" e "*vigan liberator*" portretizohet Luigj Gurakuqi dhe me epitete të një natyre tjetër si: *div, dragua, legjendar Ante, dithiramb, trim tribun* dhe *yll i rrallë i burrërisë* portretizohet Bajram Curri. *Vëlla* e quan të parin, *baba* të dytin. Trajta e shkurtër e përemrit vetor "*na"* e përsëritur, e përdorur si dhanore etike sjell një ngarkesë të ndjeshme duke e lidhur ngushtë Luigj Gurakuqin me popullin, pjesë e të cilit është dhe poeti:

Na e vranë e na e shanë,
Na i thanë tradhëtor.

Renditja e fjalëve për vrasjen e Luigj Gurakuqit bëhet me ngarkesë emocionale nëpërmjet shkallëzimit rritës: *na e vranë, na e shanë, na i thanë tradhëtor*. Edhe trajta e shkurtër "*më*" që shërben si dhanore etike në vargun "*Nëno moj, ma qaj në Vlorë*" është një përdorim i zgjedhur i formës gjuhësore për të tërhequr vëmendjen e për të nxjerrë në pah meritat. Përsëritja katër herë e fjalëve "*Nëno moj*" është një shpërthim poetik i dhimbjes së Nolit për fatin e heroit, që gjithë jetën ishte i lidhur me fatin e Shqipërisë. Antitezat e fuqishme të ndërtuara me antonime stilistike "*të qante-të qeshnin", "të veshte-të çveshnin",* si dhe përdorimi i polisindetit duke përsëritur lidhëzat nënrenditëse "*se*" e "*kur*" japin jo vetëm befasinë e kundërvënies, por edhe ngulmojnë te vlerat e heroit duke ngadalësuar me qëllim ligjëratën.

Te "Shpell' e Dragobisë" Noli përdor përsëritjen si përftesë shprehëse. Aliteracionet e fuqishme te vargjet: "*Dif dragoi i Dragobisë, /Trim tibun i vegjëlisë*" janë organizime stilistike që shfrytëzojnë afërinë e tingujve te fjalët e zgjedhura për të portretizuar heroin, siç bën edhe në strofën pasardhëse te emrat "*Bajram*" dhe "*bajrak*". Noli është i gjithëpushtetshëm me fjalën. Asnjë fjalë, shpesh edhe asnjë shkronjë nuk përdor ose nuk përsërit pa synime të qarta stilistike. Përsëritja katër herë e ndajfoljes së kohës "*kur*" krijon imazhin e nisjes së veprimeve, përsëritja katër herë e ndajfoljes së vendit "*atje*" lokalizon vendin e ngjarjes, ndërsa polisindeti i ndërtuar me përsëritjen katër herë të lidhëzës bashkërenditëse shtuese "*as*" bën që fjalitë të marrin një ecje më të ngadaltë, të qëndrohet për një kohë më të gjatë mbi fjalët, të nënvizohen e të theksohen më me forcë ato duke na përcjellë shkallë-shkallë lartësimin dhe pavdekësinë e heroit. Antitezat e fuqishme të ndërtuara me përafrimin e antonimeve "*nisi-mbaroi*", "*krisi-pushoi*", "*dridhej-mbeti"* dhe apostrofat "*O Bajram*" dhe "*or Baba*" janë figura stilistike të zgjedhura në funksion të figurës artistike. Ato dhe figura të tjera stilistike të përdorura i ngrenë heroit një monument artistik.

Edhe elementet e vjershërimit në vargjet tetërrokëshe të përdorura, theksat ritmikë në rrokjet 3. 5 dhe 3. 7, 5. 7 ose 1. 3. 5. 7 janë në shërbim të natyrës së kësaj poezie, si poezi tronditëse e dhimbjes dhe marsh luftarak njëkohësisht.

Me apostrofa të fuqishme e fillon Noli poezinë simbolike "Himni i Flamurit":

O Flamur gjak, o Flamur shkabë,
O vend e vatër, o nënë e babë.

Me metafora të zgjedhura si: "*Fortesë shkëmbi, tmerr tirani*", me elipsa që vijnë njëra pas tjetrës "*S'të tremb romani, as veneciani, /As serb Dushani, as turk Sultani*" dhe me përsëritjen e lidhëzës "*as*" tri herë jepet imazhi poetik i qëndresës historike të kombit shqiptar nëpërmjet simbolit të Flamurit. Të gjitha figurat stilistike të

ndërthurura së bashku në gjashtë strofat e poezisë i japin ligjërimit poetik një forcë të jashtëzakonshme shprehëse.

Noli krijoi edhe poezi të mbështetura në simbolikat biblike, duke i pasuruar me përmbajtje kuptimore konkrete nga përvoja e tij. Ai i zgjodhi me vetëdije figurat biblike të Mojsiut, të Krishtit, të Shën Pjetrit, të Kirenarit, të Barabbait dhe nëpërmjet tyre operoi me idenë. Me disa nga këto figura krijoi poezi të plota me një ndërtim të ngjashëm, por me vlerësim të kundërt. Të tilla janë poezitë "*Marshi i Krishtit*" dhe "*Marshi i Barabbajt*". Me sinonimet *Mesi-njeri-perëndi*, me epitete *kryetrim, kryeshenjt, kryefe, kryemjek, shpëtimtar*, me asindetet duke mënjanuar lidhëzat, polisindetet dhe përsëritjet artistike dhe me rima të brendshme jepet varg pas vargu nëpërmjet mishërimit gjuhësor-stilistik gjithë imazhi i marshit të Krishtit, përjetimi i dhimbjes dhe i krenarisë së poetit për këtë figurë simbolike.

Poezia simotër me "*Marshin e Krishtit*" është "*Marshi i Barabbajt*" që është shkruar më 28 nëntor 1928, dy vjet më përpara se poezia "*Marshi i Krishtit*", e cila është botuar në vitin 1930. Të dyja së bashku përbëjnë një çift të skajshëm, në kontrast me njëri-tjetrin. "*Marshi i Barabbajt*" jep një atmosferë të zymtë mallkuese, ndërsa "*Marshi i Krishtit*" jep një atmosferë ngazëllyese të bekimit. Barabbai i Nolit është një Barabba i përfytyruar, sepse imazhi i krijuar përmes vargjeve është një trillim artistik i poetit. Rresht pas rreshti përftohet një imazh poetik. Noli merr shtysën nga një ndodhi biblike, por më tej shkëputet prej saj dhe nuk ka më lidhje me motivin biblik e sidomos me domethënien e tij biblike. Barabbai si simbol i së keqes është një ndërtim letrar, një krijim poetik me mjeshtërinë e Nolit. Në këtë poezi Noli është treguar mjeshtër i shfrytëzimit të efekteve tingullore shoqëruese të kuptimit. Që në strofën e parë dëgjohet zhurma e rëndë e zinxhirëve, fishkëllima e kamxhikut dhe lehja e larove që mbajnë iso me zë të trashë, me zë budallai. Të tillë ishin mbështetësit e Barabbait. Ky është imazhi i terrorit. Gradacionet e fuqishme të ndërtura me sinonimet stilistike *na çthure, na çkule, na çduke*, aliteracioni mjeshtëror nëpërmjet përsëritjes pesë herë të tingullit *ç*, asindeti i fuqishëm duke renditur fjalët jo me lidhëza por me presje, rimat e brendshme te emrat asnjanës "*varfëri-poshtërsi-robëri*" dhe bashkësia e semantikës së të gjitha fjalëve të strofës së dytë janë mekanizma të shqipes që vihen në lëvizje për të përballtur fajtorin. Edhe strofa e tretë vazhdon idenë e strofës së dytë. Me apostrofa të zgjedhura, me enumeracionet sinonimike *na shtyp, na shtrydh e gjakun na pi, na ther, na grin e na bën fli*, me përsëritjet artistike të fjalëve që tërheqin vëmendjen dhe me polisindetin nëpërmjet përdorimit katër herë të lidhëzës bashkërenditëse "*e*" shprehen artistikisht të këqijat e mëdha që i ka sjellë Barabai një populli. Strofat e tjera shprehin ndëshkimin e pamëshirshëm që meriton për të këqijat që ka bërë:

Në bodrum, nëpër llom' e kufom' u mallkofsh,
Në skëterrën, katran e tiran u harbofsh,
Me tam-tam e allarm' e me nëm' u shurdhofsh,
Në zëndan mbretërofsh: Hosanna Barabba!

Në këto vargje ndryshohet rendi i fjalëve duke përdorur anasjellën si përftesë shprehëse. Përdorimi i rrethanorëve e i kundrinorëve para kallëzuesit dhe ironia "*në zëndan mbretërofsh"* janë bërë jo thjesht për të përdorur një model sintaksor, por për të përdorur theksin logjik e psikologjik, për të nxjerrë në pah vendin dhe mjetet e

ndëshkimit si dhe për efekt të përdorimit të rimës. Huazimet turko-orientale si: *dallkauk, kopuk, rezil, katil, zëndan* si dhe përngjitjet sipas modelit të anglishtes *turpendotkundërmonjës* dhe *zemërkrundegërdhu* me vlerën dhe forcën e tyre semantike e stilistike shërbejnë për të fundosur e zhytur në skëterrë Barabbanë.

Në këtë poezi Noli përdor vargun trembëdhjetërrokësh, i cili është një katërkëmbësh anapestik. Ka një muzikalitet gati marcial, i cili përftohet edhe nga përdorimi i fjalëve oksitone:

Tradhëtór/ ti na nxi/ ve na lé/ pa atdhé,
ti na çthúre, na çkúle, na çdúke çdo fé.

Edhe në poezi të tjera, ai ka përdorur një figurshmëri të pasur. Poezia "Marshi i kryqësimit" në të shtatë strofat e saj është ndërtuar mbi bazën e paradoksit. Për ilustrim po japim vetëm një strofë:

Vrajeni, se përunj dhe përmbys pasurinë,
Pasuron, dhe liron, dhe forcon varfërinë,
Se lëngatën shëron, se ndriçon verbërinë:
Kryqësoje, Pilot, në Kalvar, Golgotha!

Poezia tjetër "*Shën Pjetri në mangall*" është ndërtuar mbi bazën e shkallëzimit. Shën Pjetri në mangall mblidhet kruspull. Në fillim "*djek dorën e përdridhet*", pastaj "*djek mjekrën e përdridhet*" dhe në fund "*djek gjuhën e përdridhet*". Bukur e ka përdorur figurën e shkallëzimit rritës edhe te poezia "Jepni për Nënën":

Cilët jan' ata tiranë
Që të pren' e që të vranë,
Që të therë bij e bija,
Dhe t'u nxi, t'u mbyll shtëpia?

Sa më shumë të lexohet poezia e Nolit, aq më tepër zbulohen vlerat shprehëse të saj. Ajo mbetet model i mjeshtërisë së përdorimit funksional të figurave stilistike, i muzikalitetit të vargut, i ritmit, i llojeve të rimave e asonancave, i përpjesëtimit e i zgjedhjes së fjalëve. Për këto vlera ajo duhet të zërë një vend të merituar në programet dhe tekstet e arsimit parauniversitar dhe universitar pa u pozicionuar në rrethanat jashtëletrare.

Prof. as. dr. RAHIM OMBASHI

DUKE RIDËGJUAR LETRËN E FUNDIT

Hyrje

Atë fillimnëntori 1964, kur vdekja i ra daulles, Fan Noli bie në koma dhe më pas i nënshtrohet operacionit. Kishte folur për shqetësimin e mbramë me poezinë "*Vdekja e Sulltanit"*, nënshkruar me pseudonimin Namik Namazi, (lutje me emër, ose lutje e shenjuar). Më pas nuk shkroi më gjersa u shua, në mars 1965.

Kish jetuar aq gjatë, kish dështuar jo pak herë dhe jo në pak drejtime kish ngadhnjyer. Mori aq shumë vlerësime, por disa të tilla ishin në lidhje me bashkëkohësinë, ndaj nuk do të jetonin për shumë kohë. Tek universalja mbetet si poet, sepse krijimi është gjithashtu përvojë universale.

Optimist për nga natyra dhe me idenditet të spikatur intelektual për shumë kohë e kishte përqeshur armiken e shpresës, ndonëse kish vuajtur aq tepër sa vetëm varrit do t'ia tregonte. Ndaj edhe në çastet e fundit të jetës nuk u nda me letrën e bardhë, që s'iu zvordh asnjëherë. Atje gdhendi shpirtin e vet.

Siç shkruan në vetën e tretë te *Autobiografia*, botuar më 1958, vlerëson punën e vet së pari në fushë të veprimit fetar – kombëtar, mandej ndihmesën e tij në fushë të diplomacisë, në fushën e veprimit kombëtar – politik – revolucionar, në fushë të publicistikës, kurse për vjershat e veta thotë: "Sa për poezitë e mia, unë nuk merakosesha shumë për to. Mendoja se ato nuk vlenin fare. "

Por florinë e dallon argjendari. Mitrush Kuteli, si kishte bërë të njohur për lexuesin e studiuesin shqiptar bashkëqytetarin e vet, Lasgush Poradecin, në pranverën e verën e vitit 1943 bëri të njëjtën gjë edhe për Nolin. Jo vetëm e mblodhi, por dhe e shoqëroi me një *vështrim kritik Verbin* nolian.

Me rastin e festimeve të 25-vjetorit të Pavarësisë Kombëtare, në botimet zyrtare të qeverisë së Mbretit Zog, shkruhej: "Në qiellin e botës kulturore shqiptare shndrijnë tre yje të pashuar, Naimi, Noli dhe Fishta. " Duke pasur parasysh këtë vlerësim ai filloi të kërkonte vendin që i takonte Nolit në lëmin e poezisë.

Të dy kishin jetuar gjatë në mërgim, ndaj i përmblodhi vjershat me titullin *Mall e Brengë.* Në to ai dëgjoi dhimbjen dhe shqetësimin e ngërthyer fort brenda poezive mjeshtërore, të cilat i shijonin veçanërisht të rinjtë. Ajo shijohej prej leçitësve se *brenda veprës populli shqiptar gjen ujin e gjallë që i jep jetë jetës së vet*. E përfundon letrën me bindjen: *Mund të them pa drojë se ju kini krijuar këtu një shkollë letrare, rryma e së cilës ndjehet shumë në shkrimet e të rinjve*. [13]

Kuteli ka botuar tekste edhe mbi A. Asllanin, A. Z. Çajupin, Asdrenin e F. Shirokën, ku ai lëviz nga leximi impresiv te recensioni, por prej vargut nolian ai dëgjon diçka tjetër: *Vjersha e Nolit nuk ka ondulacionin e valëve në mezin e detit, po përplasjen e tyre anës, me zhurmë, gjithëmonë të përsëritur. Në botën e arkitekturës ajo nuk u përngjan pjesave të rumbulla, por çipeve të mprehta. Sepse Noli nuk gdhend në mermer, po në krastë. Nuk limon me daltë, po pret me sëpatë dhe me çekan të rëndë.*

I bindur që puna mjeshtërore e nisur prej tij ishte vetëm fillimi, ëndërronte: "Dhe tani, në mbarim, pyetja që na rëndon në shpirt është kjo: A do të kemi fatin të vazhdojmë dhe të plotësojmë këtë vështrim panoramik mbi veprën poetike të Fan S. Nolit? Në këto, ngritjet dhe përmbysjet e sotme askush nuk mund ta dijë. Dhe në qoftëse na refuzon fati këtë hir, ata që vijnë pas nesh- se vijnë të fortë- le ta vijojnë. "

Njohja e veprës poetike të Nolit zë fill me botimin e antologjisë "*Shkrimtarët shqiptarë",* botuar më 1941 në Tiranë nga bashkëpunëtori i tij Andon Frashëri, por mbasi lexuesi merr në dorë librin *Mall e Brengë*, më 1944 Lefter Diloja boton veprën "*Ligjëron Fan Noli"*.

Është fat për veprën poetike të Nolit që në krye të Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë është miku i tij, i cili më 12 dhjetor 1945 i përcjell letrën: "Hirësisë së Tij Imzot Nolit. Për kontributin e madh që kini dhënë në fushën e kulturës dhe të letrave shqipe, Konferenca e Shkrimtarëve të Shqipërisë që u mblodh në Tiranë më 7-11 Tetor 1945, Ju zgjodhi Kryetar Nderi të Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë.

Ndjej një gëzim të madh që jam unë ay që po ju komunikon këtë gjë. Me respekt-- Kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, Sejfulla Malëshova. "

Lidhjet miqësore të Nolit me qeverinë shqiptare vijuan të mira deri në vitin 1948. Po të tilla janë dhe raportet e zyrtare me poezinë e tij. Në këtë vit, me kujdesin e vetë autorit Federata *Vatra* boton përmbledhjen poetike *Album*, të cilin Qerim Panariti e riboton më 1966 me përmirësime. Nexhat Peshkëpia në Nju Jork, u jep lexuesve shqiptarë librin *Noli si poet dhe si poet-përkthyes*, ndërsa Tajar Zavalani e kujton në librin *Historia e Shqipërisë*.

Vehbi Bala duket me intuitën e poetit, por dhe me guximin e studiuesit të thellë, merr përsipër *të plotësojë vështrimin panoramik* të veprës noliane, kur më 1958 boton librin *Albumi-1948*.

Interpretimi i veprës poetike të Nolit, u vu në kornizën politike të kohës, pas vitit 1965. Në ditarin e vet, vetëm 2 ditë pas vdekjes së Nolit, më 15 mars 1965, drejtuesi i shtetit shqiptar bën përcaktimin taksativ: "Noli ishte një nga figurat e shquara politike dhe letrare të fillimit të këtij shekulli… Por sidomos elegjitë antizogiste dhe antifeudale të tij dhe poemat janë margaritarë të bukur që kanë frymëzuar dhe do të frymëzojnë rininë tonë, sidomos në krijimtari". [7]

Gjykimi për Nolin së pari veprimtar politik e pas tij krijues, ndërkohë që siç na thotë ai vetë pas viteve '30 tërhiqet plotësisht prej jetës politike dhe jo vetëm prej kësaj veprimtarie, përcaktoi qëndrimin e censurës zyrtare që nuk lejoi më pas botimin e veprës së plotë tij, siç ndodhi me botimin nga Vehbi Bala "*Poezi të zgjedhura të Nolit"* (1966), ndërkohë që jehona e fortë e gjykimit politik ndihet dhe te studimi

monografik "*Jeta e Fan S. Nolit"* (1972) si dhe te kapitulli në botimin zyrtar të "*Historia e Letërsisë Shqiptare"* (1984), të po këtij autori.

Në këtë ndërkohë, prej vitit 1965-1987, me veprën poetike të Nolit është marrë kritika shtetërore pozitiviste, madje duke i mëshuar një sociologjizmi të politizuar e të ideologjizuar deri në skaj, dhe që për pasojë ka dhënë vlerësime taksative, çka e ka diktuar interpretimin si dhe frenuar studimin e veprës poetike të Nolit.

Përmbysja ndodh vetëm një vit më pas. Në fjalën hyrëse të botimit akademik, *Fan S. Noli, Vepra*, Tiranë, 1988, në 5 vëllime, Aleks Buda konkludon: "Por Noli si burrë shteti e politikan nuk është as i tërë e i plotë Noli, as nuk është kjo ana kryesore e personalitetit dhe e veprimtarisë së tij. Noli burrë shteti dhe udhëheqës politik – kjo anë është ajo që, me gjithë meritat e shquara, mund të konsiderohet në veprimtarinë e tij si një aspekt që i nënshtrohet më tepër relativitetit të kohës, relativitetit dialektik të historisë.

Noli rron e do të rrojë në radhë të parë si krijues i veprave madhore poetike;"[7]

Afërsisht në këtë përfundim arrin te ky botim edhe Vehbi Bala.

Fakti që në përmbledhjen e veprës së Nolit janë shfaqur dy studiues potenciozë për kohën, duhet kuptuar si një ogur i mirë, si një hap përpara në kohë dhe njëherazi si një vlerësim më i përparuar i shkencës sonë, nga sa lejohej atëhere këtu te ne. Vepra e shumanshme e Nolit, veçmas ajo poetike, po i diktohej kohës politike, me vlerat e saj të spikatura artistike.

Nën këtë diktat dhe me këto korniza ideologjike vijoi interpretimi i veprës së tij poetike, si e shkallës që vinte pas veprimtarisë së tij politike, deri në vitin 1987. Metoda tradicionale e interpretimit historik-shkakor të veprës së Nolit, e pa poezinë e tij si ndikim nga rrethana të caktuara historiko-shoqërore. I tillë ka qenë deri dhe studimi i Nasho Jorgaqit, *Vjersha e fundit e Fan Nolit*. [8]

1. Fan Noli - Krijues antologjik

Në një bisedë me shkrimtarët, më 1958, ishte përgjigjur: "Po të më pyesni cilën poezi do të parapëlqeja, poezinë e Marathonomakut, si më të mirën. "

Këtë poezi nxirrte në krye edhe Lasgush Poradeci. [11]

Fan Noli shkroi poezi të rastit, poezi autobiografike, poezi satirike si dhe në fund të jetës poezi ku mbisundues është komizmi ironik. Më e arrira, te grupi i poezive autobiografike brenda 26 vjershave origjinale, apo 35 të tillave, po të fusnim edhe 9 variantet për to, sipas Sabri Hamitit [6], është *Marshi i Kryqëzimit*, "ndërtuar si një bisedë e sforcuar mohuese e vlerave të heroit moral të Nolit, që nga fëmijëria, siç është Jezu Krishti, por që e kundërta humane ia ngre kultin këtyre vlerave".

Marshi i kryqëzimit, krejt ndryshe prej poezive të tjera, që si lëndë bazë kanë një ide që pranohet dhe një që kundërshtohet, kësisoj figura e kontrastit bëhet figura që i lidh të gjitha, përcillet mes **paradoksit**, ku e papritura del kundër mendimit të zakonshëm. Si gjykim origjinal i papritur, bie në kundërshtim me moralin, por në thelb përputhet me të vërtetën.

Pohimi ngrihet mbi bazën e një **oksimoroni**: *Do t'të vrasim se të kemi baba*, që duke i shtuar figurën konceptuale të mbështetur në një person si Jesu, Mesi etj.

krijojnë vargjet: *Do t'të vrasim, Jesu, se të kemi baba, // Do t'të varim, Mesi, se të kemi usta, .* //, ku zhvillimi i mëtejshëm i figurave konceptuale, sjell rendin e dytë të figurave: *baba, usta* etj.

Si vjershë autobiografike që lidhet me figurën e Krishtit, e lidh heroin me përvojën e tij personale, duke u identifikuar me heroin moral të barazisë.

Është e vërtetë që sipas traditës latine të shpjegimit të Shkrimit të shenjtë një nga nivelet e shpjegimit të tij është leximi i fjalëpërfjalshëm, por këtu kuptimi është i figurshëm, sepse krijimi vetëm sa është mbështetur mbi shtratin biblik. Sabri Hamiti e vlerëson këtë krijim poetik si antologjik duke dalluar në të të tre nivelet e leximit kuptimor.

Noli pikësëpari dëshmohet si krijues dhe është vlerësuar si i tillë.

Duke pasur si bazë këto vlerësime, e kuptojmë se pse prej leximit të sipërfaqshëm, ideologjik apo ilustrues të diktatit poetik, nuk u arrit të dëgjohej deri krijimi i tij i mbramë *Vdekja e Sulltanit*.

2. Në kërkim të krijimit si përvojë universale

Vjersha është botuar së pari në gazetën "*Dielli"* të datës 18 nëntor 1965.

Në FN të DASH ruhet një autograf i vjershës me titull *Vdekja e Sulltanit* (d. 37). Është nënshkruar me pseudonimin *Namik Namazi* dhe mban datën "Nëntori 1. 1964". Një dorë tjetër ka shënuar në fund, anglisht, se Noli u operua në stomak më 2 nëntor 1964, domethënë një ditë pasi shkroi vjershën e tij të fundit. Titulli i vjershës dëshmon situatën jetësore në të cilën ndodhej, ndaj data e përfundimit të saj është shumë e domethënëse.

Duke mos pasur arsye që ta analizojmë vlerësimin e kahershëm kategorik të tekstit, përkrahim pikëpamjen e Cvetan Todorovit që duke u mbështetur në tezën e Mihail Bahtinit, "propozon një kritikë dialogjike, si mundësi e përjashtimit të shkrimit kategorik për letërsinë, qoftë ky si pëlqim total, qoftë si mohim total, që funksionalisht bëjnë një. Këto ide mund të krijojnë një kuadër për shqyrtimin e çështjes së vlerësimit dhe të rivlerësimit në botën letrare shqiptare. Këtu termi **ri-vlerësim** shkruhet me vizë lidhëse për të kuptuar jo vetëm vlerësimin në raportin **i ri / i vjetër**, por në kuptimin vlerësim tjetër". [5]

Poststrukturalisti Zherar Zhenet, që përkrahte konceptin e hipertekstualitetit në interpretimet e tij semiotike thotë: "Vjeshta është stina e kritikës" kurse diku tjetër shton: "Kritiku duhet të heshtë e të shkruajë". Thëniet e mësipërme duhen kuptuar si thirrje për një veçanti dhe një mendësi si nevojë e ekzistencës së interpretimit dhe njëherazi si parapëlqim i shkrimit letrar sistematik e të argumentuar. Kohërat që po kalojmë janë kohë të përplotësimit të ndërgjegjes intime dhe asaj publike, "ndaj vlerësimi i ri i veprave të traditës nuk merr karakterin e përmbysjes, por të zbulimit letrar. Një lexim i habitshëm dhe për herë të parë". [5]

Fan Noli u rikthye në Amerikë më 1930, në vitet e krizës së madhe. Prej asaj kohe, qëndrimi kritik ndaj botës, por veçmas ndaj vetes vjen e i përforcohet dita ditës. Pas një farë farë zbutjeje të bindjes se në atdhe duhej kohë që punët të fillonin të ndreqen, kryesisht me përfundimin e Luftës II, kontaktet e drejtpërdrejta me të dërguarit

shtetërorë në Sh. B. A. , mos realizimi i amanetit të Konicës për përcjelljen e eshtrave të tij në atdhe, e kthyen te bindja e mëhershme. I kujtohej letra e Andon Frashërit (1892-1965), bashkëpunëtorit të vet në punët e *Vatrës*, i kthyer në Korçë, ku e zuri mbarimi i luftës. Më 1958, kur u lejua të vizitonte Shqipërinë delegacioni i parë i mërgimtarëve të SHBA, ai i dha fshehurazi njërit prej atyre të ardhurve një letër për Nolin, ku i shkruante mes të tjerash: "Mos ajde këtu, se të pret burgu ose plumbi". Kanceri social, lufta e klasave, po bënte kërdinë. Përgatitej fshehtazi shpallja e shtetit të parë ateist, në vendin e parë të botës që kish lejuar përhapjen e monoteizmit kristian. Shën Konstandini kish lindur flamurin me dy krerë, sipas tij. Po me krijimin e tij të shenjtë çdo të ndodhte? I mungonte fizikisht miku i tij i shtrenjtë e i rëndonte amaneti. Në një farë mënyre ishte përpjekur t'ia lante borxhin. Në 7 gusht 1963, Fan S. Noli përktheu nga frëngjishtja dhe botoi te gazeta *Dielli* poezinë e famshme të Viktor Hygosë: *Waterloo.* I vuri përsipër titullit këtë përkushtim: *I dedikohet Faik Konitzës*. *Shqipërimi i saj i dedikohet Faik Konitzës, i cili e dinte pa kartë dhe e deklamonte Frëngjisht me ngashërim të thellë*. Nënshkroi me pseudonimin letrar Namik Namazi. [10] Në këtë atmosferë të rëndë dhe vendimesh të mëdha u ngjiz *Vdekja e sulltanit*. Kish mundur që Kishën Shqiptare ta kthente në vatër të edukimit atdhetar e qytetar. Morali, etika e krishterë, i kishin dhënë forcë të përcillte porosinë. Më 15 mars 1965, qeveria shqiptare, në letrën zyrtare që u drejton shqiptarëve të Amerikës u shprehte dëshirën që trupi i tij të sillej dhe të prehej në Atdhe. Këshilli i Peshkopatës të Kishës Ortodokse Shqiptare në Amerikë, kthente përgjigjen ku mes të tjerash shkruhej se "rrethanat e bëjnë të pamundur përcjelljen e trupit ne mëma Shqipëri, të cilës ai i kish dedikuar tërë jetën e tij. Ky nder lutim dhe shpresojmë që të realizohet në kohën e arthme".

Rivlerësimin e kësaj poezie, duhet ta gjejmë te sistemi metaforizues, te çkodimi i ngjyrimeve kuptimore, të cilat njëherazi kanë edhe të sendërtuar ndjeshmërinë e autorit. Fjalët çelës, vetëm te strofa e parë: *sulltan, agallarë, bejlerë, pashallarë, qani, u pi, u shtri* shtjellojnë motivin çelës të kësaj strofe. Kështu mund të zhvillohet edhe në katrenat e mëposhtme. Hapësirat e këtyre fjalëve çelës brenda motiveve të poezisë së fundit të Nolit, i japin dorë poetit të zgjerojë kuptimin e poezisë duke krijuar përfytyrimin poetik. Këtu ndodh që "… ndonëse raportet midis tyre janë të tilla, që të parat shërbejnë për të kuptuar të dytat, studiuesi vë re se shpesh nuk ka një përputhje midis tyre, sepse, edhe kur fjala mungon "motivi është brenda kontekstit dhe nënteksti poetik jeton përmes asociacioneve të largëta ose të afërta, që e bëjnë atë më të fuqishëm se shprehja e drejtpërdrejtë, dhe më të pranishëm se fjala që i referohet". [3] Në se hyjmë në mekanizmin e brendshëm të ndërtimit të metaforës, shohim kuptimin që merr fjala në planin e përgjithshëm të realizmit, krahasuar me kuptimin konkret që merr e njëjta metaforë në një kontekst të ri, lidhur me gjendjen emocionale të përjetuesit. Krahasuar me Saadiun apo me disa poezi me temë të përafërta të Çajupit e Konicës metafora e Nolit merr ngjyrim tjetër, që përforcon individualitetin e tij poetik, vizionin e njëmendët, si dhe e synimit të tij për të shprehur ide tjetër nga ato të motiveve të njohura të tij.

Tek kjo poezi mbizotëron filozofia aktive e veprimit dhe flijimit, në interes të një mendësie kritike, aq e nevojshme për shoqërinë shqiptare, e cila do ta largonte atë nga vetëmburrja, sidomos ajo e trimërisë fizike.

Mënyra tradicionale e interpretimit historik-shkakor të poezisë së Nolit, veçmas në Shqipërinë politike, e sheh poezinë e tij si ndikim nga rrethana të caktuara historiko-shoqërore. Studimet e pas viteve '90 po u largohen metodave tradicionale. Kësisoj, studiuesi i njohur Jorgo Bulo te vepra e tij mbi lirikën e Naim Frashërit [1], me njëmendësinë e pikëvështrimit, dëshmon se interpretimi letrar nuk mund të ketë fund, se vepra letrare është një strukturë artistike e hapur, se receptuesi i saj, aq më tepër kur është specialist i letërsisë, e sheh atë me syrin e vet, duke krijuar një lidhje të re midis kodit poetik të poetit që është derdhur në vepër dhe kodit të tij si interpretues.

Është thënë se së bashku me të papërsëritshmen, vetjaken vjen edhe poezia e madhe e traditës vendase, por edhe ajo e traditave të tjera poetike. Ekzistimi dhe formësimi i kulturës sonë midis ndikimit të kulturës së Lindjes dhe asaj të Perëndimit, është parë nga akademiku J. Bulo, por edhe nga të tjerë studiues, në veprën e Naim Frashërit. Naimi i vendosur në raport me autorë të orientit, me poetë europianë si dhe me autorët tanë filobiblikë, ata alhamiado, të letërsisë sonë të re, me mitologjinë dhe krijimet e letërsisë gojore, me shkrimet fetare, apo edhe në planin filozofik etj. , krijon një pamje të plotë të një vështrimi në plan krahasimtar.

Te Noli dallohen motive të përafërta me poezi nga *Gjylistani dhe Bostani* të Saadiut, apo nga *Rubairat* e Omar Khajamit.

Rrëfenjë: *… Armiku i shpresës, vdekja, ra mbi mua. / O shok, kujtomë mu në varr të zi! / Në gjum' e shkova jetën aq të dashur, / Ndaj, shok, të them si unë ti mos fli!*
GJYLISTANI DHE BOSTANI

47. *Me Bukë sa për shpirt, moj Hën' e Zanë, / Me Ver' e Harp' e Vjersha dhe ty pranë / Në Pjergull të Gërmadhës jam m'i lumur / Se në pallat e fron e një qint* ***Sulltanë.***

203. *Ah! Vera shkon në derë të myftinjve / Dhe Kryevegla n'arkë t'axhaminjve: / E Bukura e Dheut fle në shtrat / T'****evnukëve,*** *në djep të çiliminjve!*

290. *Rrush, o* ***Sulltan*** *Mahmud, o Ngadhënuar, / Ti helmet e ti tmerret ke larguar / Nga shpirti yn' i ngrysur e i ndryshkur, / Me shpatën tënde ti ke shpëtuar*.
RUBAIRAT

3. Nga kodi i poetit te ai i interpretuesit

Tepër i kulturuar që të mos e ironizonte e jo më ta satirizonte atë pjesë të mendësisë orinetale të kombit të vet, Noli e mbush poezinë e tij me përmbajtje humane e qytetare, duke iu shmangur pasivitetit. Njeriu shqiptar jo vetëm mundet, por edhe e ka për detyrë, të qesëndisë ndjenja të tilla të pakultivuara, si jehonë e individualitetit të tij të tejskajshëm, të cilat e pengojnë jo pak, në udhën e qytetërimit, përparimit e të begatimit, në zgjidhjen e detyrave të shumta kombëtare, vetjake, sociale.

Këto motive nyjëtohen përmes simboleve të poezisë persiane të mbretit autokrat oriental, të vezirit, agait.

Noli këto simbole i fut në kulturën shqiptare me anë të fjalës *sulltan*. Kjo përqasje e Nolit me letërsinë perse, pra përqasje vertikale, dëshmon praninë e një arketipi të mendimit universal, të dy poetëve të epokave dhe të stileve të ndryshme. Paralelet e lirikës së Naimit me poezinë evropiane janë studiuar, që për poezinë e Nolit duhet të bëhet objekt studimi.

Krahasim mund të gjejmë me poezinë e Çajupit *Sulltan*i, e botuar më 1902 te përmbledhja *Baba Tomorri*, por paralele mund të heqim edhe me poezitë e Faik Konicës: *Anadollaku në mësallë* (1903), *Zullutë e Zullulandi* (1922), *Diplomati* (1938).

Ndonëse mbështetet në hipotekste të tilla, *Vdekja e sulltanit* është një hipertekst.

Interes të madh ngjall edhe vështrimi ndërtekstual i veprës së Nolit. Duke pranuar se një tekst është i ndërvarur prej teksteve që kanë jetuar para tij, kemi parasysh ndërvartësinë e poezisë prej teksteve që kanë ekzistuar para tij. [3] Teoria strukturaliste mbronte pikëpamjen e kuptimit të qëndrueshëm të çdo teksti letrar si dhe interpretimin objektiv të tij. Më pas, postrukturalistët iu kundërvunë pikëpamjes së mësipërme. Sipas tyre, ashtu siç ishte letërsia e paqëndrueshme, edhe interpretimi i saj është produkt i përjetimit dhe vlerësimit subjektiv. Sipas një përfaqësuesi të tyre të shquar, (R. Bart), *s'ka kuptim letrar të stabilizuar, përderisa natyra ndërtekstuale e veprës letrare e çon lexuesin gjithnjë në një marrëdhënie të re me të.*

Konceptet letrare mbi ndërtekstualitetin, sollën në studimet letrare të kuptuarit e një teksti letrar si ndërtekst në raport me vepra të mëparshme, dhe njëkohësisht pranimin e tij si shumëkuptimësh, pa kufij të përcaktuar e të qartë, të hapur ndaj perceptimit të lexuesve. Pasi e përqasëm këtë poezi të Nolit me poezi të tjera, duke nxjerrë në pah marrëdhëniet e këtij teksti me ato tekste, përvijohet të zbuluarit e raporteve që mund të ndërtojë kjo poezi me lexuesin e sotshëm.

Nisur nga pohimi i J. Kristevës, se "teksti nuk është objekt i izoluar, por përshtatje e tekstualitetit kulturor", edhe kjo poezi do parë në marrëdhënie me shkrime të tjera, që i përkasin një konteksti të tillë. Për Nolin mund të përdoren shkrimet e shumta publicistike të botuara në këtë kohë, por edhe letrat e tij që shpërfaqin mendimin e vet shoqëror të kësaj kohe.

Dialogjizmi i M. Bahtinit, duke përpunuar teorinë e ndërtekstualitetit letrar, flet për marrëdhënien dialogjike midis vetes poetike dhe gjuhës sociale. Gjuha vetjake, te ky tekst, hap përmbajtje të reja kuptimore përtej kuptimit të fjalëve ku përfshihen konfliktet dialogjike. Sipas kësaj teorie kjo poezi është një krijim ndërtekstual në sfondin (pra në tekst) e shoqërisë dhe historisë, apo ajo që J. Kristeva e quajti *teksti si ideologemë.*

Noli, ndonëse jetonte larg *mëmës Shqipëri*, mbante lidhje shpirtërore të pandërprera me të. Aq më tepër që edhe mikromjedisi social ku jetoi, bashkatdhetarët me të cilët ndau gëzimet dhe hidhërimet e jetës, duke i pasur si veten, i njihte mirë. Atdheu i tij ishte karakterizuar si "qoshja më perëndimore e Gadishullit Ballkanik të orientalizuar dhe si lidhësi më i afërm i tij me botën oksidentale të gadishullit të Apenineve, si çelësi i Adriatikut dhe si pikëtakimi i botës romane me botën greke e sllave…"[2] E

njihte jo pak shumicën e popujve të Ballkanit, kësisoj edhe popullin e vet. Njihte historinë e tyre që ngjiste gjithashtu, por dhe problemet e tyre të veçanta, gjendjet e tyre shoqërore.

E pranonte mendimin e Fishtës për dallimin mes qytetërimit dhe kulturës, e njihte strukturën ekonomike shoqërore të vendit të vet deri më 1924, madje për rreth 6 muaj kishte qenë kryeministër i tij, siç kishte njohuri të plota për çka ndryshoi për mirë dhe çfarë në të kundërtën në periudhën e Monarkisë Shqiptare. Ai e dinte se deri në ç'shkallë ishte ecuria për modernizimin e vendit të tij, thënë shkoqur e evropianizimit të Shqipërisë. E kishte të palëkundur kultin e diturisë. Vetëm me anë të saj mund të kapej e madhërishmja dhe hyjnorja, që prej andej mund të zaptonin zemrën. Dhe nëse shpirti i plotësonte me besimin, shumëçka do të ecte më ndryshe në vendin e popullin e tij. "Më 7 prill, gazeta *Dielli* njoftonte: *Shpresohet se Peshkop Noli do të kthehet në Shqipëri për të kryesuar një universitet popullor. Në lidhje me këtë idé, z. Konica i çfaqi shtypit që është i mendjes ta përkrahë mendimin për të vënë Peshkopin në krye të një pozite arsimtare të këtillë*. [10]

Nje ide e guximshme për kohën, po jo të tillë për krijuesin e vlerave të reja. Vendosja e shtetit komunist nuk ndikoi për mirë mbi komunitetin shqiptar të Sh. B. A. Kish pasur kontakte dhe përplasje me drejtues të shtetit shqiptar, si ajo me *Kollonelin* Tuk Jakova në vitin 1946, që: "Po ay më shikonte shtrëmbër me mosbesimin instiktif të barbarit kundrejt njeriut të mësuar. Flas vetëm për Kollonelin, se delegatët e tjerë ishin aq të dominuar prej tij sa ay as i përfillte fare", për të cilën e informon Gjeneral Enver Hoxhën, në një letër të datës 30 shtator 1946, ku në fund të së cilës thekson: "Dy fjalë për marrëdhëniet me Amerikën, të cilat janë kyçi i problemeve tuaj këtu. U lodha dyke ju përsëritur që duhet t'i pranoni traktatet në parim pa kondita, se fundi i fundit kjo nuk është vetëm një çështje formulle pa rëndësi praktike. Pasi të lithni marrëdhënje dipllomatike me Amerikën, ahere çështja e Kryqit të Kuq Amerikan do të zgjidhet vetëvetiu me pak durim dhe vetëm ahere do të hapet udha për të nisur një fushatë serioze". [9]

E njihte temperamentin sanguin të gjakut të vet, njihte dhe komponentin priapik të tiparit moral të po këtij identiteti, por njëherazi njihte edhe prapambetjen në qytetërim, si tërësi rezultatesh që kishte arritur shoqëria shqiptare. Qytetërimi perëndimor kish arritur jo pak, ndërkohë që Qeveria e Tiranës, synonte të krijonte sipas një shprehjeje të W. Churchillit, *njeriun e qytetërimit të kazermave.*

Nisur nga tematika humano-qytetare e poezisë *Vdekja e Sulltanit*, që lidhet me të vërtetën filozofike, çelet parimi kompozicional i ndërtimit poetik, ku mbisundues është ai i analogjisë. Ajo është ndërtuar si një vaj i kultit të vlerave që nuk kanë ekzistuar kurrë, por që në të kundërtën qesëndis idenditetin intim të botës qytetare shqiptare.

Këtu të qeshurit hyn në një prej tri fazave të para të satirës dhe u përgjigjen, tri fazave të para ose ironike të komedisë, duke qenë më afër me fazën e dytë, "ose jokonvencionale në të cilën burimet dhe vlerat e vetë konvencioneve janë objekte të përqeshjes"[4]. Ironia ndërton figurën e idesë së përmbysur, sepse grishjet e vajtojcës nuk po përdoren për përcjelljen e një njeriu, sado autoritar të ketë qenë ai, por të një ideje si dhe të një mendësie dhe të një shoqërie mbarë. Vargu në fund të çdo prej

shtatë katrenave, kundërshton idenë e tri vargjeve të mësipërme të katrenës duke rritur tensionin e diskursit e duke njoftuar për një fatkeqësi, por që nuk është mbyllur, ajo është në potencë dhe do të rishfaqet në kohërat që do të vijnë. Sado që vepra e tij poetike zgjerohet kuptimisht duke u lidhur me figurat politike e shoqërore të shtetit osman, ajo është përherë produkt i një situate kolektive apo personale. Poezia ka në themel një imagjinatë të fuqishme intelektuale, që ia rrit shumë tensionin kësaj vjershe. Ndonëse këtu kemi një mimesis mes realitetit psikik e social të shoqërisë shqiptare të Nolit dhe priapizmit të tyre, nuk kemi prekje të përcjelljes së vlerave estetike. Gjuha e nënkodit poetik është bërë më shprehëse me qëndrimet që japin intonacione të fuqishme, sidomos me harmonizimin e fjalës së saj me përmbajtjen që realizojnë aliteracione të fuqishme, me ndalesa të shpeshta që japin idenë e pengimit a të qëndresës në vend, me përsëritjen a shkallëzimin në tri vargjet e para të katrenave, si dhe me vargun e fundit, ku përsëritja luan rolin e përjetësimit të vesit të kthyer në mit. Te poezia e mbrame nuk e ka ulur kujdesin për të punuar me fjalën, e cila zë vendin e parë mes elementeve poetike. E tillë është arkaizmi *hadem* që në shqipen e sotme është zëvendësuar me fjalën *eunuk*. Kjo fjalë çellës e mbush me ngjyrë e gjallëri tjetër jo vetëm vargun e strofën, po tërë poezinë. Vjersha shkakton mbresa të fuqishme estetike, që vijnë e futen në zemër e mendje edhe me anë të veshit, sepse poezia e Nolit është audive, sipas Mitrush Kutelit.

Plasticiteti i kësaj poezie është dëshmi e "sulmit të brendshëm, e sulmit shpirtëror të poetit e shprehur përmes fjalëve". [12] Mes komizmit ironik, prej katrenës së parë marrim intuitivisht efektin e qesëndisjes, jo vetëm me përmbajtjen e thellë, por edhe me anë të zanoreve të trasha *a, o, u*. Në katrenën e parë tetërrokëshe me rimë të përputhur të skemës *a, a* ndiejmë zgjatjen organike të vargjeve. Bukurtingëllimi vjen e forcohet edhe prej rimave të brendshme me zanoret i, i apo dhe më anë të konsonancave. Zanoret o në vargun e fundit të poezisë, duke qenë me tingull të hapur, të krijojnë efektin e shkundjes për mungesën e thellësisë së dhimbjes.

Toni mbizotërues i tekstit mbështetet në një diskurs poetik retorik, me figura stilistike, veçmas metafora të forta, shpeshherë konceptuale.

Poezia shquan për një tonalitet ritmik të njëjtë.

Tematika themelore e grupit të vjershave, ku futet dhe vjersha *Vdekja e Sulltanit*, të cilat Noli i nënshkroi me pseudonime, dhe që shfaqet në variante të ndryshme, ka shtruar dilemën: a do të arrijë mendësia e popullit shqiptar që me anë të evolucionit të synojë së pari kënaqësitë intelektuale e shpirtërore, apo do të vijojë të tundohet së pari prej atyre priapike.

Krijimi i jep përgjigje kërkesës që në të ardhmen, kodi etik, si element i fuqishëm i identitetit kombëtar, duhet të mos u bjerë ndesh dëshirave integruese euro-atlantike të kombit tonë.

E ndiente që ishin muajt e fundit të jetës së tij dhe dilemat e shumta e shqetësonin: *Kisha Kombëtare Autoqefale Shqiptare* e Amerikës, Federata Panshqiptare *Vatra*, gazeta *Dielli*. I njihte me emër të gjithë ata që e rrethonin. Kush më shumë e kush më pak, pëlqente të ishte vetë i parë. Pakkush dëshironte të ishte vetëm shërbëtor i Zotit dhe ushtar i Atdheut, po vetëm Peshkop a Gjeneral.

Ky është konteksti, kuadri i jashtëm i vjershës, që përkufizon tipin e shkrimit, i cili shkon në nivelin social, me ngjyrime komike-qesëndisëse, por që bioletra e cila e tejkalon shkrimin me mission, përcjell deri agresivitet.

Të përqeshurit nolian krijohet me përsëritjen e foljeve të mënyrës urdhërore: *qani, qani*, e cila i jep edhe tonin poezisë, dhe fton përfaqësuesit e komunitetit shqiptar të Amerikës me emërtime të administratës shtetërore osmane: *agallarë, bejlerë, pashallarë*, sepse *ra* sulltani mbasi *u pi* dhe papritur *u shtri.*

Shoqëritë, kësisoj edhe mendësitë diktatoriale, ndërtojnë dialogjet vetëm me shtresat sociale të kreut, pa marrë mundimin të shtrohen në tokë, ndaj Noli u drejtohet me komizmin ironik vetëm atyre që shkëputen prej saj. Në krye ata kanë një sulltan, që e imitojnë, sepse janë pak nga ai. Ndaj ai vetëm sa ka rënë, sepse do të ngrihet, pasi t'i dalë të pirët.

Ti agai, ti beu, ti pashai dhe ti sulltani jeni dehur, ndaj jeni shtrirë. Ashtu nuk keni forca të garoni për qytetërimin që duhet ta arrini. Jeni të tillë, të tillë e keni dhe sulltanin, që mundohet për të shpenzuar kohën dhe jo për ta shndërruar atë në mjet për të realizuar qëllimin e madh të qytetërimit.

Fjalët çelësa *harem* e *bajram* janë huazime dhe jo arkaizma turke, konotacionet e të cilave thadrojnë mendësi që tregon se nuk merr përgjegjësinë e ndryshimit, por atë të përshtatjes me gjendjen që po jep shpirt. Në harem ka vetëm femra por jo nuse. Mendësia që i ble mbretëreshat (jo mbretëreshën) është gjithashtu orientale, ndaj as me to nuk arrin të marrë kënaqësinë e dëshiruar duke i plakur virgjëresha. Mospërputhjet mes kontrastit, që vijon t'i lidhë idetë, gjenden më pas.

4. Porosi që mjekon madhështinë e formatuar si kapadaillëk

Mendësia që ngrihet mbi lirinë e pakufizuar i ndërton lidhjet sipas interesit vetjak, duke mos qenë i zoti të ndërtojë partneritete serioze për ardhmërinë e Atdheut. I nis paradoksalisht me kralin e sllavëve të Jugut, ku jetonte gjysma e popullsisë shqiptare, por si i prish lidhjet me carin rus, nis ato me një tjetër sultan, më në lindje. Askush s'e kundërshton dot, ndaj ndërrohen ata që kishin gjetur lidhjen e mëparshme. Për të mos jetuar në realitet duhet një suitë tjetër. Ai që ra nuk vdiq, se nuk mund të vdesë. Është mendësia për të jetuar si sulltan. Ndaj jeni të tillë, pashallarë, bejlerë, sepse jetoni por dhe rrisni një mendësi të tillë. I uron? Jo! Të duket se i ka vënë në fokus të qesëndisjes a përqeshjes, veçse ajo është e sinqertë. Është në ditët e fundit të jetës së tij aktive.

Po ashtu, brenda poezisë *Vdekja e Sulltanit* mjaft njësi s'janë gjë tjetër veç zhvendosje elementesh të mëparshmë stilistikore e metrike, që zotërojnë një kuptim të dyfishtë: atë brenda tekstit në vetvete dhe atë që do ta quanim "tekst historik e social". Qesëndisja është një raport dialogjik midis tekstit të poezisë dhe tekstit social, përfshirë dhe strukturën ideologjike të shoqërisë së kohës.

Në dallim prej kësaj mënyre interpretimi, vështrimi ndërtekstual e shmang nocionin e burimit dhe ndikimit të jashtëm dhe përqëndrohet në zbulimin e raporteve midis strukturave të brendshme shenjore me strukturat social-kulturore. Jo vetëm kaq, por ndërtekstualiteti ka të bëjë edhe me ekzistencën e vazhdueshme të këtyre teksteve në

sfondin e shoqërisë dhe historisë. Nëse fjalë të tilla si *Qani, qani, or agallarë; Se sulltani ra, u pi; Se ka qenë mbret me nam /Për harem e për bajram; Në harem kish një qint gra, Që të gjitha për bela, /Nuset nuk i kullandriste /Bënte sikur s'i sajdiste. ;. . . Se sulltani kurrë s'vdes, / Përandaj, po thërres: /Pashallarë dhe bejlerë, / Rrofshi e qofshi kurdoherë!* , shprehin konflikte të brendshme sociale, në strukturën e tekstit ato i shohim në raport të caktuar me tekstin e përgjithshëm social. Kësisoj, leximin kuptimor të kësaj poezie nuk do ta merrnim thjesht si ndikim prej dukurisë që ekziston jashtë tekstit (realiteti i shoqërisë shqiptare në një etapë të caktuar të historisë së tij), por si rezultat i lojës që bëjnë brenda veprës shenjues të ndryshëm, dukuri ligjërimore, variacionet e shenjuesve etj. Duke lexuar poezinë e fundit të Nolit nuk synojmë të gjejmë thjesht referencën e fjalëve, e formave të ndryshme të ligjërimit me botën jashtë tekstit, por me sistemin shenjor letrar, prej të cilit janë krijuar tekste të tilla.

Ky pikëvështrim vendos raporte të tjera midis tekstit dhe kontekstit. Te *Vdekja e Sulltanit* konteksti e shpjegon tekstin, në fund të fundit ai është i dallueshëm prej tij. Ndërteksti i kësaj poezie është ekzistenca e tekstit brenda një teksti tjetër dhe jo thjesht origjina e kësaj poezie. Në të kundërt, interpretimi që synon të zbulojë burimet e këaj poezie, siç e cituam më lart, apo edhe në shkrime të tjera para viteve '90, *s'është gjë tjetër veçse rënie në mitin e bijësisë.* [3]

Edhe në krijimin e fundit të Nolit dëshmohet struktura ideologjike e shoqërisë shqiptare në atdheun amë, por edhe jashtë atdheut politik si edhe në diasporë, të shprehura përmes ligjërimit, por dimensioni ndërtekstual i saj duhet parë në sfondin letrar të formuar. Poezia *Vdekja e Sulltanit* reflekton jo një ide të veçuar, por një mendësi të tekstualitetit historiko-kulturor të Shqipërisë. Ndonëse është tekst në hapësirën e teksteve paraekzistuese, ajo përfaqëson në vetvete një tekst tjetër, me veçori të strukturave të brendshme.

Vepra poetike e Nolit, si variant i sistemit letrar, është ndërtuar mbi shenjues, kode dhe tradita letrare të krijuara prej kohësh në trashëgiminë letrare tonën si dhe atë botërore. Kjo e bën atë që, në njëfarë kuptimi, të mos jetë plotësisht e pavarur, por ndërtekstuale. Procesi i leximit të saj ka të bëjë pikërisht me lëvizjen gjatë teksteve, që i përkasin të njëjtit sistem, atij letrar. Sipas këtij pikëvështrimi leximi kuptimor i këtij teksti del nga kuptimi i marrëdhënieve të tij me tekste të tjera, çka i jep mundësinë atij të jetë ndërtekstual. Ndërtekstualiteti i këaj poezie lidhet pikërisht me kodin letrar të dukurive metrike, të formave ligjërimore stilistike. Në të njëtën kohë ky tekst përkufizon tezën e Kristevës se çdo tekst *është një ndryshim i teksteve, një ndërtekst në hapësirën e një teksti të dhënë*. Ajo që e bën këtë tekst ndërtekstual është pikërisht kuptimi i marrëdhënies së strukturës së brendshme të tij me tekste të tjera, që kanë paraprirë mjaft dukuri ligjërimore të veprës. Midis tekstit të Nolit dhe strukturave paraekzistuese, korpusit të letërsisë, ekzistojnë raporte sinonimike apo homologjie artistike.

Përfundim

Noli ka shkruar gjithësej 26 vjersha të njëmendëta, të cilat nisin me vjershën "*Fryn, moj erë"...* botuar për herë të parë në gazetën "*Kombi"*, 25 janar 1907, me pseudonimin letrar Ali Baba Qyteza. E fundit ishte poezia *Vdekja e Sulltanit*, e cila u

shkrua më 1964. Të shkruash për 6 dekada poezi, një rast i veçantë ky për kulturën tonë dhe jo vetëm për këtë.

Edhe poezia e mbrame e nyjëton personalitetin krijues e qytetar të Nolit.

Nga krijimi i mbramë poetik i Nolit na ndajnë rreth 5 dekada, periudhë kjo kur vepra e Nolit është botuar e ribotuar jo pak herë. Ndaj përcaktimi i ndërtekstualitetit të krijimtarisë së tij poetike dhe veçmas të poezisë që po intepretojmë ka mundësi të lidhet edhe me marrëdhëniet që krijon vepra me lexuesit që e pasojnë. Në thelb të këtij interpretimi dalin raporte të ndryshme midis trillimit artistik, që i përket veprës, dhe trillimit të kuptimit të saj, që i takon lexuesit aktiv.

Sipas ndërtekstualitetit asnjë tekst nuk ekziston si një e tërë autonome dhe e vetëmjaftueshme, sepse përvoja e vetë poetit si dhe e lexuesit patjetër që kushtëzon formën dhe interpretimin e saj. Tradicionalisht lexuesi i kualifikuar ka nënkuptuar realitetin social të shoqërisë shqiptare në një cast të historisë së saj. Por, nëse tekstin poetik do ta ndanim në strofa, ato na çojnë në një shumësi të tekstit social, në raport me të cilin krijimi i Nolit është ndërtekst. Pra, teksti nuk do t'i përkiste vetëm tekstit social të vitit 1964, por rindërton, në njëfarë mënyre edhe tekstin social të realitetit të sotëm. Nëse këtë vepër e shohim si tekst që i drejtohet lexuesit atëherë përmasat e saj ndryshojnë, sepse lexuesi është i ndryshëm, sipas nivelit të shijes dhe kulturës së perceptimit artistik. Kështu leximi reflektiv i saj siguron vazhdimisht një mënyrë të re qëndrimi; një kategori lexuesish në një periudhë të mëparshme, disa vjeçare, sigurisht që bënte një vlerësim të ndryshëm nga lexuesi i sotëm, i cili ka shije e përfytyrim tërësor më të ndryshëm. Ndonëse, si lexues, ne nuk hyjmë të bëjmë shpjegim për leximin e ri të tekstit poetik të Nolit, në të vërtetë, vlerësimi ynë ka në themel përjetimin e kësaj poezie si ndërtekst të sistemit letrar, drejt të cilit synon të shkojë amaneti poetik i Nolit. Gjithashtu edhe rileximin e kuptimeve të reja të saj. Këtë diferencim midis trillimit artistik dhe trillimit të kuptimit secili prej nesh do ta argumentonte sipas kuptimeve që do ta gjente në dukuritë e brendshme ligjërimore, në gjithë sistemin shenjues të tekstit. Kështu ky tekst i Nolit do të shihej si zbërthyes dhe shpërndarës kuptimesh. Vlerësimet e lexuesit shfaqen të ndryshme për dy arsye: së pari nga aftësia për të kuptuar njësitë ligjërimore dhe gjithë krijimin si ndërtekst në raport me vepra të tjera letrare dhe, së dyti, për t'i lexuar në mënyrë të re njësitë dhe tërësinë e këtij teksti.

Vdekja e Sulltanit (hipertekst) mund t'i nënshtrohej vështrimit ndërtekstual (sipas konceptit të hipertekstualitetit të Zh. Zhenetit). Poezia ka një marrëdhënie që e bashkon me një tekst të mëparshëm, nga Çajupi, Konica (hipoteksti). Kemi të bëjmë me një tekst të shkallës së dytë, domethënë që në thelbin e përgjithshëm të tij rrjedh nga një tekst paraardhës. Kjo poezi sigurisht që ka kuptim të pavarur, pra në njëfarë mënyre të mjaftueshëm. Por megjithatë, sipas leximit ndërtekstual nuk do të thotë se kuptimi i kësaj poezie është përfundimtar, shterues, përkundrazi në të mund të kemi më shumë se një lexim të mundshëm, ndonëse të kuptuarit e kësaj poezie qëndron në raportin e saj me një poezi tjetër, me të cilën lidhet. Në këtë çast teksti bëhet ndërtekst. Strofa:

Dilte ditën në pazar,
Dorëhapur derdhte ar
Që të blinte mbretëresha
Dhe t'i plakte virgjëresha.

përballë strofës së fundit:

Se sulltani kurrë s'vdes,
Përandaj, po thërres:
Pashallarë dhe bejlerë,
Rrofshi e qofshi kurdoherë!

mund të lexohet në disa mënyra. Ne mund ta lexojmë atë secili në mënyrën e vet, pikërisht sepse brenda saj ekziston një dimension dhe marrëdhënie ndërtekstuale. Në këtë kuptim *Vdekja e Sulltanit* e Nolit është ndryshim i tekstit të mëparshëm. Ky lloj vështrimi do t'i përkiste kryesisht mënyrës që çon në studimet tradicionale të metodës krahasimtare.

Një ndër tiparet më themelore të ndërtekstualitetit është teza e R. Bartit mbi "vdekjen e autorit". Sipas kësaj teze, analizat nuk të shpien më as te autori dhe as te teksti, po te lexuesi. Në një vështrim të sipërfaqshëm të duket se ky lloj vështrimi e injoron autorin, por e vërteta qëndron në kah të kundërt, duke e zgjeruar dimensionin e individualitetit të tij krijues. Nëse sipas teorisë së ndërtekstualitetit letrar, vepra e çdo shkrimtari nuk ka një kuptim të përmbyllur, por mbetet e hapur ndaj lexuesit aktiv, kjo shpreh në të vërtetë, përmasat e gjera, të pafund të imazheve artistike që krijon autori. Ky i fundit në këto kushte mbetet superior në pushtetin që ka mbi lexuesin. Ndaj, ndërtekstualiteti letrar e detyron studiuesin të flasë për vlerat e autorit, duke e kuptuar këtë vepër si një tekst që është në raporte të caktuara me tekste të tjera, që i përkasin sistemit të vërtetë letrar. Poezinë do ta shohim në raportin *Noli – tekst* si një linjë që ka kohën e krijimit dhe kohën e leximit, kodin vetjak dhe kodet e sistemit letrar; Poezinë qesëndisësë, përqeshëse do ta lexojmë nga pozicioni i lexuesit "konsumator" që gjen një kuptim të qëndrueshëm, apo do ta lexojmë atë si lexues "prodhues"? Kjo përcakton dallimin midis kritikës tradicionale dhe analizës semiotike, e cila, për vetë natyrën e saj, realizon një shumësi tekstesh. Në vartësi të përmasës së këtyre shumëkuptimshmërive ne mund të përcaktojmë dimensionin e vërtetë artistik të Nolit. Për të gjetur këto të vërteta, karakteri ndërtekstual i poezisë mund të shihet në dy dimensione, në atë horizontal dhe në atë vertikal.

Në dimensionin horizontal zbulojmë individualitetin e trillimit artistik, mënyrën si e koncepton dhe e ndërton figurën e sulltanit, si shfrytëzon raportin simbolik, alegorik, metaforik, situtën kimike që sjell qëndrimin ironik deri në atë sarkastik, elementet e shenjimit etj. Ndërsa në dimensionin vertikal tekste të tilla i përkasin një teksti letrar që ka ekzistuar më parë, pra një sistemi letrar specifik që ka struktura dhe mjete ligjërimore specifike. Të dy këto dimensione, që synojnë përcaktimin e karakterit ndërtekstual të tekstit nolian, shërbejnë jo për të stërmadhuar vlerat artistike të tekstit të autorit.

Përkundrazi, kjo mënyrë vështrimi, që synon të zbulojë ndërvartësinë e tekstit të tij me tekste paraekzistuese, ose raportet në sfondin e një teksti të përgjithshëm artistik, zbulon vlerat reale. Vështrimi ndërtekstual nuk mund të jetë një analizë në vetvete, por një mënyrë shkencore e përcaktimit të shkallës së njëmendësisë dhe të vlerave reale të krijimtarisë poetike të Nolit.

Djetë vite më herët, në përvjetorin e Nolit, botova librin që e titullova "*Po vjen Noli"*... me bindjen se kishim nisur të dëgjojmë poezinë e Nolit.

Punimi për këtë përvjetor është një sprovë për të argumentuar se kemi nevojë për ridëgjim të saj nën heshtjen krijuese.

XHULIANA LIÇI

MBI NJË TIPOLOGJI INTERPRETIMESH TË IDEVE NË DRAMËN "IZRAELITË DHE FILISTINË" TË FAN NOLIT

Drama" Izraelitë dhe filistinë" e Nolit, një prej veprave të para në historikun e dramaturgjisë shqiptare dhe pse e cilësuar nga vetë autori si një"dramë-skelet', apo "një foshnje –dramë", ajo mbart brenda saj një botë idesh, si produkt i përvojës jetësore dhe botëkuptimit të shkrimtarit. Në pasthënien e dramës autori pohon se: "*Do zgjatem shumë, po të jetë që të përpiqem t'u ap këndonjësve pen' e Adrianës për labyrintin kisha nër ment ahere kur e shkruaja këtëdramë*"[250].

Autori është formësuar dhe ia ka dedikuar gjithë jetën e tij binomit Atdhe-Fe, ku i pari përfaqëson kultin dhe forcën e mendjes dhe i dyti shpirtin dhe besimin njerëzor, dy ideale këto që ushqyen njeri-tjetrin përgjatë gjithë krijimtarisë letrare dhe veprimtarisë se tij politiko-shoqërore. Prandaj historia hebraike e mbivendosur mbi realitetin ekzistues të Shqiperisë së asaj kohe, përfaqëson elementin autobiografik në vepër. Noli përzgjodhi një legjendë biblike për të aktualizuar idetë, që ajo përcjell në përqasje me përvojat e tij si një udhëheqës shpirtëror dhe politik i lëvizjes për liri dhe pavarësi të shqiptarëve. Kjo legjendë krijon hapësira për të bërë interpretime paralele dhe për ta vendosur atë si një bosht referencial për çdo kohë dhe hapësirë dhe megjithëse autori shtron alternativa për zgjidhje, ato ngelen enigmatike, "*Perandaj a u heth vëllezërve t'im një enigma, shohim kush do ta zgjithe*"[251]. Kjo zgjidhje mungon, sepse bashkëjetesa e dy popujve me një të kaluar historike konfliktuale dhe kultura të ndryshme, të themeluara që në gjenezën e tyre etimologjikisht të ndryshme dhe të kundërta në planin fetar dhe religjoz është e pamundur.

Kjo është problematika që parashtron Noli dhe sendërton një subjekt ngjarjesh duke i vendosur ato në një nga epokat me të hershme të historisë së njerëzimit, nga më të studiuarat dhe më të diskutuara për zgjidhje të mundshme për shkak një konfliktit të përhershëm mes izraelitëve dhe filistinëve. Dy popuj, që ndajnë të njëjtën hapesirë territorialo-kufitare, që janë kaq afër, por njëkohësisht kaq larg. Sipas legjendës biblike hebraike rreth tre mijë vjet më parë filistinët pushtuan brigjet fushore të Mesdheut(ardhur nga territore që sot janë të Greqisë), ndërsa izraelitët kontrollonin kodrat në brendësi.

Një bashkëkzistencë e tyre, nëse mund të quhet si e tillë duhet te karakterizohej nga një marredhënie miqësore, bashkëpunimi dhe ndërshkëmbimi kulturor, ku dy kulturat, integrohen tek njëra-tjetra, pa forcën imponuese të demagogjisë fetare. Kjo duhet të ishte një marredhënie që aspiron një frymë paqeje, harmonie dhe lirie. Por ajo që zbulojmë përmes kësaj drame është që dy popuj me dy kultura të ndryshme, jo vetëm

[250] Fan S. Noli, Vepra 1, Tiranë, 2003, f236-237

[251] Fan S. Noli, Vepra 1, Tiranë, 2003, f236-237

që s'mund të kenë një bashkëkzistencë, por kjo e fundit derivon në një konflikt etniko-ekzistencial, fetar, kulturor dhe territorial (interpretimi në planin social).

Imponimi i kulturës superiore"[252] shkakton gjithmonë një dyzim idesh, që metamorfozohen në një konflikt të pashmangshëm tragjik mes dy popujve. Ajo mbart dhe përfaqëson vlerat etnike dhe kombëtare të një populli, te kultivuara përgjate gjithe historisë dhe kjo e bën të pamundur asimilimin e tyre. Ideja që përcjell Noli përmes kësaj vepre është se s'ka kultura superiore dhe minore, që kultivohen në një terren paqeje, sepse çdo culture ka frymëmarrjen e saj organike, e cila mund të jetë mbytëse për një popull tjetër në kushtet e detyrimit apo imponimit. Pushteti është superior dhe tenton të nënshtrojë ideologjinë dhe forcën e tij duke të nënvlerësuar atë, që qëndron në shkallët e mëposhtme të hierarkisë dhe kjo nuk aspiron as civilizim dhe as demokraci shoqërore.

Sipas legjendës Samsoni ishte martuar me një grua filistine dhe kishte në mënyrë të vazhdueshme konflikte me ta, para se ta çonin të verbuar dhe ta lidhnin në tempullin e tyre në Gazë. Atje sipas historisë ai arriti të çlirohej, duke shembur të dy shtyllat, ku e kishin lidhur, duke rrëzuar tempullin dhe duke marrë me vete gjithçka. Noli i qëndron besnik legjendës, sepse çdo element i historisë së saj perfaqëson një ide apo mesazh brenda dramës së tij.

Samsoni një udhëheqës izraelit që zotëronte një forcë"[253] fizike të jashtëzakonshme gati hyjnore, të fshehur te flokët, të cilat simbolizojnë pushtetin dhe forcën noliane, si çdo cilësi njerëzore, që nuk është e përjetshme, edhe ato e kishin sekretin e tyre, "thembrën akilianë", gjë që do ta shfrytëzojnë zgjuarsisht filistinët. Si çdo qënie njerëzore Samsoni zotëronte forcën shpirtërore, që në vepër perfaqësohet nga dashuria, e cila tek ai shfaqet në dy forma: si një përkushtim dhe devocion ndaj kultit të religjonit, si një formë adhurimi për Të Vërtetën Hyjnore dhe si dashuria më tunduese, ajo erotike e dyzuar dhe e ushqyer për dy objekte femërore. Naivisht ai mendonte se çelësi i triumfit të tij ishte kjo force shpirtërore dhe pushteti i së Vërtetës, mjeti për ta arritur atë ishin fjalët dhe për t'u mbrojtur nga filistinët ishin flokët,, fuqinë e të cilave ai fillimisht nuk donte ta përdorte, sepse ishte kundër dhunës, duke besuar idealisht në forcën e fjalës.

Edhe dy dashuritë e tij janë simbolikisht dy anë të kundërta të së njëjtës medalje, të shpirtit dhe mendjes të autorit: Dalila pasqyron "mollën e ndaluar" shpirtin, anën njerëzore, mëkatin, pas të cilit fshihen tradhtia ndëshkuese"[254]. Historia ka treguar se udheheqës të mëdhenj, janë tradhëtuar fatalisht nga njerëzit të cilët ikonsideronin si

[252]*"Mësuam se do të dërgoni Samsoni-ne me ushteri nër viset tonë dhe do te na bëni me pahir me fenët'uaj"*Fan S. Noli, Vepra 1, Tiranë, 2003, f 202

[253]"*Po tani erdhi ora e shpëtimit përta. Samsoni që Perëndija i fali fuqi shpirti e trupi të sipernjerishme, pasi të marrë uratën e gjithë gjindjesë, i fortë prej perëndie dhe prej dashurie, do të muntnje t'ua qëndrojë forcën e pambajtur pas Gënjeshtres*", Fan S. Noli, Vepra 1, Tiranë, 2003, f191

[254]"*Rahil, s'e kasha atë fuqi t'a linja këtë botë që m'i mori sytë që m'a mori fuqinë, që m'i prishi gjith'ëndërrat e mia*"Fan S. Noli, Vepra 1, Tiranë, 2003, f230

më të dashurit, por që në të vertetë pas dashurisë fshiheshin plane intrigante dhe ambicioze. Kjo i bënte ata viktima të besimit te tyre naiv dhe të verbër. Dalila e josh Samsonin, e tërheq në vorbullën e pasionit dhe e shkatërron atë"[255]. Prandaj ajo përfaqëson"kalin trojan"ndërsa dashuria e Samsonit "muret e Trojes", që fatalisht dhe tragjikisht robërohen dhe rrëzohen nga kjo dobësi. Samsoni,, pra shfaqet shumë njerëzor prej gjaku dhe mishi dhe pse zotëron një forcë të jashtëzakonshme. Peshorja shkon sërish drejt idealit, në fund të dramës duke i shkuar deri në fund misionit të tij dhe pse ai nuk përmbushet ashtu si e kishte planifikuar, Samsoni. Prandaj kjo dramë mund të merret edhe si një interpretim i konfliktit mendje-ndjenjë, trup-shpirt apo ideal-pasion.

Rahila është ndërgjegja e tij, arsyeja njerëzore, e sublimuar në virtyt, shpërblimi i të cilit i fal asaj jetën. Prandaj ajo shëmbëllen në vepër si një formë e puritanizmit dhe pastërtisë"[256] hyjnore. Ajo përfaqëson të vertetën hyjnore, pasionin dhe besnikërinë hyjnore, të vetmen rrugë, që duhet të ndiqte Samsoni, Por natyra e qënies njerëzore gjithmonë tundohet nga forca tërheqëse e të ndaluarës dhe të paprekshmes, sepse njeriu kërkon atë që s'e ka dhe atë s'mund ta ketë, por që e dëshiron më shumë se gjithçka. Prandaj historia e Samsonit zbulon vetë thelbin, natyrën e qenies njerëzore.

Samsoni zgjedh sërish të dëgjojë shpirtin, zemrën mëkatare dhe joshëse, e cila e ndëshkon dhe që nëvepër simbolikisht Noli e jep me verbimin"[257] e tij. Ai s'mund të shikonte më dritën e arsyes, sepse u verbua nga pasioni infernial i dashurisë, një zgjedhje kjo tunduese dhe njerëzore. Ajo që ai mendonte se ishte një ndjenjë e vërtetë, doli zhgënjimi më imadh. Pabesia fatale dhe mirësia, që ai shikonte te e dashura e tij ishte fatkeqësia dhe dështimi tij. Kjo ëndërr dashurie u kthye në një realitet të dhimbshëm dhe tragjik. Samsoni zgjedh vetëndëshkimin"[258] si të vetmen rrugëzgjidhje drejt fundit të misionit të tij. Ideali i tij. Dhe pse nuk dryshoi, misioni i tij përfundon këtu me shembjen e tempullit filistin dhe fundin tragjik të gjithë filistinëve"[259].

Samsoni është një udhëheqës, një lider qe udhëhiqet nga E Verteta"[260] një tjetër simbol i fuqishëm në veprën e tij, e cila përfaqëson ideologjikisht mendimin dhe

---

[255]"*Shëko dielli perëndon. Perse moj Dalile, dielli perëndoi sot kaq shpejt? Gjë e keqe do të ndodhë sot. shëko. Natyra u herr rrotull. Nata dhe misteri bashkohen që të me shpien në pelqit t'ënt*" Fan S. Noli, Vepra 1, Tiranë, 2003, f218

[256]"*Ky mundim është për shpirtin me i ëmbeli nga te gjithe gëzimet. C'është me e ëmbël, se të vuanjësh dhe të mundohesh për të mirën e të tjereve? Rahila*" Fan S. Noli, Vepra 1, Tiranë, 2003, f227

[257]"*Pas pak orësh do të jesh i verbër dhe mua munt të më gëzonet vëtem ay që i ka të shëndosha syt'e trupit –dalila*"Fan S. Noli, Vepra 1, Tiranë, 2003,

[258]*Dhe tani filistinë, shoke, bëjuni gati të vdesim qafe për qafe*, Fan S. Noli, Vepra 1, Tiranë, 2003,

[259]"*Në Botë secili që hin/Debirete, dëbiret shkret / Fuqija e shpirtit i shkrin / Dhe dashja e mirë humbet*" Fan S. Noli, Vepra 1, Tiranë, 2003, f235

[260]"*Perëndia na dha shpirtin si udhë-heqës të rrojtjes së Vërtetë dhe zemrën si rufjan te se Gënjeshtërmes. Ne vafshin pas zemres, prishemi, ne vafshim pas shpirtit do bierim udhën e*

botëkuptimin e një udhëheqësi. Në misionin e tij ai fliste në emër të saj, duke urryer dhe luftuar të Gënjeshtrën dhe kjo përfaqësonte synimin dhe idealin e tij. Ai mbron dhe flet në emër të së Vërtetës"[261], e cila qëndron përballë të Gënjeshtrës, përgjate gjithë konfliktit, por kjo është e Vërteta"[262], që ai beson dhe adhuron, por jo e vërteta sublime, jo e vërteta absolute, e besueshme nga të gjithë, prandaj dhe ajo kthehet në armikun më të madh për filistinët (interpretimi në planin etik).

Atij i mungonte forca oratorike e bindjes dhe mendjes. Të qenit udhëheqës duhet t'i atribosh vetes disa cilësi, të cilat të sigurojnë suksesin e të qenit i tillë dhe Samsoni ishte një udheheqës izraelit dhe jo filistin, sepse së pari ai s'kishte origijnë filistinë dhe nuk zotëronte përkrahjen dhe simpatinë e tyre. Së dyti një individ përballë një shumësie, një auditori të tillë, në të tilla kushte, gjithmonë dështon nëse nuk zotëron "magjinë" oratorike dhe bindëse te fjalës. Ai s'mundi të shkulte rrënjët mijëvjecare të kulturës filistine, prandaj një udhëheqës itillë më shumë shpirtëror sesa mendor s'mund të çojë në një evazion kulturor, sepse kjo gjë do te çonte në asimilimin e një populli, nje kombi, një gjuhe, kulture dhe historie. Kjo gjë justifikon reagimin filistin dhe zgjidhjen tragjike të konfliktit të dramës(interpretimi në planin politik).

Me protagonistin mund të identifikohet vetë autori si një udhëheqës politik dhe shpirtëror. Misioni i Samsonit mund të përfaqësojë misionin nolian për çështjen kombëtare, kurse "muret mbrojtëse" filistine përfaqësojne dilemat, sfidat, vështirësitë dhe dritë-hijet e rrugëtimit të tij historiko-politik. Mund të themi se Noli si një udhëheqës shpirtëror dhe politik i shqiptarëve mund të identifikohet me Samsonin në pajtueshmëri me të gjitha kontributin në ngjarjet e viteve 20'-30'. Me personazhin e tij, ai përcjell vizionin dhe pikëpamjet e tij, që e shoqëruan atë përgjatë gjithë karrierës së tij politike dhe fetare.

Në aspektin fetar kjo dramë mund të interpretohet si një vepër, që ngre temën e përplasjes së dy ideologjive dhe kulturave fetare, jo vetëm të ndryshme, por dhe përjashtuese, të cilat s'mund të integrohen te njëra–tjetra dhe që përplasja e tyre çon pashmangshmërisht drejt një lufte"[263] etniko-ekzistenciale. Ky konflikt është edhe zanafilla e kësaj lufte" të përhershme" dhe historia ka treguar jo pak të tilla, që janë bërë në emër të saj, apo duke valvitur flamujt e epërsisë fetare dhe territoriale, prandaj përmes kësaj vepre Noli përcjell mesazhin e respektit të ndërsjelltë mes feve të

---

qëllimit të rrojtjes. cili katë drejte? Asnjë. Me i lumturi është ay që s'merr vesh fare nga kjo dylemë e frikshme"Fan S. Noli, Vepra 1, Tiranë, 2003, f 212

[261]"*Njeriu lind me të vërtetë dhe vdes me të vërtetë*" Fan S. Noli, Vepra 1, Tiranë, 2003, f197

[262]"*Neve të gjithë e dimë të vërtetën dhe do t'ia mësojme botës*", Fan S. Noli, Vepra 1, Tiranë, 2003, f199

[263]"*Do mundojmë nuk për të parën here marrëzinë e israelit të mallëkuar që përpiqet kurdohere tëna impozojë fen e tij. pra kush na shiguron se fej'është me e vërtetë nga jona*", Fan S. Noli, Vepra 1, Tiranë, 2003,

ndryshme si dhe frymën tolerante, që duhet të karakterizojë marrëdhënien e tyre, si një tregues i qytetarisë dhe emancipimit.

Mesazhi që përcjell vepra është domethënës dhe universal, duke nxjerrë në dukje pamjen civilizuese dhe demokratike të Nolit në aspektin kulturor dhe social.

Prof. dr. YMER ÇIRAKU

NJË LETËR E KRIST MALOKIT DHE (AUTO)BIOGRAFIA E NOLIT

Në vitin 1958, në prag të Krishtlindjeve, Krist Maloki, që nga Graci i Austrisë, ku jetonte prej vitesh, i niste një letër Fan Nolit në Amerikë. Nga shtjellimi i saj, marrim vesh se deri në këtë moment, ata nuk kanë patur kurrë ndonjë rast njohjeje a komunikimi të drejtpërdrejtë mes tyre. Pas shpalosjes së kortezisë të stilit ala aristokrat – pra, të marrjes së guximit për t`iu drejtuar *mjeshtrit* (Nolit), dhe pasi i bën modestësisht prezantimin e personit të vet, letërshkruesi i drejton atij me *përvuejtni* një kërkesë: Të ulet e të shkruajë biografinë e tij (!) **1)**Në fakt, rezulton se Noli e shkroi *(Auto)biografinë*, të titulluar *Skicë biografike e mitropolit Fan Stylian Nolit*, përfshirë tek libri *"Historia e Kishës Ortodokse Shqiptare" (1908 – 1958)*, botuar më 1960 në Boston, në përkujtim të 50- vjetorit të kësaj kishe, e themeluar dhe drejtuar prej tij.

Shtrohet pyetja: përse e kërkonte këtë autobiografi kritiku letrar dhe vallë, botimi i mëpasëm i asaj vepre prej Nolit, të ketë marrë vërtet shkas nga kjo letër?

Në kritikat e tij të viteve `30-të, K. Maloki u shfaq si idhtar i metodave psik-analitike e biografike në studimin e veprave letrare shqipe, metoda këto që në fakt ishin mjaft qarkulluese kësaj kohe në Europë. Këto metoda u panë të aplikoheshin sidomos në dy studimet e tij të gjera e që patën mjaft jehonë, konkretisht në ato mbi Naim Frashërin e Lasgush Poradecin. **2)** Tek poezia e tyre ai shihte të modeluara e të tretura artistikisht jo pak situata nga jeta e tyre personale, si p. sh. humbjen e nënës tek Naimi (që ka sjellë si kompensim të saj portretin sublimues e njëherazi mjaft mallëngjyes të nënës së Skënderbeut, Vojsavës), apo karakterin *hipokondriak* dhe staturën fizike tek Lasgushi, që sipas kritikut, nxiti shpesh bohemizmin dhe endjen e poezisë nëpër motive metafizike e ndonjëherë dhe mistike… Në kritikat e tij, studiuesi priret nga gërshetimi i metodave biografike (genetike) me ato të natyrës psikologjike dhe për këtë, e ndien të nevojshme shfrytëzimin e autobiografisë së shkrimtarit, të letërkëmbimeve të tij, të biografisë e kujtimeve të shkruara nga të tjerët mbi të, të dorëshkrimeve, fotove, statujave, që sjellin dhe nga aspekte grafologjie e frenologjie sugjerime mbi leximin e teksteve të tyre letrare.

Në këtë letër, sado me një ton të përmbajtur propozues, vijnë disa piketa, pak a shumë përcaktuese, se ku duhet të përqendrohet kjo biografi e Nolit. *Si psikolog dhe pedagog i zanatit*, i shkruan Maloki, *preferoj vet ma fort studjime dhe paraqitje kritike – letrare simbas methodash genetike, ku mund të nxirren kuptime dhe spjegime të veprave artistike qysh nga lëvizjet e para shpirtnore t`autorit mbrenda kohës së fëminisë dhe djalëris. E pra, shka më mungon rreth paraqitjes së kompleksit fan-oljan asht njajo biografi qysh nga lindja dhe deri në vjetin 1906 a 1908, deri sa keni shkelë për të parën herë në tokën egjypcjane…*

Nga pyetja e shtruar më sipër, se, nëse vërtet kjo letër e nxiti apo e kujtoi Nolin të shkruante biografinë e vet, mund të arrijmë në mendimin se, mes letrës së kritikut e

biografisë së shkrimtarit, ka lidhje jo pak të dukshme. Që në hyrje të librit, ku përfshihet Autobiografia e Nolit, sqarohet nga kompiluesi, pra nga përgatitësi, do të thotë nga vet Noli, se ky libër duhej dashur të botohej më 1958, në përvjetorin e Kishës Ortodokse Shqiptare në Amerikë, por u vonua se përgatitja e materialit mori më se dy vjet kohë dhe për këtë vonesë i kërkohej ndjesë *përunjësisht* lexuesit, me bindjen se ai lexues do të shpërblehej me botimin e një vepre disi të rrallë në literaturën shqipe. **3)** Pra, me sa duket, Nolit i kishte hyrë dëshira (*xanxa)* nga letra e vitit 1958, të ardhur nga Graci i Austrisë, që ta shkruante doemos biografinë e tij dhe ta bënte kështu pjesë të librit, duke qënë i ndërgjegjshëm për dimensionin që kishte fituar figura e tij në botën shqiptare. E kjo vepër kërkonte doemos kohën e vet për ta shkruar, prandaj shtyhemi të besojmë përse rezulton të jetë krijuar dhe ajo vonesë gati 2- vjeçare e botimit të librit, ndonëse e spieguar nga autori me *alibinë* e rastit.

Edhe pjesa tjetër e parathënies, ku shënohet se biografia e mitropolit Nolit është pak a shumë e hollësishme nga viti 1882 e deri më 1908, dhe pothuaj mbetet e skicuar pas kësaj kohe, nuk mund të shihet e shkëputur nga sugjerimi i asaj letre të Malokit, ku biografia kërkohej të fokusohej, as më shumë e as më pak, por pikërisht në këtë hark kohor. Dhe për të siguruar mirëkuptimin me lexuesin e vet, kompiluesi, pra vet Noli, i mistifikuar pas këtij emërtimi të rutinës editoriale, bën një mistifikim tjetër, duke sqaruar se u zgjodh kjo skemë shkrimi pasi *madhësia e këtij libri nuk lejoi një biografi të plotë…*(po aty)

Duke ndjekur shkrimin e biografisë nëpër këtë kalendar të jetës së tij, nga fëmijëria e deri në kohën e mbërritjes në kontinentin e ri, në Amerikë, të sugjeruar apo të kujtuar dhe nga letra e Krist Malokit, në fakt Nolit, kjo i vinte dhe më mirë për shtat. Të mos harrojmë se vitet e mëpasme të jetës së tij, janë të lidhura me ngjarje dhe aktivitete të mprehta të natyrës politike, shtetërore, publicistike, fetare, me marëdhënie shpesh të ndërlikuara mes personazheve të kohës, dhe, duke qënë të afërta në kohë, ato mund të krijonin keqkuptime e të rinisnin debate e polemika të nxehta me ta, aq të shpeshta dikur, por që kësaj kohe, Noli tanimë në pleqëri, nuk preferonte t`i ndiqte më, sepse siç thoshte shpesh me humorin e tij të mençur e gjithë kripë: *tashmë e kishte hequr nga brezi këllëçin e politikës dhe e kishte varur në muze…*

Në letrën e tij, Krist Maloki sugjeronte gjithashtu që biografia e shkrimtarit të ishte *një jetëshkrim a jetë-përshkrim ma fort si një "confessio" se sa kohëshkroje e thatë…* Dhe Noli zgjodhi të flasë për veten, pikërisht modelin e biografisë në vetën e tretë, që së jashtmi, e distanconte autorin nga personazhi për të cilin rrëfehej, i cili ishte po vetja e tij, por që ndërkaq, ia shtonte (potenconte) atij mundësinë, për t`u zhytur lirshëm në ujëra realë e fiksionalë të jetëshkrimit, me të drejtën e autorit të *gjithëdijshëm.* Dhe kësisoj, vepra shkarkohej nga paraqitja e thatë e rrjedhës së ngjarjeve të personazhit, sikundër i ishte kujtuar në letrën nga kritiku. Me të drejtë është hedhur teza se veta e tretë e rrëfimit është në harmoni dhe me pozitën e luhatshme të identifikimit të autorit (që është rrëfyes dhe personazh): mes prijësit dhe të përvuajturit (robit të zotit) Duke u endur në këto dy pole identifikues, vepra mbart tipare dykahëshe, që kthehen në potenca të kombinuara e për pasojë, të fortifikuara si vlera. **4)**

Duke e shqyrtuar këtë vepër të Nolit nga pikëpamja e klasifikimit të modelit të tij tekstor, mund të shtrohet pyetja: a kemi të bëjmë me një *biografi* apo *autobiografi*?

Përpara se t`i japim përgjigje se kujt llojit zhanror i përket kjo vepër, duhet kujtuar se autobiografinë nuk e shënjon domosdoshmërisht si të tillë vetëm *veta e parë* e rrëfimit. Ky rrëfim mund të jetë dhe në invers, në vetën e tretë, në ato raste kur identifikohet autori me narratorin e personazhin, siç është rasti i kësaj vepre të Nolit, ku *rrëfimi autodiegjetik* mbetet qartësisht i nënkuptuar, duke dëshmuar se në thelb kemi të bëjmë veç me një autobiografi, ndonëse të mistifikuar së jashtmi. **5)**

Në mbyllje, mund të themi se kemi një rast të rrallë në historishkrimin letrar në shqip, kur një letër e kritikut, nxit krijimin e një vepre të shkrimtarit, siç është rasti i Krist Malokit me Fan Nolin. E zakonshmja është ajo, që shkrimtari krijon letërsinë e tij, dhe kritiku ka për mision vlerësimin e pavarur të saj. Kurse në këtë rast, në inversin e rregullit, kritiku ka projektuar atë që duhej të realizonte shkrimtari, e që pastaj, ta shfrytëzonte për metodikat e tij studimore. Vërehet se shkrimtari e modeloi këtë vepër pothuaj në simetri me sugjerimet e propozuara, aq sa kjo simetri shkon deri dhe në shprehjet skofiare përmbyllëse të letrës së kritikut drejtuar mjeshtrit: *me përvuejtëni*, dhe të parathënies së Nolit drejtuar lexuesit: *përunjësisht*, që kanë të njëjtin objekt referencial: botimin e (Auto)biografisë.

Vërtet të ketë qënë kaq bindës Maloki dhe aq i bindur Noli! ? Më shumë se me spjegim të natyrës hierarkike apo autoritariste të raporteve që mund të ekzistojnë përgjithësisht mes kritikut e shkrimtarit, kjo duhet parë në interesin që ka pasur secili në zgjedhjen e ofruar dhe pastaj të realizuar. Nolit i erdhi për mbarë të gjente atë strukturë rrëfimore, që e shkarkonte nga përgjegjësia e referencave të biografive klasike skrupuloze, për të pasur kështu mundësi të shkruante një biografi të lirshme, që t`u linte hapësirë impresioneve e fantazisë së kujtimeve të largëta, pra, një vepër, që të kishte të vërteta historike, por dhe tharmin letrar, me interes për t`u lexuar e për të mbritur tek e fundit, tek ajo që thotë Kadare, se shkrimtari në tekstet e tij bën marrëveshje vetëm me letërsinë, pra, krijon një realitet paralel me atë të drejtpërdrejtin e shoqërisë, por që nuk identifikohet kurrsesi me të, se ndryshe ajo letërsi do të humbte ekzistencën. **6)**

Po kritiku Krist Maloki, çfarë arriti të shfrytëzojë për interest e veta studimore nga kjo vepër, që mezi ç`pritej prej tij të botohej? Kjo sot për sot nuk mundet të dihet, mbetet enigmë. Ka të dhëna se ai ka patur në dorëshkrim mjaft studime për Konicën, Naimin, Migjenin, Nolin dhe autorë të tjerë, por në rrethanat e jetës së tij të izoluar në Austri dhe me humbjen e shikimit viteve të fundit, deri sa mbylli sytë më 1972, ato nuk po japin ende shenja komunikimi me lexuesin e sotëm. **7)** Gjithsesi, kritiku letrar, që ndonjëherë nga furia e shkrimeve të veta, aq të njohura e të debatuara të viteve `30, ishte quajtur idhtar i kritikës të ashtuquajtur *eliminuese*, ia mbërriti të zgjojë nga gjumi një *bukuroshe të fjetur*, si mund të thoshim në këtë rast, pra, të rizgjojë kujtimet e largëta të Nolit e ta nxisë atë për botimin e një vepre të re, të biografisë së tij.

Kjo letër e K. Malokit ia vlen të kujtohet si rast i veçantë i një kritiku, që kësaj here, nuk shqyrtoi një vepër, por nxiti krijimin e saj.

Dr. ZEJNEPE ALILI – REXHEPI

SIMBOLIKA POETIKE E NOLIT SI "FRYMË E KOHËS" APO TENDENCË MËSE MODERNE

Poezia e Fan S. Nolit sendërtohet mbi një filozofi të vargëzuar që shpreh imazhin e jetës, kohës, së vërtetës... Vetë ëndërrimi i poetit ndërmjetësohet nga aftësia për të strukturuar disa ngjarje, prirje kjo e *poetëve vigjilentë* që tentojnë të zgjojnë *simbolet e koshiencës kolektive të depozituara në kujtesën njerëzore.*

Frymëzimi poetik i Nolit bëhet dëshmitar i një drame të madhe, të përpjekjeve për të ruajtur dinjitetin dhe identitetetin kombëtar, për faktin se *shpirti i një populli pasqyrohet në poezinë e tij më mirë se në çdo formë tjetër.* Ajo ka konstitucionin e vet shpirtëror, e mban vulën e kohës së poetit dhe shpreh identitetin e vet social e historik, duke dhënë një kuadër të përshtatshëm të rrethanave shoqërore.

Figura prej eruditi e Fan Nolit, pa dyshim, ndërtohet në më shumë sfera të artit…, por atë si personalitet e madhështon pikërisht poezia, ndonëse nga kritikët letrarë çmohet lart edhe si dramaturg, orator, publicist, përkthyes, kritik letrar, klerik, historian muzikolog, politikan e burrë shteti. *Miqtë e tij të pandarë do të ishin librat, partiturat, gjuhët, kujtimet (N. Jorgaqi).* Me tërë këtë begati e gërshetim njohurish, për të, me të drejtë thuhet se është *institucion i një kulture!* [*]

I yshtur nga ngjarjet e kohës së tij (shek. XX), Noli me guximin e një *kryeneçi* jep kushtrimin e zgjimit të popullit nga përgjumja. Kjo mbase është arsyeja më e fuqishme që edhe në 130- vjetorin e lindjes së shkrimtarit, e në prag të 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë - çështje për të cilën u përkushtua Noli, bashkëkohësit e tij dhe sigurisht tërë brezi i shkrimtarëve të Rilindjes Kombëtare, ai vazhdon të trajtohet si poet tejet origjinal në tematikë e ide, me simbolikë të qëlluar që formësohet përmes një sintakse të pasur poetike.

Ndjenja atdhetare e poetit të mërguar

Poezitë e Nolit e manifestojnë ndjesinë e poetit për atdheun, ku përvijohen pamje jetësore, të sjellura me mprehtësi mendimi, sepse: *njeriu bëhet poet, atëherë kur është në gjendje ta thotë atë që do dhe që duhet të thotë*, më bie ndër mend shprehja e Stendal-it.

Me sukses Noli provoi të sajonte poezinë me vlerë, krijoi art të bukur prej një realiteti të shëmtuar, një përditshmërie banale. Lëngata e tij shpirtërore ngrihet në një rebelim. Simbolika e mallit të përjetshëm për rikthimin në atdhe, atje ku edhe *balta është më e ëmbël se mjalta* dhe këtë peng e përjetuan edhe rilindës të tjerë, si: J. De Rada, P. Vasa, Naimi e vëllezërit e tjerë Frashëri, Asdreni, A. Z. Çajupi, F. Konica... Po, tërë qenia e tyre e përjetoi mërgatën e hidhur! Përmes një relacioni ndërstilistik, poezia e Nolit shpreh mall dhe brengë, siç përvijon M. Kuteli, në poezinë *Një dialog i përmallshëm*: *Jo një herë në dhe të largët më pat zënë malli për vjershat e Fan Nolit.*

[*] Shprehje e përdorur nga kritiku letrar, Rexhep Qosja.

Malli i atdheut, në vargjet e Nolit, hove - hove, trazon dhembje e shpresë apo siç pohon E. Çabej: *dëshira për shtegtim dhe malli i tokës bashkohen te karakteri shqiptar në mënyrë të çuditshme*. [264] Po rebelimi që e mban peng poetin larg atdheut, sa vjen e rritet... E dilema vazhdon: mos vallë vetë *Poezija asht nji kryengritje? !*

Poezia atdhetare, refleksive, filozofike, të pleksura në simbolika të fuqishme idesh, e jetësojnë lirikën e Nolit, ku gërsheton përjetimet në atdhe dhe veprimet aktive të tij prej njeriu vizionar. Estetikën poetike e karakterizon *kulti i fjalës*, gjë që e shpreh me përzgjedhjen gjuhësore e artistike. Figurën e tij poliedrike, si poet me talent e shije të hollë, dije e kulturë të gjerë, e madhështon sensi atdhetar dhe vlera antologjike e poezive. Polemikat, argumentet dhe logjika noliane janë të pathyeshme. Ai nuk qe krijues hyjnizimesh e kompromisesh, synonte të vërtetën.

Me poezinë *Hymni i Flamurit*, hapet sipari i *Albumit*, ku Noli e afirmon fuqishëm konceptin e poezisë atdhetare, sakrificën pa fund në të mirë të atdheut, kur thotë: *O Flamur gjak, o flamur shkabë, /O vënd e vatr' o nën' e babë, /Lagur me lot, djegur me flagë, Flamur i kuq, flamur i zi.* [265] Përshkrimi i flamurit, në imazhin e poetit dhe gjithsecilit është simbol i madhështisë, është vetë pararoja shpirtërore e vlerave kombëtare.

Forca e kësaj poezie shëmbëllen me modelin barletian, që ndër shekuj mbetet udhërrëfyes i portretizimit të një heroi kombëtar. Edhe kjo poezi, mbetet për më shumë se një shekull si kushtrim për liri, që vjen pas një përgjumje e letargjie të popullit, ku të tjerë krijues, si Asdreni me poezinë "*Betimi mi flamur"*, Lasgushi me "*Marshi i djalërisë"*, gjejnë modelin - simbol të poezisë atdhetare. Flamuri - simbol i atdhetarizmit në tërë brezin nolian, e bën të pashmangshëm mallin, revoltën, dhembjen, idealin... , që e harkojnë përshkrimin e atdheut edhe në poezitë e tjera.

Kritikët letrarë, Nolin e cilësojnë si mjeshtër të poezisë shqiptare, meqenëse lirikat e tij pleksen nga forca emocionale dhe sajesa të rëndësishme artistike. Si më të mira shquhen poezitë antologjike: *Anës lumenjve dhe Rent, or Marathonomak!* .

Rrëfimi dramatik i Nolit, i latuar nga përkthimet e shumta të letërsisë evropiane, simbolika e gjetur dhe gjallëria e ritmit, na zbarkon në poezinë *Rent, or Marathonomak*, ku djaloshi lajmëtar, vjen si inkarnim i largët i Marathonomakut legjendar, i cili ndonëse bie për liri, e fiton përjetësinë. Në vargjet: *Rent kudo, dyke bërtitur, /Nëpër shekuj faqe-ndritur, /Se i vogli shtrin viganin/Dhe i shtypuri tiranin, /Veç e tok, /Tok, or Marathonomak!* [266] sikur shpërthen shpirti poetik dhe vjen çasti kulmor, përkujtesë kjo, të cilën autori e plotëson me figuracionin poetik që poezisë i jep origjinalitetin tejkohor.

Poezia *Rent or marathonomak* sendërtohet asisoj sa e rrit intensitetin emocional dhe kuptimor, e me këtë mbetet poezi me vlera të larta ideore e artistike, që në esencë e përcakton atmosferën përshkruese të Shqipërisë, atëbotë. Karakteri i antikitetit përmes Marathonomakut, i tejkalon sfidat e shekujve dhe me kumtin që duhet të përcjellë i mbetet besnik aktualitetit të çdo kohe. Pra, kumti i fitores, kumti i lirisë bëhet

[264] Ernest Koliqi, *Kritikë dhe estetikë*, "Apollonia", Tiranë, 1999, f. 288.
[265] Fan S. Noli, *VEPRA* - 1, "Rilindja", Prishtinë, 1988, f. 73.
[266] Po aty, f. 101 – 103.

ndërlidhës, jo vetëm i mesazheve, por edhe i përpjekjeve e sfidave analoge, ku thellësisht ndihet fryma e realizmit lirik, e këtij *Demiurgu të shqipes.*

Universi poetik i Nolit është i thellë, me akte të ndjesisë e përjetimit, herë si poezi të ngritura mbi imazhin e Kalit të Trojës, herë me vizionin e çiltërsisë për rizgjimin e *etnitetit arkaik si fond primordial i popullit të vet.* [267] Simbolika e dramës sonë kolektive vjen si ngjizje e vetë fatit jetësor dhe ngjarjeve historike. Individualiteti krijues, i pasur në gjuhë e i begatshëm në figura e mjete stilistike, jep frymën poetike noliane edhe përtej kohës së shkrimtarit. Si sintezë ngjarjesh historike e sfidash politiko-shoqërore, vargu i tij është buçitës, jehonëbërës, me intonacione të theksuara e të përshtatshme me idenë dhe mesazhin e autorit. Si poet i frymëzimit kombëtar, shoqëror e politik, Noli qëndron ndjeshëm lidhur për tokën dhe nuk lejon që shpirti i tij të arratiset andrrallave të kota.

Poezia si kronikë autobiografike

Poezia e Nolit, ndonëse shpreh një realitet të hidhur, për kah natyra e tekstit vjen si pleksje frymëzimesh përshkruese, emocionale e dramatike, andaj rezulton si poezi dramatike. Duke mos e honepsur fenomenin e *konvertimit politik*, simbolika e poezisë së tij ka fuqinë e papushtueshmërisë.

Noli e vendos vargun poetik mbi një sistem figurash / simbolesh, ku ndërthuret, *jo mitologjia si diskurs personal, po diskursi personal si mitologji*[268] me ç'rast, poezia e Nolit universalizohet; shenja autobiografike mbetet në status interteksti dhe të shpie tek autori vetëm po e identifikove d. m. th po e zbërtheve. Në vend që diskursi mitik (biblik) ta *rrezikojë* diskursin personal, është diskursi personal që e *rrezikon* atë. [269] Me këtë, poezia e Nolit të vë përballë kërkimit të gjenezës së tekstit poetik, idesë, motivimit, pra i ndërlidhjes me jetën e autorit. Natyrisht, këtyre u shtohet tipologjia e poezisë e një niveli krahasimtar të kërkimit, si *niveli dialogjik* dhe *relacioni komentues* përmes një artikulimi shprehjesh metaforike.

Një procedim të këtillë hasim në poezitë: *Marshi i Krishtit, Krishti me kamçikun, Shën Pjetri në mangall, Marshi i Barabbajt, Marshi i kryqëzimit, Kirenari, Kryqësimi*, përmes të cilave, Fan Noli e afroi vjershërimin me vegjëlinë, por pa u shkëputur dot prej *heroit masë.* [270] Në këto poezi, të sajuara mbi *pathosin* e ngjarjeve biblike, Bibla shërben si *gramatikë e domosdoshme e arketipeve letrare.*

Poezitë e këtij motivi sillen rreth boshtit simbolik-Jezu Krishtit, me çka edhe hapet cikli me poezinë *Marshi i Krishtit*, e pasuar nga *Krishti me kamçikun*, si një *epigraf* i Krishtit, kësaj figure biblike që së bashku me poetin, pafajësisht të dënuar bien në grrackën e *Ferrit*. Pa dyshim, në to rezulton si frymë analoge, fati i *Krishtit* dhe i *Poetit*.

Në të vërtetë, simbolika e një mendimi të dendur poetik, vjen në shprehje me përshkrimin e figurave të njohura biblike: Jezu Krishti, Shën Pjetri, Barabbaj,

[267] Luan Topçiu, *Përmasa moderne në letërsinë shqipe*, Shkup, 2001, f. 97.
[268] Kujtim M. Shala, *Shekulli i letërsisë shqipe*, Tiranë, 2004, f. 164.
[269] Po aty.
[270] Shaban Sinani, Kështjella e virtytit, Tiranë, 2001, f. 156.

Kirenari, kamçiku, kryqi, kryqëzimi…, por përdorimi i tyre me pretekstin e të shprehurit të ideve të autorit, e identifikojnë vetë poetin dhe njihen si *simbole personale*. [271] Poezia e Nolit është poezi simboliste, e pasur me ngjarje reale e figura të kohës, sepse në ca pjesë të shpirtit të tij regjistrohet çdo ndjenjë, çdo situatë. Figurat, si: *Prifti, Shën Pjetri, Krishti...* , rezultojnë simbole të lashta tradicionale, por që autorit i japin dorë përmes tyre të shfaq realitetin shoqëror, pra janë frymëzim i kohës, sepse me to, ai aludon në personalitete - bashkëkohës të tij. Megjithëse, I. Kadare, poezinë e cilëson si *manifestim të artikulimit në çastin e vështirësisë*, simbolet e tilla, të përdorura gjatë kohë dhe me të njëjtën tendencë a funksion janë më të kapshme e lehtë të dallueshme për gjithsecilin, madje edhe për ata që s'e njohin poezinë.

Shpërthimi lirik i disa poezive të krijon dhe mbresa pamore me Nolin si protagonist i ngjarjeve dhe proceseve shoqërore dhe nga ana tjetër, figurë madhore e botës letrare. Në poezinë "*Shën Pjetri në mangallë"*, vihet re *shembulli më klasik i përdorimit të ritmit në letërsinë shqipe*[272] mbase në to ka ndikuar edhe edukimi i poetit në sensin muzikal, përderisa në *Marshi i Barabbajt*, mbështetja në figura të antikitetit, si: Kaini, Barabbaj, Kirenari... , bëhet për të qenë sa më real në përshkrime situatash dhe për të krijuar imazhin e ndjesinë e dramës. Për të mbetur më origjinal në kohë, poeti shërbehet me fjalë turko-arabe e persiane, si: - *turfana* (persisht – i freskët, i njomë); *kaba* (turqisht – fjalërëndë, njeri i mbrapshtë); derbeder (persisht – faqezi, vagabond); gërdhu (thërrime, mbeturina), etj.

Kombinimi i këtyre fjalëve paraqet simbol në vete, por si tërësi ato shprehin ndjeshëm origjinalitetin e situatave kur është shkruar poezia. Përmes epitetesh, antitezash e veçmas ironisë pafund, poezia "*Marshi i Barabbajt"* të krijon imazhin e kohës së Ahmet Zogut, të përimtësuar deri në hollësi. Në këtë poezi, vargun e fundit të secilës strofë e përmbyll me *Hosanna, Barabba*, ku fuqishëm përmes një ironie therrëse, Noli zbraz mllefin, dhembjen dhe ironinë.

Marshi i kryqësimit është nga ato poezi të ndjeshme, autobiografike të Nolit, ku pafajësia dhe përkushtimi për të mirën e atdheut dënohet rëndë. Vargu: *Kryqësoje, Pilat, në Kalvar, Golgotha*, [273] jep rrugën e mundimshme - Kalvarin jetësor deri në Golgotë, ku akti i kryqëzimit shënon fundin e Jezu Krishtit. *Vrajeni kryengritësin e Shënjtëruar/Si katil të mallkuar, atë ka kërkuar, /Se kujtoj që pa armë na ka për të zgjuar: /Kryqësoje, Pilat, në Kalvar, Golgotha.* [274] E tërë poezia, në të vërtetë, jep efektin e marshit të të pafajshmit që bie pre e entuziazmit dhe atdhetarizmit. Po sigurisht, ironia e fatit a rrethanat e pavolitshme të Shqipërisë të kohës së Nolit, për të udhëhequr ky *Jezu e Baba – Mesi e Usta*, bënë që ky në fakt të merrte dënimin e pamerituar, kur edhe Pons Pilati, ky qeveritar romak i Judesë, ishte i hamendur gjatë dërgimit të Jezu Krishtit përpara Gjyqit fetar. Mbase, Pilati me ndjenjën e tij purteke, e pati kuptuar se *njeriu i madh nuk e ka vetëm shpirtin e vet, por edhe shpirtin e miqve të vet*. (F. Niçe).

---

[271] Zejnulla Rahmani, *Arti i poezisë,* Prishtinë, 2001, f. 131.
[272] Sulejman Mato, *Arti i të shkruarit*, Tiranë, 2002, f. 60.
[273] Fan S. Noli, *VEPRA* - 1, "Rilindja", Prishtinë, 1988, f. 91.
[274] Po aty.

Përgjithësisht, në poezinë e Nolit, heroi dhe antiheroi i dedikohen historisë njerëzore, si: Jezu Krishti, Shën Pjetri, Kirenari, Pilati, Laneti, Kaini, Barabbaj..., ngrihen dhe marrin tipare nacionale, madje vetë synimi i poetit në to, i poetit është vetëm kombëtar, pavarësisht simbolikave që përdoren në thurjen e vargut dhe krijimin e imazhit. Edhe toponimet: Izrael, Kalvar, Golgotë, Jerusalem, mbi simbolikën e të cilave ngrihet Shqipëria, ky vend trazirash, mbetet atdhe i pazëvendësueshëm për poetin. Andaj, të bën përshtypje stili poetik i Nolit që vihet përballë shprehjes: *Të mendosh me ndjenjë dhe të ndiesh me mendim* (E. Verharen). Pikërisht këto gjetje simbolesh mund të merren si premisa teorike që i shërbyen si postulate për të shtruar problemin e Heroit dhe Lirisë. Me këtë thjeshtësohet paksa ideja e pranimit të poezisë, si *funksion shoqëror i poezisë*[275] kur lexuesi pret një mesazh dhe poezia ia ofron këtë lidhje, atëherë ajo poezi pritet mirë.

Origjina e heroit që nga lashtësia lidhet me mitet, me figurat biblike, të cilat u bënë pjesë e sajimeve dhe interpretimeve letrare, artistike. Sikurse në "*Komedia hyjnore"* e D. Aligierit, në "*Parajsa e humbur"* e Xhon Miltonit, ku karakteret janë: Zoti, Satanai, Adami, Eva, Krishti, Engjujt..., edhe Noli, poezisë së tij, i dha ngjyrimin e figurave mitike, të zanafillës së njerëzimit, përmes ngjarjesh e karakteresh biblike të shpalos realitetin e hidhur. Megjithëse, *poezia e Nolit zhvillon dialog me Biblën*, [276] pavarësisht kësaj simbolike, poezia është vënë në shërbim të misionit kombëtar.

Vargu i Nolit sendërtohet midis së qeshurës ironike dhe dhembjes së thellë, antiteza të gjetura këto që e përshkojnë poezinë dhe fundja të krijojnë imazhin e vetë kontrastit jetësor-politik që përjeton. Ideali dhe zhgënjimi shoqëror i poetit, mjaft bukur përmblidhet në vargun: *njëri sy i qesh e tjetri i qan*, në poezinë *Kush je ti? ,* të B. Londos.

Vërtet F. Noli qe njeri i dilemave të mëdha: *herë Betoven e herë Khajam, Hamlet i ngrysur e Sanço hokatar*, situata këto që ia referon kohës së atëhershme, e zbërthen sindromin makbethian dhe dilemën hamletiane. Ky dyzim, plot antiteza, poezitë e Nolit i bën ndër më të adhuruarat në artin letrar.

Invazioni i simbolikave

Poezia e Nolit, dora-dorës fiton një status të paprekshëm, ngritur me autoritetin e një bote të ndjeshme, me simbole që rezistojnë edhe përtej kohës kur u shkruan vargjet. Simbolet janë sajuar asisosh sa që herë pas here krijojnë modifikime në kumtin e poezive.

Tipi i ligjërimit të këtillë poetik, Nolin e bën poet modern. Me format stilistike që i jep lirikës, e konfirmon temperamentin krijues duke e prezantuar veten si poet ajsbergian, vargu i të cilit s'është i përciptë e i varfër, gjë që e kërkon lexuesin e

[275] Tomas. S. Eliot, *Funksioni shoqëror i poezisë*, në veprën e I. Halilit, *Takim me letërsinë e huaj* - shek. XX, Tiranë, 1999, f. 68.

[276] Mirlinda Krifca – Beqiri, *Intertekstualiteti në poezinë shqipe mes dy luftërave botërore,* "Fakti", Shkup, 2005, f. 112.

vëmendshëm dhe joshjen e kritikës edhe pas një shekulli. Pra, *Ai ngrihet e zbret shekujve duke i sfiduar ato*[277].

Poezitë u krijuan me idenë e pasjes së identitetit të sotëm, me një trashëgimi të nesërme e të përjetshme, që nënkupton se *poezia është atje ku ajri pothuaj kthehet në mendim* (F. G. Lorka). Poezia e tillë i referohet lexuesit semiotik, sipas U. Ekos, sepse ky lexues është në gjendje të zbërthejë shenjat e diskursit, pra ai duhet të jetë një lexues i sprovuar.

Pavarësisht, etimologjisë së fjalës *modernitet* (nga latinishtja *modo= tani*), poezia e Nolit gjithmonë lexohet me një *tani*, jo vetëm si dedikim i kohës kur u shkrua, por edhe sot e në vazhdimësi. Poezitë "*Himni i flamurit", "Jepni për nënën", "Rent or Marathonomak"...* , me mesazhin e fuqishëm janë aktuale edhe sot, në prag të 100-vjetorit të Pavarësisë së shtetit shqiptar. Ai edhe më tej mbetet flamurtar i idealeve kombëtare, ndonëse në thelb ai ishte një *europian revolucionar*.

Natyrisht, poezinë e Nolit, nuk e bën moderne vetëm leximi e përkthimi i veprave të krijuesve botërorë, po mbi të gjitha e bën modern *parimi estetik* përballë *parimit ideologjik*. Megjithëse, i ndikuar nga kryeveprat botërore të cilat i shqipëroi, Noli përvetëson një lloj *modus* shkrimi modern. Në poezinë e tij angazhohet për një kërkim shpirtëror. Jo përmes soditjes, e njeh realitetin në harkun e përvijuar të së ardhmes dhe kjo e radhit Nolin në *vizionarët e poezisë moderne*, siç përvijon dhe poeti William Blake *koha është dhuratë e përjetësisë*.

Pavarësisht tendencave të herëpashershme për të zbehur figurën e Nolit, qoftë mbi shkrimet *plagjiate* të veprave të Konicës, siç janë disa përpjekje, qoftë poezitë e tij të cilësuara *bejte humoristike* apo *poezi ideologjike*, personaliteti i këtij poeti mbetet një Marathonomak i letrave shqipe. Poezia e tij, madje tërë krijimtaria letrare e Nolit, të mundëson studime të reja e me vlerë. Pa mëdyshje, çdo studiues a lexues i rëndomtë ëndërron një *Udhëtim me Fan Nolin*, megjithëse këtë projekt studimor me mjeshtëri e ka realizuar profesor Nasho Jorgaqi.

Sot studiues të shumtë shqiptarë e të huaj merren me vështrime, analiza e studime të shumëllojshme mbi krijimtarinë e Nolit, tani në 130- vjetorin e lindjes së poetit e në vazhdimësi, duke kuptuar thellësisht nga vargu nolian që përsiatja, përjetimi dhe sfida janë *ligji i dinjitetit të shkrimtarit.*

Përfundim

Poezia e Fan S. Nolit sendërtohet mbi një filozofi të vargëzuar që shpreh imazhin e jetës, kohës, së vërtetës... Vetë ëndërrimi i poetit ndërmjetësohet nga aftësia për të strukturuar disa ngjarje, prirje kjo e *poetëve vigjilentë* që tentojnë të zgjojnë *simbolet e koshiencës kolektive të depozituara në kujtesën njerëzore*.

Poezia e Nolit ka konstitucionin e vet shpirtëror, e mban vulën e kohës dhe shpreh identitetin e vet social e historik. Ai trajtohet si poet tejet origjinal në tematikë e ide, i

[277] Agim Vinca, *"Portreti i Nolit në vargjet e një poeti"* në Alternativa letrare shqiptare, Shkup, 2005, 192.

pakrahasueshëm në simbolikë e në sintaksën poetike, ndërsa muzikaliteti i vargut poetik e bën poet të paimitueshëm.

Estetikën poetike të tij e karakterizon *kulti i fjalës*, gjë që e shpreh me përzgjedhjen gjuhësore e artistike. Figurën e tij poliedrike, si poet me talent e shije të rafinuar, dije e kulturë të gjerë e madhështon sensi atdhetar dhe vlera antologjike e poezive. Polemikat, argumentet dhe logjika noliane janë të pathyeshme. Ai nuk qe krijues hyjnizimesh e kompromisesh, synonte të vërtetën.

Poezia e Nolit u krijua me idenë e pasjes së identitetit të sotëm, me një trashëgimi të nesërme e të përjetshme, që nënkupton se *poezia është atje ku ajri pothuaj kthehet në mendim* (F. G. Lorka). Poezia e tillë i referohet lexuesit semiotik, sipas U. Ekos, sepse ky lexues është në gjendje të zbërthejë shenjat e diskursit, pra ai duhet të jetë një lexues i sprovuar. Natyrisht, poezinë e Nolit, nuk e bën modern vetëm leximi e përkthimi i veprave të krijuesve botërorë, po mbi të gjitha e bën modern *parimi estetik* përballë *parimit ideologjik*. Megjithëse, i ndikuar nga kryeveprat botërore, të cilat i shqipëroi, ai përvetëson një lloj *modus* shkrimi modern. Noli në poezinë e tij angazhohet për një kërkim shpirtëror. Jo përmes soditjes, e njeh realitetin në harkun e përvijuar të së ardhmes dhe kjo e radhit në *vizionarët e poezisë moderne*, siç përvijon dhe poeti William Blake *koha është dhuratë e përjetësisë*.

SEKSIONI III: ÇËSHTJE GJUHËSORE NË VEPRËN E FAN NOLIT

Prof. as. dr. ABDULLA BALLHYSA
Msc. MIRELA SHELLA

KHAJAMI I PERSISHTES – RUBAITË E SHQIPES (FJALË DHE TERMA QË KHAJAMI NUK I NJOHU)

Një plak të shenjtë, t'urt e mjekërgjatë
Kam parë që vraponte që menatë;
I thashë: "Ku po shkon kështu, Uratë? "
Më tha: "N'Alltar për Mesh' e për Kungatë"

"Në qoftë se fjala që vepra e një shkrimtari është pasqyra më e vërtetë e forma mentis dhe e shpirtit të tij, ësht'e drejtë, atëherë vjershat që shkroi ky poet dhe veprat e shqipëruara që na ka lënë, përfaqësojnë në kuptimin e tyre simbolik që në krye gjer në fund një konfension të vetëm, credon e një njeriu e të një jete. [...] Revolucionarë e profetë, poetë e dashamirës aktivë të njerëzimit, janë po aq mishërime të unë-s së tij, nëpër to shprehet ai vetë. Në këtë kuptim edhe shqipërimet në një kuptim më të thellë janë krijime të tij. "[278]

Ku është Noli tek "Rubairat"? Do të thoja gjithkund. Diku përmes fjalorit të tij tipik, diku përmes natyrës satirike të tij, diku përmes fjalëve dhe shprehjeve tipike të marra nga frazeologjia popullore shqiptare, sepse "Ai nuk është poet i lartësive eterike, po është shkrimtar i plisit të dheut"[279]. Gjurmët e dukshme të Nolit janë edhe tek fryma e re që marrin "Rubairat" në shqipërimin e tij.

Që nga 1858, kur Edward FitzGerald nxori dorëshkrimin persisht, nga pluhuri i Bibliotekës Bodleriane të Oksford-it, Rubairat e Omar Khayamit kanë njohur shumë përkthime në shumë gjuhë të ndryshme europiane. Secili prej përkthyesve është munduar të sjellë një përkthim sa më të arrirë. Dy janë burimet kryesore, le të themi, nga janë marrë Rubairat. Njëri është përkthimi në anglisht nga E. FitzGerald dhe tjetri, Rubairat origjinale në persisht. Në rastin e Nolit ai pohon se "versioni shqip - version i varfër versionesh - përmban Rubajate të përkthyera nga Fitzgerald-i, nga verioni në gjermanisht i Rosen-it dhe nga versioni frëngjisht i Grolleau-it. [280] Kjo i jep atij lirinë që ndërmjet përkthimit të lirë dhe atij autentik, Noli të tregojë se është për të parin, por duke shfrytëzuar dhe elementet e shëndosha të të dytit. Ai e ktheu në një parim krijues dhe praktikë të vetën, që duke iu përmbajtur besnikërisht mendimit dhe frymës së origjinalit, ideve dhe gamës së ndjenjave të tekstit, të bëjë ndryshime të formës. Prej kësaj vjen ajo që ai s'i përmbahet gjithmonë masës së vargut, skemës së rimave,

[278] Eqerem Çabej. "Fan Noli ynë" Revista "Nëntori" 1965 Nr. 4 fq 21
[279] Po aty
[280] Rushit Bilbil Gramshi, "Rubajatet e Omar Khajam-it" Vien 1926

numrit të fjalëve e të frazeologjisë. Duke qenë vetë poet me forcë të madhe krijuese, duke i njohur dhe shfrytëzuar aftësitë shprehëse të gjuhës shqipe, veçantitë dhe ngjyrimet e saj, Noli synon gjithmonë të rikrijojë vlerat ideoartistike të origjinalit në gjuhën amtare, duke gjetur variante ekuivalente të barabarta ose të përafërta. për t'i ruajtur vlerat artistike të veprës, ai nuk stepet para asaj që të sakrifikojë fjalët e rimën, qoftë dhe metrin dhe vargun. Ky parim i punës i ndjekur nga Noli i jep atij mundësinë të rindërtojë strukturën e renditjes së rubairave. Siç e thotë edhe vetë, pjesën më të madhe të rubairave ai e përktheu nga Fitzgeraldi, por ndërsa poeti anglez përkthimin e tij e formëson si një poemth, ku çdo rubai vendoset në një rend të tillë, që ruan në mënyrë logjike hapësirën kohore nga lindja e diellit deri në daljen e hënës.

AWAKE! for the Morning in the Bowl of Night
Has flung the Stone that puts the Stars to Flight... [281]
[...]
Ah, Moon of my Delight ëho know'st no wane,
The Moon of heav'n is rising once again[282]

ndërkohë që Noli nuk e ruan një strukturim të tillë.

Natën kur flinja, më tha Shpirti: "Pi! "
Në Gjumë dhe në Varr s'ka Lumëri:
Ngrehu! sa rron, zbraz Kupa dhe puth Çupa
Ke shekuj që të flesh në qetësi! [283]

Rubaira I

[...]
Dhe kur të shkosh, moj Dor' e Këmb' Argjende
Për të gostitur miqtë n'ato vënde,
Ku pinim bashkë, e t'arrish ku rri,

---

[281] Kjo rubai tek Noli del e renditur me numrin 8[të], ndërkohë që rubaitë në vazhdim, rubaitë 2 dhe 3 ruajnë renditjen fitzgeraldiane, për t'u prishur përsëri ky rend në rubaitë në vazhdim. Shumë rrallë ndodh që Noli t'i ketë qëndruar besnik renditjes së FitzGeraldit. Ky mosrespektim i renditjes nga ana e Nolit nuk viret re në asnjë nga përkthimet në frengjisht apo dhe në italisht. Charles Grolleau, nga dhe vetë Noli ka përkthyer disa prej rubaive, i ka qëndruar besnik E. Fitzgeraldit.

[282] Rubaiyat of Omar Khayam of Naishapur E. FitzGerald 1858. Kjo strofë që përgjithësisht është e parafundit në përkthimet me bazë Fitzgerald-in, në rastin e Nolit, qoftë në botimin e parë të 1926-s qoftë në atë të mëvonshmin, kjo rubai nuk ruan renditjen e saj fitzgeraldiane, ashtu si dhe shumë rubai të tjera të përfshira në përkthimet e Nolit.

[283] Nga botimet në anglisht, italisht, frengjisht apo dhe gjermanisht, të marra në shqyrtim, duket se kjo rubai nuk ka ekuivalenten e vet në asnjërin prej varianteve. Rubairat e marra në shqyrtim nga gjuhët evropiane, mbyllen me rubainë që Noli e rendit të parafundit. Ka vend të mendojmë se Noli, duke depërtuar thellë në botën e Khajam-it, ka ndërtuar sipas stilit dhe botëkuptimit të autorit pers, si rubainë e parë ashtu edhe atë të fundit. në këtë mënyrë ai i krijon mundësinë këtyre rubaive të qëndrojnë bashkë, në një strukrurë të përmbyllur. : Natën kur flinja, më tha shpirti: Pi! / Në Gjumë dhe në Varr s'ka Lumëri! / Ngrehu! sa rron zbraz kupa e puth Çupa, / ke Shekuj që të flesh në qetësi/ [...] Dhe kur të shuhem nënë Dhe të zi/ Dhe kur të bëhem prapë Balt' e Hi, / Mbrumëni Poçe, mbushmëni Dolli/ dhe shihni po s'u-ngjalla përsëri!

Mos psherëti! - po zbrasmë Kupën tënde. [284]

Rubaira 330

Ka mendime që Noli në përkthimet e veta është interpretues artistik, se ai duke bërë këtë, arrin jo vetëm të rijapë kuptimin e tekstit, por dhe ndjenjën dhe tonin e gjuhës, që lidhet me ngarkesën emocionale dhe veçoritë stilistike të origjinalit. Duke iu përmbajtur kësaj metode tek ai gjejmë, krahas përkthimeve me një besnikëri të plotë, pjesë të përshtatura, parafrazime, pasazhe të thjeshtëzuara, trajta popullore. [285] Ai e ka të qartë se: "Shqiptarët kurbetllinj ishin fshatarë dhe pak prej tyre kishin ndjekur shkollën - shpjegon ai me vonë. - Pra unë u përpoqa të komunikoja me ta dhe e vetmja mënyrë ishte të flisja me një gjuhë të thjeshtë e të pastër. "[286] Ky është lexuesi i Nolit dhe për t'u bërë i kuptueshëm prej tyre ai duhet ta bëjë Khajamin të flasë shqip. Për këtë arsye "duke synuar të transplantojë shpirtin e origjinalit"[287] ai nuk harron lexuesin për të cilin janë të destinuara shqipërimet e tij. Lexuesi shqiptar e ka të nevojshme që t'i flitet me gjuhën e tij, gjuhën me të cilën ai është mësuar nga krijimtaria e tradicionale. Për këtë arsye nuk janë të rastësishme përdorimet e shprehjeve të marra nga përditshmëria dhe mendësia shqiptare.

... E shkurtër është Jeta, ja, u mplakmë
Dhe mbetmë si kofini pas të vjeli

Rubaira 3

... Më qesh me buz' e sy, se shpirti i thotë:
"Bëje të mirën dhe e hidh në det"

Rubaira 37

etj

Elemente të tjera të cilat rrjedhin nga ajo që është pjesë e mendësisë shqiptare janë edhe figura si: Zana, E bukura e dheut, buzë trëndafile, shtat-selvi, kulla e natës, llahuta, Krali, plaku i urtë, besa, burbuqe, shkabë, zambak (në versionet evropiane hasim tulipan) etj. , figura që duke u nisur nga koha dhe mjedisi në të cilin krijoi Khajami, nuk mund të mendojmë se i krijoi ai, aq më tepër që nuk i gjejmë në përkthimet evropiane.

Çfarë ecurie ndiqte Noli në procesin e përkthimit? Përgjigjen e kësaj pyetjeje na e jep ai vetë. "Metoda ime, shpjegon ai, është kjo: Kur fillova të përkthej "Hamletin" e nisa me pjesën më të bukur, përktheva monologun e famshëm "Të rrosh a të mos rrosh" ose "Makbethin" nisa ta përkthej duke filluar me pjesën "Nesër dhe nesër". Po kështu dhe "Otellon" e fillova me përkthimin e pjesës më të bukur dhe pastaj mbusha boshllëqet"[288] "Ai përpiqej jo vetëm ta njihte e përvetësonte gradualisht

[284] Noli F. S "Vepra I" Tiranë 1988 fq. 241. Kjo rubai në versionin e Fitzgeraldit është rubaira e fundit.
[285] Abdullah Karjagdiu: "Noli përballë metaforikës shekspiriane. " Revista "Jeta e re" 1971 Nr. 4
[286] Nasho Jorgaqi. "Jeta e Fan. S. Nolit" Tiranë OMBRA GVG, 2005 fq. 357
[287] po atu fq 369
[288] po aty fq 369

veprën që do të përkthente, por edhe ta jetonte atë thellë[289] duke u njëjtësuar me poetin. Rikujtojmë edhe njëherë këtu vlerësimin e Çabej, i cili, pas unit të poetëve të ndryshëm botërorë, sheh të mishëruar unin e Nolit. Aq e vërtetë është kjo, saqë edhe shpjegimet e rubaive dhe shënimet në fund të tekstit, Noli do t'i përdorë për të thënë diçka nga jeta e tij. Këtë ide të krijon shpjegimi i Rubaive 146-147, sipas botimit të 1926-ës [290-291]. Interpretimi që Noli u bën këtyre rubaive, të kujton jetën e tij, raportet e tij me miqtë dhe zhgënjimet që ai mori gjatë dhe pas Revolucionit të Qershorit. Këtë ide të krijojnë rubaitë 299-303:

Të lik të bëjnë kur fiton lavdi
Dhe intrigan, kur rron në vetmi:
Qofsh pra Profet prej Qiellit, Shën-Elli
Më mirë mos u njih, mos njih njeri.

Rubaira 302

Këto shembuj janë një arsye e qëndrueshme për t'i kuptuar shqipërimet e Nolit si mënyrë e shprehjes së unit të tij dhe për këtë arsye për t'i parë ato edhe si rikrijime a krijime, që më shumë se synojnë t'i japin vendin e duhur poetit persian në letërsinë shqipe, janë një mënyrë që Noli zgjedh për të thënë idetë vetjake, për të transmetuar tek lexuesi shqiptar principet themelore të jetës së vet, të cilat janë demokratike dhe shpesh materialiste.

Noli "do të kritikonte përkthimin mjeshtëror të rubaive nga Fitzgeraldi, duke i quajtur "variante origjinale inglishte të frymëzuara nga Omer Khajami"[292], por analiza e rubaive të shqipëruara prej tij tregon se të njëjtën rrugë ndoqi edhe vetë Noli, ai i rikëndoi ato lirisht e bukur në gjuhën e tij[293] Ngjashmëritë mes origjinalit dhe gjuhës shqipe Noli do t'i shfrytëzonte shpesh me sukses. Kështu në mes të tjerash, do të ndodhë me rubainë 88, për të cilën Noli, duke pasur parasysh vargun e katërt: Ku vajti, ah, ku? Ku, ku, ku zbriti? ", shkruan: "Kjo rubai s'mund të kthehet në asnjë gjuhë më mirë sa në gjuhën tonë për arsye se fjala ku me të cilën poeti imiton vajtimin e qyqes ka gjithë atë kuptim në shqipen dhe në persishten". [294] Por ai edhe do ta

[289] Nasho Jorgaqi, Mbi procesin e punës krijuese dhe studimore të Fan Nolit", "Profile dhe probleme letrare", 2008

[290] Në botimin e 1988-ës, Noli. F. S "Vepra I" këto rubai i korespondojnë rubaive 325-326

[291] Noli i shpjegon kështu këto rubai: "Këto të dy Rubajate provojnë që Khajami, në mos tërë jetën e tij, po në pleqëri do të ketë vojtur shumë keq. Shumica e miqve e neverisnin dhe e dezertuan. Çështja e Lirisë Mejtimit mbeti pa ushtarë dhe Fanatizma mbretëronte sovrane. Shokët dhe dishepujt' e tij më të zotë a u-hodhë në kampin e Fanatizmës triumfante a kërkuan mprojtje nënë flamurin e mistikëve Sufinj. Pabesia e të parëve dhe oportunizmi i të dytëve e dëshpërojnë gjer në vdekje. Lufta është e humbur, dishfata esht e plotë. [...] Është fundi. Omar Khajami duhet të shkruanjë dhjatën. Besnik në parimet e tij gjer në varr e shkruan dhjatën me verë dhe përpara se të japë shpirt, u vërtit në fytyrë fanatikëvenjë sfidë të fundme. "...
"Rubajatet e Omar Khajamit" Vien 1926, fq 78-79. Këtë frymë e gjejmë edhe tek "Shën Pjetri në mangall"

[292] Fan Noli Rubairat e Omar Khajamit, introdukte

[293] Nasho Jorgaqi, Mbi procesin e punës krijuese dhe studimore të Fan Nolit", "Profile dhe probleme letrare", 2008

[294] F. Noli Rubairat

kapërcejë si shtratin kohor ashtu edhe arsyet që e bënë Khajamin t'i këndonte verës dhe çlirimit që sillte ajo. Çdo rubai mbart një gjurmë të figurës poliedrike të Nolit. Herë aty gjejmë të flasë me gjuhën e një politikani demokrat:

Xhami e Kish' e Tempull: robëri!
Këmban e Minare: një patërdi!
Dervish e Prift e Hoxh' e kryq e Hënë:
Pengime që të gjitha për liri!

Rubaira 226

"...hapësira liridashëse Noli u sillte shqiptarëve dhe me "Rubairat" e Omar Khajamit, ku realizohej aq bukur dhe fuqishëm personaliteti i njeriut të lirë. Ai kishte kohë që e gjente veten e tij në këto vargje të magjishme, siç gjente dhe jehonë e gjurmë të botës e të mentalitetit shqiptar. Heroi lirik i Khajamit, ndonëse vinte nga viset e Orientit, predikonte lirinë e mendimeve e të ndjenjave, gëzimin e jetës, të kënaqësisë e të bukurisë, larg çdo dogme dhe fanatizmi. Përmes tij, Noli lëshonte blasfemi kundër skllavërimit shpirtëror dhe social aq i pranishëm në shoqërinë shqiptare të kohës. Guximi dhe pakënaqësia e tij ishin aq të mëdha sa, duke shkelur mbi etikën dhe kufijt' e pozitës fetare shpallte lirinë si gjënë më të shenjtë të njeriut. Pikërisht te "Rubairat", njeriu do të lëvizte i lirë, siç do të shfaqej dhe përmes kontrastesh, ku fetari ndeshej me ateistin, asketi me epikurianin. Të tillë ua jepte shqiptarëve Noli këtë vepër, në të cilën shpirti i tij i trazuar e i stuhishëm ishte në hapësirat e veta. "[295]

Si prift ai nuk mund të shkruante blasfemi, (dhe mund të themi se as Khajami e as përkthyesit e tjerë nuk e kanë bërë një blasfemi të tillë, nuk gjendet respektiva e kësaj rubaije në versionet evropiane) por Khajami i jep atij mundësinë të jetë i lirë të shprehet:

Më thoni që do t'digjem në Skëterrë
Se adhurova Dashurin' e Verën
Aspak! Ju kini vetëm një *Ndërmjetës,*
Unë kam dy: Kungatën edhe Verën

Rubaira 282

apo

Rreth Qelqit u afroni: merrni, pini!
Rrushkat me mall kujtoni: merrni, pini!
Se Vreshta tha: "*Ky është Gjaku im,*
Q'u derdh për Ju! Kungoni: merrni, pini!

Rubaira 285

Por, përkundër këtij blasfemisti, do të vendoset prifti, sepse Noli do të flasë edhe me termat e tij kishtarë, që janë të huaj për poetin pers. Është e pranueshme përdorimi nga Khajami i fjalëve si: dervish, xhami, ramazan, Rustem, xhenet, minare etj; duke u nisur nga fakti që këto janë të lidhura dhe me botën e tij orientale, ndërsa duken jashtë botës së Khajamit fjalë të tilla si: kungatë, kishë, prift, Shën-Elli, Adami, Eva, farisjanët, uratë, alltar, meshë etj. Por shenjën, që shenjon qenësinë e tij si prift

[295] Nasho Jorgaqi. "Jeta e Fan. S. Nolit" Tiranë OMBRA GVG, 2005 fq. 52-53

nuk e gjejmë vetëm në fjalë të shkëputura, gjejmë gjithashtu dhe vargje të tëra që duket se janë ndërtuan prej mendësisë së tij prej prifti. P. sh. :

Po kemi Zotin midis nesh sa herë
Me verën e bekuar po kungojmë.

Rubaira 281

apo

Ti hiqma Udhën, ti shpëtim rrëfemë
Ti çilma Derën, Zot, dhe përdëllemë.

Rubaira 236

Dihet tashmë se Noli mbante njëkohësisht disa vepra në duar. Kjo frymë fetare që shfaqin këto vargje, të cilat nuk i gjejmë në botimin e 1926-ës, mund të lidhet dhe me faktin se ai ishte duke përkthyer njëkohësisht edhe Biblën dhe, nuk mund të shmangë plotësisht interferencat e regjistrave ligjërimorë, me gjithë përpjekjet e tij për t'u mishëruar me frymën dhe mendësinë e poetit persian. E ndërsa në këto shembuj duket se ai nuk ka mundur të fshehë qenien e tij fetare, këtë gjë e bën shumë mirë në rubaitë ku i këndon bukurisë femërore dhe dashurisë. "Në 45-vjetorin e lindjes do të shkruante vjershën "Plak topall dhe ashik". Pranonte jo pa ironi, se po i trokiste pleqëria, se hallet e kishin lodhur dhe prap kish mbetur ashik, e joshnin gëzimet e jetës, bukuria dhe dashuria, ndaj i drejtohet gruas së panjohur me vargjet[296]:

Dale moj se kam një fjalë
se më rrjedhin lotët valë
dale moj se jam i çalë
dhe më s'ecënj dot

Sepse bukuria femërore nuk ka kaluar indiferente para syve të poetit dhe ai i këndon kësaj edhe në shumë prej rubairave. Ndërsa në rubaitë e Khajamit Ajo është thjesht vajza, në shqipërimet e Nolit Ajo nuk është thjesht vajza, ajo ka tiparet e saj të mirëpërcaktuara, që na krijojnë mundësinë të krijojmë një portret të plotë të saj. Vajza në shqipërimin e poetit tonë nuk është e përcaktuar vetëm si Huri, por ajo është buzëtrëndafile, shtatselvi, zanë, e bukura e dheut, Dor' e këmb' argjende. Noli ishte njeri, pavarësisht faktit se kishte qenë i detyruar të vishte veladonin e priftit. Për këtë arsye ai, si njeri, do t'i këndonte bukurisë femërore, duke na lënë ne, lexuesve shqiptarë, përmes shqipërimit, pse jo dhe rikrijimit, një dëshmi të qartë të aftësive të tij si poet që lëvroi lirikën e dashurisë, përveç asaj politike. Rubaitë 32 - 39 e dëshmojnë qartazi këtë fakt:

Kur s'dhëmp e s'shemp nuk është Dashuri
Pa Ferr s'gjen dot Parajsë dhe Huri:
Kur zjarr' e ke në gji, me nat' e ditë
Sot ndrit me gas e nesër ndes më zi.

Rubaira 32

[296] Nasho Jorgaqi. "Jeta e Fan. S. Nolit" Tiranë OMBRA GVG, 2005 fq. 72-73

E *Dashura shkëlqeu, më verboi,*
Zemra më fliste, gjuha më pushoi:
Kush pa me sy tortyrë kësisoj?
Nga etja u dogja, u shova mun te kroj.

Rubaira 38

Noli e njeh shumë mirë lexuesin shqiptar, për të cilin ai i shqipëroi veprat e tij. Për këtë arsye ai u mundua që autorët e mëdhenj të letërsisë botërore, përmes të cilëve ai u foli shqiptarëve, të flasin gjuhën e tij. Ai e ka të qartë se suksesi i shqipërimeve të tij varet jo vetëm nga përzgjedhja e veprave, por edhe nga gjuha që ai do të përdorë për të depërtuar në shpirtin dhe mendjen e shqiptarëve, dhe për të gëzuar respektin dhe adhurimin e tyre. Këtë mendësi e dëshmon dhe tema e Nolit në seminarin e dytë të studimeve shqiptare, që u mbajt në SHBA, më 07-11. 08. 61 "Si u bëra shkrimtar" dhe, ndër të tjera këshilla që ai u jep shkrimtarëve të rinj, do të shprehet: "Kjo, do të thotë se artisti duhet të gjejë frymëzimin artistik te mjedisi që e rrethon, i duhet të mësojë teknikën e krijimit të veprave të artit, i duhet të sigurojë jetesën, duke shitur krijimet e tij dhe duhet të vlerësohet e të mbështet nga klientët e tij"[297]

"Dhe jo rastësisht, ai do t'i quante këto shqipërime, sepse, më shumë sesa përkthente fjalën, ai do të interpretonte lirisht, do të rikrijonte e rikëndonte me tone madhore në gjuhën amtare. Noli dëshmoi se ishte sa mjeshtër i madh i fjalës, aq dhe krijues i fuqishëm. "[298]

[297] Nasho Jorgaqi. "Jeta e Fan. S. Nolit" Tiranë OMBRA GVG, 2005 fq. 362
[298] Nasho Jorgaqi. "Jeta e Fan. S. Nolit" Tiranë OMBRA GVG, 2005 fq. 54

AJTENE QAMILI

ORIENTALIZMAT NË POEZINË E FAN S. NOLIT

Nga huazimet, vend të veçantë në letërsinë artistike shqiptare zënë orientalizmat. Sundimi pesëshekullor i perandorisë Osmane ka lënë gjurmë të thella në shtresat popullore, si në veshje, zakone, gatime, muzikë etj. , rrjedhimisht edhe terminologjinë e tyre. Meqë sfera më e gjerë për orientalizmat është gjuha bisedore dhe ligjërimi i shkujdesur, kur shkrimtarët shtjellojnë tema nga periudha e sundimit turk, personazhe të shtresave popullore, jetën e gjuhën e njerëve të pashkolluar etj. , duke e pasqyruar këtë, gjithsesi nuk mund t'u shmangen përdorimit të orientalizmave, të cilat gjejnë vend sidomos në shkrimet historike, humoristike e satirike.

Në këtë studim janë analizuar të gjitha poezitë origjinale të Fan S. Nolit (nuk janë marrë parasysh shqipërimet, gjegjësisht rikrijimet e tij) duke i identifikuar orientalizmat që ndërfuten mes vargjesh, duke u përpjekur të gjejmë arsyen e përdorimit të tyre saktësisht dhe konkretisht në secilën prej tyre dhe duke i klasifikuar ato në orientalizma të ngulitura apo të pangulitura (barbarizma).

Për të dhënë mendim të saktë dhe dinjitoz për një njeri siç është Noli është sfidë shumë e madhe, për të mos thënë një salto mortale. Megjithatë duke e patur parasysh këtë fakt, me modestinë më të madhe jam përpjekur të bëj analizë sa më objektive.

Noli në shkrimet e tij, përgjithësisht, përdori një shqipe të variantës Jugore, me tipare arkaike, krahinorizma dhe struktura të përpunuara, një shqipe të qartë, të fuqishme, të bukur dhe ekspresive dhe me kujdesin më të madh synonte të ruajnte e të kultivonte një shqipe sa më të pastër që është e mundur, njëlloj sikurse paraardhësit dhe bashkëkohësit e tij dhe padyshim se shmangien nga normat gjuhësore e bën për të shprehur mendimin apo porosinë e tij në mënyrë të figurshme ose tërthorazi, për të shprehur emocion (mllefin ndaj gjendjes së popullit, thirrje për kryengritje etj.), për të sajuar rimën, harmoni e tingëllim të këndshëm, muzikor etj.

Përmes barbarizmave ai mëton që të japë një ngjyrë tipike të mjedisit, të pasqyrojë një atmosferë të posaçme në të cilin gjendet populli i tij, t'ia përafrojë lexuesit kohën specifike të historisë e, sidomos, më shpesh i përdor për të ironizuar ngjarje, personalitete që ai nuk i duron dot, rendin shoqëror të bejlerëve të asaj kohe në Shqipëri etj.

Për gjendjen e atëhershme shoqërore, politike, arsimore etj. , sot kemi plot të dhëna të sakta e të mjaftueshme nga shkrimet e shkencave shoqërore, si nga historia, statistika, ekonomia, sociologjia etj. , por këto shkrime japin një pamje neutrale për këtë gjendje të mjerueshme, të cilat nuk e emocionojnë lexuesin, ashtu siç do ta emocononin poezitë e Nolit. Prandaj, me të drejtë thuhet se letërsia artistike, në krahasim me shkrimet e shkencave të tjera shoqërore, disponon tepricë informacioni.

Pikërisht këtë mundësi dhe aftësi të pashterrshme të gjuhës si mjet shprehës, Noli e njohu dhe e shfrytëzoi me mjeshtëri të madhe.

Kënaqësia që lind nga leximi i këtyre poezive është e një shkalle të lartë, që lidhet me përshtypjen artistike, ku marrin pjesë ndjeshmëria dhe intelekti. E bukura në ato vargje qëndron më lart se e bukura në natyrë, pasi jepet e plotësuar me anën shpirtërore dhe botën e brendshme të Nolit, karakterin, psikologjinë dhe personalitetin e tij të përgjithshëm. Së bashku me idealin e vet artistik ai ka edhe idealin gjuhësor më të cilën kalkulon në mënyrë mjeshtërore me visarin gjuhësor. Pikërisht ky dimension i artit letrar përcillet bukur mirë te lexuesi.

Noli shumë me mjeshtëri e bën organizimin dhe sistemimin harmonik të njësive të gjuhës: të tingujve, të rrokjeve të theksuara e të patheksuara, morfemave, fjalëve, fjalive dhe vargjeve. Ai të gjitha këto efekte të natyrës bukurtingëlluese arrin t'i orkestrojë me përmbajtjen, porosinë kuptimore të fjalës, të vargut dhe të vjershës në tërësi, për të arritur efekte më të fuqishme emocionale, kuptimore e imagjinative.

Për ta shprehur temperamentin e tij luftarak, mllefin, ashpërsinë, etjen për dhunë që te lexuesi ngjall ndjenjën e urrejtjes dhe nxitje për rebelim e revolucion Noli si vegël të fortë zgjodhi orientalizmat. Vihet re se poezitë të cilat përmbajnë më shumë orientalizma, në krahasim me ato që përmbajnë më pak ose fare, për çudi, ngjallin shumë më tepër emocione, duket sikur lexuesit fillon t'i vlojë gjaku, çohet peshë dhe është në gjendje të ndërmarrë veprime konkrete, të marrë iniciativë për revolucion, pa e kursyer fare veten. Kjo forcë mobilizuese shpesh ka qenë shumë më efikase sesa shkrimet, thirrjet dhe apelet e drejtpërdrejta politike dhe luftarake drejtuar popullit. Në poezitë patriotike të tij vërehet qartë se Noli ishte njeri i kontrasteve nga më të çuditshmet i urtë dhe i matur, por shpesh rebel dhe inatçi.

Diçka tjetër që na ra në sy gjatë këtyre analizave ishte fakti se Noli revoltën, mallin për Shqipërinë, zhgënjimin nga shokët që e linin në baltë e pasqyronte vetëm përmes orientalizmave, kjo pak për t'u habitur, sepse ai edhe pse ishte poliglot (e i njihte mirë gjuhët e keqdashësve te shqiptarëve), kur e shpreh mllefin ndaj grekomanëve dhe sërbomanëve nuk bien fort në sy greqizma dhe serbizma, në ndërkohë që orientalizmat pikasen shumë.

Me krenari të madhe Noli shpesh theksonte se në Shqipëri ka mbretëruar toleranca fetare dhe për më tepër marrëdhëniet midis myslimanëve dhe të krishterëve shqiptarë mund të shërbejë si shembull për vendet e tjera. Vetë fakti, thoshte ai, që një peshkop i krishter e kryeson një shtet me shumicë myslimane, flet shumë; megjithatë mes rreshtave të tij theks të veçantë ka mllefi dhe urrejtja ndaj servilëve turkomanë, më shumë sesa ndaj atyre serbomanë dhe grekomanë. Padyshim se ai nuk ishte besimtar fanatik, e aq më pak klerik dogmatik, megjithatë jeta kishtare për të, siç vërteton prof. Nasho Jorgaqi, vinte përpara letërsisë, përpara historisë, përpara politikës, prandaj mund të arsyetohet fakti pse pikërisht Noli elementin turk e përdori për qëllime satirike e përbuzëse ndaj bejlerëve.

Arsye tjetër e përdorimit të orientalizmave është edhe për shkak të theksimit anapest (në çdo tre rrokje), aliteracionit dhe asonancës. Noli dallohet me përdorimin e veçantë të mjeteve, me lidhjet e ndërthurjet e fjalëve, me kuptimin e ngjyrimet e reja, me dendurinë e ndryshuar të përdorimit, me sintaksën e shndërruar, me organizime

dytësore të elementeve të gjuhës që ngjallin efekte estetike, me vlerësimin e anës tingullore, të ritmit, të lidhjeve të papritura, të shpeshmërisë së figurshme e simbolizuese (ironike) dhe deri të lojës gjuhësore.

Ai mban qëndrim vlerësues ndaj ligjërimit, i çmon fjalët vetjake dhe i përçmon fjalët e tipat e shprehjes orientale dhe i satirizon ato.

Disa orientalizma Noli i përdori për të sajuar çifte sinonimike: *populli – mileti, topall – i çalë, fukara – i varfër, fakir- i gjori, yengjini – i pasuri, vatan – atdhe, behar – pranverë,*

Ka raste kur mes këtyre vargjeve përsëritet një fjalë a shprehje herë plotësisht e njëjta (qoftë shqipe apo orientale) ose çifti sinonimik shqipe - orientale, e cila shërben për theksim, për përforcim, për kundërvënie, por edhe për të dhënë një gjendje psikologjike, ngulmim në një pikë ose në të menduarit që nuk përparon, për të ngadalësuar lëvizjen e ngjarjes deri në njëtrajtshmëri, për humor, për të dhënë thjeshtësinë e të folurit deri te mungesa e aftësisë për të rrëfyer, ose, përkundrazi, për të arritur një ton oratorik dhe lirizëm.

Përplot me orientalizma është poezia "**Marshi i Barabbajt"**, si p. sh. : Allalla, rezil, katil, turfanda, zinxhir, kamçik, batërmas, tepdil, qejf, kopukët etj. dhe "**Kënga e Salep-Sulltanit",** si p. sh. : mexhlis, llokum, hanxhari, ferman, sadrazem, xhumhurieti, rehatos, mileti etj. Arsyeja kryesore e përdorimit të këtyre fjalëvë në këto dy poezi është pikërisht satirizimi i mënyrës se ceremonialeve apo manifestimeve sipas rendit dhe traditës otomane dhe terminologjinë administrative e përdor origjinal sipas përdorimit osman. Si p. sh. te "**Kënga e Salep-Sulltanit"**

një <u>mexhlis</u> të madh na çeli
Pandeli Janko Vangjeli,
Me <u>sulltan-llokum</u> na veli
Si kofini pas të vjeli.

Koço Kota mjek <u>hanxhari</u>
Nis një valle palikari,
Se me një <u>ferman</u> kusari
<u>Sadrazem</u> u bë firari.

Se ç'u shporr <u>xhumhurieti</u>,
Se ç'u <u>rehatos mileti</u>,
Se <u>Sulltanin</u> prapë e gjeti.
Se, që kur e humbi, s'fjeti! .

Edhe te **"Marshi i Barabbajt"** përbuz ata të cilët shtiren si myslimanë të vërtetë, por janë të pamoralshëm, te poshtër, të dhunshëm dhe vrasës. Këtu fjala *allalla* lidhet me fjalën Allah, fjalë të cilën shumë shpesh e përdorin myslimanët para çdo pune a veprimi, por në këtë rast me kuptim satirizues. Dhe të gjitha orientalizmat në këtë poezi janë vetëm emërtimet që japin cilësitë negative të këtyre personave.

***Allalla**, o **rezil** e **katil**, **allalla**,*
*Shtroni udhën me hithr' e me shtok **turfanda**,*
*Gumëzhit, o **zinxhir** e **kamçik**, **baterma**,*
Lehni, laro, kaba: Hosanna, Barabba!

*0 stërnip i Kainit, **tepdil** si bari,*
Ti na shtyp e na shtryth e ti gjakun na pi,
*Ti na ther e na grin e për **qejf** na bën fli;*
0 kokuth e lubi: Hosanna, Barabba!

*Në **budrum**, nëpër llom' e kufom' u-mallkofsh,*
Në skëterrën, katran e tiran, u-harbofsh,
Me tam-tam e allarm' e me nëm' u-shurdhofsh,
Në zëndan mbretërofsh: Hosanna, Barabba!

0 i çgryer, i zhyer, i vyer për hu,
Turp-e-ndot-kundërmonjës të krusen mbi gju
*Dallkaukët, **kopukët** e turmat pa tru,*
Zëmër-krund-e-gërdhu: Hosanna, Barabba!

Ngjashëm është rasti te poezia "**Anës lumenjve"**. Shkasi i gjendjes së mjerueshme të Shqipërisë e janë pikërisht: *derbederët, jabanxhinjtë, fajdexhinjtë*, prandaj i emërton origjinal sipas gjuhës që ata e përkrahin, por *vatani e mileti* janë *sakatosur* dhe vuajnë. Fjala *zengjini* simbolizon se vetëm ata që kanë përqafuar Perandorinë Osmane kanë qenë të pasur, kurse populli i rëndomtë jo. Pra mesa vërehet, vetëm atyre që u dedikohen fjalët emërtohen me orientalizma. Të gjitha këto jane huazime të pangulitura (barbarizma), në përjashtim të fjalëve sakatosur dhe mileti, të cilët kanë depërtuar më thellë, jo vetëm në krijimtarinë lëtrare, por edhe te masa e gjerë e popullit. P. sh. :

*Arratisur, **syrgjynosur**,*
Rraskapitur dhe katosur
Po vajtonj pa funt, pa shpresë,
Anës Elbë-s, anës Spree-së.
Ku e lam' e ku na mbeti,
*Vaj-**vatani** e mjer **mileti**,*
Anës detit i palarë,
Anës dritës i paparë,

Pranë sofrës i pangrënë,
Pranë dijes i panxënë,
Lakuriq dhe i dregosur,
Trup e shpirt i ***sakatosur!***

Seç' e shempnë ***derbederët****,*
Mercenarët dhe ***bejlerët****,*
Seç' e shtypnë ***jabanxhinjtë****,*
Seç' e shtrythnë ***fajdexhinjtë****,*
Seç' e pren' e seç' e vranë,
Ç'e shkretuan anembanë,
Nënë thundrën e përdhunës
Anës Vjosës, anës Bunës.

Dhe një zë vengon nga lumi,
Më buçet, më zgjon nga gjumi,
Se mileti po gatitet,
Se tirani lebetitet,
Se pëlcet, kërcet furtuna,
Fryhet Vjosa, derdhet Buna,
Skuqet Semani dhe Drini,
Dridhet beu dhe ***zengjini****,*
Se pas vdekjes ndriti jeta
Dhe kudo gjëmon trumbeta.
Ngrehuni dhe bjeruni,
Korini dhe shtypini,
Katundar' e punëtorë,
Që nga Shkodra gjer në Vlorë!

Te poezia "**Jepni për nënën"** hasen vetëm dy orientalizma të cilat janë të ngulitura dhe përdoren edhe sot. Këto nuk kanë ndonje vlerë te veçantë stilistike apo që fshihet ndonjë prapavijë tjetër.

Cilët bij të trathëtuan
Dhe të doqnë dhe të shuan
Dhe të lan', o Shkab' e ngratë
Pa fole, pa zog, pa shpatë?
Këta qena, o shok' i mbytni,
Mbushni ***gjyle*** *që t'i shtypni.*
Mbahu, Nëno, mos kij frikë,
Se ke djemtë n'Amerikë.

Armë dhe fishekë mblithni,
Qesen *edhe shpirtin hithni:*
Për lirin' e vëndit t'onë,
Sot -se nesër është vonë-
Jepni, Nënën të shpëtoni,
Komb e vatra të nderoni.
Mbahu, Nëno, mos kij frikë
Se ke djemtë n'Amerikë

Te "**Rent, or Marathonomak"**, gjithashtu pikasen vetëm dy orientalizma të cilat i përdor për qëllime metrike dhe bukurtingëllimit. Saktësisht fjala mileti ruan ritmin e këngës, se nëse atë e zëvendësojmë me fjalën populli, e shohim se që të dyja fjalët kanë nga tri rrokje, por vendi i theksit ndryshon (*miléti ~ pópulli*). Pikërisht ky element do ta prishte ritmin e strofës. Ndërkaq fjala myzhde, lidhet më tepër me rimën strofike, pra me një /**e**/ edhe atë e theksuar. Edhe pse kjo e fundit nuk është huazim i ngulitur dhe nuk është përfshirë në leksikun e gjuhës shqipe, ai ende përdorët në ligjërimin bisedor.

T'u tha gryka, po s'të pihet,
T'u mpi këmba, po s'të rrihet,
Se ***mileti*** *po të pret,*
Ankthi zëmrat ua vret,
Vrer e tmerr,
Shpejt, or Marathonomak!

Ja, arrive, ua the:
Ç'gas e ç'helm qe kjo ***myzhde****!*
"E fituam! ", brohorite
Dhe për tok' u-përpëlite;
Vdiq, or vdiq!
Vdiqe, or Marathonomak

Te" **Marshi i kryqësimit"** me fjalën *katil* shprehet një urrejtje më e madhe nga dora e armikut dhe tradhëtarit, sesa me fjalën shqipe vrasës.

Varreni, posa s'do as të vras' as të varrë,
As të bënjë të keqen as gjakun t'a marrë,
Dhe ***katilët*** *me nam na i qan si të marrë:*
Kryqësoje, Pilat, në Kalvar, Golgotha.

Vrajeni kryengritësin e Shënjtëruar
Si ***katil*** *të mallkuar, atë ka kërkuar,*
Se kujtoi që pa armë na ka për të zgjuar:
Kryqësoje, Pilat, në Kalvar, Golgotha.

Te "**Syrgjyn-vdekur"** – vetëm fjala *syrgjyn* është orientale, por është e ngulitur dhe përdorej pikërisht gjatë asaj periudhe, kurse fjala internim ndër popull ka hyrë në përdorim më vonë. Nuk duhet lënë pa u përmendur se Noli si model, pos tjerash, kishte edhe këngët folklorike, prandaj për të qenë sa më afër lexuesit dhe sa më i lehtë e i drejtë për ta kuptuar zgjidhte fjalë që i përdor populli në përditshmëri, disa prej të cilave janë fjalë orientale.

Te "Skënderbeu" – fjala *asqerit* shpjegon atë se Skënderbeu ishte stërvitur dhe rekrutuar në ushtrinë e osmanlive. Edhe terminologjia administrative e asaj kohe është pasqyruar këtu me emrat origjinale (*asqer* (asker) = ushtar, *myhyr* = vulë, *dovlet* (devlet) = shtet, *qatip* (kâtip) = sekretar, *qitap* (kitap) = libër. Fjalët *hendek* dhe *behar* më shumë janë futur për qëllime metrike. Fjala *salltanet* lidhet me mënyrën e të jetuarit në begati dhe qeverisje. Kurse fjalët *kësmeti* dhe *fakiri* përqesh dhe satirizon dështimin e betejave të ushtrisë osmane.

Kur u ngrys e kur u err,
Skënderbeu, nder, lavdi
*I **asqerit** Osmanlli,*
Me turq bashkë krismen merr,
Si lefton e si humbet
Tani shkuamë nje shkrim
_Dhe per fis e pac bekim! _
*Me **myhyrin** e **Dovletit***
Për mytesarifn' e mbretit
Qe mban Krujën, një qytet
*Rreth me mur e me **hendek**,*
Të ma kthenjë gjën' e atit
N'emrin e Sulltan Muratit;
Se çdo urdhër që të japë
Kurrë nuk merret prapë.

*Dhe **Qatipi** u krrus prej tmerit*
Dhe kështu i tha Skënderit:
*<O **Allah** i madh, i naltë,*
Që të jemi hi e baltë!
Qysh të shkruanj këto shkrime
Kur e di që koken time
*Po ma pret ay **Dovlet**? >*

*Dhe pastaj me **salltanet**,*
Veshur armët si një mbret,
Shkon kaluar në kështjellë
Edhe hyn nga port' e qjerë
*Dhe **pashajt** që urdhëron*
Përmi Kruj' i dorëzon

Urdhërin e Murat Mbretit
*Me **myhyrin** e Dovletit.*
Dhe Pashaj si heshti, tha:
Lavdi paste Perëndia,
Ja ku hiqem nga fuqia.
Merre vendin dhe qytetin;
*Kush lëfton dot me **kësmetin**?*

Ja keshtu Skenderi trim
Mori Krujën me rrëmbim;
Edhe lajma u përhap
Si një flagë si nje zjarr
*Q'i fry era ne **behar***
Dhe qytetet afër garg,
*Thotë **Ben** Isa Ben Miri*
*Në **Qitap** të tij **fakiri***
Binin m'ate lehtesi
Qe ze burri veshn' e tij.

Te "**Moisiu në Mal"** kemi vetëm fjalën zor që është futur vetëm për rimë.

Këtej ka dimrin, andej prënverën,
Kërkon parajsën, vdes në Skëterrën;
Ajme, sa vrer, sa keq e sa **zor**,
Liberator!

Edhe te "**Shpell'e Dragobisë"** përdoret vetëm fjala *bajrak* më shumë për qëllime metrike, për bukurtingëllimë, dhe sepse prej saj më shumë vlera emocionale pozitive ngërthen në vetvete fjala bajraktar, sesa flamurtar, që ka kuptimin dytësor ai që është i pari kudo. Noli duke dashur me një fjalë ta shprehë gjithë këtë, Bajram Currin e quajti *bajrak* i gjallë.

(*Elegji për Bajram Currin*)

O Bajram, **bajrak** i gjallë,
More nam me gjak në ballë,
Te një shpell' e Dragobisë,
Yll i rrall' i burrërisë.

Te "**Lidhje e paçkëputur"** kemi një rast krejtësisht ndryshe. Këtu orientalizmat shprehin përkëdheli, lazrim, të mirat dhe të këqijat që i sjell një dashuri (dhimbjet dhe vuajtjet e ëmbla dhe gëzimet e dhimbshme) dhe për të treguar se djali dhe vajza u

takojnë dy botëve të ndryshme, qofshin ato sipas fesë, kombit, klasës shoqërore apo diçka tjetër.

Ti moj Engjëll moj **Shejtane**
Moj Zambak e moj **shafrane**
Ti më dehe të papirë
Me tufan e me farmirë
Moj **kurbatkeë** katarroshe
Moj **sahroshe** koke**boshe**
Më përpjek qoshe më **qoshe**
Me **zinxhir** po me zvarrnis
Më **shastis** e më besdis
Më **kerdis**, me cakerdis
Ti ma syrgjynose gjumin
Ti me mbylle në budrumin
Ti me nxive në **zullumin**
Bashkë s'rrojme dot
Ndahemi pra sot

Nuk **ujdis** dot ti me mua
Si për çift, për burr' e grua
Unë hesht, ti po bërtet
Unë fle, ti po gërret
Unë ha, ti **ramazan**
Unë s'pi, ti zbras **kazan**
Unë rend, ti po calon
Unë ngel, ti fluturon

Te "**Shën Pjetri në mangall"** gjithashtu tregohet ndarja e dy anëve të kundërta, por në këtë rast saktësohët elementi fetar ose më saktë pushtetari (*buxhaku* = zonë administrative në qeverinë osmane;) dhe ai që nuk e përkrah atë, kurse me fjalën *allçaku* pretendohet për servilët, ata që përulen lehtë.

-"Simon Pjetër, Bar Jona,
Kështu ndahet kjo **dynja**:
Kryqi andej, këtej **buxhaku**
Dhe **allçaku**.

Te "**Kirenari"** hasëm vetëm tre orientalizma, të cilat janë përdorur për rimë, ritëm dhe për t'iu afruar më shumë këngëvë folklorike. Megjithatë shumë qartë vihet re se me orientalizma janë përshkruar vetëm fjalët që shprehin turmën e popullit, shumësinë e zërave dhe zhurmave të cilët si shumicë aludojnë të jenë myslimanë.

Ç’deshe ti, mor, në Kalvar!
O qyqar, o Kirenar!
Del me poçen për **sehir**,
Ndrit me Kryqin si martir.

Rent nëpër **kallaballëk**,
seç po ngjan, s’merr vesh as gëk,
je i pir’ e s’mban dot anë
për çlironjës a tiranë.

Nëpër pluhur dhe **shamatë.**

Dhe së fundi, për ta përmbyllur këtë analizë modeste, mund të themi se Noli si mjeshtër i mirë i stilistikës dhe metrikës, si poliglot, si njohës i mirë i letërsisë botërorë, si njeri me shumë temperament e atdhedashës diti saktë dhe mirë t’i përdorë orientalizmat për qëllime nga më të ndryshmet (të cilat i trajtuam në këtë kumtesë): qëllime metrike, stilistike, emotive etj.

Dr. ALBANA DEDA (NDOJA)

MBI MUNDËSINË E NJË QASJEJE DREJT KORPUSIT NOLIAN ME ANË TË FIGURACIONIT STRUKTUROR GJUHËSOR. SPECIFIKA STILISTIKE TË DISA FORMAVE FOLJORE KARAKTERISTIKE

Dihet se kodi gjuhësor dhe struktura specifike e tij është mjeti kryesor, i cili realizon komunikimin në shumëllojshmërinë e tij të shprehjes, nëpërmjet teksteve të ndryshme.

Një tekst specifik është dhe teksti letrar e brenda domenit të tij, akoma më i veçantë shfaqet teksti poetik. Ky i fundit formatohet, jo vetëm sipas unit poetik të një autori të caktuar, por bart në vetvete dhe tipare të përbashkëta me *une* të tjera poetike të kohës, por jo vetëm.

Në një vorbull të tillë është mbrujtur dhe realizuar dhe poezia e Nolit. Tek ajo mund të zbulohen nënshtresa të jetës së tij personale, po ashtu dhe të bashkësisë gjuhësore dhe shoqërore në të cilën ka jetuar. Një informacion i tillë, fillimisht na reflektohet nga korpusi gjuhësor i përdorur në funksion të mesazheve që ai ka dashur të përcjellë.

Nga hulumtimi i studimeve të bëra mbi veprën dhe veprimtarinë e Nolit, kemi parë se figuracioni më i evidentuar është ai që lidhet me rrafshin fonetik dhe deri diku morfologjik të shprehjes. Për sa i përket strukturës specifike të organizimit të materialit, pothuajse nuk është thënë gjë.

Edhe në punimin e tij të doktoratës prof. Fatmir Agalliu[299], kur i referohet rrafshit sintaksor të shprehjes, shumicën e ilustrimeve i merr nga proza e Nolit.

Dihet se praktikisht gjetja dhe identifikimi i figuracionit strukturor, sidomos nëse mbështetesh në referencat klasike të përcaktimit të tij, mbetet një punë jo fort e lehtë. Nga ana tjetër, një gjë e tillë nuk paraqet saktësisht lidhjet e brendshme kohezive, pasi ato më shumë konceptohen si pasuri të njësive të veçanta.

Në rrafsh teorik mund të shprehemi se përgjithësisht përkufizimet e dhëna në lidhje me një pjesë të figuracionit letrar klasik, kanë shumë probleme. Edhe vetë ndarjet e këtij figuracioni dhe përkufizimet përkatëse sipas rrafsheve të ndryshme të studimit gjuhësor, në një pjesë të mirë rastesh janë nuk janë gjithëpërfshirëse. Po e ilustrojmë këtë pohim me disa shembuj të thjeshtë.

Në Fjalorin[300] Shpjegues të Termave të Letërsisë të vitit 1972, kur flitet për antitezën thuhet: "Një figurë letrare që vë përballë dy gjendje, dy aspekte të kundërta, për të ndriçuar më me forcë një ide kryesore[301]. ".

[299]F. Agalliu, Gjuha e Nolitnëvepratorigjinaletëtij, Toena, Tiranë, 1999. I referohemi këtij punimi, pasi ai është më i zgjeruari në aspektin e analizës së modelit gjuhësor karakteristiktë përdorur nga autori në fjalë.

[300]Botim i Universitetit shtetëror dhe Akademisë së shkencave.

[301]Fq 18

Kemi parasysh faktin se antiteza, po sipas këtij fjalori, futet në grupin e figurave stilistike. Ky fjalor i koncepton figurat stilistike si mënyra të posaçme shprehjeje, tek të cilat ndërtimi sintaksor, zgjedhja e leksikut, intonacioni i shërben një qëllimi të vetëm: ta paraqesin një ide, një koncept, një ndjenjë, me gjallëri dhe dinamizëm të veçantë[302].

Shembuj klasikë për të ilustruar antitezën janë marrë nga "Anës lumenjve" e Nolit dhe "Alarme të përgjakura" të Fatos Arapit.

Anës detit i palarë	Dhe ndiheshe
Anës dritës i paparë	i pasur në varfërinë tënde
Noli	Arapi

Duket qartë se mënyra se si janë organizuar strukturat e rrafshit sintaksor, në dy shembujt e marrë nga fjalori, janë të ndryshme njëra nga tjetra.

Në poezinë e parë vihet re se kjo figurë realizohet në sfondin e një sintagme parafjalore (anës detit) dhe një mbiemri të prejardhur me një parashtesë –kokë me nuance semantike mohuese (i palarë), dhe më konkretisht ky lloj raporti semantik i të kundërtave realizohet pikërisht nga seleksionimi jo "normal[303]" i komplementeve ***det*** dhe ***dritë*** komplementeve të tillë jo normalë për modelin valentor neutral, të paveshur me ngjyresë emotive, përkatësisht mbiemrat prejpjesorë në origjinë, të formuar me parashtesën ***pa*** me vlerë semantike mohuese ***i palarë, i paparë***.

Në poezinë e Arapit semantika e antitezës është realizuar në një tjetër perspektivë, në kuadrin e një sintagme mbiemërore. Në këtë kontekst kontrasti realizohet mes kokës kryesore që është mbiemri prejpjesor ***i pasur*** dhe komplementit të tij, sintagmës parafjalore, përkatësisht komplementit të detyrueshëm të saj ***varfëri***.

Natyrisht që është e dallueshme se strukturat janë komplet të ndryshme.

Le të marrim përkufizimin e njërës nga figurat më të përmendura, më të përdorura dhe njëkohësisht më të diskutuara akoma dhe sot siç është ***metafora***.

Po në Fjalorin të cilit iu referuam më sipër, gjejmë këtë përcaktim për metaforën: "Është një nga tropet kryesore që i jep një fjale kuptimin e një fjale tjetër. Shprehjet ***qeshet natyra, më qan zemra, e ardhme e ndritur, vullnet i çelnikët*** janë shprehje metaforike, sepse foljet ***qeshet, qan*** dhe mbiemrat ***i ndritur*** dhe ***i çelnikët*** janë përdorur me kuptim të figurshëm. [304]".

Përkufizimi është komplet semantik (me njëfarë të drejte, pasi tropet janë figura të kuptimit, sipas konceptit tradicional).

Po të vihet re në mikrostrukturë, ky përkufizim përcakton metaforën si atribut vetëm të një fjale. Për këtë arsye përcakton se p. sh. foljet ***qeshet*** dhe ***qan*** kanë kuptim të figurshëm. Mirëpo nga një analizë më e mirëfilltë gjuhësore, mund të dallohet se këtë

[302] Fq70.

[303] Kur themi këtë, kemi parasysh referencën me rrafshin neutral të shprehjes, pra modelet kryesore të përdorimit të kokave në fjalë dhe komplementeve specifike të seleksionuara nga ato.

[304] Fjalori Shpjegues i Termave të Letërsisë, fq 138.

lloj kuptimi kjo fjalë e merr pikërisht nga përdorimi i saj në një perspektivë, model, jo karakteristik për të, në të cilin kanë ndryshuar si rasat semantike normale të tij, ashtu dhe komponentët semantike karakteristike të komplementeve, që janë pjesë të këtyre modeleve.

Në "shprehjen" (sintagmën foljore më saktë) ***qeshet natyra***, folja ***qeshet*** është koka dhe ***natyra*** komplementi jo karakteristik i saj.

Modeli karakteristik i kësaj foljeje do të kërkonte një komplement me tipare semantike [+frymor], [+njerëzor], ndërkohë që këtu tiparet e komplementit natyra janë [-frymor] dhe [-njerëzor] [+vend]. Pra sipas kësaj analize këtë lloj kuptimi të figurshëm koka ***qesh*** e mori pikërisht në strukturë dhe jo vetëm.

Së dyti, në këtë përkufizim shembujt e dhënë nuk i referohen vetëm kokave foljore, por dhe atyre mbiemërore. Pra nuk bëhet një specifikim i plotë i strukturave më të mundshme të cilat mund të shprehin kuptime metaforike.

Së treti, shembujt e dhënë vërtet origjinën e kanë nga marrëdhëniet e mësipërme, por nuk kanë të njëjtin figurativitet shprehjeje. E kemi fjalën p. sh. për lokucionin foljor ***më qan zemra, e ardhme e ndritur*** etj. Struktura të tilla e kanë origjinën nga marrëdhënie të tilla, por besoj se dhe në kohën kur është hartuar fjalori forca ekspresive ka qenë zbehur ose të paktën jo në të njëjtin tonalitet si te ***qeshet natyra.***

Shembujt të tillë janë të shumtë, kështu që sugjerojmë që të kihen parasysh sidomos në praktikën e hartimit të teksteve parauniversitare, në të cilat analiza stilistike lë shumë për të dëshiruar.

Gjatë punës për të hartuar këtë punim, kemi konsultuar jo vetëm korpusin bazë letrar që na paraqet puna e Nolit, por dhe punime të ndryshme kritike, që janë bërë për të shpalosur para lexuesit të parë (por jo vetëm), vlerat stilistike dhe shumëllojshmërinë e mesazhit të angazhuar, si të poezisë së tij, ashtu dhe të prozës dhe publicistikës.

Nëse i referohemi poezisë, vlerat kryesore stilistike më të përmendura kanë qenë ato që kanë lidhje me aliteracionet karakteristike, të cilat gërshetohen me ritme dhe rima specifike në funksion të mesazhit kryesor që do të përcjellë ai. Theksi karakteristik i shqiptimit i kushtëzuar dhe nga fryma e toni i mesazhit (flámur)[305].

Gjithashtu huazimet e shumta në kuadrin e fjalëve turke, arabe dhe perse(që autori i ka justifikuar me faktin se dhe këto janë në funksion të stigmatizimit të tipareve të karaktereve, dukurive tipike të kohës[306]etj. të cilat mund të jepen më mirë nëpërmjet këtij korpusi leksikor (por jo vetëm) që për të përbënte anakroniken e kohës dhe perceptimit vetjak.).

Në rrafsh morfologjik janë vënë në dukje neologjizma të formuara ose sipas modelit të kompozitave përcaktore, ose nëpërmjet prapashtesimeve të caktuara që fitojnë vlerë stilistike.

Në rrafsh leksikor dhe morfologjik, prof. Demiraj ka theksuar faktin se ai ka përdorur mjaft neologjizma, të krijuara nga rilindësit[307], por nga ana tjetër ka dhe shumë krijime të tij.

---

[305]Xh. LLOshi, Stilistikadhepragmatika, Toena, 1999, fq 55.

[306]Republika, 4. 12, 1930, Përgjigjajonëpërdisakritikadhekëshilla

[307]Sh. Demiraj, Fan Nolidhegjuha e tij, SF, 1982 I.

Sipas tij, më të zakonshmet janë kompozitat përcaktore të cilat i grupon dhe sipas kokës drejtuese.

Nëse i bëjmë një përgjithësim kritikës mbi poezinë e Nolit, do të arrinim në konkluzionin se kjo është një poezi gati simboliste, përderisa në pah del më shumë rrafshi fonetik e deri diku ai morfologjik. Në fakt nëse i bëjmë një analizë konkretetë këtij teksti poetik, spikasin dhe elemente të tjera qe janë organizuese të gjithë materialit, në sfondin e të cilit marrin jetë dhe fitojnë semantikën-simbolike dhe ato elemente të rrafshit fonetik, për të cilat është folur më së shumti në lidhje me poezinë e Nolit.

Në vijim duam të ndalemi në disa struktura të analizuara në bazë të parimeve të një analize të mirëfillte gjuhësore deskriptive të paraqitur disi dhe më lart.

Në këtë kontekst jemi marrë pak me korpusin e foljeve të përdorura dhe mënyrën se si janë projektuar në teksturën e poezive të ndryshme.

Në bazë të teorive më të fundit gjuhësore folja shihet si gjymtyra kryesore e fjalisë dhe njëkohësisht bërthama organizuese e gjithë materialit gjuhësor.

Është veçori e stilit të Nolit në poezi, përdorimi i një game shumë të madhe foljesh, të cilat në një pjesë të mirë rastesh janë të rreshtuara njëra pas tjetrës. Kjo është karakteristikë e gjithë poezisë së tij.

Vetëm në vjershën "Anës lumenjve" janë përdorur mbi dyzet e nëntë folje, pa marrë parasysh se ndonjëra prej tyre mund të jetë përsëritur disa herë.

Një denduri kaq e madhe foljesh dhe organizimi i tyre në rrafsh paralele, të lidhura me mjete të tilla kohezive, shumica me lidhëza këpujorë, ose pa lidhëza fare, fiton vlerë stilistike, pasi semantikisht rritet informacioni që jepet (në kuadrin e procesit, gjendjes a veprimit), veprimi fiton ritëm shumë të shpejtë, duke kaluar dhe në rritje progresive deri në padurim e shpërthim në pjesë rastesh të përjetimit, mesazhit politik dhe autobiografik, që përshkon gjithë poezinë e Nolit.

Një veçori të tillë e gjejmë thuajse në çdo poezi të tij (Arratisur, syrgjynosur/rraskapitur dhe kanosur; Atje nisi, atje mbaroi/ atje krisi, atje pushoi etj)

Një modelim i tillë, argumenton dhe vërejtjen e Kutelit se një poezi e tillë ka nota buçitëse[308].

Nga ana tjetër jemi ndalur pak në cilësinë e shprehjes së këtyre foljeve. Strofa e pare e poezisë "Anës lumenjve" hapet me katër pjesore (funksionalisht të diskutueshme si të tilla: Arratisur, syrgjynosur/ rraskapitur dhe katosur), nga të cilat, dy të parat semantikisht pasqyrojnë, pa rasë vendi (që do ishte një model normal përdorimi për të: ***arratisem në Amerikë***), pa e përjashtuar edhe rasën lokative, jo të përcaktuar, por dhe statusin emocional të unit poetik, i cili është në vetën e parë (një vetë kjo mjaft e përdorur nga shkrimtarët për përshkrime të semantikave të ngjashme).

Në vargun e dytë, i cili përfaqëson një paralelizëm strukturor me të parin, vazhdon dhënia e përjetimit fizik dhe emocional po me pjesore (rraskapitur dhe kanosur).

Përdorimi i pjesores i cila gjendet dendur në poezinë e Nolit, ka një peshë të madhe stilistike, nëse kemi parasysh një nga specifikat më të spikatura të saj, sidomos në

[308]M. Kuteli, Mall e brengë, Tiranë, 1943

këtolloj strukturash, ku del si kallëzuesor i kryefjalës, që na përputhet me zërin tregimtar.

Dihet se pjesorja e ka shumë të lehtë kalimin në mbiemër prejpjesor. Një fakt i tillë theksohet dhe nga modelimi që pamë më sipër i saj, si kallëzuesor, pasi siç dihet një ndër shprehësit kryesorë të këtij funksioni (kallëzuesorit) është dhe mbiemri.

Në këtë mënyrë një denduri e tillë përdorimi, si dhe mundësia e cilësimit të gjendjes së përcjellënga pjesorja, për arsye të specifikës së mësipërme, është një gjetje stilistike e cila vetëm në dy vargje jep një perspektivë informacioni shumë të madhe dhe njëkohësisht e tipizon, nëpërmjet rreshtimit, që jep shpejtësi ritmi dhe rritje progresive të gjendjes pezhorative në këtë rast. Pra vëmë re se ky stil çon në hiperkarakterizim të njësisë dhe jep mundësi krijimi të një perspektive më të gjerë.

Duhet të kemi parasysh se vetëm në vargun e tretë, shfaqet koka foljore kryesore organizuese, që është folja ***vajtoj,*** e cila ngadalëson ritmin, pasi finalizon perspektivën e zhvillimit tëngjarjes dhe përjetimit. Kjo e fundit semantikisht përfaqëson dhimbjen që gërryen dalëngadalë dhe shoqërohet nga informues sintagma parafjalore, të cilat përcaktojnë kohën pa limit deri në infinit dhe vendin e largët gjithashtu (pa fund, pa shpresë/ anës Elbë-s, anës Spre-së).

Vetë mbiemri prejpjesor haset dendur, mirëfilli si i tillë, apo dhe kur ka marrë ndonjë formant, si në rastin e realizimit të antitezave të fuqishme të vargjeve në vazhdim të poezisë në fjalë, po dhe të poezive të tjera (E kemi fjalën për vargjet: Anës detit i palarë/ Anës dritës i paparëetj. që i analizuam dhe më lart.).

Megjithatë të gjitha realizohen nën ombrellën e sintagmave parafjalore, me tipare të rasës semantike të vendit, si atij real, objektiv, ashtu dhe atij virtual (pranë dijes i panxënë).

Në një pjesë poezish, tipikisht dhe me vlerë stilistike haset dhe urdhërorja e fortë, me nuanca padurimi dhe nxitjeje (mjetet e duhura të një poezie të tillë të angazhuar me tone të spikatura ndikuese, të gërshetuara këto dhe me elementet e rrafshit fonetik, deri në atë masë, saqë dhe një lexues i thjeshtë e identifikon ritmin dhe tonin, por jo vetëm, edhe pa e ditur titullin e poezisë se kujt autori i përket).

Urdhërorja mund të realizohet ose me format e saj klasike, por dhe me format e së ardhmes së dëftore në raste të caktuara (Do të vrasim Jezus se të kemi baba; Kryqëzoje Pilat, nëkalvarGolgotha).

Gjithashtu karakteristike poezisë së Nolit është dhe forma e së tashmes dhe së kryerës së thjeshtëtë dëftores (si aktive, ashtu dhe pasive), e cila në shumicën e rasteve shoqëron dhe format e tjera foljore, por më shumë me nuanca rrëfyese e përshkruese. Gjithsesi modeli i projektimit është i ngjashëm, pasi dhe këto forma përdoren në mënyrë të ngjeshur dhe në struktura paralele (Krishtin brenda e gjykojnë/Dhe pas ligjës e dënojnë, /E goditin dhe eshtyjnë/e pështyjnë).

Më lart në u munduam të paraqesim vetëm një pjesë të vogël të laboratorit krijues nolian në rrafsh strukturor. Natyrisht ka dhe disa elemente të tjera që mendojmë se mund të bartin vlerën stilistike për të cilën diskutojmë, të tilla si tiparet e sintagmës parafjalore më të përmendur, dativi etik, disa pjesëza emocionale në pozicionin e parakokave që përsëriten etj. , që mendojmë se mund të jenë objekt i një studimi edhe më të gjerë.

Në përfundim gjykojmë se analiza të tilla, të cilat fillojnë nga mikrostruktura, mënyra se si është organizuar ajo me mjetet karakteristike shprehëse të të gjitha rrafsheve të shprehjes, mund të na japin mjaft të dhëna për stilin adekuat të çdo shkrimtari.

Për hir të së vërtetës mendojmë se studime të tilla mungojnë dhe për shkrimtarë të tillë të mirënjohur siç është dhe Noli, Migjeni, Koliqi dhe aq më tepër Camaj, ndaj dhe sugjerojmë aplikimin e metodave të reja të studimit të korpusit gjuhësor në përgjithësi dhe rrafsheve neutrale të tij. Një gjë e tillë do të lehtësonte identifikimin e shmangieve të figurshme, të cilat do të karakterizonin veçoritë e stilit të çdo lloj teksti.

Dr. ELONA (BIBA) ÇEÇE

KOHEZIONI NË TEKSTIN LETRAR TË FAN NOLIT

Teksti, në veçanti teksti letrar (poetik), përbën një kategori ligjërimore, e si i tillë, përfshihet në objektin e gjuhësisë tekstuale.

Pa mëdyshje, krijimtaria poetike e Nolit mund të merret si një model i përkryer për realizimin e kushteve të tekstualitetit. Nga shtatë kërkesat e njohura nga gjuhëtarët: kohezioni, koherenca, qëllimi, pranueshmëria, informacioni, situata dhe intertekstualiteti, në këtë kumtesë kemi përzgjedhur vetëm **kohezionin,** të cilin do ta analizojmë përmes dy shkallëve:

1. Lidhjeve të drejtpërdrejta të tij me raportet gramatikore, me marrëdhëniet sintaksore;
2. Argumentimi se kohezioni s'është vetëm bashkëvajtje morfologjike, por ai ngërthen edhe instrumente të tjera si: rikthimi, zëvendësimi, riformulimi, elizioni.

Për sa i përket shkallës së parë mjeshtërinë e Nolit, (kryesisht në poezi), e shohim:

1. në përdorimin e kohezivëve të përshtatshëm, pasi ata i korrespondojnë njohjes së lexuesit dhe kjo është realizuar në mbarë tekstin poetik, nga i cili do të veçonim p. sh. : "Kënga e Salep Sulltanit", "Syrgjyn- vdekur" (Elegji për Luigj Gurakuqin) "Shpell' e Dragobisë";
2. si dhe përmes respektimit të përkimeve gramatikore: mbaresave rasore e vetore, përshtatjes së mbiemrave, lidhjeve subjekt- predikat dhe objekt-predikat sipas rendit të duhur. Natyrisht këtu një rol të rëndësishëm luajnë edhe konjektivët, si mjete lidhëse, që janë të tipit parataktikë dhe hipotaktikë (sipas gramatikës tradicionale) dhe realizojnë lidhjen mes segmenteve në nivelin e frazës.

E në këtë kuadër nuk mund të lihen mënjanë deiktikët, të cilët realizojnë raportin e thënies me situatën shoqërore, kohore dhe hapësinore prej së cilës rrëfehet.

a. rrethanat shoqërore, p. sh. shfaqen përmes kategorisë gramatikore të numrit. Në gjuhësinë tekstuale thuhet se nëpërmjet njëjësit realizohen raportet e barazisë dhe me shumësin ato të hierarkisë. Por ç'ndodh në tekstin e Nolit? P. sh. : te poezia "Marshi i Krishtit" ai alternon shumësin me njëjësin: shtro**ni** udhën me lule…/ **thirr** e **zbraz** o gurmaz…/Të adhuroj**më** me zemër…

Nga shumësi, që lidhet me një strukturë me vetë të përcaktuar dhe që përfaqëson gramatikisht masën, popullin, kalohet te njëjësi përgjithësues, ku përfshihet dhe folësi, poeti. Natyrisht këto raste vijnë përmes strukturash njëkryegjymtyrëshe, ku s'ka nevojë të përmendet vepruesi, pasi ai nënkuptohet.

Por përkundrazi, po te kjo poezi, kur poeti do ta theksojë shpëtimtarin, ndërton strukturën dykryegjymtyrëshe: Ti na **prin** dhe na **rrit**…/ Ti na **mpron**…/ Pasuri, dhe

liri, dhe fuqi ti na dhe…, ku përdorimi i subjektit, të shprehur me përemër dëftor, mbart theksin logjik.

Nga deiktikët hapësinorë te Noli, hasim ndajfojet e vendit, Të adhurojmë me zemër **këtu** e **tëhu (**"Marshi i Krishtit" **)**

Këtej ka dimrin **andej** pranverën…("Moisiu në mal")

Dhe në furtun i funtmi u shove…

Me Malon **lart** vrapove… ("Thomsoni dhe kuçedra")

Si dhe te fjalimi i Nolit i mbajtur në parlamentin shqiptar më 1924:

(Këtu ska as klasë bejlerësh…/ **Këtu** qeni nuk njeh të zonë…/ **Këtu** ambicjet janë pa fre e kufij…/ **Këtu** i padituri i di të gjitha…/ **Këtu**… është më mirë që njeriu të jetë tradhëtor…etj.

Më tej, po këtu, jepet situate kohore kemi një shembull të bukur për partinë popullore, e cila mbahet **sot** në fuqi prej bejlerëve…

…të shikojë interesat e tij, sepse kështu do të jetë i sigurt që **të nesërmen** do të prokllamohet si patriot i madh.). Ndajfoljet *këtu, sot, të nesërmen,*

Shërbejnë si deiktikë kohorë apo vendorë, por e kanë kapërcyer funksionin e evidentimit të vendodhjes dhe të kohës së zhvillimit të ngjarjes, duke kryer një funksion poetik.

Nga deiktikët tekstualë do të veçonim:

a. zgjedhjen e nyjës shquese, e cila flet për një njohje paraprake të dhënësit, poetit. Konkretisht, përdoret:

1. Emërorja e shquar:

E rrahur nga *Greku, Serbi e Bullgari…*
Se dolli *kuçedra* e errët nga nata
Me katëqind krahë *lubi e Devollit*
Stihia shqiponjë (Thomsoni dhe kuçedra")

2. Kallëzorja e shquar:

Këtej ka *dimrin* andej *pranverën*

Kërkon *parajsën,* vdes në *skëterën* "Moisiu në mal"; Kërkon *vatrën* edhe nderë ; Diell për *vllanë,* yrnek për *fqinë* "Hymni i flamurit"; *Në skëterën,* katran e tiran, u harbofsh…"Marshi i barabbajt"; Kërkon *vatrën* edhe nderë… "Jepni për nënën".

b. Alternimi i trajtave kohore të foljeve:

1. E tashme – e ardhme, e kryer e thjeshtë te "Marshi i Krishtit" apo te "Sofokliu". Madje e tashmja përdoret për të ardhmen, (Tokën e shenjtëruar s'e *shkelni,*) te "Moisiu në mal". E tashmja shfaqet në mënyra të ndryshme, si në dëftore, në lidhore dhe urdhërore.

Përmes kategorisë gramatikore të së tashmes vjen vazhdimësia e veprimit, por përmes këtij fakti gramatikor pasqyrohet realiteti i përjetuar prej poetit.

2. E pakryer – e kryer e thjeshtë, te "Krishti me kamxhikun". Kush *fitonte* më tepër, ay ishte usta, /Dhe kush nukë *plaçkitte* ish krejt budalla. …

Me kamçik e me fshikull sarafët i *dëboj, /* Dhe nga larot gjakpirës atdhen' e *shpëtoj*.

Veprimet vërtet janë kryer në të shkuarën, por mund të jenë model për të gjitha kohërat, madje edhe për kohën reale, kur ka dalë në dritë poezia.

Gjithashtu do të ndaleshim te poezia "Anës lumenjve", ku mungesa e nyjës te mbiemrat prejpjesorë është shfrytëzuar si një efekt stilistik:

(I) *Arratisur,* (i) *syrgjynosur,* / (I) *Rraskapitur* dhe (i) *katosur*, / Po vajtoj pa fund, pa shpresë… khs. me: Anës detit *i palarë, /* Anës dritës *i paparë,* /Pranë sofrës *i pangrënë*, / Pranë dijes *i panxënë*…

Duke mos harruar që përshtatjet morfologjike te çdo folës bëhen edhe spontanisht, do të argumentojmë më tej që në tekstin letrar nolian shfaqen edhe instrumente të tjera, të cilët i japin këtij teksti kompaktësinë.

Kështu, konstatojmë se **rikthimi** është një tjetër element i kohezionit.

Në poezitë e Nolit fjalë të caktuara përsëriten në tekst për të lidhur segmentet, në rastin tonë strofat, e për të siguruar qëndrushmëri të tekstit si sistem. P. sh. te "Hymni i flamurit", fjala *flamur* përsëritet shtatë herë, pasi kjo fjalë bart peshën kuptimore. Po në këtë poezi rikthimi alternohet me **zëvendësimin**: flamuri emërtohet: *Yll i pavdekur për liri; O fushë-kuq, o shkabë-zi,* zëvendësime këto që i jepen marrësit (lexuesit) mbi bazën e një reflektimi që lidhet me kontekstin jashtëgjuhësor: mbijetesën.

Duhet të theksojmë se Noli realizon këto lloje zëvendësimesh:

1. **Me riformulim,** të cilat Dresseler i quan perifrazë, konkretisht përmes përsëritjes së përmbajtjes përmes modifikimit të shprehjes, p. sh. : te " Krishti me kamxhikun":

Sarafët i quan *parasitët gjakpirës, larot gjakpirës*.

2. **Me sinonime kontekstuale,** p. sh. : te "Marshi i Krishtit" përdor:

Çlironjës, Mesi, i bir i Davidit, i miri bari, shpëtimtar, kryemjek, kryeshenjt, kryefe.

Duke qenë se më lart, ne pamë që mbaresat foljore shërbenin për gjenerimin e strukturave njëkryegjymtyrëshe, nuk mund të anashkalojmë si një tjetër instrument edhe **elizionin** (nënkuptimin), i cili na shfaqet në poezitë e Nolit, si anforik, ku zëvendësimi pason në vargjet e tjera dhe kataforik, ku ai paraprin.

1. Për tipin e **elizionit anaforik** fillimisht, atë të tipit sintaksor, që realizohet përmes përsëritjeve, kryesisht përmes përemrave do të theksonim se në poezi, pothuajse është i pamundur; kurse elizioni semantik realizohet përmes sinonimeve, p. sh. : te poezia "Marshi Krishtit" ku sinonimet pasojnë emërtimin bazë "Mesi".



Elizionin semantik e hasim edhe te poezia “Shpell’ e Dragobisë”. Më rrallë shfaqet elizioni pragmatik, kur raportet korefernciale realizohen duke shfrytëzuar njohuritë jashtëgjuhësore të lexuesit.

2. Gjithashtu mjeshtërisht përdoret dhe **rasti kataforik,** p. sh. Te poezia “Moisiu në mal”, poeti pasi ka përdorur për të emërtuar Moisiun fjalën *krye-profet,* vetëm në strofën e parafundit, e emërton atë me emrin e tij të vërtetë Moisi. Ngjitet përpjetë Malit të shkretë, /*Krye-profeti* trim me fletë, / Të bisedojë me Perëndinë/ për Palestinë (1)

Sheh gasnë e pritmë për djalërinë/ Dhe shkretëtëtirën për pleqërinë, atje sa bukur këtu sa zi/ *o Moisi*. (2)



Së fundi, në kuadër të kohezionit, natyrisht përfhihet edhe **lidhja,** e cila sipas gjuhëtarëve si: Gleitman (1965), Lekaf (1971), Dijik(1977), mund të shprehet përmes: bashkimit, shkëputjes, kundërlidhjes dhe nënrenditjes.

Mund të themi se në tekstin poetik të Nolit, konkretisht në kushtet e poezisë ka denduri më të madhe:

a. **bashkimi,** nëpërmjet të cilit lidhen:

1. gjymtyrë, p. sh. te poezia "Marshi i Krishtit", ku lidhen objektet mbi të cilat bie veprimi:

Përmbi djall **dhe** *tiran* mbretërofsh, / *Me pean* **dhe** *temjan*, **dhe** *këmban* u këndofsh, / *Dritë* **e** *gas*, rrofsh e qofsh…,

2. ose pjesë me të njëjtin status: Ti na prin **dhe** na rrit në luadh dhe vërri, / Ti na ruan na mpron, **dhe** për ne bëhesh fli,

Po me këtë instrument poeti ynë ka krijuar edhe efekt emocional duke përdorur polisindetin, te "Krishti me kamxhikun":

Jesu Krishti s'dëgjoj, **dhe** s'e mori vesh mikun, / **Dhe** s'u unj përsëri që ta merrte kamçikun:

Dhe e kapnë kamçikun sarafët për fenë, / **Dhe** e shëmpnë çlironjësin, fenë e atdhenë.

b. **nënrenditja** është e shpeshtë, pasi realizon relacione të ndryshme të koherencës:

Je gabuar, o Krisht, **që** ke predikuar, (relacion kundrinor);
Se të marrët, të shurdhërit skanë dëgjuar. (relacion shkakor);
Ndreq kurrizin më parë, **pastaj** ndriço trurin, (relacion kohor);
Se shpirt- robi s'çlirohet askurrë pa drurin. (relacion shkakor).

Siç e shohim, kaq pak vargje janë realizuar relacione të ndryshme: ftilluese, shkakore, kohore, sipas kësaj skeme: pjesa kryesore dhe pjesa e varur e parë shërbejnë së bashku si drejtuese për pjesën e varur të dytë.

Në përfundim të kësaj kumtese, duhet të theksojmë se vërtet elementet e kohezionit mund t'i hasim në të gjithë llojet e teksteve, porse kombinimi i tyre i papërsëritshëm te Fan Noli, na çon në një probalitet të papërsëritshëm, që dëshmon edhe **kalimin nga gjuha në "metagjuhë"**, që dëshmon, natyrisht, edhe stilin e një poeti të madh dhe elegant.

GIOVANNI BELLUSCIO, FLORA KOLECI

VEÇORI LEKSIKO-GRAMATIKORE DHE STRATEGJI ORIGJINALE NË PËRKTHIMIN E "OTHELLO-S" TË FAN NOLIT NGA ANGLISHTJA

0. E hapim këtë kumtesë me dy dokumente që janë botuar me një interval gjashtëdhjetëvjetësh; bëhet fjalë për paragrafin e parë të Hyrjes së përkthimit të *Othello-s/ Otello's* nga Fan S. Noli, i pari dokumet është origjinali i vitit 1916, i dyti është përshtatja që iu bë këtij të fundit për botimin e vitit 1977[309]:



HYRJE

William Shakespeare-i, dramatisti më i math i botes pas Krishtit, lindi me 1564 A. D. nga nje familje e mire fshatarakesh te katundit Snitterfield, te vendosur ne Stratford-on-Avon.

HYRJE

Uiliam Shekspiri, dramaturgu më i madh i botës, pas Krishtit[1]), lindi më 1564 nga një familje e mirë fshatarakësh të katundit Snitërfilld, të vendosur në Stratford — on — Ajvën.

[309] Pas botimit të katërt të 1977-ës (i shënuar, gabimisht, si botim i dytë pasi tashmë ishte botuar në vitin 1960 nga e njëjta shtëpi botuese *Naim Frashëri*, e më vonë nga Rilindja e Prishtinës në 1968), *Othello* u ribotua në Tiranë nga shtëpitë botuese: Argeta 2002, Onufri 2005, Uegen 2004 dhe 2010, dhe në Prishtinë nga Vëllezërit Tafa 2009. Përveç botimit të Argetës, i cili është ribotim fotostatik i origjinalit, vetëm botimi i Uegen-it është ribotim i mirëfilltë i origjinalit të 1916-ës. Në të ripropozohet vepra e paprekur në tërësinë e saj (me të vetmin zëvendësim të grafemës <є> me <ë>, fshirjen, aty këtu, të theksave, dhe me ndreqjen e lëkundjeve në përdorimin e <r> dhe <rr>). Sigurisht, ndreqje të tilla i gjejmë edhe në botimin e 1977-ës por në vargun e një sërë ndërhyrjesh të tjera normative, që jo domosdoshmërisht ishin të nevojshme, si: heqja e plotë e theksave, rindërtimi i grupeve bashkëtingëllore, zëvendësimi i bashkëtingëlloreve të shurdhëta në fund të fjalës me të zëshmet përkatëse, mospranimi i shkronjës nistore të madhe në fjalë si Zot, Perëndi etj. , si dhe dukuri të tjera që do të analizohen më pas. Në këtë ribotim të katërt (megjthëse nuk është ndjekur një koherencë e brendshme për kthimin e fjalëve në variantin standard) duke pranuar po ato ndërhyrje, u mbështetën ribotimet e tjera të sipërmendura. Pra, pas origjinalit, duke shtuar edhe dy ribotimet e 1981-shit (Tiranë, Naim Frashëri dhe Prishtinë, Rilindja) Othello-ja u ribotua gjithsej dhjetë here.

Përqasja mes dy botimeve dëshmon qartë për ndryshimet që pësoi shqipja në hullinë e politikave gjuhësore të asaj kohe dhe teknikave të drejtshkrimit, dhe pikërisht këtu duhet të zërë fill analiza jonë[310]. Në "Parathënie" (gusht 1915), Noli e bën me dije lexuesin se veprën e ka përkthyer në pesë muaj dhe për dy muaj të tjerë[311] është marrë me lëmimin e saj, pas një periudhe qëndrimi nëntëvjeçare në Shtetet e Bashkuara (mbërriti aty në 1906, në 1912 u diplomua në Harvard, në 1915 mbaroi *Othello*-n), pra, shtatë vjet pas Kongresit të Manastirit, tre vjet pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe rreth dy vjet para Komisisë letrare të Shkodrës. Përsa i përket grafisë, Noli pranon alfabetin e Manastirit, por pa marrë parasysh rregullat normative lidhur me theksin dhe përdor gjithashtu grafemën <є>, i shtyrë, me gjasa, nga arsye tipografike (mund të hamendësohet që tipografia e Boston-it të mos ketë pasur një numër të mjaftueshëm shenjash për grafemën <ë>, e cila, sidoqoftë, del e përdorur rregullisht në fq. 3 të origjinalit për shkrimin e fjalës "Parëthënie").

1. Pjesa dërrmuese e dukurive gjuhësore që dalin në këtë vepër janë padyshim të lidhura me kodin gjuhësor në të cilin është mbështetur autori, d. m. th. në një variant dialektor toskë[312] siç tregojnë trajtat e përgjithshme të po këtij dialekti si edhe trajta të tjera si p. sh. mbaresa trajtëformuese për emrat/mbiemrat prejfoljor *–onjës*, në vend të *–ues: lakmonjєs*, mbaresa në zgjedhimin foljor me *–nj*: *lanjє, urrénj, fitónj*, shurdhimi i bashkëtingëlloreve fundore të zëshme: *njerєs, i math, funt, i lik*, përdorimi i ç-së në vend të *sh*-së: *çpєrplenj, i nderçim*, dhe të *tsh*-së/ *dsh*-së *tє ndríçime, i nderçim*, shumësi i emrave mjaft i përhapur me *–ra: kalara, drítєra, mjeshtєrirash, shakara, copra-copra* etj.

1. 1. Krahas dukurive të tilla po paraqesim edhe disa aspekte të veçanta lidhur me grafinë e përdorur si edhe luhatjet e brendshme në tekst. Noli përdor theksin e mprehtë, por jo në të gjitha fjalët, me sa duket vetëm për të treguar theksimin e rrokjes, ndonjëherë edhe me vlerë dalluese si p. sh. : *tє mє marrє* 'trajtë e shkurtër', *mє´ keq* 'pjesëz e shkallës krahasore', në raste të tjera ky përdorim del si jokoherent: *ti je senatór, ti jé Roderigu*.

1. 2. Viza përdoret sidomos si vizë lidhëse, si në rastin e kompozitave *gojє-ndyrє, krye-unjur, fat-zezє* ashtu edhe tek mënyra urdhërore e foljeve, madje këtu del më e përhapur: *sqoj-e, u-sqó*, tek mënyra dëftore *u-lutnє*, si dhe në emrat e farefisnisë kur

[310] Për këtë studim jemi mbështetur në një analizë të hollësishme të Aktit I, skena I, ndërkohë që shembuj të tjerë janë vjelur në tërë veprën.

[311] Hollësirat rreth çështjes kohore të përkthimeve jepen nga N. Jorgaqi (1987: 62) i cili sjell të dhëna të nxjerra nga *Bisedë e F. S. Nolit me shkrimtarë të rinj* e regjistruar në kasetë në vitin 1958: "Noli do të rrëfejë se punën për shqipërimet e tij madhore e filloi më 1915, në Vjenë, i nxitur nga qëllimi që t'u japë shqiptarëve një seri kryeveprash të letërsisë botërore. Këtë seri ai e nisi me 'Otellon'".

[312] Me ndonjë pikëtakim me gegërishten përsa i përket grafisë, si në shembujt: *nєr* 'ndër', *pєrmì* 'përmbi', *nofta* 'ndofta', *mi* 'mbi' etj. , ku, për rastin në fjalë, vështirë të shpjegohet reduktimi i grupeve bashkëtingëllore: *nd* e *mb*.

shoqërohen me përemra pronorë: *ime-bijϵ*, *im-mϵ*; është me vend të theksojmë se Noli ruan origjinalin e emrave të huaj[313] të përveçëm duke ndarë me vizë paradigmat e shqipes: *Shakespeare-i*, *Droeshout-it* etj. Përsa i përket apostrofit, haset një përdorim mjaft i gjerë në krahasim me rastet e përdorimit të sotëm; veç rasteve normale, ende në përdorim, si ndarja e pjesëzave mohuese (*s'do*, *s'kam*) apo e trajtave të shkurtra (*t'i*) dhe e përemrit *ç'* (*ç'jam*) etj. , gjejmë edhe këto shembuj: a) trajtat e shkurtra të bashkuara: *m'a*, *t'a nxier*, b) forma joveprore me trajtën e shkurtër: *i' u-lutnϵ*; c) përemri i pacaktuar: *ç'farϵ*; d) rënia e fonemës /ə/: *t' ϵmbϵla*, *t' anϵ* (= të atin), *desha t' isha*, *burr' i tillϵ;* e) dukuria e izafet-it: *madhim' i shkallϵs*, *mϵndj'e tij; mburj' e zbrazϵt*; si edhe në vend të vizës për urdhëroren: *ler'i*, *helmoj'a gazin*.

1. 3. Përsa u përket luhatjeve në përdorimin e shkronjave shënojmë si shembuj përzierjen e fonemave /ɾ/- /r/: *marrtohej*, *murret*, *bϵrrtit*, *mbarron*, *u-mbarua*, *rugϵs*, *régullat*, *çjerϵ*, *mburj'*, *rϵzik*, *tmeruar*; /l/-/ʟ/ (më e kufizuar si dukuri): *fllota*, *pllane*, *mithollogjisϵ*, *parollϵn* (< ital. parola '*fjalë'*), por, nga ana tjetër, *pilot*, *republikϵ*; /ʃ/-/s/: *shkena*, *shqota*, *shigur*, *shedje* (< ital. sedia '*karrige'*), *tϵ shprovuar*. Përveç këtyre, vihet re edhe përdorimi dialektor i fonemës /ə/ në kontekst hundor: *zϵmϵr*, *zϵmϵruar*, *mϵnç*, *mϵndj'e tij* si edhe rënia në pozicion të patheksuar (të brendshme dhe fundore) *dbohen*, *prralla*, *un' i mjeri*, *gishtϵrínjt'* (por *zotϵrínj* etj.).

1. 4. Lidhur me pikësimin, është e qartë që gjatë përkthimit të një vepre nuk mund të mbahet pikësimi i origjinalit, sidomos për faktin e thjeshtë që çdo gjuhë ka rregullat e veta lidhur me këtë, prandaj është e natyrshme të gjejmë jo pak ndryshime mes veprës origjinale dhe përkthimit. Në këtë rast, duke u mbështetur në një botim çfarëdo të *Othello*-s (d. m. th. pa e marrë parasysh *In folio*-n origjinal) mund të vihet re aty për aty sesi përdorimi i pikësimit nga ana e Nolit del më i pasur në krahasim me origjinalin, sidomos në përdorimin e pikëpyetjes dhe pikëçuditjes; nga ana tjetër ka shumë ndryshime midis përkthimit të Nolit dhe botimit të dytë. Po japim vetëm një shembull nga akti I, skena 1, për të ilustruar këto kapërcime nga origjinali anglisht në dy botimet e përmendura:

[313] Kjo çështje ngjall diskutime edhe sot e kësaj dite ndër gjuhëtarët shqiptarë. Sipas drejtshkrimit të 1972-shit, emrat e përveçëm të huaj duhet t'u nënshtrohen rregullave të shkrimit të tyre sipas shqiptimit. Kjo përshtatje vihet re në ribotimin e dytë të veprës siç dëshmohet në dokumentin e sjellë në krye të këtij punimi. Le t'u referohemi shembujve të marrë nga Hyrja e 1916-s *Shakespeare-i > Shekspiri, James I > Xhejms I, King's Servants > King's Servënt, Stratford Church > Stratford Çërç, Droeshout-it > Droshoutit, John Hemming dhe Henry Condell > Xhon Hemingut dhe Henri Kondellit, Macbeth > Makbethi, Othello > Otelloja, Julius Caesar > Jul Cezari, Giraldi Cinthio > Xhiraldi Çintios.*

I take it much unkindly / That thou, Iago, (...) shouldst know of this. (1914)

Jam zɛmɛruar shumɛ / Qɛ ti, Iago, (...) t'a kesh ditur kɛtɛ, - (1916)

Jam zemëruar shumë / Që ti, Jago, (...) ta kesh ditur këtë? – (1977)

2. Në një vështrim të përgjithshëm interes të veçantë paraqesin pesëdhjetë e dy fusnotat e sjella nga Noli, si për shpjegimin e kuptimit të fjalëve të ndryshme (arkaizma, neologjizma etj.) rreth aspekteve kulturore të kohës së Shakespeare-it, ashtu edhe për të sqaruar lexuesin lidhur me zgjedhjet e tij për variantet ku është mbështetur. Fusnotat mund të ndahen në tre grupe: a) shpjegimet lidhur me përkthimin dhe përdorimin e teksteve origjinale; b) shpjegimet kulturore të paqarta për efekt të largësisë kohore; c) shpjegimi i disa fjalëve të veçanta e me përdorim shumë të rrallë, kryesisht atyre me prejardhje të huaj.

2. 1. Që në krye të veprës Noli përpiqet të shpjegojë në mënyrë më të hollësishme personazhet si edhe marrëdhëniet e tyre me kontekstin historiko-politik-gjeografik ku zhvillohen ngjarjet, duke përligjësuar njëkohësisht edhe zgjedhjet e tij vetjake me qëllim përafrimin e dallimeve kuptimore mes kulturave të ndryshme:

14, 1[314]- Ktheva fjalɛn inglishte lieutenant (mylazím) me fjalɛn LEFTENAR. Kasi ɛshtɛ i pari oficér pas Othellos, ɛshtɛ njɛ soj muavini a ajutanti i gjeneralit.

14, 2- Iágua ɛshtɛ njɛ nɛnoficér i Othellos, ɛshtɛ njɛ soj baush-çaushi nɛ shɛrbím tɛ gjeneralit.

14, 3- Duka i Venetikut 'Republika e Venetikut qeverisej prej njɛ senati, me Dukɛn (italísht Doge) nɛ krye. Brabanti, i at' i Desdemonɛs, ɛshtɛ njɛ nga senatorɛt.

14, 5- Gastor 'Gastori qé shakaxhiu i palláteve dhe i shtɛpive tɛ mɛdhá. Frɛngjísht "bouffon"

14, 6- Qipro 'Qíprua, si dhe gjithɛ nisít' e Detit Bardhɛ, qenɛ nɛ duar tɛ Republikɛs sɛ Venetikut n'atɛ kohɛ'

Po në këtë grup bëjnë pjesë shpjegimet lidhur me përzgjedhjen e teksteve origjinale të veprës, siç tregon fusnota 2 në faqen 34 ku Noli, duke arsyetuar rreth përdorimit të fjalës *tɛ púthura* tregon arsyet përse parapëlqen këtu tekstin F1 (domethënë *First Folio*) përkundrejt botimit "*In Quarto*"[315]: "*Disá tekste tɛ vjetra tɛ Othellos japin*

[314] Numrat u referohen faqeve dhe fusnotave përkatëse të origjinalit.

[315] Megjithatë, përkthimi i Nolit mbështetet në të parin *In Quarto*. Botimet e shekullit XVII mund të konsultohen këtu: http: //internetshakespeare. uvic. ca/Library/facsimile/book/SLNSË_F1/818/? work=Oth

"sighs" (psheretime)... " faktikisht mbështetet në mendimin e prof. Alxander Beljame-it (1842-1906) sipas të cilit "*editorєt e pastajmє hoqnє tє púthurat dhe vunє psheretimet nga hypokrisia*".

2. 2. Në dy prej fusnotave (ff. 77 dhe 105) Noli flet për vështirësinë e përkthimit të "lodrave fjalësh" (anglisht 'puns') dhe informon lexuesin "*qє nukє munt tє kthehen nє njє gjuhє tjatєr*" megjithëse ai vetë mundohet në një farë mënyre t'i përshtasë në shqip: bëhet fjalë për "tail / tale" (CLOWN**:** Oh, thereby hangs a tail. MUSICIAN: Whereby hangs a tale, sir?) dhe për "I dare not say he lies anyëhere. " ku "lies" ka kuptimin "*rri, shtrohet*" (Noli e përkthen me "*flé*") por edhe "gënjen".

Në grupin e dytë bëjnë pjesë ato shpjegime që Noli i sjell për t'u paraprirë vështirësive që mund të haste lexuesi shqiptar i asaj kohe lidhur me zakone të ndryshme dhe me koncepte fetare ose mitologjike:

> 53 *puthur... gishtєrínjt' e tu* 'Qé zakoni ahere qє burri tє puthte gishtєrinjtє, me tє cilєt zinte doren e njє Zonjє'
>
> 42, 2 *Nє i vєnç dot brinjє*[316] 'Njє njerí i vє brinjє njє tjatri kur e ujdís me tє shoqen e tij' (shpjegim tjetër lidhur me këtë kuptim: 90, 2 *Brinjari* 'Burri, tє cilin e shoqja e gєnjen me njє tjatєr'
>
> 99 *Jovit Perєndí* 'Jovi a Jupiteri qé i pari i Perєndive... hithte rrufetє'
>
> 158, 2 *Prometheu* 'Prometheu qє njє nga Titanєt e mithollogjisє greke qє vodhi zjarrin nga qielli dhe ua dha njérєsve'
>
> 38, 2 *Kupidit* 'Perєndí' e Dashurisє'
>
> 34, 1 *njerєs t' egєr q'e kanє kokєn nєnє́ supєt* 'Nє kohє tє Shakespeare-it besohej qє kish njerєs tє tijє'
>
> 175 *E shoh nє kєmbєt* 'Nє kóhєrat e vjetra besohej qє djalli kish kєmbє si tє cjapit'
>
> 54, 3 *Ferri* 'Xhenemi' (por pa shpjegim në faqen 42).
>
> 148 *Purgator* 'Purgatori, pas Kishєs Katholike, єshtє vendi ku shkojnє shpirtet... '[317]

[316] Shakespeare-i përdor "cuckold" (*If thou canst cuckold him*) po me të njejtin kuptim që Noli jep në fusnotën përkatëse, por del qartë fakti se përkthimi i lidhur me fjalën '*brinjє'* duhet të ketë lidhje me shprehjen italisht 'fare le corna', 'essere cornuto' edhe pse nuk mund të thuhet nëse Noli e ka hasur në ndonjë përkthim italisht të asaj kohe, gjë që mund të ketë qenë e mundur, meqë, siç dëshmon Jorgaqi (1987: 63), "(...) duke qenë poliglot, Noli kur shqipëronte një vepër përdorte dhe përkthimet në gjuhë të tjera, për të njohur nga kjo përvojë analogjitë e dallimet gjuhësore e kuptimore të tekstit".

[317] Shpjegimi me sinonimin turk, si edhe perifrazimi për fjalën *Purgator*, padyshim sillen me qëllim që të kuptohen nga lexuesit e besimit mysliman.

Të gjitha këto fusnota, mjaft të dobishme si për analizën e tekstit të përkthyer, ashtu dhe për njohjen me strategjitë përkthimore të Nolit, fshihen fare në botimin e 1977-ës, duke u shkrirë në një farë mënyre me tekstin e plotë. Sidoqoftë, mbetet e paqartë arsyeja se pse Noli, në përkthimin e tij, shpeshherë, nuk përzgjodhi një terminologji me përdorim më të gjerë e më të ngulitur, por parapëlqeu arkaizma, të cilat kërkonin medoemos shpjegimet përkatëse në fusnotë. Lista e gjatë leksikore paraqet dy lloje shënimesh: a) shpjeguese, nëpërmjet të cilave jepen sqarime të shkurtra terminologjike: 16 *konsujt e republikɛs* 'Senatorɛt e Republikɛs', 20, 1 *bɛjnɛ kafshɛn me dy kurrize* 'Domethɛnɛ flenɛ bashkɛ si burr'e grua', 21 *Shigjetores* 'Shigjetorja nofta qé njɛ vɛnt ku stɛrvíteshin pɛr tɛ shtɛnɛ me shigjetɛ', 38, 3 *Farásh* 'Me farashin gratɛ mbledhin e hedhin plehɛt', 38, 4 *helmenɛ* '... mbulesɛ koke prej çeliku qɛ mbanin luftɛtarɛt; greqisht PERIQEFALEA', 40 *kɛtú e katɛr herɛ shtatɛ vjet* 'Domethɛnɛ, kɛtú e njɛzét e tetɛ vjet', 54, 1 *eskortɛ* 'Ushtarɛ dhe njerɛs pas', 65 *ekinoksi* 'Kur nata ɛshtɛ tamám sa dita; greqisht ISIMERIA', 90, 2 *Brinjari* 'Burri, tɛ cilin e shoqja e gɛnjen me njɛ tjatɛr', 90, 1 *viktimɛn* 'Gjahu qɛ i ka rɛnɛ nɛ dorɛ'; b) sinonimike, pra shënime, nëpërmjet të cilave ofrohen sinonime fjalësh, me qëllim që të lehtësojnë kuptimin e termave të caktuara (gjenden mes tyre edhe sinonime origjinale nga gjuhët e tjera, si greqisht e frëngjisht, që autori i vlerëson si të nevojshme): 14, 4 *Kasnec* 'Telláll', 20, 2 *pɛrmetuat* 'Pɛrmetonj, jap leje, izɛn', 24 *galérat* 'Anie lufte', 37, 1 *fushɛs* 'Fush' e luftɛs', 37, 2 *konfortet* 'Rahatlleke', 38, 1 *lafti* 'Lavdia', 42 *marrtesa e lavɛr* 'E lidhur lehtɛ', 54, 2 *shqotɛ* 'furtunɛ', 58 *vrer* 'helm', 59, 1 *triúmf* 'Fitím i math', 59, 2 *dostongale* 'Zjarre gɛzimi', 75 *rjetɛn* 'vegla me tɛ cilɛn zihen pishqit', 101 *mɛ rrén* 'Mɛ gɛnjen, ɛsht e pabesɛ', 155 *shedje* 'koçí', 102 *dradhera* 'Luleshtrydhe', 136 *lavirɛ* 'Kurvɛ e çjerɛ', 141 *murgeshɛ* 'Kallogré', 149 *tɛ dlirɛ* 'Tɛ paqme, tɛ pastɛr', 158, 1 *Yj tɛ qastɛr* 'Tɛ spastɛr, tɛ paqmɛ', 178 *rrɛshirɛn* 'Reçinɛ'. 54, 3 *Ferri* 'Xhenemi', 55 *kɛshtjellɛs* 'Konák, frɛngjisht CHATEAU', 56 *avanta* 'Frɛngjísht AVANTAGE', 57 *parollɛn* 'Fjala e fshehtɛ e ushtárɛve qɛ rúajnɛ', 107 *zɛmɛr liberale* 'Dorɛhapur'.

Një përdorim kaq i gjerë i shënimeve nga ana e përkthyesit (kur ato mungojnë në veprën origjinale), dëshmon, deri diku, pasigurinë në përzgjedhjen e fjalëve, gjë që, me sa u tha më lart, nuk është krejt e justifikueshme. Në shumë raste, siç tregojnë shembujt e marrë në analizë, propozimi i disa fjalëve sinonime është i panevojshëm. Ndryshe qëndron puna kur lexuesit shqiptar i sillen shpjegimet e duhura për një kuptim sa më të mirë të tekstit. Është me vend të përmendim këtu, se edhe në botimet njëgjuhëshe (kemi parasysh këtu serinë *The Pelican Shakespeare*), norma e do që të sillet një aparat kritik shkencor që t'i vijë në ndihmë lexuesit për të kuptuar si gjuhën ashtu dhe kontekstin kulturor të autorit.

2. 3. Ashtu siç del në origjinal, Noli përpiqet të ruajë sa më mirë paraqitjen e pjesëve poetike brenda tekstit, të cilët, në përqasje me vepra të tjera të Shakespeare-it, këtu shfaqen mjaft rrallë. Tekstet poetike dallohen nga përdorimi i shkronjave të pjerrëta (por ka edhe disa përjashtime si në faqet 39, 63 'gostia', 64) ku Shakespeare-i ndërfut disa vargje dyshe të shkëputura prej njëri-tjetri, për të cilët Noli kujdeset veçanarisht për ruajtjen e rimës, megjithëse e kundërta ndodh në rastin e dyvargëshave në faqen

tridhjetë e nëntë ku, duke respektuar origjinalin anglisht, nuk përdor shkronjat e pjerrëta ashtu siç nuk respekton as strukturën ritmike origjinale:

If virtue no delighted beauty lack,
Your son-in-law is far more fair than black.
Nє qoftє, Zot, se ka njє bukuri virtyti,
Dhєndєri juaj єshtє mє i hieshmє
Se sa i zi. (I, 3)

I have't; it is engender'd: hell and night
Must bring this monstrous birth to the world's light.
E gjeta; – zuri fara; – Natє dhe Skєterrє,
Mє ndihni qє t' a lint kєtє' kєlýsh kuçedre. (I, 3)

If she be black, and thereto have a wit,
She'll find a white that shall her blackness fit.
Në qofsh e zeshkє dhe e urtє, mos kij frikє,
Se njє i bardhє do t'tє marrє dhe pa prikє. (II, 1)

She never yet ëas foolish that was fair
For even her folly help'd her to an heir.
Nє qoft' e bukur dhe e marrє
Njє trim tє pasur do të marrє. (II, 1)

There's none so foul and foolish thereunto,
But does foul pranks which fair and wise ones do.
S' ka patur vajzє tє shєmtuar e tє marrє
Qє s' gjeti njє tє bukur, t'urtє dhe tє mbarє. (II, 1)

Në aktin I, 2, ndeshim një krijim tjetër në vargje, i cili konsiderohet edhe si sonet i pambaruar (megjithëse sonetet kanë një strukturë rimike të alternuar me një mbyllje me rimë të puthur), ku Noli paraqet aftësinë vetjake në rikrijimin e rimave (AABBCCDDEEFF), rindërtimin e disa strukturave të brendshme të shqipes pavarësisht nga trajtat përkatëse të origjinalit, d. m. th. atje ku zhduket diçka nga origjinali ai mundohet ta zëvendësojë nëpërmjet brumit të gjuhës së vet amtare. Nga pikëpamja e metrikës, Noli arrin t'i afrohet origjinalit megjithëse në llogaritjen e vargjeve të përkthyera ka edhe ndonjë lëkundje. Më poshtë po japim si shembull vargun e parë të lëvdatës së Desdemonës nga ana e Iago-s (II, 1):

She-that-wa-se-ver-fai-rand-ne-ver-proud, (11 rrokje[318])
A-jó-q(ë)ësh-te-bu-ku-re-dhé-jo-kre-na-re, (12 rrokje)

[318] Duke konsideruar mbylljen e vargut me rrokje të theksuar.

3. Ta konsiderosh çështjen leksikore si lëmin kryesor ku sprovohet një përkthyes, do me thënë të ndalesh medoemos në analizën tipologjike leksikore[319] të origjinalit dhe të peshosh mundësitë përkthimore që ofron gjuha pritëse. Në rastin tonë gjendemi përballë një gjuhe në përpunim e sipër (Genesin 2002), e cila ende nuk e njeh kanalizimin e një marrëveshjeje të përbashkët e të standardizuar as gramatikore dhe as leksikore. Autorë si Noli në jug dhe Fishta (Koleci 2009) në veri të Shqipërisë, ushqehen nga humusi gjuhësor i origjinës duke përcjellë në veprat e tyre ato veçori gjuhësore që mbart ky humus vetjak, i filtruar dhe integruar deri diku me një traditë gjuhësore që merret si pikë referimi apo si busull orientuese. Kështu, Noli shkrimtar (që asokohe kishte shkruar vetëm *Izraelitë dhe Filistinë* 1902, botuar më pas në vitin 1907) gjatë punës së tij përkthimore, i jep jetë një shqipeje kaq të rafinuar, falë të ushtruarit të vazhdueshëm si gazetar dhe publicist, dhe hulumtimit të gjuhës së Shakespeare-it falë njohjeve të shumanshme gjuhësore prej poligloti dhe njohjes së përkryer të anglishtes, të cilën e përsosi gjatë qëndrimit të tij në Shtetet e Bashkuara. Pavarësisht të gjithave, autori ynë e gjen veten përballë vështirësisë së kapërcimit të vazhdueshëm të kufirit, prej njërës gjuhë kulturalisht më të përpunuar, drejt asaj të vetës, në përpunim e sipër. Vështirësia qëndron, veçanarisht, në përkthimin e njësive jo të njëvlerëshme (si në leksik, ashtu edhe në referime kulturore të papërputhshme) mes gjuhës së nisjes dhe asaj të pritjes, ku vëmendje tërheqin këto lloje lidhjesh leksikore: a) përputhje e plotë, b) përputhje e pjesshme, c) mospërputhje, shembuj rreth së cilës janë sjellë më lart. Është me interes të theksojmë se Noli, për raste të tilla, mban më së shumti një qëndrim konservator sesa inovator dhe parapëlqen ta kthejë shikimin pas, në kërkim të termave jo fort të zakonshëm e jo rrallë të vështirë, aq sa sot (siç e kemi thënë), një lexues i rëndomtë do të kërkonte shpjegim rreth kuptimit të tyre, siç dëshmojnë këto shembuj[320]: *nisì* '*vjet*. ishull, ujdhesë', *qipi* 'kepi', *mandragora* (< lat. Mandragora L. , për 'madërgonë me sinonime kruspulluk, plaku, bari i trashë, duhan i egër' sipas *Fjalorit të gjuhës shqipe*, 1980), *çilimì* 'fëmijë i vogël, kalama', *kuletє* 'portofol', *pєrfryra*, *besєrisht* 'besnikërisht', *galat* 'stërqokë', *ndalím* 'pengesë', *azgєn* (për angl. lascivious = leëd; *azgën* në *Fjalorin e gjuhës shqipe* 1954, *azgan* në *Fjalorin e gjuhës shqipe*, 2002 'shtatlartë'), *u-mejtova* 'u mendova',), *kєnduar* 'lexuar', *pєqír'* 'prehër', *e palumur* 'e palumtur', *pєrhiroj* 'përgëzoi', *shpeditє* 'ekspeditë', *barra* (që përkthen orig. *charms* 'hajmali' pra nje zgjerim kuptimor i cili është keqinterpretuar si 'barëra' në ribotimin e 1977 (< *barna, me *-rn-* > *-rr-*, ose ndoshta si rezultat i fshirjës së *ë*-së së patheksuar < barëra) patjeter me kuptimin "ilaç". Por në aktin I, 3 "*pєr tє pirє ndocá barra*" faktisht kemi kuptimin e mirëfilltë "barëra", pra në f. 41 *tarrim barrat e єgєra* 'tëharrim barërat e egra'; në këtë rast, si në shumë raste të tilla, jemi para një rrafshimi të ndryshimeve terminologjike të

[319] Disa aspekte që i përkasin fushës leksikore, janë trajtuar pjesërisht në paragrafin paraardhës 2.

[320] Është e rastit, këtu, të propozohet mendimi i Jorgaqit (1987: 58) kur shkruan për metodën e përzgjedhjes së leksikut: " Interesimi i Nolit për fjalën vërehet dhe me kujdesin që ka treguar për të gjetur dhe mbledhur në kohë dhe vende të ndryshme. Për këtë, mjafton t'u hedhim një sy fletoreve dhe skedave të tij, ku gjejmë ndërmjet të tjerash fjalë e frazeologji të tilla si *liparak, shelbonj, mëlli, thërpinj, thep, gllënjkë, gërdallë* etj. "

origjinalit, gjë që shprehet në anën tjetër me përkthime të ndryshme të së njëjtës fjalë të origjinalit si në këto raste: Zounds! '*ju marrtë e mira! '* dhe '*për kokën tuaj*', Fareëell 'me *shëndet'*, '*tungjatjeta'* dhe '*rri me shëndet*'.

Pjesa dërrmuese e mospërkimeve është lidhur sidomos me disa shprehje tipike, me fjalë të urta, me mallkime (Despise me '*Mɛ humptɛ shpirti*'), urime (God be with you! *U trashɛgofshi! ,* God save you *Gɛzuash!),* pasthirrma etj. , në këto raste përkthyesi mundohet të rikrijojë në gjuhën mbërritëse nuancat e origjinalit për t'i ofruar lexuesit një vepër sa më të afërt me shijen gjuhësore dhe kulturore të tij. Në këtë kontekst, duhen mbajtur parasysh edhe referime të përpikta të zakonit shqiptar të besës dhe të ligjit kanunor, gjëra që, kuptohet vetiu, nuk mund ta kenë prejardhjen prej origjinalit: *s' m' a mban besɛn, pɛr besɛn time, mos u kini besɛ* (= mos u besoni), *burr' i besës, e pabesɛ, pas librit tɛ pɛrgjakshim tɛ kanunit, pas kanunit, e do kanuni,, tɛ pakanunɛshme, i more gjakun mikut*.

Po ashtu, ka edhe raste të tjera, më të përgjithëshme, të cilat janë ruajtur edhe në botimin e dytë, por që nuk dalin aq të natyrshme për lexuesin e sotëm: *Ua kthen nga myka miqve* (ia ktheu krahët), *Atɛr si kushɛrínj dhe pela si kushɛrira* (angl. 'Cursers for cousins and gennets for germans'), *híqmɛni nɛ gjyq* (për 'më çoni në gjyq'), *s'mɛ jep asfare dorɛ* (për 's'më levërdis'), *s'mɛ ha malli* (për 's'më ha meraku').

4. Një vështrim i vëmendshëm ndaj gjuhës së Nolit, do ta ndihmonte studiuesin të zbulonte përtej veçorive të përgjithshme (të cilat nuk është rasti t'i rendisim këtu), edhe ndonjë tipar të veçantë, që shërben si tregues i rëndësishëm për gjendjen dhe orientimin e një kahu domethënës të shqipes si në rrafsh kohor, ashtu dhe gjeografik. Duke lënë mënjanë tregues të përgjithshëm dialektorë, jemi përqendruar së pari a.) në analizën e disa të dhënave morfologjike si: trajtat e formimit të shumësit; veçori të rasës: rasti i rrjedhores, dhanores etike, vendores; trajta e emrit; nyja: mungesa e saj; koha e ardhme: format e ndërtimit dhe nuancat kuptimore të saj; foljet gjysmëndihmëse me dhe pa fleksion etj. dhe b.) në një analizë të shkurtër sintaksore që ka të bëjë kryesisht me rendin e përbërësve në frazë si dhe me ndërtimin e ndonjë lloji të veçantë fjalie, si p. sh. ajo kushtore, pa anashkaluar edhe rolin që luajnë ndërtime të veçanta sintaksore në ruajtjen dhe përcjelljen e kuptimit nga origjinali drejt veprës së përkthyer.

4. 1. Trajtat e shumësit në gjuhën e Nolit janë të larmishme dhe shpeshherë rishikohen në ribotimin e dytë, për t'iu përshtatur variantit standard, siç dëshmojnë këto shembuj: *terme > terma, xhepet > xhepat*; *trɛndafile > trëndafilë, dýertɛ > dyert, polica > policë*, por ndodh edhe e kundërta, ku ribotimi i shmanget standardit si në: tɛ krishtera > të krishtere apo ruhen të njëjtat trajta si në origjinal, të cilat nuk u nënshtrohen rregullave të standardit: *kalara, perɛndira, copra-copra, drítɛra, skllevɛt,* etj.

4. 2. Përsa i përket rasës, ashtu siç mund të pritet në një ligjërim poetik, gjejmë të përdorur shpesh dhanoren etike. *Njɛ mburj' e zbrazɛt pa praktikɛ fare/ Tɛ ɛshtɛ gjithɛ mjeshtɛrí e tij luftare;* Tɛ bɛhen zotɛrinj; *mɛ ardhe* etj.

Për ndërtimin e trajtave të rrjedhores, përdoret dendur mbaresa e vjetër *–sh* përkundrejt asaj më të resë *–ve*: *prej njérɛzish, oxhák prej mbretɛrsh, nɛpɛr mes*

ndalimesh, i plagosur *prej katilєsh,* por njëkohësisht vihet re mosrealizimi morfologjik i saj në ndërtime të tilla si: *ç'farє mall, ç'fare njerí,* të cilat ruhen të pandryshuara në botimin e dytë.

4. 2. 1. Interes të veçantë paraqet përdorimi i rasës vendore, një trajtë e vjetër e shqipes mjaft e përhapur në të folmet e sotme arbëreshe. Tek Noli e gjejmë në trajta të tilla si: *єshtє nisur pєr Qipron, nє rugєt,* të cilat duhen dalluar nga ndërtime në dukje të njëjta si: *nєsєr nє mєngjést,* ku *t*-ja del si shprehëse e gjinisë asnjanëse, ndryshe nga shembulli paraardhës, në të cilin përdoret për ndërtimin e rasës vendore.

4. 3. Në lidhjen e emrave me fjalët përcaktuese, qofshin këto mbiemra, përemra apo emra të rasës gjinore, herë-herë vërehet mungesa e nyjes siç dëshmojnë këto ndërtime: *pєrpara dashurisє tij, Zonjєs saj, burrit saj, shqerєs bardhє suaj, babajt saj,* e nga ana tjetër përdorimi redondant i saj, kryesisht në ballë të përemrave pronorë si në: *helmi i veçant' i im;* po ashtu, vlen të theksohet fakti se trajta të veçanta të nyjes, mund të jenë përdorur për efekt aliteracioni si: *shoqєs sime sє lart' e sє shkєlqyer* ku bie në sy ndërthurja tingëllore *sh-s-s-sh.*

Përdorimi i trajtave të pashquara emërore në vend të atyre të shquara, është një dukuri tjetër që vihet re në lidhjen e emrit me fjalë të ndryshme përcaktuese, kryesisht përemra, si në këto shembuj: *nє shtєpí time, nє shtrat tim.*

4. 4. Përsa i përket kohës së ardhme, Noli përdor dy lloje trajtash foljore, e para *do+të+ folje (Po ç'do tє ngjasє, po tє qe ashtú siç thoni ju?*), e cila jo rrallë del edhe pa përdorimin e pjesëzës të: *do+folje* (*do trokás mє çdo shtєpí*), siç vihet re edhe në përdorimin e sotëm bisedor. Trajta tjetër e cila tërheq vëmendjen e lexuesit të sotëm është ajo e formuar nga folja *kam+paskajore*: *Ç'kam pєr t'i thєnє Dukєs qє mє pret nє çast*. Kjo dukuri habit për faktin se është përdorur në mënyrë krejt të natyrshme, larg shtërngesave normative të mëvonshme dhe nuk mund të shihet as si ndërtim i sforcuar nga trajta origjinale *I have+infinit,* pasi autori mund të sillte trajtat *kam+lidhore,* siç haset rëndom në të folmet arbëreshe, p. sh. *kam të vete*, edhe pse aty ruhen disa trajta të ngurosura të tipit *për me+pjesore: për me ngrënë* (Altimari 2010) etj. Të dhëna të tilla, edhe pse jo shterruese, na ftojnë të reflektojmë rreth ndërtimit të këtyre trajtave të së ardhmes, nëse duhet t'i shohim ato si përftime të natyrshme, apo të ndërtuara artificialisht, siç shprehen disa studiues. Mund të themi se këto dy trajta nuk përdoren si variante të njëra-tjetrës por mbartin kuptime semantike të ndryshme, e para (*do+të+folje*) përdoret me kuptimin e mirëfilltë të së ardhmes kurse, së dytës, veç kuptimit të së ardhmes, i mbishtohet edhe një nuancë kuptimore domosdoshmërie që del e qartë nga konteksti: *kjo gjє ka pєr t'i sjellє njє ndalím,* megjthëse, në mungesë të përdorimit të kësaj strukture, Nolit i vijnë në ndihmë trajta leksikore që mbartin kuptimin e domosdoshmërisë si në: *do t'a ndrronjє doemós* dhe jo *ka për ta ndërruar[321]. Duke e përqasur me veprën origjinale vihet re se ndonjëherë Noli e përdor trajtën *kam+paskajore* edhe në ato raste kur ndodhet përballë ndërtimeve të së tashmes, si p. sh. 'I do confess' (d. m. th. *po ju rrëfej*) *kam pєr t' ju rrєfyer*.

[321] Duhet bërë e qartë se të dhënat e marra në shqyrtim nuk janë ende të mjaftueshme për të arritur në përfundime përgjithësuese.

4. 5. Foljet gjysmëndihmëse, ndryshe nga përdorimi i sotëm, ndonjëherë dalin të pashtjelluara e herë të tjera me fleksion vetor si p. sh. në:

S'munt tɛ jemi zotɛrinj
zotɛrinjtɛ mundin tɛ shɛrbehen

Lidhur me foljet ndihmëse disa herë vihet re zëvendësimi i foljes 'kam' me foljen 'jam', dukuri kjo jo e zakonshme për shqipen dhe për të cilën është vështirë të japim shpjegime:

(...) nɛ lúftɛrat e Qipros
Tɛ cilat janɛ nisur (...)

5. Përsa u përket strukturave sintaksore dhe aspekteve të ndryshme lidhur me to, jemi ndalur në mënyrë të veçantë në dy çështje që tërheqin vëmendje si: rendi i përbërësve të fjalisë dhe ndërtimi i fjalive, kryesisht atyre kushtore. Duhet mbajtur parasysh se këtu kemi të bëjmë me material të tipit letrar, me gjuhë të shkruar dhe me trajta tipike të ligjërimit poetik, kështu që gjatë kësaj analize janë lënë mënjanë të gjitha ato veçori që lidhen drejtpërdrejt me këtë tipologji gjuhësore si dhe ndikimet e pashmangshme të gjuhës së veprës origjinale. Siç e kemi sqaruar edhe më lart, kur analizojmë gjuhën e Nolit nuk mund të shkëputemi nga konteksti gjuhësor dhe kulturor i asaj kohe, çka nënkupton mungesën e një varianti letrar të njësuar, mungesën e kristalizimit të disa trajtave gramatikore por edhe mungesën e një tradite stilistike letrare të nivelit të duhur që kërkon përkthimi i veprave të një rëndësie të tillë.

5. 1 Në formimin e përbërësve 'emër+përemër+mbiemër' Noli shpeshherë e përmbys këtë rend duke preferuar 'emër+mbiemër+përemër' pa u kushtëzuar nga origjinali si te: *vajz' e bukur jaj* në vend të 'vajza juaj e bukur', *pɛr qɛllimin e veçantɛ tim* për 'për qëllimin tim të veçantë'; po ashtu në përbërësit më të thjeshtë 'emër+përemër' del rëndomë rendi i përmbysur 'përemër+emër': *Njɛ tjatɛr rugɛ* 'një rrugë tjetër'. Këto ndërtime nuk mund të shpjegohen as me anë të rregullave të metrikës duke mos qenë pjesë të një poezie. E njëjta dukuri del edhe në tekste të autorëve arbëreshë të botuara në shek. XIX siç dëshmon Turano (2001) ku shpjegohet me ndikim e strukturës së italishtes ku ndërtime të tilla janë në normë.

5. 2. Lidhur me ndërtimin e fjalisë, tërheq vëmendjen ajo e llojit kushtor, të cilën e gjejmë gjerësisht të përdorur në këtë tekst, por të kufizuar në shfrytëzimin e mjeteve lidhëse. Thuajse në të shumtën e rasteve, autori përzgjedh lidhëzën *në* e cila kushtëzon edhe trajtat foljore që e ndjekin: a) *në+folje në mënyrën dëshirore*, siç dëshmohet në shembullin e mëposhtëm:

Andáj s' kam shpresɛ tɛ fitónj nɛ gjyq,
Nɛ mprofsha vetɛ vetɛn.
Po, nɛ paçi pak

Durím do t' ju tregónj (...)

Oh, ç'farɛ mall gɛzón Arapi buzɛtrashɛ
M'atɛ pullúmp qɛ vodhi, nɛ i vaftɛ mbarɛ!

b.) *në+folje në mënyrën dëftore*:

Nɛ flé mi lule e trɛndafile,
Lɛsho-i grera (...)

Një ndër format e ndërtimit të sotëm të kushtores *po+folje në lidhore* (po të keni, etj), pothuajse nuk del fare në këtë vepër, por kjo duhet parë më gjerësisht, ashtu siç meritojnë vëmendje më të hollësishme mjaft dukuri të tjera morfo-sintakasore, të cilat nuk mund të përfshihen brenda këtij punimi.

6. Edhe pse ky studim, nuk ka si qëllim në vetvete trajtimin e aspekteve të veçanta përkthimore, e shohim me interes të hedhim dritë mbi dy raste që, veçanarisht, na tërhoqën vëmendjen:

6. 1. Një dyshim i vogël lidhur me përkthimin që Noli sjell për një pjesë të shkurtër të aktit I, 1, origjinali i të cilit në *In Folio1* shkruan:

The Ship is heere put in: *A Verenessa*, *Michael Cassio*
Lieutenant to the warlike Moore, *Othello*,
Is come on Shore. (…)

Ania hyri nɛ limán.
Njɛ Veronák qɛ quhet Mihal Kasi,
Zɛvɛndɛsi i trimit ton' Othello Arapit
Ka zbritur nɛ steré. (...)

Këtu bëhet fjalë për fjalën "Verenessa" që i referohet origjinës së Mihal Kasit; nga ana tjetër vëmë në dukje se në aktin I, 1 Noli përkthen:

Njɛ Mihál Kasi nga Florenca, (...)

pra, *Verenessa* (ose '*Veronessa'* në botimin *In Quarto*), që ka krijuar jo pak probleme për botuesit e kësaj vepre në rindërtimin e kuptimit, bën të dyshojmë edhe për përkhimin në shqip. Disa e intepretojnë me *Veronessa* (Noli: *Veronák*) prejardhjen e anijes, sipas zakonit të kohës, duke e quajtur me emrin e qytetit që duhet t'ia kishte dhuruar Republikës së Venedikut, por ka edhe të tjerë që këtë mbiemër e lidhin me 'Michael Cassio' duke e bërë atë prej Verona, megjithëse në aktin I, 1 Shakespeare-i e shkruan "One *Michael Cassio, a Florentine*" (edhe këtu me shkronja të pjerrëta), pra ndërrimi i prejardhjes së dytë mund të konsiderohet si gabim prej

Shakespeare-it. Ka edhe prej atyre që fjalën *Verenessa*/*Veronessa* e konsiderojnë emër, që në këtë kontekst mund të përdoret për Bianka, e cila faktikisht shoqëron Kasin. Noli zgjedh ta quajë Kasin si njëri prej Verone, por habit fakti që nuk jep asnjë shpjegim për këtë gjë.

6. 2. Në disa raste përkthimi paraqet vështirësi të konsiderueshme që pengojnë dhe mjegullojnë kuptimin e mesazhit dhe kjo vjen si pasojë e përpunimit të sforcuar të disa ndërtimeve të ndërlikuara sintaksore, përballë të cilave lexuesi pështjellohet dhe nuk është i aftë ta rrokë aty për aty domethënien kontekstuale si në shembullin e mëposhtëm (I, 1, f. 21):

Iagua: (...) jam shigúr,
– Me gjithє qє kjo gjє ka pєr t'i sjellє njє ndalím –
Qє Shteti nukє munt t'a hedhє pa rezík;
Se çohet me shpejtí nє lúftєrat e Qipros,
Tє cilat janє nisur, dhe s' mundin dot
Tє gjejnє tjatєr mє tє zotin se aý.

Në raste të tilla është i pashmangshëm konsultimi me veprën origjinale, çka na dha dorë të kuptojmë që lidhur me këtë pjesë, Noli thuajse e rikrijon të tërën në një trajtë të vetën, krejt origjinale, duke u përpjekur t'i qëndrojë besnik kuptimit. Kështu, gjuha del disi artificiale me një sintaksë jo shumë të qartë që vështirëson kuptimin e kësaj pjese. Shembuj të tjerë të ngjashëm me këtë janë: *kєshtú tє thom qє jam dhe unє* dhe *se єshtє aqє shigur sa qє ti jé Roderigu*, të cilët në shqip do të tingëllonin më natyrshëm në këto forma "Të them se kështu jam edhe unë" dhe "se është (po) aq e sigurtë sa ç' je ti Roderigu".

7. Siç dihet çdo përkthim lidhet me kohën në të cilën është kryer, me kontekstin kulturor të vendit, me gjuhën e kohës dhe me shijen/aftësinë e përkthyesit, pra është e vështirë të gjesh ndonjë vend ku një vepër të jetë përkthyer vetëm një herë dhe pas afër një shekulli ajo të mos jetë ripërkthyer dhe ribotuar. Po të konsiderosh faktin që *Sonetet* e Shakespeare-it janë përkthyer në shqip disa herë dhe botuar në shtatë botime (Belluscio 2009) habit fakti që përsa i përket veprave të tjera shakespiriane ato ende nuk janë botuar të gjitha në shqip madje, edhe ata që janë botuar vazhdojnë të ripropozohen në të njëjtin botim, në versionin e vjetëruar të Nolit. Në këtë rast, tregohet njëfarë respekti i kushtëzuar në lidhje me botimet mjeshtërore të Nolit, dhe kjo gjë mund edhe të pranohet, por sidoqoftë, ato tani duhen konsideruar si klasikë të letërsisë angleze në shqip, për të cilët ka nevojë edhe për një aparat kritik më të gjerë. Do të ishte mirë që sot, pas një shekulli, dikush të rimarrë origjinalet e Shakespeare-it, dhe t'i ripërkthejë duke i dhënë lexuesit shqiptar një tekst të ri, më të freskët dhe me siguri më të afërt me shijen, me gjuhën dhe me kontekstin kulturor bashkëkohor.

ISMET OSMANI

GJUHA SHQIPE NË SHKRIMET DHE PËRKTHIMET E NOLIT

Vepra e madhe e Fan S. Noli ishte e mbeti një burim i pashtershëm i pasurimit të shqipes, duke i dhënë një gjallëri e vlerë artistike gjuhës së shkruar e të folur. Ky mjeshtër i fjalës vuri në sprovë gjuhën në një kohë kur e kishte më se vështirë për të gjetur fjalën e duhur shqipe në shqipërimet e tij. Fjalë kjo që u dëgjua në të gjitha përkthimet e tij. Ai nuk transformoi, siç do të thonë shumë shkrimtarë e gjuhëtarë, nuk përktheu e përshtati, por thjeshtë shqipëroi[322], duke u bërë kështu, mjeshtër i shquar i fjalës së bukur shqipe me një morfologji e sintaksë të saktë të fjalisë. Them shqipëroi Detyrë kjo që i imponohej çdo përkthyesi që do t'i jepte të drejtë vetes për të përkthyer ndonjë vepër letrare. Noli vë në spikamë se përkthimi i mirëfilltë kërkon një analizë të hollësishme morfo-sintaksore, frazeologjike, kuptimore e stilistikore. Kështu, Noli u përpoq të krijojë me një ton kumbues të shkrimit shqip, me një gjuhë të përgjithshme të popullit.

Ndonëse filloi vonë të mësojë shqip, në moshën 25-vjeçare, talenti i tij bëri që t'i përmbush me përpikëri të gjitha hollësitë e theksuara më lartë, gjë që do të shihet me përkthimin në greqisht të veprës së Sami Frashërit "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet", si dhe me shqipërimet e tij madhore të kryeveprave botërore si Hamleti, Jul Qezari, Makbethi, Armiku i Popullit, Zonja Ingra e Ostrotit, Rubaiat, të cilat përbëjnë një gamë të gjerë të opusit të tij rikrijues, i japin një famë të veçantë, por mbi të gjitha guxim në një kohë kur vihej në sprovë gjuha e tij. Të gjitha këto, vetëm se ia shtojnë meritat për përçimin e bukurive estetike të shprehura me mjeshtëri të rrallë artistike në gjuhën tonë. Shqipërimet e tij zënë vend nderi vend nderi ne pasurinë e kulturës sonë kombëtare, jo vetëm si dëshmi artistike e kohës, por më së shumti si vlerë e qëndrueshme artistike e gjuhësore.

Kështu, Noli dha një dëshmi të fuqishme para të gjithë atyre që fare pak besonin në fuqinë e gjuhës si shprehje e përvojës njerëzore, e pasuruar ndër shekuj e breza. "Gjuha nuk është instrument i dobët dhe fajtor pse nuk shfaqen maja në krijimtarinë letrare, por janë faktorë te tjerë jashtë saj thoshte Sapir. Noli në shqipërimet e tij është një gjuhëkrijuese në vete, që s'e gjen dot në kohën e kur krijoi e veproi. Ai zgjodhi një rrugë të mundimshme të rikrijimit, me ç'rast gërshetohen arti i autorit me artizanatin siç do ta quaj Edmond Tupja përkthimin. Ai më tej do të shtojë se kemi art, sepse kemi një krijim të mirëfilltë, ndonëse kemi, njëkohësisht, edhe rikrijim. Kemi krijim në rrafshin gjuhësor, për shembull të themi *Hamletin* në gjuhën shqipe e ka shkruar Fan Noli, domethënë me fjalë krejt të ndryshme nga ato të Shakespeare-it, domethënë me fjalë shqipe.

Noli për herë të parë u njoh me shqipen e shkruar nga një mjeshtër si Konstatin Kristoforidhi dhe krijoi bindjen se ç'mund të bëhet me një gjuhë të gjallë, që kuptohet

[322] E. Tupja, Këshulla një përkthyesi të ri. Tiranë, 2000.

nga i gjithë populli. Kështu, ai me mjeshtri do të dijë të bëjë një hulli në fusha të panjohura, që tanimë do të mund të ecë çdo gjuhëtar e letrar.

Leksiku, pasuria leksikore dhe semantike janë anët e veçanta në shqipërimet dhe në veprat origjinale të tij. Fjalori që përdor ky shkrimtar është me të vërtetë pasur dhe i jep një ndihmesë të shqipes letrare ne shume drejtime: në leksik, në përpunimin semantik, në frazeologji, në togfjalësha e mënyra shprehjeje, në shprehësinë leksikore dhe në sistemin e figurshmërise. Noli pati aftësinë të nxjerrë e të ripërtërijë pasurinë gjuhësore të shqipes duke shfrytëzuar burime leksikore e frazeologjike në përmasa të gjera, pasuroi, zgjeroi dhe ripërtëriu semantiken e shumë njësive leksikore të njohura e të panjohura. Më konkretisht, në fushën e krijimtarisë leksikore, Noli solli shumë neologjizma kuptimore e stilistike, fjalë të reja, kuptime të reja dhe ngjyrime të pakufishme. Pikërisht këtu hasim në dallime të ndjeshme në rrafshin kuptimor me gjuhën e sotme, në klasën e emrave, ku neologjizmat kuptimore nuk janë të pakta, gjë që e dëshmon se Noli, kur e ka parë të mundshme, duke u udhëhequr nga një parim i qartë se duhet mënjanuar vetëm fjalët e huaja të panevojshme, u ka dhënë fjalëve ekzistuese kuptime të reja. Mjaft këto përdorime do të mbeten si neologjizma të këtij autori, ndonëse nuk do të kishte qenë keq sikur të kishin hyrë në fondin aktiv të fjalorit të gjuhës.

Ai në të shumtën e rasteve bëri të pamundurën duke zgjeruar e pasuruar sinoniminë, variantet sinonimike, sidomos sinoniminë fjalëformuese; zgjeroi e zhvilloi antoniminë leksikore, stilistike e semantike; plotësoi sistemin leksikor të shqipes së sotme me rikuptimesinë e njësive të ndryshme leksikore, ai e pasuroi gjuhën me mbiemra cilësorë, mbiemra marrëdhëniorë, si p. sh. princor, balshian, atëror etj. [323] me fjalë të përngjitura apozicionale etj. Duke qenë një përkthyes i lartë, do t'i interesoj edhe etimologjia e fjalës, gjë, që dëshmohet edhe në veprën "Historia e Skënderbeut", me ç'rast do te merret me emrin e princit Depë Zënëvisi.

Duke vështruar përkthimet dhe shkrimet origjinale të Nolit, hasim në një numër të madh të fjalëve popullore, disa prej të cilave janë bërë arkaike për shkak të zhvillimit të gjuhës (kafshë, gjë). Ndonëse me përpikëri i përmbahet të folmes së vet toske (toskërishtes letrare), në veprën e tij hasim edhe fjalë gege si *falem nderit (falemnders), të kqyrim*, të cilat ose janë ndikime nga leximet, ose i ka përvetësuar nga bisedat me shqiptarët jashtë Shqipërisë.

Huazimet në shkrimet e Nolit

Në shkrimet e Nolit vihet re një fenomen që rrok gjithë fushën e botimeve në kohën kur veprojnë e jetojnë shumë shkrimtarë e përkthyes, të cilët u munduan të bëjnë përkthime të sakta, ose thënë shkurt për t'i mbetur besnik origjinalitetit, sollën në shqipe disa fjalë, të ashtuquajtura huazime, apo huazime subjektive, ose huazime të

[323] F. Agalliu, Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij, Tiranë, 1999, f. 30.

cilat mund t'i quajmë edhe të panevojshme[324], por të domosdoshme për kohën kur shkroi Noli. Në veprat e Nolit të shumta janë huazimet e integruara apo strukturore[325], kur fjalët e huazuara i nënshtrohen rregullave të fonetikës dhe të morfologjisë së gjuhës shqipe. Ndryshojnë disa fonema, shtohet ndonjë mbaresë dhe hyjnë kështu në kategoritë e ndryshme leksiko-gramatikore të gjuhës shqipe.

Megjithatë, te Noli hasim një letrar me shije të hollë për gjuhën, ndonëse shkrimet e tij janë përplot me turqizma, arabizma e fjalë perse, të cilat autori i ka përdorur me qëllim të tipizimit të personazheve. Të tilla fjalë janë: *alim, zabit, dovlet, padishah, xhenet, xhenet, kiamet, sevda, temena, qafir* etj. Ka edhe të tilla që tanimë janë përshtatur natyrës së gjuhës shqipe, përkatësisht hasen në gjuhën e përditshme të popullit, si *ilaç, sevap*; emërtimet të gjërave ushqimore, si *çorbë, revani, hoshaf, pilaf, bollgur, tërhap* etj. [326] Përveç kësaj, në shkrimet e Nolit nuk është e paktë edhe terminologjia ushtarake turke, terma këto që kishin depërtuar në gjuhën shqipe nga turqishtja, si *jatagan, dyfek,* etj. , të cilat, megjithatë, u përpoq t'i zëvendësojë me fjalë shqipe. Lidhur me të M. Kuteli do të theksoj se në mungesë të fjalëve në shqipe, dhe veçanërisht në toskërishte, Noli do të përdorë një mori fjalësh arabisht, turqisht e persisht, si: rezil, tebdil, dallkauk, kopuk[327] tanimë të asimiluara prej shqipes. Të gjitha këto fjalë, të cilat i hasim në shqipërimet dhe në krijimet origjinale të tij, s'janë gjë tjetër vetëm një pasurim i gjuhës, dhe siç do të vë në dukje edhe ai vetë se nuk mund të qërosh një gjuhë nga fjalët e huaja pa e nakatosur. [328] Megjithatë, shquhet ndër shkrimtarët që dinë "huat t'i kthejë në monedhë të vet". [329] Noli, siç e ka vënë në dukje M. Domi[330] dhe siç e ka provuar edhe Sh. Demiraj[331], zë kryet e vendit.

Përfundimi:

Gjuha e Nolit është një gjuhë e pastër dhe thjeshtësisht e kuptueshme, e cila të shpie në universin e veprës së tij dhe e bën të përafërt me lexuesin. Noli pati aftësinë të nxjerrë e të ripërtërije pasurinë gjuhësore te shqipes duke shfrytëzuar burime leksikore e frazeologjike ne përmasa të gjera, pasuroi, zgjeroi dhe ripërtëriu semantiken e shumë njësive leksikore të njohura e të panjohura.

[324] Shih Raul Lilo, Vëzhgime rreth tipologjisë së huazimeve në shqipen e sotme, Akte të seminarit të 3 (Rreth Huazimeve në shqipen standarde), Tiranë 2004.
[325] M. Dardano e P. Trifone, vep. e cit. , fq. 566.
[326] F. Agalliu, Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij, Tiranë, 1999, f. 26.

[327] M. Kuteli, Mall e brengë, 1943, f. 15.
[328] F. Agalliu, Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij, Tiranë, 1999, f. 26.
[329] F. Agalliu, Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij, Tiranë, 1999, f. 25.
[330] Në "Nëntori, 4, 1065, ai thotë se Noli "u dha formë shqipe shumë fjalëve të huaja" (f. 27).
[331] Artikull i cituar, f. 89-90.

SASHENKA KAMBERI
ALMIRA SADIKAJ

RRETH ANTONIMISË DHE SINONIMISË STILISTIKORE NË KRIJIMTARINË POETIKE TË FAN NOLIT

Fan Stilian Noli është një figurë poliedrike në kulturën shqiptare. Ai ka dhënë kontributin e tij të çmuar në shumë fusha dhe veprimtari të jetës politike, kulturore dhe artistike. Noli ka spikatur dhe ka lënë gjurmë jo vetëm me larminë e krijimeve, por mbi të gjitha me origjinalitetin e trajtimit të gjinive e llojeve të ndryshme. Nuk mund të gjykohet asnjë nga fushat e lëvruara prej Nolit dhe aq më pak krijimtaria e tij poetike, pa u lidhur me ecurinë e zhvillimit historik të popullit shqiptar dhe përvojën e tij jetësore, pa përqasur njërën fushë me tjetrën – atë të diturisë me atë të artit e anasjelltas. [332] Pra, është pohuar shpesh nga kritika se vëllimi "Album" është një autobiografi në vargje e lidhur me zhvillimet gjatë dhe pas Revolucionit të Qershorit. Në poezinë e tij Noli ka futur, veten, ndjenjat, botëkuptimet, meritë dhe simpatitë e veta dhe i ka bërë vjershat plotësisht jetëshkrimore. [333] Ekziston mendimi se Noli nuk shkruan, nëse nuk ka një masë të mjaftueshme mbresash, faktesh, të vërtetash jetësore dhe ndjesish personale. Por të gjitha këto nuk e kanë penguar poezinë e tij, që të kapërcejë kufijtë e personales dhe të marrë vlera gjithëpërfshirëse. Ai është frymëzuar nga zhvillime të caktuar politike në Shqipëri, megjithatë motivet dhe tematika politike nuk e zbehën fjalën poetike. Poezia e tij vërtet spikat për harmoni tingullore, për muzikalitet, për formë të përsosur, por vlerë të veçantë ka shprehësia leksikore dhe semantika e fjalës. Noli është poet që ka pushtet absolut mbi fjalën, duke shfrytëzuar leksikun e shtresave të ndryshme dhe paradigmat kuptimore të fjalëve. Fjalët vetë, aty ku vihen bëhen dhe ato të gjithëpushtetshme dhe s'mund të lëvizin, sepse ato nuk lidhen me njëra – tjetrën nga fqinjësia apo rendi sintaksor, po së pari nga rregulla logjike, nga rëndësia reale, nga situata, nga dufi i poetit dhe përveç këtyre nga një harmoni akustike që nuk është kurrë qëllim formal. [334] Në poezinë e tij vizaton portrete dhe figura që kanë ndikuar në zhvillimet politike e sociale në vend dhe për të realizuar këtë Noli ndërton me mjeshtëri një sërë përftesash, si: epitete të pranëvendosura, antiteza dhe ironi. Ai portretizon me art personalitete reale historike. Për t'i dhënë me sa më vërtetësi këto portrete si dhe veprimtaritë e tyre, ai shfrytëzon sinoniminë, e cila e ndihmon për të shprehur me saktësi dhe përpikmëri vlerësimet dhe qëndrimet personale. Shkrimtari i kushton vëmendje zgjedhjes dhe përdorimit të fjalorit poetik. *Mundësia e zgjedhjes në gjuhë është rezultat i ekzistencës së sinonimeve, si fenomen*

[332] Vehbi Bala. Fan Stilian Noli – poet. Parathënia. Vepra 1, Tiranë.
[333] Rexhep Qosja. Shkrimtarë dhe periudha. Tiranë. 2005, f. 277.

[334]Adriatik Kallulli. Artikuj dhe studime për letërsinë e Rilindjes e të Pavarësisë. Tiranë 1979. f. 179.

gjuhësor. [335] Këtu mund të përfshijmë sinoniminë stilistikore si burim shprehësie, ku dallimi stilistik në çiftet apo vargjet sinonimike lidhet me diferencat në ngarkesën emocionale. Ja si e portretizon poeti Krishtin: *Hosanna, o çlironjës, Mesi hosanna / Shpëtimtar, kryemjek, kryeshenjt, kryefe* etj. Me këtë qëllim në këtë vargëzim sinonimik përfshihen sinonimet kontekstuale. Sipas prof. Xh. Lloshi, sinonimia kontekstuale përftohet duke e përgatitur thënien që të rroket lidhja sinonimike e mjeteve, të cilat nuk e kanë atë në sistemin leksikor. [336] Po sipas këtij studiuesi, shpesh për të shmangur përsëritjen e së njëjtës leksemë emërore, poetët përdorin epitete apo cilësime të njohura apo gjetje origjinale qofshin ato. Noli e ka shfrytëzuar së tepërmi këtë lloj sinonimie në vargun e tij poetik. Vlen të përmendim poezinë "Himni i Flamurit", ku poeti përdor emërtime të ndryshme për *flamurin* nga vargu në varg e nga strofa në strofë. *O flamur gjak, o flamur shkabë / Flamur i madh për vegjëli*, - thotë poeti dhe përfundon me kompozitat *o fushëkuq, o shkabëzi*; apo në vargjet: Vrajeni, se *përunj* e *përmbys* pasurinë; Një dolli me verë zbraze/ *Për* të *mbytur mallëngjime* / *Për të shuar hidhërime*, edhe këto dalin sinonime kontekstuale. Pra, këto dy sintagma jashtë këtij konteksti nuk kanë lidhje kuptimore. Poeti i përdor për të shtuar ngjyrimin stilistikor dhe efektin shprehës. Në vargjet e Nolit të bie në sy zgjerimi si përftesë leksiko-stilistike ku, *përmbajtja zgjerohet, sepse fjala e re sjell ngjyrime kuptimore, emocionuese stilistike etj*. [337] Kështu, fjalët e pranëvendosura janë të afërta nga kuptimi, por të ndryshme për nga nuancat dhe ngjyrimet stilistikore. Ato krijojnë simetri brenda vargut, përshkallëzim nocionesh dhe hijëzime kuptimore. Ky shkallëzim në përdorimin e sinonimeve stilistikore në vargjet e Nolit në përgjithësi është **përshkallëzim ngjitës**: Ti *na shtyp e na shtrydh e* ti *gjakun na pi;* Ti *na therr* e *na grin* për qejf *na bën fli; Ti na ruan, na mpron,* dhe për *ne bëhesh fli*. Ky shkallëzim bën që sinonimet e pranëvendosura jo vetëm të shprehin me saktësi dhe përpikmëri vlerësimet, mendimet, ndjenjat e përjetuara, por mjetet gjuhësore të ndikojnë edhe në shpërthimet emocionale. Ja si ndikon sinonimia në ritmin dhe ekspresivitetin e poezisë:

Seç' e *shëmpnë* derbederët,
Mercenarët dhe Bejlerët
Seç' *e shtypnë* jabanxhinjtë,
Seç' *e shtrythnë* fajdexhinjtë,
Seç' *e pren'* e seç' *e vranë*,
Ç'*e shkretuan* anembanë. (Anës lumenjëve)

Rrallë Noli përdor **përshkallëzim zbritës**: Ajme, *sa vrer, sa keq e sa zor*. Kjo lidhet ndoshta dhe me tonin e poezive, i cili shpesh është shpërthyes, goditës e fshikullues dhe shkallëzimi ngjitës i sinonimeve stilistikore e ndihmon poetin për të rritur shkallën e ekspresivitetit. Meqë përftesa me sinonimet ka natyrën e një shkallëzimi të tiparit a

[335] Shefkie Islamaj. Çështje të sinonimisë në gjuhën shqipe. Prishtinë 1985, f. 8.
[336] Xh. Lloshi. Silistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika. Tiranë 1999, f. 138
[337] Emine Sadiku. Zgjerimi semantik në letërsinë artistike. Gjuha jonë 1988, 3, f. 14.

të cilësisë, e ndihmon poetin që të shpreh emocionet me pasuri leksikore e stilistikore, pa rënë në përsëritje.

Pavarësisht se nuk ka ndarje të prerë ndërmjet shtresimit stilistik, mes gjymtyrëve sinonimike mund të vendosen marrëdhënie të ndryshme:

1. Gjymtyrët mund të kenë të njëjtën vlerë kuptimore: P. sh. O i *zhgryer, i zhyer*; *tmerr, panik* i mizorisë; *kukuth e lubi*; *qëndron me frikë, pret i tronditur*; Brohoritni *trumpeta, timpane, zurna* etj. Këto çifte a vargje sinonimike përftojnë një përsëritje vijëzore, ku fjalët shënojnë të njëjtat koncepte dhe nga fjala në fjalë nuk shtohet ekspresiviteti, por përsëritet ideja për përforcim. Në këtë rast fjala e dytë thjesht përforcon të parën ose përdoret për efekte të vargëzimit dhe të simetrisë ritmike të poezisë.

E veçantë është sinonimia brenda disa kompozitave si: *turp-e-ndot-kundërmonjës; zemër-krund-e-gërdhu etj.*

2. Gjymtyrët mund të jenë sinonime të pjesshme, ato dallojnë në ngjyrime kuptimore: P. sh O *vend e vatr'*, o nën' e babë. (Himni i Flamurit); Janë shtuar sarafët pa shpirt e pa besë/ *Tregëtojn'e gjënjejnë, rrëmbejn'e sfrutojnë* / Thon' ashtu Izraelin e *mbrojn'e shpëtojnë*/ Kur e pa këtë *zi* dhe këtë *errësirë* / *na çliro, na shpëto / Vraji, shtypi* dhe *shtrydhi*, dhe do të adhurojnë. (Krishti me kamxhikun); Tradhëtar, *ti na nxive, na le pa atdhe*, / ti na *çthurre, na çkule, na çduke* çdo fè. / *Varfëri, poshtërsi, robëri* ti na dhe/ *kukuth e lubi*. (Marshi i Barabbajt). *Drit' e gas*, rrofsh e qofsh; Hosanna, hosanna! (Marshi i Krishtit).

Këto sinonime të përdorura nga Noli, në kontekste të tjera shpesh nuk e zëvendësojnë a e plotësojnë njëra-tjetrën, por poeti duke dashur të shkaktojë emocione, të përçojë sa më mirë çdo ndjesi shfrytëzon të gjitha nuancat kuptimore që i ofrojnë fjalët e ndryshme.

3. Gjymtyrë sinonime të pjesshme, të cilat dallohen nga ngjyrimet emocionuese e figurative.

P. sh. Jezu Krishti *s'dëgjo*i dhe *s'mori vesh mikun*. (Krishti me kamxhikun). Ti *na shtyp e na shtrydh e ti gjakun na pi* / Ti *na therr* e *na grin* për qejf *na bën fli*. (Marshi i Barabbajt); *Renda, ika, flytyrova /* pse je *mrenjt* dhe je *helmuar* (Fryn, moj erë…); Që të therë bij e bija / dhe *t'u nxi*, t'u – *mbyll shtëpia*? (Jepni për nënën).

Në këto raste gjymtyra e dytë ka më tepër ngjyrim emocional, ndonjëherë është njësi frazeologjike dhe si rrjedhim rrit forcën shprehëse.

4. Gjymtyrë sinonime të cilat dallojnë për nga ngjyrimi stilistik. P. sh: Çdo i shenjt' ideal, çdo shtëpi perëndie / Ishte bërë *dyqan* dhe *pazar tregëtie*. / Me *kamxhik* e me *fshikull* sarafët dëboi/ Me *kërbaç e me shpatë* mbi ne mbretëro / Me *forc' e pahir* na çliro, na shpëto. (Krishti me kamxhikun); Në *bodrum*, në *skëterrë*, në *zëndan* mbretërofsh. (Marshi i Barabbajt). Kryqet ngulen, shtisen, / *Tallen, qesëndisen* (Kryqësimi). Fryn e çfryn veriu, / *Ngrin, mërdhin* i ziu. (Shën Pjetri në mangall). Këtu fjalët, përveçse plotësojnë njëra-tjetrën diferencohen për nga përkatësia ligjërimore.

Krijohet kundërvënie mes fjalëve asnjanëse dhe fjalëve që i përkasin stilit bisedor, të cilat shpesh janë fjalë të vjetëruara, fjalë dialektore e krahinore si dhe huazime. Sipas studiueses Sh. Islamaj, përdorimi i tyre (fjalëve të vjetëruara, dialektore dhe huazimeve), shkakton kundërvënie stilistikore në mes të fjalëve sinonime duke krijuar një farë *antonimie.* [338] P. sh. *Çdo i shenjt' ideal, çdo shtëpi Perëndie / ishte bërë dyqan dhe Pazar tregërie*: Pra, krijohet kjo lloj antonimie mes fjalëve *dyqan* dhe *pazar tregërie*; me *forcë* dhe me *pahir, bodrum* dhe *zëndan*, sepse në këto raste sinonimia ngrihet në shkallën e antonimisë kontekstuale dhe stilistikore.

Kështu, karakteri i sinonimeve është i lidhur me karakterin e antonimeve për sa u përket raporteve të nuancave kuptimore dhe konteksteve në të cilat përdoren.

Gjithmonë antonimet janë fjalë të një gjinie, që kundërvihen si shfaqje të dy llojeve të kundërta. [339] Pikërisht në vargjet e Nolit gjejmë çifte antonimike të së njëjtës kategorie gramatikore. Antonime **emra**: djalëri – pleqëri, çlironjës – tiranë, dimër – pranverë, vdekja – jeta etj. **folje**: të qante - të qeshnin, të veshte - të zhveshnin, vete – vjen, hip e zbrit, nisi – mbaroi etj. **frazeologji**: shpresën m'a yshqeve - m'a preve etj.

Antonimet stilistike, sikurse ato në përgjithësi, varen nga kushtet gjuhësore, në kohë të caktuar, nga shkalla e zhvillimit të gjuhës në raport me kohën dhe në pajtim me llojin e stilit, si dhe nga kushtet jashtëgjuhësore. [340] Pra, jo gjithmonë i përkasin të së njëjtës kategori gramatikore, kjo bën që shumë fjalë në kuptimet themelore nuk janë antonime, kurse në kontekste të caktuara dalin si të tilla, d. m. th. kanë kuptime të kundërta. Këto antonime janë kontekstore, sepse kundërvënia bëhet vetëm brenda një konteksti. [341]

Pse shpresën dyzet vjet *m'a yshqeve*,
Dhe sot *m'a preve*?
Sheh *gazn*' e pritmë për *djalërinë*
Dhe *shkretëtirën* për *pleqërinë*,
Atje sa *bukur*, këtu sa *zi*,
Këtej ka *dimrin*, andej *prënverën*,
Kërkon *Parajsën*, vdes në *Skëterrën*; (Moisiu në Mal)

Siç vihet re në këto vargje, fjalët në çiftet antonimike nuk kanë kundërvënie në përbërësit e tyre kuptimor, çka do të thotë se nuk kemi antonimi të plotë. Antonimia mes fjalëve: bukur – zi; gaz - shkretëtirë; djalëri – pleqëri; dimër – pranverë; ma ushqeve – ma preve, nuk ekziston në gjuhën shqipe. Noli i pranëvendos këto fjalë për shprehësi. Në vargjet e Nolit, përveç fjalëve, ka dhe vargje të cilët nën ndikimin e kontekstit dalin antonimike.

P. sh. Tradhëtori dinak, hipokrit e kusar,

[338] Islamaj. Sh. Çështje të sinonimisë në gjuhën shqipe. Prishtinë, 1985, f. 85.

[339] Xhevat Lloshi. Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika. Tiranë, 1999. f. 134

[340] Ibrahim Goçi. Antonimet stilistike në gjuhën shqipe. SF, 1 1987 f. 115

[341] Jani Thomai. Leksikologjia e gjuhës shqipe. Tiranë, 1999, f. 144.

Na u-ngrit gjer në kulm, dhe u bë kryetar;
Nënë zgjedhën besnikët për vdekje lëngojnë…. (Krishti me kamçikun).

Pra, në këto vargje nuk bëhet fjalë thjesht për antonimi leksikore, por për antonimi stilistikore, sepse me afrimin në një vend të antonimeve për të dhënë efekt shprehës, kërkohet mbështetja edhe e mjeteve të tjera, si: ndërtimi sintaksor, situata e përgjithshme e kontekstit ose befasia e kundërvenies. [342] Kundërvënia përfton figurën stilistike të *antitezës*, që vendos përballë dy gjendje, dy cilësi, dy dukuri të kundërta. Duke qenë se Noli për nga përvoja jetësore revoltohet nga kontraditat e shtresave dhe vlerave, si dhe pabarazitë e kohës, i shpalos ato me një sërë antitezash. Tipike dhe e papërsëritshme është antiteza sublime në vargjet elegjiake të poezisë *Syrgjyn vdekur*: Se të *deshte* dhe s'të *deshnin*,
Se të *qante* kur të *qeshnin*,
Se të *veshte* kur të *zhveshnin*,
Nëno moj, të ra dëshmor.

Në poezinë e Nolit, si në të gjitha rrafshet e tjera edhe në krijimin e antonimeve stilistikore ka ndikuar fryma e kohës, ngjarjet politike, angazhimet personale të poetit. Vargjet poetike karakterizohen nga toni luftarak, tragjik, elegjiak, që vishet shpesh me ton ironik. Të bie në sy ironia dhe sarkazma politike e shoqëruar me një sërë antonimesh mbresëlënëse:

…Je i pir'e s'mban dot anë
Për *çlironjës* a *tiranë*. (Kirenari)
Ose …Dhe Feridi faqe ndron
Dje shante, sot lëvdon,
Se Sulltani prap' *e gjeti*/ Se, që kur *e humbi* s'fjeti. (Kënga e Salep – Sulltanit).

Autori përçon idetë dhe këndvështrimin personal, duke pranëvënë në mënyrë asidentike (me mungesë lidhëzash), antonimet që lënë gjurmë në stilin e tij.

Por, Noli nuk është vetëm elegjak. Në vargjet e tij gjejmë edhe tone optimiste, të cilat i shpreh me çifte antonimesh stilistikore: Se pas *vdekjes* ndriti *jeta*, / Dhe kudo gjëmon trumbeta; Se pas *dimrit* vjen një *verë*, / Që do kthehemi një herë etj.

Të shpeshta janë kundërvënie antonimike me marrëdhënie shtuese, të cilat shërbejnë gjithashtu për të portretizuar a për të karakterizuar në mënyrë ironike figurat historike.
Jam *xhenemi* e jam *xhenneti*,
Kijameti e *selameti* (Sulltani dhe kabineti)

Noli përdori fondin e pasur të gjuhës shqipe, duke aktivizuar edhe fjalë të vjetra e duke krijuar të reja, si dhe duke futur në funksion edhe fjalë të huaja, ndaj dëshmojmë se është ndër pasuruesit më të shquar të shprehësisë poetike. Prania e fjalëve të huaja, kryesisht orientalizmave, të cilat përbëjnë një shtresë të rëndësishme në poetikën e tij,

[342] Xhevat Lloshi. Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika. Tiranë, 1999. f. 134

është gjithmonë e motivueshme, sepse ai i përdor për të demaskuar dhe ironizuar një klasë të caktuar politikanësh dhe nga ana tjetër shfrytëzon si burim shprehësie, duke i vendosur në marrëdhënie sinonimie a antonimie me fjalët e gjuhës shqipe.

Figura e kontrastit është aq e pranishme në vargjet e Noli, saqë shpesh përshkon gjithë poezinë, madje shkon më tutje duke krijuar antitezë edhe ndërmjet dy poezive, siç ka ndodhur me poezitë: *Marshi i Krishtit* dhe *Marshi i Barabbajt*.

Në poezinë "Marshi i Krishtit" Krishti simbolizon poetin, kurse "Marshi i Barabbajt" është një nga poezitë më të fuqishme, ku poeti me krahasime e epitete jashtëzakonisht të goditura demaskon figurën e Zogut - Barabba. Të gjitha mjetet leksiko - semantike e stilistike në këto dy vjersha janë kundërvënëse, të cilat të paralelizuara fjalë për fjalë formojnë antiteza dhe si rrjedhim edhe antonime. [343] Kështu kemi çiftet që emërtojnë këto dy figura: *Krisht- Barabba, çlironjës – rezil, kryetrim – tradhëtor, i biri Davidit – stërnip i Kainit, Njeri-Perëndi – kokuth e lubi*, epitetet që përdor për t'i karakterizuar: *i Miri Bari - teptil si bari, o i fort' o i urt' o i ëmbël Jezu – o i zhgryer, i zhyer, i vyer për hu.*

Edhe veprimet e secilit, poeti i ka vendosur në antitezë: *lufton, triunfon për atdhe – ti na nxive, na le pa atdhe, ti na prin dhe na rrit - ti na shtyp e na shtrydh, ti na ruan, na mpron, dhe për ne bëhesh fli – ti na therr e na grin për qef na bën fli, pasuri, dhe liri dhe fuqi ti na dhe – varfëri, poshtërsi, robëri ti na dhe*. Poeti dëshiron dhe uron nga një fund për të dyja këto figura, i cili padyshim është i ndryshëm për secilin: Ja ç'iu uron: *përmbi Dhe, përmbi Fron, përmbi qiell u bekofsh – në bodrum, nëpër llom'e kufom'u mallkofsh, Me këmban' u këndofsh – me nëm u shurdhofsh.*

Këto mjaftojnë për të evidentuar mjeshtërinë e Nolit në harmonizimin e fjalëve brenda vargjeve, të vargjeve brenda poezive, madje dhe të poezive me njëra – tjetrën. Antonimia kaq e gjerë dhe e larmishme në vargjet e tij ka pasuruar jo vetëm ligjërimin e tij poetik, por ka lënë gjurmë pasurinë leksikore të mbarë shqipes.

Në vargjet e Nolit nga kundërvënia përftohet *oksimoroni*, i cili lidh sintaktikisht fjalët antonime, që rregullisht nuk mund të lidhen nga kuptimi, mjeshtri i fjalës artistike na jep një gjendje a një realitet me ngjyra të gjalla, me një stil të kursyer dhe me shprehësi të lartë. [344] Në vargjet e poezisë *Anës lumenjve*, spikat kundërvënia ndërmjet situatave të ndryshme, ku poeti kundërvë dy realitete të shprehura me forma të ndryshme gjuhësore: *Anës detit i palarë, /Anës dritës i pa parë, / Pranë sofrës i pangrënë, / Pranë dijes i panxënë;*. Këtë përftesë e gjejmë edhe në vargje të tjera si: Se i vogli shtrin viganin */ dhe i shtypuri tiranin /. Flamur i madh për vegjëli; katrani zbardhëllon* etj.

Si përfundim mund të themi se Noli është një nga poetët më në zë të Letërsisë së Pavarësisë dhe asaj shqiptare në përgjithësi. Ai spikat për origjinalitetin e përzgjedhjes së temave, gdhendjen e figurave historike e politike, ndërtimin e diskursit poetik dhe përdorimin e një fjalori të pasur dhe të evidentueshëm. Shprehja poetike e tij përbëhet nga një mendim sintezë liriko-epik, plot duf, sulm e ritëm kumbues të protestës, të cilën e pasuron me një varg të pasur sinonimesh dhe antonimesh stilistikore. Për këtë

[343] Ibrahim Goçi. Antonimet stilistike në gjuhën shqipe, SF, 1, 1987, f. 119.

[344] Miço Samara. Çështje të antonimisë në gjuhën shqipe. Tiranë, 1986, f. 224.

ai nuk heziton të harmonizojë fjalën shqipe me fjalë të gjuhëve të tjera, kryesisht orientalizma, të cilat marrin vlerë në vargun e tij. Edhe pse nuk ka një krijimtari poetike voluminoze, Noli shquhet për pasurinë e madhe që sjell në lëmin e raporteve sinonimike dhe antonimike të fjalës poetike, duke zgjeruar kufijtë e marrëdhënieve kuptimore të fjalëve nën efektin e emocionalitetit, kontekstit dhe periudhës kohore. Poeti, pikëpamjet idealiste i shpreh me nota realiste e me gjuhë të gjallë ekspresive. Vjershat e tij kanë shërbyer si shembull se me ç'përgjegjësi duhet të krijojë një shkrimtar, se sa e kujdesur dhe e përsosur duhet të jetë shprehja poetike për të qenë shprehje artistike. [345]

[345] Rexhep Qosja, Shkrimtarë dhe Periudha, Tiranë, 2005, f. 308.

SPIRIDHULLA POÇI

DUKURI MORFOLOGJIKE NË VEPRËN E FAN S. NOLIT

Në këtë kumtesë do të përpiqemi të vëmë në dukje disa veçori morfologjike të gjuhës së Nolit në veprat "Album" dhe "Historia e Skënderbeut" 1921.

Në gjithë krijimtarinë e tij Noli ka pasur si udhërrëfyes idetë e Rilindjes Kombëtare dhe është udhëhequr nga parimi për të krijuar një gjuhë kombëtare të përbashkët për të gjithë kombin. F. Agalliu thekson: "*Në kushtet e reja të shkrimit shqip Noli eci në vazhdën e toskërishtes së pasur e të bukur të Naimit e të Samiut... . . Ai u nis nga gjuha e përgjithshme e popullit dhe është një nga ata mjeshtër që i dhanë tonin shkrimit shqip në periudhën e trajtimit të Shqipërisë si shtet më vete*"[346]

Duke analizuar dukuritë morfologjike në veprën e Nolit vërejmë se në gjuhën e tij ai është përpjekur të shmangë shumë tipare arkaike të paraardhësve, të tilla si: rasa vendore; emrat prejfoljorë asnjanës, shkrimi pa -j në emërore të shquar i emrave që mbarojnë me -i të theksuar; lakimi i emrave pa nyjen shquese –t në numrin shumës[347] etj. Për këtë kontributin të Nolit M. Domit shprehet: ".. *bashkë me ndonjë tjetër, e tëharri shqipen letrare të variantit jugor të përpunuar prej Rilindësve të mëdhenj të shekullit të kaluar, nga elemente e tipare arkaike e ngushtësisht dialektore, nga variante të shumta morfologjike, i dha asaj një karakter më të përgjithshëm, më të njësuar, më të stabilizuar dhe e bëri më të lakueshme e më të kristalizuar*"[348]

Cilat janë disa nga dukuritë morfologjike të gjuhës së Nolit në veprat e sipërpërmendura?

Disa emra e formojnë rasën kallëzore të trajtës së shquar mbi bazën e trajtës së pashquar të numrit njëjës. Kjo mënyrë ndërtimi të trajtës së shquar përfaqëson gjedhën e vjetër të gjuhës shqipe[349], pra, trajtë e pashquar + nyjë shquese, p. sh: vllanë (28, Al), atdhenë (32, Al), Skënderbenë (32, Al), gjakn' e Nënës (32, Al), gasn' (36, Al), çlirimn' (59, Al), burrën (71, Al), kamçikn (85, Al). Rasa emërore e emrave që mbarojnë me togun zanor –ua ose –a të theksuar e formojnë rasën emërore të trajtës së shquar me –j dhe jo -i: kroj (61, Al), babaj (135, Al). Ndoshta, kjo është një dukuri fonetike për shkak të diftongut oi.

Emrat femërorë që mbarojnë me –i- të theksuar në trajtën e pashquar e formojnë rasën emërore të shquar pa –j, si në gjuhën e sotme letrare, p. sh: , dashuria, lebetia (135, Al). Në ndonjë rast gjejmë dhe shkrimin me –j, si shtëpija (32, Al). Gjejmë edhe

[346]F. Agalliu, Gjuha e Nolit, Tiranë, 1999, fq. 29
[347] F. Agalliu, Gjuha e Nolit, Tiranë, 1999, fq. 33-43
[348]M. Domi, "Noli mjeshtër i madh i fjalës shqipe", Nëntori, 4, 1965, fq. 26-27.
[349]R. Memushaj, Shqipjastandarde, Tiranë, 2003, fq. 77-78

disa emra femërorë me –e të patheksuar në trajtën e pashquar, që në rasën emërore të shquar dalin pa –j, p. sh: ndërgjegja (85, Al), përgjigja (102, Al).

Disa emra, mashkullorë në njëjës, e formojnë numrin shumës me prapashtesën edhe –ra, si emrat femërorë, p. sh: kurbete (87, Al), kufiret (59, HS) etj. Mbiemri që shoqëron këta emra shpesh del në gjininë femërore e herë në gjininë mashkullore, gjë që tregon se te këta mbiemra përshtatja e gjinisë me gjininë e emrit s'qe kristalizuar plotësisht, p. sh: pllane të mëdha (85, Al), malet e pashkelur (82, Al), qytetet e mëdhenj (89, HS), kufiret janë të çkoqura (59, HS), këto sulma (132, HS), ata male (70, Al).

Disa emra, sot mashkullorë, dalin në gjininë femërore, p. sh: rasjen (86, Al), heroizma, idealizma (42, Al), lajma (70, Al), vonimn' e ligjës (85, Al), mjalta (89, Al), xhamen (100, Al) etj.

Për sa i përket formimit të numrit shumës gjejmë shumë emra, trajta e shumësit të të cilëve ndryshon nga trajta e shumësit në gjuhën letrare dhe kjo dukuri shfaqet ose për arsye fonetike, ose për mungesë të normës së njësuar, p. sh: emri kishë del edhe në shumës me të njëjtën trajtë, kishëve (184, HS). Emri qen del, këta qena (33, AL). Emri skllav del skllevë, bij-skllevësh, (35, Al). Emri lot del, lottë të zeza (70, Al), derthmi lottë atje (72, Al), nga lotët e saj (87, Al). Pavarësisht se në "Gramatika e gjuhës shqipe" është pranuar si normë shumësi lot (pa –ë), sot diskutohet shmangia e këtij përjashtimi dhe shkrimi me –ë i shumësit të kësaj fjale. Emri lab del labërit (80, HS). Emri djem del djemat(87, HS). Emri flamur del flamuret (151, HS). Në disa raste emri pas parafjalëve të rasës kallëzore del në trajtën e shquar: mbi mangallin (41, 42, Al), nëpër dhëntë (128, Al), përmbi dhenë (132, Al).

Në disa raste përemri pronor që përcakton një emër, shpesh të gjinisë femërore, të shquar, në një rasë të zhdrejtë, del pa nyje të përparme, p. sh: t'odës tij (101, Al), i shpresës tij (102, Al), ushtërisë tij (176, HS), detyrës saj (132, Al) etj.

Në klasën e përemrave, me disa përjashtime, vërejmë se shumica e tyre dalin si në gjuhën e sotme letrare. Në vend të përemrit ai, gjejmë shpesh të përdorur përemrin ay, i cili është karakteristikë për të folmet jugore, p. sh: Ay ishte usta (39, Al), ay mbeti (57, Al), ay filis (71, Al). Po kështu, gjejmë trajtat tjatër herë (49, Al), tjatër trim (85, Al), pas një tjatre (67, Al), format e vjetra të përemrit dëftor, prej syresh (149, HS)... . Për sa u përket përemrave pronorë vërehet një lëkundje në drejtshkrimin e tyre. Ata shkruhen herë me apostrof dhe herë si në gjuhën e sotme letrare: e vendit t'onë (33, Al), në gjoksin t'ënt (93, Al), kupën t'ënde (93, Al), qiellin tënt (114, Al).

Në sistemin foljor, në temat dhe mbaresat e foljeve, vërejmë shumë dukuri të ndryshme nga ato në sistemin foljor të gjuhës letrare. Në kohën e tashme, të pakryer, të ardhme, të dëftores ose të tashme e të paktyer të mënyrës lidhore, në vetën e parë ose të tretë të numrit njëjës, del mbaresa –nj, -një, si: ëndërronj (64, Al), do gjak të thëthinjë (29, Al), s'del askush që t'a shpëtonjë (41, Al), do ta kryqëzonjë (41, Al), do t'të nderonj, do t'të rrethonj (78, Al). Në kohën e pakryer të dëftores, në vetën e tretë njëjës, disa folje në temë me –t dalin me –tt dhe jo me -st si në gjuhën letrare: nukë plaçkitte(39, Al), prashitte (134, Al), shëtitte (185, HS).

Në të kryerën e thjeshtë, mbaresa e vetës së tretë, njëjës, del –i te foljet me bashkëtingëllore dhe –j te foljet me zanore, për arsye fonetike, p. sh: atje nisi, atje

mbaroj, atje krisi, atje pushoj (57, Al), atdhen' e shpëtoj (40 Al), Jezu Krishti s'dëgjoj (40 Al), e mohoj (43, Al), që shpëtoj (75, Al). Në numrin shumës shpesh gjejmë mbaresat e vjetra vetore, të cilat dalin pa tingullin mbështetës: të doqnë (33, Al), na vothnë (46, Al), kapnë (40, Al), mbetmë (94, Al), arrimë (82, Al). Ka raste kur folja del me mbaresën –ë, u mblodhë (104, HS) ose kur tingulli –v- i mbaresës është shtrirë dhe në vetën e tretë, njëjës, s'rëndovi (61, Al), dukuri që njihet në të folmet toske.

Koha e ardhme e mënyrës dëftore në mjaft raste del pa pjesëzën –të-, dukuri kjo që ndeshet në shumicën e të folmeve toske[350]: do jet' (99, Al), do shoh (104, Al), do kap (104, Al).

Në kohën e tashme të lidhores, në vetën e dytë, foljet me bashkëtingëllore dalin me mbaresën –sh dhe jo –ësh. Kjo trajtë në gegërishten jugore dhe në të folmet kalimtare funksionon si variant kryesor[351], p. sh: të përballsh (84, Al), t'u japsh (84, Al). Disa folje të tjera dalin me –ç, në vetën e dytë të së tashmes, lidhore dhe të së ardhmes, dëftore. Kjo është një dukuri me shtrirje të madhe gjeografike në të folmet toske[352]: të vdeç (84, Al), do të preç (83, Al).

Për sa u përket temave të foljeve, në të kryerën e thjeshtë, disa foljeve që në gjuhën letrare e zgjerojnëtemën me një –t, nuk dalin si të tilla, p. sh: e arriva (66, Al), arrive (62, Al). Folja jap në të tashmen e të pakryerën del në temë me –i, të më jipen (80, Al), jipnja (95, Al). Folja dua në shumë raste del me temën e së kryerës së thjeshtë, ta deshnja, desh (106, Al). Disa folje të tjera të zgjedhimit të dytë dalin në temë me togun –ua-, duallnë (120, Al), muarnë (140, Al), suallë (150, HS), dualltë (97, HS). Te këto folje, të cilat janë me burim nga e kryera sintetike, shkaku i zbërthimit të zanores së temës është ruajtja e mbaresave të vjetra[353].

Edhe temat e foljeve të zgjedhimit në –mi, kam, jam, them dalin me trajta të ndryshme nga ato të gjuhës letrare: folja kam dhe jam në të pakryerën dalin edhe në trajtën e vjetër pa mbaresë kish dhe ish, por edhe kishte e ishte: nuk e kishte (68 Al), kish andralla (149, HS), kish mësuar (152, HS), ish një vajzë (106, Al), ish i martuar (68, HS), ish vet' ajo (132, Al), na ishin (140, Al), ishte e nevojshme (146, HS). Me trajtat e vjetra ose format dialektore del edhe folja them: theshte (99, 102 Al), thosh (101, Al), të thom (113, Al), të thomi (114, Al).

Nga sa trajtuam më lart, mund të themi se veçoritë morfologjike në veprën e Nolit, janë dëshmi e një faze të re të zhvillimit të gjuhës shqipe. Ai, duke u mbështetur në gjuhën e popullit, u përpoq të përgjithësojë në gjuhën e tij veçoritë morfologjike më të përgjithshme të toskërishtes, gjë që justifikon dhe lëkundjen në përdorimin e formave të ndryshme për të njëjtën dukuri gramatikore.

[350] J. Gjinari-Gj. Shkurtaj, Dialektologjia, Tiranë, 2003, fq. 232.
[351] Po aty, fq. 233
[352] Po aty, fq. 234
[353] E. Likaj, Zhvillimi i eptimit në gjuhën shqipe, Tiranë, 2003, fq. 232.

ALI JASHARI

BURIMET E LËNDËS IDIOMATIKE NË VEPRËN E FAN NOLIT

Siç dihet, njerëzit e penës, duke jetuar në gji të popullit, përveç që marrin prej andej temat dhe problemet për shkrimet e tyre, artisin dhe elementët më të mirë të ligjërimit popullor, duke i përdorur në mënyrë të qëlluar. Kështu thithin edhe lëndën gjuhësore dhe shprehjet e tjera që ka krijuar populli në rrjedhë të shekujve dhe i shtien në ligjërimin e shkruar, sipas përmbajtjes kuptimore dhe vlerave të tyre shprehëse stilistike. Veç kësaj, shkrimtarët dhe publicistët i përkryejnë më tej në formë e në përmbajtje disa nga këto mjete gjuhësore. Penat më të fuqishme që shkruajnë në këto fusha të letrave bëjnë edhe punë krijuese gjuhësore në dy drejtime: krijojnë fjalë e ndërtime të reja dhe përpunojnë stilistikisht mjetet ekzistuese. Ndër to, edhe njësitë frazeologjike, që përdoren gjerësisht, përpunohen nga ana e ndërtimit dhe kuptimit, përsosen në përshtatje me llojin e shkrimit dhe të problemit që trajtohet etj.

Duke lexuar në tërësi veprën e Fan Nolit, krijon një bindje të plotë se ai jo vetëm është një gjuhëtar i përkorë për shkak të problemeve që trajtoi në shkrimet e tij, por është dhe një mjeshtër i madh i përdorimit të fjalës dhe lëndës idiomatike, të cilën ai e merr nga dy burime: nga ligjërimi popullor (kemi parasysh njësitë frezeologjike dhe shprehje të tjera nga gjuha e popullit) dhe nga ligjërimi i shkruar (kemi parasysh kalket dhe huazimet frazeologjike nga gjuhë të tjera).

Disa nga veçoritë kryesore dhe më të përgjithshme lidhur me përdorimin e lëndës idiomatike në veprën e Nolit janë këto:

a)Pasuria e lëndës idiomatike dhe denduria e përdorimit të saj.

Është vënë në dukje se denduria e përdorimit të njësive frazeologjike në stile e ligjërime të ndryshme nuk është e njëjtë. Për shembull, në stilin publicistik, sidomos në lloje të tilla, si pamfletet politike, portretet, skicat, përshkrimet etj. , denduria është më e madhe. Pra, mbushullia frazeologjike nuk është e njëjtë. Kjo vërehet edhe në veprën e Nolit. Ajo varet nga formimi gjuhësor i autorëve, nga temat që trajtojnë, nga llojet e shkrimeve etj. Por, kryesorja është se përmes përdorimit të frazeologjisë realizohet një kërkesë e domosdoshme ndaj veprave të shkruara: thjeshtësia dhe kuptueshmëria Kjo përbën, njëherazi, dhe një detyrë të përhershme për publicistët dhe shkrimtarët, sepse burim ushqimi për ta është gjuha e folur e popullit, leksiku dhe frazeologjia e pasur popullore. Po përmendim vetëm disa shembuj: *thuhen kokën, s'ia var tobën, i arrin thika në kockë, me mish e me shpirt, i biri i botës, si një e një bëjnë dy, fërkon duart, me gojë hapur, në buzë të varrit, gjeti tenxherja kapakun, në vend t'i bjerë gomarit I be samarit, iu mbyll shtëpia, ia bëri varrin, si kofini pas të vjeli, viç i palëpirë, s'lë kusur, nuk e bëj kabull, më paç në qafë, pa një pa dy, urtë e butë, s'lë gur pa lëvizur (pa tundur), ndërron faqe, bëj gajret*, e shumë të tjera

b) Tipari më i rëndësishëm i përdorimit të lëndës idiomatike popullore në veprën e Nolit është rikuptimësimi dhe ringjyrimi i saj, duke u vendosur në kontekse të gjera shoqërore e kombëtare.

Duke u përdorur në kontekste të gjera kombëtare e shoqërore, njësitë frazeologjike dhe shprehjet e tjera pësojnë disa ndryshime të rëndësishme:

Së pari, zhvishen nga ngjyrimi i rëndë emocionues (nëse e kanë) dhe fitojnë vlera të reja stilistike-emocionuese, ose, anasjelltas, mund të rimarrin ngjyrim emocionues (kur këtë e kanë në përdorimin e zakonshëm). Shprehje të tilla frazeologjike, si *vetë mbreti gjenial ia vë kapakun tenxheres: e emëron Koço Kotën kryetar të parlamentit*; ose:

Së dyti, mund të marrin kuptim të ri ose nuanca të reja kuptimore, të ndryshme nga ato që kanë në situata të zakonshme, si për shembull: Dhe Feridi *faqe ndërron*/Die shante sot lëvdon/Fryn bullçit e trumbeton/Që katrani zbardhëllon", ku njësia *ndërron faqen* "ndryshon, ripërtërohet" merr kuptimin "e kthen, lëkundet, nuk mban një qëndrim" etj.

Së treti, përdorimi i dy a më shumë idiomave brenda një konteksti për të rritur forcën e ligjërimit, duke i aktualizuar edhe më shumë ato, si: mjerimi ka këtë të mirë që zë për fyti miletin dhe ia sjell mentë në kokë me pahir, në qoftë se s'ia nxjerr shpirtin; kokën pra Ahmetit do t'ia hanjë Musolin shpejt a vonë si një ë një bëjnë dy. Po Musolinit kush do t'ia hanjë kokën? Shefqet beu fërkon duart, mileti e prêt me gojë hapur; jam budrumi e jam zullumi, kush ngrë kojën e merr lumi etj.

c)*Publicistika e Fan Nolit karakterizohet dhe nga përdorimi i mjaft kalkeve dhe shprehjeve të papërkthyera, të marra nga gjuhë të ndryshme*[354].

Siç dihet, kalket dhe shprehjet e papërkthyera hasen sidomos në shkrimet publicistike dhe ato tekniko-shkencore, por në veprën e Nolit këto i gjen gjithandej të përdorura me mjeshtëri, sepse Noli ishte njohës i shumë gjuhëve, edhe këtu po sjellim vetëm disa shembuj: *filli (peri), i Arianës, e bën të bardhën të zezë dhe të zezën të bardhë, heështje varri, lotë krokodili (të krokodilta), guri i Sizifit, i dha grushtin e fundit* etj. , apo huazime frazeologjike, sidomos nga latinishtja, italishtja dhe frëngjishtja si, *ca izol**e** (rast i veçuar), modus vivendi, H**a**nibal **a**nte p**o**rtas, cu de gras, mutatis mutandis, **a**sinus **a**sinum fr**i**kat, p**i**um desid**e**rium, (dëshirë e bukur, fisnike), sinë qua non, ante Cristum, ad usum Delphin;et tu, Brute! ; de gustibus non disputandum; status quo ante;horr**i**bile d**i**ktu* e shumë të tjera.

Kalket dhe huazimet frazeologjike në ligjërimin e Nolit përdoren për të dhënë në mënyrë sa më të përpiktë ide e nocione të ndryshme, të cilat me mjete të tjera gjuhësore dhe mund të mos arriheshin, por ato krijojnë edhe një atmosferë të caktuar, të domosdoshme për rrethanat ligjërimore. Edhe për këtë po përmendim shkurt disa shembuj: *duke hedhur lotë të krokodilta; të vajtojnë për liritë e popullit maker me lotë prej krokodili; peri i Ariadnës nofta nuk do të gjendet kurrë; kur të kem përpara dokumenta të cilat të më japin perin e Arianës; ka apo s'ka të drejtë të thërrasë si Riçardi i Shekspirit "Mbretërinë time për një Xhavit"* (ku aktualizohet shprehja e njohur "gjysmën e mbretërisë simë për një kalë" nga tragjedia "Rikardi III" i Shekspirit; *shtrëngohet të hyjë në grindje; këta Sizifë modern të ferrit shqiptar* etj.

[354])Nuk kemi parasysh këtu dhe shumë togje të tjera të qëndrueshme që janë në natyrën e stileve të gjuhës së shkruar, si ***merr formë***;***merr fuqinë ; merr forcë; vë në dukje; i bëj të ditur; vë në diskutim;*** etj.

Shumë prej këtyre shprehjeve Noli i përdor si tituj apo nëntituj të artikujve dhe shkrimeve të tjera, si: *Edhe ti Brut, Zia në Shqipëri, Horribile dictum* etj.

Duke u nisur nga gjithë lënda idiomatike që kemi vjelë në veprën e Nolit, mund të arrijmë në përfundimin se ai ishte njohës i mirë i frazeologjisë popullore dhe asaj të huazuar dhe mjeshtër i madh i përdorimit të saj në ligjërimin e shkruar.

ASLLAN HAMITI

VLERA EKSPRESIVE-IMPRESIVE E TINGUJVE NË POEZITË "ANËS LUMENJVE" DHE "RENT, OR MARATHONOMAK" TË FAN NOLIT

Gjuha është një oqean i pafund me pasuri e mundësi të pashterrshme, mirëpo aftësia dhe mënyra e shfrytëzimit të kësaj pasurie te njerëzit është e shumëllojshme. Vepra letrare është edhe krijim artistik edhe krijim gjuhësor, një eksplorim i mundësive të shqipes. Kjo prirje krijuese gjuhësore e shkrimtarëve nuk lidhet vetëm me krijimin e fjalëve të reja, sepse shumica e tyre janë neologjizma stilistikë, por edhe me të gjitha fushat e tjera të gjuhës.

Shkrimtarët ndikojnë me përdorimin e veçantë të mjeteve, me lidhjet e ndërthurjet e fjalëve, me kuptimin e ngjyrimet e reja, me dendurinë e ndryshuar të përdorimit, me sintaksën e shndërruar, me organizime dytësore të elementeve të gjuhës që ngjallin efekte estetike, me vlerësimin e anës tingullore, të ritmit, të lidhjeve të papritura, të shpehshmërisë së figurshme e simbolizuese (ironike) dhe deri të lojës gjuhësore.

Siç duhet, thëniet kanë vlerë kuptimore dhe vlerë stilistike. Me fjalë të tjera, thëniet (fjalët, fjalitë) kanë tri vlera:

a) vlerën logjike apo objektive;

b) vlerën shprehëse (ekspresive), dhe

c) vlerën impresive a synimin e vetëdijshëm të emetuesit që të ndikojë te marrësi; qoftë në mënyrë estetike, qoftë humoristike, qoftë satirike, apo në ndonjë mënyrë tjetër.

Tingujt e veçuar nuk kanë kuptim, por kur përbërja tingullore përkon me kuptimin e fjalës, atëherë tingujt fitojnë vlera shprehësie (vlera estetike).

Është përdëftuar se tingujt në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë në sistemin tonë nervor si dhe në shqisat tona, madje marrin vlera emotive dhe estetike. Të përshtatshëm për nyjëtim dhe të këndshëm për dëgjim (bukurtingëllues) janë padyshim ata tinguj që formohen në mënyrë të thjeshtë dhe të lehtë (zanoret dhe sonoret), ndërsa më pak të këndshëm janë tingujt që nyjëtohen rëndë (bashkëtingëlloret e zhurmëta). [355]

Vlera ekspresive-impresive e tingujve zbatim më të gjerë gjen në poezi. Kjo arrihet sidomos kur ka një lidhje ndërmjet tipareve nyjëtimore e akustike të tingujve me kuptimin e fjalës që e shprehin. Për poetët zanoret e përparme ngjallin përshtypjen e haresë, të lehtësisë, të qartësisë e të lirizmit; /o/-ja të gjerësisë, të hapësirës e të lartësisë; /a/-ja të peshës, rëndësisë; /u/-ja të thellësisë, errësirës e deri të frikës. Në gjuhën shqipe dridhëset (sidomos shumëdridhësja /rr/-ja) më mirë i përshtaten fjalëve që emërtojnë gjëra të vrazhda: *horr, varr, derr, ferr* etj; lëngëzoret /l, ll, j/ për të

[355] Antica Antoš, *Osnove lingvističke stilistike,* Školska knjiga, Zagreb, 1974, f. 34.

shprehur dritë, lehtësi, fluturim, vazhdimësi; prapagjuhoret /k, g/ dhe laringalja /h/ i përgjigjen më shumë mundimit, përpëlitjes, trokitjes, rënies së shiut (tak, trak, dëng), buzoret për shpërthimet dhe goditjet me jehonë të mbytur (bam, bum, bëlldum, buf) etj.

Edhe në përdorimin e gjithëmbarshëm të ligjërimit shfrytëzohen vlerat ekspresive dhe impresive të tingujve. Edhe njeriu i rëndomtë i shfrytëzon këto. Bie fjala, në të folurit tonë emrat e njerëzve në familje i përdorim me prapashtesa zvogëluese *(zemrush, babush* ose *bush, Limçe < Lirim);* emrat vetjakë për përkëdheli i përdorim të shkurtuar (Dilaver, Dilair > *Dil;* Ramadan > *Dan,* Rrahman > *Man,* Luljeta > *Loli,* Rrezarta > *Arta),* jo vetëm për ekonomizimin e të folurit, por edhe për arsye se ashtu tingëllojnë më bukur, derisa edhe me cungime e ndërrime të ndryshme tingullore të tipit të gjuhës fëminore, si *Bala* < Bardha (me ndërrim të /r/-së në /l/ dhe shmangie të /dh/-së, meqë kjo formë është më bukurtingëlluese), ose me mënjanimin e keqtingëllimit përmes ndërfutjes së tingujve bukurtingëllues [v, j, h] midis dy zanoresh, si *shkovi, punovi, msovi* për "shkoi, punoi, mësoi" etj.

Loja me shqiptimin shfrytëzohet shpesh për humor, p. sh. për fjalën *burrë* thuhet se ka burra me një dhe me dy /r/*: bura* dhe *burra*. Kohën e fundit nuset gjithnjë e më shumë po e zgjasin /rr/-në kur e shqiptojnë emrin vjehërr: *Hëh, vjehrrrra! ,* për të shprehur vrazhdësi, urrejtje e ironi; ndërsa dhëndurët po e zbusin në *vjehër,* për të asocuar butësi. [356]

Po kështu, jo rastësisht tridhjetë vjetët e fundit në shumicën e emrave vetjakë, që u jepen fëmijëve tanë, zanoret /e, i, a/ në ndërthurje me sonantet /r, l, n, m/ janë përbërësit tingullorë kryesorë (khs. Urim, Lirim, Artan, Arta, Alma, Arben, Erton, Agron etj.).

Madje edhe disa fjalë, të cilave nuk ia dimë kuptimin, na ngjallin një përshtypje ose ndjenjë me tingëllimin e këndshëm të tyre. Siç dihet, përsëritja e bashkëtingëlloreve e zanoreve të njëjta asocon njëtrajtësinë, butësinë, qetësinë. Kështu, edhe stërgjyshet, gjyshet e nënat tona kanë përdorur e po përdorin bukurtingëllimin, sidomos në ninulla:

nina nana more birë,
flij se gjumi të ban mirë,
të ban mirë e të rahaton,
trupin ty ta pushon...

që edhe pse foshnja nuk e di kuptimin, megjithatë me këtë kumbim të këndshëm tingujsh qetësohet, rehatohet, e ndjen veten të sigurt e fle.

Tingujt ndikojnë për të krijuar një atmosferë rreth kuptimit, anasjelltas, edhe kuptimi ndikon për mënyrën e perceptimit të tingujve. Shoqërimet tingull-kuptim quhen simbolizëm tingullor, kur vendosen qëllimisht për të arritur efekte të ndryshme. Më shpesh kjo arrihet nëpërmjet grumbullimit të tingujve, që me përshtypjen e tyre mbështesin ose përforcojnë kuptimin e fjalëve.

[356] Xhevat Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika,* kreu IV – Fonostilistika, Tiranë, 1999, f. 54-63.

Natyra ritmike-bukurtingëlluese e poezive të Nolit

Vlera ekspresive dhe impresive e tingujve varet nga një sërë faktorësh, si: nga kuptimi i fjalës, nga mënyra e artikulimit të tingullit, nga kombinimi i tyre me tinguj të tjerë, nga denduria e shfaqjes në një tekst, nga pozicioni ndaj theksit, rrokja, rima, ritmi, intonacioni etj. Edhe pse ka çështje universale në përcaktimin e kësaj vlere, megjithatë mund të thuhet se në gjuhë të ndryshme, te autorë të ndryshëm kjo vlerë është e ndryshueshme dhe vlerësimet për të janë mjaft subjektive.

Noli me mjeshtëri të rrallë në krijimet letrare në vargje ka shfrytëzuar natyrën dhe mundësinë e tingujve, si fonostilema për të sajuar ritëm, harmoni ritmike, bukurtingëllimin (eufoninë) dhe muzikalitetin e zërit. Organizimet fonetiko-fonologjike te Noli janë të një shkalle të lartë, aq sa çojnë te një orkestrim tingullor të thënieve.

Te veprat në vargje, natyra ritmike shprehet dukshëm dhe luan rol të rëndësishëm në vlerën e përgjithshme të veprës. Prandaj organizimi dhe sistemimi harmonik i njësive të gjuhës: i tingujve, i rrokjeve të theksuara e të patheksuara, morfemave, fjalëve, fjalive dhe vargjeve, është anë e rëndësishme e vlerës së përgjithshme të veprës letrare. Noli të gjitha këto efekte të natyrës bukurtingëlluese i ka vënë në funksion të vlerave artistike. Të gjitha mjetet stilistike arrin t'i orkestrojë me përmbajtjen, porosinë kuptimore të fjalës, të vargut dhe të vjershës në tërësi, dhe me këtë ka arritur efekte të fuqishme emocionale, kuptimore e imagjinative.

Për të vështruar vlerën ekspresive-impresive të tingujve në poezitë "Anës Lumenjve" dhe "Rent, or Marathonomak" të Fan Nolit u shërbyem me të dhëna statistikore mbi dendurinë e përdorimit të fonemave (grafemave) në këto dy poezi:

Denduria e përdorimit të zanoreve dhe e bashkëtingëlloreve					
Nr.	grafema	Rent, or Marathonomak	%	Anës Lumenje	%
1	a	113		97	
2	e	97		128	
3	ë	49		98	
4	o	70		31	
5	i	71		62	
6	u	43		53	
7	y	13		10	
	Gjithsej zanore	456	Gjithsej zanore	479	
8	b	15		22	
9	c	1		4	
10	ç	12		16	
11	d	23		25	
12	dh	10		14	
13	f	14		7	
14	g	13		8	

	gj	6		9	
	h	36		37	
	j	32		40	
	k	51		25	
	l	25		22	
	ll	5		1	
	m	51		32	
	n	65		79	
	nj	4		11	
	p	34		50	
	q	16		4	
	r	106		104	
	rr	9		4	
	s	25		98	
	sh	11		13	
	t	72		64	
	th	19		3	
	v	18		18	
	x	1		1	
	xh	0		2	
	z	4		4	
	zh	1		0	
	Gjithsej bashkët.	698	Gjithsej bashkët.	717	
Gjithsej zanore e bashkëtingëllore		1154	Gjithsej zanore e bashkëtingëllore		1196

Poezitë e Nolit rëndom kanë një brendi, një ngjarje, një ndodhi. [357] Nolin në kulmin e mendimit demokratik e gjejmë te poezia me gjurmë autobiografike **"Rent, or Marathonomak! "** (1930).

Rent, or rent, rent e u thuaj
Se u çthur ordi e huaj,
Se betejën e fituam
Dhe qytetin e shpëtuam!
Rent, or rent,
Rent, or Marathonomak!
Rent kudo, dyke bërtitur,
Nëpër shekuj faqe-ndritur,
Se i vogli shtrin viganin
Dhe i shtypuri tiranin,
Veç e tok,
Tok, or Marathonomak!

[357] Sabri Hamiti, *Letërsia moderne shqiptare,* Alb-ass, Tiranë, 2000, f. 65.

Te figura e rendësit të madh heroik të Maratonës së lashtë, poeti paraqiti lajmëtarin e fitores së shpejtë të vegjëlisë. I portretizuar me mjeshtri të rrallë poetike. Maratonomaku del si njeriu, që energjinë, fuqinë dhe zemrën ia kushton fitores. As etja e madhe, as lodhja kapitëse nuk e ndalin që të arrijë dhe të japë lajmin e fitores. Ai vazhdon vrapimin, duke i kaluar të gjitha pengesat dhe ëndjet vetjake që e joshin, derisa më në fund arrin të lajmërojë për fitoren dhe bie pa frymë përdhe. Nga një dramatikë jetësore, Noli nxjerr e sforcon ideologjinë e vet të fitores: devotshmëria për idenë paguhet me jetën.

Por, si e shpreh këtë nga pikëpamja fonostilistike?

Përsëritja e fjalëve në një tekst rrjedhimisht sjell edhe përsëritjen e përbërësve tingullorë të atyre fjalëve, e me këtë shtohet denduria e përdorimit të tingujve të caktuar që ngjallin efekte estetike. Kështu, në vjershën e vet më të dashur "Rent, or Marathonomak" fjala **rent** është përdorur 8 herë, **lark** – 6 herë, **Marathonomak** – 12 herë. Po kështu, edhe përsëritja e shpeshtë e rrokjeve të njëjta ngjall efekt akustik. Bie fjala, rrokjen **re** e kemi 17 herë, **er** – 7 herë, **et** – 9, **on** – 18, **or** – 16 etj. [358]

Për të zhdukur hiatin, përkatësisht për të shënuar rënien (elizionin) e **ë**-së fundore te fjalët e patheksuara kur fjala pasuese nis me zanore, Noli përdor apostrofin: në poezinë Rent, or Marathonomak 27 herë, ndërsa në "Anës Lumenjve" 19 herë. Për efekte të tilla stilistike, me të drejtë shkrimtarët, veçmas poetët edhe pas Kongresit të Drejtshkrimit shpeshherë nuk zbatojnë normat e prera të standardit.

Poezinë e Nolit e karakterizon vargu gjithmonë ritmik e i rimuar, tetë, dhjetë-e dymbëdhjetërrokësh, ku dominon katrena, apo strofa safike. [359] vlera ekspresive-impresive e tingujve shtohet edhe me shfaqjen e tyre në pozicione të njëjta a të ngjashme të fjalës. P. sh. në strofën:

*Nën**a**, motr**a**, nusj**a** d**a**lin,*
*Ngrehin kr**a**hët të të nd**a**lin,*
*Mos, se s'j**a**në veç N**a**j**a**d**a***
*M**a**gjistric**a** dhe Dri**a**d**a**;*
*L**a**rk, or l**a**rk,*
*L**a**rk, or M**a**r**a**thonom**a**k.*

5 fjalë mbarojnë me /a/ në rrokje fundore të hapur; **nëna, motra, nusja, Najada, Magjistrica**; shumë fjalë me /a/ në rrokje parafundore: **dalin, ndalin, krahët, s'janë, Najada, Driada** etj. , duke krijuar asonancë të fuqishme (përsëritje të zanoreve të njëjta).

Të gjithë tingujt nistorë të strofës të sapolexuar janë sonorë, duke formuar çifte të njëjta: **n, n; m, m; l, l**. Po të shikojmë edhe tingujt nistorë të të gjitha fjalëve të kësaj

[358] Fan. S. Noli, *Rent, or Marathonomak,* prill, 1930.
[359] Sabri Hamiti, *Letërsia moderne shqiptare,* Alb-ass, Tiranë, 2000, f. 65.

strofe, po kështu do të vërejmë një harmoni tingullore me mbizotërimin e sonanteve [**l, m, n**], përkatësisht në vargun e parë: 1. **n, m, n, d**; në vargun e dytë: **n, k, t, t, n**; në vargun e tretë: **m, s, s, v, n**; në të katërtin: **m, dh, d;** në të pestin: **l, o, l**; në të gjashtin: **l, o, m**.

Në këtë strofë me mbizotërim të tetërrokëshit (4 vargjet e para janë 8-rrokëshe, vargu i pestë 3-rrokësh, i gjashti është 7-rrokësh) me gjithsej 106 tinguj – fonema, 20 janë zanore /a/, d. m. th. rreth 20 % e tingujve. Nga ana tjetër mbizotëron kombinimi i /a/-së me tinguj sonorë: 11 herë me **n**-në, 9 herë me **r**-në, 3 herë **m**-në.

Në të vërtetë, në gjithë poezinë "Rent, or Marathonomak" /a/-ja paraqitet më së shpeshti, përkatësisht 113 herë në 1154 tinguj – fonema (grafema). Përsëritja shumë e shpeshtë e /r/-së (106 herë) tregon mundim, përpëlitje për jetë a vdekje, ndërsa /th/-ja (që përdoret 19 herë) përforcon e stilizon këmbëngulësinë e vrapuesit për të arritur në cak.

Përsëritja e fjalëve në një tekst, rrjedhimisht sjell edhe përsëritjen e përbërësve tingullorë të atyre fjalëve, e me këtë shtohet denduria e përdorimit të tingujve të caktuar që ngjallin efekte estetike, si në vargjet:

Pres një shenj' e pres një dritë,
Pres me vjet' e pres me ditë,

Padyshim, poezia **"Anës lumenjve"** është njëra nga krijimet më të bukura të Nolit. Është e njohur se ajo trajton kryesisht dy tema: gjendjen e mjeruar të vendit nën thundrën zogiste dhe domosdonë e një revolucioni popullor. Poeti, me zemër të plasur, flet për të këqijat që e kanë goditur popullin, për varfërinë dhe paditurinë e madhe; kujton me pikëllim dhe zemërim zgjedhën e egër shumëshekullore të atdheut përmes antitezash më tronditëse e më të fuqishme në letërsinë shqiptare:

Ku e lam' e ku na mbeti
vaj-vatani mjer - mileti?
Anës detit i pa larë,
anës dritës i paparë,
pranë sofrës i pangrënë,
pranë dijes i panxënë,
lakuriq e i dregosur,
trup e shpirt i sakatosur!

Por, ç'vlerë ekspresive-impresive kanë tingujt në këtë poezi?

Asonanca dhe aliteracioni, që janë shumë të shpeshta në dy poezitë në fjalë të Nolit, në të shumtën e rasteve ndeshen së bashku. Ato janë edhe elemente të ndërtimit të ritmit, të intonacionit të vargut dhe të kuptimit të vargut.

Në poezinë "Anës Lumenjve" fjala **anës** përdoret 17 herë, fjalëza (lidhëza ftilluese) **se. . .** në fillim të rreshtit a të fjalisë përdoret 22 herë, **pa** – 12 herë, prapashtesa **–ës** – 29 herë, prapashtesa **–ur** – 20 herë, prapashtesa **–osur** -10 herë. Në strofën:

Se ç'e shempnë derbederët,
Mercenarët dhe bejlerët,
Se ç'e shtypnë jabanxhinjtë,
Se ç'e shtrythnë fajdexhinjtë,
Se ç'e pren' e se ç'e vranë,
Ç'e shkretuan anembanë,
Nënë thundrën e përdhunës
Anës Vjosës, anës Bunës.

me gjithsej 125 tinguj, mbizotëron **e**-ja aq sa 26 prej tyre janë të tilla. Katër rreshta të kësaj strofe fillojnë me shprehjen **se ç'e …** Përdorimi i shpeshtë i **e**-së, bashkë me tingujt **s** (10 herë), **ç** (6 herë) në kombinim me tingujt **sh, th, dh, xh** si dhe togjet e bashkëtingëlloreve të vështira për nyjëtim: **mpn, rb, jl, pn, nxh, sht, shtr, thn, jd, njt, vr, pr, shkr, mb, ndr, rdh** përforcojnë imazhin e shfrytëzimit shumëshekull të tokave shqiptare nga derbederët, mercenarët, bejlerët, jabanxhinjtë, fajdexhinjtë "ç'e shkretuan anembanë, nënë thundrën e përdhunës".

Po kështu, edhe në këtë poezi të mrekullueshme, përsëritja e shpeshtë e rrokjeve të njëjta ngjall efekt akustik. Bie fjala, rrokjen **re** e gjejmë 17 herë, **er** – 7 herë, **et** – 9 herë, **on** – 18 herë, **or** – 16 herë etj.

Për të shprehur gjëra negative, të këqija e të dëmshme, Noli përdor fjalë me disharmoni tingullore, ku kuptimi i fjalëve përforcohet edhe me imazhin akustik:

Çakërdisur, batërdisur,
Përpëlitur dhe zalisur …

Përfundim

Shenja gjuhësore është një mpleksje e shfaqjes tingullore dhe kuptimit të fjalës. Ekzistimi i varianteve të ndryshme tingullore për të njëjtin kuptim dhe zgjedhja e variantit më të përshtatshëm mundëson praninë e vlerës afektive të fjalës e të tingullit.

Edhe denduria (frekuenca) e përdorimit dhe përndarja (distribucioni) e tingujve në fjalë kanë vlerë bukurtingëlluese (eufonie) apo keqtingëlluese (kakofonie) të ligjërimit. Siç dihet, ligjërimi është më i lehtë e më bukurtingëllues kur pas një zanoreje shqiptojmë një bashkëtingëllore e anasjelltas, pas një bashkëtingëlloreje shqiptojmë një zanore. Ndërsa, grupet prej dy e më tepër zanoresh a bashkëtingëlloresh janë më të vështira për nyjëtim dhe më të pakëndshme për dëgjim. Këtë vlerë ekspresive-impresive të tingujve të shqipes si rrallëkund e gjejmë në krijimtarinë poetike të Nolit, qoftë në poezitë origjinale, qoftë në ato të përkthyerat.

Mjeshtri i vargëmimit, Fan Noli këtë e arrin veçmas:

a)duke përdorur fjalë me tinguj bukurtingëllues e kombinime të këndshme tingullore për ta shprehur të mirën;

b) duke përdorur fjalë me tinguj keqtingëllues e kombinime çakorduese për të shprehur të keqen;

c) duke bashkëpërputhur me mjeshtëri të rrallë përmbajtjen (kuptimin) që shprehin vargjet e tij me mjetet fonostilistike të shqipes (harmoninë e disharmoninë vokalike e konsonantike, onomatopenë, asonancën, aliteracionin, ritmin, rimën e muzikalitetin e vargjeve).

Kur ky poet i pavdekshëm shpreh diçka të këndshme, të mirë, të pëlqyeshme, të hareshme. . . përzgjedh variantin më të mirë nga fondi ekzistues i fjalëve apo edhe krijon ndonjë fjalë të re me tinguj e kombinim tingujsh eufonikë. Nga ana tjetër, kur shpreh gjëra të këqija, të ashpra, të vrazhda, të errëta... përdor tinguj e fjalë me kombinime tingujsh me nyjëtim kompleks e të pakëndshëm për veshin.

Në çdo vepër letrare shkrimtari bën përzgjedhje të ligjërimit nga pafundshmëria e gjuhës. Veprimtaria letrare e Nolit, si edhe i shkrimtarëve të tjerë shqiptarë, duhet parë jo vetëm nga pikëpamja letrare, por edhe nga pikëpamja e gjuhës dhe e stilit.

BESA TURKU (SHINGJERGJI)

MITI BIBLIK DHE HISTORIZIMI I TIJ

(Vështrim semiotik, mbi dramën "Israilitë dhe Filistinë", Fan Noli **)**

Fan Noli dramën "Izraelitë dhe filistinë" e shkroi më 1902, në Athinë kur punonte në një teatër. Në shënimin me titull "Pasthënje" vetë shkrimtari e quajti "nje sqelet drame, e cila duhej zgjeruar dhe endur më shumë. "[360] Autori e quan mëkat që nuk ia fal vetes që e nxorri në dritë këtë "foshnjë-dramë". Po në pasthënie, autori shprehet se ka vendosur të mos u japë lexuesve "pen' e Ariadnës"[361] për të ndritur qartësisht kumtet e konflikteve, që vijnë njëri pas tjetrit.

"Për andaj ua hedh vëllezërve t'mi si një enigmë, shohëm kush do ta zgjidhë. "[362]- shkruante Noli. Kështu, kjo dramë mbetet të jetë një tekst i hapur për lexuesin dhe i ofron mundësi atij për shumësi interpretimesh.

Nga ky vështrim semiotik, kemi paraqitur instrumentet e përdorura për të rritur *kuptueshmërinë,* kundër mjegullnajës së përmbajtjes që del nga interpretimi i parë intuitiv, *përkatësinë,* në kuptimin e mundësisë më të madhe për të kapur elementet më të rëndësishme në masën e detajeve dhe *dallueshmërinë,* pasi semiotika të ndihmon të dallosh raportet e kundërvënies mes elementeve tekstore. [363]

Në analizën semiotike të tekstit, kemi shqyrtuar një aspekt tjetër të organizimit diskursiv që është i rëndësishëm për koherencën globale të tekstit. Elemente të ndryshme semantike paraqiten të organizuar si në nivel fraze, apo brenda një fraze, ashtu dhe në nivel ndërfrazor, pra në përmasa më të mëdha se fraza. Një element semantik bën rolin e ngjitësit mes frazave, në një tekst të përbërë prej shumë frazave.

Në semiotikë, me termin *izotopi* kuptohet qëndrueshmëria, ose tepria e disa semave të caktuara abstrakte e konkrete përgjatë gjithë tekstit. Me këtë term, kuptohet një fill semantik që përshkon një tekst, duke garantuar koherencën e tij. [364]

Kështu, pra, mund të dallojmë njësitë e nëntëshme të të shënjuarit, *semat* që sipas Greimas-it në *Semantika strutturale* (Greimas, 1996) i kishte klasifikuar në *abstrakte, figurative, timiko-pasionale.*

Në tekstet e shqyrtuara, atë biblik dhe dramatik, tema të caktuara luajnë rolin e "kryqëzimit izotopik", pra atë të vendtakimit të dy a më shumë izotopish.

---

[360] Fan Noli, Drama *Israilitë dhe filistinë*, 1907, f. 343
[361] Pen' e Ariadnës – perin e Arianës (ibid)
[362] ibid
[363] Maria Pia Pozzato, *Semiotika e tekstit*, Tiranë 2001, f. 7
[364] ibid, f. 93

Subjekti në vepër është marrë nga mitologjia biblike. Në themel të tij janë vendosur motive të nxjerra nga Dhjata e Vjetër. Historia e rrëfyer është frymëzuar nga legjenda mbi figura biblike. Nga përqasja e subjektit të dramës me mitin biblik, kemi evidentuar pikëtakime e ndryshime thelbësore. Të dhënat biblike janë ndryshuar nga autori sipas mënyrës së tij vetjake. Pra, lënda biblike është ndryshuar mjaft. Miti biblik i shfrytëzuar prej Nolit në dramën "Izraelitë dhe filistinë", është ndryshuar dhe përpunuar në përshtatje me frymën e kohës. Lënda mitologjiko-biblike shërben si shkas për të trajtuar probleme të rëndësishme etiko- morale, filozofike, shoqërore, politike. Noli në dramë krijon personazhe të reja, episode dhe konflikte që nuk gjenden në subjektin e Dhjatës së Vjetër. Autori nuk rrëfen mitin, por krijon një vepër artistike, duke krijuar personazhe dhe konflikte përmes të cilave do t'u tejçohen kumte të rëndësishme kohërave.

Më poshtë kemi paraqitur izotopitë në tekstin biblik dhe në tekstin dramatik, ku tema të caktuara luajnë rolin e "kryqëzimit izotopik", pra të vendtakimit të dy a më shumë izotopish.

IZOTOPI E PARË TËRËSORE BIBLIKE

Populli filistinas Filistinasit ishin komb i fuqishëm, që vinin nga Kreta e ishuj të tjerë dhe u vendosën në brigjet e tokës së Kanaanit. Filistinasve u pëlqente të luftonin dhe për këtë, ata sulmonin dhe shtypnin popullin izraelit.

Populli i Perëndisë Izraelitët e kishin harruar Perëndinë dhe as që u shkonin ndërmend urdhëresat e Tij. Në çdo fshat e qytet njerëzit kishin bërë nga një idhull. Mëkati i shpie drejt ndëshkimit.

Perëndia Perëndia ishte inatosur me popullin e pabindur, por ushqente një dashuri të veçantë për ta, sepse dëshmonte që ishte besnike. Madje ndërmori disa hapa për ta çliruar nga zgjedha e mëkatit popullin e Tij.

Lajmi hyjnor i Perëndisë Në Izrael kishin mbetur disa njerëz si Manoahu dhe gruaja e tij, që ende besonin dhe i shërbenin zotit. Këta besimtarë rridhnin nga fisi i Danit, afër territorit filistinas. Lajmëtari i perëndisë, engjëlli i Zotit, i shfaqet gruas së Manoahut në arë duke punuar dhe i jep lajmin e mrekullueshëm se do të bëhej me djalë.

Djali Nazirit Djali do të ishte fëmijë i veçantë, Nazirit. Ai do t'ia kushtonte jetën e tij Perëndisë dhe do të luftonte kundër filistinasve. Shenjat si shërbëtor i Perëndisë janë: djali nuk duhej të hante rrush gjatë gjithë jetës, të pinte verë dhe asnjë pije tjetër të fortë, madje sa të ishte gjallë as që duhej t'i priste flokët.

Samsoni Emri Samson do të thotë "fëmijë i diellit", sepse ai ishte si diell në jetën e prindërve të tij të vetmuar. Ai nuk solli vetëm dritë, por edhe dhimbje në jetën e prindërve, kur u rrit dhe u bë burrë i fortë.

Misioni i Samsonit Misioni i tij ishte të çlironte popullin izraelit prej filistinasve.

Martesa e Samsonit Prindërit e tij u mërzitën nga kërkesa e Samsonit për martesë me vajzën filistinase nga fshati Timnah. Kjo martesë ishte e ndaluar nga ligjet e

Moisiut. Një martesë e tillë me një grua barbare i ndalohej një izraeliti të zakonshëm, që nuk e njeh Perëndinë, aq më shumë kjo për një Nazirit (shërbëtor i Tij)

Frika, kërcënimi i filistinasve Filistinasit ndiheshin të frikësuar prej forcës së jashtëzakonshme të Samsonit. Kërcënimi i gruas së Samsonit prej filistinasve për të zbuluar të fshehtën e gjëzës prej saj.

Mashtrimi i gruas filistinase Samsoni zbulon tradhtinë e mashtrimin e gruas së tij. Ai vendos të largohet prej saj, të ndahet me të shoqen. I ati i vajzës, të shoqen vendos t'ia japë një tjetri.

Inati, hakmarrja Filistinasit e mashtruan Samsonin. Plot hidhërim dhe i mbushur me inatin e hakmarrjes ai nis luftën kundër filistinasve. Populli filistinas do ta paguante shtrenjtë.

Shpagimi Samsoni u hakmor me dinakëri. Ai zuri treqind dhelpra dhe i lidhi çifte-çifte nga bishti. Në bishtat e tyre lidhi një pishtar të ndezur dhe i la kafshët të vraponin gjithandej në panik. Zjarri u shpërnda në të gjithë territorin filistinas (nga vreshtat, ullishtat e duajt me gurë)U dogj gjithçka.

Tradhtia (nga populli i tij) Pas shpagimit Samsoni u vendos në Judea. Ai ndihet i tradhtuar prej popullit të tij. Tradhtia kësaj radhe është akoma më e dhimbshme. Tre mijë burra çifutë marshuan te shkëmbi Etam për ta lidhur e për t'ua dorëzuar filistinasve.

Sprova e Perëndisë Perëndia donte t'i tregonte Samsonit se sa i dobët ishte pa ndihmën e Zotit. Pas betejës së përgjakshme, Samsoni u end nëpër shkretëtirë për të kërkuar ujë. Ky hero i fuqishëm dhe krenar për fitoret e tij u shtri i rraskapitur mbi rërë e nuk kishte fuqi të ngrihej në këmbë. Ai iu lut Zotit të çlironte shërbëtorin e tij nga etja. Samsonit iu përtëri fuqia te " burimi i atij që thërret".

Dilajla Në luginën e Sorekës, banonte një vajzë shumë e bukur filistinase me emrin Dilajla. Samsoni ra në dashuri me të. Dilajla nuk e njihte besnikërinë. Në shtëpinë e saj erdhën sundimtarët e pesë qyteteve, që i premtuan para për të hequr qafe Samsonin.

Sekreti i Samsonit Dashuria për Dilajlën e kishte bërë Samsonin të shurdhër e të verbër. Ai luajti me dhuratën më madhështore që i kish dhënë Perëndia. Dilajla zbuloi fuqinë e Samsonit duke përdorur joshjen. Ai vendosi të tregonte se e donte Dilajlën më shumë se Perëndinë duke i treguar sekretin. Prerja e flokëve ishte prishja e besës që Perëndia kishte lidhur me Samsonin.

Robëria e Samsonit Me prerjen e flokëve, fuqia e tij mori fund. Ai nuk ishte më shërbëtor i Perëndisë. Një ushtar filistinas ia nxori sytë nga vendi dhe e dërguan në Gazë si skllav. Tani ishte rob i filistinasve.

Pendimi Samsoni ndiente dhimbje dhe pendim në zemër më tepër se humbja e syve. Filistinasit festonin fitoren në tempull.

Hakmarrja e Samsonit Perëndia iu përgjigj lutjes së Samsonit për t'i përtërirë fuqinë. Kjo ishte shenjë e sigurtë se atij i ishte falur mëkati. Samsoni gjeti me duar

shtyllat qendrore të tempullit. Ai shtyu shtyllat, çatia i zuri të gjithë ata që ishin brenda. Mijëra të vdekur mbetën nën gërmadhat e tempullit.

Vdekja e Samsonit Samsoni ishte i gatshëm të jepte jetën e tij në shërbim të Zotit. Jeta e tij s'kishte vlerë para skllavërisë së izraelitëve. Samsoni mbeti i vdekur në gërmadhat e tempullit. Izraelitët e varrosën trupin e Samsonit në fshatin e të atit.

IZOTOPI E DYTË TËRËSORE NË DRAMË

Populli i izraelit Izraelitët shfaqen në dramë si forcë vitale, e organizuar me aspirata të larta e me qëndrime të qarta, si njerëz të përkushtuar të Zotit.

Populli filistinas Filistinasit, të cilët zot kanë Perëndinë e arit, Mollohun dhe atë të dashurisë, të gëzimit, të kënaqësive tokësore e fizike. Filistinasit numerikisht janë më shumë se izraelitët. Autori thekson se sasia nuk e kushtëzon vitalitetin e ekzistencës së tyre. Nga pikëpamja shpirtërore e morale ata paraqiten të mbyllur, të frikësuar nga jeta. Në kushtet e mungesës së vizionit, gjallërojnë nga pasioni. Filozofia jetësore e tyre në dramë është mashtrimi që i shpie drejt degradimit moral.

Samsoni Samsoni, figurë e shenjtë biblike, izraeliti që Perëndia i fali fuqi fizike e shpirtërore mbinjerëzore. I zgjedhuri i Izraelit për të përmbushur një mision të shenjtë, për të përhapur të vërtetën mbi popullin filistin. Si misionar i një ideje të shenjtë, i frymëzuar nga bindja idealiste e vet, pasi mori uratën nga populli, nëna dhe gruaja e tij, u nis për t'i bindur filistinasit t'i kthejnë sytë nga Perëndia, të largohen nga rruga e tyre e kënaqësive fizike e tokësore. Ai ka bindjen se do ta kryejë detyrën duke u mbështetur në fuqinë e fjalës dhe të së vërtetës, si dhe në fuqinë e tij mbinjerëzore.

Misioni i Samsonit Samsoni si figurë biblike, mishërues i një fuqie mbinatyrore dhe i një force të pathyeshme shpirtërore bëhet misionar i ndryshimeve të epokave dhe rrjedhave historike në plan universal. Në dramë shfaqet përpjekja e tij për t'i kthyer filistinasit në rrugën e Zotit mbitokësor. [365] Ndërrimi i bindjeve të filistinëve dhe përvetësimi i monoteizmit.

Samsoni mishëron zërin e arsyes hyjnore që predikon harmoninë dhe paqen ideale, e cila arrihet me frymën e besimit në Zot. Ai mishëron arsyen që i nënshtrohet pasionit. Për këtë ndëshkohet, bëhet i vdekshëm, tragjik. Samsoni jeton për ideale të larta, e përçmon rrezikun që mund t'ia sillnin pasionet (bota shqisore). Ai përballet me sprovën e vuajtjeve të mëdha, sepse zgjedh rrugën e zemrës e injoron idealet.

Dalila Gruaja e bukur dhe e mençur filistinase, që i vodhi zemrën Samsonit, e dashura që arrin t'ia grabisë të fshehtën e dhuratës hyjnore. Dalila predikon filozofinë jetësore, besnike e filozofisë së fisit të vet për kënaqësitë fizike e tokësore, lartëson bukuritë e natyrës. Dalila në dramë shfaqet si grua atdhetare, vetëmohuese për detyrën ndaj atdheut. U vjen në ndihmë bashkatdhetarëve dhe mbron të Vërtetën e tyre. Dalila, mishëruese e së keqes biblike, e mëkatit, e cila ndjenjës së shenjtë të dashurisë së

[365] Jakup Mato, *Poetika e dramaturgjisë dhe e mendimit estetik*, Tiranë 2005, f. 20

sinqertë i kundërvë tradhtinë, mashtrimin, me të cilat shkakton zemërimin e hyjnive, ndëshkimin dhe shkatërrimin hakmarrës të tyre. Dalila në dramën e Nolit paraqitet e njëjtë me Dilajlën.

Figura të tjera të krijuara nga autori në dramë

(Kryerabini, Rabini, Rahila, mbreti i filistinëve)

Ngjarjet janë vendosur në Sinagogën e Judenjve. Populli i shenjtë i Izraelit në aktin I, është mbledhur prej kryerabinit për t'i dhënë uratën Samsonit që mori përsipër të sjellë në udhë të mbarë botën e bjerrur të filistinëve.

Rabini Rabini paraqitet në dramë si mishërues i maturisë, i zgjuarsisë, përfaqësues tipik i idesë së dhunës si mjet për ndryshimin e botës. Përmes figurës së Rabinit sugjerohen rrugët, mjetet me të cilat do të sigurohet fitorja. Shtrohet enigma për përhapjen e të vërtetës me forcën e arsyes apo me forcën e shpatës. Ai duke njohur mentalitetin pagan të filistinasve "si njerëz që besojnë në arin se ka fuqi, në dashurinë se ka fuqi, do të besojnë dhe në të Vërtetën, po të ketë fuqi"[366]. Rabini ka përvojë të hidhur. Ai kujton se ka dështuar me misionarin Ahaz, kur shkuan te filistinët. Sipas tij forca bindëse e fjalës duhet shoqëruar me forcën dhe fuqinë e detyrimit me shpatë.

Si profeci dhe si përvojë jetësore ai shfaq mendimin e vet: "E vërteta s'është veç një dobëti kur si vjen pas një forcë e realtë. Janë të marrë ata që luftojnë për të Vërtetën dhe s'kanë ndonjë tjatër pushkë, përveç asaj. Se ç'shohin njerëzia të fortë e besojnë. "[367]

Rabini paralajmëron se pavarësisht fuqisë mbinjerëzore, dobësitë e zemrës do ta trondisin fuqinë.

"S'kam besë, se fuqinë që na ep Perëndia ngaherë, neve njerëzit e përdorim për të ngopur dobësirat tona. " (f. 136)

"Le të ketë trashëguar Samsoni fuqi të sipërnjerishme! dobëtirat që do t'i pillen brënda në zëmrat, kur të hynjë në Botët do ta përshkojnë një mijë herë atë fuqi. " (f. 132)

Rahila Rahila është mishëruese e dashurisë së çiltër dhe e besnikërisë në të mirë e në vështirësi. Ajo e adhuron burrin e vet. Rahila personifikon të drejtin që e pëson nga ndjenja e pastër e dashurisë, nga besnikëria e sinqeriteti.

Puthja e Samsonit Samsoni, nga misionar i një populli, i pajisur me fuqi hyjnore (mbinjerëzore), bëhet njeri i zakonshëm që dashuron. Këtu mbaron misioni i tij tragjikisht. Veprimi i parë, puthja, të çon në hapat e mëtejshëm të lidhjes së tyre. Dalila e puth Samsonin dhe vetë puthjen e quan "gjemp' i parë". Ashtu si gjembi që ngulet në mish, pra të lë gjurmë. Dalila i ka vënë vetes qëllim "të helmojë" gjakun e Samsonit.

[366] Drama *Israilitë dhe filistinë*, Fan Noli, 1907
[367] ibid

Fuqia e Samsonit Pasi filistinët e lidhin me vargonj për ta zënë, Samsoni me një fuqi të jashtëzakonshme i thyen vargonjtë dhe mposht treqind filistinë me një nofull gomari të ngordhur.

Mashtrimi i Dalilës Sipas rrëfimit biblik, Samsoni e kishte të ndaluar prej Perëndisë të pinte verë gjatë gjithë jetës dhe të priste flokët. Dalila duke përdorur joshjen femërore e përkëdhel dhe e përkul në prehër të saj. I jep atij një kupë verë dhe përpiqet t'i presë mjekrën dhe flokët e ngjyer me gjak. Samsoni nuk pranon këtë veprim të Dalilës, duke i zbuluar asaj se në mjekër dhe flokë ka gjithë fuqinë e tij. Kështu gruaja filistinase zbulon sekretin e Samsonit.

Inati, hakmarrja e filistinasve Filistinët pasi zbuluan sekretin e fuqisë së Samsonit me ndihmën e Dalilës, kur Samsoni ishte në gjumë, ia prenë mjekrën dhe flokët me gërshërët e Dalilës dhe e lidhën me vargonj të hekurt. Filistinët i humbasin fuqinë Samsonit dhe e verbojnë me hekur të skuqur.

Dashuria, pasioni, tundimi Samsoni bëhet viktimë e dashurisë, por Samsoni është i vetëdijshëm për ndjenjën instiktive të dashurisë.

"Oh, moj Dalile, gjer tani s'desha të të puthja, po një fuqi e pa-muntshime më heq me ty, se të dua, sa e palejësuar dhe e krimeneltë është kjo dashuri për mua, aq më e fortë është pasioni"

Samsoni është i vetëdijshëm se gabimi i tij është i dyfishtë. Ai hodhi hapin drejt një dashurie të ndaluar, pasi është i martuar me Rahilën dhe nga ana tjetër, Dalila i përket kampit të armikut. Samsoni, misionar bie në prehrin e kundërshtarit.

Emocionet, ndjesitë e personazheve janë të orientuara drejt pozitivitetit e negativitetit.

Leksemat: dashuri, adhurim, shpresë, guxim, = ndjenjë/, /e lartë/, /euforike/, /pozitivitet/,

frikë, pasiguri, trishtim, zemërim, hidhërim, hakmarrje, = /ndjenjë/, /e ulët/, /pasiguri/, /dekurajim/, /negativitet/.

Siç paraqitet nga grafika e mësipërme, janë të pranishme dy plane të ndryshme. Mes vizave të pjerrëta kemi njësitë semantike që kanë dalë nga analiza e përmbajtjes së leksemave. Nëpërmjet semave bëhet dallimi i të shënjuarve të mësipërm.

Raporti arsye-ndjenjë

Samsoni

Perëndia na dha shpirtin si udhë-heqës të rrojtjes së Vërtetë dhe zëmrën si rrufjan të së Gënjeshtërmes. Në vafshim pas zëmrës, prishemi, në vafshim pas shpirtit dëbierim udhën e qëllimit së rrojtjes. Cili ka të drejtë? Asnjë. Nëpërmjet Daliles ai bëhet një me kundërshtarët e tij dhe gjithçka e bën me ndërgjegje të plotë.

Mallkimi i filistinasve Kryeprifti dhe priftërinjtë filistinas, mallkojnë të gjithë ata që vijnë të përhapin ide të reja, besime të reja, apo i hapin sytë njerëzve duke u imponuar idetë e tyre, qofshin këto të pagëzuara si të vërteta të Zotit.

Ironia e Perëndisë Pasi Samsoni e humbi fuqinë, në mjekrën e tij filluan të dilnin disa fije të holla. Ai i qetëson filistinasit që të mos tremben se këto Perëndia ia jep si ironi, si ngushëllim dhe si kujtim i hidhur për madhërinë e shkuar. Mjekrra e paprerë e Samsonit, ishte bekuar me fuqinë e Perëndisë dhe me uratën e mëmës së tij para nisjes, për të kryer misionin e shenjtë.

Fati tragjik si fatalitet Samsoni është një hero tragjik për shkak të gabimeve të veta, por edhe si pasojë e një fataliteti para bukurisë magjepsëse. Samsoni luajti me dhuratën më madhështore që i kishte dhënë Perëndia. Rabini paralajmëroi në hyrje të dramës se pavarësisht fuqisë mbinjerëzore, dobësitë e zemrës do ta trondisin fuqinë. Samsoni vetëflijohet në tempull bashkë me filistinasit, duke menduar se tani është bërë njësoj si ata.

Subjekti mitik Në rrëfimin biblik, tregohet mbi lindjen e Samsonit si Nazirit. Ai erdhi si diell në jetën e prindërve të vetmuar. Samsoni martohet me vajzën e bukur filistinase, por i ati i vajzës, ia kthen fjalën dhe vajzën ia ka dhënë një tjetri. Samsoni plot hidhërim për këtë dredhi, u dogji të korrat filistinasve. Kështu u thellua armiqësia midis izraelitëve të pushtuar prej filistinëve.

Në Bibël, misioni i Samsonit ishte të çlironte popullin izraelit prej filistinasve. Izraelitëve u mungonte guximi të luftonin kundër filistinasve. Samsoni kësaj radhe ndihej i tradhtuar prej popullit te vet, tradhti e cila për të ishte më e rëndë. Pasi humbi fuqinë, u bë rob i filistinasve në Gazë ku qëndroi si skllav. Në Bibël, Samsoni priret të kënaqë sedrën personale. Samsoni ishte i gatshëm të jepte jetën e tij në shërbim të Perëndisë. Jeta e tij s'kishte vlerë para skllavërisë së izraelitëve. Samsoni mbeti i vdekur nën gërmadhat e tempullit bashkë me filistinasit. Izraelitët e varrosën trupin e Samsonit në fshatin e të atit.

Tjetërsimi në dramë. Krahas figurave biblike, në dramë janë krijuar personazhe të tjerë si: Rabini, kryerabini, Rahila, mbreti i filistinëve.

Në Sinagogën e Judenjve, kryerabini parashtron konfliktin midis izraelitëve, si njerëz të përkushtuar Zotit dhe filistinëve të bjerrur, të cilët zot kanë perëndinë e arit (Mollohun) dhe atë të Dashurisë, të gëzimit dhe të kënaqësive tokësore dhe fizike.

Misioni i shenjtë i Samsonit në dramë është t'i kthejë filistinët në rrugën e Zotit mbitokësor, me fuqinë e tij fizike, shpirtërore mbinjerëzore. Samsoni në dialogët me Dalilën shtron dilemën midis arsyes e ndjenjës (shpirtit dhe zemrës), midis shpirtit, që zbulon të vërtetën, që e afron njeriun me Zotin dhe botën mbitokësore, dhe zemrës që të çon në rrugën e bjerrjes, prishjes, kaosit.

Dalila predikon bukuritë e natyrës, kënaqësitë fizike e tokësore. Ky është dhe thelbi i konfliktit në dramë. Ideali i shenjtë për të përmbushur misionin hyjnor, për t'i bindur filistinët të adhurojnë Zotin e Judenjve, duket i pathyeshëm nga çdo forcë. Samsoni, para bukurisë joshëse të Dalilës, pranon të shijojë kënaqësitë tokësore.

Rabini paralajmëron kurthet që të ngre jeta me të papriturat e saj të cilat mposhtin çdo lloj force, qoftë ajo dhe mbinjerëzore. Në dramë shtrohet problemi se ç'rrugë e ç'mjete duhen përdorur për të triumfuar një e vërtetë. Rabini këmbëngul që forca e fjalës duhet shoqëruar me forcën e shpatës. Ai këmbëngul që bashkë me Samsonin të

shkojnë të gjithë me shpata. Në fillim Samsoni është tepër i frymëzuar nga bindja idealiste e vet. Gjatë shtjellimit të konfliktit, kur ndeshen dy ideologjitë, ai humbet forcën mbinjerëzore dhe shqisën e të parit. Megjithatë, ai e do këtë Botë, me gjithë humbjet që pësoi. "*Me gëzim, -shton ai, -do t'i këmbenja sytë e shpirtit tim me ata që m'i dogjnë, po vetëm ta shikonja edhe për herën e fundit këtë botë kaq të mirë. "*Ai çdo veprim, që i solli humbjen, e ka kryer me vetëdije të plotë, prandaj thotë: "*s'm'u trazuan fare ment. Vetë unë desha, pa rashë në pëqi të Dalilës Jo.* " [368] Pra, ka fituar filozofia e kënaqësive të jetës, mbi ato të shpirtit të përjetshëm dhe të idealit frymëzues. Edhe në veprimin e tij, kur Samsoni largon nga katastrofa dy të dashurat, Dalilën dhe Rahilën, ai shfaqet më shumë një njeri tokësor, se misionar e predikues i një zoti hyjnor.

Ai përfundon i verbër dhe i dërrmuar nën gërmadhat e tempullit, gjë që mund të kuptohet si ndëshkim për rrugën që ndoqi, ndonëse pak çaste përpara humbjes tragjike, edhe një herë shprehet se e do Dalilën. Drama mbyllet me këngën e Dalilës: "Në Botë secili, që hin, /Dëbiret, dëbiret shkret. /Fuqija e shpirtit i shkrin, /Dhe dashja e mirë humbet. " (f. 168)

Në kontekstin universal, drama shtron një problem politik të kohës. Çlirimi i atdheut nga pushtuesit do të zgjidhej duke ndërgjegjësuar kombin, apo duke detyruar armikun me forcë? Kjo dilemë midis të vërtetës dhe forcës e ka shqetësuar Nolin gjatë jetës së tij politike. Po në këtë kontekst vepra artistike u tejçon kumte të tjera të rëndësishme kohërave.

Në përfundim

1. Lënda biblike e shfrytëzuar në dramën "Izraelitë dhe filistinë", është ndryshuar dhe përpunuar prej Nolit në përshtatje me realitetin e kohës. Autori nuk rrëfen mitin, por krijon një vepër artistike.

2. Shfrytëzimi i mitit biblik nuk e rëndon ligjërimin e tij, por e historizon atë, e bën më realist. Krijimi i raporteve me tejkohësinë i jep universialitet tekstit artistik.

3. Koherenca e tekstit dramatik konsiston në lidhjen me rend logjik të ligjëratave, duke ndjekur kriteret e rrjedhës kohore, itinerarin hapësinor, lidhjen shkak-pasojë të thurjes së intrigës së ngjarjes.

4. Koherencën në tekst e garanton një fill semantik që përshkon gjithë tekstin. Tema të caktuara luajnë rolin e vendtakimit mes dy a më shumë izotopive. Manipulimet semantike i japin tekstit vlerën artistike.

[368] Drama *Israilitë dhe filistinë*, Fan Noli, 1907

LINDITA XHANARI (LATIFI)

VLERA SEMANTIKO-STILISTIKORE E HUAZIMEVE TURKO-ORIENTALE NË VEPRËN E NOLIT

E gjithë vepra e Nolit, në tërësinë e saj, të josh për të depërtuar sa më thellë në universin nolian. Aty shpaloset me të gjitha nuancat e mundshme një dimension gjuhësor i veçantë, tejet i pasur dhe mbresëlënës, ku interferencat leksikore të huazimeve turko-orientale bëhen edhe më domethënëse, edhe më kuptimplota, edhe më realiste e mbi të gjitha, bëhen shprehëse të një "temperamenti të papërsëritshëm dhe origjinal" letrar e artistik. Për Nolin gjuha nuk është thjesht një mjet pune, por shumë më shumë se kaq. Dimensioni gjuhësor i tij është mbi gjuhën, por gjithmonë për gjuhën e në funksion të realitetit dhe të shprehjes së tij. "Vjersha e Nolit nuk ka ondulacionin e valëve në mezin e detit, po përplasjen e tyre anës, me zhurmë, gjithmonë të përsëritur. Në botën e arkitekturës ajo nuk u përngjan pjesave të rumbulla, po çipeve të mprehta. Sepse Noli nuk gëdhend në mermer, po në krastë. Nuk limos me daltë, po pret me sëpatë dhe me çekan të rëndë. Fan S. Noli sjell në letrat e Shqipes një stil individual, të tijnë, një vibracion energjik, një verb violent me shprehje metaforike të forta, qe rrokullisen njëra pas tjatrës"[369].

Ky punim analizon tërësinë e huazimeve turko-orientale[370] të përdorura nga pena e Nolit, si dhe vlerën e veçantë semantiko-stilistikore që fitojnë ato në veprën e tij. Dy ishin arsyet thelbësore që na nxitën në hartimin e këtij punimi:

Së pari, kritika deri diku e padrejtë që i është bërë Nolit në çështje të përdorimit të huazimeve turko-orientale.

Së dyti, vlera e papërsëritshme e përdorimit të këtyre huazimeve, si shprehëse e një temperamenti të papërsëritshëm letrar dhe njerëzor.

"Kush më shumë e kush më pak, Fan Nolin pothuaj shumica e studiuesve e kanë qortuar për përdorimin e tepruar të fjalëve të huaja, sidomos të turqizmave"[371]. Kritikat në të vërtetë mund t`i ndajmë në dy grupe: kritika të hershme dhe kritika më të vonshme. Kritikat e grupit të parë kanë qenë kryesisht nën frymën e purizmit "të tepruar", por edhe të përligjur, që vinte si vazhdim i frymës atdhetare të trashëguar nga Rilindja. Kështu A. Xhuvani, në një punim të bërë në 1944-ën thekson se: " Ai nuk është kujdesë gjithaq për dlirësinë e gjuhës. Në veprat e tij, si në përkthimet, si n`origjinalet, nuk mundohet që të përdorë një gjuhë krejt shqipe në frazeologji, në fjalë

[369]M. Kuteli, Poeti Fan S. Noli, Vështrim panoramik (Ribotuar nga libra "Mall e brengë", Tiranë 1943), Fan S. Noli, Vepra I, Tiranë 2003, fq. 35

[370]Do të përdorim në këtë punim termin huazim turko-oriental, për të diferencuar huazimet nga turqishtja, nga huazimet perse dhe arabe, qe kanë hyrë nëpërmjet turqishtes.

[371]F. Agalliu, "Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij", Tiranë, 1999, fq 24

e në të lidhun të mendimevet. Përdor shumë herë konstrukte e fjalë të hueja, dhe disa neologjizma nuk i ka formue mirë"[372].

Presioni në çështje të përdorimit të turqizmave dhe orientalizmave, siç del edhe nga shkrime të ndryshme kritike të bëra në ato vite, duhet të ketë qenë i madh, përderisa vetë Noli e ka ndier të nevojshme të japë sqarime përkatëse në lidhje me përdorimin e tyre. Kështu në shkrimin: "Përgjigja jonë për disa kritika dhe këshilla"[373], Noli vetë " Pasi ngrihet kundër puristëve, të cilët i quan njerëz fanatikë gjuhësorë, që s`njohin etimologjinë, artikullshkruesi thotë se s`ka gjuhë në botë që të mos ketë fjalë të huaja dhe se nuk është e mundur ta qërosh një gjuhë nga fjalët e huaja pa e sakatosur"[374], argumenton dhe arsyeton përdorimin e këtyre fjalëve duke theksuar se: " Pasi t`i qërojmë nga fjalori ynë të gjitha fjalët e huaja, u dashka të bëjmë edhe një qërim tjetër: u dashka të nxjerrim me mashë çdo fjalë të fortë, të ashpër, të rreptë, të hidhur, të thartë, të shëmtuar dhe të lëmë brenda vetëm fjalë të buta, të ëmbla dhe të bukura. Po ç`të bëjmë ahere kur është nevojë e domosdoshme të përshkruajmë një gjë të fortë, të ashpër, të rreptë, të hidhur, të thartë, të shëmtuar? ... Çdo gjë ka emrin që i përket. Do t`i japim atë emër e jo tjetër. S`kemi hapur **sheqerxhianë** për të shitur ëmbëlsira, po kemi nisur një gazetë ku duhet të japim pikturën e gjendjes së Shqipërisë, ashtu siç është, ashtu siç e shohim, si mos më keq... E vetmja nge për ne është vërtetësia"[375]. Vetë sqarimi që bën Noli është mjaft interesant dhe thelbi i tij konkretizohet me një fjalëformim të ri të realizuar nga vetë Noli "**sheqerxhianë**", që bart në vetvete dy rrënjë të huazuara: "**sheqer (seker)**" dhe "**xhihan (cihan)**"[376], e që në turqisht nuk ekziston si fjalëformim. Sigurisht që përdorimi i kësaj fjale me kuptimin: **gjithësi e sheqerkave të sajuara**, ka një vlerë semantike krejtësisht të dallueshme nga fjalët: **ëmbëltore** apo **dyqan** për të shitur ëmbëlsira, që do të përdorte çdokush në ligjërimin e tij.

Kritikat e mëvonshme për gjuhën e Nolit mendojmë se janë të një karakteri tjetër. Pikërisht kur nuk viheshin më në diskutim pikëpamjet politike të Nolit dhe kur dihej botërisht qëndrimi i tij, duhej që në një farë mënyre të sajoheshin edhe disa "pika të dobëta" të veprës së tij, pasi ishte krejtësisht e pamundur të kritikohej në çështje të frymës kombëtare e patriotike. R. Qosja shkruan: " Sikur shkrimtarët tanë të kishin ndjekur rrugën e Nolit, gjuha shqipe do të ishte bërë një **qervish**, në të cilin nuk do të dihej se a kanë qitur më shumë thelpinj hurdhash turqit, arabët, persianët, italianët, francezët apo grekët. Ai, si duket, nuk ka menduar shumë se çdo gjuhë kombëtare duhet të mbështetet në fuqitë e veta, e ato që s`mund t`i bëjë me to, atëherë të kërkojë hua, por edhe huat t`i kthejë në monedhë të vet"[377]. Vetë Qosja në kritikën e tij nuk i shpëton përdorimit të një huazimi turk me vlera të veçanta semantike, që përdoret jo aq me kuptimin e një gatimi të veçantë, se sa në kuptimin e një "**gatimi**" të përzier, të

[372]A. Xhuvani, Studime gjuhësore, 1956, fq. 53-54
[373]F. Noli, Republika, 4 dhjetor 1930
[374]F. Agalliu, "Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij", Tiranë, 1999, fq 26
[375]F. Noli, Republika, 4 dhjetor 1930
[376]**Cihan-xhihan**- me kuptimin **gjithësi, univers, botë,** Turkçe Sozluk, Ankara, 2006
[377]R. Qosja, Panteoni i rralluar, 1986, fq. 212-213

bërë lëmsh e të paemër " **kervis-qervish**"[378], mungesa ose zëvendësimi i të cilit me fjalën tjetër turke "**çorbë**", apo me keq akoma me fjalën "**supë**", do ta zhvlerësonte krejtësisht thënien.

Një qëndrim më të drejtë, e për rrjedhojë edhe më të saktë në çështje të përdorimit të huazimeve turko-orientale nga ana e Nolit, mbajnë prof. Sh. Demiraj, prof. M. Domi, prof. F. Agalliu, si dhe M. Kuteli. Kështu F. Agalliu do të shprehet se: " Nga ata që janë përpjekur më shumë që gjuha shqipe `huat t`i kthejë në monedhë të vet`, Noli, siç ka vënë në dukje M. Domi dhe siç e ka provuar edhe Sh. Demiraj, zë kryet e vendit"[379].

Këta studiues theksojnë me të drejtë faktin se gjuha e Nolit mbështetet thellësisht në gjuhën e popullit, pasi gjithmonë i drejtohet popullit. Edhe vërejtja që bën F. Agalliu[380] se ". . . . . Noli nuk është kujdesur sa duhet për pastërtinë e gjuhës dhe bashkë me Xhuvanin shkakun e kësaj dukurie e gjejmë në `faktin e njohur se ai pothuaj gjithë kohën jetoi e punoi jashtë atdheut dhe s`pati mundësi të ndjekë zhvillimin e gjuhës në vend`[381]', nuk na duket me vend, pasi gjuha e Nolit është për të gjithë dhe e të gjithëve, gjejmë aty edhe bukuritë e toskërishtes edhe fuqinë e gegërishtes, edhe fjalë e forma gramatikore të vjetra edhe fjalë e forma gramatikore të formuara rishtazi prej Nolit, e që janë kthyer në pjesë përbërëse të fondit më të mirë gjuhësor shqiptar. prof. Çabej do të thoshte se: " Ai nuk është poet i lartësivet eterike, po është shkrimtar i plisit të dheut. Është një Ante i literaturës sonë, që i merr fuqitë prej mëmës tokë. . . . . Ai na paraqitet si një lis i moçëm e plot gdhënj: lis i vetëmuar, po me rrënjë ngulur mirë në të thellat e dheut. E këtillë mbetet edhe gjuha e tij. Në këtë nuk ndihet ëmbëlsia e flladit të verës sesa furia e murrërit të dimrit. Ajo nuk ka aromën e luleve, po ka erën e shëndoshë të dheut. Ka edhe diçka prej pikash të rënda e të idhëta, në të shprehet ana e rëndë e jetës shqiptare. Në këtë poezi shihet sa mund të jetë gjuha shqipe e ashpër e e vrazhdë, dhe e fortë në ashpërsinë e saj"[382]. Sot, kur analizon hollësisht gjithë veprimtarinë e tij politike dhe kur lexon me imtësi çdo gjë të shkruar prej Nolit, poezitë, publicistikën, përkthimet etj., si dhe kur krahason semantikën e të gjitha përdorimeve të huazimeve turko-orientale me semantikën e tyre në gjuhën nga janë marrë, i bindesh faktit që "Natyrisht, këto fjalë orientale të huazuara... . . . . dhe të asimiluara prej shqipes, poeti i ka përdorur jo se ato kumbojnë fort dhe plotësojnë kështu një mungesë të kësaj gjuhe, por si një mjet stilistik të një lloji të vecantë, mbase duke ndjekur edhe shembullin e poezisë, ku fjalët orientale luajnë një rol te madh"[383]. I të njëjtit mendim është edhe A. V. Desnickaja kur thekson

[378]**Kervis-qervish,** TurkçeSozluk, Ankara, 2006

[379]F. Agalliu, "Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij", Tiranë, 1999, fq 25

[380]F. Agalliu, "Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij", Tiranë, 1999, fq 25

[381]A. Xhuvani, Studime gjuhësore, 1956, fq 53-54

[382]E. Çabej, Nëntori, 1965/4, fq. 27

[383]F. Agalliu, "Gjuha e Nolitnëvepratorigjinaletëtij", Tiranë, 1999, fq 29

se: “ Përdorimi i turqizmave në këto vjersha është një mjet stilistik suigeneris, por aspak një veçori e përgjithshme e gjuhës së Fan Nolit”[384].

Dy janë veçoritë kryesore të përdorimit të huazimeve turko-orientale në veprën e Nolit:

Së pari, ato nuk kanë të njëjtën shpërndarje në veprën e tij.

Kështu, në pjesën e parë të krijimtarisë së tij, si dhe në krijimet që përshkohen nga një frymë e lartë patriotike, kujtojmë këtu, Historia e Skëndërbeut, Anës lumenjve, Rent, or Marathonomak etj., nuk gjejmë pothuajse asnjë huazim oriental. Më pas, në pjesën e dytë të krijimtarisë së tij, sidomos në satirat e fuqishme dhe në publicistikë, ai do të përdorë një mori të madhe huazimesh turko-orientale, të gjitha me vlera të veçanta stilistikore dhe semantike, që jo vetëm e bëjnë më domethënëse veprën e tij, por e bëjnë edhe më të gjallë e të kuptueshme për masën e gjerë të lexuesve të kohës. “Kur thotë me të drejtë se `Plaga nukë shërohet dyke e fshehur e dyke mos e përmëndur`[385], Noli sikur ngrihet kundër një hipoteze të njohur në gjuhësi, e cila u njeh fjalëve edhe një rol përcaktues në jetën shoqërore. Për autorin e keqja qëndron gjetkë, ka rrënjë shoqërore e nuk vjen nga fjalë, të cilat do të përdoren sa kohë rron dukuria që ato shënojnë. Kësaj pikëpamjeje ai do t`i mbahet edhe në veprimtarinë krijuese, sidomos në publicistikë, ku fjalët turke, arabe e persiane që njiheshin në popull, qarkullonin, si të themi, lirisht, nëpër faqet e artikujve që flisnin për realitetin e kohës në Shqipëri”[386]. Pasi i ka provuar të gjitha mënyrat për të arritur një zgjim të vërtetë kombëtar, duke përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen aktive në politikë, fjalimet në parlament etj, . Noli është i detyruar t`i kthehet gjuhës dhe zhargonit popullor, madje ta pasurojë semantikën e këtij zhargoni, pasi i zhgënjyer nga moskuptimi, atij nuk i mbetet më rrugë tjetër. Është e vetmja mënyrë që i ka mbetur për të ndërgjegjësuar lexuesin, tashmë jo më politikanët e parlamentit, por popullin e thjeshtë, atë që është “**milet**”[387], pra që është një **turmë pa krye**, për t`i bërë të qartë se po kthehet prapa, në vend që të përparojë, si kombet e tjerë. Në këtë etapë të krijimtarisë do të ndeshen dendur në veprën e tij huazimet: **dovlet, hyqymet, milet, rezil, katil, tepdil, kopuk, dallkauk, zaptie, xhepane, koshadhe, dyfek, bajrak, yrnek, derman, vatan, mesele, kadi, davaxhi** etj.

Së dyti, Noli përdor dhe përzgjedh nga thesi i madh i huazimeve turko-orientale, që kanë hyrë në gjuhën shqipe, dy grupe fjalësh: fjalë me semantikë të drejtpërdrejtë, të pastër të cilën Noli nuk e ndryshon, si dhe fjalë me kuptime dytësore e figurative (mecaz) në turqisht, arabisht e persisht, të cilat Noli jo vetëm i përdor në kuptimin figurativ që ato bartin, por i pasuron edhe më tej në semantikën e tyre. Mund të përmendim këtu një varg fjalësh me kuptim të drejtpërdrejtë si: **top, kala, dafin, hurma, kanun, dyqan, pazar, budalla, qymez, mangall, behar, dynja, buxhak, zinxhir, kamçik, katran, tiran, kopuk, dallkauk, rezil, katil, kaba, nam, dolli,**

[384]A. V. Desnickaja, Voprosy teori I istori jazyka, “O stilisticeskoj funksi turcizmov albanskoy poezzi”, 1963, fq. 95

[385]Fan S. Noli, Rron, or rron, fq. 283

[386]F. Agalliu, “Gjuha e Nolitnëvepratorigjinaletëtij”, Tiranë, 1999, fq 27

[387]Huazimi: **milet**, në veprën e Nolit, përdoret në kuptimin: turmë pa kokë, dhe del nga semantika e kësaj fjale në turqisht, TurkceSozluk, Ankara, 2006.

qylafi, uzur, vergji, shamatë, gajret, zili, çekan, xhani, sarhosh, raki, sadrazem, xhumhurijeti, deve, gajret, kallaballëk, tufani, haraç etj. , si dhe një varg fjalësh me kuptim të figurshëm si: **mejdan, mexhlis, hallvaxhiu, katrani, ylefe, firari, , rehatos, sajdis, zaptoj, kabardis, batërdis, kamçikoj, ujdis, yrnek, ziafet, takat, kusur, badjava, derman, nishan, sevda, bela, çelebi**etj. Nuk mund të lëmë pa përmendur edhe disa kompozita të formuara nga Noli, që në përbërjen e tyre kanë rrënjë turke, si: **sulltan-llokum, salep-sulltan, syrgjyn-gjallë, syrgjyn-vdekur** etj. Të gjitha fjalët e huazuara të përdorura nga Noli janë gjithashtu pjesë përbërëse e Fjalorit të gjuhës shqipe, botim i vitit 1954. Kjo përforcon faktin se Noli i madh diti të përdorë me mjeshtëri fjalë të huazuara që ishin asimiluar krejtësisht prej shqipes dhe që, për këtë arsye mund të ndikonin më shumë në masën e lexuesve të tij.

LIRI SEITLLARI

RRETH SHPREHËSISË LEKSIKORE NË POEZINË E NOLIT

Fan S. Noli mbetet një model i mjeshtërisë artistike në poezinë shqiptare të traditës. Edhe në poezi, ashtu si "në gjithë degët ku ka punuar, ka sjellë një sulm të tijin, një vrrull e një verb të panjohur, madhor"[1]. Origjinaliteti i tij shfaqet në radhë të parë në aftësinë për të zgjedhur mjetet e duhura të shprehësisë leksikore. Polisemia e zhvilluar e gjuhës shqipe i ofron poetit mundësi të mëdha shprehëse. Dihet se dy përmasat që ndikojnë drejtpërdrejt në shprehësinë janë: kapaciteti nocionor i gjuhës dhe elasticiteti. Në këto dy përmasa mbështeten mundësitë potenciale të përzgjedhjes. Noli ka ditur të shfrytëzojë pasurinë e madhe të mjeteve e mundësive shprehëse që ofron gjuha shqipe dhe ka arritur të krijojë shprehësi vetjake leksikore e semantike. Ai ka ditur të zgjedhë mjetin e caktuar në momentin e caktuar. Përzgjedhjet dhe parapëlqimet në fushën e leksikut përbëjnë një nga tiparet dalluese të mjeshtërisë së tij stilistike. Fjala te Noli shfaqet në kompleksivitetin e saj më të plotë. Ajo merr funksion referencial, funksion konotativ, funksion shprehës dhe çka është më e rëndësishme funksion poetik dhe aktualizohet në lidhjet semantike e në lidhjet sintaksore. Karakteristika më e dukshme në poezitë e Nolit është poetizimi i një leksiku të zakonshëm e për më tepër i një leksiku të rëndomtë. Ai pasuroi e ripërtëriu semantikën e disa prej këtyre fjalëve dhe u dha ngarkesa e ngjyrime të tjera kuptimore duke zgjeruar lidhjet e tyre në shumë anë.

Niveli i lartë i shprehësisë leksikore në poezinë e Nolit, përpos shumë të tjerash, arrihet nëpërmjet disa treguesve të tillë si: *denduria e përdorimit të leksemave të caktuara, sinonimia, përsëritja, numërimi,, kundërvënia dhe shkallëzimi***.**

- Përdorimi i dendur i disa leksemave të caktuara është i lidhur me tematikën, me idetë dhe me gjendjet shpirtërore, emocionale të poetit, me përpjekjet e tij personale për ta futur atdheun në rrugën e zhvillimit, përparimit dhe dinjitetit kombëtar, me idealet e tij të larta të lirisë dhe demokracisë: *flamur, atdhe, vatër, liri, përlind, kryq, kryqësoj, krisht, mesi, vatër, tiran, laro, vegjëlitt, nëno, çlironjës* etj. Disa nga këto leksema arrijnë të bëhen fjalë-çelës, arrijnë të fitojnë vlerat e simbolit dhe të bëhen pika qëndrore të metaforave, të krahasimeve, të personifikimeve dhe të përbërësve të tjerë të stilit të dhe të shprehjes. Të tilla janë fjalët: *krisht, Moisi, Shën Pjetër, liberator, nënë, flamur, atdhe* etj. për shembull: "Jepni për *Nënën*", "mbahu *Nëno* mos ki frikë", "*Nënës* mos i bëni varrë"(Vepra I, f. 70); "*Nëno* moj, mbaj zi për vllanë" (Vepra I, f. 88); "O *Flamur* gjak, o *flamur* shkabë", "*Flamur* që lind Shën Konstandinin/Pajton Islamn' e Krishtërimin/çpall midis feve vllazërimin, /*Flamur* bujar për Njerëzi"(Vepra I, f. 67); "Mbi një brek të Dragobisë/Priret *flamur* i lirisë"(Vepra I f. 89); "Që më Ismail Qemalin/ngriti *flamur* trimëror"(Vepra I f. 88);dhe e kapnë kamxhikun sarafët për fenë/dhe e shempnë çlironjësin, fenë e *atdhenë***"(**Vepra I, f. 76); "Kur tufani e çthuri fenë/kur tirani e krrusi *atdhenë*"(Vepra I,

f. 89);"Marshi i *Krishtit*"(Vepra I, f. 74);"Kur e pa këtë zi dhe këtë errësirë/*Krisht*' i ëmbël u ndez dhe u bë i vështirë"(Vepra I, f. 75);"Turren burrat, çirren gratë/Turm' e ndezur, e tërbuar/*Krishtin* për ta kryqëzuar"(Vepra I f. 83);"Po Troket çekani, /Po kërcet mejdani, /Dor' e këmb' i çpon, / *Krishtin* kryqëson"(Vepra I, f. 85)etj. Vlera simbolike e leksemës *krisht* hetohet në mikrokontekst, por e plotë shfaqet në një kontekst më të gjerë, pra duke pasur parasysh tufën e vjershave autobiografike të poetit. Noli njëjtësohet plotësisht me heroin moral të barazisë, me Krishtin dhe me flijimin e tij për idetë e mëdha njerëzore. Rreth bërthamës së Krishtit, ngrihen figura të tjera që lidhen në mënyrë të vetëdijshme apo të pavetëdijshme me pësimin e tij.

Ka raste kur e njëjta fjalë merr vlera të ndryshme leksikore e gramatikore, në përputhje me kontekstin ku përdoret. Kështu, për shembull fjala *vlla* ka një ngarkesë kuptimore më të specifikuar dhe mbishtesë ngjyrimore stilistike tek elegjia për Luigj Gurakuqin, kur shkruan: "Nëno moj mbaj zi për *vllanë*". Ndërkohë, te poezia "Sulltani dhe kabineti"kjo fjalë kthehet në një fjalë asnjanëse, duke zbritur kuptimisht, deri në nivelin e një pasthirrme: "Vermë kupa dhe meze/ndryshe gjumi or *vlla* s'më ze".

Nga ana gramatikore denduri të lartë përdorimi, përveç *emrave*, kanë edhe *foljet* të cilat herë shprehin aspiratën për veprim drejt fitores, siç janë foljet *rend, vërvitet, kërcet* dhe herë mbulojnë semantikisht gjendje emocionale e shpirtërore të autorit, siç janë foljet *ulërin, përpëliset, çakërdisur, batërdisur, përpëlitur, zalisur, katosur, brohorit, vajtoj* etj. Me përdorimin e tyre shumë të dendur këto leksemat të parapëlqyra të Nolit fitojnë vlera të reja semantike e stilistike.

Mjediseve orientale, Noli u përgjigjet me një fjalor dhe frazeologji plot orientalizma, mjediseve perëndimore u përgjigjet me veçoritë përkatëse gjuhësore "Për të plotësuar fjalorin e tingujve të fortë që i mungojnë shqipes dhe veçanërisht toskërishtes, Noli përdor një varg të gjatë fjalësh arabisht, turqisht dhe persisht, të asimiluara prej shqipes"[2]. Tipike për këto përdorime është poezia "Marshi i Barabajt"me fjalët *allalla, rezil, katil, teptil, dallkauk, kopuk*, por edhe të tjera si *jabanxhi, fajdexhi, syrgjynosur, zengjini, yrnek* etj.

Disa leksema kthehen në njësi individualizuese në gjuhën e Nolit. Të tilla janë fjalët e marra nga fjalori biblik të cilat në poezinë e tij marrin ngarkesa të reja kuptimore e simbolike si *Moisi, Shën pjetër, Kirenar, Krisht, mesi, kryq.* Në një plan më të përgjithshëm, fjalët që përdoren më së shumti janë ato nga fondi i përgjithshëm, fjalë të vjetra, trajta dialektore dhe orientalizma.

-" Gjuha ka repertor shumë të gjerë mjetesh e mundësish, ndërsa shkrimtarit i mbetet të zgjedhë". [3]Noli përzgjedh në çdo nivel gjuhësor: në fonetikë, në morfologji, në sintaksë dhe sidomos në leksik. Në nivelin leksikor krahas dendurisë, ai shfrytëzon edhe sinoniminë, sepse dihet se çdo fjalë, shprehje, ndërtim a ide mund të ketë sinonimi ose mund të krijojë sinonimi. Ai di të shfrytëzojë mirë mundësitë që ofron shqipja në këtë drejtim duke zgjedhur më të përshtatshmen, më të qëlluarën, më shprehësen, gjithmonë në funksion me situatën ku vendoset. Kështu vendi për të është *atdhe, komb, vatër, nënë dhe Shqipëri*: "E zuri për gryke e shtriu përdhe/Nga thonjt' rrëmbeu të mjerin *Atdhe*"(Vepra I, f. 68); "Mbahu *Nëno* mo ski frikë/se ke djemtë n'Amerikë"(Vepra I, f. 70); "Kryqi yt do të bëhet konop i përshenjtë/Për të varur e për të munduar Hebrenjtë /Për të shuar një *komp* t'arratisur, të ndjekur/Për të cilin ke

lindur, ke rrojtur, ke vdekur? ”(Vepra I, f. 101); “sPërjetë prije *shqipërinë*/Përlintja shpirtin dhe fuqinë” (Vepra I, f. 67)etj.

Një përftesë e suksesshme në poezinë e Nolit është çifti sinonimik**.** Çifti sinonimik bëhet një stilemë intensive dhe shpeshtësia e përdorimit të tij kthehet në veçori stilistike të gjuhës së tij: o flamur gjak, o flamur shkabë/*o vënt e vatrë***…(**Vepra I, f. 67);Kërkon *Parajsën*, vdes në *Skëterrën*/ (Vepra I, f. 73);Pse kaq gjatë, Zot, m’ arratise / Pse më *përplase*, më *përpëlise* (Vepra I, f. 72);Janë shtruar sarafët pa *shpirt* e pa *besë*…Dhe me *forcë e pahir*, na *çliro*, na *shpëto***. (**Vepra I, f. 75); Allalla, o *rezil* e *katil*, allalla;Ti na *shtyp* e na *shtrydh*…(Vepra I, f. 80);Varreni, posa s’do as të *vras***’** as të *varë***…(**Vepra I, f. 81);Nëno moj, *vajto, merr malin;*Ku të dha *liri, kurorë*(Vepra I, f. 88) etj. Dendur në këto çifte hyjnë në marrëdhënie sinonimie edhe njësi që në të vërtetë nuk janë sinonime, por që në çifte funksionojnë si të tilla. Kjo mund të thuhet edhe për vargjet sinonimike. Pranëvënia e elementeve të një paradigme në një sintagmë ka krijuar tufa stilemore dhe ka sjellë shprehësi të lartë në tekst: *Fryn* e *çfryn* veriu/*Ngrin, mërdhin* i ziu(Vepra I, f. 77);*Çakërdisur, batërdisur/përpëlitur* dhe *zalisur*(Vepra I, f. 95);*Kryetrim* që lufton triumfon për atdhe/*Shpëtimtar, kryemjek, kryeshenjt, kryefe/Pasuri*, dhe *liri*, dhe *fuqi* ti na dhe (Vepra I, f. 740);*Vraji, shtypi*, dhe *shtrydhi*, dhe do t’adhurojnë (Vepra I, f. 76)etj.

Ngjyrimet kontekstuale të sinonimeve shërbejnë edhe për të përforcuar mendimet dhe idetë e shprehura nëpërmjet tyre dhe në rastet kur në qendër të vëmendjes vendosen fjalë të veçanta kyçe, ndihmojnë në zbërthimin e mesazhit letrar.

-“ Dihet, se përsëritja, si figurë e ndërtimit, krijohet me rimarrjen e elementeve të ndryshme të rrafsheve gjuhësore(tingujve, rrokjeve, fjalëve dhe fjalive, përftesave, stilemave dhe strukturimeve të ndryshme)përtej pragut paradigmatik”[4]. Përsëritja gjuhësore më e përhapur në poezinë e Nolit është ajo që shfaqet në rrafshin dytësor të organizimit gjuhësor dhe ajo me veçori të përftesës shprehëse. Përsëritja është gjithmonë në funksion të theksimit të diçkaje të veçantë dhe për të arritur efekte të veçanta stilistike në situate të ndryshme ligjërimore. Kështu, te poezia “Hymni i flamurit”, fjala *flamur* përsëritet 9 herë, në poezinë “Jepni për Nënën”, fjala *nënë* përsëritet 14 herë, në poezinë “Marshi i Kryqëzimit” fjala *kryqësoje* përsëritet 9 herë etj. Rimarrja e këtyre njësive leksikore tërheq vëmendjen, krijon shprehësi të lartë të tekstit dhe shton domethëniet kuptimore.

Përsëritjet e fjalëve, por sidomos aktualizimi e strukturimi i tyre në nivele të ndryshme bëjnë që ato të marrin vlera të reja, të panjohura më parë dhe të zgjerojnë spektrin simbolik: Se betejën e fituam/Dhe qytetin e shpëtuam/*Rent, or rent/Rent, or Marathonomak! …Hip e zbrit/Petrit, Marathonomak! …/Flamurgjak/Kuqo, Marathonomak! ... Vrer e tmerr/Shpejt, or Marathonomak! ... Turru tej /Tutje, or Marathonomak! ... Ur’e prush/Furr’, or marathonomak! ... Mbahu, or Marathonomak! S’janë veç Najada…lark, or Marathonomak! .. ”. E fituam! ” brohorite…Vdiqe, or Marathonomak! ... Se i vogli shtrin viganin/Dhe i shtypuri tiranin/Veç e tok/Tok, or Marathonomak! (*Vepra I, f. 91-92-93). Përsëritja e fjalës *Marathonomak* është në përputhje me përmbajtjen, me tonin dhe me rrethanat e ligjërimit. Me anë të saj jo vetëm dendësohen domethëniet, por krijohet edhe një mënyrë e re të shprehuri, me një ndjeshmëri shumë të veçantë.

Në poezinë e Nolit përsëriten jo vetëm fjalët me kuptim të fortë leksikor, siç janë emrat dhe foljet, por edhe ato me kuptim të zbehur si lidhëzat, pjesëzat apo pasthirrmat. Përsëritjet e tyre ndihmojnë për të karakterizuar apo mbitheksuar përjetimet e gjendjeve emocionale të autorit dhe bëhen njëkohësisht burim dhe rrafsh i përshtatshëm për përdorimin e përsëritjes si figure, duke i dhënë vargjeve muzikalitet të papërsëritshëm.. Kështu, përsëritja në ligjërimin poetik të Nolit kthehet në një mjet stilformues. Ato shfaqen si njësi leksikore, por edhe si ndërtime: Po vajtoj *pa* fund, *pa* shpresë…*Ku e* lam'*e ku* na mbeti…*Seç*'u tera, *seç***'** u mpaka/*seç*' u çora, *seç* u mplaka…*as* i gjall'*as* varrosur…*Më* bën djal'e *më* bën trim/*Më* jep forcë e *më* jep shpresë…*Se* mileti po gatitet/*Se* tirani lebetitet/*Se* pëlcet, kërcet furtuna(Vepra I, f. 94-95);*Dale, moj,* se kam një fjalë…*Dale, moj* se s'jam më djalë…*Dale, moj* se më kapite…Dale, *moj* se jam i çalë…(Vepra I, f. 96-97).

Shprehësia e ligjërimit të poetit, shprehësia e karakterizimeve, fuqia e emocioneve të shprehura përmes përsëritjes të njësive leksikore dhe ndërtimeve të njëjta në mikrokontekste, por edhe në gjithë poezinë si tërësi, është tipar dallues i gjuhës dhe stilit të Nolit.

-Edhe numërimi, si një figurë stilistike, përdoret dendur në poezinë e Nolit, madje mund të thuhet se bëhet tipar dallues. Nga pikëpamja leksiko-gramatikore njësitë që përfshihen më së shpeshti në numërim janë foljet, emrat, mbiemrat. Marrëdhëniet brenda këtyre njësive, në të shumtën e herës paraqiten të barazvlershme me një simetri gjuhësore: *Nëna, motra, nusja dalin, /Ngrehin* krahët të *të ndalin*(Vepra I, f. 92);Fryhet *Vjosa***,** derdhet *Buna***,** /Skuqet *Semani* dhe *Drini*…Anës *Vjosës,* anës *Bunës*…Anës *Elbës*, anës *Spree-së! (*Vepra I f. 95);Jam *imami* e jam *dovleti/Padishahu* e *Muhameti*/Jam *xhenemi* e jam *Xheneti/Kijameti* e *selameti.* (Vepra I, f. 104);Qani, qani, or *agallarë*/O *bejler'e pashallarë*(Vepra I, f. 117);E rrahur nga *Greku,* nga *Serbi* e *Bullgari*/Do gjak të thëthijë dhe vjen te Shqiptari…Me *armë,* me *topa*, me *kordh*'e me *shpata*/Se doli kuçedra e errët nga nata(Vepra I, f. 68);Ç'thotë ajo e ve *e gjorë*, /Mbretëreshë pa kurorë-*/Faqeçjerrur, leshlëshuar***,*** /Shpirt e zemër *përvëluar*(Vepra I, f. 70);Dhe e shempnë *çlironjësin, fenë e atdhenë*(Vepra I, f. 76)etj. Njësitë që përbëjnë këto numërime janë të një paradigme leksiko-semantike, pra edhe gjuhësore, dhe ashtu të bashkuara e të aktualizuara në një tekst letrar, fuqizojnë mesazhin poetik. Ato e nxisin përfytyrimin e lexuesit me gjerësinë, thellësinë e hollësinë e paraqitjes. Përsa i përket ndërtimit, numërimet dalin me lidhje mbizotëruese asindete, por nuk mungojnë edhe ato me lidhëza.

- I parapëlqyer për Nolin shfaqet edhe shkallëzimi. " Ai konsiderohet figurë ndërtimi e shprehjes e mbështetur në parimin e intensitetit dhe të efektit. Ndërtohet në nivelin sintaksor, në vargun e njësive të ndryshme leksikore, po edhe ndërtimeve të tjera në pikëpamje sintaksore të barasvlershme"[5]. Shkallëzimi në numërimet e përsëritjet e shumta të Nolit shton gjallërinë ose dramacitetin e gjendjeve, përjetimeve shpirtërore dhe dendëson mendimet dhe përsiatjet e tij. Ai është pozitiv ose negativ: Përmi *Dhe*, përmi *Fron*, përmi *Qiell* u bekofsh/Përmi *djall* dhe *tiran*, përmi *Ferr* mbretërofsh(Vepra I, f. 74);Se mileti po *gatitet, /*Se tirani *lebetitet*, /Se *pëlcet, kërcet*

furtuna, /*Fryhet* Vjosa, *derdhet* Buna, /*Skuqet* Semani dhe Drini…*Ngrehuni* dhe *bjeruni, /Korrini* dhe *shtypini*(Vepra I, f. 94-95)etj. Duket se shkallëzimi krijohet përmes vargut të njësive leksikore, por edhe të ndërtimeve të tjera në rrafshin sintaksor të barazvlershme dhe sipas një hierarkie kuptimore. Kryeson shkallëzimi ngjitës: *Varfëri, poshtërsi, robëri* ti na dhe…Ti *na shtyp e na shtrydh* e ti *gjakun na pi*/Ti *na ther e na grin* e për qef *na* bën *fli* (Vepra I, f. 80);Hajde, ja *Akropolia, /Ja qyteti e njerëzia*(Vepra I, f. 92)etj. Megjithatë, ajo që mund të thuhet është se nuk mungon shkallëzimi zbritës dhe se jo gjithmonë ngjitja dhe zbritja shkojnë në vijë të drejtë. Ndodh që përforcimi i intesitetit të bjerë në gjymtyrën që ndodhet në mes të shkallëzimit.

- Gjithashtu, edhe kundërvënia kthehet në një semantostlilemë të fuqishme, me efekt të madh shprehës në ligjërimin poetik nolian, duke qënë se bota e tij është vazhdimisht në konflikt me dukuri e fuqi kundërshtuese: *Hip* e *zbrit*/Perit, Marathonomak…Se *i vogli* shtrin *viganin*/Dhe *i shtypuri tiranin*/*Veç* e *tok*/*Tok*, or Marathonomak**…**Ja arrive ua the;/Ç*'gas* e ç'*helm* qe kjo myzhde(Vepra I, f. 91-92-93);Sheh gasn'e pirtmë për *djalërinë*/dhe shkretëtirën për *pleqërinë*…Këtej ka *dimrin*, andej *prënverën*/Kërkon *parajsën*, vdes në *Skëterrën(*Vepra I, f. 73);Atje *nisi*, atje mbaroi, /Atje *krisi*, atje pushoi(Vepra I, f. 89)etj.

Kundërvënia del mjaft e efektshme në përshkrimin e personazheve. Me anë të saj krijohet situata ballafaquese e cila ravijëzon më mirë njërin apo tjetrin, si për shembull figurën atdhetare të Luigj Gurakuqit dhe figurën e tradhtarëve të atdheut: Se *të deshte* dhe **s***'të deshnin, /*Se *të qante* kur *të qeshnin*, /Se *të veshte* kur *të çveshnin*, /Nëno moj të ra dëshmor. (Vepra I, f. 88)etj. Përveç antonimisë gjuhësore në poezinë e Nolit sjell vlera të reja edhe antonimia përmbajtësore. Është i konsiderueshëm numri i njësive leksikore dhe i shprehjeve që në kontekste të caktuarë hyjnë në kundërvënie kuptimore: *Të dha liri, kurorë - s'i dhe as varr për horr, larot, tradhëtor - dëshmor, trimëror, Liberator…*, Thon*', u shtri* e thon*'u vra*/po ti *s'vdiqe*, or Baba *(Vepra I, f. 88-89)etj*. Kështu, themi, se te ligjërimi poetik i Nolit ndeshim kundërvënie konceptesh e idesh, kundërvënie situatash e veprimesh si dhe kundërvënie gjendjesh dhe emocionesh të forta të cilat ndihmojnë për t'i sjellë më të fuqishme mesazhet e poezive të tij.

Në përfundim, themi se Noli i përgjigjet potencialit të madh të mundësive shprehëse që zotëron gjuha shqipe, me aftësinë e tij mjeshtërore për të përzgjedhur mjete të tilla të cilat e bëjnë atë një poet të madh të letrave shqiptare dhe me një stil krejt origjinal.. Ai di të zgjedhë fjalën, di ta aktualizojë atë fuqishëm përmes lidhjesh të duhura, di të krijojë çifte dhe vargje sinonimike me vlera shprehëse e stilistikore, di të krijojë kundërvënie të forta në rrafshin gjuhësor e leksikor, di pra, t'i japë energji dhe vibracion unik fjalës shqipe.

MATILDA PARLLAKU(ÇOLLAKU)

VEÇORI SINTAKSORE TË GJUHËS SË NOLIT PARLAMENTAR

Materialet në të cilat jemi mbështetur janë "Bisedimet e Këshillit Kombtar" 1921-1923 dhe "Bisedimet e Kuvendit Kushtetues" 1924, të cilat janë publikuar në libra të veçantë, katër herë në muaj, në shtypshkronjën "Nikaj" në Tiranë. Ato janë diskutime, të zhvilluara apo fjalime të mbajtura në seancat parlamentare të zhvilluara në vitet kur Noli ka qenë përfaqësues i shoqatës panshqiptare "Vatra" në Parlament dhe janë zbardhur e botuar në libra të quajtur në fillim "fletore zyrtare".

Këto janë forma gojore publike, të cilat përfshijnë fjalimin, diskutimin dhe bisedën politike388 dhe hyjnë në stilin e veprimtarisë shoqërore e politike. Për të njohur disa nga veçoritë sintaksore të gjuhës së Nolit, në këtë sferë të komunikimit të tij me një publik më të ngushtë se ai të cilit i është drejtuar në mënyrë të vazhdueshme me shkrimet e veta, si me poezitë, me prozat apo me shkrimet e tjera publicistike, jemi përqendruar në disa momente të rëndësishme të veprimtarisë së tij parlamentare.

Çështje të ndryshme që kanë të bëjnë si me ngjarjet e jetës së përditshme, ashtu edhe me rregulloren e Parlamentit, votëbesimin e qeverive, qëndrimin e ashpër, por të drejtë që ai ka mbajtur kundrejt veprimeve të qeverisë, ai vendosi t`i paraqesë, edhe pse me gojë, përpara një auditori vendimmarrësish e në të mirë të popullit. Përvoja e gjatë jetësore e fituar gjatë qëndrimit jashtë vendit, sidomos në Amerikë, argumenton arsyen e dhënies së herëpashershme të shembujve të funksionimit të shumë instancave apo të zgjidhjes së shumë të panjohurave.

Seanca e parë e Këshillit Kombëtar u hap më 27. III. 1920: "*Sot ditën e shtunë më 27. III. 1920, më ora 9 ¼ paradreke, në mes të nji seremonië ku muerrën pjesë gjith autoritetet civil, ushtarak e populli mbarë u-bâ çilja e parë e Këshillës Kombtare në sallë të Këshillës. Kuvendi u hap me fjalën e Fronit qi u tha nga ana e Këshillës së Naltë dhe është këjo: …"389*

Piro Tako në monografinë për Nolin shprehet: "*Lufta e Nolit në Parlamentin shqiptar të viteve 1921-1924 ishte një nga faqet më të lavdishme të jetës së tij, ku ai u tregua një burrë shteti i guximshëm. Fjalimet e tij të kësaj periudhe përbëjnë kulmin e pjekurisë oratorike që ai mundi të arrijë. "390*

Diskutimet në Këshillin Kombëtar janë mbajtur me gojë nga ai nëpër mbledhje dhe ndoshta pjesa më e madhe e tyre janë reagime të momentit, në varësi të diskutimeve të rastit, por, në Parlament, ai ka mbajtur edhe fjalime, siç ishte fjala e rastit që ai mbajti për ndarjen nga jeta të Presidentit amerikan të asaj kohe Ëillson. Në këtë fjalim, duke i bërë elozhe firgurës së këtij presidenti dhe nëpërmjet tij, shtetit amerikan, ai ndërthur

388 Xh. Lloshi, Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika, SHBLU, Tiranë 2001, f. 218
389 Bisedimet e Këshillit Kombtar "Senat" legjislatur e parë "Çilja e parë e Këshillit Kombtar" më 27. III. 1920"
390 Tako, P., Fan Noli në fushën politike dhe publicistike (vështruar nëpërmjet publicistikës, oratorisë dhe epistolareve) Monografi, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë 1975, f. 101

stilin e veprimtarisë shkencore e teknike me atë të veprimtarisë shoqërore e politike dhe atë letraro-artistik: "*Dhe u shtri e fjeti si luan profeti bujar i paqes njerezore, ati spiritual i Lidhjes së Kombeve, tirani dhe kalorësi idealist, me një serenitet dhe me një qetësi olimpiane, që është një sfidë supreme për talljet e skeptikeve qinike turishtrember e zemer-thatë. I mundur? Bah! I vdekur? Kush e tha! Fara e idealit që mbolli do të rrojë e gjallë sa kohë ka zemra njerezore në botë. Ah prehu në paqë, O shpirt i martirizuar. Lufta s`ka qenë e kottë. Se atje ku ka varrë si yti, atje ka jetë dhe ngjallje.* "[391]

Nëpërmjet përsëritjes së gjymtyrëve, edhe në këtë rast Noli kërkon të vërë në dukje cilësitë e tij prej drejtuesi dhe udhëheqësi, sa të shkolluar, aq edhe besimtar: "*Si profesor, si kryetar i universitetit Princeton, si governor i shtetit Neë Jersey, si President i Shteteve të Bashkuar që me 1913 gjer me 1921, në çdo gjesht e në çdo fjalë çfaqej njeriu mistik i illuminuar, i dërguar prej Perëndisë për një mission të shenjtë. Pranë një karakteri të çelniktë kishte mirsinë e Shën Françeskut.* "[392].

Paralelisht me vënien në dukje të cilësive të tij, Noli tregon gjithashtu njohjen personale që ai ka patur me Presidentin Ëilson dhe kontributin e tij për çështjen shqiptare: "*... Atëherë iu afrova dhe i bëra një apel në emër të kombit tonë fatzi, dhe përgjigjen e tij bujare e mbanj ment sikur po e dëgjioj sot: "Një zë do të kem në Kongresin e Paqes dhe ate ze do t`a përdor për të mirën e Shqipërisë. Dhe e mbajti fjalën. […] Projekti i copëtimit të Shqipërisë i redaktuar prej Aliateve, ishte njohur dhe pritej vetem një firmë që të behej një fakt definitiv. Firma që mungonte ishte ajo e presidentit Ëilson. […] Presidenti Ëilson, jo vetëm që nuk vuri firmën, po u përgjeq […] me dy nota që janë dy nga xhevahiret më të shndritshëm të karieres se tij se shkelqyer. Ato nota ndaluan copëtimin e Shqipëris dhe na dhanë rasje të marrim frymë e të gatitim lirinë e Shqipëris që gezojmë sot.* "[393]

Përdorimi i figurave letrare si krahasimi-*si luan* apo përdorimi paralel i sinonimeve *serenitet* dhe *qetësi* dhe antonimeve- tirani dhe kalorësi të shprehura me epitete aq të goditura-profeti *bujar*, qetësi *olimpiane*, sfidë *supreme*, skeptikëve *qinikë, turishtrembër e zemer-thatë*, apo metaforave-*fara e idealit që mbolli do të rrojë e gjallë*, nuk mund të jetë karakteristikë veçse e stilit letraro-artistik. *"U rezua per dhe dushku i math mi deget e të cilit kishin ndertuar folen e tyre enderonjesit idealiste dhe nga ky rezim oshetiu me renkim pylli i erret i dheut, dhe u shduk vizioni i një bote me të mirë dhe me njerëzore.* "[394]

Duke qenë në një mendje me përkufizimin që gojëtaria është aftësia e përdorimit të mënçur të të folurit ose të shkruarit që ka për qëllim të bindë dëgjuesit[395] të cilit mund t`i shtohet thënia e Platonit që *"Gojëtaria është mënyra e qeverisjes së mendjeve të njerzve"*, mendojmë që të dyja janë mishëruar te gjuha e Nolit.

Gjuha e tij e kujdesur karakterizohet herë pas here nga përftesa sintaksore e stilistike, të tilla si përsëritja e realizuar nëpërmjet strukturave sintaksore paralele të fjalive të përbëra nga gjymtyrë të njëjta fjalie dhe me rend: *Kundrinor i zhdrejtë i*

391 Bisedimet e Kuvendit Kushtetues Mbledhja e VIII, e hane me 11. II. 1924, ora 2. mb. dreke, F. Noli, f. 72
392 Po aty, f. 71
393 Po aty, f. 72
394 Po aty, f. 73
395 Wikipedia, enciklopedi e lirë

shprehur me trajtë të shkurtër të përemrit vetor në rasën dhanore+kallëzues në formën joveprore+kryefjalë, rend i anasjellë ky i cili është përmbysur për qëllime shprehësie. Këto periudha prihen dhe përshkohen nga *ironia*: "*Z. Kryetar! S`mund të mëshehi se u mallëngjeva nga deklarata e Z. Kryeministrit. Na u shigurue lirija e shtypit, dhe ç`gjë tjatër mund t`ëndëroj një Shqipëtar që rron në një shtet oksidental veç liris së Shtypit! Na u zotue për shëndetin, ç`gjë tjatër mund të dishrojmë veçse shohim shëndet në këtë popull, shëndet` i të cilit është shemë prej gjithfarë smundjesh! Na u zotue për pasuni. Ç`gjë dëshëron një popull më tepër se pasuni, pse sikur e dini nuk mund të ketë kulturë pa pasuni. Na u zotue për qetësi. Kush është ay që s`e don qetësin e sidomos në një vend qi historija e tij është një serie kryengritjesh. Na u zotue për një gjytetnim me anë t`arësimit. Cili prej nesh nuk e di se shteti shqipëtar nuk mund të rrojë si Shtet i lirë pa patur populli shqipëtar një gjytetnim! Me pak fjalë Z. Kryeministër na u zotue për një parajs. Në këtë parajs cili prej nesh nuk dëshëron të hyj? "*[396]

Apologjia për F. Konicën mban nota të qarta subjektive, megjithëse, siç dihet mes tyre ka pasur edhe konflikte. Vetë Konica në veprën e tij e ka përshkruar Nolin kështu: "*Kuptohet se një njeri i mendjes ka nevojë për siguri dhe për dinjitet: po t`i jepeshin këto, do t` ish një fitim për Shqipërinë. ... Atë Noli do të mbetet në histori të Shqipërisë si burri që arriu i pari, me hir të vullnetit dhe të hollësisë së tij, të këllasi zyrtarisht gjuhën shqip në meshë. ... Leshzi, me sy të mprehtë, një fizionomi të qeshur, gati të presë një shaka dhe ta kthejë me uzurë, mendjehapur, njohës i gjuhëve romane dhe skandinave, atë Noli nga kultura, nga mendësia dhe nga karakteri i tij më kujton shpesh kishtarët e Përlindjes italiane. " 1938*[397]

Në "Bisedimet" Noli e ngre lart figurën e Konicës, duke e barazuar me Ismail Qemalin: "*Faiku është kryelëronjësi i gjuhës s`onë është zbulonjësi i Flamurit t`onë të haruar-i ati Flamuri që e ngriti Ismail Qemali në Vlorë, është kryekalorësi i liris edhe indipendencës kombtare, dhe ne të gjith së jemi veç dishepujt e tij. Ku gjetkë veç në shpirtin e tij ku mbretnonte si një farë perëndie ideali stoik i detyrës, ku gjetkë veç në temparamentin e tij prej idealisti t`ashpër e të fortë që refuzon të bënjë kompromize në njerzit e Ditës dhe me faktet e pamëshirta?*

"Sot është her` e parë që përmëndet emr`i tij në Parlament të Shqipërisë së lirë, dhe ironia është se përmëndet për gjykim e për dënim Faiku, dekani i veteranve të çeshtjes kombëtare. "[398]

Duke vënë theksin, jo vetëm tek personi i tij, por edhe te ajo që ai përfaqëson: të drejtën për t`u shprehur lirisht dhe kontributin për gjuhën shqipe dhe shtetin shqiptar. Të gjitha këto i realizon nëpërmjet një gjuhe të zgjedhur, me figura letrare mjaft të bukura, të cilat i ndërton me gjymtyrë fjalie, duke filluar prej gjymtyrëve emërore të kallëzuesve emërorë të përsëritura për të lartësuar figurën e Konicës, për të vazhduar më tej me vendosjen përballë të periudhave me fjali të nënrenditura përcaktore që pohojnë disa vlera, cilësi me fjali mohore të ndërtuara në formën e kështillave për të

396 Bisedimet e Këshillit Kombtar, Mbledhja e 90të, e shtundë, më 2 dhetuer 1922, ora 4: 30, pas m. dite, f. 874
397 F. Konica, *Vepra*, Sh. Botuese "N. Frashëri, "Fan Noli", pjesë e rubrikës "Portrete dhe proza të shkurtra", Tiranë 1993, f. 85,
398 Bisedimet e Këshillit Kombtar, Mbledhja e 77të, E enjte më 9 nëntuer 1922, ora 2. 30 pas m. dite, f. 734

respektuar e për të mos hedhur poshtë ato vlera: "*Rrimë në sofrën, të cilën Faiku është përpjekur tërë jetën e tij të na e shtronjë. S`na ka hie t`i hedhim gurë. Korrim drithën qi ka mbjellur Faiku. S`na ka hie t`a goditim me draprin qi na dha në dorë. Mburremi qi jemi nji komb mirënjohës. Ja një rast i mirë qi t`a provojmë. Mburremi qi jemi trima dhe patriot. Si trima dhe patriot, nderoni krye trimin dhe patriotin Faik, jeta e të cilit është nji Lushnjë që në krye gjer në fund, një fortesë e patronditur, një flamur heroik i shoshitur me plumba po i paunjur, një burim inspirate, nji shëmbëll perseverance për brezat e pastajme. "*[399]

Nuanca të gjuhës së folur ndeshen shpesh në gjuhën e Nolit: "*... Duket se kulltuku ia u ka ndruar mendimin. "*[400] [në gjuhën e shkruar kjo do të shprehej me trajtën e bashkuar *ua* që përfshin trajtat shkurtra të kundrinorëve të renditur ajo e të zhdrejtit para të drejtit: *Duket se kolltuku ua ka ndërruar mendimin.]*

Gjuhën e Nolit e kanë vlerësuar disa personalite të letrave D. Agolli, Dh. S. Shuteriqi, Sh. Musaraj, apo edhe gjuhëtarë të shquar si M. Domi dhe E. Çabej. Në revistën "Nëntori" 1965/4 Çabej shprehet: "*Në këtë [gjuhën e tij] nuk ndihet ëmbëlsia e flladit të verës sesa furia e murrërit të dimrit. Ajo nuk ka aromën e luleve, po ka erën e shëndoshë të dheut, ka edhe diçka prej pikash të rënda e të idhëta, në të shprehet ana e rëndë e jetës shqiptare. Në këtë poezi shihet se mund të jetë gjuha shqipe e ashpër e vrazhdë dhe e fortë në ashpërsinë e saj. "*[401]

Një nga rastet e përshkruara për forcën dhe ashpërsinë e gjuhës mund të shihet në shembullin më poshtë: "*A do të mblidhemi për padrejtësi a por për të mirën e atdheut? se jemi zgjedhun nga ana e popullit e duhet t`i dëftojmë shëmbëlla. A do të punojë gjithnjë pa drejtësija? në qoftë se punojmë me këtë mënyrë mund të them se Shqipnija nuk do të vejë përpara. Parlamenti duhet të vështrojë drejtësin e kurë flas kështu nuk them vetëm për të mirën e popullit, për edhe për të mirën e atyne qi u zgjodhën. "*[402]

Studiues të gjuhës e të stlit të Nolit shkruajnë: "*Gjuha për Nolin nuk qe një mjet i gatshëm, i ngurtë dhe i paluajtshëm midis njerëzve, po kod që ofron mundësi të mëdha shprehëse dhe krijuese, varësisht nga ndjenja dhe formimi gjuhësor e kulturor i folësve të saj. "*[403]

Fjalimet politike të Nolit në Parlamentin e viteve 1921-1924 i ka vlerësuar Piro Tako në librin e tij: "*Oratoria e kaluar shqitare arrin kulmin me fjalimet politike të Nolit. Fjalimet e tij sa politike, aq janë edhe poetike. Ato përbëjnë një thesar të paçmuar në kulturën dhe artin tonë. "*[404]

Duke mbështetur pohimin e Xh. Lloshit *"... sintaksa është përçuese e stilit, është mbështetja e ndërtimeve me domethënie e ngjyrime plotësuese. "*[405] mendojmë se njohuritë e tij rreth mënyrave të ndërtimit të fjalive apo të periudhave me fjali të bashkërenditura a të nënrenditura, gjedheve, strukturave të tyre, i përdori me mjeshtëri

399 Po aty, f. 734-735
400 Bisedimet e Këshillit kombtar, mbledhja e XXXV, e premte me 1 shtatuer 1922, ora 10. 00 p. d, f. 7
401 E. Çabej, Fan Noli ynë, Revista "Nëntori", 1965/4, f. 22
402 Bisedimet e Kuvendit Kushtetues, Mbldhja e VItë dita e shtundë më 7 Maj viti 1921 ora 3. 30 pas dreke, f. 19
403 B. Krasniqi, Botëkuptimi dhe stili i Nolit, Studime Filologjike, 1988/2, f. 71-79
404 P. Tako, "Fan Noli në fushën politike dhe publicistike", Monografi, Tiranë 1975, f. 286
405 Xh. Lloshi, Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika, SHBLU, Tiranë 2001, (botimi i dytë), f. 83

edhe në diskutimet e fjalimet në Parlament, edhe pse ato ishin komunikime gojore dhe si të tilla duhet të realizoheshin me fjali të shkurtra të prera e më të shkujdesura. Ndërkohë, siç është konstatuar edhe në prozë e në publicistikë, por më tepër në këto fjalime, Noli e zotëron sallën me tonin e prerë, me ndërtime të menduara mirë, duke shfaqur nëpërmjet forcës së fjalës, besimin e vet të plotë tek ajo që shpreh dhe duke i argumentuar idetë dhe mendimet e tij me fjali, edhe pse të gjata e të ndërlikuara, të qarta e të strukturuara sipas rregullave të gjuhës së shkruar: "*Nuk i apim shum kohë, se Qeverija lipset, sa u mblodh Parlamenti, dhe u zgjedh kryesija e rregullt, t`ish gadi; se e para detyrë e saj ishte me ardhë këtu, dhe me dhanë spjegime mbi veprimin e sajë; por tue qênë se shkoj nji kohë edhe nuk erdh me dhanë shpjegime, vetë na u shterguem të proponojmë thirrjen e sajë në Parlament. Pra në kujtoni se nuk âsht gadi, mund t`i apim sa kohë të doeni. "*[406]

Një nga mjetet e formësimit të periudhës janë mjetet lidhëse. E veçanta e mjeteve lidhëse që Noli ka përdorur ka qenë shkrimi ndaras i lidhëzave apo lokucioneve lidhëzore, që në gjuhën e sotme janë përngjitur gjatë përdorimit. Po sjellim disa nga lokucionet lidhëzore që shërbejnë për të bashkuar fjalitë në periudhat me fjali të nënrenditura, që i konstatuam të përdorura më shpesh: *sa do qi, ku do qi, me qénë se, si kur, apo ndajfoljet e mënyrës drejt për drejt* etj.

Në grupin e këtyre lidhëzave është *meqenëse*, të cilën e gjejmë në disa shembuj, prej të cilëve po sjellim këtë: "*Me qénë se zgjedhja e Drinit âsht e dyshimtë si munt votojnë ata tue qènë edhe si të gjykuem edhe gjykatës. "*[407]

Periudhat me fjali të nënrenditura kushtore kanë strukturë thuajse të ngjashme me ndërtimet kushtore të përdorura në gjuhën e sotme, me ndonjë nuancim dialektor, si në përdorimin e mjeteve lidhëse me të cilat bashkohen fjalitë në periudhë, ashtu edhe në bashkëlidhjen e trajtave kohore e mënyrore të foljeve të këtyre fjalive, që përcakton modalitetin e gjithë periudhës: "*Po t`ishte se mendimi i shumicës nuk është gabim, nuk do të bëheshin kanune për mprojtjen e minoritetit, e nji pretencion se nji vendim i pranuem me shumicë është kurdoherë i pagabueshëm, është nji gjë fare absurd: se tjetër është me ju bind shumicës e tjetër është të thuash se vendimi është i drejtë. "*[408]

Gjenden jo rrallë te Noli edhe mjete të tjera të shprehjes së raporteve kushtore, jo vetëm mjetet lidhëse kushtore*: po, po të jetë se, në qoftë se, n`asht qi, n`asht se, në, ndë ësht se, sikur,* por edhe me lidhëza kohore *si* apo *kuer:*

"… se, po të heshtim nga ansija e nga hatëri atëherë s`kemi për të hyrë kurr në udhë të mirë, e s`kemi për të ndrequr kurr gabimet që ditë për ditë po përsriten. "[409]*;*

"Po të jetë se pranojmë edhe ket dorëheqje, atëherë do të ndodhemi përpara dy krizve, të cilët do të na sjellin mjaft dame. Prandaj jam i menjdes qi të mos pranohet dorëheqja, ngjerë sa të mbarohet çashtja e kufijve, e cila do të bisedohet në Lidhjen e Kombeve në Qershuer. "[410]

406 Bsedimet e këshillit Kombtar, Mbledhja e XIII, e shtunde me 21 Maj 1921; ora 3. 30 mbas dreke, f. 52
407 Bisedimet e Këshillit Kombtar, Mbledhja e VI-të, dita e shtundë, më 7 Maj viti 1921 ora 3. 30 pas dreke, f. 18
408 Bisedimet e Këshillit Kombtar, Mbledhja e XXXVII, E merkure me 6. IX. 1922, ora 3 pas dreke, f. 30
409 Bisedimet e Këshillit Kombtar, Mbledhja e XXXXII, e ejte me 14 shtatuer 1922, ora 2. 30 mbas dreke, f. 112
410 Bisedimet e Këshillit Kombtar, Mbledhja e XV, e Merkuerre me 25 Maj 1921, ora 4 mbas dreke f. 59

"N`âsht qi Z. Doktori, âsht i mendjes, qi t`i shtohet nji paragraph mbi politiken e mbrenshme, mund t`a shtojmë, por neve këjo na u duk e mjaftë[411]*;*

"Ndë ësht se diktimi ka vepruar pas merhametit, ka bërë një faj të madh, e për këtë gjë duhet qi Guverna t`i dërgojë në gjyq pjesëtarët e atij. "[412]

"Kjo nuk âsht nji çastje aqë e vogël, sa të mos dojë Parlamenti t`i japë randsi, dhe t`mos perzihet. Njai qi u rrah âsht zyrtar; rrahësi âsht ushtar i dishiplinës; vendi i ngjarjes âsht kryeqyteti. Kuer në krygjytet ngjarin të tilla, si mund të ketë siguri mâ jashte? "[413]

Raportet kushtore te fjalimet parlamentare të Nolit shprehen edhe me formën e pashtjelluar foljore-*përcjelloren*: "*(E dyta: Faiku është kryetar i Vatrës, i zgjedhur lirisht prej anëtarëve të saj, nuk është sultan i Vatrës.) Duke dënuar pra Faikun, keni për të dënue edhe Vatrën edhe anëtarët e saj që e kan zgjedhur për kryetar. "*[414]; apo me formë të pashtjelluar mohore:

"Kjo çështje i përket nderit e dignitetit të Parlamentit, kjo asht nji çështje themelore e vitale për një shtet të lirë e konstitucional, e pa u bisedue e shkoqitë mirë këjo punë, nuk munt të kërkohet votë besimi për një guvernë që i vë kazmën lirive të popullit e të përfaqësuesve të tij. "[415]

Ndërtimi i periudhave me fjali të nënrenditura ftilluese kundrinore të zhdrejta me lidhëzën *se*, në vend të *nëse* haste jo rrallë në materialet e konsultuara: "*Neve kemi ardhë për amnesty, dhe duhet të dijmë se qeverija a do t`a mbajë fjalën apo jo. "*[416] Në këtë ndërtim bie në sy gjithashtu edhe rendi jo i zakonshëm i gjymtyrëve të fjalisë së nënrenditur ftilluese pyetëse të zhdrejtë, në të cilën kryefjala i paravendoset gjithë fjalisë pyetëse, e cila në fakt duhet të kishte këtë strukturë: *[…dhe duhet të dijmë nëse qeverija do ta mbajë fjalën.]* Të njëtat komente vlejnë edhe për këtë ndërtim: "*Emzot Fan Noli: Ktu po bëhet nji komisjon i çuditshëm. Parlamenti po bëhet një gjykatore, gjë që është e pamundur, pse Paralmenti do të shohë vetëm se a ka akte të mjafta për të dërguar në gjyq dhe jo të gjykojë. Arsyeja për të cilën duhet që pjesëtart e komisjonit hetuës të jenë këtu, është që të na japin shpjegime për të cilat mund të kemi nevojë. "*[417]

Kur përcaktori me drejtim varet nga një gjymtyrë e shprehur me emër në trajtën e pashquar me parafjalë dhe shprehet me emrin dhe mbiemrin në rasën gjinore të personit që flet, vihet re përdorimi i këtij të fundit në trajtën e shquar: "*Me leje të z. Ali Këlcyrës due të them dy fjalë. "*[418] *"Qeverija nuk ka kundërshtime e Z. Kasoja i paska! "*[419]

Përcaktorët me përshtatje që varen nga emra të gjinisë femërore dhe shprehen me mbiemra të nyjshëm në gjininë mashkullore te Noli i gjejmë në shembuj të tillë: "*Z.*

411 Bisedimet e Këshillit Kombtar, Mbledhja X, e shtunde, 14 Maj 1921 ora 3. 30 mbas dite f. 40
412 Bisedimet e Këshillit Kombtar, Mbledhja e 81të e shtunë më, 18 nëntuer 1922, ora 2. 30 pas m. dite, f. 47
413 Bisedimet e Këshillit Kombtar, Mbledhja e XIII, e shtunde me 21 Maj 1921; ora 3. 30 mbas dreke, f. 50
414 Bisedimet e Këshillit Kombtar, Mbledhja e 77të, E enjte më 9 nëntuer 1922, ora 2. 30 pas m. dite, f. 733
415 Bisedimet e Këshillit Kombtar, Mbledhja e XXXXII, e ejte me 14 shtatuer 1922, ora 2. 30 mbas dreke, f. 158-159
416 Bisedimet e Kuvendit Kushtetues, Mbldhja e 48, E ejte, me 17. IV. 1924, ora 9. m. d., f. 779
417 Bisedimet e Këshillit Kombtar, Mbledhja e 82të, e hanë më, 20 nënduer 1922, ora 2. 30 pas m. dite, f. 809
418 Bisedimet e Kuvendit Kushtetues, Mbledhja e XXXXVI, e merkure me 16. IV. 1924, ora 2. 30 mb. dreke, F. Noli, f. 746
419 Po ai, po aty, f. 752

Nassi ka nisur mësimin e tij muzikor duke punuar ditën e pa ndonji ndihmë të jashtëm. ,,[420]

Në disa raste ndikimi i gjuhës së folur në fjalimet e tij është i dukshëm edhe në përdorimin e emrave prejfoljorë të formuar në rrugë analogjike, p. sh. siç ndodh në shembullin më poshtë ku emri *folja* është përdorur në vend të emrit asnjanës *të folurit* apo të emrit *diskutimi*: "*Më duket se folja mbi çështje dy herë është shumë e se gjetkë flasin vetëm një herë. Folja për herën e dytë mund të ngjajë vetëm kur është ndo një moskuptim*"[421]

Noli i përdor të dyja format e paskajores duke kaluar natyrshëm nga njëra tek tjetra, si atë që ndërtohet nga mënyra lidhore duke i paravendosur asaj pjesëzën me origjinë parafjalore për: "*Z. Kryetar! Nga fjalët e të ndershmit depytet t`Elbasanit, z. Mehdi Frashërit, merret vesh sikur Parlamenti u bë gjykatore për të dënuar Faik Konicën.* ,,[422]*;* ashtu si edhe formën tjetër të ndërtuar nëpërmjet paravendosjes së pjesëzës me origjinë parafjalore për para paskajores gege të përdorur në këtë rast në funksion të lidhores, që herë të tjera është përdorur më vete si formë e pashtjelluar: "*Shqiptarët t`onë qi kan shkue atje për me fitue d. m. th. se janë të varfër e si mund të mbajnë djelm të vet ndër shkolla e edhe me u pague taksa aq të randa!* ,,[423]

Nga veçoritë sintaksore të gjuhës së Nolit të vështruara në fjalimet e mbajtura në seancat parlamentare në të cilat mori pjesë në cilësinë e deputetit, ne përmendëm vetëm disa, aq sa mund të na lejojë një aktivitet përkujtimor për një figurë kaq të njohur e të shquar në shumë fusha e për të cilin vërtet mund të bëhet më shumë.

420 Bisedimet e Këshillit Kombtar, Mbledhja e 77të, E enjte më 9 nëntuer 1922, ora 2. 30 pas m. dite, f. 729
421 Bisedimet e Këshillit Kombtar, Mbledhja e III, e hane 5 marc 1923, ora 3 pas dreke, f. 28-29
422 Bisedimet e Këshillit Kombtar, Mbledhja e 77të, E enjte më 9 nëntuer 1922, ora 2. 30 pas m. dite, f. 733
423 Bisedimet e Këshillit Kombtar, Mbledhja e 67 e bisedimeve, f. 729

MIMOZA ZEKAJ

RRETH PASURISË SË LEKSIKUT POLITIK E SHOQËROR NË PUBLICISTIKËN E FAN NOLIT

Si emërtim **leksiku politik e shoqëror** a **leksiku politiko – shoqëror** përdoret në një kuptim të veçantë a më të ngushtë, si tërësi e termave dhe e fjalëve që lidhen me politikën dhe me politologjinë dhe në një kuptim tjetër të përgjithshëm a më të gjerë, si tërësi e të gjithave njësive leksiko – semantike ose e të gjitha fjalëve dhe e emërtimeve togfjalëshore e jotogfjalëshore, që shënojnë nocione ose dukuri shoqërore të shkencave humanitare, të veprimtarisë së organizatave shoqërore dhe të sjelljes shoqërore të njerëzve[424]. Një nga fushat që ka lidhje të drejtpërdrejtë me veprimtarinë shoqërore e politike ku përdoret ky leksik, është publicistika.

Në pasurinë e tij të madhe krijuese, Noli "skaliti" edhe stilin e tij në **publicistikë,** duke u treguar mjeshtër në përzgjedhjen e leksikut jo vetëm nga ana formale (pra, nga struktura fonetike, morfologjike e gramatikore), por duke mëshuar më shumë te përmbajtja, te kuptimi apo edhe konteksti, duke përfshirë në të nënsisteme të caktuara. Një anë qenësore të leksikut, të trajtuar mjeshtërisht e të lartësuar nga vëllimi në vëllim, e përbën ligjërimi politiko-shoqëror. Në vijim kumtesa jonë do të trajtojë mënyrën e paraqitjes të këtij leksiku në penën e Nolit, duke e parë të lidhur ngushtë me faktorë historikë dhe shoqërorë. Nga ana leksikore ky stil qëndron ndërmjet atij të letërsisë artistike dhe atij shkencor e teknik, me një leksik të zgjedhur, me terminologji të gjerë, me fjalë me kuptim kryesisht të drejtpërdrejtë[425].

Si **proza shkencore,** letërsia polotiko-shoqërore ka një leksik të zgjedhur, me **terminologji** të gjerë, me emra e fjalë të tjera abstrakte, me fjalë me kuptim të drejtpërdrejtë. Megjithëse pjesa më e madhe e fjalëve dhe termave të leksikut politiko-shoqëror ishin përdorur edhe nga pararendësit (kujtojmë elemente të këtij leksiku që në shkrimet e P. Budit dhe P. Bogdanit[426], si edhe shtresën e qëndrueshme të tij në Rilindje e në vazhdim), në krijimtarinë e Nolit, veçanërisht me publicistikën e tij, u forcuan dhe u zgjeruan më tej themelet e kësaj shtrese. U përvijua **një shtresë e qëndrueshme leksikore**, me larmi grupe paradigmatike fjalësh sipas ndërtimit dhe kuptimit. Mjaft prej fjalëve të përdorura në këtë nënsistem kanë një ose më shumë kuptime, pra kuptimet themelore dhe kuptimet e prejardhura, ku disa prej këtyre kuptimeve janë terminologjike. Duke vështruar strukturën semantike të fjalës nga pikëpamja e rrafshit të fjalës-term, mund ta përfytyrojmë atë si një strukturë të gjerë semantike speciale, brenda së cilës zbulohen edhe kuptime speciale të dyzuara ku

[424] M. Samara, *Rreth leksikut politik e shoqëror në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2008, f. 15.
[425] J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe,* Tranë, 2005, f. 256.
[426] M. Samara, *po aty*, f. 32.

bashkëjetojnë kuptimi i zakonshëm i fjalës me kuptimin terminologjik[427]. Prania e kësaj kategorie njësish e dallon këtë nënsistem nga nënsistemet e tjera të leksikut të gjuhës të përdorur në gjithë krijimtarinë e Nolit.

Në publicistikën e Nolit fjalët e këtij leksiku, duke u nisur nga vlera e tyre leksiko-gramatikore, nuk kanë denduri të njëjtë përdorimi. Më shumë dalin të përdorur **emrat** me kuptim emërtues dhe me karakter politik e shoqëror. Kjo mendojmë se lidhet nga një anë me natyrën emërtuese të emrit, si pjesë ligjërate, nga ana tjetër me rolin e tij si pasqyrues i koncepteve. Për të shprehur idenë e veprimeve abstrakte, Fan Noli, ndryshe nga autorët jugorë të fazës së parë të Rilindjes që përdornin me tepëri emrat foljorë të gjinisë asnjanëse, shtiu në përdorim të gjerë **emrat foljorë prapashtesorë**[428]. Për të ndikuar sa më shumë dhe për të pasur forcë shprehëse publicistika e tij, përdori emra të veprimit apo të vepruesit prej foljesh, duke aktivizuar disa formante fjalëformuese a trajtëformuese. Ky numër është relativisht i madh, por ne kemi përzgjedhur formantet më tipike:

a. me anë *të prapashtesave* ***–i, -si, -ri*** janë formuar kryesisht emra të gjinisë femërore që tregojnë cilësi apo veçori abstrakte: *madhëri, shqiptarësi, tradhësi, ministori, trimëri, shumësi* etj.

b. *me prapashtesat* ***–im*** ose ***–je,*** duke formuar emra abstraktë që tregojnë veprime apo gjendje, të fomuar nga tema foljore: *fitim, kërkim, ndalim, çvillim, përdorje, çarmatosje, njohje* etj.

c. me anë *të parashtesave* ***mos-, pa-***, të cilat duke u vendosur para emrave foljorë të veprimit, u japin atyre një kuptim të kundërt: *mospërgatitja, mosmobilizata, mosmarrja, mospatura, papendim, parëvajtje, padija* etj; me anë të parashtesës ***për-***, si: *përlindje, përfund, përprishje* etj.

Në shkrimet publicistike të **vëllimit të parë**, që përfshin vitet *1905-1924*, duke pasqyruar ngjarjet e mëdha që ndodhën gjatë asaj periudhe, si dhe duke u mbështetur në traditën e pasur që gjeti në këtë lëmë, bazën kryesore të këtij nënsistemi, e zënë emrat që janë përdorur nga pararendësit, si: *kuvend, kushtrim, e drejta, kryengritës, shqiptarësi, letërshpallje, atdhetarizëm, përlindje, kongres, argument, politikë, guvernë, kombëtarizëm, ministër, protektorat, shtet, protestan, propagandë, autonom, mëvetësi, miting* etj. Një vend të konsiderueshëm kanë zënë edhe disa sintagma emërore, të cilat e përforcojnë më mirë karakterin politik dhe shoqëror, si: *ndjenjë kombëtare, bukë qeverie, privilegje tregëtare, gogozhelë kombëtarë, shtet autonom, indipendencë ekonomike, peticie të përbashkëme, argumente të paluftuarshme, bisedime akademike* etj. Në shkrimet publicistike të **vëllimit të dytë**, që përfshin vitet *1925-1949*, pas largimit nga Shqipëria dhe falë formimit të gjerë që zotëronte, gjithë veprimtaria publicistike e autorit fiton një frymë polemike të theksuar. Kjo dëshmohet edhe nga leksiku i përzgjedhur, si: *demokrat, mbret, borgjez, redaktor, bejlerë, agallarë, komb, kapital, konferencë, ministër, politikë, kapital, fashizëm, parlament, katastrofë, demostratë, monarki, provokatorë, reaksionarë, antinacionalë, imperializëm, nacionalistë* etj. Këtë karakter e pasqyrojnë edhe sintagmat emërore, si:

[427] A. Duro, *Fjala-term dhe struktura semantike e fjalës*, në SF, nr. 3-4, 1991, f. 139-157.
[428] F. Agalliu, *vepër e cituar,* f. 52.

guverna Kombëtare, gjendje dipllomatike, indipendencë kombëtare, Lidhja e Kombeve, qeveri laboriste, lëvizje kombëtare, diktaturë ushtariake, grupi anglo-evropian, përbindësh apokaliptik etj.

Si **letërsia artistike**, ka edhe fjalë me kuptime të figurshme, disa fjalë të vjetruara a dialektore, frazeologji popullore. Në këtë këndvështrim, leksiku politiko-shoqëror i përdorur në publicistikën e Nolit është i gjerë, aktiv, me denduri e shpeshtësi përdorimi, me vlerë bashkëkohore, një nënsistem i veçantë i leksikut të gjuhës. Ai përdoret gjerësisht jo vetëm në publicistikë, por në gjithë krijimtarinë e Nolit.

Duke filluar me anën formale të këtij leksiku, vëmë re se në morinë e madhe të shënimeve politike, artikujve, pamfleteve, fejtoneve, ku mbizotëron shenjimi politiko-shoqëror, një vend të rëndësishëm zënë **kompozitat** e **fjalët e prejardhura**, të cilat, në pjesën më të madhe të tyre, janë formuar sipas gjedheve ekzistuese të shqipes. Gjejmë edhe mjaft kompozita të përdorura dendur nga pararendësit, si: *kryezot, kryeportë, kryeprinc, kryetrim, kryepajtonjës, kryekëshilltar, mëmëdhe, mëndjegjerë, zëmrëmadhi* etj

Duke u nisur nga klasifikimet e bëra nga studiuesit[429] e gjuhës shqipe dhe në punimin tonë për këtë lloj ligjërimi në publicistikë, dallojmë këta tipa kryesorë kompozitash:

a. kompozita ***këpujore me vlerë mbiemërore***, që janë formuar nga dy mbiemra: *anglo-evropian, anglo-amerikane, amerikano-sovjetike, shqiptaro-turk, italo-shqiptar, jugo-amerikane, turko-levantine, greko-levantine, anglo-italian, amerikano-sovjetik* etj.

b. kompozita të formuara nga ***bashkimi i dy emrave***, ku emri i dytë është një emër vepruesi: *kryengritës, gjakpirës, udhëheqës, larkpamës, keqbërës, zëmërçjerrës, shqiptarvrasës, fitimprurës* etj.

c. kompozita të formuara nga ***një temë emërore dhe një temë mbiemërore***: *kokëlidhur, zëmërprerë, fushëkuq, shkabëzi, lundërthyerish, gjakkalbur, shpirtshitur*.

d. kompozita të formuara nga ***një temë emërore dhe një emër veprimi***: *letrëkëmbim, zëdhënie, zëmërkafshim, keqbërje*.

e. kompozita të formuara nga bashkimi i ***dy emrave, ku tema e dytë përcakton*** të parën: *faqekufom, hekurvijë, shpirtrob, dekretligjë, sygjarpër, zemërvrer* etj.

f. kompozita të formuara nga ***një ndajfolje dhe një emër*** ose nga **një numëror** dhe një emër: *trimarrëveshje, katërqintvjet, mirëdashje, mirëdashës, tepërproduksion, bashkëvëlla, gjysmëmyflize, mirëbërës* etj.

Begatinë e leksikut polotiko-shoqëror në publicistikë e mundëson përdorimi mjeshtëror i disa **njësive frazeologjike emërore, mbiemërore, foljore** a **ndajfoljore**, me struktura të ndryshme, dhe një pjesë e konsiderueshme e tyre të marra nga frazeologjia popullore. *Ky komision **ka për barrë** të kontrollojë përdorjen e huas së re… Kjo anë kombëtare duhet të ketë një gazetë e cila të vërë **nën sy të** populit nevojat e kurdohershme të tij…Posa **të shkelë këmbë** mi tokën turke, ose do ta lër për pak, ose…Ne i lemë dhe shkojnë, porsa që na e **krehin bishtin** pak. Faiku **mban në***

[429] A. Kostallari, Mbi disa veçori të structures semantike të kompozitave pronësore të shqipes, në "*Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe"*, 1, 1972, f. 146.

gojë *fjalën inglishte fairness. Këta ia* ***bënë teslim*** *Shqipërinë Ahmet beg Zogollitnë dhjetor 1924.* Mendojmë që njësitë frazeologjike në publicistikë, janë përdorur për të shtuar forcën e saj ndikuese, sepse vetë këto njësi kanë vlerën nominative dhe ekspresive (shënuese e shprehëse)[430]

Vlerën ekspresive të këtij leksiku autori e plotëson edhe me disa **fjalë të urta** që ka përdorur, megjithëse jo të shumta në përdorim. Ja disa prej tyre: *Pra, kështilla që u pështpërirtin në vesh politikanëve është;* ***urtë e butë e plot tigani****. …Inglizët u zotuan të hyjnë si nërmjetarë për një zgjidhje të nderçime dhe të drejtë për të gjitha palët që* ***edhe mishi të piqet edhe helli të mos digjet***. Falë mjeshtërisë dhe thellësisë së mendimit, ka fjalë të urta që duket sikur janë nxjerrë nga përvoja jetësore e autorit: *Kapaku i kësaj tenxhereje është shqip;* ***ilaçi i krizës nuk gjendet në asnjë sperancë të botës… Po më mirë vonë se kurrë!*** *Malësorët tanë do të lihen të dërrmohen prej ushtërisë turke, "****se fati ynë është qyramidhe****"* etj.

Duke kundruar krijimtarinë e Nolit vëmë re një nga pamjet më kundërthënëse të krijimtarisë gjuhësore të tij. Në një anë kemi një veprimtar me një shpirt atdhetar që, duke ndjekur shembullin e paraardhësve, përpiqet ta lartësojë gjuhën shqipe, duke e ngritur deri në shkallën e gjuhëve të zhvilluara të Evropës, dhe në anën tjetër një mori fjalësh të huaja që vërshuan në shkrimet e tij, sidomos në publicistikë[431]. Është e rëndësishme të theksojmë se ndërkëmbimet mes shqiptarëve janë gjeografike dhe historike. Sundimi shekullor i osmanëve në Ballkan, pushtimi disashekullor turk, pranimi i besimit islam, prania e drejtpërdrejtë a e tërthortë e disa gjuhëve në territorin tonë, qëndrimi i autorit jashtë mjedisit shqiptar, kanë lënë ndikimet e veta në sistemin e gjuhës. Të gjithë këta faktorë ekonomikë, politikë, fetarë, historikë apo pozitë shoqërore, bënë të pranishme **huazimet.**

Një vend të dukshëm zënë huazimet nga **gjuhët romane** dhe më pak të përdorura disa fjalë **angleze**. Po paraqesim disa prej tyre pa i klasifikuar sipas origjinës apo vlerës së tyre lëksiko-gramatikore: *dekret, guvernë, guvernor, aneksonj, konkludonj, aliat, aparencë, indipendencë, referencë, superioritet, triumf, toleronj, insistonj, neutralizonj, ekuilibër, superproduksion* etj. Në vazhdën e misionit të Nolit për të qenë sa më afër bashkëkombasve edhe nga pikëpamja gjuhësore, janë përpjekjet e tij për t'u dhënë një **trajtë shqipe** fjalëve të huaja. Këtë gjë e realizon më së shumti duke u bashkangjitur këtyre fjalëve formante ndajshtesore (parashtesa a prapashtesa) të brumit të shqipes, të cilat për efekt të qëllimit të trajtesës sonë, nuk do t'i përmendim dhe do t'i bëjmë objekt të një punimi tjetër.

Në shkrimet publicistike, veçanërisht në artikujt gazetareskë të periudhës së dytë, ka një përdorim të madh të fjalëve të huaja, më shumë **orientalizma.** Mendojmë që ky përdorim është i lidhur me qëllimin e autorit, për të ndikuar edhe te ajo masë e gjerë, me një formim modest arsimor e kulturor. Karakteristikë e përgjithshme e orientalizmave të publicistikës është se janë fjalë të njohura dhe pjesa më e madhe e tyre i takon ligjërimit bisedor. Duke u nisur nga prania ose mosprania e tyre në fjalorët shpjegues të shqipes, dallojmë grupet e mëposhtme:

---

[430] J. Thomai, *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999, f. 7.

[431] F. Agalliu, *Gjuha e Nolit në veprat e tij origjinale*, Tiranë, 1999, f. 83.

a. shtresa e emrave dhe mbiemrave ***të vjetëruar***: *mesele, teslim, kabull, badjava, qepaze, hyqymet, dallakuk, mydyr, vatan, selam, tabor, vilajet, syrgjyn, fetfa, ylefe* etj.

b. shtresa e emrave dhe mbiemrave që përdoren në ***ligjërimin bisedor***: *kusur, behar, hallall, nishan, bela, dynja, kijameti, kalem, zanat, milet, kallaballëk, derman* etj.

Duhet të theksojmë se Noli ka treguar mjeshtëri jo vetëm në përzgjedhjen dhe shpërndarjen e tyre, por edhe në paraqitjen e tyre edhe në përdorime neutrale, edhe në përdorime të markuara, të ngarkuar **nga ana shprehimore**, sipas qëllimit të kumtimit. Ja si shkruan: *Agai i "Diellit" na qënka aq i lartë, aq i math sa i ardhka kijaleti që merret me harbutë si ne. Nuk e bëka kabull. . dhe e bën kabull të marrë kalemin e të na japë xhevap, aq sa i vjen dorësh agait të gërvishë me kalem, që s'është zanat i tij…*

Një pjesë e fjalëve të këtij leksiku kanë **zgjeruar kuptimet** e tyre, me fusha të tjera leksikore, me vlera të reja shprehëse, me ngjyrime emocionale pozitive a negative, për t'iu përgjigjur më mirë zhvillimit shoqëror. Noli, duke shkruar me një gjuhë të lëvruar relativisht pak, iu desh që të bëjë një punë të veçantë me kuptimet e fjalëve. I ndodhur para të papriturave që i dolën nga nevoja e shprehjes dhe duke u ballafaquar me gjuhë të zhvilluara, ai shpeshherë ua zgjeroi ose ua ngushtoi kuptimin fjalëve ekzistuese, u dha kuptime të tjera që nuk i kishin më parë, kur ia lypte nevoja[432]. Bie në sy edhe nxjerrja në dritë e disa kuptimeve të vjetra që përdoren vetëm në dialekte. Ja disa prej tyre: ***të errët*** *(errësirë);* ***hakë*** *(e drejtë): …e proklamojnë dhe nuk na e hanë hakën;* ***kafshë*** *(gjësend): Të këtija kafshë qenë pemët e Përlindjes shqipe;* ***llusë*** *(lustër): . . me gjithë se është e femërt, nuk i pëlqyekeshin llusat;* ***letra*** *(gërma): Kur do të mbarohet kjo luftë për fjalë dhe për letra?* ***Vjetëri*** *(e lashtë): …një shkrimtar shqiptar që ka shkruar greqisht në vjetëri;* ***plaçkë*** *(mall): …kontrabandën e plaçkës së monopolizuar*.

Në përdorime të caktuara të këtij leksiku pasqyrohet dhe një **qëndrim** i caktuar **politik,** i cili arrin deri në politizimin e pjesës ku është përdorur, duke i mbivendosur edhe mjete formale për këtë lloj ligjërimi. Politizimi lind atëherë kur te bartës të ndryshëm të gjuhës ekzistojnë mendime a pikëpamje krejt të ndryshme, madje të kundërta, për sendet a realiet të shënuara nga fjalë e terma ose kur bëhen vlerësime subjektive, krejt të ndryshme a të kundërta për to, nga ana ideoligjike, botëkuptimore, filozofike etj[433].

Noli, si një nga pjesëmarrësit më aktivë në ndeshjen politike që zhvillohej në Shqipëri, në kohën kur luftohej për vendosjen e demokracisë, shpalos frymën e tij kritike dhe politike, shpesh me tipare **oratorike**. Për ta shpalosur sa më natyrshëm këtë qëndrim dhe duke mos dashur që kjo pjesë e publicistikës të bjerë në nivelin e një shkrimi thjesht politik, Noli shfrytëzon me mjeshtëri mundësitë shprehëse të gjuhës në të tria rrafshet e saj. Një pjesë e shkrimeve publicistike janë ndërtuar në formën e ligjëratave publike, me tipare oratorike. Për të ndërtuar një rimë të vërtetë brenda tekstit, në fjali të ndryshme tregon kujdes në realizimin e kumbimit të fjalëve, veçanërisht të fundit, duke krijuar **muzikalitet të brendshëm**, si: *Uniteti që na mungon, uniteti që kërkonim, lint vetëvetiu pas çkuljes së feodalizmës, si shëndeti pas*

[432] F. Agalliu, *po aty,* f. 63.

[433] M. Samara, *vepër e cituar,* f. 29.

një kure shkencëtare. . . Feudalizma ka nevojë për padijen, për varfërinë, për skllavërinë, për fanatizmën, për pseudokulturat, për regjionalizëm, për mercenarizëm, për spiunllëkun e për tradhëtinë….

Midis elementeve të **rrafshit morfologjik**, formave apo kategorive të shumta gramatikore që përdoren në këtë nënsistem të gjuhës, autori shpesh këto mjete morfologjike i përdor në funksion të vënies në dukje të vlerës afektive, duke shprehur më mirë qëndrimin e tij politik. Një mënyrë e tillë është përdorimi i kohës së tashme dhe të kryerës së mënyrës habitore me ngarkesë emocionale. *Malum kjo kurë do të jetë fare e shkurtër, s prapë s'paska gjë sulltani, prapë nuk qënka isëmurë. Qënka fare mirë nga shëndeti. Kjo u provuaka…*

Duke qenë se **sintaksa** është niveli më i lartë i një gjuhe, ku shprehen strukturat e gjuhës dhe shkalla e intelektualizmit të saj, mund të themi se në sintaksën e publicistikës së Nolit gjuha shqipe shfaq një nivel të lartë intelektualizmi, shfaq shprehjen e një bote të brendshme të pasur, e mishëruar me struktura origjinale dhe tipike për të. Në larminë e këtyre strukturave ka zënë një vend të dukshëm ligjërimi politiko-shoqëror, sidomos natyra polemizuese e gërshetuar me qëndrim politik të hapur. Shpesh këtë gjë e ka realizuar me përdorimin e shpeshtë të **fjalive pyetëse retorike**, në disa raste të ndjekura nga një fjali thirrmore apo me përsëritjen e fjalëve pyetëse. *Si nuk e urren këtë këpushë me sojin e sorrollopin e këpushëve, me këpushët bejlerë e agallarë e laro, që fryhen dyke thither gjakun e të tjerëve? Si? Jo vetëm nuk i urren, po dhe i mpron, e i ndihmon që t'ia ppinë ca më mirë gjakun popullit shqiptar të mjerë.*

Nxjerrja në pah e disa prej tipareve të këtij leksiku, të përdorur mjeshtërisht nga Noli, na ndihmon për ta njohur dhe **analizuar** sa më mirë këtë nënsistem të gjuhës letrare shqipe, si dhe për të zbuluar më mirë **rrugën e zhvillimit** të këtij nënsistemi në veçanti dhe të gjuhës shqipe në tërësi.

NATASHA POROÇANI

NOLI NË DISA ASPEKTE TË PRAGMALINGUISTIKËS: PËRDORIMI I TEKSTEVE TË NOLIT NË MËSIMDHËNIEN E GJUHËS SHQIPE DHE LETËRSISË NË SHKOLLËN E MESME

Programet e reformuara të MASH-it duke synuar specifikisht, që t'u mundësojnë nxënësve të bëhen të aftë, të ndërtojnë saktë thënie, përftesa ligjërimore e tekste në përputhje me situata konkrete thëniesore, të lexojnë tekste të plota e po ashtu të hartojnë edhe ata vetë tekste të organizuara sipas strukturash të përshtatshme që kushtëzohen nga vetë *përftesat ligjërimore/ diskurset*, kërkojnë në mënyrë imperative qasjen e shqipes në nivelet më mjeshtërore të shprehjes së saj. Në këtë këndvështrim, në tekstet alternative të "**Gjuhës shqipe dhe letërsisë**" që tashmë kanë hyrë në përdorim në shkollën shqiptare, një vend shumë të dukshëm zë vepra e Fan Nolit, jo vetëm si poet dhe publicist, por në hapsirat e reja që ofron programi i miratuar nga MASH-i (2008-2012), kontributit i Fan Nolit interpretohet dhe trajtohet edhe në tekstet e tij publicistike, dramatike dhe të kritikës letare.

Duke i pranëvënë në vështrime krahasuese interpretimet e teksteve të shkruara nga Fan Noli, në të gjitha tekstet e "**Gjuhës shqipe dhe letërsisë**" së gjimnazit (shtëpitë botuese *Albas, Centrium, Pegi, Mediaprint*), synojmë të vlerësojmë analizën tekstuale dhe diskursive të Fan Nolit përgjatë akteve të përdorimit të gjuhës, domethënë **përgjatë çdo akti përdorimor të gjuhës shqipe**.

Le të parashtrojmë disa nga këto materie në kontekstin që ne po shqyrtojmë:

Me *diskurs* apo *përftesë ligjërimore* do të kuptojmë aktet e përdorimit të gjuhës, domethënë çdo akt përdorimor të gjuhës, çdo praktikim të aftësisë sonë ligjërimore që i referohet një produkti konkret gjatë të folurit, të shkruarit apo të lexuarit. Kjo mënyrë e të kuptuarit të gjuhës, të zotërimit të diskursit/përftesës ligjërimore përbën objektivin kryesor të mësimdhënies së gjuhës në gjimnaz. Në këtë mënyrë është vendosur në një bazë të re konceptimi i mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe letërsisë, është ndërtuar një pedagogji e re e gjuhës, "*e cila do të mund të shmangë edhe ushtrimet tradicionale të shpjegimit të tekstit, të narracionit, të kompozicionit mbi një temë të caktuar, për t'iu afruar kërkesave të komunikimit në situata reale*"[434]

Ka gjithmonë një çast nistor në përvijimin e dijeve shkencore që pret trajtime dhe parashtrime idesh, tezash, hipotezash dhe vlerësimesh, të cilat karakterizohen prej kërkesave gjithnjë e më të përqëndruara drejt tekstit dhe veçantive të tij. Për këtë arsye, referuar mënyrës së re të trajtimit të tekstit, mundësohet shqyrtimi jo më në një tekst, por tekste, më saktë, tipa të teksteve. Kjo tipologji, e karakterizuar nga prania në tekste e shenjave tipike gjuhësore, i bashkëshoqëron tekstet në kontekstet në të cilat këto tekste janë përftuar.

[434] Charles Bouron "La linguistique apliquee", PUF, Que sais-je, 1993

E bëmë hyrjen paraprake, për të përligjur analizën tekstuale të shkrimeve të Nolit, përmes operacioneve konjitive të veçanta.

E përfshirë në altertekst, vepra e Fan Nolit është analizuar në tektet shkollore të shtëpive botuese: **Albas** 11, 12; **Pegi** 10, 11; **Centrium** 10; **Mediaprint** 10, 11, tekste shkollore të cilat i përkasin botimeve të viteve 2009, 2010, 2011, 2012.

Duke iu referuar një marrëdhënieje bashkëvepruese midis objektivave të programeve shkollore (të nënvizuara më lart) dhe analizave tekstore konkrete, fillimish nënvizojmë se në analizat e teksteve të Fan Nolit, trajtimi i tyre është bërë në perspektivën e një interaksioni të vazhdueshëm midis karakteristikave të tekstit, të kontekstit dhe pa dyshim edhe atyre të lexuesit.

Po si realizohet të lexuarit dhe të kuptuarit e një teksti? Eseisti Jean Tortel shkruan: "*Unë nuk do të flas për të lexuarit me një L të madhe. Unë do ta shoh atë më shumë si një sistem, të përbërë nga raporte të dyanshme, të dy realiteteve të natyrave të ndryshme: nga njëra anë, realiteti i shtypur, dhe nga ana tjetër lexuesi. Reaiteti i shtypur, që është në vetvete sistem i shenjave dhe lexuesi sisitem vizual dhe audiv (pamor dhe dëgjimor), në të njejtën kohë edhe një aktivitet mendor. Jemi pra, para një tërësie të ndryshueshme, një tërësi që bëhet dhe çbëhet dhe që si e tillë mund të marrë forma dhe kuptime të shumta*. "[435] Në këtë kuptim procesi i të lexuarit dhe të kuptuarit të tekstit lidhet ngushtë me atë të përfitimit apo prodhimit të tekstit. Tekstet e Fan Nolit janë evidentuar vazhdimisht për stlistikë dhe elokuencë në përdorimin e shqipes. "*Mënyra e thurjes së tekstit, argumentimi, emocionaliteti e mbi të gjitha sistemi retorik i bindjes së autorit apo të lexuesit për idetë e shfaqura është i njejtësuar në nivel në të gjitha llojet e teksteve të tij, përfshirë edhe ato të folura*"[436]. Kjo është bartur si model shkrimi edhe në tekstet letrare e politike.

Me këtë vlerësim për veprën noliane, në tekstet shkollore krijimtaria e tij ka zënë vend gati me tërë komponentet e saj. E shtrirë në tekste argumentuese, informuese, poetike dhe dramatike, tekstet e Nolit, janë trajtuar në njohjen e tyre tërësore, e cila parakupton tregues që kanë të bëjnë me mikrostrukturën dhe makrostrukturën e tekstit vetë.

Të lexosh dhe të kuptosh një tekst do të thotë të nxjerrësh në pah një sasi trajtimesh konjitive, të cilat do të lejojnë:

- Të rivendosësh informacionet e nënkuptuara;
- Të administosh dhe të zotërosh tërësinë e tekstit, duke përdorur tipa të ndryshëm skemash

Sipas tipologjisë së përdorur në tekstet shkollore, vend të dukshëm zënë analizat e pjesëve me përmbajtje informuese dhe argumentuese. Duke përdorur **strategji të karakterit difuz** (të bazuara mbi një veprim difuz të mësimdhënies drejt kuptimit të nënshtresimit kuptimor) në të cilin sjellja e mësuesit nxitet nga shembulli dhe nga stimulimi i vemendjes së nxënësve sa herë që ajo rezulton pozitive; ndërtimi i aparatit pedagogjik orienton lexuesin (në rastin tonë nxënësin) drejt informacionit të nënshtresuar. Për të projektuar pyetje të cilat të çojnë te nënshtresimi kuptimor, është

[435] Decaunes, 1976, fq 14

[436] Sabri Hamiti, Letërsia moderne shqipe, UET-Press 2009, fq 208.

e domosdoshme së pari të identifikohen këto nënshtresime kuptimore dhe indikatorët e tyre tekstualë.

Teksti shpjegues-informues ka përfshirë në Albas 11 pjesë nga **Ditari i Nolit**, (fq 65) Albas 12 (fq 34) dhe dhe Centrium 10 (fq 163) pjesën "**Këshilla për shkrimtarët e rinj**", Mediaprint 11 (fq 169) "**Lutja ime".**

Në tekstin e Albas, fragmenti i Nolit merret si shembull i shkrimit të një teksti informues (ditar). Analiza e konceptimit të një ditari kalon në skeletimin strukturor të tekstit, për të evidemtuar më pas indikatorët tekstualë që do të konkretizojnë qëllimin për të cilin pjesa është përzgjedhur. Konkretisht:

-Përdorimii foljeve në vetën e parë/ mbizotërimi i kohës së tashme në përshkrimin e situatave dhe reflektimeve/ koha e kryer e thjeshtë për pjesët narrative/ gjuha joformale dhe treguesit e saj (p. sh evidentimi i fjalive njëkryegjymtyrëshe)/ ndërtimi sntaksor i thjeshtë përmes fjalive të shkurtra.

Po cilat janë **kriteret** që na bëjnë të mundur të mësojmë nëse një tekst është kuptuar apo jo nga marrësi?

Sipas Wittgenstein[437], kriteret për të përcaktuar informacionin që kërkojmë, qëndrojnë pikërisht në sjelljen e tij të mëvonshme verbale dhe jo verbale, sa e kuptueshme, e përputhshme është ajo. E aplikuar në një diskutim që komunikon informacion, ky kriter do të na thotë se personi është në gjendje ta përdorë informacionin e marrë edhe në kontekste të tjera.

E veçuam këtë referencë për të evidentuar disa nga çelësat tekstualë që përdoren në analizën e tekstit: "**Disa këshilla për shkrimtarët e rinj**" në variantet e shtëpive botuese **Albas** dhe **Centrium.**

Duke renditur njëra pas tjetrës pyetjetet: *Kujt i referohet /shembujt (brenda apo jashtë kontekstit)/ gjuha (e thjeshtë apo e ndërlikuar)/ natyra e të folurit (me humor apo serioze)/ komunikimi (miqësor apo zyrtar)/ shpjegimi (i qartë e me shembuj të kuptushëm apo akademik)*, arrihet të sigurohet një tërësi elementesh tekstualë, të cilët mundësojnë edhe riciklimin e tyre në diskurse të tjera, formulimin e perifrazave (të lira apo si përgjigje ndaj pyetjeve). Kjo strategji e përdorur shihet si një kriter i të kuptuarit parësor të tekstit të Nolit. Por një perifrazim i mirë, një perifrazim i mjaftueshëm, i detajuar dhe i vërtetë, duhet të përmbajë jo vetëm atë që një tekst i cili do të perifrazohet e thotë qartësisht dhe të nënshtresuar kuptimisht, por edhe atë që vetë teksti i ricikluar do të synojë të thotë në formën e nënshtresuar kuptimore. Me tekstin në fjalë kjo lehtësohet, sepse gjuha e autorit në këtë tekst, duke iu drejtuar një target-grupi të caktuar, të krijon mundësinë për të kooperuar me stilemat. Për shembull: në librin e Centrium, nënvizohen ato paragrafë që evidentojnë faktorët që Fan Noli i sjell si përcaktues në krijimtarinë e një artisti, por duke i kërkuar nxënësit që t'i perifrazojë ato në kontektste të tjera kohore. Shkëputja e përemrit "*ku*" dhe alternimi i saj me pohimet e vendosura pas njëra tjetërs, (*ku e mora frymëzimin/ ku e gjeta tregun/ ku mësova dhe studiova teknikën time/ ku e gjeta vlerësimin*) krijon mundësinë që perifrazimi jo vetëm të komunikojë diçka më komplekse, por nxënësi të

437 Ëittgenstein, L. 1967. *Ricerche filosofiche*. Torino: Einaudi.

vlerësojë këshillën që autori e jep të nënshtresuar (dhe jo drejtpërdrejt) në fragment. Ky kuptim më i gjerë derivon *nga përemri "ku", mënyra urdhërore e foljes "shkruani" dhe tërësia e shembujve (*Mopasan, Ten, Balet, Bethoven) që nxënësi i sjell në formë të zgjeruar kuptimore.

Sa herë që jemi para një komunikimi të nënkuptuar, një perifrazim i tij nuk mund të limitohet në përdorimin e shprehjeve sinonimike ose të bazuara në implikimin e thjeshtëzuar të logjikës, por duhet të sforcohemi për të rikrijuar një efekt me kuptim sa më të afërt, analog me origjinalin e anunçuar, duke përdorur mjete të ndryshme, në veçanti duke dubluar në mënyrë të ndryshme, raportin midis asaj që thuhet në momentin e komunikimit, me atë që komunikohet në nënshtresimin e saj kuptimor. Tek "Albas" sa thamë më lart është realizuar duke i kërkuar nxënësit të bëjë përmbledhjen e pesë faktorëve që Noli i përmend për t'u bërë shkrimtar dhe më pas në dhënien perirazike të mesazhit të pjesës.

Shkurt, perifrazimi luan në hapësirën e nënshtresimit kuptimor që shoqëron tekstin i cili perifrazohet, ose ndoshta rikthen përmbajtje që në tekstin e nisjes ishin si kuptime të nënshtresuara.

Si shembull i tekstit argumentues sillen nga Mediaprint 10 fq(119) "**Revolucioni i Spanjës"** dhe Pegi 11 (fq 80) "**Shekspiri në rrezik".**

Në tekstin e parë Fan Noli ka përcaktuar tezat mbi revolucionin nën Spanjë dhe në Rusi. Nxënësit i kërkohet të hyjë në fragment për të evidentuar karakteristikat që e bëjnë këtë tekst bindës dhe argumentues. Kjo do të thotë që nëpërmjet strategjisë së tipit **vëzhgues,** (që kanë si objektiv zotërimin e aftësisë për të njohur komunikime të nënshtresuar në fakte) –përcaktohet vendosja e tezës në fillim të argumentimit nga Noli analogjitë midis dy revolucioneve)/ numërimi fakteve konkrete dhe lidhja e tyre me tezën e rrëzimit të monarkive përkatëse, sistemet sociale post monarkike etj)/ argumentet logjike analiza ekonomiko-sociale, argumentet pragmatike (pohimet e Nolit që synojnë të bëjnë të njohur rezultatet pozitive konkrete që rrjedhin nga teza).

Ndërsa në fragmentin e përzgjedhur nga "Pegi", vështrimi është akoma më analitik. Bëhet një ndarje e gjykimit në: të kuptuarit, të kritikës dhe gjuhës e stilit. Fragmenti përveç analizës së informacioneve (Vlerat e Shekspirti dhe arsyet se përse ai është i rrezikuar) të veçuara përmes pyetjeve konstatuese, nis vënien në funksion të njohurive të marra nga teksti, duke synuar ngulitjen e tyre në një kujtesë afatgjatë përmes detyrave:

-trego çfarë teknikash argumentimi janë përdorur në këtë shkrim dhe cila është mbizotëruese. (shembuj)

-Në tekst Noli kundërshton një sërë opinionesh që janë dhënë për Shekspirin dhe veprën e tij. Argumento me idetë e tua se përse i quan të pambështetura.

Duke vënë theksin tek argumenti dhe kundërargumenti/teza dhe kundërteza, mendimi i Nolit, vlerësohet i kushtëzuar nga situata thëniesore. Mendimet e thella të Nolit lidhen me artin në tërësi dhe bukurinë e veprës së Shekspirit në veçanti. Për ta bërë të prekshme këtë, teksti veçon shprehjet*: Valteri kërkonte një artist me rregulla, po Shekspiri ishte një artist pa rregulla, përtej rregullit; pak kush mund të thotë që në atë turbullim të bukurive të egërta të dramavet shekspiriane, në atë "disharmoni", s'ka harmoni*. Në këtë tërësi shprehjesh synohet të arrihet te perceprimi i

nënshtresuar, të cilin Noli ia lë lexuesit ta përzgjedhë. Kjo bën të mundur lidhjen e fushës leksikore të përdorur, me argumentin si shtylla kryesore e tekstit argumentues. Ky hulumtim krijon një situatë të re bashkëveprimi kompleks në librin e nxënësit, pasi atij i kërkohet më pas përcaktimi llojeve të fjalive në vijueshmëri paragrafësh, duke siguruar jo vetëm njohjen e nëntekstit të autorit, por edhe interpretim të saktë e konjitiv.

Pjesa më interesante e trajtuar në tekste (në të gjitha shtëpitë botuese pjesëmarrëse në altertekst) është drama "**Izralelitë e filistinë**" e përfshirë në programet e MASH-it tek seria e veprave të detyrueshme për t'u analizuar.

Në vështrim gjithëpërfshirës, ajo që i bashkon trajtesat e fragmenteve të secilit libër është:

- *Përcaktimi i qëllimit të dramës, si vepër që dramatizon ndeshjen e dy kulturave*
- *agresiviteti dhe aprioria e qëllimeve izraelite*
- *diskriminimi etnocid ku ideja e kulturës "më të lartë" i imponohet me dhunë kulturave të tjera.*

Duke patur qëllim vlerësimin pragmalinguistik të tekstit, do të veçojmë përbashkësinë kontekstuale të analizave të diskursit, me qëllim zbërthimin e ideve të nënshtresuara:

Teksti i "Albas"-it merr në analizë dialogun Samson-Dalila dhe nëpërmjet zbërthimit leksikor të tij, shkon drejt raportit tekst-të lexuar i cili realizohet i plotë kur leksiku krijon fushë semantike të parë dhe më pas aparati pedagogjik e orienton drejt ideve që synojnë të përcjellë autori. E konkretizojmë me një shembull:

Në gjuhën e Samsonit veçohen fjalët: *s'desha të puthnja; dashuri e kriminelyë; zemrës i pëlqejnë të ligat; ushqim i qëruar; të ligat janë sharmi tënt; zemra rufjan i gënjeshtrës etj.*.

Gjuha e Dalilës: *gjemb i parë; më do për të ligat e mia; dojmë siç jam-një më një është; dashuria është dilemë; adhurova veten etj*.

Duke vlerësuar skenën ku zhvillohet dialogu, nxënësi arrin të shkojë drejt mesazhit që sjell secila nga pohimet:

Samsoni nga një misionar bëhet një njeri i zakonshëm që dashuron dhe Dalila zbërthehet gjuhësisht në qëllimin e saj. Dialogu Samson-Dalila shtrohet në nivelin e diskutimit të ideve që kanë të bëjnë me raportet *arsye-ndjenjë; jetë kolektive-jetë personale*.

Teksti i Pegit është më i përqëndruar në gjuhën e personazheve, duke synuar të kuptuarit nëpërmjet "thënies" dhe nënshtresimin kuptimor nëpërmjet stilemës.

Shohim me vend që në këtë rast të përdorim një terminologji të mbështetur në dallimin thelbësor që Grice[438] i bën dy kategorive: "*thënia*" dhe "*nënshtresimi kuptimor* ". Sipas Grice, ajo që një tekst komunikon në mënyrë të plotë, është e formuar nga ajo që në të thuhet në mënyrë sa më të qartë dhe që për të, është e lidhur me kuptimin në një marrëdhënie kushtëzuese, shumë më tepër se sa ajo vetë shpreh, sygjeron, apo lejon të kunkludosh, e mbështetur kjo qoftë me marrëveshjet linguistike,

[438] Grice, P. 1993. *Logica e conversazione*. *Saggi su intenzione, significato e comunicazione*. Bologna: Il Mulino.

apo edhe me supozimet që i përkasin situatave linguistike. Pra të kuptosh një tekst, do të thotë të kuptosh "*thënien*", më shumë kuptim nënshtresimit kuptimor. Për të parë që një tekst nuk mund të kuptohet krejtësisht nëse nuk përtithet nënshtresimi kuptimor, mund të na duhet të reflektojmë mbi mënyrat dhe rrugët nëpër të cilat *kalon* procesi i të kuptuarit.

Për të konkretizuar sa më lart referuam, veçojmë në aparatin pedagogjik dëshmitë e thënive:

Më duket, Rahil, sikur dëfrenin para se të hynin. Kërkesa: (Nisu nga fjalët e Samsonit dhe përshkruaj se si i gjykon ai ngjarjet)

Më duket sikur mjekra nisi t'i zmadhohet! Dhe sikur njëri sy i shikon. Kërkesa: (Shpjego fikën nëpërmjet këtyre fjalëve)

Sa njiheshim më parë me këtë grua. Tani jemi si të huaj. Kërkesa: komento duke mbajtur parasysh –llojin e njohjes që ata kishin; -përmasën e kohës duke vënë përballë rrethanorët *më parë dhe tani;* -pranëvënien e shprehjeve njiheshim dhe sa njiheshim, me shprehjen jemi si të huaj.

Fjalët e Rahilës *Më s'të lipset tani.* Kërkesa: shkruaj me fjali konkrete disa perifrazime që mund të zevendësojnë fjalët e Rahilës.

Siç vihet re vend të dukshëm zë **perifrazimi**. Lidhja e fortë midis **kuptimit dhe perifrazimit**, konvertohet në një lidhje po kaq të ngushtë midis **kuptimit dhe absurbimit të informacionit**. Duke marrë informacionin e duhur për marrëdhënien Samson-Rahile-Dalile nga teksti, nxënësi më pas është në gjendje të perifrazojmë pjesën që i kërkohet. Aftësia për të përthithur nënshtresimet kuptimore nuk mund të ndikojë veçse pozitivisht në të kuptuarit dhe interpretuarit e përmbajtjes së tekstit (por edhe të disiplinave të veçanta. Në këtë pohim i kapërcejmë materiet e gjuhës dhe letërsisë). Duke dashur të përdorim qasje të pragmatikës linguistike në hapësirën e zhvillimit të të kuptuarit tekstual, ky kontribut nuk duhet të interpretohet si kufizim në edukimin linguistik, por mund të ndikojë në funksionet didaktike edhe të disiplinave të veçanta.

Kjo është akoma më e dukshme në atë rast të veçantë të perifrazimit që është **përmbledhja.** Ai që aludon të bashkojë në një të vetme një përmbledhje, thjeshtësisht duke eleminuar pjesë nga teksti bazë original (duke punuar në këtë mënyrë eskluzivisht mbi "thënien") nuk do të arrijë asnjëherë të bëjë një përmbledhje të mirë: përmbledhja përmban rregullisht fraza që nuk i përkasin tekstit nisës, por ishin të nënshtresuara kuptimisht në të. Në analizën që i bën botimi i "Mediaprintit", përmbledhja e fragmentit të Nolit, synon që tekstin nisës ta fokusojë në disa hulli kryesore:

- *Bëni dallimin midis informacionit kryesor dhe informacionit dytësor.*
- *Fshini detajet, shembujt, informacionet e panevojëshme.*
- *Gjeni fjalët e përafërta ose sinonime të frazave.*
- *Në përmbledhje mbështesni pikat e forta të argumenteve të tekstit.*

Ky orientim paraprag, ka kaluar më parë në njohjen fillestare të testit, në vlerësimin e marrëdhënieve të protagonistëve, ideve dhe simbolikës së tyre, analizën diskursive dhe ideore, vlerësimin figurativ.

Më së fundi duhet përmendur teksti poetik i Nolit i trajtuar në botimin e shtëpisë botuese "Pegi" 10 (fq 83). Autorët e librit kanë preferuar të përzgjedhin Marshet e Nolit, konkretisht Marshin e kryqëzimit dhe Marshi i Baranajt. Në faqen 87 tërheq vemendjen rubrika "Të kuptojmë gjuhën e teskstit poetik". Të vlerësuara në disa raste nga kritika si poezi të rrethanave a të rastit[439], në tekstin e nxënësit poezitë janë analizuar, veç tjerash, edhe në kontekstin e tyre linguistik. Vlerësimi i lojës së Nolit me fjalët njërrokëshe aty ku ai nuk arrin të gjejë fjalë me theks fundor dhe alternimi i kësaj gjetjeje stilistikore me kalimin e fjalëve në rastet e tjera në theks fundor, e ballafaqon nxënësin me intuitën gjuhësore të poetit e cila i shkon për shtat stilistikës së përzgjedhur nga ai vetë.

Përfundime

Në tekstet e gjuhës dhe letërsisë shqipe të gjimnazit, Fan Noli vështrohet në tërë aspektet e veprës së tij: si poet, publicist, dramaturg.

Në vështrimin pragmalinguistik, tekstet e Fan Nolit mundësojnë studimin e plotë diskursiv, duke i dhënë nxënësit sigurinë e zotërimit të diskurseve/ përftesave ligjërimore të sakta dhe risjellejen e informacioneve të marra nga autori në situata të tjera thëniesore.

Analiza e teksteve të Nolit në librat e nxënësit është një analizë e plotë mbi sekuenca të veçanta tekstore, duke realizuar një tërësi kuptimore dhe ndarja në sekuenca ka ngadalësuar dhe rregulluar analizën.

Tekstet e Fan Nolit analizohen në:

- përbërjen e tyre gjuhësore (njohje e sistemeve të ndryshe, të rregullave sintaksore, leksikore, semantike, fonologjike etj).
- në përbërjen sociokulturore duke lejuar të njihen dhe inerpretohen sistemet e ndryshme dhe vendodja e tyre ne kontekin e caktuar
- në përbërjen pragmatike e cila mundëson trajtimin nga nxënësi të njohurive që kanë për natyrë mesazhet:

e organizuara dhe strukturuara në kompetencat bisedimore dhe strategjitë e ndërtimnit të diskursit të tij.

në përftimin e funksioneve me qëllime komunikimi (kompetencën funksionale)

[439] Sabri Hamiti, Letërsia moderne shqiptare, UET-Pres 2009, fq 212

SHKËLQIM MILLAKU

KOMPOZITAT, ROLI DHE FUNKSIONI I PËRKTHIMEVE TË NOLIT

Kumtimin tim për Nolit do doja ta filloja me një citat të **M. Domit**, i cili, për Nolin dhe për trashëgiminë e tij të përgjithshme gjuhësore, letrare, artistike etj., ka thënë: "E shumanshme dhe nga më të gratshmet ka qenë puna e tij në përpunimin, pasurimin e zhvillimin e gjuhës sonë letrare, i gjerë e i thellë ndikimi i tij (...). Ai e tëharri shqipen letrare të variantit Jugor të përpunuar prej rilindësve të mëdhenj të shekullit të kaluar, nga elemente dhe tipare arkaike e ngushtësisht dialektore, nga variante të shumta morfologjike, i dha asaj një karakter më të përgjithshëm, më të njësuar, më të stabilizuar dhe e bëri më të lakueshëm e më të kristalizuar. Ai është, përveç kësaj, ndër pasuruesit më të shquar e më dorëmbarë të visarit leksikor të gjuhës sonë letrare e të mjeteve shprehëse të saj (...). Ai farkoi sa e sa neologjizma, u dha formë shqipe shumë fjalëve të huaja, sajoi kombinime të ndryshme fjalësh me një ndjenjë të hollë të natyrës së gjuhës sonë e sidomos me një shije të rrallë artistike"[440].

Për ruajtjen, zhvillimin dhe pasurimin e gjuhës janë përpjekur dhe dëshmuar shumë dashamirës shqiptarë dhe të huaj. Andaj, Noli veproi dhe punoi si shumë studiues, krijues, përkthyes të tjerë, të cilët, dëshmuan vullnetin e tyre me të mirë, në kohën e duhur për ruajtjen zhvillimin dhe sjelljen e rezultateve të reja përmes krijimeve kreative, përkthimeve të ndryshme letrare dhe shkencore. Në fushën e gjuhës kemi veçuar kontributin e tij, për përdorimin e kompozitave, të cilat, përfshihen ndër tri komponentët gjuhësore (pas parashtesimit dhe prapashtesimit), që pasurojnë gjuhën me fjalë të reja. Në vazhdim do t'i paraqesim disa kompozitat të përdoruara nga Noli si: **zemërhekur, kryeprofet, gojmjalt, kryefe, kryerojtar, zemërprerë, zemërmirë** etj. Duke kuptuar dhe vlerësuar, rolin dhe kontributin e Nolit, Çabej shkruan: "*Ai nuk është poet i lartësive eterike, po është shkrimtar i plisit të dheut"*. Mirëpo, fenomeni gjuhësor në fjalë dhe përkthimet e tij, zënë një vend të veçantë dhe mjaft të rëndësishëm në veprimtarinë e Nolit, por edhe si studim kryesor i këtij artikulli. Andaj, ky personalitet i shquar i kulturës shqiptare, lindi, dhe e vazhdoi rrugën burrërore të **Barletit, Buzukut (...), Kristoforidhit, De Radës, Naimit, Samiut** etj. Ai dha kontribut në disa fusha si: në **poezi, prozë, publicistikë, gojëtari,** në **kritikë,** në **muzikë,** në **dramaturgji** dhe në **përkthime** të ndryshme **artistike**. Noli e ndërtoi famën e tij më përkthime të ndryshme si: përktheu poemën epike "**Kthimi i Skënderbeut në Krujë**" e shkruar nga Longfellou, tragjeditë "**Otello, Hamleti, Makbeth, Jul Qesari**" të Shekspiritë drama "**Armiku i popullit**", **Zonja Ingra e Ostrotit të Ibsenit, Rubairat e Khajamit**, romanin "**Kasollja**" të Blasko Ibanjezit, romanin "**Don Kishoti i Mancës**" të Servantesit. Ai përktheu nga gjuha shqipe në greqisht veprën e Samiut "**Shqipëria çka qenë, ç'është dhe çdo të bëhetë"**. Pastaj,

[440] M. Domi, **Mjeshtri i madh i fjalës shqipe,** Nëntori, 1965, nr. 4, f. 27.

përktheu në anglisht **"Psalmeve"** të Davidit dhe shumë vepra, poezi, studime, kritika të tjera, të cilat, e plotësuan veprimtarinë e tij shkencore. Fjalët kryesore:

Noli nuk u mor kryesisht me çështje gjuhësore, por ai e zbatoi me hollësi veçantinë gjuhësore në veprimtarinë e vet letrare. Si njohës i mirë i një numri të konsiderueshëm gjuhësh të huaja, Noli e njohu thellësisht shpirtin dhe natyrën e gjuhës se vet amnore. Njohuritë për gjuhën e vet amnore ai i arriti "ashtu këmbëkryq me plakat e Shqipërisë që e kishin shpurë në dhe të huaj gjuhën e popullit virgjër, Noli thëthinte mëkatarin të cilin e çkrinte pastaj në art". [441]

Për të qenë krijues, përkthyes, kompozitor apo artist i madh është kërkuar dhe kërkohet çdo herë mjeshtri e madhe në përdorimin e gjuhës sa me të pastër dhe koncize, e cila të Noli nuk mungonte në përdorimin e fjalëve të reja dhe mjaft tingëlluese në ndërtimin e vargjeve apo edhe në përshtatjen e përkthimeve. Andaj, duke kuptuar konceptin mendor dhe intelektual të një krijuesit dhe artistit të madh shqiptar **Çabej** shkruan: "Noli na paraqitet si një lis i moçëm e plot gdhenj: lis i vetmuar, po me rrënjë nguluar mirë në të thellat e dheut. E këtillë mbetet edhe gjuha e tij"[442].

Noli ndër të gjithë kontributdhënësit e kohës se tij shquhet për mjeshtrinë e fjalës dhe të krijimtarisë se tij. Ai kishte një gjuhë mjaft koncize, e cila, mund të përdoret atëherë kur krijuesi krijon fjalë të reja apo edhe kompozita. Në gjuhë, tani janë dëshmuar se cilat janë shtyllat kryesore për të krijuar fjalë të reja:

a. Ndërtimi me parashtesë,
b. Ndërtimi me prapashtesë (para dhe prapashtesë njëherazi),
c. Ndërtimi i përbërë(kompozitat).

Ndërtimet në fjalë janë mjaft produktive në krijimtarinë e Nolit. Andaj, krijimtaria dhe tipat e fjalëformimit të Nolit janë të shumta, mirëpo në këtë studim do t'i veçojmë dy çështje mjaft të rëndësishme në kontributdhënien e Nolit. Në çështjen e parë veçojmë kompozitat apo fjalët e përbëra, të cilat, kanë një përdorim të gjerë si në krijimtarinë e tij artistike ashtu edhe nga përkthimet. Vështrimi i dytë do të jetë roli i përkthimeve, i cili është i një kualiteti të lartë për nga tematika dhe përshtatja e përkthimeve në gjuhën shqipe dhe anasjelltas.

"Noli në vargjet e tij poetike me një shije të hollë artistike, dashuri e intimitet njerëzor me plot respekt e ndjenjë shoqërore, qoftë ndaj subjekteve apo objekteve të personifikuara, arriti të shprehet me veçanti të rrallë gjuhësore, poetike e stilistike, përveç mundësive të tjera edhe me anë të fjalëformimit kompozitor"[443]. Në krijimtarinë artistike, kreative dhe të disa përkthimeve të Nolit kemi veçuar dhe vjelur disa lloje të fjalëve të përbëra si: *Kryengritës*[444], *vetëmbrojtjeje*[445], *veriperëndimore*[446],

[441] Nonda Bulka, **F. S. Noli nëR bashkëkohasit, ribotim** Rilindja, Prishtinë, 1968, f. 211.
[442] Eqrem Cabej, **F. S. Noli në bashkëkohasit, ribotim** Rilindja, Prishtinë, 1968, f. 224.
[443] Mehmet Halimi, **Kompozitat në veprimtarinë letrare të Nolit**, (F. S. Noli në 100-vjetorin e lindjes 1882-1982), Prishtinë, 1984, f. 123.
[444] Fan S. Noli, **Gjergj Kastrioti Skënderbeu (1405-1468),** Prishtinë, 1988, f. 55
[445] Po aty, f. 61
[446] Po aty, f. 72

flokëbardhë[447], *kokëngrirë*[448], *zemërprerë*[449], *vdekjegrirë*[450] *gjysmëhënë*[451], *bashkëkohës*[452], *gojëdhënat*[453], *gjakderdhje*[454], *Krishtlindje*[455], *botëkuptimin*[456], *bashkëpunëtorëve*[457], *epiko-lirike, bashkëluftëtaret, njeri-perendi, zavendësohen*[458], *kundërrevolucionit, Krye-Profeti*[459], *Shpirt-këputur*[460], *bij-skllevësh*[461], *kryefeudali, kryetrim, atdhe, kryemjek, kryefe, kryeshenjt*[462], *gojëdhanës, vllavrasëin, vllavrasje*[463], *gojëmjall'*[464], *zëmër-hekur, surgjyn-vdekur, syrgjyn-gjall', lesh-lëshuar*[465], *duar-lidhur, Krye-Profeti (Mojsiu)*[466], *shpirt-këputur, gjakëprirës, shpirt-robi, vajvatani*[467], *mjer-mileti, kryerojtja (pararoja)*[468], *njeridashjes (Eskili)*[469], *brymëshkrirëse, zemër-dhimbje, zëmër-mirë, zëmërcjerëse, mallëngjyer*[470], *pikë-vështrimi*[471], *shpirt-madhësinë, fatkeqësisht*[472], *sy-përpjetë, kryevepra.*

Noli duke e kuptuar rolin dhe rëndësinë leksikore të kompozitave i përdori ato me një shije të hollë poetike, mirëpo si për Nolin dhe për shumë studiues të tjerë frymëzimin e fjalëve të reja e gjejnë nga brumi i gjuhës shqipe të përdoruara si kompozita popullore, të cilat, zënë vend si fjalë të përbëra më kuptime të reja.

Ndër kompozita apo fjalët e përbëra që i ka përdorur më se shumti Noli janë ato fjalë të cilat si komponent të parë kanë fjalën **krye, zemër, kundër, bashkë** etj., si: "krye-profet, kryetrim, kryefe, kryerojtar, kryemjeshtër, kryezot, zemërhekur, zemërprerë, zemërthyer, zemërmirë etj.

---

[447] Po aty, f. 85
[448] Po aty, f. 85
[449] Po aty, f. 85
[450] Po aty, f. 85
[451] Po aty, f. 87
[452] Po aty, f. 89
[453] Po aty, f. 89
[454] Po aty, f. 98
[455] Po aty, f. 98
[456] Fan Noli, **Sulm e lot**, Beograd, 1963, f. 16
[457] Po aty, f. 16
[458] Po aty, f. 16
[459] Po aty, f. 22
[460] Po aty, f. 22
[461] Po aty, f. 22
[462] Po aty, f. 33
[463] Po aty, f. 37
[464] Po aty f. 42
[465] Po aty, f. 45
[466] Po aty, f. 51
[467] Po aty, f. 58
[468] Po aty, 64
[469] Po aty, f. 69
[470] Qemal Xhomo dhe Dhori Qirjazi, **Antologjia e letërsisë shqipe,** Tiranë, 1972, f. 173
[471] Fan Noli, **Ligjërime Introdukta,** Prishtinë, 1968, f. 13
[472] Fan Noli, **Betoveni dhe revolucioni francez**, Prishtinë, 1968, f. 33

Llojet e kompozitave janë të ndërtuara nga pjesët e ndryshme të ligjëratave si:

Emër + emër = emër, kryehekur, kryemjek, kryerojtar, *atdhe, kryefe, kryeprofet*[473] *etj.*

Emër + pjesore = emër, zemërthyer, mësimdhënës, kokë-ngrirë, buzë-qeshur, zemërprerë etj.

Emër+mbiemër = emër, gojëmjaltë, zemërmirë, shpirtmirë, kryetrim, mendjelehtë etj.

Përemër + emër, vetëbesim, vetëkontroll, vetëqeverisim, *vetëmbrojtjeje*[474] *etj.*

Emër + ndajfolje*, syrgjyn-gjallë, shkëlqimi-plotë, sy-përpjetë etj.*

Noli ka krijuar dhe botuar dhjetëra fjalë të reja, i cili edhe pse saktësisht nuk është marrë me gjuhën, në një formë apo tjetrën ai ka paraqitur rezultate të mira gjuhësore duke përkthyer, përshtatur dhe krijuar fjalë të reja të cilat për kohën sigurisht kanë qenë mjaft me interes. Andaj, duke qenë pasionues i madh i përkthimeve të Shekspirit, Ibsenit, Khajamit, Servantesit, Longfellusit e shumë të tjerë, ai dha një kontribut mjaft të suksesshëm në jetën artistike të kulturës shqiptare.

"Noli ishte njohës *i madh i gjuhëve botërore. Ai fliste frëngjishten, anglishten, greqishten, turqishten, spanjollishten, gjermanishten dhe rusishten. Ai mësoi në një etapë të jetës së tij edhe gjuhët skandinave, e më vonë iu përvesh edhe mësimit të hebraishtes. Siç thotë vetë, shumicën e këtyre gjuhëve i mësoi me lehtësi dhe në saje të adhurimit që kishte për ndonjë shkrimtar apo autoritet që krijonte në atë gjuhë dhe kulturë*[475], kështu që studimet, krijimet dhe përkthimet e tij ishin dhe do të mbeten mjaft frytdhënëse dhe me interes për shkencën shqiptare.

Përkthimet e Nolit nuk janë thjesht një kalim nga një gjuhë në tjetrën, por natyrshëm tingëllojnë të kaluara nga një kulturë në tjetrën. Ai ka bërë përshtatje të sakta gjuhësore edhe pse lipset të respektohen elementet të rrepta gramatikore, kulturore në kuptim të gjerë të fjalës. Let*ërsia shqiptare* është pasuruar mjaft shumë me përkthimet e Nolit, i cili vërtetë i ka dhënë frymë shqipe, dhe "*më të drejtë thotë Noda Bulka se: Shekspirin, Servantesin, Ibsenin, Ponë, Longfelloun i bëri të flasin shqip*[476].

*P*ërshtatja dhe përkthimet e Nolit ishin dhe mbeten të pranueshme për kohën e veprimtarisë se tij, mirëpo edhe mundësi për t'i përshtatur dhe për të pasur model edhe sot. Kjo nuk do të thotë se sot për shqipen standarde të mos këtë zbrazëtira, mirëpo lipset të krahasohen dhe të pasurohen me ide të reja për përshtatshmërinë e përkthimeve si në vjershën e E. A. P., Anabeli Lee, strofa e pestë:

But our love ëas stronger by for than the love
Of those ëho ëere older than ëe
Of many far ëisser than ëe

[473] Po aty, f. 33
[474] Po aty, f. 61
[475] Avni Spahiu, **Noli jeta n*ë Amerikë****, Tiranë, 2007, f. 195*
[476] Lindita Aliu, **Me përkthimet e Nolit (Fan Noli, në 100-vjetorin e lindjes 1882-1992)**, Prishtinë, 1984, f. 223

Noli:

Dashuria që kishim ishte më e fortë se çdo dashuri!

S'e ka patur as plak as i ri,

As i marr' as i urtë njeri.

Nga këto vargje shihet përshtatshmëria e plotë, mirëpo mbiemri i shkallës krahasore stronger do të duhet të përkthehej më i/e fortë dhe jo si është përkthyer nga Noli "shumë më e fortë, sepse ky mbiemër po të ishte në shkallën sipërore "strongest" do të duhej të përkthehej si e kemi versionin e Nolit. Gjithashtu edhe mbiemri i përdorur nga Noli "older dhe përkthyer as plak as "i ri", mendoj se shkallën krahasore të mbiemrave nuk e ka bërë përshtatjen si duhet, sepse do të duhej "older – me i vjetër" dhe natyrisht pastaj krahasimin më të kundërtën e saj. Andaj, jo rastësisht kërkohet kalimi më shumë kujdes nga një gjuhë apo kulturë në tjetrën, sepse lipset të mos i humbet kuptimi apo të mos shkelen rregullat gjuhësore. Mirëpo, strofat e vjershës në fjalë do të duhej të përshtatet në kulturën e gjuhës shqipe si:

Dashuria jonë ishte me e fortë se e atyre,

që ishin me të vjetër dhe shumë më të mençur se ne.

Në këtë rast kemi një kontrast të plotë, sepse jemi duke bërë një përshtatje mjaft koncize e cila po humbë një fjali nga gjuha angleze në gjuhën shqipe. Andaj, muzikaliteti i përkthimit të Nolit është tingëllues në shqip dhe i pranueshëm, por shkalla krahasore e mbiemrit edhe pse nuk përdoret drejt gjuhësisht e ruan muzikalitetin e origjinalitetit.

Në disa vargje të theksuara nga "Tales of a wayside inn" (Tregime nga një bujtinë e rrugës), përkthim për Skënderbeun, të autorit Henry Wodswarth Longfellow (1802-1882), të cilat tregojnë se me çfarë mjeshtërie Noli i jep vargut anglez ngjyrën e ambientit shqiptar:

But he cared not for Hospoders

Nor for Baron or Viovode

As on through the night he rode. . .

Përkthimi fjalë për fjalë:

Por s'mërzitej ai për Gospodarët

Për Baronët dhe Vojvodët

Duke vrapuar me kalë nëpër natë...

Noli:

Po kujdes ai s'të ka

As për Bek as për Pasha

Edhe natën tek po shkon[477]...

Noli vargut anglez i ka dhënë ngjyrën e ambientit shqiptar si të përdorimi i emrit "Hospoders", edhe pse e ka përshtatur dhe duke mos e përdorur fare, mirëpo përkthimi i Lënditës, "Gospodarërt" është i ngutshëm dhe i pasaktë, sepse do të duhej "zotërinjtë" si fjalë shqipe dhe jo të përdoret një fjalë sllave, e cila nuk tingëllon bukur dhe e pa kuptimtë në gjuhën shqipe. " Noli është nw radhë të parë stilist, përkthyes e

[477] Po aty, f. 228

pastaj artist origjinal (...). Vlera e përkthimeve të Nolit për kulturën shqiptare është shumë e madhe, si për nga zgjedhja e veprave ashtu edhe për nga cilësia e përkthimeve. Ka raste kur ai ka ditur të jetë me të vërtetë përkthyes i rrallë, por çdo matje e tij me përkthyes aloglotë është e pakuptimtë"[478].

Në vitin 1926 Noli përktheu nga gjuha angleze në gjuhën shqipe 110 Rubaira të Omar Khajamit, mirëpo siç dihet Noli i ribotoi për herë të dytë të rregulluara dhe polësuara në 331 Rubaira, prej të cilave 221 i ka përkthyer në gjermanisht, frëngjisht etj. "Ajo që e dallon përkthimin e Nolit nga përkthimet e zakonshme që janë bërë në shqip, është pikërisht puna e tij prej rikrijuesit. Për t'u bindur në këto pohime, mjafton të merret një Rubair, pra një strofë e versionit anglisht, të riproduktohen në shqipet dhe se fundi e njëjta strofë të krahasohet me përkthimin poetik që i ka bërë Noli:

1. Awake! For Morning in the Bawl of Night
Has flung the stone that puts the Stars of Fleght:
And Lo! the Hunter of the East has caught
Dhe Sultan's Turret in a Noose of Light.

2. Zgjohu! Sepse mëngjesi nga rruzulli i natës
E gjuajti gurin që i trembi yjet
Dhe shih! Gjahtari i Lindjes ka zënë
Kullën e Sulltanit me spangon e dritës.

3. Zgjohu! Mëngjizi me shigjet' e grisi
Perden e natës, Yjt' i arratisi,
Dhe dielli gjahtar me rreze kapi
Ç'do maje mali e pallati e lisi[479].

Njohësi i mirë i anglishtes standarde dhe njohësi i mirë shqipes standarde nuk do të ketë problem për t'i dalluar përshtatshmërinë që e ka bërë Noli, ose me mirë të themi se ai ka rikrijuar. Fjalia e fundit lind mendime të reja, se a është e lejuar që përkthyesi të bënë përshtatje të kësaj natyre. Mendoj se duhet cituar edhe mendimin e A. Rapaport, i cili ka paraqitur dyshimin në përparësinë e rubairave të Khajamit ndaj përkthimeve të shkëlqyera të Nolit: "Dyshoj nëse katrenat e Omar Khajamit në persishte mund të jenë më të mira se ato të Fan Nolit në shqipen". [480] Një mendim të ngjashëm e ka dhënë edhe N. Jokli, i cili, ka thënë: Përkthimi i Rubairave të Omar Khajamit në shqip nga Fan Noli është më i mirë se ai i kryer në çdo gjuhë tjetër të Evropës, me përjashtim, ndofta, të atij të Edward Fitzgeraldit".

Andaj, Rubairat (Rubaijjati) e Umer Khajjamit, janë përkthyer edhe në shumë gjuhë të tjera, mirëpo janë përkthyer edhe në gjuhën shqipe nga Hafiz Ali Korça, dhe ky i

[478] Rexhep Ismajli, **Fan Noli Vepra 7**, Prishtinë, 1988, f. 602
[479] Ylli Zajmi, **Fan Noli Jeta dhe veprat,** Prishtinë, 1986, f. 194
[480] Fan Noli, **Autobiografia**, Prishtinë, 1968, f. 113.

fundit i ka tërhequr vërejtjen Nolit për pasaktësitë e përkthimit të tij, por edhe pse na del me pseudonim, "*atë të Rushit Bilibilit"*. [481]

Gjuha e Nolit ishte vërtetë e brumit të shqipes. Ai siç dihet nuk ka jetuar shumë në Shqipëri, mirëpo përkujdesi për ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës është dëshmuar në veprimtarin e tij shkencore. Përdorimi i kompozitave ka lehtësuar të krijon fjalë të reja dhe të rikrijon apo përshtat përkthimet e tij. Noli në konceptin shqiptar mbetet i pavdekur dhe burrë dhe artist i madh i shkencës shqiptare. Andaj, këtë studim e kam filluar me një citat të Mahir Domit dhe do ta përfundoja më një citat tjetër po të njëjtit autor që ka dhënë mendim për Nolin: Poet i fuqishëm, shqipërues gjenial, historian i talentuar, orator i frymëzuar, kritik letrar i mprehtë, dhe historian arti i hollë, Fan Noli, kjo figurë poliedrike vigan i botës mendore shqiptare – dhe jo vetëm e botës mendore - ngrihet madhështore edhe si mjeshtër i madh i fjalës shqipe, **Nëntor, nr. 4, Tiranë, 1965.**

[481] Hafiz Ali Korca, **Rubajjati Umer Khajjamit**, (Përkthim nga persishtja), Tiranë, 2006, f. 139

SEKSIONI IV: ÇËSHTJE TË PËRKTHIMIT DHE PUBLICISTIKËS NË VEPRËN E FAN NOLIT

ARISTOTEL SPIRO

FAN S. NOLI DHE SHQIPËRIMI SI ANTINOMI TERMINOLOGJIKE

Për bartjen e një mesazhi të shkruar nga njëra gjuhë në tjetrën gjuha shqipe përdor termin «përkthim». Kjo fjalë regjistrohet për herë të parë tek fjalori i shoqërisë «Bashkimi» (1908), por s'ka dyshim se ka qenë përdorur edhe më herët (Xhuvani 1980a: 34)[482]. Tek autorët e vjetër përdorej termi «të sjellun» dhe përkatësi foljor «me sjellë» (Xhuvani 1980a: 34). Nga shekulli XIX konstatohet përdorimi i termit «të kthyer» dhe krahas tij edhe termi «të shqipëruar», të dy në gjininë asnjanëse, siç del edhe nga një artikull i J. Vretos në revistën «Drita» 1(1884), 2-3 (Vreto 1973: 65). Fjala «të kthyer» vijon të përdoret edhe në fillim të shekullit XX, veçse tashmë në gjininë mashkullore («kthim») (Noli 1988a: 388).

Termi «shqipërim», i përdorur nga Noli, mbulon semantikisht përkthimin e teksteve letrare nga gjuha e huaj në shqip. Nuk lidhet aq me cilësinë e produktit përkthimor, sesa me një qëndrim vlerësues ndaj përkthimit letrar në përgjithësi, kundërvënë llojeve të tjera të përkthimit.

Kuptimi që mori fjala «shqipërim» për të shënuar një përkthim (letrar) të cilësisë së lartë i përket një kohe të mëvonshme. Ajo lidhet me modelin përkthimor të krijuar nga F. S. Noli, i cili arriti që të inkuadronte natyrshëm në mjedisin gjuhësor e më gjerë, atë kulturor shqiptar disa emra të njohur të letërsisë botërore (W. Shakespeare, H. Ibsen, O. Khayyám, M. de Cervantes, E. FitzGerald, Blasco Ibáñez etj.).

Por si arriti ta bënte këtë F. S. Noli? Ka disa arsye:

1) F. S. Noli kishte të zhvilluar ndjenjën gjuhësore në përgjithësi dhe atë shqipe në veçanti. Kjo u provua me përpjekjet e tij të suksesshme vjershëruese, me shkrimet polemike publicistike, por dhe me aftësitë e tij të rralla gojëtarore. Në historinë e gjuhës dhe letërsisë shqipe ai njihet si një nga stilistët më shembullorë. Vazhdimisht punonte për përmirësimin dhe përsosjen e mjeteve dhe formave shprehëse (Lloshi 1972: 50-51) duke hapur rrugën për krijimin e modeleve të reja stilistike. Është e vërtetë se të jetuarit larg Shqipërisë e pengonte të ndiqte hap pas hapi zhvillimet dinamike të shqipes, por aftësitë e tij filologjike triumfuan mbi këto pengesa (Xhuvani 1980: 43). Përzgjedhjet e kritikueshme leksikore dhe propozimet e pamiratueshme neologjike mund të zhdënohen të konceptuara brenda stilit të tij letrar.

2) F. S. Noli ishte një poliglot i mirëfilltë, por kishte gjithashtu edhe aftësi përkthimore të zhvilluar, e cila zhvillohet tek njerëzit që kanë një kulturë të gjerë enciklopedike dhe dhunti të veçanta komunikuese. Ai diti të tejçojë semiologjikisht gjithë vlerat letrare e kulturore të autorëve të rëndësishëm të letërsisë botërore.

[482] Fjalën *përkthim* S. Frashëri e përdor tek «Shkronjëtorja» e tij (1886) në vend të «lakim», sikundër *përkthesë* në vend të «zgjedhim».

3) F. S. Noli ishte jo vetëm njohës i shkëlqyer i gjuhëve të huaja, por edhe lexues shumë i kualifikuar. Një lexues i mendueshëm, i cili vendoste se cilat mesazhe letrare, kulturore, politike, shoqërore të përvojës botërore i duheshin lexuesit shqiptar (Xhaxhiu 1982, Jorgaqi 1982: 66, Bala et al. 1983: 514). Natyrshëm mund të pajtohemi me mendimin se përkthimet e Nolit zbulonin analogjitë me jetën shqiptare. Logjika e synimit për të pasuruar kulturën kombëtare shqiptare (Qosja 1988: 216) tingëllon e pranueshme, por prapëseprapë mbetet shumë filologjike dhe pjesërisht argumentuese. Përkthimi si veprimtari vlerësohet si gjest kryesisht letrar, por përkthimi si vendim është një gjest estetik, ideologjik, politik e shoqëror. «Introduktat» e përkthimeve të Nolit nuk shfajësohen aq filologjikisht, sesa estetikisht e ideologjikisht. Ato përbëjnë analiza të veprave të përkthyera, përpjekje për dekodifikimin e mesazheve artistike, por sidomos ideologjike, si dhe evokim të mesazheve politike për shoqërinë shqiptare.

4) Që veprimtaria përkthyese e F. S. Nolit paraqitet si një akt politik, përtej kuadrit filologjik, dëshmohet edhe nga dy përpjekje përkthimore të veçanta: a) «Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë» të S. Frashëri, të cilën e përktheu në gjuhën greke, në të cilën kishte hedhur bazat e edukimit të tij dhe që e njihte si në nivel gjuhe amtare, ashtu edhe në nivel akademik. b) Përkthimi i teksteve liturgjike nga greqishtja në shqip. F. S. Noli kreu shtatë përkthime liturgjike: *Shërbesën e Javës së Madhe, Librën e shërbesave të shenjta të Kishës Orthodhokse, Librën e të Kremteve të Mëdha të Kishës Orthodhokse, Triodin e Vogël, Lutjesoren, Pesëdhjetoren e Vogël dhe Uratoren e Kishës Orthodhokse.* (Beduli 1997: 16-19, 27). Më 1908 pohon se «M'u nxi shpirti nga këto kthime, se janë jo vetëm të vështira e të zorçime, por edhe të mërzitura fort», një qëndrim befasues për një njeri që merret me punë të fesë dhe që dëgjohen si blasfemi (Shuteriqi 1987: 267, Noli 1988a: 388). Çfarë e ka detyruar F. S. Nolin të merrej me një punë të cilën nuk e kishte fort për zemër? Ashtu si përfshirja e tij në çështje të fesë nuk shpjegohet prej arsyesh besimi, po ashtu edhe të përkthyerit (apo «të kthyerët» ose «kthimi» sikundër e quan ai) shihet si një imperativ kombëtar (Noli 1988b: 146-149), meqenëse vëmendjen e ka të përqendruar në përkthime «veprash letrare, për të cilat kombi ynë ka aq shumë nevojë» (Beduli 1997: 18). Demoni i shqipëruesit fitoi mbi akribinë e përkthyesit fetar. F. S. Noli «guxoi» të bënte përkthim të lirë të teksteve liturgjike, duke përshtatur e shkurtuar pjesë nga origjinali dhe duke cënuar njëkohësisht përmbajtjen për hir të melodisë. Mirëpo kjo mënyrë të proceduari është kritikuar p. sh. nga A. Xhuvani (Shuteriqi 1987: 262) dhe, siç është vërejtur, bën që këto të mos mund të përdoren si tekste zyrtare të Kishës Ortodokse të Shqipërisë (Beduli 1997: 29).

5) Me përkthimet e veta F. S. Noli fuqizoi letërsinë e brishtë shqiptare, e cila kishte nevojë të plotësonte pazëllin e vet shprehës estetik me kryevepra në gjini e lloje të ndryshme. Prandaj nuk është e rastësishme që në inventarin përkthimor të F. S. Nolit, përveç poezisë, konstatojmë edhe prozën, konkretisht romanin e dramën. Që letërsia shqiptare të hynte në fazën e pjekurisë së vet, i duhej jo vetëm poezia, por edhe gjinitë e llojet e tjera. Në pamundësi të një prodhimi të rëndësishëm letrar vendas, në mungesë të veprave madhore shqiptare, vinin në ndihmë kryeveprat e përkthyera prej F. S. Nolit.

Shqipëroj, pra, «përkthej në shqip nga një gjuhë tjetër në një mënyrë të tillë që teksti i përftuar të ngjajë sikur është krijuar natyrshëm në shqip». *Shqipëroj*, mandej, «përkthej në mënyrë të kuptueshme», sikundër sugjeron edhe etimologjia e fjalës. Tek. G. Meyer-i (1891) renditet si lemë e veçantë folja *shqiponj* me kuptimin «kuptoj» (Meyer 2007: 480). Khs. gjithashtu edhe shprehjet frazeologjike *fol shqip* «fol qartë» ose *nuk ha shqip* «nuk kupton».

Folja *shqipëroj* dhe fjalët e ngjashme me të *shqiponj, shqipërim, shqipërues* shprehin raportin semantik të kuptueshmërisë me sistemin gjuhësor të cilit i përkasin. Ky është në të vërtetë një vështrim endocentrist i sistemit gjuhësor. Përkthimi i këtyre fjalëve në gjuhë të tjera krijon gjithmonë probleme, meqenëse është e pamundur të ruhen ato konotacione të përdorimeve origjinale. Si do të përkthehej në anglisht, f. v. folja *shqipëroj*? «Translate into Albanian» ndoshta nuk do të mjaftonte, «albanize» do të kishte nënkuptime të ndryshme që do të pajtoheshin me mënyrën se si e shohin çdo gjë shqiptare anglishtfolësit joshqiptarë.

Raste përdorimesh të ngjashme konstatohen edhe në gjuhë të tjera. Khs. p. sh. në gr. *(εξ)ελληνίζω, (εξ)ελληνισμός* gjerm. *verdeutschen, Verdeutschung,* it. *italianizzare, italianizzazione*.

Më lart u tha qartë se folja *shqipëroj* (dhe emri përkatës *shqipërim*) nuk përbën neologjizëm të krijuar nga F. S. Noli, përderisa konstatohet e përdorur edhe para tij. Por kjo fjalë e përdorur si term në kuadrin e një veprimtarie përkthimore fiton përmbajtje klasifikuese dhe kuptimdalluese. Ajo përdoret për veprat letrare të përkthyera bukur. Prapëseprapë, edhe pse e përdorur si term, konotacioni është i pashmangshëm. Fjalët *shqipërim / shqipëroj* nuk mund të perceptohen si kuptimisht neutrale, thjesht denotative (shenjuese). Ato bartin përherë nënkuptimin e një teksti që është më shumë se një tejçim i thjeshtë mesazhi. Lidhen me atë magji që sjell krijimi dhe rikrijimi, dëshmuar me tekste që paraqiten si raste unikale.

Përdorimi terminologjik i *shqipërimit,* i parë në kuadrin e një polisistemi letrar e kulturor, në të cilin përfshihet edhe kultura shqiptare, si në formë ashtu dhe në përmbajtje bëhet bartës i një koncepti mbi përkthimin. Natyrshëm shkon mendja tek klasifikimi historik i F. Schleiermacher-it (1838), i cili dallonte dy praktika përkthimi: tëhuajzimin (foreignization) dhe kombëtarizimin (domestication). Për kombëtarizimin ai përdorte fjalën gjermane *Verdeutschung* (Schleiermacher 1838), që do të thotë «gjermanizim», e cila mund të shihet si përkatësja gjermane e *shqipëroj*.

A mund të mendojmë që Fan S. Noli kishte dijeni për filozofinë përkthyese hermeneutike të F. Schleiermacher-it? Kemi arsye të besojmë se, në mos drejtpërdrejt, tërthorazi ka pasur. Të diturit e gjermanishtes, shqetësimet përkthimore, implikimi me tekstet fetare liturgjike dhe në përgjithësi formimi i gjerë enciklopedik i F. S. Nolit ka shumë gjasa që ta kenë çuar jo vetëm përkah filozofia përkthyese e F. Schleiermacher-it, por edhe përkah mendimi përkthimologjik i kohës në përgjithësi. Për të karakterizuar përkthimet e veta letrare, dhe sidomos ato poetike, ai nuk përdorte fjalën *shqipërim*, por *parafrazë* (Jorgaqi 1982: 67), një term të konceptualizuar nga J. Dryden që në shek. XVII (1680) (Munday 2001: 25).

Kështu, fjala *shqipëroj* mund të shihet dyfish: si vazhduese e një terminologjie tradicionale shqiptare, por edhe si bartëse e një koncepti përkthimor të kohës. Për këtë ndihmon formalisht edhe një analizë e thjeshtë fjalëformuese e termit në shqip e gjermanisht, ku dallohen qartë dy elemente: një ndajshtesë (*ver-/-(ë)ro(j)*) dhe një temë fjalëformuese (*-deutsch(en)) / shqip-*. A është krijuar kjo fjalë në bazë të modelit të gjermanishtes apo të ndonjë gjuhe tjetër si greqishtja, kjo nuk mund të thuhet me siguri të plotë. Por një gjë është e sigurt: se ky term ka lindur si nevojë e shprehjes filologjike dhe është përdorur duke marrë parasysh përvojën e kulturave të tjera, të cilat i njihnin shqiptarët e shkolluar. Ndikimi i ndonjërës prej gjuhëve me të cilat shqipja (kultura shqiptare) kishte më shumë kontakt duhet marrë në konsideratë seriozisht.

I vendosur në perspektivën e debatit diakronik për përkthimin: shkronja apo shpirti, përkatësia formale apo saktësia kuptimore, shqipërimi u konceptua si kundërvënie ndaj përkthimit të ashtuquajtur «fjalë për fjalë». Megjithëse ekzistonte dhe përdorej edhe para tij, termi *shqipërim/ shqipëroj* u lidh asociativisht me punën shembullore të F. S. Nolit për shkak të rëndësisë që patën përkthimet e tij në kulturën dhe shoqërinë shqiptare. Megjithëse po mbushet gati një shekull, përkthimet e tij letrare mbeten ende të pazëvendësueshme.

Nëse F. S. Noli ishte i ndërgjegjshëm për misionin e tij dhe e bënte qartë dallimin midis përkthimit dhe shqipërimit (dhe parafrazës), sot vërehet shpesh një pështjellim në përdorimin e këtyre termave.

Shqipërimi nuk ka të bëjë me një përkthim shumë të mirë ose të shkëlqyer. Ai është një rikrijim i kryer nga një autoritet i padiskutueshëm në fushën e letrave. Shqipërimi nuk është detyrimisht një përkthim i saktë, në kuptimin e të ashtuquajturit përkthim «fjalë për fjalë». Nëse zbatohen kritere të një përkatësie formale gramatikore e leksikore, shqipërimi nuk është më një përkthim adekuat, por një përkthim i kritikueshëm. Lexuesi dhe studiuesi përbëjnë dy anë të kundërta të një alternative tekstore: çfarë është më mirë të përzgjedhim: një tekst të vetëmjaftueshëm letrar larg së qeni një përkthim i saktë, apo një përkthim që të evokon në çdo rresht origjinalin i shfajësuar prej një përkatësie formale? Statistikat hulumtuese mund të dëshmojnë pasaktësi e mospërkime leksikore e gramatikore në shqipërimet e F. S. Nolit (Xhuvani 1980b: 43), por të gjithë mund të bien dakord se tekstet që solli në shqip janë të përkryera (Bala 1982: 56, Jorgaqi 1982: 66, Xhaxhiu 1982: 83-84).

Sipas modelit që krijoi F. S. Noli, shqipërimi duhet të plotësojë disa kushte për t'u cilësuar si i tillë: kërkohet jo vetëm përsosmëria stilistike e tekstit mbërritës, por edhe rëndësia letrare e tekstit burimor. Mandej autori i origjinalit duhet të jetë faktor impakti në letërsinë ardhëse, i përkthyer nga një penë e fortë e letrave shqipe.

Në të vërtetë, praktika përkthimore e ka reduktuar përdorimin e këtij termi kryesisht si referim ndaj F. S. Nolit. Përdorimi i fjalës *shqipërim* në rastet e tjera ngjan më shumë si shpërdorim, po të veçojmë disa shembuj përkthyesish të ndritshëm (p. sh. Skënder Luarasi, Vedat Kokona, Vexhi Buharaja, Misto Treska, Jorgo Bllaci etj.). Mbi të gjithë përkthyesit letrarë rëndon hija e F. S. Nolit. Duket si një padrejtësi deontologjike, kur kemi parasysh shembuj të tjerë shqipërimesh e shqipëruesish pas tij

(shqipërime të dramave të Shakespeare-it, komedive të Moliere-it, romaneve të V. Hugo-it, H. de Balzac-ut etj. etj.). Atëherë pse F. S. Noli? Sepse ai hapi rrugën, krijoi modelin. Dhe ky ishte rasti i parë kur letërsia shqiptare komunikonte me letërsinë botërore; forma gjuhësore «rurale» përdoreshin për të rishprehur kryevepra letrare të Njerëzimit. Nuk ishte vetëm shembulli i një përkthyesi të suksesshëm, kalimi i një prove vetjake, as «prova e të huajit» (A. Berman), por ishte kapërcimi i një prove për vetë gjuhën shqipe. Shqipërimet e F. S. Nolit janë dëshmi e ndërthurjes së ndjenjës së zhvilluar gjuhësore, e njohjes së vazhdueshme të gjuhës shqipe, por edhe e kuadrit më të gjerë kulturor evropian, ku duhej vendosur letërsia shqipe. Propozimet e tij neologjike, edhe pse të mbetura në inventarin leksikor të stilit vetjak, tingëllojnë intelektualisht elegante. Kontributin e vet prej pionieri në fushën e përkthimit F. S. Noli e përforcoi me personalitetin e veprimtarisë politike, shtetërore, shoqërore, letrare, publicistike, fetare. Por, gjithsesi, veprimtaria në të cilën shkëlqeu në mënyrë të padiskutueshme është shqipërimi. Duke e lidhur *shqipërimin* me emrin e F. S. Nolit, ky term merr vetiu një përmbajtje historike, që gjuhësisht mund të cilësohej edhe si arkaizëm letrar. Prandaj përdorimi i tij nga përkthyesit e sotëm ngjan jo vetëm një ambicie e pafuqishme, por edhe përpjekje anakronike.

Termi *shqipërim/shqipëroj* përdoret shpeshherë edhe me kuptimin që sugjeron etimologjia e tij, pra «(për)kthej në gjuhën shqipe». Megjithatë, kjo përzgjedhje mund të interpretohet edhe si një synim drejt përkthimit ideal, i cili në të vërtetë nuk ekziston, por identifikohet me modelin më të mirë ekzistues. Sot ka mjaft përkthime që etiketohen subjektivisht si shqipërime, ndërsa përkthyesit e tyre vetëpërcaktohen narcistikisht si shqipërues.

Termi *shqipërim* fiton një përmbajtje konceptuale të veçantë dhe, mandej, ideologjike, kur zbatohet në fushën e terminologjisë teknike (Qirinxhi 1982, Duro 2009). Me *shqipërim* këtu nënkuptohet futja në sistemin shenjor të termave që motivohen me fjalë të gjuhës shqipe, të cilat përdoren në vend të ndërkombëtarizmave. Termat marrin një «veshje tingullore» shqiptare. Nëse fjala *shqipërim* shfajësohet e përdorur për riformësimin e një sistemi semiotik terminologjik, ajo është e pashfajësueshme kur përdoret në përkthimin e teksteve tekniko-shkencore e fetare. Në këtë kuptim, jo vetëm për Nolin, por edhe për lexuesin e sotëm do të ishte e pashfajësueshme që termi «shqipërim» të përdorej f. v. për një tekst me udhëzime përdorimi të një pajisjeje elektronike (Tupja 2007: 60).

Nga ana tjetër termi *përkthim* bart gjithë përmbajtjen kuptimore të nocionit dhe ka prestigjin e një termi neutral. Kjo është arsyeja ndoshta që në botimin e serisë së veprave folja *shqipëroi* është zëvendësuar me foljen *përktheu* (*nga origjinali anglisht*). Termi *përkthej* nënkupton edhe një modesti të përkthyesit, i cili pranon që vlerësimin për produktin e tij përkthimor do ta bëjë lexuesi dhe kritika.

A mund të thuhet që F. S. Noli krijoi një shkollë shqiptare të përkthimit letrar? (Jorgaqi 1982: 71). Nëse me këtë kuptojmë traditën që ai krijoi me trashëgiminë e tij përkthimore, ky vlerësim mund të pranohej. F. S. Noli përktheu jo si një filolog, por si letrar; nuk flijoi kuptimin në altarin e fjalës, por u ndie i lirë për t'u dhënë veshjen kombëtare kumteve letrare që po sillte në letërsinë shqipe. Në këtë pikë ai shkoi më larg nga ç'mund të priste një kritik përkthimi. U ndie i lirë që t'i largohej origjinalit, sa

tek «Don Kishoti i Mançës» bëhet fjalë për një Universitet të Domosdovës, ndërsa «Korbi» paraqitet në shqipërimin e tij me thuajse dyfishin e vargjeve (Jorgaqi 1982: 70). Përveç disa konsideratave nëpër «introduktat» dhe në ndonjë intervistë, Fan S. Noli nuk na ka lënë tekste teorike për përkthimin. Më shumë se teori, përkthimi ka qenë për të një mundësi për të aktivizuar aftësitë e veta ligjërimore, për t'u vënë në rolin e një ndërmjetësi kulturor si dhe për t'i hapur horizonte të reja një letërsie të sapolindur dhe një populli që aspironte të dilte në dritë.

PËRFUNDIM:

Shqipërimi paraqitet si antinomi, meqenëse i referohet një praktike përkthimore praktikisht të lavdërueshme, por teorikisht të kritikueshme. Shqipëruesi, duke u shkëputur nga varësia gramatikore e leksikore e tekstit burimor, me lirinë për të riorganizuar gjuhësisht tekstin në shqip, «sipas natyrës së shqipes», në të vërtetë ka kryer një rikrijim sipas stilit të vet letrar, saqë mund të thuhet se kjo vepër i përket tashmë shqipëruesit.

«Shqipërimi» është një term i krijuar brenda gjuhës shqipe për të konceptualizuar veçanësinë e shprehshmërisë së saj gjuhësore, por është i krahasueshëm me termat përkatës në gjuhë të tjera për të shënuar një procedurë përkthimi të orientuar nga sistemi kulturor i gjuhëve mbërritëse.

Shqipërimet e F. S. Nolit, duke zbatuar parimin e kombëtarizimit, janë tekste të integruara plotësisht brenda letërsisë shqiptare, ndërsa veçanërisht ato poetiket, kanë arritur një shkallë të tillë integriteti, saqë mund të konsiderohen si krijime të tij.

ALDA CICKO

NJË STUDIM PËRQASËS I "MY NATIVE LAND" I V. SKOTIT NË PËRKTHIMIN E NOLIT

Dëgjohet shpesh në debatet e kritikës së përkthimit të flitet për vështirësinë e deri për pamundësinë e përkthimit të poezisë, duke thënë se sfida e përkthyesit në raport me origjinalin bëhet gjithnjë dhe më e vështirë, teksa kupton se shtegu që të çon drejt njohjes së botës, drejt të kuptuarit të një realiteti tjeter nuk qenka kaq i lehtë për t'u përshkruar nga të gjithë. Çfarë mund të thuhet atëherë për një njeri që këtë sfidë e ka marrë përsipër me dhjetëra herë në përballje me kryeveprat e letërsisë mbarëbotërore, me gjenitë e letrave të shumë gjuhëve, përvesçe ai ka qenë po aq brilant sa dhe ata vetë, në mos më shumë. Duket se gjeniu ynë dinte të zgjidhte që nga veprat më të mëdha deri tek ato më "modestet, " më "të thjeshtat" në pamje të parë, por që duket të flasin shumë teksa i lexon dhe i rilexon .

E tillë është dhe poezia që ne kemi marrë në shqyrtim, sepse ishte pikërisht kjo "gjetje" e tij ajo çka na bëri përshtypje që në fillim. Dhe Noli sigurisht që dinte të zgjidhte, sepse asnjë prej veprave që ai ka menduar ta bëjë "të flasë shqip" prej penës së tij nuk është gjetur rastësisht.

Ajo që të bie menjëherë në sy në rastin e poezisë sonë, është fakti që poeti dhe përkthyesi janë bërë një dhe se Noli duket se i thërret atdheut me fjalët e W. Skotit, por me gjuhën e zemrës së tij prandaj dhe vargjet rrjedhin vetë, ashtu natyrshëm në harmoni të plotë me mendimin, ndjenjat, perceptimet, idetë dhe emocionet që përçon.

Ndërsa mundohej shumë të krijonte në veprat e tij apo të rikrijonte në veprat që zgjidhte të shqipëronte, në kushtet kur e ndiente se shqipes i mungonte tradita në këtë fushë dhe se i duhej shumë punë për t'u bërë edhe ajo " gjuhë e letersisë", ashtu si dhe simotrat e saj, Nolit jo rrallë i duhej t"u fliste shqiptarëve të tij ashtu shkurt, thjesht dhe qartë me fjalë zemre, prandaj dhe zgjedh poezi të tilla " fjalëpaka' dhe "kuptimplote".

Subjekti i poezisë është i thjeshtë, ajo që mund të kuptohet si një dedikim gjykuar nga titulli, në fakt është një thirrje, një lutje, një vajtim nga ato që Noli kishte thurrur shpesh në gjuhën e tij. Prandaj, e parë me sytë e zemrës së Nolit, kjo poezi flet shumëfish. Poezia, që në fakt u drejtohet njerëzve me shumë sesa vendit, përcillet nga Noli, në kohën dhe vendin e duhur, sepse Skocia e lashtë dhe e largët i sjell ndër mend Shqipërinë e tij të egër, me halle plot, me "bij shpirtvdekur" e zemërpadjegur", që " as mendja e as këmba nuk iu kthye mbas", siç thotë ai.

Poezia në fjalë është me karakter lirik, me elemente të theksuar narracioni, pa figura të stërholluara të imazhit, por duket qartë që përtej një vargu të thjeshtë, të lirshëm, që rrjedh shumë natyrshëm, qëndron një peshë shumë e madhe emocionale, që të përfshin për fuqinë e mendimit, peshën e fjalës dhe mesazhin që transmeton. Madhështia e këtij krijimi qëndron pikërisht te thjeshtësia e fjalëve të tij.

Përtej vlerave të padiskutueshme të origjinalit, Noli ka bërë atë që dinte të bënte vetëm ai, e ka ndier dhe kuptuar po njëlloj, duke e rishkruar mjeshtërisht, aq sa të kuptosh se ku mbaron poeti dhe ku fillon përkthyesi është pothuajse e pamundur.

Duke qenë poezi e mendimit të thellë, vlerat artistike qëndrojnë te përzgjedhja e fjalëve dhe ndërthurja e veçantë e tyre me konotacionin, një nga tiparet semantike më të spikatur të shqipes. Noli e ka zgjedhur dhe shfrytëzuar jo rastësisht atëherë kur në vend të kuptimit të parë të drejpërdrejtë për fjalën e origjinalit " wretch" (i mjerë/ fatkeq), përdor fjalën "katrani", një fjalë me ngjyrim emocional, me karakter keqësues, në rastin konkret apo kur fjalën anglisht "nurse" që kuptimin e parë e ka "mëndeshë" nuk ngurron ta përkthejë "njerkë", një zgjedhje e bërë gjithmonë në funksion të idesë së madhe që ai do të përcjellë.

E kështu, përmes analizës semantike të krijimit, mund të dalim në përfundimin se përzgjedhja e fjalëve bëhet edhe më interesante kur pena e Nolit zgjedh një variant kuptimor në vend të një tjetri, si p. sh., në rastet kur në vend të fjalës së origjinalit" poet" zgjedh "këngë", për fjalën "kënaqësi" përdor" lodër", për mbiemrin "poetic" një tjetër mbiemër" i kënduar", për fjalën " endem" përdor " bredh pa qëllim" etj.

Fjalët kyçe janë elemente më të spikatura të variantit shqip, ku mjafton të përmendim faktin se një fjalë e vetme e origjinalit e përdorur me kuptimin literal "vendlindje", përmes sinonimisë Noli e ka përcjellë njëherë si " atdhe" më pas "mëmëdhe, " madje në një rast edhe " shtëpi".

Edhe figurat e mendimit, si metafora dhe metonimia, ndonëse më pak të përdorura, vihen në funksion të plotë të shprehjes së mendimit, duke bërë që shumë fjalë, të thjeshta në dukje, të bartin në të njëjtën kohë vlera të mëdha shprehëse në figura të tilla si " shtëpia" për atdheun" e më pas " të gjallët" " të parët" " të vdekurit" etj. Nxjerrja në pah e vlerave leksikore dhe organizimit të brendshëm të vargut është qëllimi kryesor i shqipëruesit dhe, Noli ky mjeshtër i madh i fjalës, e shfrytëzon shqipen sepse e njeh mirë atë, i di instrumentet, strukturat leksikore e morfo-sintaksore, sikundër dhe mjetet e pafundme stilistikore

Dhe duke qenë mjeshtër jo vetëm "i penës", por edhe i "limës", siç e kanë cilësuar shumë herë, di të operojë me fjalë dhe vargun si rrallëkush tjetër. Ndër figurat e tjera mund të përmendim epitetin dhe përsëritjen, dy figura të imazhit, të përqendruara jo pa qëllim në strofën e fundit, aty ku rritet pesha emocionale dhe ku përmbyllet përcjellja e mesazhit së poezisë.

Një çështje tjetër e debatuar në teorinë e përkthimit është se çfarë ruhet dhe çfarë humbet gjatë procesit të përkthimit. Noli ka zgjedhur t'i qëndrojë besnik strofës dhe vargut edhe nga pikëpamja numerike. Lloji i rimës së përdorur është i njëjtë me atë të origjinalit, poezia na shfaqet nga pikëpamja strukturore si një e tërë, pa ndarje strofash në original, ndërkohë që Noli zgjedh të veçojë strofën e fundit në variantin e tij, pikërisht aty ku duket se thirrja e dëshpëruar e poetit bëhet më e fortë dhe ku, padyshim në vend të " Skotlandë" Noli thërret "Shqipëri", sikurse ka bërë edhe më shqipërimin e veprave të tjera, siç është "Don Kishoti i Mançës" së Servantesit, ku ai i aktualizon vendgjarjet me emërvende nga Shqipëria. Asgjë nuk ka humbur nga pikëpamja statistikore, sikundër dhe nga pikëpamja kuptimore apo gjuhësore.

Kur R. Frost shprehej se "poezia është ajo çka humb në përkthim" sigurisht që nuk e kishte fjalën për një poezi si kjo që ne morëm në shqyrtim, sepse në fakt nuk ndodh rëndom që poezia origjinale të fitojë kaq shumë vlera në përkthim, me përjashtim të rasteve kur krijuesi është aq mjeshtër dhe aq brilant sa ç'ishte Noli ynë.

Shtojca

Nga teksti origjinal i V. Skotit

Breathes there the man, with soul so dead,
Who never to himself hath said,
This is my own, my native land!
Whose heart hath ne'er within him burn'd,
As home his footsteps he hath turn'd
From wandering on a foreign strand!
If such there breathe, go, mark him well;
For him no Minstrel raptures swell;
High though his titles, proud his name,
Boundless his wealth as wish can claim;
Despite those titles, power, and pelf,
The wretch, concentred all in self,
Living, shall forfeit fair renown,
And, doubly dying, shall go down
To the vile dust, from whence he sprung,
Unwept, unhonour'd, and unsung.

Përkthimi i Fan Nolit

ATDHEU IM (My native land)
A rron njeri në botë me shpirt të vdekur
Cili kurrë veten s'e ka pyetur?
Është ky vënt për mua mëmëdheu im
E cilit fare s'i është djegur zemra
Që kur la shtëpinë pa iu thyer këmba
Duke bredhur në vënt të huaj pa qëllim?
Shënoje mirë, një njeri i tillë rron:
Për të këngë dhe lodrë nuk tingëllon,
Pastaj shumë tituj, dhe nam të lavdëruar,
Dhe vlerë sa dëshira i pat kërkuar
Me gjithë ofiqet, fuqi dhe pasuri
Katrani nuk pyet për asnjë njeri.
Të gjallët pa dyshim dorë prej tij heqin,
Dhe, dyfish të vdekur, duhet ta zbresin
Në pëlhurë prej kujt dolli i krijuar,
Pa qarë, pa nderuar dhe pa kënduar.

ARJAN TH. KALLÇO

NOLI, MË SHUMË SE PËRKTHYES, ËSHTË SHQIPËRUES I ZOTI

Është një nga tezat më interesante që lidhen me përkthimin dhe që ka kohë që po diskutohet jo vetëm në Shqipëri dhe veçanërisht për Nolin. Noli përktheu apo shqipëroi? Përktheu dhe shqipëroi do të ishte mendimi më i drejtë dhe teza më e pranueshme në larminë e vlerave që autori pruri. Përkthimi, si një nga dukuritë më të natyrshme në botë, kultura që të njihet duhet të përkthehet, nuk është thjesht një veprimtari mekanike që një vepër ta sjell në gjuhën amtare, por është një veprimtari tepër e komplikuar që nënkupton njohje të thella gjuhësore, kulturore, traditat dhe zakonet e një kombi që më pas t'i paraqitësh origjinale në gjuhën tënde. "Traduttore e' traditore" një maksimë që nuk mund të hidhet poshtë apo anashkalohet, pasi nuk ka dhe nuk mund të ketë kurrë një përkthim fjalë për fjalë. Nëse do të vepronim kështu, atëherë do të fshihnim dallimet thelbësore kulturore midis popujve dhe shumë shprehje, fraza nuk do të na jepnin kurrë kuptimin e saktë. A e njihte Noli traditën e madhe të përkthimit? A e mbajti parsaysh atë apo e braktisi për ideale më të mëdha? Një njeri me kulturë të gjerë si Noli nuk mund të mos i njihte shkollat e përkthimit, por Noli parapëlqeu më shumë sesa përkthimin e thatë, të pashpirt dhe të ngurtë, tingëllimin shqip të letërsisë së mrekullueshme që kishin krijuar mjeshtërat e mëdhenj të penës.

Përkthimi është arti i vërtetë i shndërrimit të një shpirti të panjohur, edhe i një kombi të veçantë, që gërshetohet në mënyrë komplekse, në një vepër tjetër asnjëherë të ngjashme me shpirt universal.

(**Autori)**

I

1. Përkthimi është art i vërtetë

Këto janë fjalët që mësuam ditën e parë në leksionin e përkthimit me përkthyesin e njohur prof. Shpëtim Çuçka. Qysh atëherë kjo fjalë me dimensione dhe kuptime të ngushta në dukje, duhej të ishte një akt i thjeshtë i kthimit të një teksti letrar në një gjuhë tjetër, në vite mori të tjera dimensione, hapësira dhe kuptime të gjera, pikërisht kur filloi të bëhet pjesë e pandarë e punës së përditshme, që më pas u shndërrua në një pasion të vërtetë. Si të gjitha artet edhe përkthimi është tepër i vështirë. Ai kërkon disa cilësi tek përkthyesi: njohje të gjera të të dyja gjuhëve, njohjen e kulturave dhe traditave, por mendoj se një prej kërkesave më të theksuara është vullneti që duhet të tregojë secili përkthyes të sjellë vepra të rëndësishme të letërsisë botërore, duke u ushtruar çdo ditë me të. Po t'i refrerohemi Nolit, të gjitha veprat që ai përktheu apo shqipëroi janë vërtet kryevepra të saj. Mjafton të përmendim poemën "Skënderbeu" të Longfellout, tragjeditë "Otello", "Hamlet", "Makbethi", "Jul Qezari", të Shekspirit, Dramat "Armiku i popullit" dhe "Zonja Igra e Ostronit" të Ibsenit; "Rubairat" e Omar Khajamit, "Don Kishoti i Mançes" i Servantesit ; "Kasollja" e Ibanjezit.

Përkthim të jetë një proces i vështirë apo i lehtë? Përgjigjia është kategorike po, por më i vështiri ka qënë dhe mbetet përkthimi letrar dhe pikërisht poezia klasike që mbart në vetvete rregulla strikte në rimë dhe në vargje, për të mos folur për elemente brenda vetë vargut. Gjithkush ka përkthyer apo ka guxuar të përkthejë në hapat e parë është ndeshur me shumë vështirësi dhe pengesa të cilat janë të kuptueshme. Edhe Noli nuk mund të mos i ketë patur këto probleme fillestare, madje sa më shumë hynte thellë në kthetrat e përkthimit, aq më mirë dhe më bukur i tingëllonin përkthimet dhe shqipërimet në gjuhën shqipe. Ndodh shpesh që edhe pse ke përkthyer shumë vargje apo faqe librash letërsie, bindesh se ka edhe një lloj tjetër përkthimi që bëhet njësh me gjuhën në të cilën po e sjell veprën, ka një përshtatje tepër fine, arrin deri aty sa ia ndryshon fjalët dhe kuptimin që mbart në gjuhën origjinale. E di se e ke tradhtuar disi veprën origjinale, ndoshta dikush mendon se ke kryer një sakrilegj, por i ke dhënë asaj një vlerë tjetër, një kuptim të ri, një tingëllim gati magjik, hyjnor në gjuhën mëmë. I ke dhënë statusin dhe pasaportën e kulturës dhe ndjenjave tipike të vendit, në rastin tonë shqiptare, për më tepër, për vetë rrethanat në të cilat jetoi dhe punoi Noli. Unë mendoj se nuk është një tradhti me synime poshtëruese për veprën, por është një tradhti e ëmbël dhe jo e hidhur, e dashur dhe jo e mërzitshme, e pranueshme dhe jo përbuzëse, është shqipërim. Dhe të arrish në një thelb të tillë nuk është e lehtë, por është delikate dhe tepër e përpunuar, pra është një shqipërim i kërkuar që mund të lindë natyrshëm tek autori që i futet një pune të tillë. A na duhen të tilla përkthime? Para se t'i japim përgjigje kësaj pyetje që më shumë se naivitet nuk përmban gjë tjetër, do të desha të sillja disa maksima që lidhen me përcaktimin që përkthyes dhe autorë të ndryshëm i kanë dhënë konceptit të përkthimit. Në to nuk është vetëm një mendim i cekët i një amatori, por është e gjithë përvoja e grumbulluar në vite, është natyra e përkthimit nga gjuha në të cilën kanë shkruar dhe versionet e shumta të përkthyera në shumë vende. Krahasimet më pas nxjerrin në pah dallimet midis tyre, që nuk janë dallime vetëm gjuhësore, por brenda tyre është shpirti i autorit, pas së cilit ndriçon kultura e tij kombëtare në të gjithë hapësirën kohore, e mbrujtur thellësisht brez pas brezi. Prandaj përkthimi nuk është lehtë për t'u kryer, se duhet kohë që të depërtosh në fijet e panumërta të shpirtit.

a) Përkthimi është si gruaja. Kur janë të bukura, nuk janë besnike, kur janë besnike nuk janë të bukura. ***Carl Bertrand***

b) Përkthimet nëse duhet të jenë të bukura, duhet të jenë jobesnike. Përse? Sepse është përkthyes i keq ai që duke dashur të jetë shumë besnik me tekstin, përdor një gjuhë të shtrembër dhe që e besdis lexuesin…Besnikëri ndaj shpirtit më shumë sesa gërmave. ***Luciano Bianciardi***

c) Origjinali është jobesnik ndaj përkthimit. ***Jorge Luis Borges***

d) Përkthimi është në rastin më të mirë një jehonë. ***George Borroë***

e) Kush nuk mund të shkruajë, përkthen. ***John Denham***

Shtrojmë pyetjen: Përse na duhet përkthimi? A nevojitet në një botë globale kur gjuha angleze duket se po mbulon botën? Këtyre pyetjeve duhet t'u japim gjithmonë përgjigjen se përkthimi nuk është një luks për disa njerëz, por është një detyrim

njerëzor brenda kufijve të mundësië dhe aftësisë për ta realizuar atë. Detyrimi rrjedh nga vetë natyra e shoqërisë njerëzore, pasi njerëzit kudo që janë komunikojnë mes tyre dhe gjatë këtij komunikimi transmetohen vlerat më të mira që një komb ka krijuar gjatë ekzistencës së vet, vlera të cilat janë të ngjizura dukshëm tek kultura. Pas autorit të librit dhe historisë që na rrëfen, përkthimi duhet të konsiderohet një rishkrim i dytë i veprës në një gjuhë tjetër dhe në themel qëndron puna e madhe e përkthyesit. Sigurisht merita kryesore i takon autorit që e shkruan veprën, por një meritë po aq e rëndësishme i takon edhe përkthyesit që na e sjell në gjuhën tonë. Të përkthesh nga një gjuhë në një tjetër do të thotë edhe pranosh faktin se jo gjithçka do të vijë gërmë për gërmë e fjalë për fjalë. Gjuhët sado të ngjajnë, asnjëherë nuk janë të njëjta, prandaj edhe përkthimi ka në vetvete një shmangie apo një lloj tradhtie që në të shumtën e rasteve është subjektive dhe që lidhet drejtpëdrejt me përkthyesin. Noli ynë i pati rrokur të gjitha këto ide dhe filozofi të jetës shqiptare, prandaj na dhuroi në shqip ato perla që sot, pas shumë dekadash, na mahnisin.

Ja shembulli më tipik i një përkthimi nolian ku vargu ritmon me ngjyrime emocionale galopimi nën ritme dhe tonalitete gjithmonë ngjitëse:

Korbi – Edgar Allan Poe

Një mesnate të bezdisur
Tek këndonja i zalisur
Disa përralla dhe magjira
Të një shkence të harruar,
Tek dermitnja i kapitur
Befas vjen një e trokitur,
Me ngadalë e goditur
Përmbi derë t' odës sime.
"Dikush është, thashë, jashtë
Që troket mi derën time –…

(*përkthyer në shqip nga Fan Noli, botuar ne Adriatic Review/ Rivista Adriatike", viti 1918*)

2. Pak histori nga tradita botërore

Mendoni për një çast veprën e Dantes, Komedia Hyjnore apo të Gëtes që janë me mijëra vargje, bile tek Dantja strukturën tercine të poemës. A do të ishte e mundur që të ruhet e gjitha nga përkthimi në një gjuhë tjetër? Të gjithë njohësit e gjuhës italiane apo gjermane mund ta bëjnë një provë vetëm me strofat e para dhe do të shohin se vargu nuk do të jetë i ngjashëm në rimë dhe në fjalë: Nel mezzo del cammin della nostra vita…Dikur një studim apo provë me nxënës të gjuhëve të huaja, nxori në pah shumëllojshmërinë e varianteve të përkthimit në gjuhën shqipe, jo nga specialistë të përkthimit, por nga nxënës që po e mësonin italishten. Dikush e solli të përkthyer, duke i qëndruar besnik vargjeve të Dantes; dikush tjetër zbuloi se jeta jonë mund të jetë në mesin e saj, në gjysmën e saj, por pati edhe variante si në km e 36 të rrugës, që natyrisht është një largim nga vargjet, por në anën figurative mbart një theks tepër të bukur duke e krahasuar jetën me kilometra. Kjo don të thotë se përkthyesi nxënës ka

kapur një shkallë tjetër të përkthimit, atë të intuitës së varianteve. Më shumë se variante mendoj se hyjnë në sferën e krijimit apo rikrijimit të vargjeve në kuptimin e tyre krejt të ndryshëm nga origjinali. A do t'i quanim këto përkthime të pavlefshme? Kurrsesi, pasi është një prurje sasiore e varianteve që të ndihmon të përzgjedhësh prej tyre atë që është më afër origjinalit ose më i arrirë në kompleksitetin e veprës.

3. Roli i përkthyesit në procesin e përkthimit

Ka patur debate dhe ide që lidhen me rolin e padiskutueshëm të përkthyesit në këtë veprimtari dhe, ashtu si kudo, faktori njeri është i padiskutuar. Nëse do të pranojmë faktin që makineritë krijojen nga njeriu që t'i shërbejnë atij, atëherë duhet të pranojmë se një proces i tillë duhet t'i besohet njeriut dhe vetëm atij. Zhvillimet e viteve të fundit në teknologji kanë sjellë një revolucion të vërtetë edhe në përkthim, sidomos në njësitë e vogla të ligjërimit deri tek fjala, por asnjëherë nuk mund të shkojmë më tej dhe të guxohet në përkthime letrare, pasi do të ishte një punë e kotë dhe kohë e çmuar e humbur. Të përkthesh prozën pra romanin, tregimin apo edhe gjini më të vogla është një punë disi më e lehtë në krahasim me poezinë. Diskutimet dhe debatet e zhvilluara në takime apo festivale poezish, brenda dhe jashtë vendit, thuhet se poezia nuk është një gjini që mund të përkthehet nga kushdo. Le të mos shkojmë më tutje se shekulli i kaluar me Klasicizmin e Karduçit dhe poezinë e tij gati të papërkthyer në shqip. A do të pranonim një përkthim Nolian apo do të kërkonim të zbatoheshin rregullat strikte të përkthimit? Më mirë të kishim një Nol dhe poezi që të tingëllonin shqip, pra shqipërim të poezive, sesa një poezi të përkthyer keq dhe pa kurrëfare shpirti karduçian.

Cili duhet të jetë përkthyesi? Kësaj pyetje edhe në takimin e fundit mes poetësh nga bota në Kongresin e Pegasianëve në Tiranë një përkthyes turk i dha përgjigjen që e kemi mbështetur të gjithë se është më mirë që përkthyesi të jetë poet, duke e konsideruar punën më të mirë dhe më të besueshme. Por edhe këtu ka kurthe që mund të na detyrojnë të mos u besojmë, sepse jo të gjithë poetët janë përkthyes apo njohës të mirë të gjuhëve nga përkthejnë. Të njohësh një gjuhë nuk do të thotë se je poet i gatshëm të përkthesh çdo formë poezie. Problemi bëhet më kompleks nëse përkthyesi nuk njeh kulturën dhe letërsinë e atij vendi apo mfshehtësinë të vetë fjalëve. Është e kuptueshme se poezia e një poeti nuk mund të rikrijohet në një gjuhë tjetër, sepse rikrijimi do të thotë ta rishkruash në gjuhën tënde. Por kur përkthyesi është poet dhe njohës i mirë i gjuhës, rikrijimin e saj e shfaq me një variant tjetër në një gjuhë tjetër. Libri im që doli dy vjet më parë sillte këtë risi, atë të shkruarit të poezisë, duke e menduar në gjuhën amtare dhe një herë në gjuhën që njeh, pa i ndryshuar titullin poezisë apo kuptimin e saj. Po sjell rubairën e parë të Nolit në shqip dhe variantin anglez të Fitzgeraldit, si dhe një prej poezive të mia për të parë qartë, sesi tingëllon në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze e italiane poezia:

Natën kur flinja, më tha shpirti: "Pi! Në gjumë dhe në Varr s'ka lumëri; Ngrehu! Sa rron, zbras Kupa dhe puth… Ke shekuj që të flesh në qetësi".

Awake! for Morning in the Boël of Night
Has flung the Stone that puts the Stars to Flight
And Lo! the Hunter of the East has caught
The Sultan's Turret in a Noose of Light.

Dashuri të tjera do kërkoj	Ad altri amori busserei
Për të jetuar mijëra jetë,	Per vivere altre mille vite,
Shpirti pa brenga s'jeton	L'anima senza crucci non vive
Ashtu di deti pa lumenjtë.	Come l'amore senza lite.

4. Ecuria e mendimit botëror mbi përkthimin

a) Më vitet '20 janë shprehur disa reflektime nga estetisti Italian, Kroçe, lidhur me përkthimin në një rrafsh filozofik dhe e quan se është çdo akt gjuhësor i paprecedentë. E papërkthyeshme është jeta e ligjërimit, pamundësia e natyrës së përkthimit. çdo përkthim e zvogëlon dhe e deformon origjnalin, sepse është krijim i një shprehje të re, që lindi nga shkrirja e origjinales me përshtypjet e përkthyesit: të përkthesh do të thotë të akumulosh papërsëritshmëri. Përkthimi i veprave poetike dhe letrare konfigurohen si mjete të mësimit të veprave origjinale, besnike të këqija apo si vepra të përkryera, por të kërkuara nga një shpirt tjetër, besnike të mira.

b) Benxhamin shkroi një tekst lidhur me detyrën e përkthyesit ku thotë se duhet ta inkuadrojmë përkthimin si një gjini të veçantë dhe autonome, midis filozofisë dhe veprës letrare. I rëndësishëm nuk është komunikimi, por thelbi i veprës dhe detyra e përkthimit është ta kapë këtë thelb dhe ta bëjë të mbijetojë. Tek mbijetesa që nuk do të quhej e tillë, nëse nuk do të ndryshonte dhe rinovohej; origjinalja transformohet. Përkthimi është shfaqje e lidhjes intime midis gjuhëve, duhet ta çlirojë gjuhën e burgosur në vepër dhe detyra është metafizike. Përkthimi duhet të krijojë një lidhje midis gjuhëve si copat e një vazoje të thyer që duhet ngjitur.

c) Vitet '50 - '60 përdoret termi shkenca e përkthimit. Studiuesit u përpoqën që të krijonin një dekalog për një përkthyes të mire, por që bazohen tek modelet matematikore dhe tek Çomski për një përkthim të përsosur. Prioritet do të kishin tekstet shkencore dhe jo tekstet letrare, pasi ishin kompleks. Gjuhëtar i njohur De Sosyr mendonte se duhen përkthyer fjalët e veçanta dhe jo të marra në kontekste.

d) Në vitet '70 - '80 studiuesit e braktisin teorinë e mëparshme dhe i mëshojnë teorisë së përkthimit. Kështu e braktisën idenë e saktësisë që lidhet me shkencën dhe e zëvendësuan me studime teoriko-përshkruese, duke përshkruar faktorët dhe elemente që karakterizojnë përkthimin. Vëmendja tashmë i kushtohet tekstit letrar.

e) Në vitet '80 u krijua termi "translation studies", një fushë e gjerë ndërdisiplinore, pra jo me rregulla apo instruksione praktike lidhur me përkthimin, por duke u nisur nga teksti i përkthyer. Përkthimi nuk është më një process mekanik, por krijues dhe jo për të gjithë.

f) Në vitet '90 marrin përparësi faktorët ideologjikë dhe kulturorë dhe problemet që lindin me lidhjet në disa rrethana mes kulturave më të largëta dhe heterogjene. Në këtë diskutim morën pjesë studiues perëndimorë. Lindi termi cultural studies, që në shpjegimin e vet bazohet tek hetimi i përkthimit në kulturat dominuese dhe të dominuara, si edhe raportet përkthim-gjini, përkthim ideologji dhe përkthim – subjektivitet.

II

1. A ka gabuar Nolin në përkthimin e Servantesit?

Nuk ka libra moralë dhe imoralë, siç beson shumica. Librat janë shkruar mirë ose keq. Kjo është e gjitha…

Oscar Wilde

Mendimet e disa studiuesve shqiptarë pas viteve ’90 theksojnë faktin se disa prej veprave të përkthyera nga Noli mbartin në vetvete ide dhe natyra që nuk janë reale, nëse merret dhe lexohet vepra, pra mesazhet janë krejt të ndryshëm nga ato që autori ka dashur të thotë në veprën origjinale. Noli në këtë pikë mendoj se nuk ka gabuar, por do të guxoja të thosha se ka bërë një punë krijuese, duke na e sjellë veprën në versionin shqiptar. E ku qëndron problemi? Mos vallë ka qëllime të tjera tek këto ide të shprehura sot? Letërsia nuk është pronë e pushteteve apo e një grupi të caktuar njerëzish, ajo është pasqyruesja më e saktë e nocioneve të kohës.

Nëse dikush ka dëshirë që një roman apo vepër ta ambientojë në një vend tjetër nuk është një gabim, por është një meritë, pasi ta sjell realitetin shqiptar në fokus dhe ai realitet që tashmë e njohim përmes brezave, ishte i njëjti apo më keq, sesa tek vepra e Servantesit. Nëse dikush nuk mund ta pranojë këtë fakt është një mendim i tij personal, pasi shumë mirë mund ta lexojë në një variant tjetër romanin apo ta lexojë në gjuhën që e ka krijuar autori. Ose më tej, le t’i futet punës dhe ta përkthejë në gjuhën shqipe sipas origjinalit. Por që të paragjykohet një përkthyes si Noli se, përse e ambientoi në Shqipëri, duhet të kthehemi prapa në kohë, kur Noli ishte i vetëm përballë ushtrive që e rikthyen Zogun në pushtet dhe ushtrisë së tarafeve të tij. Shkrimtarët janë idealistët dhe humanistët më të mëdhenj të kohërave, prandaj nuk duhet të çuditemi me ëndrrat e tyre për një botë sa më të drejtë. Kushdo mund të shkruajë një vepër edhe pse është i mllefosur, bile veprat e mëdha lindin pikërisht nga rebelimi. A nuk ishte Dantja një rebel që mori dhe syrgjynin në përplasjet gulfët e zinj dhe të bardhë? Po shumë të tjerë që historia e letërsisë na e tregon me fakte të pakundërshtueshme?

III

1. A duhen ribërë përkthimet e klasikëve? Po modeli Noli?

Një tjetër mendim i shprehur edhe në shtypin shqiptar që lidhet drejtpërdrejt me Nolin, hedh idenë e ripërkthimit të veprave klasike, pasi këto vepra të tij kanë krijuar një precedent duke e keqorientuar lexuesin shqiptar në lidhje me simbolikën e tyre. Në historinë e përkthimeve botërore ka shumë raste të përkthimit të një vepre nga shumë përkthyes. Tek ne, duke patur një sferë të ngushtë të përkthyesve të talentuar, një vepër e përkthyer nga autorët më në zë, ka krijuar një precedent të një përkthimi të vetëm. Por mjafton të shohim disa nga autorët më në zë italianë, grekë, francezë, gjermanë, amerikanë dhe do të ndodhemi para një fakti tepër kokëfortë, ai i shumë varianteve të përkthimit. Përkthimi, duke qënë një veprimtari subjektive apo e porositur nga shtëpitë botuese, e ka pjesë të vetën mundësinë e përkthimit në variante të ndryshme. P. sh Kavafisi është përkthyer 27 herë në gjuhën angleze dhe në këtë

numër të konsiderueshëm të përkthimeve nuk ka asgjë të keqe. E keja është sesi janë përkthyer këto poezi, d. m. th nga gjuha origjinale apo janë përkthime të përkthimeve në gjuhë të tjera. Në rastin e origjinalit, një variant më shumë është një pasuri, pasi hap premisa për studime të mëtjeshme të autorit dhe të poezisë së tij. Krahasimi se cili përkthim është më i miri nuk nënkupton qënien sa më besnik, por a janë zbatuar disa nga parametrat e teorisë së përkthimit. Edhe sikur të mos jenë zbatuar, e rëndësishme është që vepra të ketë kuptim dhe të tingëllojë bukur në gjuhën që sillet. Natyrisht një trasformim radikal i vargjeve nuk hyn në sferën e krahasimit. Pra, nëse Noli ka dhënë një variant të pranueshëm të përkthimit të një vepre, atëherë do të na duhet vetëm të marrim edhe variantet e tjerë dhe t'i ballafaqojmë mes tyre për të zgjedhur më të përshtatshmin. Simbolika është një element që nuk duhet të na shqetësojë shumë pasi ka karakter universal dhe protagonistët e veprave janë shembuj që ndeshen në çdo shoqëri, pasi në çdo kohë ka dhe do të ketë njerëz të mirë dhe të ligj. A thua se sot të gjithë janë të kulluar? E mira dhe e keqja janë të destinuara të mbijetojnë, përderisa drejtësia mbetet një synim që kurrë nuk u arrit, në asnjë shoqëri, bile dhe të sotmet moderne. Nëse Noli zgjodhi veprën e Servantesit për të fshikulluar disa fenomene shqiptare, ndoshta rolin e Sanços ia atribuonte dikujt që përpiqej më kot të ndryshonte gjërat, por mund të mendojmë se edhe vetë autori mund të fshihet pas tij, meqë reaksioni në Shqipëri ishte tepër i madh ndaj tij. Të dy armiqtë, edhe pse shqiptarë, kishin një urrejtje fatale ndaj njëri-tjetrit, si pasojë e një grushti që përmbysi ëndrrat e nolianëve dhe të vetë popullit shqiptar. Por ky fakt nuk mund të na çojë gjithsesi të vendosim shenjën e barazimit midis tyre: një njeri i etur për pushtet që nuk mundi kurrë të ngrihej në lartësinë e Nolit. A nuk është kjo një shenjë e dukshme e dueleve makbethiane dhe e një simbolike më karakter të përjetshëm?

Noli është një prej përkthyesve më të mëdhenj jo vetëm shqiptar, por edhe në botë, pasi kryeveprat botërore i bëri të këndonin shqip. Edhe pse ka mendime të ndryshme për dallimin përkthim-shqipërim, për mendimin tim Noli mbetet një shqipërues shumë i mirë i shkrimtarëve klasikë që sot janë në majat e letërsisë. Vargjet e përkthyera prej tij kanë në vetvete një forcë të tillë që gëlon brenda shpirtit, sikur ato të ishin krijuar enkas në gjuhën shqipe. Brilantet në penën e Nolit nuk do të mund të guxojë t'i anatemojë asnjë kritik, i drejtë dhe i paanshëm, ashtu si kolosin dhe gjeniun shqiptar.

ARTA XHIKA

NOLI NË OPTIKËN KRITIKE TË KOLIQIT

Në përpjekjen e saj për përvijim të tipareve historiko-letrare dhe kanonizim të figurave qendrore dhe periferike, kritika shqiptare ka njohur dhe mospërputhje të forta në lidhje me disa figura, ndriçimi i të cilave është kushtëzuar nga fokusimi përkatës në çështje të formës apo të përmbajtjes.

Një prej tyre është figura e Nolit, përmasa poetike e të cilit është bërë objekt diskutimi me kah të kundërt:

Noli "Anté i literaturës sonë", "lis i moçëm e plot gdhënj: lis i vetëmuar, po me rrënjë ngulur mirë në të thellat e dheut. ", do të shprehet Çabej, i cili veç çështjes së domethënies së tekstit ndjeni nevojën të prekë në mënyrë të veçantë çështjen e gjuhës së Nolit "më vete në letërsinë shqiptare": "Fan Noli si për formimin e tij poetik si për shprehjen gjuhësore qëndron më vete në literaturën shqiptare. […] E këtillë mbetet edhe gjuha e tij: Në këtë poezi shihet sa mund të jetë gjuha shqipe e ashpër e e vrazhdë, dhe e fortë në ashpërsinë e saj". [483]

Karakteri problematik i mospërputhjes mes elemente që i përkasin çështjeve të përmbajtjes dhe elemente të formës e gjejmë të përmbledhur në një shkrim të Ernest Koliqit, 1965.

Fillimisht ai vendos Nolin përkrah tre poetëvë më të mëdhenj shqiptarë, romantikëve Jeronim de Rada, Naim Frashëri dhe Gjergj Fishta, vlerësim që e klasifikon veprën e Nolit në veprat me funksion patriotik, rilindës dhe pathos edukativ.

Noli edukator dhe patriot është një nga përmasat ngritur qysh herët nga përkrahësit e poetikës së tij siç dëshmon artikulli klasik i Kutelit (1943).

Vetëm një vit më vonë se Kuteli, Arshi Pipa i ri, në revistën "Kritika" flet për Nolin si për një "Bari të popullit" dhe për artin e tij si për një art me qëllime praktike, "për me edukue popullin, tue ndezë ndjenjën kombtare"[484].

Pavarësisht mungesës së një deklarate të drejtpërdrejtë për artin e Nolit, vërehet në mendimin e Pipës prirja për ta klasifikuar poezinë e Nolit në një stil me funksion didaskalik, apo siç e quan ndryshe ai: "arti për edukatë"[485]

Në një punim tjetër te revista "Kritika", me rastin e botimit të vëllimit "Mall e brengë", Pipa do ta shprehë më hapur domethënien e ketij vlerësimi.

Duke iu referuar specifikisht toneve superlative të Kutelit në këtë parathënie, ai shpreh mendimin se Noli nuk ishte poeti i përmasave që Kuteli ndërtoi në parathënien e tij: "Gjatë gati një gjysë shekulli eksperiencë letrare, *Noli, po të kishte qenë poet*, duhej të na kishte dhanë nji vepër ku të dukej shtampa e gjeniut tij krijues".

---

[483] Eqrem Çabej, "Fan Noli ynë. Studime gjuhësorë V, Rilindja, Prishtinë 1975, f. 167-168.

[484] Arshi Pipa, *Bariu i popullit* në *Kritika*, Qershor 1944 fq. 121

[485] Po aty.

Madje punimi i Pipës, kritik ndaj qasjes kritike të Kutelit, shkon deri në ironizim të titullit "Mall e brengë" të vëllimit që, më shumë sesa nolian, është kutelian: "Ndoshta se «malli» asht i Kutelit dhe «brenga» e Nolit? "[486]

Mendimi i Koliqit, në artikullin e cituar do të shkojë në të njëjtin drejtim me Pipën kur do të operojë me kategori që e ndajnë çështjen e funksionit edukues të veprës nga problemi i gjuhës. Sipas tij nuk është se Nolit i mungoi frymëzimi letrar, por Noli nuk mundi të krijojë kryevepra sepse: "i mungoi njoftja e frymës së vendit dhe zotnimi i plotë i gjuhës "[487].

Madje realizimin formal të shprehjes artistike Koliqi, e sheh vetëm në elegjitë "*Himni i flamurit", "Syrgyn-vdekur"* dhe *"Shpell e Dragobisë"*, lirika të cilat sipas tij janë më të arrira për shkak se Noli i njihte të dy heronjtë dhe zbuloi në ta"fisnikin e njimendët të gjakut t'onë"[488].

Këto tre lirika, siç i quan ai, në pikëpamje të të shprehurit, afrojnë më shumë me gjuhën shqipe, tipar që Nolit i mungonte për shkak të moszotërimit të plotë të saj. "Vjerrsha fluturuese" janë për Koliqin lirikat e sipërpërmendura, lirika me të cilat Noli mund të krahasohet me tre poetët e mëdhenj shqiptarë, pasi janë ato të paktat herë kur ai i afrohet të shprehurit shqip. [489]

Duket se mendimi i Pipës dhe i Kutelit shkon paralel për këto tre poezi të Nolit. Sipas tij, dy elegjitë dhe sidomos "Himni i flamurit", kanë lëndë shqiptare dhe gjuha e Nolit është më afër shqipes.

Ndërsa duket të shkojnë në të njëjtën linjë mendimet e kritikëve në lidhje me arritjet stilistikore të teksteve të përkthyera prej Nolit.

Kuteli i qëndron mendimit të tij për një Nol gjenial jo vetëm në poezi, por edhe në përkthime dhe madje shkon më tej duke u shprehur për vlerën oriogjinale të këtyre përkthimeve-rikrijime që tingëllojnë shqip.

Pipa, ndonëse e vlerëson në përgjithësi stilin në përkthim të Nolit, duke u shprehur se "shumica e përkthimeve të Nolit janë njimend madhështore", ka rezervat e tij duke u shprehur se jo "gjithkund" në përkthime gjenden ato cilësi stili[490].

Gjithashtu ai kritikon Kutelin që i ka kushtuar shumë pak faqe kësaj fushe ku mund të hetohet më mirë personaliteti i Nolit.

Koliqi, edhe në këtë aspekt të personalitetit të Nolit përcjell kundërthëniet e mendimeve të sipërcituara. Ai nga njëra anë shprehet për stil të veçantë të Nolit në përkthime: "E si do t'ishte stili i tij në përpjekjet tregimtare na e tregon lloji i kryeveprave qi Ai shijonte e zgjidhte për t'i përkëthye shqip: stil ku shpotija (raillerie) e hollë thellësisht njerëzore e Cervante-s do të krypej në skepticizmin e butë e shpirtndriçues t'Omar Khajamit e do të ngjyrohej në realizimin zhuritun të Blasco Ibanez-it"[491].

---

[486] Po aty

[487] Ernest Koliqi, *Emzot Theofan S. Noli* në *Shejzat,* 1965, fq. 79

[488] Po aty.

[489] Po aty.

[490] Arshi Pipa, bur. i cit.

[491] Po aty.

Nga ana tjetër ai i rikthehet edhe në këtë fushë pengesave që nuk e lejuan Nolin që të krijonte kryevepa: mosnjohjes së frymës shqiptare dhe moszotërimit të plotë të gjuhës: "Gjuhën (d. m. th. fjalët, skajet, thanjet shqipe) qi përdorë Noli shum kush e ka shoshshlue (kritikue) me ashpërsi tue e quejtë gjuhë mushke, nji mishmash fjalësh prej gjuhësh të ndryshme, nji çorbë me turli shprehjesh. Deri diku kjo padi i avitet së vërtetës"[492]

Klasifikimi historiko-letrar i Koliqit, si gjithnjë i thukët dhe larg ekstremeve, ka rëndësi për përfshirjen e mendimeve edhe kundërshtuese midis tyre por që kanë rëndësi për zbulimin më mirë të përmasave artistike të një vepre që është përmbajtje, por njëkohësisht është dhe shprehje.

Klasifikimi dhe studimi i Nolit në rrafsh universitar dhe më poshtë ka ndjekur më tepër linjën kuteliane të glorifikimit të poezisë dhe veprës së Nolit. Zakonisht është lënë në heshtje mendimi i kundërt i Pipës i cili: "bash me Kutelin" do ta gjejë Nolin "gazetar, theolog, orator, dramaturg, historian, shqipëronjës, kritik letrar, kompozitor-*por jo poet*". [493]

Përfundimet e Koliqt në të njëjtën linjë me Pipën, njëzet vjet më vonë, janë tregues të nevojës së problematizmit të çështjeve që kanë të bëjnë me tekstin, pa frikën se i zvogëlojmë madhështinë njërës prej figurave më të rëndësishme të historisë së letërsisë shqiptare.

[492] Ernest Koliqi, bur. i cit...

[493] Arshi Pipa, *F. S. Noli"Mall e brengë". Vështrim kritik prej Mitrush Kutelit* në *Kritika*, Tiranë 1943 fq. 29

EDLIRA CERKEZI
EVIS CELO
GLADIOLA DURMISHI(ELEZI)

MESAZHET E NOLIT NË PUBLICISTIKËN SHQIPTARE DHE ASPIRATAT ATDHETARE

Në shumë pikëpamje Fan Noli është një prej shëmbëlltyrave më interesante të letërsisë në veçanti, kurse të kulturës dhe historisë sonë të re në përgithësi. Prirjen e tij të rrallë, kulturën e gjerë dhe jetën e gjatë ua ka kushtuar fushave të ndryshme të krijimtarisë, si veprimtari artistike apo shkencore, si me veprimtari politike ose fetare. Ai ka hyrë në historinë e kulturës shqiptare jo vetëm me krijimet e tij poetike, por edhe me publicistikën e pasur dhe plot mendime të thella e të rëndësishme që na ka lënë. Ai është një nga publicistët më aktivë të periudhës së luftërave të popullit shqiptar në çlirim nga zgjedha e huaj dhe zhvillimin e lirë demokratik të vendit.

Noli shkroi me dhjetëra artikuj, shënime poetike, pamflete dhe fejtone, me të cilat zuri vend në publicistikën që nisi me shkrimet e Pashko Vasës, Abdyl Frashërit, Sami Frashërit e Jeronim de Radës të cilët bënë të njohur në opinionin publik përparimtar çështjen shqiptare dhe luftuan për zgjimin kombëtar të popullit shqiptar. Por Noli i përket brezit të luftëtarëve të rinj nga radhët e intelektualëve demokratë që hynë në lëvizjen patriotike në fillim të shekullit XX

Lidhja shqiptare si një organizatë me karakter të gjerë kombëtar është shpërndarë nën presionin e persekutimeve turke në 1881, por pionierët e saj kanë vazhduar veprimtarinë e një ritëm gjithnjë e më të shpejtuar nëpër disa qendra botërore duke formuar oraganizata, gazeta e revista dhe duke botuar herë pas here vepra letrare dhe publicistikë.

Këtij qëllimi Noli i shërbeu me punën e gjerë që zhvilloi në fushën e publicistikës, ku u shqua për mprehtësinë politike, për talentin e rallë prej polemisti, dhe analizën e thellë e të goditur të fakteve dhe ndodhive politike. Veprimtarinë e tij si publicist Noli e nisi nga gjysma e dytë e vitit 1905 me një varg artikujsh të botuar në gazetën "Drita" të Shahin Kolonjës me të cilat bëri edhe hapat e para në lëvizjen patriotike.

Në veprimtarinë e gjatë publicistike të Fan S. Nolit dallojmë tri periudha të mëdha:

Periudha e parë nis në vitin 1905 kur ai hyri në lëvizjen patriotike shqiptare dhe mbyllet me Shpalljen e Pavarësisë. Periudha e dytë e veprimtarisë pubicistike fillon nga fundi i vitit 1912 -1920. Ndonëse jo aq e pasur në krahasim me të parën, publicistika e kësaj kohe paraqet interes për idetë që Noli shprehu për problemet lidhur me gjendjen e vështirë në të cilën u ndodh Shqipëria pas Luftës së Parë Botërore. Në këto vite puna e tij është e lidhur me përpjekjet për zgjidhjen dhe organizimin e shqiptarëve të Amerikës.

E frytshme dhe me interes të vecantë është periudha qe pushton vitet 1925-1932. Trashëgimia e kësaj kohe zë vend të rëndësishëm jo vetëm në historinë e publicistikës

përparimtare, por edhe në mendimin politik-shoqëror shqiptar të kohës. Kjo është koha kur lëvizja çlirimtare demokratike shqiptare hyri në një fazë të re të zhvillimit të vet.

Në qendër të publicistikës së Nolit të viteve të para të kësaj periudhe është tema e luftës kundër feudalëve që uzurpuan pushtetin qysh në dhjetor të 1924. Kjo kishte rëndësi të veçantë, pasi shtypi zyrtar ngriti një zhurmë të madhe propagandistike për ta paraqitur ardhjen në fuqi të Zogut, si vendosje "të rregullit" dhe të " ligjit". Noli zhvilloi një punë të madhe, ku përmes artikujve dhe intervistave i bëri të njohur opinionit shoqëror brenda dhe jashtë vendit se ngjarjet e dhjetorit të 1924 nuk ishin një "Triumf i Legalitetit" siç e trumbetonte propaganda zyrtare. *"Ahmet Zogu- i deklaronte Noli korrespodentit të gazetës "Boston Harold", në fillim të vitit 1925, - kurrë nuk mund ta merrte fuqinë dhe nuk mund të qënndronte në fuqi asnjë ditë pa përkrahjen e Jugosllavisë. "Triumfi i Legalitetit", sipas tij ishte shprehje e forcimit të mëtejshëm të sundimit të bejlerëve, të cilët para vitit 1912 dhe sidomos pasi u krijua shteti i pavarur shqiptar, zunë të shtireshin si nacionalistë të flaktë", " dhe e kanë luajtur aq mirë rolin e tyre- shtonte Noli, - sa kanë marrë potuaj gjithnjë pjesë në fuqi pas 28 Nëntorit"*[494]

Ngjarjet e dhjetorit 1921-1924 Noli i pa jo brenda kuadrit të ngushtë ndërmjet forcave kundërshtare politike në këto vite, por në një kontekst më të gjerë historik-politik. Në artikullin " Nacionalët, antinacionalët dhe copëtimi", Noli vuri në dukje se ndryshe nga vendet e tjera, ku lufta për clirim kombëtar ishte kurorëzuar më krijimin e shtetit të lirë kombëtar, në Shqipëri pas Shpalljes së Pavarësisë kombëtare, shteti i porsakrijuar shqiptar hasi në shumë pengesa. *"Këtu, - shpjegonte më tej Noli, - lufta e indipendencës vazhdon ose më mirë nis më egër pas proklamatës së indipendencës pas njohjes zyrtare. ". "Shkaku i këtij mjerimi është se në Shqipëri ka pasur dhe ka vetëm dy partira të mëdha: Nacinalët dhe antinacionalët, domethënë ata që duan një Shqipëri indipedente dhe ata që duan copëtimin e saj midis shteteve fqinje. Historia e Shqipërisë që më 1912 gjer më sot s'është veç lufta midis këtyre dy partive"*[495]

Për Nolin " antinacionalët" ishin bejlerët. Duke iu përgjigjur gazetës "Dielli" që përpiqej t'i nxirrte bejlerët si patriotë që kurdoherë kanë menduar për të mirën e Shqipërisë, Noli shkruante: " *Nuk janë shqiptarë, por janë vetëm bejlerë, pa fe e pa atdhe, pa din e pa vatan"*[496]. Kjo sipas Nolit, përcaktoi veçantinë e luftërave çlirimtare të popullit shqiptar, të cilit për të përmbushur aspiratën e tyre për një shtet të lirë e të pavarur i është dashur të bëjë një luftë të vështirë. *Klasa e bejlerëve, vinte në dukje Noli, "di vetëm një zanat dhe ky zanat është të thëthijë gjakun e kllasit të popullit punëtor. "*[497]

Herë me ironi të hollë dhe herë me sarkazëm therëse, ai dënoi masat që merrte regjimi zogollian për t'i shtrydhur fshatarët e varfër. Noli shkruan: "*Si mjerë ai*

[494] *Lufta për Indipendencën, "Federation Ballqanque", 1923, 1 dhjetor, nr 195*

[495] *Nacionalët, antinacionalët dhe copëtimi, "Imigranti", 1925, 25 dhjetor, nr 11-12*
[496] *Andej- këtej, "Republika", 1930, 27 dhjetor, nr 5*
[497] *Andej-këtej, "Liria kombëtare", 1929, 10 shkurt, nr 104*

tagradhënës që nuk paguan vërgjitë. Më pas popullit do t'i zbresin pasurinë e tundshme, pastaj pasurinë e patundshme, pastaj do t'i burgosin…"[498]

Në mënyrë të hollësishme dhe plot gjallëri publicist demokrat përshkroi mjerimet e shumta që ranë mbi popullin në vitet e krizës së përbotshme ekonomike. Ai nxori në dritë gjithë tragjizmin e kësaj gjendjeje, të cilin e pa si shfaqje të thellë e thelbit antipopullor të regjimit. Thelbi antikombëtar i regjimit zogollian dukej qartë në politikën e jashtme që ai zbatoi. Kjo përbën një nga temat kryesore të publicistikës së Nolit të viteve 1925-1932. Zogu e vë Shqipërinë nën kontroll financiar dhe ekonomik të kapitalit italian.

Për këtë Noli shkruan: "*Gërvishtni historinë e të gjithë skandaleve të botës- dhe nuk do të gjeni asgjëkunt një batakçillëk kaq të poshtër e të kombinuar me një tradhti të paturpshme prej një qeverie në kurriz të popullit"*[499] Këtu shprehet qartë që Zogu e kishte vënë Shqipërinë në varësi të plotë të kapitalit italian. Duke ia nënshtruar ekonominë e vendit, regjimi në fuqi i hapi shtegun depërtimit të Italisë fashiste edhe në fusha të tjera si në arsim, në edukim, në ushtri etj, duke përgatitur kështu truallin për pushtimin e Shqipërisë në 1939 nga Italia fashiste.

Përfundimi i natyrshëm i shqyrtimit kritik që Noli i bëri politikës së brendshme dhe të jashtme të regjimit të Ahmet Zogut, Shqipëria humbi lirinë dhe pavarësinë e saj kombëtare. *"Nacionalistët punuan për një Shqipëri të lirë, për një Shqipëri të popullit. Shqipëria u bë s'është as e lire, . as e popullit. Është e bejlerëve, e tradhëtarëve, e kusarëve, e italianëve, "*[500]shkruan me hidhërim Noli më 1930 duke bërë si të thuash balancën e pesë vjetëve të sundimit të Zogut. Lëvizja çlirimtare pas Shpalljes së Pavarësisë dhe Revolucionit Demokratiko- borgjez i Qershorit ishin ngjarje me rëndësi në jetën historike të vendit. Pasi flet për karakterin përparimtar të veprimtarisë së qeverisë demokratike, Noli ndalet tek shkaqet e dështimit te Revolucionit të Qershorit. Shënimet lidhur me këtë çështje shquhen nga fryma autokritike, analiza në përgjithësi e saktë dhe përfundimet e drejta. " *Jo vetëm për bindjet, por edhe për kontribtn e vet psikologjik dhe etik Noli nuk ishte revolucionar në kuptimin e plotë të fjalës. Burrë shteti është bërë jo pse e dëshiron politikën, por pse moment historik i shqiptarëve e ka kërkuar një sakrificë të tillë. Mbi çdo gje tjetër Noli ka dashur lirinë shpirtërore dhe as nuk i ka duruar prangat intelektuale, as nuk ka pasur fuqi t'ia vërë ato tjetërkujt. Si njohës i mrekullueshëm i historisë Noli i ka njohur mirë format e ndryshme të tiranisë, qoftë ato që shfaqen në trajtën e qartë të monarkisë, qoftë ato që maskohen nën petkun e demokracisë. Historinë dhe mentalitetin e shqiptarëve e ka kuptuar mirë dhe ka ditur se dhuna vetëm sa mund të sjellë pegesa në përparimin e tyre.* [501]

Në bindjet politike dhe në humanizmin e Nolit ka diçka nga filozofia e iluministëve të shekullit XVIII si dhe nga filozofia e Platonit. Ai ka dashur t'i humanizojë njerëzit duke shtuar bazat e një humanizmi universal me anë të evolucionit shpirtëror. Një

[498] *Andej-këtej, "Republika", 1932, 14 Janar, nr 63*

[499] *Andej –këtej, "Liria kombëtare", 1929, 1 janar, nr 100*

[500] *Për Hasan Bitinckën, "Republika", 1930, 18 dhjetor, nr 8*

[501] *R. Qosja "Shkrimtarë dhe periudha", Tiranë, 2000*

vend të veçantë në shqyrtimin kritik që i bëri përvojës së viteve 1921-1924 publicisti demokrat u kushtoi dy çështjeve:

Së pari: Reforma agrare që figuronte në programin e qeverisë demokratike e cila nuk u zbatua, se qeveria demokratike u tregua e pavendosur dhe si pasojë fshatarët, kur panë që qeveria nuk u dha tokën, nuk u ngritën me armë për të mbrojtur revolucionin. Për këtë Noli shkruan: " *Pas kryengritjes së Qershorit kishin një posibilitet sado të vogël të qëndronin në fuqi, sikur ta kishin çkulur kllasin e bejlerëve që nga rrënja e t'ua kishin shpërndarë tokat katundarëve, shkurt duke bërë reforma agrare për të qënë. "*[502]

Së dyti: Organizimi dhe udhëheqja e lëvizjes demokratike. *Demokratët, - shkruante Noli, -"…. kishin disa parrulla të përbashkëta të politikës për sy e faqe ishin demokratët, antifeudalë, antiregjionalistë"*[503]. Sipas Nolit mungesa e një partie si mjet për veprime politike të organizuara dhe të përbashkëta ishte një ndër shkaqet e dështimit të Revolucionit Demokratiko -borgjez të Qershorit.

"E dinim fare bukur se për të përballuar situatën duhej të forconim një grup nacionalist dhe antifeudalë, me fjalë të tjera një parti katundare, po nuk e bëmë. Dhe c'bëmë? - vijon arsyetimi i një publicist demokrat, -vazhduam luftën me një grup heterogjen, ku nacionalistët e vërtetë ishin me pakicë, dhe ky grup jo vetëm nuk ishte i organizuar, por përkundër ishte i përarçë në fushën që luftonin njëri –tjetrin me tërbim"[504]. Aspekti i rëndësishëm i procesit të kalimit të Nolit në pozitat e demokratizimit revlucionar ishte edhe koncepti i ri që ai formoi për masat si forcë e rëndësishme e ngjarjeve historike. Noli i mbahej mendimit se zhvillimi i Shqipërisë do të arrihej me anë të reformave siç do ta pohonte më vonë ai nuk e kishte të qartë thellësinë e gjerësinë e shndërrimeve që do të kryeshin në jetën e vendit. Deri në prag të ngjarjeve revolucionare të qershorit të vitit 1924, Noli nuk iu drejtua asnjëherë masave popullore për thirrje për t'u ngritur kundër qeverive çifligaro-borgjeze. Vetëm në fund të viteve '20 dhe në fillim të viteve '30 ai pranoi rolin vendimtar të popullit në ecurinë e historisë. *"Populli mund ta shpëtojë populli vetë"*, [505] -pohonte Noli në këtë periudhë i bindur tanimë se masat popullore ishin të afta ta shpëtojnë veten dhe vendin nga zgjedha e egër. Besimi në forcën e popullit, në aftësitë e tij për ta shembur regjimin e vjetër pushtonte fund e krye publicistikën e tij në vitet 1925-1932.

Përfundimet që nxori Noli nga analiza e Revolucionit të Qershorit ishin të drejta: Ato dëshmonin për elementet e reja që u shfaqën në pikëpamjet e tij politike-shoqërore. Evolucioni që pësoi botëkuptimi i tij nuk ishte diçka e rastit. Është e vështirë të përcaktosh në mënyrë të përpiktë shkaqet e largimit të tij prej lëvizjes demokratike shqiptare. Megjithatë diçka mund të sqarohet në mënyrë të tërthortë. Ajo u kushtëzua në radhë të parë nga arsye objektive historike. Fillimi i viteve '30-të është koha kur doli më qartë se kishte marrë fund roli i borgjezisë në lëvizjen çlirimtare të popullit shqiptar dhe në krye kishte ardhur klasa punëtore e cila me grevat e

[502] *Andej-këtej, "Liria kombëtare", 1929, 22 maj, nr 112*

[503] *Andej-këtej, "Liria kombëtare", 1929, 1 mars, nr 106*

[504] *Rreth 28 Nëntorit, "Liria kombëtare", 1928, 28 nëntor, nr 99*

[505] *Republikë dhe monarki", "Republika", 1931, 22 janar, nr 13*

demostratat po tregonte se ishte një forcë e aftë për të udhëhequr luftën e masave të gjera popullore kundër regjimt zagollian.

Zhvillimi i ngjarjeve gjatë dhe mbas Luftës së Dutë Botërore ka nxitur më në fund Nolin se sikundër e krijojnë, po ashtu njerëzit e ndryshojnë historinë jo me lutjet e mirësinë e tyre, por me forcën e tyre. Tani ai do të mund te thoshte ashtu si kishe thënë në fillim të rrugës së vet politike dhe krijuese, në dramën "Israleitë dhe filistinë", nëpër gojën e një protagonisti: "Dua t'u them se në vent që të dërgojmë Samsonë vetëm me të Vërtetën, është më mirë të vemë dhe të gjithë ne me shpata", [506]*, sepse " nuk e besoj të Vërtetën njeriu ndryshe"*[507].

Tepër i ndershëm që të bëhej burrë shteti i fortë dhe i pamëshirshëm, tepër i kulturuar që mos e urrente gjakderdhjen e vëllezërve dhe të njerëzve përgjthësisht, tepër konsekuent që të bëhej diplomat dinak, Noli ka mundur t'i japë fund karrierës politike ashtu siç ai ka thënë: në mërgim.

Ai ishte politikan që bën shaka në adresë të politikanëve dhe kjo më së miri duket nga fjalimi që ka mbajtur në Lidhjen e Popujve: "Parlamenti është një sallë ku mblidhen politikanë pa shpirt, që bëjnë prova operrate në trupin e gjallë të races së vet, një sallë plot me njerëz të helmuar gazi, plot me gaz të helmuar, gaz mbytës, gazi që sjell lotë qeshje…"[508]*. Kështu ka qenë dhe kështu do vazhdojë të jetë. "Me zërin politik të një mesianisti bashkëkohor ka shprehur shpresën e vet-oh cfarë iluzioni- se një vizion i tillë universal do të realizohet medoemos"*[509].

Duke besuar se bota bashkëkohore është një familje e gjerë, në të cilën asnjë anëtar nuk mund të bëjë gjësend pa u shprehur ajo e bëri edhe në fatin e të tjerëve, ai ka folur në emër të të gjithë njerëzve paqedashës. Në kuadrin e një të ardhme të tillë paqësore e ka parë dhe e ka kërkuar ardhmërinë e popullit të vet në numër të vogël.

Si përfundim mund të themi: Edhe pse nën petkun e priftit Fan Noli kurrë nuk ka qëndruar matanë të mirës dhe së keqes. Me humanizmin e tij universal ai është ngritur mbi politikën dhe mbi partitë, mbi kufizimet kohore dhe hapësinore. Ai është tepër i madh si njeri dhe si humanist që të mos dëgjonte jehonën e zërave të së ardhmes njerëzve duke na lënë mesazhe gjithëkohore në kujtesën e një kombi.

---

[506] *Fan S. Noli "Israleitë dhe fiistinë", Prishtinë, 1968, fq 23*

[507] *Aty, fq 25*

[508] *Lefter L. Dilo "Ligjëron Fan Noli" Tiranë, fq 84*

[509] *Aty, fq 88*

HEKTOR ÇIFTJA

ARSHI PIPA DHE FAN S. NOLI-DY KONTEKSTE DHE NJË TEKST

Nga "Bariu i Populllit" tek një personalitet i përmasave ndërkombëtare

Në këtë ese do të përpiqemi ti qasemi pikërisht rolit që mendojmë se kanë shkrimet e Arshi Pipës në perceptimin e sotëm për personalitetin shumëplanësh dhe kompleks të Fan Nolit. Pipa **nuk** ka shkruar volume për Nolin, gjithsej në hulumtimin tim jo më shumë se 100 faqe gjithsej. Por tezat e hedhura, qëndrimet e mbajtura, organet ku ka publikuar, momenti kur ka botuar dhe si rrjedhojë edhe qarqet studimore ku kanë qarkulluar këto publikime kanë bërë që shumë prej qëndrimeve të Pipës të reflektohen edhe sot e kësaj dite në perceptimin e përgjithshëm mbi këtë personalitet. Me të drejtë Nasho Jorgaqi, një nga njohësit më të thellë dhe të specializuar të Nolit ka vendosur që në vëllimin e VII të përfshijë një studim të Pipës krahas studimeve të Çabejit, Kutelit, Koliqit e të tjerëve.

Objektivi i këtij punimi është të skicohet një biografi intelektuale, një portret i personalitetit të Nolit, ashtu siç del ajo në shkrimet e Arshi Pipës. Metoda studimore (gjithmonë nëse ka një të vetme në shkencën e letërsisë) e përdorur nga Pipa "Bariu i popullit", Shënime kritike për librin "mall e brengë" dhe shënime kritike për dramë "Izraelitë e filistinë" është shumë më pranë tërë frymës së Idealizmit italian dhe koncepteve të Benedetto Kroçes duke bërë pasurimin e parë metodik në hartën e gjykimeve për Nolin. Vepra e fundit e Pipës mbi Nolin titullohet "Fan Noli si personalitet shqiptar me përmasa kombëtare dhe ndërkombëtare" dhe është botuar në Sudost Forchungen, Munih, një botim i specializuar akademik për kulturën, gjuhën dhe historinë e vendeve të Evropës Juglindore. Eseja e Pipës është botuar në vitin 1984, pra është relativisht bashkëkohore sa i përket studimeve për Nolin. Botimi është në gjuhën angleze, pra për një auditor akademik perëndimor. Dimensionit të frymës së kritikës së idealizmit italian, në këtë punim i shtohet edhe fryma e disiplinës akademike të studimeve kulturore. Mbi të gjitha, Pipa është shumë më i avancuar në aspektin e shkencës së letërsisë në këtë periudhë. Teza jonë në këtë punim është se këndvështrimi kulturologjik i Pipës e pasuron ndjeshëm panoramën e studimeve për Nolin. Në këtë konferencë do të flasim pikërisht për punimin "Fan Noli si personalitet shqiptar me përmasa kombëtare dhe ndërkombëtare".

Le të skicojmë si fillim përmbajtjen e esesë së Pipës. Ajo fillon me pohimin se Noli mund të quhet personaliteti më enigmatik në historinë e Shqipërisë. Pipa thotë se kërkon të shohë edhe elementet nacionale edhe elementet internacionale të personalitetit të Nolit. Këtej dhe titulli i esesë së Pipës. Patjetër që Noli ishte një "bari i popullit", një udhëheqës shpirtëror dhe fetar që i donte "delet" e tij. Por kjo duhet kuptuar shumë më gjerë. Noli ishte një prelat i iluminuar i një kishe e cila predikonte një fe universale. Pra ai nuk kishte sesi të mos i shihte problemet e vendit të tij nga një

perspektivë shumë më të gjerë sesa ajo nacionaliste. Megjithatë, thotë Pipa, internacionalizmi i tij përfshin një komponent të mirëfilltë politik, i cili ose ka kaluar në heshtje, ose është keqinterpretuar. Për të provuar tezën e tij, Pipa skicon një biografi intelektuale të Nolit duke u nisur nga një analizë kritike e shkrimeve dhe fjalimeve të tij. Noli u lind në Ibrik Tepe, një lokalitet në jug të Adrianopojës, në pjesën europiane të Turqisë, një lokalitet i cili nuk ekziston më sot. Pra ndryshe nga shqiptarët e tjerë të diasporës së atëhershme, Noli është një shqiptar pa atdhe, fshati i tij, siç e pohon edhe vetë, u zhduk nga harta pas vitit 1923. Një njeri pa atdhe, thotë Pipa, është detyrimisht një qytetar i botës. Ky kozmopolitanizëm i Nolit në rrënjët e të cilit janë arsyet gjeografike, ka një gjurmë të fortë levantine, pra të kristianëve latinë që jetonin në Lindjen e Mesme dhe Turqi. Shkollimin e bëri kryesisht në gjuhën greke, por edhe turqishten e njihte mirë, gjë që dallon nga barbarizmat në shkrimet e tij. Kur në moshën 24 -vjeçare u nis për në Shtetet e Bashkuara, ai njihte mirë dy gjuhë ballkanike, dhe mund të bisedonte në turqisht, arabisht dhe frëngjisht. Mbi të gjitha ai pat udhëtuar në pjesën më të madhe të Mesdheut Lindor.

Kapitulli i parë i punimit të Pipës ndjek fazat e jetës së Nolit siç ishte përshkruar edhe ky vetë në autobiografinë e tij. Ky kapitull titullohet " Nga sufler dhe këngëtar kishe në predikues dhe diplomat". Si sufler dhe aktor Noli pat fituar stërvitjen dhe teknikat e të folurit në publik. Si këngëtar kishe dhe si mësues muzike ai pati fatin të ketë për mësues një murg i cili ishte ekspert në muzikën bizantine. Pavarësisht se këto përvoja patën ndikimin e tyre në vendimin e Nolit për t'u bërë prift, arsyeja kryesore për këtë nismë ishte arsyeja patriotike. Atdhetarët shqiptarë me të cilët ai ishte në kontakt si Spiro Dine, Thanas Tashko, Jani Vruho e të tjerë e kuptuan se një i ri dinamik dhe inteligjent siç ishte Noli mund të merrte maksimumin nga aftësitë e veta nëse do të punonte për çështjen shqiptare në Amerikë. Në "botën e re" Noli do të bënte një jetës shumë të vështirë, "Botë e fëlliqur"do ta quante në një nga letrat e veta. Jetonte duke bërë punë nga më të rëndomtat, dhe në rastin më të mirë duke shitur përkthimet liturgjike e duke shkruar e përkthyer për "Djelli-n". Menjëherë pas Shpalljes së Pavarësisë e gjejmë në Konferencën e Londrës si përfaqësues i kishës shqiptare në një delegacion të kryesuar nga Mehmet Konica, në të cilin merrte pjesë edhe Faik Konica si përfaqësues i "Vatrës". Ky do të ishte edhe fillimi i karrierës diplomatike të Nolit i cili do të pasohej më vonë nga Kongresi i Triestes. Vazhdoi me shërbesat fetare në Bukuresht si edhe me përkthimet liturgjike. Kur kthehet në 1915 në Sh. B. A. kishte tashmë një përvojë të pasur europiane. Atje bëhet për dy vjet drejtuesi i "Vatra"-s. dhe më pas administrator i misionit ortodoks shqiptar në Amerikë. Në 1818 ai merr pjesë si delegat i "Vatra"-s në Kongresin e Kombeve të Shtypur në Uashington. Atje i krijoi mundësinë vetes të flasë me presidentin Wilson mbi gjendjen e Shqipërisë. Ndikimi i tij tek presidenti Wilson në çështjen shqiptare duhet të ketë qenë vendimtar. Më vonë do të botohet Adriatic Review, gjashtë muajt e parë të së cilës patën Nolin si kryeredaktor. Kjo ka qenë ndoshta botimi më i mirë që kanë nxjerrë shqiptarët e Amerikës, ishte në gjuhë angleze, ishte me tema politike, dhe kërkonte t'i drejtohej një audience perëndimore dhe të sensibilizonte opinionin publik atje rreth çështjes shqiptare.

Arritjet që pati Noli në letërsi, gazetari, udhëheqësi fetare dhe diplomaci gjatë Luftës së Parë Botërore bënë që ai natyrshëm të ishte mundësia më e mirë për të kryesuar delegacionin shqiptar në Lidhjen e Kombeve në Gjenevë. Ai ia doli që Shqipëria të pranohet anëtare e Lidhjes së Kombeve. Shkroi edhe gazeta "The Manchester Guardian" e cila midis të tjerash e përshkroi si një njeri i cili do ti bënte nder çdo kombi. Noli mbajti një fjalim në Lidhjen e Kombeve. Fjalimi i tij, thotë Pipa, dëshmon edhe për konceptin që Noli kishte në atë kohë për internacionalizmin kur fliste se paqja nuk vjen nga traktatet të cilat në fund të fundit janë të destinuara për t'u hedhur në kosh. Paqja duhet të vijë nga shkolla, ku t'u mësohet fëmijëve se si një vrasje e thjeshtë ashtu edhe gjenocidi janë njësoj krime dhe njësoj të papranueshme, ku tu mësohet fëmijëve se perënditë fisnore, tribale janë burimi i të gjitha të këqijave që kanë pllakosur njerëzinë për shekuj të tërë. Fëmijëve, thoshte Noli, duhet t'u mësojmë se ka vetëm një zot të vërtetë që duhet t'i shërbejmë, dhe kjo është perëndia i njerëzisë dhe perëndia e të gjithë fiseve. Në këtë pikë, vëren Pipa, Noli e përdor termin fise, tribu, si një term përkeqësues për fjalën "komb" duke atakuar kështu konceptin e "kombeve historike", pra të fuqive europiane të cilat fituan luftën. "Perënditë tribale", vëren gjithashtu Pipa, i referohet në mënyrë sarkastike si nacionalizmit të këtyre shteteve, ashtu edhe nacionalizmit të fuqive koloniale të cilët ishin një grup ujqërish që pretendonin se ishin rojet e paqes. Tek fjalimi i Nolit, Pipa nënvizon edhe një paragraf të tërë në të cilin Noli shpreh dëshirën e tij për të parë që një ditë Lidhja e Kombeve të bëhej Lidhja *përtej* kombeve, në frymën e internacionalizmit të vërtetë si i vetmi garant për paqen.

Kapitulli i dytë i esesë së Pipës quhet "Intervali shqiptar-shtetari". Ndryshe nga karriera e një politikani të zakonshëm, nënvizon Pipa, performanca e Nolit në Lidhjen e Kombeve e konsolidoi atë si një personalitet ndërkombëtar më parë sesa ai të arrinte staturën e një personaliteti kombëtari. Në atë kohë Noli njihej, por vetëm në qarqe të caktuara që ishin kryesisht qarqet intelektuale dhe politike. Ai do të ishte i vetmi në atë kohë i cili do t'i kundërvihej me dinjitet një shqiptari shumë të fuqishëm të kohës, Ahmet Zogut, i cili më vonë do të bëhej mbret i shqiptarëve. Përsëri do të shkëlqente në oratori, përsëri do t'u mësonte shqiptarve përvojën amerikane të demokracisë, do të udhëhiqte opozitën e kohës, do të vazhdonte me priftërimin. Revolucioni dështoi dhe Noli emigroi në Amerikë. Noli, thotë Pipa, me personalitetin e vet dhe kulturën e Harvardit ishte i përshtatshëm për të filluar revolucione, por jo për të drejtuar të tillë. Dhe kjo i rezulton para së gjithash nga vetë "autobiografia"e Nolit.

Kapitulli i tretë i kushtohet periudhës kur Noli emigroi përfundimisht. Kapitulli titullohet "Periudha e mërgimit politik: shkrimtari". Edhe mbas dështimit të revolucionit në dhjetor 1924, Noli thotë Pipa, vazhdoi të ketë parësore të shërbyerit ndaj atdheut. Si patriot i vendosur ai kishte nisur një projekt madhor me rëndësi kombëtare, ashtu siç dinte Noli i cili ishte i bindur se atdheut duhet t'i shërbehet duke edukuar njerëzit dhe popullin më kulturë, duke i mësuar me artet letrare dhe duke u mësuar se ç'është demokracia. Projekti kishte emrin "Libraria letrare". Mërgimi politik, thotë Pipa, e ktheu politikanin e mundur në një shkrimtar të madh, një model që e gjejmë nga Cicero-i e deri tek Dante, Bacon dhe Gramschi. Diku Noli shprehet se kur kishte vendosur t'i hyjë kryqëzatës për pavarësinë e Shqipërisë, gjëja e parë që i

kish ardhur në mendje ishte se në gjuhën shqipe kishte një mungesë totale të veprave letrare të cilat të kishin vlerë artistike. Kjo ka qenë me siguri arsyeja që Noli filloi të përkthejë kryeveprat e letërsisë botërore. Vetëm në vitin 1926 u botuan jo më pak se gjashtë të tilla. Në 1932 dolën 5 vëllimet e Don Kishotit. Të gjitha këto me të njëjtin format, të njëjtën letër dhe të njëjtën kopertinë. Ata ishin pjesë e projektit "Libraria letrare". Vetë titulli i serisë si edhe përzgjedhja e veprave tregojnë se këtë sipërmarrje Noli e kishte konceptuar si një shërbim arsimor ndaj popullit të tij. Veprat e botuara mbas vitit 1924 dëshmojnë se Noli kishte punuar me shumë përkushtim, përpara së gjithash, për pastërtinë e gjuhës shqipe. Modeli për këtë gjë u bë Konica me revistën e tij. Për letërsinë shqipe, esetë hyrëse të cilat prezantonin përkthimet e Librarisë Letrare nuk janë më pak të rëndësishme. Pipa shprehet se me këto ese, Noli inauguroi i pari një tip të kritikës letrare i cili jo vetëm që nuk ekzistonte më parë në letërsisë shqiptare, por që edhe në Europën Perëndimore i mungonte një status i qartë: kjo lloj kritike ishte sociologjia e letërsisë. Diku më vonë, në "Contemporary Albanian Literature", Pipa do të shprehet se ishin pikërisht këto introdukta të cilat duheshin quajtur si pararendëse të letërsisë së realizmit socialist shqiptar, dhe jo poezitë e Migjenit. Edhe në këto introdukta Noli do të demonstronte se kërkonte një funksion të letërsisë që bënte: letërsisë për edukim. Gjithashtu edhe një herë, këto ese apo "introdukta" demonstrojnë mirëfilli ideologjinë progresive të tij që Noli kërkonte t'ia mësonte popullit. Sociologjia e letërsisë interesohet pak ose aspak për aspektet e mirëfillta estetike të artit. Noli i quan introduktat e tij "analiza kritike". Sipas Pipës, ato janë analiza që fokusohen tek personazhet, dhe që i injorojnë elementet e formës si gjuha e stili, përmbajtja dhe dialogu, modelet narrative apo strukturat e vargjeve. Analizat e Nolit, thotë Pipa, janë origjinale në disa raste, por si rregull, gjithmonë janë të njëanshme. Për të provuar tezën e vet, Pipa i merr me radhë. Tek introdukta e Hamletit, Pipa vëren se e gjithë mënyra sesi Noli e sheh Hamletin, në fakt është mënyra sesi do ta shihte, jo një kritik, por një aktor i mirë. Dhe Noli pat qenë aktor në rininë e tij, madje pat vënë në skenë edhe Shekspirin. Të pasakta dhe jo shkencore janë edhe introduktat e Don Kishot-it dhe të Kasol. Por tek e fundit ato janë në përputhje me funksionin që Noli i kish vënë vetes të realizonte me këto ese; të mësonte popullin e tij për demokracinë dhe ndryshimin social. Tek "Introdukta" e "Jul Cezari-t" Noli thotë Pipa është në terrenin e tij, në terrenin e revolucionit, të revolucionarit dhe të heroit. Në këtë ese, thotë Pipa, Noli tregon admirim për Brutin, por ajo çka aprovon janë veprimet e Kasit. Nëse do të ishte miratuar ideja e Kasit që Antonit të mos i jepej fjala, atëherë revolucioni do të kish pasur sukses. Revolucioni e ka pjese të tijën demagogjinë dhe jo vetëm. "Morali dhe feja vihen në varësi të politikës, dhe nuk ka ndodhur e kundërta" vëren Arshi Pipa si nëntekste të introduktës së Nolit. Ata që kanë sukses në politikë nuk janë idealistët si Bruti, por pragmatistët si Kasi dhe demagogët si Antoni.

Noli shprehet në autobiografinë e tij, thotë Pipa, se njeh tri etër shpirtërorë, Napolonin, Skënderbeun dhe Jezus-in. Unë thotë Pipa, do të shtoja edhe një tjetër at shpirtëror të Nolit, Khajam-in. Përkthimi që Noli u bën "Rubairave" është një kryevepër letrare, është shumë më tepër sesa një përkthim. Ajo është e krahasueshme me përkthimin e Fitzgerald-it. Mirëpo, vëren Pipa, Rubairat nuk figurojnë në Librarinë

Letrare". Mospërfshirja do të thotë t'i vendosësh në një relief i cili është unik dhe i veçantë. Përkthimet e tjera të Nolit u motivuan nga synime që ishin edhe politiko-edukative edhe estetike. Por përkthimi i Rubairave ka qenë një vepër dashurie, ishte tingëllimi i një korde shumë personale për Nolin. Nga veprat që Noli botoi në mërgim, kjo është e vetmja e cila ka 2 botime, është e vetmja e cila është pajisur me shënime, dhe është e vetmja e cila është botuar me pseudonim "Rushit bilbil gramshi". Në traditën e tij që ta shikojë librin si një tekst të tërë, ashtu siç pat bërë edhe me "Mall e brengë të Kutelit", Pipa edhe vendosjen e pseudonimit e sheh si pjesë të përmbajtjes së tekstit. Mbasi shtron pyetjen "pse Rushit", "Pse Bilbil, "Pse Gramshi", Pipa ngre hipotezën se "Rushit" është formë e fjalës "rrush", dhe tek Khajami kemi vargjet e famshme "Natën kur flija më tha shpirti pi". Në këtë kuptim, "Rrush dhe Bilbil" janë në përputhje me filozofinë epikuriane të Khajam-it. "Pse Gramshi". Sipas Nolit, eseja hyrëse e librit u shkrua në Librazhd, gjë që natyrisht nuk është e vërtetë. Ka mundësi, thotë Pipa, që në një kohë që shqiptarët e kishin zakon të kishin si mbiemër emrin e vendit të lindjes, Noli vendosi të distancohet nga rivali i tij letrar, Faik Konica, mbiemri i të cilit shënonte një qytet të njohur të Epirit, dhe Faik-u ndërkohë ishte bej. Noli mund ta ketë zgjedhur këtë mbiemër për t'u dalluar si pasardhës të atyre që ai i quante "Shqipëria e bujqërve", dhe që ishte edhe Shqipëria e mesme, për tu dalluar nga "Shqipëria e bejlerëve", dhe që ishte edhe Shqipëria e Konicës. Një mundësi tjetër është që Noli ta ketë zgjedhur këtë mbiemër edhe si nderim për Antonio Gramshin i cili u arrestua në vitin 1926 nga fashistët, histori për të cilën Noli provohet se ishte i informuar, mbasi kishte shkruar në "Herald tribune" për Musolinin si "Klounin imperialist". Sido që të jetë, edhe kjo mënyrë vështrimi mund të provojë aspektet e personalitetit të Nolit siç janë ideologjia e tij. Diku tjetër, tek Bariu i Popullit, Pipa shprehet se zgjedhja e Khajamit dhe përkthimi mjeshtëror i tij e bëjnë Nolin një figurë që zemrën e kishte në Lindje, andej dhe nga kishte origjinën, ndërsa mendërisht ishte aq mendjehapur sa të kuptonte Perëndimin, (edhe varianti i Khajami-it që ka përkthyer është më afër variantit të Fitzgerald-it").

Veprat e mëtejshme të Nolit janë shprehëse të ideologjisë së tij. E tillë është eseja për Tolstoin që Pipa e gjen në një antologji të Nasho Jorgaqit. Noli shkon deri atje sa të heqë paralele midis Tolstoit dhe Gjon Pagëzorit.

Jo vetëm veprimtaria letrare, por i tërë aktiviteti politik dhe publicistik i kësaj periudhe të Nolit përshkohet nga militantizmi radikal, përmendim këtu organizatën KONARE, sulmet e vazhdueshme ndaj Zogut, replikat me Konicën, shkrimet ku shprehej simpatia e hapur për Bashkimin Sovjetik, esetë për figura si Shuberti e Tolstoi, botimin e gazetës Republika si antitezë e "Diellit" të Konicës. artikullin e famshëm për Toskaninin etj. Në të gjitha shkrimet ai është krenar të dalë në mbrojtje të fshatarëve, madje edhe të vetëquhet si përfaqësues i tyre, "tribun", me fjalë të tjera siç e quante vetë Pipa në një shkrim të hershëm ("Bariu i Popullit").

Kapitulli i katërt quhet "përsëri në çerdhe-studiuesi" (eng: . Back to the Fold: the scholar"). Në moshë 50-vjeçare Noli iu përkushtua detyrës së tij si drejtuesi i Kishës Ortodokse Shqiptare të Amerikës, pushoi së sulmuari Zogun, bëri paqe me Konicën dhe ju përkushtua kishës. Vazhdoi të përkthejë dhe botojë liturgji bizantine në gjuhën shqipe dhe mbi të gjitha, provoi të kompozojë. Veprimtaria muzikore, thotë Pipa, ka

qenë pjesë integrale e veprimtarisë së Nolit. Raportohet se Noli mendonte se ai nuk do të mbahej mend për poezinë e tij, por për muzikën.

Sa i përket poezisë, Pipa i emërton të gjitha poezitë e tij si poezi politike. Mirëpo, thotë Pipa, poezia politike është mjaft e vështirë, dhe vetëm pak autorë ia kanë dalë, dhe këta janë më të mëdhenjtë si Dante, Gëte, Haine, Rembo, Breht. Por, po të krahasojmë Nolin më këto, vëmë re se asnjëri nga këta të mëdhenjtë nuk e kufizoi veten vetëm me poezinë politike. Tek Noli nuk gjejmë temat e zakonshme të poetëve si natyra, dashuria, jeta njerëzore, fati, misteri i qenies. Tek Noli gjithashtu nuk shohim ndonjë preokupim për perfeksionin në formë, një perfeksion për formën ne e shohim vetëm tek Rubairat. Me mbarimin e mërgimit politik, Noli përfundon së shkruari poezi. Në Amerikë, vëren Pipa, Noli shkroi muzikë, jo poezi. Sipas Pipës poezitë e Nolit janë "shpërthime të gjalla të pasionit politik të cilat nuk arrijnë të bëhen shkëlqime lirike"[510]. Me këtë thotë Pipa nuk nënkuptojmë aspak se interesi i Nolit në poezi dhe letërsi nuk ishte i pastër. Me këtë Pipa kërkon të nënvizojë se Noli ishte i gjithëpërfshirë nga politika. Aq i theksuar ishte ky tipar, sa edhe letërsisë Noli i qaset nga perspektiva e teatrit, i cili është një zhanër miks që kombinon të shkruarit me aktrimin. Marrëdhënia e tij me letërsinë, shprehet Pipa ishte një marrëdhënie e tipit *love affair*. Duhet të ketë pasur një moment që ai e ka kuptuar se letërsia nuk ishte pika e tij e fortë, dhe kështu i përkushtohet studimit. Në aspektin politik, siç e pohon edhe Pipa, por edhe siç shihet edhe nga "autobiografia" e Nolit, në fushën e politikës, pavarësisht përpjekjeve, Nolit në këtë periudhë i mbeti pak për të bërë. Një farë dëshpërimi, por edhe një farë izolimi i cili ndoshta erdhi për shkak se madhështia apo edhe kompetencat e Nolit në polikë nuk përputheshin me nevojat e shqiptarëve të Amerikës së asaj periudhe bëri që Noli t'i rikthehej studimit. Pipa mendon se ato vepra të cilat Noli i mendonte si studime, pavarësisht se kanë vlera të padiskutueshme, nuk përmbushin parametrat për t'u quajtur studime të mirëfillta, (e tillë është f. v. përkthimi në greqisht i veprës së Sami Frashërit). Po kështu, nëpërmjet së njëjtës metodikë, është vështirë të quhen studime dy botimet e "Historisë së Skënderbeut". Por, Pipa shprehet se vlera e tyre e padiskutueshme do parë në funksion të qëllimit që Noli i kishte vënë vetes. Në botimin e parë synimi ishte mirëfilli patriotik, dhe në këtë perspektivë vepra ka vlera të jashtëzakonshme. Botimi i dytë, jo vetëm që ishte disertacion për gradën shkencore në Universitetin e Harvardi-it, por synonte, siç edhe duket qartë në të gjithë elementet, që të afronte komunitetin e shqiptarëve të Amerikës me vlerat amerikane duke ua bërë kështu më të lehtë komunikimin ndërkulturor të tyre. Në fazën që Pipa e emërton "faza e studiuesit", meritat dhe aftësitë e Nolit dalin edhe më befasuese. Në këtë fazë gjejmë ato tipare të Nolit të cilat diskutohen që në fillimet e punimit. Siç u përmend, Noli që në fillimet e tij na shfaqet një figurë edhe me dimensionin nacional edhe me dimensionin ndërkombëtar. Ky ndërkombëtarizëm lidhet me origjinën dhe formimin e tij kozmopolit, në përkatësinë e tij në një fe universale, në qasjen që kishte ndaj letërsisë (përkthimi i Rubairave" dëshmoi se shpirti i tij ishte në L indje, por mendja e tij e hapur dhe vizionare ishte nga Perëndimi), duket qartë në mënyrën sesi ai në vitet e mëvonshme shkëlqen në mjediset

[510] Fan Noli as a National and International Albanian Figure-Sud-ost Forchungen-Munich, 1984

e diplomacisë ndërkombëtare. Kur iu kthye studimeve dhe muzikës, ai dëshmoi dashurinë dhe ndjeshmërinë ndaj muzikës bizantine (një prirje lindore kjo). Në këtë periudhë thotë Pipa, Noli provoi se ishte i aftë të konkurronte si i barabartë me studiuesit e huaj perëndimorë në tema të cilat ishin në mënyrë tipike perëndimore siç ishin rasti i Bethovenin apo Tolstoit apo i "Shekspirit në rrezik". këtu përmasa e tij ndërkombëtare shkëlqen dhe është mjaft dinjitoze. Në këtë pikë Noli është siç e thotë edhe titulli i punimit të Pipës "Një personalitet shqiptar i përmasave ndërkombëtare"|.

Në analizën e produkteve të Nolit të kësaj faze Pipa shtjellon dy nëndimensione të spikatura të Nolit, ideologjinë, preokupimin e jashtëzakonshëm ndaj politikës (në mënyrë të posaçme të politikës që kishte të bënte me çështjen kombëtare), dhe kishtarin. Dy të parat janë dimensione të cilat Arshi Pipa i diskuton në traditën e disiplinës akademike të studimeve kulturore, dhe një gjë e tillë kërkon një tjetër lexim.

Së fundmi, Pipa e vlerëson lart Nolin si një letrar të shkëlqyer. Ai madje shkon deri atje sa të shprehet se Khajami duhet të ketë qenë një nga modelet që ka frymëzuar Nolin në jetën e tij, përveç Napolonit e Jezuit. Madje Noli edhe në një vepër të mirëfilltë gjuhësore dhe teologjike siç ishte përkthimi në gjuhën angleze i Dhiatës së Re(dhe ku Noli nga njëra anë na del një gjuhëtar i madh, dhe nga ana tjetër një personalitet i denjë për të konkurruar në sferat ndërkombëtare siç ishin studimet dhe botimet në gjuhën angleze për Skënderbeun, Bethovenin, Shekspirin, Tolstoin, kompozimet kishtare etj.

Si përfundim, disa konkluzione të Pipës mbi Nolin i kemi hasur edhe në veprat e tjera të Pipës, siç është teza mbi Nolin si themelues i poezisë politike në Shqipëri (në kritikën letrare bëhet gjithmonë një dallim midis poezisë me temë politike dhe poezisë politike) apo teza për Nolin si themelues i sociologjisë së letërsisë[i]. Studimi i Pipës është ndër të paktët studime të nivelit akademik për Nolin të pas Luftës së Dytë Botërore, ai është në gjuhën angleze dhe është shkruar për një auditor studiuesish të huaj. Së dyti, edhe pse studimi fokusohet tek "autobiografia" e Nolit, ai është në vetvete një tjetër biografi e mirëfilltë e jetës intelektuale dhe e profilit të Nolit. Së treti, edhe ky studim i Pipës reflekton të shikuarit e letërsisë, të procesit letrar dhe të historisë së kulturës si nga perspektiva e kritikës së idealizmit italian, ashtu edhe nga perspektiva e disiplinës akademike të studimeve kulturore duke dhënë kështu një tjetër model kritike të lëvruar pak ose aspak në studimet shqiptare. Së katërti, punimi i Pipës është i pari deri tani i cili e diskuton Nolin duke u nisur nga nocionet shkencore te ideologjisë dhe nacionalizmit. Aplikimi i këtyre nocioneve në studimin e personalitetit intelektual të Nolit bën që punimi i Pipës të mund të kategorizohet si një punim i mirëfilltë në frymën e disiplinës akademike të studimeve kulturore.. Dhe së fundmi, të shkruash dhe të botosh rreth Nolit në mjediset akademike perëndimore duke e portretizuar atë si "personalitet shqiptar me përmasat kombëtare dhe ndërkombëtare" është nderimi më i madh që një personalitet shqiptaro-amerikan si Pipa mund t'i bëjë atij që në rininë e vet e quajti "Bariu i popullit".

KLEDI SHEGANI

MESAZHE GJUHËSORE TË PUBLICISTIKËS SË NOLIT, REALITETE PËRMES HISTORISË

Nuk është hera e parë që në studime rreth figurës poliedrike të Fan Nolit merren në shqyrtim dukuri që shfaq publicistika e tij. Por, gjithsesi, çdo këndvështrim dhe interpretim duket se sjell një element më shumë në librin e madh të vlerësimeve për këtë figurë.

Si një njeri me interesa të gjera krijuese dhe kulturore, Noli vjen përmes mesazheve të publicistikës së tij, si një personalitet prej të cilit gjithmonë ke diçka për të mësuar, diçka për të cilën duhet të mendosh. Procesi i punës krijuese e studimore të Nolit është kompleks dhe i shumanshëm.

Në këtë punim, jemi përpjekur të sjellim disa prej mesazheve gjuhësore, që përcjell publicistika e Nolit, funksionet e tyre, parë në kontekstin historik dhe të vlerësuara në laboratorin e tij krijues si elemente të rëndësishme për "filozofinë" e krijimtarisë së Nolit, e cila ka të bëjë "me mendimin e tij estetik, me ato parime të botëkuptimit që e kanë udhëhequr në veprimtarinë letrare"[511].

Në gjithë veprën e tij letrare dhe publicistike janë ndërthurrur në mënyrë të dukshme ide dhe forma tradicionale, tema e vështrime që kanë të bëjnë me identitetin kombëtar, me elemente të jetës, zakone, tradita, realitete. "Portreti i Nolit, i rindërtuar nga morale dhe principe mirëfilli intelektuale, është bashkëshoqëruar vazhdimisht edhe me një portret dyfish të tij, të inicuar nga morale dhe pragmatizma ideologjike"[512], thekson studiuesi Ymer Çiraku duke vazhduar idenë se gjithmonë ka diçka të re për të thënë e këndvështrime të reja për t'u marrë në konsideratë.

Libri i parë që ka lexuar Noli në shqip ka qenë Dhiata e Re, e përkthyer nga Kristoforidhi. Më vonë, kur mbërriti në Egjipt, ai njohu "Albania"-n e Konicës, prej së cilës, siç deklaron më vonë e ka mësuar shqipen. Në këtë këndvështrim, Noli është nxënës i gjuhës shqipe i Kristoforidhit dhe i Konicës, duke pas marrë frymëzimet e para të Rilindjes Kombëtare për t' i realizuar mandej ato në krijime të modelit kritik në letërsinë shqipe. Mënyra e shprehjes së tij në publicistikë, argumentimi, emocionaliteti, e mbi të gjitha herë-herë sistemi retorik i bindjes së autorit, apo të lexuesit për idetë e shfaqura, shërben si model edhe nga pikëpamja gjuhësore, përpos mesazheve realiste në kontekst historik duke krijuar kështu një sistem autentik interpretimi dhe vlerësimi.

Në parathënien e veprës: "*Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij*", të Fatmir Agalliut, prof. Shaban Demiraj thekson se "*herë pas here janë vënë në dukje disa*

[511] N. Jorgaqi Mbi procesin e punës krijuese e studimore të Fan Nolit, Studime filologjike, 1982, f. 61

[512] Y. Ciraku, Shqyrtime kritike nga Historia e Letërsisë Shqipe, Albas, 2011, f. 65

përpjekje të Nolit për ta pasuruar shqipen letrare me fjalë të reja dhe për përdorimin e fjalëve, sidomos të huazimeve me ngjyresa stilistike te caktuara".

Bien në sy ndërtime sintaksore të ndërlikuara, përdorimi i fjalëve me ngjyrime stilistike dhe mjeshtria e tij, që nëpërmjet toneve herë sarkastike, herë të drejtpërdrejta dhe shumë herë të ngjyrosura me një mjeshtëri, që e zotëron vetëm një penë si Noli, i cili e përpunon fjalën në shkallën më të lartë. "*Fan Noli si për formimin e tij poetik, si për shprehjen gjuhësore qëndron më vete në literaturën shqiptare, na paraqitet si një lis i moçëm e plot gdhenj: lis i vetmuar po me rrënjë ngulur mirë në të thellat e dheut, e këtillë mbetet dhe gjuha e tij*"[513], thotë Çabej duke vlerësuar zërin e veçantë të Nolit në plejadën e figurave me kontribut të shquar për vendin.

Mesazhet gjuhësore të veprës së Nolit, në fakt, kanë një veçori: ato mund të lexohen në kontekste historike. Në mbështetje të kësaj ideje, prof. Demiraj vë në dukje përpjekjet e Nolit për pasurimin e shqipes dhe përdorimin e orientalizmave me qëllime stilistikore.

Publicistika e viteve '20, '30-të është jo vetëm më e madhja në numër, "por më e rëndësishmja në pikëpamje politike dhe ideologjike në të gjithë trashëgiminë e tij në këtë lëmë"[514].

Na ka tërhequr vemendjen, përcaktimi që studiuesi Fatmir Agalliu i bën gjuhës së Nolit,

duke e cilësuar si gjuhë e pasur " *me ndërtim sintaksor të paqortueshëm*" për të dëshmuar zotësinë e tij për të shkruar mjeshtërisht në shqip. Duke qenë historian kritik, atij i intereson edhe etimologjia e fjalës dhe kështu na paraqitet i kujdesshëm në zgjedhjen e fjalës shqipe duke menduar si për veshjen e saj, ashtu edhe për burimin. Duke kritikuar purizmin e tepruar, Noli thekson *" se nuk ka gjuhë në botë që të mos ketë fjalë të huaja dhe se nuk është e mundur ta qërosh një gjuhë nga fjalët e huaja pa e sakatosur*"[515]

Në publicistikë, fjalët turke, arabe, persiane, të cilat ishin shumë të njohura në popull, përdoreshin prej tij në artikujt që flisnin për realitetin e kohës. "Në shkrimet publicistike të Nolit shohim të gjëllijnë edhe formime mbiemrash me prapashtesën – *ian* që erdhën duke u shtuar. Mjafton të shohim për këtë pjesën e tij "*Mendime të kripura*"[516]

Duke folur për pasurinë e shqipes, Noli shprehet se ajo(*gjuha*), duke qenë shumë e pasur nga pikëpamja fonologjike, "*ishte e pamundur të shkruhej me 24 shkronjat e alfabetit grek*"[517]. Duke folur në një kontekst mirëfilli historik, për bashkimin e shqiptarëve, Noli nënvizon idenë e një "*abeceje për të gjithë shqipëtarët*(Gusht 17, 1906).

Gjithashtu, një karakteristikë tjetër e gjuhës së publicistikës së Nolit është edhe përdorimi i shprehjeve frazeologjike apo dhe i fjalëve të urta, me të cilat, ai i përcjell

[513] E. Cabej, Nëntori 4, 1965, f. 21

[514] K. Bihiku, Fan S. Noli dhe kultura shqiptare, Studime filologjike, 1982/1 f. 26

[515] F. Noli Rron o rron, f. 281

[516] Fan Noli, Publicistika, Dudaj, Tirane, 2007

[517] Vepra e Nolit,

natyrshëm, mesazhet e tij për lexuesin edhe më gjerë. Frazeologjitë, ashtu siç ka shkruar dhe studiuesi Agalliu, janë të strukturave të ndryshme.

Ja një korpus ilustrues që kemi nxjerrë nga disa shkrime publicistike të Nolit. [518]: "*fati ynë qyramidhe, ylefeje tri kacidhe*", f. 34 "*nuk u poq lakrori*"f. 152, "*përziemi me krunde*"; " i *mshehurë në një kasolle*", "*nuk jemi prej soji, as prej oxhaku*"; "*djek zemëra për mëmëdhenë"; "s'hyn fare në hesap";"të varrë zilen në qafët të maces";"u ipte zë tërë patriotëve; "arriu thika gjer në koskë"; "thyejmë kokën hera-herës";"var torbën urtësisë së tyre*"; "*tunduni vendit*"; "*ndruhit t ua rrëfeni botës";"të mos hamë shumë duke flecëruar*"; "*hyri puna me gjak" " dallëndyshet që të ardhën në penxhere si vllesër""do të hedhë kokës një mallkim të tmerrshëm*";"*Nisja është gjysma e punës", "vraje trimnë po mos e shaj"; "rri të nxjerrim çorapet mos më lagen*";etj

Duke dhënë mesazhe me vlerë për realitetin, Noli "kujdeset", që edhe mesazhet gjuhësore të jenë sa më të lexueshme në stilin e tij. Fjalë apo shprehje të tilla si: "*çpështjella", " kafshë kujdesjeje" "mëmëdhetarët""gjëra foshnjërishte";"pishkatorë bujarë";"udhë e hekurtë" "kundresht", "përralla çilimishte", gjuhë zyrtarishte" "zogolliane";"shkëndrit*" e sa e sa prurje të tjera noliane, dëshmojnë për një pasuri gjuhësore dhe një origjinalitet të admirueshëm.

Kur lexon publicistikën e Nolit, arrin që përmes rreshtave të prekësh erudicionin e tij dhe prania e shumë fjalëve të huaja është një element më shumë që dëshmon për këtë erudicion. Huazimet në publicistikën e tij dhe jo vetëm, janë të grupuara në dy kategori: **së pari,** huazime nga gjuhët e vendeve të Europës (*obligator, qentral, ofiqiale, konstitucie, malabresat, infantilizëm;aliancë, diskurs, diversitet, gardinë, generozitet, indemninet, ndipendencë, benevolencë, suprimonj, proklamonj, kombinezim, proprietar, brutal, decisiv, deprimant, konfortabil*) dhe **së dyti,** shtresa e huazimeve orientale(*mesele, milet, toptan, ujdis, xhepane, ziafet, kabull, takëm, teftedar, haxhillëk, derman, zullum, yrnek, behar, hava, harxhe, arallëk, badjava,*)etj, .[519]

Pas këtij përshkrimi modest, lidhur me dukuritë që shfaq publicistika e Nolit, mund të themi se ai është një figurë mjaft komplekse, i cili spikati në fushën e publicistikës si një personalitet i kompletuar dhe i padiskutueshëm.

Njohës i mirë i situatave, pozicioni i tij mbetet i lexueshëm, si kur përshkruan situatat reale, ashtu edhe kur bën thirrje nëpërmjet shkrimeve të tij, apo në qëndrimet që mban ndaj figurave dhe personaliteteve të kohës. Kur përshkruan personalitete të kohës, Noli përdor shumë gjymtyrët homogjene për të dhënë brenda një fraze të shkurtër, informacion mjaft të ngjeshur. Është një element gjuhësor që e ka përdorur me shumë efikasitet.

Si përfundim mund të themi:

[518] Fan Noli, Publicistika, Dudaj, Tirane, 2007

[519] Për më shumë shih F. Agalliu, Gjuha e Fan Nolit në veprat origjinale të tij, , Toena, 1999

Së pari, mund të përmendim përdorimin e frazeologjisë popullore, atë mozaik ngjyresash në leksik, që e bën gjuhën e tij një kalejdoskop përshtypjesh nga realiteti dhe Nolin e sjell si një njohës shumë të mirë të gjuhës së popullit.

Se dyti, qëndrimi gjuhësor tolerant ndaj fjalëve të huaja, por në të njëjtën kohë dhe përpjekja e tij, lidhur me formimin e fjalëve me brumin shqip, apo përshtatjen sa më të madhe të fjalëve të huaja brenda sistemit gramatikor të shqipes është një prirje që lexohet qartë në korpusin gjuhësor të publicistikës së tij.

Se treti, mesazhet gjuhësore të publicistikës së Nolit vijnë si realitete përmes fakteve historike e megjithatë, hapësira gjuhësore e tij është gjithëpërfshirëse dhe pena e Nolit publicist është e hollë, e mprehtë dhe shpesh kalon nëpërmjet pyetjeve retorike për të tërhequr më shumë vëmendjen e lexuesit.

Shkrimet publicistike të Nolit paraqesin interes si nga pikëpamja stilistike, ashtu edhe nga mesazhet gjuhësore që përcjellin, nëpërmjet një fraze të përpunuar mjeshtërisht dhe po kaq mjeshtërisht të veshur stilistikisht.

DION TUSHI

NOLI SI PASUES DHE PASURUES I TRADITËS SË VJETËR TË PËRKTHIMEVE TË SHKRIMEVE TË SHENJTA DHE TEKSTEVE KISHTARE.

Historia e përkthimeve të Shkrimit të Shenjtë dhe literaturës liturgjike, përbën pikënisjen e historisë së gramatologjisë dhe filologjisë të pothuajse të të gjitha kulturave dhe gjuhëve europiane. Nga ky rregull nuk përjashtohet as gjuha dhe kultura shqipe. Pikërisht historia e shkrimit të kësaj gjuhe fillon me përpjekjet e hershme për përkthimin e Shkrimeve të Shenjta, nga autorë të ndryshëm, që në rastin që po trajtojmë brenda religjionit orthodhoks fillojnë me dorëshkrimin e hershëm të shekullit XV, të gjetur në bibliotekën Ambroziana të Milanos dhe që përmban tre pjesë të ndryshme, 1. Ungjillin e shërbesës së Mëngjezit të së Premtes së Zezë (Matthteu, Kapitulli 27, var. 62 – 66.). 2. Urimin, "Për shumë vjet o Kryezot", që këndohet nga psaltët kur episkopi bekon popullin. 3. Himnin e njohur të Pashkës së Madhe "Krishti u ngjall së vdekurësh"[520].

Natyrisht që përpjekja për të përkthyer shkrimin e Shenjtë dhe shkrimet liturgjike në gjuhën shqipe, janë më të hershme se shekulli XV. Kështu profesor Eqerem Çabej shkruan në lidhje me këtë çështje: "Eshtë afër menç që për nevoja kishtare të jetë shkruar shqipja edhe ndër orthodhoksët shqiptarë të Shqipërisë së Mesme dhe të Jugut. Prandaj më duket me vend porosia e Mario Roques – it që këshillon të bëhen gjurmime të këtij drejtimi në Stamboll si edhe vetë në Shqipëri"[521].

Kjo përpjekje vërehet edhe në shekujt XVI – XVII. Këtu mund të përmendim dorëshkrimin e moçëm, me psalme dhe predikime të shkruara në gjuhën shqipe në një gegërishte të vjetër, të njohur si Anonimi i Elbasanit, që sipas studiuesit Dhimitër Shuteriqi, i cili është një ndër ata që është marrë me studimin e dorëshkrimit në fjalë, tregon se shqipja që i ka shërbyer ritit Orthodhoks, shkruhej të paktën që në shekullin e XII – të, bile edhe më herët, në lidhje me këtë ai shprehet: "Dorëshkrimi i moçëm themi se është pasardhës i një tradite më të hershme, të kohës para pushtimit osman, traditë që arbëreshët e shpunë në Itali, gjatë shpërnguljes së tyre të shekullit të XV dhe që atje u ruajt e pakta deri pas një shekulli, sigurisht me punën e klerit që atyre deri në atë kohë ua siguronte kryesisht Patriarkati i Ohrit"[522].

Shekulli XVIII është i pasur në këtë drejtim. Këtu do të përmendnim tipografin Grigor Kostandinidhi, nxënës dhe profesor i Akademisë së Voskopojës, për të cilin bashkëkohësi i tij J. Zavira na thotë se: "Përktheu Dhiatën e Vjetër dhe të Re dhe e

[520] Dhimitër Beduli, Libër i Shërbesave të Shenjta, Tiranë 1961, fq. 7

[521] Eqerem Çabej, Tekstet e Vjetra Shqip dhe Disa Kritere Rreth Botimit të Tyre, Buletini Univesitetit Shtetëror të Tiranës, Seria e shkencave shoqërore, Nr 2, Tiranë 1959, fq. 110.

[522] Dhimitër S. Shuteriqi, Mbi Barletin dhe Shkrime të Tjera, Tiranë 1979, fq. 35.

shkroi atë me gërma shqipe, të cilat vetë i shpiku"[523]. Kjo vepër fatkeqësisht ka humbur. Grigor Kostandinidhi u zgjodh nga Patriarkana Ekumenike si mitropolit i Durrësit, me qendër ndoshta në Elbasan dhe sidomos në Manastirin e Shën Joan Vladimirit, manastir i cili u bë qendër për lëvizjen e përkthimit të librave të kishës në gjuhën shqipe për Elbasanin, ku janë gjetur mjaft dorëshkrime me përkthime të ndryshme të teksteve kishtare[524]. Për të vazhduar më tej me Teodor Haxhifilipi nga Elbasani (1730 – 1806), i njohur me emrin "Dhaskal Todhri", nxënës i Akademisë së Voskopojës, mësues dhe predikator i kishës së Elbasanit, i cili bën një hap të madh përpara. Kështu, përveç Dhiatës së Vjetër dhe të Re, ai përktheu në gjuhën shqipe meshën e Shën Joan Gojëartit, e cila siç dihet është pjesa më e rëndësishme e kultit orthodhoks dhe që përdoret potuajse gjatë gjithë vitit në Kishë, si dhe disa pjesë nga Orollogjio (Libri i Orëve). Natyrisht nuk mund të pretendohet për një përkthim të rregullt dhe cilësor. Dhaskali ka ndjekur tekstin grek fjalë për fjalë dhe ka përdorur shumë neologjizma, të cilat nuk i përshtaten natyrës së gjuhës shqipe. Megjithatë inisiativa është për t'u lavdëruar. Me këtë autor kemi një përpjekje serioze për përdorimin e gjuhës shqipe në Kishë. Një punë të ngjashme me të bën në Berat Kostandin Berati. Në dorëshkrimin e tij prej 152 faqesh, gjenden mjaft pjesë nga të shërbesave kishtare. Duhet theksuar se përkthimet e përmendura më lart, nuk patën ndonjë përhapje të gjerë, për arsye se nuk patën fatin që të shihnin dritën e botimit.

Ndërkohë që përkthimet e shekullit XIX dhe të fillimit të shekullit XX, të cilat janë botuar, patën një përhapje shumë të gjerë dhe sollën futjen njëherë e përgjithmonë të gjuhës shqipe në Kishën Orthodhokse. Këtu përmendim botimin e Ungjillit në gjuhën shqipe prej episkop Grigor Gjirokastritit, (1824 dhe 1858), dhe përkthimet kishtare të Kostandin Kristoforidhit (1830 – 1895) nga Elbasani, vazhdues i denjë i veprës së Anonimit të Elbasanit dhe Dhaskal Todhrit, i cili përkthen për nevojat e shoqërisë Biblike Britanike, Dhiatën e Re të plotë, e cila u botua në Stamboll, në dialektin verior në 1869 dhe në dialektin jugor në 1879. Rreth vitit 1868 – 1872 përkthen dhe boton Psaltirin, një nga librat më poetike të Dhiatës së Vjetër, ndërkohë që gjatë periudhës 1880 – 1884 shohin dritën e botimit pjesë të Dhiatës së Vjetër si "Të bërët" (Gjenesis), "Të dalët" (Eksodhos) dhe "Nomi i Dytë" (Dhefteronomia)[525].

Përkthimet e Kristoforidhit nga pikëpamja gjuhësore janë shumë më cilësore nga përkthimet e paraardhësve të tij.

Por punën më të madhe dhe më të organizuar për shqipërimin e librave liturgjikë dhe përdorimin e tyre në Kishën Orthodhokse e bëri imzot Fan Noli, i konsideruar si protagonisi kryesor i kombëtarizimit dhe pavarësisë së Kishës Orthodhokse.

Shqipërimet e Nolit përfshijnë fusha të ndryshme, në një vështrim të parë siç është konstatuar edhe nga ndonjë studiues, këto libra të përkthyera, mund të duken si pa lidhje me njëra tjetrën. [526] Por lidhja e brendshme që i bashkon përkthimet e tij, të

[523]Historia e Letërsisë Shqipe, Volumi I, Tiranë 1959. fq. 149 – 150.

[524]Ἄνθιμος Αλεξούδθης Σύντομος περιγραφή της Ι. Μητροπόλεως Βελεγράδων, Εν Κέρκυρα 1868, fq. 148 – 149.

[525] Hisoria e Letërsisë Shqiptare, Tiranë 1983, fq. 323.

[526] Aurel Plasari, Don Kishoti Zbret në Shqipëri, Tiranë 1987, fq. 162.

fushave të ndryshme, është përdorimi i tyre si armë në luftërat politike prej vetë atij. Kështu edhe në këtë rast tekstet liturgjikë të përkthyera prej Nolit, do të jenë qysh në fillim të kësaj inisiative, një armë e fortë në luftën politike për kombtarizimin e Kishës Orthodhokse. Kështu, Noli dorëzohet prift në 8 Mars të vitit 1908, prej mitropolitit rus të Nju Jorkut imzot Pllatonit, dhe celebron meshën e parë në gjuhën shqipe. Në lidhje me këtë eveniment Faik Konica shkruan në gazetën e tij Albania: "Dita kur Fan Noli celebroi meshën e tij të parë në gjuhën shqipe, është një pikë kthese në historinë e Rilindjes Shqiptare". Kushti i parë i vendosur prej mitropolitit në fjalë dhe sinodit të Kishës Ruse për dorëzimin e Nolit prift, ishte ekzistenca e literaturës të mesimit në gjuhën shqipe. Për këtë arsye qysh në pranverë të vitit 1907, Noli filloi punën për përkthimin e librit të parë liturgjik, kështu në Mars të vitit 1908 botohet në Boston libri i parë i përkthyer prej tij "Shërbesa e Javës së Madhe", që përmbledh këndimet prej së Shtunës të shën Llazarit deri të Shtunën e Madhe. Pikërisht që këtë moment e ka zanafillën dhe kritika e përkthimit të literaturës kishtare në gjuhën shqipe. Kështu në gazetën "Kombi", të dy Majit të vitit 1908[527], ka një artikull të posaçëm ku shprehet skepticizmi për këtë përkthim të Nolit. Këtu vihet në dyshim besnikëria ndaj origjinalit. Theksohet se Noli pak e njeh greqishten e vjetër, dhe se ai ndërkohë nuk është as teolog dhe as filolog. Ndërkaq Noli ia fillon punës për përkthimin e librit të dytë dhe në lidhje me sa shkruhet dhe thuhet për përkthimin e parë ai i shkruan Elefter Nosit (Lef Nosit) në Elbasan: "Kur të shtrohen punët, le të vijnë teologët dhe filologët t'i ndreqin, tani në Amerikë, ku t'i gjej unë? ". Ndërkohë që Faik Konica, do të shkruante në faqet e Albanias në lidhje me këtë përkthim dhe për Nolin si shqipërues të tekteve liturgjikë: "Ç'përkthim! Ç'gjuhë e fortë, e lidhur, nervoze (plot nerv) dhe e gjallë. Literatura shqipe do të kishte arsye t'i mbante mëri Kishës, që na vodhi një shkronjës të lindur. Por për fat të mirë, miku ynë, duke hyrë në Kishë, nuk doli nga letrat"[528]. Ndërkohë që profesor Aleksandër Xhuvani mban një qëndrim kritik ndaj përkthimeve të teksteve liturgjike të Nolit në përgjithësi, kritika e tij konsiston më tepër se në mënyrën e përkthimit në tërësinë e këtyre teksteve, që sipas profesor A. Xhuvanit, nuk duhet që të përkthehen totalisht. Pasi nuk do të ishte e udhës që popullit t'i përkthehesin të gjitha misteret e Kishës[529].

"Libri i Shërbesave të Shenjta të Kishës Orthodhokse"[530], është libri i dytë që u përkthye dhe u botua prej tij. Ky libër përmban shërbesën e mbrëmësores, të mëngjesit, të blatës së hyjshme, meshën e Shën Joan Gojëartit, shërbesën e pagëzimit, të martesës, të rrëfimit, të prehjes për të vdekurit, të bekimit të ujit, disa himne nga Oktoihu (Tetëtingullshi), si dhe zbritësoret e vitit. Në fund ky libër ka një fjalor me termat kryesorë të Kishës. Ky libër botohet në "Boston Mass" në vitin 1909. Në parathënien e këtij libri Noli shkruan: "Po u fal shqiptarëve orthodhoksë këtë libër, e cila është e dyta dhe pandeh që përdorja e saj do t'i sjellë një shërbim vendit tonë. I kam dhënë zotim kombit tim t'u ap vëllezërve të mi bashkëfetarë librat më të

[527] Gazeta Kombi, 2 Maj 1908, Boston, Sh. B. A.
[528] Nasho Jorgaqi, Jeta e Fan. S. Nolit, OMBRA, Tiranë 2005, fq. 202.
[529] Dhimitër S. Shuteriqi, Marin beçikemi dhe Shkrime të Tjera 1987, fq 262.
[530] Libri i Shërbesave të Shenjta të Kishës Orthodhokse, Boston Mass 1909.

nevojshme për të praktikuar faljen e tyre në gjuhën kombëtare, dhe zotimin tim do ta mbaroj ndofta brenda në pak kohë, në qoftë se shqiptarët janë gati të më ndihin, sikundër më ndihnë me të shtypurit e këtyre dy librave. Me të kthyer të kësaj libre u përpoqa të mos largohem nga teksti greqisht dhe besoj se u dhashë shqiptarëve një kthim ekzakt të lutjeve të kishës orthodhokse. Natyrisht nuk mund të mbetesha i kënaqur nga botimet e vjetra të atdhetarit të shkëlqyer z. K. Kristoforidhit, dhe u përpoqa ti ndreq ato që hynë në këtë libër pas përparimit që ka bërë gjuha shqipe që nga koha e tij, pa mohuar që puna e tij qe një ndihmë dhe një themeli për mua… Shpresoj se shpejt do të kuptohet nevoja e librave të tjerë që po pregatit, dhe kjo gjë do të më bëjë të punoj me më shumë mall e qëndrim"[531]. Përgjatë shumë numrave të "Lidhjes Orthodhokse" të vitit 1909, atdhetari Mihal Grameno, boton në faqen e fundit një njoftim, ku i fton të gjithë bashkatdhatarët e tij brenda dhe jashtë Korçës për të kontribuar materialisht në ndihmë të veprës së prifit shqiptar Fan Nolit, për përkthimin e literaturës kishtare orthodhokse në gjuhën shqipe[532]. Deri në fund të këtij aktiviteti do të jenë kryesisht korçarët, ata që do ta sponsorizojnë dhe do ta ndihmojnë ekonomikisht Nolin për të realizuar përkthimet kishtare. Libri i tretë i përkthyer prej tij është "Libri i të Kremteve të Mëdha të Kishës Orthodhokse". Ky libër i cili përmban hymnet kryesore të të kremteve të mëdha të Kishës, bashkë me pjesët e apostullit dhe Ungjillit, është një përbledhje e Mujoreve (Mineove). Ky libër u botua në "Boston Mass" në vitin 1911. Në parathënien e këtij libri Noli do të shkruante: "Duke shtypur këtë libër çkarkohem nga një barrë dhe me gas shoh që më mbetet vetëm dhe një libër fetar edhe për të botuar. Kjo do të jetë Triodi dhe Pendikostari i vogël, të cilin do ta kem gati nga vera që vjen. U lutem shqiptarëve që të ndihmojnë edhe për këtë libër të funtmë, e cila do të mbushë serinë e teksteve fetare orthodhokse më të nevojshme dhe do të më lerë të lirë të merrem me kthime veprash letrare, për të cilat kombi ynë ka aqë nevojë"[533]. Të dy këta libra, Noli ia dedikon mitropolitit rus Pllatonit. Kështu në hyrje të tyre, në faqen e dytë me gërma kapitale lexojmë: "Shenjtërisë së tij dhe atit tim, imzot Platon. Kryepishkopit të Amerikës së Veriut dhe të nisive Aleutiane, si shenjë reverimi dhe mirënjohjeje këtë vepër i dedikoj. Kthenjësi".

Libri i katërt kishtar i përkthyer prej Nolit është "Triodi i Vogël", i cili përmban hymnet e mbrëmjes dhe të mëngjesit të të dielave të periudhës së kreshmëve të mëdha si dhe himnin akathist, i cili është një poemë e madhe lirike e shkruar në greqishten bizantine, përkthimin e së cilës Noli është përpjekur që ta bëjë duke i ruajtur rimën e brendshme dhe muzikalitetin.

Ky libër u botua në Boston Mass në vitin 1913[534]. Libri i pestë që do të pasojë do të jetë "Lutësorja", i cili përmban hymnet e mbrëmjes dhe të mëngjezit të të tetë tingujve të Kishës dhe i korespondon Oktoihut të Vogël të Kishës. Disa nga himnet e këtij libri

[531]Libër i Shërbesave të Shenjta të Kishës Orthodhokse, Boston 1Mass 909, fq. 5.
[532]Mihal Grameno, Lidhja Orthodhokse, 31 Korrik 1909, fq 3. & 17 Gusht 1909.
[533]Libër i Kremteve të Mëdha të Kishës Orthodhokse, Boston Mass 1911, fq. 3.
[534] Triodi i Vogël, Boston Mass 1913.

ishin përfshirë edhe në "Librin e Shërbesave të Shenjta". Ky libër u botua në Boston Mass në vitin 1914[535].

Libri i gjashtë i përkthyer prej Nolit është "Pesëdhjetorja e Vogël", e cila përmban shërbesën e plotë të së Dielës së Pashkës së Madhe së bashku me mbrëmësoren, himnet e mbrëmjes dhe të mëngjesit të të djelave të tjera të periudhës së Pendikostisë me apostullin dhe Ungjillin e ditës, me përjashtim të së dielës së Gjithëshenjtorëve si dhe shërbesën e Shestes. Ky libër është një përmbledhje e Pendikostarit të madh të Kishës dhe u botua në "Boston Mass" po në vitin 1914 dhe përkthyesi ia dedikon këtë libër të atit të tij Stilian Mavromatit me përkushtimin: "Tim eti, që më rriti dhe më mësoi, dhe që vdiq i lënduar se më pa prift. I dedikoj këtë librë, duke i lypur ndjesë"[536].

Siç del edhe nga përmbajtja e parathënieve të këtyre librave, synimi kryesor dhe imediat i imzot Nolit në kushtet e atëhershme, ishte që në një kohë sa më të shkurtër t'u jepte shqiptarëve orthodhoksë të përkthyera në gjuhën shqipe pjesët më të nevojshme të Kishës, në mënyrë që ajo të shkëputej nga ndikimi i Kishës Greke. Këta libra të tij të pritur me gëzim nga të gjithë patriotët shqiptarë orthodhoksë dhe të përhapur gjerësisht në komunitetet orthodhokse shqiptare të Amerikës, të Bukureshtit, të Sofjes dhe në vetë Shqipërinë e robëruar, i sollën një kontribut të madh dhe çështjes kombëtare dhe gjuhësore[537].

Në një kohë më të përshtatshme, më vonë Noli i rishikon këto përkthime dhe përpiqet t'i plotësojë madje edhe t'i ripërkthejë tërësisht vende – vende. Kështu mbas një rishikimi të tyre, në vitin 1941 ai nxjerr "Uratoren e Kishës Orthodhokse", i cili me disa ndryshime të vogla është libri liturgjik i Kishës Orthodhokse që nijhet me emrin "Efhologjion to Mega". Në parathënien e këtij libri Noli thotë, se ky libër përmban shërbesat kryesore të Kishës Orthodhokse, disa prej të cilave si Mesha e Shën Vasilit, Mesha e Shën Grigorit, Shërbesa e Miros, Martesa e Dytë etj, botohen për herë të parë[538]. Në vitin 1947 Noli nxjerr "Kremtoren e Kishës Orthodhokse", i cili është bashkimi i dy librave të botuara më përpara i "Lutësores" dhe "Librit të të Kremteve të Mëdha", të dyja të rishikuara dhe të plotësuara prej tij siç shprehet edhe në parathënien e këtij libri, kur thotë se: "…të gjitha troparet janë hartuar pas ritmeve dhe melodive bizantine. Përkthimin e kemi bërë lirisht pas kuptimit dhe jo fjalë për fjalë, nga greqishtja, me përjashtim të këndimeve të Shën Kozmait të Beratit, të cilat i parafrazuam nga versioni shqip, i Kryehirësisë së tij Kristofor Kissit…. që të gjitha këndimet, që janë botuar më parë dalin në dritë të revizuara.. "[539]. Këtë libër ai ia kushton nënës së tij me dedikimin: "Nënës së dashur Maria Stilian Noli, për kujtim të përjetmë. Kthenjësi". Ndërsa në vitin 1952 Noli nxjerr librin "Triodhi dhe

[535] Luësorja, Boston Mass 1914.
[536] Pesëdhjetorja e Vogël, Boston Mass 1914, fq 2.
[537] Vehbi Bala, Jeta e Fan S. Nolit, Portret – Monografi, Tiranë 1972, fq. 4.
[538] Uratore e Kishës Orthodhokse, Boston Mass 194, fq 2.
[539] Kremtore e Kishës Orthodhokse, Boston Mass 1947, fq 2.

Pesëdhjetorja"[540], i cili është bashkimi i dy botimeve të mëparshme të "Triodhit" dhe të "Pesëdhjetores së Vogël", të rishikuara prej tij dhe në disa vende të plotësuara.

Në studime që specialistë të ndryshëm i kanë bërë kohë pas kohe këtyre teksteve të përkthyera prej Nolit, është shprehur mendimi se këto tekste lenë shumë për të dëshiruar përsa i përket besnikërisë ndaj origjinalit, që është në përdorim në gjithë Kishën Orthodhokse Lindore. Ashtu siç e thekson edhe Noli vetë në parathëniet e tyre, ai ka bërë një përkthim të lirë, shpesh ka shkurtuar madje edhe ka shtuar pjesë për hir të melodisë dhe të ritmit muzikor, shkalla e këtyre ndryshimeve është e tillë që fatkeqësisht nuk lejojnë që këta libra të përdoren në Kishë si tekste zyrtare, ndonëse janë shumë të mira nga pikëpamja e përshtatjes muzikore bizantine.

Uniteti i ritit liturgjik është një traditë e vjetër dhe një nga parimet kryesore të Unitetit të Besimit të Kishës Orthodhokse Lindore[541].

Pra, si përfundim, edhe në përkthimet e teksteve liturgjikë, imzot Noli shpreh karakteristikat e tij si një përkthyes i lirë në frymë që më shumë se çdo gjë përpiqet të ruajë muzikalitetin e vargut. Në lidhje me këtë element të vargut të Nolit, studiuesi prozator Mitrush Kuteli e ka cilësuar muzikalitetin e vargut si karakteristikë themelore të vargëzimit të Nolit. Strukturës muzikore të vargut, ashtu si në poezinë e tij dhe këtu në përkthimin e poezive liturgjike, Noli ia ka nënështruar të gjitha elementet poetike si dhe leksikun poetik. Ritmi, rima, ngjyra e tingujve, përsëritjet, anaforat, aliteracionet, janë ato që iu japin një muzikalitet të theksuar vargjeve dhe teksteve liturgjikë. Vargu me të cilin Noli ka shqipëruar sidomos poezitë bizantine, në këto tekste është 11-rrokëshi, ai e preferon këtë, sepse është një varg që merr muzikalitet të larmishëm dhe ka theksa të ndryshëm ritmikë. Në tërësinë e vet ekzistenca e këtyre përkthimeve është një pasuri e madhe filologjike me rëndësi të veçantë edhe përsa i përket fondit të leksikut dhe sidomos për përqëndrimin këtu të fjalëve plaka të rralla, të cilat Noli i përdor për t'i përjetësuar. Vargu dhe mendimi i lirë, stili ngjyrues artistik dhe mjeshtëria e fjalës janë gjithmonë prezente si kudo edhe në këtë lloj përkthimi të tij.

[540] Triodhi dhe Pesëdhjetorja, Boston Mass 1952.

[541] Dhimitër Beduli, Libër i Shërbesave të Shenjta, Tiranë 1961, fq. 21 – 22.

GËZIM RREDHI

MENDIMI KRITIKO –LETRAR I FAN NOLIT NË LIDHJE ME ARTIN KLASIK BOTËROR

Fan Noli është një rast shumë interesant në fushën e letërsisë sonë edhe përsa i përket mendimit kritiko letrar në lidhje me artin e madh klasik botëror. Vepra e tij dallohet para së gjithash për një ndjeshmëri të thellë e pasionante në këtë drejtim. Kultura dhe arti klasik shërbyen si një gur themelor në formimin e tij, ndërsa pasioni i tij i veçantë bëri që ai të sjellë në shqip në mënyrë virtuoze disa nga kryeveprat e letërsisë botërore, të cilat i shoqëroi edhe me gjykime interpretime, duke ia lehtësuar punën lexuesit shqiptar. Në kushtet e varfërisë kulturore, filozofike e letrare të Shqipërisë së kohës në të cilën jetoi Fan Noli, kjo ishte një gjë e madhe që askush para tij nuk e kishte bërë në këto nivele. Edhe pse ai jetoi në epokën e modernizmit, ndikimi i kulturës klasike në formimin e tij është përcaktues. Në erudicionin e tij gërshetohen e kryqëzohen kultura e Lindjes dhe ajo e Perëndimit, kultura klasike arabo-persiane dhe ajo greko-romake. "*I formuar në një trevë të rrahur prej këtyre dy kulturave të mëdha, nuk është e çuditshme pse edhe ka dalë me një kulturë dhe sensibilitet të dyfishtë, që është shkaku i gjerësisë shpirtërore dhe intelektuale. ''*[542]- shprehet studjuesi Rexhep Qosja. Siç është theksuar në studimet tona prej kohësh, Fan Noli marrjen me kritikë dhe mendimin letrar nuk e ka patur një obligim të thellë e të drejpërdrejtë, por më tepër një zgjedhje për t'iu përgjigjur çështjeve kombëtare dhe kontekseteve historike e politike të realitetit shqiptar. [543]. Sidoqoftë në të gjithë ato shkrime artikuj apo introdukte siç i quan ai hyrjet dhe përcjelljet me të cilat i nis për tek lexuesi shqiptar kryeveprat klasike, flasin jo vetëm për një artist të mprehtë e të thellë, por edhe një erudit të artit klasik. Nëpërmjet tyre ai ka ditur me mençuri e inteligjencë të krijojë paralele të epokave historike dhe të shprehë qëndrimet e e tij politike e morale, si dhe gjendjet shpirtërore të tij në kontekstin historik të botës shqiptare. Në formimin e Nolit, por edhe në kërkimet dhe hulumtimet e tij, të bie në sy adhurimi për gjithë kulturën klasike, në mënyrë të veçantë për antikitetin greko-romak, Rilindjen, epokën e realizmit, natyralizmit francez. Punimet dhe artikujt që ai shkroi flasin për hulumtuesin pedant që këmbëngul të zbulojë thelbin e çështjeve dhe problemeve që merr përsipër të trajtojë. Noli në veprimtarinë e tij studioi shumë vepra letrare, historike, filozofike dhe prej tyre ka vlerësuar, në radhë të parë, aspektet shoqërore, etike, ideore e filozofike dhe më pak ato të karakterit estetik. Noli të bie në sy si një lexues i thellë e me interesa të gjera, si një njohës i mirë i artit botëror, në mënyrë të veçantë të artit klasik. Interesimi i tij fillon me antikitetin e vjen gjer tek arti modern i fundshekullit XIX e fillimit të shekullit XX, me pjesë të veprës së Eskilit,

[542]. Rexhep Qosja, Panteoni i rralluar, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1988, fq. 177

[543]. Shih F. S. Noli, vepra 5, Tiranë, 1988, Parathënie nga Nasho Jorgaqi: Hyrje në mendimin letrar dhe estetik F. Nolit

Khajamit, Shekspirit, Servantesit, Ibsenit, etj, përmes së cilave do të përcjellë mesazhe të qarta për lexuesin bashkëkohës. Noli solli në kulturën shqiptare kryevepra të letërsisë botërore. Ky qëndrim e pasion ndaj artit klasik europian e botëror mbeten konstant e i pandryshuar edhe kur ndjeshmëria e tij do të orientohet drejt modernizmit të Edgar Alen Poes, Pol Verlenit, Sharl Bodlerit etj. Vihet re një pasion i veçantë për realizmin klasik, temat historike në mënyrë të veçantë që duket sidomos tek dramat e Shekspirit dhe ato të Ibsenit. Qartësia dhe thellësia e veprave që analizon, qartësia e mesazheve dhe ideve filozofike të tyre përbëjnë kodin e veçantë estetik të orientimit të Fan Nolit. Mendimi letrar e filozofik i Nolit është i shpërndarë në një periudhë të gjatë kohore. Jo rastësisht ai nis e mbyllet me Shekspirin gjeniun e Rilindjes europiane dhe, interesimi e gjykimi për të përfshijnë një hark kohor prej 60 vjetësh. Roli i Nolit si themelues i shkollës kritike letrare në gjysmën e parë të shekullit XX në Shqipëri është i madh e i padiskutueshëm. Aty gjendet jo vetëm zbërthimi i përvojave letrare europiane dhe botërore përmes artikujve, eseve, introdukteve etj., por edhe shtrohen probleme të rëndësishme historike, shoqërore dhe ekzistenciale të shoqërisë dhe kombit shqiptar. Formimi i Nolit me koncepte të filozofisë klasike shpesh të bie në sy në të gjitha interpretimet dhe analizat e veprave letrare. Ai në pjesën më të madhe ishte adhurues dhe mbështetës i filozofisë së pozitivizmit dhe teorisë së dijetarit francez Ipolit Ten, që ndikoi ndjeshëm në kulturën dhe mendimin letrar europian të shekullit XIX. [544] Sipas metodës sociologjike, idhtar i së cilës është Noli, vëmendja përqendrohet mbi autorin, idetë dhe përmbajtjen e veprës. Por viher re që në vepra studimore të formatit të madh siç është studimi "Bethoveni dhe revolucioni francez", autori përqendrohet në gërshetime të fakteve të drejtpërdrejta të personazhit me kthimet në të kaluarën e tij. Lidhur me këtë fakt studiuesi R. Qosja thekson: " *Në kritikat dhe studimet e veta Noli ka kombinuar shkencëtarin më të ndërgjegjshëm me artisin më subtil*"[545]. Dhe është pikërisht ky rigorozit i shkencëtarit dhe imagjinatë e artistit që ndeshen kudo në veprën e F. Nolit. Në shkrimet e Nolit në organet e shtypit si "Drita", "Kombi", "Dielli" apo "Albania" bie në sy një njohje e gjerë e kulturës, mendimit dhe letërsisë klasike. Ato përfshijnë gjithashtu sfera të ndryshme të dijes e kulturës botërore. Aty gjen mendime e gjykime për Aristotelin, Platonin, Kantin, Shekspirin, Volterin e gjer tek L. Tolstoi, B. Show, G. Hauptmani etj.

Formimi i tij i thellë e solid, si dhe pasioni artistik bie në sy që në disa nga artikujt e hershëm, ku shfaqet interesi për universin letrar klasik si psh. në artikutjt " Aktorët imoralistë" dhe "Shekspiri në rrezik" (1906), që në dekadën e parë të shekullit XX, ku ai në mënyrë të vendosur me argumente shkencore e gjykime që përfshijnë brenda vizionin dhe idetë e tij filozofike, shpreh konceptin e vet për lirinë e artit e të artistit. Noli vihet me guxim në mbrojtje të dy shkrimtarëve të mëdhenj europianë, dramaturgut gjerman G. Hauptman dhe norvegjezit H. Ibsen, të cilët akuzoheshin me fanatizëm si "*imoralistë*". Në të vërtetë sipas mendimit të Nolit këta dy artistë të mëdhenj u mësuan njerëzve *" një moral më të lartër, më të bukur, një moral që*

[544] Shih: Nasho Jorgaqi, vep. Cit. F. S Noli, vep. 5 (Parathënie: Hyrje në mendimin letrar dhe estetik të Fan Nolit fq.)

[545]. Shih Rexhep Qosja, vep. Cit. fq 193

s'mund të rrojë brenda ndër kufijtë e ngushtë të fesë[546]. " Në debatin për gjigandin e dramaturgjisë europiane, Shekspirin, në artikullin e përmendur më sipër, mendimet e tij i kundërvë edhe ndaj figurave të shquara të artit botëror si Volteri, Gëte, Show, Tolstoi, në lidhje me artistin e madh të Rilindjes. Në botën shekspiriane ai do të zbulojë me forcën e arsyetimit dhe erudicionin që e karakterizon thelbin e artistit të madh që thyen kanonet dhe rregullat e ngurta klasike. Ai do të shprehet: *"Volteri kërkonte një artist me rregulla, po Shekspiri ishte artist pa rregulla, përtej rregullit; po kush mund të thotë që në atë trubullim të bukurive të egërta të dramave shekspiriane, në atë "desharmonie"s'ka harmoni? "*[547]. Më poshtë shton: "*As me krishterimnë e Tolstoit, as me logjikën praktike të amerikanit Show nuk ka për të zbritur Shekspiri që atje tek hipi vetë me mendjen e tij të egërtë, të marrë, pa rregull, po të bukur si natyra.* "[548] Dhe pastaj në mënyrë të vendosur po aty shprehet: "*Ay që tha fjalën e fundit për punën e Shekspirit ishte filozofi gjerman Niçe: "S'duhet ta kuptojmë Shekspirin, po duhet ta ndiejmë"*[549]

Zbulimi i thelbit filozofik të artit humanist të epokës së Rilindjes është kërkesë e vazhdueshme e Fan Nolit në shkrimet kritike dhe studimore të tij. Ai i sheh idetë e veprës letrare si mishërime artistike që ngërthehen përms konflikteve të personazheve dhe situatave ku ata veprojnë. Përdorimi i metodës së analizës dhe sintezës në zbërthimin e motiveve të veprave letrare. Nga ana e Fan Nolit jepen disa modele të zbërthimit analitik të disa veprave të mëdha dramaturgjike siç janë introduktet për "Hamletin", "Jul Qezarin" "Makbethin", "Armikun e popullit" etj., si dhe për poezitë "Rubairat" e Omar Khajamit apo romanin e Servantesit

"Don Kishoti i Mançës". Ndërsa vepra "Bethoveni dhe revolucioni francez" përbën një analizë të nivelit të lartë shkencor, shprehje e interesave intelektuale të gjithanshme të Nolit.

Mendimi kritiko-letrar i F. Nolit u shfaq në një periudhë historike komplekse dhe është i shtrirë në një hapësirë e rrethana kohore dhe filozofike të ndryshme. Pasionin e veçantë dhe adhurimin e lidhjen e fortë shpirtërore për kulmet e artit klasik ai do ta shpalosë që në artikullin e parë për Shekspirin e në vazhdim në dekadat e mëvonshme. Përmes subjekteve dhe përmbajtjeve të veprave të tij, ai do të bëjë analiza në kërkim të ligjësive universale të jetës që ato bartin në vetvete. Ky pasion i veçantë dhe adhurim për humanizmin dhe iluminizmin që karakterizonte epokën e Rilindjes si dhe një lloj kulti për epokën e realizmit europian duken qartazi në të gjithë veprën e tij. Noli e mori formimin e tij kulturor e filozofik në kushtet e gjysmës së dytë të shek. XIX e fillimit të shekullit XX të një realiteti të larmishëm e të gjallë. Edhe pse ai e nisi punën në kushtet e një mungese thuajse totale të mendimit teoriko-letrar shqiptar, gati të një djerrine nga pikëpamja kulturore dhe estetike, në dy tri dekadat e para të shekullit XX do të shënojë një ngritje të ndjeshme e cilësore. Në mënyrë të veçantë ky progres do të ndiehet nëpërmjet punës së madhe të Nolit në

[546] F. S Noli, vep. 5, fq. 225
[547] F. S Noli, vep. 5 fq. 228
[548] Po aty f q. 228
[549]. Po aty fq. 228

lidhje me introduktet me të cilat shoqëron disa nga kryeveprat e letërsisë botërore. Në këtë drejtim kontributi i tij ishte i dyfishtë me sjelljen për herë të parë në gjuhën shqipe, por edhe me pajisjen e tyre me shënime kritike, që do të shërbenin si një çelës apo manual për të kuptuar thelbin e tyre universal. Për receptuesin shqiptar është e padiskutueshme se ishte një eveniment i rrallë kulturor ndjesia e shijes artistike të këtyre kryeveprave të kulturës europiane në gjuhën amtare. Nga këto sprova kritike e studimore, gjithsej tetë introdukte e disa artikuj, ese etj, një pjesë të madhe Noli ia kushton universit shekspirian, me të cilin gjithnjë e më shumë ndihej i lidhur shpirtërisht, thuajse i përfshirë në gjeratoren e veprës së tij. Temat e trajtuara në veprën e Shekspirit janë univesale dhe kanë pika të shumta referimi me realitetin, por mbi të gjitha Noli admiron ato pasi përbëjnë paralele interesante me botën e zymtë shqiptare dhe përpjekjet ekzistenciale të saj për të dalë nga terri i historisë. Kjo afërsi e referimit me realitetin shqiptar duket thuajse në të gjitha introduktet, ku përmes universalitetit të artit shprehen raportet e individit me shoqërinë, lufta për drejtësi e barazi sociale, kundër dallimeve raciale, klasore, etj. Noli nuk hyn në shumë analiza të aspekteve artistike të veprës. Në të gjitha introduktet ai përdor një skemë të qartë trajtimi, në fillim një njohje e shkurtër me autorin, mjedisin shoqëror e historik ku zhvillohen ngjarjet e pastaj një analizë e thelbit ideor e filozofik të veprës. I ndikuar nga metoda sociologjike e pozitivizmit ai ndalet më tepër në aspektin e funksioneve shoqërore e ato që lidhen me përmbajtjen ideore të veprës. Kështu në introduktin kushtuar "Otellos" ai do të japë përcaktime të vyera në lidhje me natyrën e përgjithshme dramaturgjike të veprës duke e përcaktuar si "*tragjedia e lidhur më mjeshtërisht se të gjitha veprat e tjera shekspiriane*"[550] si dhe do të bëjë karakterizime për personazhet dhe psikologjinë e tyre. Lidhur me karakterin e ngatërruar e djallëzor të Jagos dhe mjeshtërinë e Shekspirit në skalitjen e figurës së tij shprehet: "*Ligësia e tij do të ishte me të vërtetë e paduruar, po të mos ishte bashkuar me një hollësi mendjeje, thellësi psikologjike dhe mjeshtëri intrige të rrallë e të çudiçime* "[551]. Ndërsa në fund jep me tone përgjithësuese dramën e protagonistit, Otellos, pasi ka zbuluar të vërtetën tragjike: "*Për nderin e tij vrau Desdemonën, të cilën nuk do ta kish këmbyer për një botë të artë; për nderin e Republikës lëftoi tërë jetën e tij, për nderin e tij tani vret veten.* "[552]

Në tre tragjeditë e tjera të famshme të Shekspirit përkthyer prej Nolit dhe pajisur me shënime e analiza që janë" Hamleti", "Makbethi" dhe "Jul Qezari" mund të themi se përmblidhet i gjithë thelbi i teatrit shekspirian, universaliteti i mendimit të tij, fatin dhe psikologjinë njerëzore. Por aty mbi të gjitha nga ana e Nolit jepet një mesazh për botën shqiptare, grupet politiko-shoqërore, sfidat e pritshme për njeriun dhe kombin shqiptar. Paralelizmi me kontekstin historiko-shoqëror shqiptar është mjaft i pranishëm e madje ndonjëherë ndihet një lloj prirje tepërimi.

Në tragjedinë "Hamleti" Noli mundohet të zbulojë thelbin e hamletizmit, të kësaj drame siç shprehet që në hyrje të introduktit *"të çvilluar e të zbukuruar me një*

[550]. F. S Noli, vep. 5, fq. 170
[551]. Po aty, fq. 172
[552] . Po aty fq. 174

mjeshtëri aq të çuditshme, saqë mund të quhet vepra theatrale edhe më popullore edhe më e thellë që luhet mi shkenë"[553]. Siç dihet tek Shekspiri aftësia hipnotizuese, imagjinata tejkalojnë çdo lloj kufiri njerëzor. Për Nolin, lexues të thellë, tërë tragjedia e shpirtit të Hamletit përmblidhet në vargjet:

"*Kjo botë u çthur o prapësi, o dreq,*

që unë paskam lindur të të ndreq". Ai i bënë një përshkrim të denjë e sugjestiv për lexuesin andrallave dhe vuajtjeve pa fund të Hamletit, këtij shpirti delikat që befas "*i përmbyset bota mi kokë*", *"S' është as i gjallë as i vdekur, as i marrë as nër mënt; ndodhet buzë vdekjes, buzë vetëvrasjes, buzë marrëzisë, buzë greminës, , ku e di që shpejtn a vonë do të përmbyset e do të copëtohet. Mendja e tij banon në varrezat, midis fantazmave, skeleteve dhe kafkave... [554] " "Gjakmarrja e tij është një vepër arti... " "Hamleti është piktura më e pasur dhe ë e thellë që ka dalë nga penda e Shekspirit…Hamleti është dushku më i lartë dhe më i bukur i pyllit shekspirian"*[555] etj.

Tek " Jul Cesari" dhe Makbethi" Noli përmes një njohjeje të thellë të problematikës dhe vlerave të këtyre tragjedive synon ta çojë lexuesin në përfundime e domethënie të qarta në lidhje me situatën politike të kohës, ndoshta edhe duke kaluar në teprime të disa analizave politike. Sidoqoftë në këto vepra ai përpiqet të nxjerrë thelbin e vërtetë filozofik që ato mishërojnë në raportet e forcave politike, por edhe në lidhje me dhunën e ngjarjet historike që ato ngërthejnë. Kështu që në hyrje të introduktit për "Jul Qesarin" në lidhje me ngjarjet që përfshihen në subjektin e veprës shprehet: "*Shekspiri nuk bëri tjatër veçse t'i dramatizonjë, po i ka lidhur aq bukur sa ka krijuar veprën theatrale më të fortë të botës dhe e ka sintetizuar këtë periudhë të historisë romane aq mjeshtërisht, sa "Jul Qesari" i tij i shkurtër vlen më tepër se duzina vëllimesh mi këtë themë prej historianësh të specializuar"*[556]

Në hyrjen e Makbethit Noli shkruan: *Asnjë vepër tjetër teatrale nuk përmbledh në një vënt aq të ngushtë një gjëmë aq të madhe prej ngjarjesh tronditëse dhe ngjethëse sa " Makbethi", tragjedia më e tmerruar që ka dalë nga penda demoniake e Shekspirit*[557]" dhe më tej përmes një analize të shkurtër, por të ngjeshur me mendim, e karakterizon atë saktësisht si "*pasqyrë e tërë historisë së Skotlandës*", kritikë të "*sistemit terrorist", "tragjedi e ambicies kriminale".*

Noli si një njohës i shkëlqyer i letërsisë botërore bën edhe përzgjedhje të goditura për lexuesin. Kështu jo vetëm në përkthimin, por edhe në gjykimet e tij përmes introdukteve, zgjedh jo më kot H. Ibsenin, të cilin kritika e konsiderojnë edhe sot si *"një dramaturg tejet original…post-shekspirian në të gjitha mënyrat e krijimeve të tij* [558]. Në lidhje me dramaturgjinë e H. Ibsenit Noli zgjodhi dy dramat me temë social-historike, ku veprojnë karaktere të forta e dramën "Zonja Ingar e Ostrotit" dhe "Armiku i popullit" që janë të përafërta me dramat e Shekspirit. Në introduktet që

[553]. Po aty fq. 175
[554] Po aty fq. 177
[555] Po aty fq. 177-179
[556]. F. S Noli, vep. 5, fq. 182
[557]. F. S Noli, vep. 5, fq. 192
[558]. Harold Bloom, si dhe përse të lexojmë, Tiranë 2008, fq. 237

shoqërojnë ato Noli bënë vlerësime për autorin, por edhe për dramaturgjinë ibseane si dhe zbërthime analitike të figurave të Ingrës dhe Shtokmanit. Në lidhje me Ibsenin shprehet në hyrjen e introduktës për "Armikun e popullit: " *I math si norvegjian, është ca më i math si europian. Nga teknika dhe forca dramatike qëndron në radhën e parë pranë dramatistëve të shkëlqyer, të vjetër e të rinj, të letrëtyrës së përbotëshme*"[559], ndërsa lidhur me mjeshtërinë e veçantë të Ibsenit për t'u dhënë forcë dramatike karakteve dhe mjedisit që ato përfaqësojnë thekson: "*…s'duhet harruar që njerëzit modernë e kanë humbur individualitetin aq sa janë bërë me të vërtetë kuklla, qoftë nga edukata uniforme, qoftë nga idealet e përbashkme, dhe Ibseni si artist, nuk bën tjatër veçtë na i përshkruanjë marionetat ashtu siç i kishte parë të lozin"*

Krahas analizave të veprave dramaturgjike në introduktet e tij Noli bëri objekt studimi edhe poezinë dhe prozën, në mënyrë të veçantë me kryeveprën e poezisë persiane "Rubairat" e O. Khajamit dhe romanin e famshëm "Don Kishoti i Mançës" të Servantesit. Nëpërmjet përkthimit të këtyre dy veprave si dhe analizave e interpretimeve ideore e artistike Noli e ndihmon lexuesin shqiptar për të shijuar në gjuhën amtare esencën artistike dhe filozofike të tyre. Në introduktën për "Rubairat" ai gërsheton analizën e gjerë të mjedisit historiko-social e kulturor ku ato lindën me temperamentin artistik të Khajamit si një armik i çdo lloj dogmatizmi. Noli jo vetëm i saktëson e përcakton këto krijimeve për vlerat e tyre si nga "*më të bukurat e botës*" e që janë "*aq të thella nga kuptimi sa një Rubai vlen disa togje vëllimesh, aq moderne nga mejtimet dhe ndjenjat sa na duket që autori i tyre ka rrojtur në kohët tona dhe në zemër të Evropës[560]"* por edhe ndalet në analiza të motiveve, gjendjeve emocinale e psikologjike të poetit në historinë e përkthimeve të tyre në botën letrare perëndimore etj. Gjithashtu, shënimet e shumta që shoqërojnë veprën në formën e komenteve, sqarimeve, janë pjesë përbërëse e vlerave të mendimit kritik të Nolit në aspekte të ndryshme me karakter letrar, historik apo filozofiko-estetik. Ai vlerëson Khajamin, këtë dishepull të "Lirisë së Mejtimit" dhe veprën e tij jo vetëm për lirinë e fjalës dhe guximin qytetar, por edhe për forcën magjepsëse të artit të tij: "*Me temperament artisti, ka kërkuar e ka nxjerrë mjaltë nga çdo kopësht e nga çdo lule e vjetërisë kllasike*[561]"

Mendimi kritik i Nolit shënon një stad të ri sidomos në artikujt, shënimet apo introduktin që shkruan pas përkthimit të romanit "Don Kishoti i Mançës", ku ai do të zbulojë disa nga vlerat më të spikatura të kësaj vepre të madhe. Që në fillim në artikullin e shkurtër, në formën e një shënimi që shoqëron përkthimin e romanit si një nënfletë në gazetën "Republika" ai e josh lexuesin me shprehjen*: "Ka nja njëzet a tridhjetë kryevepra letrare, të cilat s'duhet të vdesë njeriu para se t'i këndonjë"*[562]. Forca dhe bukuria e artit të Servantesit për Nolin qëndrojnë në thelbin e veprës, në atë mpleksje aq të natyrshme e të mrekullueshme të komikes me tragjiken. Figurën e Don Kishotit në dualitetin me Sanço Pançën ai e sheh si një përgjithësim historik të

[559]. F. S Noli, vep. 5, fq. 196
[560]. F. S Noli, vep. 5, fq. 206
[561]. F. S Noli, vep. 5, fq. 213
[562]. F. S Noli, vep. 5, fq. 246

anakronizmit: "*Don Kishoti është një fantazmë që ka ikur nga muzeu i kohës së mesme dhe po shetit në Spanjën gjysmë të modernizuar të shekullit shtatëmbëdhjetë… Është tipi i ëndërronjësit që rron me me prrallat e librave dhe jo me faktet e jetës"* ndërsa " *Ndryshimi i madh midis Don Kishotit Sanço Pançës është se ky i fundmi s'ka kënduar libra të kalorësisë…. dhe është më i mençur se ustai i tij, se librat s'ia kanë shtrembëruar mendjen.* [563]*"* Pra Noli, ka ditur të zbërthejë e të paraqesë para lexuesit mendimin e vet kritik për anën groteske e tragjikomike të Don Kishotit e Sanço Pançës, si dhe ravijëzoi për herë të parë në kulturën shqiptare filozofinë e donkishotizmit si një mendësi.

Në mendimin kritik të Nolit gjithashtu me interes janë edhe gjykimet e tij për gjeniun rus Leon Tolstoin, botën komplekse dhe kontradiktat që kanë shoqëruar jetën dhe veprën e njerit prej figurave më të shquara të letërsisë botërore. Figurën dhe personalitetin artistik të Tolstoit si dhe raportet e tij me shoqërinë, Noli i shpjegon përmes vizionit të filozofisë materialiste, origjinës klasore, mjedisit shoqëror dhe historik në të cilin ai jetoi.

Si përfundim, mund të themi se Noli në kushtet e zbrazëtirës që ekzistonte në kulturën shqiptare hodhi bazat e mendimit kritik, të cilat do të shërbenin si një urë komunikimi me artin dhe kulturën botërore. Puna e tij si kritik, analizat mjeshtërore dhe gjykimet artistike për veprat e artit të madh europian e botëror jo vetëm e lartësuan figurën shumëplanëshe të F. Nolit, por edhe hapën udhën e një disipline të pavarur që do ta emanciponte më tej kulturën shqip.

[563] F. S Noli, vep. 5, fq. 218

HAMIT XHAFERI

VËSHTRIM MBI STUDIMIN E NASHO JORGAQIT "UDHËTIM ME FAN NOLIN"

Studiuesi i njohur Nasho Jorgaqi, një pjesë të veprimtarisë së tij studimore, do t'ia kushtojë jetës dhe veprës "*së personalitetit të shquar të kulturës shqiptare*" - Fan Nolit. Në studimin "*Udhëtim me Fan Nolin*" bën fjalë për ideologun e njohur, personalitetin me prirje të shumta prej letrari, historiani, vjershëtari, krijuesi dhe studiuesi veprash të kulturës muzikore dhe përkthyesit autentik. Ky studiues ia doli të përmbledhë dhe analizojë në mënyrë të përsosur përmes mbresave dhe persiatjeve të tij nga rrugëtimi kërkimor "*në Thrakë dhe SHBA*", duke rrahur një sërë çështjesh, mendimesh dhe pohimesh të njerëzve që e kanë ditur përnjëherësh Nolin apo nga burimi i shkresave, korrespondencave, shënimeve të mbajtura, fjalimeve, sidomos "*në Shqipëri dhe në SHBA*". Në vështrimin e tij, vërejmë kujdesin e jashtëzakonshëm për të mbledhur dhe analizuar në hollësi, pikëpamjet themelore të gjithanshme të Nolit, për të formuar për te një mendim sa më të saktë e të drejtë. Kjo është dhe arsyeja kryesore e këtij studiuesi që e nxiti edhe më shumë për të arritur gjer tek burimet e veprimtarisë poliedrike të Nolit, që në vete ngërthejnë veçori thelbësore dëshmuese siç është vepra monografike "*Udhëtim me Fan Nolin*".

Noli në jetën letrare shqiptare shfaqet si krijues me dhunti e veti natyrore prej poeti, që disponon hollësi të lehtë të letrarit të zhdërvjellët dhe njohuri të përgjithshme letrare. Noli njihet dhe pranohet si disidenti, me të gjitha determinantet e veta historike, psikologjike, sociale dhe politike, me të gjitha synimet dhe vuajtjet, mungesat dhe mundësitë, njeriu që më së miri mundi t'i kuptojë problemet e racës së vet, të flasë në emër të kësaj race, ta mbrojë dhe udhëheqë atë. Si i këtillë është përpjekur të shqyrtojë dhe të krijojë thelbin cilësor të çështjes, me qëllim që të provojë ta ngacmojë mallëngjimin e ngashëryer me ekzistencën njerëzore dhe me bëmat e njeriut gjatë kësaj jete, pra, me çdo gjë që i rri Nolit si një kurorë e ndritshme e hirit hyjnor. Meqë mënyra për të hyrë në qenien e brendshme të njërit prej personaliteteve më të shquara "*të historisë dhe kulturës*" sonë është pasqyrimi më thelbësor dituror. Edhe profesor Muzafer Xhaxhiu, tashmë i ndjerë, në trajtesën e tij "*Udhëtim në botën noliane*", duke u orvatur të ndriçojë gjurmët e Nolit, ai fillimisht dëshiron të flasë për Nolin si poet, duke e krahasuar këtë me vjershëtorin romak Horaci i cili shprehet me fjalët: "*Njihe mirë brendinë e përmbajtjes se mendimet dalin natyrshëm*". Kohë më parë është bërë modë e kritikës që të shahej poezia si e pazonja për të dhënë tablo të tjera e të thella të jetës. Duke harruar se Noli është poet (Marku R., Tiranë, 1983, f. 79).

Në këtë mënyrë edhe stili i qartë i krijimit të Nolit është i gjallë dhe konkret. Secila thënie apo mendim i plotë i tij ka rëndësinë e vet, shkon drejt një pike takimi të përbashkët që përqëndrohet dhe përfshin gjithçka. Ky mendim flet në mënyrë të qartë për: "*... rrugëtimin gjurmues me peshë që ka të bëjë me Nolin dhe fatin e tij"*.

Fillimisht do të doja të them se ky studim i N. Jorgaqit është një kontribut me vlerë që flet për Nolin si personalitet me emër, por që duhet të zërë vendin që i takon në letërsinë tonë. Kur flasim për Nolin dhe veprimtarinë e tij, është e domosdoshme të hyjmë me zell të madh në përfytyrimet mistike noliane, duke iu shmangur disi yshtjeve frymëtare për t'u lidhur me vlerat e vjetra historike të kohës. Themi kështu, sepse kjo është koha e njëjtësimit të autorit me veprën e vet. Noli militant dhe bashkëkohës i një letërsie, flasin me mirëkuptim për të nxjerrë në shesh dallimet ndërmjet letërsisë së tyre, dallim që e shpie letërsinë shqipe me të dy këmbët në modernitet (Hamiti S., 1996, f. 59). Për shembull, profesoresha Floresha Dado duke analizuar veprat e F. Nolit, do të thotë se "*ne synojmë të zbulojmë sistemin, domethënë veprat letrare të tij, me këtë rast hetojmë edhe lidhjet e tyre me rende të caktuara të realitetit historik, social, filozofik*" (Dado F., Tiranë, 1996, f. 25). Mendimi i Nolit mbi historinë e letërsisë sonë është kontribut i konsiderueshëm për rolin dhe rrethanat në të cilat u gjend populli ynë, të cilat kanë lënë mbresa të thella në botën e brendshme të tij. F. Noli me kulturën e tij të pasur filozofike e letrare dhe me konceptin e gjerë për letërsinë, gjatë analizës së tragjedisë "Makbethi" e thekson posaçërisht që në krye të shkrimit të vet hyrës se vepra "mund të gjykohet e të admirohet nga disa pikëpamje të ndryshme, po veçanërisht nga këto të tria që pasojnë... ", duke pranuar kështu mundësitë e ndryshme të receptivit, të kuptimit e të interpretimit të një vepre letrare (Muhametaj E., Tiranë, 1983, f. 117).

Për Nolin, si një figurë mitologjike magjepse e përfytyruar do të mbetej Amerika, nga e cila do të mbesë gojëhapur nga pamjet e mrekullueshme dhe mbresëlënëse të Nju Jorkut gjigant. Për këtë qytet me madhështinë e tij, të cilin e shikon për herë të parë, "*Noli ndër të tjera do konstatojë se këtu - janë mbledhur dhe ngulitur e mrekullueshmja dhe e jashtëzakonshmja, mirëqenia dhe begatia e rruzullit tokësor. I lë përshtypje marramendëse gjallëria dhe vrrulli i madh i shkallës së zhvillimit kulturor dhe ekonomik amerikan*". Noli duket sikur vetëdijshëm del nga plogështia duke hyrë në fshehtësitë e pashpjegueshme amerikane me ndjenjën e shqetësimit të thellë duke i dalë nga mëndja se për ç'arsye ka ardhur. "*I thotë vetvetes në heshtje s'largohem dot nga përfytyrimet shpirtërore, s'largohem dhe s'heq dorë nga ky gjëllim në të cilin synoj të garoj brenda natyrës sime*".

Libri "*Udhëtim me Fan Nolin*" është një "*ekskurs studimor*", pra tërësi në vete, që ka të bëjë me rrugëtimin hulumtues. Është ky një rrugëtim i një teksti letrar të veçantë i cili nuk "*do ishte i plotë*" nëse mbështetemi vetëm në leximin e opusit të krijimtarisë letrare dhe shënimeve, të dhënave të ndryshme apo dëshmive, pa krijuar për "*së afërmi*" një imazh mbresash të fuqishme mallëngjyese dhe para së gjithash që kanë të bëjnë me qenien dhe krijimtarinë e Nolit. Noli me bashkëkohësit e tij, në një rivalitet të pashpallur, mbetet origjinal, sepse në veprën e tij madhore ka peshë mendimi, ka lartësi qiellore dhe gjerësi tokësore frymëzimi, ka nivel të lartë artistik, ka origjinalitet perlat, ka erudicion intelektual e komunikim të menjëhershëm, ka art poetik (Çapaliku A., Tiranë, 1983, f. 328-329). Kjo lidhje e përafërt dhe përjetuese do të perceptohej si një mjedis i ngushtë në një hapësirë të jetës në prehje, shtrirja e gjerë brenda së cilës plotësohet me pikëpamje e gjykime, me imagjinatë, me përfytyrime nga lexuesi i pasionuar. Megjithëse përpiqesh për t'i vështruar përnjëherë faqet e këtij

shkrimi, ngaqë gjithçka që shënohet dhe hartohet të ngulitet thellë dhe s'të lë të humbasësh. Shënimet, dëshmitë, shkëmbimi i mendimeve dhe ngjarjeve, vetvetiu fitojnë kuptimin e tyre në shtjellimin e një rrëfimi të rrjedhshëm e të ëmbël. Të gjitha gjërat që paraqiten në këtë vepër ndodh që t'i kesh ditur edhe më herët, sidomos në "*Autobiografinë*" e tij, mirëpo është e këndshme kur e lexon sërish këtë libër, të duket se takohesh me vetë Nolin.

Kur e kemi parasysh faktin se Noli s'u çmall asnjëherë me vendlindjen e tij, ndjenja e tij e zjarrtë për vendlindjen nuk e kapërdiu një realitet të këtillë duke menduar dhe sajuar gojëdhënën kinse Noli pas braktisjes së atdheut dhe arratisjes përkohësisht në Greqi duke qëndruar një natë në rrethinën e Thrakës, tek njerëzit dhe familjarët e tij. Shkuarja e Nolit atje dhe takimi i tij me bashkëkombasit e vet në këto anë, përfshijnë disa nga faqet më të dashura dhe të pëlqyera të librit. Në të ka përshkrime mallëngjyese, ndjenja, mendime, dëshira të thella vetjake, të fshehta që ngjallin ngashërime të thella. Faik Konica, Nolin do ta quajë "*shembëlltyra e shqiptarizmës më të qytetëruar dhe e vetëmohimit intelektual për identitetin kombëtar*". Flet me pasion të madh për krijuesin e federatës atdhetare "*Vatra*", për kontributin e jashtëzakonshëm të diasporës për çështjen kombëtare. Bën fjalë për revistën "*Albania*" *që ka qenë tribuna e parë e kulturës, e historiografisë, e kritikës shqiptare*. Noli, gjatë analizës së tragjedisë "Makbethi" të U. Shekspirit, duke shpjeguar raportin e njohur midis historisë dhe letërsisë, të pranishëm në këtë vepër si dhe në tragjedi të tjera me temë historike të dramaturgut të madh, e vë theksin në thurjen *bukur* dhe në sintetizimin *mjeshtëror* në të nga autori të ngjarjeve historike, çka u jep atyre një vlerë të madhe njohëse dhe i mundëson lexuesit t'i nxjerrë vetë, natyrshëm, përfundimet që rrjedhin prej rrëfimit artistik të tyre. Në këtë mënyrë Noli, edhe veprat me temë historike, vlerëson, në radhë të parë, artin e shkrimtarit, duke dalluar qartë të vërtetën artistike nga ajo historike (Muhametaj E., Tiranë, 1983, f. 119). Mjaft kuptimplotë është në këtë vështrim roli botues i "Diellit", *zbuluesi i flamurit të shqiptarëve, e mbi të gjitha, Fan Noli si* "*stilist i përkryer, studiues i shkëlqyer dhe patriot i madh*" (Kuçuku B., Tiranë, 1983, f. 37).

Konica ka ditur të kapë disa çaste nga jeta dhe veprimtaria e Nolit që i kanë ndihmuar për të bërë të njohur lexuesin me artin e tij, pjesët që të prekin thellë në zemër nga skena tronditëse, me anë të së cilës vihen në pah vitet e jetës së Nolit, këtij mërgimtari të madh. I tillë ka qenë mes tjerash edhe rasti kur Theofani një djalë i ri, "*i hipur në kalë*", braktis fshatin e tij për të mos e parë me sy asnjëherë më, vajtimi me dhembje i nënës dukej i trishtueshëm, "*nëpër shtëpi*" mbretëronte një atmosferë e zymtë dhe e pa shpresë, pasi ajo ndahet përgjithmonë nga i biri i cili merr në sy "*rrugën e kurbetit*", që të lëndon në zemër dhe të bën të vuash shpirtërisht. Letrat e shkruara me plot ankth e vuajtje shpirtërore, nga vëllai Dhimitri dhe motrat, të cilët i drejtoheshin vëllait të tyre me ndjenjën e dashurisë së dhembshur, me ankesa për mjerimin dhe skamjen, me besimin se do ua shtrij dorën e ndihmës për t'i nxjerr të paktën nga uria e kafshatës së bukës, ishin nga më prekset thellë në zemër dhe më shqetësueset.

Ndjenja e hidhur e largimit pa kthim nga atdheu u plotësua me dhembje të thellë shpirtërore, me gjurmë përfytyrimi, me ëndrrën e gjatë e të pashpresë të

emigrantit se ndonjëherë do të kthehet biri i tyre, që simbolizonte fisnikërinë e fshatrave shqiptare të Thrakës dhe gjithë Shqipërisë. Në vend të pritjes dhe kthimit, u kthyen dhe rithurën gojëdhënat e shumta që shfaqën zëra sa mallëngjyese aq edhe tronditëse, të cilat prekën thellë rrugëtimin e mërgimtarit nëpër të cilin u përshkua odiseja da noliane. Në këtë libër N. Jorgaqi i qaset me një interesim të veçantë analizës së emocioneve specifike dhe psikologjisë së njeriut shqiptar, pastaj në një mënyrë të natyrshme përshkruan vetëdijen njerëzore të takimit me bashkëvendasit. Që kjo vërtet t'i ngjajë një legjende, sa për ilustrim ne do përkujtojmë takimin interesant dhe mjaft rrëqethës me Nolin të "*fshatarit Risto nga Feresi*", i cili përshkohet me fjalët: "*Njeriu di të thotë u ndeshëm me vëllanë, por s'di të thotë kur do të takohet prapë e a do të takohet? Kësisoj janë rrugët e largimit, të hidhur nga herë. Nuk i di njeri këto si i dimë ne që rrojmë këtu në mes rrugëve të botës*". Ne do të thoshim për këta rrëfime të holla e të mprehta të burrit të vjetër në moshë "*Risto Ballkani*" shprehin një ndjenjë përjetimi të botës së brendshme të "*fshatarëve të Thrakës, që u ndanë nga Noli për të mos e parë më kurrë*". Nga të gjitha që i vërejti, mësoi dhe kuptoi drejtpërsëdrejti Nasho Jordaqi nga familjarët më të ngushtë dhe bashkëvendasit e Nolit, ne sot na mundësoi të kemi një pasqyrë më të qartë e të plotë për jetën mërgimtare të Nolit që kjo jetë e shpuri diku larg "*surgjyngjallë e syrgjynvdekur*", "*në udhët e botës siç këndon ai për Viganin Liberalor Luigj Gurakuiqin*". Duke ecur pas rrugëtimit të Nolit, lidhjeve dhe takimeve të përafërta e të gjalla, N. Jorgaqi do të thotë se: "*isha afruar më shumë Nolit dhe e shikoja më qartë figurën e tij*".

Kur flasim për Nolin duhet sintetizuar mendimin mbi afrinë e gjakut a ferefisnisë familjare dhe kombëtare. Kur e kemi parasysh faktin se ka marrë një edukatë të caktuar në një ambient fshatarak, me rregulla e norma të formimit të botës shpirtërore të mjedisit, e mbi të gjitha për faktin e thjeshtë se e braktisi fshatin e tij në moshën djaloshare. Aty ai piu nga gjiri i nënës njëkohësisht qumshtin e shëndoshë edhe gjuhën amtare me tërë fuqinë dhe mprehtësinë e jashtëzakonshme mendore të ambientit rural, për të fituar cilësi të mira me vlera të mbarsura në ato pamje tërheqëse e të jashtëzakonshme të tij. Gjithashtu gjer në kohën tonë, siç na rrëfen në studimin e tij N. Jorgaqi, "*ajo ruhet e pastër*", me zërin e hollë e të kumbueshëm shqiptar, edhe pse ndeshim në të shumë "*greqizma e turqizma*". Ajo që është sot më brengosëse se dita-ditës gjuha shqipe në këto mjedise shqiptare po zbehet, ajo gradualisht po shuhet. Kjo gjuhë e vjetër dhe e bukur shkon drejt blozës së harresës, kujtohet me prekje të thellë në zemër nga thrakasit. Këta shqiptarë janë vënë para aktit të kryer të politikës asimiluese të fanariotit grek. Me vdekjen e moshave të vjetra, vdes dhe gjuha shqipe. "*Duke shëtitur lartë e poshtë nëpër Thrakën greke, - kumton studiuesi-tek e takoj dhe bisedoj me vëllezërit tanë që jetojnë këndej, bindem përherë e më shumë se në këto vise gjinden një nga vatra të diasporës sonë ende të panjohur... Para hulumtuesit dhe studiuesit tonë shtrihet një term krejt i virgjër. Eshtë kjo një minierë vlerash që pret gjuhëtarin, dialektologun dhe etimologun, poetin dhe historianin, etnografin, muzikologun, Sociologun*", përfundon studiuesi. Studiuesi dhe kritiku letrar, dr. Ibrahim Rugova është i mendimit se "Noli, në vështrimet e tij hyrëse për vepra të shquara, të përkthyera nga letërsia botërore, nisej, siç është vënë re, "nga sociologjia pozitive dhe nga koncepti etik për artin dhe letërsinë". Po kështu edhe Enver

Muhametaj do të thotë për Nolin se "metoda e tij sociologjike pozitive, në kritikën e tij hyrëse gërshetohet herë-herë me elemente të metodës psikologjike. Si një ndër kritikët më aktivë të periudhës në fjalë, kryesisht në analizat e tij për poezinë, do të zbatojë në kritikën tonë metodën e analizës formale, e cila vëmendjen kryesore ia kushton, si dihet, shqyrtimit e zbërthimit të elementeve të formës, pra, analizës së brendshme, imanentëve të veprës letrare".

Është shumë shqetësuese dhe pikëlluese që të detyron të vrasësh mendjen sesi shuhet heshturazi prejardhja arvanitase, nga goja e të cilëve doli me tërë muzikalitetin dhe krenarinë e saj kjo gjuhë e vjetër, të cilën e fliste me ëndje dhe dashuri dhe atdhetari i shquar Theofan Noli. Duke hyrë në thelbin e kësaj gjuhe të natyrshme, secili hulumtues shkencor do të dëshironte ta njihte më mirë e më thellë. Një shembull ekzemplar i kësaj gjuhe është vetë Noli: kur e dëgjon fjalën e gjallë të shqipes së tij, të inçizuar në shiritat e magnetofonit në Boston, mbetesh me gojën hapur dhe mahnitesh me elekuencën dhe larminë e vlerës së saj, kur dihet mirëfilli se Noli në Shqipëri kishte qëndruar vetëm disa vite. Kur ballafaqohesh me një realitet të këtillë, menjëherë të rrotullohet mendja mos vallë kjo është çështje vetëm e figurave të veçanta të albanologjisë. Pa dyshim, kjo gjuhë e gjerë dhe e thellë është reflektuar edhe në folklorin e arvanitasve dhe në kulturën e tyre shpirtërore dhe materiale. Ja dhe një shembull tjetër të gjallë: kur Konstandini i shqipëroi N. Jorgaqit një këngë popullore shqiptare model, të publikuar shumë kohë përpara në "*Thraqika hronika*" me këtë rast ky interesohet për fatin e tyre dhe do të dijë mos vallë gjenden motërzime këngësh të tjera si kjo në Qytezë, Konstandini ngre supet, ul kokën dhe përgjigjet me një zë të ulët duke pohuar me ndjenjën e dhembshurisë dhe hidhërimit: "*Sa këngë vanë! Humbën nëpër mote, i morën pleqtë me vete! Tani që u kujtuam ne është vonë*". Megjithkëtë, simbol zotërues mbetet shpella në të cilën jehonat e klithjeve të ndryshme të këtyre këngëve tingëllojnë njësoj dhe nuk mund të dallohen nga të tjerat.

Janë mjaft interesante takimet dhe shkëmbimet e mendimeve me bashkëkombasit arvanitas të Thrakës së moçme, N. Jorgaqi na rrëfen siç thotë ai "*disa grimca nga e folura e tyre*" që në ndërgjegjen tonë lënë mbresa të thella me veçantinë autentike të të folurit me një laryshi gjuhësore të trevës në fjalë, kur në kohën tonë e kemi parasysh të folmen e gjuhës sonë, kudo në trevat shqiptare në Shqipëri, Kosovë, ndër shqiptarët e Maqedonisë, Mali të Zi, Luginës së Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës, veçanërisht shtypin dhe mjetet e tjera elektronike të informacionit, kanë hyrë me të madhe fjalë dhe konstrukte të panevojshme sllave, greke, italiane, angleze. Prandaj ka shumë të drejtë studiuesi N. Jorgaqi kur konstaton se "*sa shqip tingëllojnë shprehjet si Theofanin e bënin fjalë të hedhur... Pa thonë për Theofanin se i ra pas edhe jetës së Skëndërbeut dhe bëri vivël për të*". E kundërta do të ndodhë me Nolin i cili në vendlindjen e tij e mësoi gjuhën shqipe "*nga goja e prindërve, e bashkëfshatarëve njëqind e tridhjetë vjet më parë*". Sot edhe me shqipen e dikurshme magjike të Qytezës së Nolit, atë të Thrakës plakë ndodh më e keqja, kjo po vdes, sepse jeton, siç do të thotë N. Jorgaqi, "*kryesisht tek pleqtë e diasporës shqiptare në Thrakë. Është një shqipe e lodhur dhe e lektisur, por prap e bukur dhe e rrjedhshme*".

Për Nolin, studiuesi N. Jorgaqi do të thotë "*nuk mund të të afrohet sa duhet pa njohur së afërmi gjithçka që ka të bëjë me jetën dhe veprën e tij, pa njohura ata njerëz, ato mjedise shqiptare të Amerikës, tek ata ndjenjën e shqiptarizmës, dashurinë për atdheun*". Gjithashtu duhet thënë se edhe bota objektive amerikane kishte influencë të dukshme te Noli, një gjë e tillë u vu re edhe në krijimtarinë e tij. Në mënyrë tjetër nga bashkëkombasit e vet të cilët patën mërguar në Amerikë për të siguruar ekzistencën e tyre me shumë vështirësi e përpjekje të mundimshme, Nolin e detyroi për të marrë këtë rrugë të largët çështja hyjnore kombëtare e mëmëdheut, përkundrejt kësaj do të qëndrojë pa u përkulur, duke i kapërcyer pengesat e llojeve të ndryshme, siç ishin ato ekzistenciale, dredhitë keqadashëse dhe tradhtitë e rivalëve lakmues për të hyrë në politikë, orvatjet e tyre tinzare e mashtruese për ta vënë nën kthetrat e tyre popullatën e thjeshtë. Nasho Jorgaqi do të konstatojë në këtë studim se "*Të gjitha këto ishin detyra tepër të mëdha për Nolin 24 -vjeçar, por kjo ishte strateja kombëtare që nisi të përvijojë në këtë kohë*".

Për sa i përket udhëtimit kërkimor të N. Jorgaqit ndër trevat arvanitase të Thrakës, ky studim shquhet për nga përqëndrimi dhe vullneti i tij për mësuar vatrën e "*lindjes dhe rritjes*" së "*Nolit, atë djep*" në të cilin e ka përkundur nëna, duke i kënduar këngë dhe ninulla për ta vënë në gjumë. Në këtë studim ndeshim evokime të ndryshme që bëjnë fjalë për vrazhdësi dhe cënime, keqardhje dhe "*kujtime*" të hareshme për farefisin "*më të afërt nga gjaku dhe bashkvendasve të tjerë të Thrakës*", të cilët shquhen me përshkrimin e pamjes së jashtme, me vetitë e tyre shpirtërore e morale, me zhdërvjelltësinë, kurdoherë në varësi të trajtës dhe formës noliane. Rrugëtimi nëpër Amerikë paraqet pa dyshim një jetëshkrim me detaje plotësuese për "*jetën dhe veprën e këtij shqiptari të madh*", e cila fillon me ekskursin e N. Jorgaqit, të pasqyruar në mënyrë të harmonishme dhe përjetim të thellë e stil të lehtë e të qartë. Por rrugëtimi i studiuesit përfundon me shqiptime shqetësuese që të prekin thellë në zemër kur i bën homazh "*varrit të Mesisë së Shqipërisë*" i cili ngërthen në vete një jetë njeriu me plot peripeci e brenga së bashku me "*kryqin nëpër rrugën e mundimeve*". Vepron në cilësinë e jetesës njerëzore, tenton të zotërojë me imponimin e vullnetit të mirë, por gjithmonë orvatet ta mbajë modestinë e tij të natyrshme. Vepra "*Udhëtim me Fan Nolin*" është një ndihmesë e rëndësishme në tërësinë e gjurmimeve dhe veprimtarinë kërkimore shkencore që është bërë gjer më tani dhe nxitjeve për të ndërmarrë iniciativa të reja studimore, që do të kenë për qëllim të ndriçojnë fatin, jetën dhe bëmat atdhetare, letrare dhe artistike, që do të përfshinte në hollësi botën e pasur noliane. Por për hir të së vërtetës e të respektit ndaj traditës, është rasti të kujtojmë se përfaqësuesit më të shquar të kësaj periudhe, madje edhe të periudhës paraardhëse, të paktën që nga Noli, prej kohësh e kanë vlerësuar letërsinë, para së gjithash, si të tillë, si vlerë të mirëfilltë artistike, kanë parë e vlerësuar në radhë të parë përsosmërinë e shprehjes artistike të përmbajtjes (Muhametaj E., Tiranë, 1983, f. 118-119). Konsiderojmë se studimeve për Fan Nolin nuk u kemi vënë pikë, pasi ky është një furtunë e fortë që fryn në detin e pafund në stuhi.

MELI SHOPI
DENIS HIMCI

FAN S. NOLI SI PËRKTHYES E SHQIPËRUES DORËMBARË (MBËSHTETUR KRYESISHT NË PËRKTHIMIN E ROMANIT "DON KISHOTI" TË M. SERVANTES)

Fan Noli radhitet ndër ato personalitete që ia kushtuan jetën e tyre problemeve dhe shqetësimeve që kombi shqiptar po kalonte. Ai ka qenë dhe mbetet një erudit. Bashkë me Faik Konicën, si dy stilistët më të mëdhenj të gjuhës moderne shqipe, me banim në SHBA, nuk i kanë vënë shumë energji krijimtarisë letrare. E tillë ishte dhe koha. Për arsye historike e politike kulti i frymës kombëtare ka pasur përherë përparësi ndër shqiptarë, ndaj kultit të së madhërishmes, estetikës. Ndonëse shkroi relativisht pak letërsi të mirëfilltë, Noli prapëseprapë mbetet gjigand i letërsisë. Ai dha ndihmesë të madhe që gjuha shqipe të arrinte potencialin e vet të plotë letrar e krijues. Përpos të gjithave, ndihmesa kryesore e Fan Nolit për letërsinë shqipe ishte si stilist, çka vihet re, sidomos në përkthime.

Noli zgjodhi e vuri shqip vepra të tilla, të cilat kishin vlerë aktuale dhe luanin rol pozitiv në mendimin apo mënyrën komunikuese të njerëzve. Kështu, me Don Kishotin ai do t'i parodizojë me të madhe zakonet e mykura feudale, te "Rubairat", godet fanatizmin oriental dhe çmohet lart mendimi i lirë etj.

Në këto vepra ai bëri edhe përshtatje e shkurtime, duke u nisur nga konsiderata letrare dhe politiko-shoqërore, për të cilat ishte plotësisht i ndërgjegjshëm, sikurse e shpjegon vetë te parathënia e "Don Kishotit". Ai punoi për to me një ndjenjë të veçantë profesionale. Ato janë rikrijime, sepse, duke shfrytëzuar fondin e thesarin e gjuhës shqipe, e shkruan veprën e huaj me frymën e plotë të gjuhës sonë, por pa qëndruar larg origjinalit, qoftë në ide, qoftë në përshkrime e detaje artistike. *Në shqipërimet ai solli diçka të vetën, atë të stilit të vet, ndjeshmërinë e artistit apo dijetarin erudit përmes sintezës së mendimeve, rrjedhshmërisë së shprehjeve figurative. Ato u bënë fronti kryesor i veprimtarisë së tij artistike dhe objektivisht luajtën një rol të rëndësishëm në emancipimin e kulturës e të shoqërisë shqiptare në të kaluarën*[564].

Gjuha e përdorur nga Noli në krijimtarinë e tij qe mjaft e pasur dhe e larmishme. Edhe pse katër vjet ai arriti ta përvetësojë atë në mënyra të ndryshme, si: nga trashëgimia e shqipes së shkruar, nga shqiptarët të emigruar në Amerikë, etj. Duke shkruar në variantin e gjuhës së shkruar të variantit Jugor të pastër, të pasur e të bukur të Kristoforidhit e Samiut, e pasuroi më tej dhe e përpunoi mbi bazën e gjuhës së folur, për ta bërë atë më shprehëse, më zhdërvjellëse duke dhënë e ridhënë kryevepra të letërsisë botërore.

[564] N. Jorgaqi, Profile dhe dhe problem letrare, (Studime dhe problem letrare), Tiranë, 2008, f. 364.

... Ai e tërholli shqipen letrare të variantit Jugor të përpunuar prej rilindasve të mëdhenj të shekullit të kaluar, nga elemente dhe tipare arkaike dhe ngushtësisht dialektore nga variantet e shumta morfologjike, i dha asaj një karakter më të përgjithshëm, më të njësuar, më të stabilizuar dhe e bëri më të lakueshëm e më të kristalizuar. Ai është përvec kësaj, ndër më pasuruesit më të shquar e më dorëmbarë të visarit leksikor të gjuhës sonë letrare e të mjeteve shprehëse të saj (...). Ai farkoi sa e sa neologjizma, u dha formë shqipe shumë fjalëve të huaja, sajoi kombinime të ndryshme fjalësh me një ndjenjë të hollë të natyrës së gjuhës sonë e sidomos me një shije të rrallë artistike"[565]

Por Nolit i dolën disa probleme gjuhësore për të zgjidhur e pikërisht me punën me përkthimet. Problemet qëndrojnë pikërisht në përzgjedhjen e atij fjalori ku autori do ta përshtasë me veprën dhe përkthimi të mos largohet nga origjinali.

Noli ka synuar midis zgjedhjes së përkthimit të lirë dhe atij autentik[566] *të rikrijojë vlerat ideoartistike të origjinalit në gjuhën amtare, duke gjetur variante të gjuhës të barabarta ose të përafërta. Prej kësaj vjen ajo që ai s'i përmbahet gjithmonë masës së vargut të skemës së rimave, numrit të fjalëve e të frazeologjisë*[567]. Pra, ai arrin të bëjë ndryshime vetëm në formë, duke arritur të japë jo vetëm kuptimin e tekstit, por edhe ndjenjën e ngarkesën emocionale të gjuhës.

Nuk është e lehtë të marrësh përsipër përkthime të veprave, kur më tepër kemi të bëjmë me mjeshtra të shquar të përdorimit të fjalës. Kjo kërkon, siç shprehej Noli, forcë herkuliane dhe me këtë ka parasysh jo vetëm këmbënguljen, punën e mundimshme me fjalën, por edhe me njohjen e gjuhës, zotësinë dhe intelektin për të depërtuar në të fshehtat e gjuhës së artit. Përpos kësaj ai përktheu në një kohë, kur nuk kishte studime apo përvoja të mjaftueshme artistike dhe gjuhës sonë nuk i qenë zbuluar thesaret e aftësitë shprehëse.

Përvoja si aktor dhe orator, njohja me gjuhët e tjera të mëdha të kulturës botërore, sidomos me greqishten, anglishten dhe frëngjishten, i dhanë mundësi të zhvillojë shqipen e të ngrejë në shkollën e një gjuhe të përpunuar, të rrjedhshme e plot elegancë.

Si përkthyes i Shekspirit, Ibsenit ai do të sjellë dhe përkthimin e fuqishëm në shqip të pjesës së parë të Don Kishotit të M. De Servantesit, nën titullin" Sojliu mendjemprehtë don Kishoti i Mançës", Boston në vitet 1932-1933. Pra, do të kalonin disa vjet nga introduktat, siç quhen në shkrimet e Nolit, për të cilat do të shkruajë radhazi deri në vitin 1926. Fillimin e botimit e shoqëroi me një shënim të zgjeruar për veprën, i cili më shumë i ngjan një kuvendimi midis përkthyesit dhe lexuesit rreth romanit të Servantesit. Përmes analizës Noli shtron dhe zgjidh mbi bazën e disa koncepteve të përparuara historiko-shoqërore që nxjerr vepra, me një metodë si asnjë tjetër në një truall konkret social, bukurinë dhe vlerën e madhe të romanit.

---

[565] M. Dom, "Mjeshtri i madh i fjalës shqipe" "Nëntori" 1965, nr. 6, f. 27

[566] N. Jorgaqi ; Profile dhe probleme letrare, (Studime dhe probleme letrare), Tiranë, 2008, f. 364

[567] N. Jorgaqi po aty f. 364

Ndërthurja aq natyrshëm e realiste, e frymës komike me atë tragjike marrin një domethënie të thellë sociale.

Mbështetja në gurrën popullore e ka ndihmuar mjaft për të përzgjedhur dhe kombinuar mirë fjalët që shërbejnë edhe si epigrame që mbartin mendime të mençura, të përmbledhura në mënyrë konçize. Gjithashtu F. S. Noli nëpërmjet fjalive eliptike krijon ato epigrame të fuqishme që përmbledhin urtësinë e mendimit shqiptar, urtësi që përdoret për të karakterizuar njeriun. Megjithatë, duke i parë të dy variantet, F. S. Noli i ka qëndruar besnik origjinalit në përmbajtje.

Kre pas kreu, faqe pas faqeje Noli nuk do të kursehet në fjalët, kompozitat, barbarizmat apo shprehjet frazeologjike. Në raste të tilla, si:

I erdhi ndoresh (f. 11);Si një trup pa shpirt (f. 12);Për fat të bardhë (f. 12)… të ëmbël e mjaltërrjedhëse (f. 15)… shumë paqedashës (f. 17)… dhe të nxjerrtë faqebardhë… (f. 26)… I erdhën në mendje me udhëkryqet… (f. 31)… katundari zemërbardhë ia hoqi (f. 35)(F. S. NOLI, V1)

Në gjuhën popullore, kulturën shqiptare është diçka e re pohimi:

"s'e merr kalemi që të na mundonjë".

Duke u ballafaquar me fjalorin[568] e gjuhës së sotme shqipe gjejmë që fjala "kalem" do të thotë:

-laps, kalem, kopjetiv, etj, "shkruaj me kalem"

-s'dinim kalem, është me kalem (shkollë)

-i bie kalemit, me kalem në dorë, e zuri kalemi, s'e vë në kalem, etj.

Pra, e shohim në kolokacione të tilla që cituam më lart, por nuk e gjejmë në formën: "s'e merr kalemi". Dhe kjo përbën një pasurim të gjuhës shqipe dhe kjo është meritë e Nolit. Të tilla në gjithë shqipërimin janë të shumta.

Apo në lidhje me fjalitë eliptike, të paplota ku mungon këpuja:

"mbi një egërsirë mali…";"nga e flakta dashuri…"; "me shigjetën e helmuar…", e "fat' i zi e taksiratit…", Noli bën ndërhyrjen e vet si poet, por gjithmonë në funksion të vlerës emotive që karakterizon origjinalin. Tendenca për ta dhënë sa më të plotë tablonë e mendimit humanist europian të kohës bëjnë që F. S. Noli të aktivizojë krahasimet me prejardhje popullore.

… që të më qeshë buza edhe mua (f. 419)

… hapi sytë katër se mos të ikë prapë (f. 420)

Ky proces komunikativ që mundëson marrjen e mesazhit në mënyrë të plotë është i justifikuar me procesin semantik në varësi të vlerës poetike ndaj së cilës Noli mbetet gjithmonë besnik. Mungesa e këpujës e bën më popullor vargun. Në procesin e tij të

[568] Fjalori gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980, f. 763

përkthimit ai nuk ka qenë "metaforik". Ai të gjithë përmbajtjen e ka transmetuar, por ka mbetur "*dredharak*" në përkthim. Kjo për faktin që kurrë nuk ka pasur kalim të plotë gjuhësor, pasi gjithmonë ai ka gjetur ndonjë element që nuk i është nënshtruar dot përkthimit. Pikërisht ky element mbetet i papërkthyeshëm për arsye se marrëdhënia mes përmbajtjes dhe gjuhës është tepër e ndryshme në origjinal dhe në përkthim. Kështu që ky element funksionon si një metaforë për trajtesat e vështira të lidhjeve kulturore. Atëhere ne themi se përkthimi është një metaforë që destabilizon marrëdhëniet tradicionale midis figurës dhe kuptimit, që supozohet se trashëgohet në trope apo metaforë.

Metaforës së Servantesit, F. S. Noli i kundërpërgjigjet me metaforë të qëndrueshme si në:

Zemra sec iu përvëlua/, …Që më ka prerë shpresën me gërshërë/... Më qëllon më ndjek murtaja. etj.

Frazeologjia popullore e ka ndihmuar mjaft F. S. Nolin në vështirësitë e përkthimit. Në përkthim gjithmonë ka vend për plotësime dhe figura është gjithmonë shumëdimensionale, pasi analizohet edhe kuptimi në mënyrë dimensionale. I rëndësishëm mbetet fakti që gjuhës së tij F. S. Noli i ka veshur petkun e komunikimit me vetveten. Pra, gjuha e zgjedhur prej tij, është gjuhë poetike, të cilën e zotëron mjaft mirë për të përballuar sfidat në përkthim:

Te ky vend më solli fati
Fat'i zi e taksirati,
Se si unë s'ka ashik
Dhe si unë s'ka besnik
Dhe kështu më mori djalli
Me svarnis për kapistalli
Pra, nga halli e nga malli…

Lexuesi shqiptar merr variantin interpretativ të Nolit, në atë masë sa i duket që ka të bëjë me një variant origjinal, pasi përballet me karakteristikat e gjuhës dhe kulturës së shqipes, pra shijon tabanin shqiptar. Në vargjet:

Po nuk e di se ku më shpie
Sillem vërdallë aty-këtu
Dhe herë hipënj, herë bie
Sipas tallazit kuturu
……
E kish barkun sa një kosh
E kish kokën fare bosh.

Duke qenë se përkthimi është një praktikë ndërgjuhësore dhe sociokulturore, karakteristika kryesore e përkthimit mbetet lidhja e dyfishtë e tekstit. Këtu zë vend ekuivalenca funksionale që shpreh edhe ekuivalencën përkthimore të qëndrimit të

përkthyesit, që shërben edhe si një filtër kulturor. Prandaj, ne e pranojmë si të tonën shprehjen:

-Unë bëj për njëqind! - u përgjigj Don Kishoti… (f. 104)

Pranim që lehtësohet edhe nga përdorimi i shenjës së pikëçuditëses dhe strukturës së fjalisë që i jep ngjyrimin, nuancën e mundësinë kësaj fraze. Kjo nuancë kalon në përmasa të një fraze me perceptim të një rrethi kolektiv, që gjen një terren të gatshëm për ta bërë pjesë të kulturës së vet, për një masë të madhe të lexuesve. Vëmë re se ai vepron më së miri për të dhënë variantet e tij letrare, pavarësisht se nga struktura ato janë njësi frazeologjike popullore. Gjithashtu, gjatë përkthimit kemi huazime nga turqishtja dhe për të evituar turqizmat, kur ka vend për krijime të reja, falë procesit të hibridizimit kulturor, ne kalojmë në parapëlqimin e Nolit për një gjuhë letrare.

... I tha me zë të rëndë e madheshtor (f. 124)
... sikur të mos i ishte ndezur gjaku
Nga zemërimi i fortë (f. 127)
... do ta kisha marrë gjakun (f. 129)
... o yll i ndricem, ki mëshirë,
. . . Dil prap' e ndrtitmë, se të pres;
Në perëndofsh një her' e mirë,
Ahere dije se po vdes.

Tendenca e tij justifikohet me punën e tij krijuese për pasurim e standartizim të gjuhës shqipe, por edhe me prirjen e tij për të kryer më së miri rolin e tij mediator kulturor.

F. Noli shërben besnikërisht si mediator kulturor apo ndërlidhës mes dy gjuhëve dhe kulturave të largëta. Përpos të gjitha këtyre që morëm në analizë për të ilustruar, se sa besnik mbetet përkthyesi ndaj autorit, në lidhje me fjalët e frazeologjizmat, nuk mund t'i shmangemi edhe dukurive të onomastikës artistike. P. sh. në fund të pjesës së parë të përkthimit, Noli do të shkruajë:

... Të parat shkresa të pergamenave që u gjetën në sëndukun prej plumbi, qenë bërë prej disa profesorësh të universiteteve të Domosdovës, të Librazhdit, e të Rrogozhinës, etj.

Pse pikërisht ai do të përkthejë dhe do të rikrijojë universitete pranë këtyre qyteteve? A kanë ekzistuar vallë ato, apo Noli nuk ka pasur emërtim tjetër për t'ia përshtatur origjinalit?! Kjo mbetet një çështje tjetër që duhet ndoshta për t'u diskutuar. Megjithatë ai do të mbetet një mjeshtër dhe pendë e artë e përdorimit të fjalës së bukur shqipe.

MIMOZA SHQEFNI

PUBLICISTIKA E NOLIT NË HISTORINË DHE REALITETIN SHQIPTAR

Të flasësh për kontributin e Fan Nolit në lëmin e publicistikës shqiptare, në kufirin e një kumtese, është e pamundur, pasi veprimtaria e tij publicistike është shumë e gjerë dhe e gjithanshme. Megjithatë do të mundohemi që në këtë kumtesë të nxjerrin në pah sadopak ato vlera të patjetërsueshme që mbart në vetvete vepra publicistike e Fan Nolit. Në publicistikë ai shprehu qartë pikëpamjet e tij thellësisht demokratike, që janë si një kronikë e jetës politike dhe shoqërore shqiptare. Diapazoni i tij i gjerë dhe krijues bëri që të ishte zëri i shqiptarëve, sidomos në diasporë.

Publicistika e Nolit hyri në historinë e përpjekjeve shqiptare për liri dhe integritet, për të zënë një vend nderi. Me demaskimin që u bëri armiqve të atdheut, me besimin dhe optimizmin që krijoi në popull, ai u shqua si atdhetar dhe si demokrat.

Objekt të kësaj kumtese do të bëjmë veprimtarinë publicistike të Nolit në vitet 1925 – 1932, sidomos atë pjesë që zhvilloi në gazetën "Liria Kombëtare" të Gjenevës, megjithatë e shohim të udhës të hedhim një vështrim mbi veprimtarinë e tij publicistike më të hershme, e cila do të jetë si një trampolinë në të cilën do të hidhet Noli për të arritur majat e publicistikës shqiptare. Veprimtarinë e tij si publicist, Noli e filloi që herët, më 1905, me artikuj të ndryshëm të botuar në gazetën "Drita", me të cilët bëri dhe hapat e parë të shërbim të lëvizjes patriotike shqiptare. [569] Edhe pse kjo periudhë lidhet relativisht me moshën e tij të re, ai u shqua si një publicist me kurajo të madhe, që nuk u step dhe nuk u tërhoq sa herë vinte re padrejtësitë dhe prapaskenat që bëheshin në kurriz të shqiptarëve, por me fakte të forta, demaskonte realitetin e shëmtuar. Në këto shkrime të para të tij, ai demaskon sidomos ata që përpiqeshin dhe bënin çmos që gjuha shqipe të denigrohej dhe shqiptarët të mos ekzistonin si komb. *"Jemi në shekullin XX! Jemi të gjithë një komb dhe bashkëkombas me ne, janë të gjithë ata që flasin shqip"*, [570] do të shkruante Noli, duke iu kundërvënë atyre që përpiqeshin të krijonin pakënaqësi fetare midis myslimanëve dhe të krishterëve. Në artikujt e kësaj periudhe, Noli vuri gishtin në një nga pikat më nevralgjike të çështjes kombëtare. Ai shprehte idenë që organizimi i shqiptarëve të shkonte përpara, nuk mjaftonte vetëm një udhëheqës i zoti, por duhej të sigurohej një vazhdimësi në udhëheqje. Këtë mësim ua jepte historia e tyre shekullore. Sipas tij, për të ecur përpara një komb duhen "shumë krerë". [571] Për këtë ai kishte të drejtë. Përvoja historike e shumë vendeve të botës tregon edhe sot e kësaj dite, se një lëvizje e rëndësishme

1 Koço Bihiku. "Noli si publicist në luftën për lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë. 1905 - 1912", fq 8. Botuar në: "Studime filologjike" 1984, nr 3

[570] "Budallallëke turko-greke", gazeta "Drita", 1905. 12 shtator, nr. 56

[571] "Detyra e parë", gazeta "Kombi"1906, 4 gusht, nr 7.

shoqërore e politike, nuk mund të arrijë qëllimin e saj të fundit, pa një grup udhëheqësish, i cili të mbajë vazhdimësinë. [572]

Në publicistikë, Noli hyri me lidhje të shumëfishta. Kjo erdhi si pasojë e një sërë faktorësh, por më kryesorja ishte frymëzimi për lëvizjen demokratike mbarëkombëtare. Interesimi i tij për publicistikën, nuk mund të ishte i rastit. Ai erdhi duke u forcuar në kuadrin e mendimit të tij politik e shoqëror, gjatë një harku të konsiderueshëm kohor, por që pati një ngritje kulmore, sidomos në periudhën pas Revolucionit Demokratiko-borgjez të Qershorit 1924, periudhë në të cilën dështoi edhe qeveria e drejtuar prej tij, ndonëse shpalli një plan qeverisës, nuk mbijetoi më shumë se gjashtë muaj. Kësisoj, Noli u detyrua të mërgojë jashtë atdheut të tij, pasi qeveria e Zogut, e kthyer në pushtet, e dënoi me vdekje në mungesë. Kjo përvojë e qëndrimit të tij në Evropë, i forcoi akoma më shumë bindjen se faktori kryesor për të mundur armiqtë e Shqipërisë, ishte vetë lufta e popullit shqiptar. Kjo periudhë kohore solli edhe pjekurinë artistike, letrare dhe publicistike të Nolit, i cili dora – dorës u afirmua, u forcua, kjo edhe në sajë të veprimtarisë atdhetare që kreu në vende të ndryshme të Evropës, në mbështetje të shqiptarëve.

Më 25 mars, Noli themeloi në Vjenë, Komitetin Nacional Revolucionar (KONARE), ku u zgjodh dhe kryetar i saj. Ky komitet bëri të mundur që më 29 korrik të po atij viti, të botohej gazeta "Liria Kombëtare", si organ i KONARE-s, ku Noli ishte frymëzues, drejtues dhe bashkëpunëtor i saj. Pothuajse në të gjithë numrat e kësaj gazete bëhet thirrje për të përkrahur Komitetin Nacional Revolucionar, si dhe jepet informacion mbi atë çfarë është dhe çfarë do ky komitet. *"Ç'është? KONARE është organizata politike, revolucionare e popullit punëtor shqiptar, domethënë e fshatarëve, e punëtorëve, e zanatçinjve, e dyqanxhinjve të vegjël, e intelektualëve të ndershëm, shkurt e gjithë atyre që rrojnë me djersën e ballit. Ç'do? Komiteti do të përmbysë me luftë revolucionare të masave popullore, diktaturën feudale fashiste, të vendosur e të mbajtur prej të huajve kundër popullit shqiptar"*[573]. Kjo bëhej për arsyen e thjeshtë që lexuesi që merrte në dorë gazetën, të njihej me veprimtarinë e këtij komiteti dhe të bëhej pjesë e tij.

Që në artikujt e parë të kësaj gazete, bie në sy qëndrimi i Nolit për realitetin shqiptar e sidomos në lidhje me qeverinë e Zogut, me të cilën ai ishte në opozitë. Ai demaskoi në mënyrë të drejtpërdrejtë politikën që ai ndiqte në kurriz të shqiptarëve.

Problematika kryesore në veprimtarinë publicistike të Nolit, ishte çështja kombëtare. Është për t'u habitur fakti se Noli është gjithmonë në kontakt me zhvillimet e përgjithshme që ndodhin brenda Shqipërisë dhe gjithçka që ndodh aty, ai e bën objekt të shkrimeve të tij publicistike. Ai mbetet njohës i mirë i situatave që trajton, ka një pozicion të qartë e të lexueshëm, është i ndjeshëm dhe qëndrimet e veprimet e tij janë transparente. Në artikujt dhe shënimet që botoi nga viti 1925 e deri në fillimin e viteve '30, të cilat shënojnë edhe kulmin e pjekurisë së veprimtarisë së tij si publicist demokrat, vëmendje kryesore Noli u kushtoi edhe çështjeve që lidheshin me

[572] Koço Bihiku. "Noli si publicist në luftën për lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë. 1905 - 1912", fq 26. Botuar në: "Studime filologjike" 1984, nr 3.

[573] "Liria Kombëtare", numra të ndryshëm të saj.

konsolidimin e lëvizjes çlirimtare, me përpunimin e strategjive dhe të detyrave që shtroheshin përpara forcave demokratike për të kurorëzuar fitoren e revoluzionit demokratik popullor.

Publicistika e Nolit tek "Liria Kombëtare" është po aq plastike dhe e drejtpërdrejtë. Tek kjo gazetë, Noli botoi artikuj që demaskonin fashizmin dhe armiqtë e Shqipërisë, por njëkohësisht botoi dhe shkrime që nuk kishin lidhje me politikën, por me aktualitetin, kulturën e gjithçka që ndodhte përreth. Në artikujt e parë të tij, vihet re zemërthyerja e tij për shkak të zhgënjimit për qeverinë jetëshkurtër që ai drejtoi, shpreh përparësitë dhe të metat që pati ajo, por në artikujt që vijojnë, buron militantizmi për lirinë e mendimit, ushqehet nga kultura e tij shumë e gjerë dhe ndizet e merr flakë nga pathosi qytetar, për t'i dhënë forcë e energji veprimi idealit të tij. Ai kërkon t'i japë dritë një populli që sapo ka dalë nga errësira otomane dhe sorollatet në një qorrsokak vështirësish për të krijuar shtetin e vet dhe cdo gjë tjetër, duke filluar nga ripërtëritja e identitetit.

Tek ajo tërheq vëmendjen sidomos rubrika "Andej-Këtej". Kjo rubrikë u hap nga Noli në dhjetor 1928, për të vazhduar për një kohë relativisht të gjatë (një vit) në evidentimin dhe analizat e situatave të ndryshme mbi problemet që lidheshin me Shqipërinë. (Kjo rubrikë ishte e njohur edhe në gazetën "Dielli" të Bostonit, në vitet 1909 dhe më vonë në gazetën "Republika"). Në këtë rubrikë, Noli botonte artikuj të ndryshëm, pa një titull të veçantë. Aty Noli përcolli tek lexuesi shkrime për personalitete të shquara të skenave politike, social-kulturore shqiptare dhe asaj botërore. Nëpërmjet publicistikës ai u bën portretizime personaliteteve të ndryshme. Mjafton të përmendim shkrimet për Gurakuqin, Uillsonin, Musolinin e deri tek Mustafa Qemali, si dhe për Anjshtajnin, Bethovenin apo Shubertin e të tjerë. Përveç këtyre shkrimeve, në këtë rubrikë do të botonte edhe disa nga poezitë e tij më të mira, të cilat u krijuan si pasojë e ngjarjeve të kësaj kohe. Po ashtu aty botoi edhe përkthime të veprave të ndryshme botërore. Ai është konseguent në pikëpamje dhe publicistika e tij është një gjuhë bindjeje, oratorike dhe mjaft interesante. Fakteve që gjen "Andej-Këtej", (kjo rubrikë ishte shumë e goditur për autorin dhe kohën), u bën analizë konkrete, i lidh me njëra-tjetrën, parashtron kushtet dhe ndikimin midis tyre dhe të gjitha ato së bashku i vë në funksion të çështjes kombëtare shqiptare.

Po të hedhim një vështrim mbi disa artikuj të rubrikës "Andej – Këtej", do të shohim se Noli flet me dhimbje për të ardhmen e Shqipërisë. Në një artikull të botuar më 1928, ai shkruan mbi Pavarësinë e Shqipërisë, për të cilën ndien keqardhje, sepse vërtet fitoi pavarësinë mbi zgjedhën osmane, por ra pre e copëtimit nga vendet e tjera të fuqishme. Ai shprehet: "*Vetëm 16 vjet janë nga dita kur u proklamua indipendenca e Shqipërisë në Vlorë, por është zor ta besojmë, se na duket se na duket sikur kanë kaluar sa e sa vjetë. E bëjmë hesap për qime, i gjejmë prapë 16 dhe megjithëkëtë jemi të bindur se arithmetika na gënjen. Pse? Se brenda në këto 16 vjet u përmbys bota dhe nisi një periudhë e re e historisë së njerëzve. Brenda në këto 16 vjet dy herë e fituam Shqipërinë dhe dy herë na e rrëmbyen bejlerët dhe ua shitën të huajve*". [574] Këtu Noli

[574] Gazeta "Liria Kombëtare" Gjenevë, 28 Nëntor 1928, nr 97.

me një frymë të mprehtë polemike, mbështet dhe përkrah Ismail Qemalin në shpalljen e Pavarësisë, por nuk ngurron të godasë tradhëtarët e Shqipërisë, të cilët mezi ç'pritën që t'i kthenin krahët atdheut të tyre dhe të përkrahnin armikun. *"Prapë syrgjyn e prapë të pakë, si më parë. Ku na vanë shokët? Ca i lanë shëndenë jetës, ca na tradhëtuan dhe u hodhën nga ana e armikut ca u hoqnë mënjanë të lodhur, kallaballëku u shpërnda prej furtunës ashtu siç ishte mbledhur pas berihajt. Ca më mirë se kështu u nda gruri nga kashta dhe tani mësuam si t'i zgjedhim shokët. Të paktë dhe të saktë. "*[575]

Në artikujt e kësaj rubrike, Noli përshkruan në mënyrë të hollësishme, sidomos mjerimet e shumta të popullit në vitet e krizës botërore, ku për shkak të rënies së theksuar të çmimeve të produkteve bujqësore, të shtimit të taksave si dhe sëmundjeve dhe fatkeqësive natyrore, popullsia vdiste për bukën e gojës. Noli nxori në dritë tragjizmin e gjendjes dhe tregonte se gjendja e padurueshme ekonomike e shtonte akoma më tej pakënaqësinë e masave popullore.

Në një artikull tek "Liria Kombëtare", Noli zbulon se nga të ardhurat kombëtare, 70% e buxhetit kalonte për të mbuluar shpenzimet ushtarake. Këtu, Noli ironizon me një ironi të hidhur se *"dhe për këtë maskarallëk, nuk duhen çkulur flokët, se është rrezik të çkulet edhe koka bashkë. "*[576] Kështu ai me një vërtetësi të hapur në artikujt e tij godet pa patur frikë dhe drojë, regjimin e Zogut, si një regjim që po forcohej në kurriz të popullit.

Një temë e fortë që vërtiste pena e Nolit ishte edhe politika arsimore. Në shumë artikuj demaskon për mëse një herë qeverinë e Zogut për politikën e dobët të tij në kuadër të arsimit shqip. Ai shpjegonte se qeveritarët nuk janë fare të interesuar që të rritet niveli arsimor në shtresat e ulëta popullore dhe për këtë qëllim po mbyllin shumë shkolla fillore në fshat. Po kështu edhe buxheti qesharak që kalohet për arsimin, bëhet me qëllim që populli të mbetet në errësirë dhe padituri. Tek "Andej-Këtej" ai shkruan: "*Komisioni për të gatuar gjuhën letrare nuk do të formohet se Ministria e Arsimit s'ka në dispozitë të saj paratë e nevojshme. Kështu mbetnë me gisht në gojë të gjithë memurët që gatiteshin të merrnin nga nonjë rrogë sinekure (një vend me rrogë të mirë dhe ku s'ka punë), domethënë rrogë pa bërë punë. Po lajthisim të gëzohemi shpejt e shpejt. Duhet të presim edhe ca pak. Se tani po përhapet fjala se do të formohet një Akademi arnaute, pas modelit të Akademisë frënge, malum, për të meremetisur gjuhën. E mjera shqipe. "*[577]

Shqetësim është për të edhe ekonomia e Shqipërisë që rrezikohej përditë e më shumë nga borxhet në të cilat e fuste qeveria. Ai mendonte se s'kishte asnjë shpresë që

[575] Po aty.
[576] Andej-Këtej, "Liria Kombëtare", 1929, 12 shkurt, nr 15.
[577] Andej-Këtej, "Liria Kombëtare", 1929, 20 shkurt, nr 16.

Shqipëria të pasurohej nën regjimin e hajdutëve, se duke marrë borxh për të larë borxhe, shqiptarët përditë do të kishin të ardhura më të pakta dhe kësisoj varfëria dhe uria do të uleshin këmbëkryq në mesin e tyre. *"Shqipëria duhet të përpiqej të kishte një zhvillim ekonomik, sepse nuk mund të ketë liri dhe zhvillim kur nuk ka bukë. "*[578] Sipas tij, kjo krizë e rëndë që po kalonte vendi, me varfëri dhe mjerim të thellë, i kishte rrënjët thellë në sistemin anti popullor dhe goditja nuk duhej të ishte vetëm për personin e Ahmet Zogut, por kundër gjithë sistemit politiko – shoqëror.

Sërish në një artikull të botuar në "Liria Kombëtare", Noli vë sërish në qendër shqetësimin e tij për të ardhmen e Shqipërsië: "*Thika ka vajtur deri në eshtër. Korrespondencat që më vijnë, e dëftejnë gjendjen e Shqipërisë shumë të dëshpëruarë. Një pjesë e mirë e njerëzisë kënaqeshin deri tani më një qëndrim apatik, duke shpresuar përditë në një përmirësim. Jo që situata nuk ndryshon për mirë, por po ashpërsohet dita – ditës. Vendi shitet copë – copë, për të mbushur xhepat e një qarku të ngushtë, populli rrihet, ndiqet e poshtërohet, qeveria ndodhet de facto nën urdhërin e fuqive të huaja. Si do të jetë përfundimi? Mos mbase errësira që ka mbuluar Shqipërinë anembanë, është fortuna kaluese që sjell uraganin për t'i dëbuar gjithë retë dhe për t'i prurë atdheut nji horizont të çelur, të qetë dhe plot lumturi? "*[579]

Publicistika e Nolit është e lidhur ngushtë me frymën e papajtueshme me armiqtë e Shqipërisë. Ai shkruan me një mprehtësi politike, duke i shtruar çështjet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Thelbin e dukurive të kohës ai e tregoi hapur, ashtu siç ishin. Kjo mprehtësi politike bie menjëherë në sy, sapo shikon artikujt e tij. Kështu në vitin e parë të botimit të "Lirisë Kombëtare", në nr 8 të saj, Noli për herë të parë përshkruan disa tipare të qevërisë së tij, për të cilën pranon se nuk ishte ideale, por përshkruan sipas tij *"disa të mira, për faqe të bardhë"*. Ai shprehet se: "*Qeveria e Qershorit 1924, nuk qe ideale vërtet. Mungesat e saj s'munt t'ia dijë askush më mirë se i nënshkruari që ka parë maqinën e saj të punojë për së afërmi. Po pasi t'i m'i ngarkojnë mi kurriz kritika, duhet të numërojmë në favor të saj, ca të mira për faqe të bardhë". [580]* Kështu ai vë në dukje se njerëzit e kësaj qeverie qenë patriotë të kulluar, që hipën në fuqi me dëshirën e popullit dhe pa asnjë ndihmë të jashtme. Nuk shitën asnjë pëllëmbë tokë dhe qenë mbrojtës të shtetit. Ishin të ndershëm dhe nuk u dhanë pasuritë e Shqipërisë të huajve për të fituar simpatinë e tyre. Noli i përshkruan anëtarët e qeverisë si njerëz të qytetëruar. Në periudhën e qeverisjes së tyre nuk u bë asnjë vrasje politike dhe jeta e kundërshtarëve ishte po aq e mbrojtur sa edhe e të tjerëve. Kishte liri të plotë shtypi, ndonëse në kohë të tyre nuk doli asnjë numër gazete që të mos kishte kritikë, asnjëra prej tyre nuk u çensurua dhe nuk u ndalua. Në vazhdën e këtij artikulli të gjatë, Noli vazhdon të bëjë një paralelizëm me qeverinë që pasoi, pas dështimit të qeverisë së tij, të cilën e krahason me "*një çetë të hurit dhe të litarit"* dhe nga ky emërtim kuptohet edhe mendimi i Nolit dhe akuzat që drejton në adresë të tyre.

[578] "Liria Kombëtare", 1925, 19 gusht, nr 4.
[579] "Liria Kombëtare", 1925, 19 gusht, nr 4.
[580] "Liria Kombëtare, 1925, 16 shtator, nr 8.

Ai e mbyll artikullin duke u shprehur: "*Prita mjaft me shpresën që faktet e ashpra t'jua mbushin kokën që e kini humbur toruan fare. Por tani s'munt të hesht më. Ndonëse pak vonë, Thash e fola, s'ju kam faj. "*[581] Nolin e karakterizonte qëndrimi i tij i prerë. Ky qëndrim e shtynte që të shprehej prerazi, për të dhënë mendimet e tij hapur, troç, pa nënkuptime, prandaj edhe shkrimet e tij i karakterizon vërtetësia. Edhe pse shpesh këto qëndrime i sollën probleme dhe reaksion në disa rrethe patriotësh, kjo gjë nuk e shqetësoi atë. Noli mburrej dhe shpjegonte këtë me origjinën e tij, si njeri i dalë nga populli i thjeshtë. [582]

Gazeta "Liria Kombëtare" e Gjenevës do të bëhej tribuna e Fan Nolit për polemikat me mikun dhe kundërshtarin e tij politik, Faik Konica. Ata i përkisnin kaheve të kundërta politike dhe jo rrallë kjo u bë shkas për shkrime të ndryshme politike dhe polemika apo kundërpërgjigje ndaj letrave dhe artikujve që Konica shkruante në gazetën "Dielli" të Bostonit. Kështu kjo gazetë "Liria Kombëtare" (por edhe gazeta "Immigranti" në Amerikë) do të bëhej "shesh mejdani" për replikat në distancë midis dy kolosëve të letrave shqipe. Interesantë janë artikujt që botohen në lidhje me Luigj Gurakuqin, për të cilin Noli kishte një miqësi dhe respekt të veçantë. Pas një shkrimi të Konicës në gazetën "Dielli", ku ai e akuzon Nolin si vegël të Gurakuqit, Noli nuk ngurron t'i kundërpërgjigjet tek "Liria Kombëtare" me një letër të hapur, ku ndër të tjera theksonte se: "*Zoti Faik Konica është i mendjes se unë kam qenë vegla e Gurakuqit. Nuk e besonj. Por edhe sikur të ishte e vërtetë, e kam dhe do ta kem për nder. Ishte mjaft i math sa të kishte vegla si mua e si të tjerë novicë (njeri fillestar në një punë) të luftës në Shqipëri, kupa e hidhur e së cilës, ua ngjeth mishtë atyre që kanë shijuar jetën në pjesët e mira të botës së qytetëruar. "*[583] Është tipar karakteristik i Nolit, synimi për t'u shprehur prerazi, për t'i thënë mendimet e tij hapur, pa dorashka.

Mjeshtëria e publicistikës së Nolit tek "Liria Kombëtare" çdo ditë e më tepër shënonte vlera të reja. Me vështrimin e tij të mprehtë dhe me gjykimet e mençura, do të arrijë të shikojë dhe të komentojë politikën botërore, duke e trajtuar gjithmonë në raport me Shqipërinë. Kështu në optikën e tij parakalojnë çështje politike të nxehta të kohës; Amerika, Italia, Franca, Gjermania, Bashkimi Sovjetik (Rusia) etj. Duke i vënë në sitën e gjykimit objektiv dhe në qëndrimin e tij të prerë, ai shqyrtoi politikat e kohës, duke patur në mbrojtje gjithmonë interesat kombëtare.

Thamë më lart se tek "Liria Kombëtare", Noli nuk botoi vetëm artikuj politikë, por edhe socialë e kulturorë. Kështu, sa i përket temave sociale, në vazhdën e shqetësimeve të tij për Shqipërinë, ai informon lexuesit edhe për fatkeqësitë natyrore që godasin vendin e tij. *"... Shqipëria është mbytur nga shirat dhe lumenjtë. S'ka*

[581] "Liria Kombëtare, 1925, 16 shtator, nr 8.

[582] Koço Bihiku. "Noli si publicist në luftën për lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë. (1905-1912)", botuar në: Studime filologjike 1984, nr 3.

[583] Gazeta "Liria Kombëtare", 1925, 9 shtator, nr 7.

mbetur urë e udhë që të mos jetë e çkallmuar. Komunikimet janë prerë kudo. E tërë Myzeqeja është mbytur në ujë dhe rrugët janë të bllokuara. "[584] ose: "*Gjëndja në Shqipëri është për qarë me lot prej gjaku. Dimri ka përfshirë me qindra njerëz e pothuaj 40% prej bagëtive. Pas dimrit erdhi gripa, e cila korr me qindra përditë, se s'është gripa e lehtë që kemi patur nga Perëndimi këtë mot, po gripa e tmerruar, që shkretoi botën pas Luftës së Madhe. Pas gripës, zia për po mbretëron sivjet në çdo mal e fushë, në Veri e Jugë. "*[585]

Një fushë e parapëlqyer prej tij është edhe kultura, sidomos muzika. (Kujtojmë këtu, që ai në moshën 53-vjeçare, ndoqi konservatorin e muzikës dhe u diplomua aty). Në çdo rast nuk lë pa shfrytëzuar ndonjë eveniment që ndodh në fushën e muzikës. Kështu në një artikull të rubrikës "Andej – Këtej", Noli vetë kërkon të dalë nga përditshmëria dhe të "qetësojë" trurin me informacione kulturore. *"Sot, përshembull, do të flasim për pak muzikë. Muajin e kaluar u mbushën njëqind vjet që kur ka vdekur Franc Shuberti, në varsën më të bukur të burrërisë, 31 vjeç, pra në lulen e rinisë. Arrij të them një gjë të pranuar prej të gjithëve, që Shuberti është një nga më të mëdhenjtë muzikantë të botës dhe veçanërisht në fushën e këngëve (gjermanisht lied), në të cilat mbetet kryemjeshtër i pakapërcyer. "*[586] Në vazhdën e informacioneve kulturore, Noli përfshin shënime për autorë dhe shkencëtarë të ndryshëm. Psh, flet për shkencëtarin e njohur gjerman, Albert Ajnshtajn: "*Muajin e kaluar, kremtoi ditëlindjen e pesëdhjetë, i dëgjuari shkencëtar gjerman, Albert Ajnshtajni, profesor në universitetin e Berlinit, më i madhi mathematicien i gjallë i botës. Priti dhurata dhe urime nga të gjitha anët e të gjithë shtetet. Qyteti i Berlinit i fali një villë të bukur. Ajnshtajni interesohet thellësisht për të gjithë kombet e shtypura dhe është një simpathizant i Federatës Ballkanike. "*[587]

Ngjarjet kryesore të kësaj periudhe (kujtojmë se flasim për veprimtarinë publicistike të Nolit në vitet 1925 – 1932) si: vrasja e Luigj Gurakuqit, Bajram Currit etj, si dhe ngjarjet politike që pasuan, "detyruan" Nolin që në këtë rubrikë të botonte poezitë më të spikatura të tij. Të tilla ishin: "*Syrgjyn-vdekur", "Shpell' e Dragobisë", "Himni i flamurit", "Rend or Maratonomak"* apo *"Moisiu në mal", "Shën Pjetri në mangall"* etj. Me dy krijimet e para, ai ndau me lexuesin dhimbjen e madhe që shkaktoi vrasja e dy shokëve të tij të afërt. Tek elegjia e Gurakuqit, Noli nxjerr në pah mendimet e tij dhe vajton me hidhërim të thellë vdekjen e tij, mbron dhe lartëson nëpërmjet antitezash të fuqishme, figurën e pastër të tij, kurse tek "Shpella e Dragobisë", poeti sjell një paralelizëm të heroit, deri në përmasa epike, me figura që i afrohen krijimtarisë popullore. Vërtet ajo është shkruar në formë elegjie, por e gjithë poezia shpreh duf, revoltë e kushtrim për luftë. Një mesazh i drejtpërdrejtë për popullin.

Tek këto shkrime (në përgjithësi tek të gjitha shkrimet e tij publicistike), bie në sy ligjërimi i tij. Ai është i lirë, pothuajse i improvizuar. Ky ligjërim i ngjan një bisede të

[584] Gazeta "Liria Kombëtare", Gjenevë, 1928, nr 97
[585] Gazeta "Liria Kombëtare" Gjenevë, 1929, 10 prill, nr 110
[586] Gazeta " Liria Kombëtare " Gjenevë, 1929 , maj, nr 111
[587] Po aty.

qetë dhe të ngrohtë me lexuesin, të cilit i drejtohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke e futur drejt e në temë, pa hyrje të gjata e me teprime. Kjo ishte një karakteristikë e përgjithshme e publicistikës së Nolit, i cili e kishte me merak t'u shmangej frazave të gjata, të lodhshme dhe të ngatërruara. Po t'i shikojmë më me vëmendje këto artikuj të tij, do të vëmë re lidhjen e ngushtë të frymës publicistike me elementet artistike të letërsisë, çka e rendit si një publicist të shquar dhe përparimtar. Ai i kushtonte tepër vëmendje formës së shkrimeve të tij. Në to ai përdori mjaft epitete, metafora, simbole dhe figura të ndryshme stilistike, të cilat në përgjithësi kanë një forcë të madhe emocionale dhe shprehëse. Me anë të këtyre mjeteve stilistike, Noli nxori në pah më tepër portretin e personit apo thelbin e dukurisë që përshkruante. Në vazhdën e këtyre karakteristikave në krijimtarinë publicistike të Nolit, vlen të përmendim edhe shfrytëzimin prej tij të materialeve burimore të popullit, si shprehjet frazeologjike apo figura të mitologjisë antike dhe letërsisë botërore, të cilat i vuri në funksionin stilistik të shkrimeve të tij. Të gjitha këto, janë tregues të shijës së tij të hollë artistike dhe kulturës së tij të gjithanshme. Tek të gjitha shkrimet e tij, vëmë re se ai i shmanget monotonisë, përsëritjes, paragrafeve të stërgjatura etj.

Si përfundim, publicistika e Nolit ishte e pasur dhe cilësore. Ai shprehu këtu mendime të guximshme dhe tema gjithpërfshirëse, si dhe idetë e tij demokratike. Besimi i tij në kauzën e lirisë, bëri që të shpërthejnë idetë liridashëse. Herë me tone të forta e herë me tone të buta (e para më tepër e përdorur), apo edhe me nota të forta ironie dhe sarkazme, ai shprehu mendime me vlerë, të cilat tingëllojnë aktuale edhe në ditët e sotme. (Dhe të mendojmë se jemi gati 90 vjet më vonë). *"Nëpër paragrafet noliane gjejmë mendime që jo vetëm i kanë qëndruar kohës, po që tingëllojnë gati proverbial. "*[588] Ai ishte një politikan me vizion të gjerë, por më tepër ishte një intelektual, sepse ngjarjet i përjeton më thellë se sa duket. Personaliteti i tij duke qenë kompleks dhe gjenial, solli në publicistikën shqiptare dhe jo vetëm, mendime të hapura dhe mesazhe të drejtpërdrejta, duke u bërë kështu një model tek i cili mund të nxjerrë mësime dhe ide çdo individ në çdo kohë. Kjo i atribuohet largpamësisë së tij intelektuale dhe bagazhit të madh shpirtëror. Në të vërtetë ai ishte një atdhetar i madh, por është e rëndësishme të theksohet se atdhedashurinë nuk e kthen asnjëherë në një ndjenjë të mbyllur në vetvete, përkundrazi e ballafaqon me botën, e lidhi dhe e harmonizoi me vlerat universale të njerëzimit. Në vështrimin e tij intelektual dhe qytetar, Shqipëria dhe shqiptarët do të përbënin një realitet të pamohueshëm etnik të shtrirë jo vetëm në hapësirat gjeografike, por edhe si një vazhdimësi historike në shekuj.

Në fushë të publicistikës, Noli paraqitet si një personalitet dinamik, i karakterizuar nga sensi i progresit. Ai ndiqte parimin se në jetë duhet jetuar duke nxjerrë mësime nga e kaluara, duke përjetuar të tashmen, por gjithnjë duke vështruar nga e ardhmja. Në shkrimet e tij publicistike, Noli paraqitet ashtu siç është në të vërtetë; pasqyrë e vetvetes, dëshmi origjinale e mendimeve të tij dhe mban një qëndrim objektiv sa i përket analizës që u bën situatave, duke u bërë kështu një analist i rrallë që trajton

[588] Nasho Jorgaqi. "Jeta e Fan S. Nolit". Shtëpia botuese "OMBRA GVG", Tiranë 2005, vëllimi II, fq 96.

probleme të ndryshme dhe është në koherencë me gjithçka që ndodh përreth. Noli solli në publicistikën shqiptare, një sulm të tijin, një mënyrë të shprehuri me vibracion energjik, dhe mesazhe të drejtpërdrejta, buçitëse, përcolli një ideal si të thuash shoqëror – kombëtar, por gjithmonë shoqëror, gjithmonë kombëtar. Fliste hapur, nuk dinte të bënte lajka dhe më kryesorja nuk kishte frikë të shprehet. Ai bëri përpjekje si një Moisi, për të drejtuar popullin e tij në një rrugë të mbarë për të ardhmen e tij. Noli e kreu fuqishëm misionin e tij.

NEIM ZHURI
NOLI: PËRKTHYESI DHE KRITIKU

Prej kohësh qarkullon ideja për domosdoshmërinë e ripërkthimit të klasikëve në shqip, jo vetëm për shkak të gjuhës, e cila është një organizëm që lëviz, pasurohet, evoluon, por edhe për faktin se shumë dekada më parë ata që u morën me përkthimin, ka gjasë që nuk kanë mundur t'i kuptojnë si duhet përmasat reale të veprës, si dhe për çështje të receptimit në lidhje me kohën. Shumëkush do ishte pjesë e dakortësisë për një pohim të tillë, por, gjithnjë nëse ruhet besnikëria dhe respekti brenda kufijve të lirisë së interpretimit. Lidhur me besnikërinë brenda kufijve të lirisë së interpretimit Umberto Eco konstaton: "Ka një herezi të rrezikshme kritike, tipike për kohën tonë, sipas së cilës me një vepër letrare mund të bësh ç'të duash, duke e lexuar sipas shtysave tona më të pakontrollueshme… Por që ta vazhdosh këtë lojë, për hir të së cilës çdo brez i lexon veprat letrare në mënyra të ndryshme, duhet të shtyhesh nga një nderim i thellë për atë që quhet qellim i tekstit". [589] Eco ka plotësisht të drejtë kur pohon se çdo brez i lexon veprat letrare në mënyra të ndryshme dhe kjo vlen qoftë për letërsinë autentike qoftë edhe për atë të përkthyer. Arsyetimi ka të njëjtën vlerë edhe për përkthimin. Nëse përkthyesi gjatë rileximit në origjinal, qoftë edhe të një klasiku, arrin që në veprën e tij të zbulojë një përmasë të re, një dimension të ri, ai mund ta risjellë atë, gjithnjë duke pasur bindjen që mund ta tejkaloje përkthimin e parë, por edhe duke i qëndruar sa më afër origjinalit. Natyrisht që puna e përkthyesit bëhet e vështirë, nëse para tij janë emra, mjeshtra të përkthimit si Noli, Poradeci apo Kuteli, Skënder Luarasi, Vehxhi Buharaja, Viron Kokona, Jusuf Vrioni… (e shumë mjeshtra të tjerë).

Nëse flasim për Nolin si përkthyes, ajo që bie në sy është se gjithë ata që e kanë studiuar, e konsiderojnë përkthimin e tij, si një nga kontributet e jashtëzakonshme në letrat shqipe. Njeriu që u lind, siç thotë Qosja, në një vend ku kryqëzoheshin dy kultura, do na sjellë përmes përkthimit të tij mjeshtëror, emrat më të mëdhenj të dy kulturave. "Me çdo krijues që ka përkthyer Noli është njejtësuar, ka hyrë në ndjeshmërinë, në botën dhe në vizionet e tij jetësore. Ai ka ditur të vibrojë në të njëjtat valë si me Khajamin ashtu dhe me Shekspirin, si me Eskilin ashtu dhe me Bodlerin. [590]

Noli ishte i pari që çeli kanatin e një porte përmes së cilës do të hynin kalorësit e mëdhenj të letrave që nga Shekspiri e Ibseni, E. Poe e Servantesi, Ibanezi e Longfellow, për të ndriçuar mëndjet e shqiptarëve përmes kryeveprave të letërsisë botërore. Po meritë e Nolit nuk është thjesht fakti se ai qe i pari që bëri të flasin shqip edhe Hamletin edhe Don Kishotin, por, sepse përmes shqipërimeve të tij, ka mundur të na japë "një ekuivalent shqiptar të një vlere absolute". [591]

[589] U. Eco, Për letërsinë, "Dituria", 2007, f. 10
[590] Qosja, Shkrimtarë dhe Periudha, Tiranë, 2005, f. 251
[591] A. Pipa, Kritika, 1944, f. 87

Do mjaftonin Don Kishoti, Korbi i Poe dhe Rubairat e Khajanit, si provë se kemi të bëjmë me një shqipëronjës "njimënd madhështor". Duket se ai e ka bërë me shumë përkushtim detyrën e përkthyesit që siç thotë i madhi V. Kokona, "përkthyesi i talentuar duhet të depërtojë në botën e ndjenjave të autorit, në mënyrën e tij, në karakterin stilistik dhe të transmetojë, sa më mirë që të jetë e mundur, këtë botë me ndjenja të huaja, këtë mënyrë dhe këtë stil me mjetet e gjuhës amëtare, duke ruajtur gjithmonë personalitetin e autorit". [592]

Servantesi përmes veprës së tij përqesh dhe përbuz përfaqësuesit më tipikë të mentalitetit mesjetar dhe "për këtë qellim, thekson Noli në introduktin e vet, Servantesi zgjodhi si heronj të veprës së tij dy nga tipat më reaksionarë dhe mediavalë që kishte e që kemi akoma përpara sysh: bejlurçinën, sojliun e fandaksur të katundit, Don Kishotin e Manças, dhe laron, Sejmenin, fshatarin e varfër e të paditur, Sanço Pançon".

Ka 80 vjet që Don Kishoti ka zbritur për herë të parë në Shqipëri, ndërkohë që prej qindra vjetësh e kishte bërë xhiron e botës.

Ardhur në Shqipëri përmes shqipërimit mjeshtëror të Nolit, (termin shqipërues më herët e pat përdorur Kuteli tek "Mall e brengë"), kam bindjen se kalorësi i fandaksur i Servantesit ndihej mirë në realitetin gjysmëfeudal dhe gjysmëmesjetar të Shqipërisë së viteve '30. Nëse gjërat arrijnë t'i rezistojnë kohës, me të njëjtin shkëlqim për një kohë të gjatë ato meritojnë të adhurohen, madje sa më shumë kalon koha aq më i sigurt është shkëlqimi, adhurimi, lavdia. Kjo vepër me famë të përbotshme, pati shkëlqimin e vet edhe në realitetin shqiptar falë shqipërimit mjeshtëror të Nolit tonë, që siç konstaton Plasari, Don Kishoti vinte si një "arnaut i kulluar", si një bejlurçinë me silah e me tizga, me takie e me fustanellë, që fliste një shqipe "të therur me gisht". Po kështu edhe shqyrtari i tij i fandaksur nuk dukej as më shumë e as më pak si një "katundar shqiptar i varfër e i paditur, i shkurtër e i trashë nga trupi e nga mendja. Popullariteti dhe fama e Don Kishotit tek shqiptarët, janë të lidhura, pa dyshim me endrrën dhe iluzionin, me triumfin e drejtësisë në tokë dhe idealeve të larta njerëzore. Ajo pjesa prej Don Kishoti, e pranishme tek çdo qenie njerëzore, lidhet me shkëlqimin dhe iluzionin, por edhe me filozofinë e shpresës për vazhdimësinë e qenies së vet.

A. Pipa vë në dukje se shumica e përkthimeve të Nolit janë vërtet madhështore, përgjithësisht përkthimet më të mira të Nolit, janë ato më pak besnike ndaj origjinalit. "Madhështor, i pakalueshëm përkthimi i Khajanmit (këtu fjala përkthim është pak)". [593] Arsyen e përkthimit të Rubairave, Noli na i parashtron që në hyrje të introduktës së vet duke i quajtur ato veprat poetike më të bukura në botë, të qarta e të lehta për t'u kuptuar dhe moderne për nga mendimi e ndjenjat aq sa duket se autori i tyre ka jetuar në kohën tonë dhe në zemër të Evropës. Çfarë ka parasysh Pipa kur thotë se për Rubairat fjala përkthim është pak. Ndoshta faktin që disa përkthime të rëndësishme i bashkangjiten letërsisë së një vendi, pa u bërë pjesë e letërsisë së një kombi, po kur flitet për "Rubaitë e Nolit", aq shumë janë përshtatur me natyrën e gjuhës shqipe sa duket "se kanë hyrë përgjithmonë në trup të letërsisë tonë". Nuk kemi si qellim që në

[592] V. Kokona, Mbi përkthimin, Botimet "Kokona", Tiranë, 2003, f. 12

[593] A. Pipa, Revista Kulturore, Mars 1444

këtë punim të analizojmë idetë liridashëse dhe frymën e protestës dhe as antifetarizmin e ashpër apo militantizmin e lirë të mendimit që përcillet përmes rubairave, por mundin e jashtëzakonshëm, dhe suksesin e padiskutueshëm të Nolit, për ta bërë Khajamin që të flasë shqip. Noli e çmon përkthimin e Rubairave nga Fitzxheraldi në anglisht duke e konsideruar atë si punë krijuese, sipas Nolit përkthimet e bukura numërohen me gishta dhe kjo nga vështirësitë e mëdha që paraqet kjo fushë e veprimtarisë artistike. Një vlerësim të ngjashëm bën studiuesi V. Bala, për mjeshtërinë e përkthimit të Nolit, kur i cilëson Rubairat si të atilla saqë vështirë mund të dallohet nëse kemi të bëjmë me vepër të përkthyer apo origjinale të përkthyesit. [594]

Një tjetër shqipërim i suksesshëm i Nolit është poema "Korbi", një nga realizimet artistike më të bukura të Poe-s, por edhe të letërsisë së përbotshme. Shqipëruesi ynë ka mundur të shpalosë suksesshëm efektet melodike, harmonike dhe ritmike të poemës, efekte që përcillen tek lexuesi shqiptar me një lexim të parë të veprës. "Korbi" nën shqipërimin mjeshtëror të Nolit, na shfaqet me tipare të poezisë shqipe, duke u konsideruar si vlerë e (kësaj poezie) në fondin e letrave shqipe. Në një përfundim të ngjashëm arrin edhe studiuesi Kolë Ashta lidhur me poemën "Korbi". "Në këtë poezi që gati mund të guxojmë me e quejtë shqiptare, edhe jo e përkthyeme, dëgjohet jehona e një tingulli të marrë, kërcitja e një kumbone vdekje". [595]

Shqiptari preket nga leximi i poemës- vëren Ashta, sepse në të jeton një shenjë e dallueshme e "shpirtit arbnuer. Noli jo vetëm që ka mundur të perceptojë, por edhe ta përcjellë me elegancë, një nga veçoritë e mjeshtërisë së Poe-s, aftësinë për të magjepsur dhe për të hipnotizuar lexuesin. Refreni i përsëritur "Never more", që Noli na e sjell në trajtën "Kurrë më", i ngjan një vajtimi shqiptar, që përcjell tek lexuesi jo vetëm intensitet dramatik, por edhe dhimbje e dëshpërim. Është e dukshme në shqipërimin e kësaj poeme, përpjekja e jashtëzakonshme e Nolit për të hulumtuar me resurset e gjuhës shqipe, në thesaret e saj, jo vetëm që të mos t'i mbetet borxh origjinalit, por as lexuesit të tij.

Noli pra, me përkthimin e Korbit, ka mundur të krijojë një realitet të ri artistik, duke u shmangur shpesh nga origjinali, por duke e përforcuar vlerën e përkthimit të tij. Lidhur me këtë K. Ashta arin në përfundimin se: "Në përkthimin e Nolit, lexuesit gjenden para një vepre shqiptare, para një elegjie, që populli arbnuer di ta shprehë e ta kuptojë. Noli përktheu frymën e poezive në tetërrokëshin popullor, me natyrën e gjuhës shqipe, këtë trajtë të re andeje estetike që na ndrydh e na nalton". [596]

Ishte një vëzhgim i shpejtë i tri prej shqipërimeve të Nolit, që mendojmë se janë nga më të realizuarat në listën e gjatë të përkthimeve të tij, pa hyrë në analiza të hollësishme duke arritur në përfundimin, se metoda noliane e përkthimit na çon deri në rikrijim të veprës së përkthyer. Pipa nuk e tepron aspak kur thotë se Noli nuk është veç një përkthyes, por një përkthyes origjinal, më tepër se përkthyes: "rikrijues nëse jo krijues". Anglezët e përmendin Fitzxheraldin, jo për vjershat e tij, por mbi të gjitha për përkthimin e Khajamit, kurse Noli përmendet në letërsinë tonë, edhe për poezinë por

[594] V. Bala, Noli, Vepra 1, Rilindja, Prishtinë, 1989, f. 36
[595] K. Ashta, Revista "Shkëndija", Tiranë nr. 4, 1940, f. 55
[596] K. Ashta, Revista "Shkenija", Tiranë, nr. 4, 1940, f. 55

sidomos për shqiptimin e Khajamit. Nisur nga sa thamë, le t'i rikthehemi problemit që shtruam në hyrje të këtij punimi, lidhur me nevojën e ripërkthimit të klasikëve në shqip. Përse të mos ndodhë? Nëse guxon, fjala vjen, t'i risjellësh sërish rubairat në shqip, duhet të sigurohesh para së gjithash, që produkti yt të jetë më tërheqës se ai që ka servirur Noli, nëse potenciali gjuhësor i përdorur prej teje e tejkalon atë ç'ka sjell Noli, nëse ti je më besnik ndaj origjinalit se Noli, ja vlen t'i provosh. Por a kemi përkthyes të dedikuar dhe ente botuese të gatshme?

***

Veprimtaria e Nolit si kritik duket që është ngushtësisht e lidhur me atë të Nolit si përkthyes, jo thjesht për faktin se gjykimi i tij kritik shkon për ato vepra të cilat ai i përktheu, por edhe për kriteret që pati zgjedhur në përzgjedhjen e autorëve që solli para publikut të tij. Profili i Nolit si politikan kërkonte si askush tjetër që dhe arti t'i përshtatej qellimeve të tij politike, pra më shumë se sa me funksion estetik arti i Nolit kishte funksionin e edukimit, me synimin që të zgjonte ndjenjën kombëtare dhe dashurinë njerëzore. Pra, siç do vinte në dukje dhe Pipa, kredoja e tij nuk është "arti për art", siç ndodhte me artin e Konicës, por "formula e Nolit qe gjithmonë 'arti për edukatë'"[597]

Introduktat e Nolit, të cilat pasqyrojnë mendimin kritik letrar të tij, më shumë gjasë ka që të jenë shtysa të angazhimeve të tij politike, sesa kurioziteti për të depërtuar në të fshehtat e procesit krijues. Kjo duhet të jetë arsyeja që siç thekson Qosja, ai (Noli) ishte më shumë lexues sesa gjykues i veprave letrare, dhe se ai "nuk ka ndier nevojën shpirtërore të mendojë rreth fenomenit artistik dhe problemeve teorike të tij". [598] Hyrjet apo introduktat e Nolit duhet të përshtateshin me nivelin e publikut shqiptar, i cili, për herë të parë binte në kontakt me këta kolosë të letërsisë botërore duke qënë i bindur se vlera e tyre "qëndron në domethënien që kanë në të gjitha kohët, në të gjitha breznitë dhe në të gjitha mjediset". [599]

Fakti që ai përzgjodhi majat e letërsisë realiste botërore si Servantesin, Shekspirin, Stendalin, Gëten, Ibanjezin, Molierin e Khajamin, më shumë sesa për preferencat letrare të Nolit, lidhet me formulën noliane të "artit për edukim". Kuteli ishte i pari studiues i Nolit që e vlerëson atë, përpos të tjerave edhe si kritik, madje si kritikun që "hodhi themelet e një kritike të plotë shkencore". [600]

Nuk ka shumë rëndësi nëse ishte Noli i pari dhe Konica i dyti apo Konica i pari dhe Noli i dyti, ata ishin pothuajse të njëkohshëm. A ishte në të vërtet Noli ai që hodhi themelet e një kritike të vërtetë shkencore? Studiuesi S. Hamiti, mendon se është pikërisht Konica kritiku i parë i shqipes, jo se ky i pari shkroi kritika me vlerë për veprat shqipe dhe shfaqi ide për vepra dhe autorë shqiptarë, po sepse ishte i pari që kritikën letrare e shkroi me një vetëdije letrare, e përkufizoi si zhaner letrar dhe përkufizoi funksionin e saj në kuadrin e zhvillimit të letërsisë kombëtare. Teksti teorik i Konicës "Kohëtore e letrave shqipe", botuar më 1906, shpalos kredon teorike të

[597] A. Pipa, Bariu i Popullit, Revista "Kritika", nr 4, 1944

[598] R. Qosja, Shkrimtarë dhe periudha, Botimi i Akademisë se Shkencave, Tiranë, 2005, f. 264

[599] Po aty, f. 268

[600] M. Kuteli, Bota e Re, Korrik, nr 1, 1941

Konicës në fushë të kritikës dhe estetikës. Ka gjasë të ketë qënë obligimi i vazhdueshëm në jetën politike e shoqërore, që s'e ka lejuar Nolin për më tej. "Fan Noli në studimet letrare, mendimet e gjykimet që shfaq, nuk i kushtëzon nga teoritë letrare. Ai bën nga një anë një punë serioze për studimin e veprës dhe njohjen e literaturës përkatëse, dhe nga ana tjetër, falë inteligjencës, mprehtësisë, shijes së hollë dhe erudicionit të pasur përpiqet të analizojë veprën e autorit relativisht në mënyrë të pavarur dhe kjo e çon shpesh herë të japë mendime origjinale dhe të ketë një këndvështrim të ri". [601]

Kjo do të thotë që ai nuk është rob i teorive letrare, madje përpiqet t'i tejkalojë ato. Sipas Qoses, në fillimet e veta, Noli, nuk bëhet fjalë që mund të kishte një metodë të formuar, si kritik letrar, madje në parathënien e Otellos nuk kemi më tepër sesa "një përfolje të përmbajtjes së kësaj tragjedie". [602] Ndërsa në një periudhë më të vonshme "ai i afrohet metodologjisë marksiste në historiografi e kritikë". [603] Nga ana tjetër siç theksuam tek Konica, dallojmë përpjeket për ta vënë kritikën realisht mbi baza shkencore. Ai kishte guximin, siç vëren Qosja, që duke shkruar një vepër "të shfaq mendimin e vet edhe mbi fenomenin letrar, kurse Noli gjithnjë ka qëndruar larg kritikës integrale, e cila aspiron të përfshijë veprën letrare prej të gjitha aspekteve, ose prej një numri sa më të madh aspektesh". [604]

Noli i ka çmuar faktet, është mbështetur në to, por pa tentuar të bëjë formulime teorike. Noli ka synuar me kritikën e vet për të qënë edhe i qartë, edhe i thellë, por edhe modern. Ai quan vepra të mira ato që kënaqin lexuesin më të thjeshtë, që kanë thellësi mendimi, dhe njëkohësisht përmbushin edhe shijet e kritikëve më rigorozë.

Kështu, përballë kritikut modest, të mprehtë dhe të thellë në gjykim, zhbirues i vlerave më të arrira letrare, objektiv dhe racional, ngrihet figura e përkthyesit gjenial, ende të papërsëritshëm deri në ditët tona.

[601] N. Jorgaqi, Parathënie Vepra 5, Botimi i Akademisë së Shkencave, Tiranë 1988, f. 55
[602]. Qosja, Shkrimtarë dhe periudha, Botimi i Akademisë se Shkencave, Tiranë, 2005, f. 272
[603] Po aty, f. 270
[604] Po aty, f. 266

VASILIKA POJANI
HILDA LUBONJA
ERIOLA BONJA

POEMA "SKËNDERBEU" E H. W. LONGFELLOWT PËRMES SHQIPËRIMIT TË FAN S. NOLIT

Fan Noli është një nga emrat më të njohur në fushën e kulturës dhe letrave shqipe. Në figurën poliedrike të Nolit si historian, si burrë shteti, si poet e mendimtar, si krijues i madh artistik, si përkthyes e shqipërues, si kryeprift, ne jemi ndalur në punën e tij si përkthyes e shqipërues.

Noli, me përkthimet e tij, e bëri shqipen të matet denjësisht me kryegjuhët, duke merituar emrin "kryeletrar shqiptar", e shpuri shqipen dhe mendimin shqiptar më përpara.

Si njohës i mirë i disa gjuhëve, Noli dha një kontribut të çmuar në përkthimin e veprave letrare të autorëve të mëdhenj amerikanë dhe europianë në gjuhën shqipe. Ai njihet si përkthyes edhe nga gjuha shqipe në gjuhët e mëdha, si: në greqisht "Shqipëria, ç'ka qënë, ç'është, dhe ç'do të bëhetë"; në anglisht përkthimi i admirueshëm i Biblës. Ai është i pari që përdori gjuhën shqipe në shërbesat e kishës që bëheshin në anglisht. Përkthimi dhe puna si murg ishin dy kënaqësitë e jetës së tij. Me pasionin për gjuhët e huaja, në moshën 82 vjeç, ai mësoi një degë të gjuhës hebraishte dhe kur e pyetën se për çfarë i duhej, ai u përgjigj: " Më duhet kur të flas me Krishtin" (Hirësia At Johan Belushi në 35 përvjetorin e vdekjes së Nolit).

Punën si përkthyes e nisi si vazhdues i traditës së krijuar nga Kristoforidhi me disa libra të shërbesës për kishën shqiptare dhe më pas, për afro një periudhë prej gjysmëshekulli, ai iu përkushtua përkthimeve të veprave të mëdha nga letërsia botërore, të cilat e bënë të njohur si përkthyes jo vetëm në Shqipëri, por edhe jashtë kufijve të saj. Talenti për të mësuar gjuhët e huaja, si dhe njohja e thellë e gjuhës amtare dhe realitetit shqiptar, bënë të mundur që pëkthimet e tij të kthehen në krijime origjininale. Noli bëri të flasin në shqip kolosët e letërsisë botërore, si Shekspiri, Servantesi, Stendali, Hygo, Gëte, Longfellow, Khajami etj. duke ndihmuar kështu bashkëkombësit të lexojnë dhe të njohin shkrimtarët e mëdhenj dhe vepra me vlerë universale që do të zgjeronin njohuritë e tyre kulturore.

Përzgjedhja e veprave të përkthyera nga Noli, gjithashtu, dëshmon për kulturë të gjerë letrare, për aftësi gjykimi dhe shije të holla, për aftësi në njohjen e brendisë ideore të veprave, të problemeve të shoqërisë shqiptare të kohës, si dhe për përpjekje në krijimin e një traditë të re në fushën e përkthimit. Brendia atdhetare e këtyre veprave jo vetëm e pasuronte kulturën tonë kombëtare, por edhe u bënte jehonë shumë problemeve aktuale të realitetit shqiptar. Ishte koha kur gjuha jonë e shkruar duhej të përmirësohej për t'iu përgjigjur arritjeve letrare të kohës. Falë këtyre aftësive, Noli u shqua si shqipërues i një niveli botëror.

Duke lexuar shqipërimet poetike të Nolit, me të drejtë çdokush mund t'i quajë ato pjesë të krijimtarisë së tij poetike, pra rikrijime të vërteta origjinale.

Në përkthimet e tij gjithashtu përfshihen poetë të mëdhenj romantikë dhe lirikë të shekullit XIX. Me përjashtim të rubairave të Khajamit, të gjitha poezitë Noli i solli në shqip nga origjinali. Ai në përgjithësi zgjodhi dhe përktheu poezitë më të njohura të poetëvë të mëdhenj, por ka ndodhur të ketë përkthyer edhe poezi të zgjedhura për shijet e tij personale si p. sh., "Korbi" i Po-së për të cilën Noli ka dhënë dy variante përkthimi. Nota optimizmi, liriko-epike, satirike, humori dhe ndonjëherë edhe nota pesimizmi janë karakteristika të poezisë të përkthyer nga Noli të shoqëruara me një mjeshtëri poetike, me efekte melodike, harmonike dhe ritmike.

Në tërësinë e këtyre veprave kemi zgjedhur të analizojmë përkthimin e poemës "Skenderbeu" të poetit amerikan Henry Wadsworth Longfellow.

Me nota lirizmi, ndërthurur me intonime të larta epike, poema i përgjigjet thellësisht frymës së këngëve tona popullore të trimërisë dhe nxit frymën kombëtare. Poema "Skënderbeu" u shqipërua dhe u botua në Boston, në vitin 1916, në vëllimin e tij të parë. Noli ia dedikoi përkthimin e saj "një shoku armësh" Faik Be Konicës, të cilin e quan *"lëronjës të gjuhës atërore dhe kalorës të Kryqësatës Kombëtare si shenjë nderimi". (With complements of the author F. S. Noli, Boston, March 8, 1918).*

Poema "Skenderbeu" ndodhet në veprën "Historira të një hani afër udhës" (Tales of Wayside Inn).

Si në disa përkthime të tij, edhe këtë poemë Noli e hap me një parathënie (introdukt) ku spikatin mendime kritike dhe estetike. Kjo, për kohën, shihet si një gjest novator në mënyrën e të menduarit dhe të vlerësuarit të veprës. Në të lexuesi do të njihet me mendimet e drejtpërdrejta të Nolit për zgjedhjen dhe përkthimin e poemës. Noli shprehet:

"Nisa dyke botuar "Skɛnderbenɛ" e vjershɛtorit amerikan tɛ dɛgjuar Henry Ëadsëorth Longfellow. Kjo vjershɛ ɛshtɛ nofta mɛ e bukura qɛ ɛshtɛ shkruar nɛ gjuhɛ tɛ huaj pɛr trimin tonɛ kombɛtar dhe meritonte vɛndin e parë nɛ mes tɛ vɛllimeve qɛ kam nɛr ment tɛ nxier nɛ shesh pɛr kɛndonjɛsit shqiptarɛ. Vjershɛn e kam kthyer lirisht, sikundɛr do tɛ shohin me njɛ herɛ ata qɛ dinɛ inglishten, dyke pɛrdorur masɛn dhe rithmin e kɛngɛve tona popullore. Kam shpresɛ qɛ Shqiptarɛt do tɛ mɛ pɛrkrahin, dyke blerɛ vɛllimin e parɛ qɛ tɛ munt t'a vazhdonj punɛn qɛ nisa dhe tɛ botonj disa libra tɛ tjera qɛ jam dyke gatitur. " [605]

Më pas, Noli jep një biografi të shkurtër të shkrimtarit Longfellow, si dhe subjektin e poemës. Ai i kushton rëndësi biografisë së shkrimtarit, rrethanave historiko-shoqërore kur është shkruar vepra, për një shpalosje më të mirë të subjektit të saj.

Ai e shoqëroi këtë përkthim duke vënë përbri vargjeve shënime shoqëruese për historinë e Skënderbeut dhe disa shpjegime fjalësh të cilat e bëjnë atë më të kuptueshme, pra ndihmojnë lexuesin të kuptojë rrethanat në të cilat ka ndodhur ngjarja.

[605] *Fan S. Noli, Vëllimi I, "Skenderbeu" Libraria Popullore Boston, Mass. 1916, fq. 4*

Historinë e Skënderbeut e rrëfen Çifuti i Spanjës. Subjekti i saj organizohet rreth largimit të Skënderbeut pas luftës së Nishit dhe kthimit të tij në Shqipëri, ngjarje e njohur kjo për kombin, ngritjen e flamurit kombëtar dhe gëzimin i popullit për çlirmin e atdheut nga zgjedha e huaj. Noli, në introduktën e poemës shpjegon: "*Nga frika se mos e shqipërova liksht "Skënderbenë" e vjershëtorit amerikan, u jap këndonjësve dhe tekstin inglisht. Ata që s'dinë tjatër gjuhë do të kënaqen, duke marrë nga shqipërimi im një ide pak a shumë të larkme të bukurisë, me të cilën e këndoj trimin tonë kombëtar vjershëtori Longfellow. Kam një shpresë të vogël që lulja që mora nga kopshti i tij nuk e humbi fare as erën, as ngjyrën, as freskinë, duke u mbjellur në gradinën e Shqipërisë. Këndonjësit do të gjykojnë më mirë. " [606]*

Përkthimi i poezisë njihet si më i vështiri midis përkthimeve të gjinive të tjera letrare. Ashtu si e pohon edhe vetë autori, *"kthimi i një vjershe nga një gjuhë në tjatër është një gjë e zorshme, në mos e pamundshme. "* Shumë nga studimet që synojnë të analizojnë problemet e përkthimit të poezizë, konsiderohen ose si vlerësime të përkthimeve të ndryshme të së njëjtës vepër, ose si deklarata personale nga përkthyes të veçantë për zgjidhjen e problemeve të përkthimit. [607]

Kur studiojmë veprën që ka përkthyer një autor, vëmendja përqëndrohet veçanërisht në ruajtjen e kuptimit, gjithashtu interes paraqet *"pasuria e gjuhës me gjithë arsenalin e mjeteve të saj" [608]*

Por, për ta bërë më të plotë këtë analizë duhet të marrim në konsideratë ritmin e brendshëm të poemës. Në poezi ritmi është më i dukshëm, i jep muzikalitet poezisë, kështu analizat duhet të përqëndrohen më shumë te ridhënia e rrokjeve, aliteracionet, rima, ritmi, intonacioni, ngjyra e tingujve etj. Megjithëse e vështirë dhe komplekse, Noli ka mundur t'i rimarrë këto elemente në poemën e shqipëruar, duke siguaruar muzikalitetin e vargut, si pjesë të personalitetit të tij.

Rexhep Qosja shprehet: "*muzikën e vargut Noli e ka vënë në shërbim të përmbajtjes dhe të kuptimit të poezisë. Me anën e muzikës së vargjeve, Noli ka sugjeruar atmosferën, ka shtuar kuptimin e tyre…" [609]*

Ritmi i brendshëm është gjithashtu një lojë e brendshme zanoresh dhe diftongjesh, bashkëtingëlloresh e togfjalëshash që e bëjnë të vështirë përkthimin e poezisë, në mos të pamundur që të përkthehet besnikërisht. Ngjyrën e melodisë Noli ka ditur ta japë me anën e tingujve të ndryshëm ku janë përsëritur herë bashkëtingëllore e herë zanore, ose dy a më shumë tinguj në të njëjtin varg.

Në analizën e shqipërimit të poemës "Skënderbeu", e cila është bërë e famshme falë përkthimit të Nolit, do të analizojmë përftesat që mbështeten në *variacionin tingullor*, në *organizimet tingullore* dhe *simbolizmi tingullor*, si dhe lidhjen e tyre me kuptimet.

1. Variacioni fonetik

a) theksi

---

[606] *Ibid. fq 6*

[607] *Andr'e Lefevere - Specific problems of literary translation, pp 87*

[608] *Ardian Klosi, Artikull 15 Maj 2001*

[609] *Qosja, R. "Shkrimtarë dhe periudha" Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2005, fq. 287*

Theksi në gjuhën shqipe përgjithësisht është i ngulitur, por në shqipërimin e Nolit ka raste të zhvendosjes së theksit për nevojat e rimës në varg si:

Lɛftʹon luftɛn dhe fitʹon,

Mbreti Ladisllʹav gjɛmʹon,

Ajo që të bie në sy menjëherë në poemën e shqipëruar të Nolit, është vendosja e shenjës së theksit. Kjo është një mënyrë për të tërhequr vëmendjen e lexuesit në ruajtjen e ritmit dhe rimës, si dhe për një lexim të rrjedhshëm të saj; ps Then he bade them bind with chains "Lidheni, tha, me litár (fq. 11)

This man of books and brains; Shkrónjɛsin me kallamár! "

b) rrokja

Vihen re gjthashtu zgjatje të rrokjes duke e theksuar atë dhe duke e bërë fjalën të tingëllojë më solemnisht, p. sh.

In fire of hell and death's frost, Djek si Ferr, si vdekje pret (fq. 8)

On the day of the Pentecost. Ditɛn e Rushʹajevet.

c) tingujt

Po për nevojat e ritmit dhe të rimës, Noli ka përdorur si *cungimin, ashtu edhe shtimin e zanoreve*, që vihen re në vargjet e mëposhtme, psh.

From the field of battle red Dhe nga fushʹ(ë) e kuqe gjak (fq. 9)

As on through the night he rode Edhe natën tek po shkon (fq. 11)

And gazed at the fateful stars Yjt' e fatit po shikon

That ëere shining overhead; Qɛ i ndritnin n'(ë) udhɛtim;

Shtim të zanoreve

And smiled to himself, and said: Nenɛqshi edhe tha:

"This is the time to laugh. " "Єshtɛ koha pɛr gɛzim. "

And honors ëithout end Gjithɛnj'ɛ do t'tɛ nder'onj (fq. 15)

Shall surround thee on every side Me kujd'es do t'tɛ rreth'onj

Fon ëhat is ërit in his name Se çdo urdhër qɛ tɛ japɛ (fq. 13)

Can never be recalled Kurrɛ nukɛ merret prapɛ

Have I done this unto thee Pɛrandaj t'a bɛj kɛtʹɛ (fq. 13)

2. Organizimet tingullore

Organizimet fonetike si rima, ritmi, asonanca, konsonanca, aliteracioni kanë efekt shprehës dhe i japin poemës muzikalitet, atmosferë solemne dhe emocionale.

a) ritmi

Në poemë vemë re një ritëm jo të njëtrajtshëm; strofa e parë karakterizohet nga vargu jambik (- /) dhe strofa e dytë nga ai anapestik (- - /); p. sh.

(strofa I) *Djek* si *Ferr*, si *vde*kje *pret*

(strofa II) Skɛnder*beu*, nder, lavdʹ*i*

b) metrika

Vjershërimi sipas metrikës mbështetet në ritmin. Sistemi metrik lidhet me sistemin theksor të gjuhës. Vargjet shqipe kanë karakeristikë si theks ritmik theksin parafundor

në mbyllje të vargjeve dhe ndjekin sistemin rrokjetheksor, d. m. th. numërohen rrokjet e theksuara dhe vendi i theksave.

Noli ka ruajtur shtatërrokëshin e origjinalit, që edhe në shqip është shtatërrokësh. Gjithashtu edhe rimat shkojnë sipas skemës së origjinalit: AA-BB-CDDC.

The battle is fought and ëon	A	Lɛft′on luftɛn dhe fit′on, (1)	A
By King Ladislaus the Hun	A	Mbreti Ladisll′av gjɛm′on, (2)	A
In fire of hell and death's frost,	B	Djek si Ferr, si vdekje pret	B
On the day of Pentecost.	B	Ditɛn e Rush′ajevet. (3)	B
And in rout before his path	C	Dhe nga fush′ e kuqe gjak	C
From the field of battle red	D	Ikɛn, rent pɛrpara tij	D
Flee all that are not dead	D	E Muratit ushtɛr′i (4)	D
Of the army of Amurath.	C	Qɛ shpɛt′oj e s'ra nɛ lak.	C

c) theksat në varg

Ndryshe nga origjinali, Noli ka ndryshuar theksat në varg. Ndërsa Longfellow ka tri theksa për varg, shqipëruesi përdor dy, duke ndjekur traditën e poezisë shqipe, por dhe fonologjisë së fjalëve shqipe që e kanë theksin përgjithësisht në rrokjet e parafundit, kurse anglishtja ka shumë fjalë njërrokëshe dhe theks në rrokjet e para për fjalët disarrokëshe. Në poemën origjinale theksi është vendosur në fillim, te rrokja e dytë: "*The b'attle is f'ought and ë'on"*, ndërsa në poemën e shqipëruar theksi i parë ndodhet te rrokja e tretë pra, te l′uftën; *"Lëfton l'uftën dhe fit'on"*.

d) aliteracionet

Gjithashtu, si mjeshtër i vërtetë i përkthimit, Noli përdor gjerësisht aliteracionet, më shumë se vetë Longfellow. Në dy vargjet e para mbizotërojnë zanoret e mesme (apo të errëta) o dhe u, në dy vargjet e dyta mbizotëron zanorja e çelët e përparme e:

Lɛft′on luftɛn dhe fit′on,
Djek si Ferr, si vdekje pret.
Gjithashtu vihet re përsëritje e tingujve bashkëtingëllorë; si p. sh. tinguli *t* në vargjet
Ikɛn, rent pɛrpara tij
E Muratit ushtɛri

Poema karakterizohet nga një ndërthurje e ritmit herë të ngadaltë dhe herë të shpejtë, për të dhënë ndjenja të rënda, mendime të rëndësishme dhe solemne, dhe për të shprehur *"nota buçitëse, sulmuese dhe dërrmonjëse"* [610]

3. Simbolizmi tingullor

Burim shprehës për të arritur efekte të ndryshme është edhe lidhja ndërmjet tingullit e kuptimit, lidhje kjo që e bën kuptimin e fjalës më të perceptueshëm. Noli njihet "*si mjeshtër i shfrytëzimit të efekteve tingullore"* shoqëruese të kuptimit, [611]

Who we are, that shall withstand	Kur ng*r*e do*r*ën kundë*r* nesh
The wind of his lifted hand?	Dhe na g*rr*yen si *rr*ebesh (fq. 11)

[610] *Mitrush Kuteli, Vepra letrare 5, Janar 1990, fq. 275*

[611] *Xhevat Lloshi, Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika, 2005, fq. 61*

Tingulli r i përdorur në përkthimin e Nolit jep shumë bukur kuptimin e dridhjes, zhurmës rrotulluese, tmerrit që shkaktohet nga shkatërrimi, si dhe vihet re një shkallëzim rritës shprehur nga kalimi i *r-* së së butë në *rr-* në e fortë. Noli këtu ka realizuar muzikën e vargut në përputhje me idenë e lëvizjes, rrotullimit dhe shkatërrimit, duke krijuar kështu harmoni ndërmjet përmabajtjes dhe formës.

4. Grafematika

Vihet re ruajtje e pamjes vizuale të poemës së shqipëruar me atë origjinale nëpërmjet përdorimit të të njëjtit numër vargjesh në strofë dhe të formatit të saj prej gjysëmrrjeshti.

Si poet i shek. 19-të Longfellow ka përdorur shumë arkaizma dhe zhargone, p. sh.

(They lie on the bloody *sod – njeri*) ose (Noë follow *ëhither* I ride - *vend*) ose (Of the hoofs of Iskander's *steed* - kalå); (përemrat thou, thee, thy), (foljet *doest, belongeth, hast, shouldst, leadeth, shalt*); ndërsa Noli ka përdorur në shqipërimin e poemës turqizma dhe neologjizma (emër + emër foljor), sepse ka dashur të konkretizojë më mirë dhe më qartë atmosferën; p. sh.

wearing his signet ring,	Me *myhyrin* e Dovletit (fq. 11)
To King Amurath's Pasha	Pɛr *Mytesarifn'* e Mbretit (fq. 13)
And the Scribe bowed low in dread,	Dhe *Qatipi* u-krrus prej tmerrit (fq. 13)
Of the bivouac fire apart,	Afɛr zjarrit, i dɛrmuar,
With the chill of the midnight air	Flokɛ-bardhɛ, *kokɛ-prerɛ,*
On his forehead white and bare,	Nga e ftohta i mɛrdhirɛ,
And the chill of death in his heart.	*Zemɛr-prerɛ, vdekje-ngrirɛ.*

Përdorimi i barbarizmave në të shumtën e rasteve iu përgjigjet nevojave të rimës dhe të ritmit, por edhe të kuptimit të poemës, si p. sh. fjalën *duvlet,* ai e ka përdorur për të shprehur urrejtjen për shkak të formës së saj në Shqipërinë e asaj kohe, si dhe *"për ironizim"* [612]

Bazuar në strategjitë e ndryshme të përkthimit të poezisë dhe fonostilistikës, Noli ka ndjekur *përkthimin fonemik*; që do të thotë se hera herës ka riprodhuar tingullin e gjuhës angleze në gjuhën shqipe, si dhe ka krijuar një perifrazim të kuptimit, duke e bërë poemën më shprehëse, të tingëllojë bukur dhe me muzikalitet; p. sh.

When he crossed the river Drin,	Kapërxeu lumin Drin (tingulli *i*) (fq. 17)
And saw *i*n the glim of the morn	Dhe u-gdh*i* e n' agullim

Pra, çelësi i muzikalitetit te Noli ishin pikërisht përzgjedhja e fjalëve në shqip, rimat e sakta dhe aliteracionet e shumta.

612 *Qosja, R. "Shkrimtarë dhe periudha" Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2005, fq. 299*

Këto veçori dëshmojnë për kompleksitetin e përkthimit të poezisë ku natyrisht, ka ndryshime midis origjinalit dhe përkthimit, ndryshime që përfshijnë kulturën, kohën dhe hapësirën. Siç e pohon edhe Popovič, "përkthyesi ka të drejtë të ndryshojë organikisht, të jetë i pavarur", nëse kjo pavarësi ndiqet për hir të origjinalit, d. m. th. për ta riprodhuar atë si një vepër origjinale. Përkthimet reflektojnë leximet, interpretimet dhe përzgjedhjen individuale të kritereve të përkthyesit të përcaktuara nga koncepti i funksionimit të të dyjave, të përkthimit dhe të origjinalit. Suksesi apo dështimi i një përkthimi i lihet lexuesit ta gjykojë. Variacionet në metodën e përdorur shërbejnë për të theksuar faktin se nuk ka një mënyrë të vetme të drejtë në përkthimin e poezisë, ashtu si nuk ka as edhe një mënyrë të vetme të drejtë të të shkruarit të poezisë. Këtë e vërteton Noli, me përkthimin e poemës së Longfellowt.

Kështu, themi me bindje se Noli mbetet një ikonë e letërsisë shqiptare në fushën e përkthimit shqip. Me përkthimet e tij, ai ka mundur të sjellë në gjuhën shqipe botën e pasur të klasikëve botërorë, të cilët kanë folur shqip po aq bukur sa kanë folur edhe në gjuhën e tyre origjinale.

Krahas rolit të rëndësishëm për formimin shpirtëror të shqiptarëve, përkthimet e Nolit kanë ndihmuar gjithashtu, në pasurimin e kulturës kombëtare si dhe fuqinë shprehëse të gjuhës shqipe.

Kontributi kryesor i Nolit në letërsinë shqipe si përkthyes është i lidhur ngushtë me atë të stilistit. Noli mund të konsiderohet si një nga stilistet me të mëdhenj të gjuhës shqipe. *"Ai është në radhë të parë stilist përkthyes e, pastaj, stilist original".* [613]

613 *Qosja, R. "Shkrimtarë dhe periudha" Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2005, fq. 304*

VEBI BEXHETI

FAN NOLI DHE SHEKSPIRI

Kumtesën e titullova kështu, për respektin ndaj figurës së pavdekshme të Shekspirit dhe sipas Nolit, të parit në vargun e shkrimtarëve më të shquar botërorë, dhe për të argumentuar meritën e madhe te Nolit, që ka për këtë kolos, jo vetëm pse e solli atë dhe veprën e tij në mesin e shqiptarëve edhe atë shume vite më parë, por për të dëshmuar edhe meritën që ka shkrimtari ynë i madh në vlerësimet objektive të kësaj figure që shkëlqeu në letërsinë angleze dhe botërore.

Fan S. Noli si një ndër figurat më të ndritura të kulturës shqiptare, i cili u quajt edhe institucion në vete, pa veprën e Shekspirit dhe angazhimin e tij për këtë vepër, qoftë për shqipërimin e katër tragjedive më të njohura të tij, qoftë për kontributin që e dha përmes introduktave të njohura, do të dilte më i varfër. Pra, edhe Shekspiri, edhe vepra e tij e ngritën Nolin në vendin e merituar që ka sot, ashtu siç nuk është për t'u nënçmuar edhe merita e Nolit për vlerësimin objektiv dhe me kompetencë për të ngritur aq lartë këtë vepër.

Noli ishte ndër kritikët që e çmuan drejt rolin e Shekspirit dhe e caktuan vendin e tij në historinë e letërsisë e të qytetërimit botëror. [614] Kjo vlen të theksohet, sepse nuk qenë të paktë personalitete të ndryshme, madje figura gjeniale që e kritikuan aq shumë Shekspirin dhe veprën e tij.

Volteri e pëlqente Shekspirin sa për ta lexuar, por asnjëherë nuk e vlerësoi si duhet, mandej e quajti barbar, të egër. [615] Të tjerë personalitete siç janë: Niçja, Tolstoi, Bernard Shou etj., ngjallen gjithashtu dyshime në gjenialitetin e tij, duke ia mohuar shkëlqimin, bukurinë dhe vlerën e mirëfilltë. Kritiku anglez i shek XVII, Forbs në një shkrim shprehet: Shekspiri s'ka as talent tragjik, as talent komik. Tragjedia e tij ishte artificiale, kurse komedinë e shkroi instinktivisht. Kritiku Xhonson po ashtu i shek XVII, Shekspirin e akuzoi për plagjiaturë, i cili nuk ka lënë autorë pa vjedhur, shkruan ai. Tragjedinë "Otello" e quan një farsë të përgjakur ndërsa "Jul Qesarin" një dramë të ftohtë. Kësisoj vlerësimesh dhe të ngjashme, ku nënçmohet ky shkrimtar gjenial e detyruan Nolin që në artikullin e tij "Shekspiri në rrezik", të shkruar më 1906, ta mbrojë këtë shkrimtar të madh. Më këtë rast Noli shkruan kështu: As me krishterimin e Tolstoit, as me logjikën praktike të Bernard Shou-t, nuk ka për të zbritur Shekspiri që atje", që atje hipi vetë, me mendjen e tij të egër, të marrë, pa rregull, po të bukur si natyra. [616]

Edhe për këtë arsye, Shekspirin edhe Nolin, me këtë rast po i përmendim së bashku. Pikërisht për këtë Noli bëhet më madhështor. Në kohën kur kritika jonë letrare ishte ende në embrionin e vetë, Noli iu rrek një pune të madhe serioze e të guximshme, për të bërë dialog me Shekspirin, jo pse ai si individ kishte interes, por sepse e ndjeu si

[614] Alfred Uçi, Shekspiri në botën shqiptare, Shkup 1999, f. 10
[615] Po aty.
[616] Po aty.

tepër të nevojshme prezencën e veprës shekspiriane ndër lexues shqiptarë. Noli ishte i pari që e solli Shekspirin ndër ne, në një kohë kur shumë kombe nuk e kishin atë fat dhe privilegj, ashtu siç nuk e patën edhe privilegjin të kenë një Fan Nol.

Kush e di sa do të ishte vonuar Shekspiri për të ardhur ne Shqipëri, thotë Alfred Uçi, sikur të mos kishte qenë Fan Noli. Ishte gjendur ndonjë përkthyes tjetër që do ta kishte shqipëruar, vazhdon ai, por ne mendojmë ndryshe: Zor se mund të kishte pasur një të dytë, që ta kishte bërë këtë punë aq mirë dhe aq shpejtë, në atë kohë që e bëri Fan Noli. Kësaj pune – të fillojë shqipërimin e Shekspirit, mund t'i hynte vetëm një njeri të cilit ishin dhënë (nga zoti ose nga natyra)?! forca faustiane, tek i cili gjallonin energji të atij lloji që i patën vënë në lëvizje mendjen e Shekspirit.

Fan Noli e nisi këtë punë me dashuri dhe sinqeritetin më të madh, i vetmi ndër intelektualët shqiptarë të kohës. Edhe pse merret me veprimtari të gjithanshme, këtë punë e bëri me përkushtim, jo vetëm pse deshi, por edhe pse kishte zotësi. Ai e njohu në thelb fuqinë krijuese te Shekspirit, e njohu veprën e tij, dhe vuajti së bashku me personazhet e kësaj vepre, vuante për fundin tragjik të tyre.

Një intelektual po ashtu i kalibrit të madh, i kohës së tij, Faik Konica, i pati sugjeruar Fan Nolit që t'i hyjnë punës për përkthimin e veprave të Shekspirit. Derisa Konica bënte plane kah t'ia niste, Noli më 1915 e përktheu "Otello-n" dhe pas 10 vjetësh i përktheu edhe vepra tjera, njëra pas tjetrës; "Hamletin", "Jul Cezarin" dhe "Makbethin". Noli, në fillim pati dilema në suksesin që mund të arrinte. Gjuha shqipe në të cilën nuk ishte shkolluar asnjëherë, ishte gjuha e një djaloshi të diasporës shqiptare të Ibrik Tepes së largët nga Shqipëria, ndërsa gjuha angleze si gjuhë jo amtare, por e përvetësuar shumë mirë, nuk e tradhtoi Nolin. Përkthimi i "Otellos" doli i suksesshëm. Këtë sukses mund të arrijë vetëm një intelektual si Noli. Ai, Shekspirin nisi ta lexojë në moshë shumë të re, kur ishte vetëm 15 vjeç, duke e njohur atë dhe veprën e tij, edhe në cilësinë e suflerit në një teatër grek të Athinës. Takimin e këtillë me Shekspirin, ai e ka konsideruar si një nga ngjarjet më të rëndësishme të jetës së tij. Nga ky moment, Shekspiri u bë pika kryesore e referimit për gjithë jetën e tij, për të kuptuar jo vetëm artin por edhe historinë e njerëzimit. Kështu Shekspiri hyri i pari nga shkrimtarët e mëdhenj botërorë, në gjirin e kulturës e të botës shqiptare. Noli, përveç që ia ofroi lexuesit shqiptar tragjeditë e Shekspirit, ai me kritikat apo introduktat, siç i quan, i ndihmoi për ta kuptuar më mirë porosinë e veprës, ndërsa kritikës letrare shqiptare ia çeli rrugën e mbarë, për të vazhduar më vonë edhe të tjerët. Introduktat e Nolit që i paraprinë çdo vepre të përkthyer ose më mirë të themi të shqipëruar, e bënin analizën e përgjithshme të veprës duke zbërthyer problemet historike, filozofike, sociale, politike etj. Fjalët hyrëse për çdo vepër të përkthyer, janë studime të shkurtra, por shumë të ngjeshura, nëpërmjet të cilave në mënyrë të gjithanshme, nëpërmjet gjuhës shqipe që e përdorte aq bukur dhe me përgjegjësi, i zbuloi dhe i dënoi veset e një kategorie shoqërore, siç ishin: lakmitë e shfrenuara, të pjesës hipokrite, dinakërinë, karrierizmin dhe vëllavrasjen me pabesi dhe misterioze. [617]

Vepra e parë e përkthyer ishte "Otello", që u botua në SHBA me 1916, ndërsa tri veprat e tjera që i përmendëm u botuan në Bruksel më 1926. Nëpërmjet këtyre

[617] Idriz Ajeti, Fan Noli në 100- vjetorin e lindjes, Prishtinë 1984, f 15

vlerësimeve, që Noli nga modestia i quan shpjegime elementare, kishte për qëllim të zgjonte kureshtjen e lexuesit, ta shikonte, ta shijonte, e ta gjykonte vetë dramaturgjinë shekspiriane.

Vlerat epokale të përkthimeve të veprave të Shekspirit dhe të tjerëve në një gjuhë që në atë kohë nuk kishte ndonjë përvojë të madhe në traditën e letërsisë së shkruar, ishin rezultat i një pune serioze dhe me përgjegjësi të një intelektuali që habiti jo vetëm gjuhëtarët tanë, por edhe personalitete të kulturës botërore. Në vargun e shumë përkthimeve, që po ashtu qëndrojnë në kulmet e vlerave të përkthimologjisë në gjuhën shqipe, shqipërimet e tragjedive të Shekspirit, edhe sot llogariten më të mirat nga të gjitha përkthimet që janë bërë nga shumë gjuhë të botës. I tërë ky gjenialitet qëndron para se gjithash, në respektin intelektual që kishte ndaj gjuhës së tjetrit, vlerave letrare që dëshironte t'i sillte të palënduara ne gjuhën tonë, dhe në njohjen e mrekullueshme të kësaj gjuhe në tërë shtrirjen e saj. Ky mister i Nolit qëndron edhe në aftësinë e tij për aktivizimin e fjalëve të reja që ndoshta nuk ishin dëgjuar e as lexuar deri atëherë. Fjalët e këtyre nuancave kuptimore, thotë Adriatik Kalulli, ndërtohen pa e çnatyruar shqipen. E tërë kjo punë, për të sjellë në gjuhën shqipe vlerat e kryeveprave të letërsisë botërore, u bë me kujdesin më të madh, duke e peshuar çdo fjalë, duke pasur kujdes në qartësinë e saj, në ngarkesën ideore dhe bukurinë e stilit. I tëre ky kujdes dhe kjo sakrificë e tij, që është rezultat i një intelektuali që respekton vlerat e veprave më të spikatura botërore, dhe prezantimin e tyre para lexuesit shqiptar, shihet edhe te porosia e tij që i bën përkthyesit Altri Kristo: Mos përkthe më shumë se katër vargje në ditë, silli ndërmend gjatë gjithë ditës, edhe kur të ecësh rrugëve. Veçse kujdes të mos të shkelin makinat, se unë desh e kam pësuar dy –tri herë. [618] Gjatë një takimi në Amerikë, kur ky përkthyes ia ofron Nolit përkthimin e dy vargjeve të "Romeo e Xhulietës", Noli i drejtohet: Merri me vete këto dy vargje dhe mendohu gjithë ditën, ngado që të vesh, në hotel, në tren, në rrugë, në shtrat…

Fjalën e fuqishme artistike të Shekspirit, si mjet themelor për ndërtimin e veprës së tij të madhe, Noli e modifikoi duke i dhënë ngjyrim, kuptim dhe muzikalitet shqip, pa rrezikuar se mund ta deformojë idenë e Shekspirit, pa rrezikuar se mund t'i japë kahe tjetër. Përkundrazi, Noli ishte shumë i sigurt se largimi nga një përkthim besnik e fjalë për fjale që mund të kishte ndonjë peshë gjuhësore, do ta varfëronte veprën e Shekspirit në gjuhën shqipe. Me veprimin e tij, drejt shqipërimit e jo përkthimit, e afronte lexuesin shqiptar kah thelbi i veprës shekspiriane dhe kështu ajo vepër e ruan madhështinë artistike pa e lënduar fare idenë poetike dhe mesazhet e saj. Trajtën e fjalës së huaj, në këtë rast të gjuhës angleze, e përpunon deri në masë, kur bindet se ka fituar një trajtë të kapshme në gjuhën e vet, por nga e njëjta materie.

Që është kështu e tregojnë vetë vargjet e përkthyera të veprave të Shekspirit. Për këtë rast po marrim vetëm një shembull nga katër vargjet e përkthyera të "Hamletit". përkthimi jopoetik, i të cilave fjalë për fjale duhet të ishte kështu: *dysho se yjet janë zjarr/ dysho se dielli lëviz/ se e vërteta është gënjeshtër/ por mos dysho se dashuroj*. Në përkthimin me ngjyrim poetik e të mrekullueshëm të Nolit i cili me mjeshtërinë e vet dhe me sensin e një poeti të madh, këto vargje nuk i përkthen, por i shqipëron, na i

[618] Adriatik Kalulli, Pema e jetës, Tiranë 2002, f 178

sjell kështu: *thuaj yjtë s'janë zjarr, / thuaj dielli u shua, / thuaj jeta është varr, / po mos thuaj që s'të dua.*

Ftesa që iu bë Fan Nolit më 1964 nga Komiteti festiv anglez, me rastin e 400-vjetorit të lindjes se Shekspirit, për të dëshmuar punën e tij për përkthimin, botimin, e studimin e veprave të shkrimtarit anglez, këtë e dëshmon me mirënjohjen e madhe dhe respektin për kontributin e tij në këtë fushë studimesh. [619]

Për kulturën shqiptare, studimet që ua bëri veprave të përkthyera e kanë edhe peshën tjetër. Nëpërmjet këtyre bëhet një paralelizëm i shoqërisë shqiptare të kohës së Nolit, me tërë ngjarjet historike politike e shoqërore. Artikullin e shkruar me 1964, me titull "Shekspiri dhe unë", Noli e mbyll me këto fjalë: Pavarësisht se sa bëjmë për Shekspirin, ne kurrë nuk arrijmë të bëjmë mjaft për të, ky është më i madhi i gjithë poetëve.

Përveç vlerave të tjera të veprës së përgjithshme të Nolit, që janë të një spektrit të gjerë, me punën që bëri në fushën e përkthimit, fitoi famë edhe më të madhe duke e afirmuar veten dhe kulturën shqiptare. Profesor Jup Kastrati, kur flet për kontributin e Fan Nolit në fushën e përkthimit, përmend edhe personalitete të njohura të albanologjisë me vlerësimet që i bëjnë ato Nolit si përkthyes dhe si kritik letrar. Kam pas lexuar, thotë ai diku, se njëherë, duke biseduar në katedrën e Universitetit të Vjenës, i vlefshmi albanolog Norbert Jokli, profesor i filologjisë shqipe pat thënë: Sikur të kishte lindur Noli në një ndër shtetet e mëdha të Evropës, do ta kishin bërë të njohur vetëm përkthimet e kryeveprave te Shekspirit, e posaçërisht introduktat e tij të famshme. [620]

Noli shumë vonë, pas 38 vitesh deshi t'i përkthejë edhe veprat e tjera të Shekspirit. Ai i kishte vlerësuar se përkthimi i vetëm katër veprave të tij, ishte pak. Unë mund të bëja këtë, shkruante Noli, jam ende i ri, jam vetëm 82 vjeç. Mosha e bëri të veten dhe ai nuk mundi ta kryejë këtë premtim që ia dha vetes. Noli, ndërkohë përshëndeti përkthyesit e rinj shqiptarë që e vazhduan punën në përkthimin e Shekspirit, e ndër to edhe mikun e tij të vjetër Skënder P. Luarasin.

Më vonë, me veprën e Shekspirit u morën një varg studiuesish shqiptarë, por përkthimet që jo rastësisht u quajtën shqipërime dhe introduktat e tij, vetëm Nolin e bënë mikun më të madh të Shekspirit.

[619] Alfred Uçi, Shekspiri në botën shqiptare, Shkup 1999, f. 13
[620] Jup Kastrati, Fan Noli ndër bashkëkohanikët, Prishtinë 1968, f 206

VJOLLCA RRAPAI
MIRELA SARAÇI

NJË DOKUMENT I RI ORATORIK I FAN S. NOLIT (DEKLARATA NË LIDHJEN E KOMBEVE, 2 TETOR, GJENEVË, 1921)

Fan S. Noli ishte një ndër personalitetet më të spikatura të botës shqiptare të shekullit të kaluar. Kontributet intelektuale të tij dëshmohen në disa fusha të mendimit dhe veprimtarisë kulturore, letrare dhe politike të kohës. Mes të tjerash Noli ishte mjeshtër i fjalimeve dhe komunikimeve publike, ishte një orator i spikatur me vlera të shumëfishta, diplomat i përkryer, ekspert në politikën ndërkombëtare, debatues i zoti dhe njohës i disa gjuhëve të huaja si: greqisht, latinisht, frëngjisht, anglisht, turqisht etj. Noli gjatë jetesës së tij në mërgim për më shumë se një dekadë kishte arritur të realizonte vepra të mëdha si: themelimi i Kishës Kombëtare Ortodokse, organizimin e federatës "Vatra", botimin e gazetës "Dielli" etj. Ajo kishte qenë një periudhë e rëndësishme e jetës së tij, me arritje historike dhe dështime të pashmangshme, por me një bilanc shumë të çmuar që e bëri atë të kthehej krenar në atdhe. Mbas disa pengesave që kishte hasur për të hyrë në Shqipëri, nga fillimi i nëntorit të vitit 1920 gjatë qëndresës së tij në Romë, Noli merr një letër nga Isuf Vrioni, Kryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme, nëpërmjet së cilës i njofton vendimin e qeverisë shqiptare për emërimin e tij si Kryetar i Delegacionit Shqiptar në Lidhjen e Kombeve. Zgjedhja e Nolit në krye të delegacionit shqiptar ishte padyshim një zgjedhje e merituar dhe e gjetur, duke qenë se Noli që nga viti 1913 kishte punuar për ngritjen e shtetit shqiptar mbi bazën e një sistemi demokratik, me koncepte moderne dhe frymë europiane sipas filozofisë së tij politike dhe përvojës që kishte fituar në botën perëndimore. Noli ishte orator i mirë jo vetëm në gjuhën shqipe, por ai ishte orator i shkëlqyer edhe në gjuhët e huaja, dhe siç pohon ai vetë, një nga arsyet pse u zgjodh kryetar i delegacionit shqiptar në Lidhjen e Kombeve, ishte sepse ai fliste rrjedhshëm anglishten dhe frëngjishten, gjuhët zyrtare të kohës.

Shqipëria u pranua në Lidhjen e Kombeve më 17 dhjetor1920, pas shumë takimeve dhe insistimeve të Nolit me delegatët e mbarë botës në Gjenevë. Noli ishte protagonisti i kësaj ngjarjeje historike dhe fitorja që arriti e bëri edhe më të njohur dhe më të vlerësuar në sytë e diplomatëve dhe qarqet gazetareske botërore, qarqe, të cilat do të flisnin gjatë për triumfin e tij. Një dëshmi mjaft interesante shkëputur nga shtypi botëror për oratorinë e Nolit në Gjenevë e sjell Prof. Dr. Nasho Jorgaqi, kur kujton portretizimin e figurës së Nolit, në gazetën angleze "The Manchester Guardian": "Fan Noli është një njeri, i cili do të shquhej në çdo vend. Një diplomat i përkryer, ekspert në politikën ndërkombëtare, debatues i zoti, që nga ditët e para ai la përshtypje të thella në Gjenevë. Ai mposhti kundërshtarët e tij ballkanikë në mënyrë të

mrekullueshme, kurdoherë me buzën në gaz. Është një burrë me kulturë të gjerë, që ka lexuar gjithçka që meriton të lexohet në frëngjisht dhe anglisht"[621].

Kontributi i Nolit për çështjen shqiptare nuk përfundonte këtu, detyra të tjera e të vështira e prisnin diplomatin shqiptar në misionin fisnik që kishte ndërmarrë. Një ndër to ishte edhe çështja e njohjes dhe e ruajtjes së integrimit territorial të shtetit shqiptar në Lidhjen e Kombeve. Mbas kësaj arritjeje, kthimi i tij në atdhe u prit me mjaft entuziazëm. Zgjedhja e Nolit si përfaqësues i federatës "Vatra", në Parlamentin e parë shqiptar e vuri atë në krye të jetës politike në vend. Pjesëmarrjen në jetën parlamentare dhe detyrën si anëtar të Komisionit të drejtësisë, Noli do ta realizonte në mënyrë të pjesshme. Pjesën tjetër të kohës ai gjendej me misione diplomatike në Lidhjen e Kombeve, në Gjenevë. Gjatë qëndrimit të tij në Gjenevë, Noli do të bëhet pjesëmarrës aktiv në Komisionin e Minoriteteve, duke debatuar ashpër me përfaqësuesit e shteteve fqinje mbi gjendjen e minoriteteve në Shqipëri.

Në këtë kontekst, objekti i kumtesës sonë do të jetë deklarata e tij për "Mbrojtjen e Minoriteteve", si kryetar i delegacionit shqiptar në Lidhjen e Kombeve, mbajtur në Gjenevë, më 2 tetor 1921. Kjo deklaratë ishte e një rëndësie të veçantë politike për kohën, sepse nga ajo vareshin marrëdhëniet e shtetit të brishtë shqiptar me unionin e kombeve të botës. Theksojmë se garancia për mbrojtjen e minoriteteve ishte kusht themelor për pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve. Deklarata titullohet "Mbrojtja e minoriteteve në Shqipëni" dhe përbëhet nga shtatë stipullata (nene), të cilat i kushtohen mbrojtjes dhe njohjes së të drejtave të të gjithë nënshtetasve shqiptarë, pa dallim gjuhe, race dhe feje. Noli, deklaratën e datës 2 tetor 1921, në Gjenevë e ligjëroi në frëngjisht dhe përfaqësoi denjësisht Shqipërinë në Lidhjen e Kombeve, me diturinë, elokuencën dhe mjeshtërinë e tij oratorike, letrare e gjuhësore. Dokumenti që ne disponojmë është kopje e materialit origjinal, realizuar në Gjenevë, më 5 tetor 1921. Materiali është përkthyer nga kopja e deklaratës origjinale, nga përkthyesi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, më 1921, *Visko Babatasi*. Ky dokument është pronë e *Arkivës së Përgjithshme të Shtetit Shqiptar*.

Në artikullin e parë të kësaj deklarate, Noli bën të ditur rolin dhe vlefshmërinë që do të luajë *Çpallja*, e paraqitur në Lidhjen e Kombeve, nenet e së cilës do të jenë të njohura në Shqipëri si ligje themelore dhe asnjë ligj apo veprim tjetër zyrtar nuk do të mund të kundërshtojë vlefshmërinë e tyre, as në atë kohë e as në të ardhmen. Noli, si diplomat i zoti që ishte diti t'i bëjë për vete përfaqësuesit e vendeve perëndimore, me njohuritë e gjera që posedonte dhe me diskursin e tij brilant. Ai e nis në këtë mënyrë Deklaratën për Mbrojtjen e Minoriteteve: *Stipullatat këtu-brënda në këtë çpallje do të jenë të njohura në Shqipëri si ligja themelore. Asnjë ligje, asnjë regull as edhe një veprim zyrtar nuk do të jenë në kundërshtim apo në bisedim fjalësh mbi këto stipullata dhe asnjë ligje, asnjë regull' as edhe një veprim zyrtar nuk do ta kenë vleftë kundër*

621. Nasho Jorgaqi "Jeta e Fan S. Noli", Vëllimi i parë. Seria e Botimeve, Letërsi Dokumentare. Shtëpia Botuese "OMBRA GVG", Tiranë, 2005. fq 394-395.

këtyre, as nashta as në kohën e ardhur[622]. Noli gjatë hartimit dhe ekzekutimit të deklaratës për mbrojtjen e minoriteteve ishte përgatitur në mënyrë të jashtëzakonshme për t'u bërë ballë vështirësive që mund të haste nga fqinjët tanë lidhur me pretendimet e tyre, se Shqipëria si një vend me shumicën e popullsisë myslymane mund të krijonte probleme në Ballkan. Noli, diti të mbrohej me argumente politike, historike dhe juridike, kundrejt pretendimeve të palëve kundërshtuese.

Në artikullin e dytë, Noli shprehet qartë se ligjet e deklaratës mbrojnë në mënyrë të barabartë të gjithë shtetasit dhe nënshtetasit që banojnë në territorin shqiptar, pa dallim kombësie, race apo feje. Noli, vazhdon më tej argumentimin e tij, se çdo banor i Shqipërisë do të jetë i lirë të praktikojë besimin apo fenë që ai dëshiron. Një pikë mjaft interesante në këtë nen është edhe e drejta që u jepet shtetasve dhe nënshtetasve shqiptarë që duan të ndryshojnë fenë së cilës i përkasin.

Stipullata e tretë e deklaratës trajton me hollësi çështjet e shtetësisë dhe nënshtetësisë, qoftë për personat e lindur në Shqipëri, qoftë edhe ata që janë vendosur aty para Luftës së Parë Botërore, këtyre të fundit, Noli u lë të drejtën e zgjedhjes me vullnet të lirë për personat mbi 18 vjeç, nëse duan të bëhen nënshtetas shqiptar. Noli, në këtë nen paraqet në mënyrë të detajuar të gjitha procedurat dhe marrëveshjet e shtetit shqiptar me Fuqitë Aleate dhe me shtetet fqinjë.

Artikulli katërt i deklaratës së Nolit thekson se para ligjit të gjithë nënshtetasit shqiptarë do të jenë të barabartë dhe do të gëzojnë po ato të drejta qytetare dhe politike pa dallim race, feje dhe gjuhe. Kjo e drejtë do të praktikohet në mënyrë absolute në Shqipëri, qoftë edhe në rastet kur individët ndryshojnë fenë e tyre. Në fund të artikullit të katërt, Noli i dedikon një paragraf të veçantë çështjes së përdorimit të gjuhës amtare, ai thekson se, nëse është e nevojshme për nënshtetasit shqiptar kur ata janë në një proces gjyqësor, ata gëzojnë të drejtën për të ligjëruar në gjuhën amtare. *Përveç themelimit prej Qeverisë Shqipëtare për një gjuhë zyrtare' lehtësira të veçanta do të jepen ndënshtetasve shqiptarë të një gjuhe tjetër, se asaj zyrtare, për përdorjen e gjuhës tyre, qoftë në të folur, qoftë në të shkruar, përpara gjykatorve*[623].

Në mënyrë të qartë, qëllimi themelor i Deklaratës së Nolit shprehet në stipullatën numër pesë. Në sinkroni të plotë me artikulimin e deklaratës, Noli përzgjedh me kujdes dhe kulturë fjalët, shprehjet dhe nocionet juridike të kësaj shpalljeje të një rëndësie të jashtëzakonshme për shtetin shqiptar. *Ndënshtetasit shqiptarë që përkasin në minoritetet me racë, me fe apo me ato gjuhë, do të gëzojnë po atë trajtim apo me ato sigurime në të drejtë dhe në fakt me të tjerët ndënshtetas shqipëtarë. Dhe më shumë, do të kenë një të drejtë të njëshme për të përmbajtur, drejtuar dhe kontrolluar me shpenzimet e tyre apo të krijojnë në kohën e ardhur përdillmorë (charitables) fejore apo shoqënore, si shkolla dhe të tjera themelime stërvitjeje, me të drejtë të plotë të përdorin liruar gjuhën e tyre dhe të praktikojnë liruar fen' e tyre...* [624]. Tek ky nen

[622]. Artikulli I, i Deklaratës "Mbrojtje e Minoriteteve në Shqipëni", Shtyp. Mbrothësija "Kristo Luarasi", Tiranë, 1922. fq. 3

[623]. Artikulli IV, i Deklaratës "Mbrojtje e Minoriteteve në Shqipëni". fq. 5.

[624]. Artikulli V, i Deklaratës "Mbrojtje e Minoriteteve në Shqipëni", Shtyp. Mbrothësija "Kristo Luarasi", Tiranë, 1922.

reflektohet politika e re, fryma perëndimore, demokratike dhe liberale që përfaqësonte mendësinë e Nolit, udhëheqës i sprovuar dhe me merita të veçanta. Në mënyrë specifike, ai vë në dukje mirëtrajtimin e minoriteteve në Shqipëri, harmoninë fetare që ekzistonte dhe të drejtat që minoritetet gëzojnë në territorin shqiptar. Ky nen paraqet ide të reja emancipuese dhe tolerancën e madhe që ka ekzistuar mes shqiptarëve, duke sjell një shembull unik në Lidhjen e Kombeve nga një vend i vogël, siç ishte Shqipëria.

Artikulli gjashtë i deklaratës për mbrojtjen e minoriteteve i kushtohet arsimimit të shtetasve dhe nënshtetasve shqiptarë, artikulli në mënyrë specifike ndalet tek grupet e vogla apo dhe tek grupet më të mëdha të minoriteteve që gjenden në Shqipëri; *Në pikëpamjen e arsimit popullor, qeveria shqiptare do të jap, - në qytetet dhe krahinat ku ri një sasi mjaft e madhe ndënshtetash shqipëtarë të një gjuhe tjetër se atë zyrtare – lehtësira të veçanta për të siguruar që arsimi në shkollat fillore do të jepet, në gjuhën e tyre, fëmijëve këtyre ndështetasve shqiptarë.* Noli vazhdon më tej stipullatën duke folur për lehtësirat që duhet t'u krijojë shteti shqiptar këtyre nënshtetasve, për të bërë të mundur arsimimin apo predikimet fetare në gjuhët amtare. Formimi dhe filozofia e tij politike dhe fetare e bënin atë një diplomat të suksesshëm dhe të ndryshëm nga të tjerët.

Në artikullin e fundit të deklaratës Noli bën një përmbledhje të stipullatave të tjera, duke theksuar rëndësinë e *Çpalljes* së bërë prej tij. shpallje, e cila ka të bëj me minoritetet në Shqipëri, pa dallim race, feje apo gjuhe. Noli, thekson se këto nene përbëjnë interes për ndërkombëtarët dhe për këtë arsye, ato, do të vihen nën sigurinë e Shoqërisë së Kombeve. Pikat e kësaj deklarate do të mund të ndryshohen vetëm me vendimin e shumicës së Këshillit të Shoqërisë së Kombeve. Në këtë mënyrë përfundon Deklarata për Mbrojtjen e Minoriteteve në Shqipëri, mbajtur më 2 tetor 1921, në Gjenevë.

Për suksesin e Nolit dhe të Shqipërisë që ai përfaqësonte në Lidhjen e Kombeve do të shkruanin gazetat më të njohura të Evropës dhe të botës si: "La Suiss", "Manchester Guardian", "Daily News", "New York Times", "Jurnal de Geneve" etj, duke vënë në dukje vlerat e mëdha të diplomatit shqiptar, njohuritë e gjera historike, juridike, gjuhësore dhe sidomos elokuencën e tij oratorike. Deklaratën për "Mbrojtjen e Minoriteteve", Noli e ligjëroi në mënyrë të jashtëzakonshme me pathos atdhetar të shprehur bukur me një frëngjishte të pasur dhe me stil të rrjedhshëm.

Këtë deklaratë Noli e paraqiti për mbrojtje në një seancë të Parlamentit shqiptar nga pozitat e ministrit të Punëve të Jashtme, edhe pse kjo deklaratë ishte miratuar në tetor në Lidhjen e Kombeve në Parlamentin shqiptar u kundërshtua nga disa deputetë. Por, Noli me aftësitë e tij argumentuese dhe bindëse bëri që deklarata të pranohej, duke qenë se ajo ishte edhe një nga kushtet themelore të pranimit të Shqipërisë në organizatën botërore të Lidhjes së Kombeve. Fan S. Noli ishte intelektual i vërtetë, i arsimuar në një nga universitetet më të mira të botës, në atë të Havardit, ai kishte njohuri të gjera në shumë fusha, ishte erudit, poliglot, historian, politikan dhe të gjitha këto njohuri e bënin atë një orator me aftësi të shkëlqyera.

Përfundim:

Fan S. Noli është një nga personalitetet më të njohura shqiptare të shekullit XX. Noli ishte intelektual me përmasa të gjera kulturore e me cilësi të larta në fushën e dijes. Ai ishte orator i zoti, diplomat i përkryer, ekspert në politikën ndërkombëtare, debatues i denjë dhe njohës i disa gjuhëve të huaja. Noli, veç të tjerash, do të kujtohet për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve. Shqipëria u pranua në Lidhjen e Kombeve më 17 dhjetor1920, pas shumë takimeve dhe insistimeve të Nolit me delegatët e mbarë botës në Gjenevë. Noli ishte protagonisti i kësaj ngjarjeje historike dhe fitorja që arriti e bëri edhe më të njohur dhe më të vlersuar në sytë e diplomatëve dhe qarqet gazetareske botërore, qarqe, të cilat do të flisnin gjatë për triumfin e tij. Objekti i kumtesës sonë ishte deklarata e tij për "Mbrojtjen e Minoriteteve", si kryetar i delegacionit shqiptar në Lidhjen e Kombeve, mbajtur në Gjenevë, më 2 tetor 1921, duke bërë një veshtrim filologjik mbi aspektet historike, kulturore, gjuhësore e oratorike të deklaratës. Deklarata përbëhet nga shtatë stipullata (nene), të cilat trajtojnë në mënyrë të detajuar mbrojtjen dhe njohjen e të drejtave të të gjithë nënshtetasve shqiptarë, pa dallim gjuhe, race dhe feje. Noli në mënyrë specifike vë në dukje mirëtrajtimin e minoriteteve në Shqipëri, harmoninë fetare që ekzistonte dhe të drejtat që minoritetet gëzojnë në territorin shqiptar. Noli, në Gjenevë ligjëroi në mënyrë të jashtëzakonshme, me pathos atdhetar të shprehur bukur, me një frëngjishte të pasur dhe me stil të rrjedhshëm, duke dëshmuar se ishte intelektual me kulturë të gjerë në shumë fusha.

SEKSIONI V: ÇËSHTJE TË HISTORISË DHE POLITIKËS NË VEPRËN E FAN NOLIT

ADELINA NEXHIPI

GJASHTË MUAJT E QEVERISJES SË NOLIT (ARRITJET DHE DËSHTIMET E NOLIT SI KRYEMINISTËR)

Fan Stilian Noli është padyshim një nga figurat më erudite në historinë e Shqipërisë. Ai u shqua në shumë fusha. Noli ishte shkrimtar, filozof, publicist, poliglot, përkthyes, orator, diplomat, politikan, historian, muzikant e teolog. Ai është themelues i Federatës Vatra, si dhe themelues i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare.

Në karrierën e tij si politikan disa nga momentet më të spikatura janë: kryesimi i delegacionit shqiptar në Lidhjen e Kombeve, që mundësoi antarësimin e Shqipërise më 17 dhjetor 1920, mbajtja e postit të ministrit të Jashtëm në qeverinë e Xhafer Ypit (14 dhjetor 1921-26 dhjetor 1922), si dhe postin e Kryeministrit të Shqipërisë (16 qershor 1924- 23 dhjetor 1924)

Kur Noli mori postin e Kryeminisrit, gjendja ekonomike dhe politike në Shqipëri ishte e vështirë. Në aspektin ekonomik, Shqipëria vuante nga një prapambetje e theksuar. As që bëhej fjalë për zhvillim industrial, dega kryesore e ekonomisë ishte bujqësia. Në fshat ekzistonte një e çarë e madhe mes fshatarësisë dhe klasës sunduese, bejlerëve. Pjesa më e madhe e tokës ishte në pronësi të një numri të vogël familjesh çifligare, që ushtronin dhunë ekonomike mbi fshatarësinë e varfër. Gati 85% e popullsisë jetonte në fshat, vetëm 9% e tokës ishte e punueshme, shtatë familje të mëdha çifligare (Vrioni, Vërlaci, Zogu, Toptani, Libohova, Vlora, Këlcyra) zotëronin 2000 ha tokë, kurse shumica e fshatarësisë kishin në zotërim më pak se 1, 8 ha tokë dhe shumë të tjerë nuk kishin fare. (Austin, 2003, p. 29)

Gjendjen politike Austin e përshkruan në këtë mënyrë: "*Kultura politike ishte e pazhvilluar dhe pak nga ato parti politike, personalitete dhe grupe që u shfaqën, në kërkesat e tyre nuk ishin në gjendje të dilnin jashtë kufijve të krahinës dhe përkatësive fetare. Nuk kishte një marrëveshje të përgjithshme se çfarë drejtimi do të merrte shteti: drejt Lindjes, duke ruajtur trashëgiminë 500 vjeçare të sundimit osman, drejt një qeverie parlamentare europiano-përendimore apo diku në mes tyre. Në thelb Shqipëria mbeti e paintegruar, e sunduar nga një klasë politikanësh që kishin interesa vetjake në ruajtjen e statukuosë shoqërore dhe ekonomike të krijuar nën Perandorinë Osmane. Mbi të gjitha, pjesa më e madhe e vegjëlisë nuk kishte interes për proçesin politik.* " (Austin, 2003, p. 22)

Në 16 qershor 1924 Noli krijoi qeverinë e tij, një kabinet i vogël, i përbërë nga përfaqësues të të gjithë grupimeve të kryengritjes së Qershorit, ushtrisë, bejlerëve, liberalëve, progresistëve dhe lobit shkodran. Ndërsa Komiteti i Kosovës nuk u përfshi në qeveri. Kabineti qeveritar përbëhej nga:

Fan Noli - Kryeministër

Sulejman Delvina- ministër i Jashtëm
Luigj Gurakuqi – ministër i Financave
Stavro Vinjau – ministër i Arsimit
Kasëm Qafëzezi – ministër i Luftës
Rexhep Shala - ministër i Brendshëm
Qazim Koculi – ministër i Bujqësisë
Xhemal Bushati – ministër pa portofol.

Anëtarët e kabinetit përfaqësonin interesa të kundërta, mes tyre mungonte kohezioni, e vetmja gjë që i kishte bashkuar ishte qëndrimi antizogist. Sipas Austin, Gurakuqi ishte i moderuar, Noli dhe Vinjau ishin më radikalët, Shala dhe Qafëzezi ishin thjesht karrieristë me bindje antiçifligare, por nuk ishin për ndryshimin e sistemit të vjetër. (Austin, 2003, p. 96). Fischer e quan qeverinë "*grupim laraman*" (Fischer, 2004, p. 78); Myfit Libohova, ish-ministër i Financave e konsideronte "*qeveri të paligjshme dhe terroriste*", (Austin, 2003, p. 188) ndërsa vetë Noli pak kohë pas largimit nga Shqipëria shkruan në gazetën " Dielli": "*Qeveria e Qershorit 1924 nuk qe ideale, vërtet. Mungesat e saj s'munt t'ia dijë askush më mirë se i nënëshkruari, që e ka parë maqinën e saj të punojë për së afërmi. Po, pasi t'i ngarkojmë mi kurris kritika mi kritika, duhet të nëmërojmë në favor të saj ca të mira për faqe të bardhë: 1) Njerëzit e saj qenë patriot të kulluar; 2) Qenë mprojtës të pasurive të shtetit; 3) Qenë të nderçim; 4) Qenë të qyteteruar; 5) Qenë liberal; 6) Qenë njerës të kanunit.* " (Noli, 2007, p. 251)

Në 19 qershor qeveria e Nolit shpalli programin e saj, një program reformash me 20 pika, të cilat ishin:

" 1) Çarmatimi i përgjithshëm dhe pa-përjashtim

2) Dënim i shkaktarëvet të kësaj vëllavrasje dhe i agjentvet të tyre kryesorë me ekspulsim dhe konfiskatë të pasurisë ose me ndëshkime të tjera si mbas masës së përgjegjesisë së secilit.

3) Ristabilizim i qetësisë, i rregullës dhe i mbretnimit të ligjit

4) Lartësim i autoritetit të Shtetit mbi ç'do fuqi personale ose ekstralegale.

5) Shrranjosje e feudalizmit, shlirim i popullit dhe vendosje definitive e demokratis në Shqipëri.

6) Reformë radikale e të gjitha degavet t' administratës civile e ushtarake.

7) Simpifikate e burokratis e paksim e pastrami nëpunësvet. N' emnimin e tyne do të merret para sysh, përveç zotsis e moralit, dhe patriotizmi i tyne.

8) Sigurim i të drejtavet si edhe caktimi përgjegjsis së nëpunësvet me nji ligjë.

9) Organizim i konunavet për të përmirësuem gjendjen e katundevet e të katundarvet, me kompetencë të gjënë mbi çashtje lokale.

10) Barasim i budxhetit me kursime radikale.

11) Ndrim i systemit të taksavet në mënyrë qi të lehtësohet populli.

12) Përmirësim i gjendjes së bujkut dhe emancipatë ekonomike e tij.

13) Lehtësim i hyrjes së kapitalit të huej e mprojtje dhe organizim i kapitalevet të vendit.

14) Lartësim i prestigjit dhe kreditit të Shtetit në botën e jashtme.

15) Indipendencë e vërtetë e gjyqëvet.

16) Reformë radikale e kanunevet gjyqsore të vjetrueme.

17) Ndreqje e udhavet dhe e uravet e kujdesim i veçantë për të gjitha komunikatat e Shtetit.

18) Organizim i Degës së Shëndetsis për të luftuem sëmundjet qi po shembin popullin.

19) Organizim i Degës s'arësimit mbi baza moderne, kombëtare dhe praktike në mënyrë qi prej Shkollavet t'ona të dalin qytetas të vlefshëm, patriot e punëtor të mirë.

20) Marrëdhanje miqsore me të gjithë Shtetet e veçanërisht me fqijt. " (Duka, 2007, p. 444) (programi është shkuar në bazë të dokumentit origjinal, pa ndryshuar as anën drejtshkrimore)

Studiues të shumtë kanë dhënë vlerësimet apo kritikat e tyre për këtë program:

Jacques e vlerëson "*tepër radikal*" (Jacques, 1995, p. 418); Austin e vlerëson *"një program vërtet ambicioz, …. Po të ishte vënë në zbatim, do të kishte çuar në një ndryshim revolucionar të vendit"* (Austin, 2003, pp. 99-100)*;* ndërsa Fischer shkruan: " *Me programin e Nolit do të krenohej çdo demokrat përendimor, e megjithatë Kryeministrit i mungonin dy elementë vendimtarë, pa të cilët askush nuk mund të kryente një varg kaq të gjatë reformash rrënjësore: përkrahja financiare dhe mbështetja e brendshme. "* (Fischer, 2004, p. 77) Profesore Valentina Duka shprehet: " *programi synonte krijimin e një shteti modern në stilin përendimor. Ky program dëshmonte liberalizmin, por njëkohësisht edhe naivitetin politik të tij* (Nolit)" (Duka, 2007, p. 149); Swire, shkruan në librin e tij: " *ishte një program i admirueshëm, i hartuar nga njerëz që synonin vërtet ta realizonin dhe që nxiteshin nga motivet më të larta"* (Swire, 2005, p. 344)*;* Harry Eyres (përfaqësuesi i Britanisë së Madhe në Shqipëri) e përshkruan si "*një program që nuk shkonte me realitetin shqiptar*" (Austin, 2003, p. 194); Grant Smith (përfaqësuesi amerikan në Shqipëri) e cilëson "*një hap i vërtetë në rrugën e progresit politik e shoqëror"* (Austin, 2003, p. 180)

Pra, Noli dhe qeveria e tij hartuan një program që është vlerësuar nga bashkëkohës dhe studiues. Por për kushtet e shoqërisë, ekonomisë dhe shtetit shqiptar ishte i parakohshëm dhe siç e tregoi koha i vështirë, për të mos thënë i pamundur për t'u realizuar. Ai ishte një sfidë përballë së cilës Noli dhe qeveria e tij dështuan. Nolit nuk i mungonte as dëshira dhe as vullneti për ta vënë në jetë programin e tij, por pati një sërë faktorësh që ndikuan negativisht, si: mungesa e fondeve, mosdhënia e nje kredie nga Lidhja e Kombeve apo shtetet e zhvilluara, përçarjet brenda vetë qeverisë, harxhimi i energjive dhe i një kohe të gjatë për problemet në politikën e jashtme.

Pavarësisht nga kjo, nuk mund të mohojmë arritjet që pati qeveria e Nolit. Në aspektin financiar qeveria arriti të balancojë buxhetin e shtetit. Qeveria e Qershorit trashëgoi nga qeveritë e mëparshme një defiçit prej 7 milion franga ari dhe rroga të papaguara prej shtatë muajsh. Për të zvogëluar borxhin, qeveria pakësoi 25% të nëpunësve dhe rrogat i zbriti në 40%. (Puto, 1990, pp. 271, 280). Në fushën e arsimit u bënë përpjekje për të zgjeruar rrjetin shkollor dhe për të ngritur nivelin e përgatitjes së arsimtarëve. Më 10 nëntor u themelua në Vlorë një shkollë tregtare. Në kuadër të luftës për çrrënjosjen e feudalizmit u morën disa masa me qëllim lehtësimin e

shfrytëzimit të fshatarësisë. U miratua dekretligji për shitjen e taksës të së dhjetës së prodhimeve bujqësore fshatit, jo myltezimëve.

Përsa i përket reformës agrare, qeveria përgatiti një projektligj "Mbi shpronësimin e pasurisë shtetërore", sipas të cilit bujqëve çifçinj do t'u ndaheshin pa pagesë vetëm tokat që ishin pronë e shtetit. (Çami, 2007, p. 343) Ndërsa në shtator, në gazetën "Bashkimi", ministri i Bujqësisë paraqet planin e qeverisë për reformën agrare që synonte shpronësimin e familjeve çifligare dhe shpërndarjen e tokës fshatarësisë. Reforma agrare nxori në pah mungesën e unitetit brenda qeverisë. Elementët e saj konservatorë ishin kundër konfiskimit të tokës dhe mbronin interesat e klasave të pasura. Edhe grupi liberal këmbëngulte në respektimin e pronës private. Swire shprehet se: "*kryeministri ishte një idealist që nuk gëzonte mbështetjen pa rezerva as të kabinetit, as të qeverisë së tij. "* (Swire, 2005, p. 345) Edhe Fuqitë e huaja e quajtën të paligjshme reformën agrare, sipas tyre Noli nuk mund të ndërmerrte një reformë agrare pa një ligj përkatës. Reforma agrare, pika kryesore e programit të qeverisë, mbeti në letër. Kjo bëri që Noli të humbte mbështetjen popullore. Vetë Noli shkruan: "*duke këmbëngulur për reformat agrare, unë ngjalla zemërimin e aristokracisë së tokës, duke mos arritur t'i realizoja ato, humba mbështetjen e masave fshatare. "* (Swire, 2005, p. 350)

Një vëmendje të madhe, Noli i kushtoi çështjes së mbrojtjes së kufijve dhe mbrojtjes së të drejtave të shqiptarëve jashtë kufijve të shtetit shqiptar. Në këtë drejtim ai tregoi aftësi të mëdha diplomatike dhe arriti suksese.

Që nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër, në 1913, kishin mbetur ende pa një vendim përfundimtar, ose pa u zbatuar vendimet e marra në lidhje me Vermoshin, Shën Naumin dhe 25 fshatrat në Korçë. Për këto të fundit ishte vendosur që 14 fshatra t'i mbeteshin Shqipërisë, kurse 11 t'i kalonin Greqisë, por Greqia nuk pranonte t'i dorëzonte. Noli dhe qeveria e tij i kushtoi rëndësi të madhe këtyre çështjeve në takimet në Lidhjen e Kombeve, gjatë vizitës dymujore në Gjenevë, në muajt shtator-tetor 1924.

Në fjalimin e tij në Këshillin e Lidhjes së Kombeve, Noli përmendi padrejtësitë që i ishin bërë popullit shqiptar, territoret dhe popullsinë që kishin mbetur jashtë shtetit shqiptar, tensionet që krijonte çështja e kufijve në marrëdhëniet me shtetet fqinje, zvarritjen e këtij procesi dhe koston financiare, që i sillte arkës së boshatisur të shtetit shqiptar pagesa për komisionin ndërkombëtar të kufijve, si dhe për avokatin Zhilber Zhides, që përfaqësonte shtetin shqiptar në Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës, për çështjen e Shën Naumit. Ishte përllogaritur se vetëm pagesa për komisionin ndërkombëtar të kufijve i kishte kushtuar Shqipërisë një milion franga ari. (Çami, 2007, p. 120)

Përpjekjet e Nolit dhanë frytet e tyre. Këshilli i Lidhjes së Kombeve e ftoi qeverinë greke të zbatonte vendimin e marrë dhe t'i dorëzonte Shqipërisë 14 fshatrat e ish kazasë së Korçës. Dorëzimi u bë më 30 tetor 1924.

Ankesa e qeverisë shqiptare lidhur me Vermoshin u shqyrtua në Këshillin e Lidhjes me 3 tetor 1924. Këshilli miratoi një rezolutë, ku i kërkonte Konferencës së Ambasadorëve *" të merrnin në shqyrtim çështjen dhe të shpejtonin caktimin përfundimtar të kufirit midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë. "* (Çami, 2007, p. 130)

Problemi i Vermoshit nuk gjeti zgjidhje sepse pësoi vonesa të tjera. E njëjta gjë ndodhi me Shën Naumin. Këshilli i Lidhjes bëri të vetin vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare, e cila linte në fuqi vendimin e Konferencës së Ambasadorëve të vitit 1922. Ky vendim ia caktonte Shqipërisë "*nga Lini në Shën Naum*". (Çami, 2007, p. 139) Pavarësisht nga ky vendim Jugosllavia nuk e dorëzoi Shën Naumin.

Në Lidhjen e Kombeve Noli i kushtoi vëmendje dhe çështjes së të drejtave të popullsisë shqiptare të Çamërisë. Popullsia myslimane çame po shpërngulej me dhunë drejt Turqisë duke shfrytëzuar Marrëveshjen e Lozanës, për shkëmbimin e popullsisë mes Turqisë dhe Greqisë. Greqia kishte deklaruar në Lozanë se popullsia shqiptare përjashtohej nga ky shkëmbim, por në realitet shqiptarët po shpërnguleshin në mënyrë masive.

Noli i kishte dërguar letra, për këtë problem, Lidhjes së kombeve, më 23 Korrik 1924 dhe 11 gusht 1924, por asgjë nuk kishte ndryshuar. (Çami, 2007, pp. 149,151) Gjatë kohës së qëndrimit në Gjenevë, Noli kërkoi krijimin e një komisioni të ri për shkëmbimin e popullsisë, por nga pala greke kjo u pa si një ndërhyrje në punët e brendshme. Lidhja e hodhi poshtë kërkesën e Shqipërisë. Më 30 Shtator 1924 vendimi i Këshillit "*ia rezervonte Këshillit të Lidhjes së Kombeve të drejtën e mbikqyrjes mbi zbatimin e Marrëveshjes së Lozanës në përputhje me Traktatin e Minoriteteve. …. qeveria shqiptare kishte të drejtën të sinjalizonte, por jo të dilte si palë në çfarëdo mosmarrëveshje lidhur me zbatimin e shkëmbimit të popullsisë greko-turke".* (Çami, 2007, p. 157) Për fat të keq ky formulim nuk jepte garanci për përmirësimin e gjendjes.

Në aspektin diplomatik Noli nuk pati vetëm suksese, por edhe dështime, siç ishte njohja ndërkombëtare e qeverisë së tij. Noli ishte i vetëdijshëm se mënyra se si erdhi në pushtet, (me kryengritje, jo me zgjedhje popullore) e bënte të domosdoshme njohjen ndërkombëtare.

Qeveria e Nolit shpresonte të fitonte mbështetjen dhe simpatinë e Britanisë së Madhe. Ministri shqiptar në Angli, Mehmet Konica, i dërgon ministrisë së Jashtme (Foreign Office) kërkesën për njohjen e qeverisë shqiptare të kryesuar nga Noli. Përgjigja angleze theksonte se *"Governa Britanike ka si princip të mos njohë menjëherë governat që vijnë në fuqi me violencë dhe fjalët tona nuk e ndryshojnë këtë princip.* " (Puto, 1990, p. 30) Veç kësaj një ndikim të madh në qëndrimin britanik luajtën dhe synimet e saj për konçensionet e vajgurit. Anglia e shikonte qeverinë e Nolit si pengesë për realizimin e këtij qëllimi. Sipas saj, Noli, si një ish- emigrant amerikan, do të preferonte SHBA-të, kurse Luigj Gurakuqi cilësohej italofil. Për më tepër kur Noli ishte në opozitë në Këshillin Kombëtar, në shtator 1923, kishte kundërshtuar dhënien me konçension të zonave naftëmbajëse shoqërisë angleze Anglo-Persian. Ardhja në pushtet e qeverisë laburiste e kryesuar nga Mc Donald, ngjalli shpresat e qeverisë shqiptare, se qëndrimi anglez do të ndryshonte. Në fakt asgjë nuk ndryshoi. Qëndrimi i Britanisë varej nga mendimi i përfaqësuesit të saj në Shqipëri, Harry Eyres. Eyres e shikonte Nolin si një figurë kalimtare, që do të prishte qetësinë në Ballkan. Ai kishte miqësi të ngushtë me Ahmet Zogun, të cilin e cilësonte të aftë të merrte edhe masa drastike për të vendosur rregullin dhe qetësinë.

Ndërsa qeveria amerikane fillimisht e përshëndeti fitoren e Nolit. Qëndrimi pro amerikan i Nolit u ngjalli shpresa SHBA-ve se do të realizonin interesat ekonomike amerikane në Shqipëri. Më pas e ndikuar dhe nga qëndrimi anglez qeveria amerikane refuzoi ta njohë qeverinë e Nolit. Qeveria amerikane u ndikua në qëndrimin e saj nga disa faktorë: - politika izolacioniste, që ajo ndoqi në periudhën mes dy luftërave botërore; - interesat ekonomike, (SHBA-të qenë protagonisti kyesor, përkrah Britanisë, në betejën për koncensionet e vajgurit); - legalizimi i ardhjes në pushtet të Nolit; - problemi i vrasjes së dy qytetarëve amerikanë, në prill 1924.

Përsa i përket Francës, ajo e shikonte të panevojshme çështjen e njohjes, pasi ajo i shihte ngjarjet e Qershorit një ndryshim të thjeshtë të qeverisë. Përfaqësuesi i Ministrisë së Jashtme franceze në një takim me Mehmet Konicën, shprehej: "*çështja e njohjes nuk është shtruar fare nga Franca, përderisa Qeveria e tanishme e kryesuar nga imzot Fan Noli e ka marrë pushtetin nga Këshilli i Regjencës dhe se pavarësisht nga kryengritja, ajo është formuar në mënyrë të rregullt. "* (Puto, 1990, p. 41) Veprimet e politikës franceze ishin kontradiktore. Nga njëra anë ajo shprehej se e njihte qeverinë e Nolit, ndërsa nga ana tjetër përfaqësuesi zyrtar i Francës, në Shqipëri, nuk pranonte të hynte në kurrëfarë marrëdhënie zyrtare me qeverinë e Nolit. (Puto, 1990, p. 42)

Italia i kishte parë me një farë shprese ndyshimet politike në Shqipëri. Ajo shpresonte se mund të përfitonte nga pozita e dobët e Nolit për të realizuar qëllimet e saj ekonomike dhe territoriale në Shqipëri. Qeveria italiane e Musolinit u tregua dashamirëse ndaj qeverisë shqiptare, por ajo ngurroi ta njihte atë. Shkak i ngurrimit të qeverisë italiane ishte se: "ajo nuk donte të vepronte vetëm, pa qeveritë aleate. " (Puto, 1990, p. 19) Veç kësaj Italia shpresonte të përdorte çështjen e njohjes si mjet për të ndikuar në sjelljen e Nolit. Edhe Noli i kuptonte qartë qëndrimet e Italisë për të fituar kontroll të madh mbi Shqipërinë, ndaj qëndroi i palëkundur në refuzimin e kërkesave italiane.

As shtetet fqinje, Greqi e Jugosllavi, nuk e njohën qeverinë e Nolit. Greqia dhe Jugosllavia, në atë kohë aleate me njëra- tjetrën, punuan së bashku për destabilizimin e qeverisë së Nolit. Noli bëri thirrje për marrëdhenie të mira me shtetet fqinje. Në gazetën serbe "Vreme", më 13 shtator 1924, Noli shprehet: "*Nga ana jonë, ne dëshirojmë marrëdhënie fqinjësie të mirë me shtetin jugosllav se kemi nevojë për qetësi që të mbledhim tërë vëmendjen tonë në organizimin e shtetit dhe zhvillimin e ekonomisë. Sa për mua, unë nuk shikoj ndonjë arsye, përse të dy shtetet tanë të mos rrojnë në miqësi. Si shtete fqinje, kemi interesa të përbashkëta. "* (Puto, 1990, p. 269)

Madje Noli shkoi më larg, ai hodhi idenë për një Konfederatë Ballkanike. Po në gazetën "Vreme", të datës 13 Shtator 1924 ai shprehet: "*Konfederata Ballkanike është një ideal për të cilin duhet të punojmë të gjithë. Me këtë do të mundnin tërë shtetet ballkanike të pakësonin ushtritë dhe të përdornin të hollat e kursyera për mirëqënien*. " (Puto, 1990, p. 270) Rëndësinë e kësaj Konfederate Noli e përsërit në gazetën greke "Politika", të datës 9 Shtator 1924: "*nuk kujtoni se duhet të shohim popujt jo si të vuajnë nga mosmarrëveshjet, por me vullnetet e tyre të ndritur, si drejtohen apo duhet të drejtohen nga një e ardhme më e bukur?* " (Puto, 1990, p. 275)

Në marrëdhëniet e tensionuara me Jugosllavine ndikuan: - prania e Zogut në Beograd;

-çështjet e pazgjidhura territoriale (çështja e Vermoshit dhe Shën Naumit); - trajtimi i problemit të të drejtave të popullsisë shqiptare të Kosovës në Lidhjen e Kombeve.

Në lidhje me Greqinë, Noli shpresonte se mund të vendoste marrëdhënie miqësore, meqënëse ai ishte ortodoks, por nga pala greke ai shihej si antigrek duke qenë se ishte themelues i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Marrëdhëniet mes dy vendeve u ndikuan nga çështja e kufirit dhe të drejtat e minoriteteve. Në lidhje me minoritetet Noli shprehet: "Minoritetet duhet të shërbejnë jo si një pengesë, por si një lidhje dhe urë marrëveshjeje midis nesh. " *(Puto, 1990, p. 274)* Qëllimet e Nolit për një politikë të mirë fqinjësie nuk u përkrahën nga Greqia dhe Jugosllavia.

Fuqitë e Mëdha mbajtën të njëjtin qëndrim edhe ndaj kërkesës së qeverisë shqiptare për mbështetje financiare, që do ta ndihmonte të ndërmerrte reforma në vend. Noli e dinte se s'mund t'i realizonte transformimet e premtuara pa një ndihmë financiare nga jashtë. Ai shpresonte në ndihmën amerikane, angleze ose të Lidhjes së Kombeve. Dhënia e një huaje nga Lidhja e Kombeve do të ishte më mirë, pasi do të evitonte vendosjen e ndikimit të një fuqie të huaj në Shqipëri. Në vizitën e tij në Gjenevë Noli këmbënguli për këtë. Gjuha e ashpër dhe ironike që përdori Noli në Asamblenë e Lidhjes forcoi, tek ata që e dëgjuan, mendimin se ai ishte një figurë e rrezikshme, i vendosur për të prishur paqen në Ballkan. Ky qëndrim i Nolit bëri që ai të kthehej duarbosh në Shqipëri. Gjatë vizitës së tij në Romë ai i kërkoi qeverisë italiane një hua prej 100 milion liretash. Por Musolini kërkoi kontrollin mbi shpenzimet ushtarake shqiptare. Noli nuk ishte i gatshëm të bënte lëshime që cënonin pavarësinë e Shqipërisë.

E gjendur para izolimit të plotë, qeveria e Nolit iu përgjigj pozitivisht kërkesës së Bashkimit Sovjetik për vendosje të marrëdhënieve diplomatike mes dy vendeve. Më 4 Korrik 1924, ministri i Jashtëm shqiptar i shkroi Komisarit sovjetik të Punëve të Jashtme se qeveria shqiptare ishte gati të vendoste marrëdhënie normale e miqësore ndërmjet dy popujve. Austin argumenton se Noli e ndërmori këtë veprim për të dalë nga izolimi ndërkombëtar, ose për të siguruar mbështetje financiare, ose ndoshta për të tërhequr vëmendjen e ndërkombëtarve *(Austin, 2003, pp. 213,214)* Afrimi i Nolit me Bashkimin Sovjetik u vlerësua si një veprim i nxituar e i pamenduar. Ai u kritikua nga përfaqësitë diplomatike evropiane, megjithëse disa shtete perëndimore, si Anglia, Austria, Norvegjia, Greqia e kishin njohur BRSS. Shtypi i kohës e akuzoi Nolin si bolshevik apo peshkop i kuq. Ky reagim e detyroi Nolin të rishikonte qëndrimin e tij. Ai largoi nga Shqipëria delegacionin rus të kryesuar nga Krakovjecki.

Një gabim i pafalshëm i Nolit ishte moslegalizimi i qeverisë së tij. Noli erdhi në pushtet me dhunë dhe nuk zhvilloi zgjedhje për të marrë mandatin popullor. Pasi mori postin e Kryeministrit, ai nuk thirri Parlamentin e dalë nga zgjedhjet e dhjetorit të vitit 1923. Ai pretendonte se e kishte marrë autorizimin për të krijuar qeverinë nga Këshilli i Regjencës, por në Shqipëri, pas ngjarjeve të Qershorit 1924, kishte mbetur vetëm një anëtar i Këshillit të Regjencës, Sotir Peçi. Sipas Statutit të Lushnjes kjo e bënte jofunksional Këshillin. Në programin e tij Noli parashikonte mbajtjen e zgjedhjeve pasi të ishte qetësuar situata në Shqipëri. Ai nuk arriti të vlerësojë rëndësinë që kishte

mbajtja sa më shpejt e zgjedhjeve në legjitimitetin dhe njohjen e qeverisë së tij. Noli shfaqej kontradiktor në veprimet e tij. Ai fliste për forcimin e demokracisë ndërkohë që qeverisi për gjashtë muaj pa Parlament. Ajo që e bëri më të pafalshëm gabimin e tij ishte fjalimi në Lidhjen e Kombeve ku e quajti Parlamentin "murtajë, fatkeqësi, bestytni të përbuzur…. një sallë ku politikanët e pashpirt mblidhen të bëjnë copë-copë racën e vet, një sallë e mbushur me gaz helmues, me gaz lotsjellës…" *(Swire, 2005, p. 346)* Më 13 nëntor, Këshilli i Regjencës (përfaqësuesi i vetëm i tij, që kishte mbetur në Shqipëri) firmosi dekretin për mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare të cilat do të zhvilloheshin nga 20 dhjetori 1924 deri më 20 janar 1925. Kur Noli vendosi të zhvillonte zgjedhjet, ishte tepër vonë. Sulmi i Ahmet Zogut e detyroi atë të shtynte datën e zgjedhjeve, të cilat nuk u zhvilluan asnjëherë.

Gabimeve të Nolit u shtohet dhe krijimi i Gjyqit Special për dënimin e elementeve prozogiste, të akuzuar për vëllavrasje. Swire e ka quajtur këtë "gafë të pafalshme". *(Swire, 2005, p. 345)* Gjykata politike dënoi ata që kishin kundërshtuar ushtarakisht Revolucionin e Qershorit. U dënuan rreth 107 njerëz, anëtarë të qeverisë së mëparshme, të Parlamentit madje dhe të Këshillit të Regjencës. Gjykata kishte të drejtën e dhënies edhe të dënimit me vdekje. Ajo konfiskoi pronat e të gjithë personave që kishin dalë para gjyqit. "Spastrimet në administratë, shfarosja e armiqve dhe mania e persekutimit, shprehet Austin, - modeluan variantin e tij (Nolit) të shtetit policor zogist…Si kreu i një qeverie që u zotua për demokratizimin dhe modernizimin e shoqërisë shqiptare, Nolit do t'i kishte shërbyer më mirë shpallja e amnistisë së përgjithshme. " *(Austin, 2003, pp. 107,109)*

Edhe koha që zgjodhi për udhëtimin në Gjenevë është vlerësuar si një veprim i pamenduar mirë nga Noli. Mungesa e tij në Shqipëri për një periudhë dymujore, i dha mundësi të nxirrnin kokë përçarjet në qeveri. Gjatë mungesës së tij qeveria u nda në katër fraksione: mbështetësit e shoqërisë "Bashkimi", grupimi Demokrat Nacional, grupimi Demokrat Radikal dhe grupi nolist. Kundërshtarët e Nolit brenda qeverisë tani ishin në gjendje t'i diktonin atij politikën e tyre. Kështu koalicioni i Nolit ishte çarë në mënyrë të pariparueshme, mes tyre mungonte toleranca që çoi në krijimin e një amullie të brendshme. Këtë situatë e shfrytëzoi Ahmet Zogu për të filluar sulmin kundër qeverisë së Nolit. Ky moment duhej shfrytëzuar edhe për të mos lejuar mbajtjen e zgjedhjeve që mund të legalizonin pushtetin e Nolit. Ahmet Zogu rekrutoi njerëz në Shqipëri dhe Jugosllavi, vuri në lëvizje krerë feudalë, siguroi ndihma në të holla, ndihmë ushtarake nga Jugosllavia dhe filloi sulmin kundër Tiranës përgjatë gjithë kufirit shqiptaro-jugosllav. Organet shtetërore të Tiranës nënvlerësuan forcën e kundërshtarit dhe u treguan të ngathta në marrjen e masave mbrojtëse. Noli u bëri thirrje Lidhjes së Kombeve dhe Fuqive të Mëdha të ndërhynin pranë qeverisë serbe, që t'i jepte fund agresionit mbi Shqipërinë, i cili kërcënonte paqen në Ballkan. Asnjë veprim nuk u ndërmor, Lidhja e Kombeve dhe shtetet e tjera mbajten "qëndrim prej soditësi" *(Çami, 2007, p. 365)* Noli i bëri thirrje popullit të luftonte për të mbrojtur idealet e larta të Revolucionit, por kjo nuk u shoqërua me asnjë masë mbrojtëse. Më 24 dhjetor 1924 Ahmet Zogu dhe forcat e tij hynë në Tiranë. Qeveria e Nolit u përmbys. Noli, ministrat dhe figurat kryesore antizogiste u arratisën jashtë vendit. U rikthye në pushtet qeveria e Iljaz Vrionit.

Noli, në gjashtë muajt e qeverisjes së tij pati suksese, dështime, gabime, në fund të fundit si të gjithë udhëheqësit e çdo kohe, e çdo vendi. Në një fjalim të tij në Federatën Vatra, në vitin 1963, Noli thotë: "Më pyesin: -Ç'bëmë? U them: - S'mund të presësh nga foshnja që t'i ketë të gjitha mirësitë. Duhet të presësh që foshnja të rritet, të tregojë ç'lule është. "

ALBA KREKA

FIGURA E NOLIT NË STUDIMET HISTORIKE KOMUNISTE DHE BASHKËKOHORE

Jeta e Fan Nolit karakterizohet nga një sërë veprimtarish në fushën fetare, politike dhe letrare. Personaliteti i tij u formua në ecurinë e ngjarjeve të rëndësishme, të cilat e përgatitën Nolin për veprat më madhore të tij, qoftë për punë krijuese letrare, qoftë për idealet e tij mbi lirinë dhe demokracinë. Duke lexuar Nolin të bie në sy fryma kritike e tij ndaj problemeve dhe fenomeneve të kohës. Gjatë gjithë veprimtarisë së tij Noli i kushtoi një rëndësi të veçantë emancipimit mendor të shqiptarëve, të cilët sapo kishin dalë nga periudha e errët e sundimit osman. Profesor Aleks Buda e quan Nolin si "*njeriun e alternativave, kontradiktave të brendshme, të hipjeve dhe zbritjeve në rrugën e jetës – të cilat pasqyrojnë kontradikta dhe tensione që janë të një epoke të tërë"*. [625]

Që në moshë të vogël Noli u rrit me dashurinë ndaj muzikës dhe traditës bizantine ortodokse e cila ndikoi drejt vokacionit fetar të tij, që është aq i diskutuar në studimet shqiptare dhe të huaja. Sipas historiografisë komuniste "*Noli u bë prift pa patur ndonjë thirrje të brendshme sepse ai ishte "skeptik" në qendrimin ndaj fesë, por u vetëflijua tragjikisht për "nevojat e politikës kombëtare"*. [626] Ndërsa Noli në "Autobiografinë" e tij deklaron se pati mundësinë që të pajtonte vokacionet e tij më të fuqishme, atë fetar dhe atdhetar, duke u vënë plotësisht në shërbim të tyre dhe pa sakrifikuar kurrfarë lirie të vetvetes. Çështja fetare ka qenë pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së Nolit. Në një artikull të tij në një gazetë gjermane (nuk dihet emri), por të ribotuar nga gazeta greke "Dhimokratia", ai shprehet se "*Shqipëria mund të zgjidhë çështjen fetare njëherë e përgjithmonë sepse ajo është si Amerika dhe Franca, pa fe zyrtare. Shteti dhe nënpunësit e tij nuk kanë të drejtë të përzihen në çështjet fetare sepse individi është zot i vetes dhe feja është çështje ndërgjegjeje. Kushtetuta jonë e siguron plotësisht lirinë fetare"*. [627] Sipas studimeve bashkëkohore, nuk ishte as një "thirrje" e brendshme dhe as nevoja për të siguruar jetesën që e çoi Nolin në këtë rrugë.

Nolin e shqetësonte prapambetja e thellë kulturore dhe ekonomike e Shqipërisë dhe ishte i bindur se përparimi dhe zhvillimi i vendit do të vinte nga përqafimi i kulturës, arsimit dhe lirisë së mendimit. Këto pikëpamje liberale dhe kultura e tij e gjerë e ndihmuan në rrugën drejt politikës dhe vendosjes së demokracisë.

---

[625] A. Buda. *Fan. Noli-individualiteti i alternativave*, në studime mbi Fan S. Nolin, Vepra VII, Shtëpia Botuese Dudaj, Tiranë, 2008, f. 15.

[626] http: //albanovaonline. unishk-history. com/ A. Cefa – *Vokacioni atdhetar dhe kontradiktat e Nolit.*

[627] A. Puto. *Demokracia e rrethuar*, Shtëpia Botuese "8 Nëntori", Tiranë, 1990, f. 289.

Delegati britanik në Lidhjen e Kombeve, lordi Cecil shpreh një konsideratë të thellë për Nolin, si një personalitet i staturës ndërkombëtare. Vlerësimi që i bëhet figurës së tij shprehet qartë edhe në një shkrim të gazetës angleze "Manchester Guardian" ku cilësohet si "*liberal që në krye e gjer në fund, aq liberal në teologji sa edhe në politikë dhe si liberal i vërtetë është krejt tolerant dhe asfare fanatik".* [628] Fan Noli, nën cilësinë e kryetarit të delegacionit shqiptar në Lidhjen e Kombeve në Gjenevë, bëri të mundur anëtarësimin e Shqipërisë në këtë organizatë (në 17 dhjetor 1920) duke e konsideruar këtë si arritjen e tij më të madhe politike, sepse i dha Shqipërisë njohjen ndërkombëtare. Në njëfarë mënyre kjo ngjarje e ndihmoi edhe më shumë për t'u futur në rrugën e politikës. Në dhjetor të vitit 1921 ai mbante postin e ministrit të Jashtëm në qeverinë e H. Prishtinës dhe në dhjetor të 1922 mbante të njëjtin post, por në qeverinë e Xhafer Ypit. Kjo periudhë karakterizohet nga mosmarrëveshjet e Nolit me Zogun, të cilat e kthyen atë në opozitë. Atëherë kur e ndjeu veten të fortë, menjëherë pas vrasjes dhe martirizimit të Avni Rustemit, Noli ndërmori masa të armatosura ndaj Zogut dhe përkrahësve të tij duke realizuar Revolucionin e parë demokratik shqiptar. Historiografia komuniste i mëshoi idesë se rrëzimi i qeverisë së mëparshme ishte rezultat i një lëvizjeje masive të fshatarëve dhe punëtorëve. Nën analizën e studimeve të mëvonshme doli se shumë pak njerëz ishin përgatitur të rrezikonin jetën për Zogun, i cili, për momentin nuk ishte një figurë popullore. "*Ishte ushtria e lodhur nga kaosi dhe rrogat e papaguara, që vendosi se kush duhej të drejtonte vendin" – shprehet V. Duka.* [629] Noli ishte i bindur se me qeverinë e tij demokratike do t'i dhuronte Shqipërisë një sistem demokratik që nuk e kishte patur kurrë më parë. Ai u përpoq të organizonte forcat për atë *"yrysh" të përgjithshëm kundër botës së feudalizmit, një "yrysh i cili me dritën e diturisë do ta nxirrte popullin nga shpella e errësirës".* [630] Pavarësisht ambicies dhe dëshirës së madhe, Noli solli një demokraci të brishtë, e cila nën idelogjinë komuniste u pa në kuadrin e një demokracie klasike borgjeze me një funksion të dyfishtë antifeudal dhe antimperialist. Dështimi i saj vërtetoi se programi ishte më shumë teorik sesa praktik për kushtet e Shqipërisë së asaj kohe. Përveç kësaj Noli nuk arriti të kënaqte askënd duke krijuar një situatë amullie të brendshme. Vështirësitë ishin po kaq të mëdha edhe në politikën e jashtme. Marrëdhëniet me vendet fqinje mbeteshin të tendosura, ndërsa Fuqitë e Mëdha vazhdonin të ndiqnin rrugën e mosnjohjes së qeverisë së Nolit. Noli u përpoq (që përpara se të bëhej Kryeministër) në vendosjen e marrëdhënive miqësore me disa shtete perëndimore. Në kohën kur ai kishte postin e minsitrit të Jashtëm, SHBA-ja vendosi marrëdhënie zyrtare me Shqipërinë në vitin 1922, vetëm falë këmbënguljes së Nolit, por nuk mbajti të njëjtin qendrim ndaj qeverisë demokratike të tij; kjo ndodhi sepse kishte dyshime për ligjshmërinë e saj. "*Qeveria amerikane nuk donte t'i lidhte interesat e saj në Shqipëri me një qeveri të izoluar në arenën ndërkombëtare. "*[631] Noli është gjykuar për ardhjen e tij në pushtet me rrugë revolucionare dhe kjo e ka penalizuar në sytë e

[628] A. Puto. *Vepër e përmendur,* f. 176.
[629] V. Duka. *Histori e Shqipërisë 1912 – 2000*, SHBLU, Tiranë, 2007, f. 147.
[630] A. Buda. *Vepër e përmendur,* f. 15.
[631] A. Puto. *Vepër e përmendur*, f. 40.

ndërkombëtarëve. Ndërsa në kuadrin e historiografisë komuniste fryma revolucionare që udhëhiqte Nolin u dëshmua vetëm me ardhjen e tij në pushtet, ndërsa në rastet e tjera ishte e pamjaftueshme. Mendësia e tij karakterizohej nga iluzione reformiste, madje pacifiste dhe "*përdorimi i dhunës nuk u kthye te Noli në një bindje të thellë të brendshme".* [632] Britania e Madhe, ashtu si dhe vendet e tjera perëndimore, mbajti një qendrim mohues ndaj qeverisë demokratike. Pavarësisht dëshirës së Nolit për të vendosur marrëdhënie diplomatike, ai mbeti i zhgënjyer nga qëndrimi i saj. Krahas nevojës se madhe për njohjen e qeverisë së tij, ai e simpatizonte Britaninë e Madhe më shumë se çdo vend tjetër të Europës. Ideologjia komuniste e interpretoi si jokorrekt këtë qendrim të Nolit. Simpatia e tij mund të ishte "*e vërtetë për letërsinë sepse lufta politike e Anglisë kundrejt qeverisë demokratike nuk i japin arsye të ushqejë një simpati të tillë".* [633]

I vetmi vend që i ofroi mbështetje dhe njohje qeverisë së Nolit ishte Rusia Sovjetike, prandaj dhe qendrimet e tij ndaj saj u përfolën dhe përbënin një çështje kontradiktore. Në periudhën e regjimit komunist ai u duartrokit për orientimin e tij drejt një vendi bolshevik, ndërsa në studimet e huaja dhe ato shqiptare të periudhës postkomuniste, orientimet e Nolit drejt Bashkimit Sovjetik u trajtuan deri diku si përcaktuese për njohjen e qeverisë demokratike në arenën ndërkombëtare. Rusia Sovjetike u përpoq disa herë të zyrtarizonte marrëdhëniet me Shqipërinë, por Noli ngurroi për faktin se Rusia njihej botërisht si një qendër bolshevike. Bashkëpunimi i KONARE-s, organizatë në të cilën kryetar ishte Fan Noli, me Internacionalen Komuniste, pas dështimit të Revolucionit Demokratik, është trajtuar gjerësisht në studimet e kohës dhe jo vetëm. Në fillimet e saj KONARE u "kritikua" nga studiuesit e regjimit, sepse në të bënin pjesë elemente heterogjene borgjeze të cilët ndikuan në idetë politike të saj. "*Më vonë kjo organizatë "reflektoi" qëllimin e saj të vërtetë".* [634] Gjatë studimit objektiv të fakteve dëshmohet se KONARE ndihmohej financiarisht nga Moska. Pjesë e KONARE-s fillimisht ishin elementet e djathta konservatore, të cilët më vonë u larguan nga kjo organizatë për frymën revolucionare në rritje. Pavarësisht se Federata Komuniste Ballkanike shpresonte për krijimin e Partisë Komuniste në Shqipëri, ajo ishte e pamundur. *"Noli edhe pse në programin e tij shprehte disa ide të majta, ato bolshevike nuk gjetën terren për t'u shtrirë në Shqipëri".* [635] Ai u orientua drejt Bashkimit Sovjetik, sepse në atë kohë ky vend shihej nga ai, si vendi i drejtësisë sociale. Noli veproi i shtyrë jo nga arsyeja shtetërore, por nga bindjet dhe vizioni i tij mbi shoqërinë njerëzore. Simpatia e tij kundrejt Bashkimit Sovjetik lidhet me një fakt shumë të rëndësishëm, pasi Rusia Sovjetike pati publikuar Traktatin e Fshehtë të Londrës për copëtimin e Shqipërisë.

---

[632] *Po aty,* f. 177.

[633] *Po aty,* f. 176.

[634] V. Koka. *Rrymat e mendimit politiko – shoqëror në Shqipëri në vitet 3 të shekullit XX,* Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë. Tiranë, 1985, f. 166.

[635] P. Milo. *Shqipëria dhe Jugosllavia 1918 – 1927*. Shtëpia Botuese "Enciklopedike", Tiranë, 1992, f. 260.

Revolucioni i Nolit ishte për marksistët shqiptarë njëlloj si Revolucioni i shkurtit 1917, ndërsa për historianët sovjetikë ishte një kërkesë e domosdoshme ideologjike për "revolucionin proletar" të 1944-ës në Shqipëri. Megjithatë, Noli ishte kundër çdo diktature, sepse ideali i tij politik ka qenë një regjim demokratik republikan. Studiuesi Robert. C. Austin ka mendimin se historiografia komuniste kishte për qëllim *"të kënaqte vijën e partisë dhe mendësinë fortifikuese të diktatorit Enver Hoxha që synonte ta portretizonte Shqipërinë si një vend nën rrethim të përjetshëm. "*[636]

Ideja se Shqipëria duhet të mbështetet tek forcat e veta ka përshkruar gjithë periudhën komuniste dhe për këtë arsye Noli kritikohet kur thotë se *"shpëtimi i Shqipërisë do të vijë nga bota e jashtme"*. [637] Të gjitha këto kundërshti lidheshin me idetë që u shpalosën nga Partia Komuniste në një periudhë më të vonshme, e cila e lidhte dështimin e Revolucionit të Qershorit me mungesën e një ideologjie të mirëfilltë revolucionare komuniste. Vetë Noli e pa revolucionin si një fitore të intelektualëve demokratikë borgjezë, ndërsa masat politike u konsideruan si një forcë e dorës së dytë, sipas interpretimit të studimeve komuniste. Noli u bind se as Lidhja e Kombeve dhe as Fuqitë e Mëdha nuk do t'i jepnin ndihmën dhe mbështetjen për të cilën kishte nevojë.

Edhe pse Noli nuk kishte kontakt me lëvizjen e re revolucionare që kishte shpërthyer në atdhe në vitet '40, ai e përshëndeti si zgjidhjen e vetme. Ai e shihte Lëvizjen Popullore Shqiptare si një lëvizje që "*përmbysi njëherë e përgjithmonë ata armiq të vjetër të këtij populli që kishin qenë dhe ishin armiq edhe të Nolit"*. [638] Ai më vonë e kuptoi se "*koncepti për revolucionin ishte më pranë revolucionit të Haxhi Qamilit, sesa "revolucionit të tij demokratiko – borgjez, meqë ky i fundit u pa me urrejte nga ata që qenë në fuqi"*. [639]

Studiuesi Arshi Pipa e ka parë Nolin si një figurë të rëndësishme të politikës shqiptare por që nuk e çoi misionin e tij deri në fund. Sipas mendimit të tij " *të bësh revolucion dhe të qeverisësh një komb janë dy gjëra të ndryshme. Noli ishte mjaft i përshtatshëm për të parën, por jo për të dytën. "*[640]

Historiografia komuniste shqiptare, pavarësisht se është e gjerë, ajo është e njëanshme. Historianët marksistë u përpoqën ta shfrytëzonin sundimin e Nolit për qëllime politike dhe nuk paraqitën kurrë një qendrim kritik. Literatura e krijuar në Shqipëri në vitet e komunizmit është tejet e politizuar, përsëritëse, e prirur drejt një pikëpamjeje bardhezi. Kjo literaturë pohon se Shqipëria gjatë qeverisjes së Nolit përjetoi një betejë midis liberalizmit dhe feudalizmit, e cila e arriti kulmin me Revolucionin Demokratiko–borgjez të Nolit. Kufizimet ideologjike për historiografinë komuniste në vitet 1944-1991 treguan se ishin injoruar faktorë të tjerë ndikues në

[636] R. C. Austin. *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit (Demokracia shqiptare në vitet 1920 – 1924)*. Shtepia Botuese albin, Tiranë, 2003, f. 17.
[637] A. Puto. *Vepër e përmendur*, f. 261.
[638] A. Pipa. *F. Noli si një figurë kombëtare dhe ndërkombëtare*, në Studime mbi Fan. S. Nolin, *Vepër e përmendur*, f. 32.
[639] *Po aty*, f. 114.
[640] *Po aty*, f. 122.

ecurinë e qeverisë së parë demokratike shqiptare, të tilla si "*tendencat shpërbërëse fetare dhe rajonale dhe roli i shqiptarëve që jetonin jashtë Shqipërisë, në rajonin serb të Kosovës dhe ushtria".* [641]

Duke analizuar të gjithë veprimtarinë e tij atdhetare dhe politike mund të themi se Noli ishte i pari që solli për herë të parë parimet e një demokracie të mirëfilltë, të cilat e patën të vështirë të mbijetonin në një shoqëri anarkike, feudale dhe të prapambetur siç ishte shoqëria shqiptare e asaj kohe. Akademiku Rexhep Qosja ndan mendimin se " *Noli ka dështuar si demokrat dhe ne e kemi humbur demokracinë në kohën kur atë nuk e kanë pasur as popujt e tjerë të Ballkanit".* [642]

[641] R. C. Austin. *Vepër e përmendur*, f. 17.
[642] P. Milo. *Vepër e përmendur,* f. 328.

BASHKIM JAHOLLARI
PAVLLO CICKO

FAN NOLI DHE LIDHJET E TIJ ME KORÇËN

Një figure të tillë si Noli, që për idhull dhe ideal pati vetëm Shqipërinë, progresin dhe demokracinë, historia i ka dhënë vendin e merituar në plejadën e shquar të atdhetarëve shqiptarë. Ai jetoi dhe punoi në një periudhë të mbushur me ngjarje të rëndësishme, gjatë të cilave nuk ishte thjesht dëshmitar, por pjesëmarrës aktiv, që me veprimtarinë e vet la gjurmë të thella. Kjo veprimtari pati shtrirje të gjerë kohore dhe gjeografike. Ajo u zhvillua për gjysmë shekulli në Shqipëri, Greqi, Turqi, Rumani, Egjipt dhe veçanërisht në SHBA. Në veprimtarinë e zhvilluar në Shqipëri, veçohet edhe ajo në Korçë. Për vetë hapësirat që lejon një kumtesë, objekt të saj kemi bërë dy aspekte kryesore:

Së pari: Veprimtaria kishtare e Nolit në Korçë

Së dyti: Pjesëmarrja e tij në jetën politike të këtij qyteti

Pas 13 vjet qëndrimi në mërgim, në moshën 31-vjeçare, më 20 korrik 1913, Noli vjen për herë të parë në Shqipëri. Fillimisht qëndroi në Vlorë dhe më pas në Durrës. Dëshironte të vinte edhe në Korçë për t'u marrë me punë fetare, por kjo dëshirë nuk mundi t'i realizohej, sepse në atë kohë ky qytet ndodhej i pushtuar nga forcat greke. Vizita e dytë i takon muajit mars të vitit 1914. Ai mbërriti në Durrës dy ditë pas ardhjes së Princ Vidit, kur ende nuk ishte shuar jehona e pritjes pompoze që iu bë këtij të fundit. Duhet theksuar se dy vizitat e para ishin të shkurtra vetëm disa ditore. Për herë të tretë Noli shkeli në tokën amtare më 8 prill 1921. Shtypi përparimtar, midis të tjerash, dhe gazeta "Koha" që botohej në Korçë e përshëndetën këtë vizitë, duke e cilësuar si një ngjarje me interes në favor të çështjes kombëtare. Përshëndetje dhe telegrame urimi, ai mori edhe nga korçarët. Në to shprehej respekti e mirënjohja e popullsisë korçare dhe patriotëve të saj për figurën e Nolit. Deri në këtë moment për të cilin flasim, ai nuk kish qenë ndonjëherë në Korçë. Por Noli njihte mirë traditën dhe historinë e këtij qyteti. Njëkohësisht në mërgim kishte takuar dhe bashkëpunuar me mjaft patriotë korçarë.

Qysh nga takimi i tij i parë, më 1903 në Egjipt me patriotin e shquar korçar Spiro Dine, veprimtaria e Nolit do të ishte e pandarë nga ajo e patriotëve korçarë. Po në Egjipt ai u njoh me patriotët Thanas Tashko dhe Jani Vruho. Duke e angazhuar në lëvizjen kombëtare shqiptare ata i propozuan të shkonte në SHBA, si organizator për themelimin e shoqërive patriotike shqiptare. Këtu Noli u njoh dhe vendosi lidhje me shumë korçarë, që bënin pjesë në radhët e shoqërive atdhetare si: "*Malli i Mëmëdheut"*, *"Besa-Besën"* dhe veçanërisht në atë *"Vatra"*. Për këtë arsye kur ishte në Korçë, Noli mbarti me vete respektin dhe vlerësimet më të mira për qytetin dhe popullsinë korçare. Në këtë kohë ai kishte skicuar portretin e tij prej atdhetari dhe luftëtari të vendosur të çështjes kombëtare. Këtë e dëshmonte puna e bërë për organizimin e drejtimin e shoqërisë *"Vatra"* në SHBA, shkrimet e botuara në faqet e

shtypit përparimtar të mërgimit dhe veçanërisht ndihmesa e dhënë për pranimin më 17 dhjetor 1920 të Shqipërisë, si anëtare e *"Lidhjes së Kombeve"*. Duke vlerësuar këtë angazhim serioz të tij, këshilli bashkiak i Korçës e shpalli atë "qytetar nderi".

Pas largimit nga Korça, Noli vendoset në Tiranë. Këtu ishte qendra e Parlamentit shqiptar, ose ndryshe Këshillit Kombëtar, i dalë nga zgjedhjet e 5 Prillit 1921. Në përgjigje të kërkesës së qeverisë shqiptare, shoqëria *"Vatra"* e kishte caktuar atë deputet të saj në këtë Parlament. Në të Noli qëndroi, një vit si deputet i "*Vatrës" dhe një vit si deputet i Korçës"*[643]. Qysh në fillim në Parlament u kristalizuan dy grupime: njëri që mbronte platformën e Kongresit të Lushnjës dhe tjetri që ishte kundër saj. Më i fuqishëm ishte grupimi i parë, i quajtur *"Populllor"*, me të cilin u bashkua edhe Noli. Për më tepër ai u zgjodh dhe kryetar i këtij grupimi. Kështu Noli hyri në pararojën e klasës politike shqiptare, duke u bërë edhe përkrahës e mbështetës për shumë politikanë të tjerë të cilët dëshironin zhvillimin e vendit.

Krahas angazhimit në fushën politike ai nuk nënvlerësonte edhe veprimtarinë në fushën kishtare. Programi i tij kishtar synonte krijimin e Kishës Autoqefale Shqiptare brenda vendit.

Ky synim gjeti mbështetje tek popullsia ortodokse dhe klerikët përparimtarë ortodoksë. Ai mund të konkretizohej në mjaft qytete të vendit, prej të cilave Noli kishte edhe kërkesa, por ai zgjodhi Korçën. Kjo ishte shprehje e vlerësimit që Noli i bënte ortodoksisë korçare, e cila e mirëpriti synimin e tij. Sigurisht që realizimi i këtij synimi kërkonte masat e duhura përgatitore, të cilat do t'ia lehtësonin punën Nolit. Në marrjen e këtyre masave u dalluan klerikët atdhetarë at Vangjel Çamçe dhe at Vangjel Marko. Krahas tyre u radhitën dhe një sërë patriotësh korçarë, që kishin punuar me shoqëritë atdhetare të SHBA, si: Mihal Grameno, Foqon Postoli etj. Për rrjedhojë u krijua një situatë premtuese. Mbizotërues u bë mendimi se Kisha Autoqefale Shqiptare, e krijuar në mars 1908 në Boston nga Noli, duhej të kurorëzohej edhe brenda vendit dhe konkretisht në Korçë, e cila e mirëpriste këtë veprim. Edhe pse larg këtij qyteti, ai ndiqte me vëmendje gjithçka ndodhte në të. Klerikët korçarë e kërkonin të vinte sa më shpejt dhe kjo u realizua më 9 dhjetor 1921.

Në hyrje të qytetit Nolit i organizuan mitingun e mirëseardhjes. Ia uruan atë anëtarë të këshillit bashkiak, klerikë ortodoksë e myslimanë dhe përfaqësues të shoqatave të ndryshme. Ata që morën fjalën në këtë miting vunë në dukje meritat e Nolit në lëvizjen atdhetare dhe ndihmesën e tij për kishën ortodokse shqiptare dhe për pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve. Duke falenderuar për pritjen e bërë, në fjalën e tij, midis të tjerash ai theksoi: "*Sikundër ne djemtë e Korçës u përpoqëm në Amerikë t'i hedhim themelet e kishës sonë ortodokse, kështu dhe këtu në Korçë, me prindërit e tyre do të pasojmë rrugën e nisur, për të forcuar kishën e Krishtit*". [644] Në konkretizim të synimit të tij, më 11 dhjetor 1921, i veshur me rrobën e dhespotit, Noli mbajti meshën në kishën e Shën Gjergjit. Ishte hera e parë që një veprim i tillë bëhej në gjuhën amtare. Në këtë mënyrë froni i Kishës Ortodokse Autoqefale zuri vendin e vet në Shqipëri. Ngjarja pati jehonë të gjerë. Ajo gëzoi jo vetëm Korçën, por mbarë

[643] Vehbi Bala "Jeta e Fan S. Nolit", Tiranë 1972, f. 70

[644] Nasho Jorgaqi "Jeta e Fan Nolit", Tiranë 2005, V. 1, f. 418

Shqipërinë. Shtypi përparimtar e pasqyroi gjerësisht këtë ngjarje në faqet e tij. Nolit iu drejtuan përshëndetje dhe telegrame të shumta urimi. Pas qëndrimit trejavor në Korçë ai shkoi në Pogradec e Elbasan, ku edhe këtu meshoi në gjuhën shqipe. Më 10 janar 1922, Noli kthehet në Tiranë dhe vazhdon punën e tij. Tani ai mbarte mbi vete jo vetëm rolin e deputetit të Parlamentit shqiptar, por edhe atë të drejtuesit të Kishës Ortodokse Shqiptare.

Ecuria e mëtejshme kërkonte ligjërimin e kishës së porsakrijuar. Për këtë qëllim lindi dhe u zhvillua një lëvizje e fuqishme e cila dëshmonte se ortodoksia shqiptare jo vetëm kishte përqafuar mendimin e Nolit për krijimin e kishës autoqefale, por edhe mbështeste të gjitha përpjekjet që kisha të ecte në rrugë të mbarë. Në plan të parë doli domosdoshmëria e organizimit të një kongresi kombëtar i cili do të bënte këtë ligjërim. Kjo kushtëzohej edhe nga fakti se Shqipëria ishte i vetmi vend në Ballkan që nuk kishte kishën e vet autoqefale. U vendos që kongresi të mbahej në qytetin e Beratit. Pas punës të nevojshme përgatitore ai zhvilloi punimet më 11-13 shtator 1922. Në të morën pjesë 33 delegatë. Kryetari i kongresit u zgjodh krye Ikonom Papa Josifi. Ideatori dhe mbështetësi kryesor i këtij kongresi ishte vetë Noli, pavarësisht se për arsye taktike ai nuk mori pjesë në të. Vendimet e kongresit shënuan përfundimisht krijimin e Kishës Autoqefale Ortodokse Shqiptare. Gjuha e veprimtarive dhe botimeve të saj do të ishte shqipja. Po kështu klerikët e lartë duhet të ishin shqiptarë. Njëkohësisht Kongresi zgjodhi edhe Këshillin me kryetar klerikun korçar at Vasil Marko. Natyrisht që kisha do të kishte edhe qendrën e saj. Midis disa qyteteve si e tillë u caktua Korça. "*Atje – theksoi Kongresi- duhet të jetë qendra e diktuar nga veprat e shkëlqyera kombëtare kishtare të korçarëve*[645]. Nga ana e tyre këta të fundit vlerësuan vendimet e marra në Berat dhe në një nga telegramet dërguar Kongresit shkruanin se "*këto vendime i jepnin frymë kombëtare kishës mbi bazë të komunave, u jepnin qenësinë krishtere gjithë ortodoksisë korçare*"[646]. Më 18 shtator 1922 qeveria shqiptare njohu vendimet e Kongresit Kombëtar Kishtar të Beratit dhe pranoi kishën autoqefale, në bazë të parimeve të sovranitetit e të pavarësisë së shtetit shqiptar.

Ashtu si ndoqi me vëmendje të veçantë punimet e Kongresit edhe tani Noli interesohej së tepërmi për ecurinë e kishës. Kësaj i shërbente edhe korrespondenca e rregullt që ai mbante me klerikë të qyteteve të ndryshme, midis të cilëve edhe me ata korçarë. Veçohet këtu korrespodenca me Ikonom Papa Josifin, të cilit vetëm gjatë muajit nëntor Noli i dërgoi tre letra. Në letrën e parë të datës 1 nëntor 1922, ai shkruante: "*Hendeku i parë u kapërcye me trimëri, zotësi e hollësi të rrallë dhe suksesi nismëtar duhet t'u japë shpresë dhe siguri për kapërcimin faqebardhë të hendekëve të tjerë*"[647]. Po në këtë letër do të vazhdonte: "*U gëzova shumë, duke mësuar se kleri dhe populli i Korçës është i bashkuar rreth Kishës Kombëtare dhe uroj me gjithë zemër që ky bashkim të rritet e forcohet dita-ditës, për të mirën e vendit"*.

Në përfundim të këtij aspekti mund të themi se Noli hodhi themelet e Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, duke lidhur bukur rrobën e priftit dhe predikimin

[645]Broshurë "70 vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare", Tiranë 1999, f. 16

[646] Broshura e mësipërme, f. 17

[647] Vehbi Bala, vepër e cituar, f. 80

fetar me kushtrimin për liri e demokraci. Në këtë veprimtari ai u udhëhoq nga parimi se autoqefalia e kishës kombëtare ishte akt plotësues i pavarësisë dhe i sovranitetit të shtetit shqiptar, prandaj krahas krijimit të kishës kombëtare shqiptare, me vrrullin e talentin e tij, punoi edhe për konsolidimin e saj.

Për aspektin e dytë, atë të lidhjeve politike të Nolit me Korçën, mund të themi se ato u mbështetën në interesa të përbashkëta kombëtare. Pas ardhjes së Nolit për herë të tretë në Korçë, lidhjet mes tyre u bënë më të ngushta. Në plan të parë tani doli veprimtaria politike e tij. Kjo për faktin se muajt e fundit të vitit 1923 kishin ngarkesën e tyre politike. Ato përkuan me fushatën elektorale për zgjedhjen e Parlamentit Shqiptar (Asamblesë Kushtetuese). Fushata u çel më 13 tetor 1923, kurse zgjedhjet ishin caktuar për më 27 dhjetor të këtij viti. Përballë Partisë Popullore tani ndodhej Partia Liberale, me kryetar Nolin, e cila u krijua nga opozita në Korçë në pragun e fushatës. Kandidatët për deputet të kësaj partie kishin përparësi mbi kundërshtarët, sepse i dallonin aftësitë dhe vlerat morale e intelektuale. Kjo parti e caktoi Nolin kandidat për deputet në Korçë. Me programin e Partisë Liberale, ai përgatiti fushatën e vet elektorale në këtë qytet. Për të garantuar suksesin Noli zhvilloi edhe një fushatë paraelektorale. Në këtë kuadër ai organizoi takime në qytetet e prefekturës: Ersekë, Bilisht dhe Pogradec. Pas këtyre takimeve, në gusht u kthye në Korçë, ku u prit me entuziazëm nga shumë mbështetës e adhurues të tij. Gjatë këtij muaji Noli mbajti dy mitingje me popullin e Korçës. Mitingu i parë, ai i 18 gushtit 1923, u zhvillua në sheshin para *"Hotel Metropol"*. Pjesëmarrja në të ishte tepër masive si rrallë ndonjëherë. Qysh në fillim të fjalimit të tij Noli shprehu konsiderata të larta për Korçën dhe qytetarët e saj. Boshtin e këtij fjalimi e përbënin zgjedhjet e ardhshme elektorale. Për këtë ai iu drejtua pjesëmarrësve të mitingut: "*Kam ardhur në qytetin tuaj të bukur që të shkëmbejmë mendimet për çështjen e Kuvendit Themeltar. Kam ardhur këtë herë, vazhdoi ai, jo me bekime, me të cilat populli përgjigjet "Amen", por me propozime dhe mendime, të cilat do t'iu ftoj, t'i peshoni, t'i pëlqeni e t'i vazhdoni*"[648]. Duke shprehur vlerësimin për popullin, ai e quajti atë të zgjuar, që dinte të mos e shpërdoronte votën e tij. "*Kam besim të plotë - theksoi Noli - që populli ynë është mjaft trim sa të votojë ashtu si i thotë ndërgjegjja*"[649].

Mitingu i dytë, ai i 19 gushtit, u zhvillua para kopshtit "Themistokli Gërmenji". Sigurisht që edhe në të mbizotëroi tema e zgjedhjeve, por në dallim nga mitingu i parë, tani kritika ndaj qeverisë ekzistuese ishte më e hapur. Ai e quajti kabinetin qeveritar të paaftë, duke i vënë epitetin "kabineti i pykave". Sipas tij kjo e kishte burimin tek padituria dhe mungesa e vlerave civile. "*Prandaj*-theksoi Noli- *ideali i qeveritarëve nuk është të organizojnë shtetin, por të mbajnë kolltukët me çfarëdo çmimi*"[650]. Ai kërkoi që qeveria të shpërndahej sa më shpejt, pasi Shqipërisë i duhej një qeveri e popullit dhe për popullin, e përbërë nga njerëz të aftë, të ndershëm e patriotë. Për këtë arsye gjatë mitingut Noli hodhi parullën: "*Rroftë kabineti i ri! "*.

[648] Pirro Tako "Fan Noli në fushën politike dhe publicistike", Tiranë 1975, f. 120
[649] Gazeta "Shqiptari i Amerikës", 25 gusht 1923
[650] Nasho Jorgaqi. Vepër e cituar, f. 469

Në ditën e përvjetorit të Pavarësisë, më 28 nëntor 1923, ai zhvilloi një miting tjetër elektoral në Korçë. Pas kësaj organizoi takime në fshatrat: Zvezdë, Vinçan, Podgorie e Dishnicë. Thelbin e fjalës së tij në këto takime e përbënte domosdoshmëria e zhvillimit të zgjedhjeve të ndershme e korrekte. Njëkohësisht u evidentuan edhe problemet që duhet të zgjidhte Asambleja e dalë nga këto zgjedhje. Ato u zhvilluan në ditën e caktuar, më 27 dhjetor 1923, por në kushte të pabarabarta, sepse opozita u ndodh nën presionin e qeverisë. Por edhe opozita pati problemet e veta të brendshme. Për rrjedhojë nga 102 deputetë të Asamblesë Kushtetuese, ajo fitoi vetëm 1/3 e tyre.

Për sa i takon prefekturës së Korçës, situata ishte e ndryshme nga ajo në shkallë kombëtare. Në Korçë fitoi lista e kandidatëve të Partisë Liberale, të cilën e kryesonin Faik Konica dhe Noli. Vetë ky i fundit, sipas njoftimit të gazetës "Shqiptari i Amerikës", mori në Korçë "*... numrin më të madh të votave, nga të 50 kandidatët për deputetë të Prefekturës*"[651]. Ky rezultat ishte shprehje e respektit të popullsisë korçare për Nolin dhe njëkohësisht e mbështetjes që ajo i jepte opozitës demokratike.

Me mandatin e deputetit të Korçës, më 2 janar 1924, ai largohet nga ky qytet për në Tiranë, sepse më 21 janar fillonte punimet Asambleja Kushtetuese e porsadalë nga zgjedhjet. Edhe në radhët e kësaj Asambleje, ai nuk u pajtua me politikën e qeverisë, por e kritikoi ashpër atë duke u shndërruar në një nga drejtuesit kryesorë të opozitës parlamentare. Veprimtaria si deputet dhe roli aktiv në ngjarjet politike të pranverës 1924, rritën më tej personalitetin e tij, duke e evidentuar atë si drejtuesin më të spikatur të rretheve demokratike shqiptare. Prandaj, jo rastësisht korçarët, midis të cilëve edhe shumë liceistë e përkrahën Nolin në ngjarjet e qershorit të këtij viti.

Në përfundim të aspektit të dytë mund të themi se lidhjet e Nolit me Korçën kanë qenë të ngushta, për probleme të rëndësishme, pavarësisht se ai nuk qëndroi gjatë në qytetin tonë. Drejtpërsëdrejti këto lidhje filluan qysh me vizitën e tij të parë në Korçë. Pavarësisht nga kjo, ai linte të kuptohej se në vetvete ato ishin më të hershme. Prandaj në përshëndetjen e mitingut të kësaj vizite, Noli veçoi edhe këto fjalë: "*sikundër ne djemtë e Korçës" si edhe "jam krenar që mund të numërohem midis brezave patriotë të Korçës së bukur"*[652].

Përfundime

Noli është një figurë e rëndësishme e lëvizjes kombëtare shqiptare. Ai, në bashkëpunim me patriotë të tjerë shqiptarë, zhvilloi një veprimtari të dendur atdhetare, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, kryesisht në SHBA, për një periudhë afro gjysmëshekullore.

Noli, ndonëse larg, në mërgim, asnjëherë nuk e shkëputi vëmendjen prej atdheut. Ai, me punën e kryer, dha një kontribut të rëndësishëm për çështjen shqiptare, në momente mjaft të vështira për këtë të fundit.

Pjesë e rëndësishme e aktivitetit të Nolit brenda vendit është dhe veprimtaria e tij në Korçë. Ajo u përqendrua në dy aspekte: në atë kishtar dhe në atë politik.

[651] Gazeta "Shqiptari i Amerikës", 5 janar 1924

[652] Nasho Jorgaqi. Vepër e cituar, f. 403

Për sa i përket aspektit të parë, Noli synonte krijimin e Kishës Autoqefale Shqiptare. Në këtë drejtim ai gjeti mbështetje të gjerë nga popullsia ortodokse dhe klerikët e qytetit të Korçës, ku ai erdhi për herë të parë më 9 dhjetor të vitit 1921. Dy ditë më pas Noli i ulur në fronin e dhespotit zhvilloi meshën e parë në gjuhën shqipe në këtë qytet.

Për sa i përket aspektit politik të veprimtarisë së Nolit në qytetin e Korçës, ai në vitin 1923 u zgjodh deputet i këtij qyteti, si përfaqësues i Partisë Liberale, në Parlamentin shqiptar (Asambleja Kushtetuese). Fakti që ai u zgjodh deputet me numrin më të madh të votave, tregon për respektin që popullsia korçare kishte për të, si dhe për mbështetjen që ky qytet i ka dhënë që në atë kohë opozitës demokratike.

BLERIM BALLA

FAN NOLI DHE REVOLUCIONI I QERSHORIT

Figura politike e Fan Nolit mbetet një nga më të shndritshmet në panteonin shqiptar të baballarëve të kombit. Si një nga bashkëkohësit e denjë të rilindësve tanë të mëdhenj ai do të vazhdonte veprën e tyre të lavdishme. Në vazhdën e tyre ai do të merrej me pothuajse të gjitha fushat ku kombi dhe shteti shqiptar do të kishin nevojat e tyre. Ai u mor me përkthimin në gjuhën shqipe të librave të shenjtë, u shugurua prift në SHBA në kohën kur kërkohej themelimi i Kishës Ortodokse Shqiptare duke e çuar punën e tij deri në konsolidimin e autoqefalisë së kësaj Kishe. Noli do të shkëlqente në veprat historike për Skënderbeun, i cili kishte qenë guri i themelit i Rilindjes sonë Kombëtare. Diplomatin Fan Noli e gjeje në të gjitha konferencat ndërkombëtare ku vendosej fati i Shqipërisë dhe i shqiptarëve. Nën shembullin e Naim Frashërit, si një edukator i popullit të tij, ai do të përkthente kryeveprat e letërsisë botërore duke mbetur edhe sot mbase përkthyesi më i mirë dhe njëkohësisht iluministi i elitave shqiptare drejt ideve të Perëndimit. Objekti i kësaj trajtese është roli i Fan Nolit si Kryeministri i qeverisë që doli pas ngjarjeve të qershorit të'24-ës.

Pikëpamjet e historiografisë sonë mbi këto ngjarje ndahen sipas dy këndvështrimeve të kundërta. Historiografia e periudhës së komunizmit ka mbrojtur me forcë tezën se ngjarjet e qershorit të 1924-ës ishin një revolucion demokratiko-borgjez i organizuar dhe i drejtuar nga borgjezia e re shqiptare, e cila kërkonte çrrënjosjen e sistemit feudal shqiptar që ishte bërë një pengesë serioze në zhvillimin e Shqipërisë. Pas rënies së komunizmit një pjesë e historianve tanë i ka etiketuar ngjarjet e qershorit të 1924-ës si një grusht shteti i organizuar nga opozita e asaj kohe me mbështetjen e një pjese të mirë të ushtrisë e xhandarmërisë shqiptare. Meqë objekti i kësaj trajtese lidhet me rolin e Fan Nolit dhe të qeverisë së tij pas qershorit të vitit 1924, ne nuk do të merremi me përcaktimet se çfarë ishte me të vërtetë kjo ngjarje, ngaqë kuptohet se diçka e tillë kërkon një studim më të thellë dhe më të zgjeruar, që i kapërcen caqet e një kumtese.

Fan Noli do të hynte fuqishëm në jetën politike të viteve 1920-1924 duke pasur si *backegraund* ato ndihmesa që përmendëm më sipër, si dhe faktin e të qenit kryetar i Shoqatës Panshqiptare "Vatra". Përplasjet e shumta që karakterizuan periudhën pas Kongresit të Lushnjës do të bënin që situata në Shqipëri të degradonte deri në buzë të anarkisë totale. Shembulli më elokuent i kësaj është ndërrimi i qeverive të panumërta në harkun e katër viteve. Parlamenti shqiptar i kësaj periudhe do të bëhej arenë e përplasjeve të rrymave të ndryshme politiko- sociale, krahinoro-fetare, si dhe i lojërave të ndryshme parlamentare që shqiptarët deri atëherë pa përvojë kishin filluar t'i mësonin. Copëtimi i Shqipërisë që kishte sjellë ndarjen nga trungu shqiptar të viseve më të pasura dhe të asaj popullsie që kishte dhënë kontributin kryesor në shpalljen e Pavarësisë, shto këtu edhe odisenë e gjatë të njohjes e përcaktimit e të kufijve të shtetit shqiptar, po e kthenin Shqipërinë në një 'tokë të askujt'. E gjithë kjo

nga ana strukturore kishte sjellë krijimin e dy blloqeve kryesore në skenën politike shqiptare. Blloku i parë, më i fuqishmi, ishte ai i bejlerëve dhe pronarëve të mëdhenj të tokave, të cilët duke përfituar nga pushteti ekonomik, si dhe përvoja e gjatë administrative që nga koha e Perandorisë Osmane, kërkonin me çdo kusht ruajtjen e pushtetit politik si garantues të interesave të tyre ekonomikë që, për fat të keq, i bënin refraktarë ndaj çdo lëvizjeje ose reforme liberale, duke u kthyer *defacto* në ruajtës të *statu quo*-së, çka e kishte çuar popullin shqiptar në kufijtë e mjerimit. Figura kryesore e këtij grupimi qe Ahmet bej Zogolli, ambiciet për pushtet të të cilit, të pacak siç ishin, do t'i hapnin mjaft telashe Shqipërisë. Si çka ngjarë rëndom në historinë e shqiptarëve, Ahmet Zogolli ishte një bej shumë i vogël krahasuar me oxhaqet e mëdha shqiptare që e mbështesnin dhe që ai i përfaqësonte.

Në bllokun tjetër që ishte mjaft heterogjen bënte pjesë borgjezia e re shqiptare, intelektualët e rinj të shkolluar në Perëndim, rinia shqiptare e inkuadruar nën shoqërinë"Bashkimi"me në krye Avni Rustemin, si dhe emigrantët kosovarë të tubuar rreth Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës. Me këtë bazë sociale e strukturore opozita mblodhi rreth vetes figura të shquara që kishin luajtur një rol të dorës së parë në shpalljen e Pavarsisë, si Hasan Prishtina, Bajram Curri, Fan Noli, Luigj Gurakuqi, Stavro Vinjau e tjerë. Përplasjen kryesore këto dy grupe do ta kishin në vjeshtën e vitit 1923 për zgjedhjet në Asamblenë Kushtetuese, e cila do të kishte si detyrë përcaktimin e formës së regjimit, caktimin e kryeqytetit dhe në njëfarë mënyre caktimin e rrugës nga do të shkonte Shqipëria. Sistemi i votimit në dy shkallë, si dhe shfrytëzimi i pushtetit nga Ahmet Zogu, në postin e kryeministrit, dhe mbështetësit e tij, do bënte që situata paszgjedhore të ishte e nderë. Nuk munguan as akuzat e të dy palëve për shantazh, vjedhje dhe blerje votash. Megjithë pretendimet e opozitës, rezultatet e zgjedhjeve ofruan një grafi të saktë të klimës politike në Shqipëri. Asnjë nga grupet nuk siguroi dot shumicën. Në Asamblenë me 102 vende kandidatët e opozitës fituan 39, ndërsa Zogu me të tijët 44 vende. Të tjerët ishin kandidatë të pavarur konservatorë që anonin nga krahu i Zogut. [653]Ajo çka për fat të keq treguan këto zgjedhje ishin dasitë e mëdha krahinore e fetare. Opozita fitoi në Jug dhe në Veri, ndërsa Zogu me pasuesit e tij në Shqipëri të Mesme dhe në Dibër. Atmosfera e nderë paszgjedhore u zhvendos në sallën e Parlamentit. Më 24 shkurt të vitit 1924 Kryeministrit Ahmet Zogu iu bë atentat në hyrjen e Parlamentit nga Beqir Valteri, njëriosh nga Mati. Pasuesit e Zogut e lidhën atentatin me shoqërinë "Bashkimi"dhe kryetarin e saj Avni Rustemin, meqë atentatori ishte anëtar i kësaj shoqërie. Zogu u tërhoq nga posti i Kryeministrit duke ia lënë vëndin vjehrrit të tij, Shefqet Vërlacit. Pavarësisht prej këtyre lëvizjeve politike, situata ishte mjaft e nderë. Në marsin e vitit 1924 qeveria kishte dy kundërshtarë të vendosur, forcat përparimtare të mbledhura rreth Fan Nolit dhe Komitetin e Kosovës. [654]Mund të themi me siguri se të dyja kampet po përgatiteshin për betejën finale, kuptohet jo me rrugë politike.

Ajo që ndezi flakë situatën ishte vrasja e Avni Rustemit, një figurë mjaft popullore, e cilësuar si trubuni i rinisë shqiptare. Vrasësi, Isuf Reçi ishte mbështetësi i Esat

[653]Robert C. Austin, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit*, Albin, Tiranë, 2003, f. 73.
[654]Robert C. Austin, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit*, Albin, Tiranë, 2003, f. 78.

Pashës dhe 'mori hak' për vrasjen e pashait. Po t'i besojmë Eqrem bej Vlorës, ky kishte qenë një akt i shkëlqyer hakmarrjeje, që jo vetëm përputhej me rregullat e kodit të vendetës shqiptare, por bënte dhe një shërbim tjetër, pajtonte dy rrymat politike, esadizmin dhe ahmetizmin, deri atëherë të ndara. [655]Vrasja e Avni Rustemit solli bashkimin e të gjitha grupeve heterogjene të opozitës rreth Fan Nolit, si figura qendrore e saj. Varrimi i Avni Rustemit u kthye në sinjalin e fillimit të kryengritjes. Futja në lojë e dy garnizoneve ushtarake, të atij të Shkodrës nën komandën e Rexhep Shalës, dhe atij të Përmetit, komanduar nga Kasëm Qafëzezi, si dhe mësymja e forcave të Bajram Currit nga Kruma, bënë që qeveria të largohej nga Shqipëria së bashku me Ahmet Zogun dhe pasuesit e tij. Më 19 qershor1924 qeveria e koalicionit, e kryesuar nga Noli, do të shpallte programin e saj ku përfshiheshin reforma të thella sociale dhe politike që kërkonin kthimin e shtetit shqiptar drejt Perëndimit për t'u bërë si kombet e qytetëruara. Konsulli amerikan në Firence, Joseph Hejvn, ishte i bindur se qeveria e Nolit përbëhej nga elemente liberale e demokrate, se ajo ishte qeveria e popullit dhe jo bolshevike siç donin ta paraqisnin disa. [656]Po ashtu, ai nuk ngurron ta paraqesë Nolin si admirues të sinqertë të Amerikës. [657]Megjithatë qeveria e Nolit u përball me probleme të mëdha ekonomike e politike. Përplasja e rrymave të ndryshme që kishin marrë pjesë në revolucion me qëllimin e vetëm për të larguar Zogun dhe pasuesit e tij nga pushteti, situata alarmante financiare së cilës as një figurë si Luigj Gurakuqi në postin e ministrit të Financave nuk i bënte dot ballë, do të sillte mungesë kohezioni brenda qeverisë. Ashtu siç shprehet Joseph Rothscild, regjimit të Nolit që përbëhej nga reformatorë përparimtarë dhe nga elementë feudalë që ndanin me Zogun të njëjtat vlera, por që e ndienin veten të pashpërblyer siç duhet nga shpërdarja konkrete e favoreve prej tij, i mungonte uniteti. [658] Përpjekja e Nolit për një politikë ekonomike kombëtare duke përjashtuar fuqitë e mëdha nga koncesionet e pasurive shqiptare për të cilat ishin mjaft të interesuara, do t'i sillnin probleme në Lidhjen e Kombeve edhe me këto fuqi. Në shtator Lidhja e Kombeve do t'ia mohojë ndihmën financiare qeverisë së Nolit. Përpjekja për zbatimin e reformës agrare do ta vërë Nolin edhe kundër bejlerëve mbështetës të tij. Lënia jashtë pushtetit e Komitetit të Kosovës si lëshim që iu bë fqinjit verior, Jugosllavisë, i hoqi Nolit një mbështetje mjaft besnike. Përpjekja për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me BRSS-në do t'i ndihte kundërshtarët e Nolit ta damkosnin si bolshevik. Kjo do t'u vinte për shtat jo vetëm fqinjëve aspak miqësorë, por edhe qarqeve diplomatike të fuqive të mëdha. Duhet theksuar se ky epitet për një figurë si Noli ishte i padrejtë. Po t'u besojmë kujtimeve të Ali bej Këlcyrës, të botuara tash së fundi, na del se dhe Ahmet Zogunë vitet '20 kishte marrë ndihma të konsiderueshme nga agjentët sovjetikë. Në kohën kur Nolit i qenë zënë të gjitha shtigjet Ahmet Zogu në Beograd po përgatitej me mbështetjen e pakufishme jugosllave të hynte në Shqipëri. Zogu si mjeshtër i politikës dhe kulisave do t'u premtonte fuqive të mëdha koncesione pa fund në pasuritë

[655]Eqrem bej Vlora, *Kujtime*, SHLK, Tiranë, 2003, f. 505.
[656] Haris Silajxhiç, *Shqipëria dhe SHBA*, Dituria, Tiranë, 1999, f. 188.
[657] Haris Silajxhiç, *Shqipëria dhe SHBA*, Dituria, Tiranë, 1999, f. 189.
[658] Joseph Rothscild, *Evropa Lindore midis dy luftërave botërore*, Dituria, Tiranë, 2004, f. 355.

natyrore shqiptare. Me bjellogardistët e Vrangelit, forcat e rregullta jugosllave si pararojë dhe me pëlqimin e fuqive të mëdha, Zogu do të marshonte drejt Tiranës. Noli i braktisur nga të gjithë, me dëshirën për të shmangur një gjakderdhje tjetër, do të ishte një gjah i lehtë. Në fund të dhjetorit të 1924 forcat e Zogut të nisura nga Jugosllavia dhe Greqia do të marrin Tiranën duke hasur një rezistencë të dobët. Kështu do të triumfonte 'legaliteti'që ishte motoja e Ahmet Zogut. Me largimin e qeverisë dhe mbështetësve të Fan Nolit për në Itali merr fund edhe rrekja shqiptare për një republikë parlamentare dhe për reforma përparimtare që do na bënin si gjithë Evropa. Pa dashur të nxjerrim konkluzione të mëdha, përfundimi i epopesë së Fan Nolit si politikan, meriton atë epilog që i pati dhënë Kadareja tek eseja e tij "Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe" –Fan Noli ishte Kryeministri më i kulturuar i Europës në vendin më të prapambetur.

DRITAN PALNIKAJ

FJALIMI I FAN S. NOLIT NË LIDHJEN E KOMBEVE NË 10 SHTATOR 1924 SI SHPREHJE E PIKËPAMJEVE TË TIJ PËR POLITIKËN NDËRKOMBËTARE

Fjalimi që Fan Noli mbajti më datën 10 shtator 1924[659] në Sesionin e 5-të të Lidhjes së Kombeve që u mblodh në Gjenevë të Zvicrës. Situata e Shqipërisë dhe e qeverisë së drejtuar nga Noli, në periudhën në të cilën Noli paraqitej përpara Lidhjes së Kombeve ishte mjaft kritike, flasim për një qeveri të instaluar pas një Revolucioni "demokratik", kemi të bëjmë më një situatë kur dominon problemi i mos njohjes nga Përfaqësia Ndërkombëtare dhe nga probleme të shumta ekonomike financiare si dhe territoriale me fqinjët. Ky fjalim u dominua nga disa karakteristika tërësisht personale të Kryeministrit Nol, ishte një lloj fjalimi inspirues dhe cinik, inteligjent dhe ironik, gjithëpërfshirës dhe specifik, pra për sa i përket këtij fjalimi duhet thënë dhe duhet ritheksuar fakti botërisht i njohur se Noli ishte një euridit i madh, me kulturë sa perëndimore për shkak të formimit të tij në Harvard aq edhe mesdhetare dhe tradicionale.

Fan Noli e nis fjalimin e tij me një kritikë të fortë për Lidhjen e Kombeve duke u shprehur: "Oh! Më mirë luftë sesa të gjitha këto llomotitje të mërzitshme për paqen! Ç'kemi bërë për paqen? Çfarë bëjmë tani në këtë çast në këtë Asamble? Ajo që është bërë këta 5 vjet të shkuar pushon qetë-qetë në paqen e përjetshme mbyllur fort, varrosur në dosjet e vdekura të Sekretariatit, të ruajtura me kujdes prej atij fort të ndershmërit e të shquarit xhentelmen, që është Sekretari i Përgjithshëm i Lidhjes së Kombeve. Është e vërtetë që Lidhja e Kombeve ka bërë disa shërbime të vogla për paqen në përgjithësi dhe në veçanti nuk lejoi copëtimin e Shqipërisë, duke siguruar kështu paqen në rajon dhe rendin në Ballkan. Siç e di, Shqipëria ishte një kaçkë e fortë për t'u thyer dhe më e rëndë për t'u ndarë, kështu që Lidhja e Kombeve me mënçuri vendosi ta lejë Shqipërinë të qetë të lagur nga valët e Adriatikut". [660]

Siç shihet Noli e përdor një ironi deri në sarkazëm në fjalimin e tij përpara Lidhjes së Kombeve duke e konsideruar atë një organizatë të paqenë si dhe të tejmbushur nga burokracia dhe mosveprimi. Koncepti i tij për sekretariatin dhe fort të nderuarin Sekretar të Përgjithshëm në këndvështrimin e Noli-t ato ishin veçse hallka ku hallet e anëtarëve të kësaj lidhje thjesht depozitohen, arkivohen për të mos u trajtuar më ndonjëherë. Arsyeja pse Noli e ka gjithë këtë mllef ndaj Lidhjes së Kombeve ka të bëjë me faktin se ai i është drejtuar asaj për ndihmë ndaj Shqipërisë dhe përgjigja nga

[659] Societe Des Nations, Journal Officiel. Actes de la V Assemblee. Compte- rendu des debats. Geneve 1924 pp. 105-106.

[660] Arben Puto, *Demokracia e Rrethuar*, Fq 315

Lidhja e Kombeve nuk ka qenë pozitive. Ai shprehet: "Por, ju lutem, zoti Sekretar i Përgjithshëm, përse refuzoni t'i jepni Shqipërisë një hua që do t'i lejonte të ecte vetë? Ne nuk na duhen më shumë se 300 milion franga ari. Apo më shumë? Atëherë po bëj gjestin elegant të zbres në shumën modeste prej 200 milionësh. Ju tundi kokën. Epo jam gati të hyj në bisedime për një shumë më të vogël, p. sh. për 100 milionë. Më falni, mos pretendoni se nuk më keni takuar kurrë dhe, pra nuk jeni i dispozuar të më jepni asnjë dhjetësh? Atëherë merreni edhe kërkesën time dhe varroseni në dosjet e vdekura të sekretariatit, kyçini mirë dhe mbyteni fort përpara se ta futni në nekropolin tuaj, sepse mund t'ju dalë nga varri[661]".

Në këtë pjesë ai vazhdon përsëri të ironizojë rolin e Lidhjes për mungesën e fondeve i zhgënjyer nga Lidhja që nuk iu përgjigj pozitivisht kërkesës për një hua në një kohë kur me hua ishte trajtuar Austria dhe Hungaria që ishin shtete më pak në nevojë se sa shqiptarët. E në këto kushte Noli sheh një mllef duke e konsideruar Lidhjen të paqenë dhe të pashpresë.

Por një ndër problemet kryesore me të cilat u desh të përballej Noli në Lidhjen e Kombeve ishte edhe fakti se në Shqipëri nuk ekzistonte jeta parlamentare dhe për këtë arsye Noli nga ana e tij ë perifrazon jetën parlamentare duke iu drejtuar përsëri me ironi Lidhjes: "Po a e dini ju se ç'është parlamenti? Pa dyshim e dini. Por do ta keni një ide më të qartë kur tju them se ç'mendoj për të. E, pra, Parlamenti është një sallë ku mblidhen politikanët pashpirt për të bërë prova operatë në trupin e gjallë të racës së tyre, një sallë plot me gazra helmues, gazra mbytës, që shkaktojnë lot dhe të qeshura dhe gjithë gazrat e tjerë që u përdorën gjatë luftës së fundit për t'u dhënë fund gjithë luftrave e për të vendosur paqen, atë paqe që po flasim. Por, pasi ngulni këmbë, ne nuk refuzojmë të bëjmë zgjedhje të reja e të thërresim plagë, atë fatkeqësi të madhe, atë besytni të shëmtuar që është parlamenti, pasi të kemi bërë dy ose tre vjet qeverim atëror. A do pranonit atëherë z. Sekretar i përgjithshëm, të më jepni pas tre vjetësh huanë prej 400 milion frana ar për të cilën ramë dakort para disa minutash? Ju përgjigjeni prapë "jo" e dija. [662]"

Noli me këtë goditje që i bën Parlamentit si një nga institucionet bazë të demokracisë, flet kundër vizionit të tij, dhë kundër bindjeve të tij për idealin demokratik. Kjo madje është shpjeguar edhe si një mungesë takti në politikë pasi damka që mori nga paragjykimi që ju bë në Lidhjen e Kombeve ishte jashtëzakonisht e madhe. Duke u vendosur në kontekstin e kohës duhet kuptuar se situata politike ishte sa dramatike aq edhe qesharake në Shqipëri, duke pasur një demokraci të brishtë ku qeveritë ndërroheshin me një periodicitet mjaft të shpeshtë edhe nga 3 qeveri në javë, duke qenë Parlamenti i përbërë nga aparatçint e disa borgjezëve shqipëtarë me në krye Ahmet Zogun.

Situata politike parlamentare ishte mjaft e rënduar. Situata u rëndua më shumë me vrasjen e Avni Rustemit dhe kjo çoi në Revolucionin e Qershorit. Revolucion i cili vuri në krye Fan S. Noli-n dhe ky ishte i gatshëm të vendoste gjithë kapacitetin e tij

[661] Po aty 316

[662] Arben Puto*, Demokracia e Rrethuar*, Fq 316

intelektual, mendor dhe shpirtëror për të drejtuar vendin me drejtësi dhe demokraci, por duhet theksuar se periudha në të cilën ai udhëhoqi qeverinë nuk favorizonte këtë lloj lideri. Të drejtë, të ndershëm dhe të pakompromis me të keqen. Ndaj edhe sulmi që i bën Noli Parlamentit dhe parlamentarizmit e rreshtoi atë tek vëndet me demokraci të cunguar dhe tek liderat bolshevikë. Ky lloj paragjykimi e dëmtoi shumë Nolin dhe qeverinë e tij, pasi frika e një orientimi komunist kryesisht rus, si dhe disa arsye meskine dashakeqë të fqinjëve të Shqipërisë bënë që qeveria e Nolit të rrëzohej pas vetëm dy muajsh pavarësisht vullnetit të tij maksimal për të bërë mjaft reforma me karakter jetik për vendin. Vlen të theksohet tendenca e tij për të implementuar reformën agrare që në atë periudhë, tendenca e tij pacifiste dhe pozitiviste për të vendosur fqinjësi të mirë me shtetet dashakeqe që na rrethonin. Kundërshtarët e Nolit e përdorën shumë faktin se Noli, na qenka një "i kuq" një komunist Bolshevik, dhe se ai e rrezikonte demokracinë si dhe duke marrë në konsideratë faktin se ata për të rrëzuar qeverisjen e tij nuk kursyen as territoret shqipëtare, atëherë duke shfrytëzuar rrethanat e kohës dhe faktet e sipërpërmendura kundërshtarët e tij ia dolën mbanë që të rrëzonin qeverinë e Nolit.

Nolin në fjalimin e tij në Lidhjen e Kombeve vazhdon më tutje duke i kërkuar llogari të pranishmëve se çfarë është bërë në 5 vite për paqen dhe jep po vetëpërgjigjen duke cituar Shekspirin e madh "Fjalë, fjalë fjalë… dmth erë asgjë më tepër"[663].

Kjo ironi shkon edhe më tej kur ai fillon të përshkruajë rrugën që duhet të ndjekin aspiratat për paqen, kthehen në rezoluta kundërrezoluta, kërkesa-komisione, nënkomisione-kërkesa drejtuar sekretariatit, dhe deri tek zoti i gjithëpushtetshëm etj. Ky lloj qëndrimi i Kryeministrit Noli pati natyrisht reagime madje edhe largimin e Kryeministrit Mac Donald dhe atij francez Herriot nga salla. Por rrethanat në të cilat ndodhej qeveria e Noli-t vetëm në këtë përfundim mund të shkonin. Një qeveri e një vendi të vogël të Ballkanit e ardhur me revolucion në pushtet, mjaft e varfër për nga të ardhurat, me një popullsi të vogël në shtetin që qeveriste, si dhe me një pamudësi totale për një ringritje të shpejtë ekonomike dhe infrastrukturore. Gjithashtu mungesa totale e mbështetjes ndërkombëtare, Shqipëria nuk kishte më Austro-Hungarinë që ta ndihmonte apo shtete të tjera që dikur në varësi të interesit politik ditor i kishin dhënë ndonjë ndihmë Shqipërisë, pra Shqipëria ishte e vetme.

Në kushtet kur kriza politike në vend ishte një realitet i prekshëm dhe pritej të shpërthente nga çasti në çast një kundërrevolucion atëherë Noli kishte dy rrugë për të paraqitur veten në Lidhjen e Kombeve. Rruga e parë ishte të paraqitej si një nga pjesëmarrësit, etik, protokollar, korrekt dhe me një profil prej dëgjuesi të duruar, të parashtronte kërkesat e tij modeste, dhe kërkesat e tij të futeshin në spiralen e pafundme të Sekretariatit që ai vete e ka përshkruar në fjalimin e tij. Dhe kjo rrugë Nolin natyrisht nuk do e çonte asgjëkundi pasi në atë periudhë Lidhja e Kombeve vetë si një organizatë e brishtë nuk kishte shumë mundësi për të bërë diçka për Shqipërinë dhe fatin e saj. Të dalë nga Lufta e Parë Botërore të gjitha shtetet kishin llogaritë e

[663] Po aty, f. 317

veta në plan të parë. Dhe Noli si periferiku i një vendi dhe qeverie periferike nuk do kishte arritur as të meritonte vëmendje për t'iu dëgjuar zëri.

Rruga e dyte e cila është edhe ajo që ndoqi gjatë atij takimi në Lidhjen e Kombeve është rruga e rebelit moskokçarës, e ironikut inteligjent, e personit të vetëm që do tërhiqte vëmendjen e të gjithë të pranishmëve në sallë me elokuencën e tij dhe me mënyrën që zgjodhi për t'u paraqitur aty, protestë, ngritje zëri, kërkesë llogarie, të gjitha këto me elokuencë dhe euridicion të jashtëzakonshëm, me finesë në brendësinë e tyre dhe duke perifrazuar qoftë Shekspirin gjithashtu edhe Faustin e Gëtes. Pra ky është një fjalim brilant që arriti të krijonte impaktin për të cilin Noli e shkroi, pikërisht vëmendjen e të pranishmëve ndaj Shqipërisë së rrënuar.

Ky lloj qëndrimi, Nolit i krijoi mjaft audiencë pozitive dhe negative, tërhoqi vëmendjen e të pranishmëve për faktin se një shtet i vogël pa asnjë lloj kapaciteti imponues po bëhej kaq kërkues dhe arrogant, në dokumentet e Lidhjes së Kombeve thuhet se u prit me "duartrokitje të gjalla" ndoshta diplomatët duartrokitën oratorinë dhe euridicionin e tij në atë sallë. Por për qëndrimet e mbajtura Noli u quajt edhe "Peshkopi i Kuq" dhe u akuzua direkt për bolshevizëm, sipas referimeve të kohës Nolin e dëgjuan me "kënaqësi keqëdashëse[664]". Kjo situatë e ndihmoi si një shkak më tepër për ta sulmuar dhe anatemuar më tepër Nolin dhe qeverinë e tij.

Edhe pritja në opinionin e vendit nuk ishte unanime, pati fjalë lavdëruese si: "me fjalimin e tij Noli gjëmoi me zë apostulli në mbledhjen e lartë të Gjenevës[665]". Në anën tjetër gazeta "Dajti" që ishte edhe gazetë opozitare nuk i bëri fare vend fjalimit, gjë që tregon se në qarqe të caktuara vihej në dyshim oportuniteti i "fjalës së zhveshur në mbledhjen e Gjenevës. " Sejfi Vllamasi që ishte kundër revolucionit, në kujtimet e tij e quan fjalimin "jo oportun dhe jo prej politikani". Noli foli sikur të ishte "delegat i shtetit më të fuqishëm në botë" pas kësaj Ninçiçi e uroj Zogun se tani i kishte dyert e hapura për t'u kthyer në Shqipëri[666]. Konica e çmonte atë fjalim "nga ana letrare, nga pikpamja e së vërtetës, por jo nga pikpamja e taktit diplomatik"

Në fund të këtij fjalimi Noli përsëri gjen diçka për të inkurajuar vazhdimësinë e Lidhjes së Kombeve dhe aspiratës për paqe dhe drejtësi duke cituar Faustin e Gëtes ai shkruan "Verweile doch, Du bist so schon! " (Oh, megjithatë qëndro, ti je kaq e bukur!) [667]

Paraqitjen e Nolit në Lidhjen e Kombeve e pasqyruan mediat e kohës të gjitha gazetat shqiptare, gazetat e vendeve fqinje si dhe disa gazeta botërore. Problematikat që ai trajtoi në Lidhjen e Kombeve kishin të bënin me çështjen e Çamërisë, çështjen kufijve të 14 fshatrave të Korçës, si dhe çështjen e Shën Naumit dhe malit të Vërmoshit. Këto çështje u trajtuan pre tij në Lidhjen e Kombeve dhe u pasqyruan

[664] Sipas gazetës "Drita " dt. 25. 09. 1924
[665] Gazeta "Bashkimi", dt. 07. 10. 1924
[666] S. Vllamasi, *Kujtime*. fq 274
[667] Arben Puto*, Demokracia e Rrethuar*, Fq 323

gjërësisht në mediat e kohës si p. sh. gazeta "Drita" "Shqipëtari i Amerikës" "Bashkimi" "Politika" Gazeta greke "Skrip" apo ajo serbe "Vreme"etj

Një tjetër ide e Nolit e parashtruar në Lidhjen e Kombeve ishte edhe ajo e krijimit të një Konfederate Ballkanike për të cilën ai kërkonte ndihmën e të gjithëve. Pasi me këtë do mundnin tërë shtetet të pakësonin ushtëritë dhe të përdorin të hollat e kursyera për mirqënien e vendeve të tyre. Ai gjithashtu ishte i ndërgjegjshëm për pengesat që do dilnin gjatë krijimit të saj, por shpresonte që me një frymë bashkëpunimi mund të arrihej kjo konfederatë e cila do sillte jo vetëm mirëqënie, por gjithashtu edhe do shmangte mosmarrveshjet e shumta territoriale. Për sa i përket problemeve me kufinjtë, ai natyrisht ngre pretendimet e tij për problemet që ka me Greqinë, por shpreh gadishmërinë maksimale për të bashkëpunuar në funksion të një zgjidhje oportune për të dyja palët. "Pasi ka mjaft territore të ngelura jashtë kufinjëve të Shqipërisë duke përjashtuar 14 fshatrat e Korçës të cilat falë këmbënguljes së Nolit Lidhja e Kombeve nxorri një vendim dhe ja kaloi përfundimisht Shqipërisë[668]. "

Nolin në diskutimet e tij në Lidhjen e Kombeve mundohet të ndërgjegjësojë të pranishmit se çështja e kufirit të 1913-ës helmon marrëdhëniet me fqinjët. "Ska lezet të zgjatet më tepër, dhe duhet mbaruar njëherë e mirë, për të shmangur pengimet në marrëdhëniet tona të mira. Çështjet e Shën Naumit dhe të Vërmoshit, që janë objekt mosmarrveshjesh, kanë për të përfunduar shpejt ose vonë, dhe pastaj mund të fillojë një kapitull i ri. Ne nuk jemi të kënaqur me kufirin absurd që na kanë vendosur Fuqitë e Mëdha. Kemi humbur mjaft toka dhe toka ku banojnë me shumicë shqipëtarët. Të flasim për krahinën e Gjakovës, ju e dini që e morët atë vetëm sepse kishit atje manastirin e Deçanit, përkundër faktit që tërë popullsia atje është shqiptare, përveç tridhjet familjeve brenda në qytet. Të tëra krahinat e tjera në Kosovë kanë 85-95 përqind popullsi shqiptare. Po ne ju bindëm kësaj, ndonëse dimë se jashtë Shqipërisë mbetën më tepër shqiptarë sesa ka brenda në kufinjt e saj. Aq më tepër se ju jeni 16 herë më të mëdhenj se ne dhe 50 herë më të pasur, duhet të bindeni që Shën Naumi dhe Vërmoshi të na mbeten neve sipas vendimeve të Fuqive të Mëdha. Sipas mendimit tim do të ishte absurde që Mbretëria e Jugosllavisë të jetë në konflikt me të voglën Shqipëri për një mal të thatë si Vërmoshi dhe për një manastir të vobektë si Shën-Naumi. "[669]

Noli gjithashtu mundohet që të ngrejë ura bashkëpunimi me anë të diplomacisë me grekët dhe serbët kur shprehet tek gazeta "Politika": "Politika jonë thekson Kryeministri shqiptar, është ajo që na bashkon dhe jo ajo që na ndan, me synimin drejt një konfederate ballkanike"[670].

U rikujton grekëve miqësinë e vjetër, duke iu kujtuar atyre ndihmesat nga ana e shqiptarëve ndër shekuj, si dhe përpiqet të eleminojë shprehjën e thënë nga grekët se Shqipëria është "një Turqi e vogël e maskuar", duke u përgjigjur se megjithëse ka element mysliman në Shqipëri… "nuk besoj të ketë një shtet në këtë botë të qytetëruar

[668] Gazeta e Beogradit "Vreme" dt. 13. 09. 1924
[669] Gazeta e Beogradit "Vreme" dt. 13. 09. 1924
[670] Nasho Jorgaqi, *Jeta e Fan S. Nolit*. Fq 538

ku të mbretërojë aq deri në indiferentizëm tolerancë feje sa në Shqipëri? Provë për këtë, me të cilën krenohen shqiptarët është fakti se "në krye të qeverisë jam unë një peshkop ortodoks, dukuri e panjohur edhe për shtetet ortodokse. "[671]

Noli kërkoi nga Greqia që çamët të mos dërgoheshin në Turqi me pretekstin se janë turq por të bëhej një shkëmbim sipas një vendimi të dhënë nga Lidhja e Kombeve me qenë se kishte edhe shtetas grekë të mbetur në Shqipëri. Gjithashtu Noli ngriti pretendime për pakicat e mbetura jashtë Shqipërisë dhe për trajtimin e tyre "Ashtu siç i respektojmë ne pakicat tuaja respektoni ju pakicat tona" kjo ishte një kërkesë e Nolit.

Nolin në mesazhet e tij para dhe pas mbledhjes së Lidhjes së Kombeve ishte shumë i qartë në pretendimet e tij, dhe shumë diplomat në kërkesat që bënte ndaj fqinjëve. Duke ditur pozicionin e Shqipërisë dhe pamundësinë e saj për t'iu imponuar askujt, atëherë Noli detyrohej të bënte elokuentin dhe diplomatin pavarësisht faktit se ishte ndërgjegjshëm që pretendimet e tij ishin të drejta dhe të bazuar.

Në përfundim të debatit, Këshilli i Lidhjes miratoi një rezolutë me anën e së cilës i kërkonte edhe një herë tjetër Konferencës së Ambasadorëve, që të merrte në shqyrtim çështjen dhe të përshpejtonte caktimin përfundimtar të kufirit midis Shqipërisë e Jugosllavisë. Kjo ishte një zgjidhje e papërcaktuar, tipike dhe në stilin e Lidhjes së Kombeve kur ishte fjala për të mospërfillur interest e popujve e vendeve të vogla. Një shtrim i tillë i problemit do të thoshte që t'u hapej shtegu interpretimeve të reja të vendimeve të mëparshme. Rezoluta bashkoi në një çështje të vetme si Vërmoshin ashtu edhe Shën –Naumin. Me 6 tetor 1924 kjo rezolutë, në të cilën kishte gjetur vend edhe mendimi konsultativ i Gjykatës Ndërkombëtare i 4 shtatorit, iu përcoll Konferencës së Ambasadorëve.

Si konkluzion, fjalimi i Nolit në Lidhjen e Kombeve pati një impakt për sa i përket çështjes shqiptare, ishte guri i fundit që mund të luante qeveria shqiptare për të treguar se ekziston, dhe këtë ekzistencë e dëshmoi më së miri Noli me fjalimin e tij. Duhet marrë në konsideratë fakti që Shqipëria në rast se Noli nuk do të ngrinte zërin në Lidhjen e Kombeve as nuk do ishte fare pjese e diskutimeve për vetë rrethanat e kohës. Pra i duhet kosideruar një meritë e madhe Nolit fakti që arriti të tërhiqte vëmendjen ndaj çështjes shqiptare. Por gjithashtu vlen të theksohet se kjo gjuhë arrogante mbase krijoi disa armiqësi, keqkuptime dashakeqe pasojat e të cilave i vuajti vetë Noli me rrëzimin e qeverisë vetëm 2 muaj pas këtij fjalimi.

[671] Nasho Jorgaqi, *Jeta e Fan S. Nolit*. Fq 538

ERINDA PAPA
BENITA STAVRE
PAVLLO CICKO

PËRPJEKJET E FAN NOLIT NË RANG NDËRKOMBËTAR PËR TË ZGJIDHUR NGËRÇET E POLITIKËS SHQIPTARE

Jeta e Nolit, shkollimi dhe veprimtaria e tij para vitit 1908, sidomos gjatë qëndrimit të tij në Amerikë.

Politika e shtetit shqiptar gjatë viteve 1915 – 1925 përshkruhet si një arenë politikanësh karrieristë, pa angazhime të veçanta dhe sidomos pa një program qeverisjeje të përcaktuar qartë. Megjithatë ndihej edhe prania e atyre politikanëve dhe organizatave me një vizion afatgjatë për Shqipërinë. Për t'u përmendur janë Fan Stilian Noli dhe Ahmet Zogu, që shfaqen si udhëheqës të rinj, të vendosur për një Shqipëri të re. Ishte pikërisht konflikti ndërmjet aspiratave të këtyre njerëzve që përcaktoi konfliktin politik në Shqipërinë e viteve 1920 – 1924. Ky ishte një konflikt ndërmjet dy tipa politikanësh në Shqipërinë e asaj kohe: të atyre politikanëve të cilët fituan përvojë gjatë regjimit Otoman si Ahmet Zogu nga njëra anë dhe atyre siç ishte Noli të cilët ose nuk kishin ndonjë përvojë të mëparshme qeverisjeje ose e fituan atë jashtë Shqipërisë.

Noli nuk ishte një politikan i zakonshëm. Para 1920 ai thuajse nuk kishte kaluar asnjë periudhë në Shqipëri. I lindur në Ibrik – Tepe (Qytezë, në shqip), një fshat shqiptar nën regjimin Otoman në vitin 1882, Noli mori shkollimin e parë në gjimnazin e Adranopolit. Ai ishte një shtetas Otoman, që fliste shqip në shtëpi dhe greqisht në kishë dhe shkollë. Ndërmjet viteve 1900 dhe 1903 Noli jetoi në Greqi ku punoi si përkthyes dhe aktor, para se të nisej në Egjipt për të marrë postin e mësuesit në një shkollë gramatike dhe atë të drejtuesit të korit të kishës. Në vitin 1906, në moshën 24-vjeçare, ai udhëtoi për në SHBA ku filloi aktivitetin e tij për çështjen kombëtare.

Pasi mbëriti në Nju Jork, fillimisht vendoset në Bufalo, filloi punën në një punishte manifakture, dhe më pas u vendos në Boston, ku në Korrik të vitit 1906, ai filloi punën për çeljen e gazetës së parë në gjuhën shqipe botuar në SHBA, gazetën "*Kombi"* në bashkëpunim me Sotir Pecin. Pas një grindjeje me Pecin, Noli filloi punë si stampues kanaçesh. Përfundimisht ndien vokacionin ndaj kishës, megjithëse vendimi i tij për t'u bërë prift ishte kryesisht i nxitur nga ndjenja patriotike. Në vitin 1908, në Nju Jork, u kurorëzua si kryepeshkop i Kishës Ortodokse Ruse, në pamje të parë në rrethana të dyshimta. Duke shpresuar të eliminonte ndikimin grek brenda Kishës Ortodokse Shqiptare, ai e përqëndroi aktivitetin e tij fillimisht në përkthimin e teksteve liturgjike në shqip dhe më pas në përpjekjet për vendosjen e Kishës Autoqefale Ortodokse Shqiptare. Ai e konsideronte këtë të fundit si arritjen kryesore për unifikimin e kombit si dhe një goditje të rëndë për mbështetësit e "Idesë së Madhe"greke.

Në vitin 1908 filloi studimet në Universitetin e Harvardit, dhe u diplomua në Arte në vitin 1912. U përfshi në një aktivitet të dendur politik, duke punuar si redaktuesi i gazetës shqiptaro-amerikane "Dielli" duke luajtur një rol tepër aktiv në shoqërinë "Vatra", një shoqatë shqiptaro-amerikane me qendër në Boston e themeluar prej Faik Konicës.

Në vitin 1908 Noli e gjeti veten shpejt në krye të shqiptarëve të Amerikës. Ky prestigj zgjoi kureshtjen e të gjithë atyre që mendonin se, duke mos qenë lindur në Shqipëri, Nolit i mungonin gjithë lidhjet e nevojshme familjare dhe më gjerë të cilat ishin premisat kryesore ku bazohej ardhmënia e një politikani të suksesshëm në vend.

Në vitin 1911 ai viziton komunitetin ortodoks shqiptar në Bullgari, Ukrainë dhe Rumani dhe prej vitit 1912, me shpalljen e Pavarësisë, Noli shpalos aftësitë e tij si gazetar dhe shkrimtar përpos qenies së tij si drejtues i komunitetit ortodoks shqiptar në SHBA. Gjatë gjithë kësaj kohe bie në sy erudicioni i tij dhe njohjet e shumë gjuhëve si greqishtes, turqishtes, arabishtes e frëngjishtes.

Karriera e tij si diplomat fillon me deklaratën e Pavarësisë në 1912. Ndërmjet viteve 1912 – 1915 ai bën të njohur çështjen shqiptare në mbarë Evropën. Vizitën e parë në Shqipëri e bën në vitin 1913.

Në vitin 1915 Noli u duk përsëri në krye të Shoqërisë Vatra të Amerikës, falë përfaqësimeve shumë të denja që i kshte bërë çështjes shqiptare në disa konferenca ndërkombëtare në Evropë. Kjo e kishte tërhequr njëkohësisht vëmendjen e këtyre drejtuesve të rinj larg tendencës pro-gjermane e cila i kishte karakterizuar gjatë qëndrimit të princ Vidit në Shqipëri. Për më tepër, kur Amerika hyri në Luftën e Parë Botërore, thirrjet e Presidentit Wodrow Willson për të drejtën e çdo kombi për vetvendosje u bënë motoja që udhëhoqi veprimtarinë e gjithë atdhetarëve në atë kohë në mërgrim. Shoqëria Vatra u bë militante e çështjeve të frymëzuara nga Fuqitë Aleate të luftës. (*Federal 58*) Anëtarët e saj kontribuan financiarisht për të dhe vetë Noli mbajti një numër fjalimesh në kampet e paraluftës në Massachusetts.

Muajt që pasuan përfundimin e Luftës ishin periudhë vendimtare për historinë e Shqipërisë. Shteti shqiptar shpresonte që Fuqitë Aleate t'i mbështesnin pretendimet shqiptare për mosmarrjen parasysh të vendimeve të Paktit të Londrës 1915, sipas të cilit pjesë të konsiderueshme të territorit shqiptar ishin lënë jashtë kufijve të vendit dhe ishin ndarë midis shteteve fqinje Itali, Greqi, Serbi dhe Mal i Zi. Me këtë pikësynim, Shqipëria dërgoi një delegacion në Konferencën e Paqes në Paris. Fryma patriotike e shqiptarëve të Amerikës u ndie në donacionet mbresëlënëse prej $150. 000 që bënë emigrantë shqiptarë aty për të financuar qëndrimin e këtij delegacioni në Paris. Raporti i shkruar nga Federal Writers thekson sidomos shumën e $500 të dhuruar nga një pronar shqiptar dyqani në Boston dhe $360 që ofruan secili nga dy punëtorët e thjeshtë shqiptarë të Fore River Shipyard në Quincy. Një pjesë e shumës së mësipërme u shpenzua për botimin e një gazete të përmuajshme me titull "*The Adriatik Review"*, tek e cila botoheshin artikuj që kishin për synim të tërhiqnin vëmendjen e aktorëve të rëndësishëm ndërkombëtarë në lidhje me problematikën e ndërlikuar të kufijve dhe qenësisë së kombit shqiptar. Kopje të saj u dërgoheshin shpesh zyrtarëve amerikanë dhe gazetat më në zë në Amerikë filluan të botojnë artikuj të shkruar nga "miqtë e Shqipërisë" të cilët shpesh u referoheshin sloganeve të presidentit Wilson "e drejta për

vetvendosje" dhe "qeverisje që plotësonte vullnetin e popullit". (60) Vetë Presidenti amerikan Wodrow Willson kishte kërkuar informacion rreth këtij vendi që ishte kaq shumë i përmendur në axhendën e Konferencës së Paqes dhe raporti u hartua nga G. F. Williams, në atë kohë ministër Amerikan në Athinë, i cili mblodhi materiale të mjaftueshme nga vizita që bëri në Shqipërinë e Jugut në vitin 1915. Materialin e përmblodhi më vonë në një libër të titulluar "Shqiptarët". Aty autori u bëri thirrje të hapur popullit dhe qeverisë amerikane kur, në përfundim të përsiatjeve të tij rreth mënyrës se si Shqipëria mund të rriste ardhmëninë e saj, shkroi: "*Nuk do të ketë punë më fisnike për popullin amerikan se të ndihmojë shqiptarët të vendosin qetësinë dhe rendin në vend. Një rast i tillë është i pashembullt në historinë e sotme. " (Ëilliams, 51)*

Në këtë kuadër, Presidenti Willson thirri Kongresin e Kombeve të Shtypura në Washington në korrik 1918. Noli, i cili një vit më parë ishte zgjedhur Kryetar i Shoqërisë "Vatra" për herë të dytë, e përfaqësoi Shqipërinë në atë kongres. Ai dhe përfaqësues të kombeve të tjera të shtypura shoqëruan Presidentin Willson për te varri i George Ëashington-it ku Presidenti mbajti fjalimin e tij të njohur mbi kombësinë dhe vetëvendosjen. Në librin e tij "*Shqiptarët; Historia e Popullit shqiptar nga mesjeta deri në ditet e sotme"* historiani amerikan Edwin Jacques përshkruan edhe atë çka ndodhi më vonë po atë ditë, kur Noli dhe delegacioni që ai drejtonte patën një takim paraprak me presidentin në jahtin presidencial "Mayflower". Aty u fol kryesisht në emër të pavarësisë shqiptare. Presidenti premtoi se do t'i mbronte të drejtat e shqiptarëve dhe deklaroi shprehimisht "…*në Kongresin e Paqes do të kem një zë dhe atë zë do ta përdor për të mirën e Shqipërisë*". (*Liria 27 Nëntor 1976, 2 Vep. cit Jacques 403)* Kjo e bëri më të lartë zërin e shqiptarëve në Konferencën e Paqes në Versajë në vitin 1919. Ndikim i Presidentit Wilson në këtë Konferencë ishte vendimtar për Shqipërinë.

Më herët në po atë vit nacionalistët shqiptarë kishin kërkuar që Lidhja e Kombeve t'i jepte Amerikës të drejtën e një mandati qeverisësh në Shqipëri. (*Dervishi, 97*) Pavarësisht se kjo kishte rezultuar një kërkesë tërësisht jo praktike për natyrën e lidhjeve ndërkombëtare që Presidenti Wilson kishte frymëzuar gjatë luftës dhe më vonë, mbështetja nga ana e këtij të fundit nuk mungoi për shqiptarët në janar të vitit 1920. Udhëhequr nga parimi i kufijve "sipas kombësisë" në Konferencë, Presidenti refuzoi të firmoste planin që Shqipëria të ndahej midis Jugosllavisë, Greqisë dhe Italisë dhe që vetëm një pjesë e vogël e saj të lihej autonome nën protektoratin Italian. (*Dervishi, 95*) Ky veprim thuajse firmosi pavarësinë e Shqipërisë.

Fill pas kësaj shqiptarët u mblodhën në Kongresin e Lushnjës në përfundim të të cilit Shqipëria kishte një qeveri të sajën, të organizuar nga një Këshill Regjence, një kryeqytet, dhe mbi të gjitha, kishte *besën* kombëtare që shqiptarët i dhanë njëri-tjetrit kundër armikut të përbashkët. Shqipëria nisi kështu rrugën e saj drejt të qenit një Republikë Parlamentare.

Një ndër faktorët që dhanë kontributin e tyre të padiskutueshëm për ngritjen dhe përforcimin e saj ishte edhe shoqëria "Vatra" e Amerikës. Në korrik 1920 Noli u zgjodh unanimisht përfaques i zërit të shqiptarëve të Amerikës në parlamentin

shqiptar. Që prej këtij viti ai nuk do të rreshte së luftuari për reforma sociale dhe demokratike në vend. Shpejt u vu re se republika e frymëzuar nga Kongresi i Lushnjës kishte ndryshuar natyrën e saj duke iu përshtatur klimës tipike shqiptare të mbijetuar nga pushtimi i gjatë turk. Fryma e sjellë nga përtej kufijve kishte natyrë tepër radikale për atë realitet të ngulitur konservator, në të cilin bejlerët ishin shumë të vendosur për të mos bërë lëshime personale për çështje me karakter kombëtar. Pjesa më e madhe e 20. 000-30. 000 shqiptarëve të kthyer nga Amerika me shpresën se diçka do të ndryshonte në vend u detyruan t'i riktheheshin emigracionit. (*Federal, 66)* Noli dhe të tjerë apostuj të demokracisë vendosën të qëndrojnë në vend për të treguar se kishte ende shpresë.

Marrëdhëniet midis liberalëve dhe konservatorëve në Shqipëri arritën kulmin sidomos në fund të vitit 1923 kur, në emër të liberalëve, Noli kërkoi mbledhjen e një konvente të re kushtetuese. Kjo kulminoi me zgjedhjet e janarit 1924. Në fazën e parë të votimit, kur populli zgjidhte përfaqësuesit e tyre delegatë, të cilët do të zgjidhnin anëtarët e parlamentit në një fazë të dytë votimi, (*Dervishi, 191*) fituan liberalët. Edhe në fazën e dytë liberalët fituan më shumë vende në parlament se çdo grup tjetër parlamentar (35 nga 105). Megjithatë këta të fundit u bashkuan duke formuar një mazhorancë qeveritare që mori pushtetin. (*Federal, 70)* Opinioni publik në Amerikë reagoi ashpër. Në gazetën "*Dielli"* u protestua hapur: "Partia liberale fitoi besimin e popullit. Faza e parë e zgjedhjeve dëshmoi popullaritetin e saj. Kur të vijë koha, ky besim do të bëhet arma me të cilën do të luftohet kundër pronarëve të pushtetit. " (*Dielli, 15 Shkurt, 1924*)

Në fakt ngjarjet precipituan shumë shpejt. Pas vrasjes së Avni Rustemit, gjatë varrimit të tij, Fan Noli mbajti një fjalim që zgjoi ndjenjën kombëtare që flinte në zemrat e liberalëve shqiptarë. Brenda dy javëve liberalët morën pushtetin në kryeqytet dhe Fan Noli u zgjodh Kryeministër i qeverisë së re. Kjo qeveri hartoi një program në dukje ambicioz për të zgjidhur gjithë problemet që shoqëria shqiptare kishte trashëguar që nga administrimi turk i vendit. Synimi i saj ishte krijimi i një modeli qeverisës që të reflektonte në program praktika të demokracive perëndimore. Për këtë Noli kishte nevojë për mbështetjen e fuqive perëndimore.

Nevoja për të zgjidhur ngërçet ndërkombëtare shqiptare me anë të ndërmjetësisë së Lidhjes së Kombeve

Oratoria dhe elokuenca e gjuhës që përdorte në fjalime e kishin ndihmuar gjithmonë Fan Nolin të merrte përsipër funksione përfaqësie në emër të komunitetit shqiptar të Amerikës apo dhe në emër të qeverisë shqiptare. Përballja e tij e parë me Lidhjen e Kombeve kishte qenë në nëntor të viti 1920, kur ai kryesoi një delegacion të posaçëm në Gjenevë që kishte marrë përsipër trajtimin e çështjes së statusit ndërkombëtar shqiptar. Sipas kërkesës së Eric Drummond, në atë kohë Sekretar i Përgjithshëm i Lidhjes së Kombeve, delegacioni paraqiti përveç disa dokumenteve mbështetëse që "provonin se qeveria shqiptare ishte njohur "de facto" ose "de jure" nga qeveri të tjera" edhe një kërkesë prej 15 kapitujsh për pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve. (*Dervishi, 126*) Me mbështetjen e hapur të Britanisë së Madhe me anë të

përfaqësuesve të saj në Lidhje, Shqipëria e mori statusin e anëtarit të Lidhjes së Kombeve në 17 dhjetor 1920.

Në 25 qershor 1921 qeveria shqiptare duke vepruar si organ i një shteti anëtar i Lidhjes së Kombeve nëpërmjet Fan Nolit, kryetar i delegacionit të saj, e shtroi çështjen e kufijve para këshillit të Lidhjes dhe kërkoi ndërhyrjen e organizmave të posaçme për zbrazjen e pjesëve të territoreve shqiptare të pushtuara nga trupat e huaja. Ky delegacion mbrojti pikëpamjen e vet me anë të mendimit se Konferenca e Ambasadorëve nuk mund të ishte organi kompetent për t'u marrë me çështjen shqiptare. Fokusi i kësaj konference ishin çështje dhe probleme të shteteve pjesëmarrëse në luftë dhe, për sa kohë që Shqipëria kishte qenë neutrale gjatë Luftës, kjo i jepte të drejtë delegacionit shqiptar të kërkonte një tjetër mënyrë vlerësimi të çështjes.

Në këtë rast Noli nënshkroi një deklaratë për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve ku thuhej se të gjithë "shtetasve me banim në Shqipëri, do t'u jepej mbrojtje e plotë e jetës dhe lirisë së tyre, pa ndryshim lindjeje, kombësie, gjuhe, race dhe feje" dhe se "nuk pengohej e drejta e ndërrimit të fesë. " (*Dervishi, 145*) Veç Nolit këtë deklaratë e nënshkroi edhe Eric Colban, që në atë kohë ishte Drejtor i Seksionit të Komisionevet Administrative e i Minoritetit. Kjo bëri që në takimin e saj të 9 nëntorit 1921 Lidhja e Kombeve të njihte pavarësinë e shtetit shqiptar me disa ndryshime të vogla të kufijve të saj ekzistues në Shkodër, Prizren, Gollobordë dhe Lin.

Gjithësesi kufijtë shqiptarë kishin kohë që zgjonin debate të shteteve evropiane. Ato ishin kthyer në marrëveshje mirëkuptimi dhe pakte bashkëpunimi jo vetëm midis shteteve fqinjë, por edhe shteteve të tjera evropiane që kërkonin të ruanin drejtpeshimin e pushteteve ndërkombëtare në Evropë. Noli e artikuloi qartë mendimin e tij në lidhje me këtë. "Lidhja e Kombeve është pasuese e natyrshme e koncertit evropian që ka rregulluar çështjen e Shqipërisë, " – u shpreh ai para Këshillit të Lidhjes. (*Dibra 150*) Kjo u përshtat zyrtarisht edhe me një notë të Kryeministrit shqiptar Iliaz Vrioni të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve në 29 qershor 1921 ku thuhej se: "Qeveria shqiptare solemnisht tërheq vëmendjen e Këshillit të Lidhjes së Kombeve ndaj faktit që populli shqiptar do të kundërshtojë ashpër çdo vendim për copëtimin e territorit tonë kombëtar siç është fiksuar në 1913. " (*PRO. FO317/5728, C14605/508/90. 29. 06. 1921, vep. cit, Dibra 150)* Këtë notë e shoqëruan edhe me kërkesën që pavarësisht punës që Konferenca e Ambasadorëve po bënte për përcaktimin e kufijve të Shqipërisë, Lidhja e Kombeve të dërgonte një komision të posaçëm në Shqipëri. Gjithësesi, edhe këtë herë, duke dashur të mos krijonte divergjenca të mëdha midis anëtarëve të komisioneve që tashmë merreshin me çështjen shqiptare dhe që në vetvete përfaqësonin interesat kombëtare të shteteve të tyre, Lidhja e Kombeve zgjodhi të mbetej thjesht vëzhguese e zhvillimit të ngjarjeve në Konferencë. (*Dibra 152)*

Kur Noli erdhi në krye të qeverisë shqiptare i ndjeu së tepërmi pasojat e faktit që vendet e huaja nuk po e njihnin legjitimitetin e qeverisë së tij. Kjo e bënte të pamundur marrjen e ndonjë huaje financiare në mbështetje të projekteve për përmirësimin e vendit dhe vënien në jetë të reformave që ai kishte parashikuar. Për këtë, dy muaj pas marrjes së pushtetit, ai ndërmori një udhëtim në Evropë dhe në 10 shtator 1924 mbajti

një fjalim para Lidhjes së Kombeve dhe kërkoi nga "ky organizëm një hua prej 100-300 milionë frangash ari. " (*Dervishi, 225*)

Joseph Swire, studiues anglez i jetës shqiptare në vitet 1920, citoi në librin e tij një pjesë të konsiderueshme të këtij fjalimi, tek i cili vuri re "karakterin e gjallë" dhe "të rrallë" për mbledhje serioze si ato të llojit të mësipërm.

"Duke rishikuar punën që është kryer nga Lidhja e Kombeve gjatë pesë viteve të jetës së saj aktive, unë kam frikë se edhe pacifisti më i ekzaltuar do të ngrejë krahët lart dhe do të thërrasë: "Më mire le të kemi luftë sesa këto biseda të mërzitshme për paqen"…. Ajo çka është bërë në pesë vjetët e shkuar prehet në paqe – në paqen e përjetshme- e kyçur fort në dosjet e vdekura të sekretariatit…. "(*Sëire, 345*)

Swire e quajti të përligjur këtë kritikë cinike ndaj metodave të Lidhjes dhe administrates së saj. "Nëse kjo organizatë do të kishte vepruar me më pak frikë dhe kujdes dhe me një veprimtari më konkrete, "- shpjegoi ai- "Shqipëria do të kishte qenë jo një pikë e rrezikshme, por një shtyllë e sigurisë dhe e stabilitetit në gadishullin e Ballkanit. " (*Swire, 346*) E bërë në vitin 1929, vit kur Swire u largua nga Shqipëria, kjo deklaratë mbart realisht arsyet se përse çështja shqiptare ngelej një ngërç politik i ndërlikuar në cilatdo nisma ndërkombëtare për të qetësuar ujrat e turbullta të Ballkanit.

Në fakt, gjatë qeverisjes së tij, Nolit iu desh të përballej me dy çështje të këtij lloji që qëndronin pezull mbi kufijtë e Shqipërisë. Çështja e pakicave në Greqi dhe tri pika të diskutueshme në kufi që përfshinin katërmbëdhjetë fshatra pranë Korçës që qëndronin nën trupat greke (lirimi i tyre u bë vetëm në tetor të 1924); rajoni i Vermoshit, që pavarësisht se me vendim të Konferencës së Ambasadorëve i ishte lënë Shqipërisë, vazhdonte të mbante peng bisedimet e palës jugosllave në takime ndërkombëtare; si dhe Manastiri i Shën Naumit, përkatësia e të cilit ishte lënë në pikëpyetje, pavarësisht argumentave të të dyja palëve dhe zvarritjes së stërzgjatur së kësaj çështjeje. Sipas Swire-it bisedimet në lidhje me këto vende i kushtonin Shqipërisë "afërsisht 1. 000. 000 franga ari, një humbje e rëndë për burimet e një vendi me kaq vështirësi financiare. " (*Sëire, 346*)

I ndeshur me faktin që këto tre çështje po bëheshin pengesë për mbarëvajten e brendshme të politikës dhe ekonomisë shqiptare, më 25 shtator 1924, Noli, bëri para Lidhjes së Kombeve përshkrimin e mëposhtëm të mënyrës sesi Shqipërisë i ishte dashur të përpiqej ndoshta edhe pafundësisht për të ruajtur kufijtë e saj legjitimë.

"Çështja e kufijve të Shqipërisë që ishte në diskutim qysh përpara Luftës Botërore, njëmbëdhjetë vjet më parë ende po pret një zgjidhje përfundimtare- një zgjidhje që çdo dimër është shtyrë për në verën e ardhshme. A duhet të presim një tjetër shtyrje në dimrin që po vjen – me të gjitha konfliktet dhe ndërlikimet që do të sjellë kjo si pasojë? Kjo është një pyetje që populli shqiptar e bën me një shqetësim që rritet vazhdimisht. Kjo torturë ka zgjatur tepër gjatë; kjo barrë e padurueshme po peshon tepër rëndë mbi një popull që dëshiron vetëm paqen. " (*po aty*)

Në këtë pikë Noli e gjykoi të nevojshme të bënte një përmbledhje të dimrave dhe verave që Shqipëria kishte qenë "një vend që nuk i përkiste askujt" deri në vitin 1921 kur "çështja e kufijve u rimor (….) pas pranimit në Lidhjen e Kombeve – një ngjarje rëndësia e të cilës është e pamundur të mbiçmohet. " Ai e mbylli fjalimin e tij duke u kërkuar njëkohësisht Këshillit të Lidhjes dhe Konferencës së Ambasadorëve ta

zgjidhnin çështjen e kufijve të Shqipërisë brenda dimrit të atij viti (1924). (*Official Journal of the League of Nations, tetor 1924, 1335, vep. Cit, Sëire, 349*) Megjithatë dimri i vitit 1924 rezultoi për Shqipërinë shumë më i ftohtë sesa Noli e kishte pritur, dhe kjo jo thjesht në aspektin e marrëdhënieve ndërkombëtare.

ESTELA HOXHA

VEPRIMTARIA E FAN S. NOLIT NË LIDHJEN E KOMBEVE NË VITET 1920-1921

Mbarimi i Luftës së Parë Botërore është pasuar me ngjarje të mëdha historike. Kështu, në Shqipëri vitet '20 karakterizohen nga qëndresa e vazhdueshme dhe iniciativa e vetëvendosjes së popullit shqiptar e shprehur kjo me formimin Kongresit Kombëtar të Lushnjës dhe luftën e Vlorës. Shqipëria ishtë përballë një lufte të ashpër diplomatike e iniciuar kjo nga përpjekjet e Fuqive të Mëdha dhe shteteve fqinjë si Jugosllavia dhe Greqia, për të rivënë dhe një herë në diskutim nga e para çështjen shqiptare. Duke u nisur nga situata e krijuar, anëtarësimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve ishte një sukses dhe një fitore e madhe politike. Lidhja e Kombeve ishte e para organizatë që merrte në mbrojtje çdo anëtar të saj përballë kërcenimeve ndaj sigurisë kolektive, si dhe do të ndërtonte marrëdhënie demokratike dhe transparente midis shteteve anëtare të saj. Këtë kishte parasysh edhe klasa politike shqiptare e asaj kohe kur këmbënguli duke shfrytëzuar çdo mundësi për t'u pranuar anëtare e Lidhjes së Kombeve. Ky punim përfshin periudhën e viteve 1920-1921 të marrëdhënieve të Shqipërisë dhe Lidhjes së Kombeve. Çështjet kryesore që trajtohen janë: anëtarësimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, ripohimi i pavarësisë, çështja e kufijve dhe debati mbi minoritetet, sigurisht roli i rëndësishëm i figurës së shquar të Fan Nolit, kontributi i të cilit ishte i jashtëzakonshëm dhe me vlera të padiskutueshme.

Për Shqipërinë e pasluftës ishte krijuar një situatë e re ndërkombëtare e pafavorshme. Nuk kishte më një Austro-Hungari që ta mbronte ekzistencën e saj në diskutimet diplomatike mes të mëdhenjve, dhe nga ana tjetër, ekzistonte Traktati i Londrës 1915, që parashikonte copëtimin e Shqipërisë, që e kishin firmosur edhe Anglia e Franca të cilat ishin të detyruara ta respektonin[672]. Qeveria shqiptare bëri disa përpjekje për të zgjidhur konfliktin me Jugosllavinë nëpërmjet bisedimeve dypalëshe, po kështu dhe me Greqinë. Rezultati ishte negativ, pasi ishte e pamundur arritja e një zgjidhje që të plotësonte kërkesat e palëve, realizimi i të cilave çonte në coptimin e trevave shqiptare. Qeveria e formuar nga Kongresi i Lushnjës e përqëndroi vëmendjen pikërisht te ripohimi ndërkombëtar i vendimeve të 1913-s, mbi njohjen e pavarësisë së Shqipërisë dhe të kufijve të saj. U gjykua se Lidhja e Kombeve ishte selia më e përshtatshme për t'i gjetur një zgjidhje pozitive kësaj çështje ashtu siç shpresonin të gjithë popujt e vegjël. Ajo sillte një element të ri në jetën ndërkombëtare, ajo i trajtonte çështjet në debat mbi bazën e publicitetit, pra të pjesëmarrjes së opinionit publik[673]. Në lidhje me këtë do të shprehej më vonë Noli si përfaqësues i Shqipërisë në

[672] Akademia e Shkencave e Shqipërisë*, Historia e Popullit Shqiptar III*, f. 38

[673] Arben Puto, *Shqipëria Politike*, f. 286

Lidhjen e Kombeve. Ai shprehet se publiciteti që iu bë çështjes shqiptare, ishte me dobi dhe vlerë të madhe, "nga Lidhja u njohëm si komb, si komb sovran" [674].

Pikërisht këtë anë të Lidhjes pati parasysh qeveria shqiptare kur vendosi t'i drejtohej asaj për të hedhur poshtë dyshimet mbi statusin e Shqipërisë pas Luftës së Parë. [675] Më 15 nëntor 1920 do të hapej në Gjenevë të Zvicrës e para Asamble e Lidhjes së Kombeve. Një muaj para hapjes së Asamblesë, më 12 tetor 1920 delegacioni shqiptar në Konferencën e Paqes, i paraqiti Sekretarit të përgjithshëm Drummond kërkesën e Qeverisë së Tiranës për Pranimin e Shqipërisë në Lidhje[676]. Në krye të delegacionit shqiptar për të mbrojtur interesat kombëtare u vendos Fan Noli. Në fakt veprimtaria e Nolit në mbrojtje të interesave kombëtare duke mbështetur gjithnjë tezën e Shqipërisë së pavarur kishte filluar që në gjirin e "Vatrës", pra kishte dhënë prova se sa mirë dinte të mbronte çështjen e atdheut të tij. Pranimi në Lidhje, besonte Noli do të krijonte jo vetëm burim mjaft të nevojshëm ndihme financiare, por edhe premtimin e ndërhyrjes ndërkombëtare në mbrojtjen e integritetit të shtetit shqiptar, që ndihej nën kërcënimin e vazhdueshëm të fqinjëve. [677] Nolit iu besua kryesia e delegacionit shqiptar me qëllim që të mbrohej në mënyrë sa më dinjitoze çështja shqiptare në Lidhjen e Kombeve. Caktimi i tij ishte kandidatura më e përshtatshme për kohën dhe jo krejt e rastësishme sepse ai fliste me lehtësi gjuhët zyrtare që fliteshin në sallat e Lidhjes së Kombeve, si anglisht dhe fërngjisht, por ai ishte drejtues i fesë ortodokse, që përbënte një shembull të shkëlqyer të bashkëjetesës së besimeve fetare në vendin tonë. Noli ishte gjithashtu edhe përfaqësuesi i Federatës "Vatra" në SHBA i cili kishte bërë përpjekje të jashtëzakonshme për t'ia paraqitur Presidentit Uillsonit problemin shqiptar dhe për ta angazhuar atë tërësisht në çështjen shqiptare. Në një nga darkat ku Noli ishte i ftuar i Presidentit Uillson, ai arriti që t'i shkëpuste këtij të fundit përkrahjen maksimale të SHBA-së kundrejt çështjes shqiptare. Noli ia paraqiti situatën në të cilën ndodhej Shqipëria edhe zonjës Uillson duke u shprehur: "Zonjë, shqiptarët më kanë porositur t'ju lutem që ta kujtoni Shqipërinë, një vend aq të varfër, pa miq dhe pa ndonjë përkrahje. Po nuk qajnë për urinë dhe mjerimet që heqin, po për humbjen e saj"[678]. Zonja e Parë si përfaqësuese e ndjenjave amerikane për vetëvendosje, tregohet e ndjeshme ndaj kësaj çështje, sepse këtë e shohim te përgjigjia që kthen duke deklaruar se: "Po na vjen shumë keq për kombësitë e vogla si Shqipëria, Belgjika e të tjerat"[679]. Në vazhdim të bisedës, Noli deklaron se situata e Shqipërisë është më e koklavitur dhe e trazuar dhe se e vetmja shpresë për Shqipërinë dhe shqiptarët jeni ju Z. President dhe Amerika. Dhe Presidenti kthen një përgjigje që për Shqipërinë përbën histori më vete; "Po unë do të kem vetëm

[674] Nasho Jorgaqi, *Fan S. Noli, Vepra V*, f. 128
[675] Pranvera Teli (Dibra), *Shqipëria dhe Diplomacia Angleze 1919-1927*, f. 124
[676] Public Record Office (PRO-më tej E. G). Fo 371/4885, C9605/9/22. Kërkesë e Qeverisë Shqiptare drejtuar Z. Ric Drrumond, Sekretar i përgjithshëm i Lidhjes së Kombeve, Paris 12 tetor 1920
[677] Robert C. Austin, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit*, f. 49
[678] Nasho Jorgaqi, *Fan S. Noli, Vepra V*, f. 96
[679] Po aty, f. 96

një zë në kongresin e paqes dhe atë zë do ta përdor dhe për të drejtat e Shqipërisë"[680]. Pra kishte një sërë arsyesh që përligjën besimin ndaj Fan Nolit.

Delegacioni arriti në Gjenevë me 12 nëntor dhe që nga ky moment, trajtimi i çështjes së statusit ndërkombëtar të Shqipërisë kaloi nga Konferenca e Paqes në Lidhjen e Kombeve. Që në momentin e parë që Noli arrin në Gjenevë, situata ishte e disfavorshme. Problemi i parë me të cilin u përball ishte refuzimi i kërkesës për arsye procedurale, për faktin se kërkesa kishte arritur në Sekretari pas 15 tetorit. Megjithatë falë aftësisë së tij si diplomat, ai bëri të gjitha manovrat e duhura për kapërcimin e kësaj pengese. Kështu, arriti të kontaktojë me shumë delegatë të vendeve të ndryshme të Belgjikës, përfaqësuesin e Francës në Sekretariat, delegatë të Zvicrës, Japonisë, të Afrikës së Jugut, të Italisë. Në këtë kuadër ai shprehet dhe për simpatinë e Spanjës dhe të republikave latino-amerikane, çfarë nënkupton mbështetjen e tyre. Gjithashtu, Noli pati një takim me diplomatin e lartë britanik H. Nikolson, prej të cilit mori premtimin e përkrahjes angleze. [681] Përkrahësi më i madh i çështjes shqiptare ishte Obri Herbert, anëtar i parlamentit anglez, i cili përdori ndikimin e tij mbi delegacionet e tjera, sidomos atë kanadez. Me kontaktet që realizoi Noli duket sikur parapërgatiti kushtet për shtrimin e kauzës shqiptare në Lidhjen e Kombeve. Ngërçi për refuzimin e kërkesës shqiptare për shkaqe procedurale u kapërcye, pasi neni i rregullores që kërkonte një muaj paralajmërim për çdo propozim nuk ishte në fuqi në kohën kur Shqipëria paraqiti kërkesën e saj. Komisioni ishte i mendimit që kërkesa ishte e rregullt. [682]

Paraqitja e kanditaturës së Shqipërisë shtroi menjëherë çështjen e statusit të saj ndërkombëtar. Këtë e kërkonte neni i Statutit të Lidhjes ku thuhej se " mund të bëhet anëtar i Lidhjes çdo shtet që qeveriset lirisht, pra Shqipëria duhej të përmbushte kushtin themelor, të ishte shtet i pavarur[683]. Drummond kërkonte që të paraqiteshin këto dokumente: 1) kopje autentike të dokumenteve me anën e të cilave Shqipëria ka shpallur pavarësinë ose i është njohur vetëqeverisja e plotë dhe 2) kopje autentike të deklaratave, me anë të cilave qeveritë e tjera e kanë njohur qeverinë e Shqipërisë si qeveri *de facto* ose *de jure*[684]. Duke iu përgjigjur kërkesës së Sekretarit të Lidhjes, Noli paraqiti ekstrakte nga aktet ndërkombëtare si traktati i Londrës i 30 majit 1913. Vendimi i Konferencës së Ambasadorëve i 29 korrikut 1913, Statuti Organik i Shqipërisë. [685] Krahas tyre u paraqit dhe një memorandum që ishte përmbledhje e argumenteve të delegacionit shqiptar. Nëpërmjet memorandumit, Noli demaskonte Traktatin e Fshehtë të Londres dhe kërkonte nga ai forum i lartë të garantonte pavarësinë e Shqipërisë dhe paprekshmërinë e kufijve të atdheut nga lakmitë serbo-greke. [686]

---

[680] Po aty, f. 96

[681] Arben Puto, *Shqipëria Politike* 1912-1939, f. 292

[682] Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare pas Luftës së Parë Botërore,* f. 275

[683] Po aty, f. 338

[684] Po aty, f. 338

[685] Arben Puto, *E drejta Ndërkombëtare Publike*, f. 470

[686] Piro Tako, *Fan Noli në Fushën Politike dhe Publicistike,* f. 100

Në memorandumin e paraqitur nga Fan Noli ishte argumentuar fakti se Shqipëria nuk ishte një shtet i ri i krijuar pas lufte, pra ajo ekzistonte si shtet i pavarur që më 1913 me vendim të Konferencës së Ambasadorve. Aktet kryesore që njihnin pavarësinë e Shqipërisë dhe që caktonin kufijtë e saj ishin ato të viteve 1913-1914. Asnjëra prej Fuqive nënshkruese nuk i kishte denoncuar ato. Sipas së drejtës ndërkombëtare ato ishin gjithnjë në fuqi. Përveç njohjes së shtetit shqiptar si shtet i pavarur, u shtua edhe njohja e qeverisë shqiptare me Princ Vidin si princ të Shqipërisë. Fuqitë e Mëdha, që e kishin caktuar vetë Vidin si princ të Shqipërisë, e njohën de jure qeverinë e tij. Në Durrës, u dërguan përfaqësues diplomatikë nga shtete të ndryshme, ndërsa edhe Shqipëria dërgoi disa përfaqësues përjashta[687].

Gjatë luftës, Shqipëria e porsalindur u përfshi nga valët e luftës dhe territor i saj u bë arenë e forcave ndërluftuese. Pra periudha e luftës cilësohej si një shkelje e akteve të 1913-1914-s dhe jo si një anullim i tyre. Periudha e luftës nuk provoi se shteti shqiptar nuk ishte i aftë të ekzistonte, por ai pësoi fatin që pësuan edhe disa shtete të tjera. Tani, pas lufte Shqipëria u rimëkëmb, u riorganizua dhe nxori nga gjiri i saj një qeveri kombëtare që është zotëruese sovrane e gati të gjithë territorit që iu caktua në 1913. [688]Konkluzioni që rridhte së këtejmi ishte se shteti shqiptar ishte njohur që përpara luftës, se statusi i tij si shtet i pavarur nuk ishte ndryshuar nga ngjarjet e luftës[689].

Problemi tjetër kishte të bënte me njohjen e qeverisë shqiptare, me pozitën e saj në arenën ndërkombëtare. Në memorandum mbrohej teza se qeveria shqiptare i kishte të gjitha atributet për t'u konsideruar si qeveri *de jure* dhe *de fakto* e shtetit shqiptar[690]. Ajo plotësonte dy kushte kryesore: në pikëpamjen e brendshme kishte dalë nga një asamble kombëtarë, shprehje e vullnetit të gjithë popullit dhe e shtrinte pushtetin e saj mbi shumicën e territorit të 1913; në pikëpamje të jashtme, kishte dalë si palë edhe në arenën ndërkombëtare, duke lidhur marrëveshje me Italinë (marrëveshja e 2 gushtit 1920) me Greqinë (Protokolli i 28 majit 1920) dhe duke hyrë në bisedime me Jugosllavinë për rregullimin e disa problemeve kufitare mbi bazën e akteve të 1913-ës. Së këtejmi, arihej në përfundimin se Italia, Greqia dhe Jugosllavia e kanë njohur *de fakto* qeverinë shqiptare[691]. Pyetjes së nënkomisionit të posaçëm për kandidaturën e Shqipërisë se "a është njohur qeveria juaj *de jure, de fakto* dhe nga kush? " Noli i përgjigjet: "Qeveria e Shqipërisë u njoh *de jure* më 1914 nga 6 Fuqitë e Mëdha të Evropës, si dhe nga Rumania, Bullgaria dhe Greqia, dhe të gjitha këto dërguan në Durrës përfaqësues diplomatikë të akredituar rregullisht. Qeveria e tanishme e Shqipërisë ka hyrë në marrëdhënie me Italinë, Serbinë dhe Greqinë dhe ka lidhur me to marrëveshje, të cilat përbëjnë një njohje *de fakto*. Italia ka tani një ministër fuqiplotë në Tiranë, kryeqyteti i përkohshëm i Shqipërisë". [692]

[687] Arben Puto*, Shqipëria Politike,* f. 287
[688] Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare pas Luftës së Parë Botërore*, f. 268
[689] Arben Puto, *Historia Diplomatike,* f. 340
[690] Bajram Xhafa, *Historia e Shqipërisë 1912-1939*, f. 226
[691] Po aty, f. 227
[692] Arben Puto, *E Drejta Publike Ndërkombëtare*, F. 472

Kërkesa e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve ndeshi në kundërshtimin e Jugosllavisë, Greqisë, Francës e cila mbante anën e këtyre dy vendeve dhe të Italisë. Megjithatë, mbështetja për çështjen shqiptare erdhi nga përfaqësuesi i Afrikës së Jugut Lordi Robert Cecill i cili ndikohej nga Herberti, ashtu dhe nga përfaqësuesi i Kanadasë, që padyshim vepronin sipas udhëzimeve të Britanisë së Madhe. Noli bëri një mbrojtje të shkëlqyer kauzës shqiptare, duke argumentuar të drejtat e popullit shqiptar. Si përfundim, Lidhja e Kombeve e pranoi Shqipërinë më 17 dhjetor 1920 me 35 vota pro dhe 7 abstenime. Noli në fjalën e mbajtur në Asamblenë e Lidhjes shpreh entuziazmin dhe gëzimin e tij për futjen e Shqipërisë në këtë organizatë ndërkombëtare.

Ai i drejtohet Lidhjes me këto fjalë: " Një herë në Dhomën e Komunave Edmund Burke thirri: Mjerisht ka kaluar koha e kalorësisë. Ajo që ndodhi dje këtu, kur Shqipëria u pranua në Lidhjen e Kombeve, më bind se Burke e kishte gabim. Kur pashë dje kampionë nga të gjitha anët e botës të viheshin në mbrojtje të asaj fëmije të braktisur të Europës, kampionë nga Arika dhe Amerika; nga Azia dhe Europa; kur pashë fqinjët tanë, fqinjë si të gjithë fqinjët europianë, të jepnin bujarisht votën në favorin tonë, me sytë e mbushur me lot dhe lëmshin që po më zinte fytin, ndjeva sikur po thërrisja me gjithë fuqinë e mushkërive: Jo, koha e kalorsisë nuk ka kaluar"[693].

Jehona e pranimit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve u shpreh si në shtypin e brendshëm ashtu dhe ndërkombëtar. Ajo çfarë spikat është përshkrimi me nota superlative për figurën e Nolit dhe specifikisht për fjalimet e mbajtura prej tij. Në opinionin shqiptar suksesi ishte i lidhur drejtpërdrejt me emrin e Nolit. Vetë Noli e ka quajtur atë"një sukses të shkëlqyer", "suksesi më i madh që ka patur në karrieren e tij diplomatike"[694]. Jehona e fjalimeve të tij e bëri atë një emër të njohur në Lidhjen e Kombeve, në qarqet e jashtme në përgjithësi. Ai spikati me oratorinë e tij të jashtëzakonshme, ku ndërthuret fjala e lirë me origjinalitetin e mendimit dhe ndjenjën shërbimit ndaj atdheut të tij. Falë oratorisë së tij u bë e dukshme epërsia ndaj delegatëve të shteteve fqinjë. Kjo shprehet dhe në shtypin e huaj. Kështu në një shkrim të botuar në gazetën angleze "Mançester Gardian" thuhet se: " Noli është një njeri, që do të ishte i shënuar në çdo vend; ndër delegatët e ardhur në Lidhjen e Kombeve nga shtetet e Ballkanit, ai ishte fare lehtë i pari"[695]. Ai paraqitet si një diplomat plot takt, që bëri një përshtypje të madhe në Gjenevë me njohuritë e tij të gjëra mbi botën dhe politikën ndërkombëtare. Ndërsa në shtypin e brendshëm M. Gramenoja u shpreh kështu: "Noli për të prapmen herë i dha Shqipërisë fitoren më të madhe në Lidhjen e Kombeve"[696]. Në fakt Noli i kushtoi një vëmendje të veçantë propagandës së çështjes së Shqipërisë në shtyp duke e konsideruar si një armë të vlefshme për mbrojtjen e kombit tonë të vogël duke e ndërkombëtarizuar çështjen shqiptare. Si me lajme të shtypit ashtu dhe me intervistat e dhëna, ai shprehet se është munduar për të fituar

[693] Robert C. Austin, *Shtegu i Pashkelur i Fan Nolit*, f. 51

[694] Arben Puto, *Demokracia e rrethuar. Qeveria e Fan Nolit në marrëdhëniet e jashtme*, f. 210

[695] Po aty, f. 211

[696] Gazeta "*Koha*", 1 janar 1921

mendimin botëror, madje shume prej miqve të tij ishin shprehur se shtypi ishte i fituar prej tyre[697].

Menjëherë pas pranimit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, Noli u ngarkua me zgjidhjen e problemit të kufijve shtetërorë shqiptar. Kjo nevojë ishte e rritur nga politika armiqësore që po ndiqnin shtetet fqinje ballkanike, Jugosllavia dhe Greqia. Qeveria shqiptare ndërmori në maj të 1921 një nismë të dyanshme diplomatike duke dërguar delegacione të veçanta në Athinë e në Beograd për të arritur një marrëveshje me shtetet përkatëse. Kur u pa se divergjencat me dy fqinjët ballkanikë nuk po sheshoheshin me anën e bisedimeve dypalëshe, qeveria e Tiranës trokiti në dyert e Lidhjes së Kombeve për të kërkuar ndihmën e saj për zgjidhjen e këtij konflikti[698]. Në kërkesën e paraqitur u kërkua rinjohja e kufijve të vitit 1913 dhe i kërkohej Lidhjes së Kombeve të ndikonte në tërheqjen nga trojet shqiptare të ushtrisë jugosllave dhe largimin e forcave greke nga 26 fshatrat në kufirin greko-shqiptar[699]. Duke qenë se Jugosllavia dhe Greqia përveç se kishin pushtuar padrejtësisht territore shqiptare dhe në të njejtën kohë përpiqeshin te tregonin paaftësinë e qeverisë shqiptare për t'u vetëqeverisur, misioni i Nolit u degëzua në dy pjesë, në mbrojtjen e pavarsisë së vendit dhe të kufijve të tij. Fan Noli parashtroi në emër të qeverisë shqiptare politikën pushtuese të Jugosllavisë ndaj territoreve shqiptare dhe rrjedhojat e rënda të saj për popullin shqiptar[700]. Në fjalimin e mbajtur Noli shprehet se pushtimi i Jugosllavisë ka sjellë çrregullime në jetën politike dhe ekonomike të shtetit të ri shqiptar. Sipas tij qeveria shqiptare ka bërë disa herë përpjekje miqësore pranë qeverisë jugosllave për zbrazjen e këtyre territoreve të pushtuara padrejtësisht. Në të njejtën kohë ai ekspozon dhe situatën e Shqipërisë së jugut ku trupat greke mbajnë të pushtuar një pjesë të territorit të krahinës së Korçës dhe shprehet me shqetësim për rrezikun që i kanoset vendit. [701] Nga fryma e përgjithshme e fjalimit të mbajtur duket sikur Noli ishte më i ashpër në qëndrimet e tij ndaj fqinjëve duke pasur si qëllim kryesor mbrojtjen e kufijve të Shqipërisë të viteve 1913. Pavarsisht këmbënguljes që bëri Noli që çështja e kufijve të merrte zgjidhje nga Lidhja e Kombeve, diskutimi i kufijve të Shqipërisë u spostua nga Lidhja e Kombeve tek Konferenca e Ambasadorëve.

Një tjetër çështje që Shqipërisë iu desh të përballej fuqishëm në Lidhjen e Kombeve, ishte ajo e minoriteteve. Në sesionin e 15 dhjetorit 1920, Asambleja e Lidhjes së Kombeve, u kishte kërkuar shteteve kaukaziane dhe ballkanike, midis të cilave dhe Shqipërisë, të cilat pretendonin të bëheshin anëtare të saj, të merrnin masa të domosdoshme, që në frymën e traktateve të Lidhjes së Kombeve mbi minoritetet të rregullonin legjislacionin e brendshëm[702]. Qeveria shqiptare u tregua menjëherë e

[697] Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme, viti 1921, dosja 41, fl. 209

[698] Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Historia e Popullit Shqiptar III*, f. 172

[699] Po aty, f. 127

[700] Paskal Milo*, Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927*, f. 131

[701] AQSH. Fondi 251, dosja 149, viti 1921, Fjala e Fan Nolit në Këshillin e Lidhjes së Kombeve, 25 qershor 1921

[702] Ledia Dushku, "Debatet shqiptaro-greke dhe Lidhja e Kombeve (1920-1922), në: *Studime Historike*, 3-4, Tiranë 2006, f. 76

gatshme ta pranonte këtë kusht. Por qeverisë shqiptare nuk iu kërkua vetëm rregullimi i legjislacionit të brendshëm, por dhe nënshkrimi i një deklarate për mbrojtjen e minoriteteve para Lidhjes së Kombeve. Si rregull, imponimi i këtyre detyrimeve u bëhej shteteve që ishin krijuar nga Sistemi i Versajës ose shteteve që në përfundim të Luftës së Parë Botërore e kishin zgjeruar dukshëm territorin e tyre[703]. Shteti shqiptar nuk hynte në asnjërën nga këto kategori. Por, detyrimet e veçanta të Shqipërisë në lidhje me minoritetet rridhnin nga një rezolutë e Asamblesë së Lidhjes së Kombeve[704]. Dhimitër Berati në librin e tij *Qëllimi dhe organizimi i Lidhjes së Kombeve*, shprehet se nënshkrimi i një deklarate për mbrojtjen e minoriteteve nuk ishte kusht për pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, por "Shqipëria i plotësoi pa asnjë kundërshtim gjithë ato të drejta që vetë Lidhja e Kombeve i ka gjetur të arsyeshme"[705]. Ky konstatim lë të nënkuptohet se nënshkrimi i kësaj deklarate për mbrojtjen e minoriteteve ishte lënë në vullnetin e qeverisë shqiptare.

Në të vërtetë, Deklarata u nënshkrua më 2 tetor 1921, pra, gati 10 muaj më vonë se Shqipëria të pranohej në Lidhjen e Kombeve. Kështu, juristi dhe diplomati Dh. Berati pohon me të drejtë se nënshkrimi i Deklaratës nuk ishte kusht për pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, por, nga ana tjetër, nuk mendoj se ishte thjesht dhe vetëm akt i një vullneti të mirë nga ana e qeverisë shqiptare. Gjatë zhvillimit të Konferencës së Paqes, delegacionit shqiptar që përfaqësonte qeverinë e Durrësit, i ishte dashur disa herë të theksonte vullnetin e qeverisë shqiptare për t'u garantuar minoriteteve të gjitha të drejtat që u takonin.

Edhe nëse kjo kërkesë e Lidhjes së Kombeve të mos kishte karakter detyrues, Shqipëria ishte e detyruar ta nënshkruante një deklaratë për mbrojtjen e minoriteteve dhe kjo për shumë arsye. *Së pari*, një gjë të tillë e diktonte situata ndërkombëtare, në të cilën gjendej shteti shqiptar. Me pranimin në Lidhjen e Kombeve, vërtet Shqipërisë i sigurohej njohje kolektive e ekzistencës së saj si shtet i pavarur, por qeveria shqiptare nuk ishte njohur ende ndërkombëtarisht. Për më tepër, në Konferencën e Ambasadorëve pritej të thuhej fjala e fundit edhe për kufijtë e shtetit shqiptar. Në këtë situatë, shtetit shqiptar i duhej të dëshmonte bindje të plotë dhe luajalitet maksimal ndaj legjislacionit të Lidhjes, duke përfshirë dhe atë për mbrojtjen e minoriteteve. Një qëndrim i tillë në mbështetje të standarteve të Lidhjes së Kombeve për minoritetet do të krijonte siguri dhe do të ndihmonte në rikonfirmimin e kufijve të shtetit shqiptar të vitit 1913. Në fund të fundit, përfaqësuesit shqiptarë në Konferencën e Paqes, disa herë ishin shprehur se ishin të gatshëm t'u akordonin minoriteteve të gjitha të drejtat që shtetet e qytetëruara u japin atyre. Tashmë ishte kohë të ndërmerreshin disa angazhime konkrete.

---

[703] Për më tepër në lidhje me këtë shiko: Michael Burns, "Disturbed Spirit: Minority Rights and Neë Ëorld Order, 1919 and the 1990s" në *Neë Eurpean Order 1919 and 1991*, edited by Samuel F. ells Jr. and Paula Bailey Smith, Ëashington: Ëoodroë Ëilson International Center, 1996, f. 46

[704] Ledia Dushku, "Debatet shqiptaro-greke. . . ", f. 76

[705] Dhimitër Berati, *Qëllimi dhe Organizimi i Lidhjes së Kombeve*, Tiranë: 1931, f. 16

Së dyti, nënshkrimi i deklaratës së Lidhjes së Kombeve për mbrojtjen e minoriteteve ishte një hap përpara në krahasim me regjimin e kapitulacioneve. Në ndryshim nga ky regjim, deklarata parashikonte që të drejtat e minoriteteve në Shqipëri të siguroheshin nga shteti shqiptar dhe të garantoheshin nga organizmat e Lidhjes së Kombeve. Statuti i Lidhjes së Kombeve nuk lejonte asnjë shtet që nuk ishte anëtar i këshillit të saj të ngrinte në këshill çështje që lidheshin me minoritetet. Kjo pengonte ndërhyrjen e shteteve fqinje të Shqipërisë, të cilat, në mbrojtje të minoriteteve, vazhdonin politikën e tyre irredentiste në territorin shqiptar.

Më 2 tetor 1921, delegati i qeverisë shqiptare pranë Lidhjes së Kombeve, Fan Noli nënshkroi Deklaratën për mbrojtjen e minoriteteve. Ai deklaroi se qeveria e tij "do të merrte parasysh çdo rekomandim që mund t'i bëhej për minoritetet nga Lidhja e Kombeve"[706]. Para nënshkrimit të kësaj deklarate, qeveria greke i kërkoi Lidhjes së Kombeve të detyronte qeverinë shqiptare të pranonte të drejtën e Greqisë për të folur në forumet e Lidhjes në emër të minoritetit grek në Shqipëri, kërkesë kjo që nuk u pranua[707]. Një atribut i tillë në bazë të deklaratës i takonte vetëm anëtarëve të Këshillit të Lidhjes së Kombeve. Në nenin e parë të Deklaratës thuhej se dispozitat e kësaj deklarate do të njihen si ligj bazë në Shqipëri[708].

Deklarata e 2 tetorit 1921 parashikonte që qeveria shqiptare t'u njihte minoriteteve që jetonin në Shqipëri të drejta të barabarta "me ligj dhe në fakt" me të gjithë shtetasit e tjerë. Ajo gjithashtu përmbante dispozita për garantimin e së drejtës së minoriteteve për të përdorur dhe mësuar gjuhën e tyre amtare, lirinë e besimit dhe të ndërgjegjes si dhe mbajtjen e shoqatave të tyre të bamirësisë[709]. Në deklaratë parashikohej, gjithashtu, që qeveria shqiptare brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga nënshkrimi i deklaratës do t'i paraqiste Këshillit të Lidhjes së Kombeve të dhëna të detajuara mbi komunitetet fetare, kishat, manastiret, shkollat, shoqatat e bamirësisë të minoriteteve të racës, të fesë dhe të gjuhës[710]. Duke qenë se çështjet në lidhje me pakicat rregulloheshin me këtë Deklaratë, e cila si akt ndërkombëtar kishte përparësi ndaj atyre kombëtare, në Statutet themeltare si të Republikës Shqiptare, ashtu dhe të Monarkisë Shqiptare nuk u përfshinë norma specifike për minoritetet[711], gjë që do të thoshte që çështjet që lidheshin me statusin e minoriteteve rregulloheshin në bazë të parimeve të Deklaratës.

Në një kohë kur shtetet fqinje ushtronin trysni mbi qeveritë shqiptare për të siguruar të drejta maksimale për minoritetet e tyre në Shqipëri, popullsisë shqiptare në shtetet fqinje nuk i ishin garantuar as të drejtat minimale të jetës dhe të pronës. Noli në fjalimin e mbajtur përpara Këshillit të Lidhjes bën një paralelizëm të trajtimit të

[706] Po aty, f. 18
[707] Po aty
[708] Cour permanente de Justice Internationale*, École Minoritaire en Albanie,* documents transmis par le Secretaire General de la Société des Nations, janvier 1935, f. 11
[709] Po aty*,* f. 13
[710] Po aty.
[711] Luan Omari, "Kushtetuta e Shqipërisë dhe pakicat kombëtare", në: *Tribuna Juridike*, Nr. 40 (1), 2003, f. 8

minoriteteve në Shqipëri dhe shqiptarëve të mbetur jashte kufijve duke u shprehur se shqiptarëve në Jugosllavi dhe në Greqi nuk u lejohej hapja e shkollave në gjuhën shqipe ndërsa minoritetet e tyre ne Shqipëri e gëzonin këtë të drejtë. [712] Në këto kushte, minoritetet u bënë shpesh objekt diskutimi dhe fërkimesh në marrëdhëniet e shtetit shqiptar me qeveritë e shteteve fqinje. Kjo ka qenë veçanërisht më e theksuar gjatë viteve 1920-1924 kur çështja e kufijve shqiptarë nuk ishte përfunduar plotësisht dhe nuk ishin vendosur ende marrëdhëniet diplomatike mes Shqipërisë dhe fqinjëve ballkanikë.

Si konkluzion, pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve u realizua me përkrahjen e faktorit të jashtëm, me mbështetjen në mënyrë të fuqishme të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe gjithë popullit të thjeshtë, por një rol të rëndësishëm ka dhe figura e Fan Nolit, kontributi i të cilit në çështjen shqiptare të asaj kohe ka qënë i jashtëzakonshëm.

Për sa i përket minoriteteve, historia e shtetit shqiptar në periudhën midis dy Luftërave do të dëshmojë se vetëm vullneti i qeverisë shqiptare për të garantuar të drejtat e minoriteteve nuk do të mjaftonte. Në jo pak raste, shtetet fqinjë e shfrytëzuan vullnetin pozitiv të shtetit shqiptar ndaj minoriteteve, por dhe dobësinë e tij si shtet i ri dhe i pakonsoliduar, për të krijuar vatra të politikës së tyre antishqiptare.

[712] AQSH. Fondi 251, dosja 149, viti 1921, Fjala e Fan Nolit në Këshillin e Lidhjes së Kombeve, 25 qershor 1921

ETLEVA BRESHANI NITA

QASJE DHE INTERPRETIME PËR FIGURËN E FAN S. NOLIT DHE "REVOLUCIONIN E QERSHORIT" NË TEKSTET SHKOLLORE PARA DHE PAS VITEVE '90

Fan S. Noli është pa dyshim një ndër personalitetet më të shquara të historisë kombëtare shqiptare. E tërë veprimtaria e tij si, publicist demokrat, orator si njohës i mirë i fjalës së shkruar e të folur shqipe, politikan me një potencial të fuqishëm, iu kushtua jo vetëm mbrojtjes së interesave kombëtare por ashtu edhe luftës për ndërtimin e demokracisë së shtetin të ri shqiptar. E tërë veprimtaria e tij, i bëri ballë kohës dhe mbeti e dokumentuar edhe në historiografinë e sistemit komunist ashtu si edhe sot si një nga personalitetet më të shënuara të historisë. Noli është përcaktuar si protagonist kryesor i një ndërmarrje të rëndësishme historike që "*paralajmëroi falimentimin e një rendi me mbeturina të forta mesjetare*[713]" dhe bëri përpjekje për ndërtimin e shtetit demokratik. Gjatë viteve të sistemit komunist trajtimi dhe interpretimi i figurës së Fan S. Nolit dhe "Revolucionit të Qershorit", siç jemi mësuar ta quajmë, u bë në kornizat e këtij sistemi. Politizimi dhe trajtimi i njëanshëm i personalitetit të Nolit dhe "Revolucionit të Qershorit" karakterizonte tekstet e historisë kombëtare gjatë viteve '45-'90. Tekstet e pas viteve '90 synuan që historia të rikonceptohej, në mënyrë objektive e shkencore të ngjarjeve, të proceseve e të personaliteteve në mënyrë që të çlirohej nga politizimi dhe njëanshmëria.

Lëvizja e Qershorit zë një vend shumë të rëndësishëm në historinë e popullit shqiptar. Qeveria e dalë prej tij dhe programi i saj janë përpjekjet e para për ndërtimin e demokracisë shqiptare. Në **tekstet e para viteve '90** kjo lëvizje do të trajtohet si një revolucion i cili drejtohej në dy fronte "*feudalizmit në jetën e brendëshme dhe imperializmit në arenën ndërkombëtare"*[714] Nga ky "revolucion" fshatarësia shqiptare dhe populli i thjeshtë duhet të mësonte se fitorja ndaj klasës së pasur bëhej me anën e luftës dhe mund të fitohej në këtë luftë ashtu siç ndodhi në qershor të 1924. Ky revolucion në fakt u përdor nga regjimi komunist sepse nëpërmjet tij do të justifikonte luftën klasore. Gjithashtu revolucioni do të trajtohet si nismëtar i ideve komuniste dhe do të lartësohet si një revolucion i madh, sepse me të hidhen idetë marksiste. Sipas historiografisë së regjimit komunist në tekstet shkollore thuhet se: "*Pa revolucionin e 1924-s nuk do të mund të kuptohej evolucioni i mëtejshëm i Shqipërisë bashkëkohore ku Lufta e Madhe Nacionalçlirimtare dhe Revolucioni Populloor bënë sintezën e përpjekjeve shekullore dhe hapën një epokë të re në historinë shqiptare-epokën e shoqërisë socialiste.* [715]

[713] Arben Puto "Demokracia e rrethuar", viti i botimit prill 1990, fq-258
[714] Po aty, fq-255
[715] Po aty, fq-256

Lëvizja e Qershorit është e lidhur ngushtësisht me figurën e Fan Nolit. Me qeverinë e formuar prej tij ai vuri në jetë një program që kishte si qëllim krijimin e një shteti demokratik. **Historiografia e regjimit komunist** u përpoq të justifikonte dhunën klasore duke lartësuar Revolucionin e Qershorit. "*lëvizja punëtore në vendin tonë merr një hov të ri dhe duke u mbështetur në këtë përvojë revolucionare të vyer*"[716]Veprimtaria e mëtejshme e Nolit tregoi se ai nuk ishte në parim shumë dakort në përdorimin e dhunës një nga shprehjet e tij është "*Nga kërcënimi i jashtëm, lirinë duhet ta mbrosh përmes forcës së armëve dhe trimërisë, kurse nga rreziku i brendshëm me forcën e shpirtit dhe guximin qytetar, të cilët qëndrojnë më lart se forca e armëve" [717]* Qëndrimi i Nolit ndaj dhunës për rrëzimin e pushtetit dhe daljes në mbrojtje të hapur ndaj fshatarësisë dhe klasës punëtore bënë që bashkohësit e tij ta përcaktonin atë si "Peshkopi i Kuq" ose "Bolsheviku i rrezikshëm" Veprimtaria e mëvonshme e Nolit tregoi se ai ishte mbështetës i demokracisë dhe të drejtave themelore të njeriut.

Si u trajtua ky revolucion në tekstet shkollore para '90 dhe pas saj.

Në vitet 1921-1922 çështja e formës së regjimit të shtetit, dhe hartimi i statutit themeltar kishin mbetur të pazgjidhura. Diskutimi i projektligjit për formën e regjimit u bë i fortë ndërmjet forcave opozitare njëra e kryesuar nga Ahmet Zogu që mbështeste politikën e qeverisë që kryesohej nga ai vetë dhe grupimi opozitar i kryesuar nga F. Noli që mbante një qëndrim kritik ndaj qeverisë. Fan Noli dhe intelektualë të tjerë të arsimuar në vendet e Europës Perëndimore që përbënin grupin opozitar, të gjithë intelektualë me kulturë perëndimore, dëshironin ta shihnin Shqipërinë drejt rrugës së zhvillimit të qytetërimit europian duke çuar më tej arritjet në fushën e demokratizimit. Në **historiografinë e viteve të regjimit komunist** mbahet një qëndrim i hapur në favor të grupimit opozitar të drejtuar nga Fan Nolin, duke e cilësuar si forcën më demokratike, e cila mbështetej nga populli, e vendosur përballë grupimit "raksionar" çifligar të përfaqësuar nga qeveria e Ahmet Zogu. Tekstet e **Historisë së Shqipërisë së vitit 1964 dhe1984** janë të mbushura me sharje, me sulme ndaj grupimit qeveritar të drejtuar nga Ahmet Zogu.

Asambleja i zhvilloi punimet në një gjendje politike të nderë kur lufta politike ndërmjet forcave po ashpërsohej. Opozita me në krye Fan Nolin, Luigj Gurakuqin, Stavro Vinjaun etj., doli me thirrjen për spastrimin me themel të administratës, për reformat të thella politike dhe ekonomike. Ajo e quajti të paligjshme qeverinë e Zogut, që sipas ligjeve duhej të jepte dorëheqjen, dhe filloi luftën për rrëzimin e saj. Në tekstin e **Historisë së Shqipërisë 1964** dhe **1984** i jepet më tepër vëmendje situatës ekonomike duke theksuar se lufta politike kundër "reaksionit çifligar" ishte acaruar në rrethanat e keqësimit të mëtejshëm të gjendjes ekonomike të masave, gjë që e thelloi krizën revolucionare.

Në këto tekste shkollore theksohet se shkaku kryesor që nxiti Kryengritjen e Qershorit ishte gjendja e mjeruar e fshatarësisë Ky revolucion përbënte *"shprehjen më*

[716] Po aty

[717] Nina Smirnova, Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit të XX, fq -139

të fuqishme të rritjes së ndërgjegjes politike dhe të vetëveprimit të masave popullore në periudhën midis dy luftrave. [718]". Pas zgjedhjes së Asamblesë Kushtetuese, Zogu nuk u largua nga qeveria. Fushata e zgjedhjeve i kishte dhënë lëvizjes një hov të tillë, që nuk mund të mbahej. Në tekst shkruhet "*Populli në rrezik të vdiste urije, kërkonte me këmbëngulje bukë dhe heqjen e taksës mbi drithin e jashtëm. Fshatarët e shtuan luftën kundër çifligarëve për tu marrë atyre tokat.* " Historiografia e regjimit komunist e krahason kryengritjen e qershorit me kryengritjen fshatare të Shqipërisë së Mesme të drejtuar nga Haxhi Qamili. Në tekst shkruhet se: "*Gazeta "Shqiptari i Amerikës" kërkonte nga asambleja që të zgjidhej çështja agrare; për ndryshe, shkruante ajo,* "*mund pëlcasë mëria e popullit përsëri, sikundër plasi në kohën e Haxhi Qamilit, kur rebelimi mori ngjyrën e klasës"*[719] Duke e ndier rrezikun, çifligarët morën menjëherë masat për të zotëruar gjendjen. Në mars u formua qeveria e re me përfaqësues të çifligarëve të mëdhenj të Shqipërisë dhe "*agjent të imperializmit*. "[720] Nga analiza që i bëhet Revolucionit të Qershorit duket qartë se teksti synon të bind lexuesin se armiqtë e betuar të popullit ishin feudalët të pasurit dhe fuqitë perëndimore të cilat kishin shkelur pavarësinë e Shqipërisë.

Në kushtet e ashpërsimit politik në asamble, elemente radikale antizogiste kryen atentatin ndaj Zogut më 23 shkurt 1924. Pas kësaj u formua qeveria e Shefqet Vërlacit, pronar i madh tokash, me bindje konservatore, që nuk u prit mirë nga opozita dhe opinion publik përparimtar. Formimi i qeverisë së çifligarëve të mëdhenj e drejtuar nga Shefqet Vërlaci e thelloi edhe më shumë krizën politike. Metodat terroriste për të shuar lëvizjen, jo vetëm që dështuan, por edhe e acaruan më tepër gjendjen politike. Forcat demokratike po shtrëngonin radhët. Lufta e opozitës parlamentare po bëhej gjithnjë edhe më e ashpër. Por meqënëse përbërja e asamblesë nuk siguronte zgjidhjen e detyrave demokratike filluan të mendonin për kryengritjen e armatosur. Pritej vetëm rasti për shpërthimin e kryengritjes. Situata tensionohet më shumë dhe arrin kulmin, kur më 20 prill, mbas një atentati, Avni Rustemi kryetar i shoqërisë "Bashkimi" dhe aktivist i shquar demokrat vdes. Avni Rustemi u shndërrua në simbol të atdhetarisë dhe të demokracisë. Vrasja e tij do të shërbejë si një shkëndijë për shpërthimin e Kryengritjes së Qershorit.

Përgatitja dhe shpërthimi i kryengritjes së armatosur.

Për vrasjen e Avni Rustemit opozita akuzoi qeverinë dhe kundërshtoi të marrë pjesë në punimet e Asamblesë Kombëtare. Në popull vrasja u kuptua si një veprim me karakter politik.

Nga të gjitha anët e vendit u bënë protesta, mitingje dhe demostrata antiqeveritare. Varrimi i Avni Rustemit u vendos të bëhej në Vlorë në qytetin e Pavarësisë, vetë Fan Noli ishte shprehur më se një herë publikisht, se: "*qyteti më i përshtatshëm për*

[718] Arben Puto, "Demokracia e Rrethuar", viti i botimit 1990, fq-3
[719] Historia e Shqipërisë, viti 1964, fq-212
[720] Po aty

mbledhjen e Asamblesë do të ishte Vlora, si simbol i 28 Nëntorit"[721]. Një maji 1924 u shndërrua në një manifestim të madh, ku morën pjesë 10 mijë qytetarë e fshatarë të krahinës së Vlorës. Pas varrimit, Vlora u bë qendra e përgatitjes së kryengritjes. Për drejtimin e saj, në Vlorë u formua komiteti administrativ me Fan Nolin në krye.

Kryengritja filloi më 24 maj me sulmin e Bajram Currit. Me të u bashkuan edhe garnizonet ushtarake të Shkodrës, të Përmetit, kleri katolik i Shkodrës etj. Kryengritja u mbështet nga forcat demokratike në vend dhe shtresa të gjëra popullore.

Sukseset luftarake të çetave të Bajram Currit në verilindje dhe të kryengritësve në veri dhe në jug, bënë që qeveria e Shefqet Vërlacit të japë dorëheqjen. Krijohet qeveria e Iljaz Vrionit po pa sukses. Më 10 qershor kryengritësit hynë në Tiranë. A. Zogu dhe qeveritarë të tjerë largohen në Jugosllavi, Itali dhe Greqi.

Në **tekstet e historisë para viteve '90** historiografët përpiqen t'i japin një rëndësi e veçantë lidhjes së "Revolucionit të Qershorit" me lëvizjet e tjera komuniste në Ballkan në to thuhet "*Lajmi rreth ngjarjeve në Shqipëri u prit me simpati nga punonjësit e vendeve europiane. Presidiumi i Federatës Komuniste Ballkanike u bëri thirrje punëtorëve dhe fshatarëve të ballkanit dhe të Italisë për të ndaluar çdo ndërhyrje të këtyre vendeve në punët e brendëshme të Shqipërisë. Punëtorë dhe fshatarë të Shqipërisë, -thuhej në thirrje; kujdesuni që prangat të mos ua lidhin përsëri edhe më fort. Pikërisht tani ju duhet të vini të gjitha fuqitë që të siguroni fitoret tuaja shoqërore dhe politike; përndryshe do të mashtroheni dhe atëherë lufta juaj do të jetë dy herë më e madhe"*[722]

Revolucioni i Qershorit sipas **historiografisë të regjimit komunist** kishte karakter demokratiko- borgjez. Forca kryesore lëvizëse e tij ishte fshatarësia, e interesuar drejtëpërsëdrejti për t'u çliruar nga mbeturinat e shumta të rendit çifligar. Edhe pjesa më e madhe e reparteve të ushtrisë që ngritën krye kundër qeverisë shprehnin, në përgjithësi interesat e fshatarësisë dhe urrejtjen e saj kundër reaksionit çifligar. Revolucionin e drejtoi borgjezia demokrate shqiptare e cila, në krahasim me forcat e tjera të kohës-klasën punëtore e fshatarësinë, të interesuara për përparimin ekonomik dhe shoqëror të vendit, ishte më e organizuar dhe më e pjekur politikisht. Ajo u përfaqësua nga ajo pjesë e opozitës parlamentare që qëndroi në pozita antifeudale dhe veçanërisht nga inelektualë borgjezë përparimtarë si Fan Noli.

Revolucioni i Qershorit u interpretua nga historiografia e viteve të **regjimit komunist** si një ngjarje e shënuar për Shqipërinë, si një lëvizje e gjerë popullore kundër reaksionit kundër shtypjes çifligare dhe kundër depërtimit ekonomik të kapitalit të huaj. Ky revolucion sipas teksteve dhe botimeve historike në vitet të regjimit komunist u pa si një goditje ndaj synimeve imperialiste në Shqipëri e Ballkan. *"Për gjashtë muaj (qershor-dhjetor 1924) Shqipëria e vogël u kthye në një bazë të lëvizjes revolucionare në Ballkan, ku jo vetëm gjetën strehë e u mirëpritën revolucionarët e vendeve të tjera në Ballkan, por u vendosën dhe lidhjet midis tyre. Në saj të këtyre lidhjeve dhe qëndrimit pozitiv të demokratëve shqiptar kundrejt*

[721] Historia e Popullit Shqiptar, III, Akademia e Shkencave, viti i botimit 2007

[722] Historia e Shqipërisë, viti 1964, fq-213

revolucionarëve ballkanikë dhe të luftës kundër synimeve imperialiste, militantët e lëvizjes demokratike shqiptare u mikpritën në gjirin e lëvizjes demokratike shqiptare, u mirëpritën në gjirin e lëvizjes demokratike revolucionare dhe komuniste në Ballkan dhe lidhjen me Federatën Komuniste Ballkanike. "[723]

Më 18 qershor 1924 Fan Noli u bë Kryeministri i qeverisë së re demokratike e cila kishte në parim një program ambicioz reformash demokratike. Ky "revolucion" sot interpretohet si një nga përpjekjet më të rëndësishme në shkallë kombëtare për të futur Shqipërinë në rrugën e përparimit dhe të demokracisë. Kryengritja e 1924-ës kishte një përmbajtje demokratike dhe sipas **historiografisë së pas viteve '90** ishte "*vijim i revolucionit kombëtar të 1920"*[724] por me një ndryshim rrënjësor, nëse më 1920 populli shqiptar luftoi kundër pushtuesve të huaj për rifitimin e pavarësisë kombëtare më 1924 forcat demokratike u ngritën për të ç'rrënjosur mbeturinat feudale nga jeta politike dhe ekonomike-shoqërore e vendit e për demokratizimin e tij. Lëvizja demokratike e pranverës së vitit 1924 në Shqipëri ishte pjesë e lëvizjeve me të njejtën përmbajtje, të zhvilluara më parë në vendet e tjera të kontinentit europian.

Kryengritja e qershorit 1924 e organizuan dhe e drejtuan forcat demokratike, të cilat synonin ta përdornin pushtetin politik për zgjidhjen e problemeve ekonomike e shoqërore që qëndronin përpara vendit. Çështja kryesore ishte zgjidhja e situatës agrare, për të cilën ishte e interesuar fshatarësia, forca kryesore e kryengritjes. Interesat e të cilës ishin të ndryshme. Një pjesë e saj ëndërronte të bëhej pronare e një cope toke ose të zgjeronte sasinë e pakët të tokës që zotëronte. Pjesa tjetër donte të çlirohej nga detyrimet e rënda e të shumta shtetërore (nga e dhjeta e, nga taksa e xhelepit etj.) Kryengritja e Qershorit të vitit 1924 mori kështu një karakter demokratik antifeudal.

Sipas **teksteve historike të pas viteve'90** rrëzimi i qeverisë u bë pa gjakderdhje dhe nuk ishte rezultat i ndonjë lëvizjeje masive të fshatarëve dhe punëtorëve siç paraqitet në tekstet e historisë gjatë viteve të sistemit komunist. Fan Noli në fund të vitit 1925 shkruante që pas vrasjes së Avni Rustemit "*s'kish njeri që ta ndalonte kryengritjen, se ashtu sikundër është zor të fabrikohet një kryengritje pas qejfit, ashtu është edhe zor të ndalohet kryengritja e provokuar kur ndizen gjakrat"*[725]

Programi i qeverisë së Nolit.

Më 16 qershor 1924 u formua qeveria e përkohshme e kryesuar nga F. Noli, e përbërë nga Sulejman Delvina, Rexhep Shalën, Kasem Qafëzezin, Luigj Gurakuqin etj, . Më 19 qershor qeveria shpalli programin e saj. Sipas tekstit shkollor të **Historisë së Shqipërisë të vitit 2000**, trajtohet si një qeveri që doli nga revolucioni dhe që synoi "çrrënjosjen e feudalizmit" dhe vendosjen përfundimtare të demokracisë. Sipas tekstit qeveria e Nolit nuk u ndal vetëm në përmirësimin e sistemit të taksave dhe të gjendjes së bujkut por edhe në zhvillimin e arsimit, të shëndetësisë taksave etj. Pasi të kryheshin reformat e parashikuara, qeveria deklaronte se do të zhvillonte zgjedhjet e

[723] Studime historike, Viti XX, Insituti i Historisë Akademia e Shkencave, viti 1966, fq-113
[724] Historia e Popullit Shqiptar, 1912-1939, Toena;2007, fq-226
[725] Historia e Popullit Shqiptar, 1912-1939, Toena;2007, fq-227

përgjithshme parlamentare. Populli e priti me entuziazëm programin e parashtruar nga qeveria me shpresën se do ta nxirrte vendin nga prapambetja e thellë ekonomike. "*Qeveria ndërmori disa masa. Ajo garantoi liritë e shtetasve, vendosi njerëz të rinj në administratën shtetërore, bëri çarmatimin e popullsisë, balancoi buxhetin, bëri disa ndryshime në sistemin e taksave dhe u përpoq për zhvillimin e arsimit. U përgatit dhe projektligji për reformën agrare, që do të prekte vetëm tokat shtetërore*[726]

Në **tekstet shkollore para '90-s** përmenden detyrat e parashtruara nga program i qeverisë së Fan Nolit por më tepër ato përqëndrohen tek karakteri antifeudal i këtij programi. Sipas tyre detyra më e rëndësishme dhe më e ndërlikuar ishte çrrënjosja e feudalizmit nga jeta ekonomike e shoqërore e vendit dhe në radhë të parë, zgjidhja e çështjes agrare në të mirë të fshatarëve. "*Qeveria parashikonte t'u jepte gratis bujqve nga 4 hektarë tokë për familjet nga çifliqet e shtetit. Bejlerët do të punonin vetë tokën e tyre; në rast të kundërt do të shpronësoheshin... . Urrejtja e popullit kundër bejlerëve u shpreh me forcë të madhe. Qeverisë i bëheshin nga të gjitha anët kërkesa e propozime në lidhje me demokratizimin e plotë të vendit. Bujqit e shtypur të Myzeqesë, Korçës, Durrësit e Tiranës kërkonin konfiskimin e tokave të çifligarëve të mëdhenj dhe ndarjen e tyre fshatarëve. "*[727]

Lajmi për fitoren e arritur nga populli shqiptar me kryengritjen e qershorit, pati një jehonë të madhe në Europë dhe në Ballkan. Ky revolucion u mbështet nga bashkësistë demokratike të Europës. **Historia e para viteve '90** i kushtoi një rëndësi të veçantë thirrjes së Presidiumit të Federatës së komunistëve të Ballkanit dhe Partia Komuniste e Italisë drejtuar më 25 qershor 1924 punëtorëve dhe fshatarëve të shteteve të Ballkanit në të vihej në dukje rëndësia e madhe e lëvizjes mbarëpopullore në Shqipëri. Njëanshmëria e trajtimit të programit të qeverisë së dalë nga revolucioni është i qartë.

Politika e jashtme e qeverisë së Fan Nolit.

Sipas **historiografisë së sotme**, sfida kryesore që do të përballonte qeveria e Fan Nolit në politikën e jashtme të shtetit shqiptar do ishte sigurimi i burimeve ekonomike për konsolidimin e shtetit dhe zhvillimin e vendit. Qeveria e Nolit u përpoq të zhvillonte një politikë të jashtme aktive. Qeveria e Nolit i ftonte qeveritë e shteteve europiane dhe fqinje për bashkëpunim dhe marrëdhënie të mira diplomatike. Qeveria, me ministër të Jashtëm Suejman Delvinën, nuk u njoh nga shumica e vendeve europiane e veçanërisht nga Britania e Madhe dhe Jugosllavia.

Sipas **historiografisë së sotme** qëndrimi i vendeve të huaja ndaj qeverisë Noli u përcaktua jo aq nga mënyra e ardhjes së saj në fuqi, sesa nga interesat e tyre politike dhe ekonomike që mund të cënoheshin nga qeveria demokratike, e cila me programin e vet do të mbronte interesat e drejta kombëtare të Shqipërisë dhe të të gjithë shqiptarëve brenda vendit e në rrafsh ndërkombëtar[728].

Qeveria e Nolit mbajti një qëndrim thellësisht kombëtar në politikën e jashtme. Në muajt shtator- tetor 1924 Noli në krye të një delegacioni shkoi në Lidhjen e Kombeve

[726] Historia e Shqipërisë, viti 2000, fq-206

[727] Historia e Shqipërisë, viti 1964, fq-214

[728] Historia e Shqipërisë, vëllimi III Akademia e Shkencave, viti i botimit, fq- 232,

në Gjenevë. Çështja kryesore që mbrojti delegacioni shqiptar në sesionin e Lidhjes, ishte ajo e kufijve me fqinjët ballkanikë. Jugosllavia pretendonte të merrte Shën Naumin dhe Vermoshin. Në këshillin e Lidhjes së Kombeve, Fan Noli hodhi poshtë pretendimet shoviniste të qeverisë serbe-kroate sllovene dhe të asaj greke. Qeveria e Nolit mbrojti me forcë të drejtat e popullsisë çame dhe kosovare dhe mori masa për pritjen e refugjatëve të persekutuar nga qarqet shoviniste.

Noli i kushtoi një rëndësi të madhe rolit të Lidhjes së Kombeve në zgjidhjen e problemeve shqiptare. Duke besuar në të kërkoi një hua prej 100 milionë frangash, por mori përgjigje negative. Në lidhje me qëndrimin e Nolit ndaj Lidhjes së Kombeve **historiografia komuniste** e konsideroi si një "*gabim të rëndë që qeveria e Nolit mbivlerësoi Lidhjen*[729]" sepse besimi i tepruar ndaj Lidhjes e lanë të shkujdesur qeverinë ndaj përgatitjeve të sulmit në territorin jugosllav.

I vetmi vend që mbajti qëndrim pozitiv ishte Bashkimi Sovjetik. Në këto kushte në të cilat Shqipëria kishte nevojë jetike për njohje ndërkombëtare dhe nga ana tjetër nevoja ekonomike, qeveria tentoi të lidhte marrëdhënie diplomatike me BRSS. Ky veprim i qeverisë e veçanërisht Nolit pati jehonë shumë negative si jashtë vendit ashtu edhe brenda vendit. Raporte alarmuese filluan t'i vinin Ministrisë së Jashtme në Tiranë nga legatat shqiptare në Londër, Paris etj. Nën këtë presion të opinionit të përgjithshëm qeveria nuk pranoi të priste delegacionin e madh sovjetik të udhëhequr nga Arkadij Krakoveckij.

Për këtë hap të qeverisë Noli, të guximshëm për kohën, ndikoi lidhja e marrëdhënieve diplomatike me Bashkimin Sovjetik të Britanisë së Madhe, Italisë, Norvegjisë, Greqisë dhe Austrisë etj. dhe jo nga fakti që Noli ishte simpatizant i bolshevizmit. Idealet e Nolit ishin mbrojtja e çështjes kombëtare shqiptare dhe ndërtimi i një shteti demokratik. Jeta dhe veprimtaria e tij vërtetuan se qëllimi i tij ishte ndërtimi i një shteti demokratik ai në krijmtarinë e tij shprehet se "*u vu në krye të kryengritjes vetëm për të përzënë mashtruesit, kriminelët dhe mendonte tu sillte njerëzve besimin tek liria, të ndihmonte të varfërit, të shkurorëzonte të pasurit dhe tiraninë dhe jo të sundonte mbi ta. "*[730]

Sipas **teksteve para '90** qeveria e Fan Nolit u përpoq të forconte pozitat ndërkombëtare, po qeveritë e fuqive të mëdha "imperialiste" e të vendeve ballkanike mbajtën qëndrim "armiqësor" ndaj saj. Izolimi ndërkombëtar, në të cilën u vu qeveria e Nolit ishte për shkak të qëndrimit armiqësor të shteteve perendimore dhe ballkanike kundër lëvizjeve punëtore dhe demokratike. Sipas **tekstit të vitit 1964** thuhet *"Rrethanat e jashtme nuk ishin të favorëshme. Në këtë kohë lëvizja revolucionare në Europë dhe në Ballkan ishte në zbaticë dhe fuqitë imperialiste ishin hedhur në sulm kundër lëvizjes punëtore dhe demokratike. Ato nuk e pritën mirë vendosjen e regjimit demokratik në Shqipëri".* [731]

Këto kushte të jashtme jo të favorshme për qeverinë e Fan Nolit dhe për forcat demokratike në përgjithësi, së bashku me problemet e brendshme dhe kontraditat

[729] A. Puto, Demokracia e rrethuar, fq-254

[730] Nina Smirnova, Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit të XX, fq-139

[731] Historia e Shqipërisë, viti i botimit 1964, fq-215

brenda qeverisë, çuan në gjallërimin e forcave kundërshtare brenda dhe jashtë vendit, që synonin të ndërmernin shtypjen e Revolucionit.

Shtypja e Revolucionit

Qëndrimi jo dashamirës i ndërkombëtarëve ndaj qeverisë demokratike i dha kurajo Ahmet Zogut dhe përkrahësve të tij. Forcat e përmbysura shfrytëzuan edhe dobësitë e qeverisë së Nolit dhe kontraditat brenda kabinetit qeveritar. Me largimin e Fan Nolit, Luigj Gurakuqit dhe Bajram Currit për në Gjenevë për të marrë pjesë në sesionin e Lidhjes së Kombeve, ku do të shqyrtohej çështja e kufijve të Shqipërisë, anëtarët e tjerë të qeverisë u hodhën hapur kundër lëvizjes revolucionare të masave për realizimin e programit qeveritar, e cila kishte marrë hov. Ata urdhëruan të hidhej në gjyqin ushtarak, kushdo që vazhdonte të bënte agjitacion "kundër të drejtës së pronës" (është fjala për ata që kërkonin konfiskimin e tokave të çifligarëve)

Përkrahësit e reformave filluan të ndiqeshin si bolshevikë të rrezikshëm. Përveç luftës kundër lëvizjes revolucionare qeveria mori një numër vendimesh që mbronin drejtpërdrejt interesat e çifligarëv. U vendos përsëri taksa për drithin e sjellë nga jashtë dhe kjo solli nga njëra anë shtrenjtësimin e bukës dhe nga ana tjetër ua shton të ardhurat çifligarëve, që kishin depozita të mëdha drithi. Qeveria lejoi që të arratisurit jashtë shtetit të ktheheshin në Shqipëri. U morën dhe masa të tjera në dëm të interesave të njerëzve të varfër. Armën e "bolshevizmit", si mjet propagande për të luftuar demokracinë e brishtë, e trumbetuan përfaqësuesit e fuqive të huaja sidomos përfaqëuesi anglez Aires. Për rolin e tij vetë Fan Noli do të deklaronte më vonë: " *Zoti Aires arriti të bindë të gjithë ç'ishin rreth meje se reformat agrar ishin një novacion i rrezikshëm bolshevik"*[732]

Duke përfituar lëkundjet e qeverisë dhe ngathtësia e demokratëve, kundërshtarët e revolucionit u hodhën në luftë të hapur kundër lëvizjes demokratike dhe organizuan grupe të armatosura të cilët nisën terrorin kundër elementëve revolucionar. Ata shkuan edhe më tej kërkuan që qeveria të jepte dorëheqjen, po Fan Noli, që sapo ishte kthyer nga Gjeneva, deklaroi se nuk do të jepte dorëheqjen pa u mbledhur parlamenti.

Kundërshtarët e revolucionit, me të cilën u bashkuan elementë të tjerë, kërkoi me këmbëngulje që të bëheshin zgjedhjet parlamentare. Fan Noli e kundërshtoi, duke ngulur këmbë që zgjedhjet të bëheshin pas reformës agrare, e cila do t'u siguronte demokratëve mbështetjen e masës së fshatarësisë. Po duke qenë i kërcënuar nga rrethanat e vështira u detyrua të pranonte. Kështu u hap fushata e zgjedhjeve. Ngjarjet politike ndodhën në një mënyrë të tillë që nuk u arrit të zhvilloheshin as zgjedhjet.

Hovi i lëvizjes antifeudale i muajve të parë pas revolucionit kishte rënë. Në aparatin shtetëror, civil dhe ushtarak po zotëronte shthurja. Qëndrimi i ftohtë i shteteve europiane kundrejt qeverisë demokratike ndikoi për keq në opininin e gjerë publik.

Sipas Historiografisë së regjimit komunist rrëzimi i qeverisë demokratike dhe shtypja e Revolucionit të Qershorit në Shqipëri ishte rezultat i drejtpërdrejtë i ndërhyrjes të huaj i cili mori trajtën e një komploti ndërkombëtar perëndimor

[732] Historia e Popullit shqiptar, vëllimi III, Botimi Toena 2007, fq 238

Agresioni i jashtëm

Ndërhyrja kundër qeverisë demokratike në Shqipëri u krye nga Jugosllavia dhe Greqia. Greqia dhe Jugosllavia përqëndruan dhe një herë trupa të shumtë në kufi me Shqipërinë. Italia përqëndroi forca ushtarake gati për zbarkim në Siçili. SHBA dhe Franca kërkuan që Shqipëria të vihej nën kontrollin e një komisioni ndërkombëtar. Të gjitha këto u interpretuan nga historiografia komuniste si një luftë e hapur kundër shtetit shqiptar, nga njëra anë e fuqive të mëdha perëndimore dhe nga fqinjët, sipas **botimit 1984** thuhet-"*Të gjitha këto masa ishin hapat e para të fuqive imperialiste drejt ndërhyrjes së armatosur kundër shtetit shqiptar.* "

Sulmi i Zogut kundër qeverisë së Nolit u konsiderua si "*pushtim*" i Shqipërisë si nga ana e ushtrisë jugosllave ashtu dhe Zogut.

Qëndrimi i ngathët dhe oportunist i pjesëtarëve të qeverisë e çorganizoi mbrojtjen e vendit. Pasi thyen qëndresën e forcave popullore, repartet jugosllave dhe zogiste morën njërin pas tjetrit qytetet e Shqipërisë dhe më 24 dhjetor 1924 hynë në Tiranë.

Historiografia para viteve '90 përshkruan ngjarjet saktësisht por mban një qëndrim të ashpër dhe përbuzës ndaj Ahmet Zogut, kundërshtarëve politikë të Revolucionit të Qershorit, dhe Fuqive të Mëdha, në një prej teksteve *thuhet "Revolucioni i Qershorit shtypet. Në Shqipëri u vendos regjimi reaksionar i Ahmet Zogut dhe u zhduk një bazë e rëndësishme e lëvizjes çlirimtare dhe revolucionare në Ballkan"*[733]

Rëndësia e revolucionit demokratiko- borgjez të qershorit sipas historiografisë para viteve '90

Revolucioni demokratik-borgjez i qershorit dështoi, sepse atë nuk e udhëhiqte një parti politike revolucionare, e cila do ta shpinte revolucionin deri në fund, do të zgjidhte me guxim dhe vendosmëri detyrat demokratike borgjeze dhe do të mbështetej në popullin e e armatosur për të mbrojtur lirinë dhe pavarësinë e vendit nga ndërhyrja e armatosur. Ai dështoi gjithashtu sepse kundër tij u bashkuan imperialistët italianë anglezë dhe francezë, reaksioni jugosllavë dhe grek, bandat kundërrevolucionare të Zogut, bandat mercenare bjellogardiste, të cilat përmbysën qeverinë e Fan Nolit. Revolucioni i Qershorit ka rëndësi të madhe historike. Ai i mësoi popullit shqiptar se:

a) Feudalizmi nuk mund të luftohej pa luftuar njëkohësisht edhe imperializmin. Nevojën për një luftë të tillë populli e ndjeu që në ditët e para të kryengritjes, kur ndërhyrjet kërcënimet dhe presionet e imperialistëve filluan të bëheshin haptazi dhe në mënyrë sistematike.

b) Duke patur në udhëheqje partitë borgjeze, ishte e pamundur të bëhej një luftë e vendosur kundër feudalizmit. Partitë politike borgjeze me të ardhur në fuqi të frikësuara nga vrrulli revolucionar i masave, e tradhtuan revolucionin dhe bënë kompromis me bajraktarët dhe çifligarët.

c) I vetmi aleat i sinqertë dhe mik i vërtetë i popullit shqiptar ishte BS, i cili i shtriu dorën vendit tonë në kohën kur atë e kërcënonin imperialistët nga të katër anët. Në BS atdheu i dytë i revolucionarëve

[733] Historia e Shqipërisë, vëllimi III, botimi 1984, fq-306

Sipas historiografisë të viteve ’90 në tekstet shkollore.

Në tekste shkollore të viteve ‘90 “Revolucioni i Qershorit”është trajtuar me kujdes, pa paragjykime, si pjesë e historisë sonë me veçoritë dhe karakteristikat që ka patur duke u larguar nga politizimet, gjykimet dhe politizimet. Revolucioni i Qershorit në tekstet shkollore sot trajtohet si një revolucion i cili pati një rëndësi të veçantë pasi ishte përpjekja e parë në shkallë kombëtare për çrrënjosjen e mbeturinave feudale në vend dhe vendosje e demokracisë dhe ndërtimin e një shteti demokratik. Ndërsa në tekstet shkollore të pas viteve 2000, Kryengritja e Qershorit është trajtuar si kryengritje e armatosur e forcave demokratike kundër atyre konservatore. Mund të përmend këtu tekstin e shtëpisë botuese “Mediaprint”, botimin “Morava”, “Albas”, “Uegen”, “Pegi” të cilat e trajtojnë si një Lëvizje të armtosur e cila ka hyrë në histori si përpjekja e parë e armatosur për të zhdukur mbeturinat feudale brenda vendit dhe për kryerjen e reformave të shpejta me karakter perëndimor, demokratik.

FEHMI XHEMO
JONELA SPAHO

NOLI DHE LIDHJET E TIJ POLITIKE ME DEVOLLIN

I- HYRJE

Në vitin 1920, pas gjashtë vitesh lufte (1912-1918), i pasuar nga dy vite të anarkisë politike (1918-1920), patriotët shqiptarë u ballafaquan me shumë probleme ku më kryesori ishte ngritja e ndërtesës së shtetit-komb. Më shumë se fqinjët e saj, Shqipëria kishte nevojë për t'u ndërtuar si një shtet- komb me një identitet të spikatur kombëtar, në një kohë kur situata ishte, tërësisht jo në favor të saj. Axhenda më madhore për shumicën e shtetarëve shqiptarë të kohës ishte sigurimi i mbijetesës së Shqipërisë, si një shtet i pavarur dhe sigurimi i vendit të saj brenda Ballkanit të post-Versajës. Kjo nuk ishte detyrë e lehtë. Shqipëria ishte e dobët, pa aleatë, dhe me një territor të lakmuar nga fqinjët, që ishin shumë më të fuqishëm dhe me mbështetje shumë më të madhe. Ngjarjet që zhvilloheshin brenda Shqipërisë nuk krijonin arsye dhe terren për optimizëm. Kultura e saj politike ishte rudimentare dhe disa prej partive politike, personaliteteve apo grupimeve që u shfaqën, ishin të paaftë për të marrë ngarkesa dhe përgjegjësi përtej përkatësisë fetare apo krahinore. Nuk kishte asnjë marrëveshje të përgjithshme se ku dhe si do të shkonte shteti: në Lindje, duke ruajtur trashëgiminë e 500 viteve të sundimit osman, në Perëndim duke u ngritur si një shtet evropian me demokraci parlamentare apo diku në mes.

Shqipëria mbeti, në thelb, e paintegruar, e dominuar nga një klasë politike që kishte interes ruajtjen e situatës social-ekonomike dhe statusin e krijuar nën Perandorinë Osmane. Shumica dërrmuese e popullsisë, për më tepër, nuk kishte interes për procesin politik. Këto pengesa kontribuonin në mungesën e stabilitetit të brendshëm politik, i cili vuri në pikëpyetje mundësitë dhe aftësitë e Shqipërisë për vetëqeverisje, duke inkurajuar fqinjët për të përmbushur ambiciet dhe orekset e tyre, nëpërmjet copëtimit të territorit të saj. Qetësia e jashtme ishte e gënjeshtërt. Por, ajo që do të ndihmonte në procesin e ndërtimit të shtetit dhe kombit do të ishte nëse udhëheqësit politikë shqiptarë, në fillim të viteve 1920, do të ishin të angazhuar ndaj një vizioni afatgjatë për Shqipërinë. Por, kishte edhe politikanë vizionarë. Mes tyre, dy kryesorët ishin Ahmet Bej Zogu dhe Fan Stilian Noli. Konflikti në atë kohë mes aspiratave të këtyre njerëzve që ndihmuan për të përcaktuar karakterin e luftës politike, nga 1920 deri në vitin 1924, ishte midis dy lloje politikanësh: ata që e bazonin vizionin e tyre tek përvoja politike e marrë gjatë sundimit osman (si Ahmet Bej Zogu) dhe ata që nuk kishin asnjë përvojë ose e kishin fituar atë jashtë Shqipërisë(si Fan S. Noli). Në këtë kontekst, Noli nuk ishte një politikan i zakonshëm shqiptar. Para vitit 1920, ai nuk kishte qëndruar pothuajse fare në Shqipëri dhe, vizioni dhe veprimtaria e tij politike, duke qenë tërësisht perëndimore, nuk u përshtatën si duhej me psikologjinë dhe mentalitetin shqiptar të kohës. Në vitin 1921, Noli u kthye në SHBA dhe u zgjodh kryetar i Federatës "Vatra", por ndërkaq, në vitet '20 u lidh dhe ndikoi në lëvizjen

demokratike që zhvillohej në Shqipëri. Këtë do ta bënte nëpërmjet gazetës "Dielli" dhe "Shqiptari i Amerikës".

II. "BESA - BESËN", "KOMBI", "VATRA", "DIELLI", "SHQIPTARI I AMERIKËS"

Gazeta "Kombi", e cila u botua për herë të parë në vitin 1906, ishte e para gazetë shqipe në Amerikë. "Kombi" pushoi botimin më 10 janar 1909. Në këtë gazetë shkruhej se kur ajo filloi të botohej, në Amerikë kishte shtatë mijë shqiptarë. Me 6 janar 1907, në Boston u themelua shoqëria kombëtare "Besa - Besën". Gazeta "Dielli" u themelua me 15 shkurt 1909, nga shoqëria "Besa - Besën", si gazetë e përjavshme, 36 ditë pas mbylljes së gazetës "Kombi". Më 1912, gazeta filloi të botohej nga Federata "Vatra". Gjatë disa viteve "Dielli" doli dy herë në javë, tri herë në javë dhe më vonë dilte edhe çdo ditë. Autor i programit të gazetës ishte Fan Noli, njëkohësisht themelues dhe redaktor i saj, dhe do të qëndronte në këtë pozitë deri në tetor të vitit 1909, kohë kur erdhi Faik Konica në Amerikë.

"Vatra" ishte burimi kryesor i mbështetjes për Nolin, sidomos në aspektin financiar. Ajo u themelua në vitin 1911, me Faik Konicën si sekretar të përgjithshëm dhe Nolin si një nga anëtarët e saj kryesorë. Pas Luftës së Parë Botërore, "Vatra" dhe komuniteti shqiptaro-amerikan, në tërësi, kanë luajtur një rol jetik në zhvillimet politike shqiptare, në mbështetje për një Shqipëri të pavarur dhe sovrane. "Vatra" ka vepruar, gjithashtu, si një qeveri në mërgim për Shqipërinë gjatë luftës.

Më 4 korrik 1918, Presidenti Wilson ftoi për një takim grupin diplomatik të Uashingtonit dhe përfaqësuesit e kombeve të robëruara, midis të cilëve figuronte dhe Fan S. Noli, përfaqësues i "Vatrës". Në këtë rast të veçantë, Fan Noli foli dy herë me Presidentin Wilson dhe një herë me zonjën Wilson. Mbledhja historike u mbajt në Mount Vernon, përpara arkivolit të Xhorxh Uashingtonit. Fjalët e pakta që pati rast të shkëmbejë Fan Noli me Presidentin Wilson shpëtuan Shqipërinë nga copëtimi. Para se të kthehej në Boston, Fan Noli i dërgoi "Vatrës" këtë telegram: *"Udhëtimi im këtu triumfoi. Fola dy herë me presidentin Wilson, i cili më dha shpresa të mëdha... ".*

Më 25 korrik 1918, Fan Noli pati një bashkëbisedim të gjatë në Harvard Club, New York City, me ish- presidentin e Amerikës, Teodor Rusvelt. Intervista vazhdoi për një kohë të gjatë. Noli e gjeti Presidentin Rusvelt çuditërisht të informuar hollësisht, mbi gjendjen e Shqipërisë dhe ndër të tjera i tha Fan Nolit: *"Shqiptarët i dua dhe i admiroj, se janë një racë e vjetër dhe trime që meriton të shpëtohet dhe vetëqeveriset. Di që në shumë raste, turqit, grekët dhe serbët bashkoheshin dhe lidheshin në mes tyre që t'u bënin ballë shqiptarëve. Di pastaj që shqiptarët janë besnikë dhe të ndershëm dhe kur e japin falën e mbajnë si burra... Thuaju shqiptarëve që dëshiroj ta shoh Shqipërinë të pavarur dhe që pavarësia e tyre duhet të sigurohet nën mbrojtjen dhe garancinë e painteres të fuqive aleate si, Amerika, Anglia dhe Franca. Nga ana ime do të bëj ç'të më vijë dore për të drejtat e racës shqiptare".*

Në gazetën "Dielli", të datës 4 prill 1921, mësojmë se Noli mbërriti në Tiranë dhe populli shqiptar e priti me entuziazëm peshkop Nolin, që bëri të mundur pranimin e Shqipërisë në Ligën e Kombeve.

Gjithashtu, gazeta "Dielli" e datës 16 qershor 1921 lajmëron se peshkop Noli shkoi sërish në Ligën e Kombeve për të mbrojtur kufijtë e Shqipërisë. 15 fshatra mbetën brenda kufijve të Shqipërisë, midis të cilëve, Tresteniku dhe Vidhova në Devoll.

Pas Kongresit të Lushnjës, komuniteti shqiptaro-amerikan u bë burimi kryesor i mbështetjes për reforma politike perëndimore në Shqipëri. Ndikimi i komunitetit shqiptaro-amerikan ishte rezultat i tre faktorëve: numrit në rritje të anëtarëve të tij, për shkak të emigrimit të vazhdueshëm, lirive të gjera politike që degëve të tjera të diasporës shqiptare u mungonin dhe pranisë të patriotëve shumë të shquar si Konica dhe Noli. Emigracioni në SHBA, në dekadën e parë të shekullit të 20-të, përbëhej kryesisht me toskë kryesisht ortodoksë. Nga këta, rreth 20. 000 - 30. 000 shqiptarë, ashtu si Noli, u kthyen në atdhe në vitet 1919-1925 dhe morën pjesë në rindërtimin e vendit. Pavarësisht nga madhësia relativisht e vogël, komunitetin shqiptaro-amerikan, Faik Konica dhe Noli e transformuan në komunitetin më me ndikim në çështjen shqiptare. Me iniciativën e Nolit, Konica arriti në Boston, më 1909, për t'u bërë redaktori "Diellit". Për të zgjeruar përpjekjet e saj, në tetor të vitit 1922, filloi botimi në Korçë i gazetës "Shqiptari i Amerikës", filial i "Diellit", dhe organ i "Vatrës", gazetë njëjavore kjo e mbështetur nga shqiptaro-amerikanët. Gazeta kishte Konicën, si redaktor dhe Hasan Bitinckën, një tjetër patriot progresist, si drejtor (menaxher). Nën drejtimin e Nolit dhe Konicës "Shqiptari i Amerikës" ishte një kritik i zellshëm i politikës së Zogut dhe klasës të bejlerëve me prirje islamike në pushtet. Kthimi i Nolit në jetën politike ishte, më shumë, për shkak të presionit të Faik Konicës dhe "Vatrës". Faik Konica, Noli, "Dielli" dhe "Shqiptari i Amerikës", ishin të pamëshirshëm në sulmet e tyre ndaj Ahmet Zogut. Në fakt, Zogu ndërmori hapa të shumtë për të kufizuar ndikimin e "Vatrës" dhe "Diellit", duke mbyllur zyrat e "Vatrës" dhe duke u përpjekur të kufizojnë qarkullimin e "Diellit". "Shqiptari i Amerikës" u padit në gjykatë dhe drejtori i tij, Hasan Bitincka u dënua me 20 ditë burg.

III. HASAN BITINCKA DHE LIDHJET E TIJ ME NOLIN

Hasan Bitincka u lind në korrik 1886, në Bitinckë të Devollit, në një familje me tradita patriotike. Në shtator të vitit 1912, Hasan Bitincka ishte prijës i çetës së Devollit, ndërsa në tetor të vitit 1912, priti vullnetarët që erdhën nga Amerika për shpalljen e Pavarësisë. Shtëpia e tij u kthye në strehën e komitëve dhe në çerdhen e propagandës kombëtare. Në Luftën e Parë Ballkanike, Hasan Bitincka luftoi në Poloskë e Kapshticë kundër andartëve grekë. Në këto luftime u plagos dhe u zu rob. U burgos në Selanik, por mundi të arratisej me ndihmën e disa të burgosurve atje dhe pas kësaj shkoi në Izmir. Që andej shkoi në SHBA, ku u bë anëtar i shoqërisë "Vatra" dhe ndërkohë filloi të botonte shkrime në gazetën "Dielli". Mihal Grameno shkruan në gazetën "Koha" më 20 korrik 1916: *"... Hasan Bitinckën e poqa vjet, në një kuvend të "Vatrës" dhe mbeta i habitur duke parë gjithë atë Hasan që kisha njohur dhe me të cilin kemi bashkëpunuar duke ndenjur në burg për çështjen kombëtare. Është gjithnjë ay, i urtë dhe gati për çdo therori kur e lyp nevoja e atdheut. "* Në vitet 1906-1912, i ngarkuar nga Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare të Korçës, herë punon në SHBA për bashkimin e emigranteve rreth "Vatrës", herë kthehet në atdhe për të udhëhequr çetën e Devollit. Në SHBA u njoh për herë të parë dhe me Fan S. Nolin, me të cilin lidhi një

miqësi e ngushtë. Në vitet 1915-1916, ai ishte një nga drejtuesit dhe organizatorët më të shquar të "Vatrës". *Komisioni i "Vatres", në vitet 1917- 1918, përbëhej prej kryetarit At F. S. Noli, arkëtarit Goni Katundi dhe anëtarëve Shefki Aliko, Miçe Bardho, Hasan Bitincka dhe Stathi Suli*

Në vitin 1922, Hasani kthehet në Shqipëri për të drejtuar në Korçë gazetën përparimtare antifeudale "Shqiptari i Amerikës", degë e revistës "Dielli". Më 18 prill 1923, në gazetë u shkrua një artikull kundër regjimit të Ahmet Zogut: *"Zogu - një tiran, brutal dhe injorant. "* Për këtë Hasani shkoi në gjyq. Në bangën e të akuzuarit mes të tjerash ai tha: "*... Le të dihet se 12 vjet të shkuara, po në këtë fron jam gjykuar prej qeverisë turke për çështjen shqiptare dhe sot, përsëri në këtë fron, gjykohem për atë çështje, por këtë radhë prej qeverisë shqiptare. Qëllimi im është të shoh çdo pëllëmbë vend të atdheut të zhvillohet, që të lumturohet populli ynë i shumëvuajtur dhe të garantohet independenca tonë, se liria pa lumturi nuk ka ndonjë vlerë të madhe. "*

Hasan Bitincka ndihmoi në shtimin e radhëve të njësiteve kryengritëse që përgatitën Revolucionin e Qershorit të vitit 1924. Në ato pak muaj të qeverisë së Nolit, Hasani ishte komisar i Bashkisë së Korçës. Pas dështimit të revolucionit, Hasani u arrestua dhe kishte rrezik të dënohej me vdekje, po të mos ishte personi i masave të gjera të njerëzve. U lirua me kusht që të mos dilte nga shtëpia për tre vjet, ndryshe do të vritej pa gjyq. Pas Revolucionit të Qershorit, Hasan Bitincka i tha Fan Nolit: "*Bëre shtëpi të re me qereste të vjetër. "*

Hasani ishte iniciatori në mbledhjen e ndihmave për gjyqin që u përgatit kundër Avni Rustemit për vrasjen e Esat Toptanit. Së bashku me Besim Spahon, ai mblodhi ndihma për të ndihmuar shtetin e ri shqiptar, krijoi, tok me të tjerë, shoqërinë botore "Puna", me qëllim që të hapte rrugë e të ndërtonte ura, në dobi të vendit të prapambetur, por regjimi i Zogut i krijoi mjaft pengesa. Në fillim të dhjetorit 1930, u gjet i vrarë në një nga hotelet e Durrësit. Shtypi zyrtar e quajti vetëvrasje, por dyshimet dhe renditja e ngjarjeve tregoi se ishte një vrasje politike.

Fan S. Noli, më 28 dhjetor 1930, shkroi te gazeta "Republika": "*Tragjedia e tij e kapërcen kufirin e një mjerimi personal. Është tragjedia e Toskërisë katundare që plaçkitet prej bejlerëve e kusarëve si Ahmet Zogu e Abdurrahman Krosi... ajo kobure që vrau Hasanin, na qëllon m'u në kraharor të gjithëve, tërë Shqipërinë. Hasani e beri lajthimin tragjik, e vuri kokën në gojë të ujkut për të provuar se ujku është dele e perëndisë. "*

Në gazetën "Dielli", të datës 12 dhjetor 1930, komisioni i "Vatrës" shkruan: "*... I ndjeri Hasan Bitincka ishte një nga veteranët e çështjes kombëtare. U përpoq me tërë fuqinë e tij që të përhapte principet e federatës dhe t'i shërbente çështjes kombëtare. Vrasja tragjike e Hasanit i humbet Shqipërisë një bir besnik dhe të kthjellët, e "Vatrës" një nga anëtarët që i ka shërbyer asaj me ndërgjegje të plotë. "*

Gazeta "Albania" shkruan: "*... Le të pranojmë këtu me mirënjohje faktin se Hasan Bitincka u bë një shtyllë e fortë dhe bëri të tilla sakrifica për përparimin e saj (Vatrës) sa në anëtarët e organizatës nuk gjendet rekord tek ndonjë person tjetër të vdekur ose të gjallë t'ia kapërcejë ose të paktën të barabitet me atë të Hasan Bitinckës. "*

IV. IMZOT NOLI NË BILISHT, LIDHJET POLITIKE

Imzot Noli, i shoqëruar prej një shumice shokësh, deputetësh dhe miqsh, shkoi në mëngjesin e datës 22 gusht 1923 në Bilisht. Pasi vizitoi zyrat e katundarisë dhe nënprefekturës, të cilat i gjeti të sistemuara mirë, doli në kopshtin e bukur të pazarit prej ku përsëriti fjalimin"*mbi Kuvendin Themeltar*" dhe "*konditat preliminare për realizimin e tij në një mënyrë të dobishme"*. Në mes të fjalimit disa njerëz të vënë qëllimisht, kundërshtuan çështjen mbi faljen e fajtorëve politikë dhe mbi krijimin e qeverisë, duke thënë se qeveria ishte e mirë. Noli u dha"*një përgjigje për t'u mbajtur ment*": "*Kur, në njëzet vjet të shkuara, ne përpiqeshim për Shqipëri, ju as s' e dinit fare një ide të këtillë e t'a kundërshtonit.*

Po arthtë në mendjen t'onë. E tani kemi durim dhe jemi të sigurtë që më vonë do të vini prapë në mendjen t'onë, se tërë popullin nuk munt t' a gënjesh për gjithnjë. "

" Populli i mbledhur rreth folësit të shkëlqyer, në sheshin përpara nënprefekturës e zyrave të tjera qeveritare, degjoj me një vërejtje fjalën ndonëse kjo u zgjat më tepër se një orë dhe dielli diqte përtej masës dhe tërë kohën ish i ekspozuar në shkëndit' e tij"(Shqiptari i Amerikës, Korçë 23 Gusht 1923).

Për pritje kishte dalë tek ura e Bilishtit një pjesë e parisë të vendit, e cila e përshëndeti me një fjalë të shkurtër, ndërsa Noli tha: "*... Ju Devollinj, ju njoh. Kam njohur e kam bashkëpunuar me vëllezërit e bijtë t' uaj n' Amerikë. Sa kini luftuar trimërisht atje, aq edhe këtu kini luftuar me pushkë në dorë për mprojtjen e atdheut. E di që jini trima dhe punëtorë dhe kam besim që do të veproni me ndërgjegje e me zemër"*.

Fjalët mbaruan me brohorimë: " *Rroftë Imzot Noli! ",* ndërsa kur u përmend "Dielli"dhe Faik Konica, kryetari i "Vatrës", turma brohoriti: "*Rroftë Imzot Noli dhe kompania e tij! "*

Në zgjedhjet e dhjetorit të vitit 1923, Imzot Fan Noli, Faik Konica, Dr. M. Turtulli, Akif Elbasani, Llambi Kotta, Hasan Bitincka, Idhomene Kosturi, Beqir Rusi, Ilia Kota, Sali Babani dheIsak Eski ishin kandidatë të partisë liberale për qarkun e Korçës. Këto zgjedhje u humbën nga Partia Liberale, e cila u bë në parlament një opozitë e fortë. Pasazhi politik shqiptar pësoi një ndryshim masiv dhe ndikoi duke shtyrë "Vatrën" dhe Nolin në Revolucionin e Qershorit të vitit 1924.

Në listën e kandidatëve për deputetë të Partisë Liberale të Nolit dhe Konicës, në zgjedhjet e dhjetorit 1923, ishin edhe tre figura patriotike nga Devolli; Hasan Bitincka, Salih Babani dhe Isak Eski. Nga të tre, vetëm Salih Babani fitoi mandatin. Ai kishte mbaruar për drejtësi dhe kishte punuar si prokuror në Korçë. Në ngjarjet që pasuan, këta burra që kishin dhënë gjithçka për Shqipërinë, i qëndruan besnikë asaj dhe udhëheqësit të tyre, Fan S. Noli, duke marrë mbi vete kosto të mëdha për vete dhe për familjet të tyre.

ERMELINDA KASHAHU, EDLIRA DHIMA

LAUREATI DHE INTELEKTUALI SHQIPTAR QË NDIKOI FIGURËN E HUMANISTIT

Hyri në letërsi për të mos dalë më prej saj, në një kohë kur ndodheshin në një terren sizmik me dridhje e lëkundje të fuqishme pulsime të pandërprera dhe lidhje të pakëputura me traditën letrare shqiptare. Ky ishte Fan Noli. Historia e popullit shqiptar me shekuj i ishte nënshtruar luftrave të përgjakshme, situatave komplekse, të cilat ishin vështirë për t'u analizuar dhe për t'u zgjidhur. Në këto rrethana tejet kontraverse, këto çështje aq të ngërthyera nga apetitet dhe interesat e popujve fqinjë, që në vazhdimësi krijonin situata nga më të vështira, shpresa dhe thirrja përndritej në mënyrë të natyrshme dhe ide të plota. Interesant të duket sikur prurje kaq të mëdha faktesh dhe emocionesh shkaktojnë monotoni dhe frikë, por jo…Karakteri objektiv e strukturon larminë kaotike të ngjarjeve. Erdhi koha ku mbërriti në Olimpin e historisë, madje në majat më të larta të saj, i madhi Fan Noli. Kam dëgjuar shumë për humanistët dhe intelektualët shqiptarë, por Noli revizionoi një tezë disadekadëshe, që e sheh intelektualin në kërkim rrënjësor të traditës letrare shqipe dhe si një fenomen në kulturën shqiptare. Kjo figurë madhore, na jep idenë e zbërthimit të mallit për kohën e shkuar, që lidhet me ëndrrën dhe realitetin, për të sajuar përfytyrimin, refleksionin dhe kategorinë e kuptimit të ekzistencës. Ndoshta, kjo korrespodon përmes kontrasteve emocionale, përsiatjeve të vazhdueshme mbi pozicionin e perspektivës njerëzore. Ky popull i lashtë kishte nxjerrë një figurë të ndritur, me histori të bujshme dhe me një traditë të veçantë. I tillë ishte ky personalitet, që me figurën e tij dhe punën e palodhshme kontribuoi për njohjen e kauzës shqiptare. Punoi si intelektuali shqiptar, ku shqiptarizmi i tij nuk ishte një akt sentimental, por një konvertim shpirtëror dhe intelektual. Shfaqi çështjen dhe sintezën e trajtimit realist, përsiatjeve moderne për fatin e njeriut në situata specifike historike, ku dhe i besoi sinqerisht idealit të proklamuar të revolucionit mbi drejtësinë shoqërore dhe barazinë sociale midis popujve dhe njerëzve. Ende çështjet nuk ishin kristalizuar. Përbrenda labirinthit jetësor u strukturuan ngjarje, ndodhi apo copëza historish, gojëdhënat dhe legjendat, dimensionet e dashurisë, vetmisë dhe frymës njerëzore. Kujtojmë këtu, poezinë e titulluar: "Fryn moj erë"

" Nga po na vjen moj erë e rreptë
pse vërshëllen me aq mallëngjim
vij drejt në malet e Shqipërisë
për të përhapur zi e vajtim
fryn moj erë e shkretë fryn
drejt më zemër, më zemër time hyn"…

Shpirti i humanistit ishte i ngarkuar për së tepërmi me ritmikën që e kishte imponuar tempoja e re e jetës. Në qendër të vjershës është një elegji e mirëfilltë, është brenga që

i ngjall në shpirt poetit, pasi fatkeqësia kishte goditur një grua të thjeshtë, ku i vdiq e bija në moshë fare të re, e shkruar mesa duket në bazë të referimit të ndonjë shqiptari. Poezia shquhet për ndjenjat e sinqerta dhe paksa naive, por që ka gjetur shprehje të drejtpërdrejta. Noli i lutet erës që ta përcjellë dhembjen në Shqipëri. Me anën e këtyre vargjeve kuptojmë se Shqipëria ishte gjuha shqipe, ishte fryma njerëzore, jeta, ëndrra dhe jovdekja. Kjo figurë e ndritur vlonte me një ndjeshmëri të zjarrtë të krenarisë kombëtare, që këlthet në dinjitetin njerëzor. Me dashurinë e tij të madhe e të pastër, që rrezatoi për atdheun e gjuhën shqipe, për diturinë dhe emancipimin, i hapi rrugën mendimit iluminist shqiptar. Ashtu si Çabej i cili kërkonte shenjat e kombit, duke formuar dhe shpallur hobin kryesor të mendimit letrar, Fan Noli pasuroi mendimin shkencor, zgjeroi problematikat e veçanta që ishin në themel të një shkence letrare. Sa e sa çështje i vlonin në kokë humanistit shqiptar. Dijetari që preku rrënjët e shkrimtarisë shqipe, përfaqësoi krahun e intelektualëve në kulturën shqiptare, trashëguesi i shpirtit shqiptar, heroi apo kryeheroi i shqiptarizmit, shtroi çështjet e mozaikut të vlerave dhe arritjeve. Sipas tij, për të krijuar një shtet në shërbim të popullit, "duhet forcë dhe mend, forcë dhe dije, forcë dhe zotësi, forcë dhe kanun". Ai ngriti çështjet e emancipimit të gruas, si një çështje "vitale për jetën tonë". Kjo figurë gjeniale bazohej në ngritjen e shpirtit dhe në edukimin filozofik, në një kohë ku shprehej esenca e gjërave, njerëzore dhe hyjnore.

Përse? A thua që racionalizmi i ashpër po e vyshkte këtë figurë?

I kushtoi një vëmendje të gjerë ndjenjës në përgjithësi dhe dashurisë në veçanti, sepse e kuptoi drejt që përpara tij dhe letërsisë qëndronin çështje shumë të mprehta, zgjidhja e të cilave kishte të bënte me fatet e mëtejshme të kombit shqiptar. Nuk u pajtua me atë shoqëri që mbahej në këmbë vetëm nga hipokrizitë dhe urrejtjet. Por përkundrazi, mendësia e tij u përpoq me të gjitha mënyrat të thellojë greminën që e ndante nga realiteti, për të krijuar botën me karakteristikat morale, shpirtërore dhe intelektuale. Mendonte se shekulli kishte për detyrë të përmbushë revolucionin e viteve, t'u japë formë idealeve të mëdha, proklamoi tribunën politike në veprat që përfshiheshin tek "Legjenda e shekujve".

Por, të mos harrojmë se letërsia është një nga shenjat e jetës njerëzore që ekziston.[734] Prandaj humanisti shqiptar nuk mundi të merrej me enigmatiken apo qielloren, por temperamenti dhe profili i tij poetik, i krijuar në kohën e acarimit më të theksuar të kontraditave politike e sociale, shfaqej më i plotë në sensibilitetin e njohur të virtyteve dhe pasioneve fisnike të mendimtarit. Kjo figurë e lashtë i tejkaloi pamundësitë dhe mposhtjet e barrierave, duke mos rënë në harresë dhe duke mbajtur qëndrimin vital, shpirtëror e intelektual. Kujtojmë këtu thënien e prof. Nasho Jorgaqi: "Kur shoh prapa nuk më besohet që kam përshkruar një rrugë kaq të gjatë, rruga është gjithmonë me lodhje dhe pengesa, me klithma e dilema". Fryma demokratike dhe hija artistike përbëjnë botën emocionale të këtij intelektuali. E vërteta kështu ishte. Fa Noli ishte

[734] *Për këtë dukuri ka folur prof. R. Qosja në librin "Prej tipologjisë deri te periodizimi". Prishtinë 1979, f. 338-348.*

me ndjeshmëri të lartë dhe kulturë të thellë. Kemi parasysh letërkëmbimet e tij me patriotë të ndryshëm si, Th. Tashko e J. Vruho, I. Qemali e L. Gurakuqi, H. Mosi e Asdreni, A. Xhuvani etj. Ishin ata që në pikëpamjet e tyre, ruajtën një vlerë të jashtëzakonshme njohëse të pikëpamjeve dhe përqëndrimeve të Nolit, në ngjarjet ku mori pjesë dhe në rrethanat ku jetoi. Kjo tregoi që çështjet që shtoheshin ishin në interes të historisë kombëtare dhe ruanin vlerat letrare nga më të shquarat, ku dhe zbulonin intelektualin siç ka qenë ai përherë. [735]

I lumtur është ai popull që nxjerr njerëz si Fan Noli, që edhe pse kishte të meta, (këtë e ka theksuar prof. Nasho Jorgaqi), nuk u tremb nga të metat dhe dobësitë. Njeriu në jetë duhet të ketë një yll, ta ushqejë veten edhe pse ai në të vërtetë jeton me iluzione. Ky yll, këto iluzione e pasurojnë në jetë dhe e bëjnë më të begatshëm në realitet.

Vitet '20' shënojnë apogjeun e jetës së Nolit. Militanizmi politik dhe intelektuali krijues, çeli në truallin shqiptar shtigje të reja mendimi dhe krijimi, përftoi vlera me rëndësi historike. Këtë vitalitet do ta manifestonte në jetën politike, me mendësi të reja dhe me një shtet ligjor, vetëm Noli. I angazhuar totalisht në veprimtarinë politike dhe letrare, duket se detyrat ishin më të ndërlikuara, një veprimtari e frymëzuar nga të njëjtat ideale dhe e mbështetur në një platformë të përbashkët. Padyshim, këto i bënte mendja e rrallë e peshkopit tonë, në një kohë kur dufet shpirtërore dhe interesat artistike do t'i shprehë në përkthimet që ai nis t'i bëj. Por ai nuk shkëputet edhe nga interesat shkencore (gjatë kohës në Vjenë në 1923). Ishte gjendja shpirtërore, ishin dufet e brendshme të moshës, ato që përcaktuan opinionet dhe qëndrimet politike, ku mbi militanizmin fiton artisti, fiton shpirti i tij i lirë, por edhe i riu me ambicie. Kjo dhembshuri e poetit nuk shpjegohet vetëm me karakterin e pikëlluar të ngjarjeve. Kujtojmë këtu dramën: "Israelitë dhe Filistinë", ku shestimi i dramës i ka rrënjët në vetë përvojën jetësore të Nolit djalosh. Kujtojmë Migjenin, i cili në shtratin e vdekjes la pa përmendur leximin e një biografie për Gëten. Noli kishte një mbretëri në çastet e fundit, atë të librave…

U influencua nga shkrimet e filozofit gjerman Fridrih Niçe, eksponenti i forcës dhe i vullnetit të paepur. Intelektuali më në zë, një talent i fuqishëm dhe i spikatur, rrahu shtigjet e panjohura dhe të palëvruara gjer atëherë, në kohën kur veprat mbartën tendencat më të dukshme e thelbësore të zhvillimit të letërsisë sonë. Në shpirtin e heroit zienin pasione të fuqishme, të cilat nuk shkaktonin veç vuajtje, trishtim, zymtësi. Thellë në shpirt iu kundërvë paragjykimeve ku dhe shpirtërisht ai u ndesh me to.

A thua që ky humanist kërkonte vazhdimisht të përparuarën, të arsyeshmen e të mirën, ndjenjën e hollë ndaj së bukurës? !

Prelat dhe politikan, intelektual i shquar, ku edhe në kushtet e jetës së trazuar shqiptare nuk harronte punën e tij humaniste. Shqipëroi "Makbethin". Kthimi i tij në atdhe u shoqërua me dy dhurata të çmuara që ai i bënte popullit të vet, "Historia e

---

[735] Disa nga fjalimet e shkrimtarit, i botoi L. Dilo në përmbledhjen "Ligjëron Fan Noli, T. 1994; një përmbledhje e shkrimeve më të mira publicistike dhe diçka nga letërkëmbimi botoi P. Tako në: F. S. Noli, "Rron, or rron dhe nuk vdes shqiptari", T. 1976.

Skënderbeut" dhe romani: "Kasollja e Ibanezit". Ja si shprehej ai: "Vetëm degët kemi lëshuar në dherat e huaja. Rrënjët i kemi në Shqipëri. Mund të shkëputësh një njeri nga vendi i tij, por nuk mund ta shkëputësh vendin nga zemra e njeriut". Kujtojmë këtu që gjatë viteve të para në Amerikë, Noli u ndesh me vështirësi të mëdha për të siguruar jetesën. "Nuk më pëlqen Amerika, - thot Noli, - këtu m'u shtrëngua shumë zemra. M'u nxi dynjaja. S'qenka Bot'e re këtu, po bot' e fëlliqurë", - i shkruan ai Tashkos më 1906. [736] Por veprimtarinë time unë nuk do ta lë. Të kësaj kohe do të jenë shqipërimet e mija të para artistike. [737]

Fillimi i viteve 60' do ta gjejë Nolin në valën e punës. Ja si shprehet ai: "Jam mbytyr në punë, - i shkruante një miku në Shqipëri, më 10 korrik 1960. Kurse një bashkatdhetari në Turqi i shkruante : "Mosha që kam, mesa duket nuk më pengon për punët, idetë dhe lëvizjet e reja shpirtërore. Kulturën dhe jetën tonë e ka pasuruar populli im me një frymë të re". [738]

Kur flasim për meritat e Nolit, nuk kemi parasysh vetëm shkrimtarin, publicistin, eseistin dhe përkthyesin, por intelektualin e përfshirë në dimensione madhore. Duket sikur temperamenti egocentrik i ka sjellë sadopak ndërlikime personalitetit të tij dhe ia errëson figurën humanistit në kulturën shqiptare. Por jo. Bota e tij është bota e kulturës njerëzore, e historisë dhe e filozofisë, e letërsisë dhe e arteve, e shkencës dhe e psikologjisë së njeriut. Verbi dhe epiteti i Nolit shfaqet në karakterizime dhe përgjithësime, që u kthyen në vlera të shquara të poezisë shqipe. Një talent i fuqishëm, me aftësi të shquara artistike, me një potencial intelektual, me kontraste, valëvitje mendimesh dhe iluzionesh, që ka punuar dhe krijuar në shpirt, ndien atdhedashurinë e sinqertë dhe zgjeron cilësi të reja artistike. Vlera e kësaj figure është pjesë e letërsisë shqiptare dhe i takon traditës së saj më të shëndoshë. Por duke i qëndruar denjësisht provës së kohës, padyshim që ruan vlerat më të çmuara njohëse, edukative dhe artistike. Bilanci sasior i kësaj sfere në veprimtarinë e Nolit, nuk mund ta përcaktojë vlerën e një shkrimtari. Të mos harrojmë se vepra e Nolit lindi në një kohë të rëndë për fatin e popullit dhe kjo nuk është vetëm një dokument historik, por një dhuratë për lexuesin.

Themelore për konceptin nolian është se ai i shikonte të pandara të bukurën dhe të mirën. Arti që të jetë art duhet t'i shërbejë së mirës dhe shoqërisë në zhvillimin e saj pozitiv. Ky koncept lidhej ngushtë me qëllimin e madh që i caktoi ai krijimtarisë së vet, zgjimin e ndërgjegjes kombëtare të popullit shqiptar. Pohohet në këtë mënyrë mundësia e njohjes përmes artit, karakteri aktiv dhe mundësia transformuese e këtij arti në shërbim të jetës. Solli për herë të parë në mendimin tonë estetik një kontribut të

---

[736] Sipas raportit të diplomatit anglez Robert Parri, dërguar Foreign Offis në 15 korrik 1924, kur shkruan: "Ai fliste një anglishte të shkëlqyer" dhe i kish pohuar se "Anglia është mallkimi i Evropës dhe se institucionet e lira të saj të kopjuara prej shqiptarëve paraqesin një farsë të përgjakshme".

[737] N. Jorgaqi, Larg dhe afër, (Udhëtime dhe meditime)Tiranë, 1987.

[738] Në kujtimet e veta kompozitori dhe dirigjenti Thoma Nashi, tregon se "Noli ëndërronte ta bënte Shqipërinë një Zvicër të dytë" Më thirri ta ndihmoja për të sjellë nga Italia një grup muzikantësh të klasit të parë, për të ngritur një konservator dhe bërthamën e së parës orkestër simfonike".

gjerë e me rëndësi të veçantë për formimin e një koncepti të gjerë pozitiv mbi të bukurën, konceptin që i përshtatej krijuesit të një letërsie me një frymë popullore. Të mos harrojmë se pozitat shoqërore dhe estetike të mjaft kritikave të kohës nuk ishin kurdoherë të diferencuara mirë. Por ky intelektual si letrar përparimtar, kishte mendime të qarta në kokë. Kujtojmë këtu Dhimitër Shuteriqin (1936), i cili shkruante: "Koha erdhi, që po nuk u muar shkrimtari me shoqërinë, po nuk qe dhe ky i dobishëm për atë shoqëri, as që është nevoja të quhet shkrimtar"…

Dimë që artin në tërë historinë e tij të lashtë e ka shoqëruar gjykimi dhe mendimi i shoqërisë. S'ka dyshim, se mendimi estetik është pjesë e pandarë e kulturës dhe e jetës shpirtërore të popullit, tregues kuptimplotë i vitalitetit dhe individualitetit të tij. Veprat e Nolit me të vërtetë kanë provuar burimin e pashtershëm të vlerave shpirtërore, për nga koha, bukuria dhe gjenaliteti. E vërteta kështu ishte. Mendimi letrar i asaj kohe u pasqyrua nëpër kalendarë, ku hodhi shtat shkenca letrare mbi letërsinë. Për Nolin, mendimi estetik nuk shkruhej as për krijuesin, as për vrojtuesin e së bukurës, por vetëm për mendimtarin dhe humanistin, sepse ndryshe do të qe enigmatik qëndrimi i tij. Ishte Noli ai, i cili luftoi kundër mbeturinave të vjetra, inaguroi punën e tij, ku dhe hodhi themelet e kritikës demokratike shqiptare. (kujtojmë artikullin: "Shekspiri në rrezik", 1906). Pavarësisht se mendimi estetik ishte i shpërndarë, Noli dhe shumë të tjerë të asaj kohe morën prej kësaj estetike folklorin, si shprehja e gjallë dhe e thellë e shpirtit të popullit. Jeta e pasur dhe e zhvilluar shpirtërore e njeriut, s'mund të përfytyrohej pa këto vlera, që janë të shkrira në çdo vepër të përsosur të artit përparimtar. Forca dhe larmia e çështjeve të kohës doemos i kanë kërkuar këtij personaliteti, shumë mund e punë për t'i skalitur dhe besoj, se kjo është vlera esenciale e një vepre letrare. Dramat e Sofokliut dhe të Shekspirit, simfonitë e Bethovenit dhe veprat e Verdit, tablotë e Leonardo da Vinçit dhe skulpturat e Mikelanxhelos, romanet e Balzakut dhe të Leon Tolstoit, portretet e Rembrandit dhe peizazhet e Resholdit, gjithë kryeveprat e artit përparimtar të çdo lloji e gjinie, sollën përsosmëri estetike, intelektuale dhe morale, me forcën e tyre ekspresive ato shkaktuan përjetime të thella emocionale, pastruan dhe lartësuan shpirtrat njerëzorë.

E përmendëm këtë fakt, se jo pa qëllim duke qenë se në veprat e tij haset prirja polifonike në planin strukturor dhe estetik, këtë konsekuencë e ruajti në idetë dhe sentencat e karakterit përsiatës. Nga sa kemi lexuar, në lidhje me pikëpamjet estetike të popullit, këto çështje ishin të pranishme në të gjitha krijimet artistike. Kurse te Noli, u "nxorrën"prej andej. Një punë e tillë ishte e lehtë dhe e vështirë. E lehtë, sepse mendimi i tij ishte i qartë dhe i materializuar aq bukur dhe aq thjesht, saqë mund të kuptohej fort mirë. E vështirë, sepse ai ishte shumë i thellë dhe i shpërndarë në detajet e një arti. Kujtojmë këtu përkthimet e realizuara të Nolit, të cilat ishin kryevepra nga letërsia botërore, kujtojmë Nolin që depërtoi në rrethanat historike të kulturës perse. (Rubaitë e Khajamit ku Noli i vlerësonte jo rastësisht në tokën persiane). [739] Personaliteti i botës shqiptare forcoi besimin në vete dhe zhvilloi prirjen e së vërtetës, e kishte obsesion konstant dhe forcë të veçantë ekspresive përkushtimin ndaj shtjellimit të ideve dhe veçorive të humanizmit pers. Ndoshta kjo, do të ndikonte

[739] *F. S. Noli, vëll. 6, Rilindja, f. 71, Prishtinë, 1988.*

drejtpërdrejt në lindjen e humanizmit evropian. Ishte ndër më të shquarit eseistë të kritikës letrare, që përhapi pikëpamje të drejta mbi vlera ideore. (Disa vepra që përktheu Noli i përcolli me "introdukta", parathënie të cilat kishin vlerë të shënuar, ose shqipërimin e poemës së Longfellout, "Kthimi i Skënderbeut në Krujë" (1916), shqipërim që foli aq lart për mundësitë e tij si poet, duke manifestuar gjykimin e mençur të Nolit dhe përpjekjen për të depërtuar në art). [740] Kujtojmë edhe variantin e dytë shqip, fletorja "Shqiptari i Amerikës", ku njoftonte se Noli në Vjenë punonte për të kërkuar dokumente mbi Skënderbenë, një arritje interesante kjo, që e shihte veprën e Nolit si një unitet shumë të thellë dhe se elementet e një vepre artistike i bashkonte një lidhje organike. Ai zgjodhi dhe vuri në shqip vepra të cilat kishin vlerë aktuale dhe luanin rol pozitiv në edukimin politik dhe estetik të popullit. Ishte orator dhe i zgjuar, i gjallë dhe i përpiktë, ku dhe siç thotë i madhi Shuteriqi, - "Fjala e tij kaq spontane dhe kaq e lidhur, bëri të shtangin si njerëzit pa opingë ashtu edhe dhelpërat e diplomacisë". [741] Puna e tij nuk ishte e shkëputur nga puna prej intelektuali. Fytyra dhe epoka e Skënderbeut zënë një vend të madh në krijimtarinë shkencore të Nolit, me një vlerë të madhe njohjeje dhe edukimi estetik. I dha tonin shkrimit shqip pas Rilindjes Kombëtare. [742] Nuk kishte kurrsesi që veprimtaria noliane si politikan, muzikolog, poet e përkthyes, misionar i kishës autoqefale shqiptare, të errësonte epokat që do të vinin më pas…Kujtojmë këtu mendimin e estetit zvicerian, Sh. de L'Andelyn i cili ka theksuar se rruga në të cilën u krye edukimi estetik ishte ajo e artit. Koha jonë, si kohë e integrimit të Shqipërisë, sheh te Noli humanistin, intelektualin dhe laureatin e hershëm të një letërsie të emancipuar. Kjo është arsyeja që ne jemi mbledhur sot këtu, që vepra merr një tingëllim të fuqishëm aktual, ku arti dhe horizonti estetik do t'i detyrohen këtij personaliteti krijues dhe erudit. Edhe pse nuk hodhi armët, vendin e tij e pa në fushën letrare, në kryefushën e lirë nga konkurenca bazhibozuke, plot me gëzime intelektuale, pa pusira e për të kulturuar popullin.

[740] Këtë poemë Longfellou e shkroi nën nxitjen e Dora d'Istrias, që vizitoi Amerikën më 1880 dhe që u njoh me shkrimtarin e dëgjuar. Në origjinalin anglisht u pat ribotuar te gazeta: " Kombi", 1907. Mund të supozohet se ribotimin e bëri Noli, që punoi në atë gazetë përkrah S. Pe it.

[741] Dh. S. Shuteriqi, Fan S. Noli, "Nëntori", 1965, nr. 4, f. 20.

[742] M. Domi, mjeshtër i madh i fjalës shqipe, "Nëntori", 1965, nr 4, f. 27.

ETLEVA GOXHAJ

DRITËHIJET E NJË POLITIKANI: NOLI NË LIDHJEN E KOMBEVE GUSHT-SHTATOR 1924

Fan Noli është një nga figurat komplekse të historisë së Shqipërisë. Ai ishte patrioti brilant, i cili në kulmin e fushatës helenizuese themeloi Kishën Autoqefale Shqiptare. Ai me shkrimet e tij arriti t'i shërbente forcimit të identitetit kombëtar të shqiptarëve. Noli si patriot dhe Noli si politikan janë dy anë të një medalje, të cilat kanë nevojë për analiza të thella dhe jashtë pasioneve politike. Studiuesit bien përgjithësisht dakord në vlerësimet e tyre për Nolin si patriot, ndërkohë që ky unitet nuk vërehet për figurën e tij si politikan. E nëse ka ndonjë moment në karrierën e tij si politikan ku debatet janë më të zjarrta, është pikërisht veprimtaria e tij gjatë vitit 1924. Kështu, Sejfi Vllamasi, bashkëkohës dhe kundërshtar politik i Nolit shprehet: "Unë përulem me respekt përpara shërbimeve të tij. Por unë nuk kam punë me këtë vigan letrar dhe krijuesin e kishës autoqefale që varrosi ëndrrat greke për grabitjen e Shqipërisë së Jugut. Unë kam punë me Nolin si politikan, i cili në fushën e politikës i ka bërë dëm çështjes". [743]

Pak a shumë në të njëjtën linjë janë dhe studiuesit shqiptarë dhe të huaj në lidhje me figurën e Nolit si politikan. Kështu, studiuesi amerikan B. J. Fisher shkruan: "Noli gjykohej përgjithësisht si njeri besnik i parimeve dhe patriot, por politikisht ishte disi jashtë linje, ishte i paaftë të punonte në strukturën politike të pazakontë të Shqipërisë. Besnik ndaj parimeve të tij, porsa hyri në Tiranë dhe formoi qeverinë e re, Noli paraqiti programin e tij ambicioz, i cili po të realizohej, do të mund të krijonte një shtet modern Perëndimor". [744]

Studiuesi i mirënjohur shqiptar Aleks Buda do të shprehte vlerësimet maksimale për figurën e Nolit, duke i dhënë me të drejtë atij merita të jashtëzakonshme në procesin e shkëputjes së ortodoksisë shqiptare nga Patriakana. Ky akt, sipas prof. Budës, "ishte hapi i parë i madh që do të dilte përpara politikës greke të aneksimit të Shqipërisë së Jugut mbi bazën e fesë". [745] Ndërsa do ta quante Nolin burrë shteti, politikan e udhëheqës politik, prof. Buda do të shihte në këtë figurë edhe disa mangësi që në konceptin e tij "mund të konsiderohen. . . si një aspekt që i nënshtrohet më tepër realitetit të kohës, relativitetit dialektik të historisë". [746]

Qeveria Demokratike e Fan Nolit erdhi në fuqi në qershor 1924. Ishte qeveria e 12-të e formuar në Shqipëri pas qeverisë së parë të Ismail Qemalit. Qeveria e qershorit 1924, u gjend në një situatë krejt tjetër në krahasim me qeveritë e mëparshme. Ajo

[743] Sejfi Vllamasi*, Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942*, Tiranë, 1995, fq. 279
[744] Bernd J. Fisher, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*, Tiranë, 2000, fq. 65
[745] Arben Puto, *Shqipëria politike 1912-1939,* Tiranë, 2009, fq. 384
[746] *Po aty*, fq. 385

ishte rrjedhojë e ashpërsimit të luftës politike që kishte nisur që në vitin 1921[747], e që u shndërrua në lëvizje të armatosur në qershor 1924. Fill pas marrjes së pushtetit qeveria e re u përball me një sërë problemesh.

Në planin e politikës së jashtme, sfida më e rëndësishme e Nolit ishte çështje e njohjes së qeverisë së tij si nga Fuqitë e Mëdha, ashtu dhe nga shtetet fqinje. Çështja e kufijve ishte një tjetër moment krucial që duhej t'i jepej një zgjidhje përfundimtare. Dy probleme që kishin të bënin drejtpërsëdrejti me kufijtë ishin: ai i kufirit verior, pra çështja e Shën Naumit dhe Vermoshit, që mbaheshin te pushtuara nga serbët, si dhe ai i jugut, pra problemi i 14 fashatrave të Korçës që ishin ende nën pushtimin grek.

Në planin e brendshëm, problemi i parlamentarizmit ishte aspekti më i rëndësishëm që kësaj qeverie iu desh të përballej. Por ajo që do ta gërryente thellë qeverinë e Nolit, deri në rrënimin e saj, ishin financat. Pikërisht ky problem do të shndërrohej në thembrën e Akilit të retorikës noliste në Lidhjen e Kombeve.

Duke kaluar në veprimtarinë konkrete të qeverisë së Nolit në planin e politikës së brendshme, qeveria u gjend përballë një problemi me karakter kushtetues. Së pari, Asambleja Kushtetuese u shpërnda vetëvetiu. Mbeti vetëm Këshilli i Lartë i cili vazhdoi të ekzistonte formalisht. [748] Në këtë mënyrë qeveria e re u bë drejtuese e jetës politike, ekonomike dhe shtetërore të vendit. [749] Në planin ekonomik detyra më e rëndësishme dhe më e ndërlikuar për zbatimin e programit të qeverisë, ishte çrrënjosja e mbeturinave të feudalizmit nga jeta ekonomike e shoqërore e vendit, ku si detyrë parësore ishte zgjidhja e çështjes agrare në të mirë të fshatarësisë. [750] Lidhur me reformën agrare, qeveria arriti të përgatiste një projektligj të titulluar "Mbi shpronësimin e pasurisë shtetërore", që në të vërtetë do të ishte një reformë gjysmake, përderisa linte të paprekur pronat e çifligarëve privatë. [751] Programi i qeverisë do të mbetej thjesht në letër, për të nuk u mor asnjë masë konkrete për zbatimin e saj në praktikë. Kjo e cënoi prestigjin e saj brenda vendit. Ekipi drejtues ra në konfuzion dhe amulli. [752] Në këto rrethana, qeveria u gjend e bllokuar dhe krejt e pa aftë për të zbatuar programin.

Nolit iu krijuan shumë barriera që do e pengonin në realizimin e programit të tij. Ndoshta ai nuk diti t'i përshtaste idetë e tij demokratike në një vend tërësisht feudal. Këtu mund të ngremë pikëpyetjen cilat ishin parimet ku mbështetej Noli? Ai ishte edukuar në një vend ku demokracia ishte parimi bazë i shoqërisë, por a mund të gjenin zbatim idetë e tij në një terren te tillë si Shqipëria e asaj kohe?

Në kujtimet e veta Eqerem bej Vlora do të theksonte për Nolin: "Miku im personal dhe kundërshtari politik, metropoliti shumë i kulturuar, Fan Noli tha një ditë: Ky vend i çuditshëm nuk ka shok në botë. Këtu shpesh, bej mund të jetë një fshatar, fshatari një

[747] Muin Çami, *Shqipëria në rrjedhat e historisë 1912-1924*, Tiranë, 2007, fq. 336
[748] Arben Puto*, vep. cit,* fq. 359
[749] *Po aty*, fq. 359
[750] Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Historia e Popullit Shqiptar,* vëll. III, Tiranë, 2007, fq. 230
[751] *Po aty*, fq. 230
[752] Arben Puto, *vep. cit*, fq. 364

patric, të gjithëve nën ato gunat e lypsit iu duket vetja kalorës i barabartë dhe madhështor sa tjetri. Këtu ndryshimi midis të pasurit dhe të varfrit, midis të fortit dhe të dobëtit, fshihet nga ndjesia e dinjitetit të barabartë, apo dhe e përshtatjes. Këtu është sinori midis mënyrës evropiane dhe asaj aziatike të jetës, midis koncepteve sociale gjermanike dhe latine, midis etikës së krishterë dhe asaj myslimane, këtu është paleta ku ngërthehen të gjitha ngjyrat dhe dritëhijet, të gjitha refleksionet e së kaluarës dhe të së tashmes". [753]

Mesa duket Noli nuk mundi të përshtatej në situatën e vështirë që u gjend qeveria e tij e cila shkonte sa në një krizë tek tjetra. Sfida më e madhe për Nolin ishte padyshim sigurimi i njohjes ndërkombëtare. Kjo u bë një nga çështjet kryesore të politikës së jashtme të qeverisë së tij. Këtu u përqendruan të gjitha përpjekjet e saj. Qeveria e Nolit ndërmori aksione diplomatike për njohje, fillimisht pranë vendeve fqinje.

Noli e kuptonte se Shqipëria kishte nevojë për marrëdhënie të mira veçanërisht me Beogradin nëse donte që eksperimenti i tij demokratik të mbijetonte. [754] Përgjigjja e Beogradit ndaj ardhjes së Nolit në pushtet nuk qe pozitive. Çështja më e rëndësishme mbetej Kosova. Udhëheqësit jugosllavë ishin të kënaqur që regjimet paraardhëse, veçanërisht ato të drejtuar ose të kontrolluar nga Ahmet Zogu, nuk i kishin për zemër as ndryshimet radikale të kufijve as presionet mbi Beogradin për të përmirësuar trajtimin e pakicës shqiptare. [755]

Edhe qeveria greke mbajti kundrejt qeverisë së Nolit në thelb një qëndrim të ftohtë, po aq kundërshtues sa Beogradi. [756] Shkak për mosmarrëveshjet midis dy qeverive kishin të bënin me fshatrat e ish-kazasë së Korçës. Noli ishte për marrëdhënie korrekte me fqinjët. Ai shkoi deri në idealin e tij për një "konfederatë ballkanike". [757] Ideja e tij nuk u prit mirë nga asnjë nga vendet fqinje, madje Athina u rreshtua në krah të Beogradit me akuza kundër qeverisë shqiptare për "organizim bandash sulmuese kundër vendeve fqinje". Shtypi grek filloi të bënte thirrje për një front të përbashkët të vendeve ballkanike kundër asaj që quhej "fqinjë e pakorrigjueshme". [758]

Aksionin diplomatik për njohjen e qeverisë së tij, Noli e vazhdoi me Italinë me shpresën se ajo ndoshta do të tregohej e gatshme, duke marrë parasysh interesat e saj të veçanta në Shqipëri. Në fillim ishin disa faktorë ekonomikë dhe politikë që e shtynin qeverinë e Romës të mbështeste qeverinë e Nolit, përderisa elementët që e përbënin këtë qeveri ishin treguar më të prirë që të parapëlqenin firmat koncesionare italiane në Shqipëri. [759] Ministri italian në Durrës i rekomandonte qendrës së tij që të hynte në marrëdhënie me qeverinë e Nolit, pra ta njihte atë. [760] Qëndrimi i Romës ndryshoi negativisht aty nga fundi i verës. Kërkesës së qeverisë shqiptare, të paraqitur

[753] Eqerem bej Vlora, *Kujtime 1885-1925*, Tiranë, 2003, fq. 514-515
[754] Robert C. Austin, *Shtegu i pa shkelur i Fan Nolit*, Tiranë, 2003, fq. 122
[755] *Po aty*, fq. 123
[756] Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *vep. cit*, fq. 235
[757] Arben Puto, *vep. cit*, fq. 369
[758] *Po aty*, fq. 369
[759] Akademia e Shkencës e Shqipërisë, *vep. cit*, fq. 233
[760] Arben Puto, *vep. cit*, fq. 365

me anë të të ngarkuarit me punë, Tefik Mborja për përkrahjen e Italisë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes së kufijve[761], Musolini iu kundërpërgjigj me propozimin për një pakt të veçantë miqësie, por që natyrën e vërtetë të këtij pakti, Roma nuk deshi ta sqaronte. [762] Noli e kuptoi se me Italinë nuk ishte rrugë të mesme dhe se mbijetesa e Shqipërisë si vend i pavarur do të varej nga ndihma më pa interes e Britanisë së Madhe ose e Lidhjes se Kombeve.

Edhe Londra nga ana e saj ngurroi ta njihte qeverinë e re. Eyres përfaqësuesi anglez në Durrës i rekomandonte Londrës zyrtare se "njohja duhej shtyrë derisa të sigurohej që qeveria ishte konstitucionale dhe nuk ushtronte reprezalje mbi kundërshtarët politikë". [763] Qeveria angleze vendosi që qeverisë së re shqiptare të mos i jepej asnjë njohje zyrtare. Përgjigja për qeverinë e Nolit ishte që "... ne nuk mund të njohim një qeveri si qeveri legale derisa ajo të mos ketë ndërmarrë hapa për të provuar se ajo është përfaqësuese e shumicës së popullit. Parlamenti shqiptar është shpërndarë dhe derisa ky të mos thirret përsëri ose të mos mbahen zgjedhje të reja, vështirë se mund ta quajmë qeverinë e re si të ligjshme, në të vërtete ajo nuk ka fare status kushtetues. [764]

Pas refuzimit të Londrës, përçapje u bënë pranë qeverisë së SHBA-së. Këtë çështje Noli vendosi ta merrte në dorë vetë. [765] Ai shkoi në legatën amerikane ku bëri takim me ministrin amerikan në Tiranë, Grant-Smith. Ministri e dëgjoi me mirëdashje kërkesën e Nolit për njohjen e qeverisë së re duke vlerësuar faktin që kishte ardhur në fuqi pa gjak dhe se do të ndiqte një politikë të matur. [766] Por optimizmi i tij do të binte shpejt. Ai i raportonte Departamentit të Shtetit, se nuk mund të pritej asgjë nga një qeveri që nuk kishte shanse të mbijetonte gjatë, e paqëndrueshme brenda dhe e izoluar në shkallë ndërkombëtare. [767] Të njëjtin qëndrim refuzues për njohjen e qeverisë së Nolit mbajti dhe Franca. [768]

Qeveria e Nolit u gjend përpara një izolimi të plotë ndërkombëtare e cila e detyroi atë të ndërmerrte disa veprime të dëshpëruara. Përpjekjet e tij për të vendosur marrëdhënie diplomatike me qeverinë sovjetike duhen parë pikërisht në këtë optikë. [769]

Izolimin ndërkombëtar që ndeshi në marrëdhëniet e saj diplomatike me botën e jashtme, qeveria e Nolit u përpoq ta kundërbalanconte duke kërkuar mbështetjen e Lidhjes së Kombeve. Ajo i përqendroi përpjekjet kryesore në këtë pikë. Më 22 gusht 1924, Fan Noli së bashku me Luigj Gurakuqin u nisën për në Gjenevë për të marrë pjesë në sezonin V të Asamblesë së Lidhjes së Kombeve. [770] Dy shqetësime lëvrinin në kokën e politikanëve shqiptarë: së pari, të kërkonin një hua dhe, së dyti, të trajtonin problemin e mbetur pezull të kufijve.

---

[761] Robert C. Austin, *vep. cit*, fq. 177
[762] Arben Puto, *vep. cit*, fq. 366
[763] Pranvera Teli (Dibra), *Shqipëria dhe diplomacia Angleze 1919-1927*, Tiranë, 2005, fq. 247
[764] Pranvera Teli(Dibra), *vep. cit*, fq. 248
[765] Nasho Jorgaqi, *Jeta e Fan S. Nolit*, Tiranë, 2005, fq. 517
[766] *Po aty*, fq. 518
[767] Arben Puto, *vep. cit*, fq. 373
[768] *Po aty*, fq. 371
[769] Muin Çami, *vep. cit*, fq. 354
[770] Robert C. Austin, *vep. cit*, fq. 111

Deri në atë kohë qeveria e tij nuk kishte arritur pothuajse asgjë të rëndësishme, të gjitha projektet e qeverisë së re kishin mbetur në letër, kështu në vend që Noli të qëndronte në Shqipëri dhe të çonte përpara reformat, ai i kushtoi më shumë rëndësi sigurimit të mbështetjes ndërkombëtare. Këtë ide të tij ai e mbështeste në faktin se duke siguruar një mbështetje financiare dhe një njohje në arenën ndërkombëtare, do te qetësonte jo vetëm kritikët e qeverisë së tij brenda vendit, por do të plotësonte edhe pikat e programit të tij. Kështu që Noli vendosi t'i vinte çështjet e jashtme mbi ato të brendshme. [771]

Sesioni i Asamblesë të Lidhjes së Kombeve u hap më 1 shtator. Në këtë sezon do të diskutoheshin problemet që shqetësonin kohën. Në kuadër të këtyre diskutimeve e mori fjalën edhe Luigj Gurakuqi. Fjalimi i tij ishte me tone të buta ku shprehej qartë pozita e vështirë financiare në të cilën ndodhej vendi. Ai i kërkoi ndihmë Lidhjes për lehtësimin e zisë së bukës të dimrit dhe të vjeshtës të po atij viti, duke theksuar se pa ndihmën financiare të Lidhjes së Kombeve fati i malësorëve të mbërthyer nga uria do të ishte i tmerrshëm. [772]

Delegacioni shqiptar u përball me një indiferentizëm nga ana e Fuqive të Mëdha, kështu që Noli vendosi të bënte takime me politikanët që ndodheshin aty duke iu sqaruar situatën në të cilën ndodhej qeveria e tij. Pas shumë përpjekjeve ai u bind se e vetmja shpresë për të mbetej Lidhja. Noli e kish provuar dashamirësinë e saj dhe e çmonte Lidhjen si dukuri të re në jetën politike ndërkombëtare. [773] Mirëpo tani rrethanat dhe situatat ishin krejt ndryshe se katër vjet më parë.

Ftohja midis Lidhjes dhe qeverisë shqiptare kishte ndodhur pak kohë më parë se Noli të vinte në pushtet. Në maj të vitit 1923 me kërkesë të qeverisë shqiptare në vend kishte mbërritur një këshilltar financiar për të ndihmuar vendin si dhe për të kapërcyer vështirësitë financiare. [774] Ky ishte holandezi J. D. Hanger, përvoja e të cilit në Shqipëri nuk ishte aspak pozitive dhe shpesh u pengua nga qeveria shqiptare. Qeveria e asaj kohe kërkoi largimin e tij, me pretekstin se nuk mund të përballonte shërbimet e tij. [775] Kjo gjë nuk u kapërdi lehtë nga Lidhja.

Kështu, kur Noli erdhi në pushtet trashëgoi marrëdhënie tejet të tensionuara me Lidhjen e cila shpresonte se Hangeri do te kthehej në pozitën e mëparshme me ndryshimin e qeverisë. Mirëpo kjo gjë nuk ndodhi, kështu më 8 shtator 1924, Noli njoftonte sekretarinë e Lidhjes se i vinte keq për qëndrimin që kishte mbajtur qeveria paraardhëse. Ndërkohë që Lidhja e pranoi qëndrimin e qeverisë shqiptare, rikthimi i Hungerit dhe mbyllja e çështjes do të kishte qenë një veprim i zgjuar po të kihet parasysh fakti që Noli kërkonte me dëshpërim nga Lidhja ndihma financiare. [776]

---

[771] *Po aty*, fq. 114

[772] Arkivi i Ministrisë të Punëve të Jashtme (më tej AMPJ), viti 1924, dosja 191, f. 9-10

[773] Nasho Jorgaqi, *vep. cit*, fq. 529

[774] AMPJ, viti 1924, dosja 191, f. 93

[775] Robert C. Austin, *vep. cit*, fq. 202

[776] *Po aty*, fq. 203

Kryeministri u gjend në një situatë tepër të vështirë. As Fuqitë e Mëdha, dhe as Lidhja e Kombeve nuk donin të tregonin mirëkuptim për të ndihmuar Shqipërinë e varfër. Bojkoti ishte total, politik dhe ekonomik, dhe çdo përpjekje në rrugë diplomatike ishte e kotë. [777]

Më 10 shtator në seancën plenare të Asamblesë të Lidhjes së Kombeve e mori fjalën edhe Fan Noli. Fjalimi i tij ishte tepër ndëshkues në adresë të Lidhjes kur ajo nuk arriti t'i jepte një hua Shqipërisë, hua për të cilën vendi kishte aq shumë nevojë për rimëkëmbje. Ai evidentoi rolin që pati Lidhja në fillimet e saj për moscopëtimin e Shqipërisë, por a ishte kjo e mjaftueshme nëse Lidhja nuk e ndihmonte këtë vend të vogël të ecte me këmbët e saj? [778] I prekur nga refuzimi dhe indiferenca e saj, ai vazhdon:

Ne kemi nevojë për 300 milionë franga ari. Shumë, do thoni ju. Epo mirë, po bëj gjestin elegant të zbres në shumën modeste prej 200 milionësh. Po tundi kokën. Epo, jam gati të hyj në bisedime për shumën më të vogël, të themi 100 milion. Më falni, mos keni ndërmend të thoni se nuk më keni takuar kurrë në jetën tuaj dhe se nuk do të më huani asnjë qindarkë. Epo mirë, atëherë, merreni kërkesën time dhe futeni në dosjet e vdekura te Sekretariatit, kyçeni mirë, por sigurohuni që e keni mbytur përpara se ta varrosni në nekropolin tuaj, sepse ka të ngjallet së vdekuri. [779]

Mendoj se ky fjalim i Nolit nuk e justifikon performancën e tij. Koha dhe vendi nuk ishin të përshtatshëm për një fjalim të tillë. Ai shkoi pranë Lidhjes për të kërkuar ndihmë ekonomike dhe, në një situatë të tillë nuk mund të hiqesh më i mençur sesa duhet. Politika të mëdha bëjnë shtetet e fuqishme dhe Noli nuk e kishte këtë luks duke ditur situatën financiare në të cilën ndodhej vendi i tij, por edhe peshën që zinte vendi i tij i vogël. Ai mund të kishte të gjitha arsyet që të ishte i zemëruar me qëndrimin e Lidhjes ndaj vendit të tij, por aftësia e një diplomati dhe e një burri shteti këtu duket, që të dijë të fshehë mendimin që ai ka në të vërtetë në lidhje me një problem. Një kërkesë shumë më diplomatike drejtuar Lidhjes nga ana e Nolit do t'i shërbente më shumë interesave të vendit. Fjalimi i tij nuk bëri gjë tjetër veçse forcoi mendimin se figura e tij mund të përbënte rrezik për paqen në Ballkan.

Por mllefi i Nolit nuk mbaron këtu. Ai vazhdon t'i thellojë tonet tallëse kur shton më tej se Lidhja jo vetëm nuk i jep hua vendit të tij të vogël, por as nuk dëshiron të hyjë në bisedime për një hua, ngaqë qeveria e sotme shqiptare është një qeveri kryengritëse, pa parlament. [780] Ai sulmoi institucionin e parlamentit dhe parlamentarizmin duke ngritur pyetjen se:

Çfarë është parlamenti? Pa dyshim e dini. Por do të keni një ide më të qartë kur t'ju them ç'mendoj për të. Parlamenti është një sallë ku mblidhen politikanë të pashpirt, për të bërë eksperimente me racën e tyre, një sallë plot me gazra helmuese, me gazra që shkaktojnë lot dhe të qeshura që u përdorën në luftën e fundit për tu dhënë fund të gjitha luftërave dhe për të vendosur paqen. . . . Por meqë ju ngulni këmbë, ne jemi

[777] Nasho Jorgaqi, *vep. cit*, fq. 530
[778] Robert C. Austin, *vep. cit*, fq. 203
[779] Fan S. Noli, *Vepra 5*, Tiranë, 2002, fq. 214
[780] Joseph Sëire, *Shqipëria ngritja e një mbrëtërie*, Tiranë, 2005, fq. 345

gati të bëjmë zgjedhje të reja dhe të mbledhim atë murtajë, atë fatkeqësi, atë bestyni të neveriteshme që është parlamenti, mbasi të keni bërë, le të themi, dy ose më mirë tre vjet qeveri atërore.. [781]

Në këtë fjalim Noli goditi institucionin bazë të demokracisë, Parlamentin. Kjo tregoi dëshpërimin e tij në lidhje me këtë institucion të rëndësishëm, dhe shprehu dukshëm mungesën e taktit në politikë. Ky qëndrim i Nolit la të shtanguar jo vetëm pjesëmarrësit në Lidhje, por të njëjtin impakt pati edhe te miku i tij Luigj Gurakuqi i cili nuk ishte dakord me qëndrimin që mbajti Noli. Vetë Gurakuqi do të preferonte një qëndrim shumë më zbutës nga ana e Nolit, mirëpo Noli nuk u konsultua për sa i takon qëndrimeve të tij me asnjë nga miqtë, kështu që përgjegjësia e tij ishte individuale.

Pas përpjekjeve të dështuara për të siguruar huan dhe legjitimitetit të qeverisë së tij, Noli iu përkushtua çështjes së mbrojtjes së kufijve të vendit. Kjo ishte dhe arsyeja që Noli qëndroi deri në mbarim të punimeve të Asamblesë të Lidhjes. Çështja e kufijve u shqyrtua dhe u diskutua në Këshillin e Lidhjes në pesë mbledhje, që zgjati deri në fillim të tetorit. [782] Ishte një betejë jetike për fatin e tokave shqiptare.

Noli e mori disa herë fjalën në Këshillin e Lidhjes së Kombeve duke bërë një paraqitje të historikut të ecurisë së çështjes së kufijve tokësore. Noli kritikoi ngadalësinë me të cilën po shqyrtoj kjo çështje nga Fuqitë e Mëdha, si dhe kërkoi që problemi i kufijve të zgjidhej përfundimisht para dimrit. [783]

Ndërsa ishte duke luftuar me delegacionin grek në Gjenevë, Noli foli edhe me disa gazeta greke për nevojën e marrëdhënieve të mira midis fqinjësh. Duke qenë se kishte minorite respektive në të dyja vendet, ato nuk duhet të shërbejnë si pengesë por si ura pajtimi midis vendeve. [784]

Pas debateve të shumta qeveria greke u detyrua të tërhiqte forcat e saj nga të 14 fshatrat rreth liqenit të Prespës, të cilat në tetor 1924 u morën në dorëzim nga qeveria shqiptare. Kjo ishte arritja e vetme gjatë qëndrimit në pushtet të Nolit, çështje të cilën e zgjidhi me këmbëngulje në Lidhjen e Kombeve.

Ajo çka treguan gjashtë muajt e qeverisjes së Nolit, ishte mungesa e orientimit të tij politik. Më mirë se kushdo këtë e ka thënë vetë Noli në një letërkëmbim të tij me historianin anglez J. Swire. . . .

"Duke dashur të realizoj reformën agrare, ngjalla zemërimin e aristokracisë së tokës, duke mos arritur ta realizoj atë, humba mbështetjen e masave fshatare". [785]

Konkluzion.

Mënyra sesi erdhi Noli në pushtet i krijoi atij barriera të vështira për të kapërcyer situatën, barriera të cilat do ta pengonin dukshëm në realizimin e programit të tij. Ai nuk diti t'i përshtaste idetë e tij demokratike në një vend tërësisht feudal. Madje ai u bë më feudal se feudalët që gjeti dhe këtë e vrejmë te gjyqet politike që ngriti fill pas

[781] Fan S. Noli, *vep. cit*, fq. 215
[782] AMPJ, viti 1924, dosja 132, f. 9, 10, 11
[783] AMPJ, viti 1924, dosja 132, f. 15
[784] AMPJ, viti 1924, dosja 82, f. 53
[785] Joseph Sëire, *vep. cit*, fq. 350

ardhjes në pushtet. Kjo ishte e pafalshme për Nolin, pasi ai vetë kur ishtë në opozitë, ishte një kritikus i ashpër i qeverive, pikërisht për këto probleme.

I ndodhur përballë një izolimi ndërkombëtar e vetmja shpresë për të mbeti vetëm Lidhja e Kombeve, ku Noli hasi në një indiferentizëm, jo vetën nga Fuqitë e Mëdha, por dhe nga vetë Lidhja në të cilën ai besonte aq shumë. Ai mban në tribunën e Lidhjes dy fjalime të njëpasnjëshme. Përsa i takon fjalimit të parë, ishte një fjalim që nuk e justifikonte performancën e Nolit. Nuk ishte as koha dhe as vendi për një fjalim të tillë. Ai shkoi pranë Lidhjes për të kërkuar ndihmë, dhe këtu do dukej aftësia e një politikani kombinuar me atë të diplomatit.

Në fjalimin e dytë që është madje shumë më kritikues se fjalimi i parë, Noli goditi institucionin bazë të demokracisë, Partamentin. Kjo tregoi dëshpërimin e tij në lidhje me këtë institucion të rëndësishëm, dhe shprehu dukshëm mungesën e taktit në politikë. Të dy fjalimet janë përgjegjësia individuale e Nolit.

FADIL GRAJÇEVCI

FAN S. NOLI DHE MARIN BARLETI

Marin Barleti dhe Fan S. Noli përfaqësojnë epoka të ndryshme të kulturës shqiptare. Që të dy me përkujdesjen e tyre për përjetësimin e ngjarjeve më të lavdishme dhe më frymëzuese të historisë sonë kombëtare, luftërave heroike të popullit shqiptar gjatë shekullit XV kundër pushtuesve osmanë, përjetësisht emrat e tyre i lidhën ngushtë me emrin e kryeheroit të atyre ngjarjeve, me emrin e burrështetasit, të strategut e patriotit të madh shqiptar, Gjergj Kastriotit Skënderbeut.

Marin Barleti supozohet se jetoi dhe veproi në katër dekadat e fundit të shekullit XV dhe më shumë se një dekadë në shekullin XVI. Në fëmijëri pati fatin të përjetojë rrethimin e parë osman të qytetit të Shkodrës, vendlindjes së tij, kurse në rrethimin e dytë (1478-79) edhe të marrë pjesë me armë në dorë në mbrojtje të tij. Pjesën më të madhe të jetës, për shkak të rrethanave të krijuara në Shqipëri, pas rënies së pothuaj të gjitha trojeve shqiptare nën sundimin e Perandorisë osmane, u shtrëngua ta kalojë në mërgim, në trevat e Venedikut.

Rreth 400 vjet më vonë, Fan S. Noli si fëmijë do ta përjetojë robërinë nën sundimin e Perandorisë Osmane, kurse si i ri do të veprojë përkrah patriotëve më meritorë shqiptarë për çlirimin e Shqipërisë nga ajo robëri. Edhe pse, më 1912, një pjesë e trojeve shqiptare u çlirua dhe e shpalli Pavarësinë, Noli, pothuaj gjithë jetën, u shtrëngua ta kalojë larg atdheut. Por, përderisa Barleti ishte i detyruar të marrë rrugën e mërgimit për shkak të rënies së pothuaj të gjitha territoreve shqiptare nën sundimin e Perandorisë Osmane, kundër së cilës edhe vetë kishte marrë pjesë me armë në dorë, Noli, paradoksalisht, edhe pse Shqipëria nuk ishte e pushtuar nga të huajt, pas dështimit të qeverisjes së tij demokratike (dhjetor 1924), për shkak të pasigurisë (nga kundërshtarët e tij politikë ishte dënuar me vdekje), deri në vdekje u shtrëngua të jetojë e të veprojë larg atdheut, por për atdheun.

Edhe Barleti edhe Noli, ishin edukuar dhe formuar si priftërinj, njëri i ritit katolik e tjetri i ritit ortodoks. Që të dy lanë të shkruara edhe vepra me karakter fetar, por në historinë e kulturës shqiptare vend të rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm do të zënë: Barleti si shkrimtar e historian, kurse Noli si veprimtar politik, si shkrimtar, si historian, si publicist, si përkthyes e si orator. Të rëndësishme për historinë e kulturës sonë mbeten sidomos veprat e tyre historiografike, veprat në të cilat trajtuan temën e atdheut dhe temat e tjera që lidhen me të kaluarën, me të tashmen dhe me të ardhmen e popullit që i takonin. Botimet dhe ribotimet e shumta të veprave të tyre historiografike në gjuhën e origjinalit dhe përkthimet dhe botimet e ribotimet edhe në shumë gjuhë të huaja, përbëjnë ngjarje më të rëndësishme për kulturën shqiptare.

Marin Barleti u formua si intelektual, falë njohjes së shkëlqyeshme të latinishtes, përmes së cilës njohu rrymat më të reja shkencore, letrare e artistike të kohës. Në stilin e historiografëve romakë, si: Gaj Jul Cezari, Kornel Nepoti, Gaj Salust Krispi, Perandori August, Vispan Agripa, Pompei, Trogu e sidomos Tit Livi, të cilin edhe e

citon, Barleti në dy veprat e tij historiografike: *Rrethimi i Shkodrës* (1504) dhe *Historia e jetës dhe e vepravet të Skënderbeut, princit të epirotëve* (1508-1510), rëndësi të veçantë i kushton paraqitjes objektive të ngjarjeve, përshkrimit të marrëdhënieve politike, situatave dramatike strategjike, si dhe fakteve të ndryshme gjeografike – etnografike. Krenaria për të kaluarën e lavdishme të popullit që i përkiste, qoftë ajo më e largët, e në veçanti ajo më e afërt që lidhej me emrin e kryeheroit, Gjergj Kastriotin Skënderbeun dhe malli i pashuar për atdheun, ndikuan në krijimin e botëkuptimeve e të botëpërjetimeve të tij, të cilat e kushtëzuan edhe përcaktimin e tij për zgjedhjen e përmbajtjeve të caktuara, të cilat karakterizohen me shprehjen e ndjenjave, të synimeve, të mendimeve e të idealeve më humane politike e shoqërore të popullit të vet. Stili i qartë, transparent e patetik me plot mjete retorike dhe me plot refleksione moraliste është një vlerë tjetër që veprat e tij i bën më interesante dhe më tërheqëse për lexim.

Në të dy veprat e Nolit kushtuar Skënderbeut: *Historia e Skënderbeut*, (Boston 1921) dhe *George Castrioti Scanderbeg* (Nju Jork, 1947), dashuria për atdheun dhe lirinë e tij, admirimi për origjinën ilire të popullit të vet, krenaria për bëmat e popullit shqiptar me në krye Skënderbeun përballë otomanëve, herë-herë edhe venedikasve, por edhe krenaria për monumentet letrare kushtuar atyre bëmave, të ngritura nga historiografët shqiptarë si Tivarasi e Barleti, shprehen në çdo kapitull, në çdo ngjarje e në çdo situatë.

Sipas shumë studiuesve, vepra "Historia e Skënderbeut" e priftit humanist Marin Barletit, vepra më me ndikim për lindjen e një letërsie të tërë shkencore historike, filozofike e letrare artistike kushtuar luftërave heroike të popullit shqiptar me në krye Skënderbeun kundër ekspeditave pushtuese të Perandorisë Osmane, u botua në Romë ndërmjet viteve 1508-1510. Noli, mbase nga admirimi për këtë vepër, që gjithsesi mbetet nga më të rëndësishmet për njohjen, jo vetëm të jetës dhe veprës së Skënderbeut, por edhe të ngjarjeve të tjera të rëndësishme në Ballkan e më gjerë, veprën *Historia e jetës dhe e vepravet të Skënderbeut* të Barletit e nxjerr të botuar dy vite më herët, më 1506-1508. Përveç botimit në Romë, kjo vepër e shkruar në bazë të të dhënave dhe kujtimeve të bashkëkombësve dhe të dëshmitarëve të tjerë të Motit të Madh, në gjuhën e origjinalit, d. m. th. në latinisht, u botua edhe tri herë dhe u përkthye në pothuaj në gjuhët kryesore europiane për t'u ribotuar disa herë, si në gjermanisht, italisht, frëngjisht, spanjisht e anglisht. [786] Derisa në gjuhën e origjinalit, në latinisht, vepra e Barletit "Historia e Skënderbeut" u botua disa herë dhe u përkthye në shumë gjuhë të tjera, duke u ribotuar disa herë, në gjuhën shqipe, në gjuhën e popullit për të cilin lidhen ngjarjet e veprës, u përkthye dhe u botua vetëm pas Luftës së Dytë Botërore. Gjatë Rilindjes Kombëtare, vepra "Historia e Skënderbeut" e Barletit u njoh vetëm nga disa intelektualë e patriotë shqiptarë që zotëronin mirë gjuhët e huaja dhe që mund t'i shfrytëzonin bibliotekat e qendrave më të njohura kulturore europiane. "Pjesë nga vepra "Historia e Skënderbeut" filloi të botojë organi arbëresh i Anselmo Lorechios "La nazione albanese" më 1900, ndërsa më më 1905

[786] Stefan I. Prifti, Hyrje, në librin: Marin Barleti, *Historia e jetës dhe e vepravet të Skënderbeut",* Rilindja, Prishtinë 1982, f. 10.

dhe 1912 qenë botuar dy studime të shkurtra rreth Barletit dhe Beçikemit në Shkodër dhe në Bruksel (revista "Albania"). [787]

Fan S. Noli, rreth 410 vjet pas botimit të veprës me ndikim "Historia e jetës dhe veprave të Skënderbeut... " (1508-10) të priftit e humanistit shkodran Marin Barleti, më 1921, në Boston, me ndihmën e Federatës Panshqiptare "Vatra", që vepronte në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, botoi veprën me titull të përafërt me atë të Barletit, "Historia e Skënderbeut", që është vepra e parë shkencore e historiografisë shqiptare, që në mënyrë të plotë trajton luftërat e popullit shqiptar me në krye Skënderbeun kundër ushtrisë më moderne të shekullit XV, ushtrisë së Perandorisë Osmane. Me këtë vepër Noli sikur nis jo vetëm t'i plotësojë zbrazëtitë e shumta të historiografisë shqiptare, por edhe t'i risë themelet e saj. Siç e kemi të njohur tashmë, zhvillimi i historiografisë shqiptare, pas ndërprerjeve të gjata (Barleti, Beçikemi, Frëngu, Muzaka, Bardhi) mori hov gjatë periudhës së romantizmit. Autorët si Thimi Krej, i cili përshtati apo përktheu një histori mbi Skënderbeun (1877); Zef Jubani, i cili la në dorëshkrim një histori mbi Skënderbeun; Naim Frashëri, i cili botoi veprën e tij në vargje "*Istori e Skënderbeut"* etj., kishin pretendime të qarta shkencore megjithëse veprat e tyre më parë mund të quhen histori të letrarizuara se sa vepra njëmend shkencore. [788] Në frymën e këtij disponimi dhe si vazhdues i përpjekjeve të rilindësve tanë për të shkruar historinë e popullit të vet, me qëllim që te lexuesit të ndikojë në formimin e tyre shpirtëror, në njërën anë dhe në anën tjetër përmes këtyre shkrimeve të ndikojë edhe në opinionin europian, e shohim edhe veprën "Historia e Skënderbeut" (1921) të Fan S. Nolit. Vite me radhë kjo vepër e shkruar me një gjuhë e stil tërheqës e të rrjedhshëm, si dikur vepra e Barletit, të cilën edhe Noli e pati mbështetje kryesore, ashtu si edhe rilindës të tjerë, u lexua me entuziazëm duke u bërë shumë popullore.

Sigurisht se kontekstet kohore të krijimit të veprave kushtuar Skënderbeut, asaj të Barletit dhe asaj të Nolit, janë të ndryshme: Barleti monumentin letrar historiografik për historinë e popullit shqiptar të personalizuar rreth figurës së Skënderbeut e shkroi dhe e botoi në fillim të shekullit XVI, kur Shqipëria kishte rënë nën sundimin e Perandorisë Osmane, kurse Noli të dy variantet e monumenteve të tij historiografike për Skënderbeun i shkroi dhe i botoi kur Shqipëria ishte çliruar nga sundimi shumëshekullor i Perandorisë Osmane dhe e kishte shpallur Pavarësinë. Nisur nga këto kontekste është me interes të vihen në pah edhe shtytësit e tjerë, përveç dashurisë për atdheun dhe krenarisë për origjinën, për t'i hyrë sipërmarrjeve të mëdha, ngritjes së monumenteve historiko-letrare shëmbëlltyrës sonë kombëtare, Skënderbeut.

Barleti, monumentin letrar të "Motit të Madh", veprën "*Historia e Skënderbeut... "*, ia kushton, siç na thotë në ballë të Parathënies, "*Kastriotasit Donferand, nipit të tij", d. m. th. nipit të Skënderbeut, "Princit shumë të ndritur të Epirotëvet"*. Ky Kastriotas atëherë jetonte i mërguar në Napoli, së bashku me shumë familje të tjera feudale shqiptare, të shpërngulura, kryesisht, pas rënies së atdheut të tyre nën sundimin e

[787] Mikel Prenushi, *Kontribut shqiptar në Rilindjen Evropiane,* Tiranë 1981, f. 116.

[788] Rexhep Qosja, *Historia e letërsisë shqipe-Romantizmi I, "*Rilindja", Prishtinë 1984, f. 171-172.

Perandorisë Osmane. Tek familja e Kastriotëve, Barleti kishte besim të madh, sepse ajo që atëherë ishte bërë simbol i bashkimit të shqiptarëve. Kastriotët gëzonin autoritet dhe besim jo vetëm tek feudalët e tjerë shqiptarë, por edhe tek shtetet europiane. Barletin ende e mbante shpresa e organizimit të ndonjë kryengritjeje vendimtare shqiptare për çlirimin e atdheut, sepse tek shumë bashkëkombës ende shihte vullnet, dëshirë dhe gatishmëri për sakrifica të reja për çlirimin dhe kthimin në atdhe. Duke pasur parasysh rezistencën dhjetëvjeçare shqiptare për mbrojtjen e kështjellave edhe pas vdekjes së Skënderbeut, përpjekjet e të birit të Skënderbeut, Gjonit dhe më vonë edhe të nipit të Skënderbeut, Gjergjit, i njohur me emrin Skënderbeu i Ri, për organizimin e kryengritjeve të përgjithshme për çlirimin e atdheut, Barleti besonte se vepra e tij me bëmat e Skënderbeut, do t'i ndërgjegjësonte dhe do t'i mobilizonte edhe më shumë bashkëkombësit e tij.

Nga të dy parathëniet e "Historisë së Skënderbeut" të Marin Barletit, një nga biografët më të mëdhenj të Skënderbeut, siç e quan Noli, njëra në fillim të veprës dhe tjetra pas kapitullit (librit) të gjashtë, të shkruara nga vetë autori, mësojmë se vepra u shkrua kur Barleti ishte në moshë të shtyrë, kur "*fuqitë për të shkuar më tej, përpara, po e linin*"[789] dhe se vepra u shkrua pas shumë hamendjeve dhe pas pritjes së gjatë të autorit se mos "*kjo lëndë kaqë e gjerë të nxiste ndonjë shkrimtar*. "[790]

Ndryshe nga Barleti, Noli ndërmarrjes për t'i dhënë popullit të vet një histori të Skënderbeut, i hyri shumë më i ri, pa përvojën e mjaftueshme përballë një lënde sa të madhe e të pashtershme, po aq edhe të panjohur dhe vështirë për ta pasur në dorë. "*Libri i vitit 1921 ishte shkruar më tepër me dorën e letrarit patriot, se sa të një historiani kritik; ai mbështetej kryesisht mbi burime të dorës së dytë, siç ishin biografitë e Heroit të shkruara në kohë të vona, kurse burimet e dorës së parë, materialet arkivale bashkëkohëse, Noli atëherë ose nuk i njihte, ose nuk i kishte në dorë.* "[791]

Barleti veten nuk e konsideronte të zotin të shkruante për një figurë e për ngjarje aq të lavdishme, prandaj me modesti thoshte: "*duhet të ruhemi fort që lënda të mos ia kalojë pendës.* "[792] Kjo thënie e Barletit në një formë sikur kishte reflektuar në Nolin, sepse e kishte kuptuar se pikërisht në veprën e tij, atë të vitit 1921, lënda ia kishte kaluar pendës. Prandaj, 25 vjet më vonë, i vetëdijshëm se heroi i tij, Skënderbeu "*shembëllente më tepër me një figurë legjendare se sa me një figurë reale, historike,* "[793] dhe i vetëdijshëm se vepra e tij vuante edhe nga shumë të meta të tjera, Motit të Madh dhe personalitetit të shumanshëm të Skënderbeut i kthehet edhe një herë. Dashuria për atdheun dhe veprat heroike të Skënderbeut dhe të bashkëluftëtarëve të tij, pasardhës të Pirros e të Aleksandrit, ashtu si Barletin, që nuk e kishin lënë të qetë, por, përkundrazi, e kishin nxitur të shkruajë për to, edhe Nolin dashuria për të vërtetën

[789] Marin Barleti, *Historia e Skënderbeut,* Prishtinë 1982, f. 285.
[790] Po aty, f. 47.
[791] Aleks Buda, *Fan S. Noli, historian I Skënderbeut.* Në librin: Fan S. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu,* "Rilindja, Prishtinë 1968, f. 12.
[792] Barleti, Vep e cit., f. 47.
[793] Aleks Buda, Vep e cit., f. 12.

shkencore nuk do ta linte të qetë. Duke qëmtuar pas dëshmive të reja, ai Skënderbeut dhe bashkëluftëtarëve të tij do t'u ngrinte një përmendore edhe më të madhe e më të fortë historiografike. Noli nuk mund të qëndronte indiferent përballë shumë historianëve kritikë, të cilët pretendonin se numri më i madh i fitoreve të Skënderbeut ishin pak a shumë të zmadhuara prej biografëve të tij, gjë që ai nuk mund edhe ta mohonte plotësisht, aq më shumë nuk mund të qëndronte indiferent përballë përfundimeve të disave se "*gjithë historia e Skënderbeut është një ballon i fryrë*. "[794] Në këtë kontekst, Noli duke iu kundërvënë historianëve, që nuk ishin të pakët, të cilët i zhvlerësonin luftërat e Skënderbeut, njëkohësisht vihej në mbrojtje edhe të biografëve më meritor për gëzimin e famës së Skënderbeut shekuj me radhë në mbarë Evropën, Tivarasit, e sidomos Barletit.

Shpjegimi i arsyeve për t'iu rikthyer historisë së Skënderbeut në Hyrjen e veprës së vitit 1947, të mbrojtur një vit më parë si disertacion doktorate, na e kujton tonin polemizues të Barletit në parathëniet e veprës së tij. Barleti, përveç që në moshë të shtyrë e kishte nisur punën e madhe, ai ishte edhe i revoltuar me sjelljen e papërgjegjshme të autorëve të shkrimeve të ndryshme me fjalime e kujtime të parëndësishme në krahasim me veprën e Skënderbeut: "*Por asnjeri gjer tani s'e ka preferuar një mund kaqë të shenjtë, me gjithë që nuk pushojnë së botuari çdo ditë (më falni për shprehjen) fjalime të reja me kujtime të panumura, gjer në çpërdorim, sikur të mos jetë me të vërtetë më e shenjtë dhe më e bukur që t'u lësh brezave të ardhshëm trimërinë që kanë bërë të tjerët, se sa kujtimet që kemi pasur vetë, me qëllim që nga eksperienca e tyre shembëllat për qeverisjen e shtetevet dhe të popujvet të dalin më të sigurta se sa mësimet nga porositë tona. Nuk mund të qëndronja, pra, më gjatë, që të flas më lirisht, në një turp të tillë të një shpirti mosmirënjohës bashkë me të tjerët, dhe preferova që të dukem ndoshta, për ata që meritojnë kështu, më fort i pacipë sesa disi malok.* "[795] Kur flet për këto shkrime shpërdoruese, Barleti nuk lë shumë për të nënkuptuar se fjalën nuk e ka për shkrimtarë të huaj, por për autorë shqiptarë, të cilëve, më shumë se të tjerëve, u takonte të shkruanin për të kaluarën e atdheut të tyre dhe për figurën shembullore të Skënderbeut, para se të shkruanin kujtime e gjenealogji për familjet e tyre. "Historia e Skënderbeut" e Marin Barletit ishte përgjigjja më e mirë ndaj shkrimeve panegjirike të autorëve të ndryshëm të historive gjenealogjike e të kronikave familjare që i madhonin veprat e të afërmve të tyre. Duket se Barleti me këtë vepër ua ndali hovin shkrimeve të tilla, madje ato për t'u botuar do të prisnin disa dekada, derisa pasardhësit e autorëve të tyre të merrnin guximin. Me "Historinë e Skënderbeut" Barleti, pothuaj në çdo aspekt i tejkaloi shkrimet e bashkatdhetarëve të vet.

Noli në kapitullin VII, ku bën komentimin e burimeve të veprës së vet, burime kryesore letrare shqiptare për historinë e Skënderbeut i konsideron biografët e mëdhenj shqiptarë: Tivarasin dhe Barletin, kurse autorët e gjenealogjive dhe të kronikave familjare, të cilët në parathënien e vet Barleti i kishte qortuar, i konsideron

[794] Fan S. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu, "*Rilindja, Prishtinë 1968, f. 42.
[795] Barleti, Vep e cit., f. 47.

biografë të radhës së dytë[796]. Në këtë kapitull, komentet për Barletin Noli na i jep kryesisht përmes vlerësimeve të historianëve të tjerë për të. E ata nuk ishin pak. Sipas Nolit, i cili mbështetet në të "Bibliografinë" e Petroviçit, vepra e Barletit ishte bërë burim bazë për krijimin e rreth 200 veprave të ndryshme kushtuar Skënderbeut[797]. Në veprën e Nolit kushtuar Gjergj Kastriotit Skënderbeut, emri i Barletit zë vend të posaçëm. Pas Skënderbeut, ai është emri më i përmendur. Pothuaj nuk ka asnjë ngjarje që në vepër komentohet e autori, të mos i referohet Barletit. Edhe në kapitullin VIII, ku në kronologji flet për vepra dhe përmbledhje burimesh të shfrytëzuara, bën komente të shkurtra, duke i theksuar kopjuesit, përkthyesit apo mbështetësit në mënyra të ndryshme të veprës së Barletit, si: Sansovino, Noulës, Dyponse, Sismond, Hamer, Paganel, Fallmerajer, Makushev, Pizani, Armstrong, Barbariç, Babinger etj., por edhe kritikuesit e tij, si: Spondano, Gibbon, Fojgt, Jorga etj. Gjithsesi, mbetet shumë i kuptueshëm kujdesi i veçantë i Nolit ndaj fakteve që ofron vepra "Historia e Skënderbeut" e Marin Barletit, kur kemi parasysh Nolin historian, por edhe admirimin që jo gjithnjë mund ta fshehë ai për përmbajtjen e shumanshme të saj, për të dhënat e shumta, pothuaj enciklopedike, për historinë e një periudhe shumë të rëndësishme të popullit shqiptar.

Duke ia kushtuar talentin e vet prej historiani dhe prej letrari përjetësimit të ngjarjeve të periudhës më të lavdishme të historisë së popullit shqiptar, luftërave me në krye Skënderbeun, kundër pushtuesve osmanë, Barleti përgjithmonë, emrin e vet e lidhi me emrin e Skënderbeut dhe vepra e tij, shekuj me radhë, u bë burim frymëzimi për lindjen e një letërsie të tërë historiografike e letrare artistike në pothuaj të gjitha gjuhët më me ndikim të Evropës. Njëherësh, me veprën "*Historia e Skënderbeut... "*, por edhe me *"Rrethimi i Shkodrës"*, Barleti kulturën shqiptare e përfaqësoi denjësisht në lëvizjen e madhe kulturore të Rilindjes Evropiane. Edhe Noli me të dy veprat kushtuar simbolit më përbashkues të shqiptarëve, Gjergj Kastriotit Skënderbeut, gjithnjë duke i pasur mbështetjen më të fortë veprat e historiografëve të parë shqiptarë (Tivarasin e Barletin), mbetet njëri nga historiografët më të rëndësishëm skënderbegianë. "*Me punimin e vitit 1921, ai përfaqëson kalimin nga historiografia rilindase romantiko-letrare në historiografinë postrilindase romantiko-shkencore*"[798], kurse me disertacionin e vitit 1947, ashtu si dikur Barleti që u bë frymëzues i shumë veprave të tjera kushtuar kryeheroit tonë, Noli, duke e shtruar për studim problemin e Skënderbeut në një plan të ri, më të ngritur, me pikëpamje më të përparuara, historiografinë shqiptare e kaloi në një fazë shumë më të avancuar në atë kritike-shkencore.

[796] Fan S. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu (1405 – 1468),* "Rilindja", Prishtinë 1968, f. 154.
[797] Po aty, f. 157.
[798] Flamur Hadri, *Fan S. Noli në historiografinë skenderbegiane,* Në librin: Fan S. Noli në 100-vjetorin e lindjes 1882-1982, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1984, f. 182.

IRENA NIKAJ

NAPOLEONI, SHEKULLI I DRITAVE DHE NOLI-NJË JEHONË NOLIANE NË KOHË TË TJERA

"Göttern schadet nichts"
Me perënditë nuk matesh dot

1. Shekulli i Dritave dhe revolucioni i 1793-it

Iluminizmi i njohur me përcaktime *Aufklärung* në gjermanisht, *Lumières* në frëngjisht, sipas I. Kantit, ishte një arritje e njerëzimit tek emancipimi i vetëdijes nga gjendja e papjekur e injorancës dhe gabimit. Sqarimi i rolit të kësaj epoke të arsyes në zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë ka tërhequr vëmendjen e mendimtarëve të rëndësishëm të modernitetit dhe pasmodernitetit, duke iu referuar B. Rusell-it, P. Gay. Sipas P. Gay, Iluminizmi prishi atë rreth të shenjtë brenda të cilit dogma kishte burgosur mendimin(P. Gay, 1967: 72).

Shekulli i Dritave themeloi hapësirën publike që karakteristikë të qartë shpalli diskutimin racional, kritik dhe të çiltër të çështjeve publike, ose ndryshe themelimi i hapësirës publike borgjeze, shpërthimin e kulturës së shkrimit, arritjet madhështore, veçanërisht, në muzikë etj.

Franca është revolucionare në thelbin e vet dhe eci rrugës së modernitetit me Revolucionin, Napoleonin dhe me reforma tërësore. Shekulli i Dritave kulmoi në mënyrë paradoksale me Revolucionin Francez, që ndryshoi të ardhmen e Evropës; paradoksale sepse Franca e salloneve ku mblidheshin e diskutonin idetë dhe teoritë e tyre maja e ideologëve dhe mendimtarëve të Evropës, për të bërë ndryshimin e madh politik bëri Revolucion, dhe ky revolucion ishte më tronditësi, më transformuesi jo vetëm në Evropë, por jehona e ndikimi i tij ishte global. Idetë shkencore dhe kulturore të Iluministëve dhe realizimet politike dhe shoqërore të Revolucionit shërbyen për të ndryshuar edhe rrjedhën e fatit kombëtar dhe kulturor të shumë kombeve evropianë. Zhvillimi i Evropës pas Revolucionit të 1793-it është shumë francez në politikë dhe shumë gjerman në filozofi, kulturë dhe letërsi.

2. Bonapart

Vepra dhe personaliteti i tij rilindi mitin e Evropës që përparonte në rrugën e reformave dhe transformimit drejt modernitetit. Pak njerëz kanë sunduar kohën e tyre në mënyrë kaq gjithëpërfshirëse sa Bonaparti. Por shumë prej admiruesve të tij, Perandori u kujtonte të kaluarën dhe nuk i bindte për të ardhmen, prandaj dhe e kundërshtuan brenda Frances, dhe në gjithë Evropën.

Fjalët e fundit të Bonapartit ishin: Franca, ushtria, kreu i ushtrisë, Josephine. Pas vdekjes së Napoleonit, governatori anglez i Shën Elenës, Sir Hudson Lowe diskutoi me francezët lidhur me mbishkrimin e varrit: "Napoleon Bonapart apo Perandori Napoleon; nuk ranë dakord dhe varri mbeti pa emër, ndërsa u plotësua dëshira e fundit: Dëshiroj që hiri im të prehet në brigjet e Senës-shprehu dëshirën e vet Napoleon Bonaparti-ai prehet në mazoleun e krijuar për nder të tij në Muzeun e Armëve, vendi i Heronjve të Francës.

3. Revolucioni Francez, Bethoveni, Noli dhe Shqipëria e pas 1944-ës

Me një vepër si "Bethoveni dhe Revolucioni Francez" botuar në 1947, Noli doli para opinionit publik në përgjithësi dhe shqiptar për të dëftyer, sipas nesh, mësimet e rëndësishme që ai kishte nxjerrë nga përvoja dhe bëmat e veta në frymë revoucionare, për t'u folur shqiptarëve të pas luftës se çfarë gabime mund të bënin po aq tragjikisht sa ato që bëri Noli dhe të vetët gjatë Revolucionit dhe pas revolucionit të 1924-ës.

Në fakt duket se Noli ka treguar interes për të shkruar për frymëzimin që ideologjia e Revolucionit francez, dhe posaçërisht roli i Reformatorit më të madh, Bonapart kanë luajtur në krijimin e sinfonisë së tretë, të nëntë dhe operas "Fidelio" të kompozitorit filozof më të madh, gjigantit Ludwig van Beethoven.

Kjo është faksimile e fletës së parë të "Sinfonisë së tretë" që Bethoveni e quajti "Bonapart, "sepse vlerësonte shumë rolin e Napoleon Bonapartit si konsull i Francës, për ta ndryshuar këtë dedikim, ndërsa Napoleoni shpallej Perandor, në "Heroike". Ndryshimi i dedikimit u bë, sepse Bethoveni mendonte se si perandor ai do të shkatërronte gjithë ato ndryshime rrënjësore që frymëzoi Revolucioni dhe ai si një prej më të shquarve në mbrojtje të Republikës, ashtu si mendonte se kjo kthese ishte kthesë drejt tiranisë, drejt babëzisë për pushtet dhe terrorit ndaj kundërshtarëve.

Vepra e Nolit "Bethoveni dhe Revolucioni francez" shfaqet në vitin 1947, pas shumë veprave që ishin shkruar për Bethovenin dhe muzikën e tij, por edhe për marrëdhëniet e tij me Revolucionin francez të 1793-shit. Këtyre shkrimeve Noli u kthehej pas një kohe relativisht të gjatë që nuk merrej me shkrime dhe studime. Mendojmë se më shumë sesa për të plotësuar bibliografinë e veprave kushtuar dy gjigandëve që transfomuan epokën kur jetuan, Noli shkroi për Bethovenin dhe Napoleonin, duke pasur synim të jepte opinionin, pikëpamjet e veta në lidhje me Shqipërinë dhe atë që duhej të shoqëronte organizimin e qeverisjen e shoqërisë shqiptare pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore.

Mund të kujtojmë që Noli kishte mendimin se nëse Napoleoni nuk i rezistoi tundimit për t'u bërë i pavdekshëm dhe e shpalli veten Perandor, kjo nuk ishte ndonjë ngjarje që nuk mund të ndodhte në Shqipëri: shembujt nuk mungonin, Zogu nga President e shpalli veten Mbret të Shqiptarëve. Po kështu mund të ndodhte dhe me forcat e reja që kishin marrë pushtetin në Shqipëri dhe rreziku nuk qendronte tek forma që i jepnin sundimit të tyre, por tek ambicia për të sunduar, për të mbajtur pushtetin me dorë të fortë, qeverisje kjo që s'ka asgjë të përbashkët me dëshirën, synimet e grupeve më të

përparuara të mendimtarëve shqiptarë, atdhetarëve dhe veprimtarëve të çështjes shqiptare të cilët ëndërronin që një ditë Shqipëria të hynte në familjen e popujve të qytetëruar perëndimorë, të ndërtonte një shtet demokratik e të qeverisej nga dashuria dhe jo nga urrejtja e ndasitë.

Duket se frika e meraku i Nolit, sipas nesh, kishte bazë dhe u vërtetua nga rrugëtimi i vështirë i Shqipërisë gjatë pjesës më të madhe të gjysmës së dytë të shekullit XX, përmes varfërisë, prapambetjes ekonomike dhe mungesës së lirisë.

Në përfundim, duam të bëjmë me dije se shekulli i Elegancës, Iluminizmit dhe Revolucionit ka pasur një ndikim të madh në përpjekjen e Nolit për të sugjeruar konturet e shoqërisë shqiptare të Pasluftës. Ndoshta në këtë kuadër ai e botoi në 1947 "Bethoveni dhe Revolucioni francez", për të risjellë karakteristikat e modernitetit europian dhe për të grishur shqiptarët që me forcë intelektuale, me delikatesë, por me vendosmëri dhe pa ekstreme t'i drejtohen modernitetit të munguar në hapësirat e tyre sociale.

ORJON AGO

VEPRIMTARIA POLITIKE E FAN NOLIT NË VITET 1923- 1924 SIPAS SHTYPIT TË QYTETIT TË KORÇËS

Veprimtaria e gjithanshme e Nolit dhe jeta e tij aktive në politikë në vitet 1920-1924 më shtynë për të trajtuar punimin me temë: "Veprimtaria politike e F. S. Nolit në vitet 1923-1924 sipas shtypit të qytetit të Korçës". Qëllimi i punimit është zbardhja e veprimtarisë së tij parë nga një këndvështrim ndryshe, pra nga shtypi i qytetit të Korçës për kohën në të cilën po flasim. Punimi, veç qëllimit kryesor, ka edhe një qëllim tjetër ndonëse dytësor që të tregojë se në çfarë shkalle është gazetaria e kohës si i shikon dhe trajton këto ngjarje.

Në vitin 1920 Noli vjen në Shqipëri si delegat i "Vatrës" për në Parlamentin shqiptar. Tashmë ai ishte i mirënjohur në Shqipëri për aktivitetet e tij në mbrojtje të shtetit Shqiptar. Në vitin 1920 ai mori pjesë në Kongresin e vendeve të shtypura në Washington ku takoi Uillsonin dhe i shpjegoi atij çështjen shqiptare. Në vitin 1920 ai ishte delegat i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve duke mbrojtur me sukses çështjen shqiptare. Është e njohur shprehja e Kryeministrit grek Venizellos kur ai nuk mundi t'i bashkonte Greqisë, Shqipërinë e Jugut ose Epirin e Veriut siç e quante ai. Më mundi "Vatra" u shpreh dhe pikë së pari me këtë ai i referohej Nolit.

Pas ardhjes në Shqipëri Noli mori pjesë aktivisht në politikë dhe ishte pjesë e dy kabineteve qeveritare si ministër i Jashtëm. Nga fundi i vitit 1922 ai u terhoq disi nga jeta politike duke u marrë me veprimtari fetare. Por nga gjysma e dytë e vitit 1923 ai rikthehet në jetën aktive politike. Ai fillon të mbajë disa konferenca ku parashtron idetë e tij, propozon amnisti për të larguarit politikë, kritikon qeverinë, mban fjalime në politike në parlament[799]. Mjaft i njohur është fjalimi që Noli mban në Parlamentin shqiptar me rastin e vdekjes se ish-presidentit amerikan Uillson. Ai formon Partinë Liberale dhe harton programin e kësaj partie. Ky program është mjaft përparimtar për kohën, përmendim kështu pikën për të drejtë vote të përgjithshme dhe të fshehtë, garantimin konstitucional kundër diktaturave, decentralizimin e bashkive, lirinë e fjalës, të shtypit, të ndërgjegjies etj. [800] Noli bëhet kështu përfaqësuesi kryesor i opozitës ndërsa qendra e veprimtarisë së tij është në Korçë, por ai nuk arrin që të krijojë një opozitë të mirëfilltë të bashkuar. Në qytete të ndryshme formohen grupe politike që janë kundër politikave të qeverisë, por që nuk kanë bashkëpunim mes tyre. Ky mos rakordim ndoshta është edhe një nga shkaqet e humbjes së zgjedhjeve nga opozita.

Zgjedhjet ishin parashikuar të mbaheshin me dy raunde. Në raundin e parë do të marrin pjesë të gjithë meshkujt me të drejtë vote të cilët do të zgjedhin delegatët.

[799] *Gazeta Koha,* Korçë, 25 gusht 1923, fq. 1

[800] *Po aty*, 13 tetor 1923, fq. 2

Zgjedhësit e dytë pra delegatët zgjidhin anëtarët e Asamblesë Kombëtare. Kjo mënyrë votimi u kritikua nga opozita dhe nga Noli, por edhe nga shtypi. Me të drejtë u ngrit pyetja. A voton zgjedhësi i dytë për atë që dua unë? Noli dhe mbështetësit e tij debatojnë në parlament kundër këtij ligji. Në këtë atmosferë u mbajtën zgjedhjet.

Në një shkrim me titull, Fryma Kombëtare e *Gazetës së Korçës* e 18 dhjetorit 1923 konstatojmë se autori i bën një trajtim disi ndryshe atmosferës së zgjedhjeve. Shkrimi nuk trajton programet apo partitë politike që marrin pjesë në zgjedhje, por ai trajton frymën me të cilat u zhvilluan ato. "*Në votimet e qytetit tonë triumfoj Nacionalizmi. Fryma e propagandës së huaj pas shumë vojtjesh u ç'rrënjos, nga qarku i ynë dhe për të cilën gjë duhet të gëzohemi të gjithë"*. [801] Gjithashtu autori duke mbajtur një qëndrim neutral shprehet se asnjë nga grupet nuk mund të pretendojë fitoren.

Ndërsa në shkrime të tjera vihen re pozicionet e ndryshme që mbajnë gazetat për fitoren e njërës apo tjetrës palë. Kështu gazeta *Zëri i Popullit* aludon për triumfin e Grupit Popullor të Korçës. *"Fitimi i plotë i këtij grupi është parashikuar që më parë, po ditët e fundit ca mosmarrëveshje në qarket dhe veçanërisht roli i Dollarit më një krahinë shkaktuan humbjen e 4 kantidatëve të këtij grupi. Thamë që fitimi ishte siguruar që më parë duke marrë parasysh simpathinë që ndjen populli për anëtarët e këtij grupi dhe me të vërtet e tregoj dhe këtë herë si shumë herë të tjera"*. [802] Kurse në një shkrim të gazetës *Shqiptari i Amerikës* tregohet se si funksionarë të qeverisë përdorën funksionin e tyre për të ndikuar mbi zgjedhësit për të fituar zgjedhjet dhe sipas kësaj gazete ky ishte shkaku që liberalët humbën zgjedhjet në Korçë. [803]

Periudha paszgjedhore karakterizohet nga përplasje të forta midis pozitës dhe opozitës. Këto përplasje aritën kulmin me plagosjen e Kryeministrit Ahmet Zogu në Parlament nga Beqir Valteri. Kjo ngjarje e detyroi Zogun të japë dorëheqjen. Hije dyshimi mbi këtë plagosje ranë mbi opozitën. Krijimi i qeverisë së re nuk ishte aspak i lehtë pasi amullia ekzistonte në të dy kahet e kundërta të politikës. Në këtë situatë të ndezur zgjidhja e problemeve në politikën shqiptare të kohës përfshinte të gjitha mjetet. Në 20 prill 1924 plagoset Avni Rustemi dhe pak ditë më vonë ai vdes. Titulli i një shkrimi i *Gazetës së Korçës* i datës 26 prill 1924 paralajmëron në mënyrë të saktë se si do të rridhnin ngjarjet. Më konkretisht ajo shprehet: "*Vrasja e Avni Rustemit bëri përshtypje të keqe në të gjithë Shqipërinë. Do të influencojë drejtimin e politikës generale*". [804] Në një reagim të disa ditëve më vonë kjo gazetë me anë të një artikulli ''Të bindet njëra palë''[805] pasi analizon situatën e vështirë bën apel për qetësi. Autori sqaron se një situatë e ngjashme kishte qënë edhe ajo e vitit 1914, që kishte çuar më pas në prishjen e shtetit.

Opozita e larguar në Vlorë për të varrosur A. Rustemin i kërkon prej andej qeverisë plotësimin e disa kërkesave. E para, *e arsyeshme* që kishte të bënte me kapjen dhe dënimin e vrasësit të A. Rustemit, por edhe të dy qytetarëve amerikanë të vrarë në

[801] *Gazeta e Korçës,* Korçë, 18 Dhjetor 1923, fq. 2
[802] *Zëri i Popullit,* Korçë, 5 Janar 1924, fq. 1
[803] *Shqiptari i Amerikës,* Korçë, 11 mars 1924, fq. 2
[804] *Gazeta e Korçës,* Korçë, 26 prill 1924, fq. 1
[805] *Po aty*, fq. 2

Shqipëri. Kërkesa tjetër, *politike* kishte të bënte me moslejimin e qëndrimit të Ceno Bej Kryeziut në Krumë, i cili kishte hyrë i armatosur me një grup mercenarësh në këtë krahinë, veprim i cili sipas opozitës përbënte një akt antikonstitucional dhe antikombëtar. [806]

Dhe në të vërtetë ngjarjet siç ishin parashikuar morën një rrjedhë tjetër. Po kjo gazetë njofton se anëtarët e Kuvendit që ishin larguar në Vlorë nuk e njohin qeverinë e Tiranës dhe se një nga anëtarët e Këshillit të Lartë Z. Gjon Çobo kishte dhënë dorëheqjen, kurse regjimenti i Përmetit ishte bashkuar me opozitën. [807] Siç edhe duket ky është momenti kur Zogu është më i dobët se kurrë dhe këtë moment kundërshtarët e tij politikë kërkojnë ta shfrytëzojnë me çdo kusht. Ngjarjet janë të vrullshme dhe vetëm dy ditë më vonë kërkesat e kundërshtarëve të tij vijnë duke u rritur. Në një shpallje botuar te *Shqiptari i Amerikës*, Komandanti i Regjimentit të Shkodrës Rexhep Shala, i dërgon ultimatum qeverisë dhe i kërkon asaj që Zogu të largohet jashtë Shqipërisë. Veç kësaj shkrimi sjell në dije se Shkodra dhe Kosova janë në sinkron me ngjarjet që po ndodhin në Vlorë dhe Përmet. [808] Disa ditë më vonë të njëjtën gjë bëri dhe kryekomandanti i fuqive ushtarake të Jugut nën-kolonel Kasëm Qafëzezi nën justifikimin se: "*Ushtria Kombëtare, e cila ka për detyrë të lartë patriotike të shpëtojë atdhenë nga rreziku ku ndodhet, të sigurojë qetësin e lirinë personale nuk mundet të rrinjë Sehirixhi me duar lidhur përpara kësaj pamjes tragjike të shkatërrimit të përgjithëshm.* "[809]

Të marra në tërësinë e tyre, këto ngjarje shpjegohen qartë dhe nga vetë protagonistët mbi bazën e një pyetje që i është bërë atyre nga "*Gazeta e Korçës"*. Pyetjes : *Cila është gjendja e sotme e punëve*? A. Zogu i përgjigjet: për situatën që ndodhemi çdo patriot duhet të përkrahë me çdo mënyrë qeverinë për shpëtimin e atdheut ndërsa për ata që veprojnë jashtë ligjit do të përdoret forca. Një qëndrim krejt ndryshe mban Fan Noli i cili përkrah veprimet e ushtrisë kundër qeverisë, duke theksuar se është detyrë patriotike të përkrahet vepra e saj. [810] Të gjitha përpjekjet për qetësimin e situatës duket se janë të pasuksesshme. Qeveria e Tiranës nuk është e aftë të vendosë qetësinë dhe të bëjë kompromise. Përfaqësuesit e Asamblesë të larguar në Vlorë e kanë kuptuar se ky është momenti i tyre për të marrë pushtetin, ata formojnë një Komision Administrativ ndërsa Noli bëhet kryetar i tij. Ai vepron shumë aktivisht dhe me anë të shtypit ai i dërgon një sërë mesazhesh popullit, grupimeve të caktuara shoqërore dhe politike. Arsyet e këtyre veprimeve kundër qeverisë ai i sqaron në një mesazh të botuar në Gazetën e Korçës. *Njëra arsye thotë ai është përpjekja e një grupi bejlerësh feudalë që përveç pushtetit që kishin kërkonin të uzurponin dhe Kuvendin Themeltar. Përpjekjet e opozitës për të mbrojtur lirinë e këtij institucioni çuan në vrasjen e A. Rustemit. Por sipas Nolit populli, ushtria shqiptare dhe deputetët liberalë i*

[806] *Po aty*, 6 Maj 1924, fq. 1
[807] *Po aty*, 27 Maj, 1924, fq. 1
[808] *Shqiptari i Amerikes,* Korçë 29 Maj 1924, fq. 3
[809] *Po aty,* 3 Qershor 1924, fq. 4
[810] *Gazeta e Korçës,* Korçë, 31 Maj 1924, fq. 1

kundërshtuan këto veprime dhe marshuan drejt Tiranës. Kjo lëvizje sipas tij ka karakter të brendshëm dhe nuk ndryshon asgjë në politikën e jashtme. [811]

Në 16 qershor formohet qeveria e re dhe në këtë kabinet Noli është Kryeministër. Një ish- ministër i qeverisë së mëparshme dhe dy ish- komandantë të lartë të ushtrisë shqiptare janë pjesë e saj. Siç del edhe nga ngjarjet e mësipërme ata kanë një rol të rëndësishëm në rrëzimin e qeverisë së mëparshme. Kështu sipas parimit të shpërblimit ata marrin poste të rëndësishme dhe për një periudhë të shkurtër nga nënkolonel ushtarak bëhen ministra të Mbrojtjes dhe të Luftës.

Shtypi i kohës u kushton rëndësi këtyre ngjarjeve. Një pjesë e shtypit të kohës së qytetit të Korçës është indiferent, p. sh gazeta "*E drejta"*, ndërsa pjesa më e madhe përkrah këto zhvillime. Në faqet e shtypit të këtyre ditëve hasim një sërë mesazhesh përshëndetëse. Me interes për t'u parë është një shkrim i dates 17 qershor 1924 i gazetës *Shqiptari i Amerikës* i cili i jep lëvizjes një karakter kombëtar me pjesëmarrje të gjerë popullore. Gazeta *Koha* raporton në datë 14 qeshor për një miting të madh, me pjesëmarrjen e 10000 vetave, për të përshëndetur këtë fitore. Në një shkrim tjetër të po kësaj date i bëhet jehonë Ushtërisë Kombëtare, për rolin e saj dhe përkrahjen që i dha opozitës. [812] Pas formimit të qeverisë, Noli dhe kabineti i tij hartuan një program prej 20 pikash vërtet ambicioz për kohën. Duke iu përmbajtur temës "tonë" nuk do ta analizoj atë pikë për pikë pasi ai është vërtet i mirëstudiuar, por do të trajtoj ato çfarë kërkon shtypi i Korçës nga kjo qeveri. Në artikullin e saj të 21 qershorit 1924 me titullin"Ç'presim nga qeveria e re? " "*Gazeta e Korçës"* kërkon që qeveritarët e sotëm të mos bëjnë punë gjysmake dhe pa dobi si ata të djeshmit. Së dyti, e rëndësishme është çështja financiare dhe balancimi i buxhetit. Së treti, autori kërkon të përkrahen elementet nacionaliste prej nga qeveria pretendon se rrjedh dhe, së katërti, është e nevojshme ndryshimi i disa nëpunësve dhe zëvendësimi i tyre me njerëz të zotë. [813] Po kjo gazetë një ditë më parë kishte botuar një shkrim lidhur me disa nga pikat e tjera të programit duke i parë ato si të parealizueshme duke qenë se ato binin në kundërshtim me karakterin shqiptar të kohës. Çarmatimi i përgjithshëm i popullsisë, citon gazeta është i pakuptueshëm pasi kush e njeh shqiptarin e kupton fare mirë që ai më tepër dëshiron armët se një shtëpi. Madje ajo vijon duke konstatuar se çarmatimi i popullsisë ka sjellë gjithmonë kryengritje dhe shpreson që këtë herë populli të mos ngrihet kundra qeverisë së Nolit. Pika që ka të bëjë me reformën e tokës, vijon më tej gazeta do të haste kundërshtimin e bejlerëve të cilët do bënin ç'ishte e mundur për të mos humbur tokat e tyre megjithëse ata cilësohen si shkaktarët kryesorë të gjendjes së mjeruar në të cilën ndodhej Shqipëria. [814]

Kurse gazeta "*Shqiptari i Amerikës"* ka një qasje disi ndryshe. Ajo i kërkon qeverisë që ta zbatojë programin pikë për pikë dhe populli nga ana tjetër të bindet duke shfaqur

[811] *Po aty*, 14 Qeshor 1924, fq. 1
[812] *Koha*, Korçë, 14 Qeshor 1924, fq. 1
[813] *Gazeta e Korçës,* Korçë, 21 Qershor 1924, fq. 2
[814] *Po aty, 20 Qeshor 1924, fq* 4.

jo vetëm dëshirën por dhe punën. Në këtë shkrim kjo gazetë i bën thirrje popullit të jetë më i durueshëm me qeverinë dhe t'i japë asaj kohën e nevojshme. [815]

Siç edhe na del nga këto shkrime qeveria e Nolit ka përpara sfida të mëdha. Së pari, asaj i nevojitet legjitimiteti brenda vendit dhe kjo nuk mund të bëhet tjetër përveçse me anë të zgjedhjeve. Noli e parashikon këtë në programin e tij, por nuk ngutet dhe këtu na del një Noli tjetër nga ai që kemi njohur deri në këtë kohë. Në një intervistë të botuar tek "*Gazeta e Korçës"* ai e përshkruan Parlamentin e mëparshëm si shërbëtor të qeveritarëve dhe tashmë që Kuvendi Themeltar është shpërbërë, qeverisja pa Parlament në këtë moment është më e mirë. Fillimisht duhen mbaruar reformat për një shtet dhe Shqipëri moderne, pastaj mund të mblidhet Parlamenti i ri shprehet ai. [816] Siç duket ai nuk është i bindur për një fitore në rast se zgjedhjet zhvilloheshin menjëherë. Problem tjetër i qeverisë së tij është edhe frika prej qeverisë së larguar. Shtypi boton rregullisht për veprimtarinë e Zogut në Beograd dhe qeveria shqiptare i kërkon Jugosllavisë disa herë të largojë Zogun. Për arsye të frikës që ekzistonte prej kundërshtarëve të larguar ngrihet edhe një gjykatë politike. Gazeta *"Koha"* boton ligjin mbi funksionimin e Gjykatës Politike. Po të lexohen nenet e këtij ligji ai parashikon dënime të rënda. [817] Shumë shpejt u pa se qëllimi i saj ishte dënimi i kundërshtarëve politikë më shumë sesa dënimi i shkaktarëve të vëllavrasjes. Faik Konica edhe pse një nga përkrahësit kryesorë të qeverisë së Nolit hedh dyshimin mbi qëllimin e vërtetë të kësaj gjykate. Ai me argumente kërkon që të mos bëhen dënime politike, pasi prej këtyre gjërave askush nuk mund të dalë i fituar, pra të mos kalohet në hakmarrje me arsyen e drejtë se kjo mund të ndodhë përsëri në një të ardhme me ndryshimin e kësaj qeverie, por kërkon falje me anë të asaj që ai e quan sistemi i sfungjerit, i të fshirit, i të harruarit të punëve të mëparshme. [818]

Si çdo qeveri që vjen në pushtet por sidomos kur ajo vjen me anë të kryengritjeve ose grusht shteti, ka nevojë për njohjen nga shtetet e tjera. Që në fillim Noli u tregua i kujdesshëm mbi këtë çështje duke u shprehur se pavarësisht se ç'po ndodh në vend politika e jashtme e shtetit shqiptar nuk do të ndryshojë. Kjo ishte shumë e domosdoshme po të kihet parasysh gjendja e shtetit shqiptar të kësaj kohe. Vetëm pas përpjekjesh të shumta ishte bërë e mundur të rinjihej statusi i pavarur i Shqipërisë së para Luftës së Parë Botërore, dhe akoma ekuilibrat ishin të brishtë. Noli kërkoi një fqinjësi të mirë pavarësisht se ai nuk ishte i gatshëm të procedonte ndaj kërkesave të Greqisë dhe Jugosllavisë.

Në një interviste të dhënë prej tij të botuar tek "*Shqiptari i Amerikës"* shihet qartë vizioni i Nolit për marrëdhëniet me fqinjët. Për të është e qartë se nuk ka arsye për marrëdhënie të ftohta mes Shqipërisë dhe Greqisë. Mosmarrëveshjet shprehet ai kanë ardhur si pasojë e çështjeve të kufirit, por këto probleme vazhdon ai mund të kalohen me respektimin e të drejtave të pakicave nga të dyja palët në të dy anët e kufirit. Madje

[815] *Shqiptari i Amerikës,* Korçë 6 Shtator 1924, fq. 2
[816] *Gazeta e Korçës,* Korçë, 23 Shtator 1924, fq. 2
[817] *Koha,* Korçë, 26 Korrik 1924, fq. 1
[818] *Gazeta e Korçës,* Korçë, 4 Tetor 1924, fq. 1

ai e mbyll intervistën se bashkëpunimi mund të jetë më i gjerë për të shkuar drejt një bashkëpunimi Pan-Ballkanik. [819]

Edhe për raportet jugosllavo-shqiptare, Noli shprehet vetë në një intervistë të gjatë dhënë gazetës, "*Vreme"*. Ai përsërit që dëshiron marrëdhënie të mira me Jugosllavinë dhe premton se nuk do të ndihmojë irredentistët kosovarë. Por nga ana tjetër i kërkon palës jugosllave që të respektojë të drejtat e kosovarëve. Kjo, thotë ai, është e rëndësishme për vetë jugosllavët pasi kosovarët aty janë shumicë. [820] Ndërsa kur vjen puna tek çështjet e kufirit dhe tek tokat e kontestuara të Vermoshit dhe Shën Naumit, Noli nuk ngurron aspak, madje në këtë rast nuk përdor një gjuhë diplomatike, siç është e nevojshme por shprehet pa kulisa. Ne, thotë ai, s'jemi të kënaqur me kufirin absurd që na dhanë Fuqitë e Mëdha, kemi humbur mjaft toka, por iu bindëm këtij vendimi. Megjithatë vazhdon ai jemi të bindur se këto territore, Vermoshi dhe Shën Naumi i takojnë shtetit shqiptar dhe ne nuk jemi të gatshëm të tolerojmë më tej. [821]

Noli jo vetëm gjatë qeverisjes 6 mujore por edhe më parë i kishte kushtuar vëmendje problemit të kufijve dhe minoriteteve shqiptare jashtë vendit. Ishte i bindur në padrejtësitë e bëra dhe ai kishte luftuar për këto çështje. Ishte miku më i madh i shqiptarëve jashtë Shqipërisë. Ja sesi e përshkruan Nolin gazeta e Beogradit "Politika". *"Fan Noli është themelues i "Vatrës", peshkop i Durrësit, urren orthodaksët serbë. Si nacionalist ai shpreh simpati ndaj Komitetit të Kosovës, pavarësisht se nuk e shpall se ai do të bashkëpunojë me ta".* [822] Edhe çështja e Çamërisë nuk mbetet jashtë vëmendjes së qeverisë së tij. Në 28 korrik Ministria e Jashtme Shqiptare i dërgon Sekretariatit të Lidhjes së Kombeve një telegram të gjatë ku i kërkon kësaj të fundit që të përpiqet që të bëjë më shumë për problemet e popullsisë çame. Aty denoncohen përpjekjet e qeverisë greke për të detyruar shqiptarët të largohen nga trojet e tyre dhe kërkohet që të merren masa për të respektuar të drejtat e tyre. [823]

Por dy nga problemet që Noli u përball më së shumti gjatë qeverisjes ishin njohja e qeverisë së tij nga Fuqitë e Mëdha dhe mbajtja e zgjedhjeve. Noli fillimisht shihej me simpati nga Perëndimi pasi ai ishte arsimuar në Amerikë dhe ishte njohës shumë i mirë i kulturës perëndimore. Por kur erdhi në pushtet ai u ndodh në vështirësi. Qeveritë e vendeve të mëdha nuk u treguan të gatshme ta njihnin atë. Një arsye ishte kërkesa e tyre për zgjedhje, arsye tjetër ishte politika e vendeve fqinjë që nuk e kishin me sy të mirë, Nolin dhe qeverinë e tij që e etiketonin si nacionaliste. Por, nga ana tjetër, edhe vetë Noli kontribuoi për ta vështirësuar më tej situatën. Në shtator 1924 ai shkoi në Gjenevë dhe mori pjesë në seancat plenare të Lidhjes së Kombeve. Është i njohur fjalim i tij mbi parlamentarizmin dhe kjo i shokoi udhëheqësit e këtyre vendeve. Gazeta "*Shqiptari i Amerikës"* më shumë se një analizë rreth fjalimit dhe pakënaqësisë që shkaktoi mes antarëve të Lidhjes i bën jehonë komenteve të gazetave

[819] *Shqiptari i Amerikës,* Korçë, 11 Tetor 1924, fq. 1
[820] *Gazeta e Korçës,* Korçë, 23 Shtator 1924, fq. 1-2
[821] Po aty
[822] *Po aty,* 5 Korrik 1924, fq. 2
[823] *Po aty*, 29 Korrik 1924, fq. 1-2

të huaja mbi fjalën e Nolit. Si një nga mbështeteset më të fuqishme të veprimtarisë së Nolit kjo gazetë e mbyll shkrimin duke cituar titullin e gazetës "New Yorku-t ", "*Peshkop Noli Kryeministër i Shqipërisë meriton medaljen e heroizmës*. ''[824]

Ndërsa "*Gazeta e Korçës*" mban një qëndrim më realist dhe kritik. Gazeta nuk është dakort me mendimin e Kryeministrit duke u shprehur se, "*në vend që të shfaqte mirënjohjen e popullit në drejtim të Lidhjes së Kombeve ai në të kundërt e sulmoi atë dhe kjo nuk mund të jetë veçse mendimi i tij personal. Ai duhej të ishte treguar i matur dhe ti sillte përfitime dhe jo dëme popullit shqiptar, ai shkoi aty për ndihmë dhe jo për tu tallur vazhdon shkrimi. Dhe së fundi çfarë fitoi, më e pakta që mund të thuhet është dëmi moral përfundon shkrimi*". [825]

Në një situatë të tillë ndërkombëtare, i acaruar me Lidhjen, pa siguruar ndihmë nga ajo, pa njohje nga Fuqitë e Mëdha dhe vendet fqinjë zgjidhja e vetme që Noli të mund të mbijetonte do të kishin qenë zgjedhjet parlamentare. "*Gazeta e Korçës"* boton një deklaratë të ministrit të Punëve të Jashtme të Serbisë mbi njohjen e qeverisë shqiptare, deklaratë në të cilën theksohet se nuk mund të zgjidhet qeveria si legale pa patur votën e Parlamentit. Pra vazhdon më tej shkrimi në qoftë se qeveria e ndien dëmin që i bën vendit duke mos e njohur as Anglia duhen mbajtur menjeherë zgjedhjet pasi mjet tjetër shërimi nuk ka. [826] Por Noli ashtu si edhe në fillim nuk ishte i bindur për fitore. Ai tashmë ishte i vetëm madje po haste pengesa edhe nga disa prej antarëve të qeverisë së tij dhe nuk kishte arritur të realizonte as një nga pikat e programit të tij. Nga të gjitha anët po bien kambanat për të, thuajse të gjitha gazetat me tituj domethënës si '*'Një orë e më parë zgjedhje''*, apo duke sjellë edhe reagime të shtypit të huaj për nevojën e zgjedhjeve i bejnë apel qeverisë të mbajë zgjedhje të reja. Kurse "*Shqiptari i Amerikës"* që siç del në këto momente është kthyer në zëdhënëse të qeverisë i akuzon këto gazeta se po i shërbejnë të huajve. *Ne justifikohet ajo nuk mund të mbajmë zgjedhje për të kënaqur të huajt.* [827]Më në fund, por me vonesë qeveria e Nolit vendos të mbajë zgjedhjet. Ato do të zhvillohen përsëri me dy raunde. Por tashmë nuk ka kohë.

Përfundime

Nga analiza që i bëmë shtypit të Korçës për periudhën në fjalë mund të themi pa frikë se pothuajse i gjithë shtypi e mbështeti veprimtarinë e Nolit. Shtypi u bë zëdhënës jo vetëm i veprimtarisë së tij por edhe i ideve dhe programit të tij politik. Duke qenë se shtypi përfaqësonte shtresën më patriotike dhe më të aftë për të kuptuar nevojat e kohës, Noli u pa si njeriu që mund të përmbushte shpresat e tyre për Shqipërinë dhe mund të thuhet se shtypi ishte aleati i tij më i sinqertë. Nga ana tjetër, mund të thuhet se shtypi nuk ia kurseu kritikat. Kështu mund të përmendim se qeveria e tij u kritikua kur krijoi Gjykatën Politike, ose shpeshherë iu bë thirrje për mbajtjen e

[824] *Shqiptari i Amerikës*, Korçë, 15 Nëntor 1924, fq. 2
[825] *Gazeta e Korçës,* Korçë, 18 Tetor 1924, fq. 2
[826] *Po aty*, 20 Shtator, 19234, fq. 1
[827] *Shqiptari i Amerikës,* Korçë, 27 Shtator 1924, fq. 2

zgjedhjeve. Po ashtu ai u kritikua edhe personalisht për fjalën e tij në Lidhjen e Kombeve.

Për sa i përket veprimtarisë politike mund të përmendim disa arsye për dështimin e tij. Kundërshtarët e tij të larguar dhe sidomos Zogu që kishte dhe mbështetjen e Beogradit, ishin njerëzit më të pasur dhe kishin përkrahësit e tyre në Shqipëri. Për sa i përket gjendjes së brendshme: së pari ai, nuk arriti të zhvillojë zgjedhje për të legjitimuar pushtetin dhe së dyti, ai nuk mundi të sigurojë një mbështetje të gjerë sociale për vetë kushtet e zhvillimit të vendit. Në një shoqëri rurale, analfabete, megjithëse programi i tij ishte tërësisht në favor të këtyre shtresave, nuk mund të kuptoheshin idetë e tij përparimtare për një kohë relativisht të shkurtër. Arsye tjetër e dështimit të tij ishte mungesa e njohjes dhe e mbështetjes nga ana e Fuqive të Mëdha apo dhe politikat jodashamirëse të fqinjëve.

RUDINA MITA
LIRA GJEVORI
HYSEN KORDHA

ALTERNATIVA E OPOZITËS DEMOKRATIKE PËR ZGJIDHJEN E KRIZËS POLITIKE NË SHQIPËRI GJATË VITIT 1924

Gjatë punës hulumtuese na ra në dorë një dokument, i cili në vetvete përbën një letër të opozitës demokratike drejtuar Këshillit të Lartë të Shtetit Shqiptar më 25 shkurt 1924. Letra është nënshkruar nga deputetët: Fan S. Noli, Sulejman Delvina, Bahri Omari, Luigj Gurakuqi, Hil Mosi, Shuk Gurakuqi, Elias Muka, Ali Këlcyra, Hafiz Repishti, Aqif Elbasani, Avni Rustemi, Spiro Koleka, Ismail Tatzati, Patër Ambroz Marlaskaj, Dom Ndre Mjeda, Xhemal Bushati, Ibrahim Gjyrezi, Pietër Bumçi, Avdul Kuçi, Hoxha Kadri Prishtina, Luigj Koliqi, Dervish Mitrovica, Qazim Koculi, Fahri Reshiti, Dr. Nush Bushati, Rasim Babameto, Numan Ferizi, Ibrahim Xhindi. Pra kanë nënshkruar 28 deputetë. Ç`përmban letra dhe cila është rëndësia e saj? Shkurt me dy fjalë do të ndalemi në analizën e përmbajtjes dhe rëndësinë e saj. Themi shkurt, sepse menduam që këtë letër ta paraqesim sot të plotë, ashtu siç e kemi gjetur, për tu dhënë mundësi të gjithëve në këtë panel të njihen dhe të vlerësojnë vetë këtë dokument të çmuar. I pari që firmos dokumentin është F. S. Noli. Kjo s`është dhe s`mund të ishte rastësi. Ai ishte intelektual që me idetë e tij liberale e demokratike, me konceptet politike përparimtare fitoi autoritetin e një prej liderve kryesor të lëvizjes për demokraci e përparim e për oksidentalizmin që përfshiu Shqipërinë menjëherë pas Kongresit të Lushnjes, i cili shënoi një kthesë të madhe historike për popullin shqiptar. Këtë periudhë të re, me detyra dhe përmbajtje të re historike e kuptoi Noli dhe me përgjegjësinë e përkushtimin e atdhetarit të zjarrtë punoi pa pushim për ta futur Shqipërinë, shtetin dhe popullin shqiptar në rrugën e zhvillimeve politike e shoqërore të vendeve më të përparuara demokratike të Perëndimit, ta integronte Shqipërinë në Europë. Por përpjekjet e tij dhe të elementëve të tjerë intelektualë liberalë, demokratë, nga radhët e të cilëve doli opozita demokratike dhe krahu reformator në lëvizjen politike ndeshën në rezistencën e konservatorëve që iu kundërvunë ndryshimeve dhe kërkonin të ruanin në Shqipëri mbeturinat e feudalizmit duke penguar çdo reformë me natyrë përparimtare e demokratike. Midis intelektualëve liberal – demokrat reformatorë dhe konservatorëve u zhvillua luftë e ashpër politike gjatë viteve 1920 – 1924, madje dhe me fillimin e vitit 1924, ajo u acarua shumë dhe mori tiparet e krizës politike. Në ato momente të vështira, siç dëshmon dokumenti në fjalë, opozita demokratike, nëpërmjet një letre drejtuar Këshillit të Lartë të Shtetit shqiptar, parashtroi alternativën e vet për zgjidhjen e detyrave të momentit dhe për kapërcimin e krizës politike. Propozoi alternativën demokratike, tolerancën, bashkëpunimin e të gjithave forcave politike, konsensusin midis tyre, pra rrugën paqësore, mjetet

demokratike për përballimin dhe për zgjidhjen e detyrave. Por le t`ia lemë fjalën dokumentit. Ja si shkruhet në të:

Shkëlqesavet të Tyne/Zotnijvet Misë të Këshillit të Naltë.

Shkëlqesa: Ata, si kanë ndjekun rrjedhjen e punvet dy vjet e sot, s`mund të kenë as nji ma të voglin dyshim qi shkaku i shkatrrimit, nga i cili po vuen sot Shteti i ynë, asht Qeveria e Z. Ahmet Zogut. Këjo, po thue, ka pasun fuqi diktatoriale për t`emnuem gjithë organet e Administratës e për të pushue nga puna çdo njeri qi nuk i pëlqente. Ky sistem qeverimi dështoi plotësisht, dhe tani duket sheshazi se vazhdimi i kësaj Qeverie në fuqi do me thanë shkatërrim i plotë me ngatërresa të mbrendshme e të jashtme qi mund të jenë fatale për jetën e atdheut.

Skenat që ngjan në sallën e Asamblesë pas atentatit të deploruem janë kunora e këtij sistemi Qeveritar. Katër orë të plota Asamblea Kombëtare mbeti e terrorizueme nën kërcënimin e vrasjes nga njerëz t`armatosun të papërgjegjshëm që ka mbledhun Kryeministri për të impunuem vullnetin e vet. Bile. . . .* (fjalë e palexueshme – autorët) *qiu banë n`Asamble... . . . (fjalë e palexueshme – autorët.) *të cilave duhej t... . . . guximtari janë karakteristika të situatës kaotike (*e palexueshme – autorët)*... . . . . . misvet të Asamblesë tregoj qi s`i kishte besim Gjykatores dhe nji tjetër kërkonte që guximtari të ruhej mbrenda sallës s`Asamblesë. Me fjalë të tjera, degat e Drejtësiës, të Gjindarmëries dhe të Ushtriës, që janë të ngarkueme së bashku për të mbajtun qetësinë e vëndit, kanë arritun, nën Qeverinë e sotme, të jenë tri guverna armike njana kundër tjetrës dhe nji rrezik për t`anë Shtetin.*

Për të shpëtuem nga kjo gjandje anarkojde e për të kthyem Shtetin në kondita normale ka vetëm njii shërim, të largohen nga Qeverija ata qi janë drejtë për drejtë të përgjegjshëm për këtë situatë, dhe fuqija t`i dorëzohet një Qeverie të përbamun prej njerëzish të tjerë t`urtë e të moderuem e cila t`imponojë mretnimin e ligjës e jo mbretnimin e qejfit e t`ambicjeve personale, e cila të përdorë të hollat e shtetit për të *mirën e popullit e jo për t`ushqyem njerëz parazitë e garda pretoriane, e cila të inspiroj besim e jo terror, e cila të sjellë pajtimin e shpirtnavet e jo luftën civile dhe e cila t`a shpjerë Shqypnien nga anarkija e sotme n`udhën e urdhnit e të përparimit.*

Nji Qeveri e tillë, nga e cila të lihen jashtë pjestarët e Qeverisë së sotme, asht nji gja qi bahet lehtas me pak vullnet të mirë. Grupi i deputetvet të nënshkruem propozon nji Kryeministër, i cili, si person u inspiron besim të gjithë grupeve, dhe të cilit të nënshkruemit me anën e kësaj deklarate, i japin Carta bianca për të zgjedhun shokët e vet. Ky njeri është Z. Sami Vrioni.

Me këtë nuk duam të themi se vetëm njeriu i ynë e gabineti (kabineti - autorët) *i tij mund t`a shpëtojnë situatën e sotme; përkundrazi jemi gati të provojmë vullnetin e mirë që kemi tue hymë në marrveshtje me çdo njeri tjëtër, i cili të shënohet* (caktohet - autorët) *prej Këshillit të Naltë, i cili të jetë i autorizuar nga çdo grup tjetër për të formue nji gabinet me konditat e tregueme e parashtrueme më sipër.*

*Në qoftë se asjana prej këtyne gjanave nuk bahet ne jemi të shtrënguem të deklarojmë... . (*nuk lexohet - autorët*). . . . nga përgjegjësia e përfundimeve fatale qi do të ndodhin prej një gabinetit të formuem nën shtymjen e pasjoneve e t`ambicjevet pafre të njerzvet të cilët vënë në rrezik jetën e Shtetit. Me nderime të nalta F. S. Noli.*

Pas tij nënshkruajnë gjithë deputetët emrat e të cilëve i shënuam në fillim të shkrimit. Ja, ky ishte dokumenti, përmbajtja e të cilit dëshmon se opozita demokratike kërkonte dhe i mbetej besnike idesë për zgjidhjen e problemeve me rrugë konstitucionale, me mjete demokratike, me rrugë paqësore, pa tensione sociale, nëpërmjet bashkëpunimit midis forcave politike, apo siç ka pohuar Noli "me një mënyrë e cila as ta tronditëte Shqipërinë me një turbullim të brendshëm, as ta deskreditonte Shqipërinë në botën e jashtme si një Meksikë të Ballkanit„.

Alternativa e opozitës demokratike për zgjidhjen e krizës politike në Shqipëri në fillim të vitit 1924 do të përbënte shtysën që do të përgatiste terrenin për shpërthimin e Revolucionit të Qershorit 1924.

Tashmë dihet mirë se për të dhënë mendime e vlerësime objektive, të drejta e të sakta, për ngjarjet ose figurat historike gjykohet sipas kriterit kombëtar, pra, sa dhe si ndihmoi ajo ngjarje ose figurë në zgjidhjen e plotësimin e detyrave historiko – politike të kohës. Kjo kërkon që ngjarjen ose figurën historike medoemos duhet ta analizojmë e ta shqyrtojmë në lidhjet e saj me detyrat e kohës, me momentet historiko – politike e shoqërore që kalonte vendi dhe kombi në atë kohë. Legjitimitetin dhe justifikimin historik një ngjarjeje ia japin rrethanat dhe detyrat e kohës, roli që luan ajo në zhvillimin historik.

Duke zbatuar këtë kriter edhe për gjykimin e vlerësimin e Revolucionit Demokratik të Qershorit të vitit 1924, problemi del ndryshe nga sa e paragjykojnë ose e përcaktojnë disa, ose siç përpiqen ta cilësojnë me synime të caktuara disa të tjerë.

Dihet se pas Kongresit të Lushnjës, i cili shënoi një kthesë historike për fatet e popullit tonë, në Shqipëri nisën përpjekjet për ndërtimin e forcimin e shtetit të saporiformuar shqiptar, për demokratizimin e jetës social – politike, për zgjidhjen e problemit agrar dhe sidomos për afrimin e Shqipërisë me Evropën, ose siç thuhej atëhere për oksidentalizimin e Shqipërisë, çështje të papërmendura në historiografi gjatë periudhës moniste. Ky proces nuk ishte i ri. Përpjekja e shqiptarëve për kthimin e Shqipërisë nga Perëndimi, e cila përbënte një ndër drejtimet kryesore të lëvizjes demokratike të viteve 1920 – 1924 dhe të Revolucionit të Qershorit 1924, nuk lindi në vitet `20 të shek. XX, por kishte filluar shumë kohë më parë, madje qysh në gjysmën e dytë të shek. XIX gjatë Rilindjes Kombëtare.

E themi këtë, sepse çdo ngjarje nuk duhet parë si një akt, por si një hallkë e një procesi që zhvillohet. Prandaj mund të pohojmë se lëvizja për oksidentalizimin e Shqipërisë ishte një hallkë tjetër e re e një procesi që kishte nisur shumë kohë më parë.

Lëvizja demokratike e viteve 1920 – 1924 ishte vijim i një procesi historik të nisur shumë kohë më parë, por që tashmë zhvillohej në rrethana të reja historike.

Në qoftë se viti 1912 shënoi një hap në këtë drejtim, vitet 1920 – 1924 e çuan deri në fund përmbushjen e kësaj detyre. *Shkëputja e realizuar në vitin 1912 për shtetin shqiptar përfaqësonte shkëputje politike e administrative, por jo shoqëror, ekonomike, kulturore, madje as shkëputje nga praktikat administrative jo vetëm si koncept e strukturë, por edhe si personel. Të gjitha këto pengonin realizimin e atij procesi ndaj ndihej nevoja e ndryshimeve, për t`i hapur rrugë përmbushjes së tij si aspiratë e shqiptarëve.*

Në prill të vitit 1921 Avni Rustemi, që e kishte kuptuar dhe ndier si domosdoshmëri historike të kohës bashkimin e gjithë shoqërive të vendit, e shpalli me guxim botërisht para delegatëve të Kongresit. Ai deklaroi: "Nevojën që nuk mund të rrojmë siç jemi e ndjen cilido popull„. [828]Një muaj më vonë, në maj të vitit 1921, deputeti i Dibrës në Parlamentin e parë pluralist shqiptar Ramiz Daci, duke e zhvilluar më tej këtë ide, theksoi: "të mos harrojmë se vegjëlia kërkon një ndryshim të vërtetë, një drejtësi të plotë, një konstitucion të dobishëm, një njësi të përgjithshme, e një qetësi të plotë për fatin e vet„. [829] Gjithashtu Faik Konica në telegramin që i dërgoi Asamblesë Kushtetuese në janar të vitit 1924 vinte në dukje: "shumica e popullit shqiptar e ka shfaqur sheshit se dëshiron ndryshime sociale me themel„[830]. Lufta për zgjidhjen e këtyre detyrave që diktonte nevoja për ndryshime mobilizoi e vuri përballë njëra – tjetrës forca social – politike të ndryshme. Po t`i grupojmë në ndarje të mëdha, ato formuan dy rryma që shprehnin dhe mbronin dy alternativa themelore: liberal – demokrate dhe konservatore. E para kërkonte liberalizimin e jetës politiko – shoqërore nëpërmjet reformave demokratike në tërë fushat e jetës, duke synuar oksidentalizimin e Shqipërisë, afrimin me botën demokratike perendimore, ndërsa e dyta synonte ruajtjen e status – quosë dhe kundërshtonte reformat që preknin interesat e saj ekonomiko – politikë dhe shoqërorë.

Ballafaqimi midis këtyre dy rrymave dhe alternativave të tyre sundoi skenën politike shqiptare dhe u shpreh më qartë se kudo në veprimtarinë e Parlamentit ku u vunë përballë njëra-tjetrës Partia Popullore dhe Partia Përparimtare. Drejtues i Partisë Popullore ishte Fan S. Noli. Përfaqësuesit e Partisë Popullore në Parlament kërkuan kryerjen e reformave demokratike antifeudale në jetën politike, ekonomike dhe shoqërore të vendit. Me kalimin e kohës në radhët e Partisë Popullore ndodhën ndryshime për shkak të divergjencave ndërmjet anëtarëve të saj lidhur me rrugët e zgjidhjes së problemeve ekonomike, shoqërore e politike të vendit. Deputetët me prirje demokratike të Partisë Popullore përfaqësonin në Parlament opozitën. Me opozitën u bashkuan edhe personalitetet e emigracionit politik kosovar që nuk miratonin politikën e ndjekur nga Ahmet Zogu ndaj çështjes së Kosovës[831]. Në drejtimin e opozitës demokratike u shqua përsëri Fan S. Noli. "[832]

"Partia Popullore, përbënte të majtën e Parlamentit përballë Partisë Përparimtare që përbënte të djathtën me tendenca konservatore„[833]. Opozitare ndaj njëra – tjetrës, ato shprehën dhe mbrojtën dy alternativat themelore të kohës. "Partia Popullore, - theksohej në hyrje të programit të saj, - asht nji parti politike dhe parlamentare, e cila do të mbrojë një program reformash thjesht moderne nga shpirti, por të urta e të shkallëzuara që të mos tronditet asnjë ndjenjë ose zakon i vendit. Partia do të përpiqet

[828]"Atdheu", nr. 1, viti 1924, faqe 24.
[829] "Shkumbini", Elbasan, 27 maj 1921.
[830]Bisedimet e Këshillit Kombëtar, 1924, faqe 348.
[831] Po aty
[832] Rudina, Mita, Hysen Kordha, "Pluralizmi politik shqiptar në vitet 1914-1924", Elbasan 2011, faqe 53.
[833]"Hylli i Dritës", nr. 3-4/1997, faqe 29.

ta rritë, ta edukojë e ta pasurojë popullin e ta vërë në rradhët e popujve të Evropës Perendimore„. [834] Siç shihet rryma liberal – demokrate reformatore, që të përfaqësohej nga Partia Popullore në Parlament, kërkonte ndryshime nëpërmjet zbatimit të një sistemi reformash, të cilat të përfshinin gjithë fushat e jetës politike, ekonomike, kulturore, administrative, shoqërore etj. *Reformatorët synonin dhe propagandonin që reformat, të cilët do të sillnin ndryshimet e shndërrimet e nevojshme, të kryheshin në rrugë institucionale, me mjete legale, me mënyra demokratike, me forma paqësore, pa dhunë dhe pa tronditje shoqërore. Kjo njihet. Çështja që synojmë të vemë në dukje, sepse deri më sot është lënë paksa në hije pa i dhënë vendin që i takon, është se mbartësit dhe përbërësit e kësaj rryme përparimtare ishin intelektualët e shkolluar në perëndim. Këta intelektualë u frymëzuan dhe krijuan bindje se Shqipëria e shteti shqiptar për t`u begatuar e zhvilluar duhej të ndiqnin medoemos rrugën dhe shembullin e shteteve demokratike evropiane. Ata u ndërgjegjësuan se "vetëm dielli i Oksidentit do ta përparonte e lulëzonte Shqipërinë„*[835]*. Këtë çështje vë në dukje Refik Topia në një letër drejtuar Mithat Frashërit ku ai ka theksuar: "Atdheu do të përfitonte prej atyre djelmoshave që nëpër shkolla kishin mundur të formonin ide moderne e të shpëtonte nga kalbësirat e vjetra që pengonin udhën e përparimit„.* [836]

Intelektualët e rinj u bënë promotori i lëvizjeve për afirmimin e Shqipërisë me botën evropiane dhe i përhapjes së kësaj ideje në të gjitha anët, madje në ato vite e bënë moton e ditës në jetën politike e shoqërore të vendit.

Për intelektualët liberalë – reformatorë, që organizuan e udhëhoqën lëvizjen politike të forcave demokratike, koncepti i orientimit të Shqipërisë drejt Perëndimit nënkupton kalimin e vendit nga një vend me mbeturina të theksuara feudale në një vend të zhvilluar kapitalist dhe në rrafshin politik – krijimin e shtetit demokratik modern shqiptar sipas shembullit e modelit të strukturave dhe të funksionimit politiko – administrativ të shteteve të zhvilluara e të qytetëruara të Evropës Perendimore.

Gazeta "Fjalë e lirë„ që botohej në Vlorë, duke shprehur në mënyrë origjinale konceptin e qarqeve liberal – reformatore për oksidentalizimin e Shqipërisë bënte këtë zbërthim:

O- Operacione në nënpunësa
K- Konçensione për zhvillimin ekonomik
S-Shkurtime në çdo degë të administratës
I-Veçim i të ligut dhe të pamoralit
D-Demokraci me fakte dhe jo me fjalë
E-Energji në legalitet të Drejtësisë
N-Nacionalizëm me tru e jo me ngjyrë
T-Taksa të lehta sipas fuqisë
A-Asamble Kushtetuese në rast të favorshëm
L-Liri për shtyp por me frena llastiku
I-Irredentizëm për moralin kombëtar

[834] "Taraboshi", Shkodër, 22 maj 1921.
[835] Po aty, faqe 9.
[836] Arkivi Qendror Shtetëror, Fondi Mithat Frashëri, Dosja 36/5, fl. 1150.

S-Sinqeritet në shpenzime e n`urdhra

M-Miqësi me shtetet që u shkon fjala

A-Afrimi i elementit të duhur të opozitës në bashkëpunim. [837]

Këto 14 shkronja janë për shqiptarët aq me rëndësi sa ishin për paqen botërore 14 pikat e Wilsonit – përfundonte artikulli i gazetës. Rreth idesë së oksidentalizimit pati debate të ashpra politike në shtyp, në rrethe e në grupe politike, në mjedise intelektuale e në Parlament.

Pikërisht këtë ka pasur parasysh Fan Noli, kur në vitin 1923 me guxim shpalli në Parlament konstatimin për luftën politike që zhvillohej midis idhtarëve të oksidentalizimit të Shqipërisë dhe konservatorëve. "Këtu idealet e shtrembra, të errëta e të mumifikuara të Fanarit e të Buharës përfyten për jetë a vdekje me idealet më të gjalla, më elegante e më të ndritshme të Perëndimit„. [838]

Pikërisht zgjidhjen e çështjeve që u shërbenin afrimit të Shqipërisë me botën demokratike evropiane mori përsipër lëvizja demokratike e viteve 1920 – 1924 dhe Revolucioni i Qershorit të vitit 1924, ishte kurorëzim i saj. Kjo u shpreh qartë në programin e reformave që shpalli Qeveria e Nolit në qershor të vitit 1924 ku u deklarua një sistem i tërë reformash që përfshinte gjithë fushat e jetës shqiptare atëherë dhe që realizimi i tij përmbushte kërkesat dhe u jepte zgjidhje detyrave objektivave të kohës dhe të forcave përparimtare, siç shkruante një analist politik në gazetën "The Times„[839]të Londrës. Prandaj ajo ngjarje kulmore e historisë së popullit tonë me orientim perëndimor, me sistemin politiko – shoqëror që vendosi, përfaqëson pikërisht një hap politik shumë të rëndësishëm për afrimin më drejtpërdrejt dhe sa më të shpejtë të shqiptarëve me botën demokratike perëndimore. Kjo përputhej tërësisht me aspiratat e lëvizjes për demokraci e përparim, me kërkesat e detyrat objektive të viteve 1920 – 1924. Kjo i jep legjitimitetin historik kësaj ngjarjeje. Me shembullin e Amerikës e të demokracive parlamentare perëndimore, të ngrije flamurin për demokraci në Shqipëri në një Ballkan monarkist, ku gjithçka rreth e rrotull Shqipërisë ishte kundër ideve demokratike e republikane, përbente dhe përfaqësonte domosdo një akt mjaft përparimtar që duhet vlerësuar si shprehje e përpjekjeve të shqiptarëve për t`u afruar me qytetërimin europian.

[837]"Fjalë e lirë", Vlorë, 14 dhjetor 1922.

[838]Bisedimet e Këshillit Kombëtar, 1923, 27 shtator 1923.

[839] "The Times", Londër, 7 qershor 1924.

SHKELZEN RAÇA

VEPRIMTARIA E FAN NOLIT NË PAVARËSIMIN E KISHËS ORTODOKSE SHQIPTARE

Prirjet e përdorimit të shqipes nëpër shërbesat fetare, nisën që në fundin e shek. XVIII në kushtet e veprimit të një rryme të re shqiptare, me tendenca shkëputjeje nga Patrikana e Stambollit, e cila në praktikën kishtare lejonte vetëm zbatimin e greqishtes. Një përpjekje serioze drejt flakjes së një praktike të tillë vihet re në mesharin e "Anonimit " të Elbasanit, shkruar me një "shqipe arkaike" dhe që në thelb përmbante predikime të lira fetare, [840] ndërsa një punë më kualitative për të zëvëndësuar liturgjinë e greqishtes me gjuhën shqipe, vend të veçantë zuri përpjekja e Dhaskal Todhrit.

Synimet autonomiste, të paktën që reflektonin fillimisht inkuadrimin e shqipes nëpër institucionet e shenjta të ortodoksisë, shfaqen e rriten dy decenie më vonë, pas zhdukjes fizike e djegies së librave të Theodor Haxhifilipit në Elbasan. Ishte mjeku i ri nga Labova e Gjirokastrës, Vangjel Meksi ai, i cili përkthen në shqipet "Dhjatën e Re", ndërmarrje kjo e madhe për rrethanat e kohës dhe të një interesi jo të vogël, në prag të Rilindjes. Bëhej fjalë, sipas të gjitha indikacioneve, për një tentativë serioze të zyrtarizimit të shqipes, si gjuhë të përdorshme në librat e shenjtë, për besimtarët ortodoksë në Shqipëri. [841]

Dhe, nëse praktikisht nuk mund të dihet fryma ndikuese e botimeve të karakterit fetar në shqipet, por me shkronja greke nga Korfuzi me shumë ungjillorë, atëherë është e sigurt se ato pak lëvizje të viteve '20 të shek. XIX hapën rrugën e punës efektive të Konstantin Kristoforidhit, në këtë drejtim. Rilindësi nga Elbasani, po aq sa edhe "babai" i gjuhës shqipe për kohën, bëhet një përkthyes i pasionuar veprash fetare. Më 1857 shqipëron "Ungjillin e Matheut", ndërsa një mot më vonë "Dhjatën e Re", [842] për çka elbasanasi i ri, ky propagandues i ideve të Shoqërisë Biblike Britanike dhe të Huaj", nuk dha dorë se kishte qenë vetëm një përhapës i flakët i punëdhënësve nga Londra. Ai, megjithatë, kishte qenë diç më tepër.

Veprimtaria e tij, para se gjithash, pati një rëndësi të veçantë politike, por edhe fetare në embrionin e misionit kombëtar, duke synuar, as më pak dhe as më tepër, ndihmesën në procesin e tejkalimit të klerokracisë së huaj poshtë Shkumbinit. Mbase, historia e etnisë tonë, ajo e shek. XIX njeh edhe disa lëvizje e preferenca porosish të qarta, në funksion të strukturimit e të ndërgjegjësimit etnik të shqiptarëve të krishterë

[840] Ishte një vepër që përmbante përkthime pjesësh të katër ungjijve në gjuhën shqipe. Më gjerësisht: Dhimitër Shuteriqi, Shkrimet shqipe 1332-1850, Prishtinë 1978, 91-93; Robert Elsie, Historia e letërsisë shqiptare, Pejë 2001, 94.

[841] Jup Kastrati, Historia e albanologjisë, Tiranë 2000, 516-517.

[842] Mbi rëndësinë e përkthimit të librave të shenjte në shqipet nga K. Kristoforidhi, më gjerësisht: Rexhep Qosja, Historia e letërsisë shqipe Romantizmi II, Prishtinë 1984, 384-392.

nga areali i "fesë së drejtë". Qe për admirim, intensifikimi i aktivitetit të disa rilindasve, ku krahas nismës për një alfabet mbi bazat e shkronjave latine, ata shtrojnë edhe imperativin e zbatimit të shqipes, si gjuhë të meshës në kishë. Enciklopedisti dhe eruditi ynë, Sami Frashëri, kështu, në veprën monumentale, "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet", ndërmjet një vargu idesh e mesazhesh, vuri në dukje edhe rëndësinë madhore të themelimit të kishës ortodokse shqiptare mbi baza kombëtare. [843]

Mirëpo, në kapërcyell të shek. XIX, siç duket, kondidat praktike e teorike për një ndërmarrje të tillë, që duhej të reflektonin "shkurorëzimin" përfundimtar të shqiptarëve nga Patrikana e Stambollit, as përafërsisht nuk ishin përmbushur. Kalendari historik bën të ditur se, kolonia shqiptare e Bukureshtit është një qendër e vendosjes për shumë punë të dobishme, veç tjerash, edhe për tejkalimin e problemeve të besimtarëve ortodoksë shqiptarë[844]. Në këtë kontekst, shoqëria "Drita" e kolonisë shqiptare të Bukureshtit në programin e saj të shpalosur më 27 maj të 1900-së shkruante për rëndësinë kapitale të themelimit eventual të Kishës së pavarur ortodokse shqiptare. Për këtë institucion të një rëndësie jetike projektohej ideja e shkëputjes nga Patrikana e Stambollit, si dhe zbatimi i gjuhës shqipe në liturgjinë e saj. [845]

Dy vite më vonë, gjatë Konferencës ndërkombëtare në Vjenë ku u debatua çështja e statusit politik të kombeve e të kombësive nën administrimin osman, Kristo Dako parashtroi kërkesën e hapjes së shkollave kombëtare dhe të mbajtjes së meshës në shqip. Rrjedhimisht, në këtë sfond veprimi, kalendari historik i fillimit të shekullit të kaluar veçon përpjekjet serioze të Gjerasim Qiriazit, Grigor Cilkës dhe Mihal Gramenos në Korçë, të Papa Kristo Negovanit në Florinë, ndërsa në kujtesën e lëvizjeve identike përkujtohet memorandumi i Nikolla Naços dërguar Fuqive të Mëdha. Ky rilindas i devotshëm, ndërmjet tjerash, përveç çështjes së autonomisë së Shqipërisë, deponon edhe kërkesën për shkolla dhe Kishë ortodokse shqiptare. [846]

Megjithatë, në krijim konceptesh, formash zgjidhjeje të daljes nga humnera e errësirës shpirtërore si pasojë e administrimit policentrik të institucionit suprem të "fesë së drejtë"në qytetin perandorak buzë Bosforit, duket se Fan Noli pati një trajtim e qasje më të kapshme. Fatkeqësinë e shqiptarëve të krishterë të fesë ortodokse, vetë ai do ta kundronte si pasojë e aktivitetit intensiv antikombëtar të klerit të huaj, ndërsa shpëtimin e ikjes nga rrethimi i hekurt e kërkonte, tek zëri i gjuhës shqipe dhe të priftërinjve shqiptarë në altarin e kishës. [847] Nisur nga kjo, prandaj, peshkopi i "kuq"nis punën me përkthimin dhe përshtatjen e teksteve të shenjta për bashkëkombasit e vet të krishterizmit lindor.

Veprimtaria e tij në fushën eklesiastike përkon me kalendarin historik të 1908-së, atë të fazës së katërt të Rilindjes e të Lëvizjes kombëtare shqiptare, duke publikuar në

[843] Sami Frashëri, Shqipëria ç'ka qenë ç'është e ç'do të bëhet/, Tiranë 1962, 49.

[844] " Aktiviteti i shqiptarëvet në Rumani " Diturija II, Tiranë 1927, 87-88.

[845] Stavro Skendi, The Albanian National Awakening 1878-1912, Neë Jersey 1967, 161; Albania IV, 1900, 107.

[846] Akte të Rilindjes kombëtare shqiptare (Përgatitur nga S. Pollo dhe S. Pulaha), Tiranë 1978, 185.

[847] S. Skendi, The Albanian…,

gjuhën amtare "shërbesat e javës së madhe", me përmbajtje himnesh e mësimesh nga java e shenjtë dhe pashkët. Ishte kjo një kremte e madhe për krejt besimtarët e krishterizmit lindor të tempullit shqiptar të Shën Gjergjit[848], po aq sa edhe akti sinjifikativ i fillimit të punës së Kishës ortodokse shqiptare në dhe të huaj, si kishë misionare, e varur përkohësisht nga Kisha ortodokse ruse në Amerikën e largët. Kalendari i historisë kombëtare shënon motin e madh 1908 dhe shugurimin e Nolit për prift, me çka "kalorësi i famshëm i Skënderbeut" vijon rrugën e përkthimit të shërbesave kryesore të kishës ortodokse, duke i zëvëndësuar fjalët e veçanta greke, me ato të gjuhës shqipe. Tash e pas, "uratat e mëdha të mbrëmjes", ato të mëngjesit, orët, liturgjia e Shën Gojartit, etj., do të thuhen, lexohen e këndohen nga besimtarët ortodoks shqiptarë vetëm në shqip. Për më tepër ky akt ishte edhe më domethënës, sepse u referohej bashkimit politik të shqiptarëve myslimanë, me shqiptarët e krishterë katolik. [849]

Lëvizjet e fuqishme të Fan Nolit në Amerikën e largët padyshim se nuk mbetën pa jehonë në mjediset publicistike të kohës. Korrespodenti i gazetës londineze, "Times" në kryeqendrën e Perandorisë Osmane, në artikullin me titull: "Shqiptarët dhe grekët" shkruar më 25 nëntor të vitit 1909 bënte të ditur se" shqiptarët nuk janë të ngarkuar me historicizmin romantik, por që krahas organizimit të kryengritjes kundër sulltanit, ata tashmë pretendojnë zbatimin praktik të arsimimit kombëtar, krijimin e Kishës së tyre të pavarur nga Patrikana e Stambollit, duke synuar shkëputjen nga çfarëdo ndikimi të mundshëm grek. [850] Ishte e qartë se rruga e realizimit të idesë për një pavarësim shpirtëror varej në masë të konsiderueshme nga rezultatet dobiprurëse, tutje Atlantikut. Dhe ato në Amerikën e largët sublimohen në shkallë kombëtare, sepse Kisha ortodokse shqiptare atje organizohet si dioqezë e pavarur më 27 korrik të vitit 1919, ndërsa Noli emërohet Peshkop i një institucioni kishtar krejtësisht të pavarur. [851]

S'ka pikë dyshimi se bëmat e tij, dikur me arsimim të helenizmit modern paralajmëronin ngjarje të stuhishme në rrafshin e "disiplinës kishtare", në jugun e Shqipërisë. Duke shkrirë erudicionin me guximin, ishte e kuptueshme ndeshja me rivalët në fushën ballkanike të shahut, që me aq mjeshtri do ta udhëhiqte vetë ai, në këtë pjesë të hapësirës së saj. Motivi për një ndërmarrje të shenjtë në plisin e dheut të vet u dha pikërisht atëherë kur për ekzarh të Korçës emërohet mitropoliti i Durrësit, Jakovi, i cilësuar sipas njohësve të rrymës autoqefaliste personi më apokaliptik, në historinë e krishterizmit lindor të Shqipërisë. Së pari, menjëherë pas shkeljes arbitrare në këtë qytet, themeloi shoqatën e rrezikshme "Bashkimi ortodoks shqiptar", që për synim qëndror kishte synimin e interesave jetike të idhtarëve të autoqefalisë dhe, së dyti, pengoi ardhjen e Nolit në Shqipëri, me arsyetimin se dorëzimi i tij për peshkop

[848] Siç dihet, Noli aty celebroi meshën e parë në gjuhën shqipe, më 223 mars të vitit kalendarik 1908. Më gjerësisht: Gani Katundi, Shoqëria "Besa Besë" dhe themelimi i Kishës kombëtare, "Lufta për çlirimin kombëtar në vitet 1878-1912", Tiranë 1962, 229.

[849] S. Skendi, Vep. cit., 163.

[850] "Ἐκκλησιαστική Ἀλήθεια ", τόμ. 29, έν Ἀθήναις 1909, 381.

[851] Noli, Metropolitan F. S., compiler, Fiftieth Anniversary of the Albanian Orthodhox Church in America, 1908-1958, Boston 1960, 110.

qe jashtë kanonizmit fetar të kishave ortodokse të "lindjes". Nisi kështu, një luftë e pakompromis ndërmjet idhtarëve të ekuivalencës së Rilindjes e modeleve për një kishë ortodokse kombëtare dhe atyre që ishin për një ekumenizëm klasik të tipit bizantin.

Përpara uniformizmit të Patrikanës së Stambollit, Nolit i imponohet itinerari i veprimit të shpejtë, aq më tepër kur Korça, tashmë ishte porta kryesore e komunikimit ndërshqiptar, si dhe shesh dyluftimi eklesiastik. Në funksion të veprimtarisë së tij, ardhja e mitrofor, Vasil Markut e Vangjel Çamçes në Korçë nga Amerika, padyshim se përshpejtoi procesin e nismës së pavarësimit të Kishës ortodokse shqiptare. Ishte maji i vitit 1920 kur këta dy bashkëmendimtarë të peshkopit demokrat shkelin në "Parisin e vogël" ndërsa katër muaj më vonë, me ndihmën materiale të federatës panshqiptare "Vatra" në vendim amë arriti, edhe vet Fan Noli. [852] Dy të parët bënë një punë të madhe, duke mobilizuar masën e komunitetit ortodoks shqiptar dhe në Premten e Madhe të 1921-së, çliruan Kishën e Shën Gjergjit, ndërsa në këtë akt, si dhe në disa të tjera, baza burimore politiko-kishtare e proveniencës së huaj nuk shihte tjetër përveç se dorën e "peshkopit të rrejshëm" të Kishës së krishterë ortodokse shqiptare në Amerikë.

Ngjarjet eklesiastike të Korçës rezultuan me largimin e ekzarhut të huaj, si person i padëshirueshëm, ndërsa vetë Noli tashmë është kryeprotogonist, veprimtaria e të cilit synon forcimin e bazës juridike drejt sendërtimit të idesë për një Kishë të pavarur ortodokse kombëtare shqiptare. Ai është truri dhe sajuesi praktik i hapave tutje drejt pavarësimit institucional në planin shpirtëror dhe ndonëse i padukshëm në veprime, ai është po ashtu figurë qëndrore, ku të tjerët humbnin përpara tij. Gazeta aspak miqësore "Pellazgu" në Korçë, kështu, më 25 qershor 1921 njoftonte se, peshkopi i ardhur nga Amerika e largët ia doli të siguronte, sa përkrahjen dhe përkushtimin e shqiptarëve "nacionalistë", po aq edhe evidentimin e idesë pragmatike drejt objektivave të ri në planin politik. [853] Sidoqoftë, shfaqja e parë, më domethënëse e Nolit qe fundi i po atij viti kur hap "kutinë e Pandorës" për pushtetin, deri atëherë të huaj kishtar në Shqipëri. Në dheun e të parëve të vet mban meshën e plotë në gjuhën shqipe më 11 dhjetor të vitit kalendarik 1921. [854]. Vendi i evenimentit madhështor ishte tempulli i Shën Gjergjit, me çka nis procesi praktik i indipedencës së Kishës ortodokse shqiptare, në rrafshin kombëtar.

Përpara ngritjes mbi terrin ende mesjetar, ai vijon me ngulm strukturimin dhe me të lindjen e një kishe të re ortodokse mbi baza kombëtare, pavarësisht demarsheve dhe kontestimin nga të tjerët. Nuk stepet së vepruari për t'i dhënë fund epërsisë kishtare të binomit greko-sllav përballë shqiptarëve ortodoks, duke pasur që nga mesjeta e Bizantit modelin e qytetit perandorak buzë Bosforit. Fan Noli, kështu, bën redakturën përfundimtare të Kanonizmës së Kishës së pavarur ortodokse shqiptare, e shtruar në

[852] Piro Tako, Fan Noli në fushën politike dhe publicistike (vështruar nëpërmjet publicistikës, oratories dhe epistolareve), tiranë 1975, 98.
[853] "Pellazgu", Nr. 1196, Korçë 25. 06. 1925, 1.
[854] P. Tako, Vep. cit., 109.

14 pika dhe e prezantuar në "puçin kishtar" të Kongresit të Beratit. [855] Ky dokument i fortë, i pari në historinë eklesiastike shqiptare të krishterimit lindor bënte të njohur modelin e administrimit të Kishës ortodokse shqiptare. Kanonizma (Rregullorja) do të binte mbi krahët e fortë të At Vasil Markut, të Ikonom Papa Josifit nga Korça, por edhe të Dhori Haviarit, Simon Shuteriqit, Tol Arapit e Stathi Kondit, si përfaqësues të popullit, jashtë kuadrit klerikal. Për më tepër, vetëm mbi postulatet e këtij dokumenti të fortë, që për autor njihte Fan Nolin, qeveria dhe Parlamenti shqiptar, më 18 shtator të vitit 1922 miratojnë Dekretligjin e njohjes së Kishës ortodokse shqiptare për kishë autoqefale e kombëtare.

Ishte i pritshëm kundërreagimi tani i Patrikanës së Stambollit, që kundërpërgjigjet thjeshtë se nuk njeh vendimet e Kongresit në qytetin e 1. 000 dritareve, ndërsa vetë Nolin për peshkop. Kjo e para ishte e gatshme të ulej në sofrën e bisedimeve, pra ta shqyrtonte çështje të formimit të autoqefalisë së Kishës ortodokse shqiptare vetëm pas rikthimit të katër mitropolitëve, të cilët tashmë gjendeshin jashtë kufinjve të Shqipërisë. Në anën tjetër, përpara kontestit të thellë të autoqefalisë dhe presionit të vazhdueshëm diplomatik, ky i fundit, tok me Këshillin e lartë kishtar siguroi në gjysmën e dytë të 1923-së gradën më të lartë kishtare të mitropolisë së Durrësit. Veprimtaria kishtare posaçërisht e tij, gjen sërish shtrirje të gjerë në Korçë[856], ngaqë me ceremoninë e shugurimit për mitropolit të Durrësit, Fan Noli arriti një fitore tjetër të madhe: atë të inkuadrimit në cilësinë e anëtarit të tretë të Sinodit të shenjtë të Kishës ortodokse shqiptare. [857] Njëkohësisht, dy anëtarët e tjerë të Sinodit: Jerotheo, në cilësinë e mitropolitit të Korçës dhe Kristofori, atë të Beratit dërguan letër patrikut të Patrikanës së Stambollit, duke e informuar për dorëzimin e Nolit në funksionin e mitropolitit të Durrësit. Mbështetjen e tyre, ata e bazonin në vendimet e kuadrit vendas shpirtëror, por që mjerisht binin ndesh nga Patrikana dhe lëkundjet Kryepeshkopit Kishës ruse për Amerikën Veriore, Aleksandri.

Pavarësisht vështirësive, ky akt sublimoi fuqishëm për atë kohë vendimet e Kuvendit kishtar të Beratit, pra kombëtarizimin aq të shumëpritur të Kishës ortodokse shqiptare. Përballë injorimit, presionit dhe kontestimit të autoqefalisë, Fan Noli dhe ithtarët e rrymës noliane ishin të vetëdijshëm se mvetësia dhe lindja e kishës ortodokse kombëtare shqiptare, qe e pjesshme. Ç'është e drejta, dy faktorë kontestimi me këtë rast nuk ishin kush tjetër, përveç se qeveria greke dhe Patrikana Ekumenike e Stambollit parashtronin kushtëzime të rënda, ndërmjet tjerash se çështja e pavarësimit

[855] Punimet e Kongresit të Beratit nisën më 10 shtator 1922 në praninë e 33 e përfaqësuesve të qarqeve kishtare të Shqipërisë. Këtu miratohet Kanonizma e Kishës ortodokse autoqefale shqiptare, e administruar nga Këshilli i lartë kishtar, i përbërë prej 8 anëtarëve dhe se për qendër drejtimi caktohet Korça. Më gjerësisht: Γεωργίος Ν. Τασούδης, Ὁ Ἀρχιεπίσκοπος Ἀθηνών Χρύσανθος ἀπο Τραπεζούντος. Ἡ ἐθνική ἐκκλησιαστική δράσις του 1925-1949, Ἀήναι 1972, 30.

[856] Ceremonia e celebrimit u bë në tempullin e Shën Gjergjit. Më gjerësisht: Noli, Metropolitan F. S., compiler…, 12.

[857] Inkuadrimi i tij brenda Sinodit treanëtarësh të Kishës autoqefale ortodokse shqiptare u zyrtarizua në mbledhjen e 14 dhjetorit të vitit 1923. Më gjerësisht për këtë: J. Lacombe, Chronique des Eglises Orientaales, Echos d'Orient, 23, Paris 1924, 222-223.

të Kishës ortodokse shqiptare mund të rregullohej po qe se vetë "Peshkopi i kuq" tërhiqej nga ambiciet e tij, prej një titullari Kryepeshkopi të Kishës ortodokse shqiptare. Porse, për universin e ri shqiptar, qe ky një institucion suprem shpirtëror, por edhe politik, i vlefshëm tejmase në funksion të mbijetesës dhe ndërgjegjësimit etnik, për t'iu shmangur furrës së pamëshirshme të asimilimit. Në këtë drejtim, veprimtaria e Kryepeshkopit gjithnjë të kontestuar nga Patrikana e Stambollit dhe e qeverisë greke atëherë, nuk pësoi rënie, as pas demokracisë së shpërfillur dhe largimit nga trualli amë.

Në Amerikën e largët më pastaj ai përcolli çdo lëvizje të bashkmendimtarëve të vet në rrugëtimin e vështirë të ndërtimit të pavarësimit të Kishës ortodokse shqiptare. Ai nuk dëshmoi prirje pretencioze për vete. Ishte e kundërta, sepse përshëndeti çdo veprim në kuadrin e veprimtarisë së shenjtë të tij. Admiroi sukseset e Visarion Xhuvanit, megjithë kundërshtitë e dikurshme me të, madje edhe atë të rivalit të përbetuar, Ahmet Zogut. Për më tepër, të parin e konsideroi jo pak herë për Kryepeshkopin më energjik që kishte patur Shqipëria, ndërsa të dytin, në çështjet e injorimit të autoqefalisë, një figurë, që diti ta kundronte atë mbi baza kombëtare, krejtësisht parimore.

SHYQYRI HYSI

HOMAZH I ASAMBLESË KUSHTETUESE DHE FJALA E NOLIT PËR UDRO UILLSONIN, SHKURT 1924.

Fan Stiljan Noli lindi në Ibrik Tepe, [858] fshatin e banuar prej shqiptarëve, më 6 janar të vitit 1882. Fshati ku lindi Noli ndodhet në zonën e Edrenesë ose në zonën europiane të Turqisë. Ai vdiq më 13 mars 1965 në Florida dhe u varros në Fortesën Hills të Bostonit. Noli njihet prej historiografisë shqiptare si; publicist, historian, përkëthyes, klerik i lartë, diplomat, botues, përkëthyes, gazetar, shkrimtar, dijetar, historian, diplomat, atdhetar e demokrat. Historiografia shqiptare e vlerëson Nolin për;

- kontributin në fushën fetare, sepse Noli punoi si mësues e punonjës i kishës në diasporën shqiptare të Egjiptit. Ai shkoi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vitin 1906 dhe një vit më vonë, ai u dorëzua prift nga mitropoliti Platon i Nju Jorkut. Në janar të vitit 1908[859] mbajti meshën e parë në gjuhën shqipe, [860] ndërsa në korrik të vitit 1919 u shugurua peshkop. Organizimi i kishës ortodokse shqiptare në SHBA, filloi në vitit 1907 si degë e kishës ortodokse Lindore. Por, organizimi i saj si një dioqezë e pavarur kishtare ortodokse, u bë në korrik të viit 1919. [861] Ideja e formimit të KOASH, [862] sikurse e konfirmon dhe Noli, zë fill qysh në vititn 1907, u arrit në vitin 1919(SHBA) dhe u kurorëzua me Kongresin e Beratit shtator 1922. [863]
- Noli ka një kontribut modest edhe në historiografinë shqiptare, disa nga temat e preferuara të tij ishin; Figura e Skënderbut, Prometeu, historia e krishterimit, Bethoveni dhe Revolucioni Francez, temat e antikitetit etj. Në veprën e Nolit temat historike janë një binom jetik me atdhetarinë, me idetë e Rilindjes Europiane dhe rilindasve shqiptar. Ato janë të lidhur me çështjen kombëtare, si mishi me kockën, "*si indet*"[864].
- Noli diplomat, administrator, politikan dhe figurë e luftës për demokraci. Noli ishte kryetar i delegacionit shqiptar dhe me ligjëratat e tij, mbrojti çështjen shqiptare në Lidhjen e Kombeve 1920. [865] Historiografia shqiptare e njeh kontributin e tij, në pranimin e Shqipërisë si anëtare e Lidhjes së Kombeve, më 17 dhjetor 1920. Pas fitores së Revolucionit të

[858] Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 2009, f. 1849 – 1852.
[859] Gazeta "*Kombi*", 1 janar, 1907, nr. 21, f. 2.
[860] AQSH, F. 146, viti 1924, f. 157.
[861] Noli, vepra, VI, f. 549.
[862] Hysi Shyqyri, *Histori e komuniteteve fetare shqiptare*, Tiranë, 2007, f. 176 – 183.
[863] AQSH, F. 674, viti 1923, dos. 206, f. 1 – 13.
[864] Noli, vepra, vëll. IV, f. 5.
[865] Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë, *Histori e Popullit Shqiptar*, vëll. III, Toena, Tiranë, 2002, f. 171 – 175.

Qershorit(1924) Ai u bë Kryeministër i Shqipërisë. Në 26 dhjetor 1924 emigroi në Europë. Noli u bë kryetar i KONARE – së, (1925) dhe më 1927 u vu në krye të KÇN. Edhe pse nuk u kthye më në Shqipëri, Noli mbeti një atdhetar simbol dhe një intelektual i përmasave të kohës.

- Noli deputet, Ai nuk u zgjodh deputet nëpërmjet zgjedhjeve të vitit 1921, por ishte paisur me një "*një letër - kredenciale*" nga "Vatra", si përfaqësues i shqiptarëve të Amerikës, si "*përfaqësues i punëtorëve dhe bujqëve shqiptarë të Amerikës*". Pra, shqiptaro- amerikani Noli, në Parlamentin e parë shqiptar, ishte deputet i Vatrës. Parlamenti i filloi punimet, më 21 prill 1921. Ndërsa në zgjedhjet e 27 dhjetorit 1923, Noli u zgjodh deputet i Partisë Liberale për zonën e Korçës. Noli tregoi aftësi oratorike dhe pjekuri politike në seancat e Parlamentit. Midis fjalimeve të tij, veçojmë edhe fjalën homazh në nderim të Presidentit Udru Uillson, fjalë të cilën, Nasho Jorgaqi e cilëson si; "*fjalimi panegjerik më elokuent që kishte mbajtur ndonjëherë*". [866]

Më 3 shkurt të vitit 1924 vdiq ish – kryetari i SHBA –së, U. Uillson. [867] Një ditë më vonë, ditën e hënë, Asambleja Kushtetuese zhvilloi mbledhjen VII, [868] në të cilën deputeti i Durrësit, gjirokastriti diplomat Rauf Fico, kërkoi fjalën dhe duke ndërprerë seancën e sapo filluar[869] tha: "*z. Kryetar! Pa hy në bisedimin e rendit të ditës, dua të bëj një propozim. Me hidhnim murmë vesh se ish-kryetari i Shteteve të Bashkuara t'Amerikës W. Wilson-i vdiq. Duke marrë parasysh shërbimet e mëdha që i ka bërë Shqipërisë, propozoj të bëhen 5 minuta pushim si shenjë hidhnimi dhe t'i hiqet një telegram ngushëllimi familjes së të ndjerit*". [870]

Parlamenti shqiptar pranoi njëzëri propozimin dhe mbajti 5 minuta pushim në nderim të Udru Uillsonit.

Pas pushimit seanca rifilloi me një tjetër propozim. Deputeti Jashar Erebara propozoi 5 minuta pushin në nderim të Leninit, si njeriu që denoncoi Traktatin e Fshehtë të Londrës. Në fjalën e tij deputeti i Beratit tha: "*Para se të hyjmë në bisedime, propozoj të bëhen 5 minuta edhe për Leninin, se në qoftë se Willson – i do flitet për të mirën e Shqipërisë, më tepër do flitet Lenini për Shqipërinë e Madhe*". Deri në vitet nëntëdhjetë ky propozim i atribuar, atdhetarit libohovit Avni Rustemi. Sipas dokumentacionit të kohës rezulton se, pasi u kryen homazhet për të dy personalitetet ndërkombëtare Avni Rustemi mori fjalën dhe tha: "*…Nuk dua që Shqipëria të jetë bolshevike, sepse gjendja dhe pozita e saj nuk i do këto ndjenja, po për principet e larta njerëzore duhet që me një respekt të nxihet në gojë emni i tija…, që dencoi traktatin e mçeft të 1915 që ishte për coptimin e Shqipërisë*". [871] Pra siç shihet nuk është Avni

[866] Jorgaqi, Nasho, Jeta e Fan S. Nolit, OMBRA GVG, Tiranë, 2005, vëll. 1, f. 484.
[867] Noli, vepra VI, f. 153.
[868] Bisedime të Kuvendit Kushtetuese, shkurt 1924, dos. 51, f. 141.
[869] AQSH, F. 146, Viti 1924, D. 51, f. 141.
[870] AQSH, F. 146, viti 1924, D. 51 f. 142.
[871] AQSH, po aty, f. 143.

Rustemi që ka propozuar të mbahet zi për Leninin, por Jashar Erebara, me këtë rast ndreqet edhe një lapsus i historiografisë shqiptare.

Noli nuk u ndodh pranishëm në atë seancë homazh, por në seancën e datës 11 shkurt, [872] ai erdhi në sallë dhe kërkoi menjëherë fjalën, duke iu drejtuar kryetarit: "*Kryetar, nga shkaku i një moskuptimi nuk u ndodha të hënën e kaluar në mbledhjen kur u –përmend vdekja e Presidentit Uillson. Kasha pak fjalë për të thënë atë ditë. E pasi nuk munda. Ju lutem të më jepni leje t'i them sot*". [873]

Noli, në fjalën e tij homazh, mbajtur në Asamblenë Kushtetuese, bëri për herë të parë të pranishme përgjigjen bujare që Wilsoni i kishte dhënë në takimin që ai kishte me presidentin në korrik 1917. "*E kam njohur këtë kalorës të kohëve të harruara, në një kohë tragjike, [874] më 4 të korrikut të vitit 1917, në Yach-in Presidencial Mayflouer, kur i rrethuar prej kabinetit, prej trupit diplomatik dhe prej përfaqsonjësve të rracave të ndryshme në Shtetet e Bashkuara, shkonte te varri i Washington-it për të prononcuar të parin diskurs luftarak. Atëhere iu afrova dhe i bëra një apel në emër të kombit tonë fatzi, dhe përgjigjen e tij bujare, tha Noli në Asamblenë Kushtetuse, e mbaj mend sikur po e dëgjoj sot*: Një*ë zë do të kem në Kongresin e Paqes dhe atë zë do t'a përdor për të mirën e Shqipërisë*, [875]

Presidenti, me 14 pikat e shpallur më 8 janar të vitit 1918, kërkoi vendosjen e paqes mbi bazën e parimit të kombësisë dhe të vetëvendosjes, parim që iu mohua kombit shqiptar nga Konferenca e Ambasadorëve 1912-1913 dhe bëri të mundur vendosjen e çështjes shqiptare në rrugën e zgjidhjes. Duke mirëpritur fjalën e presidentit amerikan, populli shqiptar e përjetësoi këtë veprim diplomatik në këngët e veta: [876] "*Shqipëtar kudo që ini, / thoni rroftë Willsoni, / me 14 pika, / i tha Evropës qëndroni*".

Denoncimi i Traktatit të Fshehtë të Londrës dhe qëndrimi i Presidentit amerikan, duke kundërshtuar kompromisin anglo-franko-italian, janar 1920, [877] zgjoi ndjenjën liridashëse të shqiptarëve. Mesazhi i Wilsonit ishte në kohën e duhur për Lëvizjen

[872] Bisedime të Kuvendit Kushtetuese, Mbledhja VIII.

[873] AQSH, F. 146, viti 1924, dos. 51. F. 156.

[874] Castellan Georges, *Historia e Ballkanit*, ÇAEJ, Tiranë 1996, fl. 450. Gjendja tragjike e vendit, -thekson Castellan, mobilizoi patriotët shqiptarë, përfshirë këtu emigrantët e Shteteve të bashkuara, organizata e të cilëve, "*Vatra"*, e kryesuar nga Fan Noli, diti të tërheq vëmendjen e Presidentit Uillson.

[875] AQSH, f. 146, viti 1924, dos. 51, fl. 161.

[876] Këngën, ma citonte Baba Sherifi Elbasani(Canometi), në shkurt të vitit 1984, duke dëgjuar fshehurazi në shtëpinë e tij(teqe), nga radion Ilira, Zërin e Amerikës.

[877] Kompromisi parashikonte; kalimin e Shkodrës, Shëngjinit dhe të luginës së Drinit në kufijt e Mbretërisë Sërbo-Kroate-Sllovene(MSKS). Kompromisi i janarit 1920 suprimonte memorandumin e lidhur midis këtyre fuqive, në dhjetor 1919, i cili bënte fjalë për një dalje tregëtare të MSKS në territorin e shtetit shqiptar. Për më tepër shih, *Histori e Shqipërisë vëll. III, 1984*.

Kombëtare Shqiptare, e cila organizoi Kongresin i Lushnjes[878] dhe Luftën e Vlorës, [879] me anë të së cilave arriti të konsolidojë ekzistencën kombëtare.

Këto dy ngjarje kulmore të historisë së kombit shqiptar në fillim të viteve njëzet u pasuan nga veprime të tjera politike të cilat siguruan tërësinë tokësore dhe pavarësinë e Shqipërisë.

Fjalën e plotë të Nolit e sigurova, si nga burimet arkivore, [880] ashtu dhe nga bisedimet e Asamblesë Kushtetuese, por nuk e shoh të arsyshme ta botoj të plotë sepse: Kjo ligjëratë është botuar e plotë në, Noli vepra VI, [881] botuar nën kujdesin e z. Ekerem Bardha, Tiranë 1996. Gjithashtu ky ligjërim është botuar nga studiuesi Nasho Jorgaqi, në punimin, "*Fan Noli Ligjërime*". Për këto motive nuk e shikoj të arsyeshme, të përfshij në këtë punim, fjalën e plotë të Imzot Nolit, për Presidentin amerikan. Por, do të shkëpus prej saj disa momente tepër domethënëse.

Në fjalën e tij, Noli përmendi arsyen pse Shqipëria merrte pjesë përkrah Amerikës, në atë ditë zie për Amerikanin e Madh. "*Titulli "Amerikan", mjafton që t'a bëjë popullin tonë të marrë pjesë në çdo vajtim të Amerikës, se që të gjithë e dim*ë *sa të mira kemi parë prej saj. Që në 1900 Amerika ka qenë kurbeti më i math i shqiptarëve... . . Në Amerikë shqiptarët themeluan Kishën Kombëtare, e cila është një bimë e rritur me djersën e punëtorëve tanë të atjeshëm dhe e cila pastaj u-transferua në Shqipëri. Dhe ky institucion si e dini ka nderuar faqen e Toskërisë Jugore"*. [882] Më tej Noli theksoi- "*Veç titullit "Amerikan", Wilson-i ka për mirënjohjen tonë edhe një titull tjetër, atë të idealistit, dhe të profetit të vëllazërimit kombëtar dhe të paqes së përbotshme[883]... . Më 1916 u përpoq të të sjell paqen... . E dini që të gjithë, cili qe programi universal i Wilsonit në Versilles. Cili prej jush s'ka dëgjuar të Katërmbëdhjetë pikat e Wilson-it, të sintetizuara në paktin e Lidhjes së Kombeve"*. [884]Noli për ta përjetësuar Wilsonin, në fjalën e tij, u shpreh: "*I mundur? Bah! I Vdekur? Kush tha! Fara idealiste që mbolli do të rrojë e gjallë sa kohë ka zemra njerëzore në botë*". [885]

Me duartrokitje dhe entuziazëm u përcoll fjala e Nolit dhe kujtimi i Presidentit Wilson prej gjithë parlamentarëve. Noli e ngriti zërin e tij për të respektuar Presidentin Wilson edhe në Lidhjen e Kombeve. Ai, duke i ftuar anëtarët e Lidhjes së Kombeve të rreshtohen nën flamurin e saj(LK), u shpreh: "*Përpara drejt shpëtimit, shpirti i Wilsonit atit dhe profetit të saj(LK) na udhëheq*". [886]

---

[878] Guga Nase, *Premisat historike për thirrjen e Kongresit kombëtar të Lushnjës*, kumtesë botuar në, *Kongresi i Lushnjës dhe Lifta e Vlorës*, Tiranë 1974, fl. 7-19.

[879] Po aty, Çami Muin, *Lufta e Vlorës luftë e popullit shqiptar*, fl. 139-154.

[880] AQSH, F. 146, viti 1924, f. 156-162.

[881] Akademi e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, *Fan S Noli, vepra 6*, Tiranë 1996, f. 151-164. dhe më tej, Nasho Jorgaqi, *Fan Noli Ligjërime*.

[882] AQSH*, F. 146, viti 1924, f. 157.*

[883] Po aty, f. 158.

[884] Po aty, f. 159.

[885] Po aty, f. 160. ose Noli, vepra nr. VI, fl. 151-156.

[886] Puto Arben, Demokracia e rrethuar, 8 nëntori, Tiranë 1990, f. 189.

Kuvendi Kushtetues i Shqipërisë mori gjithashtu vendimin për t'i dhënë "*emrin e Presidentit amerikan, Woodrow Wilson qytetit të Shëngjinit*". Për këtë ndryshim të emrit Drejtoria e shtypit njoftonte Prefekturën e Durrësit, dhe ajo me anë të një qarkore iu bënte të ditur dikastereve vartëse këtë ndryshim të emrit. Në njoftimin e saj, Prefektura e Durrësit theksonte: "*Drejtoria e Shtypit telegrafisht na njofton se, Këshilli i Nalt në bazë të vendimit të Këshillit Ministrial dhe të propozimit të Kryesisë së "Vatrës", bamun në Kuvendin Kushtetues, dekretoj ndryshimin e emnit Shëngjin në Wilson*". [887]

[887] *AQSH, F. I Prefekturës së Durrësit, viti 1924, dos, 30, f. 3.*

** Këtu duhet të kihet parasysh organizimi i shqiptarëve të Amerikës në shoqëritë atdhetaro-kulturore dhe formimi i Fderatës "Vatra". Shih sythin përkatës.*

VALBONA KALO (SHËNGJERGJI)

KRITIKA FUNKSIONALE E NOLIT, NË KONTEKSTIN SOCIAL-POLITIK TË VITEVE 1926-1930

Fakti që ende sot, studiuesit e letërsisë, historisë e të kulturës shqiptare, vazhdojnë t'ua kushtojnë studimet e tyre figurës së Fan Nolit, do të thotë, pa dyshim, që Noli i ka rezistuar provës së madhe të kohës, duke shënuar kështu një nga personalitetet e rëndësishëm të letrave shqipe.

Një ndërmarrje e tillë, siç është hulumtimi e analiza e mendimit kritik të këtij personaliteti të letrave shqipe paraqet vështirësi, sidomos të karakterit teorik, të cilat nisin që nga përkufizimet dhe modifikimet e shumta me të cilat është përballur termi "kritikë", që nga "Poetika" e Aristotelit e deri më sot.

Nisur nga përkufizimi i studiuesit Northrop Fraj, i cili *me fjalën kritikë përfshin tërë veprën skolastike dhe shijen që ka të bëjë me letërsinë e që përbën një pjesë të kulturës ose një fushë të studimit të arteve humane*[888], në fokus të këtij artikulli do te jetë, pikërisht, ajo pjesë e krijimtarisë së Nolit, e cila shpreh gjykimet dhe vlerësimet e tij për letërsinë.

Duhet theksuar fakti, se përpos mendimit të Nolit mbi letërsinë dhe diskursit që ai ka zhvilluar rreth saj, e gjithë vepra shkrimore e këtij studiuesi të letërsisë dhe kulturës karakterizohet nga fryma kritike, frymë kjo, e cila jo rrallëherë priret, më shumë drejt një natyre polemike. Këtu kemi parasysh veprën poetike, dramatike, publicistike e studimore të autorit. Tërësia e mendimeve të artikuluara mbi kritikën e Nolit (ajo që rezulton si kritikë mbi kritikën) nis me gjykimet e Çabejit[889], më 1936, e vazhdon deri në ditët e sotme, duke bërë pjesë të saj emra e personalitete të shumtë të fushës së letrave si: Kutelin, Pipën, Jorgaqin, Bihikun, Qosen, Aliun, Vincën, pa lënë mënjanë dhe konsideratat e vyera të albanologëve Jokli e Elsie.

Vështirësia që paraqet një procedurë e tillë, e interpretimit dhe shpjegimit të interpretimeve ekzistuese të Nolit mbi letërsinë, ka kushtëzuar dhe faktin se, disa nga këto gjykime, në lidhje me vlerat e kritikës së Nolit në ndonjë rast, paraqiten kontradiktore, madje duket sikur bien ndesh mes tyre. [890] Mjafton t'u referohemi dy gjykimeve të poshtëshënuara:

---

[888] Northrop Fraj, "Anatomia e kritikës", Prishtinë, 1990

[889] Eqerem Çabej *"Gjithë përkthimet e Nolit kanë një tendencë sociale në drejtim të përmirësimit të shoqërisë shqiptare"*

[890] Cit- Michel Montaigne*: "Më e vështirë është t'i interpretosh interpretimet se t'i interpretosh gjërat", .*

Rexhep Qosja tek "*Panteoni i rralluar*": "*Noli, edhe pse njohës i letërsive më të mëdha botërore, mbi të cilat është krijuar dhe shija e tij, ishte më shumë lexues se gjykues i veprave letrare*[891].

Agim Vinca tek *" Alternativa e letrave shqiptare*": " *Shqipërimet e veta të kryeveprave botërore, si janë tragjeditë e Shekspirit, romani i Servantesit, dramat e Ibsenit, Rubairat e Khajamit, etj, ai i shoqëroi me introdukta, por shkroi dhe shumë artikuj e ese për Shekspirin, Tolstoin, prandaj mund të thuhet që është një nga themeluesit e kritikës letrare në gjuhën shqipe, që e konstituoi atë si zhanër më vete.*

Jo vetëm poezia e tij, por edhe publicistika, fjalimet, introduktet, studimet etj, tingëllojnë sot të freskëta dhe aktuale". [892]

Duke iu referuar të dhënave historiografike, në lidhje me veprën e autorit, rezulton se interesimet e Nolit për kritikën, kanë nisur më 1906-tën, me një shkrim të tij për Shekspirin. Më pas, që nga përkthimi i "Otellos", më 1916-tën, Noli vijoi ta shprehë gjykimin e tij, për një sërë kryeveprash letrare, në formë introduktesh, veprimtari kjo, e cila mori formën e vërtetë të një kritike introduktore (të njohur si një nga format e kritikës botërore), të realizuar në harkun kohor të viteve 1926-1930.

Pas këtyre viteve, mendimi kritik i Nolit do të përfaqësohet vetëm përmes një artikulli për Tolstoin, ndërsa, pas vendosjes përfundimtare në Amerikë, ai do t'i kushtohet kryesisht studimit shkencor të heroit tonë kombëtar, Skënderbeut dhe figurës së Bethovenit.

Pikërisht këto shkrime kritike, si dhe proza historike" Historia e Skënderbeut" e studimi " Bethoveni dhe revolucioni francez", përbëjnë atë pjesë të veprës së Nolit, që do t'i japë atij atributin e një prej pararendësve të shkencës së re shqiptare. Ndërkohë, është e rëndësishme të theksohet se kritika, si një strukturë e mendimit, e pavarur nga pjesa tjetër e krijimtarisë së Nolit, nuk përbën një veprimtari sistematike dhe as sasiore në jetën letrare e kulturore të tij. Në këtë pikë, figura e Nolit kritik, pavarësisht nga mungesat që e karakterizojnë, duhet parë e lidhur ngushtë me figurën e tij shumëdimensionale, në fushën e letërsisë- politikës- fesë. Si përfaqësues i kombit në kuptimin e plotë të fjalës Noli, më shumë se çdo shkrimtar tjetër, e bëri letërsinë por dhe pjesën tjetër të krijimtarisë së tij i udhëhequr nga qëllime pragmatike, në funksion të edukimit të popullit shqiptar, duke synuar t'i ndezë atij ndjenjën kombëtare, në funksion të aktualitetit shqiptar të kohës së tij, si dhe të fatit të tij personal. [893] Në këtë këndvështrim, duhet parë dhe ndryshimi konceptual i asaj kritike, që synonte "Artin për art" e që do të të ishte "credo-ja' e një Konice, me formulën e Nolit, e cila do do të ishte gjithmonë "Arti për edukatë[894]. Kjo formulë do të përbënte dhe qëllimin e tij themelor, i cili do të kushtëzonte tiparet specifike, jo vetëm të veprës së tij letrare por edhe të asaj kritike.

[891] Rexhep Qosja, Panteoni i rralluar, "Rilindja", 1973, Prishtinë, f. 187

[892] Agim Vinca, Alternative letrare shqiptare, 'Shkupi", Shkup 2005.

[893] Ali Aliu, Kërkime, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1990, f. 271.

[894] Arshi Pipa Kritika, "Princi", Tiranë, 2006.

Pjesa më e madhe e kritikave të Nolit u shkruan si Introdukta[895], hyrje, të cilat sugjerojnë leximin si dhe mundësitë e ndryshme të kuptimit e të receptimit të disa prej veprave më të njohura të letërsisë botërore.

Kështu, kritika introduktore, përtej qëllimit pragmatist në lidhje me receptimin e kryeveprave botërore do t'i jepte gjithashtu mundësitë Nolit të shqyrtonte problemet që i dukeshin me interes dhe që krijonin asosacione të gjera me kuptimin e këtyre veprave të përkthyera po prej tij.

Duke folur për tragjedinë "Makbethi", Noli shprehet se: *kjo vepër mund të gjykohet e t'admirohet nga disa pikëpamje të ndryshme, nga këto të tria që pasojnë:*

1.Është pasqyra e tërë historisë së Skotlandës.

2.Është kritika e sistemit terroristik të guvernës dhe nga kjo pikëpamje është një përgjigje Makiavelian.

3.Është tragjedia e ambicies kriminale mëkati dhe punitja, jo në Ferrin e jetës tjetër, po në Ferrin e kësaj toke.

Kjo paraqitje është një shfaqje e qartë e dimensionit demokratik dhe të çliruar të kritikës noliane si dhe të vetëdijes së lartë kritike të tij për sa i takon pluraritetit të kuptimeve që mund të përmbajë një vepër letrare. Pikërisht, në këtë introduktë shprehet edhe koncepti i Nolit për kritikën si gjykim nën këndvështrimin e vlerësimit dhe të analizës që i bëhet veprës letrare[896], koncept ky mjaft i përafërt me atë të kritikës koniciane.

Qëllimi kryesor i kësaj analize nuk konsiston, thjesht, në përsëritjen e atyre fakteve që rezultojnë të përgjithshme dhe të njohura në lidhje me kritikën e Nolit, por në një këndvështrim specifik, që e fokuson kritikën e Nolit në kontekstin social-politik të Shqipërisë së viteve 1926-1930.

Pas shpalljes së Pavarësisë, në Shqipëri bëhet gjithnjë e më i dukshëm aktiviteti kulturor i shtypit, si një nga mediumet më aktive të kulturës, i cili në vitet '30 realizon një konsolidim të vërtetë. Gjithashtu, dhe arsimi pëson një hov zhvillimi, krahas atij të shtypit.

Përveç përkthimeve të Nolit, të cilat depërtonin në Shqipëri në mënyrë ilegale, përkthimet nga autorë të stileve e të popujve të ndryshëm, hapën këndvështrime të reja në vetë mendimin letrar e kritik të kohës. Përpos bazës teorike, prej nga nisej mendimi kritik shqiptar i kësaj periudhe, premisat jashtëletrare ndikonin dukshëm në formësimin e kritereve të vlerësimit të veprave letrare, ku vendin kryesor e zinte kriteri kombëtar.

Përtej tipareve të përbashkëta të kritikës shqiptare të kësaj periudhe, fizionomia origjinale e secilit prej përfaqësuesve të saj, përcaktohej nga formimi teoriko-kulturor, si dhe nga faktorë ekstraletrarë, biografikë, presonalë etj.

---

[895] Fjalor anglisht- shqip *introduction- Paraqitje, hyrje.*

[896] F. S. Noli, Vepra 5, Tiranë 1988, shtypshkronja "8 Nëntori", f. 192.

Në këndvështrimin teorik, Noli, në masë të dukshme, në kritikën e tij inkuadronte ndikime të teorisë së Hipolit Tenit e sidomos të raportit trikotomik raca-ambjenti dhe momenti. [897]

Dy prej tipareve karakterizuese të kritikës noliane janë ato, të cilat hedhin dritë mbi raportet që letërsia krijon me historinë, nga njëra anë dhe me shoqërinë, nga ana tjetër.

Raportin mes letërsisë e historisë, aq të pranishëm e të diskutuar nga kritika, që nga lashtësia, Noli e ndeshi ndërsa përkthente veprën dramatike të Shekspirit.

Në analizat kritike, që i paraprijnë veprës së dramaturgut të madh, konstatimet e tij dëshmojnë thellësi dhe qartësi për sa i takon këtij raporti:

"Shekspiri, është aq artist sa asgjëkundt nuk na jep përshtypjen se mban një konferencë historike dhe politike të kurorëzuar prej një sermioni plot mësime morale. Na tregon një histori dhe na lë të heqim konkluzjen[898]*".*

Ky gjykim i Nolit, por edhe të tjerë, që i takojnë mendimit të tij kritik, shprehin qartë pikëpamjet që ai kishte në lidhje me natyrën e artit e të letërsisë në veçanti, sipas të cilës, qëllimi i artit nuk është të jetë një riprodhues besnik i historisë, por të synojë një të vërtetë artistike e cila është shumë më e rëndësishme se ajo historike.

Pavarësisht nga prirjet dhe natyra e tij prej historiani, Noli ka ditur të bëjë dallimin mes të kaluarës historike si dekor dhe kësaj të kaluare si lëndë letrare, përmes së cilës shkrimtari nxjerr përfundime universale. Jo rastësisht, Noli vlerëson më shumë ato vepra të cilat, Shekspiri i ka shkruar " *pa marrë shumë në sy hollësitë historike*".

Noli i ka shkruar kritikat duke pasur parasysh receptuesit shqiptarë të kohës së tij, të cilët i karakterizonte një arsimim dhe formim letrar modest, madje i një shkalle të ulët**.** Në këtë aspekt, pozitivizmi i tij, lidhur me shpjegimin e kontekstit historik e kulturor të autorit të veprës (metoda biografike) si dhe përmbledhja e shkurtuar e ngjarjeve historike që ka në qendër vepra me të cilat nis pothuajse çdo introduktë e tij, ka pikërisht këtë qëllim: T'u afrojë atyre receptuesve mundësi leximi dhe t'i drejtojë drejt një domethënie që këto vepra duhet të marrin për të gjitha kohërat e breznitë.

Duke u parë në kronologjinë e zhvillimit të saj, kritika e Nolit vjen duke u rritur nga introduktat e tij të para, ku ndiehet mungesa e një metode të formuar dhe e një qasjeje të sigurtë ndaj veprës letrare. Në këtë fazë të kritikës introduktore funksionon e njëjta skemë formale, e cila paraqitet: fillimisht, na paraqitet një lloj biografie artistike të autorit, e më pas paraqitet në formë të shkurtuar, subjekti i veprës, shpeshherë vetëm përmes disa rreshtave. Duke u përqëndruar më shumë tek ngjarjet që përbëjnë thelbin e veprës, Noli realizon analizën e thellë të personazheve qëndrore dhe dytësore të Makbethit, të botës së gjerë e komplekse të Hamletit, apo të Brutit e Kasit, duke i vendosur në ambientin dhe rrethanat historike ku ato veprojnë. Pra, historia, në momentet e kthesave të mëdha, do t'i shërbejë atij si një kornizë për zbërthimin e personazheve dhe për të realizuar interpretimet e tij-vizionin që ai ka për veprën, çka përbën dhe një nga detyrimet e kritikës introduktore.

---

[897] Ibrahim Rugova, "Kahe dhe premise të kritikës letrare shqiptare, 1504-1983", Eurorilindja, 1996, botim II, Prishtinë. f 125.

[898] F. S. Noli, Vepra 5, Tiranë 1988, Shtypshkronja "8 Nëntori", f. 194.

.

Letërsia edhe kur arrin kulmin, në një vepër arti të shkëlqyer është pasqyrë shpirtërore dhe shprehje e shoqërisë njerëzore në një fazë të caktuar historike e në tension të plotë mes ideales e realitetit, ajo bëhet art sublime vetëm kur i riprodhon këto kushte historike, në sajë të kapaciteteve të saj transformuese. [899]

Një nga treguesit e ndikimit, që kritika sociologjike ka patur në konsolidimin e metodës kritike të Nolit, janë çështjet e rëndësishme teorike që ai shtron, në lidhje me aspektin tematik të veprave letrare të përkthyera prej tij e sidomos, mënyra se si ai i sjell këto problematika dhe personazhe në realitetin politiko-social shqiptar të viteve '30, duke i bërë jehonë këtij të fundit.

Kështu, tek "Otello" theksohet problemi racial dhe ai i intrigës, tek "Makbethi", dëshira e verbër për pushtet, ambicia kriminale, tek "Jul Qesari" lufta e grupeve për pushtet dhe psikologjia e tiranit, ndërsa tek veprat "Armiku i popullit" e "Don Kishoti" ngrihet teza e klasave shoqërore.

Përmes qasjes së trefishtë, të racës, ambientit e momentit, Noli do ta analizojë sidomos figurën e Don Kishotit, si përfaqësues të klasës së tij: "*S'ishin as tamam aristokratë, as tamam fshatarë, po ca më keq se të dy palët. Duke mos pasur as punë, as bazë, përpiqeshin t'i gjenin këto të dyja, jo përpara, po prapa, në kohët e vjetra…Kështu, Don Kishoti kërkon e gjen punë si kalorës i arratisur, sic ishin stërgjyshët e tij…*[900]"

"Kur ata bëhen qesharakë dhe hanë dru doemos këndonjësit gëzohen, se në fytyrën e tyre bëhen qesharakë dhe hanë dru dy klasat shoqërore më të urryera dhe më prapavajtëse, klasa e bejlurçinës dhe klasa e laros"[901]

Nga gjithë literatura e konsultuar në lidhje me dy heronjtë e kryeveprës së Servantesit nuk ka qenë e mundur të gjendet një mendim-vlerësim tjetër kaq aktualo-subjektiv mbi këtë çështje sa ky i shprehur më sipër. [902]

Më shumë se sa bindje, teza dhe argumenti për ngjashmërinë e identiteteve (identifikimi i Don Kishotit e Sanço Pançës në realitetin shqiptar) ishte nevojë e brendshme e Nolit, përjetim i dramës së të syrgjynosurit, i cili çdo lëvizje njerëzore përpiqet ta vërë në shërbim të situatës politike që ishte krijuar në Shqipëri, sidomos në 1924.

Me introduktën "Don Kishoti'', ai mbetet shembulli më karakteristik për sa i takon prirjes së adaptimit dhe njësimit me aktualitetin shoqëror dhe kombëtar-historik; Don Kishoti i Servantesit posa shkel në truallin shqiptar detyrohet të marrë pjesë aktivisht në ngjarjet kryesore politiko-shoqërore të viteve '20-'30.

Më shumë informatike se analitike, më shumë interpretuese e ideve, kritika introduktore e Nolit është një pasqyrim i qëndrimeve të tij politike dhe morale si dhe një model i mënyrës se si i mbron bindjet e tij artistike, sociale e ideologjike një kritik letrar.

---

[899] Cit- "Sulle posibilita di interpretazione"Krauss, 1963, Berlin.

[900] F. S. Noli, Vepra 5, Tiranë, 1988. f 219

[901] Po aty, Introdukta.

[902] Ali Aliu, Kërkime, Shtëpia botuese"Naim Frashëri", Tiranë, 1990, f. 268.

Nga gjithë begatia e pashtershme kuptimore që ka sugjeruar gjatë shekujve kryevepra e Servantesit, Noli zgjodhi me vetëdije të plotë t'ia nënshtrojë çdo veprim, çdo mundësi demaskimit të prapësisë si dhe çlirimit të popullit e atdheut të tij nga kjo prapësi, me qëllim ndërgjegjësimin e shoqërisë shqiptare dhe edukimin e saj.

Në këtë mënyrë kritika e Nolit vërteton pohimin e strukturalistit. Barthes, sipas të cilit: "*çdo kritikë është kritikë e veprës dhe kritikë e vetvetes; ajo është njohje e tjetrit dhe lindje e vetvetes. E parë në këtë këndvështrim, kritika nuk është thjesht një përmbledhje gjykimesh, ajo është qenësisht aktivitet, domethënë një varg aktesh intelektuale thellësisht të anagazhuara në ekzistencën historike dhe subjektive të atij që i realizon".* [903]

[903] Cit-R Barthes, Bajram Krasniqi, Letërsia dhe vetëdija historike, "Rilindja"Prishtinë, 1984, f212

ZEQIR KADRIU

FISNIKËRIMI E EDUKIMI I NOLIT NË IBRIK-TEPE

Si një copëz e shkëputur nga Shqipëria e të parëve të fisit të tij, ishte vendosur te vendlindja e Fan Nolit, Ibrik –Tepe; një fshat shqiptar në Thraki, afër Adrianopojës, ashtu siç ishin edhe disa lokalitete të tjera afër tij; që për nolianët një zonë ku jetonin me të gjitha traditat, ashtu si për nga mënyra e jetesës, edhe për nga zakonet, doket dhe temperamenti i të parëve që kishin marrë me vete si trashëgim nga Shqipëria. Aty shpirti i tij (Nolit), thithi të pastër botën e etnisë shqiptare, kulturën e gjerë popullore, mori informacionin e parë për historinë e Shqipërisë e jetën e kryetrimit Skënderbe dhe fitoi edukatën e familjes me shumë përkujdesje nga gjyshja e tij Suma; me të cilën u rrit, u edukua e u kultivua si fëmijë.

Një këshillëdhënës tjetër i Fan Nolit që në moshë të re ishte Gjerd Kapidani i cili e ndiqte në çdo hap punën e djaloshit të vogël që ushqente ambicie shumë të mëdha nga sfidat e njëpasnjëshme të jetës së rëndë fëmijërore në fshatin e Trakisë ku ishin vendosur shumë shqiptarë asokohe dhe kishin gjetur mundësinë të punonin e jetonin si bujq e ararë. Thrakia e asaj kohe ishte një pellg i pasur në mes dy lumenjve dhe vendasit nuk kishin mundur ta mbulonin me punë; ndaj edhe qe mundësuar që kjo pjesë të popullohej me shqiptarë, sado që jeta e tyre shpesh herë ndodhej në rreziqe ngaqë patriarkana greke dhe sundimi Bizant nuk kishte mendime të mira për shqiptarët, aq më tepër për ardhacakët e vendosur në pellgun e bereqetshëm në mes dy lumenjve ku bëhej buka dy herë në vit. Ndaj edhe për çdo moment jeta e tyre ishte si në gojën e ujkut. Asokohe të gjithë të krishterët ortodoksë, të Perandorisë Turke, pa marrë parasysh racën dhe gjuhën e tyre, mësonin në shkolla greke dhe apriori kishin tendenca që t'i asimilonin e t'i konvertonin, me të vetmin qëllim që edhe të mos prishej balanci i punës që bënin me mësim në shkollat greke së bashku me dhaskalët e tyre për të zhdukur përfundimisht shqipen e shqiptarët e zonës përreth Maricës.

Po si shpëtoi Noli nga ky sebep? Ai ishte nxënësi më i mirë i edukuar dhe emancipuar në frymën patriarkale shqiptare nga gjyshe Sumba e cila ishte një fshatare fisnike me botëkuptime të vjetra; ndaj nuk kishte dyshim se Noli si nxënës i shtatëvjeçares dhe i gjimnazit grek nuk i përballoi edhe aq me lehtësi sfidat që kishte me moshatarët e shkollës. I edukuar sipas traditës; ai me zgjuarsi do të vështrojë veprimet e gjyshes së tij Sumba, e cila mbante me fanatizëm të veshur kostumin e maleve të Shqipërisë së Jugut sidomos të Dardhës së Korçës dhe Lungjerisë afër Gjirokastrës ngaqë veshjet e lirit me bojëra turke nuk i pëlqenin fare[904].

Kjo në një farë mënyre do të ngulitet në trurin e djaloshit të vogël për të pasur edhe një respekt ndaj asaj që shihte te gjyshja po edhe tek shqiptarët – burrat e tjerë që me kënaqësi do të bëhen pjesë e emancipimit dhe kulturës kombëtare tek Noli i vogël për frymën e tij patriotike që më pastaj do t'iu përcjellë gjeneratave gjatë gjithë jetës.

[904] Qosja, Rexhep. *Historia e letërsisë shqipe 2.* Prishtinë 1984

Edhe pse shëndetlig, ai kishte shumë dëshirë të merrte pjesë në recitalet që bëheshin në shkollë me mësuesin e tij në Ibrik-Tepe, ku shpesh ishin edhe fshatarët por e keqja qe, sepse të gjitha këto ishin në greqishte, dhe askush nga të pranishmit nuk i kuptonte, madje as edhe gjyshi i Nolit nuk dinte as edhe një fjalë greqisht, por magjepsej pas recitalit që bënte i nipi i tij me një artikulim shumë të qartë e të rrjedhshëm, edhe pse nuk ia dinte kuptimin.

Ai shpesh (siç pohon edhe vetë Noli), nganjëherë ia behte në këmbë duke protestuar me zë të lartë: "Shqip ore, shqip"! Që donte të thoshte, se ne nuk marrim vesh asnjë fjalë!

Dhe me të vërtetë, pjesa dërmuese e të pranishmëve pajtohej me Gjerd Kapidanin, sepse as ata nuk merrnin vesh nga ajo që recitohej. Kjo gjë ia kujtonte Fan Nolit të ri, se shqipja, e jo greqishtja, lipsej t'u mësohej atyre fëmijëve shqiptarë. Kështillëdhënës tjetër ishte edhe Xha Tasi, i biri i gjymtë i gjyshit Mitrush. Ai siç edhe thuhej nga vetë Noli (në autobiografia) ishte i paaftë që të punonte në arë; por merrej tërë kohën me leximin e librave.

Në fshat kishte bibliotekën më të madhe dhe vetëm lexonte e jepte këshilla. Pikërisht në atë kohë Stilian Noli dhe e gjithë familja e tij, bashkë me gjyshen Sumba, u shpërngulën në një shtëpi tjetër po kjo nuk i pengoi që edhe më tej këta të hynin e dilnin te njëri –tjetri e të kishin afri familjare. Noli do të shprehte edhe më tepër pasion të dëgjonte e merrte libra nga Xha Tasi prej të cilit mori edhe një edukatë të mirë. Dashuria për të lexuar e bëri që Noli të mësonte gjërat nga më të mirat që kishte edhe pse në moshë shumë të re, dhe të bënte ndonjëherë edhe çudira të cilat i habisnin të gjithë familjarët se si ky djalosh i cili në fillim nuk e donte shkollën fare; tani rinte me bërryla për dysheme duke lexuar pa ndërprerë libra të ndryshëm.

Shpesh Xha Tasi e pyeste për Skënderbeun ose Dhiatën e re, në mënyrë që ta kishte të qartë se sa kishte lexuar çuni i vogël; por vështirë se e mbetej pa përgjigje, gjë që e magjepste Xha Tasin; e bënte të mburrej me edukatën dhe kulturën që i kishte dhënë Nolit të vogël. Noli me të vërtetë në këtë fazë mori një edukatë e emancipim të mirë por, mbi të gjitha ai vazhdoi të punonte e mësonte me shumë pasion edhe në shkollën edhe në familje. Në shkollë pati shumë mësues, po nga njëri prej tyre mori mësim dhe edukim të mirëfilltë. Ndërsa në shtëpi kishte dy të tjerë më kryesorë!

Meqë kishte dy prijës që i kishin mbetur trashëgim nga edukata famulltare dhe familjare. Jezuin dhe Skënderbeun, vazhdonte të besonte me fanatizëm dhe shpesh bënte krahasime. Të krahasosh me ta, mësuesit grek të fillores dhe të gjimnazit ishin me të vërtetë shumë të vegjël, që t'i linin mbresa ose të kishin ndonjë ndikim mbi të; por leximi i vazhdueshëm e kishte aftësuar të riun të gjykojë arsyeshëm edhe në momentet më kritike të jetës së tij.

Mirupafshim, Ibrik-Tepe!

Udhëheqësit e asaj kohe, (e shkollës në Adrianopojë), për shkak të një greve që organizohet në mbrojtje të një profesori të quajtur Athanasiadis, duke e akuzuar Nolin si organizator e pengoi që të diplomohej në afatin e paraparë, dhe shtyu diplomimin nga maji gjer në shtator (të atij viti), me ç'rast Noli ngeli prapa dhe nuk iu mundësua as të diplomohet e as të punësohet në ndonjë vend si mësues. Kjo u bë shkas që Noli të lëshojë Ibrik-Tepen dhe të shkoj në ndonjë vend tjetër. Në kokë të riut inteligjent, i

silleshin shumë ide pasi ishte kalitur me shumë mësime e ndjenja dhe ishte pjekur tani më që të çante rrugën vet. E vetmja gjë që shpesh e vente në dyshim ishte, shëndeti i tij i lig i cili e kishte përmbysur disa herë dhe kishte çuar deri në prag të vdekjes. Përpara këtyre dilemave Nolit i ishte bërë shprehi ta pyes veten: Vallë, çdo të bënte Napoloni në një rast të tillë? Ose: Vallë si do të vepronte Skënderbeu në një rast të tillë? Përgjigjen e kishte të lehtë për ta gjetë. " A thua si do të vepronte Jezui në një rast të tillë"? Përgjigja ishte e lehtë që ta jepte! "Jezuiu do t'i besonte Perëndisë dhe do të shkonte përpara". Por Noli më shumë se kaq besonte tek gjyshja Sumba e cila për raste të tilla anashkalonte Skënderbeun e Napolonin dhe besonte vetëm Jezuin. Prandaj vendimi që mori qe anonim.

Noli do të lë Ibrik Tepen. Ai do të niset për në Athinë. Definitivisht (më në fund), që nga ai moment do të ndryshojë edhe kahen jeta e tij. Punët e rënda që do të bëjë, njëra pas tjetrës do ta kalitin djaloshin dhe do ta aftësojnë shumë më tepër për jetë. Do ta bëjnë më të aftë e më atdhetar dhe do ta çojmë në një rrugë për të mbetur përgjithmonë figurë e nderuar në kujtesën jo vetëm të familjes së stelianëve por të gjithë shqiptarëve. Ibrik –Tepeja do t'i japë Rilindjes shqiptare një pionier i cili do ta përmbushë misionin e një atdhetari e patrioti të nderuar. Ashtu siç e parandiente edhe ai vetë. Rrugët e Edrenesë e Keshanit që do t'i ketë frekuentuar shumë herë vetë; do t'i kujtojnë atë kalldrëmin e vjetër që me siguri do ta ketë çapitur edhe vetë Skënderbeu, që mbi të gjitha do të kryej me nder e sakrificë misionin e vetë. Noli i vetëdijshëm për misionin e tij të vështirë, kurrë nuk do të ndalet së vepruari, por me ngulmë do të vazhdoj punën.

Edhe pse i ndërgjegjshëm se rrugët e ndihmesës së çështjes kombëtare ishin mjaft të gjata dhe kishte shumë për të bërë, nuk do ta ndërpresin hovin e djaloshit ambicioz për të vazhduar edhe më tej për ndjenjën e thellë të atdhedashurisë që ai kishte.

Pasi kreu në greqishte, shkollën fillore dhe gjimnazin, në vitin 1900, në moshën 18 - vjeçare, ai u largua nga vendlindja për të mos u kthyer më dhe shkoi në Athinë. Në gjimnazin grek ai ishte njohur me letërsinë antike greke, me letërsinë europiane e sidomos me veprën e Shekspirit.

Kjo gjë i kishte ngjallur atij dëshirën për ta zgjeruar kulturën e vet, dëshirë që mbeti e zjarrtë në shpirtin e tij deri sa edhe vdiq. Kështu ky djalosh i ri, me interesa të gjera; edhe pse shëndetlig, por i guximshëm e me një intuitë të zhvilluar, i hyri rrugës së studimeve, që për të, ishte mjaft e vështirë, sepse i mungonte përkrahja e mjetet financiare. Pikërisht prej kësaj mungese ai shpejt i ndërpreu ato aktivitete, me dëshirë që do të mund t'i vazhdonte shumë më vonë në një moshë më të pjekur. (Vetëm me 1912 ai kreu studimet e larta dhe u diplomua për arte, kurse më pas në moshën 55-vjeçare, mbaroi konservatorin, dhe në moshën 63-vjeçare mori doktoratën e filozofisë për histori).

Për të siguruar jetesën hyri në një shoqëri tramvajesh e me pas si sufler në një teatër.[905] Herë-herë luante edhe ndonjë rol të vogël, por puna në teatër nuk i pëlqeu më

[905] Noli. Fan, Autobiografi, 1960

tepër, sepse e nxiti të shkruante dramën **"Zgjimi",** në greqisht, (e cila u ndalua të shfaqej, sepse aludonte për lëvizjen shqiptare për liri), dhe me vonë dramën në shqip **"Izraelitë e filistinë**". Më 1903 shkoi në Egjipt ku punoi për dy vjet si mësues. Gjatë kësaj kohe ai u njoh me patriotë të shquar të kolonisë shqiptare të Egjiptit: Thanas Tashkon e Jani Vruhon, të cilët luajtën një rol të rëndësishëm për drejtimin që do të merrte jeta e Fan Nolit. Ata e lidhën atë me lëvizjen patriotike shqiptare edhe ai po në këtë kohë përktheu në greqisht veprën e Sami Frashërit **"Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet"**. Më 1906 Noli u dërgua në Amerikë nga patriotët e kolonisë së Egjiptit për organizimin e lëvizjes kombëtare të shqiptarëve të atjeshëm. Brenda një kohe të shkurtër Noli krijoi shoqërinë "**Besa-besë**", që më pas u shkri në federatën **"Vatra**"si dhe gazetën **"Dielli".** Periudha më e rëndësishme e aktivitetit të tij në të gjitha fushat është dekada 1920-1930. [906]

Noli zhvilloi një luftë të ashpër në Parlament dhe jashtë tij kundër gjithë forcave reaksionare dhe feudale, duke ngritur zërin për vendosjen e lirive demokratike dhe zbatimin e reformës agrare. Fjalimi i tij mbi varrin e Avni Rustemit në Vlorë shënoi fillimin e Revolucionit Demokratik në Shqipëri.

Këtu do të nisë lufta politike dhe parlamentare që Noli do ta zhvillojë për një kohë, por pa sukses. Si shpirt demokrat që ishte, kurrë nuk do të dorëzohet përpara padrejtësive dhe sfidave të cilat do ta shoqërojnë Nolin përgjatë gjithë periudhave; por as këtu nuk do të zbrapset! Shoqëria shqiptare ende (për fat të keq), asokohe nuk ishte e përgatitur për idetë përparimtare e revolucionare që do t'i ofronte Noli së bashku me aleatët e vetë. "Në mungesë të shtetit shqiptar, vepra kulturore e shqiptarëve hynte në tregun me të çuditshëm që mund të kishte pasur ndonjëherë. "

Ndaj përpjekjet qëllimmira do të mbeten vetëm një orvatje e cila do të përfundojë pas një periudhe gjashtëmujore e cila ngeli si një copëz e historisë së një kulture demokratike që njeh demokracia e brishtë shqiptare për atë kohë.

Kthimi i Nolit sërish në Ibrik-Tepe

Noli kurrë më nuk do të kthehet në Ibrik –Tepe. Nuk do ta shohë as gjyshe Sumbën, e as vëlla Dhimitrin që e deshi aq shumë. Nuk do të takojë asnjë nga fisi i të parëve të tij. Jeta do ta çojë gjithandej në kënde të ndryshme të botës, sepse i tillë ishte Noli, të tillë e shihte jetën dhe nuk kënaqej me atë për çka mendonte se duhet të bëjnë shqiptarët. Malli do t'i mbetej i pashuar për gjithë jetën në kujtesën e tij. Por vitet ecnin, historia e shqiptarëve do mbetej si një rrugë e patrazuar për një demokraci të vërtetë. Noli do të largohet përgjithmonë nga Shqipëria, që aq shumë e deshi, aq shumë u mundua por nuk u bë ashtu siç e mendoi dhe dëshiroi ai vetë. Puna dhe aktiviteti i tij do të gjejë më shumë përkrahje jashtë atdheut, ashtu sikundër vepruan e

[906] Historia e letërsisë shqipe-Romantizmi, 1, Prishtinë, 1984,

punuan shumë rilindës të tjerë të cilët me forma e mënyra nga më të ndryshmet, e ndihmuan vendin e atdheun e tyre. Për Nolin Amerika hapi një rrugë të re e cila më pas do të jetë udhërrëfyes për kulturizimin e emancipimin e gjeneratave që do vijnë. Ai në Amerikë do të punojë së bashku me shumë patriotë të tjerë shqiptarë që kurrë nuk kursyen për të mirën e çështjes kombëtare. Do të takojë fillimisht Vani Vagjeli një patriot shqiptar që aso kohe udhëhiqte shoqatën"Malli i Mëmëdheut"e cila i bashkonte shqiptarët dhe bënte ç'është e mundur për të ndihmuar Shqipërinë. Do të njihet pastaj me Soti Pecin, Spiridon Ilon e Gjergj Gjushin, që aso kohe vepronin nga Nju Jorku i Amerikës. Veprimtaria e tij do vazhdojë pastaj me shumë punë nga fusha e gazetarisë, karrierës kishtare, punës organizative dhe kontaktet e shumta me patriotë të ndryshëm që vepronin aso kohe nga Amerika. Me rëndësi qe bashkëpunimi i tij me Nikolla Naçon e Faik Konicën të cilët bëhen edhe strumbullarë për ngritjen, emancipimin dhe edukimin, jo vetëm të shqiptarëve të Amerikës por edhe të tjerëve përgjithësisht. Për një kohë ato do të bëhen shokë të pandashëm e të përjetshëm dhe do të bashkëpunojnë për kauzën shqiptare, ndonëse për shumë çështje nuk do të pajtohen duke shfaqur herë-herë edhe fërkime të mëdha. Noli në rrugën e tij për emancipimin dhe edukimin shqiptar do të bëjë orvatjet edhe përmes Kishës Ortodokse (që e pat themeluar prej kohësh); por edhe ajo nuk do të mjaftojë aq sa duhet që ai të arrinte qëllimin.

Do të vazhdojë edhe më tej me këmbëngulësi si Delegat i Kishës, Kryetar i Vatrës, Delegat në lidhjen e kombeve, Kryeministër i Shqipërisë, por sërish vdekja do ta presë në mërgim. Ai kurrë nuk do të kthehet në Shqipëri dhe do të përmbyllë karrierën e tij në Boston më 1965.

Pas 130-vjet nga lindja e tij më 6 janar 2012, do të inaugurohet busti i Fan Nolit, në sheshin Republika, të Ibrik-Tepesë, një vepër mbi 2 metra e lartë e cila është realizuar në bronz nga Andrea Demce. Sot, si i tillë, busti është mirë që vendoset pikërisht këtu në Turqi; por bustin e Nolit ku do ta shikojnë gjithë shqiptarët tani. Atë po e ngre Korça, aty ku është edhe qendra e Universitetit po me të njëjtin emër.

Pra për të ngelur i pavdekshëm e përgjithmonë dhe për ta përkujtuar me krenari figurën e

Nolit, patriotit, kësaj mendje universale, poetit të shquar, historianit, publicistit e përkthyesit të pasionuar, diplomatit e burrështetasit, Kryeministrit e mbi të gjitha themeluesit të parë të Kishës Autoqefale Shqiptare, muzikantit e përkthyesit të madh i cili me mjeshtri shqipëroi nga anglishtja, më mirë se çdokush tjetër.

Një gazete lokale e quajtur "DUNYA" botoi lajmin, se po vendoset busti i Nolit përfundimisht në vendlindjen e tij. [907]

[907] Arnavutluk'un ilk Başbakanı Theofan Stilian Noli'nin büstü, 6 Ocak 2012 Cuma günü İbriktepe Beldesi'ne dikilecek. 6 Ocak 1882 tarihinde İbriktepe'de doğan ve Arnavutluk tarihinin en ünlü kişilerinden, Arnavut kültürünün önde gelen düşünürü, yazar, tarihçi, 1924 yılı Haziran ayından aynı yılın Aralık ayına kadar Arnavutluk'un Başbakanlığını yapan Theofan Stilian Noli'nin büst dikme törenine Arnavutluk'tan 60 kişilik heyet katılacak. Törene, Edirne Valisi Gökhan Sözer'in yanı sıra, birçok bürokratın da katılacağı kaydedildi. Daha önce 6 Ocak 2011 tarihinde yapılacağı açıklanan büst dikme töreni, organizasyon eksikliği nedeniyle 1 yıl sonraya ertelenmişti. "Dunya", revistë lokale, Edirne, 12, janar, 2012

EDLIRA DHIMA
ERMELINDA KASHAHU

NOLI-NJË FIGURË POLIEDRIKE

Noli, larg dhe afër Shqipërisë

Emri i Fan Nolit është lidhur me gjithë kulturën e re shqiptare të shekullit tonë. Për fat të keq si shumë artistë të mëdhenj shqiptarë, ai lindi dhe vdiq larg atdheut. Por midis këtyre dy datave, zemra e tij e madhe rrahu vetëm për Shqipërinë, shpirti i tij krijoi gjëra madhështore që e lartësuan dinjitetin e shqiptarit, kurse në veprimtarinë energjike të përditshme iu përkushtua pavarësisë e tërësisë tokësore të atdheut dhe sidomos demokratizimit të jetës shqiptare.

Ai qe njeri me talent të gjithanshëm e të fuqishëm. Një erudit, një enciklopedist. Ndryshe nuk mund të shpjegohet vepra e tij madhore.

Lindur në një kënd në kryqëzimin e kulturës Lindore dhe asaj Perëndimore: greke e romake, arabe e persiane, i rrahur prej këtyre kulturave të mëdha, nuk çuditemi për kulturën dhe sensibilitetin e tij të dyfishtë. Kjo gjerësi shpirtërore dhe intelektuale shfaqet si prirje e tij për t'iu adaptuar çdo klime shpirtërore. Përcjellës i dy kulturave të mëdha në gjuhët e tyre origjinale, ai ka mundur t'u përshtatet njësoj të dyjave. *"I prirur sa për dramaturgji aq edhe për lirikë, sa për punë shkencore aq edhe për krijimtari muzikore, Fan Noli sikur besonte se çdo aktivitet tjetër përpos atij patriotik dhe politik, ishte një punë gati e parëndësishme në krahasim me kërkesat praktike që shtronte kjo gjendje në të cilën gjendeshin shqiptarët".* [908] Si intelektual i mirëfilltë dhe i formuar më së miri, ai besonte se: "*Kish për detyrë të çlironte dy milionë shqiptarë nga Perandoria Turke, e cila kish një populsi prej më se gjashtëdhjetë million banorësh".* [909]

I vendosur në rrugën e idealit të tij patriotik, për hir të të cilit ai sakrifikoi gjithçka në jetë, gjakftohtë dhe vetëmohues, i papërkulur në bindjet e veta ideologjike dhe politike, ai ishte një vullkan energjie dhe vendosmërie, një njeri që merr frymë vetëm për qëllimin drejt të cilit ecën. Origjinal në mendime dhe në sjellje, origjinal edhe në dashurinë ndaj Shqipërisë, ai e deshi atë me të mirat dhe të këqijat. Sipas tij, ajo vuante prej pesë anarkive: *anarkisë fetare, anarkisë sociale, anarkisë morale, anarkisë patriotike dhe anarkisë së idealeve.* [910]

Noli luftoi për shtresat e varfra dhe u orvat të krijonte një shtet modern shqiptar, pikërisht në dobi të tyre. Edhe pse për shqiptarët mendonte se ishin të vrazhdë e të paqytetëruar, ai bëri përpjekje titanike për ngritjen morale dhe kulturore të tyre. Racionalist dhe realist, ai nuk i fshehu kurrë problemet politike e shoqërore si shumë

---

[908] R. Qosja, *Shkrimtarë dhe periudha*, Mësonjëtoreja, Tiranë, 2005, f. 234.
[909] F. Noli, *Autobiografia,* Rilindja, Prishtinë, 1968, f. 75.
[910] L. Dilo, *Ligjëron Fan Noli,* Ismail Mal Osmani, Tiranë, 1944, f. 64-65.

të tjerë. Dëshmitar i Shpalljes së Pavarësisë, i dy luftërave ballkanike e botërore, ai përjetoi dhe baticat e zbaticat e popullit të tij.

Figurë madhore e kombit

Fan Noli është njëri nga personalitetet më komplekse të letërsisë shqipe, qoftë nga veprimtaria politike, shoqërore e kulturore, qoftë nga ideologjia drejtuese e pikëpamjet estetike, qoftë nga krijimtaria publicistike e letrare. Qysh në rininë e hershme, nevoja e shtyu të endet nëpër botë dhe të njihet personalisht me burra shtetesh, diplomatë, klerikë të lartë, ideologë, revolucionarë, shkencëtarë, muzikantë, artistë, letrarë, filozofë dhe humanistë.

I etur për dituri, në Amerikë ai u shkollua rregullisht dhe u diplomua për filozofi në Universitetin e Harvardit në Boston Mass, si edhe për muzikë në konservatorin e Nju-Englandit dhe në moshën 63 vjeç, mori doktoratën për histori në Universitetin e Bostonit. Themelues i gazetës "Dielli" dhe Federatës "Vatra", udhëheqës i lëvizjes patriotike të shqiptarëve të SHBA-së, kryeministër i Qeverisë Demokratike që doli nga Revolucioni i Qershorit më 1924 dhe luftëtar i denjë kundër fashizmit. Noli bashkëpunoi edhe me shumë të përkohshme demokratike si: "Dielli", "Kombi", "Koha", "Republika", "Shqiptari i Amerikës", "The Adriatic Reveu" etj. Poet, dramaturg, studiues i muzikës, historian, përkthyes i pasionuar, politikan, në të gjitha këto fusha ai ka lënë krijime me vlerë për historinë dhe kulturën e popullit tonë.

Shkrimtarët dhe krijuesit e antikitetit grek e romak hyjnë në fushën e interesave të Nolit. Ai krijoi kur në arte dhe në shkencë fjalën kryesore e kishin Prusti, Xhojsi, Mani, Shou, Kafka, Majakovski, Gorki, Pirandelo, Hajdegeri, Anjshtajni e të tjerë, por në shkrimet e tij përmenden emrat e së kaluarës së largët: Sokrati, Platoni, Aristoteli, Virgjili, Khajami, Shiriazi, Firdusi, Saadi, Dante, Makiaveli, Servantesi, Shekspiri, Volteri, Rusoi, Davidi, madje edhe Niçe, Vagneri, Tolstoi e Ibseni. "*Kjo domethënë se Noli kishte qejf të kridhej në të kaluarën kulturore, por edhe të ecte gjithmonë majave të larta, ndonëse kurrë nuk ka treguar moskuptim për artet moderne e veçanërisht, për poezinë".* [911] Përkthyes i poezive të Po-së, Bodlerit, Verlenit, Ibsenit ai ka shprehur mirëkuptim lexuesi e mendimtari për to.

Sipas prof. Rexhep Qoses: "… *Noli kurrë nuk është asimiluar edhe pse ka pasur të bëjë me shkrimtarët që me fuqinë e tyre shprehëse e rrezikojnë personalitetin më të fuqishëm të një përkthyesi. Sipas rastit ai ka ditur të tkurret e të bymehet emocionalisht, por gjithnjë ka mbetur Nol. Ai ishte si feniksi që rilind prej hirit të vet, ose si salamandër që jeton në flakën e ndjenjës së vet".* [912]

Përkthyes i Prometeut të mbërthyer të Eskilit apo Rubairave të Khajamit, ai ka kërkuar në to mesazhet për brezat e rinj, por si përkthyes i poezive të Sharl Bodlerit, Verlenit e Edgar Po-së ai bëhet dëshmues i ndjeshmërisë së tij moderne.

Mjaft interesante na paraqiten edhe studimet e kritikat e tij ku rigoroziteti i shkencëtarit shkrihet me imagjinatën e artistit. Në studimet për Skënderbeun e Bethovenin, kritikat për Khajamin, Shekspirin, Servantesin, sipas Çabejt "…*është përderdhur fryma komplekse e shkrimtarit. ...Revolucionarë e profetë, poetë e*

[911] R. Qosja, *Shkrimtarë dhe periudha,* Mësonjëtoreja, Tiranë, 2005, f. 250.

[912] Po aty, f. 251.

dashamirës aktivë të njerëzimit janë po aq mishërime të unë-s së tij, nëpër ta shprehet ai vetë". [913]

Poezia - kronikë e kohës

Odisejada jetësore e Nolit gjeti shprehjen e vet edhe në krijimtarinë e tij poetike. E para poezi e botuar prej tij më 1907, "*Fryn moj erë",* përshkohet nga toni emocional e romantik, fryma patriotike dhe çlirimtare. Edhe pse para Revolucionit të Qershorit ka shkruar ndonjë poezi, siç janë "*Tomsoni dhe kuçedra"*(1914) dhe "*Jepni për nënën"*(1917), fizionominë e vet si poet e ka treguar në poezitë e krijuara pas dështimit të këtij revolucioni.

Në shikim të parë, ato duken si kronikë në vargje e jetës së poetit dhe e ngjarjeve e rrethanave në të cilat u gjend ai, duke i përjetuar qoftë si pjesëmarrës aktiv, qoftë si dëshmitar i gjallë. Noli solli në letrat shqipe poezinë filozofiko-politike, në kuptimin e madh dhe të mirëfilltë të fjalës. Poet e njëkohësisht personazh legjendar i saj, ai krijoi një poezi politike të madhërishme si rrallëkush në letrat evropiane. [914] Duke shkruar me përvojën e një burri shteti që bën bilancin e një pune historike, të shkurtër por të rëndësishme, me mllefin e tij ironik dhe satirik, si artist i madh ai sulmon kundërshtarët politikë. Si rrallëkush në letërsinë tonë, ai ngre zërin e urrejtjes dhe të mallkimit mbi ta:

O Stërnip i Kainit, tepdil si bari,
Ti na shtyp e na shtrydh e ti gjakun na pi,
Ti na ther e na grin e për qejf na bën fli;
O kokuth e lubi: Hosana, Baraba! [915]
(Marshi i Barabbajt)

Glorifikues i rolit të vet por edhe i shokëve të luftës dhe të idealeve, ai e ka ngritur veten në rolin e një çlirimtari, duke u krahasuar me shembëlltyrën e shenjtë të Jezu Krishtit:

Hosanna o çlironjës, Mesi, hosanna!
Shtroni udhën me lule, dafin' e hurma,
Brohoritni trumbeta, timpane, zurna,
Thirr e zbras, o gurmas: Hosanna, hosanna! [916]
(Marshi i Krishtit)

Poezitë *"Marshi i Krishtit", "Marshi i kryqëzimit", "Kryqëzimi", "Marshi i Barabajt", "Krishti me kamzhikun", "Shën Pjetri në mangall"* dhe *"Kirenari"* si tekste thuajse të plota, janë marrë prej "*Pesë librave të Mojsiut"* dhe "*Dhiatës së Re"*, por ai i ka bërë këto poezi tregime të kohës dhe të situatës politike.

Disa konkluzione

Luftëtar i progresit demokratik të popullit, Noli u përpoq shumë për lirinë e mendimit dhe të fjalës. Me dëshirën që shqiptarët të hynin në radhën e popujve më të qytetëruar, ai luftoi deri në fund të jetës. Qysh nga lindja e tij (ai lindi në një ditë me

[913] E. Çabej, *Fan Noli ynë,* "Nëntori", n. 4, Tiranë, 1965, f. 21.
[914] I. Kadare, *Ardhja e Migjenit në letersinë shqipe,* Shtypshkronja "8 Nëntori", 1991, f. 89.
[915] F. Noli, *Albumi,* Rilindja, Prishtinë, 1968, f. 46.
[916] Po aty, f. 39.

Krishtin), bën *" identifikimin e parë moral e social, që do të bëhet esencë e veprimit dhe krijimit të tij gjatë gjithë jetës…*[917] Në arenën e historisë sonë, me daljen e tij u shënua një kualitet i ri në shoqëri, politikë, kulturë dhe moral. Noli u mor me politikë, por u demoralizua dhe e braktisi shpejt; u mor me histori dhe la vetëm një studim për Skënderbeun; shkroi poezi, por nuk la më shumë se njëzet krijime; u mor me kritikë dhe la pesë a gjashtë hyrje; u mor me muzikë dhe me studime muzikore, por nuk la më shumë se studimin për jetën e Bethovenit dhe disa kompozime të shkurtra.

"Rëndësinë më të madhe për kulturën shqiptare, Noli e ka si përkthyes"[918]dhe për letësinë shqipe si poet. Shqipërimet e tij të shkrimtarëve më të mëdhenj botërorë janë kryevepra krijuese, po aq të madhërishme sa origjinalet. Ndonëse shkroi relativisht pak letërsi të mirëfilltë, ai krijoi një gjuhë letrare moderne, një gjuhë që ende priste dhe kërkonte letërsinë e vet. "*Ai mund të konsiderohet si njëri nga stilistët më të mëdhenj në dialektin tosk, duke rreshtuar përkrah tij edhe Faik bej Konicën.* [919]

Pas tij, pas gjurmëve të tij, shkuan shumë intelektualë. E rëndësia e veprës së një shkrimtari shihet edhe prej asaj se sa ajo krijon vazhdues. Kjo na shtyn t'i kujtojmë edhe një herë fjalët e Çabejit të madh: "*Noli është një Ante i literaturës sonë, që i merr fuqitë prej mëmës tokë. Në fushën e kësaj literature, ai nuk është një fill bar, që sot bleron e nesër thahet, nuk është as lule, që sot shkëlqen e nesër vyshket. Ai na paraqitet si një lis i moçëm e plot gdhënj: lis i vetmuar, po me rrënjë ngulur mirë në të thellat e dheut".*

Shih "Contemporary Albanian Literature", 1989

[917] S. Hamiti, *Poetika shqipe,* Shtëpia botuese 55, Maj 2010, f. 440.

[918] Edhe studiuesit e huaj gjykojnë se Noli është më i rëndësishëm si përkthyes dhe politikan dhe më pak si poet. Shih: Gaetano Petrotta, *Popolo, lingua e la letteratura Albanese*, Palermo, 1931, f. 361-366; Si edhe: Stuart E. Mann, *Albanian literature,* Bernard Quariteh, LTD, London, 1955, f. 106-108.

[919] R. Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare,* Shtypshkronja "Dukagjini", Pejë, 2001, f. 278.

MAZLLUM BARALIU

ERUDITIZMI I FAN S. NOLIT, RRJEDHOJË E KUSHTEVE DHE RRETHANAVE TË KOHËS APO E GJENIALITETIT POLIEDRIK TË PERSONALITETIT TË TIJ

I. SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME PËRKITAZI ME ECURITË JETËPËRSHKRUESE DHE AKTIVITETET KRYESORE JETËSORE TË NOLIT

Bazuar në rrethanat shoqërore, kushtet dhe ecuritë e Rilindjes italiane dhe asaj gjithëevropiane, kur flitet e shkruhet për Rilindjen shqiptare, domosdoshmërisht duhet konstatuar e theksuar se kjo rilindje, fillon me Jeronim De Radën, fuqizohet me Sami Frashërin për të kulmuar dhe përfunduar njëkohësisht me Fan Stilian Nolin. Për të shkruar për Nolin, rrjedhimisht për të ndriçuar më shumë veprën e tij jetësore, do të duhej të punonin pa rreshtur dhe me vite e dekada të tëra, ekipe specialistësh e shkenctarësh të mirëfilltë, si dhe që të dy akademitë tona shqiptare. Themi kështu për arsye se eruditizmi dhe poliendrizmi i papërsëritshëm deri me tani i Fan Stilian Nolit, kërkon angazhim dhe përkushtim të thellë e të vazhdueshëm multidimensional dhe multibranshor të studiuesve të mirëfilltë, të fushave dhe projeksioneve ndër më të ndryshmet të dijes dhe shkencës, të artit dhe të kulturës, të retorikës e të diplomacisë, të elokencës e të kritikës letrare polemizuese, të stilit dhe të gjuhës; me një fjalë të shumësisë polivalente diturake, artistike dhe shkencore. Të gjitha këto do të duhej të ishin të ngërthyera në figurën dhe personalitetin poliendrik dhe enciklopedik, të gjeniut të letrave, të kulturës, të shkencës e të kombit shqiptar.

Fan Noli kishte fatin e rëndë, që të lindte, të jetonte e të zhvillohej (si njeri dhe si intelektual) në rrethana dhe kushte mjaft të vështira, komplekse dhe delikate-specifike. Ai u lind me 6. janar. 1882 në qytezë (turqisht: Ibrik Tepe), në një nga fshatrat shqiptare në Thraki, jo shumë larg nga Qyteti i Edrenes. Që në vegjëli Noli kishte vuajtur nga sëmundje të rënda prandaj shkollën e kishte filluar me vonesë. Ndonse thuhet e shkruhet aty këtu se nuk kishte pasur vullnet për shkollim dhe arsimim; fal gjenialitetit të tij, vetëdijës dhe intuitës për drejtësinë, njerëzinë, barazinë dhe kombëtarinë ai me shpejtësi dhe lehtësi të pazakonshme do të përmbush vakumet eventuale të vonesës dhe do të prijë e dallohet para bashkëmoshatarëve, duke befasuar dhe shembëllyer mbizotërueshëm edhe ndaj miqve-idhtarë edhe ndaj armiqve-kundërshtarë të tij. Shkollën fillore dhe të mesme Noli i kreu në gjuhën greke në Heybeliada, Stamboll. Ndonëse në shikim të parë shumë i qetë dhe i strukur, që në bankat e shkollës herëpashere manifestohen shkëndia dhe sekuenca serioze të karakterit të tij të pavarur; të integritetit të lartë dhe frymës së revoltës ndaj padrejtësive të shumta që bëheshin nga regjimet e kohës. Që nga viti 1900, kur Noli do të shkojë në Greqi për t'u shkolluar në Fakultetin e Filosofisë, për shkak të vështirësive dhe kushteve të rënda me të cilat ballafaqohet, ai nuk do të mund të

studiojë, po do të jetë i detyruar që për hir të mbijetesës dhe ekzistencës, të punojë punë nga më të ndryshmet; veçanërisht ato siç janë sufler, kopistator e një trupe shëtitëse greke etj. Mirëpo pikërisht për shkak të kushteve të pavolitshme dhe vështirësive me të cilat përballej në Greqi, me 1903 Noli do të emigrojë në Egjipt për të punuar si mësues i greqishtes. Ndërkohë në Egjipt Noli do të ndihej, punonte dhe bashkëvepronte me shumë bashkatdhetarë patriot, të cilët atje vepronin dhe punonin në të mirë të afirmimit, zhvillimit dhe të shtrirjes së levizjes kombëtare dhe të çështjes kombëtare shqiptare atje.

Në Egjipt ashtu sikur edhe më parë, Noli do të vazhdojë të shkruajë artikuj të rëndësishëm publicistikë dhe ta përkthej greqisht librin **"Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet" të Sami Frashërit**; libër ky që në të vërtetë ishte edhe një program politik relevant i rilindasve shqiptarë; atëherë dhe më vonë. Noli gjatë jetës së tij për kushtet dhe rrethanat në të cilat jetoi, relativisht të gjatë, lëvizi, përjetoi dhe pësoi shumë e shumë gjëra të dëshiruara e të padëshiruara, por edhe dha e kontriboi më shumë se shumëkush tjetër: **për atdhe, komb e fe;** për popullin shqipëtar dhe për botën mbarë.

Në harkun kohor në mes të viteve 1908-12, Noli do të shkojë në SHBA., për ti kryer studimet e larta në Universitetin e Harvardit, të cilat falë talentit, përkushtimit maksimal dhe sakrificës, do t'i përfundojë me sukses të dalluar-cum laude.

Pas shpalljes së Pavarësisë duke u gezuar shumë për arritjen e saj dhe duke përkrahur qeverinë e Vlorës, që **në vitin 1913 erdhi në Shqipëri**, për të parën herë në jetën e tij. Ai ndërkohë do të shkojë sërish në SHBA, do të kontribojë shumë në themelimin dhe afirmimin e Federatës panshqiptare "Vatra" në SHBA. Do të shkruajë dhe do të punojë ME PËRKUSHTIM të jashtëzakonshëm atje, për t'u kthyer pastaj në Shqipëri në fillim të viteve '20 në mënyrë që, të konsolidohej atje gjendja e rëndë e shkaktuar nga vuajtja dhe mjerimi, në të cilin partitë e ndryshme dhe krerët çifligarë e kishin katandisur popullin. Në atdhe Noli, do të jetë deputet i Këshillit kombëtar të Kongresit të Lushnjës, ku edhe do të mbrojë platformën e këtij kongresi. Në vitin 1924 Noli do të luajë një rol parësor të organizimit dhe drejtimit të Revolucionit Demokratik të qershorit. Pas ngadhnjimit të këtij revolucioni, ai do të jetë edhe kryetar i qeverisë shqiptare. Pas shkatërrimit të revolucionit nga reaksioni i brendshëm dhe ai i jashtëm i shtyrë dhe ndihmuar në mënyrë të veçantë nga qarqet hegjemone serbosllave dhe ruse, me 24 dhjetor 1924, Noli me qeverinë e tij dhe bashkëmendimtarët, do të emigrojë jashtë vendit, për të mos u kthyer në të, kurrë më gjatë jetës së tij.

Pas largimit nga vendi në vitin 1924, Noli në fazën fillestare të veprimtarisë së tij madhore dhe shumëdimensionale, krahas angazhimeve politike dhe patriotike me qëllim të stabilizimit të shtetit shqiptar; pavarësimit dhe stabilizimit të tij të plotë, do të zhvillojë edhe aktivitete të fuqishme krijuese; në fusha të ndryshme, por edhe në planin politik-kombëtar. Në këtë mënyrë ai do t'i denoncojë fuqimisht, godasë dhe në masë të konsiderueshme do t'i davarisë - me argumente dhe akribi gjeniale - veprimet jashtëzakonisht të dëmshme e me pasoja rrënuese, të reaksionit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar i cili pamëshirësisht po vepronte kundër afirmimit dhe konsolidimit të

kauzës kombëtare, të shtetit etnik shqiptar;të ardhmërisë perspektive dhe prosperuese të shqiptarëve.

Pas vitit 1930, Noli do të largohet nga Evropa për t'u vendosur përfundimisht në SHBA. Atje do të punojë ditë e natë për të mirën e Shqipërisë, trojeve të tjera etnike shqiptare, kauzën kombëtare dhe për fatet dhe ardhmërinë e kombit shqiptar. Në funksion të kësaj, ai do të punonte në fronte dhe sfera të shumta e të ndryshme. Dy janë shtyllat kryesore orientuese dhe vepruese - qendrore dhe strategjike të aktiviteteve dhe veprimtarisë së Nolit.

1. Afirmimi i çështjes kombëtare shqiptare
2. Afirmimi deri në pavarësim i Kishes Ortodokse Autoqefale Shqipetare.

Gjatë viteve 1961-1963 Noli do të botojë dy vjershat e tij të fundit maestrale-origjinale dhe disa shqipërime vjershash të poetëve me renome dhe famë botërore.

Nën peshën e rëndë dhe rrënuese të jetës, e si pasojë e goditjeve të pamëshirshme të fortunave të saj; të taboreve dhe tarafeve të pasinkronizuara nga ato të "provinciencës" bashibuzuke, injorante dhe retrograde e deri te ato forca të provinciencës tjeter - ekstreme e fine; çifligare-borgjeze-demokratike, pasi që do të shkojë për pushim në banesën e tij - në Fort Laurderdare të Floridas, i sëmurë dhe i raskapitur maksimalisht, do të ndërrojë jetë, me 13. Mars të vitit 1965, për të pushuar në amshim, shpirti i tij fisnik dhe mendja e tij gjeniale. **Ikona kombëtare shqiptare dhe kryetribuni ynë popullor-Noli i vegjëlisë, drejtësisë dhe i demokracisë shqiptare**, do të varroset në varrezat e Forrest Hillit në qytetin e Bostonit; larg atdheut dhe popullit të tij të shtrenjtë; të cilëve ua kishte kushtuar tërë jetën dhe të cilët i respektoi dhe i deshi përjetësisht; me një pasion të pashembulltë dhe me zjarr të pashuar.

Ajo që mund të quhej e veçantë, diverse, specifike dhe e jashtëzakonshme në jetën dhe veprimtarinë e Nolit të madh, nuk ishin vetëm kontradiktat, obskuranca, antagonizmat e shumtë; mobiliteti dhe diversiteti gjeografik i ambienteve në të cilat ai parakaloi e jetoi, por edhe vështirësitë, trajat dhe pengesat, nëper të cilat ai kaloi, si dhe tensionet dhe problemet, të cilat e përcollën atë, pothuajse gjatë gjithë jetës së tij;që pamdyshje mund të quhet jetë- sakrificë dhe jo më shumë dhe jo më ndryshe, sidomos nuk mund të quhet jetë cilësore dhe jetë lumturore.

Këto vështirësi dhe këto tensione Nolit iu manifestuan si në jetën e tij personale ashtu edhe në atë shoqërore. Ambienti shoqëror në të cilin Noli e kishte kaluar fëmijërinë e tij, ishte heteroetnik e ndërkufitar, ishte gjallërim midis botërash, gjuhësh, kulturash, e feshë të ndryshme. Me një fjalë ishte një ambient sa divers aq edhe prapanik dhe me kontradikta të shumta dhe prapambetje të theksuar.

Për më tepër Noli i ri-gjimnazist në një shkollë greke do të përballet me dy ide- deri në ideologji dhe orientime strategjike, krejtësisht të ndryshme, nga njëra- tjetra, si për nga përmbajtja ashtu edhe nga qëllimi. Me idenë grekomadhe-megalloidenë famëkeqe, që ishte edhe jo humane edhe hegjemone edhe e dëmshme - për jogreket, si dhe me idenë e Rilindjes Kombëtare shqiptare; që ishte ide sublime; idenë bazike e çlirimit dhe të pavarësimit të shqiptarëve dhe trojeve të tyre etnike nga pushtuesit shekullor-grabitqar-barbarë. **Me të dy këto ide bazë të kaheve dhe synimeve diverse, Noli ynë**

i madh ia doli, që të barabitet me sukses; duke e goditur seriozisht me argumente bindëse e fakte autentike dhe shkencore - të parën(megalli idenë) dhe duke e trazuar dhe afirmuar deri në qellimin final-të dytën ide madhore;idenë e e madhërishme dhe amshuese të lirisë e të pavarësisë së popullit dhe kombit të tij.

Të jashtëzakonshme në rrugën jetësore, politike, shkencore artistike dhe kombëtare të Nolit, nuk ishin vetem mjediset gjeografike, kushtet dhe rrethanat komplekse të ndryshme dhe të vështira jetësore, në të cilat ai për mëse 83 vjet zhvilloi veprimtarinë-krijimtarinë e tij. Nuk ishin as baticat dhe zbaticat tejet dramatike gjatë pothuaj gjithë jetës së tij vetmitare, përkushtuese e sakrifikuese, por siç do të thonte Fishta - për atme e fe, por ishin aktivitetet, puna këmbëngulse, devocioni dhe sakrifica e tij permanente dhe gjeniale; në shërbim dhe funksion të çështjes së lirisë e të pavarësisë, të tërësisë dhe të paprekshmërisë së tokave të atdheut të cënuar e të lënduar, të sovranitetit kombëtar; të luftës kundër imperializmit grabitqar dhe shovenizmit shtetomadh të fqinjëve në rajon dhe të tjerëve më larg; kundër obskurantizmit mesjetar vendor dhe fuqisë shtypëse e shfrytëzuese të tij, që ushtrohej në mënyrë të pamëshirshme ndaj vegjëlisë shqiptare. Të gjitha këto përkushtime e veprime Noli ynë i bëri, për dobi dhe interes të fesë ortodokse autoqefale shqiptare dhe besimeve të tjera popullore në trojet shqiptare, të cilat nuk vepronin në kundërshtim me interesat kombëtare shqiptare dhe kundër interesave popullore e në dobi të pushtuesve të huaj apo të qarqeve më reaksionare. **E beri palodhshmërisht dhe me emulacion e devocion permanent Noli, për hir të atdheut dhe kombit të tij**. Mirëpo jeta-jetë; me gjithë travajet e shumta, ngritjet dhe zbritjet e shpejta, veprimet dhe me pasojat e saj, Nolit - në rrugën e tijë titanike të gjellimit prometheik i fali në një masë a gamë të caktuar edhe kënaqësi (psh. kur u çlirua Shqipëria londineza në vitin 1945 nga pushtuesit e huaj) edhe madhështi, edhe suksese edhe shkëlqim edhe gëzim. Mirëpo, ajo nuk e kurseu as nga traumat, goditjet dhe tronditjet e mëdha, as nga kupa e helmit, siç do theksonte në shkrimet e tij një kronik i Nolit. Pikërisht ky densitet dhe intensitet jetësor variabil i karakterizuar dhe i përshkuar me shumë kontradikta, tensione, alternative e antagonizma; si në planin objektiv ashtu edhe në atë subjektiv, mund të identifikohen dhe shpjegohen-në shkallë të konsiderueshme vërtetësie edhe me veçorizimin e një rruge të veçantë dhe mbase të papërsëritshme;një rrugëtimi dhe rrefimi jetësor sui generis(të llojit të veçantë);të një stazë monopatike e cila ndoshta dhe mund të quhet: - "rrugë jetësore e Golgotës Noliane". Kështu ose përafërsisht me këtë model eksplikimi, do të mund të thuhej dhe konstatohej, veçmas për periudhat e caktuara të jetës së Nolit, në të cilat do të ndodhin kthesa të shpejta, të mëdha; rënie dhe pësime të konsiderueshme; siç ishte bie fjala, harku kohor i pas vitëve 1925 etj. Mirëpo si mund të ndodhë rëndom edhe në rastet më pësuese dhe më deprimuese, mund të lumëzojnë simptoma dhe procese edhe reaktive edhe pozitive. Kështu ndodhi psh. pas goditjes së Revolucionit Demokratik të qershorit të vitit 1924. Të paktën në një dimension relevant, në një fushë veprimi, siç ishte krijmtaria letrare, Noli gjatë kësaj periudhe do të krijojë vepra të rëndësishme, që do të shënojnë kulmet e sukseseve dhe të aritjeve të tij dhe të letersisë gjithëshqiptare. Pikërisht ashtu sikurse edhe të mendimit shoqëror panshqiptar.

Përkundër pranimit me korrektësi dhe vetëdije të disfatës, lidhur me Revolucionin e vitit 1924, kur ndër të tjera Noli me dorën e tij, do të shkruante edhe sintagmën vijuese**: "kemi vrarë veten me dorën tonë",** ai pra dhe bashkëmendimtarët e tij, do të gjejnë forcë, energji dhe aleatë të vegjelisë, për të trazuar më tej rrugën dhe për ta arritur, siç thoshte ai çastin e : "**dasmës së madhe"-** për të siguruar fitoren e siç thoshte ai**: " të voglit mbi viganin dhe të shtypurit mbi tiranin".** [i]
Ishte kjo koha kur Noli me tërë forcën e intelektit të tij, luftonte kunder relikeve të shoqërisë së vjetër, që sipas tij, ishte kalbur e brejtur nga kontradiktat e saja të brendshme dhe si e tillë ishte denuar, që të shëmbej e rrënohej, në mënyrë që mbi rrënojat e saj të ndërtohej një shoqëri e re, shoqëri e së ardhmes; një shoqëri demokratike e barazisë, harmonisë dhe e ardhmërisë të së gjithëve pa dallim.

1. Rrethanat dhe kushtet në të cilat lindi u formua si personalitet, veproi dhe kulmoi Fan S. Noli

Kushtet dhe rrethanat në të cilat u lind e u rrit dhe veproi Fan Noli në trojet etnike shqiptare, ishin sa të rënda e të vështira aq edhe specifike, sinergjike dhe shtytëse-bulzuese. Që në vendlindjen e tij, Noli ra në kontakt dhe u mishërua fuqimisht me ide jashtëzakonisht të rëndësishme iluministe dhe rilindëse, për sa i përket ngritjes së vetëdijes dhe ndërgjegjes së tij kombëtare; si në Thraki, po ashtu edhe në Egjipt, Evropë dhe Amerikë. Gjatë qëndrimit në këto vende, Noli do bjerë në kontakt dhe do të inspirohet katërcipërisht me idetë më përparimtare dhe më të zjarrta kombëtare të bashkëkohanikëve të tij. Nga këto ide, mendime, punë dhe aktivitete, ai do të ndikohet, motivohet dhe mbruhet, me shkrime dhe veprime përparimtare në dobi të lirisë dhe pavarësisë së vendit, ashtu sikurse edhe të demokratizimit të tij.
Me të drejtë shkrimtari Dalan Shpallo në vrojtimet e tij mbi jetën dhe veprën e Nolit ndër të tjera do të theksojë: " **Fan Nolin e lindi shpirti i shqetësuar i Shqipërisë, në një periudhë të rëndësishme të historisë së saj**. Ai u identifikua dhe u mbrujt me mendimin popullor e revolucionar, me fjalën e gjallë[2], joshëse dhe bindëse të tribunit të vërtetë, me veprime dhe bëma energjike, permanente dhe sinergjike, të një atdhetari dhe luftëtari të paepur për pavarësinë kombëtare dhe lulëzimin e atdheut të tij-Shqipërisë.
Pra Fan Noli si poet e si shkrimtar, si publicist e si orator brilant, si historian e si muzicient i veçantë;si kritik e si polemist i patejkalueshëm;si personalitet i rrallë e i madh kombëtarisht i dedikuar dhe si demokrat, por edhe sakrifikues për kauzën e ka lidhur vetën pashkëputshmërisht me atdheun e me popullin, me historinë e kulturës e të letërsisë kombëtare; veçanërisht e ka lidhur jetën, fatin dhe qenien e tij me aspiratat dhe interesat e kombit, të fesë e të popullit të vetë, në funksion të së ardhmes.
Ai punoi ditë e natë dhe sakrifikoi jetën e tij për njerezit e atdheut të tij.
Me po aq devocion ai luftoi, krijoi e punoi edhe për njerëzit e tjerë në përgjithësi. Pra ai nuk ishte vetëm iluminist i dedikuar nacional, por ishte edhe personalitet i mirëfilltë dhe i kompletuar me vullnet të çeliktë për punë e për përparim, me vlera e me potencë

të jashtzakonshme dhe jashtëserike universale. Pra ai ishte përsonalitet i veçorive dhe vlerave më humane dhe më sublime universal e sakrale.
Nga ana tjetër, në kushtet dhe rrethanat që në kohen e tij ekzistonin edhe për popullin e vet dhe për njerezit e tij, Noli nuk shkroi gjithëherë me plotë dashuri, por edhe me dhembje të madhe (shih. Dritero Agolli, op. cit. -ndër bashkëkohësit., fq. 238.).
Puna e pandërprerë përkushtuese dhe e madhe e Nolit dhe lufta e tij përherë progresive dhe konseguente, në rrethanat dhe kushtet ekzistuese të kohës, si dhe vepra e tij, sa kolosale aq edhe shumëdimensionale - në lëmin e shkencave e të arteve, nga ana tjetër, ia siguruan Nolit tonë të madh, pavdeksinë dhe vendin, në ballin e plejadës së rilindësve tanë.

2. Shumëdimensionaliteti i punës, krijimtarisë-veprimtarisë dhe i vepres së Nolit, rezultat i energjisë ekzemplare sinergjike, guximit, përkushtimit, sakrificës dhe diturive poliendrike – eruditizmit të tij

Ecuria jetësore dhe shumëdimensionaliteti eruditik e enciklopedik i veprës dhe krijimtarisë së Nolit, pasqyrohet në kompleksitetin, ndërduarsinë dhe ndërlikueshmërinë e rrethanave dhe kushteve jetësore, të lëvizjeve dhe shpërnguljeve të tij emigruese, por edhe me përkushtimin, punën e madhe dhe sakrificën, që ai bëri gjatë gjithë jetës së tij për të mirën e atdheut, të popullit të vet, me një fjalë për të tjerët, duke mos bërë asgjë për veten e tij e duke flijuar tërë egon dhe qenien e tij psikofizike; gjithnjë e në vazhdimësi për të mirën dhe lirinë e Atdheut; të popullit të tij. Që në rini të hershme, duke përjetuar mbi supet dhe egon e tij peshën e robërisë; duke qenë dëshmitar i padrejtësive të mëdha sociale, politike e historike, që i bëheshin në vazhdimësi atij dhe popullit të tij, veçanërisht në trojet e lashta shqiptare të Thrakisë, Noli do të piqet dhe vetëdijësohet shumë kohë, para kohe dhe do të fillojë të veprojë e kundërshtojë fuqishëm, padrejtësitë e kohës, pra të regjimit shtypës, që i bëheshin atij dhe popullit të tij historik dhe autokton.

Nën ndikimin pozitiv të familjes, të afërmve dhe bashkatdhetarëve të tij, të formuar drejtësisht dhe kombëtarisht të ngritur, ai që në rininë e tij të hershme, do të lexojë shumë, dhe do të pajiset me njohuri të rëndësishme e dituri të avancuara, që kishin të bënin me historinë dhe vërtetësinë e tabanit kombëtar, trajatave, peripecive dhe tragjedive historike, që populli shqiptar kishte përjetuar nën thundrën e pushtuesve të ndryshëm, dhe të monarkive ose regjimeve hegjemoniste - absolutiste, siç ishin ndër të tjera Perandoria Osmane dhe megalli ideja greke – fanaristët e stambollit, etj. Pikërisht nën ndikimin e veprimtarëve të dalluar dhe të devotshëm të Rilindjes Kombëtare, siç ishin ata të kolonisë shqiptare të Egjiptit fillimisht, të familjes dhe bashkatdhetarëve të tij të qytezës Ibrik Tepe, por edhe të veprimtarëve të tjerë në kolonitë e dalluara e të konsoliduara shqiptare të kohës; me entuziazmin dhe emulacionin mbinjerëzor të një të riu ambicioz e të përkushtuar katërcipërisht, Noli do t'i përvishet punës shumëfrontëshe dhe luftës gjithëjetësore të tij, parësisht për të mirën e atdheut dhe të kombit të tij.

Në këtë funksion dhe për këtë qëllim, që në vitin 1906 Noli do të shkojë në Amerikë, ku përkundër vështirësive të jashtëzakonshme, me të cilat do të përballet dhe realitetit të imagjinuar të cilin Noli do ta shijonte dhe do ta quante edhe "të fëlliqur", ai do t'i rreket punës titanike, tejet të vështirë dhe gati të paimagjinueshme, të përafrimit të grupeve të ndryshme të shqiptarëve të emigruar në Amerikë, si dhe të konsolidimit të situatës organizative por edhe vetëdijësuese të tyre atje. Përçarjet e mëdha në mes të formacioneve dhe grupacioneve të ndryshme dhe të shumta të emigrantëve shqiptarë në SHBA, gjatë rrjedhave të kohës ishin shkaktuar si pasojë e veprimit të politikës jashtëzakonisht aktive dhe tejet të rrezikshme shoveniste grekomadhe. Kjo politikë shovene bizantiniste – greke, inspirohej, dirigjohej dhe ushtrohej në mënyrë të veçantë dhe parësisht nga Patrikana fanarite e Stambollit, përmes emisarëve të saj radikalë kishtar greko- ortodoks. Qëllim kryesor i kësaj politike ishte davaritja organizative dhe funksionale e substancës kombëtare shqiptare dhe kishtare, të grupacioneve të ndryshme emigrante shqiptare në Amerikë dhe gjetiu. Ilaçi më i mirë sipas preokupimeve, ideve dhe bindjeve të Nolit, për të penguar influencën tejet rrënimtare greko – kishtare ndërshqiptarë, ishte meshërimi shqip dhe mëvetësimi gradual dhe i plotë i kishës shqiptare ortodokse në Amerikë dhe në trojet shqiptare gjithandej. Pikërisht më 1906, shoqëria "Malli i mëmëdheut", kërkoi kishë me meshë në gjuhën shqipe dhe me prift shqiptar të lindur. Noli në fakt ishte inspirator i kësaj kërkese dhe realizator i mëvonshëm i saj. Me shumë vështirësi, përjetime dhe peripeci, në shkurt të vitit 1919, Noli do të kurorëzohet ipeshkv i kishës shqiptare, ndërkaq më 26 korrik të po këtij viti, Noli dhe shqiptarët e tjerë të mërgatës, do t'ia dalin që përmes komisionit episkopal ta shpallin pavarësinë e kishës me ipeshkv të parë autoqefal – Fan S. Nolin. Me këtë fakt dhe akt, veprimtaria shumëvjeçare e Fan S. Nolit, në njërën nga frontet më të rëndësishme të jetës së tij, krijimi i kishës autoqefale shqiptare dhe meshërimi i saj shqip, ishte kurorëzuar me sukses duke i vënë ndër të tjera në vend, edhe porositë dhe aspiratat e të madhit Papa Kristo Negovani dhe shumë veprimtarëve të tjerë të kishës shqiptare, që gjatë gjithë jetës ia kishin kushtuar aktivitetet e tyre pikërisht kësaj çështjeje, madje disa nga ta edhe duke u masakruar e helmuar nga shovenistët e megalli idesë greke. Jo rastësisht në enciklopedinë e madhe greke, emri dhe veprimtaria e Fan Nolit do të përshkruhen ndër të tjera edhe me këto fjalë: "Fan Noli konsiderohet një nga fytyrat politike më të fuqishme të Shqipërisë, megjithëse ortodoks dhe nga mëmë greke, ai u tregua një urrejtës kundrejt helenëve dhe të dështuarit e çështjes greke në Epirin e veriut, i detyrohet edhe intrigave të tij vetjake. Qe mendja që udhëhoqi dhe që i dha shpirt idesë shqiptare dhe boshti kryesor për botën e jashtme, për hir të kulturës që zotëronte, të shumë gjuhëve që dinte, dhe të marrëdhënieve të tij fletorare"[i].

Fan Noli në të vërtetë dhe në realitet, nuk ishte anti-grek dhe as ksenofobist, ai ishte vetëm një personalitet i devotshëm, një intelektual dhe një veprimtar gjenial i popullit të tij, i cili i kishte kuptuar më së miri dhe në mënyrën më të spikatur të mundshme qëllimet dhe aspiratat jashtëzakonisht të rrezikshme dhe morbide të reprezentëve kishtarë e pushtetarë grek, inspiruesve dhe zbatuesve të megalli idesë, zbatimi i së

cilës në fakt do të nënkuptonte gllabërimin e mëtejmë të tokave shqiptare dhe të zhdukjes së civilizimit shqiptar nga faqja e dheut.

Me sigurimin e autoqefalisë së kishës ortodokse shqiptare, Noli me bashkëmendimtarë dhe bashkëveprimtarë të tij ia shkurtoi "ymrin" dhe këmbët lakmisë territoriale greke. Argumentet e shumta dhe autentike që ai dinte dhe kishte aftësinë brilante oratorike dhe shkencore për t'i shprehur dhe elaboruar, si të gjalla dhe të pamohueshme i paraqiti dhe mbrojti me sukses të jashtëzakonshëm në lidhjen e Kombeve, me fjalën e tij brilante, në të cilën, mrekullisht shkrihej argumentimi kulmor i një shkencëtari të mirëfilltë; toni pushtues i oratorit, shprehja vizulluese e poetit e diplomatit, si dhe gjërësia e thellësia diturore e enciklopedistit, e manifestuar përmes një anglishteje të përsorur. Noli në këtë mënyrë dhe me këtë rast, në mënyrën më elokuente, intelegjente dhe argumentuese, pikërisht në Selinë e Lidhjes së Kombeve, para përfaqësuesve të pothuajse të gjitha vendeve të botës, arriti të qërojë hesapet me hegjemonët grekë, pretendues të tokave shqiptare, veçanërisht të rrethit të Korçës. Bashkë me Faik Konicën, njërin prej bashkëveprimtarëve dhe bashkëkombasve më kompetent, po ashtu gjenial e poliendrik siç ishte edhe Noli, dhe me bashkëveprimtarë të tjerë, më 1912, themeloi federatën panshqiptare "Vatra", në të cilën u shkrinë shoqëritë e deriatëhershme: "Flamuri I Krujës", "Shoqnia kombëtare", "Besa-besën", dhe "Dallëndyshja". Në një aktivitet tjetër të veçantë, Noli në vitin 1912, së bashku me Konicën, do të shkojnë në konferencën e Ambasadorëve në Londër, njëri si përfaqësues i kishës ortodokse shqiptare të Amerikës, e i dyti – Konica, si i dërguari i "Vatrës". Në harkun kohor 1912-1915, Noli do të udhëtojë nëpër kolonitë e ndryshme shqiptare, në Sofje, Bukuresht e gjetiu, për të organizuar biseda, kontakte dhe për të trajtuar çështje të rëndësishme parësisht për fatet e kombit, me patriotët shqiptar atje. Më 1913 do të marrë pjesë në Kongresin e Trieshtes, ndërsa më 1918, do të jetë përfaqësues në konferencën e paqes në Paris; më 1920, edhe delegat në Lidhjen e Kombeve, me ç'rast Shqipëria falënderuar edhe angazhimit të tij të veçantë dhe gjenial, arriti të pranohet anëtare e saj. Për të zhvilluar dhe forcuar ndjenjën kombëtare dhe të përkatësisë shqiptare, për ta forcuar dhe përparuar vendin dhe për ta pavarësuar definitivisht atë, në vitet e '20-ta, Noli do të udhëtojë fillimisht në Shqipëri, e pastaj do të zhvillojë aktivitete të jashtëzakonshme për nga rëndësia atje. Në fund të vitit 1921, do të emërohet ministër i Punëve të Jashtme në qeverinë e Xhafer Ypit; më 1923, do të zgjidhet deputet i Korçës, ndërsa më 17 Qershor të vitit 1924, si pasojë e pakënaqësive të mëdha dhe kryengritjes kundër qeverisë së regjimit të atëhershëm retrograd, Noli do të formojë qeverinë e tij të parë demokratike në Shqipëri, në ballë të së cilës do të qëndrojë deri më 24. 12. 1924. Përkundër kritikave të llojllojshme dhe shpeshherë të paargumentuara kundër kësaj qeverie dhe Nolit si udhëheqës të saj, kjo është periudha më e ndriçuar e demokracisë shqiptare të kohës, duke shënuar njëherazi edhe fillet e saj, dhe është periudha më pozitive për zhvillimin e ideve demokratike e revolucionare të popullit të asaj kohe. Ky revolucion demokratik i Nolit me shokë, në fakt ishte lëvizje e mirëfilltë për drejtësi sociale, për jetë më të mirë, për barazi dhe për perspektivë gjithëkombëtare. Përkundër kësaj rëndësie të kohëzgjatjes së qeverisë së tij, për më tepër, Noli shprehet realisht dhe me

vetëkritikë për punën dhe qeverisjen e tij. Ai, lidhur me këtë thotë: "unë ngjalla zemërimin e aristokracisë së tokës, duke mos mundur t'i nxjerr jashtë ata, unë humba mbështetjen e masave fshatare. Kolegët e qeverisë si dhe pjesa më e madhe e oficerëve të ushtrisë, ose ishin armiq, ose në rastin më të mirë ishin indiferent ndaj këtyre reformave, megjithëse ishin deklaruar në favor të tyre më parë. Zoti Sotir Peci, Regjenti, i kundërshtoi ato me forcë dhe haptazi. Z. Eyres mundi t'i bindë të gjithë rrotull meje se reformat agrare, ishin një novacion i rrezikshëm Bolshevik. [i]"

Krahas veprimtarisë së tij shumëdimensionale fetare dhe atdhetare, Noli do të japë maksimumin e potencialit të tij intelektual dhe shkencor në fushën e dijes. Janë dy veprat e papërsëritshme të tij në radhë të parë, "Historia e Skenderbeut" dhe "Bethoveni e revolucioni francez", që i kanë siguruar autorit të tyre vend të merituar në altarin e shkencës shqiptare dhe gjithëbotërore.
Nolit i takon merita e jashtëzakonshme dhe e pazëvendësueshme që me veprën "Historia e Skenderbeut", jo vetëm që arriti ta zbardhë, argumentojë dhe fuqizojë piadestalisht veprën e Skenderbeut tek bashkatdhetarët e tij, e gjithandej, por edhe për faktin që me fuqinë e punës kolosale, argumenteve dhe akribisë shkencore – objektivitetit, arriti që ta zbardhë krejtësisht njërën nga periudhat më të lavdishme dhe të ndritshme të historisë së popullit shqiptar.
Meritë tjetër e veçantë dhe specifike e cila i takon Nolit lidhur me këtë, qëndron në faktin se duke hulumtuar në labirintet më të errëta të mundit shkencor, ai ia arriti ta zhveshë historinë e Skenderbeut dhe të popullit shqiptar të asaj kohe, nga legjendat dhe mitet të cilat herë – herë, në gamë të caktuar e kishin kapluar atë gjatë historisë së deri tanishme. Derisa "Historia e Skenderbeut" do të mund të konsiderohet si kryevepra e tij shkencore, "Bethoveni e revolucioni francez" sigurisht është një tjetër e arritur kulminante shkencore e Nolit, në një fushë tjetër tepër atraktive dhe interesante jo vetëm për lexuesin shqiptar e cila, pa mëdyshje ia ngriti namin dhe famën autorit tonë në nivel botëror. Kritikat pozitive dhe objektive shkencore të autorëve dhe dijetarëve më të njohur të kohës lidhur me këtë vepër që i bëhen Nolit, më së miri e vërtetojnë këtë konstatim. Se studimi i Nolit mbi Bethovenin është njëra nga krijimet më të arrira, pjellë e një shkencëtari të mirëfilltë, të artistit dhe eruditit të provuar, të përmasave botërore dhe se mbetet si më e mira dhe më e plota vepër dedikuar Bethovenit, e dëshmojnë katërcipërisht edhe mendimet dhe kritikat jashtëzakonisht objektive, tejet kompetente dhe pozitive në letra të Bernard Shout, të Tomas Manit, të Gllushqeviqit e të ndonjë tjetri.

Fan Noli do të manifestojë në mënyrë të pakontestueshme, gjeniale dhe poliendrike talentin e tij edhe në fushën e artit poetik, kritik, dramaturgjik dhe përgjithësisht letrar e publicistik. Krijimet e tij në këtë domen, veçorizohen me një forcë të jashtëzakonshme e të rrallë artistike, figurative, edukative dhe porosi-dhënëse. Cilado nga krijimet e tij poetike, qofshin të zhanrit satirik, elegjik, simbolik apo apologjetik, shënojnë, një vlerë jashtëzakonisht sublime dhe maksimale, duke u karakterizuar me semantikë dhe përmbajtje specifike, me ton dhe ngjyrë po ashtu

specifike. Të gjitha këto veçori dhe përmbajtje, ofrojnë një dëshmi vlerash të mirëfillta, sa laryshore, aq edhe të thella- në gamën horizontale dhe vertikale; një shprehje sa të re, aq të fuqishme poetike dhe artistike, të papërseritshme në nënqiellin letrar shqiptar.

II. KONTRIBUTI I FAN S. NOLIT SI ORATOR, KRIJUES LETRAR, PËRKTHYES DHE PUBLICIST, FETAR, SHKENCËTAR, POLIGLOT DHE POLEMIST

1. Kontributi i Nolit si orator

Fjala "oratori", rrjedh nga termi latin që do të thotë, oro, orare – në shqip tregoj, flas, fjaloj; oratio, orationis – bisedë; orator, oratoris – gojëtar; oratoria – oratoriae – gojëtari, gojëtare. Në greqisht fjala oratori do të thotë retorikë, që nënkupton aftësinë e përdorimit të mençur të të folurit ose të shkruarit me qëllim kryesor për të bindur ose për të kënaqur dikënd.

Oratoria si art i të folurit të bukur dhe kuptimplotë, ka historinë e vet që nga lashtësia antike ilire, greke, romake dhe arabe. Platoni p. sh., për oratorinë thoshte se: "është mënyrë e qeverisjes së mendjes së njerëzve". Ndërkaq Jan Zamioski p. sh., shton se: "gojëtaria nuk është asgjë tjetër përveçse arsye e mveshur mirë dhe argumentet e vendosura me rend"[i].

Oratoria e Nolit është si duket rezultat i afiniteteve të tija të rralla e të veçanta natyrore; veçorive të tij po ashtu të veçanta ; natyrës dhe fuqisë së tij e të personalitetit të tij në njërën anë, por edhe rezultat i aftësive të tij të lindura dhe atyre të fituara përmes leximit dhe studimit të vazhdueshëm gjithëjetësor të tij, që i dha mundësi atij për të përthithur të arriturat diturake më të thella të dijetarëve të kohës. Ajo që është karakteristikë elementare e një oratori dhe parakusht i suksesit të tij, siç është formimi i tingujve, rregullat fonetike, fjalët e dekoruara, gjestikulacionet, rezonanca dhe disonanca tonike e gojëtaria e kombinuar, sigurisht që ishin veçori karakterizuese të gojëtarisë magnifike edhe të Nolit. Pikërisht kjo gojëtari kulminante, atraktive dhe e admiruar në vazhdimësi nga auditoriume të ndryshme me të cilat kudoqoftë dhe kurdoqoftë të jetë takuar apo përballur Noli, e karakterizonte atë, vihej në pah në fjalimet e tij të zjarrta meshtare, diplomatike, tribunale – në takime me idhtarët e tij dhe masat e gjëra popullore gjatë kohës që qëndronte në Shqipëri, por edhe në debatet e ndryshme shkencore e profesionale, si dhe në shkrimet e tij të fushave nga më të ndryshmet, me të cilat ai gjatë jetës së tij është marrë. Oratoria e Nolit do të jehojë me tërë fuqinë dhe intesitetin kulminant drejt auditorit të dedikuar, veçanërisht shqiptarëve në mërgatë, por edhe atyre në atdhe. Është e njohur ligjërata e tij e parë për nga efektet dhe emocionet e mbajtur në shoqërinë "Malli i mëmëdheut" 1906, ku Noli me mjeshtëri specifike dhe kulminante oratorike, evokoi traditat e bukura

kombëtare dhe shprehu besimin në të ardhmen e lirë e të lumtur të atdheut; ligjërata në Boston me rastin e themelimit të shoqërisë "Besa besën" (1907); pastaj ajo që mbajti për të evokuar Skenderbeun, si dhe figurën e Kristoforidhit, në mënyrë të veçantë e bën Nolin, që qysh atëherë të quhej në popull "Demosteni ynë". Kujtime të pashlyera ndër bashkëkohanikë të mërgatës jo vetëm në SHBA, por edhe në Rumani, Bullgari e gjetiu, do të linin fjalimet e Nolit përkitazi me denoncimin e xhonturqëve, veprimeve të tyre dhe të shovenistëve ballkanas. Të gjitha këto ai i bënte me qëllim për ta afirmuar, përkrahur dhe ekzaltuar madje lëvizjen kombëtare shqiptare në përgjithësi, ndërsa atë të malësorëve kryengritës kundër pushtuesve në veçanti.

Logjika e fortë e argumentimit, erudicioni i gjerë përmbajtësor dhe ai i shprehjes, predispozita e zjarrtë shpirtërore, patosi patriotik dhe mjeshtëria e shtjellimit të fjalës, të cilat i shquanin fjalimet e Nolit në këtë përiudhë, do të mbeten padyshim veçantitë më specifike dhe sublime e të përhershme të oratorisë së Nolit tonë[i].

Një tjetër ligjëratë e veçantë e cila do ta shquajë edhe më shumë Nolin si një zëdhënës të qarqeve më të përparuara demokratike shqiptare të kohës, të njohur si antifeudal e antiimperialist, është ligjërata e mbajtur në Durrës më 1914. Si përfaqësues i vegjëlisë shqiptare, Noli në këtë ligjëratë, në mënyrën më të bukur e të mirëfilltë oratorike, do të shprehë aspiratat e tij dhe të popullit të tij për një regjim demokratik. Optimizmi i tij i shprehur përmes sintagmës: "Anija jonë do të dalë në vendin që është nisur", me forcë dhe elokuencë të një oratori të dalluar, do ta bindë audiencën e tij për rëndësinë e përpjekjeve drejt demokracisë e lirisë, por edhe të kuptuarit e rreziqeve të cilat i kërcënoheshin popullit dhe kombit shqiptar në përgjithësi.

Etapa më e shënuar e oratorisë së Nolit, mbase ishte ajo e viteve 1921-1924, interval kohor ky kur ai u kthye në atdhe dhe qëndroi në ballë të lëvizjes demokratike. Krahas publicistikës dhe epistolarit të Nolit, oratoria e tij pa mëdyshje se ngërthen njërën nga vlerat më të mëdha të lëvizjes mendore përparimtare shqiptare të gjysmës së parë të shekullit tonë. Në shumë pika dhe gama përmbajtësore të saj, këto zhanre të krijimtarisë së tij, edhe sot e kësaj dite tingëllojnë dhe realisht janë aktuale, të pranueshme dhe të zbatueshme. Në to për më tepër janë shkrirë, shija poliedrike e artistit, me dijen e shkencëtarit, përkushtimin e atdhetarit, ndërgjegjen e plotë e të devotshme dhe amshuese të fetarit, e sidomos ndjenjën e zjarrtë të patriotit e demokratit revolucionar. [i]

2. Aktivitetet dhe veprimtaria e Nolit në fushën e religjionit

Afinitetet dhe respektin për religjionin, Noli i kishte fituar dhe ushtruar që në fëmijërinë e tij të hershme, në Thraki, duke e shoqëruar babain e tij në aktivitetet kishtare. Noli gjatë gjithë jetës së tij kishte respekt të paluhatur, jo vetëm për fenë

ortodokse, por edhe të njëjtin respekt dhe intensitet për të gjitha fetë dhe drejtimet e ndryshme fetare. Nuk fitohet përshtypja se Noli ishte i luhatur, skeptik, e aq më pak ateist apo kundër religjioneve. Përkundrazi, ai ishte një besimtar dhe shërbyes i devotshëm i bashkatdhetarëve të tij dhe perëndisë.

Mirëpo, angazhimet e Nolit në religjion dhe lidhur me të, ishin të orientuara në realizimin e qëllimit suprem të tij, bashkëveprimit, koordinimit, kohezionit dhe kompaktësisë së aktiviteteve fetare dhe kombëtare në dobi të lirisë, pavarësisë dhe prosperitetit kombëtar dhe fetar autoqefal bashkarisht. Ai godiste pa mëshirë çdo veprim apo efekt të cilitdo segment fetar apo sektar në kuadër të trungut kombëtar, i cili neglizhonte apo edhe për më keq dëmtonte interesit dhe perspektivën e kombit rrjedhimisht mbarësisë zhvillimore të tij. "Një nga mjerësitë e tjera të kombit shqiptar, thoshte ndër të tjera Noli, është se asnjë nga fetë e njohura të Shqipërisë nuk praktikohet në gjuhën kombëtare. Krerët e feve, thoshte ai, kanë qenë, jo vetëm armiq të popullit shqiptar, por edhe armiq me njeri-tjetrin, nën pikëvështrimin politik dhe kështu, bashkë me bekimin e ndryshimit fetar, na prunë dhe bekimin e ndryshimit politik dhe natyrisht u ndamë në 3 fera, por edhe në 3 anë politike armiqësore. Asnjë s'mundet ta mohojë sot, që fetë në Shqipëri, janë vegla politike dhe më shumë nga të gjitha, orthodoksia dhe myslymanizmi. Kur nisi lëvizja jonë kombëtare, kryetarët e saj e kuptuan fort mirë, se cili është shkaku i mjerimit tonë kombëtar… S'u mejtuan shumë gjersa ta gjenin. Fetë na prishnë? – thanë, t'i hedhim pra fetë dhe të leçitim për perëndi, Muhamet, Krisht, papë dhe patrik, Shqipërinë. Ashtu bënë dhe frenqtë në kryengritjen e tyre të madhe!! ! "[i]. Ai vazhdonte në këtë ritëm më tutje, duke konstatuar se: "fetë nuk janë të liga siç janë, po siç ua mësojnë shqiptarëve të farmakosura dhe të shtrembëruara, janë të rrezikshme për vdekje…. Mjerimi ynë s'ish aqë në ndryshimin fetar, sa nër krerët fetar të huaj dhe në meshtarët shqiptar që vepronin si vegla të tyre të verbër… Na duheshin e na duhen priftërinj e biskupë, si dhe hoxhallarë e myftinjë të vërtetë, jo vegla politike të huaj, por meshtarë prej çdo feje që ti kenë me të vërtetë frigë perëndisë dhe të përhapin me drejtësi e me zell urdhërimet e tij, dhe vetëm urdhërimet e tij"[i].

Për të konfirmuar orientimet dhe përcaktimet e Nolit të potencuara më sipër në këtë shkrim, vlen që të parafrazohet, një qëndrim tjetër autentik i tij lidhur me rëndësinë vendimtare që ka kauza kombëtare, gjithnjë organikisht e ndërlidhur dhe e kohezionuar me atë fetare, do të shprehet në një fjalim të tij, mbajtur para shqiptarëve të Amerikës, më 1911, ku ndër të tjera thotë: "Dyke shpresuar se tërë atdhetarët e vërtetë, do të na japin ndihmë për punën, aqë fetare sa edhe kombëtare, që nismë, u dërgoj urimet më të mira".

Kontributi i Nolit në afirmimin dhe pavarësimin e kishës shqiptare autoqefale, nuk është njëdimensional. Krahas vetëdijësimit kombëtar dhe fetar të mërgatës shqiptare në Amerikë, Noli bëri shërbime të jashtëzakonshme dhe të dobisë primare edhe të gjithë shqiptarëve të tjerë, veçanërisht literaturës epistolare, duke përkthyer e përpiluar dokumente e rregulla jashtëzakonisht të rëndësishme fetare, që nga dhiata e

vjetër. Përkthimet e tilla që në fakt edhe në këtë fushë ishin më tepër rikrijime dhe rishkrime (reecriture) sesa përkthime të rëndomta. Shërbimet e drejtpërdrejta kishtare të Nolit, kontaktet e përhershme dhe të vazhdueshme me qytetarët shqiptarë, si dhe përkthimet në shqip të dokumenteve relevante kishtare, ndikuan në mënyrë të pazëvendësueshme në edukimin kombëtar dhe fetar të tyre me dekada të tëra.

3. Noli si poet, dramaturg dhe përkthyes

Veprimtaria letrare e Nolit do të fillojë qysh në fillim të shekullit të 20-të. Më 1902, shkroi dramën "Israelitë dhe filistinë", kjo është e para vepër e Nolit, dhe një ndër dramat e para në gjuhën shqipe, tani që ajo mbeti e papërfunduar, pra mbeti si një "skelet drame" me subjekt nga Bibla, e me ide filozofike. Syzheu kryesor i kësaj drame ka të bëjë me besimin e kryeprotagonistit dhe figurës qëndrore të saj, izraelitit Samson, i cili për t'ia arritur qëllimit të tij, që është përmbushja e idealit dhe besimi i pathyeshëm në drejtësinë e idealit, është gati të bëjë dhe sakrifikojë çdo gjë. Mbase motivi kryesor i autorit në këtë dramë, ka qenë motivimi i njëjtë edhe i bashkatdhetarëve të tij, ose edhe më saktë, nxjerrja e një prijësi të mirëfilltë të popullit, nga populli, për ta nxjerrë njëherë e përgjithmonë atë nga robëria, zija dhe mjerimi shekullor i tij ndër pushtues. Noli ka shprehur dhe dëshmuar talentin e tij të jashtëzakonshëm dhe emblematik edhe në fushën e poetikës. Poezia e tij në pjesë të konsiderueshme të saj është refleksion i ngjarjeve, dramave dhe përjetimeve tragjike të popullit, por edhe të vet poetit si protagonist i kësaj drame shumë aktëshe të një periudhe të caktuar historike të popullit shqiptar. Secili zhanër poetik i Nolit, shënon një vlerë dhe një tonalitet kompleks e domethënës në poezinë e tij; është dëshmi e një shprehjeje të re, të veçantë e të fuqishme poetike, në krijimin artistik shqiptar. Pretendimet dhe përpjekjet e herëpashershme të individëve të caktuar për të minimizuar apo edhe mohuar rolin e Nolit dhe qenësinë(unë do thosha madhështinë) e tij si poet, janë të kota, ngaqë edhe pse në numër shkroi relativisht pak poezi të shkruara origjinale, ai zë vend nderi dhe respekti në altarin e letërsisë kombëtare, por edhe asaj botërore. Përndryshe është e njohur bamuria se sasia nuk përcakton vlerë dhe qëndrueshmëri kohore të vlerës artistike, por pikërisht cilësia e krijimeve artistike, është determinanca kryesore e jetëgjatësisë dhe aktualitetit të tyre.

4. Noli si shkencëtar dhe muzikant

Noli ka lënë gjurmë të thella edhe në shkencën shqiptare edhe në atë gjithëbotërore. Më parë në këtë shkrim e kemi përmendur rëndësinë e krijimtarisë shkencore të Nolit, jo vetëm në fushën e artit dhe të letërsisë, por edhe në atë të historisë dhe të muzikës. Mirëpo, vështruar nga aspekti shkencor, "Historia e Skenderbeut" the "Bethoveni dhe revolucioni francez" janë dy veprat kryesore emblematike shkencore të Nolit. Ato u analizuan dhe u vlerësuan gjithanshmërisht, por edhe pozitivisht nga savanët e kohës, të fushave përkatëse. Ata nuk ishin të nivelit lokal e provincial, por mendjet më të ndritura e më të avancuara të shkencës, në suaza

të fushave përkatëse. Këta dijetarë dhanë vlerësimet më të larta dhe konsideratat më autentike për krijimet shkencore të Nolit, veçanërisht të dy veprave të sipërpërmendura. Pra në këtë drejtim – Noli i bëri nder jo vetëm shkencës shqiptare, por edhe asaj europiane e botërore. Se Noli ishte i përkushtuar, ndër të tjera, edhe për muzikën dhe hulumtimet shkencore në të, më së miri dëshmon fakti që në moshën e tij 52 vjeçare, do të studiojë dhe përfundojë Konservatorin e New England në Amerikë. Përveç studimit të mirënjohur për Bethovenin, më 1936 ai do të botojë një përmbledhje këngësh fetare me titull "Hymnore", të cilat edhe do t'i adaptojë për kor të përzier. Edhe në fushën e muzikës, ai do ta dëshmojë përkushtimin e tij për ta afirmuar dhe afruar sa më afër dhe më thellë në zemrën e shqiptarëve figurën legjendare të Skenderbeut – heroit tonë kombëtar.

Në funksion të kësaj, ai do të kompozojë edhe një "Rapsodi të Skenderbeut" përmbajtja dhe vlerat artistike të së cilës nuk janë të njohura.

5. Noli si përkthyes dhe publicist

Fan Stilian Noli me bazë, të drejtë dhe arsye edhe sot e kësaj dite konsiderohet si përkthyesi ynë më i mirë i veprave të njohura botërore. Ndonëse ishte shkolluar në gjuhë të tjera, falë talentit dhe afinitetit të tij gjenial, ai ia arriti që ta studiojë e lartësojë shqipen dhe të mësojë e studiojë gjuhë të tjera të shumta botërore. Noli ishte ndër poliglotët tanë më të spikatur dhe më dobisjellës;si për diplomacinë ashtu edhe për letersinë dhe artin shqiptar. Ai studioi e mësoi shumë dhe në vazhdimësi, jo vetem në rini por gjatë gjithë jetës së tij. Studioi dhe shkroi pandërprerë. Këto studime bënë që Noli të arrinte në majat e njohurive dhe diturive të artit letrar, për të na siguruar ne pasardhësve të tij përkthimet më të mira, maestrale, më të ëmbla dhe më autentike në historinë e kulturës dhe të gjuhës sonë; madje mbase edhe më të mira, më të kuptueshme dhe mbamendëse, sesa vetë krijimet e autorëve nga të cilët u përkthyen këto vepra. Një vështrim sado syprinor, qoftë ai i përkthimeve të Nolit, ofron mundësinë e konkludimit për një punë të jashtëzakonshme, të veçantë dhe ekzemplare të tij, duke dëshmuar një kulturë të gjërë e të thellë letrare të Nolit, pikërisht ashtu sikurse mund të konkludohet edhe për shijen dhe ndjeshmërinë e tij të hollë artistike. Ai ishte shumë i kujdesshëm në përkthim, por edhe në përzgjedhjen e veprave që përktheu. Falë këtij fakti notor, Noli zgjodhi një pjesë më të mirë të ajkës së letërsisë së bukur botërore. Është me rëndësi të përmendet edhe një fakt tjetër relevant përsa i përket përkthimeve. Gjatë përzgjedhjes dhe përkthimeve të veprave dhe autorëve të elitës botërore të letërsisë, Noli kishte kujdes maksimal në përzgjedhjen e shprehjes të fjalës të përshtatshme në gjuhën shqipe, duke ruajtur kurdoherë natyrën dhe frymën e saj, e duke zbatuar dinamizmin dhe eufoninë përkatëse. Gjatë përkthimeve të tij, Noli asnjëherë nuk ka zbehur apo zvetënuar forcën dhe as zvogëluar bukurinë estetike dhe kuptimore të tekstit origjinal. Përkundrazi, ai ia ka arritur, në mënyrë të pakrahasueshme që të ruajë harmoninë kuptimore dhe estetiko-artistike, dinamizmin dhe eufoninë e teksteve në të dy gjuhët, por në të njejtën kohë edhe të krijojë apo rikrijojë ndoshta diçka edhe më specifike dhe më autentike në gjuhën shqipe-

përkthimin e një teksti të caktuar letrar. Jo rastësisht lidhur me këtë, p. sh. për Rubairat e Omer Kajamit, njërën nga xhevahirët e artit letrar të orientit, thuhet se më mirë tingëllon, kuptohet dhe pranohet në gjuhën shqipe, sesa në origjinal. Pikërisht për këtë, disa nga njohësit më të mirë të letërsisë në fjalë dhe në ndërkohë siç ishte p. sh. Jokli dhe të tjerë, kanë theksuar se përkthimi i Rubairave të Kajamit nga Noli, përveç Fitzxheraldit, padyshim që paraqet përkthimin apo rikrijimin më të mirë të mundshëm dhe të dorës së parë[i].

Disa vepra që i përktheu Noli, i përcolli me parathënie - "introdukta". Këto introdukta kanë vlerë dhe nivel të shënuar artistik dhe semantik. Me to Noli numërohet ndër të parët lëvrues të kësaj gjinie të eseistikës dhe kritikës letrare te ne, duke përhapur në këtë mënyrë dhe zgjeruar pikëpamje adekuate dhe vlera ideore e artistike të veprave që përkthente ai.

Duke përfunduar lidhur me këtë fushë të veprimtarisë së Nolit, pamëdyshje mund të konstatohet se shqipërimet artistike të Nolit, zënë një vend shumë të rëndësishëm në veprimtarinë letrare të tij. Këto përkthime që me të drejtë do të duhej të cilësoheshin si shqipërime rikrijuese artistike, paraqesin një kontribut të jashtëzakonshëm dhe të çmuar të Nolit në historinë e kulturës dhe të gjuhës sonë.

6. Noli si poliglot dhe polemist

Përveç që ishtë një studiues dhe njohës avangard i gjuhës amtare, Noli zotëronte një fjalor dhe frazeologji të jashtëzakonshme të gjerë dhe të pasur të thesarit të shqipes, por në të njëjtën kohë zotëronte edhe një gamë të gjerë gjuhësh të huaja klasike e moderne, duke filluar nga greqishtja, latinishtja, frengjishtja, spanjishtja, gjermanishtja, anglishtja, turqishtja etj.

Pikërisht kjo shumësi poliglotike i ka dhënë rast dhe mundësi Nolit që edhe më tepër të shprehë fuqinë krijuese dhe gjenialitetin intelektual të tij, në fusha të shumta dhe të ndryshme të dijes, të shkencës e të artit. Me të drejtë është theksuar se talenti i jashtëzakonshëm i Nolit për të studiuar dhe njohur parësisht gjuhën e vet amtare pa u shkolluar e arsimuar në të, dhe gjuhët e tjera me shpejtësi e lehtësi të jashtëzakonshme, ia ka mundësuar atij që falë gjenialitetit të lindur, të krijojë vepra shkencore dhe letrare por edhe më shumë ti përkthejë dhe shqipërojë ato nga pjesët më të mira të thesarit të letërsisë botërore. Njohja e shumë gjuhëve, i ka mundësuar Nolit edhe avancimin e shprehjes së tij më të lirë dhe më komunikuese me botën e artit e të shkencës, por edhe shkelqimin e tij në tribunëri, diplomaci, oratori dhe politikë. Një gamë e rëndësishme e fushëveprimtarisë së Nolit, paraqet sigurisht edhe krijimtaria e tij dhe komunikimi me bashkëkohanikët, veçanërisht me kundërshtarët e tij.

Janë të njohura polemikat e Nolit me të madhin Faik Konica, Arshi Pipën, Zogun etj.

III. VLERËSIMET E BASHKËKOHANIKËVE - IDHTARË DHE KUNDËRSHTARË TË NOLIT PËR TE

Si idhtarët, bashkëmendimtarët dhe pasuesit e Nolit, ashtu edhe kundërshtarët e tij në masë të konsiderueshme, ia pranojnë vlerat, aftësitë dhe madhështitë e veçanta dhe të jashtëzakonshme erudite dhe gjeniale të Nolit. Ata të cilët e njohën më së miri dhe bashkëpunuan e bashkëjetuan me të, e vlerësuan atë realisht, megjithatë dhe parësisht si njeri; po të veçantë, po të talentuar, po fisnik dhe mendjendritur, por edhe individ me veçori dhe mani të caktuara, me huqe dhe teke, por të cilat i karakterizojnë vetëm njerëzit e mëdhenj. Për këtë ka qenë i vetëdijshëm edhe vet Noli dhe përkundër të gjitha goditjeve, ngarkesave, minimizimeve dhe zhvlerësimeve që mund t'iu bëhet njerëzve të mëdhenj, apo huqeve që ata realisht dhe objektivisht i kanë, ai me të drejtë në përfundim të veprës së tij të madhe "Bethoveni dhe revolucioni freng", përfundon me fjalët: "asgjë nuk mund t'i dëmtojë perënditë" (GOETTERN SHCADET NICHTS).

Por të kthehemi tek vlerësimet e atyre që më së miri e njohën dhe e respektuan:

- "Noli ishte apostulli i dytë i shqiptarëve mbas Shën Palit" (hirësia e tij Artur Liolin)
- "Titan i letërsisë shqipe" (Loni Prifti nga Arlingtoni)
- "Njeri i të gjitha kohëve… njeri që të magjeps… orator brilant – Churchilli i Shqipërisë" (Anthony Athanas)
- "Biri më i zgjedhur i nënës Shqipëri" (Gary Riska)
- "Fan Noli është njeri i madh" (Dhimitri Nikolla, botues i gazetës "Liria")
- "Fan Noli nuk është një madhësi efemere. Fjala e tij nuk është nga ato që i merr era. Me këtë Shqipëri, mëmë e lashtë burrash të shquar, të cilën ai e deshi me të gjitha fijet e zemrës, ai mbetet i gjallë ndër ne, si sot, si në ditët që do të vijnë" (Eqrem Çabej për Nolin)
- "Noli ishte i lidhur gjatë gjithë jetës së tij me popullin e vet, me njerëzit e vegjëlisë, me punëtorët e katundarët, të cilëve ua njohu vuajtjet dhe i thirri në luftë dhe u admiroi fitoret, militon midis nesh; është i yni; pikërisht i këtij populli (…) ashtu siç e pat ëndërruar dikur Noli, të ardhmen e këtij kombi me rrënjë të lashta dhe gjithmonë i ri" (Alex Buda)
- "Noli ishte një "Mojsi" modern. Ndonëse nuk e ndoqi dot popullin e vet në "tokën e premtuar", megjithatë "Mojsiu" i Qershorit ushtroi një ndikim të fuqishëm në mendjet dhe zemrat e shqiptarëve, duke qenë një pikë referimi e përhershme dhe një udhëheqës shpirtëror i njohur përgjithësisht i qarqeve përparimtare në gjithë botën shqiptare" (Rexhep Qosja)
- "Noli ishte elokuent (orator) në mbrojtjen e çështjes shqiptare"

Përkundër vlerësimeve maksimale pozitive dhe afirmative të pjesës dërrmuese të studiuesve të Nolit dhe veprës së tij, padyshim si rëndom në jetë, për njerëzit e mëdhenj dhe të veçantë, gjithmonë gjendet një numër i të tjerëve që vlerësojnë ndryshe, respektivisht kundërshtojnë dhe kritikojnë çdo gjë për asgjë, me arsye e pa arsye bindëse. Njëri nga kundërshtarët më ekzemplar i personalitetit të Nolit dhe veprimtarisë së tij, padyshim është edhe Lazër Shantoja, i cili ndonëse Nolit nuk mund t'ia mohojë eruditizmin e tij në të gjitha fushat që ai shkroi dhe veproi, megjithatë, atë e konsideron si "aventurier politik" dhe si njeri që "mori në qafë Shqipërinë dhe popullin shqiptar". Duke iu drejtuar Nolit në vitin 1924, Shantoja shkruan si në vijim: "qesh, o pagan, o peshkop i pa shkop, o fetar i pafe, o imzot i paZot, o nacionalist internacionalist, o toskë gegofob, o shqiptar Bolshevik… Pse ti, o vigan i penës u fsheh këtë herë nën pseudonimin e një studenti xhuxhmaxhuxh. Del në fushë, sikur dole tash vonë, para aeropagut të internacionales së Moskovës, për me predikue ungjillin e komunizmës tanë hiperortodokse… A don me ta përsëritë edhe ma rrumbullak? Utopia e jote – dhe fjala utopi është shprehja më e butë për gafat e tua të pakualifikueshme, e mori në qafë Shqipninë, o Fan Nol! ... Sa për malcortë, mos i nxen me gojë aspak, se nuk je i denjë. Një copë e vogël e lëkurës së tynë me zdrale, është shumë ma e vlefshme se te tanë tolla (qerosa) e jote e lagur me ujë kolonjet… Ndenje 6 muaj në Tiranë, o kryeministër ideal… i Shqipnisë, e nuk begenise me shkue makare një herë të vetme deri në Lezhë të shifshe ata malësorë që të dhimsen aq fort, ata malësorë që luftoshin për Shqipni, kur t'i luaje si palaço ndër theatro e kabaretë…"[i].

III. PËRFUNDIM

Përkundër asaj që është thënë dhe është bërë gjer më tani për Fan Nolin dhe veprën e tij, është evidente dhe notore se ende është thënë, është analizuar e studiuar pak. Vepra madhore e Nolit e cila në vete ngërthen mbi 40 vepra të zhanreve dhe përmbajtjeve nga më të ndryshmet, sigurisht që ka nevojë për studime edhe më të thukta e më të thella ekipesh të shkencëtarëve dhe ekspertëve, sidomos të institucioneve relevante të fushave në të cilat ai shkroi dhe na la një vepër kapitale, me vlerë për të gjitha kohërat.

Është e pakontestueshme se Noli ishte artist, patriot, shkencëtar, letrar, politikan, kritik, muziktar, historian, dramaturg, publicist dhe përkthyes i majave më të larta. Ishte vigan i rezistencës, demokracisë dhe kulturës shqiptare, ishte tribun i vegjëlisë dhe një intelektual i kalibrit sipëror, i cili tërë jetën e tij ia kushtoi atdheut, mëvetësimit, lirisë dhe pavarësisë së tij. Ishte krijues dhe lëvrues enciklopedik, ishte njeri i mendjes së ndritur dhe dijes gjithëdimensionale – erudite dhe kapitale.

Duke iu përgjigjur pyetjes së shtruar në mënyrë specifike në titullin e këtij punimi, se a thua kushtet dhe rrethanat mikro dhe makro shoqërore ishin ato të cilat e

krijuan dhe e madhështuan personalitetin erudit, gjenial dhe poliendrik të Nolit dhe veprën e tij madhore e të përjetshme, apo ishte gjenialiteti i tij i lindur dhe krijues, kryefaktori dhe kryeindikatori përcaktues i këtij eruditizmi të personalitetit sa kompleks, aq edhe enciklopedik të Nolit tonë të madh, përgjigja është jo dilematike. Edhe njëra edhe tjetra komponentë ndikuan në formimin dhe rrezatimin e përjetshëm të personalitetit krijues e gjenial dhe veprës së Nolit në kulturën, historinë dhe qenësinë e kombit shqiptar.

Prandaj, Noli me të drejtë e përmbyll veprën e tij madhore për Bethovenin dhe revolucionin francez me togfjalëshin, "Perënditë, askush nuk mund t'i dëmtoj". Ndërkaq ne konsiderojmë se përkundër të gjitha përpjekjeve, bëmat, veprën dhe madhështinë amshuese vlerore dhe kontributin, ashtu sikurse edhe figurën e ndritur dhe të përjetshme të kolosëve, përkundër të gjitha tentimeve, askush nuk mund t'ia arrij që ta neglizhojë, minimizojë e as mohojë, ndërkaq personalitetin e tyre siç është ky ekzemplar i Nolit tonë vigan, ta dëmtojë.

BEGZAD BALIU

FAN STILIAN NOLI DHE SHEKULLI I PAVARËSISË

Në 100- vjetorin e madh të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, institucionet publike dhe joqeveritare kombëtare po e kujtojnë edhe 130- vjetorin e lindjes së Fan Stilian Nolit (1882-2012). Përvjetorët e tillë kombëtarë, të cilët më shumë se sa historikë janë bërë shenjtëri, na kthejnë kujtesën edhe në shumë periudha, ngjarje, personalitete dhe vepra të rëndësishme, të cilat në një mënyrë apo një tjetër i kanë prirë apo i kanë përcjellë zhvillimet historike të botës shqiptare. Fan Stilian Noli nuk është njëri nga ato personalitete të përlindjes shqiptare, si Jeronim de Rada, Naim Frashëri, Sami Frashëri, Abdyl Frashëri, Jani Vreto, Pashko Vasa, Hasan Prishtina etj., i cili me veprën e tij i ka prirë Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, e megjithatë me emrin dhe veprën e tij politike, fetare dhe kulturore, lidhet pandashëm shteti dhe ndërtimi i institucioneve të tij në jetën e popullit shqiptar. Kjo është arsyeja pse kujtimi i sotëm për përvjetorin e tij është njëkohësisht edhe kujtim për disa nga përbërësit më të rëndësishëm të qytetërimit modern shqiptar, të cilët janë diskutuar dhe vazhdojnë të diskutohen edhe sot në shoqërinë shqiptare të shekullit XXI.

I.

Fan Stilian Noli ka lindur më 1882 në qytezën e Ibrik-Tepesë, një vendbanim në Perëndim të Turqisë së sotme, atëherë në kuadër të Perandorisë Osmane. Duke kaluar fëmijërinë dhe rininë e hershme në këtë vend, krahas ruajtjes së shenjtërisë shqiptare, ai ndërlidhi edhe dy përbërës kulturorë të kohës: qytetërimin Lindor, që vinte si vlerë edhe shtetërore në të cilin jetonte, si dhe fytyrën Perëndimore të qytetërimit shqiptar, në të cilin ishte orientuar përgjithësisht Rilindja Kombëtare Shqiptare. Krahas tyre, Noli ynë (siç shprehej Profesor Çabej) personalitetin e tij po e ndërtonte edhe nën veladonin e priftit ortodoks, në të cilin si askund tjetër bashkoheshin tiparet lindore dhe perëndimore të popullit shqiptar.

Në përvjetorin e sotëm të shpallje së Pavarësisë së Shqipërisë, prandaj kujtimi për të dhe për mënyrën se si ai filloi ta ndërtojë personalitetin e tij do të thotë njëkohësisht edhe kujtimi për trashëgiminë tonë kombëtare dhe mënyrën e ndërtimit të sfondit nacional të bardëve të shtetit të ardhshëm të shqiptarëve të asaj kohe.

II.

Fan Stilian Noli personalitetin rinor të tij e ndërtoi në Amerikë, me njërin prej brezave të parë të mërgatës shqiptare në atë kontinent. Atje, Noli ynë provoi dhe krijoi idenë për demokracinë si një prej vlerave më të çmueshme të një populli dhe sidomos të një shteti. Ndonëse biografinë fëmijërore dhe një pjesë të hershme të tij e kishte ndërtuar mbi një sistem feudal otoman dhe nën veladonin e despotizmit fetar bizantin,

prej të cilit madje nuk do të lirohet pothuajse asnjëherë, ai do ta përvetësojë pothuajse si asnjë shqiptar tjetër idenë për demokracinë, si vlera më e rëndësishme e sjelljes së një politikani, por edhe si shprehja më e lartë e artikulimit të ligjësisë së një shteti. Me këtë qëndrim ai dëshmoi se demokracia dhe artikulimi i saj më parë se sa qëndrim individual i një intelektuali është shprehje dhe atribut i politikanit dhe sistemit shtetëror. Në këtë vend, pas lutjeve shpirtërore dhe fetare për lirinë e Shqipërisë e të popullit shqiptar, ai bëri edhe lutjen e parë politike para një burrështeti amerikan, për të mbrojtur pavarësinë e Shqipërisë në Konferencën e Paqes. Në Amerikë ai do të realizojë edhe njërën prej ëndrrave më të rëndësishme të brezit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare: Autoqefalinë e Kishës Ortodokse Shqiptare.

A është kjo një nga arsyet e shumta pse përvjetori i shtetit shqiptar dhe i institucioneve të tij, aq shumë të shquara sot për mungesë të demokracisë, të bëhen objekt studimi dhe diskutimi mbi bazat paradigmatike të koncepteve noliane për demokracinë dhe të sistemit amerikan të demokracisë planetare, në fillim të shekullit XXI.

III.

Me emrin e Fan Stilian Nolit lidhen edhe disa nga ngjarjet më të rëndësishme të dekadës së dytë dhe të tretë të shekullit XX, si: Konferenca e Paqes, Asambleja Kombëtare, Qeveria e Hasan Prishtinës, Revolucioni i Qershorit dhe rënia e tij, autokracia shtetërore e Ahmet Zogut, monarkia e tij, shpërndarja e Komitetit të Mbrojtjes Kombëtare, eliminimi i personaliteteve kombëtare (Bajram Currit, Hasan Prishtinës, Luigj Gurakuqit etj.) që janë ngjarje, aktivitete dhe situata të ndërlidhura gjerësisht me emrin e Fan Nolit. Me emrin e tij edhe sot bashkohen shembulli i diskutimit intelektual dhe përdorimi shembullor i demokracisë së shprehjes në Asamblenë e djeshme shqiptare, me modelin e paqenë të gjuhës së dhunshme në Parlamentin e sotëm Shqiptar; me bëmat e Nolit (të njohura si Revolucioni i Qershorit dhe rënia e tij) reflekton ngushtë shembulli i përpjekjes së kalimit të vështirë nga despotizmi lindor në anarkinë perëndimore të shtetit dhe shoqërisë shqiptare; shembulli i krijimit të vështirë të udhëheqjes kolektive të shqiptarëve, si institucion shtetëror dhe si prirje e të menduarit demokratik; me largimin e Nolit në Perëndim (Europë dhe Amerikë), bashkohen të gjithë përbërësit më të errët të riorganizimit feudal të shtetit shqiptar: shpërndarja e organizatës së vetme që vazhdonte të mbronte çështjen shqiptare nën Jugosllavi (Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare), shpallja e monarkisë së varur (sa nga Jugosllavia po aq edhe nga Italia), eliminimi më tragjik i patriotëve të kohës, personalitetin e të cilëve Noli e ka mbindërtuar në poezinë e tij më të plotë se secila vepër e historisë së popullit shqiptar etj.

A është kjo arsye e mjaftueshme për të kujtuar sot bëmat e intelektualit dje dhe virtytet e intelektualit sot, guximin politik dhe pragmatik të intelektualit dje dhe guximin qytetar të intelektualit sot, prirjet largvajtëse të intelektualit dje dhe heshtjen e pakuptueshme të intelektualit sot, përbërësit e dhunshëm të sistemit dogmatik shtetëror dje dhe sistemit të korruptuar e të frikshëm në jetën tonë prej qytetarësh sot;

eliminimin fizik të intelektualit nga shteti i përqendruar në një dorë dje dhe përjashtimin e sotëm të intelektualit nga qarqet e nëntokës apo nga qarqet akademike sot, despotizmi i të cilave lëvizë mes mbetjeve neokomuniste dhe organizimit dogmatik e klanor.

IV.

Me emrin e Fan Stilian Nolit lidhen ngushtë edhe disa nga kthesat e mëdha të shtetit shqiptar, shoqërisë dhe kulturës shqiptare: dalja e Shqipërisë nga Lufta e Dytë Botërore dhe mbrojtja e integritetit të saj ndërkombëtar, qëndrimi i diasporës historike shqiptare dhe miti i intelektualit të postrlindjes kombëtare. Fan Stilian Noli do të shquhet për mbrojtjen e Lëvizjes Antifashiste Shqiptare, në një kohë kur intelektualë të shumtë oportunistë të diasporës shqiptare qëndronin indiferentë ndaj luftës së popullit shqiptar për mbrojtjen e vendit të okupuar; ai do të qëndrojë në anën e shtetit shqiptar, më parë se sa në anën e partive, grupeve dhe ideologjive të majta e të djathta, në kohën që më parë se sa partitë dhe ideologjitë ishte momenti të mbrohej ndërkombëtarisht në Europë dhe Amerikë, shteti, përkatësisht atdheu i tij; ai do të vazhdojë angazhimin e tij prej rilindësi edhe në Amerikë, madje edhe gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX, për tu bërë strumbullari i gjithë diasporës historike shqiptare në këtë vend: mes ortodoksësh, katolikësh e myslimanësh, mes emigrantësh shekullorë e emigrantësh të sapoardhur, mes institucionesh fetare, kulturore nacionale dhe shtetërore amerikane etj.; ai do të jetë shembulli i përfaqësimit të intelektualit të denjët shqiptar në diasporë: jo si dorë e zgjatur e grupeve dhe misioneve të huaja kundër vendit të tij, po si një misionar i denjë: përfaqësues në qeveri e institucione shtetërore, fetare e kulturore të tyre.

Nuk mund të thuhet ndërkaq se shteti, institucionet dhe shoqëria shqiptare e kishte nxënë mjaftueshëm përvojën dhe veprën e Fan Nolit. Shteti shqiptar, qeveria dhe shoqëria shqiptare, e cila pas Luftës së Dytë Botërore e shquante me mburrje dhe krenari Revolucionin antifeudal të Qershorit, pikërisht në kundërshtim me veçoritë dhe përvojën e Nolit gati sa e çoi vendin në luftë qytetare; qeveritarët shqiptarë, të cilët Nolin e mbanin për simbol revolucioni dhe fitoreje, pikërisht në kundërshtim me përvojën e tij prej intelektuali, përdhunuan në mënyrë të skajshme klasën intelektuale shqiptare të kohës. Në këtë rrjedhë, kishte vetëm një shenjë besimi se Fan Stilian Noli ishte edhe më tej simbol identiteti në jetën shqiptare: vlerësimi i veprës letrare të tij. Gjatë kësaj periudhe, më parë se sa veprat fetare me të cilat Noli ka shërbyer një jetë të tërë, më parë se sa dokumentet shtetërore me të cilat ai u përpoq të ndërtonte sistemin demokratik të shtetit shqiptar, në Shqipëri dhe më tej, në Kosovë, u botuan veprat letrare dhe historike të tij: *Historia e Skënderbeut* (monografia e parë kritike për jetën dhe veprën e Skënderbeut), *Albumi* (poezia e tij) dhe përkthimet monumentale të tij të veprave të *Shekspirit, Khajamit, Servantesit, Ibanjezit, Longfellout* etj.

V.

Me emrin e Fan Stilian Nolit, më parë se sa përpjekja për ndërtimin e shtetit shqiptar, të shoqërisë shqiptare dhe madje kur e kur edhe të kishës autoqefale

shqiptare, të cilat në periudha të caktuara janë heshtur apo censuruar në dimensionin e plotë të tyre, janë të lidhura shumëplanshëm kultura shqiptare: oratoria, gjuha, përkthimi, historiografia, mendimi kritik, poezia, letërkëmbimi, polemika etj.

Kush nuk e ka kujtuar Fan Nolin në letrat shqipe dhe nuk e ka theksuar oratorinë e tij sublime në Parlamentin shqiptar dhe në institucionet e tjera qeveritare e shtetërore, në konferencat dhe institucionet ndërkombëtare, ku përshkruheshin fatet e popujve të vegjël, në takimet diplomatike ndërkombëtare ku Noli shkëlqente pikërisht me oratorinë e tij, dhe më në fund në institucionin e Kishës Autoqefale Ortodokse Shqiptare ku mbante meshën e tij.

Kush nuk e ka kujtuar Fan Nolin në letrat shqipe të shekullit XX dhe krahas oratorisë nuk e ka theksuar gjuhën e pasur të tij, në të vërtetë leksikun e pasur të tij, leksikun popullor dhe leksikun libror, fjalësin e mësuar dhe neologjizmat e krijuara, semantikën e orientalizmave dhe sintaksën e shqipes, përbërësit e ndërkombëtarizmave dhe kuptimin e anglicizmave etj., të gjitha këto të lidhura ngushtë me oratorinë e tij, me polemikat e tij me Konicën dhe bashkëkohës të periudhës historike të tij, me diskutimet dhe polemikat në institucionet shtetërore shqiptare e ndërkombëtare, si dhe doemos me poezinë e tij.

Kush nuk e ka vlerësuar jetën dhe veprën e Skënderbeut dhe nuk e ka konsultuar e diskutuar monografinë e Fan Stilian Nolit për Skënderbeun, e cila më parë se sa për sintezën e shkëlqyeshme të tij, më parë se sa për bibliografinë e pasur dhe të detajuar ndërkombëtare të tij, do të shquhet për natyrën kritike, për modelin dhe metodologjinë, për gjedhen dhe përzgjedhjen e diskutimit të temave të mëdha dhe të vështira historike dhe sidomos për përmasën e përgjegjësisë së diskutimit të monumenteve historike kombëtare, të cilat më parë se sa personalitet, paraqesin mitin dhe kultin e paprekshëm të një kombi, vetë kujtesën historike të tij, referencën identitare (*...neve na quajnë epirotas...*) dhe shtetërore (*Arbëria na kujton...*) të tij.

Kush ka shkruar qoftë edhe sintezën më të vogël të historisë së letërsisë shqipe gjatë shekullit XX dhe nuk e ka përfshirë krijimtarinë letrare të Nolit, e cila është shquar për shumësinë letrare e përmbajtësore të saj. Sado e vogël të quhet vepra e tij poetike për nga vëllimi, Noli ynë e ka pasuruar poezinë e tij më shumë se sa asnjë krijues i brezit të tij, me përbërës historikë e bashkëkohorë: Skënderbeu, Bajram Curri, Luigj Gurakuqi, Koloneli Tomson; qytetërues: Skënderbeu; etnitar: flamuri; dhe mitikë e biblikë: portreti i tij dhe i kundërshtarëve të tij. Prandaj, sado të veçantë dhe modern të quhen bashkëkohësit e tij (Migjeni, Lasgush Poradeci, Ernest Koliqi etj.), në historinë e letërsisë shqipe Fan Noli paraqitet më kompleks dhe më komplementar se secili prej tyre. Noli, madje ndryshe nga shumë bashkëkohës të tij, në historitë dhe antologjitë e letërsisë shqipe paraqitet jo vetëm me poezitë e tij origjinale, po edhe me poezitë, prozat dhe dramat e shqipëruara. Në përgjithësi kritika dhe madje filologjia shqiptare i ka shquar shqipërimet e tij për vlerat estetike të tyre, ndërsa unë këtu dua të shquaj konceptin e tij për lidhjet fundamentale të këtyre përkthimeve me qytetërimin Lindor e Perëndimor të misionit nolian. Në krijimtarinë letrare të tij, si pak kund tjetër,

bashkohen të gjitha virtytet e tij njerëzore, intelektuale, qytetare dhe krijuese e nacionale: gjuha e pasur, kultura e gjerë dhe e thellë, mendimi kritik, ironia e skajshme, pasuria e bëmave jetësore, forca e gjykimit dhe urtia e pushtetit, horizonti i demokracisë planetare dhe liria e shenjtë e refuzimit.

VI

Janë disa vite dhe mote të veçanta, të cilat na bëjnë të reflektojmë për të kaluarën dhe të caktojmë referencat historike, individuale e kolektive. Shekulli i pavarësisë dhe përvjetori i Nolit, sikur bashkohen për t'i rrëfyer njëri - tjetrit për bëmat, arritjet, gabimet dhe shqetësimet tona. Përvjetori i Nolit sot kërkon të përplotësojmë para kombëtarëve të sotëm Nolin shumëdimensional, çfarë ishte: postrilindas, burrështetas, autoqefalist i formuar sipas formatit Lindor, intelektual i referencave europiane, dhe pragmatist i bëmave mbi modelet amerikane. Populli shqiptar gjatë gjithë shekullit XX ka dhënë një numër të madh personalitetesh përmasash nga më të ndryshmet, por zor të gjesh një personalitet që më parë se sa njeriun përfaqëson institucionin e kombit, që më parë se sa historinë reflekton të ardhmen e tij. Ky është Noli ynë, Noli që pret të rikthehet i plotë në jetën tonë: institucion, sikur ishte! E kjo do të thotë, të kthehet Autoqefalia e Kishës Ortodokse Shqiptare, fjalësi i parlamentarizmit të vërtetë në institucionet tona shtetërore, sistemi i demokracisë europiane dhe pragmatizmit amerikan etj. Në të vërtetë, kjo do të thotë të diskutohet e kaluara jonë dhe të mos politizohen themelet e qytetërimit tonë! Pikërisht pse Noli ynë ishte njeriu që i zotëronte të gjitha këto, ai mbeti i yni edhe sot. Dhe pikërisht se këto përmasa largvajtëse populli ynë i ka trashëguar dhe i ka bërë referenca historike të tij, i ka mbijetuar shumë situata të vështira në rrugëtimin e tij historik, para të cilave popujt e tjerë, të vegjël si ne, janë shuar! Ne sot jemi këtu sepse kishim përpara një misionar si Noli, që nuk e ndiqte prapa Krishtin për ta takuar Hyjin, por i printe popullit të tij, për ta kryer misionin historik që i takonte!